

KOMENTAR

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

LIBRI II

Hartimi dhe botimi i këtij Komentari u mbështet nga Projekti për Sundimin e Ligjit, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara, (UNDP) misioni në Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, falë mbështetjes së Qeverisë së Holandës, nën koordinimin e:

Virgjina Dumnica, Analiste e Programit të Drejtësisë, UNDP Kosovë

Rrezearta Reka, Menaxhere e Projektit për Sundimin e Ligjit, UNDP Kosovë

Autorët:

Prof.Dr. Nerxhivane Dauti

Avokat Ruzhdi Berisha

Avokat Adem Vokshi

Prof.Dr. Abdulla Aliu

Sefadin Blakaj

Lektor:

Sabri Mehmeti

Të gjitha të drejtat rezervohen: UNDP nuk mban kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e këtij Komentari dhe korrektësinë, saktësinë apo cilësinë e të dhënave në këtë Komentari.

Te drejtat e autorit për pjesët e këtij Komentari dhe të drejtat e UNDP-së janë të rezervuara. Nuk lejohet kopijimi/dyfishimi i materialit apo shfrytëzimi i të njëjtit për publikime të tjera eventuale, pa pajtimin e UNDP-së dhe autorëve.

Shtator, 2013

Prishtinë

PARATHËNIE

Fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë është prioritet me rëndësi. Mbështetja për institucionet e Kosovës që të bëhen më efikase, transparente, me ndërgjegje gjinore dhe përgjegjëse, është çelësi i zhvillimit të Kosovës në të gjithë sektorët, qoftë në rritjen ekonomike, shëndetësi, arsimim, apo për funksionimin sa më të mirë të shërbimeve publike. Sundimi i ligjit dhe qasja në drejtësi janë gjithashtu kyç për përparimin e Kosovës drejtë integritimit evropian. Saktësisht, Procesi për stabilizim-asocim (PSA), kërkon gjykata dhe prokurori efikase, të pavarura, të përgjegjshme dhe të paanshme, të cilat janë plotësisht të pavarura nga politika.

Gjatë dhjetë viteve të kaluara UNDP-ja ka qenë partner i rëndësishëm i përpjekjeve të vazhdueshme për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë me një synim të përgjithshëm që të ndërtohet një sistem i pavarur dhe efikas i drejtësisë i cili do të mbrojë dhe promovojë standardet e të drejtave të njeriut dhe që do të siguroj qasje më të mirë ndaj drejtësisë për të gjithë qytetarët. Programi i Sundimit të ligjit i UNDP-së përqëndrohet në katër prioritete kryesore: trajtimi i trashëgimisë së konfliktit, përmirësimi i sigurimit njerëzor, ngritja e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ofrimi i sigurisë dhe qasjes në drejtësi për gruan.

Është i dukshëm progresi në sundimin e ligjit në Kosovë nga viti 1999. Mirëpo, edhe më tej janë të nevojshme mbështetja dhe përkushtimi i shtuar për të siguruar vazhdimin e arsimit dhe ngritjes së diturisë të kryesve të punëve në sektorin e drejtësisë dhe zbatimin e aktiviteteve të cilat e mbështesin qasjen ndaj drejtësisë për të gjitha komunitetet.

Duke marrë parasysh se sistemi i drejtësisë në Kosovë është relativisht i ri, të kuptuarit e gjerë të interpretimit të ligjeve ekzistuese apo të reja, është gjithashtu prioritet i rëndësishëm. Për këtë arsye, UNDP dhe Ministria e Drejtësisë kanë nënshkruar një marrëveshje partneriteti, e cila do të mbikëqyrë mbështetjen e UNDP-së për përpilimin dhe botimin e Ligjit dhe Komentarit të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore.

Komentarët janë mjeti bazë për profesionistët ligjor në shtetet demokratike dhe kjo pjesë e legjislacionit do të ndihmojë në masë të madhe komunitetin ligjor në Kosovë për të interpretuar dhe aplikuar dispozitat ligjore brenda legjislacionit, e sidomos do të jetë ndihmë për gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe profesionistët tjerë ligjor që kanë qasje të kufizuara ndaj standardeve ndërkombëtare dhe evropiane.

Komentari do të jetë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe.

Osnat Lubrani

Koordinatorë e OKB-së për zhvillim
Përfaqësuesë e përhershme e UNDP-së në Kosovë

KONTRIBUT I VEÇANTË

Të nderuar lexues,

Kam kënaqësinë që të prezentoj para jush komentarin për Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, komentare i parë për këtë ligj.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi janë ndërmarrë një sërë iniciativash dhe janë realizuar një numër i madh i aktiviteteve që kanë për qëllim të forcojnë zbatimin e rendit dhe ligjit në vend dhe forcimin e sistemit gjyqësor në përgjithësi. Në vazhden e këtyre reformave janë nxjerrë një numër i madh i ligjeve dhe në mesin e tyre, pas një procesi të gjatë pune, është miratuar edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ky, padyshim, është një ndër ligjet më të rëndësishme dhe më komplekse të sistemit tonë juridik.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të këtij ligji në praktikë është konsideruar e rëndësishme që të përgatitet Komentari mbi Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Komentari është rezultat i bashkëpunimit shumëvjeçarë në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP) ku kjo e fundit ka dhënë kontributin kryesorë në përgatitjen e komentarit në fjalë.

Ky Komentari ka një rëndësi të madhe sepse është Komentari i parë i cili bën interpretimin dhe komentimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ligj ky i cili është në fazat e para të zbatimit në praktikë. Komentari është hartuar nga ekspertë të shquar të fushës me përkushtimin më të lartë. Paraqet një konkretizim dhe interpretim të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Më konkretisht Komentari përmban interpretim të detajshëm të secilit nen, në mënyrë ilustrative dhe praktike, duke përfshirë detaje lidhur me përmbajtjen dhe kuptimin e nenit në fjalë, qëllimin, objektivat, objektin e rregullimit, palët që afektohen nga ai nen, format e ndryshme të interpretimit e aplikimit dhe detaje tjera relevante. Si i këtillë, Komentari ka për qëllim që të kontribuojë në implementim sa më efikas dhe korrekt të Ligjit, duke synuar kështu që të lehtësojë aplikimin e pjesëve të ndryshme të këtij Ligji. Komentari do të shërbejë të gjithë personave të kyqur në sistemin e drejtësisë duke përfshirë gjyqtarët, prokurorët, avokatët, arbitrat, noterët, shërbyesit civil, studentët dhe qytetarëve në përgjithësi. Komentari është i përgatitur në atë formë që të jetë i kuptueshëm dhe lehtë për tu përdorur nga të gjithë palët e interesuara.

Komentari është ndarë në dy pjesë: libri i parë i cili përmban interpretimin e dispozitave të përgjithshme mbi obligimet kontraktuale dhe detyrimore dhe libri i dytë që përmban interpretimin dhe komentimin e dispozitave që i'u referohen marrëdhënieve të veqanta të dispozitave kontraktuese.

Me publikimin e këtij Komentari, shpresojmë të kemi hapur një praktikë të re për sistemin tonë të drejtësisë, për të ndihmuar kështu komunitetin e juristëve dhe të tjerëve në zbatimin sa më efikas, të drejtë dhe të lehtë të ligjeve i cili është edhe prioriteti ynë. Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë të mbështesë iniciativat e tilla të cilat kontribuojnë në zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës dhe forcimit të rendit dhe ligjit në përgjithësi.

Me respekt,

Prof. Dr. Hajredin Kuçi
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë

PËRMBAJTJA

Parathënia.....	V
Kontribut i veçantë.....	VII

Prof.Dr. Nerxhivane Dauti

LIBRI 2

MARRËDHËNIET E VEÇANTA TË DETYRIMEVE KONTRAKTUESE

PJESA I - KONTRATA PËR SHITJEN	1
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	1
Neni 438. Nocioni	1
Neni 439. Rreziku	4
Neni 440. Kalimi i rrezikut në rast të vonesës së blerësit	5
KREU 2 - PJESËT PËRBËRËSE TË KONTRATËS SË SHITJES	6
NËNKREU 1 - OBJEKTI	6
Neni 441. Rregullat e përgjithshme	6
Neni 442. Kur sendi është shkatërruar para kontraktimit	8
Neni 443. Shitja e sendit të huaj	8
Neni 444. Shitja e së drejtës së kontestuar	9
NËNKREU 2 - ÇMIMI	10
Neni 445. Kur çmimi nuk është caktuar	10
Neni 446. Çmimi i caktuar	11
Neni 447. Kur është kontraktuar çmimi i ditës	12
Neni 448. Kur caktimi i çmimit i është besuar personit të tretë	13
Neni 449. Kur caktimi i çmimit i është lënë njëzë palë kontraktuese	13

Abdulla Aliu

KREU 3 - DETYRIMET E SHITËSIT	14
NËNKREU 1 - DORËZIMI I SENDIT	14
I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR DORËZIMIN	14
Neni 450. Koha dhe vendi i dorëzimit	14
Neni 451. Objekti i dorëzimit	16
Neni 452. Kur është kontraktuar dorëzimi brenda një periudhe të caktuar	17
Neni 453. Kur data e dorëzimit nuk është caktuar	17
Neni 454. Kur vendi i dorëzimit nuk është caktuar me kontratë	18
Neni 455. Dorëzimi transportuesit	19

Neni 456. Organizimi i transportit	20
Neni 457. Shpenzimet	20
II. DORËZIMI I NJËKOHSHËM I SENDIT DHE PAGIMI I ÇMIMIT	21
Neni 458. Shtyrja e dorëzimit deri sa të paguhet çmimi	21
Neni 459. Shtyrja e dorëzimit në rastin e transportit të sendit	22
Neni 460. Pengimi i dorëzimit të sendit të dërguar	24
NËNKREU 2 - PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT MATERIALE	26
I. TË METAT MATERIALE NË PËRGJITHËSI	26
Neni 461. Të metat materiale për të cilat shitësi përgjigjet	26
Neni 462. Kur ekzistojnë të metat materiale	27
Neni 463. Të metat, për të cilat shitësi nuk përgjigjet	29
Neni 464. Shikimi i sendit dhe të metat e dukshme	31
Neni 465. Të metat e fshehta	33
Neni 466. Afatet në rast riparimi, zëvendësimi, etj	35
Neni 467. Njoftimi për të metën	36
Neni 468. Rëndësia e faktit se shitësi ka qenë në dijeni për të metën	36
Neni 469. Kufizimi kontraktues ose përjashtimi i përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale	37
Neni 470. Përmbarimi i dhunshëm	39
II. TË DREJTAT E BLERËSIT	39
Neni 471. Të drejtat e blerësit	39
Neni 472. Mos përmbushja e kontratës brenda afatit të arsyeshëm	41
Neni 473. Kur blerësi mund ta zgjidhë kontratën	42
Neni 474. Mospërmbushja e kontratës në afatin plotësues	43
Neni 475. Të metat e pjesshme	44
Neni 476. Kur shitësi i ka dhënë blerësit sasi më të madhe	44
Neni 477. Caktimi i çmimit për disa sende	46
Neni 478. Humbja e të drejtës për zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave	47
Neni 479. Ruajtja e të drejtave të tjera	48
Neni 480. Efektet e zgjidhjes për shkak të të metave	48
Neni 481. Zbritja e çmimit	49
Neni 482. Zbulimi gradual i të metave	50
Neni 483. Humbja e të drejtave	50
III. GARANCIONI PËR FUNKSIONIMIN E RREGULLT TË SENDIT TË SHITUR ...	52
Neni 484. Përgjegjësia e shitësit dhe e prodhuesit	52
Neni 485. Kërkesa për riparim ose zëvendësim	54
Neni 486. Zgjatja e afatit të garancionit	56
Neni 487. Zgjidhja e kontratës dhe zbritja e çmimit	57

Neni 488. Shpenzimet dhe rreziku	58
Neni 489. Përgjegjësia e kooperuesve	59
Neni 490. Humbja e të drejtave	60
NËNKREU 3 - PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT JURIDIKE	60
Neni 491. Të metat juridike	60
Neni 492. Njoftimi i shitësit	63
Neni 493. Sanksionet për të metat juridike	64
Neni 494. Kur blerësi nuk e njofton shitësin	65
Neni 495. Kur e drejta e personit të tretë është haptazi e bazuar	66
Neni 496. Kufizimi kontraktues ose përjashtimi i përgjegjësisë së shitësit	68
Neni 497. Kufizimi i natyrës juridiko-publike	69
Neni 498. Humbja e të drejtave	70
 <i>Sefadin Blakaj</i>	
Neni 499. Koha dhe vendi i pagimit	72
Neni 500. Kamata në rast të shitjes me kredi	73
Neni 501. Pagimi i çmimit në rastin e dërgesave të njëpasnjëshme	74
NËNKREU 2 - MARRJA E SENDIT	75
Neni 502. Marrja e sendit	75
 KREU 5 - DETYRIMI I RUAJTJES SË SENDIT PËR LLOGARI TË BASHKËKONTRAKTUESIT	
Neni 503. Rastet e detyrimit të ruajtjes	76
Neni 504. Kur blerësi nuk dëshiron ta marrë sendin që i është dërguar	78
Neni 505. E drejta e palës së detyruar për ta ruajtur sendin	79
 KREU 6 - SHPËRBLIMI I DËMIT NË RAST TË ZGJIDHJES SË KONTRATËS	
Neni 506. Rregulla të përgjithshme	80
Neni 507. Kur sendi ka çmimin vijues	81
Neni 508. Kur shitja ose blerja është bërë për mbulesë	84
Neni 509. Shpërblimi i dëmit tjetër	86
 KREU 7 - RASTET E VECANTA TË KONTRATËS PËR SHITJE	
NËNKREU 1 - SHITJA ME TË DREJTËN E PARABLERJES	
Neni 510. Nocioni	87
Neni 511. Afatet për ushtrimin e së drejtës dhe për pagimin e çmimit	88
Neni 512. Mundësia e trashëgimit dhe të tjetërsimit	90
Neni 513. Në rastin e shitjes publike të detyrueshme	91
Neni 514. Kohëzgjatja e së drejtës së parablerje	92

Neni 515. Nëse është bërë bartja e pasurisë pa e njoftuar shitësin	93
Neni 516. E drejta ligjore e parablerjes	94
NËNKREU 2 - BLERJA ME PROVË	96
Neni 517. Nocioni	96
Neni 518. Prova objektive	97
Neni 519. Rreziku	99
Neni 520. Blerja pas kontrollimit përkatësisht me rezervimin e të provuarit	100
NËNKREU 3 - SHITJA SIPAS MOSTRËS OSE MODELIT	100
Neni 521. Shitja sipas mostrës ose modelit	100
NËNKREU 4 - SHITJA ME SPECIFIKIM	102
Neni 522. Shitja me specifikim	102
NËNKREU 5 - SHITJA ME KUSHTE	104
Neni 523. Kushtet	104
Neni 524. Rreziku	106
NËNKREU 6 - SHITJA ME KËSTE	106
Neni 525. Përkufizimi së shitjes me këste	106
Neni 526. Forma e kontratës	108
Neni 527. Pjesët esenciale të kontratës	109
Neni 528. Zgjidhja e kontratës dhe kërkesa për pagimin e plotë të çmimit	110
Neni 529. Pasojat e kontratës së anuluar	112
NËNKREU 7 - SHITJA ME ANE TE AKREDITIVIT	114
Neni 530. Detyrimet e palëve	114
NËNKREU 8 - URDHRI I SHITJES	119
Neni 531. Nocioni	119
Neni 532. Rreziku i shkatërrimit dhe i dëmtimit të sendit	120
Neni 533. Kur konsiderohet se urdhër marrësi e ka blerë sendin	121
 <i>Nerxhivane Dauti</i>	
Neni 534. Nocioni	123
Neni 535. Efektet e kontratës për këmbimin	125

PJESA III - KONTRATA PËR DHURATËN	126
KREU 1 - PËRKUFIZIM I PËRGJITHSHËM	126
Neni 536. Nocioni	126
Neni 537. Shpërblimi	130
Neni 538. Dhurata e përzier	131
Neni 539. Përbushja periodike	132
Neni 540. Përgjegjësia e dhuratëdhënësit për dëmin	133
KREU 2 - FORMA	134
Neni 541. Forma	134
KREU 3 - REVOKIMI I KONTRATES SE DHURATES	136
Neni 542. Revokimi për shkak të varfërimit	136
Neni 543. Revokimi për shkak të mosmirënjohjes së thellë	139
Neni 544. Revokimi për shkak të lindjes së pastajshme	141
Neni 545. Pasojat e revokimit	142
Neni 546. Afatet për revokimin	143
Neni 547. Heqja dorë nga revokimi	144
KREU 4 - DHURATA NË RAST TË VDEKJES	145
Neni 548. Dhurata në rast të vdekjes	145
PJESA IV - KONTRATA PËR DORËZIMIN DHE NDARJEN E PASURISË (KONTRATA E DORËZIMIT)	146
Neni 549. Përkufizimi	146
Neni 550. Kushtet për vlefshmërinë	147
Neni 551. Subjekti (Objekti) i dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë	150
Neni 552. Pozita e pasurisë së dorëzuar	151
Neni 553. Pajtimi i pasardhësve	152
Neni 554. Ruajtja e të drejtave gjatë dorëzimit	154
Neni 555. E drejta e bashkëshortit/es së dorëzuesit/es	156
Neni 556. Borxhet e dorëzuesit	157
Neni 557. Garancia	158
Neni 558. Revokimi i dorëzimit	159
Neni 559. Të drejtat e pasardhësve, fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar pas revokimit	161
PJESA V - KONTRATA PER MBAJTJEN E PERJETSHME	162
Neni 560. Përkufizimi	162

Neni 561. Forma	169
Neni 562. Ndalimi i përdorimit në favor të palës mbajtëse	170
Neni 563. Përgjegjësia për borxhet	171
Neni 564. Shkëputja e (Anulimi i) kontratës	172
Neni 565. Ndryshimi i rrethanave	176
Neni 566. Shkëputja e kontratës	177
PJESA VI - KONTRATA PËR HUANË	180
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	180
Neni 567. Nocioni	180
Neni 568. Kamata	182
KREU 2 - DETYRIMET E HUADHËNËSIT	184
Neni 569. Dorëzimi i sendeve të premtuara	187
Neni 570. Gjendja e keqe materiale e huamarrësit	570
Neni 571. Dëmi për shkak të të metave të sendeve të dhëna hua	187
KREU 3 - DETYRIMET E HUAMARRËSIT	188
Neni 572. Afati i kthimit të huas	188
Neni 573. Zgjedhja me rastin e kthimit të huas	190
Neni 574. Heqja dorë nga kontrata	191
Neni 575. Kthimi i huas para afatit	192
KREU 4 - HUAJA ME DESTINIM	193
Neni 576. Huaja me destinim	193
 <i>Adem Vokshi</i>	
PJESA VII - KONTRATA PER HUA PERDORJEN	195
KREU 1 - DISPOZITAT E PERGJITHSHME	195
Neni 577. Përkufizimi	195
KREU 2 - DETYRIMET E HUAPËRDORËMARRËSIT	196
Neni 578. Përdorimi i sendit	196
Neni 579. Mbajtja e sendit	197
Neni 580. Transferimi i përdorimit	198
Neni 581. Kthimi i sendit	198
Neni 582. Zgjidhja e kontratës	199
Neni 583. Përgjegjësia	200
KREU 3 - DETYRIMET E HUAPËRDORDHËNESIT	200
Neni 584. Dëmi nga të metat	200

PJESA VIII - KONRATA PËR QIRANË	202
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	202
Neni 585. Nocioni	202
KREU 2 - DETYRIMET E QIRADHËNËSIT	203
Neni 586. Dorëzimi i Sendit	203
Neni 587. Mirëmbajtja e sendeve	204
Neni 588. Zgjidhja e kontratës dhe zbritja e qirasë për shkak të riparimeve	205
Neni 589. Ndryshimet në sendin e marrë me qira	206
Neni 590. Përgjegjësia për të metat materiale	207
Neni 591. Të metat për të cilat qiradhënësi nuk përgjigjet	208
Neni 592. Zgjerimi i përgjegjësisë për të metat materiale	210
Neni 593. Përfundimi kontraktues ose kufizimi i përgjegjësisë	210
Neni 594. Njoftimi i qiradhënësit mbi të metat dhe rreziqet	211
Neni 595. Të drejtat e qiramarrësit kur sendi ka ndonjë të metë	212
Neni 596. Kur e meta paraqitet gjatë qirasë dhe kur sendi nuk ka veçori të kontraktuar ose të zakonshme	214
Neni 597. Përgjegjësia e qiradhënësit për të metat juridike	215
KREU 3 - DETYRIMET E QIRAMARRËSIT	216
Neni 598. Përdorimi i sendeve sipas kontratës	216
Neni 599. Denoncimi për shkak të përdorimit në kundërshtim me kontratën	218
Neni 600. Pagimi i qirasë	219
Neni 601. Denoncimi për shkak të mospagimit të qirasë	220
Neni 602. Kthimi i sendit të marrë me qira	221
Neni 603. Denoncimi për shkak të nënqirasë së palejueshme	223
Neni 604. Kërkesa e drejtpërdrejtë e qiradhënësit	224
Neni 605. Shuarja e nënqirasë në bazë të vetë ligjit	224
KREU 4 - TJETËRSIMI I SENDIT TË MARRË ME QIRA	224
Neni 606. Tjetërsimi pas dorëzimit me qira	224
Neni 607. E drejta e çmimit të qirasë	227
Neni 608. Tjetërsimi i sendit të marrë me qira para se t'i dorëzohet qiramarrësit	228
Neni 609. Denoncimi i kontratës për shkak të tjetërsimi të sendit	229
KREU 5 - SHUARJA E QIRASË	230
Neni 610. Kalimi i kohës së caktuar	230
Neni 611. Përtëritja heshtazi e qirasë	231
Neni 612. Denoncimi	232
Neni 613. Shkatërrimi i sendeve për shkak të forcës madhore	234
Neni 614. Vdekja	235

Nerxhivane Dauti

Neni 615. Kuptimi	236
Neni 616. Raporti me kontratën për shitjen	238
Neni 617. Cilësia e materialit të kryerësit	239
KREU 2 - MBIKËQYRJA	240
Neni 618 Mbikëqyrja	240
KREU 3 - LIDHJA E KONTRATËS ME ANË TË ANKANDIT	240
Neni 619. Ftesa për ankand mbi çmimin e punimeve	240
Neni 620. Ftesa për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të punëve të synuara ...	242
KREU 4 - DETYRIMET E KRYERËSIT	242
Neni 621. Te metat e materialit	242
Neni 622. Detyrimi për ta kryer veprën	243
Neni 623. Zgjidhja e kontratës për shkak të shmangies nga kushtet e kontraktuara	244
Neni 624. Zgjidhja e kontratës para kalimit të afatit	245
Neni 625. Besimi i kryerjes së punës personit të tretë	245
Neni 626. Përgjegjësia për bashkëpunëtorët	246
Neni 627. Kërkesa e drejtpërdrejtë e bashkëpunëtorëve të kryerësit ndaj porositësit	246
Neni 628. Dorëzimi i sendit të prodhuar porositësit	247
KREU 5 - PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT	247
Neni 629. Kontrollimi i veprës së kryer dhe njoftimi i kryerësit	247
Neni 630. Të metat e fshehura	249
Neni 631. Shuarja e së drejtës	249
Neni 632. Rastet kur kryerësi humb të drejtën të thirret në nenet paraprake	250
Neni 633. E drejta e kërkesës për mënjanimin e të metave	251
Neni 634. Zgjidhja e kontratës në rastin e veçantë	251
Neni 635. E drejta e porositësit në rastin e të metave të tjera të veprës së kryer	252
Neni 636. Zbritja e shpërblimit	253
KREU 6 - DETYRIMET E POROSITËSIT	253
Neni 637. Detyrimi i pranimit të punës	253
Neni 638. Caktimi dhe pagimi i shpërblimit	254
Neni 639. Llogaritja me garanci shprehimore	255
KREU 7 - RREZIKU	257
Neni 640. Kur kryerësi e ka dhënë materialin	257
Neni 641. Kur porositësi e ka dhënë materialin	258
Neni 642. Rreziku në rast të dorëzimit pjesë-pjesë	259
KREU 8 - E DREJTA E PENGUT	259
Neni 643. E drejta e pengut	259

KREU 9 - SHUARJA E KONTRATËS	260
Neni 644. Zgjidhja e kontratës me vullnetin e porositësit	260
PJESA X - KONTRATA PËR NDËRTIMIN	262
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	262
Neni 645. Nocioni	262
Neni 646. Objektet ndërtimore	263
Neni 647. Mbikëqyrja e punimeve dhe kontrolli i cilësisë së materialit	263
Neni 648. Shmangie nga projekti	263
Neni 649. Punimet urgjente të paparashikueshme	264
Neni 650. Çmimi i punimeve	265
Neni 651. Ndryshimi i çmimit	265
Neni 652. Dispozitat për pandryshueshmërinë e çmimeve	267
Neni 653. Zgjidhja e kontratës për shkak të rritjes së çmimit	268
Neni 654. E drejta e porositësit për të kërkuar zbritjen e çmimit të kontraktuar	268
KREU 2 - KONTRATA PËR NDËRTIMIN ME DISPOZITË TË VEÇANTË	269
Neni 655. Kontrata për ndërtimin me dispozitë të veçantë	269
KREU 3 - PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT	270
Neni 656. Zbatimi i rregullave të kontratës për veprën	270
Neni 657. Kalimi i të drejtave nga përgjegjësia për të metat	270
KREU 4 - PËRGJEGJËSIA E KRYERËSIT DHE E PROJEKTUESIT PËR SOLIDITETIN E GODINËS	271
Neni 658. Nga çka përbëhet	271
Neni 659. Detyra e njoftimit dhe humbja e të drejtave	272
Neni 660. Zvogëlimi dhe përjashtimi i përgjegjësisë	273
Neni 661. Regresi	273
 <i>Ruzhdi Berisha</i>	
PJESA XI - KONTRATA PËR TRANSPORTIN	275
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	275
Neni 662. Nocioni	275
Neni 663. Detyrimet e transportuesit në transportin liniar	277
Neni 664. Denoncimi i kontratës	279
Neni 665. Shuma e shpërblimit për transport	280
Neni 666. Kufizimi i zbatimit të dispozitave të kësaj pjese	282
KREU 2 - KONTRATA PËR TRANSPORTIN E SENDEVE	
NËNKREU 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	282
Neni 667. Dorëzimi i sendeve	282

Neni 668. Detyrat e dërguesit për ta njoftuar transportuesin	283
Neni 669. Fletëngarkesa	285
Neni 670. Kontrata për transportin dhe fletëngarkesa	287
Neni 671. Vërtetimi për marrjen në dorëzim për transport	288
NËNKREU 2 - MARRËDHËNIA E DËRGUESIT DHE TRANSPORTUESIT ..	288
Neni 672. Paketimi	288
Neni 673. Shpërblimi për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin	290
Neni 674. Disponimi me dërgesën	292
Neni 675. Drejtimi i transportit	294
Neni 676. Pengesat gjatë kryerjes së transportit	295
Neni 677. Shpërblimi në rastin e ndërprerjes së transportit	296
Neni 678. Kur dërgesa nuk mund të dorëzohet	299
Neni 679. Përgjegjësia e transportuesit ndaj dërguesit	300
NËNKREU 3 - MARRËDHËNIA E TRANSPORTUESIT DHE MARRËSIT	301
Neni 680. Njoftimi i marrësit për arritjen e dërgesës	301
Neni 681. Dorëzimi i dërgesës kur është lëshuar duplikati i fletdërgesës	303
Neni 682. E drejta e marrësit për të kërkuar dorëzimin e dërgesës	303
Neni 683. Vërtetimi i identitetit dhe i gjendjes së dërgesës	305
Neni 684. Detyrimi i marrësit për të paguar shpërblimin për transportin	307
NËNKREU 4 - PËRGJEGJËSIA E TRANSPORTUESIT PËR HUMBJE, DËMTIM DHE VONESËN E DËRGESËS	309
Neni 685. Humbja ose dëmtimi i dërgesës	309
Neni 686. Humbja ose dëmtimi i dërgesës së sendeve të shtrenjta	504
Neni 687. Kthimi i shpërblimit të paguar për transport	313
Neni 688. Kur marrësi e merr dërgesën pa kundërshtim	314
Neni 689. Përgjegjësia e transportuesit për vonesë	316
Neni 690. Përgjegjësia për ndihmësit	317
NËNKREU 5 - PJESËMARRJA E DISA TRANSPORTUESEVE NË TRANSPORTIN E DËRGESËS	318
Neni 691. Përgjegjësia solidare	318
Neni 692. Përgjegjësia e pjesëtuar e transportuesve	322
NËNKREU 6 - E DREJTA E PENGUT	323
Neni 693. Kur transportuesi ka të drejtë pengu	323
Neni 694. Konflikti i të drejtave të pengut	326
KREU 3 - KONTRATA PËR TRANSPORTIN E PERSONAVE	327
Neni 695. Dispozita e përgjithshme	327
Neni 696. E drejta e udhëtarit për vendin e caktuar	328
Neni 697. Përgjegjësia e transportuesit për vonesë	329

Neni 698. Përgjegjësia e transportuesit për sigurinë e udhëtarëve	330
Neni 699. Përgjegjësia për bagazhin e dorëzuar për transport dhe sende të tjera	331

Abdulla Aliu

PJESA XII - KONTRATA PËR LICENCËN	333
KREU 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	333
Neni 700. Nocioni	333
Neni 701. Forma	337
Neni 702. Kohëzgjatja e licencës	337
Neni 703. Licenca ekskluzive	338
Neni 704. Kufizimi territorial i të drejtës së shfrytëzimit	339
KREU 2 - DETYRIMET E DHËNËSIT TË LICENCËS	340
Neni 705. Dorëzimi i objektit të licencës	340
Neni 706. Dhënia e udhëzimeve dhe njoftimeve	341
Neni 707. Detyrimi i garantimit	342
Neni 708. Përgjegjësia për të metat juridike	343
Neni 709. Dorëzimi i dhënësit të licencës ekskluzive	345
KREU 3 - DETYRIMET E FITUESIT TË LICENCËS	346
Neni 710. Shfrytëzimi i objektit të licencës	346
Neni 711. Shfrytëzimi i përfeksionimeve të mëvonshme	347
Neni 712. Ruajtja e objektit të licencës në fshehtësi	348
Neni 713. Cilësia	349
Neni 714. Të shënuarit	350
Neni 715. Shpërblimi	350
Neni 716. Paraqitja e raportit	351
Neni 717. Ndryshimi i shpërblimit të kontraktuar	352
KREU 4 - NËNLICENCA	354
Neni 718. Kur mund të jepet	354
Neni 719. Kur dhënësi mund të refuzojë lejen	356
Neni 720. Denoncimi për shkak të nënlicencës së palejueshme	357
Neni 721. Kërkesa e drejtpërdrejtë e dhënësit të nënlicencës	358
KREU 5 - SHUARJA E KONTRATËS	359
Neni 722. Kalimi i kohës së caktuar	359
Neni 723. Përtëritja e heshtur e licencës	360
Neni 724. Denoncimi	361
Neni 725. Vdekja, falimentimi dhe likuidimi	362
Neni 726. Kuptimi	364
Neni 727. Depozita e sendit të huaj	367

NËNKREU 2 - DETYRIMET E DEPOZITËMARRËSIT	367
Neni 728. Detyrimet e ruajtjes dhe të njoftimeve	367
Neni 729. Dorëzimi i sendit tjetrit për ruajtje	369
Neni 730. Përdorimi i sendit	369
Neni 731. Përdorimi dhe dorëzimi i sendit personit tjetër	370
Neni 732. Kthimi i sendit	370
NËNKREU 3 - TË DREJTAT E DEPOZITËMARRËSIT	371
Neni 733. Shpërblimi i shpenzimeve dhe i dëmit	371
Neni 734. Shpërblimi	371
Neni 735. Kthimi i sendit në rastin e depozitës falas	372
NËNKREU 4 - RASTET E VEÇANTA TË DEPOZITËS	373
Neni 736. Depozita e parregullt	373
Neni 737. Depozita e domosdoshme	373
KREU 2 - DEPOZITA HOTELIERE	374
Neni 738. Hotelieri si depozitëmarrës	374
Neni 739. Detyrimet e hotelierit për ta pranuar sendin për ruajtje	374
Neni 740. Detyrimi i mysafirit për ta paraqitur dëmi	375
Neni 741. Shpalljet për përjashtimin e përgjegjësishë	375
Neni 742. E drejta e mbajtjes (retencionit)	376
Neni 743. Zgjerimi i zbatimit të dispozitave për depozitën hoteliere	376
PJESA XIV - KONTRATA PËR MAGAZINIMIN	377
KREU 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	377
Neni 744. Nocioni	377
Neni 745. Detyrimet e magazinierit	378
Neni 746. Kur ekziston detyra e sigurimit	379
Neni 747. Kufizimi i shpërblimit të dëmit	379
Neni 748. Përzierja e sendeve të zëvendësueshme	380
Neni 749. Kontrollimi i mallit dhe marrja e mostrave	381
Neni 750. Kërkesa e magazinierit dhe e drejta e pengut	381
Neni 751. Tërheqja e mallit dhe shitja e mallit të patërhequr	382
Neni 752. Të metat me rastin e pranimit të mallit	382
Neni 753. Zbatimi i rregullave për depozitën	383
KREU 2 - FLETËMAGAZINIMI	383
Neni 754. Detyra e dhënies së fletëmagazinimit	383
Neni 755. Pjesët përbërëse dhe përmbytja e fletëmagazinimit	384
Neni 756. Fletëmagazinimi për pjesët e mallrave	384
Neni 757. Të drejtat e poseduesit të fletëmagazinimit	385
Neni 758. Bartja e dëftesës dhe e fletëpengut	385

Neni 759. E drejta e poseduesit të dëftesës	386
Neni 760. E drejta e poseduesit të fletëpengut	387
Neni 761. Protesta për shkak të mospagimit dhe shitjes së mallit	388
Neni 762. Kërkesa e pagimit nga bartësi i fletëpengut	389
PJESA XV - KONTRATA PËR URDHËRIN	391
KREU 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	391
Neni 763. Nocioni	391
Neni 764. Personat që kanë për detyrë të përgjigjen në ofertën e urdhrit	393
KREU 2 - DETYRIMET E DEKRETMARRËSIT	393
Neni 765. Zbatimi i urdhrit sikundër është deklaruar	393
Neni 766. Shmangia nga dekreti (urdhri) dhe udhëzimi	394
Neni 767. Zëvendësimi	395
Neni 768. Dhënia e llogarive	395
Neni 769. Paraqitja e raportit	396
Neni 770. Përgjegjësia për përdorimin e të hollave të dekretdhënësit	396
Neni 771. Përgjegjësia solidare e dekretmarrësve	397
KREU 3 - DETYRIMET E DEKRETDHËNË-SIT	398
Neni 772. Paradhënia në të holla	398
Neni 773. Shpërblimi i shpenzimeve dhe marrja e detyrimeve	398
Neni 774. Shpërblimi i dëmit	398
Neni 775. Sasia e shpërblimit	399
Neni 776. Pagimi i shpërblimit	400
Neni 777. E drejta e pengut	400
Neni 778. Përgjegjësia solidare e dekretdhënësve	401
KREU 4 - SHUARJA E DEKRETIT	401
Neni 779. Heqja dorë e dekretdhënësit nga kontrata	401
Neni 780. Denoncimi i kontratës nga dekretmarrësi	402
Neni 781. Vdekja, shuarja e personit juridik	403
Neni 782. Falimentimi, heqja e aftësisë për të vepruar	403
Neni 783. Çasti i shuarjes së dekretit	404
Neni 784. Përjashtimet	404

Sefadin Blakaj

PJESA GJASHTË - KONTRATA PËR KOMISIONIN

KREU 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	405
Neni 785. Nocioni	405
Neni 786. Zbatimi i rregullave për kontratën për dekretin	407

Neni 787. Lidhja e punës nën kushte të ndryshme nga ato të dekretit	787
Neni 788. Shitja e mallit personit që ka shumë borxh	410
Neni 789. Kur vetë komisionari blen mallin e komitentit ose ia shet mallin e vet ..	412
KREU 2 - DETYRIMET E KOMISIONARIT	413
Neni 790. Ruajtja dhe sigurimi	413
Neni 791. Njoftimi për gjendjen e mallit të pranuar	414
Neni 792. Njoftimi për ndryshimet në mall	415
Neni 793. Njoftimi i komitentit për emrat e palës kontraktuese	416
Neni 794. Dhënia e llogarisë	417
Neni 795. Del credere	795
KREU 3 - DETYRIMET E KOMITENTIT	421
Neni 796. Shpërblimi (provizioni)	421
Neni 797. Sasia e shpërblimit	423
Neni 798. Shpërblimi i shpenzimeve	424
Neni 799. Paradhënia e të hollave komitentit	425
KREU 4 - E DREJTA E PENGUT	426
Neni 800. Të drejtat e komisionarit për pengun	426
KREU 5 - MARRËDHËNIET ME PERSONA TË TRETË	427
Neni 801. Të drejtat e komitentit në kërkesat nga puna me të tretin	427
Neni 802. Kufizimi i të drejtës së kreditorëve të komisionarit	428
Neni 803. Falimentimi i komisionarit	428
PJESA XVII - KONTRATA PËR PËRFAQËSIMIN TREGTAR	430
KREU 1 - DISPOZITA TE PËRGJITHSHME	430
Neni 804. Nocioni	430
Neni 805. Forma	432
Neni 806. Lidhja e kontratës në emër të urdhërdhënësit	433
Neni 807. Pranimi i përmbushjes	433
Neni 808. Deklaratat e dhëna përfaqësuesit tregtar për urdhërdhënësin	434
Neni 809. Deklaratat në emër të urdhërdhënësit	435
Neni 810. Masat e sigurimit	435
KREU 2 - DETYRIMET E PËRFAQËSUESIT TREGTAR	437
Neni 811. Kujdesi për interesat e urdhërdhënësit	437
Neni 812. Informatat dhe raportimi	439
Neni 813. Pjesëmarrja në kontraktimin e punëve	440
Neni 814. Ruajtja e sekreteve të punës	441
Neni 815. Kthimi i sendeve të dhëna në përdorim	442
Neni 816. Rasti i veçantë i përgjegjësisë	443

KREU 3 - DETYRIMET E URDHERDHENESIT	444
Neni 817. Rregulla e përgjithshme	444
Neni 818. Detyra e njoftimit	446
Neni 819. Natyra e detyrueshme e dispozitave	447
Neni 820. Shpërblimi (provizioni)	447
Neni 821. Shuma e shpërblimit	449
Neni 822. Fitimi i të drejtës së pagesës	451
Neni 823. Pagimi i provizionit	452
Neni 824. Shpërblim i veçantë	454
Neni 825. Shpenzimet	455
KREU 4 - E DREJTA E PENGUT	456
Neni 826. E drejta e pengut e përfaqësuesit tregtar	456
KREU 5 - SHUARJA E KONTRATËS	457
Neni 827. Zgjidhja e kontratës së lidhur për një kohë të pacaktuar	457
Neni 828. Zgjidhja e kontratës së lidhur për një kohë të caktuar	458
Neni 829. Zgjidhja e kontratës pa afat denoncimi	459
Neni 830. Shuma e pjesëtuar	460
Neni 831. Baza për përjashtimin e pjesëtimit të shumës	463
Neni 832. Shfrytëzimi i shumës së pjesëtuar	464
Neni 833. Ndalimi i konkurrencës pas shkëputjes së kontratës	465
PJESA XVIII - KONTRATA PËR NDËRMJETËSIM	468
KREU 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	468
Neni 834. Kuptimi	468
Neni 835. Zbatimi i dispozitave të ligjit për kontratën për veprën	469
Neni 836. Pranimi i përmbushjes	470
Neni 837. Revokimi i urdhrorit për ndërmjetësim	472
Neni 838. Mungesa e detyrimit për urdhërdhënësin që të lidhë kontratë	473
KREU 2 - DETYRIMET E NDËRMJETËSUESIT	474
Neni 839. Detyrimi i kërkimit të rastit	474
Neni 840. Detyrimi i njoftimit	476
Neni 841. Përgjegjësia e ndërmjetësuesit	476
Neni 842. Ditari ndërmjetësues dhe fleta	478
KREU 3 - DETYRIMET E URDHËRDHËNËSIT	478
Neni 843. Shpërblimi	478
Neni 844. Kur ndërmjetësuesi fiton të drejtën e shpërblimit	480
Neni 845. Shpërblimi i shpenzimeve	482
Neni 846. Ndërmjetësimi për të dy palët	483
Neni 847. Humbja e të drejtës së shpërblimit	484

PJESA XIX - KONTRATA PËR SHPEDITIMIN (DËRGIMI)	485
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	485
Neni 848 - Nocioni	485
Neni 849 - Heqja dorë nga kontrata	487
Neni 850 - Zbatimi i rregullave për kontratën e komisionit përkatësisht të përfaqësimit tregtar	487
KREU 2 - DETYRIMET E SHPEDITUESIT	488
Neni 851. Tërheqja e vërejtjes për të metat e urdhrit	488
Neni 852. Tërheqja e vërejtjes për të metat e paketimit	489
Neni 853. Ruajtja e interesave të urdhërdhënësit	490
Neni 854. Veprimi sipas udhëzimeve të urdhërdhënësit	491
Neni 855. Përgjegjësia e shpedituesit për persona të tjerë	494
Neni 856. Veprimet doganore dhe pagimi i doganës	495
Neni 857. Kur shpedituesi kryen vetë transportin ose punët e tjera	496
Neni 858. Sigurimi i dërgesës	497
Neni 859. Dhënia e llogarisë	498
KREU 3 - DETYRIMET E URDHËRDHËNËSIT	499
Neni 860. Pagimi i shpërblimit	499
Neni 861. Kur dërguesi mund të kërkojë shpërblim	500
Neni 862. Shpenzimet dhe paradhënia	500
Neni 863. Kur është kontraktuar që shpërblimin ta paguajë marrësi i sendeve	501
Neni 864. Sendet e rrezikshme dhe të çmueshme	502
KREU 4 - RASTET E VEÇANTA TË SHPEDITIMIT	504
Neni 865. Shpeditimi me shpërblimin fiks	504
Neni 866. Shpeditimi përmbledhës	505
KREU 5 - E DREJTA E PENGUT E SHPEDITUESIT	506
Neni 867. E drejta e pengut e shpedituesit	506
PJESA XX - KONTRATA PËR KONTROLLIN E MALLRAVE DHE TË SHËRBIMEVE	508
Neni 868. Nocioni	508
Neni 869. Vëllimi i kontrollit	510
Neni 870. Nuliteti i disa dispozitave të kontratës	510
Neni 871. Ruajtja e mallrave, respektivisht e mostrave	511
Neni 872. Detyrimi i lajmërimit të porositësit	512
Neni 873. Shpërblimi	513
Neni 874. E drejta e pengut	514
Neni 875. Të besuarit e kontrollit të mallit kryerësit tjetër të kontrollit	514
Neni 876. Kontrolli i mallit me kryerjen e disa veprimeve juridike	515

Neni 877. Kontrolli i mallit me garanci	515
Neni 878. Kontrolli i shërbimeve dhe i sendeve që nuk janë destinuar për qarkullim	516
Neni 879. Zgjidhja e kontratës	516

Abdulla Aliu

Neni 880. Përkufizimi	518
Neni 881. Dhënia e vërtetimit mbi udhëtimin	522
Neni 882. Raporti i kontratës dhe i vërtetimit mbi udhëtimin	525
Neni 883. Prezumimi i saktësisë së vërtetimit	526

KREU 2. DETYRIMET E ORGANIZATORIT TË UDHËTIMIT

Neni 884. Mbrojtja e të drejtave dhe e interesave të udhëtarit	526
Neni 885. Detyrimi për të njoftuar	527
Neni 886. Detyrimi i ruajtjes së sekretit	529
Neni 887. Përgjegjësia për organizimin e udhëtimit	529
Neni 888. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur i kryen vetë shërbimet e veçanta ..	530
Neni 889. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur kryerjen e shërbimeve të veçanta ua ka besuar personave të tretë	531
Neni 890. Zbritja e çmimit	533
Neni 891. Përrjashtimi dhe kufizimi i përgjegjësive së organizatorit të udhëtimit	535

KREU 3. DETYRIMET E UDHËTARIT

Neni 892. Pagimi i çmimit	537
Neni 893. Detyrimi i dhënies të të dhënave	538
Neni 894. Përmeshja e kushteve të parashikuara me dispozita	538
Neni 895. Përgjegjësia e udhëtarit për dëmin e shkaktuar	539

KREU 4 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E VEÇANTA TË PALËVE

KONTRAKTUESE

Neni 896. Zëvendësimi i udhëtarit me ndonjë person tjetër	540
Neni 897. Rritja dhe ulja e çmimit të kontraktuar	541
Neni 898. E drejta e udhëtarit për të hequr dorë nga kontrata	543
Neni 899. E drejta e organizatorit të udhëtimit për të hequr dorë nga kontrata	547
Neni 900. Ndryshimet në programin e udhëtimit	550

PJESA XXII - KONTRATA NDËRMJETËSUESE PËR UDHËTIMIN

Neni 901. Nocioni	554
Neni 902. Detyrimi i dhënies së vërtetimit	555
Neni 903. Veprimi sipas udhëzimeve të udhëtarit	556
Neni 904. Zgjedhja e personave të tretë	557
Neni 905. Zbatimi përkatës i dispozitave të kontratës për organizimin e udhëtimit	558

PJESA XXIII - KONTRATA PËR ANGAZHIMIN E KAPACITETEVE TË HOTELIERISË (KONTRATA PËR ALOTMANIN)	559
KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME	559
Neni 906. Nocioni	559
Neni 907. Forma e kontratës	561
KREU 2. DETYRIMET E AGJENCISË TURISTIKE	561
Neni 908. Detyrimet e njoftimit	561
Neni 909. Detyrimi i respektimit të çmimeve të kontraktuara	563
Neni 910. Detyrimi i pagimit të shërbimeve të hotelierisë	564
Neni 911. Detyrimi i dhënies së dokumentit të veçantë me shkrim	565
KREU 3. DETYRIMET E HOTELIERIT	566
Neni 912. Detyrimi i vënies në përdorim të kapaciteteve strehimi të kontraktuara ..	566
Neni 913. Detyrimi për trajtim të barabartë	567
Neni 914. Detyrimi i hotelierit që të mos i ndryshojë çmimet e shërbimeve	568
Neni 915. Detyrimi i pagimit të provizionit	569
KREU 4 - E DREJTA E AGJENCISË TURISTIKE PËR TË HEQUR DORË NGA KONTRATA	570
Neni 916. E drejta për të hequr dorë nga kapacitetet e angazhuara të strehimit	570
Neni 917. Detyrimi i agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara ..	572
 <i>Ruzhdi Berisha</i>	
Neni 918. Nocioni	574
Neni 919. Rasti i siguruar	577
Neni 920. Përrjashtimi i disa sigurimeve	580
Neni 921. Shmangia nga dispozitat e kësaj pjese	581
NËNKREU 2 - LIDHJA E KONTRATËS	583
Neni 922. Kur është e lidhur kontrata	583
Neni 923. Polica dhe lista e mbulesës	586
Neni 924. Sigurimi pa policë	590
Neni 925. Lidhja e kontratës në emër të tjetrit pa autorizim	590
Neni 926. Sigurimi për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket	592
Neni 927. Përfaqësuesi i sigurimit	595
NËNKREU 3 - DETYRIMI I SIGURUESIT, PËRKATËSISHT I KONTRAKTUESVE TË SIGURIMIT	597
Neni 928. Detyra e lajmërimit	597
Neni 929. Lajmërimi i pasaktë i bërë me dashje ose lënia në heshtje	929
Neni 930. Pasaktësia e paparamenduar ose lajmërimi jo i plotë	600
Neni 931. Zgjerimi i fushës së zbatimit të neneve paraprake	603

Neni 932. Rastet në të cilat siguruesi nuk mund të thirret në pasaktësinë ose lajmërimin jo të plotë	604
Neni 933. Detyra e pagimit dhe e marrjes së premisë	605
Neni 934. Pasojat e mospagimit të premisë	607
Neni 935. Rritja e rrezikut	612
Neni 936. Kur rasti i siguruar ndodh ndërkohë	615
Neni 937. Zvogëlimi i rrezikut	616
Neni 938. Detyrimi i njoftimit për paraqitjen e rastit të sigurimit	617
Neni 939. Nuliteti i dispozitave për humbjen e të drejtave	619
NËNKREU 4 - DETYRIMET E SIGURUESIT	620
Neni 940. Pagimi i shpërblimit ose i shumës së kontraktuar	620
Neni 941. Përfshirja e përgjegjësisë së siguruesit në rastin e paramendimit dhe të mashtrimit	623
Neni 942. Kundërshtimet e siguruesit	624
NËNKREU 5 - KOHËZGJATJA E SIGURIMIT	626
Neni 943. Fillimi i efektit të sigurimit	626
Neni 944. Ndikimi i falimentimit mbi sigurimin	629
 <i>Adem Vokshi</i>	
KREU 2 - SIGURIMI I PASURISË	630
NËNKREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	630
Neni 945. Interesi i sigurimit	630
Neni 946. Qëllimi i sigurimit të pasurisë	633
Neni 947. Parandalimi i rastit të siguruar dhe shpëtimi	640
Neni 948. Lënia e sendit të dëmtuar që është siguruar	642
Neni 949. Shkatërrimi i sendit për shkak të ngjarjes që nuk është parashikuar në policë	643
NËNKREU 2 - KUFIZIMI I RREZIQEVE TË SIGURUARA	
Neni 950. Dëmet e mbuluara nga sigurimi	645
Neni 951. Dëmet e shkaktuara nga të metat e sendit të siguruar	647
Neni 952. Dëmet e shkaktuara nga operacionet e luftës dhe kryengritjet	648
NËNKREU 3. MBISIGURIMI DHE KONTRATA ME DISA SIGURUES	
Neni 953. Mbisigurimi	649
Neni 954. Zvogëlimi i mëvonshëm i vlerës	651
Neni 955. Sigurimi i shumëfishtë dhe i dyfishtë	651
Neni 956. Bashkësigurimi	654
NËNKREU 4 - NËNSIGURIMI	
Neni 957. Nënsigurimi	655

NËNKREU 5 - KALIMI I KONTRATËS DHE PAGIMI I SHPËRBLIMIT NGA SIGURIMI TJETRIT	657
Neni 958. Kalimi i kontratës në përfituesin e sendit të siguruar	657
Neni 959. Akordimi i shpërblimit titullarëve të pengut dhe të të drejtave të tjera ...	661
NËNKREU 6 - KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN (SUBROGIMI)	662
Neni 960. Subrogimi	662
NËNKREU 7 - SIGURIMI NGA PËRGJEGJËSIA	667
Neni 961. Përgjegjësia e siguruesit	667
Neni 962. E drejta personale e të dëmtuarit dhe padia e drejtpërdrejtë	671
KREU 3 - SIGURIMI I PERSONAVE	674
NËNKREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	674
Neni 963. Përcaktimi i shumës së siguruar	674
Neni 964. Polica e sigurimit të jetës	678
Neni 965. Paraqitja e pasaktë e moshës së të siguruarit	680
Neni 966. Pasojat e mospagimit të premisë dhe zvogëlimi i shumës së siguruar	682
Neni 967. Sigurimi i personit të tretë	684
Neni 968. Sigurimi në rastin e vdekjes së personit të mitur dhe personit me aftësi të kufizuar për të vepruar	685
Neni 969. Kumulimi i shpërblimit dhe i shumës së siguruar	686
NËNKREU 2 - RREZIQET E PËRJASHTUARA	688
Neni 970. Vetëvrasja e të siguruarit	688
Neni 971. Vrasja me dashje e të siguruarit	689
Neni 972. Shkaktimi me dashje i rastit të fatkeqësisë	690
Neni 973. Operacionet e luftës	691
Neni 974. Përrjashtimi kontraktues i rrezikut	692
NËNKREU 3 - TË DREJTAT E KONTRAKTUESIT TË SIGURIMIT PARA SHKAKTIMIT TË RASTIT TË SIGURUAR	693
Neni 975. Ribletja	693
Neni 976. Paradhënia	696
Neni 977. Lënia peng e policës	697
NËNKREU 4 - SIGURIMI I JETËS NË DOBI TË PERSONIT TË TRETË	699
Neni 978. Caktimi i shfrytëzuesit	699
Neni 979. Pjesëtimi i dobisë midis disa shfrytëzuesve	702
Neni 980. Revokimi i dispozitës për caktimin e shfrytëzuesve	702
Neni 981. E drejta personale dhe e drejtpërdrejtë e shfrytëzuesit	705
Neni 982. Kreditori i kontraktuesit të sigurimit dhe të siguruarit	706

Neni 983. Kalimi i shumës së siguruar	708
Neni 984. Kur shfrytëzuesi i caktuar vdes përpara rrjedhjes së shumës për pagesë .	708
Neni 985. Sigurimi për rast vdekjeje pa shfrytëzues të caktuar	709
Neni 986. Pagimi i ndërgjegjshëm i shumës së siguruar personit të paautorizuar ..	710

Nerxhivane Dauti

Neni 987. Nocioni	711
Neni 988. Kontributet	713
Neni 989. Vendimet e ortakëve dhe udhëheqja	715
Neni 990. Ushtrimi i të drejtave dhe detyrimeve në ortakëri	716
Neni 991. Fitimi dhe humbja	717
Neni 992. Paraqitja tek personat e tretë	718
Neni 993. Pasuria e ortakërisë	718
Neni 994. Marrëdhënia ndërmjet ortakëve	719
Neni 995. Ndërrimi i ortakëve	720
Neni 996. Përfundimi i ortakut	720
Neni 997. Shuarja e Ortakërisë	721
Neni 998. Shkëputja e kontratës	722
Neni 999. Likuidimi	724

Sefadin Blakaj

PJESA XXVI - BASHKËSIA	726
Neni 1000. Përkufizimi	726
Neni 1001. Pjesët	726
Neni 1002. Detyrimet e anëtarëve të bashkësisë	727
Neni 1003. Përdorimi dhe shfrytëzimi	728
Neni 1004. Marrja e vendimeve për çështjet e përbashkëta	729
Neni 1005. Shpenzimet e bashkësisë	730
Neni 1006. Kërkesa për mbarim	731
Neni 1007. Pasojat e mbarimit	732
Neni 1008. Themelimi i ortakërisë	734

PJESA XXVII - KONTRATA PËR DORËZANINË	735
--	------------

KREU 1 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	735
Neni 1009. Nocioni	735
Neni 1010. Forma	736
Neni 1011. Zotësia për të vepruar e dorëzantit	737
Neni 1012. Dorëzania për personin e paaftë për të vepruar	737

Neni 1013. Objekti i dorëzarisë	738
Neni 1014. Volumi i përgjegjësisë së dorëzantit	739
Neni 1015. Kalimi i të drejtave të kreditorit në dorëzantin (subrogimi)	740
KREU 2 - RAPORTET E KREDITORIT DHE TË DORËZANËSIT	741
Neni 1016. Format e dorëzarisë	741
Neni 1017. Solidariteti i dorëzanesve	742
Neni 1018. Humbja e të drejtës në afat	743
Neni 1019. Falimentimi i debitorit kryesor	743
Neni 1020. Rasti i përgjegjësisë së zvogëluar të trashëgimitarit të debitorit	744
Neni 1021. Kundërshtimet e dorëzantit	744
Neni 1022. Detyrimi i njoftimit të dorëzantit mbi ometimin e debitorit	746
Neni 1023. Shkarkimi i dorëzantit për shkak të vonesës së kreditorit	746
Neni 1024. Lirimi i dorëzantit për shkak të heqjes dorë nga mjetet e sigurimit	747
KREU 3 - RAPORTET E DORËZANËSIT DHE TË DEBITORIT	748
Neni 1025. E drejta për të kërkuar kompensimin nga debitori	748
Neni 1026. E drejta e dorëzantit të një debitori solidar	748
Neni 1027. E drejta e dorëzantit në sigurimin paraprak	749
Neni 1028. Humbja e të drejtës së kompensimit	750
Neni 1029. E drejta për kthimin e pjesës së paguar	750
KREU 4 - REGRESI I PAGUESIT NDAJ DORËZANËVE TË TJERË	751
Neni 1030. E drejta e kompensimit nga dorëzantët tjerë	751
KREU 5 - PARASHKRIMI	751
Neni 1031	751
PJESA XXVIII - KONTRATA PËR DËRGIMIN (ASIGNACIONI)	753
KREU 1 - NOCIONI I KONTRATËS	753
Neni 1032. Nocioni i kontratës	753
KREU 2 - MARRËDHËNIET MIDIS DËRGUESIT DHE TË DËRGUARIT	754
Neni 1033. Aprovimi nga ana e dërguesit	754
Neni 1034. Kundërshtimet e dërguesit	755
Neni 1035. Kalimi i asignacionit	755
Neni 1036. Parashkrimi	756
KREU 3. MARRËDHËNIA MIDIS ASIGNATARIT DHE ASIGNATIT	757
Neni 1037. Në qoftë se asignatari është kreditor i asignatit	757
Neni 1038. Asignacioni nuk është përbushja	758
Neni 1039. Detyra e asignatarit për ta njoftuar asignantin	758
Neni 1040. Heqja dorë nga asignacioni i aprovuar	759
Neni 1041. Revokimi i autorizimit të dhënë marrësit të dërgesës	759

KREU 4 - MARRËDHËNIET E ASIGNATIT DHE TË ASIGNATARIT	760
Neni 1042. Në qoftë se asignati është debitor i asignantit	760
Neni 1043. Revokimi i autorizimit të dhënë asignatit	761
KREU 5 - VDEKJA DHE PRIVIMI I AFTËSISË PËR TË VEPRUAR	762
Neni 1044. Vdekja dhe privimi i aftësisë për të vepruar	762
KREU 6 - ASIGNACIONI NË FORMË TË LETRËS SË PRURËSIT	762
Neni 1045. Asignacioni në formë të letrës së zotëruesit	762
KREU 7 - ASIGNACIONI NË FORMË TË LETRËS SIPAS URDHËRIT	764
Neni 1046. Asignacioni në formë të letrës sipas urdhërit	764
PJESA XXIX - UJDIA	765
Neni 1047. Përkufizimi	765
Neni 1048. Shtrirja e lëshimeve reciproke	766
Neni 1049. Aftësia	767
Neni 1050. Objekti	767
Neni 1051. Zbatimi i dispozitës për kontratat e dyanshme	768
Neni 1052. Dëmtimi i pamasë	768
Neni 1053. Efekti i ujdisë ndaj dorëzimit dhe pengdhënësit	769
Neni 1054. Ujdia për punën e cila mund të kundërshtohet	770
Neni 1055. Pavlefshmëria e ujdisë	771
Neni 1056. Nuliteti i një dispozite të ujdisë.....	771
PJESA XXX - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	772
Neni 1057. Zbatimi i këtij ligji	772
Neni 1058. Ndërprerja e vlefshmërisë dhe zbatimi i ligjeve tjera	772
Neni 1059. Hyrja në fuqi	774

Nerxhivane Dauti

LIBRI 2

MARRËDHËNIET E VEÇANTA TË DETYRIMEVE KONTRAKTUESE

PJESA I

KONTRATA PËR SHITJEN

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 438. Nocioni

1. Me kontratën e shitjes detyrohet shitësi që sendin të cilin e shet t'ia dorëzojë blerësit dhe t'ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin.
2. Shitësi i ndonjë të drejte tjetër detyrohet se blerësit do t'ia kalojë të drejtën e shitur, ndërsa kur ushtrimi i asaj të drejte kërkon posedimin e sendit, t'ia dorëzojë edhe sendin.

Kontrata e shitjes është një kontratë me anë të së cilës një subjekt, që quhet shitës, detyrohet të bartë ndonjë send në pronësi ose t'ia dorëzojë ndonjë të drejtë pronësore një subjekti tjetër, që quhet blerës, i cili detyrohet nga ana e vet të paguajë shumën e caktuar të parave, si çmim.¹

Subjektet që lidhin kontratë të shitjes janë shitësi dhe blerësi, të cilët janë palë kontraktuese në këtë kontratë. Kontraktuesi që detyrohet të bartë të drejtën e pronësisë së sendit të caktuar ose të drejtën pronësore të caktuar kontraktuesit tjetër, quhet **shitës**, kurse kontraktuesi që detyrohet të paguajë shumën e caktuar të parave, si çmim, quhet **blerës**. Me vetë faktin e lidhjes së kontratës së shitjes nuk fitohet e drejta e pronësisë. Kontrata e shitjes paraqitet si bazë juridike (**iusus titulus**), e cila është e domosdoshme për fitimin e së drejtës së pronësisë edhe akti i dorëzimit të sendit, si akt real (**modus aquirendi**).² Për sendet e luajtshme akti i dorëzimit bëhet “prej dorës në dorë”, kurse për sendet e paluajtshme – “dorëzimi simbolik i dokumentit”.³ Kontrata e shitjes është një ndër kontratat kryesore të qarkullimit të mallrave dhe dhënies së shërbimeve, që synon të realizojë interesat ekonomike dhe t'i plotësojë nevojat e palëve që marrin pjesë në lidhjen e saj, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, privatë ose shtetërorë, vendas ose te huaj.⁴ Kontrata e shitjes është instrumenti më i përdorur në qarkullimin juridik. Aktiviteti ynë i përditshëm shprehet

.....
1 Shih më hollësisht nenin 574 parag.1, 2, të LMD.

2 Mr. Hrvoje Momčinović, *Ugovori obveznog prava*, Prava Kinjga, Zagreb, 1987, fq. 1.

3 Mr. Milenko Ubavić, “*Ugovori u premeti nakretnina*”, Beograd, 1994, fq. 107.

4 Dr. Mariana Semini, *Kontrata e shitjes në ekonominë e tregut*, Tiranë, 1995, fq. 41.

me lidhjen e kësaj kontrate. Qëllimi ekonomik i lidhjes se kësaj kontrate është tjetërsimi i së drejtës së pronësisë ose fitimi i ndonjë të drejte tjetër pasurie nga ana e blerësit.

Kontrata e shitjes, si kontratë mbi tjetërsimin e sendeve dhe të drejtave, karakterizohet me veçori të caktuara juridike.

Kontrata e shitjes është kontratë konsensuale, që konsiderohet e lidhur me pajtimin e lirë të vullnetit të palëve kontraktuese, shitësit dhe blerësit, për lëndën e kontratës (për sendet ose të drejtën që tjetërsohet) dhe për çmimin (shumën e të hollave e cila paraqet barasvlerën në para të vlerës së sendit ose të drejtave që fitohen).

Kontrata e shitjes është kontratë joformale, sepse për plotëfuqishmërinë e saj nuk kërkohet forma e caktuar në bazë të së cilës duhet të arrihet pajtimi i vullnetit. LMD bën përjashtim nga rregulla, duke përcaktuar që kontrata e shitjes është kontratë formale në ato raste kur lëndë e saj janë sendet e paluajtshme.

Kontrata e shitjes është kontratë me shpërblim, në të cilën prania e çmimit që jepet në këmbim të një sendi ose të një të drejte, e bën atë kontratën më tipike me shpërblim. Blerësi, si palë kontraktuese për atë send ose të drejtë, të cilën e fiton në bazë të kontratës së lidhur, ka për ta dhënë shumën e caktuar të parave, që paraqet shpërblimin e barasvlershëm për sendin ose të drejtën e fituar në rastin konkret.

Kontrata e shitjes është kontratë komutative, sepse palët kontraktuese që në çastin e lidhjes së saj i dinë të drejtat dhe detyrat e tyre, të cilat janë të sigurta dhe të caktuara.

Kontrata e shitjes është kontratë e dyanshme detyruese, në të cilën palët kontraktuese në këtë kontratë kanë detyra reciproke ndaj njëri-tjetrit. Shitësi është i detyruar ta bartë të drejtën e pronësisë mbi ndonjë send ose mbi ndonjë të drejtë pasurore, kurse blerësi shumën e caktuar të parave - çmimin.

Kontrata e shitjes hyn në grupin e kontratave me të vjetra të së drejtës së detyrimeve. Vlen të theksohet se pararendëse e kësaj kontrate ka qenë kontrata e këmbimit. Zhvillimi i tregtisë diktoi lidhjen e kontratave të para, nga këmbimi mall me mall në shkëmbimin e mallit me një barasvlerë të përbashkët. Me prerjen e monedhave të para metalike, shitja merr formë të plotë juridike, duke u veçuar si kontratë e veçantë dhe me shumë rëndësi.⁵ Rregullat e para juridike të kontratës së shitjes paraqiten qysh në Kodin e Hamurabit, por zhvillimin më të hovshëm juridik e arrijnë në të drejtën romake. Në vazhdim do të paraqesim kontratën e shitjes në të drejtën romake, në shtetin ilir dhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Në të drejtën romake kontrata e shitjes - **emptio venditio**, ishte kontratë konsensuale, bilaterale, që lidhej me marrëveshjen e thjeshtë ndërmjet shitësit dhe blerësit që shitësi ta kalojë mallin në posedim të papenguar të blerësit, kurse blerësi t'i paguajë çmimin

5 Dr. M. Semini, vep. e cit., fq. 42.

shitësit. Çdo shitblerje mbante dy prestime: shitësi zotohej se do ta kalonte mallin në posedim të papenguar të blerësit (**merx**), kurse blerësi zotohej se do t'ia paguante shitësit çmimin (**pretium**). Objekt shitblerjeje mund të ishin të gjitha sendet e trupshme dhe të patrupshme (të drejtat) madje edhe sendet e ardhshme. Çmimi ose pretium duhej të ishte shuma e caktuar e të hollave - **pecunio numerata** dhe duhej të ishte **pretium certum, pretium verum** dhe **pretium justum**. Detyrimi themelor i shitësit në bazë të kontratës së shitjes ishte që t'ia dorëzonte mallin blerësit në atë kohë dhe vend ashtu siç ishin marrë vesh vetë blerësit. Shitësi përgjigjej për çdo dëm që paraqitej në sende deri në lartësinë e **culpa levis in abstracto** dhe për **custodia**, mirëpo nuk përgjigjej kurrë për casus majores (fuqinë madhore).⁶ Shitësi kishte detyrën e garantuesit për mungesat fizike, gjë që rregullohej me paditë: **actio redhibitoria, actio quanti minoris** ose **actio aestimatoria**. Garantimi i shitësit në rast të eviksionit rregullohej me rregullat e **actio auctoritatis**. **Actio venditio** përdorej për t'i mbrojtur të gjitha të drejtat e shitësit. Përveç kësaj padie, shitësi kishte në dispozicion edhe **pactum de retroemendo in diem addictio, lex commisoria** dhe **pactum protimiseos**.⁷ Detyrimet e blerësit në bazë të kësaj kontrate ishin që t'ia paguajë shitësit çmimin, që të marrë përsipër rrezikun për shkatërrimin e rastësishëm të sendit dhe që të marrë mallin e dërguar. Për mbrojtjen e të drejtave të veta, shitësi përdorte padinë **actio empti**.

Në të drejtën e shtetit Ilir, nga marrëdhëniet kontraktore që njiheshin dhe mbroheshin më shumë juridikisht, ishte shitja dhe qiraja. Normat juridike civile saknsiononin dhe rregullonin institutin e parablerjes. Kjo buron nga një ligj i vitit 391 të e.s. i perandorit romak, që i drejtohej guvernatorit të Ilirikut, duke i kërkuar të shfuqizohej parablerja, meqë vinte në kundërshtim me të drejtat e plota të pronarit romak.⁸ Vlen të theksohet se “parablerja lidhej me qëllim që të ruante deri diku pronat e vogla të fshatarëve nga grabitjet e latifondistëve skllavopronare”. Sipas këtij institucioni, një person i afërt i shitësit ndërhynte, duke kërkuar që të bëhej ai blerësi i një sipërfaqeje toke kundrejt një të huaji, duke i ofruar shitësit kushte po aq të favorshme.⁹

E drejta zakonore shqiptare, si: **Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut** dhe ai i **Labërisë**, e rregullonin kontratën e shitjes si një ndër kontratat më të rëndësishme, që lidhej me rastin e shkëmbimit të sendeve të ndryshme. Kanuni i Lekë Dukagjinit e rregullon kontratën e shitjes: me kushte, pa kushte, me kapar dhe me dëshmitarë. Sipas nenit 425 të Kanunit, “sendi i blerë me kushte, në qoftë se dilte me të meta pas shitjes, i kthehej shitësit”. Ndërkaq, po të blihej bagëti me kushte dhe po të dilte e sëmurë deri ditën e Shën Gjergjit, ajo i kthehej shitësit dhe blerësi merrte çmimin (neni 483). E drejta zakonore shqiptare e njihnte dhe në mënyrë të veçantë e rregulloi dhe e zbatoi institutin e parablerjes dhe të riblerjes. Tek instituti i parablerjes, kjo e drejtë zakonisht vepronte në kontratat e shitjes së tokës ose të pasurive të paluajtshme. Kështu, para se të shitej një copë tokë, mulliri etj.,

6 Dr. I. Puhan, vep. e cit., fq. 249.

7 Po aty, fq. 351.

8 Dr. M. Semini, vep. e cit., fq. 11.

9 Po aty.

kjo u ofrohej kushërinjve, vëllazërisë dhe fisit. E drejta e parablerjes kërkonte pëlqimin e katundit (neni 250 i kanunit). Siç theksuam edhe më lart, e drejta zakonore njëhte edhe **riblerjen**, që zbatohet posaçërisht për shitjen e tokës kur kontrata e shitjes bëhet me kusht që, në rast të rishitjes nga ana e blerësit, shitësi do të ishte i pari blerës i tokës. Zhvillimin më të hovshëm rregullat e kontratës së shitjes e gjejnë në të drejtën borgjeze, kur paraqitet një zhvillim i hovshëm i marrëdhënieve ekonomike shoqërore. KC i Francës, i Austrisë, i Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Polonisë, Ligji për Detyrimet i Zvicrës, me dispozita konkrete juridike, e rregullojnë kontratën e shitjes, duke e konsideruar këtë si një ndër instrumentet kryesore dhe më të rëndësishme juridike të qarkullimit të mallrave.

Për t'u lidhur kontrata e shitjes duhet të plotësohen **kushtet e përgjithshme** për lidhjen e kontratës, siç janë: aftësia për të vepruar e palëve kontraktuese, pajtimi i vullnetit dhe lënda e kontratës.

Shitësi dhe blerësi, si palë kontraktuese në kontratën e shitjes, duhet të kenë **aftësi të plotë** për të vepruar. Aftësia për të vepruar e palëve kontraktuese ndikon në vlefshmërinë e kontratës. Edhe personat e mitur, nën moshën 14-vjeç, mund të lidhin kontratë të shitjes, por për vlefshmërinë e saj nevojitet pëlqimi i prindërve, i kujdestarit ose i organit të kujdestarisë. Personat e mitur që kanë 15 vjet dhe kanë krijuar marrëdhënie pune, mund të lidhin pavarësisht kontratë të shitjes, në të cilën si objekt i kontratës paraqitet pasuria e fituar nga marrëdhënia e punës.

Neni 439. Rreziku

- 1. Deri në dorëzimin e sendit blerësit, rrezikun nga shkatërrimi ose dëmtimi i rastësishëm të sendit e bartë shitësi, ndërsa me dorëzimin e sendit rreziku kalon në blerësin.**
- 2. Rreziku nuk kalon në blerësin, në qoftë se për shkak të të metave të sendit të dorëzuar, ai e ka zgjidhur kontratën ose ka kërkuar zëvendësimin e sendit.**

Rreziku i dëmtimit të sendit.- Shitësi është i detyruar që t'ia dorëzojë blerësit sendin në gjendje të rregullt, siç ka qenë në çastin kur është lidhur kontrata. Por, nëse gjendja e sendit ndryshohet për shkak të dëmtimit ose asgjësimit të sendit, atëherë shtrohet pyetja nëse ky ndryshim është bërë për fajin e shitësit apo për shkak të fuqisë madhore. Deri në dorëzimin e sendit blerësit, rrezikun e zhdukjes së rastësishme ose të dëmtimit të sendit e bartë shitësi, kurse me dorëzimin e tij rreziku kalon te blerësi (neni 439 parag. 1, 2 e LMD). Në rast se dëmtimi ose zhdukja e sendit është bërë për fajin e shitësit, ai do të përgjigjet sipas bazës së përgjegjësisë së fajit të supozuar, sipas të cilit i përgjigjet çdo debitori për mospërmbushje të detyrimit. Shitësi ka mundësi të lirohet nga kjo përgjegjësi, nëse do të vërtetojë se dëmtimi i sendit është shkaktuar nën ndikimin e fuqisë madhore.¹⁰ Kur sendi dëmtohet ose zhduket nën ndikimin e fuqisë madhore, e cila e ka penguar shitësin që t'ia dorëzojë sendin blerësit e sendi, si objekt i kontratës së shitjes, është individualisht i caktuar, rreziku i përket shitësit

10 Po aty.

dhe ai nuk do të ketë të drejtë të kërkojë pagimin e çmimit të shitjes. Në rast se dëmtohet ose zhduket sendi i caktuar sipas llojit, shitësi është i detyruar t'ia dorëzojë atij një send tjetër të llojit të njëjtë. Në rast të dëmtimit të pjesëshëm të sendit nën ndikimin e fuqisë madhore, derisa ka qenë te shitësi, kontrata mund të mbetet në fuqi nëse dëshiron blerësi, i cili ka të drejtë të kërkojë edhe zvogëlimin proporcional të çmimit të shitjes.

Koha e dorëzimit.- Shitësi është i detyruar ta dorëzojë sendin në kohën e parashikuar me kontratën e lidhur të shitjes. Koha e dorëzimit është intervali kohor brenda të cilit shitësi duhet t'ia dorëzojë sendin blerësit. Afatin e dorëzimit e caktojnë shitësi dhe blerësi me marrëveshjen e tyre. Kur data e dorëzimit të sendit blerësit nuk është caktuar, atëherë shitësi është i detyruar ta dorëzojë sendin në një afat të arsyeshëm pas lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh natyrën e sendit dhe rrethanat e tjera (neni 459 i LMD). Nëse shitësi nuk e dorëzon sendin në afatin e caktuar, ai bie në vonesë. Në praktikë, rëndom, afati caktohet duke fiksuar datën e dorëzimit ose duke marrë parasysh një ngjarje të caktuar.

Neni 440. Kalimi i rrezikut në rast të vonesës së blerësit

- 1. Në qoftë se dorëzimi i sendit nuk është bërë për shkak të vonesës së blerësit, rreziku kalon në blerësin nga çasti kur ai bie në vonesë.**
- 2. Kur objekt i kontratës janë sendet e caktuara sipas llojit, rreziku kalon në blerësin që gjendet në vonesë, në qoftë se shitësi i ka veçuar sendet e destinuara haptazi për të bërë dorëzimin dhe për këtë gjë i ka dërguar njoftimin blerësit.**
- 3. Kur sendet e caktuara sipas llojit janë të një natyre të tillë që shitësi nuk mund ta veçojë një pjesë të tyre, mjafton që shitësi t'i ketë kryer të gjitha veprimet e nevojshme që blerësi të mund t'i merr sendet dhe për këtë t'ia ketë dërguar njoftimin blerësit.**

Kalimi i rrezikut në rast të vonesës së blerësit rregullohet në nenin 440 par. 1, 2, 3 i LMD. Sipas parag. 1 të nenin 440, nëse dorëzimi i sendit nuk është bërë për shkak të vonesës së blerësit, rreziku kalon te blerësi nga çasti kur ai bie në vonesë. Në këtë rast duhet që blerësi të mos e ketë marrë sendin, të refuzojë marrjen e sendit. Po qe se blerësi ka arsye të refuzojë marrjen e sendit, atëherë ai nuk shkakton vonesë.

Shitësi në këtë rast duhet ta ruajë sendin me kujdesin e ekonomistit të mirë, si dhe ta deponojë sendin në gjykatë me shpenzimet e blerësit ose ta shesë sendin, nëse ekzistojnë arsyet për shitje.

Kur kreditori është në vonesë ose është i panjohur apo kur është e pasigurt se kush është kreditor ose ku ndodhet ai ose kur kreditori është i paaftë për të vepruar dhe nuk ka përfaqësues të vetin, debitori mund ta depozitojë në gjykatë për kreditorin sendin të cilin e ka borxh. Për depozitim debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin po qe se di për të dhe për vendbanimin e tij. Depozitimi bëhet në gjykatën e kompetencës lëndore në vendin

e përmbushjes, përveç, nëse për shkaqet e leverdisë ekonomike ose vetë natyra e punës kërkojnë që depozitimi të bëhet në vendin ku ndodhet sendi.

Kur objekt i kontratës janë sendet e caktuara sipas llojit, rreziku kalon te blerësi që gjendet në vonesë, në qoftë se shitësi i ka veçuar sendet e destinuar haptazi për të bërë dorëzimin dhe për këtë gjë i ka dërguar njoftimin blerësit. Kjo është parashikuar shprehimisht në parag. 2 të nenit 440 të LMD.

Kalimi i rrezikut në qarkullimin tregtar ka rëndësinë e vet, sepse në këto marrëdhënie ekonomike kemi sende me vlerë të madhe, kurse një rrethanë tjetër me rëndësi është ajo se kemi shitjen në distancë. Te kjo shitje malli i dërguar gjatë transportit mund të zhduket ose të dëmtohet. Duke marrë parasysh karakterin dispozitiv të rregullave të rrezikut, shitësi dhe blerësi këtë çështje e zgjidhin me marrëveshjen e tyre dhe me kohë mund të rregullojnë këtë çështje. Problemet e rrezikut të humbjes ose dëmtimit të sendit paraqiten me zhvillimin e rregullave të sigurimit të mallit gjatë transportit.¹¹

Çështja e kalimit të rrezikut te kontrata e shitjes rregullohet edhe me ”*klauzolat e rrezikut*”. Këto klauzola vlejné vetëm për marrëdhëniet midis shitësit dhe blerësit te kalimi i rrezikut dhe kanë të bëjnë me dërgimin dhe marrjen e dërgesës dhe me kalimin e rrezikut, në rast të dëmtimit ose humbjes së sendit. Me këto klauzola rregullohen çështjet rreth ambalazhit, shpenzimeve, kontrollit të cilësisë dhe të sasisë së mallit, pagimit të doganës, tatimet. Me anë të “klauzolave të rrezikut” mundësohet që sa më shpejt të lidhet kontrata, siç janë *klauzolat e transportit, që janë nxjerrë në vitin 1936 nga Oda ndërkombëtare në Paris, në vitin 1936, 1953. Klauzolat e transportit u përmirësuan dhe u quajtën INCOTERMS. Incoterm i vitit 1936 ka 11 klauzola të transportit, kurse INCOTERMS i vitit 1953 bënë përmirësimin e klauzolave të përmendura, të cilat plotësohen në Montreal.*¹²

Kur sendet e caktuara sipas llojit janë të një natyre të tillë që shitësi nuk mund ta veçojë një pjesë të tyre, ai duhet t’i ketë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, në mënyrë që blerësi të mund t’i marrë sendet dhe “...për këtë t’ia ketë dërguar njoftimin blerësit”. (parag. 3 i nenit 440). Pra njoftimi duhet gjithsesi t’i dërgohet blerësit.

KREU 2 PJESËT PËRBËRËSE TË KONTRATËS SË SHITJES

NËNKREU 1 - OBJEKTI

Neni 441. Rregullat e përgjithshme

1. Sendi që është objekt i kontratës duhet të jetë në qarkullim. Është nule kontrata për shitjen e sendit, i cili është jashtë qarkullimit.

11 Komentar ZOO, II, Bgd. 1980, fq. 949.

12 Enciklopedija imovinskog prava i prava udruženog rada, Bgd. 1978, fq. 843.

2. Për shitjen e sendeve, qarkullimi i të cilave është i kufizuar vlejshëm dispozita të veçanta.

3. Shitja mund të ketë të bëjë edhe me sendin e ardhshëm.

Vullneti i lirë në kontratën e shitjes është dakordimi i plotë i vullnetit, përputhja e vullnetit të shitësit dhe blerësit lidhur me elementet thelbësore të kësaj kontrate. Vullneti i lirë i palëve qëndron kur shitësi i paraqet ofertë blerësit dhe blerësi e pranon ofertën pa kurrfarë ndryshimi. Theksuam se palët kontraktuese duhet të pajtohen lidhur me elementet thelbësore. Si çështje themelore në kontratën e shitjes paraqitet ajo që ka të bëjë me elementet thelbësore. **Elemente thelbësore** të kësaj kontrate janë **sendi** dhe **çmimi**. Mirëpo, në rast se shitësi dhe blerësi me rastin e lidhjes së kësaj kontrate e kushtëzojnë krijimin e kontratës edhe me pëlqimin për disa elemente të tjera, siç janë: koha, vendi, forma, mënyra e përmbushjes, nuk do të ketë kontratë të shitjes, derisa nuk arrihet pëlqimi edhe për to, pa marrë parasysh se është arritur pëlqimi për sendin dhe çmimin.¹³

Bazë e kontratës së shitjes është qëllimi juridik që i ka shtyrë palët kontraktuese – shitësin dhe blerësin, të krijojnë të drejta dhe të marrin detyrime.

Lënda është kusht i domosdoshëm për lidhjen e kontratës së shitjes. Objekt i kontratës së shitjes është: sendi ose e drejta dhe çmimi.

a) Sendi, si objekt i kontratës së shitjes. - Si element të parë thelbësore dhe të domosdoshëm LMD e thekson sendin. Sipas konceptit bashkëkohor që dominon në doktrinën juridike, me “send”, në kuptimin juridik, nënkuptohet sendi si pjesë e natyrës, i cili mund t’i nënshtrohet pushtetit të njeriut. Këto janë sendet në kuptimin e ngushtë, pra ato që janë materialisht ekzistuese (të ashtuquajtura *sende trupore*).¹⁴ Doktrina juridike dhe praktika gjyqësore si sende i konsiderojnë edhe energjinë atomike, energjinë elektrike, gazin etj. Objekt i kontratës së shitjes mund të jenë “vetëm sendet që gjenden në qarkullim” (neni 441 parag. 1 i LMD). Në **qarkullim** janë ato sende (**res in commercium**) që mund të blihen, të shiten ose të këmbehen. Nëse objekt i kontratës janë **sendet jashtë qarkullimit (res extra commercium)**, si, p.sh., parqet, sheshet, lumenjtë, rrugët etj., kontrata është absolutisht e pavlefshme (441 parag. 1 i LMD). Edhe sendet që kanë qarkullim të kufizuar mund të jenë objekt i kontratës së shitjes, por për to vlejshëm rregulla të veçanta (neni 441 parag. 2 i LMD). Në grupin e **sendeve me qarkullim të kufizuar** hyjnë: barnat, shitja e helmeve, mjeteve narkotike, armëve, platinë, arit, barërave të rrezikshme. Për qarkullimin e tyre nevojitet sigurimi i lejes së veçantë nga organi kompetent. Objekt i kontratës së shitjes mund të jetë **sendi i tanishëm** (sendi që ekziston në çastin e lidhjes së kontratës) dhe **sendi i ardhshëm** (neni 441 parag. 3 i LMD). Kemi të bëjmë me kontratë të shitjes së sendeve të ardhshme në rast se në kontratë është caktuar lloji dhe sasia e sendeve, si dhe çmimi i atyre sendeve,

¹³ Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 291.

¹⁴ Mr. J. Momčinović, vep. e cit., fq. 6.

p.sh., blerja e 1000 kg grurë të prodhimit të vitit 2005 nga pronari i grurit. Kjo kontratë quhet kontratë e shitjes së sendeve me shpresë (**emptio rei speratae**). Objekt i kontratës së shitjes mund të jetë edhe **sendi i huaj**, p.sh., komisionari mund të shesë sendin e huaj ne emër të vet, e për llogari të komitentit, e kontrata e tillë t'i detyroje kontraktuesit.

Neni 442. Kur sendi është shkatërruar para kontraktimit

- 1. Kontrata e shitjes nuk ka efekt juridik, në qoftë se në momentin e lidhjes së saj sendi që është objekt i kontratës ka qenë i shkatërruar.**
- 2. Në qoftë se në çastin e lidhjes së kontratës sendi pjesërisht ka qenë i shkatërruar, blerësi mund ta zgjidhë kontratën ose të mbetet pranë saj me zbritjen proporcionale të çmimit.**
- 3. Megjithatë, kontrata do të mbetet në fuqi dhe blerësi do të ketë vetëm të drejtën e zbritjes së çmimit në qoftë se shkatërrimi i pjesshëm nuk e pengon realizimin e qëllimit të kontratës, ose në qoftë se për sendin e caktuar ekziston një zakon i këtyllë në qarkullimin juridik.**

Sipas nenit 442 parag. 1 i LMD, kontrata e shitjes nuk ka efekt juridik, në qoftë se në momentin e lidhjes së saj sendi, që është objekt i kontratës, ka qenë i shkatërruar. Kjo rregull nuk përfshin rastet që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes, si: 1) kur për pamundësinë e përmbushjes nuk përgjigjet njëra palë; 2) kur për pamundësinë e përmbushjes përgjigjet pala tjetër; 3) kur shuhet detyra për shkak të pamundësisë së përmbushjes; 4) kur lënda e detyrës është sendi i caktuar sipas llojit dhe 5) te rastet e detyrimeve alternative.

Parag. 2 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është shprehimor dhe decidiv, sepse konsideron se kontrata e shitjes nuk ka efekt juridik, nëse sendi është shkatërruar, blerësi mund ta zgjidhë kontratën ose t'i qëndrojë asaj me zbritjen proporcionale të çmimit, (parag. 2 i nenit 442). Nëse sendi, si objekt i kësaj kontrate, zhduket pjesërisht, atëherë blerësi ka dy të drejta: **së pari**, të zgjidhë kontratën dhe **së dyti**, të kërkojë zvogëlimin proporcional të çmimit.

Parag. 3 i Ligjit ofron mundësinë që kontrata të mbetet në fuqi dhe blerësi të ketë vetëm të drejtën e zbritjes së çmimit, në qoftë se shkatërrimi i pjesshëm nuk e pengon realizimin e qëllimit të kontratës ose kur për sendin e caktuar ekziston një praktikë e tillë në qarkullimin juridik.

Neni 443. Shitja e sendit të huaj

Shitja e sendit të huaj i detyron palët kontraktuese, mirëpo blerësi që nuk ishte në dijëni ose nuk ka qenë i detyruar të jetë në dijëni se sendi është i huaj, mundet, po që

se për këtë shkak nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës, ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e demit.

Në qoftë se blerësi nuk e ka ditur as që ka pasur mundësi të dite se sendi është i huaj, kur për këtë shkak nuk mund ta realizojë qëllimin e kontratës, ai mund të kërkojë zgjidhjen e saj dhe shpërblimin e demit (neni 443 i LMD). Objekt i kontratës së shitjes mund të jetë çdo send, pa marrë parasysh natyrën e tij: i luajtshëm, i paluajtshëm, konsumues dhe jo konsumues, i zëvendësueshëm dhe i pazëvendësueshëm, individualisht i caktuar dhe i caktuar sipas gjinisë. Në rast se objekt i kontratës është sendi individualisht i caktuar (**res in species**), mjafton që të saktësohen cilësitë kryesore, me të cilat dallohet nga sendet e tjera. Kur objekt i kontratës së shitjes është sendi gjenerik, sipas llojit (**res in genere**), sendi duhet të caktohet sipas llojit, cilësisë dhe sasisë. Lloji i sendit caktohet me një përshkrim të përafërt të të dhënave për sendet, siç janë: tipi i sendit, lloji, numri dhe vetitë e tjera. Sasia e sendeve shprehet me sistemin decimal, me numër, peshë dhe me dimensione të sendeve.¹⁵ Sasia mund të caktohet në mënyrë të prerë dhe saktësisht, p.sh. 1000 kg grurë. Sasinë e caktojnë me marrëveshje shitësi dhe blerësi, por edhe me iniciativën e personit të tretë kur ketë e autorizojnë vetë palët kontraktuese.

Cilësia e sendit caktohet me përcaktimin e cilësive kimike, fizike, duke bërë përshkrimin e sendit me anë të modelit, standardeve e të tjera. Në rast se sendi është zhdukur në kohën e lidhjes së kontratës, konsiderohet se kontrata nuk prodhon efekte juridike. Me rastin e interpretimit të kësaj dispozitë juridike, duhet të nisemi nga diferencimi i sendeve të zëvendësueshme dhe individuale. Në rast se objekt i kontratës së shitjes është sendi gjenerik, detyrimi i shitësit nuk shuhet me zhdukjen e sendit, sepse lloji nuk zhduket, p.sh., ku si lëndë e shitjes është drithi, vera, këpucët etj. Në rast se objekt i kontratës së shitjes është sendi i caktuar *res in specia*, p.sh. piktura e caktuar, portreti i caktuar, në këtë rast detyrimi i shitësit shuhet, por eventualisht mund të ketë përgjegjësi shitësi për dëmin që i shkakton blerësit.

Neni 444. Shitja e së drejtës së kontestuar

- 1. E drejta e kontestuar mund të jetë objekt i kontratës së shitjes.**
 - 2. Nule është kontrata me të cilën avokati apo urdhërmarrësi tjetër do ta blinte të drejtën kontestuese, realizimi i së cilës i është besuar atij ose do ta kontraktonte për vete pjesëmarrjen në ndarjen e shumës së caktuar me vendim gjyqësor urdhërdhënësit të tij. 96**
-

Të drejtat si objekt i kontratës së shitjes. – Përveç sendit, si objekt i kontratës së shitjes mund të jenë edhe të drejtat. Si objekt i kontratës së shitjes mund të jenë vetëm të drejtat

¹⁵ Po aty.

pronësore dhe ato që mund të barten. Të gjitha të drejtat e kërkesës mund të jenë objekt i kontratës së shitjes. Objekt i kontratës së shitjes mund të jenë e drejta e autorit, e drejta e kërkesës, e drejta e pronësisë industriale. Por ka edhe të drejta të kërkesës, të cilat nuk mund të cedohen për shkak se janë të lidhura për personalitetin e subjektit e këtu hyjnë: e drejta e mbajtjes, e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial. Objekt i kontratës së shitjes mund të jetë: e drejta e pronësisë, e drejta e gëzimit të fryteve (usus fructus), e drejta e përdorimit (usus), e drejta e servitutit sendor. Të drejtat e pengut dhe të hipotekës nuk mund të jenë lëndë e shitjes së veçantë, sepse ato janë të drejta aksesore, të cilat lidhen me fatin e të drejtave kryesore.

NËNKREU 2 ÇMIMI

Neni 445. Kur çmimi nuk është caktuar

- 1. Në qoftë se me kontratën e shitjes çmimi nuk është caktuar, ndërsa as kontrata nuk përmban të dhëna të mjaftueshme me të cilat do të mund të caktohej çmimi, kontrata nuk ka efekt juridik.**
- 2. Kur me kontratën e lidhur ndërmjet ndërmarrësve nuk është caktuar çmimi dhe as që ka të dhëna të mjaftueshme me të cilat do të mund të caktohej çmimi, blerësi ka për detyrë të paguajë çmimin të cilin e ka arkëtuar rregullisht shitësi në kohën e lidhjes së kontratës, e në mungesë të kësaj çmimin e arsyeshëm.**
- 3. Çmim i arsyeshëm konsiderohet çmimi i ditës (vijues) në kohën e lidhjes së kontratës dhe nëse çmimi nuk mund të përcaktohet, atëherë atë e cakton gjykata sipas rrethanave të rastit.**

Në të drejtën anglosaksone ekziston një regjim juridik i ngjashëm, sipas të cilit një kontratë e shitjes mund të ekzistojë edhe në qoftë se çmimi nuk është shprehur në të. E drejta civile angleze dhe amerikane mbrojnë pikëpamjen e të ashtuquajturit çmim rrjedhës.¹⁶ Mendoj se, kur çmimi nuk është i caktuar dhe as i caktueshëm, nuk ka kontratë, sepse nuk ekziston lënda e saj. Pra, kontrata është e pavlefshme. Një konstatim i tillë është në përputhje me dispozitën juridike të LMD, neni 445. Çmimi i shitjes duhet t'i plotësojë vetitë e caktuar, të cilat janë:

- Çmimi duhet të jetë i caktuar në para.- Nëse çmimi në një pjesë do të caktohej në para, kurse në një pjesë me ndonjë send tjetër, kontrata e lidhur do të jetë kontratë e shitjes kur dhënia në para do të ishte më e madhe, përndryshe do të konsiderohet se është lidhur kontratë për shkëmbimin;¹⁷

.....
16 Dr. M. Semini, vep. e cit., fq. 48.

17 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 294.

- **Çmimi duhet të jetë real (pretium verum).**- Çmimi është real kur i përgjigjet vlerës së vërtetë të sendit, cilësive të tij. Nëse çmimi nuk është i vërtetë dhe real, këtu kemi të bëjmë me kontratë për dhuratën.

- **Çmimi duhet të jetë i drejtë (pretium iustum).**- Çmimi është i drejtë, nëse është sa gjysma e vlerës së vërtetë të sendit ose në qoftë se është sa një e dyta e vlerës së vërtetë të sendit ose sa dyfishi i saj. Nëse çmimi nuk e plotëson këtë veti, kontrata e shitjes mund të sulmohet për shkak të dëmtimit pa masë (**laesio enormis**) ose si kontratë me fajde dhe të shpallet e pavlefshme.

- **Çmimi duhet të jetë i caktuar ose i caktueshëm (pretium certum).**- Çmimi është i caktuar, nëse është caktuar me marrëveshjen e palëve numerikisht në para ose në shumë të prerë, p.sh. 1000 €. Çmimi është i caktueshëm, nëse me kontratë janë parashikuar elemente të konsiderueshme që do të caktohen më vonë, p.sh., çmimi do të caktohet sipas vlerës së çmimit në treg në tetor të vitit 2005.

Ekzistojnë disa lloje çmimesh: çmimi paritet, çmimi me arkë - skonto dhe çmimi me rabat.

Çmimi paritet caktohet duke marrë parasysh vendin ku është bërë ngarkimi i sendit.

Çmimi me arkë - skonto është çmim me zbritje që bën shitësi ndaj blerësit, në rast se blerësi e paguan çmimin para skadimit të afatit të kontraktuar.

Çmimi me rabat është kontraktim i çmimit me lirim, p.sh., nëse çmimi është 1000 €, rabati kontraktohet 10%, blerësi paguan çmimin prej 900 €.

Neni 446. Çmimi i caktuar

Kur është kontraktuar çmimi më i lartë se që është ai për llojin e caktuar të sendeve që e ka caktuar organi kompetent, blerësi ka borxh vetëm shumën e çmimit të caktuar; në qoftë se çmimi i kontraktuar është paguar blerësi ka të drejtë të kërkojë që t'i kthehet diferenca.

Në nenin 446 të LMD është parashikuar çmimi i caktuar në rastet kur në kontratë është caktuar një çmim më i lartë sesa ai i parashikuar për sendet në shitje që janë objekt i kontratës, parashikuar nga organi kompetent. Caktimi i çmimit të shitjes për llojet e veçanta të sendeve, mallrave, produkteve, bëhet me dispozita të veçanta, si rregull, për interes të përgjithshëm për mbrojtjen e prodhuesit ose konsumatorit. Në *kuptimin e ngushtë*, me çmimi të caktuar kuptohet ai çmim i caktuar saktësisht nga organi kompetent si çmim i shitjes për llojin e caktuar të sendeve. Në *kuptimin e gjerë*, me çmim të caktuar nënkuptohet caktimi i çmimit minimal nga ana e organit kompetent.¹⁸ LMD, në nenin 446,

18 Komentar ZOO, Knjiga II, Glavni redaktor S. Perović – D. Stojanović, Kragujevac, 1980, fq. 42

është mbështetur në kuptimin e ngushtë të çmimit të caktuar. Sipas këtij neni, blerësi është i obliguar të paguajë vetëm shumën e caktuar të çmimit, por në qoftë se ka paguar më tepër se çmimi i kontraktuar, ka të drejtë të kërkojë nga shitësi që t'i kthehet diferenca. Në ligj nuk bëhet diferencimi nëse kanë qenë ose jo të njoftuar kontraktuesit se çmimi ka qenë i parashikuar. Ligji nuk parashikon asgjë kur është kontraktuar një çmim më i ulët nga ai i caktuari. Kjo është bërë për shkak se rëndom çmimi caktohet për mbrojtjen e interesit të blerësit. Mirëpo, çmimi mund të bëhet për të mbrojtur edhe interesin e shitësit. Si bazë e zbatimit të këtij neni është parimi i ndalimit të shfrytëzimit të pozitës monopoliste. Në një rast të tillë blerësi do të ishte i detyruar që shitësit t'i paguajë diferencën ndërmjet çmimit të kontraktuar dhe çmimit të caktuar, pa marrë parasysh a është marrë sendi apo jo.

Neni 447. Kur është kontraktuar çmimi i ditës

- 1. Kur është kontraktuar çmimi i ditës, blerësi paguan çmimin e përcaktuar me evidencë zyrtare në tregun e vendit të shitësit, në kohën kur është dashur të bëhej përmbushja.**
- 2. Në qoftë se një evidencë e tillë nuk ekziston, atëherë çmimi i ditës caktohet në bazë të elementeve me të cilat, sipas dokeve të tregut, përcaktohet çmimi.**

Rasti kur është kontraktuar çmimi vijues gjen shprehje në nenin 447 të LMD. Sipas këtij neni, kur është kontraktuar çmimi vijues, blerësi paguan çmimin e përcaktuar me evidencë zyrtare në tregun e vendit të shitësit, në kohën kur është dashur të bëhej përmbushja. Në këtë nen rëndësi thelbësore paraqesin këto pyetje: “çfarë paraqet çmimi vijues”, “ç’ është evidenca zyrtare” dhe “çfarë paraqet tregu i vendit të shitësit”.

Kur në rastin konkret është kontraktuar “çmimi vijues”, blerësi paguan çmimin e përcaktuar me evidencë zyrtare në tregun e vendit të shitësit, në kohën kur është dashur të bëhej përmbushja.

Evidenca zyrtare është ajo që mbahet nga organet kompetente shtetërore.

Tregu i vendit të shitësit është vendi i lidhjes dhe i përmbushjes i shitësit. Rregulla e këtillë juridike e përmbajtur në nenin 447 është me karakter dispozitiv, kështu që shitësi dhe blerësi mund ta përcaktojnë me marrëveshje çastin prej lidhjes së kontratës, si moment relevant për vërtetimin e çmimit vijues të kontraktuar. Nëse në rastin konkret një evidencë e tillë zyrtare nuk ekziston, atëherë çmimi vijues caktohet në bazë të elementeve me të cilat, sipas dokeve të tregut, përcaktohet çmimi. (parag. 2 i nenin 583). Në këtë rast çmimin duhet ta përcaktojë gjykata, duke marrë parasysh elementet kalkuluese, me ndihmën e të cilave formohet çmimi në një treg të caktuar. Këtu duhet të merren parasysh doket të

cilat vlejnë në tregun e vendit të shitësit dhe këto në kohën e caktuar për përmbushjen e detyrimit të dorëzimit të sendit.¹⁹

Neni 448. Kur caktimi i çmimit i është besuar personit të tretë

Në qoftë se personi i tretë, të cilit i është besuar caktimi i çmimit nuk dëshiron ose nuk mundet ta caktojë çmimin, ndërsa kontraktuesit nuk dakordohen më vonë mbi caktimin e çmimit dhe as që e zgjidhin kontratën, do të konsiderohet se është kontraktuar çmimi i arsyeshëm.

Çmimi është element thelbësor i kontratës së shitjes. Çmimi paraqet shumën e parave të cilat blerësi ia paguan shitësit, si kundërvlerë adekuate për sendin që e merr prej tij. Rëndom, çmimin e shitjes e caktojnë palët kontraktuese me marrëveshje. Mirëpo, palët kontraktuese mund t'ia besojnë caktimin e çmimit edhe një personi të tretë fizik ose juridik ose ndonjë institucioni. Si persona të tretë mund të paraqiten: eksperti, gjykatësi, oda ekonomike, agjencia, arbitrazhi.²⁰ Personi i tretë është i detyruar të caktojë çmimin sipas vlerësimit të drejtë duke u bazuar në ndershmëri dhe ndërgjegjshmëri. Kur çmimi caktohet nga personi i tretë, ai ka karakter konstitutiv.

Neni 449. Kur caktimi i çmimit i është lënë njërës palë kontraktuese

Dispozita e kontratës me të cilën caktimi i çmimit i lihet në vullnetin e njërës palë kontraktuese konsiderohet sikur të mos ishte kontraktuar fare. Në këtë rast, blerësi ka borxh çmimin sikur në rastin kur çmimi nuk është caktuar. 97

Çmimi nuk mund të caktohet vetëm nga njëra palë kontraktuese. Mirëpo, edhe kur caktohet, në këtë rast do të konsiderohet se është kontraktuar çmimi rrjedhës, në kohën e lidhjes së kontratës në tregun e vendit të caktuar për dorëzimin e sendit.²¹

.....
19 Komentar ZOO, Kragujevac, 1980, fq. 45.

20 Po aty, fq. 12.

21 Dr. Aleksandar Goldštajn, *Privredno ugovorno pravo*, Informator, Zagreb, 1967, fq. 77.

Abdulla Aliu

KREU 3 DETYRIMET E SHITËSIT

NËNKREU 1 DORËZIMI I SENDIT

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR DORËZIMIN

Neni 450. Koha dhe vendi i dorëzimit

- 1. Shitësi ka për detyrë t'ia dorëzojë sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar me kontratë.**
- 2. Shitësi e ka kryer parimisht detyrimin e dorëzimit ndaj blerësit, kur ai (shitësi) ia dorëzon blerësit sendin apo ia dorëzon dokumentin me të cilin mund të merret sendi.**

I. Vështrim i përgjithshëm (KREU 3).- Kreu 3 përfshin dispozitat me të cilat rregullohen detyrimet e shitësit, përkatësisht dorëzimi i sendit si detyrim i shitësit, pastaj dorëzimi i njëkohshëm i sendit dhe pagimi i çmimit, si dhe përgjegjësinë për të metat materiale të sendit. Kreu 3 gjithashtu përmban dispozita me të cilat rregullohen të drejtat e blerësit, pastaj garancia për funksionimin e rregullt të sendit të shitur, përgjegjësia për të metat juridike të sendit etj.

450. Vështrim i përgjithshëm.- Koha e dorëzimit të sendit dhe vendi i dorëzimit të sendit të shitur është me rëndësi të veçantë të kontrata e shitjes. Sendi jo vetëm që duhet të dorëzohet në gjendjen siç janë marrë vesh palët, por dorëzimi i tij duhet të bëhet edhe në kohën dhe vendin e caktuar në kontratë ndërmjet shitësit dhe blerësit. Kur mungon marrëveshja e palëve, gjejnë shprehje dispozitat e LMD të Kosovës, si dispozita dispozitive plotësuese. Koha e dorëzimit dhe vendi i dorëzimit rregullohen edhe me kode civile të tjera²².

450.1. Paragrafi 1 përcakton detyrimin e shitësit për t'ia dorëzuar sendin blerësit në kohën dhe në vendin e parashikuar në kontratë. Një ndër detyrimet kryesore të shitësit është dorëzimi i sendit te blerësi në kohën dhe në vendin e parashikuar në kontratën e shitjes. Dorëzimi i sendit nënkupton kalimin e pronësisë mbi sendin. Dorëzimi është veprimi kur sendi vihet në duart e blerësit ose kur këtij të fundit i jepet mundësia

.....
22 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.7850, dt: 29.07.1994, Gazeta Zyrtare Nr.11, 12, 13, 14/1994, neni 712, ku thuhet "Shitësi duhet të dorëzojë sendet: 1. në datën e caktuar në kontratë ose që është e përcaktueshme në bazë të kontratës; 2. në çdo moment të periudhës së kohës që është caktuar ose që është e caktueshme sipas kontratës, përveç kur del nga rrethanat se i është lënë blerësit të zgjedhë datën; 3. në çdo rast tjetër brenda një afati të arsyeshëm që nga përfundimi i kontratës" (këtu e tutje KCSH).

ta marrë atë në mënyrë që të kryhet dorëzimi (Kodi Civil i Francë i vitit 1804, neni 1604)²³. Në këtë mënyrë, blerësi i mundësohet pushteti faktik dhe juridik mbi sendin e blerë. Pushteti faktik mbi sendin e blerë është realizim i përmbajtjes së sendit nga ana e blerësit, p.sh., dorëzimi i veturës së shitur. Nëse nuk është dorëzuar sendi, por ndonjë e drejtë tjetër pasurore, atëherë me dorëzimin e kësaj të drejte mundësohet ushtrimi faktik i përmbajtjes së të drejtës, p.sh., e drejta e qiramarrjes. Dorëzimi i sendit te blerësi nuk mund të realizohet pa veprimin e tij për ta marrë sendin në pushtetin e vet faktik. Nëse blerësi, për shkaqe të ndryshme, është i penguar ta marrë sendin e dorëzuar nga shitësi, atëherë ai mund të ruhet dhe përgjegjësia që mund të lindë gjatë ruajtjes së sendit, i cili, në fakt, konsiderohet i dorëzuar nga shitësi, bie mbi blerësin, duke përfshirë edhe shpenzimet e ruajtjes. Dorëzimi i sendit nga shitësi te blerësi është në korelacion me dorëzimin e çmimit nga blerësi te shitësi i sendit. Parimisht, dorëzimi i sendit kushtëzon detyrimin e blerësit për pagimin e çmimit të sendit të blerë. Në jetën juridike ekzistojnë disa mënyra të dorëzimit të sendit nga shitësi te blerësi dhe këto janë : **a) dorëzimi nga dora në dorë; b) dorëzimi simbolik dhe c) dorëzimi me deklaram**²⁴.

a) Dorëzimi i sendit nga dora në dorë – gjithmonë ka të bëjë me sende të luajtshme, sepse vetëm ato mund të dorëzohen nga shitësi te blerësi, p.sh., dorëzimi i veturës së shitur mbi të cilën blerësi e fiton pushtetin faktik dhe juridik me dorëzimin e sendit. Në qoftë se shitësi ka disponimin e drejtpërdrejtë mbi sendin e shitur, ai ia dorëzon atë blerësit në mënyrë faktike, nga dora në dorë dhe ky dorëzim faktik mundëson kalimin e disponimit të tij në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi sendin e shitur nga shitësi te blerësi²⁵.

b) Dorëzimi simbolik i sendit – dallon nga dorëzimi i sendit nga dora në dorë, sepse te dorëzimi simbolik nuk dorëzohet sendi, por dorëzohen diçka që simbolizon aktin e dorëzimit të sendit, p.sh., dorëzimi i çelësave të veturës pa e dorëzuar fizikisht edhe veturën. Çelësat e veturës nënkuptojnë mjetin me të cilin mundësohet ushtrimi i pushtetit faktik mbi atë send që është objekt i dorëzimit nga shitësi te blerësi.

c) Dorëzimi i sendit me deklaram – nënkupton rastin kur sendi që duhet t'i dorëzohet blerësit tanimë ndodhet te blerësi në bazë të ndonjë baze tjetër juridike, p.sh., në bazë të kontratës së qiramarrjes. Kjo do të thotë se, me aktin e deklaramit të vullnetit për dorëzimin e sendit të shitur, realizohet edhe dorëzimi, sepse nuk ka arsye t'i merret sendi blerësit dhe t'i dorëzohet përsëri.

450.2. Paragrafi 2 përcakton se konsiderohet moment i dorëzimit të sendit kur shitësi e lë sendin në posedim të blerësit ose kur ia dorëzon dokumentin me të cilën mund të merret sendi. Kalimi i posedimit mbi sendin bëhet në mënyra të ndryshme, përkatësisht nga dora në dorë (tradicio breedi manu) ose në mënyrë simbolike, p.sh., me dorëzimin e sendit. Nëse

23 Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 44.

24 Česić dhe të tjerë vepra e cituar, fq. 605.t

25 USAID, Programi sistemi i përmbartimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Forma Standarde e Agro-Kontratës për shitjen, me komentarin ligjor dhe udhëzuesin për përdorim të përgjithshëm, Prishtinë, 2012, fq. 12.

blerësi e ka në posedim sendin mbi baza të tjera, atëherë merret se sendi është i dorëzuar dhe, në momentin e lidhjes së kontratës, konsiderohet se ka përfunduar veprimi i dorëzimit të sendit te blerësi.

Neni 451. Objekti i dorëzimit

- 1. Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, apo nuk rrjedh diçka tjetër nga vetë natyra e punës, shitësi ka për detyrë t’ia dorëzojë sendin blerësit në gjendje të rregullt bashkë me pjesët aksesore të tij.**
- 2. Frytet dhe dobیت e tjera nga sendi i takojnë blerësit prej momentit kur shitësi e ka pasur për detyrë t’ia dorëzojë.**

451. *Vështrim i përgjithshëm.*- Neni 451 përcakton se objekti i dorëzimit të sendit nënkupton kalimin e disponimit mbi sendin te blerësi, ndërsa sendi i dorëzuar të jetë pa të meta juridike apo fizike.

451.1. Paragrafi 1 përcakton shprehimisht se objekti (sendi) blerësit duhet t’i dorëzohet në gjendje të rregullt bashkë me pjesët aksesore. Aksesorë të një toke bujqësore do të ishin makinat për punimin e tokës. Mirëpo, paragrafi 1 i këtij neni përcakton se mund të parashikohet edhe diçka tjetër kur bëhet fjalë për objektin që duhet të dorëzohet nga shitësi te blerësi. Nganjëherë, gjendja e rregullt e objektit varet nga vetë natyra e punës, pra nuk përjashtohet mundësia që të kontraktohet dorëzimi i një sendi, i cili nuk është në gjendje të rregullt dhe, në këtë rast, kemi të bëjmë me dorëzimin e sendit që është në gjendje jo të rregullt. Ky paragraf lejon mundësinë që palët, domethënë shitësi dhe blerësi, mund të merren vesh që pjesët aksesore të mos jenë objekt i dorëzimit, por vetëm sendi kryesor, pa pjesë aksesore. Dorëzimi i sendit nga shitësi te blerësi duhet të bëhet ashtu siç janë marrë vesh palët me kontratë dhe, në mungesë të marrëveshjes, vlejnë rregullat e LMD të Kosovës, që do të thotë se sendi duhet të dorëzohet pa të meta materiale dhe juridike. Edhe kodet tjera përcaktojnë se si duhet të jetë sendi që është objekt i dorëzimit²⁶. Objekt i dorëzimit është sendi për të cilin është rënë dakord²⁷, përkatësisht sendi duhet të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në kontratë²⁸. Barra e provës së dorëzimit i ngarkohet shitësit, kurse ajo e mospërputhjes së sendit me kontratën i ngarkohet blerësit²⁹.

26 KCSH, neni 711, ku thuhet “Sendet dorëzohen në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e përfundimit të kontratës. Sendet duhet të dorëzohen së bashku me aksesorët, shtesat dhe frytet që nga dita e përfundimit të kontratës, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë. Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t’ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve”.

27 Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 45.

28 Code Civile, 101 Edition, Dalloz, 2002, neni 1614, ku thuhet “sendi duhet të jetë i njëjtë me atë të parashikuaraë me kontratë”.

29 Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 45.

451.2. Paragrafi 2 përcakton se frytet qofshin ato natyrore apo civile dhe dobitë e tjera nga sendi i takojnë blerësit dhe këto prej momentin kur shitësi e ka pasur për detyrim t'ia dorëzojë sendin blerësit. Kjo nënkupton se frytet dhe dobitë e tjera nga sendi, i cili është dashur të dorëzohet por nuk është dorëzuar te blerësi, duhet të dorëzohen së bashku me objektin e dorëzimit. Pra, për sa u përket fryteve të fituara apo qirasë së marrë nga objekti, që është dashur t'ia dorëzohet blerësit por është vonuar dorëzimi, duhet t'ia dorëzohen blerësit ato që janë krijuar nga momenti kur është dashur të dorëzohet sendi nga shitësi te blerësi. Në kodet civile të vendeve të tjera parashikohet që frytet e sendit i përkasin blerësit, duke filluar nga dita e nënshkrimit të kontratës³⁰.

Neni 452. Kur është kontraktuar dorëzimi brenda një periudhe të caktuar

Kur është kontraktuar që dorëzimi i sendit të bëhet brenda një periudhe të caktuar, ndërsa nuk është caktuar se cila palë do të ketë të drejtë ta caktojë datën e dorëzimit brenda asaj periudhe, kjo e drejtë i takon shitësit, përveç kur nga rrethanat e rastit rrjedh se caktimi i datës së dorëzimit i është lënë blerësit.

452. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 452 përmban dispozitën e cila është e karakterit deklarativ, sepse rregullon rastin kur palët nuk e kanë kontraktuar me marrëveshje momentin e dorëzimit të sendit në datën e caktuar, por kanë parashikuar afatin e dorëzimit të sendit brenda një periudhe të caktuar. Në këtë rast, togfjalëshi "në periudhën e caktuar" nënkupton një periudhë disaditore ose disamujore etj. dhe në këtë rast LMD i Kosovës të drejtën e caktimit të datës për dorëzimin e sendit brenda asaj periudhe ia lë shitësit, nëse nuk kanë caktuar me marrëveshje se cili prej tyre ka të drejtë ta caktojë datën e dorëzimit të sendit. Nëse nga rrethanat e rastit, edhe pse nuk është caktuar shprehimisht se kush ka të drejtë të caktojë datën e dorëzimit brenda asaj periudhe, rrjedh se caktimi i datës së dorëzimit i është lënë blerësit. Në këtë rast, datën e dorëzimit brenda asaj periudhe të kontraktuar ka të drejtë ta caktojë jo shitësi, por blerësi. Pra, kjo, në fakt, përbën një përjashtim, sepse është rregull që, kur kontraktohet dorëzimi i sendit brenda një periudhe të caktuar dhe nuk parashikohet shprehimisht cili prej tyre do ta caktojë datën e dorëzimit të sendit, datën e dorëzimit të sendit brenda asaj periudhe gjithmonë do ta caktojë shitësi.

Neni 453. Kur data e dorëzimit nuk është caktuar

Kur data e dorëzimit të sendit te blerësi nuk është caktuar, shitësi ka për detyrë ta bëjë dorëzimin brenda afatit të arsyeshëm pas lidhjes së kontratës duke marrë parasysh natyrën e sendit dhe rrethanat e tjera.

453. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 453 rregullon rastin kur palët kontraktuese – shitësi dhe blerësi nuk kanë caktuar datën e dorëzimit të sendit, domethënë as ditën konkrete, as

³⁰ Code Civile, 101 Edition, Dalloz, 2002, neni 1614.

periudhën brenda së cilës duhet të bëhet dorëzimi i sendit; atëherë, kjo dispozitë parashikon se sendi nga shitësi të blerësi duhet të kalojë brenda një afati të arsyeshëm pas lidhjes së kontratës, duke marrë parasysh natyrën e sendit dhe rrethanat e tjera. Natyra e objektit që duhet të dorëzohet është përcaktuese edhe për caktimin e datës së dorëzimit, p.sh., dorëzimi i një malli që mund të priset ose t'i kalojë koha kur mund të shitet, gjithsesi kjo nënkupton se dorëzimi i sendit duhet të bëhet sa më shpejt që është e mundur. Nëse kjo nuk realizohet atëherë humb kuptimi i lidhjes së kontratës sidomos në raport me blerësin.

Neni 454. Kur vendi i dorëzimit nuk është caktuar me kontratë

- 1. Kur vendi i dorëzimit nuk është caktuar me kontratë, dorëzimi i sendit bëhet në vendin ku shitësi në momentin e lidhjes së kontratës e ka pasur vendbanimin e vet apo vendqëndrimin, nëse mungon vendbanimi, e në qoftë se shitësi e ka lidhur kontratën në kuadër të veprimtarisë së vet ekonomike të rregullt, atëherë vendi i dorëzimit është selia e tij.**
- 2. Në qoftë se në çastin e lidhjes së kontratës palët kontraktuese e kanë ditur se ku ndodhet sendi, përkatësisht se ku duhet të prodhohet, dorëzimi bëhet në atë vend.**

454. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 454 përmban dispozitën e karakterit dispozitiv, me të cilën rregullohet se ku është vendi i dorëzimit të sendit të shitur kur palët nuk e kanë përcaktuar në kontratë vendin e dorëzimit të sendit të shitur.

454.1. Paragrafi 1 përcakton vendin e dorëzimit të sendit të shitur, nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe me kontratë. Në këtë rast, ky paragraf parashikon se sendi do të dorëzohet në vendin ku shitësi, në momentin e lidhjes së kontratës, e ka pasur vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin. Vendbanim konsiderohet vendi ku shitësi ka vendosur të jetojë përgjithmonë, përkatësisht adresa e banimit të përhershëm të shitësit. Ndërkaq, vendqëndrim është vendi ku shitësi jeton përkohësisht, pra është adresa e banimit të përkohshëm dhe kjo do të gjejë shprehje vetëm në rastet kur nuk dihet vendbanimi i shitësit. Kjo ka të bëjë me rastin kur shitësi është person fizik, pra individi si subjekt i së drejtës. Kjo dispozitë ligjore parashikon se vendi i dorëzimit, kur kontrata është rezultat i veprimtarisë së rregullt ekonomike të shitësit, është selia e tij. Selia e personit juridik konsiderohet vendi ku ai e ka të regjistruar veprimtarinë e tij të rregullt. Selia e personit juridik është, pra, vendi (adresa) ku personi juridik ushtron veprimtarinë, që nënkupton vendin ku bëhet administrimi i personit juridik. Selia e personit juridik përcakton edhe kompetencën gjyqësore; selia përcaktohet me aktin e themelimit të personit juridik³¹. Me këtë dispozitë, në mënyrë parimore caktohet vendi i dorëzimit të sendit, përkatësisht vendi ku shitësi duhet ta dorëzojë sendin dhe vendi ku blerësi duhet të vijë ta marrë sendin. Është rregull parimore dhe e përgjithshme, sepse kjo dispozitë gjen shprehje vetëm në rastet kur palët kontraktuese nuk e kanë parashikuar në kontratë vendin e dorëzimit të

.....
31 Më gjerësisht, shih : Aliu, Abdulla, E Drejta Civile, Prishtinë, 2013, fq. 264.

sendit, sepse kjo dispozitë u jep liri palëve kontraktuese që vendi i dorëzimit të mos jetë as te vendi i shitësit, as te vendi i blerësit apo te ndonjë vend i tretë. Në rast se shitësi ka edhe vendbanim, edhe vendqëndrim dhe blerësi e di vendqëndrimin e shitësit, atëherë konsiderohet se vendi i dorëzimit do të jetë vendqëndrimi i shitësit³². Dihet se veprimtari ekonomike ushtrojnë jo vetëm personat juridikë, por edhe personat fizikë, të cilët nuk kanë seli, por kanë vendbanim, prandaj thuhet se paragrafi 1 i këtij neni nuk ka të bëjë me të gjithë shitësit që kanë lidhur kontratë lidhur me veprimtarinë e vet të rregullt ekonomike, por vetëm me ata shitës që janë persona juridikë dhe, nëse bëhet fjalë për persona fizikë, në rrethana të tilla thuhet se duhet të merret qëndrimi se sendi në rend të parë dorëzohet në vendin ku personat fizikë ushtrojnë veprimtarinë³³. Kodi Civil i Francës parashikon se “dorëzimi duhet të bëhet në vendin ku gjendet sendi në momentin e shitjes, me përjashtim të rastit kur palët bien dakord ndryshe”³⁴.

454.2. Paragrafi 2 përmban rregullën, sipas së cilës, kur në momentin e lidhjes së kontratës blerësi dhe shitësi, si palë kontraktuese, e kanë ditur vendndodhjen e sendit që është objekt i shitjes, përkatësisht i blerjes ose e kanë ditur vendin ku duhet të prodhohet ai send, atëherë dorëzimi i tij bëhet në atë vend. Pra, blerësi këtë send duhet të shkojë ta marrë në vendin ku e ka ditur se ndodhet sendi, përkatësisht në vendin për të cilën ka pasur dijeni se ku do të prodhohet ai send. Ndërkaq shitësi ka për detyrë ta dorëzojë sendin e shitur në vendin ku ndodhet sendi e jo në vendin ku e ka vendbanimin apo selinë ose në vendin ku e ka prodhuar atë send, për të cilin ka pasur dijeni edhe blerësi. Kjo rregull zbatohet kur vendbanimi, vendqëndrimi dhe selia e shitësit nuk janë vende ku ndodhet sendi që është objekt i dorëzimit ose ku ai do të prodhohet. Mirëpo, palët kontraktuese, në momentin e lidhjes së kontratës, e kanë pasur të njohur vendin e ndodhjes së sendit që duhet të dorëzohet, përkatësisht vendin ku sendi duhet të prodhohet, ndërkaq, nëse palët nuk kanë ditur për vendin ku ndodhet sendi, përkatësisht ku do të prodhohet ai, atëherë si vend për dorëzimin e sendit do të jetë vendbanimi, vendqëndrimi apo selia e shitësit³⁵.

Neni 455. Dorëzimi transportuesit

Në rastin kur sipas kontratës nevojitet që të bëhet transportimi i sendeve, ndërsa në kontratë nuk është caktuar vendi i përmbushjes, dorëzimi quhet i kryer me dorëzimin e sendit transportuesit ose personit i cili e organizon transportin.

455. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 455 përcakton rregullën kur nuk dihet vendi i përmbushjes së kontratës, përkatësisht ai nuk është parashikuar në kontratë dhe sendi duhet të transportohet, sepse kur dihet vendi i blerësit dhe ai nuk është në vendin ku e ka

32 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 613.

33 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 614.

34 Code Civile, 101 Edition, Dalloz, 2002, neni 1609.

35 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 614.

vendbanimin shitësi, ekziston nevoja e dorëzimit të sendit përmes transportit. Në këtë rast, konsiderohet se shitësi e ka bërë dorëzimin e sendit në momentin e kryerjes së formaliteteve për transportin e sendeve ndaj transportuesit ose një personi tjetër që organizon transportin³⁶. Nga momenti i dorëzimit të sendit te transportuesi ose personi që organizon transportin, shitësi lirohet nga përgjegjësia për dëmet eventuale lidhur me sendin. Sepse, konsiderohet se sendi është dorëzuar në mënyrë të rregullt te blerësi me aktin e dorëzimit të sendit te transportuesi. Duhet bërë dallim mes vendit të dorëzimit dhe vendit të pranimit të sendit që është objekt i kontratës së shitblerjes. Pra, shitësi e kryen detyrimin e vet të dorëzimit të rregullt të sendit, në këtë rast, me faktin e dorëzimit të sendit të shitur te transportuesi.

Neni 456. Organizimi i transportit

Në qoftë se shitësi e ka pasur për detyrë t'ia dërgojë sendin blerësit, ai duhet që në mënyrë të zakonshme dhe në kushte të rëndomta të lidhë kontratën e nevojshme për realizimin e transportit deri në vendin e caktuar.

456. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 456 rregullon rastin kur shitësi dhe blerësi janë marrë vesh që shitësi t'ia dorëzojë sendin blerësit në vendin e caktuar, përkatësisht në vendin të cilin e kanë caktuar si vend për dorëzimin e sendit nga shitësi te blerësi. Atëherë, detyrimi i shitësit është që, në mënyrë të zakonshme dhe në kushte të rëndomta, të lidhë kontratë me transportuesin me qëllim që të realizohet transporti i sendit të shitur deri te vendi i caktuar në bazë të marrëveshjes midis shitësit dhe blerësit. Kjo dispozitë ligjore nënkupton se shitësi autorizohet t'ia kryejë të gjitha formalitetet e nevojshme për dorëzimin e sendit te transportuesi dhe kontraktimin sipas marrëveshjes, përkatësisht të lidhë kontratë në mënyrë që është e zakonshme dhe në kushte të rëndomta për transportin e mallit të shitur që ky të mbërrijë në vendin ku e pret blerësi, përkatësisht në vendin që është caktuar si vend ku duhet të mbërrijë sendi.

Neni 457. Shpenzimet

Shpenzimet e dorëzimit si dhe ato që i paraprijnë dorëzimit i bartë shitësi, ndërsa shpenzimet e dërgimit të sendit dhe të gjitha shpenzimet e tjera pas dorëzimit i bartë blerësi, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.

457. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 457 përcakton se, nëse palët kontraktuese nuk janë marrë vesh ndryshe dhe vendi i dorëzimit është vendi ku ndodhet sendi, shpenzimet që bëhen lidhur me dorëzimin e sendit te transportuesi dhe shpenzimet e bëra para se të bëhet

.....
36 Edhe KCSH, neni 711, paragrafi 2, parashikon se, “Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve”

dorëzimi, që nevojiten për përgatitjen e sendit për dorëzimi heq shitësi. Ndërkaq, të gjitha shpenzimet e tjera pas dorëzimit, pra shpenzimet e transportit deri te vendi i dorëzimit dhe shpenzimet e tjera që mund të dalin deri te vendi ku duhet të bëhet pranimit i sendit, i takojnë blerësit të sendit. Kjo normë është gjithashtu e karakterit dispozitiv, sepse lejon mundësinë që palët të merren vesh ndryshe dhe të parashikojnë njërin a tjetrin ose bashkërisht si bartës të shpenzimeve deri te dorëzimi i sendit, përkatësisht deri te pranimit (marrja) e tij. Ky nen parashikon se, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, vlen rregulla e përgjithshme se, në mungesë të marrëveshjes midis palëve lidhur me shpenzimet e dorëzimit të sendit te transportuesi, ato i bartë shitësi i sendit. Shpenzimet e shitësit lidhur me dorëzimin e sendit janë vetëm ato që konsiderohen të natyrshme dhe në çdo rrethanë duhet t'i bëjë çdo shitës i sendit. Nëse, për faj të blerësit, krijohen shpenzimet shtesë, të cilat nuk do të ishin detyrim i rregullt i shitësit, ato bien në ngarkim të blerësit, edhe pse bëhet fjalë për shpenzime që kanë të bëjnë me dorëzimin e sendit. Në literaturën juridike parashikohet që shpenzimet e dorëzimit të sendit bien mbi shitësin, ndërsa shpenzimet e transportit bien mbi blerësin, por nuk përjashtohet mundësia që me marrëveshje të parashikohet edhe ndryshe³⁷.

II. DORËZIMI I NJËKOHSHËM I SENDIT DHE PAGIMI I ÇMIMIT

Neni 458. Shtyrja e dorëzimit deri sa të paguhet çmimi

Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër ose diçka tjetër nuk rrjedh nga zakoni, shitësi nuk e ka për detyrë ta dorëzojë sendin në qoftë se blerësi njëkohësisht nuk e paguan çmimin e tij ose nuk është i gatshëm ta bëjë këtë njëkohësisht, por as blerësi nuk e ka për detyrë të paguajë çmimin para se të ketë pasur mundësinë ta kontrollojë sendin.

458. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 458 përmban dispozitën me të cilën rregullohet shtyrja e dorëzimit të sendit të shitur derisa të paguhet çmimi, sepse në këtë rast vlen rregulla që dorëzimi i sendit dhe pranimit i çmimit të jetë i njëkohshëm. Dorëzimi i sendit dhe pagimi i njëkohshëm i çmimit është rezultat i asaj që kontrata është e dyanshme detyruese dhe, në këtë rast, është rregull që dorëzimi i sendit dhe pagimi i çmimit të jetë i njëkohshëm, gjithmonë nëse nuk është kontraktuar diçka tjetër ose nga rrethanat nuk del diçka tjetër. Prandaj, shitësi nuk është i detyruar t'ia dorëzojë sendin blerësit, nëse ai nuk e ka paguar çmimin njëkohësisht me dorëzimin e sendit ose në qoftë se nuk ekziston gatishmëria që pagesa të bëhet njëkohësisht me dorëzimin e sendit. Kjo dispozitë parashikon se shitësi nuk është i obliguar, pra nuk ka detyrimin ta dorëzojë sendin, në qoftë se blerësi njëkohësisht nuk e paguan çmimin e tij ose nuk është i gatshëm ta bëjë këtë njëkohësisht, ndërkaq kjo e drejtë vlen edhe për blerësin, i cili nuk ka detyrimin ta paguajë çmimin para se të ketë pasur mundësi ta kontrollojë sendin. Mosdorëzimi i sendit derisa nuk bëhet pagesa e çmimit për sendin, vlen gjithmonë kur nuk është kontraktuar midis palëve diçka tjetër ose diçka tjetër nuk rrjedh nga zakoni, sepse, në disa raste, si burim i ndonjë të drejte

³⁷ Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 48.

apo detyrimi, përkatësisht si rregull se si duhet të sillemi në raste të caktuara, është edhe zakoni, në këtë rast mendohet për rregullën e sjelljes që ndryshe quhet e drejta zakonore, e cila respektohet në mjedise të caktuara në marrëdhëniet tregtare. Mënyra e realizimit të njëkohshëm të dorëzimit të sendit dhe pagesës është një çështje faktike, sepse kjo mund të bëhet me depozitimin e parave dhe është e ekzekutueshme në momentin kur shitësi i sendit shpreh dëshirën që t'i marrë këto mjete. Ndërkaq, dorëzimi i sendit konsiderohet perfekt dhe blerësi ka për detyrim të bëjë pagesën, kur blerësi ka dijeni të plotë për sendin e dorëzuar, pra pasi ka pasur mundësi ta ketë kontrolluar sendin ose të mund ta kontrollojë atë. Pjesëmarrësit e marrëdhënies detyimore duhet të veprojnë në pajtim me doket e mira afariste në marrëdhëniet e tyre dhe nuk mund të përjashtojnë ose të kufizojnë këtë detyrim, (veprimin në pajtim me doket e mira afariste, që ndryshe quhen zakonet tregtare). Nga kjo del se doket e mira, pra zakoni, është në epërsi kundrejt normës dispozitive, sepse këto gjithmonë janë të tilla me rastin e zbatimit të një norme të karakterit dispozitiv. Doket e mira, përkatësisht ajo që është e zakonshme për rastin konkret në marrëdhëniet tregtare, ka epërsinë mbi normën dispozitive³⁸. Dorëzimi i njëkohshëm i sendit dhe pagimi i njëkohshëm i çmimit nënkupton kryerjen e dorëzimit dhe çmimit në të njëjtin moment. Kjo nënkupton atë që ndodh në tregun e rregullt, p.sh., blen sendin - paguan paratë, kurse sot blerja me para zëvendësohet me kartela kreditore, megjithëse kjo, në fakt, është mjaft vështirë të realizohet në të gjitha rastet në të njëjtin moment, prandaj ekzistojnë ligje të veçanta për mënyrën e realizimit të pagesave për mallin e blerë, kur ato nuk shoqërohen me marrëveshje të caktuara. Nuk konsiderohet që është në vonesë për pagimin e çmimit, kur blerësi nuk e ka bërë pagimin e çmimit para se ta kontrollojë sendin, por në qoftë se me kontratën e shitjes është parashikuar pagimi i çmimit në momentin e dorëzimit të dokumenteve përkatëse të sendit, me të cilat ai autorizohet të kërkojë dorëzimin e sendit, atëherë blerësi nuk mund ta refuzojë pagimin e çmimit me arsyetimin se nuk ka mundur ta bëjë kontrollin e mallit, përkatësisht se nuk ka mundur ta verifikojë sasinë dhe kualitetin e sendit. Në literaturën juridike thuhet se, kur vendi i pagesës nuk është përcaktuar, ajo duhet të kryhet në vendin e dorëzimit dhe rasti më i shpeshtë është kur pagesa kryhet në dyqanin e shitësit, ndërsa shumica e parave të çmimit është e sjellshme nga blerësi dhe jo e kërkueshme nga shitësi³⁹.

Neni 459. Shtyrja e dorëzimit në rastin e transportit të sendit

- 1. Kur dorëzimi i sendit realizohet duke ia dorëzuar transportuesit, shitësi mund ta shtyjë dërgimin e sendit deri sa të paguhet çmimi ose ta dërgojë sendin ashtu që të rezervojë të drejtën e disponimit të tij gjatë kohës së transportit.**
- 2. Në qoftë se e ka rezervuar të drejtën e disponimit të sendit gjatë kohës së transportit, shitësi mund të kërkojë që sendi të mos i dorëzohet blerësit në vendin e destinimit deri sa të mos e paguajë çmimin, ndërsa blerësi nuk e ka për detyrë ta paguajë çmimin para se të ketë pasur mundësinë ta kontrollojë sendin.**

38 Çesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 397; LMD i Kosovës, neni 11, ku thuhet “Doket afariste, uzansat dhe praktika e krijuar ndërmjet palëve duhet të merren në konsideratë për vlerësimin e sjelljes së kërkuar dhe efekteve të saj në marrëdhëniet e detyrimeve të subjekteve afarist”.

39 Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 63.

3. Kur kontrata parashikon pagimin kundrejt dorëzimit të dokumentit përkatës, blerësi nuk ka të drejtë të refuzojë pagimin e çmimit për shkak se nuk ka pasur mundësinë ta shikojë sendin.

459. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 459 rregullon rastin kur shitësi mund ta bëjë shtyrjen e dorëzimit të sendit, përkatësisht të rezervojë të drejtën e vet që blerësit të mos i dorëzohet sendi i shitur dhe i dorëzuar te transportuesi, derisa blerësi nuk e paguan çmimin e sendit të blerë dhe kjo vlen kur palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

459.1. Paragrafi 1 përcakton rastin kur dorëzimi i sendit realizohet kur ky i dorëzohet transportuesit; atëherë shitësi mund ta shtyjë dërgimin e sendit derisa të paguhet çmimi ose derisa ta dorëzojë sendin, ashtu që ta rezervojë të drejtën e disponimit të tij gjatë kohës së transportit. Kjo dispozitë e favorizon shitësin për të siguruar pagimin e çmimit nga blerësi dhe i mundëson që sendi të mos i dërgohet atij, domethënë ai ka të drejtë ta ndalë transportimin e sendit për të blerësi ose ta dërgojë sendin me një klauzolë me të cilën e rezervon të drejtën e disponimit të tij gjatë kohës së transportit. Kjo do të thotë se sendi, edhe pas dorëzimit të tij te transportuesi nga ana e shitësit, por edhe gjatë transportimit, ende konsiderohet i ndodhur në pronësi të shitësit, për shkak se ai ka të drejtë ta rezervojë të drejtën e disponimit të sendit, gjë që do të thotë se me sendin e vet mund të bëjë çfarë të dojë edhe gjatë kohës së transportit. Në momentin që blerësi e paguan çmimin e sendit të dorëzuar nga shitësi, i cili ka rezervuar të drejtën e disponimit të tij gjatë kohës së transportit, këtij të fundit i shuhet kjo e drejtë, kështu që nga momenti i pagimit të çmimit dhe mbasi dorëzimi i sendit ka qenë i rregullt, përkatësisht është bërë në vendin e shitësit, pronar i sendit gjatë transportit, ngaqë është paguar çmimi i tij, është blerësi.

459.2. Paragrafi 2 parashikon se kur shitësi ka rezervuar të drejtën e disponimit të sendit gjatë kohës së transportit, ai njëkohësisht mund të kërkojë që sendi të mos i dorëzohet blerësit në vendin e destinimit, derisa të mos e paguajë çmimin, ndërsa blerësi nuk ka për detyrim ta paguajë çmimin para se të ketë pasur mundësinë ta kontrollojë atë. Pra, disponimi i së drejtës për të mos iu dorëzuar sendi blerësit në vendin e destinimit, domethënë për të mos kaluar në pronësi të tij pa paguar çmimin, nuk e përjashton mundësinë që malli që ka arritur në vendin e destinimit të kontrollohet nga blerësi dhe pas kësaj t'i lindë e drejta për ta paguar çmimin e sendit të dorëzuar te blerësi, në vendin e destinimit. Pra, kur pagimi i çmimit është i varur edhe nga e drejta e blerësit që ta kontrollojë sendin e dërguar, atëherë si moment i pagimit të çmimit nuk është momenti kur është dorëzuar sendi te transportuesi, por do të jetë momenti kur blerësi ka pasur mundësinë ta kontrollojë sendin. Kjo do të thotë se ai bindet se bëhet fjalë për sendin për blerjen e të cilit është marrë vesh me shitësin, pra të mos ndodhë që në vend të një sendi, t'i vijë një send tjetër ose me cilësi të tjera dhe jo sipas marrëveshjes midis palëve.

459.3. Paragrafi 3, rregullon rastin kur në kontratën e shitblerjes parashikohet pagimi i çmimit kundrejt dorëzimit të dokumentit përkatës të dhënë nga shitësi, në bazë të

të cilin blerësi ka të drejtë ta marrë mallin si të dorëzuar dhe, në këtë rast, blerësi nuk ka të drejtë ta refuzojë pagimin e çmimit për shkakun se nuk ka pasur mundësi ta kontrollojë (ta shikojë) sendin. Kjo dispozitë përjashton të drejtën e blerësit që pagimin e çmimit ta bëjë gjithmonë pasi ta kontrollojë sendin e dorëzuar, kur nuk janë marrë vesh ndryshe me shitësin. Këto kanë të bëjnë me rastet kur blerësi e paguan çmimin në bazë të dokumentit të dorëzuar, fletëpagesës që e autorizon ta marrë mallin e blerë nga transportuesi ose, p.sh., kur bëhet fjalë për sendin e paketuar që nuk mund ta shohë (kontrollojë) aty për aty. Kjo ndodhë për shkak se shitësi e dorëzon dokumentin me të cilin blerësi mund ta marrë mallin dhe në këtë rast nuk mund ta refuzojë pagimin e çmimit për shkak se nuk ka pasur mundësinë ta shikojë sendin, por është i detyruar ta bëjë pagimin e çmimit, kur janë marrë vesh që çmimi të paguhet me dorëzimin e sendit përkatësisht me marrjen e dokumentit përkatës. Dokumenti përkatës paraqet një lloj dorëzimi simbolik të sendit, me të cilin sendi mund të merret.

Neni 460. Pengimi i dorëzimit të sendit të dërguar

- 1. Në qoftë se pas dërgimit të sendit vërtetohet se gjendja materiale e blerësit është e tillë sa që mund të dyshohet në mënyrë të bazuar se ai do të mund të paguajë çmimin, shitësi mund ta pengojë dorëzimin e sendit blerësit edhe atëherë kur blerësi ta ketë në dorë dokumentin që e autorizon të kërkojë dorëzimin e sendit.**
- 2. Shitësi nuk mund ta pengojë dorëzimin në qoftë se këtë e kërkon ndonjë person i tretë i cili është posedues i rregullt i dokumentit që e autorizon të kërkojë dorëzimin e sendit, përveç nëse dokumenti përmban kushte (rezerva) lidhur me efektin e bartjes së tij apo në qoftë se shitësi dëshmon se poseduesi i dokumentit ka vepruar qëllimisht në dëm të shitësit.**

460. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 460 rregullon pengimin e dorëzimit të sendit të dërguar, domethënë mosdorëzimin e sendit (i cili tashmë është dërguar) në duart e blerësit, respektivisht pengohet që blerësi të mos e krijojë pushtetin faktik derisa nuk bëhet pagimi i çmimit për sendin e blerë.

460.1. Paragrafi 1 parashikon se, edhe në rastet kur ka ndodhur dërgimi i sendit në mënyrë të rregullt, por që ende nuk ka arritur t'i dorëzohet blerësit, nëse vërtetohet se gjendja materiale (ekonomike) e këtij të fundit është e tillë që bën të dyshohet me të drejtë se ai nuk do të mund ta paguajë çmimin, p.sh., i ka të gjitha llogaritë e mbyllura (të bllokuara) ose firma e tij është në procedurë falimentimi; në këtë rast shitësi mund ta pengojë, përkatësisht mund të intervenojë që të ndalohet dorëzimi i sendit te blerësi edhe atëherë kur blerësi ta ketë në dorë dokumentin që e autorizon të kërkojë dorëzimin e sendit. Pra, në këtë rast blerësi, edhe pse mund ta posedojë dokumentin përkatës, përkatësisht dokumentin që e autorizon atë ta marrë sendin nga transportuesi, i cili e ka dërguar atë deri te vendi ku duhet të pranohet nga blerësi, prapë se prapë, duke u mbështetur në këtë dispozitë, e cila rregullon pengimin e dorëzimit të sendit, shitësi e ka

gjithmonë të drejtën ta pengojë dorëzimin e sendit te blerësi, kur provohet përkatësisht vërtetohet se gjendja materiale e tij është e tillë që e vë në pikëpyetje, përkatësisht krijon dyshim të bazuar se ai nuk mund ta paguajë çmimin për shkak të gjendjes së tij materiale. Ky paragraf përmban dispozitën e karakterit parimor, sepse në paragrafin vijues parashikohet një rast që ndalon pengimin e dorëzimit të sendit, kur dokumentin përkatës për dorëzimin e mallit e posedon ndonjë person i tretë.

460.2. Paragrafi 2 paraqet një përjashtim për pengimin e dorëzimit të sendit të dërguar, për shkak se dyshohet se blerësi nuk mund ta bëjë pagimin e çmimit të sendit të blerë. Ky paragraf parashikon shprehimisht se shitësi nuk mund ta pengojë dorëzimin, në qoftë se kërkon që sendi t'i dorëzohet personit të tretë i cili është posedues i rregullt i dokumentit që e autorizon të kërkojë dorëzimin e sendit. Kjo nënkupton se, kur kalimi i dokumentit te personi i tretë është i vlefshëm dhe personi i tretë është me mirëbesim (i ndërgjegjshëm), atëherë shitësi nuk mund ta pengojë dorëzimin e sendit një personi të tillë të tretë për shkak të gjendjes materiale të blerësit, që e bën të dyshimtë mundësinë e pagimit të çmimit për sendin që dorëzohet. Pra, në këtë rast, personi që kërkon dorëzimin e sendit në bazë të dokumentit përkatës, që i jep të drejtë të kërkojë dorëzimin e sendit nga shitësi, nuk është vetë blerësi, por një personi i tretë, i cili është posedues i rregullt i dokumentit, me të cilin autorizohet të kërkojë dorëzimin e sendit. Mirëpo, edhe paragrafi 2 i këtij neni parashikon përjashtimin lidhur me këtë rregull, sepse njeh edhe rastin kur kjo rregull nuk do të zbatohet, nëse dokumenti të cilin e posedon personi i tretë përmban kushte (rezerva) lidhur me efektin e bartjes së tij apo në qoftë se shitësi dëshmon se poseduesi i dokumentit ka vepruar qëllimisht në dëm të shitësit, për të realizuar efektin e paragrafit 1 të këtij neni. Pra, përjashtimi i parë ekziston kur dokumenti ka rezerve në pikëpamje të efektit të bartjes, gjë që nënkupton se, me rastin e dorëzimit të dokumentit përkatës, vihet rezerva se në cilat kushte mund të pengohet pranimi i mallit edhe kur dokumenti ndodhet në posedim të personit të tretë. Ndërkaq, përjashtimi i dytë ekziston atëherë kur personi i tretë, si posedues i dokumentit përkatës, në bazë të të cilit autorizohet ta marrë sendin e dërguar, (nëse ka vepruar qëllimisht në dëm të shitësit), do të thotë se këtë e ka bërë me qëllim që, përkundër gjendjes materiale të blerësit e me qëllim që ta dëmtojë shitësin, ka marrë dokumentin për pranimin e mallit. Në këtë rast, personi i tretë që ka për qëllim t'i shkaktojë dëm shitësit gjithmonë është i pandërgjegjshëm dhe atëherë kjo dispozitë e autorizon shitësin që të mos i dorëzohet sendi as personit të tretë, i cili dokumentin e posedon me qëllim të mbrojtjes së blerësit, por në dëm të shitësit.

NËNKREU 2 - PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT MATERIALE

I. TË METAT MATERIALE NË PËRGJITHËSI

Neni 461. Të metat materiale për të cilat shitësi përgjigjet

1. Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut në blerësin, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit.
2. Shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut në blerësin, në qoftë se janë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë.
3. E meta materiale e parëndësishme nuk merret parasysh.

461. Vështrim i përgjithshëm.- Përgjegjësia për të metat materiale të sendit, i cili është objekt i kontratës së shitblerjes, është njëra prej përgjegjësive të shitësit, i cili ka për detyrim që sendin ta shesë ashtu si janë marrë vesh, përkatësisht sendi nuk duhet të ketë të meta me rastin e dorëzimit të blerësi, në qoftë se këto të meta nuk janë kontraktuar. Përgjegjësia për të metat materiale rregullohet me dispozitat e LMD të Kosovës, me nenet 461-490. Edhe kodet civile të tjera e rregullojnë përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit⁴⁰. Në këtë pjesë përfshihen të metat materiale të sendit, për të cilat është përgjegjës shitësi i sendit, pastaj trajtohet ekzistimi i të metave materiale, për të cilat shitësi nuk përgjigjet, të metat e dukshme dhe të fshehta materiale të sendit; ndër të tjera, kjo pjesë rregullon edhe të drejtat e blerësit kur ekziston e meta materiale e sendit, pastaj sanksionon edhe përgjegjësinë e shitësit dhe të prodhuesit për të metat e sendit që janë pjesë e garancisë për funksionimin e rregullt të sendit të shitur etj. Nenet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë për të metat materiale të sendit, i cili është objekt i kontratës së shitblerjes, do të komentohen në mënyrë të detajuar (secili nen veç e veç). Përgjegjësia për të metat materiale, në fakt, përgjegjësia e debitorit për të metat materiale bëhet sipas kriterit objektiv dhe jo sipas atij subjektiv. Kjo nënkupton se për ekzistimin e përgjegjësisë për të metat materiale nuk është e nevojshme dashja ose pakujdesia, por ai përgjigjet, pa marrë parasysh fajësinë, me vetë faktin e ekzistimit të të metave⁴¹.

461.1. Paragrafi 1 e përcakton shprehimisht përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit të cilat i ka pasur në momentin e kalimit të rrezikut të blerësi, pavarësisht se shitësi kishte ose jo dijeni për të metat e sendit. Paragrafi 1 i neni 461 të LMD të Kosovës ka të bëjë gjithmonë me përgjegjësinë e shitësit, i cili nuk ka respektuar marrëveshjen në bazë të

.....
40 KCSH, neni 716, paragrafi 1, ku thuhet “Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërputhje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut tek blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti”, dhe paragrafi 2 “Shitësi është përgjegjës edhe për mospërputhjen që vërtetohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm e që vjen nga mospërmbyshja e një detyrimi çfarëdo të tij, duke përfshirë edhe garancinë sipas së cilës, për një periudhë të caktuar kohe sendet do të mbeten të përshtatshme për përdorimin e tyre normal ose për ndonjë përdorim të posaçëm, ose do të ruajnë cilësinë dhe karakteristikat e caktuara”.

41 Gorenc, Vilim & Slakoper, Zvonimir, Opci Dio Obveznog Prava, Zagreb, 2004, fq. 273.

së cilës ka marrë përsipër detyrimin që blerësit t'i dorëzojë sendin me cilësinë e kërkuar në kontratë. Përgjegjësia e shitësit ekziston gjithmonë për të metat materiale të sendit, të cilat i ka pasur në momentin kur përgjegjësia apo rreziku kalon te blerësi. Nuk është me rëndësi mirëbesimi, përkatësisht keqbesimi i shitësit, i cili e ka shitur sendin me të meta. Pra, edhe kur shitësi e ka ditur se sendi që kalohet te blerësi ka të meta materiale, por edhe kur nuk e ka ditur se sendi ka të meta materiale, ai do të përgjigjet për të metat materiale të tij. Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit, por sendi mund të ketë edhe të meta juridike, të cilat gjithashtu janë objekt i LMD të Kosovës në vazhdim. Përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit ka të bëjë dhe përfshin vetëm të metën materiale të dukshme ose të fshehtë, të cilën blerësi ka për detyrim ta zbulojë dhe në afat e në mënyrë të rregullt ta njoftojë shitësin, i cili duhet saktësisht të vërtetojë ekzistimin e të metës materiale dhe ta provojë se ajo ka ekzistuar në momentin e kalimit të rrezikut.

461.2. Paragrafi 2 e zgjeron përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit edhe për kohën pas kalimit të rrezikut te blerësi, vetëm nëse të metat e sendit janë pasojë e shkakut që ka ekzistuar më parë, domethënë para se të bëhet kalimi i rrezikut te blerësi për të metat e sendit. Kjo saktësisht nënkupton se e meta materiale e sendit, që shfaqet më vonë, pra në kohën kur zakonisht shitësi nuk është përgjegjës, ai do të përgjigjet për të metat e sendit edhe në këtë rast, nëse blerësi provon se shkak i ardhjes së të metës materiale të sendit më vonë ka ekzistuar (ka ndodhur) që në momentin kur sendi ende nuk kishte kaluar te blerësi, përkatësisht ende nuk ekzistonte kalimi i rrezikut te blerësi. Përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit ka të bëjë dhe përfshin vetëm të metën materiale të dukshme ose të fshehtë, të cilën blerësi ka për detyrim ta zbulojë dhe në afat dhe në mënyrë të rregullt ta njoftojë shitësin, i cili duhet saktësisht të vërtetojë ekzistimin e të metës materiale dhe ta provojë se e meta materiale e cila është shfaqur pas kalimit të rrezikut te blerësi dhe se e meta materiale është shkak që ka ekzistuar para kalimit të rrezikut.

461.3. Paragrafi 3 parashikon një zgjidhje, sipas së cilës, e meta materiale e parëndësishme nuk merret parasysh. Se çfarë konsiderohet e metë materiale e parëndësishme e sendit është një çështje faktike dhe vlerësohet sipas asaj se çka është e zakonshme në një mjedis të caktuar.

Neni 462. Kur ekzistojnë të metat materiale

1. E meta ekziston:

- 1.1. në qoftë se sendi nuk ka veçoritë e duhura për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim;**
- 1.2. në qoftë se sendi nuk ka veçoritë e duhura për përdorim special për të cilën e blen blerësi, e që e ka pasur të njohur shitësi, ose është dashur ta kishte të njohur;**
- 1.3. në qoftë se sendi nuk ka veçori dhe karakteristika të cilat janë kontraktuar shprehimisht ose heshtazi, përkatësisht që janë caktuar;**

1.4. kur shitësi e ka dorëzuar sendin që nuk i është përshtatur mostrës ose modelit, përveç nëse mostra ose modeli janë treguar vetëm për qëllime njoftimi.

462. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 462 përcakton rastet kur konsiderohet se sendi ka të meta materiale. Në këtë rast ekziston përgjegjësia e shitësit për të metat materiale deri në momentin e kalimit të rrezikut te blerësi, por edhe pastaj, në qoftë se shkak u lind para ose në momentin e kalimit të rrezikut te blerësi.

462.1. Paragrafi 1 i nenit 462 të LMD të Kosovës i numëron rastet kur konsiderohet se ekziston e meta materiale te sendi të cilin shitësi e ka lënë te blerësi në bazë të kontratës së shitblerjes. Ky paragraf numëron katër raste, që përcaktojnë ekzistimin e të metës dhe ato përfshihen në katër pikat e paragrafit të këtij neni. Paragrafi fillon me numër (1), me siguri për të arsyetuar pikat vijuese të këtij paragrafi⁴².

462.1.1. Pika 1 e këtij paragrafi parashikon se konsiderohet se sendi është me të meta, në qoftë se nuk ka veçoritë e duhura për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim. Kjo pikë e paragrafit 1 e nenit 462 nuk është aq e qartë sa kërkohet në këtë rast, sepse e metë e sendit konsiderohet nëse nuk ka veçoritë e duhura për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim, që janë dy shprehje shumë të përgjithshme dhe ato duhet të precizohen, përkatësisht duhet të tregohet se çka kuptohet me fjalën përdorim i rregullt i sendit ose veçori e duhur për qarkullimin e atij sendi. Përdorimi i rregullt i sendit nënkupton që ai t'i ketë ato veçori që të bëhet i përdorshëm ose të jetë i mjaftueshëm për qarkullim. Veçoritë e duhura për përdorim janë ato që e cilësojnë sendin se është i njëjtë me të gjitha sendet e tjera që kryejnë një veprim të njëjtë, kur përdoret në mënyrë të rregullt. Sendi i shitur është e nevojshme t'i ketë vetitë materiale që kërkohen për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullimin e të drejtës pa pengesa. Veçoritë e duhura të sendit që konsiderohet se pamundësojnë përdorimin e tij të rregullt kanë të bëjnë në radhë të parë me sasinë, cilësinë dhe tërësinë e tij. Pika 1 e paragrafit 1 të këtij neni, kur thotë veçoritë e duhura për përdorim të rregullt ose për qarkullim, mendon për vetitë sasiore që nënkuptojnë sasinë e kërkuar që mundëson realizimin e përdorimit të rregullt të sendit, p.sh., kërkohet dorëzimi i kamionit 5 tonësh ose 10 tonësh, kurse shitësi e dërgon kamionin 5 tonësh, dhe kjo është një veçori që nuk mundëson përdorimin e tij të rregullt, prandaj e meta materiale është e karakterit sasior. Ndërsa e meta do të jetë e karakterit cilësor kur është kërkuar që kamioni të jetë prodhim gjerman, për shkak të qëndrueshmërisë, kurse në vend të tij shitësi dorëzon një prodhim të njëjtë të një vendi tjetër me qëndrueshmëri më të dobët. Në këtë rast, bëhet fjalë për të metën cilësore. E meta mund të ketë të bëjë edhe me tërësinë e sendit, p.sh., dorëzohet kutia e shahut me mungesë të disa figurave. Këtu bëhet fjalë për të metën materiale për mangësitë e sendit në tërësinë e tij. Në këtë rast, përdorimi i sendit nuk mund të jetë i rregullt për shkak se mungojnë disa figura të shahut.

.....
⁴² Neni vijues (463) krijon huti te lexuesi sepse pikat e Paragrafit 1 të nenit 462, ai i quan "paragrafe", sepse nga përmbajtja e tekstit të nenit 462 nuk del se janë paragrafe por janë pikat e nenit 462 i cili përmban vetëm një paragraf.

462.1.2. Në pika 2 të këtij paragrafi konsideron se e meta ekziston edhe në qoftë se sendi nuk ka veçorinë e duhur për përdorim special, për të cilën e blen blerësi dhe këtë veçori që kërkohet për një send të tillë e ka pasur të njohur shitësi ose është dashur ta kishte të njohur. Kjo nënkupton se sendi ka mangësi kur nuk është me atë cilësi që mundëson përdorimin special të tij, për të cilin është i interesuar blerësi. Pra, shitësi ka pasur dijeni ose është dashur të kishte dijeni se blerësi nuk e kërkon sendin me veçori që mundësojnë përdorimin e rregullt të sendit, ai duhet të ketë cilësi, karakteristika të duhura për përdorim special, p.sh., blerja e makinës së shpimit me kapacitet shpimi prej mbi 100 metra thellësi, ndërsa makinat që plotësojnë veçoritë e duhura për përdorim të rregullt janë të gjitha ato që bëjnë shpimin e tokës më së shumti deri në 100 metra thellësi. Në literaturën juridike tërhiqet vërejtja që nuk duhet të përzihet dorëzimi i sendit tjetër dhe jo atë të kontraktuar, dhe sendit të përshtatshëm por me të meta.

462.1.3. Pika 3, ka të bëjë me rastin kur e meta materiale e sendit gjithmonë ekziston kur sendi nuk ka veçori dhe karakteristika të cilat janë kontraktuar shprehimisht ose heshtazi, përkatësisht janë caktuar. Kjo nënkupton se shitësi ka për detyrim t'ia dorëzojë blerësit sendin me cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar me kontratë dhe të vendosur e të ambalazhuar në mënyrën e caktuar në kontratë. Në këtë rast, sa herë që dorëzimi i sendit bëhet në kundërshtim me atë që është parashikuar në kontratë, përkatësisht sa herë që nuk i përmban ato veçori apo karakteristika që janë kontraktuar shprehimisht ose heshtazi, konsiderohet se sendi ka të meta materiale.

462.1.4. Pika 4 konsideron se ekziston e meta materiale e sendit edhe në rastet kur shitësi e ka dorëzuar sendin që nuk i përshtatet mostrës ose modelit, përveç nëse mostra ose modeli janë prezantuar ose treguar vetëm për qëllime njoftimi dhe jo për të treguar cilësinë e sendit i cili do t'i dorëzohet shitësit. Në shumicën e rasteve, blerësi kërkon t'i dorëzohet një mostër ose model që i referohet sendit që është objekt i kontratës së shitblerjes dhe nëse këto janë fakte në bazë të të cilave është porositur sendi, atëherë shitësi patjetër duhet t'i përmbahet mostrës, domethënë sasisë së marrë nga një send ekzistues, e cila shërben për të vlerësuar cilësinë e sendit në tërësinë e tij⁴³, ndërsa modeli është një sasi e sendit e cila prodhohet paraprakisht me qëllim vlerësimin e cilësisë së tij dhe për të nxjerrë përfundimin mbi cilësinë e sendit në tërësinë e tij⁴⁴. Nëse mostra dhe modeli janë ekspozuar sa për t'u njoftuar personat e interesuar, atëherë nuk mund të thuhet se ekziston e meta materiale e sendit të dorëzuar që nuk i është përshtatur mostrës ose modelit, por duhet të kërkohen rregulla të tjera për përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale, p.sh., lajthimi.

Neni 463. Të metat, për të cilat shitësi nuk përgjigjet

1. Shitësi nuk përgjigjet për të metat e specifikuar në paragrafët 1. dhe 3. nga neni paraprak në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ishte në dijeni për këto të meta, ose ato nuk kanë mund të jenë të panjohura për atë.

43 Skrame, Olti, Komentari i Kodit Civil, Vëllimi 2, Tiranë, 2011, fq. 271.

44 Skrame, Olti, Komentari i Kodit Civil, Vëllimi 2, Tiranë, 2011, fq. 271.

- 2. Konsiderohet se nuk kanë mund të jenë të panjohura për blerësin ato të meta të cilat një person i kujdesshëm, me dituri dhe përvojë mesatare të personit të mjeshtërisë dhe të profesionit të njëjtë sikur të blerësit do të mund t'i vërente lehtë gjatë shikimit të rëndomtë të sendit.**
- 3. Megjithatë, shitësi përgjigjet edhe për të metat të cilat blerësi ka mundur t'i vërente lehtë, në qoftë se shitësi ka deklaruar se sendi nuk ka kurrfarë të metash apo se sendi ka cilësi apo karakteristika të caktuara.**

463. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 463 i LMD të Kosovës përmban dispozitën me të cilën përjashtohet përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit. Përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit ekziston gjithmonë edhe kur ai ka dijeni për të metën materiale por edhe kur nuk ka dijeni për të metën materiale. Mirëpo, dispozitat parashikojnë rregulla të veçanta për rastin kur shitësi nuk ka pasur dijeni për të metat materiale të sendit dhe për këtë shitësi, pas kalimit të një afati të caktuar, lirohet nga përgjegjësia për të metat e sendit në kushtet e parashikuara me ligj. Një zgjidhje të tillë e parashikojnë edhe kodet civile të vendeve tjera⁴⁵.

463.1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se shitësi nuk përgjigjet për të metat që janë pasojë e mungesës së veçorive të duhura të sendit për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim (pika 1, paragrafi 1 i nenit 462) dhe që sendi nuk ka veçori që janë kontraktuar shprehimisht ose heshtazi, përkatësisht janë caktuar veçoritë dhe karakteristikat e sendit (pika 3, paragrafi 1 i nenit 462), në qoftë se blerësi, në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes, ishte në dijeni për të metat e përmendura në nenin 462, pika 1 dhe 3 ose ato nuk kanë mundur të jenë të panjohura për të. Dispozita e paragrafi 1 të nenit 463 e liron shitësin nga përgjegjësia për të metat materiale të sendit, kur e meta e tij konsiston në veçoritë e duhura për përdorimin e tij të rregullt ose për qarkullim dhe kur sendi nuk ka veçori dhe karakteristika të cilat janë kontraktuar shprehimisht ose heshtazi, ndërsa blerësi për këtë ka pasur dijeni ose është dashur të ketë dijeni nga rrethanat në të cilat është lidhur kontrata.

463.2. Paragrafi 2 përcakton se në cilat raste konsiderohet se për blerësin nuk kanë mundur të jenë të panjohura të metat materiale të sendit. Pra, ai parashikon shprehimisht se konsiderohet se nuk kanë mundur të jenë të panjohura për blerësin ato të meta që një person i kujdesshëm, me dituri dhe përvojë mesatare të profesionit të mjeshtërisë dhe të profesionit të njëjtë si të blerësit, do të mund t'i vërente lehtë gjatë shikimit të rëndomtë të sendit, p.sh., dallimi i ngjyrës së sendit të dërguar nga ana e blerësit gjatë kontrollimit të rëndomtë të tij, d.m.th., një blerës që ka njohuri mesatare për ngjyrat, nuk mund të kërkojë përgjegjësinë e shitësit se sendi ka të meta materiale. Pra, ajo që ka mundur të vihet re gjatë

.....
⁴⁵ KCSH, neni 717, paragrafi 1, parashikon se, “Blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit, në qoftë se nuk denoncon tek shitësi, duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi, përveç kur palët ose ligji kanë caktuar një afat tjetër”, dhe paragrafi 2 “Në çdo rast blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit, në qoftë se nuk e ushtron këtë të drejtë brenda dy vjetëve nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk është në kundërshtim me kohëzgjatjen e një garancie kontraktore”.

me një shikimi të rëndomtë, nuk mund të konsiderohet e metë materiale e sendit, sepse një të metë të tillë do ta kishte vërejtur çdo person i kujdesshëm, me dituri dhe përvojë mesatare në krahasim me blerësin. Në rastet kur blihet paluajtshmëri e një sipërfaqeje të rrethuar, pala blerëse duhet të marrë njohuri jo vetëm nga shitësi, por edhe nga regjistrat publikë ku është i regjistruar pronari dhe sipërfaqja e paluajtshmërisë⁴⁶.

463.3. Paragrafi 3 sanksionon përgjegjësinë e shitësit edhe për rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, me të cilin ai lirohet nga përgjegjësia për të metat materiale të sendit, nëse bëhet fjalë për të meta që blerësi ka mundur t'i vërente lehtë, por shitësi i ka deklaruar atij se sendi nuk ka kurrfarë të metash apo ka cilësi a karakteristika të caktuara. Kjo do të thotë se, edhe pse është bërë shikimi i rëndomtë i sendit që ka qenë objekt i marrëdhënies kontraktuese dhe konsiderohet se ato të meta kanë qenë të njohura për blerësin, shitësi, për faktin që ka deklaruar shprehimisht para blerësit se sendi nuk ka kurrfarë të metash materiale apo se ka cilësi a karakteristika të caktuara, ai prapë se prapë do të përgjigjet për të metat materiale të sendit të shitur.

Neni 464. Shikimi i sendit dhe të metat e dukshme

- 1. Blerësi ka për detyrë që sendin e pranuar ta shikojë ose ta japë në shikim sapo kjo të jetë e mundur sipas rrjedhës së rregullt të gjërave dhe për të metat e dukshme ta lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh, ndërsa te kontratat midis ndërmarrësve pa shtyrje përndryshe e humb të drejtën që i takon mbi këtë bazë.**
- 2. Kur kontrollimi të jetë bërë në prani të të dy palëve, blerësi është i detyruar që vërejtjet e veta për të metat e dukshme t'ia komunikojë shitësit menjëherë, përndryshe e humb të drejtën e cila i takon mbi këtë bazë.**
- 3. Në qoftë se blerësi e ka nisur më tutje sendin pa shkarkim, ndërsa shitësi e ka ditur ose është dashur ta dijë mundësinë e dërgimit të mëtutjeshëm, shikimi i sendit mund të shtyhet derisa të arrijë në destinacionin e ri dhe në atë rast blerësi është i detyruar ta lajmërojë shitësin për të metat sapo sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ka mundur të merr vesh për to nga klientët e vet.**

464. Vështrim i përgjithshëm. - Neni 464 përmban dispozita lidhur me shikimin (kontrollimin) e sendit dhe të metat materiale të sendit të cilat janë të dukshme. Pra, kjo përcakton detyrimin e blerësit që të bëjë shikimin e sendit më së voni deri në momentin e pranimit

⁴⁶ Shih : Aktgjykimin e Gjykatës Komonale Zagreb, Gžn. 1481/10 od 22. ozujka 2011.g, ku ndër të tjera thuhet: “Duke u nisur nga ajo se paditësja ka blerë paluajtshmëri, ashtu që i paditur ia ka bërë të njohur sipërfaqën e tokës e cila ka qenë e rrethuar, pa e shikuar gjendjen në libra të tokës, Gjykata përfundon se blerësit nuk ka mundur t'i mbeten të panjohura të metat, sepse shikimi i gjendjes në librat e tokave të paluajtshmërisë, që është objekt i shitblerjes, paraqet mënyrë të rregullt të shikimit të gjërave të tilla dhe askush nuk mund t'i referohet faktit se gjendja në librat e tokave nuk i ka qenë e njohur, prandaj shitësi, në pajtim me dispozitat e nenit 479, paragrafi 1 dhe 3 të LMD të Kroacisë, nuk do të ishte përgjegjës për të metat materiale të sendit”.

të tij. Në qoftë se e ka shikuar sendin, domethënë ka bërë kontrollimin e sendit të blerë, atëherë shitësi nuk do të përgjigjet për të metat materiale të sendit, të cilat parashikohen në nenin 462 të LMD të Kosovës, paragrafi 1, pika 1 dhe 3. Kjo dispozitë kërkon nga shitësi që, pas shikimit përkatësisht kontrollimit, të metat materiale të dukshme të sendit që është objekt i kontratës, duhet të paraqiten menjëherë.

464.1. Paragrafi 1 i nenit 464 të LMD të Kosovës parashikon se blerësi ka detyrimin që sendin e pranuar ta shikojë vetë ose t'ua japë për shikim personave të kualifikuar për të, në momentin kur kjo bëhet e mundur, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave, kurse, pas shikimit, blerësi ka detyrimin që për të metat e dukshme ta lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh, domethënë e njofton shitësin për të metat materiale të sendit të dërguar, të cilat, për nga natyra, janë të dukshme. Kjo do të thotë që, me kalimin e kohës prej 8 ditësh, nuk mund t'i referohet përgjegjësisë së shitësit për të metat e dukshme, për shkak se e drejta e tij parashkruhet. Kjo dispozitë përmban edhe një pjesë tjetër, sipas së cilës, kur bëhet fjalë për kontrata të lidhura mes ndërmarrësve, kjo bëhet pa shtyrje, përndryshe humbet e drejta që i takon mbi këtë bazë. Të metat materiale të dukshme janë ato që kanë mundur të vërehen përmes shikimit të rëndomtë. Në literaturën juridike thuhet se mungesa materiale duhet të jetë e tillë që mund të zbulohet me shikim të zakonshëm gjatë pranimit të sendit të shitur⁴⁷. Shikimi i rëndomtë i sendit nga blerësi ose përmes personit të tretë (që ka dijeni për shikimin e sendeve të tilla), nuk është i sqaruar mirë, sepse shprehja “shikim i rëndomtë”, përveç që ka kuptim të ngushtë, mund të ketë edhe kuptim të gjerë. Lidhur me këtë, në literaturën juridike thuhet se nocioni i shikimit të zakonshëm nënkupton mënyrën e kontraktuar të shikimit, kur ndonjë mënyrë e shikimit ka qenë e kontraktuar dhe nuk ka ndodhur, çdo shikim tjetër është shikim i zakonshëm i sendit që është objekt i shitblerjes⁴⁸.

464.2. Paragrafi 2 parashikon se, nëse kontrollimi i sendit që është objekt i shitjes është bërë në prani të të dy palëve, atëherë blerësi është i detyruar që vërejtjet që i lidh me sendin me të meta të dukshme materiale, t'ia komunikojë shitësit menjëherë, përndryshe e humb të drejtën që i takon mbi këtë bazë. Ky paragraf parashikon se, çdoherë kur kontrollimi përkatësisht shikimi i sendit të blerë bëhet në prani të dy palëve – të shitësit dhe të blerësit dhe në këtë rast blerësi ka për detyrim që menjëherë, pra nuk ka afat tjetër përveç atij momental, që të metat e dukshme t'ia komunikojë shitësit, përndryshe, nëse nuk e bën vërejtjen aty për aty për të metat e dukshme të sendit, ai e humb të drejtën të kërkojë përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit, të cilat janë të dukshme, për shkak se nuk i ka bërë vërejtjet e veta, përkatësisht nuk ia ka komunikuar shitësit vërejtjet lidhur me sendin menjëherë. Në rastet kur kontrollimi bëhet në prezencën e të dy palëve, dispozita kërkon që blerësi menjëherë t'i bëjë vërejtjet për të metat materiale të dukshme dhe ta njoftojë shitësin, përndryshe e humb të drejtën që të kërkojë përgjegjësinë e tij në bazë të kësaj dispozite.

.....
47 Georgiev, Pop, vepra e cituar, fq. 31.

48 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 635.

464.3. Paragrafi 3 parashikon se, në qoftë se blerësi e ka nisur sendin e pranuar pa e shkarkuar, pra ka vazhduar ta transportojë atë, ndërsa shitësi e ka ditur ose është dashur të dijë për mundësinë e dërgimit të mëtutjeshëm, përkatësisht vazhdimin e transportimit pa shkarkim deri në destinacion të ri, atëherë shikimi i sendit mund të shtyhet derisa të arrijë atje dhe, në këtë rast, blerësi është i detyruar ta lajmërojë shitësin për të metat (sipas rrjedhës së rregullt të gjërave), sapo të ketë marrë vesh për këtë nga klientët e vet. Kjo do të thotë se, kur kemi të bëjmë me vazhdimin e transportit të sendit pa e shkarkuar deri te klientët që janë blerës të ri të tij, afati për të kërkuar përgjegjësinë e shitësit për të metat e dukshme materiale të sendit nuk është 8 ditë, por është i lidhur me rrjedhën e rregullt të gjërave, pra kur blerësi mëson për të metat materiale të sendit nga klientët e vet, domethënë nga personat që e kanë blerë sendin për nevojat e veta apo për shitje të mëtutjeshme. Në këtë rast, shikimi i sendit të shitur me të meta materiale të dukshme nuk realizohet nga blerësi, por nga klientët e blerësit, nga të cilët ai mëson për të metat materiale të sendit dhe në këtë rast blerësi, me të marrë vesh për të metat, duhet ta lajmërojë shitësin. Koha, brenda së cilës shitësit duhet të lajmërohet për të metat e sendit është një çështje faktike, sepse varet nga rrjedhja e rregullt e gjërave, pra nga koha e transportit të mëtutjeshëm, përkatësisht nga shikimi prej klientëve të blerësit, domethënë nga mundësia që kanë pasur këta ta shikojnë sendin e blerë me të meta të dukshme dhe pastaj ta lajmërojnë blerësin fillestar se sendi që e kanë marrë ka të meta të dukshme materiale si dhe nga koha e nevojshme që i duhet blerësit t'i drejtohet shitësit për vërejtjet që i ka marrë nga klientët e vet lidhur me të metat materiale të sendit. Afatet brenda të cilit blerësi duhet ta lajmërojë shitësin për të metat e vërejtura janë të karakterit prekluziv, prandaj me kalimin e afatit për lajmërim të rregullt, blerësi humb të drejtën që i takon për përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit; karakteri prekluziv vlen vetëm për rastin kur shitësi nuk ka ditur për të metën e sendit dhe kur nuk ka mundur të dijë për të metën e tij, sepse vlejné rregulla të tjera kur shitësi ka ditur për të metën e sendit ose është dashur të dijë për të, në të cilin rast nuk vlen afati prekluziv, që u përmend në këtë nen⁴⁹.

Neni 465. Të metat e fshehta

- 1. Kur pas marrjes së sendit nga blerësi shihet se sendi ka ndonjë të metë e cila nuk ka mundur të zbulohet me shikim të rëndomtë me rastin e marrjes së sendit (e meta e fshehtë), blerësi është i detyruar me kërcënim të humbjes së të drejtës, që për atë të metë të lajmërojë shitësin në afat prej tetë (8) ditësh duke llogaritur prej ditës kur e ka zbuluar të metën, ndërsa te kontrata midis ndërmarrësve menjëherë.**
- 2. Shitësi nuk përgjigjet për të metat të cilat shfaqen pasi të kalojnë gjashtë (6) muajve nga dorëzimi i sendit, përveç nëse me kontratë është caktuar ndonjë afat më i gjatë.**

465. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 465 përmban dispozita me të cilat parashikohet se si caktohet përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit, të cilat konsiderohen

⁴⁹ Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 636.

të meta të fshehta. Nëse e meta materiale e sendit nuk mund të zbulohet me shikim të zakonshëm, kjo konsiderohet e metë e fshehtë materiale e sendit. Pra, ky ligj përmban edhe dispozitën për të metat materiale të fshehta që mund t'i ketë sendi. E meta e fshehtë është ajo që, edhe pas shikimit profesional të tij, nuk ka mundur të vërehet, pra jo vetëm ajo që nuk ka mundur të vërehet me rastin e blerjes, kur bëhet shikimi i rëndomtë.

465.1. Paragrafi 1 parashikon se, kur pas marrjes së sendit nga ana e blerësit, shihet që ai ka ndonjë të metë që nuk ka mundur të zbulohet me shikim të rëndomtë me rastin e pranimit të tij, e cila në ligj quhet e metë e fshehtë, kur blerësi është i detyruar që, me kërcënim të humbjes së të drejtës, për atë të metë të fshehtë ta lajmërojë shitësin në afat prej 8 ditësh, nga dita e zbulimit të saj, ndërsa te kontratat e lidhura mes ndërmarrësve, lajmërimi duhet të bëhet menjëherë, pra nuk ka afat të dytë sikurse në rastin e parë. Kjo dispozitë, pra, parashikon se, kur sendi i blerë nga shitësi ka të meta materiale, atëherë afati nuk fillon nga momenti i pranimit të mallit, kur kërkohet të bëhet edhe shikimi i rëndomtë i sendit të blerë, siç është rasti për të metat materiale të dukshme, por në rastin e të metave të fshehta afati prej 8 ditësh për lajmërimin e shitësit nga ana e blerësit për të metën e zbuluar, e cila konsiderohet e fshehtë, është, po ashtu, 8 ditë dhe ky afat fillon të rrjedhë prej ditës kur është zbuluar e meta. Mirëpo, në qoftë se kontrata është mes ndërmarrësve, domethënë, subjekteve që merren me qarkullimin e mallrave të tilla, atëherë lajmërimi për të metat e fshehta duhet të bëhet menjëherë, sepse përndryshe humb baza e blerësit, mbi të cilën ky mund të kërkojë përgjegjësi nga shitësi për të metën materiale të fshehtë të sendit të shitur. Shitësi përgjigjet edhe në rastet kur me marrëveshje parashikohet blerja e sendit me shikim, domethënë nëse kontraktohet blerja me shikimin e sendit në momentin e blerjes nga ana e blerësit. Kjo do të thotë se nuk mund të përjashtohet përgjegjësia e shitësit për sendet me të meta materiale, edhe pse është kontraktuar shitja me shikim të sendit⁵⁰.

465.2. Paragrafi 2 i këtij neni e përjashton përgjegjësinë e shitësit për të metat e fshehta, të cilat shfaqen pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i sendit. Edhe për këtë rregull ekziston përjashtimi, sipas të cilit përgjegjësia e shitësit do të ekzistojë edhe pas kalimit të 6 muajve, nëse në kontratën e palëve është caktuar shprehimisht ndonjë afat më i gjatë, p.sh., kur shitësi do të përgjigjet për të metat e fshehta të cilat mund të shfaqen

50 Shih aktgjykimin e Gjykatës së Rrethit Varazhdin (Županijski sud u Varaždinu), Gž. 566/03-2 od 06. svibnja 2003, në të cilin thuhet "Edhe pse vetura është e blerë "me shikim", shitësi përgjigjet për të metat materiale të cilat nuk kanë mundur të zbulohen me kontrollim të rëndomtë, nëse ka pohuar se vetura nuk ka kurfarë të metash". Aktgjykimi mbështetet në arsyetimin se, as rrethana e përmbajtjes së dokumentit që është bërë me rastin e lidhjes së kontratës ku parashikohet se blerësi blen veturën me shikim në gjendjen të cilën e ka gjetur dhe nuk ka kurfarë vërejtje lidhur me kualitetin e saj, përkatësisht çmimin e blerjes të cilin i padituri (shitësi) në veçanti e thekson në ankesë, nuk e përjashton përgjegjësinë e të paditurit, si shitës, për të metat e sendit të shitur, për shkak se nga përmbajtja e procedurës së shkalës së parë del se pa dyshim bëhet fjalë të metën e cila nuk ka mundur të zbulohet me një shikim të rëndomtë me rastin e marrjes së veturës, gjegjësisht me një vozitjen provuese, prandaj. Në një situatë të tillë, i padituri përgjigjet për të metën e fshehtë, e cila është zbuluar gjatë shfrytëzimit të rregullt të veturës, sidomos për faktin se, me rastin e lidhjes së kontratës, shitësi ka pohuar se vetura nuk ka kurfarë të metash dhe për shkak se i padituri nuk ka reaguar me njoftimin e rregullt të paditësit për të metën e fshehtë, paditësit i takon e drejta e zgjidhjes së kontratës...dhe i padituri detyrohet ta kthejë shumën e paguar të çmimit dhe të bëjë shpërbllimin e shpenzimeve që janë dashur për e çeljen e makinës për të konstatuar prishjen e veturës.

pas 1 viti, llogaritur nga dita e dorëzimit të sendit. Pra, shitësi nuk përgjigjet për të metat e fshehta të sendit, nëse ato lajmërohen (zbulohen) pas gjashtë (6) muajve, llogaritur nga dorëzimi i sendit, megjithëse blerësi mund të lajmërojë për të metën e fshehtë edhe pas këtij afati, nëse ajo paraqitet dhe konstatohet para kalimit të ditës së fundit të muajit të gjashtë (6), përveç kur blerësit i ka qenë e njohur e meta. Kjo do të thotë se kundërshtimet lidhur me të metat e fshehta nuk mund të bëhen pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muajve nga dita e pranimit të sendit, sepse ky afat është afat prekluziv, por blerësi mund të jetë i mbrojtur me afatin garantues të kontraktuar.

Neni 466. Afatet në rast riparimi, zëvendësimi, etj

Kur për shkak të ndonjë të mete janë bërë riparime të sendit, dërgimi i sendit tjetër, zëvendësimi e të ngjashme fillojnë afatet e dy neneve paraprake fillojnë të rrjedhin që nga dorëzimi i sendit të riparuar, dorëzimi i sendit tjetër, zëvendësimi i pjesëve e të ngjashme.

466. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 466 përmban dispozitën lidhur me afatet në rast të riparimit, përkatësisht të zëvendësimit të sendit me të meta materiale etj. Në këto raste, e drejta e blerësit që të kërkojë përgjegjësi nga shitësi nuk lidhet për momentin e dorëzimit të sendit, i cili ndërkohë është riparuar ose është zëvendësuar, por afati fillon të rrjedhë prej momentit kur dorëzohet sendi i riparuar, përkatësisht sendi i zëvendësuar, që i nënshtrohet shikimit të rëndomtë për të metat e dukshme, përkatësisht kur bëhet ridërgimi pa shkarkim, kështu që shikimi i rëndomtë bëhet në momentin kur sendin me të meta materiale e pranojnë klientët e blerësit. Ky nen parashikon shprehimisht se, kur për shkak të ndonjë të mete, janë bërë riparime të sendit apo është dërguar sendi tjetër si zëvendësim për sendin me të meta materiale apo ka ndodhur ndonjë zëvendësim tjetër i ngjashëm, atëherë afatet fillojnë të rrjedhin që nga dorëzimi i sendit të riparuar dhe e meta është e dukshme, atëherë afati është 8 ditë nga shikimi i rëndomtë i sendit të dërguar të riparuar apo të zëvendësuar ose 8 ditë nga dita kur është zbuluar e meta e fshehtë e sendit. Kjo do të thotë se, këto afate vlejné kur shitësi nuk ka pasur dijeni për të metat materiale të sendit. Afati mbetet i njëjtë, në qoftë se këto sende janë objekt i kontratës midis ndërmarrësve. Në këtë rast, afati për të lajmëruar të metën e sendit duhet të bëhet menjëherë nga dita e dorëzimit të sendit me të meta materiale të dukshme në bazë shikimit të rëndomtë, përkatësisht nga dita e zbulimit të të metave materiale të fshehta të sendit të riparuar ose të zëvendësuar. Gjithashtu, nuk përjashtohet afati 6 mujor në bazë të të cilit lirohet shitësi nga përgjegjësia për të metat të cilat shfaqen pas këtij afati, përveç nëse me kontratë është caktuar ndonjë afat më i gjatë i parashikuar në nenin 465, paragrafi 2.

Neni 467. Njoftimi për të metën

- 1. Në njoftimin mbi ekzistimin e të metës së sendit, blerësi ka për detyrë ta përshkruajë të metën hollësisht dhe ta ftojë shitësin ta kontrollojë sendin.**
- 2. Në qoftë se njoftimi për ekzistimin e të metës, të cilin blerësi ia ka dërguar me kohë shitësit me letër rekomande, me telegram ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurt vonohet ose nuk arrin fare deri te shitësi, do të konsiderohet se blerësi e ka kryer detyrimin e vet për ta njoftuar shitësin.**

467. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 467 i LMD të Kosovës, në dy paragrafët e tij, rregullon njoftimin për të metën materiale të sendit.

467.1. Paragrafi 1 përcakton shprehimisht se blerësi, i cili e njofton shitësin për ekzistimin e të metës së sendit, ka për detyrë ta përshkruajë të metën hollësisht dhe ta ftojë shitësin ta kontrollojë sendin. Njoftimi për ekzistimin e të metës së sendit duhet të bëhet në afatin e parashikuar në nenet 464, 465 dhe 466 të LMD të Kosovës nga ana e blerësit, i cili njëkohësisht ka për detyrë ta përshkruajë në mënyrë të hollësishme të metën e sendit për të cilën njoftohet shitësi. Me rastin e njoftimit për ekzistimin e të metës së sendit, blerësi, përveç që bën njoftimin e hollësishëm të së metës së sendit, kërkohet ta ftojë shitësin ta kontrollojë sendin e vet të shitur, për shkak se blerësi e njofton për ekzistimin e të metës së sendit.

467.2. Paragrafi 2 parashikon se, në qoftë se njoftimi për ekzistimin e të metës materiale të sendit, të cilin blerësi ia ka dërguar me kohë shitësit me letër rekomande ose me telegram ose në një mënyrë tjetër të sigurt, vonohet ose nuk arrin fare deri te shitësi, do të konsiderohet se blerësi e ka kryer detyrimin e vet për ta njoftuar shitësin. Kjo do të thotë që, pa marrë parasysh që shitësi nuk e ka marrë njoftimin për ekzistimin e të metës përmes letrës rekomande ose telegramit a në një mënyrë tjetër të ngjashme dhe nëse në këtë rast njoftimi vonohet ose nuk arrin fare te shitësi, do të merret se blerësi e ka kryer detyrimin e vet për ta njoftuar shitësin.

Neni 468. Rëndësia e faktit se shitësi ka qenë në dijeni për të metën

Blerësi nuk e humb të drejtën që të thirret në ndonjë të metë edhe kur nuk e kryen detyrimin e vet që sendin ta shikojë pa shtyrje ose detyrimin që brenda afatit të caktuar ta njoftojë shitësin mbi ekzistimin e të metës, si dhe kur e meta të jetë shfaqur vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i sendit, po që se për këtë të metë shitësi ka qenë në dijeni apo nuk ka mundur të mos jetë në dijeni.

468. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 468 përmban dispozitën, sipas së cilës, kur shitësi i sendit ka pasur dijeni për të metën e sendit të shitur, e drejta e blerësit që të kërkojë

përgjegjësini e tij nuk lidhet me afatet e përmendura në nenet 464 dhe 465 të LMD të Kosovës, sepse, në këtë rast, blerësi nuk e humb të drejtën që t'i referohet ndonjë të metë edhe atëherë kur nuk e ka zbatuar detyrimin e vet që, me rastin e pranimit, ta shikojë sendin e blerë pa shtyrje ose nuk e ka përmbushur as detyrimin që, brenda afatit të caktuar, ta njoftojë shitësin për ekzistimin e të metës, por edhe kur e meta është shfaqur pasi të kenë kaluar 6 muaj nga dorëzimi i sendit, po që se për këtë të metë shitësi ka qenë në dijeni ose nuk ka mundur të mos jetë në dijeni. Në rastet kur shitësi ka ditur ose ka mundur të dijë për të metat materiale të sendit dhe nuk e ka njoftuar blerësin për to, konsiderohet se ai nuk e ka respektuar parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, kështu që, në këtë rast, shitësi konsiderohet person me keqbesim. Të drejtat e blerësit që dalin nga marrëdhëniet e detyrimeve janë të drejta relative, pra të drejta të cilat mund të parashkruhen dhe kjo e kushtëzon blerësin që edhe për këtë rast të parashtrijë padi brenda një kohë të caktuar për përgjegjësini e shitësit lidhur me sendin me të meta materiale, kur shitësi ka pasur dijeni ose ka mundur të dijë për të metat e sendit, ashtu që mos të ndodhë parashkrimi i kërkesës së blerësit, i cili ka cilësinë e kreditorit. Në këtë rast do të vlejnjë afatet e parashikuara me institutin e parashkrimit të kërkesave të parashikuara në këtë Ligj⁵¹.

Neni 469. Kufizimi kontraktues ose përjashtimi i përgjegjësies së shitësit për të metat materiale

- 1. Kontraktuesit mund ta kufizojnë ose ta përjashtojnë krejtësisht përgjegjësini e shitësit për të metat materiale të sendit.**
- 2. Dispozita e kontratës mbi kufizimin ose përjashtimin e përgjegjësies për të metat e sendit është nule në qoftë se e meta ka qenë e njohur për shitësin, ndërsa ai për këtë gjë nuk e ka njoftuar blerësin, si dhe kur shitësi e ka imponuar këtë dispozitë duke e shfrytëzuar pozitën dominuese.**
- 3. Blerësi i cili ka hequr dorë nga e drejta për ta zgjidhur kontratën për shkak të të metave të sendit, mban të drejtat e tjera nga ato të meta.**

469. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 469 parashikon mundësinë që palët, me marrëveshje, pra përmes kontratës, mund ta kufizojnë apo ta përjashtojnë në tërësi përgjegjësini e shitësit për të metat materiale të sendit dhe, në këtë rast, edhe kur sendi ka të meta materiale, nuk do të ekzistojë përgjegjësia e shitësit, për shkak se palët janë marrë vesh që të mos ketë përgjegjësi ose përgjegjësia të jetë e kufizuar.

469.1. Paragrafi 1 parashikon që kontraktuesit, pra shitësi dhe blerësi, mund ta kufizojnë ose ta përjashtojnë krejtësisht përgjegjësini e shitësit për të metat materiale të sendit. Shprehja “ta kufizojnë përgjegjësini e shitësit për të metat materiale të sendit” nënkupton se palët mund të caktojnë vetë kritere se për cilat të meta shitësi do të ketë përgjegjësi dhe, në këtë rast, blerësi mund të kërkojë përgjegjësini e shitësit vetëm për të metat e sendit, për të cilat

51 LMD i Kosovës, nenet 341-374.

janë marrë vesh. Ndërkaq, shprehja “se palët kontraktuese merren vesh ta përjashtojnë krejtësisht përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit” nënkupton se në këtë rast përjashtohet instituti i përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale të sendit.

469.2. Paragrafi 2 përcakton se dispozita mbi kufizimin ose përjashtimin e përgjegjësisë për të metat e sendit është nule (absolutisht e pavlefshme), në qoftë se e meta ka qenë e njohur për shitësin, i cili nuk e ka njoftuar blerësin për të, si dhe kur shitësi e ka imponuar këtë dispozitë, duke e shfrytëzuar pozitën e vet dominuese. Kjo dispozitë e mbron shprehimisht blerësin edhe në rastet kur ekziston kontrata për kufizimin apo mospërgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit, nëse shitësi ka ditur për to, gjë që do të thotë se blerësi mbrohet me dispozitë detyruese në rastet kur shitësi dhe blerësi lidhin kontratë me të cilën përjashtohet përgjegjësia për të metat materiale të sendit, përkatësisht nëse blerësi i është nënshtruar pozitës dominuese të shitësit. Në këtë rast, nëse shitësi ia imponon vullnetin e vet blerësit, kjo do të thotë se shkelet parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë. Shitësi, për të realizuar marrëveshjen, përkatësisht kontratën për kufizimin ose përjashtimin e përgjegjësisë së shitësit për të metat e sendit, duhet të mos e fsheh të metën me rastin e lidhjes së kontratës si dhe i ndalohet që ta keqpërdorë pozitën dominuese të tij ndaj blerësit. Shitësi ka rol dominues, kur ai e ka monopolin për shitjen e sendeve të tilla dhe blerësi ka qenë i detyruar ta pranojë kontratën me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit. Nule është si pjesa e kontratës që ka të bëjë me përjashtimin e përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale të sendit, ashtu edhe dispozita me të cilën kufizohet përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit. Të provuarit se shitësi ka pasur dijeni për të metat materiale të sendit, përkatësisht se ai e ka shfrytëzuar pozitën dominuese me rastin e lidhjes së kontratës për përjashtimin, përkatësisht kufizimin e përgjegjësisë së shitësit për të metat e sendit të shitur, është një çështje faktike dhe kërkohet të provohet nga ana e blerësit. Kontratat nule mund të kërkohet të shpallet e pavlefshme brenda kohës sa zgjatë e drejta e blerësit kundrejt përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale të sendit, sepse, pas kalimit të këtij afati, kjo kontratë është pa efekt juridik. Shitësi nuk mund t’i referohet dispozitës e cila tërheq pavlefshmërinë absolute (nule) duke u mbështetur në kontratën për kufizimin ose përjashtimin e përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale të sendit të shitur.

469.3. Paragrafi 3 përmban dispozitën, sipas së cilës blerësi, i cili ka hequr dorë nga e drejta për ta zgjidhur kontratën për të metat e sendit, pra nuk kërkon pavlefshmërinë e dispozitave për kufizimin përkatësisht përjashtimit të përgjegjësisë së shitësit për të metat, duke hequr dorë të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave të sendit, ruan të drejtat e tjera lidhur me ato të meta materiale të sendit. Në këtë rast, blerësi, kur heq dorë nga zgjidhja e kontratës për shkak të të metave të sendit, ka të drejtë t’i realizojë të drejtat e tjera, të cilat i takojnë për shkak se ekzistojnë të metat materiale të sendit, p.sh., ndryshimi i çmimit të blerjes, shkaktimi i dëmit etj.

Neni 470. Përmbartimi i dhunshëm

Poseduesi, sendi i të cilit shitet në një ankand publik të dhunshëm nuk përgjigjet për të metat e sendit.

470. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 470 përmban dispozitën me të cilën përcaktohen pasojat e sendit me të meta materiale, që është objekt i përmbartimit të detyrueshëm (shitjes së dhunshme). Kjo dispozitë parashikon shprehimisht se mbajtësi, përkatësisht poseduesi i sendit, i cili shitet në një ankand publik të dhunshëm, nuk përgjigjet për të metat materiale të tij. Pra, në çdo rast, kur sendi shitet kundër dëshirës së pronarit, përkatësisht poseduesit të tij dhe kjo shitje ndodh në procedurën përmbartuese (përmbartimi i dhunshëm), blerësi i këtij sendi nuk mund t'i referohet përgjegjësisë së poseduesit për të metat materiale të sendit të shitur në ankandin publik. Shitja publike e dhunshme nënkupton se sendi që shitet nuk është i ri, por një send i përdorur deri tani dhe këto fakte blerësve të mundshëm u janë të njohura dhe te blerja e sendit në ankand publik nuk ekziston parimi i ekuivalencave të vlerave për sendet e shitura, sepse përjashtohet parimi i anulimit të kontratës për shkak të dëmtimit përtej gjysmës⁵². Ndaj poseduesit të sendit të luajtshëm ose të paluajtshëm që shitet në një ankand publik të dhunshëm, nuk zbatohen dispozitat për përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale. Pra, në këtë rast, poseduesi i një sendi të tillë të shitur në ankandin publik të dhunshëm nuk përgjigjet as për të metat materiale të sendit, as për të metat juridike të tij.

II. TË DREJTAT E BLERËSIT

Neni 471. Të drejtat e blerësit

- 1. Blerësi i cili e ka njoftuar shitësin me kohë dhe në mënyrë të rregullt mbi të metën, mundet:**
 - 1.1. të kërkojë nga shitësi që të metën ta mënjanojë, ose t'ia dorëzojë sendin tjetër pa të meta (përmbushja e kontratës);**
 - 1.2. të kërkojë zbritjen e çmimit;**
 - 1.3. të deklarojë zgjidhjen e kontratës.**
- 2. Në secilin nga këto raste blerësi ka të drejtë për shpërblimin e demit.**
- 3. Përpos kësaj dhe pavarësisht nga kjo, shitësi i përgjigjet blerësit edhe për dëmin të cilin e ka pësuar ky për shkak të të metave të sendit në të mirat e tjera të veta, dhe këtë sipas rregullave të përgjithshme mbi përgjegjësinë për dëmin.**

471. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 471 përmban dispozita me të cilat parashikohet se cilat janë të drejtat e blerësit, kur janë plotësuar kushtet e parashikuara për përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit të shitur.

⁵² Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 644.

471.1. Paragrafi 1 parashikon se, në rastin kur blerësi e ka njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt shitësin për të metën materiale të sendit, ai mund t'i realizojë të drejtat e parashikuara në pikat 1, 2, 3 të paragrafit 1 dhe në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

471.1.1. Pika 1 e paragrafi 1 të këtij neni i jep të drejtë blerësit që të kërkojë nga shitësi ta mënjanojë të metën materiale nga sendi i shitur me të metë ose t'ia dorëzojë një send tjetër pa të meta, domethënë ta bëjë zëvendësimin e sendit me të meta me një send pa të meta të llojit dhe të cilësisë së njëjtë. Kjo pikë paraqet mundësinë më të arsyeshme për heqjen apo shmangien e të metës materiale, përkatësisht për përmbushjen e rregullt të kontratës. Pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit 1 të nenit 471 duhen shikuar si tri autorizime të mundshme për blerësin, sepse shitësi ka të drejtë të zgjedhë njërën nga tri mundësitë për të korrigjuar të metën materiale të sendit. E para, siç thamë, parashikohet në pikën 1 të paragrafit 1 të këtij neni, sipas së cilës blerësi ka të drejtë të kërkojë mënjanimin e të metës, përkatësisht dorëzimin e një sendit tjetër pa të meta. Pastaj, ai ka të drejtë të kërkojë zbritjen e çmimit, në qoftë se kjo është më e arsyeshme sesa të bëhet mënjanimi i të metës materiale nga sendi, përkatësisht zëvendësimi i sendit me të meta me një send tjetër (pika 2). Dhe, e drejtë e blerësit që del nga përgjegjësia e shitësit për të metat materiale të sendit, është edhe të deklarojë zgjidhjen e kontratës midis shitësit dhe blerësit, për shkak se sendi i dorëzuar ka të meta materiale.

471.1.2. Pika 2 e autorizon blerësin ose i jep të drejtë atij, (kur sendi i shitur ka të meta materiale), të kërkojë zbritjen e çmimit dhe në këtë mënyrë të krijohet ekuivalenca midis sendit të shitur me të meta dhe çmimit të paguar prej sendit me të meta materiale. Natyrisht, kjo zgjidhje do të gjejë shprehje kur blerësi e zgjedh këtë mënyrë për përmbushjen e kontratës. Në këtë rast, blerësi pajtohet me të metat materiale ekzistuese për shkak se, shitësi dhe blerësi janë pajtuar, kanë arritur pëlqimin për zbritjen e çmimit të sendit që është me të meta materiale. Blerësi e arrin zbritjen e çmimit në marrëveshje me shitësin, sepse kjo është një çështje e negociueshme që buron nga e drejta e blerësit që, për shkak të përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale të sendit të shitur, të kërkojë zbritjen e çmimit. Në qoftë se blerësi nuk pajtohet me zbritjen e çmimit, atëherë shitësi i mbetet e drejta të kërkojë ose mënjanimin e të metave materiale, ose zëvendësimin e sendit, ose ta deklarojë zgjidhjen e kontratës për shkak të ekzistimit të të metave materiale në sendin e shitur. Blerësi është ai që vendos se kur do të kërkojë zbritjen e çmimit për shkak të të metave materiale të sendit.

471.1.3. Pika 3 e paragrafit 1 të nenit 471 parashikon se blerësi, kur e ka njoftuar shitësin me kohë dhe në mënyrë të rregullt për të metat materiale të sendit, mund ta deklarojë zgjidhjen e kontratës dhe kjo nënkupton zgjidhje të njëanshme të saj, për shkak të përgjegjësisë së shitësit për të metat materiale të sendit. Blerësi këtë të drejtë mund ta realizojë gjithmonë, kur e ka përmbushur detyrimin e njoftimit me kohë dhe në mënyrë të rregullt për të metat materiale të sendit. Blerësi duhet të zgjedhë njërën nga mundësitë e parashikuara në paragrafin 1, pikat 1, 2 dhe 3. Pra, ai nuk mund të kërkojë njëkohësisht të tri zgjidhjet që ia mundëson paragrafi 1 i këtij neni. Në literaturën juridike thuhet se zgjidhja, si sanksion për

moszbatimin e detyrimit të kontraktuar të dorëzimit, për shkak të mospërputhje së sendit të shitur me atë të porositur, nuk i nënshtrohet sjelljes së provës për shkaktimin e dëmit, por kur blerësi bën kërkesëpadi mbi përgjegjësinë e kontraktuar për arsye të mospërputhjes së sendit të shitur me atë të porositur, ai duhet të sjellë provën e ekzistencës së dëmit⁵³.

471.2. Paragrafi 2 parashikon shprehimisht se, pa marrë parasysh se cili prej këtyre tri mundësive do të realizohet nga blerësi, ai ka të drejtën e shpërblimit të dëmit që ka pësuar për shkak të mënjanimit të së metës materiale të sendit të shitur ose për shkak të zëvendësimit të sendit me të meta me një send tjetër ose për shkak të zbritjes së çmimit a për shkak të zgjidhjes së kontratës. Shpërblimi i dëmit do të bëhet sipas rregullave që vlejnjë për përgjegjësinë e kontraktuar për shkaktimin e dëmit.

471.3. Paragrafi 3 parashikon edhe një të drejtë të veçantë për blerësin, duke sanksionuar shprehimisht se, përpos kësaj dhe pavarësisht nga e drejta në paragrafin 2 të këtij neni, shitësi do të përgjigjet ndaj blerësit edhe për dëmin të cilin e ka pësuar ky për shkak të të metave të sendit në të mirat e tjera të tij, p.sh., dëmtimi i zërit të mirë të firmës ose dëmtimi i sendeve të tjera në depo, ndërkaq përgjegjësia e shitësit do të trajtohet sipas rregullave të përgjithshme të LMD të Kosovës që kanë të bëjnë me dëmin⁵⁴.

Neni 472. Mos përmbushja e kontratës brenda afatit të arsyeshëm

Në qoftë se blerësi nuk e fiton përmbushjen e kërkuar të kontratës brenda afatit të arsyeshëm, mban të drejtën e zgjidhjes së kontratës ose të zbritjes së çmimit.

472. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 472 parashikon rastin kur përmbushja e kontratës, duke mënjeluar të metën materiale nga sendi ose duke zëvendësuar sendin me të meta materiale me një send tjetër, nuk përmbushet brenda të afatit të arsyeshëm, sepse midis palëve ekziston një kontratë për zëvendësimin e sendit me të meta me një send tjetër pa të meta materiale dhe kjo duhet të bëhet në një afat të arsyeshëm. Ky nen parashikon shprehimisht se, kur blerësi nuk e realizon përmbushjen e kërkuar të kontratës brenda afatit të arsyeshëm, i cili është një çështje faktike, ai mban të drejtën e zgjidhjes së kontratës ose të zbritjes së çmimit. Nga kjo dispozitë del se blerësi, në radhë të parë për shkak të parimit të ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, duhet të kërkojë nga shitësi mënjanimin e të metës materiale nga sendi, përkatësisht zëvendësimin e sendit me të meta materiale me një send tjetër pa të meta materiale. Ndërkaq, e drejta e zgjidhjes së kontratës ose e drejta e zbritjes së çmimit gjejnjë shprehje kur kontrata për mënjanimin e të metave materiale apo për zëvendësimin e sendit me të meta materiale me një send tjetër pa të meta materiale nuk bëhet në afatin e arsyeshëm. Megjithatë, mund të thuhet se e drejta e zgjedhjes i takon blerësit, i cili vendos se cilën nga zgjidhjet do ta realizojë, për shkak se nuk ekziston ndonjë rregull që përcakton hierarkinë e të drejtave të blerësit të parashikuara në pikat 1, 2

⁵³ Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 49.

⁵⁴ LMD i Kosovës, neni 136-153.

dhe 3 të paragrafit 1 të nenit 471 të LMD të Kosovës. Radhitja e mundësive të blerësit, që njëkohësisht janë të drejta të parashikuara në paragrafin 1, pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 471, në fakt, tregojnë se si do të duhej të ishte, por jo e obligueshme në realizimin e të drejtës së blerësit në rastet kur ekziston përgjegjësia e shitësit për shkak të metave materiale. Qëllim i palëve është përmbushja e kontratës dhe jo zgjidhja e saj. Kjo dispozitë gjen shprehje kur blerësi ka vendosur për përmbushjen e rregullt të kontratës përmes mënjanimi të të metave materiale ose zëvendësimit të sendit me të meta materiale me një send pa të meta materiale; në këtë rast, kur sendi riparohet dhe i dërgohet blerësit ose zëvendësohet, fillojnë të rrjedhin nga e para afatet që kanë të bëjnë me kontrollimin e sendit dhe lajmërimin e shitësit për mungesat e dukshme, përkatësisht të fshehta të tij.

Neni 473. Kur blerësi mund ta zgjidhë kontratën

- 1. Blerësi mund të zgjidhë kontratën vetëm në qoftë se paraprakisht ia ka lënë shitësit afatin plotësues të arsyeshëm për përmbushjen e kontratës.**
- 2. Blerësi mund ta zgjidhë kontratën edhe pa e lënë afatin e ri plotësues në qoftë se shitësi, pas njoftimit mbi të metat, i ka komunikuar se nuk do ta përmbushë kontratën apo në qoftë se nga rrethanat e rastit konkret rezulton qartas se shitësi nuk do të mund të përmbushë kontratën as në afatin plotësues.**

473. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 473 përmban dispozita që përcaktojnë se në cilat raste blerësi mund ta zgjidhë kontratën. Zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave materiale të sendit e parashikojnë edhe legjislacionet tjera⁵⁵.

473.1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se blerësi mund ta zgjidhë kontratën kur ajo nuk është përmbushur brenda afatit të arsyeshëm, pra nuk është bërë riparimi i sendit, përkatësisht mënjanimi i të metës materiale të sendit apo zëvendësimi i sendit me të meta materiale me një send tjetër, vetëm në qoftë se paraprakisht ia ka lënë shitësit afatin plotësues të arsyeshëm për përmbushjen e kontratës. Kjo do të thotë se blerësi ka për detyrim t'i mundësojë shitësit që përmbushjen e kontratës ta bëjë në një afat plotësues të arsyeshëm. Ky afat plotësues i arsyeshëm varet nga natyra e sendit që është objekt i kontratës dhe ka pasur të meta materiale, të cilat ndërkohë duhen mënjeluar apo nga mundësia e zëvendësimit të sendit me të meta materiale me një send tjetër pa të meta materiale. Pra, kjo është një çështje faktike, e cila zgjidhet në pajtim me doket e mira, duke pasur parasysh rastin konkret. Kjo do të thotë se merret parasysh koha që nevojitet edhe për shitësit e tjerë për ta përmbushur këtë lloj të kontratës në rastet konkrete.

.....
55 KCSH, neni 722, paragrafi 1, parashikon se “Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit blerësi nuk mund të përdorë asnjë mjet juridik për mospërmbushjen, përveç kur është njoftuar nga shitësi se ky i fundit nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar”, dhe Paragrafi 2 “Në çdo rast blerësi nuk humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e demit”.

473.2. Paragrafi 2 parashikon shprehimisht se blerësi mund ta zgjidhë kontratën, d.m.th., të deklarojë zgjidhjen e saj edhe pa caktuar një afat të ri plotësues, në qoftë se shitësi, pas njoftimit për të metat materiale të sendit të shitur, ia komunikon blerësit se nuk do ta përmbushë kontratën, pra e kundërshton përmbushjen e saj apo kur, nga rrethanat e rastit, duket fare qartë se shitësi nuk do të mund ta përmbushë kontratën as brenda afatit plotësues. Pra, kjo nënkupton rastin kur shitësi refuzon përmbushjen e kontratës, duke mënjanuar të metën materiale të sendin ose duke zëvendësuar sendin me të meta materiale me një send tjetër pa të meta materiale, si dhe kur rrethanat e rastit konkret bëjnë të ditur ose bëjnë të mundur të shihet qartas se shitësi në kurrfarë mënyre nuk është në gjendje ta përmbushë kontratën, pra ta bëjë zëvendësimin e sendit me të meta me një send pa të meta materiale ose ta mënjanojë të metën nga sendi dhe pastaj t'ia dorëzojë blerësit as në afatin plotësues, të cilin do të mund t'ia caktonte blerësi, p.sh., kur është diçka që nuk riparohet ose sendi ka qenë unik dhe nuk mund të zëvendësohet; në këtë rast nuk ka arsye të caktohet afati plotësues dhe blerësi drejtpërsëdrejti mund ta zgjidhë kontratën pa e lënë afatin e ri plotësues.

Neni 474. Mospërmbushja e kontratës në afatin plotësues

Në qoftë se shitësi në afatin plotësues nuk e përmbush kontratën, ajo zgjidhet sipas ligjit, por blerësi mund ta mbajë në qoftë se pa vonesë i deklaron shitësit se kontratën e mban në fuqi.

474. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 474 përmban një zgjidhje ligjore gjithnjë të karakterit dispozitiv, dispozicion ky që është vetëm në anën e blerësit, sepse thuhet shprehimisht se, kur shitësi në afatin plotësues nuk e përmbush kontratën afatin plotësues të caktuar nga blerësi, pas njoftimit se sendi ka të meta që duhen mënjanuar ose ai duhet të zëvendësohet me një send tjetër pa të meta materiale, atëherë kontrata zgjidhet sipas ligjit (*ex lege*), pra vetvetiu konsiderohet e zgjidhur, mirëpo efekti i zgjidhjes *ex lege* i kontratës mund të pezullohet, nëse blerësi, pa vonesë i deklaron shitësit se kontratën e mban në fuqi, edhe pse nuk është përmbushur në afatin plotësues, pa marrë parasysh se ligji e konsideron të zgjidhur kontratën *ex lege*. Zgjidhja e kontratës (*ex lege*) ose sipas ligjit, do të thotë se kontrata është zgjidhur në momentin e kalimit të afatit, pa ndërmarrë veprime juridike plotësuese, siç do të ishte padia për zgjidhjen e kontratës⁵⁶. Mbajtja e kontratës në fuqi nga ana e blerësit nënkupton se blerësi është pajtuar me përmbushjen e kontratës edhe kur ajo është përmbushur në afatin plotësues, gjë që nënkupton se blerësi është pajtuar me të metat materiale të sendit. Kjo dispozitë ligjore, për shkak se është e karakterit dispozitiv, nuk ndalon mundësinë që palët kontraktuese të krijojnë ndonjë marrëveshje të re për mënyrën e përmbushjes së kontratës, e cila do të mbetet në fuqi. Nëse ndodh zgjidhja e kontratës së shitjes për shkak të së metës materiale të sendit të shitur, atëherë efektet juridike të zgjidhjes së kontratës janë të njëjta si në rastin kur ndodh zgjidhja e kontratave të dyanshme detyruese për shkak të mospërmbushjes.

⁵⁶ Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 650.

Neni 475. Të metat e pjesshme

- 1. Kur vetëm një pjesë e sendit të dorëzuar ka të meta ose kur është dorëzuar vetëm një pjesë e sendit ose një sasi më e vogël se sa është kontraktuar, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në kuptim të neneve të mësipërme vetëm në lidhje me pjesën e cila ka të meta ose vetëm në lidhje me pjesët ose sasinë që mungojnë.**
- 2. Blerësi mund ta zgjidhë kontratën në tërësi vetëm në qoftë se sasia e kontraktuar ose sendi i dorëzuar përbën një tërësi, apo në qoftë se blerësi ka edhe ashtu interes të arsyeshëm që ta marrë sendin e kontraktuar ose sasinë në tërësi.**

475. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 475 përmban dispozitën kur të metat materiale të sendit janë të pjesshme. Në këtë rast ligji rregullon situatën kur një pjesë e sendit të dorëzuar ka të meta ose kur është dorëzuar vetëm një pjesë e sendit ose një sasi më e vogël sesa është kontraktuar.

475.1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se, kur vetëm një pjesë e sendit të dorëzuar ka të meta materiale, domethënë kur e meta materiale nuk është në tërë sendin, por vetëm në një pjesë të tij ose kur është dorëzuar vetëm një pjesë e sendit dhe jo i tërë sendi ose një sasi më e vogël sesa është kontraktuar, atëherë blerësi mund ta zgjidhë kontratën në vështrim të neneve të mësipërme, që rregullojnë zgjidhjen kontratës për shkak të të metave materiale të sendit vetëm në lidhje me pjesën që ka të meta ose vetëm në lidhje me pjesët ose sasinë që mungojnë. Pra, kjo dispozitë nuk lejon zgjidhjen e kontratës në tërësi, në qoftë se të metat janë të pjesshme, sepse në këtë rast blerësi mund ta zgjidhë kontratën vetëm në lidhje me pjesën që ka të meta ose në lidhje me pjesët ose sasinë që mungojnë. Pra, ai ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës për sasinë e munguar ose për pjesën që ka të meta ose për pjesën që mungon.

475.2. Paragrafi 2, për dallim nga paragrafi 1 i këtij neni, parashikon mundësinë që blerësi ta zgjidhë kontratën në tërësi, (kontratën ekzistuese), vetëm në qoftë se sasia e kontraktuar ose sendi i dorëzuar përbën një tërësi. Kjo do të thotë se këto vetëm së bashku përbëjnë objektin që nënkupton përmbushjen e kontratës; apo, në qoftë se blerësi edhe ashtu ka interes të arsyeshëm që ta marrë sendin e kontraktuar ose sasinë e kontraktuar, por jo pa sasinë që mungon ose pa pjesët që mungojnë ose pa pjesën e cila ka të meta, sepse interesi i arsyeshëm i blerësit është ta marrë sendin e kontraktuar si tërësi ose sasinë në tërësi. Pra, ai ka arsye të mos pajtohet që, p.sh., të mos marrë në vend të 100 kg – 70 kg.

Neni 476. Kur shitësi i ka dhënë blerësit sasi më të madhe

- 1. Me kontratën e shitjes midis ndërmarrësve, kur shitësi i sendeve të caktuara sipas llojit ia ka dhënë blerësit sasinë më të madhe nga sa është kontraktuar, ndërsa blerësi brenda afatit të arsyeshëm nuk deklaron se e refuzon tepricën, do të konsiderohet se e ka marrë edhe këtë tepricë, kështu që ka për detyrë ta paguajë me të njëjtin çmim.**

2. Në qoftë se blerësi refuzon të merr tepricën, shitësi ka për detyrë t'ia shpërblejë blerësit dëmin e shkaktuar.

476. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 476 përmban dispozitën me të cilën përcaktohet se si do të veprohet në rastin kur shitësi i ka dhënë blerësit një sasi më të madhe, domethënë e meta konsiston në sasinë më të madhe sesa që ka kërkuar me kontratë.

476.1. Paragrafi 1 parashikon se me kontratën e shitjes, kur subjekte të saj janë ndërmarrësit (kontratat ekonomike) dhe shitësi i sendeve të caktuara sipas llojit i ka dhënë një sasi më të madhe nga sa është kontraktuar, ndërsa blerësi nuk deklaron brenda një afatit të arsyeshëm se refuzon tepricën, do të konsiderohet se ai e ka marrë edhe këtë tepricë, pra edhe këtë sasi që është më shumë sesa është kontraktuar dhe, në këtë rast, blerësi ka për detyrim ta paguajë atë me të njëjtin çmim. Kjo do të thotë se, nëse, p.sh., shitësi ka dorëzuar 10 tonë grurë, ndërsa blerësi ka kontraktuar me të 8 tonë, atëherë te kontratat ekonomike blerësi duhet menjëherë, përkatësisht brenda afatit të arsyeshëm, të deklarojë se e refuzon tepricën e pranuar prej 2 tonë dhe, nëse nuk e bën refuzimin, konsiderohet se e ka marrë këtë tepricë, përkatësisht se është pajtuar që sasia nga 8 të jetë 10 tonë, aq sa ka dorëzuar shitësi, kurse blerësi ka të vetmin detyrim që për sasinë që është tepricë (2 tonë grurë) ta paguajë çmimin që vlente edhe për sasinë e kontraktuar, përkatësisht ndryshimin e çmimit.

476.2. Paragrafi 2 parashikon se kur blerësi refuzon të marrë tepricën nga sasia e kontraktuar, atëherë shitësi ka detyrimin t'ia shpërblejë blerësit dëmin e shkaktuar. Kjo do të thotë se i gjithë dëmi që i është shkaktuar blerësit për pasojë të tepricës, bie mbi shitësin, për faktin se sasia e porositur e grurit ka qenë 8 tonë, ndërsa shitësi ka dërguar më shumë (10 tonë), gjë që do të thotë se dëmi është shkaktuar nga rritja e shpenzimeve të transportit (kur transporti i sendit është në ngarkim të blerësit), pastaj nga ruajtja eventuale deri te kthimi i sendit te shitësi etj. Në këtë rast, e meta materiale e sendit ka të bëjë jo me cilësinë e sendit, por me sasinë e tij dhe kjo bën që kontrata të mos mund të përmbushet në mënyrë të rregullt dhe teprica duhet të kthehet, domethënë blerësi nuk ka detyrimin ta paguajë atë, por vetëm ta marrë shpërblimin e dëmit. Kjo rregull vlen te kontratat ekonomike (midis ndërmarrësve).

Neni 477. Caktimi i çmimit për disa sende

- 1. Kur me një kontratë dhe për një çmim janë shitur disa sende ose një grumbull sendesh, ndërsa vetëm disa prej tyre kanë të meta, blerësi mund ta zgjidhë kontratën vetëm për sa u përket sendeve me të meta, por jo edhe për të tjerat.**
- 2. Në qoftë se këto përbëjnë një tërësi kështu që ndarja e tyre do të ishte e dëmshme, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në tërësi, apo në qoftë se ai megjithatë deklaron se e zgjidhë kontratën vetëm për sa u përket sendeve me të meta, shitësi nga ana e tij mund ta zgjidhë kontratën edhe për sa u përket sendeve të tjera.**

477. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 477 përcakton rastin kur caktimi i çmimit nuk bëhet për disa sende dhe si do të veprohet kur nga tërësia e sendeve, disa prej tyre kanë të meta materiale.

477.1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se, kur me një kontratë dhe me një çmim, (pra kontrata përmban vetëm një çmim), janë shitur disa sende ose një grumbull sendesh, ndërsa vetëm disa prej tyre kanë të meta materiale, atëherë e drejta e blerësit konsiston në zgjidhjen e kontratës, por vetëm sa u përket sendeve me të meta materiale, por jo edhe për sendet e tjera, të cilat janë pa të meta materiale. Në këtë rast, blerësi ka për detyrim t'i pranojë sendet nga tërësia përkatësisht nga grumbulli i sendeve, të cilat nuk kanë të meta materiale dhe të kërkojë zgjidhjen e kontratës vetëm për sa u përket sendeve me të meta materiale. Në këtë rast, zgjidhja e kontratës nuk mund të bëhet *ex lege*, por këtu bëhet fjalë për mundësinë e blerësit që ta zgjidhë kontratën vetëm për sendet që i takojnë tërësisë (grumbullit të sendeve) dhe kanë të meta materiale.

477.2. Paragrafi 2 parashikon përjashtimin, sipas të cilit, në qoftë se këto sende përbëjnë një tërësi dhe ndarja e secilës prej tyre do të ishte e dëmshme, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në tërësi apo në qoftë se ai, megjithatë, deklaron se e zgjidh kontratën vetëm për sa u përket sendeve me të meta, atëherë shitësi, gjithashtu, ka mundësi ta zgjidhë kontratën edhe për sa u përket sendeve të tjera. Pra, ky paragraf i jep të drejtë blerësit, kur sendet që kanë të meta përbëjnë një tërësi dhe ndarja e tyre nga sendet pa të meta do të ishte e dëmshme, atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhë kontratën në tërësi, por ai njëkohësisht ka të drejtë të deklarojë se e zgjidh kontratën vetëm për sa u përket sendeve me të meta materiale dhe, në këtë rast, kur shitësi është i pakënaqur me zgjidhjen e kontratës kur janë shitur disa sende ose një grumbull sendesh me një çmim dhe blerësi kërkon ta zgjidhë kontratën vetëm për sendet që kanë të meta materiale, atëherë edhe shitësi ka të drejtë të kërkojë ta zgjidhë kontratën edhe për sa u përket sendeve të tjera. Kjo do të thotë se shitësi tani kërkon zgjidhjen e kontratës për të gjitha sendet që janë shitur me një çmim në një kontratë ose kur janë shitur një grumbull sendesh.

Neni 478. Humbja e të drejtës për zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave

- 1. Blerësi humb të drejtën e zgjidhjes së kontratës për shkak të të metave të sendeve kur është në pamundësi ta kthejë sendin ose ta kthejë në gjendjen në të cilën e ka marrë.**
- 2. Megjithatë, blerësi mund ta zgjidhë kontratën për shkak të ndonjë të mete të sendit, në qoftë se sendi është zhdukur tërësisht ose pjesërisht ose është dëmtuar për shkak të të metave që justifikon zgjidhjen e kontratës apo për shkak të ndonjë ngjarje e cila nuk rezulton prej tij dhe as prej ndonjë personi për të cilin përgjigjet ai.**
- 3. E njëjta gjë vlen në qoftë se sendi është zhdukur ose dëmtuar tërësisht ose pjesërisht për shkak të detyrimit të blerësit që ta kontrollojë sendin, apo në qoftë se blerësi para se të jetë zbuluar e meta e ka konsumuar ose e ka ndryshuar një pjesë të sendit gjatë përdorimit të tij normal si dhe në qoftë se dëmtimi ose ndryshimi janë të parëndësishme.**

478. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 478 përmban dispozitën, sipas së cilës përcaktohet se në cilat raste, përkatësisht kur blerësi e humb të drejtën për zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave materiale të sendit të blerë nga shitësi.

478.1. Paragrafi 1 parashikon se blerësi humb të drejtën e zgjidhjes së kontratës për shkak të të metave materiale të sendit gjithmonë kur nuk ka kurrfarë mundësie ta kthejë sendin te shitësi (sepse e ka shkatërruar) ose ta kthejë në gjendjen në të cilën e ka marrë. Kjo dispozitë parashikon qartë se blerësi e humb të drejtën e zgjidhjes së kontratës gjithmonë kur nuk është në gjendje ta kthejë sendin te shitësi ose ta kthejë në gjendjen në të cilën e ka marrë. Pra, zgjidhja e kontratës për shkak të të metave materiale të sendeve në këto dy raste nuk mund të bëhet nga ana e blerësit.

478.2. Paragrafi 2 parashikon përjashtimin, sipas të cilit blerësi prapë se prapë mund ta zgjidhë kontratën për shkak të ndonjë të mete të sendit, në qoftë se sendi është zhdukur tërësisht ose pjesërisht ose është dëmtuar për shkak të të metave, që justifikojnë zgjidhjen e kontratës apo për shkak të ndonjë ngjarjeje e cila nuk rezulton prej tij dhe as prej ndonjë personi për të cilin përgjigjet ai. Kjo dispozitë i jep të drejtë blerësit që të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave materiale të sendit edhe kur sendi është zhdukur tërësisht ose pjesërisht ose është dëmtuar për shkak të të metave për të cilat mund të kërkohet zgjidhja e kontratës. Pra, në këtë rast, sendi është zhdukur tërësisht ose pjesërisht ose është dëmtuar nga ekzistimi i të metës materiale, për të cilën blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, p.sh., në qoftë se një makinë që ka pasur të meta me rastin e fillimit të punës shkatërrohet në tërësi ose pjesërisht ose dëmtohet për shkak se e meta ka ekzistuar që në momentin e dorëzimit të saj te blerësi, i cili ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës edhe për këto sende. Gjithashtu, blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të të metave materiale të sendit edhe kur sendi me të meta materiale zhduket tërësisht

apo pjesërisht ose dëmtohet për shkak të ndonjë ngjarjeje e cila nuk rrjedh nga ai ose nga ndonjë person për të cilin ai përgjigjet.

478.3. Paragrafi 3 përcakton se blerësi gjithashtu ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se sendi është zhdukur tërësisht apo pjesërisht për shkak të detyrimit të blerësit që ta kontrollojë sendin apo në qoftë se blerësi, para se të jetë zbuluar e meta, e ka konsumuar ose e ka ndryshuar një pjesë të sendit gjatë përdorimit të tij normal si dhe në qoftë se dëmtimi apo ndryshimi janë të parëndësishme. Kjo dispozitë nënkupton rastin kur blerësi ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës, nëse sendi me të meta materiale është shkatërruar tërësisht ose pjesërisht ose është dëmtuar gjatë kryerjes, përkatësisht gjatë përmbushjes së detyrimit të blerësit që ta kontrollojë sendin, domethënë gjatë kohës kur blerësi e bën kontrollimin e sendit të blerë që është obligim me rastin e dorëzimit të tij nga shitësi ose kur blerësi, para se ta zbulojë të metën materiale të sendit, e ka harxhuar (e ka konsumuar) atë ose e ka ndryshuar një pjesë të tij gjatë kohës së rregullt të përdorimit si dhe kur dëmtimi ose ndryshimi janë të parëndësishme. Edhe në rastin kur ekziston e drejta e kthimit të sendit për shkak të të metave materiale, nëse dëmtimi apo ndryshimi është i parëndësishëm, prapë se prapë blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës. Kjo do të thotë se shitësi nuk mund ta ndalojë zgjidhjen e kontratës, duke iu referuar faktit se dëmtimet dhe ndryshimet janë të parëndësishme.

Neni 479. Ruajtja e të drejtave të tjera

Blerësi i cili për shkak të pamundësisë që ta kthejë sendin ose ta kthejë në gjendjen në të cilën e ka marrë e ka humbur të drejtën e zgjidhjes së kontratës, ka të drejta të tjera që ia jep ligji për shkak të ekzistimit të ndonjë të mete.

479. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 479 përcakton ruajtjen e të drejtave të tjera të blerësit, kur bëhet fjalë për sendet që kanë të meta materiale. Kjo dispozitë parashikon se, kur blerësi i cili, për shkak të pamundësisë që ta kthejë sendin ose ta kthejë në gjendje në të cilën e ka marrë, nuk mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak se e ka humbur këtë të drejtë, ai ka të drejta të tjera që ia jep ligji për shkak të ekzistimit të ndonjë të mete materiale të sendit. Në këtë rast, blerësi ka të drejta të kërkojë dorëzimin e një sendi tjetër, zbritjen e çmimit dhe të drejta të tjera të cilat mund të realizohen sipas nenit 471 të LMD të Kosovës.

Neni 480. Efektet e zgjidhjes për shkak të të metave

- 1. Zgjidhja e kontratës për shkak të të metave të sendit ka efekte të njëjta sikurse edhe zgjidhja e kontratave të dyanshme për shkak të mos përmbushjes.**
 - 2. Blerësi i debiton shitësit kompensimin për dobinë nga sendi edhe kur është në pamundësi që ta kthejë krejtësisht ose një pjesë të tij, ndërsa kontrata megjithatë është zgjidhur.**
-

480. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 480 ka të bëjë me efektet juridike të zgjidhjes së kontratës së shitblerjes për shkak të të metave juridike.

480.1. Paragrafi 1 përmban dispozitën, sipas së cilës, zgjidhja e kontratës për shkak të të metave të sendit ka efekte të njëjta, pra ka pasoja juridike të njëjta që ekzistojnë edhe të zgjidhja e kontratave të dyanshme për shkak të mospërbushjes. Sepse, edhe kontrata e shitblerjes është kontratë e dyanshme, por zgjidhja e saj bëhet për të metat materiale të sendit që pamundësojnë përmbushjen e kontratës përkatësisht që janë bazë për zgjidhjen e kontratës së shitblerjes⁵⁷.

480.2. Paragrafi 2 parashikon se blerësi i ka borxh shitësit shpërblimin për dobinë nga sendi edhe kur është në pamundësi ta kthejë krejtësisht ose një pjesë të tij, ndërsa kontrata megjithatë është e zgjidhur. Kjo nënkupton se, kur blerësi deri në zbulimin e të metave materiale të sendit, në bazë të së cilës e ka zgjidhur kontratën, kur e ka përdorur sendin dhe ka pasur fitime prej tij, atëherë të gjitha dobitë e fituara nga sendi me të meta materiale, blerësi ia ka borxh shitësit. P.sh., nëse vetura e blerë me të meta materiale, deri te zbulimi i tyre, është përdorur nga ana e blerësit, ta zëmë, si taksì, atëherë fitimet nga përdorimi i veturës duhet t'ia shpërblejë shitësit. Kjo nuk do të thotë se përjashtohet përgjegjësia e shitësit për shkak të dëmit që i shkaktohet blerësit, si rezultat i sendit të shitur me të meta materiale.

Neni 481. Zbritja e çmimit

Zbritja e çmimit bëhet sipas raportit midis vlerës së sendit pa të meta dhe vlerës së sendit me të meta në kohën e lidhjes së kontratës.

481. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 481 përmban dispozitën me të cilën përcaktohet rregulla se si do të veprohet kur sendi ka të meta materiale dhe do të ruhet kontrata, por do të ndodhë zbritja e çmimit të sendit me të meta materiale dhe në këtë rast kontrata pëson ndryshim vetëm në pikëpamje të çmimit për sendin e blerë me të meta materiale. Ky nen parashikon se zbritja e çmimit për sendin e blerë me të meta materiale bëhet sipas raportit midis vlerës së sendit pa të meta dhe vlerës së sendit me të meta materiale në kohën e lidhjes së kontratës. Pra, caktimi i zbritjes së çmimit mbështetet në çmimin real të sendit pa të meta materiale dhe pastaj caktohet sasia e të metave materiale të sendit që ka ndikim në çmim dhe, duke i pasur për bazë dallimet midis sendit pa të meta dhe sendit me të meta materiale, do të caktohet edhe zbritja e çmimit. Kjo është një çështje faktike dhe, zakonisht, bëhet me marrëveshje midis palëve kontraktuese, kur është e mundur; nëse kjo nuk është e mundur, ajo do të bëhet me ndihmën e ekspertëve që do të rezultojë me vendim të arbitrazhit ose të gjykatës.

⁵⁷ Shih : LMD i Kosovës, neni 106, ku thuhet “Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet e parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e demit”, dhe komentin e këtij neni.

Neni 482. Zbulimi gradual i të metave

Blerësi i cili ka realizuar zbritjen e çmimit për shkak të ekzistimit të ndonjë të mete, mund ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e re të çmimit në qoftë se më vonë zbulohet ndonjë e metë tjetër.

482. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 482 përmban dispozitën me të cilën rregullohet rasti kur zbulimi i të metave materiale të sendit nuk bëhet menjëherë, por në mënyrë graduale. Kjo do të thotë se, përveç zbulimit të të metave materiale që kanë ekzistuar më herët, për të cilat është bërë zbritja e çmimit, mund të ndodhë që zbulimi i ndonjë të mete tjetër materiale të bëhet më vonë. Kjo dispozitë ligjore parashikon se, kur një blerës ka realizuar zbritjen e çmimit për shkak të ekzistimit të ndonjë të mete materiale, ai atëherë ka të drejtë që, në qoftë se më vonë zbulon ndonjë të metë tjetër të sendit të njëjtë, ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e re të çmimit. Pra, blerësi që ka realizuar zbritjen e çmimit njëherë, për shkak të ekzistimit të ndonjë të mete materiale të sendit, nëse më vonë zbulon ndonjë të metë tjetër materiale në të njëjtin send, ai tash ka dy të drejta, të cilat mund t'i realizojë: njëra është zgjidhja e kontratës dhe këtë nuk mund ta kundërshtojë shitësi, ndërsa e drejta tjetër i përket kur ekziston zbulimi gradual i të metave materiale të sendit; domethënë, pasi ka realizuar zbritjen e çmimit për shkak të ndonjë të mete materiale, ai mund të kërkojë zbritjen e re të çmimit në pajtim me nenin 481 të LMD të Kosovës, domethënë zbritjen e çmimit të sendit edhe për shkak të së metës materiale të re të zbuluar më vonë.

Neni 483. Humbja e të drejtave

- 1. Të drejtat e blerësit, i cili e ka njoftuar me kohë shitësin mbi ekzistimin e të metave, shuhen pasi të ketë kaluar një (1) vit duke llogaritur nga dita e dërgimit të njoftimit shitësit, përveç nëse blerësi për shkak të mashtrimit nga ana e shitësit ka qenë i penguar t'i realizojë ato të drejta.**
 - 2. Blerësi i cili e ka njoftuar me kohë shitësin mbi ekzistimin e të metave mund pasi të ketë kaluar ky afat, në qoftë se ende nuk e ka paguar çmimin të realizojë kërkesën e vet për zbritjen e çmimit ose t'i shpërblehet dëmi, si kundërshtim kundër kërkesës së shitësit që t'i paguhet çmimi.**
-

483. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 483 i LMD të Kosovës, parashikon mundësinë, që të ekzistojë edhe humbja e të drejtave të blerësit.

483.1. Paragrafi 1 i nenit 483 parashikon të drejtat e blerësit pasi ta ketë njoftuar me kohë shitësin për ekzistimin e të metave materiale të sendit dhe kur nuk ndërmerr veprime për t'i realizuar të drejtat e veta në pajtim me nenin 471 të LMD të Kosovës, me të cilin rregullohen të drejtat e tij të parashikuara nga neni 471, të cilat shuhen pasi të ketë kaluar një (1) vit nga data kur shitësi i është dërguar njoftimi. Kjo e drejtë nuk do të shuhet vetëm nëse blerësi, për shkak të mashtrimit nga ana e shitësit, ka qenë i penguar t'i realizojë këto

të drejta. Kjo dispozitë kërkon nga blerësi që të drejtat e veta, të parashikuara në nenin 471 të LMD të Kosovës, t'i realizojë brenda një (1) viti, nga dita kur i ka dërguar njoftimin shitësit se sendi ka të meta materiale, kurse kërkesat e tija do të ishin: së pari, mënjanimi i të metave materiale të sendit ose dorëzimi i një sendi tjetër pa të meta materiale, sepse kjo është rregull për të arritur qëllimin e kontratës – që është përmbushja e saj; së dyti, zbritja e çmimit dhe, në qoftë se nuk ndodhin këto dy të parat, të deklarojë zgjidhjen e kontratës në pajtim me nenin 471 të LMD të Kosovës. Blerësi nuk do t'i humbë të drejtat me kalimin e afatit prej një viti, që parashikon paragrafi 1 i këtij neni, nëse ka qenë i mashtruar nga ana e shitësit dhe ky mashtrim e ka penguar t'i realizojë të drejtat e veta ndaj shitësit lidhur me të metat materiale të sendit të shitur.

483.2. Paragrafi 2 parashikon një përjashtim, sipas të cilit, nëse blerësi e ka njoftuar me kohë shitësin për ekzistimin e të metave, që është njëri për kushteve për të fituar të drejtat për shkak të të metave materiale të sendit, mund ta realizojë zbritjen e çmimit ose t'i shpërblehet dëmi kundrejt kërkesës së shitësit që t'i paguhet çmimi, kur blerësi nuk e ka paguar çmimin. Pra, blerësi ka mundësi ta realizojë kërkesën e vet për zbritjen e çmimit ose t'i shpërblehet dëmi si kundërshtim ndaj kërkesës së shitësit që t'i paguhet çmimi, edhe pse ka kaluar koha prej një (1) viti, që rezulton me humbjen e të drejtave, kur blerësi ende nuk e ka paguar çmimin. Kjo do të thotë se, pas pagimit të çmimit, nuk mund të realizohet e drejta e blerësit për zbritjen e çmimit ose për shpërblimin e dëmit si kundërshtim ndaj kërkesës së shitësit që t'i paguhet çmimi. Ndërkaq, për sa i përket zgjidhjes së kontratës për shkak të të metave materiale të sendit nga dita kur kalon një (1) vit prej njoftimit të shitësit për ekzistimin e të metave, nuk ka bazë juridike që shitësi ta realizojë këtë, kur nuk ka penguar të realizohet e drejta e blerësit për zgjidhje të kontratës për shkak të mashtrimit nga ana e shitësit. Praktika gjyqësore e respekton paragrafin 2 të këtij neni dhe mundëson zbritjen e çmimit edhe në rastet kur ka kaluar afati prej një viti që është afat prekluziv, sipas të cilit blerësi e humb të drejtën të kërkojë përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit, nëse e ka njoftuar me kohë shitësin për ekzistimin e të metave materiale pasi të ketë kaluar ky afat dhe, kur nuk e ka paguar çmimin e plotë, mund ta realizojë kërkesën e vet për zbritjen e çmimit⁵⁸.

58 Shih : Aktgjykimin e Gjykatës së Rrethit Varazhdin (Županijski sud u Varaždinu), Gž. 1074/08-2 od 04.08.2008, në arsyetimin e të cilit, ndër të tjera, thuhet se “me që i padituri që në përgjigjen ndaj padisë ka pretenduar ekzistimin e të metave materiale të kafshëve të blear, duke kundërshtuar pagimin e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes, e cila është object I kërkesëpadisë së paditësit, çka do të thotë se i padituri haptazi ka parashtruar kundërshtim për uljen e çmimit në kuptim të nenit 422, paragrafi 2 të LMD të Kroacisë, si kundërshtim ndaj kërkesëpadisë për pagimin e shumës së çmimit të mbetur dhe i padituri nuk ka qenë i detyruar të bëjë kërkesëpadi për uljen e çmimit?”.

III. GARANCIONI PËR FUNKSIONIMIN E RREGULLT TË SENDIT TË SHITUR

Neni 484. Përgjegjësia e shitësit dhe e prodhuesit

1. Kur shitësi i ndonjë makine, motori, te ndonjë aparati, ose te sendeve tjera si këto që i përkasin te ashtëqujtura „malli teknik“, ia ka dorëzuar blerësit fletëgarancionin me të cilën prodhuesi garanton funksionim të rregullt të sendit gjatë një kohe të caktuar duke llogaritur nga dorëzimi i tij, blerësi mundet në qoftë se sendi nuk funksionon në rregull, të kërkojë si nga shitësi ashtu edhe nga prodhuesi që sendi të riparohet në afatin e arsyeshëm ose, nëse nuk e bën këtë, në vend të tij t’ia dorëzojë sendin i cili funksionon në rregull.
2. Me këto rregulla nuk preket në rregullat mbi përgjegjësinë e shitësit për të metat e sendit.

484. *Vështrim i përgjithshëm.* - Neni 484 përmban dispozita që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e shitësit dhe të prodhuesit, përkatësisht me garancinë mbi funksionimin e rregullt të sendit të shitur. Lidhur me garancinë mbi funksionimin e rregullt të sendit të shitur, subjekte që përgjigjen për mosfunksionimin e rregullt të sendit të shitur janë shitësi dhe prodhuesi i sendit, përgjegjësia e të cilëve rregullohet me dispozita të këtij Ligji. Garancia mbi funksionimin e rregullt të sendit të shitur rregullohet me nenet 484-490. Për garancinë thuhet se ka për qëllim garantimin e një posedimi të qetë dhe të dobishëm të sendit, pra ajo ka synim të dyfishtë: ndaj shpronësimit – për të siguruar një posedim të qetë dhe ndaj të metave të fshehta – për të siguruar një posedim të dobishëm⁵⁹.

484.1. Paragrafi 1 i nenit 484 të LMD të Kosovës parashikon se, kur shitësi i ndonjë makine, motori, aparati ose i sendeve të tjera siç janë ato që u përkasin të ashtuquajturave “mallra teknike”, ia ka dorëzuar blerësit fletëgarancinë, me të cilën prodhuesi garanton funksionimin e rregullt të sendit gjatë një kohe të caktuar, llogaritur nga dorëzimi i tij, atëherë blerësi, kur sendi i blerë nuk funksionon në rregull, mund të kërkojë si nga shitësi, ashtu edhe nga prodhuesi që sendi të riparohet në një afat të arsyeshëm ose, nëse nuk e bën këtë, në vend të tij t’ia dorëzojë sendin i cili funksionon në rregull. Ky paragraf përcakton në mënyrë shumë të qartë se, kur sendet e shitura që bëjnë pjesë në kuadër të mallit teknik, për të cilin shitësi ia ka dorëzuar fletëgarancinë blerësit, me të cilën prodhuesi garanton funksionimin e rregullt brenda një afati të caktuar, i cili fillon të rrjedhë prej momentit të dorëzimit të sendit, por nëse makina, motori ose ndonjë aparat tjetër, që janë mallra teknike, nuk funksionon në rregull, domethënë jo ashtu siç janë marrë vesh palët kontraktuese, atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë si nga shitësi, ashtu edhe nga prodhuesi që sendi të riparohet në një afat të arsyeshëm. Kjo e drejtë është e njëkohshme, domethënë mund t’i drejtohet edhe shitësit, edhe prodhuesit, përkatësisht mund t’i drejtohet vetëm shitësit ose

59 Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006, fq. 50.

vetëm prodhuesit dhe, nëse shitësi apo prodhuesi nuk e bëjnë riparimin e sendit të shitur në një afat të arsyeshëm, atëherë shitësi, përkatësisht prodhuesi ka për detyrim që, në vend të sendit që nuk ka mundur të riparohet ose nuk i është bërë riparimi, t'ia dorëzojë blerësit një send tjetër që funksionon në rregull. Sendet që janë objekt i kontratës së shitblerjes, përveç që duhet të jenë pa të meta materiale, disa prej tyre, siç janë malli teknik, duhet edhe të funksionojnë mirë. Pra, këtu e meta nuk ka të bëjë me vetitë materiale të sendit, por me funksionimin e mirë të tij, për të cilin garanton shitësi përkatësisht prodhuesi. Mosfunksionimi i mirë i sendit mund të jetë edhe objekt i kërkesës për të metat materiale të sendit. Sepse, edhe kur sendi nuk funksionon mirë, konsiderohet se mund të cilësohet si send me të meta materiale. Mirëpo, se cilën përgjegjësi lidhur me mosfunksionimin e rregullt të sendit do ta kërkojë blerësi, është çështje e tij për të cilën vendos në çdo rast konkret. Ndërkaq, garantimi për funksionim të mirë të sendeve është detyrim i shitësit dhe prodhuesit, kështu që kur ndodh mosfunksionimi i mirë i sendit, atëherë është më e lehtë të gjejnë shprehje dispozitat për përgjegjësinë për shkak të mosfunksionimit të mirë të sendeve, sepse mund të realizohet më shpejt riparimi përkatësisht zëvendësimi i sendit me një send tjetër i cili funksionon në rregull. Për ekzistimin e përgjegjësisë për mosfunksionim të mirë të sendit duhet të plotësohen këto kushte: **a) që sendi i shitur të jetë mall teknik dhe b) që për sendin e shitur, i cili nuk funksionon në rregull, shitësi t'ia ketë dhënë blerësit fletëgarancinë.** Kur plotësohen këto dy kushte dhe sendi i blerë nuk ka funksionim të rregullt, atëherë blerësi ka të drejtë që, në bazë të përgjegjësisë së shitësit dhe prodhuesit, të kërkojë riparimin e sendit, por kur shitësi, përkatësisht prodhuesi nuk e bën riparimin e sendit, atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e një sendi tjetër i cili funksionon në rregull dhe, në këtë mënyrë, duke u dhënë një send tjetër që funksionon në rregull, bëhet realizimi i plotë i qëllimit të kontratës së shitjes. Në qoftë se nuk bëhet riparimi dhe as dorëzohet një send tjetër që funksionon në mënyrë të rregullt, atëherë shitësi mund t'i realizojë të drejtat që dalin nga mospërbushja e rregullt e kontratës. Në raste të caktuara, edhe ligje të veçanta parashikojnë rregulla se si do të veprohet kur shitësi nuk është në gjendje të riparojë sendin⁶⁰. Shitësi ka detyrimin (edhe ligjor) që t'ia dorëzojë blerësit fletëgarancinë lidhur me sendin e shitur, i cili është mall teknik. Fletëgarancinë e jep prodhuesi, ndërsa blerësit që është shfrytëzues i fundit i atij sendi, listën e garancisë ia jep shitësi njëkohësisht me dorëzimin e sendit, por në rastet kur prodhuesi ia dorëzon atë send blerësit, i cili është shfrytëzues i fundit, atëherë edhe fletëgarancinë prodhuesi i atij sendi ia dorëzon drejtpërsëdrejti blerësit. Në kuptim të këtij ligji, mallra teknike konsiderohen: makina, motori, aparatet etj. Fletëgarancia mbi funksionimin e rregullt të sendit është bazë juridike për të kërkuar përgjegjësinë e shitësit dhe të prodhuesit për mosfunksionimin e rregullt të sendit të shitur. Fletëgarancia garanton që shitësi mban përgjegjësi që malli të funksionojë dhe ta ruajë cilësinë gjatë një kohe të caktuar. Për mosfunksionimin e rregullt të sendit të shitur përgjigjen si shitësi, ashtu edhe prodhuesi i atij sendi, ndërsa blerësi vendos se prej cilit subjekt do të kërkojë përgjegjësinë për mosfunksionimin e rregullt të sendit. Kërkesën që të bëhet riparimi ose zëvendësimi i sendit që nuk funksionon në rregull blerësi

60 Ligji Nr. 04/L-121 Për Mbrotjen e Konsumatorit i Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.32, datë 20 nëntor 2012, neni 5, pika 6, ku thuhet "Nëse shitësi gjatë periudhës së garancisë nuk mund ta riparojë mallin e dëmtuar për të cilin ka dhënë garancinë, atëherë detyrohet që konsumatorit t'i japë mallin e ngjashëm apo t'ia kthej mbrapa të hollat me dëmshpërblim".

mund ta bëjë gjatë afatit të garancisë, gjë që do të thotë se, pas kalimit të afatit të garancisë, nuk mund t'i referohet fletëgarancisë për përgjegjësinë e shitësit, përkatësisht të prodhuesit për mosfunksionimin e rregullt të sendit të shitur. Në rastet kur objekt i shitjes është malli teknik, d.m.th., me garanci, atëherë të gjitha të metat materiale të sendit, të cilat paraqiten gjatë kohëzgjatjes së afatit të garancisë, është i detyruar t'i mënjanojnë shitësi dhe prodhuesi. Mirëpo, ata lirohen nga përgjegjësia e parashikuar në garanci për të metat e sendit kur shitësi dhe prodhuesi provojnë se e meta ka ardhur për pasojë përdorimit të sendit në kundërshtim me udhëzimet teknike dhe me qëllimin e sendit, që është mall teknik.

484.2. Paragrafi 2, parashikon se, me rregullat që i përmban paragrafi 1 i këtij neni nuk preket në rregullat mbi përgjegjësinë e shitësit për të metat e sendit. Kjo do të thotë se blerësi ka të drejtë të zgjedhë që, lidhur me përgjegjësinë e shitësit për mallin e shitur që nuk funksionon në rregull, ta konsiderojë atë mall si send me të meta materiale, sepse nuk e përmbush qëllimin për të cilën blerësi e ka.

Neni 485. Kërkesa për riparim ose zëvendësim

- 1. Blerësi mundet për shkak të funksionimit jo në rregull të kërkojë nga shitësi, përkatësisht nga prodhuesi riparimin ose zëvendësimin e sendit gjatë afatit të garancionit, pavarësisht se kur është shfaqur e meta në funksionimin e sendit.**
- 2. Ai ka të drejtë në shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak se ka qenë i privuar nga përdorimi i sendit që nga momenti i kërkesës për riparimin ose zëvendësimin deri në kryerjen e tyre.**

485. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 485 përmban dispozitën me të cilën rregullohen ose caktohen kushtet e parashkrimit të kërkesës për riparimin e sendit që nuk funksionon mirë apo në rregull ose zëvendësimin e sendit i cili nuk funksionon dhe është me garanci.

485.1. Paragrafi 1 parashikon që blerësi, në çdo kohë brenda afatit të garancisë, për shkak të funksionimit jo në rregull të sendit, mund të kërkojë nga shitësi, përkatësisht nga prodhuesi riparimin ose zëvendësimin e sendit, pavarësisht se kur është shfaqur e meta në funksionimin e sendit. Shfaqja e të metës duhet të jetë brenda afatit të garancisë dhe kërkesa mund të ushtrohet vetëm gjatë afatit të garancisë. Zëvendësimi i sendit për shkak të funksionimit jo të rregullt me një send tjetër, është një formë e realizimit të përgjegjësisë së shitësit për mosfunksionim të rregullt të sendit dhe kur, në vend të sendit me funksionim jo të rregullt, blerësit i dërgohet sendi me funksionim të rregullt, atëherë sendi që është me funksionim jo të rregullt, edhe pse ligji nuk e parashikon askund, uhet t'i kthehet shitësit. Pra, blerësi nuk mund ta mbajë edhe sendin me funksionim të rregullt, edhe sendin që është zëvendësuar.⁶¹

61 Kjo zgjidhje ekziston në Kodin e Përgjithshëm Civil të Gjermanisë të vitit 1900, në paragrafin (nenin) 439, pika 4, të të cilit thuhet: "Shitësi i cili në mënyrë plotësuese ka dorëzuar sendin pa të meta, mund të kërkojë kthimin e sendit me të meta, kurse shitësi i bartë shpenzimet për dorëzimin e sendit të zëvendësuar, shpenzimet e transportit, shpenzimet e rrugës, shpenzimet e punës dhe të materialit".

485.2. Paragrafi 2 parashikon se blerësi ka të drejtën e shpërblimit të dëmit që e ka pësuar për shkak se ka qenë i privuar nga përdorimi i sendit që nga momenti i kërkesës për riparimin e ose zëvendësimin e tij deri në kryerjen e tyre. Ky paragraf përcakton të drejtën e blerësit për dëmin që pëson gjatë kohës kur ai nuk ka mundur ta përdorë sendin që duhet të riparohet ose të zëvendësohet për shkak të mosfunksionimit të rregullt të tij. Këtu, kemi të bëjmë me mospërdorim të sendit kur blerësi, pasi konstaton funksionimin jo të rregullt të sendit, e bën kërkesën për riparimin ose zëvendësimin e tij dhe ai nuk mund ta përdorë sendin për shkak se është dërguar për riparim ose pritët të zëvendësohet, ndërsa ky, për shkak të mospërdorimit, pëson një dëm të caktuar që do të mund të shfaqej, p.sh., si fitim i humbur, nëse, ta zëmë, blerësi ka blerë nga shitësi apo prodhuesi një makinë të rëndë – autobus për agjencinë e vet turistike dhe ka pasur të kontraktuar transportin e udhëtarëve, e në këtë kohë ai nuk mund ta kryejë transportin e tyre për shkak se autobusi është në riparim ose pritët të zëvendësohet dhe krejt ky fitim që do të ishte realizuar, po qe se sendi do të funksiononte në rregull, për blerësin është pësim i dëmit. Nuk kërkohet që shpërblimi i dëmit të bëhet nga dita e dërgimi i sendit për riparim, por si moment i fillimit të ecjes së kohës së shkaktimit të dëmit për mosfunksionim të sendit merret momenti kur blerësi e ka bërë kërkesën për riparim ose zëvendësim dhe kjo zgjatë derisa nuk kryhet riparimi, përkatësisht nuk bëhet zëvendësimi i sendit. Paragrafi 2 nuk parashikon se kush është ai që duhet ta bëjë shpërblimin e dëmit në lidhje me paragrafin 1, por del se shpërblimin e dëmit, të cilin blerësi e pëson për shkak se ka qenë i privuar nga përdorimi i tij, duhet ta bëjë shitësi, përkatësisht prodhuesi. Ndërkaq, raportet midis shitësit dhe prodhuesit janë të një natyre tjetër, që do të thotë se shitësi ka të drejtën e regresit, nëse i paguan shpërblimin e dëmit blerësit, sepse që të dy ata në këtë rast përgjigjen në mënyrë solidare. Shpërblimi i dëmit i takon blerësit edhe kur kryhet riparimi ose zëvendësimi i sendit, por bëhet zgjidhja e kontratës. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar mund të gjejë shprehje vetëm nëse dëmi është real, domethënë që dëmi të ketë ardhur për pasojë të mosfunksionimit të rregullt të sendit, përkatësisht për shkak se sendi nuk ka punuar dhe është kërkuar riparimi përkatësisht zëvendësimi i tij. Afati brenda të cilit duhet të riparohet a të zëvendësohet sendi zgjat derisa të ekzistojë garancia mbi funksionimin e rregullt të sendit. Riparimi dhe dorëzimi duhet të bëhen sa më shpejt – në një kohë të arsyeshme e më së voni deri në përfundim të garancisë.

Neni 486. Zgjatja e afatit të garancionit

- 1. Në rast të ndonjë riparimi të vogël, afati i garancionit zgjatet aq sa blerësi ka qenë i privuar nga përdorimi i sendit.**
- 2. Kur për shkak të funksionimit jo në rregull është bërë zëvendësimi i sendit, ose ndonjë riparim thelbësor të tij, afati i garancionit fillon të rrjedhë përsëri që nga zëvendësimi përkatësisht që nga kthimi i sendit të riparuar.**
- 3. Në qoftë se është zëvendësuar apo riparuar thelbësisht vetëm ndonjë pjesë e sendit, afati i garancionit fillon të rrjedhë përsëri vetëm për atë pjesë.**

486. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 486 përmban dispozitën me të cilën rregullohet zgjatja e afatit të garancisë mbi funksionimin e rregullt të sendit. Me këtë dispozitë, në fakt, rregullohet ndikimi i riparimit, përkatësisht zëvendësimit të sendit me funksionim jo të rregullt gjatë kohëzgjatjes së garancisë.

486.1. Paragrafi 1 parashikon se, në rast të ndonjë riparimi të vogël, afati i garancisë zgjatet për aq sa blerësi ka qenë i privuar nga përdorimi i sendit. Kjo do të thotë se, kur sendi riparohet në bazë të përgjegjësisë së shitësit përkatësisht prodhuesit për funksionimin jo të rregullt të sendit dhe ky riparim ka qenë shumë i vogël, që do të thotë se është bërë shumë shpejt, atëherë edhe afati i garancisë gjithsesi zgjatet përtej kohës së parashikuar në garanci, por vetëm për aq kohë sa blerësi ka qenë i privuar nga përdorimi i sendit, domethënë për aq ditë sa blerësi nuk e ka pasur në posedim sendin për shkak se ndodhej në riparim. Pra, këtu nuk kemi vazhdimin e garancisë prej fillimit të mosfunksionimit të rregullt të sendit, por vetëm për aq kohë sa blerësi ka qenë i privuar nga përdorimi i tij, p.sh., nëse sendi është riparuar për dhjetë (10) ditë, atëherë edhe afati i garancisë do të vazhdohet vetëm për dhjetë (10) ditë për aq sa blerësi nuk ka qenë në gjendje ta përdorë atë për shkak të riparimit të vogël. Në këtë paragraf përdoret shprehja “riparim i vogël” dhe nuk interpretohet se çfarë quhet riparim i vogël. Pra, çështja se çka konsiderohet riparim i vogël është një çështje faktike që vlerësohet sipas natyrës së sendit që riparohet dhe llojit të riparimit. Në rastin e paragrafit 1, pra kur riparimi është i vogël, në literaturën juridike konsiderohet ndalje e afatit të garancisë, çka do të thotë se nuk do të rrjedhë afati i garancisë vetëm atëherë kur bëhet fjalë për riparime të vogla të sendit, gjë që nënkupton se afati do të vazhdohet vetëm për aq kohë sa blerësi nuk ka mundur ta përdorë sendin e ndodhur në riparim⁶².

486.2. Paragrafi 2 parashikon rastin se kur, për shkak të funksionimit jo të rregullt, është bërë zëvendësimi i sendit, domethënë në vend të sendit me funksionim jo të rregullt, jepet sendi tjetër me funksionim të rregullt ose nëse është bërë riparimi thelbësor i sendit, atëherë afati i garancisë fillon të rrjedhë përsëri që nga zëvendësimi, përkatësisht që nga kthimi i sendit thelbësisht të riparuar. Kjo nënkupton se afati i garancisë nuk zgjatet si në paragrafin 1, por fillon të rrjedhë përsëri nga zëvendësimi, përkatësisht nga riparimi i sendit, sepse tash bëhet fjalë për një send tjetër që e ka zëvendësuar sendin me funksionim jo të rregullt

62 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 668.

dhe prandaj është krejtësisht normale që garancia e re të vlejë për këtë send prej fillimit. Njësoj vlen edhe kur riparimi i sendit me garanci ka qenë thelbësor, prandaj garancia për funksionimin e rregullt të sendit fillon nga dita e kthimit të sendi të riparuar. Koha e garancisë që ka vlejtur para riparimit nuk llogaritet më, sepse riparimi është thelbësor dhe shitësi ka detyrimin që ta caktojë afatin e garancisë mbi funksionimin e rregullt të sendit të riparuar njësoj me afatin që ka ekzistuar kur është shitur sendi që nuk ka funksionuar në mënyrë të rregullt, por këtë funksionim të rregullt e ka fituar mbas riparimit thelbësor. Kur afati i garancisë nis prej fillimit për shkak të zëvendësimit përkatësisht riparimit thelbësor të sendit, i cili ka qenë me funksionim jo të rregullt, konsiderohet se afati garantues ndërpritet, d.m.th., afati i garancisë që ka ekzistuar më herët ndërpritet, ashtu që afati për sendin me të cilin është zëvendësuar ai me funksionim jo të rregullt, përkatësisht afati i garancisë për sendin e riparuar thelbësisht e që ka të bëjë me tërë sendin, nis nga fillimi për tërë sendin e zëvendësuar, përkatësisht për sendin e riparuar thelbësisht.

486.3. Paragrafi 3 parashikon një përjashtim, sipas të cilit, në qoftë se është zëvendësuar apo riparuar thelbësisht vetëm ndonjë pjesë e sendit, atëherë afati i garancisë fillon të rrjedhë përsëri vetëm për atë pjesë të zëvendësuar të sendi me funksionim jo të rregullt ose për pjesën e riparuar thelbësisht të tij. Ky paragraf dallon nga paragrafi 2 i këtij neni, sepse në rastin e paragrafit 3, kur kemi të bëjmë me zëvendësim a riparim thelbësor vetëm të një pjesë të sendit, garancia e plotë dhe nga fillimi jepet vetëm për këtë pjesë, ndërsa për pjesët e tjera të sendit që i është zëvendësuar apo riparuar thelbësisht ndonjë pjesë, vazhdon të rrjedhë në mënyrë normale afati i parashikuar në garancinë fillestare. Blerësi në çdo rast gëzon të drejtën e shpërblimit për dëmin e shkaktuar nga zëvendësimi apo riparimi thelbësor i ndonjë pjesë të sendit.

Neni 487. Zgjidhja e kontratës dhe zbritja e çmimit

Në qoftë se shitësi nuk e kryen brenda afatit të arsyeshëm riparimin ose zëvendësimin e sendit, blerësi mund ta zgjidhë kontratën ose të bëjë zbritjen e çmimit dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

487. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 487 parashikon mundësinë e zgjidhjes së kontratës dhe zbritjen e çmimit, kur bëhet fjalë për sendin që është me afat garancie, por që nuk është zëvendësuar, përkatësisht nuk i është bërë as riparimi brenda një afati të arsyeshëm. Kjo dispozitë parashikon shprehimisht se, kur shitësi nuk e kryen brenda një afati të arsyeshëm riparimin ose zëvendësimin e sendit, atëherë blerësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës ose të bëjë zbritjen e çmimit dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit. Neni 487 i LMD të Kosovës e përmend të drejtën e blerësit (vetëm kundrejt shitësit) për zgjidhjen e kontratës dhe zbritjen e çmimit për shkak se detyrimi që ka ekzistuar për zëvendësimin e sendit, i cili nuk kishte funksionim të rregullt në krahasim me një send që ka funksionim të rregullt ose riparimin brenda një afati të arsyeshëm që ishte detyrim edhe i shitësit, edhe i prodhuesit; në këtë rast, blerësi, si palë kontraktuese e shitësit, ka të drejtë të kërkojë

zgjidhjen e kontratës nga shitësi, sepse kontrata është e lidhur midis shitësit dhe blerësit ose të kërkojë zbritjen e çmimit, sepse zbritja e çmimit mund të negociohet me shitësin nga ana e blerësit, por gjithmonë e ka të drejtën të kërkojë edhe shpërblimin për dëmin e pësuar. Shpërblimi për dëmin duhet të bëhet jo vetëm për shkak të kohës sa nuk është përdorur sendi për pasojë të mosfunksionimit të tij, por edhe për të gjitha dëmet që ka pësuar blerësi, si pasojë e mospërmbushjes së rregullt të kontratës.

Neni 488. Shpenzimet dhe rreziku

- 1. Shitësi përkatësisht prodhuesi ka për detyrë që me shpenzime të veta ta transportojë sendin deri në vendin ku duhet të riparohet ose të zëvendësohet, si dhe sendin e riparuar ose të zëvendësuar t'ia kthejë blerësit.**
- 2. Gjatë asaj kohe shitësi përkatësisht prodhuesi bartë rrezikun për shkatërrimin ose dëmtimin e sendit.**

488. *Vështrim i përgjithshëm.* - Neni 488 rregullon shpenzimet që mund të bëhen për shkak të riparimit të sendit, përkatësisht zëvendësimit të tij, por edhe rrezikun që mund të ekzistojë për shkak të shkatërrimit të sendit gjatë kohës së transportit.

488.1. Paragrafi 1 parashikon se shitësi, përkatësisht prodhuesi, ka detyrimin që, me shpenzime të veta, ta transportojë sendin që është me garanci deri në vendin ku duhet të bëhet riparimi i vogël ose riparimi thelbësor ose ku duhet zëvendësuar, ndërsa sendin e riparuar ose të zëvendësuar t'ia kthejë blerësit në vendin ku është marrë sendi për riparim, përkatësisht për zëvendësim. Ky paragraf nënkupton se shitësi, përkatësisht prodhuesi ka për detyrë t'i mbulojë shpenzimet që do të bëhen për transportin e sendit nga blerësi deri te vendi ku do të bëhet riparimi, prej ku sendi i riparuar ose i zëvendësuar i kthehet blerësit aty ku është marrë sendi⁶³.

488.2. Paragrafi 2 parashikon se gjatë kohës së transportit të sendit deri në vendin ku duhet të riparohet ose të zëvendësohet dhe pastaj, i riparuar ose i zëvendësuar, t'ia kthehet blerësit, shitësi përkatësisht prodhuesi bartin rrezikun për shkatërrimin ose dëmtimin e sendit. Edhe pse në dispozitë thuhet “gjatë asaj kohe”, duke menduar për kohën gjatë transportit të

.....
63 Mund të ndodhë që, për shkak të rrethanave, blerësi ta bëjë transportin e sendit, por kjo dispozitë në këtë rast blerësit i jep të drejtë t'i kërkojë shpenzimet e transportit të bëra nga shitësi përkatësisht prodhuesi dhe ato jo vetëm të transportit, por të gjitha shpenzimet që bëhen për mbërritjen e sendit deri te vendi i riparimit dhe anasjelltas. Këtë shembull të shtjelluar, kur blerësi bën transportin e sendit që do të riparohet ose do të zëvendësohet, nuk e parashikon ky paragraf, por kjo nuk përjashtohet si mundësi, duke pasur parasysh natyrën e sendit, përkatësisht që riparimi të bëhet sa më shpejtë. Mirëpo, derisa është i thjeshtë përcaktimi i shpenzimeve të bëra lidhur me transportin deri te vendi i riparimit dhe kthimi te vendi i blerësit, kur ai bëhet edhe nga ana e blerësit me pajtim të shitësit përkatësisht prodhuesit, është shumë kontestuese se kush e bart rrezikun gjatë transportit dhe kohës sa qëndron në riparim dhe gjatë kthimit deri te vendi i blerësit. Edhe në këtë rast konsiderojmë se mbasi rreziku për këtë lloj të transportit të sendit është detyrim i shitësit dhe prodhuesit, atëherë edhe rrezikun për shkatërrimin e sendit ose dëmtimin e tij e bart shitësi përkatësisht prodhuesi.

sendit, shitësi përkatësisht prodhuesi bartin rrezikun për shkatërrimin ose dëmtimin e sendit edhe për kohën derisa ai ndodhet në riparim dhe jo vetëm gjatë transportit⁶⁴.

Neni 489. Përgjegjësia e kooperuesve

Kur në prodhimin e pjesëve të veçanta të sendit ose në zbatimin e veprimeve të veçanta kanë marrë pjesë disa prodhues të pavarur, përgjegjësia e tyre ndaj prodhuesit final për funksionimin jo të rregullt të sendit që rezulton prej këtyre pjesëve ose prej këtyre veprimeve shuhet, kur shuhet përgjegjësia e prodhuesit final ndaj blerësit të sendit.

489. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 489 përmban dispozitën me të cilën parashikohet se si do të veprohet kur ekziston përgjegjësia e kooperuesve përkatësisht përgjegjësia e shumë prodhuesve, të cilët marrin pjesë në krijimin e sendit final, funksionimi i rregullt i të cilit i garantohet blerësit. Neni 489 i LMD të Kosovës parashikon shprehimisht se, kur në prodhimin e pjesëve të veçanta të sendit ose në zbatimin e veprimeve të veçanta kanë marrë pjesë disa prodhues të pavarur, atëherë edhe ata janë përgjegjës për pjesët e tyre të prodhuara, por kjo përgjegjësi e tyre ekziston ndaj prodhuesit final për funksionimin jo të rregullt të sendit, që është rezultat i këtyre pjesëve të prodhuara nga kooperuesit e ndryshëm ose prej veprimeve të kooperuesve të ndryshëm, ndërkaq përgjegjësia e tyre ndaj prodhuesit final të sendit, i cili ka funksionim jo të rregullt, do të shuhet kur shuhet përgjegjësia edhe e vetë prodhuesit final ndaj blerësit të sendit. Pra, për aq kohë sa ekziston përgjegjësia e prodhuesit final ndaj blerësit për sendin me funksionim jo të rregullt, ekziston edhe përgjegjësia e kooperuesve për pjesët e tyre të veçanta të sendit ose për zbatimin e veprimeve të veçanta në prodhimin final të sendit, të cilin prodhuesi final ia ka kaluar blerësit. Kjo dispozitë tregon se blerësi, edhe për sendin që është produkt i kooperuesve, mund ta paditë vetëm prodhuesin final të sendit për funksionim jo të rregullt të tij, ndërsa prodhuesi final ka të drejtë të kërkojë nga kooperuesit që kanë prodhuar pjesë të veçanta të sendit ose kanë zbatuar veprime të veçanta që janë me të meta materiale ose që kanë bërë që sendi final të jetë me funksionim jo të rregullt, p.sh., makinën rrobalarëse e shet prodhuesi final Gorenje, ndërsa pjesët e saj janë prodhuar nga kooperues të ndryshëm, kështu që, kur konstatohet se ndonjë pjesë e bën jo të rregullt funksionimin e sendit dhe dihet cili kooperues e ka prodhuar pjesën që ka shkaktuar funksionimin jo të rregullt, blerësi nuk mund të kërkojë përgjegjësi për funksionimin jo të rregullt të asaj pjese, por përgjegjësinë e kërkon nga prodhuesi final i sendit me funksionim jo të rregullt (Gorenje), ndërsa ky i fundit ka të drejtë të kërkojë përgjegjësi ndaj kooperuesve të vet, përgjegjësia e të cilëve shuhet në momentin kur shuhet përgjegjësia e prodhuesit final ndaj blerësit. Te sendi me funksionim jo të rregullt, të prodhuar nga disa kooperues, si prodhues final konsiderohet (pa marrë parasysh rolin e tij në krijimin e sendit final) personi që figuron në fletëgaranci si garantues, sepse ai ndaj shitësit përgjigjet në bazë të fletëgarancisë⁶⁵.

64 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 670.

65 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 670.

Marrëdhëniet ndërmjet kooperuesve dhe prodhuesit final për funksionimin e pjesëve është çështje që mund të kontraktohet midis tyre.

Neni 490. Humbja e të drejtave

Të drejtat e blerësit ndaj prodhuesit në bazë të fletëgarancionit shuhen pasi të ketë kaluar një (1) vit, duke llogaritur nga dita kur ka kërkuar prej tij riparimin ose zëvendësimin e sendit.

490. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 490 përmban dispozitën lidhur me humbjen e të drejtave të blerësit të parashikuara në fletëgarancinë mbi funksionimin e rregullt të sendit. Me këtë dispozitë shumë qartas parashikohet se të drejtat e blerësit ndaj prodhuesit në bazë të fletëgarancisë shuhen pasi të ketë kaluar 1 (një) vit, llogaritur nga dita kur ka kërkuar prej tij riparimin ose zëvendësimin e sendit. Kjo dispozitë parashikon afatin për realizimin e të drejtave të blerësit që kanë për bazë fletëgarancinë. Dilema lidhur me këtë dispozitë është se aty përmendet vetëm e drejta e blerësit ndaj prodhuesit dhe harrohet shitësi, i cili në mënyrë solidare përgjigjet së bashku me prodhuesin për funksionimin jo të rregullt të sendit dhe e njëjta gjë duhet të vlejë edhe për shuarjen e kërkesës së blerësit ndaj shitësit. Afati një- vjeçar brenda të cilit duhet të realizohet kërkesa e blerësit ndaj prodhuesit në bazë të fletëgarancisë fillon të rrjedhë nga dita kur ka kërkuar prej tij riparimin ose zëvendësimin e sendit. Prandaj, nëse nuk bëhet riparimi ose zëvendësimi i sendit brenda këtij afati, atëherë blerësi duhet të ngrejë padi për mospërbushje të rregullt të kontratës.

NËNKREU 3 PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT JURIDIKE

Neni 491. Të metat juridike

- 1. Shitësi përgjigjet në qoftë se në sendin e shitur ekziston ndonjë e drejtë e të tretit e cila e përjashton, zvogëlon ose kufizon të drejtën e blerësit, e për ekzistimin e saj blerësi nuk është njoftuar, e as që ka dhënë pëlqimin që ta marrë sendin e ngarkuar me këtë të drejtë.**
 - 2. Shitësi i ndonjë të drejte tjetër garanton se ajo ekziston dhe se nuk ka pengesa juridike për realizimin e saj.**
 - 3. Në qoftë se në regjistrat publik është regjistruar ndonjë e drejtë e personave të tretë, e cila në realitet nuk ekziston, shitësi është i detyruar që me shpenzime te veta të bëjë çregjistrimin e asaj të drejte.**
-

491. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 491 përmban dispozita me të cilat rregullohet përgjegjësia për të metat juridike të sendit të shitur. Siç u vu në dukje më sipër, sendi

mund të ketë të meta materiale, por mund të ketë edhe të meta juridike dhe, në të dy rastet, ekziston përgjegjësia për të metat materiale të sendit dhe të metat juridike të sendit. Kur bëhet fjalë për të metat materiale të sendit, përgjegjësia bie mbi shitësin dhe prodhuesin e sendit, ndërsa për të metat juridike të sendit është përgjegjës vetëm shitësi. Kur sendi ka të meta juridike, kalimi i të drejtave mbi të, për çka është i interesuar blerësi, nuk mund të ndodhë sipas marrëveshjes, për shkak se sendi ka të meta juridike si, p.sh., kur një person i tretë ka ndonjë të drejtë mbi sendin me të meta juridike që është objekt i shitjes, e. Me blerjen e sendit, përmes kontratës së shitblerjes krijohet baza juridike që sendi të kalojë në posedim të blerësit dhe me kalimin e posedimit të fitohen edhe të drejtat mbi sendin, përkatësisht të fitohet e drejta pronësisë mbi atë send dhe, kur blerësi bëhet pronar i tij, ai e fiton të drejtën e disponimit mbi sendin si dhe të drejtën e përdorimit dhe shfrytëzimit të tij pa pengesa. Përgjegjësia për të metat juridike ndryshe quhet edhe mbrojtje nga evikcioni. Evikcioni është një akt juridik i personit të tretë ose veprim i personit të tretë, i cili drejtohet kundër të drejtës së fituar nga shitësi, me qëllim që e drejta e fituesit (blerësit) të kufizohet, të zvogëlohet ose të merret, sepse personi i tretë gëzon të drejtën e evikcionit sa herë që i cenohet e drejta e tij, pra edhe në rastin e blerësit të sendit nga shitësi, ndërsa mbrojtja nga evikcioni është e drejtë subjektive e fituesit, përkatësisht e blerësit kundrejt shitësit të sendit, kur ndaj tij është parashtruar kërkesë evikcioni nga personi i tretë. Në këtë rast, blerësi i sendit, mbi të cilin ka fituar të drejta të caktuara, pra edhe të drejtën e pronësisë, kur është sendi i luajtshëm, të cilën e fiton me dorëzimin e sendit nga shitësi dhe kur është sendi i paluajtshëm, me regjistrimin e tij në Regjistrin për regjistrimin e të drejtave mbi paluajtshmëritë⁶⁶, ka të drejtë të kërkojë prej shitësit që t'i ofrojë mbrojtje nga pretendimet e personit të tretë, i cili pretendon se ka të drejta të caktuara mbi sendin të cilin e ka blerë blerësi nga shitësi. Mbrojtja e blerësit ose përgjegjësia e shitësit për të metat juridike parashikohet edhe në kodet civile të shteteve të tjera⁶⁷.

491.1. Paragrafi 1 përcakton përgjegjësinë e shitësit kur mbi sendin e shitur ekziston ndonjë e drejtë e të tretit, e cila e përjashton, e zvogëlon ose e kufizon të drejtën e blerësit, kurse për ekzistimin e të drejtës së të tretit blerësi nuk është njoftuar dhe as që ka dhënë pëlqimin që ta marrë sendin e ngarkuar me këtë të drejtë. Objekt i shitjes mund të jetë sendi, por edhe ndonjë e drejtë tjetër, pra një e drejtë që është e qarkullueshme nga një titullar te një titullar

66 Ligji Nr.03/L-154 “Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës”, Gazeta Zyrtare Nr.57, datë 04 Gusht 2009, neni 21, ku thuhet “Për fitimin e pronësisë në një send të luajtshëm është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit të pronësisë si dhe dorëzimi i sendit te fituesi i pronësisë” dhe neni 36, ku thuhet “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”.

67 Svajcarski Zakonik o obligacijama, Od 30. Marta 1911, sa izmenama i dopunama izvrsenim do 1 Januara 1976, Bg, 1976 (përkthim) nenet 192-196; Kodi Civil i Francës (CC 1804) neni 1485; KCSH, neni 719, ku thuhet “Shitësi duhet të dorëzojë sendet, të shkarkuara nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe”.

tjetër. Nëse shitësi ka shitur dhe dorëzuar sendin e huaj⁶⁸, atëherë ai send nuk i ka vetitë e nevojshme që blerësi të bëhet pronar i tij dhe në këtë rast lind përgjegjësia e shitësit për të metat juridike të sendit, e cila ka të bëjë me detyrimin e shitësit që t'i garantojë blerësit që sendi i shitur nuk ka të meta juridike dhe blerësi mund ta fitojë të drejtën e pronësisë mbi atë send. E meta juridike mund të paraqitet edhe kur sendi është i ngarkuar me barrë sendore, p.sh., me peng, dhe shitësi nuk i tregon blerësit për këtë, por i garanton se sendi i shitur nuk është i ngarkuar me barrë të tilla. Sendi është me të meta juridike edhe kur është pronë e përbashkët e bashkëshortëve dhe njëri prej bashkëshortëve e shet sendin që është në pronësi të përbashkët, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Shitësi i garanton blerësit se sendi i shitur është në pronësi të tij, edhe pse, në fakt, ai është pronë e përbashkët e të dy bashkëshortëve. Në këtë rast lind përgjegjësia për të metat juridike të sendit të shitur. Paragrafi 1 e konsideron sendin me të meta juridike, kur një person i tretë ka ndonjë të drejtë që e përjashton në tërësi të drejtën e blerësit, i cili për këtë të drejtë të personit të tretë fare nuk është njoftuar e as që ka dhënë pëlqimin për ta blerë një send të tillë; pastaj e metë juridike është kur e drejta e të tretit e zvogëlon ose e kufizon të drejtën e blerësit, p.sh., ekzistimi i servitutit mbi sendin, pra nëse dikush do të kishte të drejtën e uzufuktit mbi sendin e shitur, atëherë blerësi do ta blinte sendin, por e drejta e fryteve do t'i takonte jo blerësit të sendit, por titullarit të uzufuktit, kështu që ky fakt do ta kufizonte të drejtën e blerësit me të drejtën e personit të tretë, i cili në këtë rast është uzufuktuesi, ndërsa q shitësi gjithmonë përgjigjet për të metat juridike kur nuk e ka njoftuar blerësin ose kur nuk ekziston pëlqimi i dhënë nga blerësi për të metat juridike të sendit.

491.2. Paragrafi 2 parashikon se shitësi mund ta ketë objekt të shitjes ndonjë të drejtë tjetër, ekzistimin e së cilës e garanton, duke pohuar se nuk ka pengesa juridike për realizimin e saj, p.sh., shitësi mund ta shesë të drejtën e kërkesës të ndonjë borxhi, gjë që do të thotë se blerësi nuk e blen sendin, por kërkesën e shitësit (kreditorit), të cilën e ka në raport me një person të tretë, që ndryshe quhet debitor. Në këtë ndryshe e quajmë edhe blerje të kërkesave (blerje të borxheve), por objekt i shitjes mund të jetë edhe e drejta e patentës. Në këto raste, kur shitësi shet të drejta, ai ka për detyrë të tregojë se ato ekzistojnë, përkatësisht të provojë ekzistimin e së drejtës, e cila është objekt i shitjes, por, përveç ekzistimit, duhet të provojë se nuk ka pengesa juridike për realizimin e saj. Kjo do të thotë se nuk ekziston ndonjë kundërkërkesë e debitorit në raport me të drejtën e shitësit.

491.3. Paragrafi 3, parashikon se, kur në regjistrat publikë, p.sh., në regjistrin e të drejtave për paluajtshmëritë ose për regjistrimin e pengut në regjistrin për sendet e luajtshme, është regjistruar ndonjë e drejtë e personave të tretë, përkatësisht pengu, pronësia, hipoteka, servituti etj. dhe nëse ajo nuk ekziston, atëherë shitësi është i detyruar që, me shpenzimet e veta, ta bëjë çregjistrimin e asaj të drejte, përkatësisht të drejtën e hipotekës, të drejtën e pronësisë të regjistruar gabimisht, të drejtën e servitutit, në qoftë se ajo nuk ekziston, por është e regjistruar etj.

68 Shih : Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Zagreb, Gžn-1737/09 od 27. travnja 2011.g, ku, ndër të tjera, thuhet: “e paditura e dytë është përgjegjëse, si shitëse i sendit me të meta juridike sipas nenit 508, paragrafi 1 të LMD të Kroacisë, sepse paditësit i ka shitur sendin mbi të cilin personi i treti ka të drejtën që e përjashton të drejtën e paditëses, sepse shënimet burimore të lejës së qarkullimit janë shlyer dhe janë shënuar të tjera, prandaj janë të papranueshme thëniet e kundërta në ankesë, sepse nuk janë të arsyeshme për përjashtimin e përgjegjësive së dëmshme të së paditurës së dytë”.

Neni 492. Njoftimi i shitësit

Në qoftë se konstatohet se personi i tretë paraqet një të drejtë mbi sendin, atëherë blerësi është i detyruar ta njoftojë shitësin për këtë, përveç nëse shitësi për këtë është në dijeni, dhe të kërkojë prej tij që brenda afatit të arsyeshëm ta lirojë sendin nga e drejta ose pretendimi i personit të tretë, ose kur objekt i kontratës janë sendet e caktuara sipas llojit, t'ia dërgojë sendin tjetër pa të metë juridike.

492. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 492 i LMD të Kosovës parashikon se blerësi, kur konstaton të metën juridike, është i detyruar ta njoftojë shitësin për këtë në kushtet e parashikuara me këtë dispozitë. Kjo dispozitë parashikon se, në rastet kur konstatohet që personi i tretë e pretendon një të drejtë mbi sendin, përkatësisht kur pretendon se është sendi i vet ose ka ndonjë të drejtë mbi të ose është bashkëpronar, atëherë blerësi është i detyruar ta njoftojë shitësin për këtë, pra blerësi duhet t'i drejtohet shitësit se personi i caktuar ka pretendime mbi sendin e blerë prej tij. Mirëpo, blerësi nuk është i detyruar ta njoftojë shitësin për pretendimet e personave të tretë se kanë ndonjë të drejtë mbi sendin, nëse shitësi tanimë është në dijeni për pretendimin e personit të tretë dhe, pas njoftimit, pra njëkohësisht me njoftimin, të kërkojë nga shitësi që, brenda një afati të arsyeshëm, ta lirojë sendin nga e drejta ose pretendimi i personit të tretë, domethënë, të kërkojë prej tij që të hiqet e drejta e personave të tretë nga regjistrat publikë, nëse ekziston, ose të ndalohet pretendimi i personit të tretë, mirëpo kur objekt i kontratës janë sendet e caktuara sipas llojit, blerësi ka të drejtë të kërkojë që shitësi t'ia dërgojë një send tjetër pa të meta juridike. Personat e tretë lajmërohen për të drejtat e tyre ndaj sendit të blerë, natyrisht, pas lidhjes së kontratës, ndërsa blerësi nuk ka pasur dijeni dhe as që ka mundur të dijë për pretendimet e personave të tretë ndaj sendit të blerë. Në këtë rast ekziston mundësia që, pas njoftimit të shitësit nga ana e blerësit, të kërkohet edhe çregjistrimi i të drejtës eventuale ekzistuese mbi sendin e blerë. E drejta e blerësit që të kërkojë heqjen e të metave juridike nuk ekziston vetëm kur personi i tretë pretendon dhe kërkon jetësimin e së drejtës së vet mbi sendin që e ka blerë blerësi prej shitësit, por edhe atëherë kur personi i tretë hesht, kur i është njohur ekzistimi i të drejtës së tij mbi sendin e blerë. Blerësi ka detyrimin që ta njoftojë shitësin për të metat juridike të sendit, për të cilat ka mësuar më vonë, por në qoftë se blerësi nuk e njofton shitësin, ai nuk i humb të drejtat që i takojnë lidhur me ekzistimin e të metave juridike të sendit të blerë, por këto të drejta ai do t'i humbë pasi të kalojë afati prekluziv. E drejta e blerësit, kur sendi ka të meta juridike, për të kërkuar nga shitësi të shkarkohet nga të drejtat apo pretendimet e personit të tretë, nuk është diçka që ia humb të drejtën për t'u mbrojtur nga personat e tretë edhe në mënyrë të pavarur, por në këtë rast përgjegjësia e mbrojtjes nga të metat juridike bie mbi blerësin.

Neni 493. Sanksionet për të metat juridike

1. Në qoftë se shitësi nuk vepron sipas kërkesës së blerësit në rastin kur merret sendi nga blerësi kontrata zgjidhet sipas ligjit, e në rastin e zvogëlimit ose të kufizimit të së drejtës së blerësit, sipas dëshirës së vet blerësi mundet ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen proporcionale të çmimit.

- 2. Në qoftë se shitësi nuk e përmbush detyrën ndaj blerësit që në afatin e arsyeshëm ta lirojë sendin nga e drejta ose nga pretendimi i personit të tretë, blerësi mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se për atë shkak qëllimi i saj nuk mund të realizohet.**
- 3. Në çdo rast blerësi ka të drejtë për shpërblimin e dëmit të pësuar.**
- 4. Në qoftë se blerësi në çastin e lidhjes së kontratës ka qenë në dijeni për mundësinë që sendi t'i merret, ose që e drejta e tij t'i zvogëlohet ose t'i kufizohet, nuk ka të drejtë në shpërblimin e dëmit në qoftë se ajo mundësi realizohet, por ka të drejtë të kërkojë kthimin, përkatësisht zbritjen e çmimit.**

493. Vështrim i përgjithshëm. - Neni 493 ka për objekt sanksionet për të metat juridike që, në fakt, në të kaluarën janë quajtur si të drejta të blerësit.

493.1. Paragrafi 1 përmban dispozitën, sipas së cilës, kur shitësi nuk vepron sipas kërkesës së blerësit, në rastin kur i merret sendi, atëherë kontrata zgjidhet sipas ligjit (*ex lege*), domethënë, si sanksion për të metat juridike kur shitësi nuk vepron sipas kërkesës së blerësit, të cilit i është marrë sendi, atëherë *ex lege* bëhet zgjidhja e kontratës dhe kjo quhet zgjidhja e kontratës për shkak të ekzistimit të të metave juridike. Ndërkaq, në rastin kur ekziston kufizimi ose zvogëlimi i të drejtës së blerësit, pra kur realizohet e drejta e blerësit mbi sendin në përqindje më të vogël sesa është kontraktuar, p.sh., jo 100% por 90%, sepse sendi është në bashkëpronësi ose kur kemi të bëjmë me kufizimin e së drejtës së blerësit, sepse ekziston servituti ose ndonjë barrë sendore, atëherë blerësi, sipas dëshirës - mund ta zgjidhë kontratën për sendin e blerë me të meta juridike, gjë që kryesisht varet nga dëshira e tij ose të kërkojë zbritjen proporcionale të çmimit lidhur me sendin e blerë me të meta juridike, p.sh., nëse shitësi ka qenë pronar i sendit të blerë me 90% ,ndërsa personi i tretë është pronar me 10%, atëherë kemi zvogëlimin e të drejtës së pronësisë për shkak të ekzistimit të bashkëpronarit tjetër me 10% dhe, në këtë rast, blerësi ka të drejtë ose të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ose të kërkojë zbritjen proporcionale të çmimit. Në rastin konkret, zbritja proporcionale do të ishte 10%. Për t'u bërë zgjidhja e kontratës *ex lege* për shkak të të metave juridike të sendit duhet që shitësi të mos ketë vepruar sipas kërkesës së blerësit për mënjanimin e të metave juridike, përkatësisht për përmbushjen pa të meta dhe pastaj edhe duhet të jetë marrë sendi nga blerësi. Lidhur me këtë thuhet se marrje të sendit nga blerësi nuk përbën çfarëdo heqje atributësh nga sendi, por kur sendi i merret përgjithmonë. Ky send i merret blerësit, p.sh., kur ai ka qenë send i vjedhur dhe, në këtë rast, zgjidhja e kontratës nuk ka nevojë të kërkohet nga blerësi, por ligji, *ex lege*, e konsideron kontratën të zgjidhur, kur do të vlejnë rregullat për mospërmbushjen e kontratës. Ndërkaq, kur ekziston kufizimi ose zvogëlimi i të drejtës së blerësit, kontrata nuk zgjidhet *ex lege*, por kjo do të ndodhë vetëm nëse e kërkon shprehimisht blerësi (me dëshirën e blerësit).

493.2. Paragrafi 2 parashikon rastin kur shitësi nuk e përmbush detyrimin ndaj blerësit në një afat të arsyeshëm, për ta liruar sendin nga e drejta apo nga pretendimi i personit të tretë. Në këtë rast, blerësi ka të drejtë dhe mund ta zgjidhë kontratën, në qoftë se, për atë shkak, qëllimi i kontratës nuk mund të realizohet. Kjo do të thotë se, kur shitësi nuk mund ta çregjistrojë të drejtën e personit të tretë nga librat publike në një afat të arsyeshëm, blerësi

konsideron se qëllimi i kontratës nuk mund të realizohet dhe për këtë arsye ai mund ta zgjidhë atë. Zgjidhja e kontratës, pra, bëhet me deklarimin e njëanshëm të vullnetit (në këtë rast të blerësit), por për t'u zgjidhur kontrata, duhet të kalojë një kohë e arsyeshme për lirimin e sendit nga e drejta ose nga pretendimi i personit të tretë dhe, nëse ekzistimi i të drejtës, përkatësisht pretendimi i personit të tretë, krijon një gjendje të tillë që e bën të pamundur realizimin e qëllimit të kontratës. Nëse zgjidhet kontratës për shkak të së metës juridike e cila nuk ka mundur të eliminohet, blerësi duhet ta kthejë sendin e blerë dhe të kërkojë kthimin e çmimit. Shpërblimi i dëmit me rastin e zgjidhjes së kontratës gjithmonë është i mundur për blerësin.

493.3. Paragrafi 3 parashikon se blerësi, i cili ka blerë sendin me të meta juridike, në çdo rast, pra në çdo situatë (dhe jo vetëm për shkak të zgjidhjes së kontratës), ka të drejtën e shpërblimit të dëmit të pësuar. Për shpërblimin e dëmit në bazë të këtij paragrafi thuhet se do të zbatohen rregullat e përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin për shkak të mosrespektimit të kontratës dhe jo rregullat e përgjithshme për përgjegjësinë e kontraktuar për shkaktimin e dëmit⁶⁹. E drejta e shpërblimit të dëmit, të cilin e ka pësuar blerësi për shkak të ekzistimit të të metave juridike, është e varur nga mirëbesimi i blerësit, domethënë që blerësi të mos ketë pasur dijeni për të metat juridike ekzistuese. Në rast se ekziston e meta juridike në sendin e shitur, përkatësisht kur ekziston e drejta e personit të tretë, e cila e përjashton ose e zvogëlon të drejtën e blerësit, i cili për këtë nuk ka qenë i njoftuar, atëherë këtij i përket e drejta e shpërblimit të dëmit të pësuar.

493.4. Paragrafi 4 parashikon se, në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ka qenë në dijeni për mundësinë që sendi t'i merret ose që e drejta t'i zvogëlohet ose t'i kufizohet, atij nuk i takon e drejta e shpërblimit të dëmit kur ajo mundësi realizohet, por ka të drejtë të kërkojë kthimin përkatësisht zbritjen e çmimit. Personi që ka ditur për mundësinë e marrjes së sendit të blerë për shkak të të metave juridike bart, po ashtu, një lloj rreziku dhe, në këtë rast, nëse sendi i merret, atëherë ka vetëm të drejtën e kthimit të tij, por për shkak se ka pasur dijeni se sendi mund t'i merret, atij nuk i takon e drejta e shpërblimit të dëmit. Kjo do të thotë se, edhe në rastet kur blerësi e ka ditur se mund t'i merret sendi në tërësi ose pjesërisht, d.m.th., kur dikush tjetër ka ndonjë të drejtë mbi sendin e tij të blerë, atij i takon vetëm e drejta e kthimit të plotë ose të pjesshëm të çmimit për sendin e blerë dhe kurrsesi nuk mund të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 494. Kur blerësi nuk e njofton shitësin

Blerësi, i cili duke mos njoftuar shitësin është lëshuar në kontest me personin e tretë dhe e ka humbur kontestin, megjithatë mund të thirret në përgjegjësinë e shitësit për të metat juridike, përveç nëse shitësi provon se ka disponuar mjete që të refuzohet kërkesa e personave të tretë.

494. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 494 përmban dispozitën me të cilën rregullohet rasti kur blerësi nuk e njofton shitësin se personi i tretë, i cili pretendon ndonjë të drejtë mbi

⁶⁹ Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 679.

sendin e blerë, ka filluar procedurën për vërtetimin e të drejtës së vet dhen nëse ndodh ta humbë kontestin, prapë se prapë blerësi, edhe kur e humb kontestin kundrejt personit të tretë i cili pretendon të drejtën mbi sendin e blerësit, mund t'i referohet përgjegjësisë së shitësit për të metat juridike që i ka pasur sendi në momentin e dorëzimit të blerësi. Këtu bëhet fjalë për rastet kur blerësi i sendit me të meta juridike i hyn procedurës me personin e tretë, i cili pretendon për ndonjë të drejtë mbi sendin e tij të blerë dhe e humb kontestin, domethënë, personi i tretë e vërteton të drejtën e vet në rrugë gjyqësore mbi sendin e tij të blerë. Në literaturën juridike vihet në dukje se humbja e kontestit nuk ka të bëjë vetëm me rastet kur ai zhvillohet në gjykatë, por kjo mund të ndodhë edhe në procedurën administrative⁷⁰, kurse procedura për vërtetimin e ndonjë të drejte, përveç që bëhet në favor të personit që insiston për atë të drejtë, mund të bëhet edhe për të drejtën e ndonjë personi tjetër, pra kur paditësi nuk e zhvillon procedurën për vete, por për ndonjë person tjetër⁷¹, p.sh., kur Organi i Kujdestarisë paraqitet si përfaqësues i fëmijës së mitur, e drejta e të cilit ekziston mbi sendin e blerë. Kjo dispozitë gjithashtu parashikon edhe përjashtimin e liritimit të përgjegjësisë së shitësit në rastin kur humb kontestin me personin e tretë dhe shitësi nuk është njoftuar për procedurën e cila zhvillohet me personin e tretë, si pretendues i të drejtës mbi sendin e blerësit, nëse shitësi provon, përkatësisht dëshmon se ka disponuar mjete për refuzimin e kërkesës së personit të tretë dhe ta pengojë kështu fitimin e të drejtës në procedurë gjyqësore nga personi i tretë, p.sh., kur shitësi i sendit ka mundur të vërtetojë se ekzistimi i të drejtës së pengut mbi atë send është shuar ose se personi i tretë e ka humbur të drejtën e pronësisë mbi atë send, për shkak se ka ndodhur parashkrimi fitues, domethënë e ka të humbur të drejtën e pronësisë, edhe pse ajo është e regjistruar në librin publik, kështu që, në të njëjtën kohë, shitësi është bërë pronar përmes institutit të parashkrimit fitues. Në këtë rast, nuk mund të kërkohet përgjegjësia e shitësit për të metat juridike të sendit, sepse po të ishte njoftuar dhe po të kishte marrë pjesë ai në procedurën gjyqësore, me provat e tij, do të bënte që të refuzohej kërkesa e personit të tretë, p.sh., kur shitësi e ka blerë sendin nga jopronari në kushtet e parashikuara me ligj⁷².

Neni 495. Kur e drejta e personit të tretë është haptazi e bazuar

1. Blerësi ka të drejtë të thirret në përgjegjësinë e shitësit për të metat juridike edhe kur pa e njoftuar shitësin dhe pa kontest ka pranuar të drejtën e të tretit haptazi të bazuar dhe padysim.

70 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 680.

71 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 680.

72 Më gjerësisht, shih: Aliu, Abdulla, E Drejta Sendore, Prishtinë, 2013, fq. 146, ku trajtohet fitimi i pronësisë nga jopronari: Personi me mirëbesim fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin e luajtshëm të marrë me shpërblim nga jopronari, i cili, në kuadër të veprimtarisë së vet, vë në qarkullim sende të tilla nga jopronari, të cilit pronari ia ka dorëzuar sendin në posedim në bazë të punës juridike, i cili nuk paraqet bazë për fitimin e pronësisë, si dhe në shitjen publike (neni 147, paragrafi 1); dhe LPDTS i RM-së, parashikon se, LPDTS i RM-së, parashikon shprehimisht se të drejtat e personave të tretë që e ngarkojnë sendin shuhet me fitimin e pronësisë nga shitësi, të cilit sendi nuk i takon, mirëpo nuk shuhet ato të drejta të personave të tretë, për të cilat fituesi ka ditur se ekzistojnë ose ka qenë i detyruar ta dijë në momentin kur e ka fituar pronësinë, si dhe ato të drejta që janë të regjistruara në librat publike (neni 147, paragrafi 5).

2. Në qoftë se blerësi ia ka paguar të tretit një shumë të hollash për të hequr dorë nga e drejta e vet e padyshimtë, shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia e vet në qoftë se ia shpërblen blerësit shumën e paguar dhe dëmin e pësuar.

495. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 495 përmban dispozitën, sipas së cilës, blerësi ka të drejtë t'i referohet përgjegjësishë së shitësit për të metat juridike, edhe pa e njoftuar atë dhe pa kontestuar të drejtën e personit të tretë, kur ajo është haptazi e bazuar dhe e padyshimtë⁷³.

495.1. Paragrafi 1 parashikon se blerësi ka të drejtë ta pranojë të drejtën e personit të tretë, e cila është një e drejtë e padyshimtë dhe e bazuar, të cilën blerësi ia ka pranuar personit të tretë dhe ai edhe në këtë rast mund të kërkojë përgjegjësinë e shitësit për të metat juridike të sendit, pa marrë parasysh se shitësi nuk është njoftuar dhe nuk është zhvilluar kontest, sepse e drejta e të tretit është qartësisht e bazuar dhe e padyshimtë, p.sh., kur ekziston hipoteka e regjistruar mbi paluajtshmërinë dhe blerësi është bindur në bazë të dokumentit ekzistues se me të vërtetë ekziston e drejta e hipotekës në favor të personit të tretë ose, bie fjala, ekziston bashkëpronësia mbi sendin e njëjtë, p.sh., piktura e shitur, edhe pse ka qenë në posedim të shitësit, ajo njëkohësisht ka qenë edhe në bashkëpronësi të personit të tretë në bazë të vendimit të gjykatës. Në këtë rast, edhe pse e ka pranuar të drejtën e personit të tretë mbi sendin e vet të blerë, nuk përjashtohet e drejta e blerësit që t'i referohet përgjegjësishë së shitësit për të metat juridike. Blerësi, pra, mund ta pranojë të drejtën e personit të tretë që ekziston mbi sendin e shitësit, të cilin e ka blerë, pa bërë kontest në gjykatë, përkatësisht pa e kundërshtuar këtë të drejtë të personit të tretë dhe pa e njoftuar shitësin për pretendimet e personit të tretë. Në rastet kur blerësi e ka pranuar të drejtën e personit të tretë, duke menduar se është qartazi e bazuar dhe e padyshimtë, duke lënë pa e njoftuar shitësin, i cili mund të vërtetojë mosekzistimin e të metës juridike të pranuar nga blerësi, atëherë shitësi do të lirohet nga përgjegjësia për të metat juridike të sendit.

495.2. Paragrafi 2 përcakton rastin kur blerësi, për t'u liruar nga e drejta e personit të tretë, ia ka paguar të tretit një shumë të hollash për të hequr dorë nga e drejta e vet e padyshimtë, atëherë shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia e vet për të metat juridike të sendit, në qoftë se ia shpërblen blerësit shumën e paguar dhe dëmin e pësuar. Kjo nënkupton se, kur blerësi me vetiniciativë, duke paguar çmimin e caktuar, lirohet nga e drejta e personit të tretë për sendin e blerë, ai ka të drejtë që të kërkojë përgjegjësinë e shitësit edhe pasi i ka paguar të tretit një shumë të hollash, por kjo dispozitë parashikon se shitësi mund të lirohet nga përgjegjësia e vet, në qoftë se pranon t'i paguajë blerësit shumën e paguar personit të tretë dhe t'ia shpërblejë dëmin e pësuar për shkak të pagimit të çmimit personit të tretë që të heqë dorë nga e drejta e vet e padyshimtë, p.sh., bashkëpronarit të pikturës së blerë ia paguan pjesën e vet të bashkëpronësisë, të cilën e ka mbi atë send në bazë të vendimin të gjykatës, në mënyrë që të konsiderohet pronar i vetëm i pikturës. Mirëpo, edhe

⁷³ Cesiç dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 681, ku parashikohet se e drejta është qartazi e bazuar atëherë kur ekzistojnë prova të forta përkatëse për ekzistimin e të drejtës së përshtatshme që në procedurën juridike adekuate paraqesin fakt thelbësorë për miratimin e kërkesës së të tretit, në qoftë se ajo procedurë do të kishte filluar.

me rastin e pagimit, përkatësisht deri te fitimi i pronësisë mbi tërësinë e sendit, blerësi, përveç pagimit të shumës së të hollave me qëllim që personi i tretë të heqë dorë nga e drejta e vet e padyshimtë, ka mundur të pësojë edhe një dëm real, domethënë shpenzime të veçanta deri te marrëveshja me personin e tretë për të hequr dorë nga e drejta e pjesës së bashkëpronësisë, duke marrë shumën e të hollave për këtë qëllim.

Neni 496. Kufizimi kontraktues ose përjashtimi i përgjegjësisë së shitësit

- 1. Përgjegjësia e shitësit për të metat juridike mund të kufizohet me kontratë ose të përjashtohet krejtësisht.**
- 2. Në qoftë se në kohën e lidhjes së kontratës shitësi ka qenë në dijeni ose nuk ka mundur të mos ketë qenë në dijeni për ndonjë të metë në të drejtën e tij, dispozita e kontratës mbi kufizimin ose mbi përjashtimin e përgjegjësisë për të metat juridike është nule.**

496. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 496 rregullon çështjen e mundësisë së kontraktimit të kufizimit ose përjashtimit të përgjegjësisë së shitësit për të metat juridike të sendit të shitur.

496.1. Paragrafi 1 lejon mundësinë që shitësi dhe blerësi të kontraktojnë kufizimin a përjashtimin krejtësisht të përgjegjësisë së shitësit për të metat juridike të sendit. Një marrëveshje e tillë krijon bazën që shitësi të mos ketë përgjegjësi ose këtë përgjegjësi ta ketë të kufizuar për të metat juridike të sendit. Pra, kjo është një dispozitë e karakterit dispozitiv, sepse ekziston parimi i dispozitivitetit të normave për evikcionin⁷⁴. Kontraktimi i kufizimit ose përjashtimit të përgjegjësisë së shitësit për të metat juridike të sendit thuhet se nuk duhet kuptuar vetëm si favor për shitësin, sepse palët, për shkak të karakterit dispozitiv të kësaj norme, mund të kontraktojnë edhe ashpërsimin e përgjegjësisë së shitësit për të metat juridike të sendit⁷⁵. Për dallim nga paragrafi 1, ekziston edhe përjashtimi se nuk mund të kontraktohet as kufizimi, as përjashtimi i përgjegjësisë për të metat juridike të sendit, në qoftë se shitësi ka qenë në dijeni ose është dashur të jetë në dijeni për ndonjë të metë juridike në të drejtën e tij.

496.2. Paragrafi 2 parashikon shumë qartë se në cilin rast marrëveshja ndërmjet shitësit dhe blerësit për përgjegjësinë për të metat juridike të sendit do të kufizohet ose do të përjashtohet në tërësi, do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme, përkatësisht kontratë nule. Kjo do të ndodhë kur në kohën e lidhjes së kontratës shitësi ka qenë në dijeni për të metën juridike të sendit të shitur ose nuk ka mundur të mos ketë qenë në dijeni për ndonjë të metë juridike të të tij, por për këtë nuk e ka njoftuar blerësin i cili, për shkak të heshtjes së shitësit, nuk ka mundur të dijë se sendi është me të meta juridike, të cilat ishin të njohura për shitësin në kohën e lidhjes së kontratës, p.sh., në qoftë se shitësi e ka ditur se sendi është i ngarkuar

74 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 682.

75 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 682.

me hipotekë dhe, megjithëkëtë, lidhë kontratë me blerësin për përjashtimin e përgjegjësishë për të metat juridike, atëherë kjo kontratë është nule (absolutisht e pavlefshme), çka do të thotë se, me kalimin e kohës, kjo nuk mund të bëhet e vlefshme⁷⁶. Ky paragraf e konsideron nule në këtë rast jo gjithë kontratën e shitblerjes, por vetëm atë dispozitë (pjesë të saj) me të cilën bëhet kufizimi ose përjashtimi i përgjegjësishë së shitësit për të metat juridike, kur shitësi ka qenë në dijeni ose ka mundur të dijë për ndonjë të metë në të drejtën e tij. Mirëpo, të drejtat e blerësit për t'iu referuar përgjegjësishë së shitësit për të metat juridike duhet të ushtrohen në pajtim me nenin 498 të LMD të Kosovës, sepse kontrata nule për përjashtimin e përgjegjësishë së shitësit për të metat juridike nuk mund të prodhojë efekte juridike pas kalimit të afatit për realizimin e të drejtave që kanë të bëjnë me përgjegjësishë e shitësit për të metat juridike të sendit, si dhe në rastet kur nuk është parashikuar fare përjashtimi i përgjegjësishë. Sepse, kontrata nule konsiderohet pa efekt, sikur të mos ekzistonte fare, dhe blerësi në çdo kohë, pa marrë parasysh ekzistimin e kontratës, mund të kërkojë brenda afatit përgjegjësishë e shitësit për të metat juridike të sendit.

Neni 497. Kufizimi i natyrës juridiko-publike

Shitësi përgjigjet edhe për kufizime të veçanta të natyrës juridiko-publike të cilat nuk kanë qenë të njohura për blerësin, në qoftë se ai i ka ditur kufizimet ose ka ditur se ato mund të priten e nuk ia ka komunikuar blerësit.

497. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 497 i LMD të Kosovës parashikon përgjegjësishë e shitësit, i cili ka dorëzuar sendin me kufizime të natyrës juridiko-publike, pra që janë kufizime të veçanta, të cilat nuk kanë qenë të njohura për blerësin në momentin e dorëzimit të sendit. Kufizimet e natyrës juridiko-publike do të ekzistojnë atëherë kur ndonjë person i së drejtës publike, p.sh., shteti ose pushteti lokal (komuna), gjatë ushtrimit të pushtetit publik, me aktin e përgjithshëm ose të veçantë, përjashton ose kufizon ose zvogëlon qoftë vetëm të drejtën apo autorizimin që i takon titullarit të asaj të drejte⁷⁷. Shitësi përgjigjet për kufizimet e veçanta të natyrës juridiko-publike, për sendin e dorëzuar te blerësi, nëse ai (shitësi) i ka ditur kufizimet që në kohën e lidhjes së punës juridike ose në momentin e dorëzimit të sendit ose ka pasur dijeni se ato mund të paraqiten, përkatësisht pritet që të paraqiten dhe për këtë nuk e ka njoftuar blerësin, pra nuk e ka vënë në dijeni për mundësinë e pritjes eventuale të kufizimeve të veçanta të natyrës juridiko-publike, p.sh., se sendi do të jetë objekt i shpronësimit. Kufizimet e veçanta të natyrës juridiko-publike nuk konsiderohen të meta juridike vetëm kur ekzistojnë në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes, por edhe nëse ato do të paraqiten në të ardhmen dhe për këtë shitësi ka pasur dijeni. Përgjegjësia e shitësit për të metat juridike të natyrës juridiko-publike do të ekzistojnë gjithmonë, kur kontrata është e vlefshme, ndërsa e meta juridike ekziston në momentin e kalimit të pronësisë, përkatësisht të drejtës, nëse e meta nuk ka qenë e njohur për blerësin në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa këtë e ka ditur shitësi, por nuk ia ka bërë të

⁷⁶ Më gjerësisht lidhur me pavlefshmërinë absolute, shih: Aliu, Abdulla, E Drejta Civile, Prishtinë, 2013, fq. 379.

⁷⁷ Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 683.

njohur blerësit. Këtu mendohet se ekziston një dallim në krahasim me të metat juridike në rastet e tjera, për të cilat shitësi përgjigjet pa marrë parasysh nëse ka ditur ose jo për të metën juridike. Pra, që të ekzistojë përgjegjësia e shitësit për të metat e natyrës juridiko-publike, kërkohet që ai të ketë pasur dijeni për ekzistimin e tyre ose e dinte se ato mund të priten, por këtë nuk ia ka bërët ditur ose nuk ia ka komunikuar blerësit⁷⁸. Nga dispozita e nenit 497, në të cilën bëhet fjalë për kufizimin e natyrës juridiko-publike, si e metë juridike e sendit apo e së drejtës, del se ajo mund të ekzistojë jo vetëm në momentin e lidhjes së kontratës ndërmjet shitësit dhe blerësit, por mund të paraqitet edhe më vonë, ndërkaq, si kriter i paraqitjes së mëvonshme të kësaj të mete juridike merren fjalët e ligjit ku thuhet se “ato mund të priten” pra mendohet për të metat juridike që lajmërohen në të ardhmen⁷⁹. Kështu, përgjegjësia e shitësit për të metat juridike të natyrës juridiko-publike ekziston edhe kur e meta juridike lajmërohet pas kalimit të pronësisë mbi sendin, përkatësisht pas kalimit të së drejtës, në qoftë se shitësi ka qenë në dijeni për të metat juridike që mund të priten dhe këtë nuk ia ka komunikuar blerësit dhe, natyrisht, këto të meta që priten nuk kanë qenë të njohura për blerësin.

Neni 498. Humbja e të drejtave

- 1. E drejta e blerësit në bazë të të metave juridike shuhet me skadimin e një (1) viti nga dita kur ka mësuar për ekzistimin e të drejtës së personit të tretë.**
- 2. Në qoftë se personi i tretë, para skadimit të këtij afati ka iniciuar procesin, ndërsa blerësi e ka ftuar shitësin që të ndërhyjë në proces, e drejta e blerësit shuhet vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj pas përfundimit të plotfuqishëm të kontestit.**

498. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 498 parashikon se, në rastet kur sendi ka të meta juridike, atëherë ushtrimi i të drejtës për mënjanimin e tyre i nënshtrohet një afati të caktuar. Pala kontraktuese nuk mund të ushtrojë padi për mënjanimin e të metave juridike ose zgjidhjen e kontratës në çdo kohë, por kjo duhet të bëhet brenda një kohe të caktuar, që rregullohet me këtë nen. Afatet e parashikuara në këtë nen janë të karakterit prekluziv dhe blerësi patjetër duhet të fillojë procedurën brenda këtyre afateve për realizimin e të drejtave që i takojnë për shkak të të metave juridike.

498.1. Paragrafi 1 përcakton se e drejta e blerësit që të mbrohet nga të metat juridike të objektit të blerë shuhet me kalimin e afatit prej një (1) viti, nga dita kur ka mësuar për ekzistimin e ndonjë të drejte të personit të tretë mbi atë send. Pra, kur shitësi e shet sendin dhe garanton se nuk ka të meta juridike dhe se mbi sendin e tij (të shitësit) nuk ka askush ndonjë të drejtë, ndërsa blerësi mëson më vonë se mbi atë send një person i tretë ka ndonjë të drejtë, ai ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës ose heqjen e të metës juridike. Mirëpo, kjo e drejtë duhet të ushtrohet në afatin e caktuar (1-vjeçar) nga dita kur blerësi ka

78 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 683.

79 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 684.

marrë dijeni për ekzistimin e të drejtës së personit të tretë. Kjo nënkupton se kemi të bëjmë me parashkrimin e të drejtës së kërkesës së blerësit për të metat juridike të sendit të blerë.

498.2. Paragrafi 2 i nenit 498 të LMD të Kosovës përcakton se, kur është iniciuar procedura nga personi i tretë, para skadimit të afatit 1-vjeçar, ndërsa blerësi e ka ftuar shitësin që të ndërhyjë në proces, domethënë t'i përgjigjet personit të tretë për kërkesën e iniciuar, atëherë e drejta e blerësit shuhet vetëm pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muajsh, pas përfundimit me formë të prerë të kontestit mes personit të tretë dhe shitësit. Kjo nënkupton se të drejtat e blerësit ndaj shitësit për sendin e dorëzuar me të meta juridike do të shuhen vetëm pasi vendimi i organit kompetent të bëhet i plotfuqishëm (të marrë formë të prerë) dhe ky pas kalimi të afatit prej gjashtë (6) muajsh.

Sefadin Blakaj

Neni 499. Koha dhe vendi i pagimit

- 1. Blerësi ka për detyrë të paguajë çmimin në kohën dhe në vendin e caktuar me kontratë.**
 - 2. Në mungesë të dispozitës kontraktuese ose dokeve tjera, pagesa bëhet në momentin dhe në vendin ku kryhet dorëzimi i sendit.**
 - 3. Në qoftë se çmimi nuk duhet të paguhet në momentin e dorëzimit, pagesa bëhet në vendbanimin respektivisht në selinë e shitësit.**
-

499.1. Blerësi, në kontratën e shitjes, si kundërvlerë për fitimin e lëndës ose të drejtave mbi lëndën e shitjes, ka detyrimin që ta paguajë çmimin, kurse shitësi ka të drejtë ta kërkojë atë. Blerësi është i detyruar që shitësit t'ia paguajë çmimin në vendin dhe kohën e caktuar me kontratën e shitblerjes (neni 499.1 LMD). Rëndom, palët saktësojnë në kontratë vendin dhe kohën e pagesës së çmimit, pasi që saktësimi i çmimit, si dhe saktësimi i kohës së pagesës dhe vendit të pagesës së çmimit paraqet një element me rëndësi të kontratës së shitjes. LMD, me paragrafin në fjalë, ua ka njohur dispozitivitetin palëve për ta saktësuar lirisht kohën dhe vendin e pagesës së çmimit. Nëse blerësi, me gjithë saktësimin e kohës dhe vendit të pagesës së çmimit me kontratë, nuk kryen pagesën e çmimit, konsiderohet se blerësi ka rënë në vonesë. Doktrina juridike dhe praktika juridike përgjithësisht kanë pranuar se blerësi bie në vonesë në momentin e skadimit të afatit për pagesën e çmimit, nëse palët me kontratë kanë saktësuar afatin e pagesës, ashtu që për rënien në vonesë të blerësit, në një situatë të tillë, nuk do të duhej të kërkohej që shitësi të lëshojë ose ekzekutojë ndonjë kërkesë formale adresuar blerësit.⁸⁰ Thjesht, mospagesa e çmimit nga blerësi brenda afatit ose më së largu deri në afatin e caktuar nga palët në kontratë, shkakton rënien në vonesë të blerësit dhe kjo pastaj shkakton edhe pasoja juridike negative për palën që është në vonesë.

499.2. Kur koha dhe vendi i pagimit të çmimit nuk janë të saktësuar në kontratën e shitjes, çmimi paguhet në vendin dhe kohën në të cilën bëhet dorëzimi i sendit (neni 499.2 LMD). Detyrimi i njëkohshmërisë së përmbushjes së detyrimit të shitësit dhe të blerësit, nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe me kontratë, buron nga karakteri i kontratës së shitjes, si kontratë e dyanshme detyruese dhe me shpërblim. Sigurisht, nëse palët në kontratën e shitjes kanë lënë pa e saktësuar kohën dhe vendin e pagesës së çmimit ose në qoftë se nuk del ndryshe nga rrethanat konkrete të kontratës së dhënë të shitjes, atëherë nevoja e barabarësisë së palëve dhe drejtshmërisë së marrëdhënies kërkon që koha dhe vendi i pagesës së çmimit të shitjes të jenë të njëkohshme me kohën dhe vendin e dorëzimit të sendit (parimi i njëkohshmërisë së përmbushjes së detyrimeve reciproke).⁸¹ Në kuptim dhe funksion të kësaj zgjidhjeje ligjore, disa autorë mendojnë se detyrimi i blerësit për të paguar çmimin në

80 Shih në lidhje me këtë : Schlechtrie, Peter dhe Ingeborg Schöenzer. *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods*. Oxford University Press, Printed in Great Britain, 2005: fq. 647.

81 Shih në lidhje me këtë: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 309.

asnjë rast nuk do të duhej të fillonte para se blerësi të ketë pasur mundësi ta ekzaminojë – ta kontrollojë sendin ose mallin e pranuar, (përveç nëse palët kanë kontraktuar diçka tjetër). Kjo zgjidhje ligjore duket se nënkuptohet nga dispozita e nenit 499.2, pasi që pranimi i sendit nënkupton të drejtën e blerësit që ai paraprakisht të bëjë ekzaminimin e zakonshëm të sendit ose mallit të pranuar.⁸²

499.3. Mund të ndodhë që çmimi nuk duhet të paguhet në momentin e dorëzimit të sendit, në qoftë se ashtu është kontraktuar ose ashtu del nga rrethanat konkrete të kontratës së dhënë. Në atë rast çmimi paguhet në vendin në të cilin shitësi ka vendbanimin, respektivisht selinë (neni 499.3 LMD). Detyrimi që të paguhet çmimi në vendbanimin, respektivisht në selinë e shitësit është pasojë e asaj se pagesa e “çmimit” kryesisht nënkupton përmbushjen e detyrimit në të holla (para), ashtu që është rregull e përgjithshme që detyrimi në të holla, rëndom, përmbushet në vendin në të cilin kreditori (në këtë rast shitësi) ka vendbanimin, respektivisht selinë. Një shembull i tillë mund të jetë rasti të kontrata e shitjes me këste, kur palët në kontratë nuk saktësojnë vendin ku duhet të ekzekutohet detyrimi periodik i blerësit që të paguajë çmimin; rëndom, në një rast të tillë vendi i pagesës është vendbanimi ose selia e shitësit.

Neni 500. Kamata në rast të shitjes me kredi

Në qoftë se sendi i shitur me kredi jep uzurfrukt ose dobi tjera, blerësi debiton kamatë prej momentit kur i është dorëzuar sendi pavarësisht nëse detyrimi i pagimit të çmimit ka rrjedhur ose jo.

500. Të shitja e sendit me kredi, rëndom, blerësi ngarkohet të paguajë edhe kamatën, përveç çmimit (borxhit kryesor), nëse ashtu kanë saktësuar palët kontraktuese në kontratë. Palët i saktësojnë dhe rregullojnë me marrëveshje edhe situatat kur kamata fillon të rrjedhë, përkatësisht kur maturohet borxhi kryesor. Megjithatë, LMD parashikon një dispozitë të veçantë të shitja me kredi, nëse sendi që dorëzohet është send frytdhënës ose nëse sendi gjeneron ndonjë dobi tjetër (fjala “dobi tjetër” është mjaftë e papërcaktuar, ashtu si është përdorur, megjithatë, duket se këtu ligjvënësi mendon për dobinë pasurore, përkatësisht për dobinë e cila gjenerohet nga sendi në formë të fryteve). Në kuptim të dispozitës në fjalë (neni 500), nëse objekti i shitjes është send-mall që jep fryte, atëherë blerësi ngarkohet edhe me kamatën që nga momenti kur sendi frytdhënës i është dorëzuar blerësit, kurse

⁸² Në kuptim të adresimit të drejtës së blerësit për ta ekzaminuar paraprakisht sendin-mallin, d.m.th., para se të paguajë çmimin, shih më lart për këtë komentimin e nenit 458 të LMD. Duket se edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave ka bërë një përcaktim të ngjashëm, duke saktësuar në nenin 58.3: “Blerësi nuk detyrohet të paguajë çmimin, derisa ai ta ketë mundësinë për t’i ekzaminuar mallrat, përveç kur procedurat e rena dakord për dorëzim ose pagim nga palët janë kontradiktore me këtë mundësi.”. Të një përcaktimi të tillë janë edhe autorët të cilët interpretojnë këtë Konventë. Në lidhje me këtë, posaçërisht shih: Schlechtrie, Peter dhe Ingeborg Schöenzer. *Commentary on the UN Convention of the International Sale of Goods*. Oxford University Press, Printed in Great Britain, 2005: fq. 645.

kamata rrjedh pavarësisht maturitetit të detyrimit të debitorit (maturitetit të pagesës së çmimit ose kësteve, si pjesë e çmimit). Për situatat e tilla mendohet që kamata të jetë një lloj ekuivalenti për frytet, respektivisht për dobitë e tjera që i mbledh blerësi nga sendi i frytshëm i shitur me kredi.

Sigurisht, nëse palët kanë saktësuar me kontratë normën e kamatës të aplikueshme në marrëdhënie, rregullat e përcaktimit kontraktor për kamatën do të duhej të zbatoheshin edhe për rastin e dhënë. Megjithatë, do të mund të shtrohej pyetja: çfarë nëse palët nuk kanë saktësuar normën e kamatës. Mendoj se në një situatë të tillë rregullat e nenit 385.2 do të duhej të aplikoheshin për saktësimin e normës së kamatës që do të duhej të ishte e aplikueshme.⁸³

Duke pasur parasysh karakterin e dispozivititetit të marrëdhënieve të detyrimeve, posaçërisht të marrëdhënieve kontraktore, mendohet se kërkesat e nenit 500, si më lart, janë të natyrës plotësuese dispozitive, gjë që nënkupton se ato zbatohen vetëm nëse palët nuk kanë kontraktuar ndryshe ose nga rrethanat konkrete të kontratës së dhënë nuk del diçka tjetër.⁸⁴

Neni 501. Pagimi i çmimit në rastin e dërgesave të njëpasnjëshme

- 1. Në rastin e dërgesave të njëpasnjëshme, blerësi ka për detyrë të paguajë çmimin për çdo dërgesë në momentin e marrjes në dorëzim, përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër ose rrjedh nga rrethanat e punës.**
- 2. Në qoftë se në kontratën me dërgesat e njëpasnjëshme blerësi ia ka dhënë shitësit paradhënien, dërgimet e para arkëtohen nga paradhënia, po qe se nuk është kontraktuar diçka tjetër.**

501.1. LMD, në nenin 501, ka parashikuar dhe rregulluar situatat e veçanta të pagesës së çmimit atëherë kur malli i dorëzohet ose i dërgohet blerësit suksesivisht, në disa dërgesa të kohëpaskohshme ose të njëpasnjëshme (p.sh., 100 vagonë të porositur me grurë i dërgohen blerësit nga 10 vagonë çdo muaj). Në situatat e tilla, sipas kuptimit të paragrafit të parë të nenit 501 të LMD, blerësi është i obliguar ta paguajë çmimin për çdo dërgesë, në momentin e pranimit të saj, përveç nëse palët kanë kontraktuar ndryshe ose kur nga rrethanat e rastit nënkuptohet diçka tjetër. Në rastin e dhënë kemi të bëjmë me dorëzimin e sendit-mallit pjesë-pjesë, prandaj, me dorëzimin e secilës pjesë të veçantë paguhet pjesa proporcionale e çmimit (pjesa e çmimit të paguar të jetë proporcionale ose ekuivalente me pjesën e mallit të dorëzuar); shihet se kjo rregull ligjore është në harmoni me zgjidhjen parimore të nenit 499.2 si më lart, pasi që edhe këtu paraqitet si rregull dorëzimi i njëkohshëm i pjesës së mallit-sendit dhe pagimi i çmimit në pjesë proporcionale, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe ose nga rrethanat e rastit nuk del diçka tjetër.⁸⁵

83 Shih komentimin e Nenit 385.2 më lartë, ku rregullohet saktësimi I lartësisë së kamatës për rastet për rastet kur palët me marrëveshje nuk kanë saktësuar lartësinë e kamatës.

84 Shih mbi kuptimin e kërkesave të këtij Neni: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1333.

85 Në kuptim të kësaj shih komentimin e nenit 499.2 të LMD në këtë pjesë, më lart.

501.2. Të kontrata e shitjes me dërgesa suksesive - të kohëpaskohshme të mallit ose të sendeve, mund të paraqiten situatat kur blerësi t'i ketë paguar një paradhënie shitësit, para se t'i jetë dorëzuar malli, gjë që nënkupton rastin kur blerësi përmbush para afatit një pjesë të detyrimit të pagesë së çmimit, (pasi që pagesa e paradhënies konsiderohet, përveç të tjerash, edhe si përmbushje e pjeshme e detyrimeve të palës që paguan paradhënien. Për situatat e tilla, LMD parashikon rregullën që dërgesat e para të mallit-sendeve përlllogariten në sasinë e paradhënies së paguar nga blerësi (si pagesë e pjeshme); sigurisht, nëse palët nuk kanë kontraktuar diçka tjetër ose nga kontrata nuk nënkuptohet diçka tjetër.⁸⁶

NËNKREU 2 MARRJA E SENDIT

Neni 502. Marrja e sendit

- 1. Marrja e sendit konsiston nga ndërmarrja e veprimeve të nevojshme për t'u bërë i mundur dorëzimi dhe mundësimi i pranimit dhe marrjes së sendit.**
- 2. Në qoftë se blerësi pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon marrjen e sendit, dorëzimi i të cilit i është ofruar në mënyrë të kontraktuar ose të zakonshme dhe me kohë, shitësi mundet të deklarojë se e zgjidhë kontratën, në qoftë se ka shkak të arsyeshme të dyshojë se blerësi nuk do ta paguajë çmimin.**

502.1. Një nga detyrat kryesore të palëve te kontrata e shitjes është ndërmarrja e të gjitha veprimeve, me të cilat do të mundësohet dorëzimi (si detyrim i shitësit), respektivisht pranimit-marrja e sendit-mallit (si detyrim i blerësit). Sigurisht, detyrimi i pranimit-dorëzimit të sendit është detyrim reciprok i palëve te kontrata e shitjes. Shumë çështje që ndërlidhen me detyrën e dorëzimit të sendit, si detyrim i shitësit, janë adresuar posaçërisht me dispozita të veçanta në LMD.⁸⁷ LMD përmban rregulla edhe për mundësimin e dorëzimit të sendit, përkatësisht detyrimin e blerësit që ta marrë – ta pranojë sendin - mallin e dorëzuar. Në kuptim të kësaj, konsiderohet të jetë detyrim i blerësit që ta pranojë sendin, përkatësisht që shitësit t'i mundësojë dorëzimin e sendit, ashtu që t'ia kalojë blerësit trupin e sendit dhe të përmbushë detyrimin e shitësit. Në këtë kuptim, konsiderohet se detyrimi i pranimit të sendit nënkupton ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme, në pajtim me kontratën e shitjes (ose praktikën e themeluar ndërmjet palëve ose me natyrën e marrëdhënies kontraktuese), të cilat mundësojnë marrjen e sendit nga blerësi, përkatësisht dorëzimin dhe lirimimin e shitësit nga sendi ose malli. Kështu,

⁸⁶ Shih për këtë edhe: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II*. 1983: fq. 1334.

⁸⁷ Shih për këtë posaçërisht komentimin e nenit 450 për kohën dhe vendin e dorëzimit; nenit 451 për objektin e dorëzimit, nenit 452 për dorëzimin e sendit brenda një periudhe të caktuar; neni 453 adresimi i çështjes së dorëzimit kur data e dorëzimit nuk është caktuar; neni 454 për caktimin e vendit të dorëzimit, kur vendi i dorëzimit nuk është caktuar me kontratë; neni 455 për dorëzimin e sendit transportuesit; neni 456 në lidhje me organizimin e transportit për dorëzimin e sendit, si dhe neni 457 në lidhje me shpenzimet e dorëzimit.

p.sh., nëse afati i dorëzimit të sendit është kontraktuar në interes të blerësit, blerësi do ta njoftojë shitësin për afatin e dorëzimit; ose, te shitja me specifikim, blerësi i jep në kohë shitësit specifikimin e caktimit të mallit që duhet t'i dorëzohet sipas kontratës; ose, kur është detyrim kontraktues i blerësit të caktojë ambalazhin dhe t'ia sigurojë atë shitësit, të ndërmarrë të gjitha veprimet për sigurimin e tij etj.⁸⁸

502.2. LMD ka rregulluar edhe rastin kur blerësi ka lënë pa i ndërmarrë veprimet e kontraktuara ose të nevojshme për pranimin-marrjen e sendit. Pra, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 502.2 të LMD, shitësi do të mund ta deklarojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës, nëse blerësi, pa ndonjë arsye të veçantë, e refuzon marrjen e sendit (ose ekzekutimin e veprimeve që konsistojnë në pranimin e sendit prej tij) dhe kjo kur shitësi vjen në përfundim të arsyeshëm se nga një sjellja e tillë e blerësit rrezikohet pagesa e çmimit. Sigurisht, nëse blerësi lë pa ndërmarrë veprimet që nënkuptojnë detyrimin e tij për ta pranuar mallin, konsiderohet se blerësi bie në vonesë. Në një situatë të tillë, do të kishim vonesën e kreditorit, kur konsiderohet se detyrimi i shitësit për ta dorëzuar sendin, është detyrim i debitorit. Vonesa e palës në marrëdhëniet e detyrimeve, (në këtë rast rënia në vonesë e blerësit), shkakton pasoja juridike negative për palën që ka rënë në vonesë. Në rast të vonesës së blerësit, kur plotësohen kushtet për të, që përfshin lënien pa e pranuar të mallit nga ana e blerësit, (si pasojë e rënies në vonesë), përkatësisht krijimin e përshtypjes së arsyeshme se kjo mund ta rrezikojë interesin e shitësit që t'i paguhet çmimi i kontraktuar; konstituohet e drejta e shitësit që të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës së shitjes. Për më tepër, kur blerësi lë pa ndërmarrë veprimet e domosdoshme dhe të nevojshme për pranimin e sendit-mallit, kjo ka për pasojë ekspozimin ndaj të gjitha efekteve negative që i shkakton edhe vonesa e kreditorit, (kryesorja ka të bëjë me çështjen e kalimit mbi blerësin të rrezikut kundrejt objektit të përbushjes).⁸⁹ Natyrisht, nëse mundësohet zgjidhja e kontratës në një rast që mundësohet nga paragrafi në fjalë i komentuar, shitësit i takon edhe e drejta e shpërblimit të dëmit.⁹⁰

KREU 5

DETYRIMI I RUAJTJES SË SENDIT PËR LLOGARI TË BASHKËKONTRAKTUESIT

Neni 503. Rastet e detyrimit të ruajtjes

1. Kur për shkak të vonesës së blerësit rreziku ka kaluar në blerësin para dorëzimit të sendit, shitësi ka për detyrë ta ruajë sendin me kujdes të ekonomistit të mirë respektivisht të shtëpiakut të mirë dhe për këtë qëllim të ndërmerr masa të nevojshme.

88 Shih mbi këtë: *Komentari Zakona o Obligationim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1015. Shih në lidhje me detyrimin e blerësit për marrjen e sendit edhe: Në lidhje me këtë shih: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 309 - 310.

89 Në lidhje me këtë shih: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 309 - 310.

90 Në lidhje me zgjidhjen e kontratës për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të njëres palë kontraktuese, shih komentimin e neneve të LMD, duke filluar nga neni 106 deri në neni 115.

2. E njëjta gjë vlen edhe për blerësin kur i është dorëzuar sendi, ndërsa ai dëshiron t'ia kthejë shitësit, qoftë për shkak se e ka zgjidhur kontratën, qoftë se ka kërkuar sendin tjetër në vend të tij.
3. Në njërin dhe rastin tjetër kontraktuesi i cili është i detyruar të ndërmarrë masa për ruajtjen e sendit ka të drejtë në shpërblimin e shpenzimeve të nevojshme për ruajtjen e sendit.

503.1. Gjatë procesit të përmbushjes së detyrimeve të pranimit-dorëzimit të sendeve-mallrave ndërmjet shitësit dhe blerësit, sidomos në rastin kur ata bien në vonesë, LMD përmban disa dispozita të veçanta, qëllimi i të cilave është detyrimi për ruajtjen dhe mbrojtjen e sendeve ose mallrave të cilat janë objekt i ekzekutimit të shitjes. Kështu, p.sh., nëse blerësi bie në vonesë që të marrë-pranojë sendin, ai do t'u ekspozohet efekteve juridike negative të rënies (së kreditorit) në vonesë, ashtu që mbi të do të kalohet edhe çështja e bartjes së rrezikut për dëmtimin - zhdukjen e rastësishme të sendit (dëmtimi - zhdukja e rastësishme e sendit). Megjithatë, sipas kuptimit të LMD, (paragrafi i parë i nenit 503.1 të LMD), edhe nëse blerësi bie në vonesë në pranimin e sendit-mallit, shitësi ende do të ngelë i detyruar ndaj ruajtjes së sendit-mallit; madje mendohet se standardi dhe përgjegjësia e shitësit ndaj ruajtjes së sendit rritet, (shitësi duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm për ruajtjen e sendit-mallit), ashtu që LMD, në këtë situatë, kërkon nga shitësi të tregojë kujdes të shtuar të ruajtjes së sendit; kështu, shitësi gjatë ruajtjes së sendit duhet të tregojë kujdesin e "shtëpiakut të mirë", (nëse bëhet fjalë për marrëdhënie të kontraktuara jashtë fushës së ekonomisë, përkatësisht shitjet civile-juridike), ose të tregojë kujdesin e ekonomistit të mirë, (nëse bëhet fjalë për marrëdhënie të kontraktuara në fushën e ekonomisë). Rrjedhimisht, shitësi, i ndodhur në një situatë të tillë, duhet të ndërmarrë masa adekuate, të cilat në radhë të parë qëndrojnë në ruajtjen dhe mbikëqyrjen e sendit, (p.sh., shitësi duhet të marrë masa që sendin ta ruajë nga fatkeqësitë e natyrës, ta mbrojë mallin nga ndikimi i temperaturës ose kushteve të tjera atmosferike, eventualisht ta sigurojë, nëse i është ekspozuar rrezikut etj); ose nëse rrethanat lejojnë, sendet t'ia dorëzojë në përkujdesje një personi tjetër, ose eventualisht t'i shesë ato, (për mundësinë që sendet t'i jepen për ruajtje një personi të tretë ose të shitën, shih më poshtë komentimin e nenit 505 të LMD. Mendohet se kjo zgjidhje juridike, të cilën e ofron LMD, është një zgjidhje moderne, pasi qëllimin parësor ai e vë në mbrojtjen e vlerave pasurore, përkundrajt veprimeve ose mosveprimeve të palëve kontraktuese në marrëdhënien e dhënë.⁹¹

503.2. Nën të njëjtat detyrime dhe standarde të sjelljes dhe përgjegjësisë rreth përkujdesjes së veçantë për sendin e pranuar - të marrë mund të gjendet edhe blerësi, nëse e ka në posedim sendin të cilin paraprakisht e ka pranuar nga shitësi, e të cilin dëshiron t'ia kthejë prapa shitësit mbi bazën e së drejtës për shkëputje të njëanshme të kontratës ose zëvendësimin e sendit, (p.sh., zëvendësimin e sendit me mungesa me sendin pa mungesa) - shih për këtë komentimin e neneve nga 471 deri 476 të LMD; ose edhe për raste tjera të zgjidhjes së kontratës - shih për këtë komentimin e neneve nga 111 të LMD. Rrjedhimisht, në situata të ngjashme, kur blerësi e ka në mbajtje sendin dhe gjatë kësaj kohe, me gjithë

⁹¹ Shih mbi kuptimin e kërkesave të këtij Neni: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1339 .

deklarimin e zgjidhjes së kontratës ose të drejtës së zëvendësimit të sendit, ai vazhdon të jetë i detyruar që për sendin-mallin, të cilin vazhdon ta mbajë, të tregojë kujdes të shtuar, ashtu që u ekspozohet të gjitha standardeve të përgjegjesisë, siç u komentua për shitësin në paragrafin paraprak të këtij neni.

503.3. Secila palë kontraktuese, si në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, ashtu edhe në rastin nga paragrafi i dytë i tij, është e autorizuar që veprimet e ruajtjes dhe mbikëqyrjes së sendit-mallit t'i ndërmarrë me shpenzimet dhe rrezikun (për dëmtimin ose zhdukjen e rastësishme të sendit) në ngarkim të palës tjetër. Kështu, në rastin nga paragrafi i parë, shitësi vazhdon t'i mbajë dhe t'i ruajë sendet me shpenzimet e blerësit dhe me rrezikun në ngarkim të blerësit dhe, anasjelltas, në rastin e paragrafit të dytë të nenit në fjalë, blerësi është ai që i heq shpenzimet e ruajtjes dhe që ka në ngarkim rrezikun e shkatërrimit të rastësishëm të sendit. Sigurisht, si në rastin e paragrafit të parë, ashtu edhe në rastin e paragrafit të dytë, mbajtësi-ruajtësi i sendit mbart përgjegjësi për humbjet e sendit ose mallit, nëse sjellja e tij ka qenë e një standardi më të ulët, nga ajo që u shpjegua më lart lidhur me paragrafin e parë.⁹²

Neni 504. Kur blerësi nuk dëshiron ta marrë sendin që i është dërguar

Blerësi që nuk dëshiron ta pranojë sendin që i është dërguar në vendin e destinimit dhe që i është lënë atje në disponim, ka për detyrë ta merr përsipër për llogari të shitësit, në qoftë se ky nuk është i pranishëm në vendin e destinimit, dhe as që ndodhet atje ndokush i cili kishte për ta marrë përsipër sendin për te, me kusht që kjo të jetë e mundur pa paguar çmimin dhe pa ndërlikime të mëdha ose shpenzime të tepruara.

504. Për dallim nga paragrafi i dytë i nenit 503 të LMD, (i cili rregullonte detyrimin e blerësit që të ruajë sendin i cili tashmë i ishte dorëzuar blerësit), të komentuar më lartë, neni 504 i LMD rregullon situatën e detyrimit të blerësit për ruajtjen e sendit, kur nuk dëshiron ta pranojë sendin që i është adresuar në destinacionin e duhur ose adekuat dhe atje i është vënë në dispozicion. Në rastin konkret, blerësi ende nuk e ka marrë sendin në posedim, por ai ka arritur në destinacionin e caktuar nga palët dhe i është krijuar mundësia të ketë qasje në të.

Një situatë e ngjashme mund të jetë rasti, p.sh., kur blerësi, pasi që sendi i është vënë në dispozicion ose qasje, ka konstatuar se sendi të cilin e ka porositur nuk e ka pamjen e sendit që i është treguar si model ose mostër ose është tjetër send ose ka mangësi të tjera në dukje ose në lidhje me të cilin ka pasur ankesa të tjera dhe, për pasojë të të gjitha këtyre, nuk pranon ta marrë atë send etj. Nëse do të ishte fjala për këtë rast, atëherë blerësi

.....
92 Bukljas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II I*. Zagreb: 1979: fq. 1758. Dispozitat e mësipërme të nenit 503.3 të LMD duket se korrespondojnë me zgjidhjet juridike të ofruara nga Konventa e Hagës në lidhje me unifikimin e ligjit ndërkombëtar për shitjen e mallrave, Konventa e 1 korrikut e vitit 1964, përkatësisht neni 92 i saj, zgjidhje juridike këto të cilat, si duket, LMD i ka huazuar nga kjo Konventë. Në lidhje me këtë Konventë, shih: < unidroit.org/english/conventions/c-ulis.htm >, dt. 19.06.2013.

është i detyruar ta marrë sendin për mbajtje dhe përkujdesje me shpenzimet dhe rrezikun (për dëmtim ose zhdukje të rastësishme të sendit) në ngarkim të shitësit, kur ky nuk është i pranishëm në vendin e destinacionit të sendit, ose nëse nuk ka ndonjë përfaqësues ose agjent, i cili, për llogarinë e tij, do të mund ta pranonte sendin për mbajtje.

Në situatën e përshkruar më lart në komentimin e këtij neni, blerësi do të jetë i detyruar ta pranojë sendin për mbajtje, nëse janë plotësuar së bashku tri kushte: 1) kur blerësi nuk është i detyruar ta paguajë paraprakisht çmimin për pranimin e sendit; 2) kur pranimi i sendit-mallit blerësit nuk i sjell vështirësi të jashtëzakonshme dhe 3) kur pranimi i sendit për ruajtje blerësit nuk do t'i shkaktonte shpenzime të tepërta. Dhe, anasjelltas, blerësi nuk do të ishte i detyruar ta pranonte sendin për ruajtje, nëse do të ishte i detyruar ta paguante paraprakisht çmimin pas marrjes së sendit ose pranimi për ruajtje i sendit do t'i sillte ndërlikime ose shpenzime të tepërta. Natyrisht, për atë se ç'janë ndërlikimet e mëdha ose shpenzimet e tepërta, do të vendosë gjykata në çdo rast konkret, duke i mbajtur parasysh të gjitha rrethanat e rastit si edhe rregullat e drejtshëmrisë proporcionale ndërmjet të dyja palëve. Nga ajo që del nga teksti i dispozitës së këtij neni që komentohet, duket se qëllimi i dispozitës është që të mundësojë mbrojtjen e sendeve nga dëmtimi ose shkatërrimi, të cilat në një moment ndodhen papritur pa përkujdesje të pronarit, ose të të autorizuarit të pronarit.⁹³

Neni 505. E drejta e palës së detyruar për ta ruajtur sendin

Pala kontraktuese e cila sipas dispozitave paraprake ka për detyrë të marrë masa për ruajtjen e sendit, mundet nën kushte dhe pasoja të caktuara në dispozitat e këtij ligji për depozitim në gjykatë dhe shitjen e sendit që është borxh, ta depozitojë në gjykatë, t'ia dorëzojë për ruajtje ndonjë tjetri ose ta shesë për llogari të palës tjetër.

505. Në kuptim të neneve të përmendura më lart, të cilat imponojnë detyrimin e palëve kontraktuese që të marrin në mbajtje ose ruajtje sendin për palën tjetër, (në situatat e veçanta të përshkruara më lart), neni 505 i LMD i mundëson palës kontraktuese me kontratë të shitjes që të lirohet nga detyrimi i ruajtjes së sendit (për palën tjetër), nëse sendin që e ka në mbajtje e dorëzon në gjykatë ose ia dorëzon për ruajtje një personi të tretë ose e shet atë për llogari të palës tjetër. Kështu, neni 505 i LMD i jep të drejtë palës kontraktuese, e cila ka në mbajtje sendin (dhe e cila ka qenë e detyruar t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e tij, sipas dispozitave të LMD), të lirohet nga ky detyrim, nëse sendin e dorëzon për ruajtje në gjykatë, nëse sendin për ruajtje ia beson personit të tretë (kjo mund të jetë mjaftë e përshtatshme te kontratat në ekonomi, kur i treti, si profesionist, ushtron aktivitet të depozitimit ose ruajtjes

⁹³ Sa për krahasim, në kuptim të detyrimeve të palëve për ruajtjen e sendeve - mallrave të pranuar të kontrata e shitjes, nga ajo që është rregulluar me nenet 503 dhe 504 të LMD, një zgjidhje shumë të ngjashme juridike duket se ofron edhe Konventa e Hagës për unifikimin e ligjit ndërkombëtar për shitjen e mallrave, Konventa e 1 korrikut e vitit 1964, përkatësisht neni 92 i saj, zgjidhje juridike këto që, si duket, LMD i ka huazuar nga kjo Konventë. Në lidhje me këtë Konventë, shih: < unidroit.org/english/conventions/c-ulis.htm >, dt. 19.06.2013.

së sendeve) ose që sendin ta shesë në llogari të palës tjetër dhe ashtu të lirohet nga detyrimi i mbajtjes, (sigurisht kjo e fundit, si një masë drastike që mund të ndërmerret për sendin e huaj, justifikohet me domosdoshmërinë që sendi të shfrytëzohet ekonomikisht para prishjes ose kalimit të afatit për shfrytëzimin e tij, sepse atëherë nuk do të mund të shfrytëzohej dhe do të paraqiste humbje të plotë për titullarin-pronarin e tij). Sidoqoftë, të gjitha këto masa për ruajtjen e sendit, të cilat i ndërmerren pala kontraktuese, do të shlyhen me shpenzimet e palës tjetër kontraktuese. Mundësia për dorëzimin për ruajtje të sendeve në gjykatë një personi të tretë ose për shitjen e tyre (si veprim në interes të palës tjetër kontraktuese), shtjellohet posaçërisht në LMD, duke filluar nga neni 308 deri te neni 314 i LMD, ashtu që për shpjegime më të detajuara të tyre, shih komentimin e neneve në fjalë.⁹⁴

KREU 6 SHPËRBLIMI I DËMIT NË RAST TË ZGJIDHJES SË KONTRATËS

Neni 506. Rregulla të përgjithshme

Kur shitja është zgjidhur për shkak të cenimit të kontratës nga ana e njëres palë kontraktuese, pala tjetër ka të drejtë në shpërblimin e dëmit të cilin atë e pëson për këtë sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga cenimi i kontratës.

506. Neni 506 i LMD e sanksionon çështjen e zgjidhjes së kontratës nga pala kontraktuese me mirëbesim (te kontrata e shitjes), ndaj palës tjetër kontraktuese, e cila ka cenuar kontratën. Kështu, ky nen sanksionon të drejtën e palës me mirëbesim (e cila nuk ka shkelur kontratën) të kërkojë shpërblimin e dëmit, të cilin pala e pëson për shkak të zgjidhjes së kontratës (për fajin e palës tjetër kontraktuese). Për shpërblimin e dëmit, ky nen përmban referenca përkatëse dhe përcakton se shpërblimi i dëmit për këto raste bëhet sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga cenimi i kontratës.

Qëllimi i këtij neni plotësohet me dispozitat e neneve të tjera të LMD, që shtjellojnë çështjen e “zgjidhjes së kontratës”, “shpërblimin e dëmit për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuese” e të ngjashme. Kështu, p.sh., për çështjet e shkëputjes së kontratës, shih komentimin e neneve nga 106 deri 114 të LMD, (nenet që shtjellojnë çështje, si këto: të drejtat e njëres palë, kur pala tjetër nuk përmbush detyrimet e saj; kur përmbushja e kontratës është element thelbësor i kontratës; kur përmbushja e detyrimit brenda afatit nuk është element thelbësor i kontratës; të drejta e zgjidhjes së kontratës pa lënien e afatit të ri; të drejtën e zgjidhjes së kontratës para skadimit të afatit; zgjidhjen e kontratës me detyrime të vazhdueshme; pasojat juridike të zgjidhjes së kontratës etj. Ndërkaq, në lidhje me

94 Sa për krahasim, zgjidhje shumë të ngjashme juridike ofron edhe Konventa e Hagës në lidhje me unifikimin e Ligjit ndërkombëtar për shitjen e mallrave, Konventa e 1 korrikut e vitit 1964, përkatësisht nenet 93- 5 të saj, zgjidhje këto që, si duket, LMD i ka huazuar nga kjo Konventë. Në lidhje me këtë Konventë, shih: < unidroit.org/english/conventions/c-ulis.htm >, dt. 20.06.2013.

çështjet e së drejtës së shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimeve, shih komentimin e neneve nga 245 deri 252 të LMD, (nenet në fjalë sanksionojnë këto çështje: pasojat e mospërmbushjes së detyrimit; lirimimin e debitorit nga përgjegjësia; zgjerimin kontraktues të përgjegjësisë; kufizimin dhe përjashtimin e përgjegjësisë; vëllimin e shpërblimit të dëmit, çështjen e fajësisë së kreditorit etj).

Sigurisht, që të themelohet e drejta e shpërblimit të dëmit për shkak të mospërmbushjes së kontratës, kërkohet që pala tjetër të jetë fajtoare për mospërmbushjen. Përveç kësaj çështjeje të përgjithshme, te kontrata e shitjes, LMD parashikon edhe shumë çështje ose raste të veçanta të zgjidhjes së kontratës së shitjes. Këto mund të përmbliohen si më poshtë: zgjidhja e kontratës në rast të “shitjes së sendit të huaj” - shih komentimin e nenit 443; zgjidhja e kontratës për shkak të mungesave materiale të sendit të shitur - shih për këtë komentimin e neneve 471, 472, 473, 475, 478 të LMD; shkelja e detyrimeve të shitësit dhe zgjidhja e kontratës te garancia për funksionimin e mirë të sendit - shih komentimin e nenit 487 të LMD; zgjidhja e kontratës për shkak të mungesave juridike të sendit - shih komentimin e nenit 493 të LMD; zgjidhja e kontratës për rastin e vonesës së blerësit, (kur mund të dyshohet ndaj aftësisë së blerësit për të paguar çmimin) - shih komentimin e nenit 502.2 të LMD ose rasti i ngjashëm më këtë të fundit te shitja me specifikim - shih komentimin e nenit 522.1 të LMD.

Duhet të theksohet se, sipas rregullave të përgjithshme për zgjidhjen e kontratës, ekziston edhe e drejta e blerësit për zgjidhjen e kontratës, nëse shitësi është në vonesë lidhur me dorëzimin e sendit si dhe e drejta e shitësit për zgjidhjen e kontratës, në qoftë se blerësi është në vonesë lidhur me pagesën e çmimit të blerjes ose, në disa raste, edhe nëse blerësi bie në vonesë në lidhje me pranimin e sendit, (shih komentimin e nenit 502 të LMD).

Neni 507. Kur sendi ka çmimin vijues

- 1. Kur shitja është zgjidhur për shkak të shkeljes së kontratës nga ana e njëres palë kontraktuese, ndërsa sendi e ka çmimin rrjedhës, pala tjetër mund të kërkojë diferencën midis çmimit të caktuar në kontratë dhe çmimit rrjedhës në ditën e zgjidhjes së kontratës në tregun e vendit ku është kryer puna.**
- 2. Në qoftë se në tregun e vendit ku është kryer puna nuk ka çmim rrjedhës, për llogaritjen e shpërblimit të dëmit merret në konsiderim çmimi rrjedhës i tregut, i cili do të mund ta zëvendësonte në rastin konkret, të cilit i duhet shtuar diferenca e shpenzimeve të transportit.**

507.1. Neni 507 i LMD shtjellon çështjen e shpërblimit të dëmit në rast të zgjidhjes së kontratës së shitjes, kur sendi-malli shitet sipas çmimit rrjedhës. Te kontrata e shitjes sipas çmimit rrjedhës, çmimi është i ndryshueshëm, varësisht nga ndryshimi i kushteve të tregut. Mund të ndodhë që çmimi në momentin e lidhjes së kontratës të ndryshojë ose të jetë më i ulët së çmimi në momentin e zgjidhjes së kontratës ose anasjelltas. Sigurisht,

nëse kemi të bëjmë me këtë rast, atëherë qëllimi i paragrafit të parë të nenit 507.1 është t'ia njohë palës me mirëbesim të drejtën që të kërkojë ndryshimin që ekziston ndërmjet çmimit të kontraktuar, (çmimi që ekziston në momentin e lidhjes së kontratës), dhe çmimit rrjedhës, që ekziston në ditën e zgjidhjes së kontratës (sigurisht, nëse ndryshimi është i favorshëm për palën me mirëbesim kontraktuese). Kjo formë e dëmit në teori njihet edhe si “dëmi abstrakt” dhe quhet dëm abstrakt, sepse kalkullohet në bazë të ndryshimit që ekziston ndërmjet çmimit ekzistues në momentin e lidhjes së kontratës dhe çmimit aktual (që ekziston në momentin e zgjidhjes së kontratës), i cili sigurisht përcaktohet më vonë (pasi të kalkullohet), ashtu që kjo formë nuk merr për bazë dëmin real që e ka pësuar në fakt pala kontraktuese. Mënyra abstrakte e llogaritjes së dëmit, në fakt, është zhvilluar në shitjet sipas rregullave të bursave, ndërkaq autorë të ndryshëm mendojnë se është mjaftë praktike edhe në kontratat e zakonshme tregtare, sepse përlllogaritjet dhe matet lehtë me kritere objektive, ashtu që kjo formë e lehtëson qarkullimin juridik dhe është një formë e kundërt me dëmin konkret, (i cili ndonjëherë është i vështirë për t'u dëshmuar).⁹⁵

Ashtu si u shpjegua më lart, përlllogaritja e dëmit abstrakt bazohet në diferencën që ekziston ndërmjet çmimit aktual dhe çmimit kontraktues të mallrave-sendeve. Blerësi që kërkon njëanshmërisht zgjidhjen e kontratës (për shkak të mospërmbushjes ose shkeljes së detyrimeve nga pala tjetër kontraktuese), do të mund t'u referohej rregullave të këtij neni, nëse diferenca e çmimit aktual është më e lartë se çmimi i kontraktuar. Sipas këtij koncepti të përlllogaritjes së dëmit, supozohet se, sikur blerësit t'i ishte dorëzuar malli me kohë, ai do të mund ta rishiste mallin (ashtu që të fitonte një vlerë të re) ose kur blerësi vendos ta blejë sendin ose mallin e një pale e tretë, ai do të detyrohej ta paguante tanimë një mall më shtrenjtë. Në të kundërtën, shitësi do të kishte të drejtë të kërkonte diferencën, në rast se çmimi aktual është më i vogël sesa çmimi i kontraktuar, ashtu që supozohet që shitësi është dëmtuar për shumën e diferencës përkatëse, pasi që ai duhet ta shesë mallin me një çmim më të ulët, (pasi çmimi i tregut për atë mall ka pësuar ulje).⁹⁶

Shumë autorë mendojnë se përlllogaritja abstrakte e dëmit, sipas rregullave të këtij neni, është më e lehtë për t'u provuar, sepse të provuarit mbështetet vetëm në kritere objektive, siç është identifikimi i diferencës ndërmjet çmimit të kontraktuar dhe çmimit aktual, ashtu që është shumë praktik për t'u zbatuar. Megjithatë, zbatimi i këtyre rregullave nuk e privon palën e dëmtuar që të kërkojë tërë shpërblimin e dëmit, nëse dëmi i palës ka qenë më i madh se i ashtuquajturit “dëm abstrakt”. Për këtë mundësi, shih komentimin e nenit 509 të LMD (më poshtë).

Në lidhje me kuptimin e të ashtuquajturit “çmim vijues ose çmimin rrjedhës“, shih komentimin e nenit 447 të LMD (më lart). Vihet re se LMD nuk është konsistent në terminologjinë që përdor në lidhje me trajtimin e çështjeve të cilat kanë të bëjnë me çmimin

95 Për çështjen e dëmit abstrakt dhe konkret, shih gjithashtu: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1026 - 1027. Gjithashtu shih: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë: 1988: fq. 47 - 48.

96 Në lidhje me këtë formë të dëmit, shih gjithashtu: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë: 1988: fq. 47 - 48.

vijues, përkatësisht çmimin rrjedhës; kështu, për të njëjtin nocion në nenin 447 përdoret termi “çmimi i ditës”, me të cilin ligjvënësi i referohet çmimit vijues ose çmimit rrjedhës.

Paragrafi i parë i nenit 507 në lidhje me përcaktimin e diferencës ndërmjet çmimit të kontraktuar dhe çmimit vijues, përdor kriterin, sipas të cilit, duhet të merret për bazë **“tregu në vendin ku është kryer puna”**. Kjo është më e thjeshtë për tregun e brendshëm juridik, pasi që edhe ashtu vendi ynë nuk përbën një treg të “madh dhe heterogjen”. Çështja komplikohet te shitjet ndërkombëtare, kur kontrata lidhet në një vend, ndërsa ekzekutohet ose pasojat e ekzekutimit të saj manifestohen në një vend tjetër, ndërkaq tregu i dy apo më shumë vendeve të ndryshme mund të jetë heterogjen. Në rastin e dhënë do të shtrohej pyetja se tregu i cilit shtet ose vend do të merrej për bazë për përlllogaritjen e kësaj forme të dëmtimit. Sigurisht, shumica e autorëve i japin përparësi kriterit të vendit ku ekzekutohet kontrata, përkatësisht vendit ku krijohen pasojat juridike për të ose vendit të dërgesës së mallit.⁹⁷ Kështu, në përlllogaritjen e dëmit abstrakt shumica e autorëve mendojnë se kriteri bazë që duhet të merret në konsiderim do të duhej të ishte çmimi mesatar që ekziston në vendin e dërgesës së mallit, kurse moment relevant deri kur duhet të bëhet përlllogaritja e ndryshimit është momenti kur malli është dashur të jetë dërguar, përkatësisht dita e dërgesës mallit.

507.2. Paragrafi i dytë i nenit 507 të LMD rregullon mënyrën e përlllogaritjes së dëmit abstrakt, kur në vendin e tregtimit, aty ku është kryer puna ose ku është krijuar efekti i kontratës ose ku është dashur të dërgohet malli nuk ka çmim vijues, përkatësisht nuk ka çmim rrjedhës. Në një rast të tillë, nëse në vendin e tregtimit, në të cilin është kryer puna, nuk ka çmim aktual rrjedhës, Ligji parashikon që për këtë rast kriter bazë do të duhej të merrej çmimi aktual i tregut, i cili më së miri do të mund t’i përshtatej rastit konkret, kurse në një rast të dhënë, krahas diferencës që ekziston ndërmjet çmimit të kontraktuar dhe çmimit aktual, LMD kërkon që të merren në konsideratë edhe shpenzimet e transportit dhe ato të përlllogariten në kuadër të dëmit abstrakt. Se cili do të ishte tregu më i përshtatshëm që do të duhej të merrej për bazë, autorët e ndryshëm i referohen tregut më të afërt, i cili mund ta sigurojë kriterin e saktësimin të çmimit aktual.⁹⁸

97 Sigurisht, çështja e ngritur është një çështje e natyrës praktike, së cilës duhet t’i japë përgjigje gjykata ose arbitrazhi, në rastet e kontratave të shitjes me element të huaj, kur të drejtat e të dy apo me shumë shteteve konkurrojnë në rregullimin e një marrëdhënie kontraktuese me element të huaj. Sigurisht, në këtë çështje nuk do të ndalemi më shumë, pasi që edhe ashtu është një çështje që i referohet më shumë problemit të zgjidhjes së konfliktit të ligjeve, ndërkaq pyetjet që mund të ngrihen në këtë kontekst tejkalojnë qëllimin e komentimit të këtij neni.

98 Sa për krahasim, zgjidhje shumë të ngjashme juridike ofron edhe Konventa e Hagës në lidhje me unifikimin e ligjit ndërkombëtar për shitjen e mallrave, Konventa e 1 korrikut e vitit 1964, përkatësisht neni 84 i saj, zgjidhjet juridike këto që, si duket, LMD i ka huazuar nga kjo Konventë. Në lidhje me këtë Konventë, shih: < unidroit.org/english/conventions/c-ulis.htm >, dt. 20.06.2013.

Neni 508. Kur shitja ose blerja është bërë për mbulesë

- 1. Kur objekt i shitjes është një sasi sendesh të caktuara sipas llojit dhe kur njëra palë nuk e kryen me kohë detyrimin e vet, pala tjetër mund të bëjë shitjen respektivisht blerjen për mbulesë dhe të kërkojë diferencën midis çmimit të caktuar me kontratë dhe çmimit të shitjes apo të blerjes për mbulesë.**
- 2. Shitja dhe blerja për mbulesë duhet të bëhet në afatin e arsyeshëm dhe në mënyrën e arsyeshme.**
- 3. Për qëllimin e shitjes përkatësisht blerjes, kreditori është i detyruar ta njoftojë debitorin.**

508.1. Për ndryshim nga nenin pararendës, neni 508 i LMD e rregullon të ashtuquajturën çështje të shpërblimit të “dëmit”, i cili ndërlihet ose shkaktohet kur në kontratën e shitjes njëra palë lë pa përmbushur detyrimin e saj kontraktues, përkatësisht lë pa dorëzuar ose pa pranuar, sipas kontratës, mallrat “e caktuara sipas llojit”; ndërkaq, në kuptim të këtij neni, pala tjetër me mirëbesim e kontratës ka të drejtë ta bëjë shitjen, respektivisht blerjen “për mbulesë” (palës së tretë), ashtu që krahas shitjes-blerjes, pala me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë edhe diferencën që ekziston ndërmjet çmimit të caktuar me kontratë dhe çmimit të realizuar nga shitja-blerja që është bërë për mbulesë.

Karakteristike për këto rregullave të këtij neni është ajo se ato kërkohen të zbatohen vetëm te kontratat e shitjes, të cilat kanë për objekt sendet e shquara në gjini (gjë që është karakteristike për tregtimin e mallrave), kurse mbrojtja juridike palës me mirëbesim të kontratës i sigurohet, duke i mundësuar asaj që, krahas shitjes-blerjes së mallit nga pala e tretë (për mbulesë), të kërkojë edhe ndryshimin ndërmjet çmimit të kontraktuar dhe çmimit të realizuar nga shitja me palën e tretë (sigurisht, nëse ndryshimi në çmim është negativ për palën me mirëbesim të kontratës).

508.2. Paragrafi i dytë i nenit 508 të LMD vendos disa kushte, duke përcaktuar se kur shitja, respektivisht blerja për mbulesë mund të realizohet. Paragrafi në fjalë përcakton se shitja dhe blerja për mbulesë mund të realizohet, nëse bëhet brenda një kohe të arsyeshme dhe në mënyrë të arsyeshme. Për atë se cila është koha e arsyeshme brenda së cilës blerësi, respektivisht shitësi mund të bëjë blerjen-shitjen për mbulesë, Ligji hesht plotësisht. LMD nuk jep ndonjë sugjerim se nga cili moment fillon të rrjedhë mundësia që pala me mirëbesim kontraktuese t’i referohet zbatimit të rregullave të këtij neni, përkatësisht të bëjë shitjen, respektivisht blerjen për mbulesë si dhe të kërkojë diferencën përkatëse. Shumë autorë mendojnë se, megjithatë, çështja e kohës së arsyeshme është një çështje që duhet të shtjellohet në çdo rast veç e veç, duke i pasur në konsideratë rregullat e sjelljes me mirëbesim të palëve. Kështu, p.sh., ka mendime në praktikën juridike që sugjerojnë se, nëse blerësi brenda një kohe të gjatë (pasi shitësi të ketë rënë në vonesë), nuk do të kërkonte zbatimin e rregullave të blerjes me mbulesë, atëherë lehtësisht mund të mendohet se heshtja për një kohë të gjatë, në rrethana të caktuara, mund të tregojë se pala-blerësi është tërhequr plotësisht nga kontrata, ashtu që edhe rregullat e mirëbesimit nuk do të

mund të lejonin që blerësi të keqpërdorte këtë mundësi dhe të kërkonte zbatimin e këtyre rregullave në mënyrë arbitrare, (p.sh., kur pas një kohe të gjatë, si rezultat i ndryshimeve të konsiderueshme në çmimet e tregut, blerësi, përtej pritjeve të tij që i ka pasur në një moment, të ketë për qëllim t'i keqpërdorë këto rrethana). Andaj, në këtë kuptim, se cila është koha e arsyeshme për t'iu referuar këtyre rregullave, duhet të çmohet varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret, posaçërisht duke pasur në konsideratë mirëbesimin e palës, e cila i referohet zbatimit të rregullave të këtij neni.

LMD, edhe pse thekson se shitja-blerja për mbulesë mund të bëhet për “shkaqe të arsyeshme”, megjithatë është i heshtur lidhur me shtjellimin e shpjegimit se çka do të mund të paraqiste shkak të arsyeshëm për aplikimin e rregullave të këtij neni. Sigurisht, qëllimi i ligjvënësit për këtë rast ka qenë që arsyeshmëria e zbatimit të rregullave të këtij instituti të zhvillohet nga praktika juridike, duke ia përshtatur atë rrethanave të rastit konkret. P.sh., do të mund të shtrohej si pyetje nëse mos dorëzimi i mallit në vendin e destinimit për blerësin do të ishte i mjaftueshëm që t'i referohet zbatimit të këtyre rregullave, apo arsyeshmëria e rregullave të ndërgjegjshmërisë së palëve do të mund të kërkonte që blerësi ta ketë pranuar mallin edhe në një vend tjetër (të ndryshëm nga vendi i destinimit), me shpenzimet e transportit të shitësit. Sigurisht, përgjigja ndaj arsyeshmërisë së zbatimit të shitjes-blerjes për mbulesë duhet të mbështetet në zbatimin e rregullave të mirëbesimit të palës që i referohet zbatimit të këtyre rregullave, duke pasur për bazë me rastin e zbatimit të shitjes-blerjes për mbulesë edhe zbatimin e standardit të shtëpiakut të mirë ose ekonomistit të mirë, (ashtu që ngarkimi për palën tjetër të jetë sa më i vogël dhe sa më i justifikueshëm). P.sh., në një situatë të dhënë, në qoftë se blerësi blen mallra “për mbulesë” me një çmim më të ulët se çmimi i kontratës, sigurisht nuk ka të drejtë të kërkojë diferencën sipas bazës së këtyre rregullave, (sepse diferenca e çmimeve nuk është e disfavorshme për të); por, sigurisht kjo nuk do t'ia mohojë blerësit të drejtën që ai të kërkojë zhdëmtim nga pala tjetër që nuk ka përmbushur detyrimet e saj, nëse ka arsyeshmëri për baza të tjera të zhdëmtimit. Në kuptim të kësaj, mund të përfundohet se rregullat e mirëbesimit dhe të drejtshmërisë do të kërkonin nga blerësi ose eventualisht nga shitësi që kur bëjnë shitje-blerje për mbulesë, duhet gjithmonë të veprojnë me përkushtim dhe ndershmeri, me vëmendje të caktuar të kërkesave në qarkullim, (“vëmendja e ekonomistit të mirë” dhe “vëmendja e shtëpiakut të mirë”). Këto standarde të sjelljes do të kërkonin nga pala me mirëbesim që të bëjë një blerje ose shitje ekonomikisht sa më të përshtatshme, sigurisht që të vizitojë ose shqyrtojë blerjen-shitjen te më shumë tregtar ose palë të treta, në mënyrë që ajo të jetë sa më e favorshme për të, gjë që do të krijonte një barrë më të vogël për palën tjetër. Rëndom, te shitja-blerja për mbulesë, kur çmimi i mallrave vlerësohet sipas çmimit të tregut, blerësi-shitësi ka për detyrim që në ekzekutimin e blerjeve-shitjeve për mbulesë t'i përmbahet çmimit të tregut. Ekziston mendimi që ndryshimi në aspektin e cilësisë, kohës, vendit e kështu me radhë, nuk e bëjnë blerjen-shitjen për mbulesë a priori të pavlefshme, megjithatë këto rrethana duhet të çmohen në kuptim të asaj që shitja-blerja për mbulesë të ketë qenë sa më ekonomike.⁹⁹

99 Për çështjen e dëmit konkret, shih gjithashtu: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1026 - 1027

508.3. Paragrafi i fundit i nenit 508 të LMD vendos edhe një kusht dhe ky është detyrimi i njoftimit të debitorit nga kreditori për bërjen e shitjes, respektivisht blerjes për mbulesë. LMD e vendos këtë kërkesë si masë të detyrueshme, e cila do t'i mundësonte debitorit që të përkujdeset për mbrojtjen e interesave të tij, ashtu që edhe dëmi ose barra e detyrimit për të të ishte sa më e vogël. Kështu, p.sh., blerësi, si debitor, do të mund ta informonte shitësin se kur ai do të mund ta kryente një shitje më të favorshme (nga e cila dëmi ose ngarkesa për debitorin do ishte më e vogël); ose edhe në raste të tjera të ngjashme, të cila do t'i mundësonin debitorit të përkujdesej për mbrojtjen e interesave të tij. Megjithatë, ka edhe mendime që mosnjoftimi i debitorit për shitjen-blerjen e bërë për mbulesë nuk sjell pavlefshmërinë e plotë të blerjes-shitjes për mbulesë, por mund të ndikojë në sasinë e diferencës në çmime që mund t'i takojë kreditoret ose në sasinë e detyrimit të plotë të shpërblimit të dëmit, që duhet të paguajë debitori për kreditorin.¹⁰⁰

Neni 509. Shpërblimi i dëmit tjetër

Krahas të drejtës për shpërblimin e dëmit sipas rregullave nga nenet paraprake, pala e cila i mbetet me mirëbesim kontratës ka të drejtë edhe në shpërblimin e dëmit më të madh, në qoftë se e ka pësuar.

509. Neni 509.1 i LMD është një vazhdimësi e mbrojtjes juridike që ofrojnë nenet e mësipërme (506, 507 dhe 508 të LMD për palën me mirëbesim të kontratës, qëllimi i të cilit është të sanksionojë të drejtën e zhdëmtimit të palës me mirëbesim të kontratës edhe përtej asaj që ofrojnë nenet e mësipërme; (këto nene të mësipërme shtjellonin çështjen e shpërblimit të dëmit abstrakt ose shpërblimin në rast të shitjes-blerjes me mbulesë). Sipas bazës së këtij neni, pala me mirëbesim e kontratës ka të drejtën për zhdëmtim të plotë edhe përtej asaj që ofrojnë rregullat e zhdëmtimit për shkeljen e kontratës në rast të dëmit abstrakt ose të shitjes-blerjes për mbulesë. Sipas kuptimit të këtij neni, palës me mirëbesim dhe të ndërgjegjshme në marrëdhëniet kontraktuese, krahas mbrojtjes së mësipërme në nenet e komentuar më lart, i takon edhe e drejta e zhdëmtimit të plotë si të dëmit të vërtetë, ashtu edhe e fitimit të munguar, nëse ka prova për të dëshmuar dëmin e pësuar.

Për dallim nga dëmi abstrakt i përmendur më lart, i cili mbështetet në kritere objektive, kjo formë e dëmit duhet të provohet nga i dëmtuari, i cili nganjëherë varet edhe nga rrethanat subjektive të rastit ose të të dëmtuarit, ashtu që ndonjëherë nuk është e lehtë për t'u provuar. Kështu, sipas bazës së këtij neni, të dëmtuarit i takon e drejta e zhdëmtimit të plotë dhe ky si për dëmin i cili rrjedh ose është pasojë e cenimit të kontratës ose që rrjedh nga

100 Shih në lidhje me këtë konstatim: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1339 . Gjithashtu, sa për krahasim, zgjidhje shumë të ngjashme juridike ofron edhe Konventa e Hagës në lidhje me unifikimin e ligjit ndërkombëtar për shitjen e mallrave, Konventa e 1 korrikut e vitit 1964, përkatësisht neni 85 i saj, zgjidhje juridike këto që, si duket, LMD i ka huazuar nga kjo Konventë. Në lidhje me këtë Konventë, shih: < unidroit.org/english/conventions/c-ulis.htm> , dt. 20.06.2013; e drejta krahasuese ofron një zgjidhje juridike shumë të ngjashme në lidhje me shitjen-blerjen për mbulesë: shih në këtë kontekst nenin 191 dhe neni 215 i Kodit zviceran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 22.07.2013.

përgjegjësia kontraktuese (shih për këtë komentimin e nenit 249 të LMD), ashtu edhe për dëmin që është pasojë e përgjegjësisë deliktore, (shih për këtë komentimin e nenit 173 të LMD). Një nga aspektet kryesore të zhdëmtimit, sipas këtij neni, është se dëmi i pësuar nga i dëmtuari duhet të vërtetohet. Kreditori, përkatësisht pala me mirëbesim e kontratës, mund të kërkojë para së gjithash shpërblimin e dëmit të vërtetë (damnum emergens), që ndërlidhet me dëmin real që e ka pësuar i dëmtuari. Por, kreditorit, mbi këtë bazë, i takon edhe fitimi i munguar (fitimi i cili nuk është realizuar për shkak të cenimit të kontratës ose dështimit të përmbushjes së detyrimeve të debitorit; p.sh., nuk është dorëzuar në kohë makineria e porositur, ashtu që procesi i prodhimit është shtyrë ose ka humbur klientela ose është dëmtuar emri afarist i të dëmtuarit dhe të gjitha këto mund të kenë për pasojë humbjen e fitimit në afarizëm). Me fitimin e humbur (të ashtuquajturin *lucrum cessans*) LMD nënkupton fitimin e arsyeshëm që mund të pritët në rrjedhën normale të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet konkrete të debitorit dhe kreditorit. Prandaj, në lidhje me fitimin e humbur, është e nevojshme që i dëmtuari të provojë nëse rritja e fitimit do të mund të pritej në mënyrë të arsyeshme, sikur kontrata të ishte përmbushur sipas kushteve dhe afateve të saj.¹⁰¹

KREU 7

RASTET E VECANTA TË KONTRATËS PËR SHITJE

NËNKREU 1

SHITJA ME TË DREJTËN E PARABLERJES

Neni 510. Nocioni

Me dispozitën kontraktuese mbi të drejtën e parablerjes obligohet blerësi që ta njoftoj shitësin mbi shitjen e sendit që ka ndërmend t’ia bëjë personit të caktuar, si dhe mbi kushtet e kësaj shitjeje dhe t’ia ofroj që ky ta blej sendin me të njëjtin çmim.

510. Shitja me të drejtën e parablerjes konsiderohet një formë e veçantë e kontratës së shitjes, sipas së cilës, shitësi, me dispozitë kontraktuese, pajtohet me blerësin, ashtu që themelon dhe ruan për vete të drejtën e parablerjes ndaj të tretëve, në qoftë se blerësi i tij vendos ta rishesë sendin. Nëse e drejta e parablerjes është kontraktuar ashtu, atëherë blerësi është i obliguar që ta njoftojë shitësin për qëllimin e vet që mund të ketë lidhje me shitjen e sendit personit të caktuar, të cilit t’ia bëjë të njohura kushtet e shitjes dhe t’ia ofrojë atij, në mënyrë që ta blejë sendin për çmimin e ofruar (në kushte të njëjta me blerësit e tjerë potencialë). Sigurisht, ashtu si lexohet edhe nga vetë dispozita ligjore e nenit

101 Përcaktimi i këtij neni i përgjigjet nenit 86 të Konventës së Hagës në lidhje me unifikimin e ligjit ndërkombëtar për shitjen e mallrave, Konventa e 1 korrikut e vitit 1964. Në lidhje me këtë Konventë, shih: <unidroit.org/english/conventions/c-ulis.htm>, dt. 20.06.2013. Në lidhje me këtë shih gjithashtu: Blagojević, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1350 - 1351.

510 të LMD, kjo formë e së drejtës së parablerjes themelohet me kontratë, përkatësisht ajo nënkupton një marrëveshje kontraktuese ndërmjet palëve. Fakti që shitësi themelon të drejtën e parablerjes mbi sendin që e shet, nuk nënkupton aspak rrezikimin e së drejtës së pronësisë dhe të drejtës së disponimit të blerësit në lidhje me sendin që blen. Blerësi, me gjithë ekzistimin e së drejtës së parablerjes të shitësit mbi sendin e blerë, e fiton në mënyrë të rregullt të drejtën e pronësisë dhe të gjitha atributet e tjera të cilat e karakterizojnë të drejtën e pronësisë. Megjithatë, vetëm nëse blerësi i fundit vendos ta rishesë këtë send, ka për obligim që, në kushte të njëjta, së pari sendin t'ia ofrojë për shitje shitësit të fundit, (ky i fundit si titullar i parablerjes). Rrjedhimisht, nëse kjo e fundit ndodh, atëherë palët vetëm ndërrojnë rolet, ashtu që shitësi i fundit bëhet blerësi, ndërsa blerësi i fundit bëhet shitësi në transaksionin shitblerës të radhës. Në kuptim të kësaj, ekzistimi i së drejtës së parablerjes të shitësit në asnjë mënyrë nuk ndikon në të drejtën e pronësisë së blerësit mbi sendin e blerë ose nuk determinon ose kufizon atributet e tjera të pronësisë; gjithashtu konsiderohet se ekzistimi i së drejtës së parablerjes mbi sendin përkatës nuk determinon kushtet eventuale të shitjes, të cilat blerësi i fundit, varësisht nga kushtet e tregut, mund t'ia drejtojë shitësit të tij si ofertë me një përmbajtje të caktuar.¹⁰²

Neni 511. Afatet për ushtrimin e së drejtës dhe për pagimin e çmimit

- 1. Shitësi ka për detyrë ta njoftojë blerësin në mënyrë të sigurt mbi vendimin e vet për ta shfrytëzuar të drejtën e parablerjes brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh duke llogaritur që nga dita kur shitësi, e ka njoftuar mbi këtë shitjen që ka ndërmend ti bëjë personit të tretë.**
- 2. Njëkohësisht me deklaratën se ai e blen sendin, shitësi ka për detyrë ta paguajë çmimin e njoftuar personit të tretë, ose ta depozitojë pranë gjykatës.**
- 3. Në rast se në kontratën me të tretin është parashikuar afati për pagimin e çmimit – shitësi mund ta shfrytëzoj këtë afat vetëm në qoftë se ofron siguri të mjaftueshme.**

511.1. Sipas kuptimit të nenit paraprak, në lidhje me të drejtën e parablerjes, blerësi (i fundit) detyrohet ta njoftojë shitësin (e fundit), i cili e ka të drejtën e parablerjes, si për qëllimin e shitjes së sendit që ka ndërmend t'ia bëjë personit të caktuar, ashtu edhe për kushtet e shitjes, ashtu që titullarit të së drejtës së parablerjes t'ia ofrojë mundësinë që ky ta blejë sendin me të njëjtin çmim. Paragrafi 511.1 i LMD rregullon çështjen e afatit të ushtrimit të kësaj të drejte. Kështu, sipas kuptimit të paragrafit në fjalë, blerësi i fundit (përkatësisht shitësi i cili ka për qëllim ta shesë sendin që është i ngarkuar me të drejtën e parablerjes), ka për detyrim që titullarin e së drejtës së parablerjes ta njoftojë për qëllimin e shitjes së sendit dhe për kushtet e shitjes, duke bërë këtë 30 ditë para se sendi të mund t'i shitet personit të tretë. Afati prej 30 ditësh fillon të rrjedhë nga momenti kur titullari i së drejtës së parablerjes është njoftuar për qëllimin e shitësit për

¹⁰² Për shitjen me të drejtë të parablerjes, shih: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 316 - 317; si edhe: Miloshevic, Ljubisa. *Obligaciono pravo*. Beograd. 1982: fq. 306.

ta shitur sendin e tij (të ngarkuar me të drejtën e parablerjes). Me fjalë të tjera, titullari i së drejtës së parablerjes mund ta ushtrojë të drejtën e tij dhe ta blejë sendin në afatin prej 30 ditësh, pasi që ka marrë njoftimin nga shitësi për shitjen e sendit. Shitësi, krahas njoftimit të qëllimit të tij për shitjen e sendit, së bashku me njoftimin, titullarit duhet t'i ofrojë edhe kushtet e shitjes dhe eventualisht të lidhet-ekzekutohet kontrata, nëse pranohen kushtet në fjalë nga titullari i së drejtës së parablerjes.¹⁰³

Një pyetje e veçantë që mund të shtrohet ka të bëjë me atë se si mund të bëhet njoftimi i qëllimit të shitjes së sendit. LMD në këtë pikëpamje është i heshtur, megjithatë, shumë autorë mendojnë se njoftimi i qëllimit të shitjes së sendit duhet të bëhet në një mënyrë të sigurt për pjesëmarrësit; sigurisht që edhe të mund të provohet më lehtë, si, p.sh., nëse është e mundur njoftimi të bëhet në një dokument në letër (në adresën e regjistruar të pranuesit) ose tani eventualisht edhe nëpërmjet mjeteve elektronike, të cilat për shfrytëzuesit e tyre lënë gjurmë të mjaftueshme që mund të provohen nga palët në rast kontesti.¹⁰⁴

Në lidhje me afatin e njoftimit, për dallim nga shumë ligje ose kode civile të tjera, LMD ofron një afat unik dhe të përbashkët të aplikueshëm si për shfrytëzimin e së drejtës së parablerjes për shitjen e sendeve të luajtshme, ashtu edhe për shfrytëzimin e së drejtës së parablerjes për shitjen e sendeve të paluajtshme. Për ndryshim nga kjo qasje e LMD, e drejta civile krahasuese ofron afate të ndryshme, të cilat janë të zbatueshme për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme. Kështu, p.sh., sipas Kodit Civil Austriak, afati i njoftimit për shitjen e sendit, (të ngarkuar me të drejtën e parablerjes), është 24 orë në rastin kur, si objekt shitjeje është pasuria e luajtshme ose afati prej 30 ditësh, kur është fjala për shitjen e sendit të paluajtshëm, (neni 1075).¹⁰⁵

511.2. Titullari i së drejtës së parablerjes, nëse dëshiron ta blejë sendin, për qëllimin e shitjes së të cilit është njoftuar nga shitësi, duhet t'i deklarojë shitësit se dëshiron ta blejë sendin me kushtet të cilat i janë ofruar.¹⁰⁶ Krahas bërjes së deklaratës për blerjen e sendit, titullari i së drejtës së parablerjes duhet t'ia paguajë shitësit çmimin përkatës, (ashtu siç është dakorduar ose ka mundur të dakordohet ai me personin e tretë), ose që çmimin përkatës ta dorëzojë në gjykatë (në rastin e fundit, nëse titullarit i pamundësohet që çmimin t'ia paguajë shitësit të sendit). Komentues të LMD mendojnë se paragrafi i dytë i nenit 511 të LMD kërkon që momenti i deklarimit të titullarit të së drejtës së parablerjes se e blen sendin, është i njëkohshëm me detyrimin e tij për pagesën e çmimit blerës.¹⁰⁷

511.3. Paragrafi i tretë i nenit 511 të LMD rregullon mundësinë që, përjashtimisht, titullari i së drejtës së parablerjes të kërkojë një afat shtesë për pagesën e çmimit, që është i ndryshëm

103 Bukljas, Ivan. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I, II*. Zagreb, 1978: 263 - 264.

104 Shih në lidhje me këtë: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë: 1988: fq. 66.

105 Në lidhje me këtë, shih nenin 1075 Kodin Civil Austriak i qasshëm ne: <biblio.org/ais/abgb1.htm>, dt. 06.09.2013;

106 Bukljas, Ivan. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I, II*. Zagreb, 1978: 264.

107 Shih në lidhje me këtë: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë: 1988: fq. 67.

nga momenti i deklarimit të tij se dëshiron të blejë sendin (si objekt i së drejtës së parablerjes). Sipas kuptimit të kësaj dispozite, me kushtin që shitësi më të tretin ta ketë kontraktuar një afat më të gjatë të shitjes së sendit, titullari i së drejtës së parablerjes mund ta shfrytëzojë këtë afat më të gjatë për pagesën e çmimit, me kusht që titullari i së drejtës së parablerjes t'i ketë ofruar siguri të mjaftueshme shitësit se do t'ia paguajë çmimin përkatës. Paragrafi i tretë, ashtu siç është ndërtuar nga ligjvënësi, duket të jetë vetëm një përjashtim që titullari i së drejtës së parablerjes mund ta shfrytëzojë, nëse shitësit i ofron sigurim të mjaftueshëm për pagesën e çmimit, i cili duhet të bëhet më vonë, (ashtu siç e ka kontraktuar shitësi me të tretin). Në mungesë të një mjeti të përshtatshëm të sigurimit të detyrimeve të tij të pagesës, titullari i së drejtës së parablerjes nuk mund t'i referohet kësaj mundësie.

Neni 512. Mundësia e trashëgimit dhe të tjetërsimit

E drejta e parablerjes së sendeve të luajtshme nuk mund të tjetërsohet dhe as të trashëgohet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

512. Neni 512 i LMD i është përmbajtur zgjidhjes së mesme juridike, sipas së cilës, e drejta e parablerjes së sendeve të luajtshme nuk mund të tjetërsohet dhe as të trashëgohet, përpos nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe.

Për dallim nga e drejta ligjore e parablerjes, e cila, sipas shumicës së autorëve, mund të bartet dhe të trashëgohet, në lidhje me të drejtën kontraktore të parablerjes, mendohet se ekzistojnë dy teori juridike në përgjithësi. Sipas teorisë së parë, e drejta kontraktore e parablerjes është një e drejtë personale, e kontraktuar personalisht nga palët dhe e lidhur me personalitetin e tyre, rrjedhimisht, edhe e pabartshme ose e patrashëgueshme. Kjo zgjidhje juridike, sipas së cilës e drejta kontraktore e parablerjes është një e drejtë personale, e pabartshme mbi një person të tretë, duket se është përfaqësuar në Kodin Civil Austriak.¹⁰⁸ Sipas teorisë së dytë, e cila duket se është zhvilluar sipas doktrinës juridike gjermane, edhe e drejta kontraktore e parablerjes mund të bartet, respektivisht të trashëgohet.¹⁰⁹

Në kuptim të kësaj që u tha më lart, shumë autorë mendojnë se zgjidhja juridike e LMD, në lidhje me mundësinë e bartjes së të drejtës kontraktore të parablerjes, megjithatë është një zgjidhje juridike e mesme, pasi që ajo shprehimisht përjashton mundësinë që kjo e drejtë të jetë e bartshme për sendet e luajtshme, përpos nëse, në një rast të veçantë, Ligji në fuqi nuk sanksionon diçka tjetër. Kjo zgjidhje juridike e LMD është e bazuar mbi parimin e mostransferimit dhe të mostjetërsimit të së drejtës së parablerjes te pasuria e luajtshme, përpos nëse, në një situatë të veçantë juridike, ndryshe lejohet me Ligj. LMD nuk ka një përcaktim dhe rregullim të veçantë në lidhje me të drejtën kontraktuale të parablerjes,

108 Në lidhje me këtë shih Nenin 1074 të Kodin Civil Austriak i qasshëm ne: <ibiblio.org/ais/abgb1.htm>, dt. 06.09.2013.

109 Në lidhje me këtë mundësi, shih edhe: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1356 - 1357.

kur objekt i saj janë paluajtshmëritë. Mendojmë që shtjellimi i së drejtës kontratuale të parablerjes në lidhje me paluajtshmëritë është përtej kuptimit të dispozitës së nenit 512 të LMD. Në këtë kuptim, duket se ligjvënësi ka menduar se shtjellimi i së drejtës së parablerjes në lidhje me paluajtshmeritë (duke përfshirë edhe mundësinë e kontraktimit të saj kur janë objekt paluajtshmeritë), është përtej përcaktimit të LMD.

Neni 513. Në rastin e shitjes publike të detyrueshme

- 1. Gjatë ankandit publik të detyrueshëm përfituesi i së drejtës së parablerjes (blerësi) nuk mund të përdori të drejtën e vet të parablerjes.**
- 2. Mirëpo, përfituesi i së drejtës së parablerjes (blerësi) e drejta e parablerjes e të cilit është shkruar në regjistrin zyrtar, mund të kërkojë anulimin e shitjes publike në qoftë se nuk është ftuar posaçërisht.**

513.1. Paragrafi i parë i neni 513 të LMD përcakton se në rastet e shitjes publike të dhunshme (shitjes në ankandin publik), titullari i së drejtës së parablerjes nuk mund t'i referohet të drejtës së vet të parablerjes, nëse sendi është shitur në ankandin publik për kënaqjen e interesave të shitjes së detyrueshme. Në teorinë juridike ekziston mendimi se, kur sendi shitet në procedurën e ekzekutimit me dhunë (shitja publike për kënaqjen e interesave të kreditorëve), konsiderohet se sendi shitet pa ngarkesa ose barrë, ashtu që një shitje e tillë e dhunshme përjashton edhe të drejtën e parablerjes së titullarit të saj. Ky mendim posaçërisht konsiderohet i drejtë te shitja e sendeve të luajtshme.¹¹⁰

513.2. Në lidhje me atë që u tha më lart në komentimin e këtij neni, paragrafi i dytë i të cilit vendos një përjashtim kur është fjala për shitjen ose përmbarimin mbi sendet e paluajtshme. Sipas kuptimit të tij, në rast të shitjes publike të sendit të paluajtshëm, titullari i së drejtës së parablerjes duhet posaçërisht të njoftohet për shitjen përmes ankandit publik dhe t'i sigurohen njoftimet përkatëse rreth organizimit të ankandit publik, të cilat do t'ia mundësonin pjesëmarrjen në ankand, si, p.sh., njoftimi për kohën dhe vendin e organizimit të shitjes publike. Në kuptim të kësaj dispozite, titullari i së drejtës së parablerjes do të kishte të drejtë të kërkonte anulimin e shitjes në ankandin publik, nëse organizatori i ankandit publik ka shkelur detyrimet sipas kësaj dispozite që titullarin e së drejtës së parablerjes ta ftojë posaçërisht për pjesëmarrje në ankandin publik. Një zgjidhje të ngjashme juridike me paragrafin e dytë të këtij neni ofron edhe e drejta krahasuese civile.¹¹¹

110 Në lidhje me këtë konstatim, shih: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1357 - 1358.

111 Shih në lidhje me këtë nenin 1076 të Kodin Civil Austriak i qasshëm ne: <ibiblio.org/ais/abgb1.htm>, dt. 06.09.2013.

Neni 514. Kohëzgjatja e së drejtës së parablerje

- 1. E drejta e parablerjes shuhet në kohën e përcaktuar me kontratë.**
 - 2. Nëse koha nuk është përcaktuar me kontratë, e drejta e parablerjes shuhet pesë (5) vite pas lidhjes së kontratës.**
-

514.1. Në komentimin e këtij neni, kur flitet për kohëzgjatjen e së drejtës së parablerjes, sigurisht mendohet për kohëzgjatjen e së drejtës kontraktore të parablerjes, sepse e drejta ligjore e parablerjes është subjekt i një rregullimit të veçantë ligjor. Në të drejtën krahasuese, veçanërisht në ato sisteme juridike ku e drejta e parablerjes cilësohet si e drejtë personale, ekziston botëkuptimi se e drejta e parablerjes zgjat aq sa zgjat jeta e titullarit të së drejtës së parablerjes. Prandaj, disa legjislacione nuk janë ndalur shumë në problematikën e kohëzgjatjes së kësaj të drejte. Kjo qasje, sipas së cilës e drejta e parablerjes zgjat për një kohë relativisht të gjatë, (sa zgjat jeta e titullarit), duket se nuk është zgjidhja më e mirë juridike, pasi që ajo mund të jetë një barrierë e konsiderueshme për pronarin e sendit. Sigurisht, vetë ekzistimi i së drejtës së parablerjes mbi sendet që janë objekt i qarkullimit juridik, në një masë, kufizon qarkullimin juridik të atyre sendeve, sepse jetësimi i kësaj të drejte kërkon procedurë dhe afate të caktuara kohore, të cilat paraqesin pengesë për përshpejtimin e qarkullimit juridik të të mirave materiale - sendeve. Kështu, legjislacionet e kohës më të re, ashtu siç është edhe rasti me LMD, kanë për qëllim të kufizojnë kohëzgjatjen e mundësisë së ushtrimit të së drejtës së parablerjes në afate sa më të shkurtra, kur palët nuk kanë vendosur një afat kontraktor të kohëzgjatjes së saj. Autorë të ndryshëm mendojnë se kjo qasje e kufizimit të kohëzgjatjes së të drejtës së parablerjes është në pajtim me modernizimin e së drejtës dhe nevojën e rritjes së shpejtësisë së qarkullimit juridik, në mënyrë që kjo të jetë një barrierë sa më e kufizuar për pronarin e sendit. Në kuptim të këtij qëllimi, LMD në paragrafin e parë të nenit 514 ka sanksionuar se e drejta e parablerjes zgjat për aq sa palët e kanë përcaktuar kohëzgjatjen me kontratë. LMD në këtë kuptim ka respektuar autonominë e vullnetit të palëve, si një nga parimet fundamentale të LMD dhe të së drejtës kontraktore. Në fakt, edhe nga vetë përcaktimi i së drejtës kontraktore të parablerjes del se palët e themelojnë me kontratë atë, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj, gjë që është në pajtim me parimin e autonomisë së vullnetit të palëve.

514.2. Nëse palët nuk kanë saktësuar në kontratë kohëzgjatjen e së drejtës së parablerjes, paragrafi i dytë i nenit 514 të LMD ka saktësuar mjaft qartë se e drejta e parablerjes shuhet në afatin prej 5 vjetësh, nga dita e lidhjes së kontratës, me të cilën është themeluar e drejta e parablerjes. Në rastin e parashikuar në këtë dispozitë bëhet fjalë për afatin ligjor të kohëzgjatjes së të drejtës së parablerjes, nëse palët nuk e kanë përdorur mundësinë e saktësimi të tij në kontratë. Në këtë kuptim, LMD ka pasur për qëllim që ky afat të jetë sa më i shkurtër, përkatësisht të mos jetë barrierë e përhershme për shpejtësinë e qarkullimit të mallrave dhe sendeve në shoqërinë e cila bazohet mbi parimet e tregut të lirë dhe të qarkullimit të vlerave pasurore.

Në kuptim të kohëzgjatjes së të drejtës së parablerjes, LMD nuk ka bërë dallim ndërmjet të drejtës së parablerjes mbi sendet e luajtshme dhe sendet e paluajtshme. Me fjalë të tjera, rregullat e këtij neni, në mënyrë uniforme, zbatohen si për rastet e së drejtës së parablerjes mbi sendet e luajtshme, ashtu edhe mbi ato të paluajtshme. Mendohet se zgjidhja e tillë juridike është bërë me qëllim që të jetë sa më shumë në funksion të shpejtësisë së qarkullimit juridik.¹¹²

Neni 515. Nëse është bërë bartja e pasurisë pa e njoftuar shitësin

- 1. Në qoftë se shitësi e ka shitur sendin dhe pronësinë e tij e ka bartur në personin e tretë, duke mos e njoftuar përfituesin e së drejtës së parablerjes (blerësin), megjithëse i tretë e ka ditur ose është dashur ta dinte se përfituesi i së drejtës së parablerjes ka të drejtën e parablerjes, përfituesi i së drejtës së parablerjes mundet brenda gjashtë (6) muajsh, nga koha kur është njoftuar për kontratën e shitjes, të kërkojë që bartja të anulohet dhe sendi t'i cedohet këtij nën të njëjta kushte.**
- 2. Në qoftë se shitësi e ka njoftuar në mënyrë jo të saktë blerësin mbi kushtet e shitjes së bërë personit të tretë, dhe nëse i tretë e ka ditur këtë ose është dashur ta dinte, ky afat prej gjashtë (6) muajsh fillon të rrjedhë nga dita kur përfituesi i së drejtës së parablerjes ka mësuar për kushtet e vërteta të kontratës.**
- 3. E drejta e parablerjes në çdo rast shuhet pasi të kenë kaluar pesë (5) vjet nga bartja e pronësisë në personin e tretë.**

515.1. Mosnjoftimi i titullarit të së drejtës së parablerjes për shitjen e sendit mund të shkaktojë disa pasoja juridike negative për kontratën që lidh shitësi me personin e tretë. Kështu, në kuptim të paragrafit të parë të nenit 514 të LMD, nëse me gjithë ekzistimin e së drejtës së parablerjes, shitësi ia shet sendin të tretit, pa i dërguar njoftimin përkatës titullarit të së drejtës së parablerjes, ky i fundit mundet që, në afatin prej 6 muajsh (nga momenti kur ka mësuar për shitjen e sendit), të kërkojë anulimin e kontratës së shitjes, të cilën shitësi e ka lidhur më të tretin me kusht që i tretë të ketë ditur ose do të duhej të dinte se objekti i shitjes ka qenë i ngarkuar me të drejtën e parablerjes. Që titullari i së drejtës së parablerjes të kërkojë zbatimin e dispozitave të këtij paragrafi, së pari duhet të plotësohen kushtet si në vijim: që të ketë qenë e themeluar e drejta e parablerjes, që shitësi të ketë lidhur kontratë me të tretin për shitjen e sendit, që shitja e sendit të jetë ekzekutuar pa njoftimin përkatës të titullarit të së drejtës së parablerjes, që i tretë të mos ketë ditur ose të mos ketë pasur mundësi të dinte për mundësinë e ekzistimit të së drejtës parablerjes. Nëse plotësohen kushtet në fjalë, titullari i së drejtës së parablerjes mund të kërkojë anulimin e kontratës së shitjes të shitësit të lidhur me personin e tretë dhe këtë në afatin prej 6 muajsh (afat ky që llogaritet nga dita kur titullari i së drejtës së parablerjes ka mësuar për ekzekutimin e kontratës së shitjes të shitësit me të tretin). Titullari i së drejtës së parablerjes, së bashku me anulimin e kontratës së shitjes, kërkon gjithashtu që sendin e shitur ta rikthejë-ta blejë me

112 Shih në lidhje me këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1015.

kushte të njëjta të kontratës, të cilën shitësi e ka ekzekutuar me të tretin. Në kuptim të kësaj që u tha në këtë paragraf, nëse i treti nuk ka ditur dhe as që ka pasur mundësi të dinte për ekzistimin e së drejtës së parablerjes, atëherë titullari i së drejtës së parablerjes nuk mund të kërkojë anulimin e kontratës së shitësit me të tretin. Megjithatë, në një rast të tillë, titullarit të së drejtës së parablerjes i takon e drejta e shpërblimit të dëmit ndaj shitësit të sendit.¹¹³

515.2. Afati prej 6 muajsh për anulimin e kontratës, i përcaktuar në paragrafin paraprak të këtij neni, nuk do të fillojë të rrjedhë, nëse shitësi nuk e ka informuar saktësisht ose i ka siguruar informata të pasakta titullarit të së drejtës së parablerjes, me kusht që i treti të ketë ditur ose është dashur të dinte për këtë sjellje të shitësit. Në kuptim të kësaj, paragrafi i dytë i këtij neni i ofron mbrojtje juridike titullarit të së drejtës së parablerjes në kuptim të mundësimin të zgjatjes së afatit të anulimit të kontratës që shitësi ka lidhur me të tretin. Në kuptim të paragrafit në fjalë, afati për anulimin e kontratës nuk fillon të rrjedhë nga momenti kur titullari i së drejtës së parablerjes ka mësuar për lidhjen e kontratës së shitjes, por nga momenti kur ka mësuar për kushtet e vërteta të kontratës së shitjes, të cilat nuk i ka ditur më herët ose është keqinformuar për to. Megjithatë, në kuptim të këtij paragrafi, titullari i së drejtës së parablerjes gëzon mbrojtje juridike vetëm në qoftë se i treti ka ditur ose është dashur të dinte që titullari i së drejtës së parablerjes ka qenë i keqinformuar ose nuk ka qenë i informuar për kushtet e sakta të kontratës së shitjes. Siç mund të shihet, paragrafi i dytë i këtij neni i mundëson titullarit të së drejtës së parablerjes zgjatjen e afatit për mundësinë e paraqitjes së kërkesës për anulimin e kontratës, ashtu që qëllimi i këtij neni është në tërësi mbrojtja maksimale e palës së ndërgjegjshme në marrëdhëniet e detyrimeve.

515.3. Paragrafi i tretë i LMD cakton afatin absolut të shuarjes së të drejtës së titullarit të së drejtës së parablerjes që të kërkojë anulimin e kontratës. E drejta e titullarit, në këtë vështrim, shuhet në çdo rast, nëse kalon afati prej 5 vjetësh, llogaritur nga momenti kur shitësi ka lidhur kontratë me personin e tretë. Ky afat absolut rrjedh pavarësisht nëse titullari i së drejtës së parablerjes ka mësuar ose jo për kontratën e shitjes dhe pavarësisht nëse ka marrë dijeni ose jo për kushtet e vërteta të kontratës së shitjes. Në çdo rrethanë, të drejtat e titullarit, pasi të kalojë afati në fjalë, shuhet në tërësi. Në kuptim të këtij paragrafi, ligjvënësi ka parashikuar që afati prej 5 vjetësh është një afat mjaft i gjatë për t'ia bërë të mundur shitësit që të mësojë (brenda këtij afati) për shitjen e sendit, mbi të cilin ai ka të drejtën e parablerjes ose të mësojë për kushtet e vërteta të shitjes së sendit të tretit.¹¹⁴ Rrjedhimisht, pasi që afati i përcaktuar me këtë paragraf nuk varet nga rrethanat ose njohuritë personale të palëve, konsiderohet si afat objektiv për shuarjen e së drejtës së parablerjes.

Neni 516. E drejta ligjore e parablerjes

- 1. Persona të caktuar mund të kenë të drejtën e parablerjes sipas ligjit.**
- 2. Kohëzgjatja e së drejtës ligjore të parablerjes është e pa kufizuar.**

113 Bukljaas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima III*. Zagreb: 1979: fq. 1770.

114 Shih në lidhje me këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1040.

3. Rregullat e shitjes me të drejtën e parablerjes zbatohen përshtatshmërisht edhe tek e drejta ligjore e parablerjes, përveç nëse në rastet e veçanta parashikohet ndryshe.

516.1. Në teorinë e së drejtës flitet për të drejtën kontraktore dhe të drejtën ligjore të parablerjes. E drejta ligjore e parablerjes ekziston atëherë kur kjo nuk është parashikuar me kontratë, por kur për persona të caktuar kjo është parashikuar me ligj. Tek e drejta kontraktore e parablerjes thuhet se ajo është themeluar ekskluzivisht nga palët në kontratë dhe vepron inter-partes (vepron vetëm ndërmjet palëve dhe kryesisht i shërben interesit të veçantë të palëve). Për dallim nga ky shpjegim për të drejtën kontraktore të parablerjes, për të drejtën ligjore të parablerjes thuhet se ka për qëllim të mbrojë interesin e përgjithshëm shoqëror. Kështu, me të drejtën ligjore të parablerjes, ligjvënësi, duke saktësuar të drejtën e parablerjes së subjektit të caktuar, për interes të subjektit të caktuar, duke mbrojtur interesin e titullarit të së drejtës së parablerjes, mbron edhe interesin e përgjithshëm shoqëror. E drejta ligjore e parablerjes vepron erga-omnes (ndaj të gjithëve), ashtu që të gjithë duhet ta respektojnë të drejtën e titullarit të së drejtës së parablerjes.¹¹⁵ Në kuptim të së drejtës ligjore të parablerjes, ligji ua njeht disa subjekteve të së drejtës të drejtën që, në kushte të caktuara, të jenë bartës të kësaj të drejte. Kryesisht rastet e së drejtës ligjore të parablerjes janë të rregulluara me ligje të veçanta. Kështu, p.sh., e drejta e parablerjes i është njohur bashkëpronarit, (shih në lidhje me këtë nenin 52.4 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, Ligji nr. 03/L-154) ose e drejta e parablerjes që i është njohur pronarit të njësisë së pronësisë në kate (shih në lidhje me këtë nenin 52.4 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, Ligji Nr. 03/L-68), etj.¹¹⁶

516.2. Paragrafi i dytë i nenit 516 të LMD sanksionon se e drejta ligjore e parablerjes nuk është e kufizuar në kohë. Moskufizimi i realizimit të së drejtës ligjore të parablerjes përbën dallimin kryesor nga e drejta kontraktore e parablerjes. Është menduar se e drejta ligjore e parablerjes nuk kufizohet në kohë, për shkak të faktit se kjo e drejtë, edhe pse është vendosur në interesin e subjekteve të caktuara, qëllimi i këtij institucioni është kryesisht mbrojtja e interesit të përgjithshëm shoqëror.

516.3. LMD nuk i rregullon në mënyrë të hollësishme modalitetet e realizimit të së drejtës ligjore të parablerjes. Sido që të jetë, ligjet e veçanta, me të cilat themelohet e drejta e parablerjes së sendeve të caktuara, përmbajnë dispozita më të detajuara për realizimin e kësaj të drejte.¹¹⁷ Përveç dispozitave të lartpërmendura në lidhje me të drejtën ligjore të parablerjes, LMD përmban vetëm edhe një dispozitë udhëzuese, sipas së cilës dispozitat

115 Bukljaas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima III*. Zagreb: 1979: fq. 1767.

116 Shih në lidhje me të drejtën e parablerjes edhe rregullimin ligjor të saktësuar në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, Ligji Nr. 03/L-154; posaçërisht shih nenet nga 44 deri 50, pastaj nenin 52 dhe nenin 68.

117 Shih në lidhje me të drejtën e parablerjes në lëmin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore rregullimin ligjor të së drejtës së parablerjes në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, Ligji nr. 03/L-154; posaçërisht shih nenet nga 44 deri 50, pastaj nenin 52 dhe nenin 68.

që aplikohen për shitjen mbi bazë të parablerjes, në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe tek e drejta ligjore të parablerjes (paragrafi i tretë i nenit 516 të LMD), gjë që nënkupton se dispozitat e lartpërmendura të institutit të së drejtës së parablerjes zbatohen përshtatshmërisht edhe në të drejtën ligjore të parablerjes, (megjithëse, gjatë zbatimit të tyre, duhen pasur në konsideratë veçantitë e së drejtës ligjore të parablerjes).

NËNKREU 2 BLERJA ME PROVË

Neni 517. Nocioni

- 1. Kur është kontraktuar që blerësi ta merr sendin me kusht që ta provojë për të vërtetuar nëse i përgjigjet dëshirës së tij, blerësi ka për detyrë ta njoftojë shitësin brenda afatit të caktuar në kontratë ose sipas dokeve se a mbetet pranë kontratës, e në qoftë se nuk ka një të tillë, atëherë në afatin e arsyeshëm të cilin do t'ia caktonte shitësi, përndryshe konsiderohet se ka hequr dorë nga kontrata.**
- 2. Në qoftë se sendi i është dorëzuar blerësit për ta provuar deri në afatin e caktuar ndërsa ky nuk e kthen deri në skadimin e afatit ose nuk i deklaron shitësit se heq dorë nga kontrata, konsiderohet se ka mbetur pranë kontratës.**

517.1. Një formë e modalitetit të veçantë të kontratës së shitblerjes është blerja me provë. Kontrata e shitblerjes me provë (ose e blerjes me provë) është kontratë për shitblerjen e lidhur me kushtin shtyrës, ashtu që fati i kontratës dhe lidhja e saj varen nga të provuarit e sendit si objekt i kontratës, përkatësisht nëse kalimi i provës është i suksesshëm për palët kontraktuese, përkatësisht për blerësin. Qëllimi i kësaj kontrate është që blerësi të sigurohet nëse sendi, si objekt i kontratës, u përgjigjet nevojave apo dëshirës së blerësit ose të verifikojë që sendi i blerë i ka vetitë e caktuara ose nëse është ose jo i përshtatshëm për përdorim të caktuar. Me fjalë të tjera, sipas këtij modaliteti të blerjes, blerësi fiton të drejtën që së pari sendin ta përdorë-ta provojë dhe të sigurohet nëse ai i përgjigjet dëshirës së tij dhe më pas të deklarohej, (brenda afatit të caktuar) nëse sendin e blen ose refuzon ta blejë.

Neni 517 i LMD jep kuptimin e kontratës së shitblerjes me provë. Sipas paragrafit të parë të këtij neni, blerja me provë kontraktohet me qëllimin që blerësi ta marrë sendin në provë, për t'u siguruar dhe për të provuar nëse ai i përgjigjet dëshirës së tij, përkatësisht nevojave të tij, ndërsa për suksesin e provës blerësi ka detyrimin që ta njoftojë shitësin brenda afatit të caktuar për kontratën ose, kur palët nuk kanë caktuar afatin e provës, njoftimi bëhet brenda afatit të caktuar sipas dokeve ose nëse edhe sipas dokeve afati i të provuarit nuk mund të përcaktohet, atëherë ai caktohet nga shitësi (në rastin e fundit, shitësi në çdo rast mund ta njoftojë blerësin se kërkon t'i kthehet sendi dhe se mundësia e të provuarit të sendit ka përfunduar). Parimisht, kur blerësi deklaron se e ndal sendin (si objekt të provuari) konsiderohet se kontrata e blerjes në provë definitivisht është lidhur, përndryshe, kur blerësi ia kthen atë shitësit ose e njofton shitësin se prova nuk ka kaluar, konsiderohet se blerësi ka hequr dorë nga kontrata.

Nëse lexohet me kujdes paragrafi i parë i nenit 517 të LMD, ligjvënësi ka sanksionuar që “blerësi ta marrë sendin me kusht që ta provojë për të vërtetuar, **nëse i përgjigjet dëshirës së tij**”, pra nga ky tekst kuptohet se prova ose të provuarit e sendit i nënshtrohet të ashtuquajturit “test subjektiv”, që përfaqëson dëshirën e blerësit. Nëse blerësi konfirmon se sendi i përgjigjet dëshirës së tij (brenda afatit të caktuar), konsiderohet se kontrata është lidhur. Për shembull, një formë e tillë e të provuarit do të ishte ajo kur lidhet kontrata e shitjes me kusht që vera e shitur t’i pëlqejë shijes së blerësit. Në atë rast, blerësi është i obliguar ta provojë sendin dhe ta lajmërojë shitësin se a i qëndron kontratës së shitjes me provë. Ai atë duhet ta bëjë në afatin e kontraktuar ose brenda afatit që mund të nënkuptohet sipas dokeve. Në rast se afati nuk është kontraktuar dhe nuk ka as afat të përcaktuar sipas dokeve, atëherë blerësi atë duhet ta bëjë në afatin që do t’ia caktojë shitësi. Në qoftë se blerësi nuk bën njoftimin në cilindo nga afatet e lartpërmendura, konsiderohet se është tërhequr nga kontrata. Në kuptim të paragrafit të parë të nenit 517 të LMD, do të konsiderohet se blerësi është tërhequr nga kontrata vetëm kur sendi ndodhet në posedim të shitësit, përndryshe paragrafi në vijim parashikon një situatë të kundërt.¹¹⁸

517.2. Për dallim nga paragrafi i parë i nenit 517 të LMD, paragrafi i dytë i tij rregullon situatën kur sendi, si objekt i të provuarit, ka kaluar në posedimin e blerësit. Sipas këtij paragrafi, nëse blerësi nuk e informon shitësin brenda afatit të caktuar (me kontratë, sipas dokeve ose në mungesë të tyre, brenda afatit që e cakton shitësi) se heqë dorë nga kontrata ose nëse prova nuk ka kaluar me sukses, konsiderohet se blerësi i qëndron kontratës dhe e blen sendin. Me fjalë të tjera, në kuptim të paragrafit në fjalë, blerësi duhet të deklarohet para kalimit të afatit se prova nuk ka kaluar, përndryshe mosnjoftimi brenda afatit të caktuar ka për pasojë konkludimin se blerësi pranon sendin e dhënë në provë. Në kuptim të kësaj që u tha si më sipër, LMD nuk bën dallim nëse objekt të blerjes me provë janë sendet e luajtshme ose ato të paluajtshme, sepse LMD ka bërë përpjekje të ofrojë zgjidhje uniforme, mbasi ndryshimi në vlerën e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në botën bashkëkohore është shumë relativ. Megjithatë, në të drejtën e mëhershme ka ekzistuar mendimi se afati i provës për sendet e paluajtshme duhet të jetë më i gjatë.¹¹⁹

Neni 518. Prova objektive

Kur prova është kontraktuar për të vërtetuar nëse sendi ka cilësi të caktuar ose nëse është i përshtatshëm për përdorim të caktuar, mbetja në fuqi e kontratës nuk varet nga vlerësimi i blerësit, por nga fakti nëse ai ka me të vërtetë këto cilësi përkatësisht nëse është i përshtatshëm për përdorim të caktuar.

518. Që të vlerësohet nëse një send, si objekt i kontratës së shitjes, është i përshtatshëm ose jo për t’u blerë, palët mund të kontraktojnë kritere *subjektive ose objektive*. Për ndryshim

118 Shih në lidhje me këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1043. Në lidhje me blerjen me provë, shih gjithashtu: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 313 - 314.

119 Miloshevic, Ljubisa. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 1971: fq. 301 - 302.

nga neni 517 i LMD, (i cili i referohet kryesisht testit subjektiv të të provuarit të sendit që blihet), palët mund të kontraktojnë gjithashtu që blerja, përkatësisht sukcesi i lidhjes së kontratës së shitblerjes të kushtëzohet me ekzistimin e cilësive të caktuara të sendit ose që sendi t'i përgjigjet një përdorimi të caktuar. Kështu, p.sh., palët mund të kontraktojnë që blerësi të pranojë në provë sendin e blerë me qëllim që të verifikojë nëse i ka cilësitë e kontraktuara ose i përgjigjet ose jo përdorimit-destinimit të kontraktuar, (p.sh. të provuarit nëse me të vërtetë automobili i blerë i harxhon vetëm 4 litra karburant në 100 km në rrugë të hapur). Nëse ashtu është kontraktuar nga palët, kemi të bëjmë me të ashtuquajturën provë objektive, gjë që do të thotë se sukcesi i kalimit të provës, përkatësisht i lidhjes së kontratës së shitjes, nuk varet ekskluzivisht nga vullneti ose dëshira e fituesit-blerësit (i ashtuquajturi testi subjektiv), por nga përgjigja nëse sendi i dhënë në provë i ka cilësitë e kontraktuara ose i përgjigjet përdorimit të kontraktuar (i ashtuquajturi test ose provë objektive).¹²⁰

Sigurisht, që të vlerësojë nëse sendi i përgjigjet interesit ose nevojave të tij, blerësi kryesisht mbështetet në arsye subjektive. Në këtë kuptim, edhe teoria juridike, sikurse edhe legjislacionet e ndryshme, kur shtrohet çështja e blerjes me provë dhe ajo e problemit të testit të provës, si rregull, mendohet për kritere-teste subjektive që sendi duhet t'i kalojë ose t'i plotësojë (të cilat varen nga vullneti ose dëshira e blerësit), me qëllim që prova të jetë e suksesshme. Për dallim nga kjo qasje teorike dhe ligjore, disa legjislacione të tjera ofrojnë aso zgjidhje juridike të cilat, krahas testit subjektiv, rregullojnë edhe mundësinë e zbatimit të kritereve objektive për vlerësimin e kalimit të testit ose provës. Ky është rasti kur në kontratën e shitjes është kontraktuar që sendi që dorëzohet në provë t'i ketë cilësitë e caktuara ose t'i përgjigjet destinimit të caktuar. Kjo është zgjidhja juridike e adaptuar edhe nga neni 518 i LMD, ashtu që, në kuptim të këtij neni, pavarësisht dëshirës së blerësit, do të konsiderohej se prova është tejkaluar me sukses dhe se kontrata është lidhur, nëse objektivisht provohet se sendi i ka cilësitë e kontraktuara ndërmjet palëve ose nëse sendi i përgjigjet destinimit për të cilin blerësi ka deklaruar se ka për qëllim që ta përdorë atë. Në teorinë juridike mendohet se testi objektiv ose prova objektive ofron më shumë siguri në përsheptimin e qarkullimit juridik, pasi që, nëse është kontraktuar ashtu, sukcesi i lidhjes së kontratës nuk varet ekskluzivisht nga diskrecioni "arbitrar" i blerësit që të deklarojë nëse prova është e suksesshme, por kryesisht do të varej nga kriteret me të cilat mund të vlerësohet objektivisht nëse sendi që është dorëzuar në provë i ka cilësitë e duhura.¹²¹

120 Në lidhje me testin objektiv të vlerësimit të blerjes me provë, shih me shumë në lidhje me këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1045.

121 Numri i legjislacioneve që ofrojnë dhe rregullojnë të ashtuquajturën "provë objektive" është më i pakët. Megjithatë, shumë autorë mendojnë se një zgjidhje e tillë juridike i përgjigjet përsheptimit të qarkullimit juridik, i cila është edhe synim i ligjeve ose të drejtave bashkëkohore. Sa për krahasim, një zgjidhje të ngjashme juridike na ofron edhe Kodi Civil Italian në nenin 1521. Për më shumë në lidhje me këtë, shih Kodin Civil Italian të qasshëm në: <italian-laeyers.com/en/link.html>, dt. 12.08.2013.

Neni 519. Rreziku

Rrezikun e shkatërrimit ose të dëmtimit të rastësishëm të sendit që i është dorëzuar blerësit për provë e bartë shitësi derisa blerësi të deklarojë se mbetet pranë kontratës, përkatësisht deri në skadimin e afatit kur blerësi ka qenë i detyruar t'i kthejë sendin shitësit.

519. Të blerja me provë, pasi që posedimi i sendit kalon të blerësi para se kontrata të konsiderohet e lidhur, (para se të tregohet nëse prova është e suksesshme - përkatësisht, para se të bartet pronësia), rëndom shtrohet pyetja se kush e bart rrezikun për shkatërrimin ose dëmtimin e rastësishëm të sendit - shitësi apo blerësi? Përgjigja ndaj pyetjes së shtruar rëndom buron nga koncepti i përgjithshëm juridik për përgjegjësinë për dëmtimin dhe zhdukjen e rastësishme të sendit, gjë që nënkupton barrën që bart pronari i sendit. Sipas kuptimit të nenit 519 të LMD, te shitja me provë, përderisa nuk tregohet prova e suksesshme, përkatësisht përderisa blerësi nuk deklarohet se e mban sendin ose përderisa nuk kalon afati i provës, konsiderohet se akoma nuk është lidhur kontrata e shitblerjes (përkatësisht konsiderohet se ajo është lidhur me kushtin shtyrës dhe, po u plotësua kushti, kontrata konsiderohet e lidhur që nga fillimi). Rrjedhimisht, në kuptim të kësaj, shitësi, “si pronar i sendit”, do të vazhdojë ta bartë rrezikun e shkatërrimit ose të dëmtimit të rastësishëm të sendit, përderisa blerësi të deklarohet se i qëndron kontratës ose përderisa të kalojë afati i “provës”. Kjo nënkupton atë se, gjatë kohës së provës, blerësi gëzon të gjitha të drejtat e kreditorit, (përderisa të realizohet kushti), ndërsa shitësi është i detyruar ta ketë në ngarkim rrezikun dhe dëmet e rastësishme eventuale, që mund t'i shkaktohen sendit; kjo gjithashtu do të thotë se, në rastet e tilla, kur zhdukja ose dëmtimi i sendit është aksidental - i rastësishëm, shitësi nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit. Ndërkaq, nga momenti kur blerësi deklaron se prova është e suksesshme dhe mban sendin ose kur nuk e kthen sendin brenda afatit të provës, konsiderohet se rrezikun për zhdukjen-dëmtimin e rastësishëm të sendit e bart blerësi, sepse, në cilëndo situatë të fundit, konsiderohet se blerësi e ka pranuar sendin në bazë të kontratës së shitjes, ashtu që në ngarkim të tij ka kaluar edhe rreziku për zhdukjen ose dëmtimin e rastësishëm të sendit, (përkatësisht blerësi ka fituar edhe pronësinë mbi sendin).¹²²

Dispozita e nenit në fjalë nuk përmban ndonjë rregull ose përgjigje të pyetjes se çfarë nënkuptohet me “shkatërrim ose dëmtim të rastësishëm të sendit” te kontrata e blerjes me provë, ashtu që lidhur me të duhet të zbatohen standardet e rëndomta të themeluara nga LMD, si dhe praktika juridike që ka të bëjë me shkatërrimin ose dëmtimin e rastësishëm të sendit, në përgjithësi.¹²³

122 Shih në lidhje me këtë: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 313.

123 Gjithashtu shih: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë: 1988: fq. 76.

Neni 520. Blerja pas kontrollimit përkatësisht me rezervimin e të provuarit

Dispozitat për blerjen me provë zbatohen përshtatshëmrisht edhe për blerjen pas kontrollimit dhe ndaj blerjes me rezervimin e së drejtës së të provuarit.

520. Një formë shume e ngjashme me kontratën e blerjes me provë është edhe kontrata “për blerjen pas kontrollimit” dhe kontrata “me rezervimin e së drejtës së të provuarit”. Ashtu si u pasqyrua më lart, te kontrata e blerjes me provë, ajo lidhet me kushtin shtyrës, çka do të thotë se kontrata, edhe pse është lidhur, nuk prodhon efekte juridike, përderisa prova të dalë me sukses, ose përderisa të mos kalojë afati për kthimin e sendit të dhënë për provë. Për dallim nga blerja me provë, te kontrata “për blerjen pas kontrollimit” dhe te kontrata “me rezervimin e së drejtës së të provuarit” konsiderohet se kontrata e shitjes, në realitet, as që është lidhur, përderisa sendi përkatës nuk kontrollohet ose provohet. Pra, te këto modalitete të shitblerjeve “kontrollimi” respektivisht “prova” është element esencial i lidhjes së kontratës së shitjes, kurse te blerja me provë “të provuarit e objektit të shitjes” është vetëm kusht për shkëputjen e kontratës së shitjes. Rrjedhimisht, në rastin e kontratave në fjalë, përderisa nuk është bërë “kontrollimi” respektivisht “prova” e objektit të kontratës, as që konsiderohet se është lidhur kontrata e shitjes, ndërsa te blerja me provë, mospërmbushja e provës çon në shkëputjen e kontratës së lidhur të blerjes me provë.¹²⁴

Përkundër dallimeve të shtjelluara më lart, kontrata për blerjen me provë dhe kontrata “për blerjen pas kontrollimit”, si dhe kontrata “me rezervimin e së drejtës së të provuarit” kanë shumë ngjashmëri, prandaj në kuptim të këtyre ngjashmërive, neni 520 i LMD, ka sanksionuar se dispozitat e LMD që vlejnjë për blerjen me provë, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për kontratën për “blerjen pas kontrollimit” dhe kontratën “me rezervimin e së drejtës së të provuarit”.

NËNKREU 3

SHITJA SIPAS MOSTRËS OSE MODELIT

Neni 521. Shitja sipas mostrës ose modelit

- 1. Në rastin e shitjes sipas mostrës ose modelit, te kontratat ndërmjet ndërmarrësve në qoftë se sendi të cilin shitësi ia ka dorëzuar blerësit nuk është i njëjtë si mostra ose modeli, shitësi përgjigjet sipas dispozitave për përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit, ndërsa në raste të tjera shitësi përgjigjet sipas dispozitave për përgjegjësinë për mos përmbushjen e detyrimit.**

.....
124 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1368 - 1369.

2. Shitësi nuk përgjigjet për të metat e njëjtësisë në qoftë se mostrën, përkatësisht modelin ia ka paraqitur blerësit vetëm për qëllim njoftimi dhe caktim të përafërt të karakteristikave të sendit pa premtim të njëjtësisë.

521.1. Një formë e veçantë e kontratës së shitjes është shitja sipas “modelit” ose “mostrës”. Kjo është kontratë e shitjes tek e cila sendi i shitur duhet t’i ketë ato veti që i ka mostra ose modeli, me ndihmën e të cilave ato janë përcaktuar, veti këto të modelit, respektivisht mostrës, që janë identifikuar që më parë ose më së voni në momentin e lidhjes së kontratës. Te kjo kontratë shitësi ka pranuar detyrimin që sendin ose mallin t’ia dorëzojë blerësit në përputhje me karakteristikat, cilësitë ose dukjen e mostrës ose modelit, që i është treguar paraprakisht blerësit për informim.¹²⁵ Mostra rëndom paraqet pjesë cilësore ose elemente të sendit që është i përcaktuar sipas llojit dhe që i përmban të gjitha elementet kualitative të atij sendi (p.sh., 1 kg oriz, me veti të një kualiteti të caktuar nga palët, ashtu që e tërë shumta e kontraktuar e orizit duhet t’i ketë ato veti të cilësisë). Ndërkaq, modeli paraqet një send, pamjen dhe vetitë e të cilit duhet t’i ketë sendi i shitur - i kontraktuar që duhet t’i dorëzohet blerësit, si tregtar (p.sh., një palë këpucë vetitë e të cilave duhet t’i kenë 1.000 palë këpucë, si sende të shitura).¹²⁶

Nëse në kontratën e shitjes palët shprehimisht kanë kontraktuar se sendi do t’i ketë vetitë, cilësitë ose pamjen e modelit-mostrës, atëherë një dispozitë e tillë kontraktuese për përputhjen e sendit-mallit të shitur me mostrën ose modelin, janë elemente esenciale të kontratës së shitjes, të lidhur konform vullnetit të palëve, nga e cila dalin detyrime për shitësin dhe për këtë arsye edhe përgjegjësi në rast të cenimit të kontratës. Në kuptim të kësaj, LMD, në paragrafin e parë të nenit 521, ka vendosur disa parime bazë për rregullimin e kontratës së shitjes sipas modelit - mostrës. Te shitja sipas modelit ose mostrës, sendi-malli që shitet duhet t’i përgjigjet plotësisht modelit ose mostrës, që është kontraktuar paraprakisht ndërmjet palëve. Nëse sendi-malli i dorëzuar nuk i përgjigjet modelit-mostrës së kontraktuar, atëherë atë send blerësi, në momentin e pranim-dorëzimit, mund ta refuzojë.¹²⁷ Kështu, nëse është fjala për kontrata që lidhen ndërmjet ndërmarrësve (kontratat në ekonomi), mungesa e përputhjes së sendit-mallit me modelin-mostrën ka për pasojë përgjegjësinë e shitësit si në rastin e përgjegjësisë për mungesat materiale të sendeve. Me fjalë tjera, shitësi përgjigjet sipas dispozitave për përgjegjësinë e shitësit për mungesat materiale të sendit, përkatësisht konsiderohet se sendi që nuk i përgjigjet modelit-mostrës së kontraktuar, në kuptim të kontratës së kontraktuar, konsiderohet si send me mungesa materiale, ashtu që shitësi përgjigjet mbi këtë bazë.¹²⁸ Për dallim nga kjo, në raportet kontraktuese civile (jashtë fushës së ndërmarrësisë - ekonomisë), mospërputhja e sendit-mallit me modelin-mostrën e kontraktuar ka për pasojë përgjegjësinë e shitësit, sipas

125 Shih për këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1047.

126 Shih në lidhje me këtë: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 310 - 311.

127 Shih për këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1048.

128 Në lidhje me kuptimin për të metat materiale të sendit dhe përgjegjësinë për mungesat materiale të sendeve, shih komentimin e nenit 103 të LMD si dhe komentimin e neneve të LMD nga neni 461 deri në nenin 483.

rregullave të përgjegjësisë për mospërbushje të kontratës ose përbushje të padrejtë (përbushje të parregullt) të kontratës.¹²⁹

521.2. Më tej, sipas LMD, nuk do të konsiderohet se është lidhur kontrata e shitjes sipas modelit-mostrës, nëse paraqitja-njohja e modelit-mostrës i është bërë blerësit vetëm sa për ta njohur nga afër me sendin-mallin, pa përfshirë premtimin e konformitetit nga shitësi në këtë rast. Kështu, sipas paragrafit të dytë të nenit 521 të LMD, shitësi nuk do të përgjigjet për mungesën e përputhjes së sendit-mallit të dorëzuar me modelin-mostrën, nëse modeli, respektivisht mostra i është treguar blerësit vetëm për hir të informimit ose për t'i parë nga afër vetitë e sendit pa premtimin e konformitetit të sendi-malli të dorëzuar me vetitë, cilësitë, ose dukjen e modelit, respektivisht mostrës. Në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 521 të LMD, konsiderohet se është e lejueshme mundësia që një model-mostër t'i tregohet blerësit vetëm sa për ta parë nga afër sendin-mallin që do t'i dorëzohet, duke përjashtuar konformitetin e plotë të mallit që do të dorëzohet, me modelin-mostrën. Në rastin nga ky paragraf, konsiderohet se modeli-mostra e treguar nuk përbëjnë element esencial të kontratës, prandaj edhe nuk sjellin përgjegjësi për shitësin.¹³⁰

NËNKREU 4 SHITJA ME SPECIFIKIM

Neni 522. Shitja me specifikim

- 1. Në qoftë se me kontratë është rezervuar e drejta për blerësin që të caktojë më vonë formën, masën ose ndonjë karakteristikë tjetër të sendit, ndërsa blerësi nuk e kryen këtë specifikim deri në datën e kontraktuar, ose derisa të kalojë një afat i arsyeshëm, duke llogaritur nga kërkesa e shitësit për ta bërë këtë, shitësi mund të deklarojë se e zgjidhë kontratën ose të bëjë specifikimin sipas asaj që është në dijeni për nevojat e blerësit.**
- 2. Në qoftë se vet shitësi kryen specifikimin, ai ka për detyrë ta njoftojë blerësin mbi hollësitë e tij dhe t'ia caktojë një afat të arsyeshëm që të bëjë një specifikim tjetër.**
- 3. Në qoftë se blerësi nuk e shfrytëzon këtë mundësi, mbetet i detyruar specifikimi të cilin e ka bërë shitësi.**

522.1. Neni 522 i LMD përmban dispozita për rregullimin e kontratës së shitjes sipas specifikimit. Kontrata e shitjes sipas specifikimit është një kontratë e tillë e shitjes, sipas së cilës, së pari lidhet kontrata e shitjes, kurse për blerësin është rezervuar për me vonë e drejta që ai ta përcaktojë formën, masën, asortimentin ose detajet e tjera të sendit të shitur.

129 Në lidhje me mospërbushjen e kontratës, shih komentimin e neneve të LMD, duke filluar nga neni 106 - 115.

130 Shih në lidhje me këtë: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 311.

Me këtë lloj të kontratës së shitjes palët kontraktuese, në momentin e lidhjes së kontratës, caktojnë llojin dhe sasinë e sendit, duke kontraktuar që vetitë, cilësia, dimensionin, ngjyra, forma e sendeve-mallit të caktohen për më vonë, në bazë të një njoftimi-specifikimi që blerësi ia paraqet shitësit.¹³¹ Do të kishim të bënim me një rast të tillë kur, p.sh., janë shitur dhjetë printerë për nevojat e një zyre, por blerësi më pas duhet t'i përcaktojë karakteristikat, cilësinë, formatin, llojin, eventualisht ngjyrën ose përmasat e tjera të rëndësishme të tyre për realizimin e qëllimit kontraktues të blerësit.

Sipas paragrafit të parë të nenit 522 të LMD, nëse e drejta e dhënies së specifikimit është kontraktuar në dobi të blerësit, ashtu që blerësi të japë specifikimin për saktësimin e mallit për më vonë dhe ky bëhet brenda afatit të caktuar, në atë rast blerësi është i obliguar që specifikimet e vetive të kontraktuara të sendit të shitur - të blerë t'i bëjë deri në datën e caktuar, (kjo për rastin kur afati i dorëzimit të specifikimit është saktësuar). Për rastin kur afati i dorëzimit të specifikimit nga blerësi nuk është kontraktuar, shitësi në çdo kohë mund ta ftojë blerësin që ai, brenda një afati të arsyeshëm, ta dorëzojë specifikimin. Në rastin e fundit, blerësi është i obliguar që njoftimin e specifikimit t'ia dorëzojë shitësit brenda një afati të arsyeshëm, i cili fillon të rrjedhë prej momentit kur shitësi ka kërkuar të përcaktohet specifikimi. Si në rastin e parë, kur specifikimi nuk dorëzohet nga blerësi brenda afatit të kontraktuar, ashtu edhe në rastin e dytë, kur specifikimi nuk dorëzohet nga blerësi brenda afatit të arsyeshëm, (pasi blerësi ta ketë marrë kërkesën nga shitësi për dorëzimin e specifikimit), shitësi mund të deklarojë se e zgjidh kontratën ose që specifikimin e mallit shitësi ta bëjë vetë në bazë të informatave që ai i posedon në lidhje me kënaqjen e nevojave të blerësit. Mendohet që ligjvënësi e ka lënë këtë zgjedhje për shitësin, pasi që njoftimi i specifikimit për të e kushtëzon përmbushjen e detyrimeve të shitësit, (pasi që ai, pa njoftimin e specifikimit, nuk mund të ketë dijeni për specifikat që duhet t'i ketë sendi që duhet t'i dërgohet blerësit).¹³² Sigurisht, derisa shitësit nuk i dërgohet specifikimi, ky nuk mund të përmbushë detyrimet e veta të përcaktuara në kontratë. Sipas kuptimit të këtij paragrafi, konsiderohet se blerësi bie në vonesë, nëse brenda afatit të kontraktuar ose brenda një afati të arsyeshëm nuk ia dorëzon specifikimin shitësit. Rrjedhimisht, me qëllim të mbrojtjes së shitësit nga blerësi i pandërgjegjshëm, LMD ka lejuar mundësinë që shitësi të zgjedhë ndërmjet zgjidhjes së kontratës dhe bërjes vetë të specifikimit.¹³³

522.2. LMD, në paragrafin e shtjelluar më lart, ka lejuar mundësinë që, në mungesë të veprimit të blerësi, specifikimin mund ta bëjë edhe shitësi, duke i respektuar nevojat dhe qëllimin e blerësit për specifikimin e mallit (në bazë të informatave që ai posedon). Po që se bëhet fjalë për një rast të tillë dhe shitësi zgjedh që ta bëjë vetë specifikimin, atëherë ai është i obliguar ta lajmërojë blerësin për detajet e specifikimit të bërë prej tij dhe njëherësh t'ia caktojë atij edhe një afat shtesë të arsyeshëm, brenda të cilit do të mund ta plotësonte specifikimin e bërë nga shitësi ose do të mund ta bënte një specifikim krejtësisht tjetër.

131 Bukljaas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II I*. Zagreb: 1979: fq. 1777.

132 Shih për këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1050.

133 Shih për këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1050 - 1051.

522.3. Në kuptim të paragrafit tre të nenit 552 të LMD, nëse blerësi nuk përdor mundësinë që edhe brenda një afati të arsyeshëm (pas bërjes së specifikimit nga shitësi dhe njoftimin e blerësit për të) të veprojë, domethënë ta bëjë specifikimin, LMD, me qëllim të mbrojtjes së shitësit të ndërgjegjshëm, përcakton që specifikimi i bërë nga shitësi është definitiv dhe e detyron blerësin. Në atë rast shitësi do t'ia dërgojë sendin blerësit, sipas specifikimit që e ka bërë vetë ai.

Në vështrim të sa u tha më sipër, ekziston një mendim i gjerë në teorinë juridike se, megjithatë, shitësi nuk do të duhej ta bënte specifikimin për blerësin, nëse ai është në dijeni se specifikimi i bërë prej tij nuk do t'u përgjigjej nevojave të blerësit.¹³⁴

NËNKREU 5 SHITJA ME KUSHTE

Neni 523. Kushtet

- 1. Shitësi i një sendi të caktuar të luajtshtëm mundet që nëpërmjet një dispozite të veçantë në kontratë të ruaj të drejtën e pronësinë mbi sendin që i është dhënë blerësit derisa blerësi të paguaj çmimin e shitjes.**
- 2. Ruajtja e së drejtës së pronësisë ka efekt për kreditorin e blerësit vetëm nëse nënshkrimi mbi kontratën që përmban dispozitën e ruajtjes së të drejtës së pronësisë është noterizuar para falementimit të blerësit apo bashkëngjitjes së pronës së luajtshme.**
- 3. Tek sendet të cilat mbahen regjistra të posaçëm publik, pronësia mund të rezervohet vetëm nëse një gjë e tillë është përcaktuar me dispozitat mbi organizimin dhe administrimin e regjistrave të tillë.**

523.1. Një formë e veçantë e kontratës së shitjes është shitja me të drejtën e mbajtjes së të drejtës së disponimit, respektivisht të drejtës së pronësisë. Kjo formë e kontratës së shitjes mund të lidhet vetëm për sendet e luajtshme. LMD (neni 523.1) rregullon mundësinë që palët kontraktuese, në lidhje me shitjen e sendit të luajtshtëm, ta parashikojnë me dispozitë të veçantë në kontratën e shitjes mbajtjen nga shitësi të së drejtës së pronësisë edhe pas dorëzimit të sendit te blerësi, derisa ky i fundit ta paguajë çmimin në tërësi. Kjo formë e kontratës së shitjes është mjaftë praktike për sigurimin e interesit të shitësit, sidomos në rastet kur çmimi i shitjes nuk paguhet në momentin e lidhjes së kontratës, përkatësisht në momentin që sendi i dorëzohet blerësit.¹³⁵ Një shitje e tillë, me të drejtën e ruajtjes së pronësisë, i mundëson shitësit ta ruajë pronësinë (duke

¹³⁴ Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1372 - 1375.

¹³⁵ Shih mbi këtë: *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1053.

përfshirë të gjitha tagrat e së drejtës së pronësisë), përderisa blerësi të mos e paguajë në tërësi çmimin. Kjo i shërben sigurimit të interesave të shitësit, i cili, nëse blerësi lë pa përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës (të paguajë çmimin), shitësi, si pronari i sendit, mund të kërkojë kthimin e tij në pronësi. Kështu, kjo formë e kontratës, përveç që iu mundëson palëve të bartin vlera pasurore ndërmjet tyre, ajo shërben edhe si një lloj sigurimi për shitësin se blerësi do ta përmbushë vërtet detyrimin e tij. Në këtë mënyrë, shitësi e siguron të drejtën e vet për ta marrë çmimin nga blerësi, në vend që atë ta bëjë me ndonjë mjet tjetër për sigurimin e kontratës. Blerësi, i cili e ka pranuar sendin në posedim sipas kësaj kontrate, e ka vetëm të drejtën që e ka çdo posedues i ligjshëm i sendit, (të drejtën që të shfrytëzojë dhe të mbledhë fryte nga sendi). Një blerës i tillë nuk ka të drejtë që këtë send t'ua vërë në dispozicion personave të tretë, përkatësisht ta ngarkojë atë, përderisa ta plotësoj kushtin e pagesës së çmimit, si tërësi. Që kjo kontratë të quhet e lidhur, palët duhet shprehimisht ta kontraktojnë kushtin e ruajtjes së të drejtës së pronësisë nga shitësi. Kontraktimi i këtij kushti zakonisht mund të inkorporohet në vetë kontratën e shitjes ose mund të kontraktohet edhe si një kontratë e veçantë.

Sipas kontratës së shitjes më të drejtën e mbajtjes së pronësisë, shitësi lejon kalimin e pronësisë vetëm pasi ta inkasojë në tërësi çmimin e shitjes. Në rastin kur blerësi lë pa paguar çmimin në tërësi, shitësi mund ta kërkojë pagesën e çmimit nga blerësi ose të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve nga blerësi.¹³⁶ Shitësi gjithashtu mund të kërkojë pagesën e çmimit edhe në rastin kur sendi që i është dorëzuar blerësit është zhdukur ose është dëmtuar, (blerësi bart rrezikun e dëmtimit - zhdukjes së rastësishme të sendit, shih komentimin e nenit në vijim).

523.2. Kontrata e shitjes me të drejtën e ruajtjes së të drejtës së pronësisë kryesisht ka efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese. Megjithatë, LMD (neni 523.2) parashikon mundësinë që kjo kontratë të ketë efekt juridik edhe ndaj kreditorëve të blerësit. Që kontrata e shitjes me të drejtën e mbajtjes së të drejtës së pronësisë të ketë efekt juridik ndaj të tretit, përkatësisht kreditorëve të blerësit, LMD kërkon që ajo të jetë e noterizuar, përkatësisht që vullneti i palëve për lidhjen e saj të jetë vërtetuar para noterit, kurse noterizimi të jetë bërë para se të jetë hapur procedura e falimentimit ndaj debitorit, përkatësisht para se sendi i luajtshëm të jetë “bashkëngjitur” (regjistruar) në procedurën e ekzekutimit me dhunë.¹³⁷

523.3. LMD i bën një kufizim mundësisë së kontraktimit të shitjes me të drejtën e mbajtjes së pronësisë në shitësin. Ky është rasti për objektet e shitjes (sendet) për të cilat mbahen regjistra të veçantë publikë. Në këtë vështrim, në qoftë se objektet e kontratës së shitjes me të drejtën e mbajtjes së të drejtës së pronësisë janë sendet e luajtshme, për të cilat mbahen libra të veçanta publike, atëherë ajo e drejtë mund të mbahet vetëm kur është e parashikuar dhe rregulluar në administrimin e librave të tilla publike (neni 523.3 I LMD).

136 Shih për këtë: *Komentari Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1055.

137 Shih për këtë: *Komentari Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1055.

Neni 524. Rreziku

Rreziku për shkatërrimin apo dëmtimin e rastësishëm të sendit merret përsipër nga ana e blerësit prej momentit të dorëzimit të sendit.

524. LMD, te kontrata e shitjes me të drejtën e mbajtjes së të drejtës së pronësisë, i bën një përjashtim rregullës, sipas së cilës, “rrezikun e mbajtjes së sendit e bart pronari i sendit - res perit domino”. Sipas nenit 524 të LMD, rrezikun për zhdukjen e rastësishme të sendit, përkatësisht dëmtimin e rastësishëm të sendit, si objekt i kontratës së shitjes, nuk e bart shitësi (si mbajtës i së drejtës së pronësisë mbi sendin), por në momentin kur objekti i shitjes kalon në posedimin e blerësit, edhe rreziku në lidhje me zhdukjen ose dëmtimin e rastësishëm të sendit kalon mbi blerësin. Shumë autorë e arsyetojnë këtë rregull, duke argumentuar se, pasi që sendin në një rast të tillë e mbanë blerësi, i cili e ka blerë me qëllim të fitimit të pronësisë mbi të, ai e mban atë si të vetin, nxjerr në mënyrë të pavarur fitime nga gëzimi dhe shfrytëzimi i tij, prandaj, sipas këtij koncepti, me qëllim të mbrojtjes së shitësit, rregullat e drejtshmerisë kërkojnë që blerësi ta bartë rrezikun mbi sendin.¹³⁸

NËNKREU 6 SHITJA ME KËSTE

Neni 525. Përkufizimi

Me anë të kontratës së shitjes me këste, shitësi obligohet t’ia dorëzojë blerësit një send të posaçëm të luajtshëm para se çmimi i blerjes të paguhet në tërësi, dhe blerësi obligohet të paguaj me këste në periudha të caktuara kohore.

525. Kontrata e shitjes me këste është një kontratë e veçantë e shitjes, të cilën e kanë njohur edhe të drejtat e vjetra. Megjithatë, në të drejtën bashkëkohore, duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit të industrisë bankare, posaçërisht të zhvillimit të kredi-konsumit, shitblerjet me pagesën e çmimit në këste po zënë një vend mjaft të gjerë në ekonominë e çdo vendi. Kontrata e shitjes me pagimin e çmimit me këste është një kontratë e tillë me të cilën shitësi obligohet t’i dorëzojë blerësit një send të caktuar të luajtshëm, para se t’i paguhet çmimi në tërësi, ndërsa blerësi obligohet që shitësit t’ia paguajë çmimin në këste, pra në intervale kohore të caktuara paraprakisht ndërmjet palëve, (gjë që natyrshëm rrjedh nga kuptimi i nenit 525 të LMD). Më tej mund të thuhet se kjo kontratë i mundëson blerësit që çmimin e shitjes, (si kundërvlerë për fitimin e sendit) të mos e paguajë në momentin kur e pranon atë, por pjesë- pjesë, sipas planit të pagesës së aprovuar ndërmjet palëve.

138 Sa për krahasim, një zgjidhje të ngjashme juridike na e ofron edhe Kodi Civil Italian në nenin 1523. Për më shumë në lidhje me këtë shih Kodin Civil Italian të qasshëm në: <italian-laeyers.com/en/link.html>, dt. 27.08.2013.

Fusha e rregullimit të kontratës së shitjes me këste në të drejtën krahasuese është rregulluar në mënyra të ndryshme, duke pasur në konsideratë kompleksitetin e industrisë së kreditimit dhe shitjes. Kështu, disa të drejta lidhur me rregullat e kontratës së shitjes me këste i kanë përfshirë në ligjet themelore të tyre, si, p.sh., rasti i Kodit Civil Italian ose rasti i Kodit Zviceran të Detyrimeve.¹³⁹ Megjithatë, ekzistojnë edhe sisteme të tjera juridike që këtë fushë e sanksionojnë me ligje të veçanta, të cilat rregullojnë fushën e kreditimit dhe të shitjeve me kredi, duke mos e quajtur me një emër të veçantë kontratën e shitjes me këste. Megjithatë, përgjithësisht, ashtu siç është rregulluar kontrata e shitjes me këste në LMD në vendin tonë, po ashtu edhe në ligjet e reja për detyrimet të ish-republikave jugosllave, pothuajse është adaptuar koncepti bazë i ish- LMD i vitit 1978, pra mendohet se kontrata e shitjes me këste është një kontratë që është konceptuar të mbrojë interesin e blerësit (si konsumator), por duke e siguruar edhe interesin e shitësit.¹⁴⁰

Në vështrim të përshkrimit të kuptimit të kontratës së shitjes me këste, ashtu siç është përcaktuar në nenin 525 të LMD, kur flitet për këtë kontratë duhet të shtjellohen disa elemente të saj, para së gjithash ai se çfarë mund të jetë objekt i kësaj kontrate, pastaj cili është momenti i dorëzimit të objektit të kësaj kontrate, si dhe, së fundi, ajo që e përcakton çështjen e vetive të subjekteve - palëve të kësaj forme të kontratës së shitjes.

Objekti i kontratës së shitjes me këste.- Në lidhje me atë se ç' mund të jetë objekt i kontratës së shitjes me këste, LMD ka siguruar një përgjigje të qartë, duke përcaktuar që objekt i shitjes me këste mund të jenë vetëm sendet e luajtshme. Ligjvënësi dhe autorët e LMD kanë pasur për qëllim që në dispozitat rreth kësaj kontrate të përjashtohen paluajtshmëritë, pasi që për to, (duke pasur parasysh rëndësinë dhe specifikat e paluajtshmërisë), vlen një regjim i ndryshëm juridik që mund të sanksionohet me dispozita jashtë rregullave të LMD. Përpos këtij përjashtimi, LMD nuk vendos përjashtime të tjera në kuptim të asaj se çfarë mund të jetë objekt i kontratës së shitjes me këste.

Detyrimi i dorëzimit të objektit të kontratës dhe i pagesës së çmimit.- Në teorinë juridike në lidhje me dorëzimin e objektit të kontratës së shitjes me këste ekzistojnë dy teori. Sipas teorisë së parë, e cila duket të jetë e tejkualuar, (pasi që nuk i përgjigjet qëllimit të kontratës së shitjes me këste), momenti i dorëzimit të sendit është momenti i pagesës së çmimit në tërësi (momenti i pagesës së këstit të fundit). Ndërkaq, sipas teorisë së dytë, që duket se shprehimisht është pranuar nga LMD dhe është inkorporuar në tekstin e nenit 525 të LMD, rëndom, sendi i dorëzohet blerësit para pagesës së çmimit në tërësi. Sigurisht, zgjidhja juridike që ofron teoria e dytë, duket se është në pajtim edhe me qëllimin e kësaj kontrate, e cila, ndër të tjera, synon t'i shërbejë më mirë përshpejtimin të qarkullimit juridik të mallrave dhe tregtisë, ashtu që prodhuesit dhe tregtarit u mundësohet të shesin mallra përpara se blerësi ta ketë poseduar – ta ketë paguar çmimin e plotë, pra ai, në njëfarë forme, kreditohet dhe paguan çmimin e shitjes pjesë-pjesë.

139 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1385 - 1387.

140 Shih mbi këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1057.

Sipas mendimit që mbizotëron në teorinë juridike, dorëzimi i sendit të blerësi, para se ky ta ketë paguar çmimin në tërësi, nuk nënkupton që atij po i kalohet edhe pronësia mbi sendin. Përkatësisht, dominon mendimi se shitësi, të shitja me këste, ruan të drejtën e pronësisë mbi sendet-objektin e kontratës, përderisa blerësi ta paguajë edhe këstin e fundit të çmimit të shitjes. Kjo nënkupton edhe atë që, nëse çmimi i shitjes nuk i paguhet në tërësi shitësit nga blerësi, shitësi, si pronari i sendit të dorëzuar, përmes padisë pronësore kërkon kthimin e sendit të tij në pronësi, çka do të thotë se për shitësin e drejta që të kërkojë kthimin e sendit në pronësi, paraqet një bazë më të fortë juridike për mundësinë e riposedimit të sendit.¹⁴¹

Kush mund të jenë subjektet e kontratës së shitjes me këste.- Në lidhje me atë se çfarë atributesh duhet të posedojë blerësi në kontratën e shitjes me këste, ekziston një mendim i vjetër se blerës mund të jetë vetëm individ, që nënkupton personin fizik. Bazuar në këtë koncept, është menduar se qëllimi i shitjes me këste është konsumi dhe financimi i konsumit, prandaj, në rastet më të shpeshta, në cilësinë e konsumatorit është individ, prandaj edhe është menduar se vetëm individ mund të ketë pozitën e blerësit të kontratës së shitjes me këste. Ky mendim, që u potencua më lart, kryesisht bazohet në zgjidhjen juridike të ish-Ligjit jugosllav për Marrëdhëniet e Detyrimeve (i vitit 1978), i cili në paragrafin e dytë të nenit 542 të tij e përcaktonte shprehimisht dispozitën si në vijim: *“dispozitat e këtij seksioni për shitjen me pagimin e çmimit në këste zbatohen vetëm në qoftë se blerësi është person fizik”*. Përkundër këtij rregullimi ligjor të vjetër, i cili ishte në fuqi në Republikën e Kosovës deri në fund të dhjetorit 2012, LMD aktual nuk përmban një dispozitë apo kufizim të tillë në përcaktimin etributeve të veçanta të cilësive, të cilat duhet t’i plotësojë cilado palë ose blerësi. Me fjalë të tjera, LMD është e heshtur në këtë aspekt, nëse blerësi në kontratën e shitjes së sendit me këste duhet të jetë individ - person fizik, përkatësisht nuk bën asnjë dallim ndërmjettributeve të cilat eventualisht mund t’i posedojë cilado palë e kontratës së shitjes me këste, ashtu që mund të përfundohet se në cilësinë e blerësit mund të jetë edhe një entitet tjetër ligjor, përkatësisht edhe personi juridik.

Duke pasur parasysh se kontrata e shitjes me këste, në rastet më të shpeshta, supozon që në cilësinë e blerësit merr pjesë konsumatori, subjekt i rregullimit të marrëdhënies së tillë kontraktuese mund të jenë edhe dispozitat ligjore që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në marrëdhëniet kontraktuese, (rregullat e këtyre ligje kryesisht kanë karakter detyrues).¹⁴² Në këtë kontekst, edhe LMD në nenin 12 ka bërë dallimin ndërmjet kontratave komerciale dhe kontratave jokomerciale, (për më shumë shpjegime, shih komentimin e nenit 12 të LMD).

Neni 526. Forma e kontratës

Kontrata e shitjes me pagimin e çmimit në këste duhet të përpilohet në formë të shkruar.

141 Shih në lidhje me këtë: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 312 - 313.

142 Shih në këtë kontekst eventualisht Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligji nr. 04/L-121, I datës 19 tetor 2012; i qasshëm në: <mti-ks.org/repository/docs/LIGJI%20Nr.%2004-L-121%20PER%20MBROJTJEN%20E%20KONSUMATORIT%20(shqip).pdf>, dt.27 gusht 2013.

526. LMD, në nenin 526, përcakton se kontrata e shitjes me pagimin e çmimit me këste duhet të përpilohet në formë të shkruar, çka nënkupton karakterin formal të kësaj kontrate. Detyrimi që kjo kontratë të lidhet në formë të shkruar është një kërkesë detyruese e dispozitës së përmendur të LMD, ashtu që mosrespektimi i formës së shkruar shkakton pavlefshmërinë e kësaj kontrate. Mendohet se forma e shkruar e kësaj kontrate mbron interesin si të shitësit, ashtu edhe të blerësit dhe se është në funksion të mbrojtjes së interesit të të dy palëve, pasi që dorëzimi i sendit blerësit, para se ta ketë paguar në tërësi çmimin shitjes, sjellë pasiguri juridike ndërmjet palëve. Thuhet se kjo kontratë mbron interesin juridik të shitësit, pasi që palët saktësojnë në kontratë mënyrën e pagesës së çmimit, ashtu që shitësi mund t'i kërkojë blerësit që t'u përmbahet afateve të pagesës, ashtu siç është saktësuar në kontratë. Gjithashtu, mendohet se kjo kontratë mbron edhe interesin e blerësit, pasi që shitësi nuk mund t'i kërkojë atij pagesën në një afat më të shkurtër ose shuma më të mëdha të kësteve, përveç ashtu siç është përcaktuar në kontratë, (ose në planin e pagesës së kësteve - i cili rëndom i bashkëngjitet kontratës). Gjithashtu, pasi kjo kontratë detyrimisht duhet të hartohet në formën me shkrim, vetë kjo formë paraqet një provë objektive të përmbajtjes së marrëveshjeve të palëve, ashtu që pala që lë pa përmbushur detyrimet e veta kontraktuese, mund të thirret në përgjegjësi nga pala tjetër kontraktuese, e cila mund t'i kërkojë asaj zbatimin e premtimit të dakorduar në kontratë; për më tepër, vetë forma me shkrim mund të shfrytëzohet edhe si një burim shumë i rëndësishëm informacioni para cilitdo autoritet ose mekanizëm, të cilin palët e përdorin me qëllim të ekzekutimit të kontratës ose të kërkesave për shpërblimin e dëmit, për shkak të lënies pa përmbushur të detyrimeve të përcaktuara në kontratë.

Neni 527. Pjesët esenciale të kontratës

Tek shitja me para të gatshme, përveç sendit dhe çmimit të tij, dokumenti i kontratës duhet të përcaktojë edhe shumën totale të të gjitha kësteve, duke përfshirë edhe ato të paguara në momentin e lidhjes së kontratës, shumën e secilës pagesë së veçantë dhe numrin e tyre si dhe afatet kohore për secilën.

527. Neni 527 i LMD vendos disa elemente esenciale, të detyrueshme, që duhet t'i përmbajë dokumenti i kontratës së shitjes me pagimin e çmimit në këste. Këtu ligjdhënësi kërkon shprehimisht që dokumenti i kontratës, përveç sendit që shitet dhe çmimit që duhet të paguhet, duhet të përmbajë informata edhe për përshkrimin e shumës së kësteve, duke përfshirë edhe shumën ose shumën (nëse janë disa), të cilat janë paguar në momentin e lidhjes së kontratës, pastaj shumën e kësteve të veçanta, duke përfshirë edhe numrin e përgjithshëm të kësteve që duhet t'i paguhet shitësit, si dhe afatet për pagimin e kësteve. Rregullat e dispozitës në fjalë, që synojnë të saktësojnë elementet esenciale të dokumentit të kontratës së shitjes me këste, për nga natyra e tyre, janë rregulla të karakterit detyrues, ashtu që mungesa e përshkrimit të cilitdo element esencial në dokumentin e kontratës ka për pasojë pavlefshmërinë e saj.¹⁴³

143 Bukljas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II I*. Zagreb: 1979: fq. 1782.

Ashtu siç u vu në dukje edhe më sipër, dokumenti i kontratës duhet të përmbajë përshkrimin e dy elementeve qenësore – saktësimin e sendit që shitet dhe saktësimin e çmimit të përgjithshëm që blerësi duhet t’ia paguaj shitësit. Në pikëpamje të saktësimin të shumës së çmimit që duhet të paguhet me këste dhe kufizimit të mundësisë së kreditimit për blerësin, (përkatësisht të mbi-kreditimit të blerësit), LMD është plotësisht i lirë dhe nuk ndërhyr në vullnetin e palëve në kuptim të kufizimit të shumës së kreditimit-ngarkimit të blerësit të shitja me këste. Megjithatë, janë praktika juridike dhe doktrina juridike-ekonomike që sugjerojnë që, me qëllim që të mbrohet nga rreziku i mbikreditimit dhe eventualisht të mbrohet edhe nga rreziku i falimentimit ose varfërimit, blerësi nuk do të duhej të ngarkohej me detyrimin e pagesës së kësteve më tepër se 1/3 (një e treta) e të ardhurave të tij (mujore ose periodike, varësisht se në çfarë periudhash paguhen këstet).¹⁴⁴

Më tej, dispozita e nenit në fjalë kërkon që në dokumentin e kontratës të përshkruhen veç e veç shumat e pagesave - kësteve individuale, të cilat shitësi duhet t’ia paguajë blerësit, duke përfshirë edhe saktësimin në dokumentin e kontratës të numrit të pagesave individuale - kësteve. LMD nuk vendos ndonjë kufizim në këtë drejtim, megjithatë kërkon që palët, duke i saktësuar detyrimet në lidhje me pagesat, ato të jenë të vetëdijshme dhe të vullnetshme për detyrimet që marrin përsipër dhe për nivelin e ekspozimit (ngarkesës me pagesa) ndaj palës tjetër. Në kuptim të nenit 527 të LMD, krahas individualizimit të kësteve dhe shumave për pagesë, në dokumentin e kontratës duhet të saktësohet edhe shuma e mjeteve, këstet dhe shuma e kësteve ose e mjeteve, të cilat i janë paguar shitësit nga blerësi në momentin e lidhjes së kontratës.

Një element tjetër më rëndësi në kontratën e shitjes me këste është edhe saktësimi i kohës, përkatësisht i afateve të pagesës së kësteve dhe afati i pagesës së tërësishme të çmimit. Nga vetë fjala identifikuese e kësaj kontratë, këstet nënkuptojnë ndarjen e detyrimit të pagesës së çmimit në disa shuma të barabarta, të cilat duhet t’i paguhen shitësit në periudha të caktuara kohore, përkatësisht në periudha mujore. Megjithatë, LMD ua lë palëve mundësinë e lirë për kontraktimin e saktësimin të kësteve, numrit të tyre, ndarjes në mënyrë proporcionale (ose joproporcionale), si dhe saktësimin të periudhave kohore në të cilat këstet duhet të paguhen. LMD vetëm kërkon që vullneti i palëve për këto elemente esenciale të jetë i pasqyruar në dokumentin e kontratës, ashtu që ndërmjet palëve të mos ekzistojë asnjë dyshim për sa i përket saktësimin të tyre.¹⁴⁵

Neni 528. Zgjidhja e kontratës dhe kërkesa për pagimin e plotë të çmimit

1. Në rast se blerësi vonohet në kryerjen e pagesës së këstit fillestarë, shitësi mund ta zgjidhë kontratën.

144 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1388 - 1390.

145 Shih për këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1061.

2. Pas pagesës së kështit fillestar, shitësi mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se blerësi vonohet me të paktën dy këste të njëpasnjëshme, që përbëjnë të paktën një të tetën e çmimit.
3. Përjashtimisht, shitësi mund ta zgjidhë kontratën kur blerësi vonohet me pagesën e një kësti të vetëm, në qoftë se për pagesën e çmimit nuk janë parashikuar më tepër se katër këste.
4. Në rastet e parashikuara në paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni shitësi mundet që në vend që ta zgjidhë kontratën, të kërkojë nga blerësi pagimin e krejt shumës së mbetur të çmimit, por në këtë rast ka për detyrë t'i mundësojë blerësit një afat të ri prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

528.1. Neni 528 i LMD përcakton çështjen e mundësisë së zgjidhjes së kontratës së shitjes me pagesën e çmimit në këste, nëse blerësi lë pa paguar ose vonohet të paguajë këstet (kur plotësohen kushtet sipas këtij neni), ose i mundëson shitësit t'i bëjë kërkesë blerësit që ky i fundit të paguajë tërësisht çmimin. Paragrafi i parë i nenit 528 rregullon mundësinë që shitësi të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur blerësi të ketë rënë në vonesë që në këstin e parë. Kështu, rënia në vonesë që në këstin e parë lë përshtypjen se bëhet fjalë për një blerës "ekonomikisht" pa zotësi pagimi, ashtu që një gjendje e tillë e mban shitësin pa shpresë që blerësi i tij rregullisht do t'i paguajë këstet e mbetura. Prandaj, me këtë dispozitë i mundësohet shitësit që, menjëherë, sapo një blerës i tillë bie në vonesë që në këstin e parë, të kërkojë zgjidhjen e kontratës. Mendohet se një rregull e tillë i mundëson shitësit të mbrohet nga blerësi i pandërgjegjshëm, ashtu që i mundësohet ta zgjidhë kontratën në një afat sa më të shkurtër dhe në këtë mënyrë t'i ekspozohet sa më pak një blerësi insolvent ose të pandërgjegjshëm që në fillim të marrëdhënies kontraktuese. Duke pasur për qëllim mbrojtjen e shitësit nga një ekspozimi i tillë, në praktikën afariste janë krijuar edhe asi zakonesh që i mundësojnë shitësit ta shtyjë dorëzimin e sendit, përdërisa blerësi nuk paguan ose nuk është i gatshëm të paguajë këstin e parë të pagesës.¹⁴⁶

528.2. Në një rast tjetër, blerës ka paguar këstin e parë, por ka rënë në vonesë në pagesën e kësteve vijuese. Në rast se është paguar kësti fillestar i çmimit të shitjes, LMD parashikon rregulla me të rrepta për shitësin që të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të vonesës së pagesës së kësteve, nëse vonesa ka ngjarë për këstet e mëpastajme. Kështu, paragrafi i dytë i nenit 528 të LMD parashikon mundësinë që shitësi të kërkojë zgjidhjen e kontratës, nëse blerësi ka rënë në vonesë për pagesën e të paktën dy kësteve të njëpasnjëshme, pas pagesës së kështit fillestar, me kusht që shuma e dy kësteve për të cilat ka rënë në vonesë, të marra së bashku, të paraqesin së paku 1/8 e çmimit të përgjithshëm të kontraktuar. Ashtu siç rezulton nga vetë kuptimi i tekstit të kësaj dispozite, mundësia që shitësi të kërkojë zgjidhjen e kontratës është kufizuar me rënie në vonesë për të paktën dy këste të njëpasnjëshme nga ana e blerësit e gjithashtu që shuma për të cilën blerësi ka rënë në vonesë të jetë e konsiderueshme (1/8 e çmimit të përgjithshëm të kontraktuar).

146 Shih mbi këtë: *Komentar Zakona o Obligationim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1065.

Pothuajse edhe kodet e tjera civile parashikojnë një kufizim të konsiderueshëm për shitësin për të kërkuar zgjidhjen e kontratës, pas pagesës së kështit fillestar. Në shumicën e këtyre kodeve për këtë situatë është parashikuar që, me qëllim që shitësit t'i mundësohet zgjidhja e kontratës, blerësi duhet të ketë rënë në vonesë në të paktën dy këste vijuese. Ndërmjet sistemeve të ndryshme juridike ka dallime lidhur me atë se çfarë kushtesh të tjera duhet të plotësohen, përpos rënies në vonesë në pagesën e dy kësteve vijuese. Kështu, p.sh., Kodi Zviceran i Detyrimeve kërkon që shuma totale e dy kësteve që kanë rënë në vonesë të përbëjë të paktën një të dhjetën (1/10) e çmimit të përgjithshëm të kontraktuar.¹⁴⁷

528.3. Pa marrë parasysh kufizimin që i është bërë shitësit në mundësinë e zgjidhjes së kontratës në paragrafin e dytë të nenit 528, paragrafi vijues sanksionon mundësinë që, përjashtimisht, shitësi të kërkojë zgjidhjen e kontratës pas rënies në vonesë të blerësit në cilindo kësht (vijues), në qoftë se për pagesën e çmimit të shitjes, sipas kontratës, nuk janë parashikuar më tepër se katër këste. Megjithatë, mendohet se ky është një përjashtim që është në interes të mbrojtjes së shitësit, për rastet kur marrëdhënia e kontraktuar dhe detyrimi i pagesës së çmimit është ndarë në vetëm katër këste të vetme.

528.4. Për rastet e parashikuara nga paragrafi i dytë dhe i tretë të nenit 528 të LMD, që u komentuan më lart, LMD ka parashikuar mundësinë për shitësin që, megjithatë, ai të mos kërkojë zgjidhjen e kontratës, por të kërkojë pagesën e tërë borxhit të mbetur nga të gjitha kështet. Në një rast të tillë, shitësi mund t'i kërkojë blerësit pagesën e të gjitha kësteve të mbetura, me kusht që t'ia mundësojë atij edhe një afat plotësues prej 15 ditësh shtesë për pagesën e tërë borxhit të mbetur. Në rast se blerësi e bën pagesën brenda kësaj periudhe të tolerancës (afatit shtesë 15-ditor), ai konsiderohet të ketë përmbushur në mënyrë të heshtur detyrimet e tij në përputhje me vullnetin e shprehur të ligjvënësit dhe të kreditorit, ashtu që, pasi shitësi ta ketë marrë pagesën e shumës së duhur, nuk mund kërkojë shkëputjen e kontratës. Ashtu siç është ndërtuar paragrafi i katërt i nenit 528 i LMD, duket se shitësit i është lënë mundësia, si e drejtë alternative e zgjedhjes - nëse do të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës apo t'i kërkojë blerësit pagesën definitive të çmimit (me kushtin e mësipërm. Nëse blerësi as brenda afatit shtesë prej 15 ditësh nuk përmbush detyrimin, atëherë konsiderohet se ka rënë në vonesë për pagesën e plotë të shumave të përgjithshme të të gjitha kësteve.

Neni 529. Pasojat e kontratës së anuluar

- 1. Nëse kontrata anulohet shitësi duhet t'i kthej të gjitha kështet e pranuar së bashku me interesin që nga dita kur i ka pranuar, si dhe t'i kthejë të gjitha shpenzimet e nevojshme që blerësi ka pasur për sendin.**
- 2. Blerësi duhet t'ia kthej sendin shitësit në gjendjen në të cilën e ka pranuar, si dhe të paguaj kompensimin për përdorimin e bërë të sendit gjerë në momentin e anulimit të kontratës.**

147 Në lidhje me këtë kufizim shih Nenin 228 të Kodit Zviceran të Detyrimeve (I njëjti I qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 22.07.2013.

529.1. Neni 529 i LMD përdor shprehjen “anuluar” dhe shtjellon çështjen e pasojave në rast të anulimit të kontratës së shitjes me pagim të çmimit në këste. Duket se në tekstin ligjor të këtij neni kemi një lëshim, i cili ka mundur të jetë bërë si rezultat i krahasimit ose përkthimit të më shumë teksteve ligjore në fazën që Ligji ishte projekt, ashtu që duket se ligjvënësi e ka përdorur shprehjen “anuluar”, në vend se ta përdorte shprehjen “zgjidhur”. Me gjithë ngjashmëritë e mëdha, shprehjet “anuluar” dhe “zgjidhur”, në kuptimin juridik-teknik, kanë domethënie të ndryshme, madje bëhet fjalë për diferenca në pasojat që shkaktojnë. Nëse e shohim me kujdes tekstin ligjor të ish-LMD (Ligji i ish-RSFJ për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të vitit 1978), neni 549 i tij shpeshherë ka shërbyer si burim për hulumtimin dhe përzgjedhjen e tekstit ligjor të LMD në fuqi. Në këtë nen është përdorur shprehja “zgjidhur”, me fjalë të tjera, në kontekst të këtij neni që komentohet, mund të flitet për pasojat juridike në rast të zgjidhjes së kontratës nga shitësi.

Gjithashtu, nëse e shikojmë kuptimin e nenit pararendës (528), ligjvënësi ka sanksionuar mundësinë që, në disa situata, shitësi të kërkojë njëanësisht zgjidhjen e kontratës. Pra, nga vetë kuptimi i dispozitës së këtij neni rezulton se ligjvënësi ka pasur për qëllim që t’i pasqyrojë pasojat e zgjidhjes së kontratës nga shitësi (zgjidhjen e kontratës të mundësuar nga neni pararendës). Rrjedhimisht, duket që do të ishte më vend përdorimi i shprehjes “zgjidhje”, në vend të shprehjes “anulim”, që është përdorur në nenin në fjalë. Prandaj, në rast të një revidim të mundshëm të këtij Ligji, është me rëndësi që ky lëshim teknik, i cili mund të ketë konsekuenca përmbajtësore juridike, të korrigjohet.

Nga kuptimi i paragrafit të parë të nenit 529 të LMD nënkuptohet që, nëse kontrata zgjidhet (në situatat e mundësuar nga neni paraprak), atëherë lind detyrimi për shitësin që blerësit t’ia kthejë shumën e të gjitha kësteve të arkëtuara, duke përfshirë interesin eventual që ka mundur të rrjedhë për shumën e kësteve të arkëtuara, duke llogaritur atë nga dita kur shitësi suksesivisht i ka pranuar pagesat sipas kësteve të caktuara, si dhe t’i kompensojë shumën përkatëse në emër të shpenzimeve të domosdoshme që i ka pasur blerësi lidhur me mirëmbajtjen e sendit në gjendje të rregullt. Duket se ligjvënësi edhe në këtë rast ka adaptuar një rregull, e cila është rregull e përgjithshme që zbatohet në rastet kur shkaktohet zgjidhja e kontratës. Sipas këtij kuptimi, palët duhet të kthejnë të gjithë atë që kanë marrë ose që kanë përfituar në marrëdhënien kontraktuese nga pala tjetër, duke përfshirë në rastin konkret edhe detyrimet përkatëse për shitësin që dalin nga kontrata e shitjes me këste.¹⁴⁸

Në lidhje me paragrafin në fjalë mund të shtrohet pyetja se cili është interesi ose cila është norma e interesit që shitësi duhet t’ia paguajë blerësit për këstet e arkëtuara, për kohën sa ka mbajtur ose sa i ka shfrytëzuar mjetet financiare në fjalë. Në lidhje me normën e interesit me të cilën shitësi ngarkohet në situata të ngjashme, disa autorë mendojnë se ajo duhet të jetë një normë që aplikohet për detyrimet financiare të vonuara, përkatësisht të aplikohet norma e kamatëvonesës.¹⁴⁹ Në lidhje me komentimin e dispozitave të LMD,

148 Bukljas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II I*. Zagreb: 1979: fq. 1785.

149 Shih në lidhje me këtë: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve (pjesa e veçantë)*. Prishtinë: 1988: fq. 91.

të cilat i referohen kamatëvonesës, shih komentimin e neneve 382, 383 dhe 384 të LMD. Si duket, për këtë çështje nuk ka shumë burime juridike, megjithatë, ngarkimi i shitësit edhe me normën e kamatëvonesës (për shumën e kësteve të arkëtuara), që është pasojë e zgjidhjes së një marrëdhënie kontraktore për shkak të vonesës së palës tjetër, (në rastin konkret, të blerësit), duket që në shikim të parë që ajo është joproporcionale. Në fakt, nga shuma e mjeteve të arkëtuara në emër të kësteve, shitësi ka mundur të krijojë leverdi për veten, të cilën, sipas paragrafit në fjalë, ka për detyrim ta kthejë mbrapa, por megjithatë shkalla e normës së interesit të aplikuar në këtë rast mbetet mjaft e debatueshme.

Nëse shihet me kujdes teksti ligjor i paragrafit në fjalë, LMD përdor vetëm shprehjen interes, pa aluduar në detyrimin që norma e interesit të jetë në këtë rast proporcionale me normën e kamatëvonesës. Më tutje, kamatëvonesa, si instrument ligjor, aplikohet te detyrimet e ngecura financiare dhe ka për qëllim ta disjolinjë debitorin, i cili ka rënë në vonesë në detyrimet financiare. Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me rënie në vonesë të shitësit, prandaj as nuk duhet të ketë sanksione proporcionale lidhur me kamatëvonesën në ngarkim të shitësit. Në kuptim të tërë kësaj që u tha më lart, megjithatë, duket se LMD ka një përgjigje më adekuate, e cila nënkupton që, për rastet e tilla, të aplikohet norma e interesit në masën që saktësohet në paragrafin e dytë të nenit 385 të LMD, (në lidhje me kuptimin e interesit sipas paragrafit në fjalë, shih komentimin e nenit 385 të LMD).

529.2. Paragrafi i dytë i nenit 529 të LMD vendos dhe saktëson detyrimet e blerësit në rast të zgjidhjes së kontratës në njërin nga situatat e mundësuar nga neni paraprak. Kështu, së pari blerësi ka detyrimin t'ia kthejë mbrapa shitësit sendin në gjendjen në të cilën e kishte pranuar, përkatësisht blerësi mbetet përgjegjës ta shpërblejë shitësin për çfarëdo ndryshimi të sendit ose të vlerës së tij, e cila është në shpërpjesëtim me gjendjen e sendit që ka ekzistuar në momentin kur blerësi e ka pranuar atë. Gjithashtu, krahas kthimit të sendit, blerësi ka detyrimin që shitësit t'ia kthejë edhe të gjitha frytet (civile ose natyrore), të cilat blerësi i ka vjelë nga sendi, që nga dita e parë e hyrjes në posedim të sendit. Përpos kësaj, blerësi është i detyruar t'ia paguajë shitësit shpërblimin përkatës që është në përpjesëtim me fitimet e blerësit, të cilat ky i ka realizuar gjatë ose që kanë qenë të ndërlidhura me shfrytëzimin e sendit nga ana e tij.

NËNKREU 7

SHITJA ME ANE TE AKREDITIVIT

Neni 530. Detyrimet e palëve

- 1. Nëse ekziston marrëveshja që pagesa të bëhet me anë të akreditivit blerësi detyrohet që me shpenzimet e tij në një afat të përshtatshëm të sigurojë se kësti i parë bankarë hap një akreditiv që është në përputhje me kontratën e shitjes. Akreditivi duhet të jetë i vlefshëm për një kohë të mjaftueshme pas përmbylljes së detyrimit të shitësit në mënyrë që shitësi të ketë mundësi të mbledhë dhe dorëzojë dokumentet në bankë.**

2. Nëse banka nuk e hapë akreditivin në përputhje me paragrafin paraprak ose nuk paguan shumën kreditore edhe pse shitësi ka paraqitur dokumentet e nevojshme, dispozitat mbi vonesat e debitorit do të zbatohen përshtatshmërisht në marrëdhënien ndërmjet shitësit dhe blerësit.
3. Shitësi i cili akreditivin e hapur nga banka nuk e përdorë në përputhje me kontratën e shitjes nuk e humbë të drejtën për të kërkuar çmimin e shitjes, por detyrohet që të kompensojë dëmin e blerësit.
4. Palët mund të përcaktojnë se hapja e akreditivit është kusht për vlefshmërinë e kontratës.
5. Nëse akreditivi është zgjatur me marrëveshjen e të dy palëve, secili prej tyre merr përsipër gjysmën e shpenzimeve. Nëse zgjatja është bërë për arsyt e njëjës palë, shpenzimet i ngarkohen kësaj palë.
6. Dispozitat e këtij neni nuk i zëvendësojnë rregullat e akreditivit si transaksion bankar, as e kundërta.

530.1. Që në fillim të komentimit të paragrafit të parë të nenit 530 duhet të vëmë re se në tekstin ligjor të paragrafit në fjalë kemi të inkorporuar një gabim (si duket teknik), i cili në tërësi fjalinë e parë të paragrafit në fjalë e bën të mangët dhe pa mundësi për aplikim praktik. Si duket, gabimi ka mundur të rrjedhë gjatë përkthimit të tekstit ligjor nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, pasi që në disa raste si burim informacioni për hulumtimet e zgjidhjeve ligjore, që ishin bërë nga grupi punues gjatë hartimit të projektit të LMD, ndër të tjera, është shfrytëzuar edhe një version në gjuhën angleze i Kodit sloven të Detyrimeve, i cili kishte prejardhje dhe zgjidhje shumë të ngjashme ligjore me ato të aplikuara në Kosovë deri te adaptimi i LMD. Kështu, nëse e lexojmë tekstin ligjor të Kodit sloven për Detyrimet - versioni në gjuhën angleze, fjalia e parë e paragrafit të parë të nenit 527 të tij parashikon si në vijim: *“If the payment is agreed upon using a documentary credit the buyer shall be obliged to ensure at the buyer’s own expense and by an appropriate deadline that a first-rate bank opens a documentary credit that must be in accordance with the sales contract. [...]”*¹⁵⁰ Nëse e bëjmë një përpjekje për përkthimin e fjalisë së parë të paragrafit në fjalë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, do të mund ta përfitonim një fjali me një kuptim si në vijim (përkthim jozyrtar): *“Nëse ekziston marrëveshja që pagesa të bëhet me anë të akreditivit, blerësi detyrohet që të sigurojë që, me shpenzimet e blerësit dhe brenda një afati të përshtatshëm që një bankë e rangut të parë hap një akreditiv, i cili duhet të jetë në përputhje me kontratën e shitjes.[...]”*. Nëse e shohim me kujdes tekstin ligjor të fjalisë së parë të LMD dhe e krahasojmë me këtë burim juridik, do të shohim se ligjvënësi, si duket, ka pasur për qëllim që paragrafit në fjalë t’i japë një kuptim të njëjtë ose të ngjashëm, ashtu që, sigurisht, kjo fjali e nenit 530 të LMD duhet të korrigjohet dhe të sigurojë një kuptim të qartë dhe praktik. Megjithatë, për qëllimet e këtij Komentari, ne po nisemi dhe po i

150 Në lidhje me këtë shih paragrafin e parë të Nenit 527 të Kodit Sloven të detyrimeve, versioni në gjuhën Angleze, I njëjti I qasshëm në: <uil-sipo.si/fileadmin/upload_folder/zakonodaja/povezano/Obligations-Code_Slovenia_2001.pdf>, dt. 09.09.2013.

pasqyrojmë aspektet e paragrafit të parë të nenit 530 të LMD në përputhje me vërejtjet në fjalë dhe kuptimin e këtij paragrafi sipas burimit juridik të cituar më lart.

Në përgjithësi akreditivi është një punë komplekse juridike, (që nënkupton kryerjen e një sërë veprimesh ndërmjet bankës dhe klientit të saj), përmes së cilës banka pranon një urdhër nga klienti i saj (urdhërdhënësi), që ajo, sipas urdhrorit të pranuar, t'ia bëjë pagesën një personi të tretë (rëndom shfrytëzuesit), nëse plotësohen kushtet e caktuara, (nëse akreditivi është lëshuar me kushte të caktuara), ose që pagesa të tretit t'i bëhet pa asnjë kushtëzim, (nëse akreditivi është lëshuar pa kushte). Rëndom, akreditivi dhe lloji i akreditivit varen nga përmbajtja e urdhrorit që urdhërdhënësi i jep bankës së tij, (apo cilësdo bankë pranë së cilës hap akreditivin). Rëndom, puna ose marrëdhënia e akreditivit ndërthur tri ose katër subjekte në marrëdhënien e akreditivit, duke përfshirë: urdhërdhënësin, që rëndom është blerësi te kontrata e shitjes me akreditiv, (personi që hap akreditivin pranë bankës me përmbajtjen e urdhrorit të caktuar që banka në fjalë të ekzekutojë pagesën me kushte ose pa kushte); bankën pranë së cilës hapet akreditivi, (veprimi i së cilës kushtëzohet dhe kufizohet varësisht nga përmbajtja e urdhrorit të dhënë nga urdhërdhënësi); shfrytëzuesin e akreditivit, (që rëndom nënkupton subjektin ndaj të cilit duhet të ekzekutohet pagesa me kushte e saktësuara në urdhër ose pa kushte, kur ashtu është vendosur nga urdhërdhënësi dhe ky rëndom është shitësi te shitja me akreditiv), kurse në disa situata, (sidomos në kushte e shitjes ndërkombëtare të mallrave), ndërhyjnë edhe banka e shfrytëzuesit të akreditivit, (e cila paraqitet si bankë referuese që ndërmjetëson komunikimin e shfrytëzuesit të akreditivit me bankën ku është hapur akreditivi).¹⁵¹

Në kontekstin e nenit 530, duket se LMD ka lejuar dhe ka sanksionuar mundësinë që kontraktimi i shitjes së mallit - sendeve dhe pagesës së çmimit të realizohet ndërmjet palëve në kontratë, duke shfrytëzuar akreditivin bankar. Kështu, shitja me anë të akreditivit nënkupton një formë të veçantë të shitjes, përkatësisht të kontratës së shitjes, sipas së cilës, palët janë pajtuar që pagesa e çmimit të shitjes të bëhet përmes bankës së blerësit, sipas kushteve për hapjen e akreditivit të vendosura në kontratën e shitjes. Vlen të theksohet se shitja me anë të akreditivit është një instrument shumë i përshtatshëm dhe i sigurt me qëllim të ekzekutimit të pagesave ndërmjet pjesëmarrësve në qarkullimin juridik, për rastet kur palët kontraktuese nuk kanë një siguri të mjaftueshme ose të përshtatshme se pagesa e çmimit do të kryhet në kohë ose në tërësi, pasi të dorëzohet malli ose dokumentet e mallit. Kështu, marrëdhënia e akreditivit posaçërisht i ofron siguri të plotë shitësit se pagesa e çmimit do të ekzekutohet nga banka e urdhërdhënësit (blerësit), sipas kushteve të kontraktuara ndërmjet palëve (akreditivi i kushtëzuar) ose pa kushte, (akreditivi i pakushtëzuar). Kjo është posaçërisht e rëndësishme për tregtimin e mallrave, veçanërisht për tregtimin ndërkombëtar të mallrave.

.....
151 Për më shumë në lidhje me akreditivin, shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 494.

Nga kjo që u tha më sipër del se te shitja me anë të akreditivit, paragrafi i parë i nenit 530 të LMD parashikon që, kur palët kanë vendosur me kontratë që shitja, respektivisht pagimi i çmimit të shitjes të realizohet përmes akreditivit (hapjes së akreditivit nga blerësi në bankën e tij), atëherë është detyrim ligjor i blerësit që, me shpenzimet e veta, të sigurojë (shitësin) se akreditivi në fjalë, sipas kushteve të kontraktuara në kontratë dhe brenda një afati të përshtatshëm, është hapur në një institucion bankar të rangut të bankës së parë (bankës më të mirë). Nëse lexohet me kujdes fjalia e parë e paragrafit në fjalë, shihet se ajo përfshin disa detyrime të blerësit, të cilat do të diskutohen në vijim. Fillimisht, detyra e blerësit është që të hapë një akreditiv brenda një afati të arsyeshëm dhe me shpenzime të blerësit. Zakonisht, se cili është afati i hapjes së akreditivit palët e saktësojnë me kontratë; në mungesë të një dispozite kontraktuese, LMD e ka përdorur shprehjen “afat i arsyeshëm”. Se cili është afati i arsyeshëm, varet kryesisht nga rrethanat e rastit konkret dhe marrëdhënia e dhënë, e themeluar ndërmjet palëve, të cilën në çdo rast gjykata do ta vlerësojë veç e veç. Në kuptim të kësaj, hipotetifikisht do të mund të konsiderohej si kohë e arsyeshme e tërë koha që ekziston para momentit kur shitësi t’i jetë ekspozuar rrezikut të palës tjetër kontraktuese, gjë që nënkupton momentin para se sendi-malli t’i jetë dorëzuar blerësit ose momentin para se atij t’i jenë dorëzuar dokumentet e mallit. Një kërkesë mjaft e rëndësishme e këtij neni është që akreditivi të hapet në përputhje me kushtet e kontratës. Kushtet e kontratës të vendosura nga palët, të cilat saktësojnë përmbajtjen e akreditivit, konsiderohen kushte thelbësore të marrëveshjes së palëve, në kuadër të të cilave duhet të hapet akreditivi - urdhri pranë bankës së blerësit. Cenimi i kushteve të kontratës me rastin e hapjes së akreditivit paraqet shkelje esenciale të kontratës së shitjes, që do të kishte për bazë të drejtën e shitësit për t’iu referuar rregullave të shkeljes, respektivisht mospërmbushjes së kontratës nga pala tjetër kontraktuese.

Një kërkesë tjetër e paragrafit të parë të nenit 530 të LMD është ajo që blerësi duhet t’i japë urdhër të atillë bankës së tij që akreditivi të qëndrojë i hapur në bankën në fjalë për aq kohë, pas përmbushjes së detyrimit të shitësit, sa do të ishte e mjaftueshme për shitësin që të sigurojë – të mbledhë të gjithë dokumentacionin, të cilin t’ia dorëzojë bankës me qëllim që shitësi të sigurojë arkëtimin e pagesave sipas akreditivit të hapur. LMD edhe në këtë rast i jep një kuptim abstrakt kësaj çështjeje, që në çdo situatë duhet t’u përshtatet rrethanave dhe nevojave të shitësit, në të cilat ndodhet ai në rastin e dhënë.

530.2. Paragrafi i dytë i nenit 530 i LMD synon ta mbrojë dhe t’i sigurojë shitësit mjete-instrumente të përshtatshme juridik nëse ndodh që banka, tek e cila është kërkuar hapja e akreditivit, nuk e hap atë ose pasi e ka hapur, nuk e ekzekuton pagesën (shumën e kredituar) në përputhje me kontratën e shitjes dhe urdhrin të blerësit, me gjithë prezantimin e të gjithë dokumentacionit relevant nga shitësi, (ku shihet konfirmimi i shitësit se i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij ndaj blerësit). Në këtë kuptim, paragrafi në fjalë parashikon që, nëse banka nuk hap akreditivin (sipas kushteve të saktësuara dhe komentuara në paragrafin paraprak të këtij neni) ose kur banka ku është hapur akreditivi nuk paguan shumën e kredituar (nga blerësi, i cili me hapjen e akreditivit jep urdhër që shuma e kredituar në fjalë t’i paguhet shitësit), me gjithë faktin që shitësi i ka paraqitur

kësaj banke të gjithë dokumentacionin relevant për ekzekutimin e pagesës, (ashtu si është saktësuar me urdhrin e blerësit për hapjen e akreditivit - përkatësisht kontratën e shitjes); pra, nëse paraqitet cilado nga këto situata të përshkruara më lart, konsiderohet se blerësi ka rënë në vonesë, ashtu që paragrafi në fjalë sugjeron që përshtatshmërisht, për situatat në fjalë, të zbatohen dispozitat e LMD për vonesën e debitorit, (në përgjithësi). Në këtë mënyrë, me sanksionimet dhe rregullat e përgjithshme të dispozitave, të cilat shtjellojnë vonesën e debitorit, mbrohen interesat e shitësit edhe te shitja me akreditiv. Në lidhje me vonesën e debitorit, posaçërisht shih komentimin e nenit 305 të LMD dhe komentimin e neneve të nënkreut 3 të LMD, ku parashikohen çështjet e vonesës në përmbushjen e detyrimeve në të holla, (duke filluar nga neni 382 i LMD), si dhe nenet e tjera të LMD, të cilat parashikojnë pasojat juridike të vonesës së debitorit.

530.3. Paragrafi i tretë i nenit 530 të LMD rregullon situatën kur shitësi eventualisht nuk e përdor akreditivin në përputhje me kontratën e shitjes, sipas kushteve të së cilës akreditivi është hapur. Megjithëse shitësi ka mundur ta shfrytëzojë akreditivin përtej kushteve të kontratës, paragrafi në fjalë përpiqet të ofrojë një zgjidhje juridike të balancuar ndërmjet shitësit dhe blerësit. Sipas këtij paragrafi, nëse kjo është situata kur shitësi përdor akreditivin përtej kushteve të kontratës, ai në këtë rast nuk e humb të drejtën të kërkojë nga blerësi pagesën e çmimit të shitjes, (përkatësisht që nga shuma e lejuar për kreditim, sipas akreditivit, shitësi të arkëtojë çmimin e shitjes sipas kontratës); megjithatë, nëse blerësi eventualisht ka pësuar ndonjë dëm për shkak të tejkalimit të mundësisë ose kushteve të shfrytëzimit të akreditivit, shitësi do të ngelë përgjegjës që, sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit, t'ia shpërblejë blerësit cilindo dëm të pësuar me atë rast.

530.4. Te shitja me akreditiv, në kontratën e shitjes palët mund të saktësojnë se “hapja e akreditivit është kusht për vlefshmërinë e kontratës” së shitjes. Nëse kemi të bëjmë me këtë rast, konsiderohet se kontrata e shitjes (me akreditiv) është lidhur me kushtin shtyrës, përkatësisht që kontrata do të konsiderohet e plotfuqishme dhe do të prodhojë efekte juridike ndërmjet palëve vetëm pas hapjes së akreditivit, sipas kushteve dhe qëllimit të kontratës për shitjen me akreditiv. Për rastin në fjalë vetë hapja e akreditivit është një kusht ose element qenësor i kontratës së shitjes, pa plotësimin e së cilës konsiderohet se ajo as që është lidhur fare, (nuk prodhon efekte juridike).

530.5. Paragrafi i pestë i nenit 530 të LMD ka për qëllim që të rregullojë situatën se kush ngarkohet me shpenzimet për akreditivin, nëse palët pajtohen me marrëveshje që të zgjasin akreditivin e hapur (të hapur më herët për qëllimin e caktuar - të kontraktuar nga palët), si dhe situatën se kush ngarkohet me shpenzimet për akreditivin, nëse zgjatja e tij kërkohet për shkaqe ose arsye të determinuara vetëm nga njëra palë kontraktuese. Për rastin e parë të parashikuar nga ky paragraf, d.m.th., kur akreditivi i hapur zgjatet me marrëveshjen e përbashkët të palëve, (nëse palët nuk kanë parashikuar diçka tjetër në marrëveshjen e tyre për shpenzimet e zgjatjes së akreditivit), që të dy palët, proporcionalisht, në pjesë të barabarta, ngarkohen me shpenzimet e shkaktuara rreth zgjatjes së akreditivit. Në rastin e dytë të parashikuar nga ky paragraf, nëse zgjatja e afatit të akreditivit është bërë për arsyet

e vetëm njërës palë kontraktuese, pala që ka qenë shkaktare e zgjatjes së akreditivit rëndom mbulon edhe shpenzimet shtesë që kanë rezultuar nga zgjatja e akreditivit, (nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe me kontratë).

530.6. LMD në paragrafin e gjashtë të këtij neni saktëson qëllimin e vërtetë të dispozitave të këtij neni. Sipas kuptimit të paragrafit në fjalë, del se, në realitet, qëllimi i nenit 530 të LMD është të rregullojë raportin e shitblerjes ndërmjet shitësit dhe blerësit në lidhje me akreditivin e hapur bankar. Shitësi dhe blerësi, në marrëdhënien e tyre kontraktuese, vendosin për shfrytëzimin e akreditivit bankar dhe kushtet (materiale) në të cilat akreditivi bankar mund të hapet. Vetë funksionimi i akreditivit bankar, si një transaksion bankar, dhe rregullat juridike (profesionale) të cilave duhet t'u nënshtrohet në këtë kuptim ky transaksion bankar, janë një subjekt jashtë dispozitës së nenit 530 të LMD; ndërkaq, rregullat juridike, të cilat rregullojnë akreditivin si një transaksion bankar (jashtë rregullave të LMD), nuk mund të shtjellojnë çështje materiale të rregullimit të të drejtave dhe përgjegjësive të palëve te kontrata e shitjes me akreditiv, (rëndom, natyra e këtyre çështjeve të fundit mund të jetë subjekt i rregullimit me kontratë ose me rregullat e nenit 530).

NËNKREU 8 URDHRI I SHITJES

Neni 531. Nocioni

- 1. Me kontratën e urdhrit për shitje detyrohet urdhër marrësi që sendin e caktuar të luajtshëm, të cilin ia ka dorëzuar urdhërdhënësi, ta shesë me një çmim të caktuar në afatin e caktuar ose që në atë afat t'ia kthejë urdhërdhënësit.**
- 2. Urdhri i shitjes nuk mund të revokohet.**

531.1. Urdhri i shitjes ose, siç njihet në teorinë juridike, “dekreti i shitjes”, është një kontratë e veçantë e shitjes, e cila, për nga elementet e saj, qëndron ndërmjet kontratës së shitjes dhe kontratës për përfaqësim. Urdhri i shitjes paraqet një marrëdhënie kontraktuese ndërmjet dy palëve (ose disa palëve), nga të cilat urdhërdhënësi jep urdhër që sendi i tij i luajtshëm të shitet nga urdhërmarrësi, ashtu që kjo shitje të realizohet brenda një afati të caktuar, me një çmim të caktuar ose, nëse dështon shitja brenda afatit të caktuar, sendi sërish të kthehet te urdhërdhënësi (shitësi). Rëndom, në teorinë juridike vihet në dukje se urdhri i shitjes paraqet një kontratë përmes së cilës dikush mundëson t'i shiten sendet e tij të luajtshme nga personi që ka besim të ndërmarrë këtë aktivitet.¹⁵² Edhe LMD, në paragrafin e parë të nenit 531, saktëson një kuptim të njëjtë të urdhrit të shitjes, duke parashikuar që urdhërmarrësi merr përsipër detyrimin që sendin e luajtshëm të urdhërdhënësit ta shesë me një çmim të caktuar, në një afat të caktuar, ose ta kthejë atë mbrapa te urdhërdhënësi

152 Perovic, Slobodan. *Obligaciono pravo*. Beograd, 1980: 591 - 592.

brenda afatit të caktuar, (nëse nuk realizohet shitja e sendit). Në këtë kuptim, paragrafi në fjalë kufizohet më shumë në saktësimin e kuptimit të urdhrit të shitjes.

531.2. Më tej, paragrafi i dytë i nenit 531 të LMD parashikon se “urdhri i shitjes nuk mund të revokohet”. Rëndom, urdhri i shitjes parashikon që shitja të realizohet brenda afatit të caktuar, ashtu që, po u dha njëherë, urdhri nuk mund të revokohet, por pushon me mbarimin e afatit (ose me shitjen e sendit, nëse është realizuar shitja). Kjo zgjidhje juridike është adaptuar nga LMD, sepse ofron më shumë siguri juridike nga mundësia eventuale që urdhri të revokohet prej shitësit, kurse për revokimin të mos ketë pasur dijeni të sakta urdhërmarrësi ose pala e tretë, ndërkaq një problem i veçantë do të paraqiste vetë të provuarit e revokimit të urdhrin etj. Mendohet se me zgjedhjen juridik që ka bërë LMD, duke sanksionuar përvokueshmërinë e urdhrin të shitjes, ka kontribuar në sigurinë juridike të shitjeve dhe të tregtisë (në përgjithësi), e cila mundësohet përmes urdhrin të shitjes, për t’i mbrojtur kështu më mirë interesat e palëve të treta, të cilat blejnë ose fitojnë sende-mallra, duke ndërlidhur edhe mundësinë e shfrytëzimit të këtij instrument juridik.¹⁵³

Neni 532. Rreziku i shkatërrimit dhe i dëmtimit të sendit

Sendi i dorëzuar urdhër marrësit mbetet në pronësinë e urdhërdhënësit dhe ai e bartë rrezikun e shkatërrimit ose të dëmtimit të tij të rastësishëm, por ai nuk mund ta disponojë deri sa të mos i kthehet.

532. Edhe pse urdhri i shitjes është i përvokueshëm, përderisa afati për realizimin e shitjes të kalojë, megjithatë, duhet të vihet në dukje se deri në shitjen e sendit nga ana e urdhërmarrësit, respektivisht deri në skadimin e afatit në të cilin ai është i detyruar t’ia kthejë sendin urdhërdhënësit, ky i fundit edhe më tej mbetet pronar i sendit-mallit. Për këtë arsye, te shitja me urdhër, urdhërdhënësi ngarkohet edhe me rrezikun e dëmtimit ose zhdukjes së rastësishme të sendit. Megjithëse urdhërdhënësi vazhdon të konsiderohet pronar i sendit, (deri në momentin e shitjes, respektivisht kalimin e afatit të shitjes), i cili gjithashtu ngarkohet edhe me rrezikun nga dëmtimi ose humbja e rastësishme e sendit, urdhërdhënësi, për aq kohë sa zgjat afati (i shitjes, që i është dhënë urdhërmarrësit), nuk mund ta disponojë sendin si objekt të kësaj kontrate (përderisa sendi t’i kthehet në posedim të tij, kur ai i kthehet brenda afatit në rast të dështimit të shitjes). Çështja e përgjegjësisë së urdhërdhënësit për rrezikun mbi sendin është parashikuar edhe me LMD (neni 532).

Përrjashtimisht nga rregulla e mësipërme e nenit 532 të LMD, nëse urdhërmarrësi ka lënë pa njoftuar me kohë urdhërdhënësin për mospunësin e shitjes së sendit dhe, për pasojë, nuk ia kthen sendin as në afatin e caktuar, konsiderohet se që nga ai moment, (momenti i kalimit të afatit), urdhërmarrësi ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës. Rënia në vonesë e urdhërmarrësit ka për pasojë ngarkimin e tij me rrezikun

153 Shih për këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1073.

dhe përgjegjësinë për dëmtimin ose zhdukjen e rastësishme të sendit. Kalimi i rrezikut mbi urdhërmarrësin konsiderohet si një lloj sanksioni ndaj tij për shkak se ka lënë pa përmbushur detyrimin e vet sipas kontratës.¹⁵⁴

Neni 533. Kur konsiderohet se urdhër marrësi e ka blerë sendin

- 1. Në qoftë se urdhër marrësi nuk e shet sendin dhe nuk ia dorëzon çmimin e caktuar urdhërdhënësit deri në afatin e caktuar, e as që e kthen atë në afat, konsiderohet se ai e ka blerë sendin.**
- 2. Mirëpo, kreditorët e tij nuk mund të bëjnë sekuestrimin e sendit derisa ai të mos ia paguajë çmimin urdhër dhënësit.**

533.1. Paragrafi i parë i nenit 533 të LMD e rregullon çështjen se çfarë ndodh kur urdhërmarrësi nuk e shet sendin brenda afatit të caktuar dhe nuk ia kthen atë shitësi brenda afatit të caktuar. Sipas kuptimit të dispozitës në fjalë, nëse urdhërmarrësi nuk e shet sendin në afatin e caktuar dhe nuk ia paguan çmimin e shitjes urdhërdhënësit dhe as ia kthen sendin urdhërdhënësit (brenda afatit të caktuar), atëherë konsiderohet se sendin e ka blerë vetë urdhërmarrësi. Dispozita në fjalë pasqyron rastin kur, nëse plotësohen kushtet ashtu si u tha më lart në komentimin e kësaj dispozite (mosshitja e sendit, përkatësisht mospagesa e çmimit të shitjes urdhërdhënësit si dhe moskthimi i sendit brenda afatit të caktuar urdhërdhënësit), konsiderohet se në bazë të ligjit, urdhërmarrësi e ka blerë vetë sendin, ashtu që ky ka për detyrim t'ia paguajë më pas çmimin e shitjes urdhërdhënësit.¹⁵⁵

Në teorinë juridike mendohet se, në disa situata, edhe kur është rasti si më sipër (mosshitja e sendit, përkatësisht mospagesa e çmimit të shitjes urdhërdhënësit, si dhe moskthimi i sendit brenda afatit të caktuar urdhërdhënësit), megjithatë, nuk konsiderohet se urdhërmarrësi e ka blerë sendin. Këto janë rrethana të cilat urdhërmarrësin objektivisht e kanë penguar që ai ta përmbushë detyrimin kontraktues ndaj urdhërdhënësit. Një rast i tillë do të ishte, p.sh., nëse shkatohet vdekja ose humbja e zotësisë për të vepruar e urdhërmarrësit dhe kjo të jetë shkaktuar para përfundimit të afatit të kontraktuar për shitjen e sendit, respektivisht para kthimit të sendit të urdhërdhënësit. Ky përjashtim duket plotësisht i kuptueshëm, kur kihet parasysh se kryerja e “urdhrit” ose kontrata e urdhrit konsiderohet një punë personale “intuitu personae”, ashtu që vdekja ose humbja e zotësisë për të vepruar e urdhërmarrësit shkaktonte shuarjen e detyrimeve personale të urdhërmarrësit. Për dallim nga ky vështrim, mendohet se nuk do të kishim të bënim me këtë rast, kur urdhërdhënësi vdes ose humb zotësinë për të vepruar. Mendohet se në një situatë të tillë, urdhërmarrësi do të duhej të vazhdonte me zbatimin e urdhrit, përderisa trashëgimtarët, përkatësisht suksesorët e urdhërdhënësit të mund të merrnin për sipër mbrojtjen e interesave të masës pasurore të trashëguar – të fituar.¹⁵⁶

154 Bukljas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II I*. Zagreb: 1979: fq. 1792 - 1793.

155 Bukljas, Ivan dhe Boris Vizner. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II I*. Zagreb: 1979: fq. 1793.

156 Shih mbi këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1075.

533.2. Në vijim të këtij neni, paragrafi i dytë i tij, i cili ka për qëllim t'i mbrojtë interesat pasurore të urdhërdhënësit ndaj kreditorëve të urdhërmarrësit, parashikon që sendin të cilin vazhdon ta mbajë urdhërmarrësi, i cili nuk e ka shitur atë dhe as ia ka kthyer në afatin e caktuar urdhërdhënësit, nuk mund të jetë objekt sekuestrimi, përkatësisht nuk mund të jetë objekt i shitjes me dhunë nga kreditorët e urdhërmarrësit. Në teorinë juridike kjo zgjidhje ligjore shpjegohet ashtu që, nëse plotësohen kushtet e parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni, konsiderohet se urdhërmarrësi e ka blerë sendin me kushtin shtyrës, përkatësisht me gjithë faktin se urdhërmarrësi vazhdon ta mbajë sendin në posedim, akoma nuk mund të konsiderohet se ai është bërë edhe pronar i tij, derisa t'ia paguajë çmimin në tërësi urdhërdhënësit.¹⁵⁷

.....
157 Shih mbi këtë: *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I*. Beograd: 1980: fq. 1075.

*Nerxhivane Dauti***Neni 534. Nocioni**

- 1. Me kontratën për këmbimin secili kontraktues detyrohet ndaj bashkëkontraktuesit të vet ta dorëzojë sendin që këmbehet, kështu që ai të fitojë të drejtën e pronësisë.**
- 2. Objekt këmbimi mund të jenë edhe të drejtat e bartshme.**

Kontratë për këmbimin është ajo në të cilën të dy palët kontraktuese, që quhen këmbyes, detyrohen ndaj njëri-tjetrit të bartin në pronësi sendet e caktuara ose ndonjë të drejtë tjetër të pasurisë, pa ndërmjetësimin e parave. Kjo kontratë është e rregulluar në nenin 534 të LMD. Fillet (embrioni) e kësaj kontrate hasen në të drejtat e vjetra, kur është paraqitur nevoja e këmbimit të mallit me mall, kur paraja nuk paraqitet si ndërmjetësuese në qarkullimin e mallrave. Rëndësia e kësaj kontrate shfaqet në ekonominë e mbyllur natyrale, të pazhvilluar. Zbatim më të madh kjo kontratë gjen në periudhat e krizave monetare, në inflacion dhe dukuri të tjera të ngjashme, të cilat shkaktojnë mosbesimin e palëve (subjekteve) ndaj vlerës së parave si mënyrë ligjore e pagesës.¹⁵⁸ Pra, kontrata për këmbimin ka pasur rëndësi të madhe në të drejtat e vjetra, në ekonominë natyrore, të pazhvilluara ekonomikisht, në të cilat kjo kontratë paraqitet si instrument më i rëndësishëm juridik i qarkullimit të mallrave. Me paraqitjen e parave si ndërmjetësuese, si masë e përgjithshme e vlerave, kontrata për këmbimin fillon të humbë rëndësinë si instrument juridik i qarkullimit, kurse rritet rëndësia dhe vlera e kontratës për shitblerjen e mallrave, si kontratë kryesore e qarkullimit të mallrave.¹⁵⁹ Edhe pse nuk e ka rëndësinë sikurse në të drejtat e mëhershme, kjo kontratë gjen zbatim në praktikë, sidomos në rastet e komasacionit, arondimit të tokave bujqësore, në këmbimin e tokave ndërtimore, të cilat inicohen edhe me masa administrative (kur kemi të bëjmë me tokën urbane ose me zonat e caktuara industriale),¹⁶⁰ e posaçërisht ajo paraqitet në sektorin e të drejtës banesore, ku vitet e fundit gjen zbatim të madh me rastin e këmbimit të banesave. Kjo kontratë gjen shprehje edhe në qarkullimin juridik ndërkombëtar në forma të ndryshme të bashkëpunimit tekniko-shkencor dhe afarist, të kooperimi, në kontratat e kompensimit.¹⁶¹

Në kontratën për këmbimin palët kontraktuese ose këmbyesit i kanë të dy rolet, rolin e debitorit dhe të kreditorit, sepse njëra palë e ka rolin ose pozitën e debitorit, meqenëse duhet të bartë sendin ose të drejtën e palës tjetër kontraktuese, kurse e ka rolin ose pozitën e kreditorit, sepse ka të drejtë të kërkojë që të bartet pronësia e një sendi ose e drejta e pronësisë. Këmbimi i sendeve me send ose i të drejtave me të drejtën pa ndërmjetësimin e parave, vlera e tyre duhet të jetë e barabartë. Është me rëndësi të thuhet se “në kontratën për këmbimin çdo kontraktues merr përsipër detyrim ndaj kontraktuesit të vet që të dorëzojë

158 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 596.

159 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 67.

160 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 331; Komentar ZOO, Knjiga II, Bg., 1995, fq. 1006.

161 Dr. Radomir \urović, *Medjunarodno privredno pravo*, Beograd, 1994, fq. 201-205.

sendin që këmbëhet dhe në këtë mënyrë ai fiton të drejtën e pronësisë” (neni 672 al. 1 e LMD). Bartja e pronësisë bëhet në çastin e dorëzimit të sendit dhe me këtë rast bëhet diferencimi varësisht nga ajo nëse objekt i kësaj kontrate është sendi i luajtshëm a i paluajtshëm. Në rast se objekt i kësaj kontrate është sendi i luajtshëm, dorëzimi bëhet me dorëzimin faktik të tij, kurse kur lëndë e kësaj kontratë është sendi i paluajtshëm dorëzimi bëhet me regjistrimin në librat e tokës, kurse te të drejtat në të cilat ekziston tapia, kalimi i pronësisë bëhet me dorëzimin e tapisë.

Palët kontraktuese ose këmbyesit duhet ta pajtojnë vullnetin e tyre lidhur me elementet thelbësore, në mënyrë që kjo kontratë të krijojë efekte juridike. Si elemente thelbësore të kësaj kontratë paraqiten: këmbimi i sendit me send, përkatësisht këmbimi i të drejtave që njëkohësisht paraqiten edhe si objekt i kësaj kontrate. Si objekt i kontratës për këmbimin mund të jenë sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, të caktuara ose të caktueshme, të mundshme, të lejuara, në qarkullim, kurse “të drejtat të jenë të bartshme” (neni 534 parag. 2 i LMD), pra, ato të drejta të kërkimit që nuk janë të lidhura me personalitetin e subjekteve (intuitu personae).

Për vlefshmërinë e kësaj kontrate duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme për lidhjen e saj, siç janë: aftësia për të vepruar e palëve kontraktuese, pëlqimi i vullnetit të tyre, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Si kusht i veçantë që duhet të ekzistojë për plotëfuqishmërinë e kontratës për këmbimin është forma me shkrim e kontratës, në të cilën si lëndë paraqitet sendi i paluajtshëm, p.sh., kontrata për këmbimin e banesave duhet të lidhet në formën me shkrim.

Kontrata për këmbimin karakterizohet nga veçori të caktuara juridike, siç janë:

- Kontrata për këmbimin është:
- **kontratë e thjeshtë**, në përmbajtjen e së cilës përfshihen elementet e një kontrate;
- **kontratë kauzale**, meqenëse baza e saj është e njohur për palët kontraktuese dhe për personat e tretë;
- **kontratë e pavarur**, sepse pavarësisht nga kontratat e tjera, krijojnë efekte juridike ndërmjet palëve kontraktuese;
- **kontratë komutative**, sepse palët kontraktuese që nga çasti kur e lidhin kontratën i dinë të drejtat dhe detyrimet e veta dhe prestimin që duhen realizuar;
- **kontratë me emër**, sepse LMD e rregullon me dispozita të caktuara, shprehimore (me nenin 534 të LMD);
- **kontratë e dyanshme detyruese**, sepse për të dy palët kontraktuese krijohen të drejta dhe detyra të caktuara;
- **kontratë me shpërblim**, në të cilën çdo palë kontraktuese për atë që merr jep një kundërvlerë të caktuar, duke dorëzuar sendin e caktuar ose duke bartur të drejtën e caktuar;

- **kontratë konsensuale**, në rast se objekt i kontratës është sendi i luajtshëm, kurse në rast se objekt i kontratës është sendi i paluajtshëm, kjo kontratë është formale, në të cilën forma paraqitet si element thelbësor për vlefshmërinë e saj.

Neni 535. Efektet e kontratës për këmbimin

Me kontratën për këmbimin krijohen për secilin kontraktues detyrime dhe të drejta të cilat me kontratën e shitjes krijohen për shitësin.

Efektet e kontratës për këmbimin shprehen në të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese, përkatësisht të këmbyesve. Qe të dy palët kontraktuese i kanë këto detyra themelore: bartjen e të drejtës së pronësisë, dorëzimin e sendit, garantimin se sendi nuk ka mungesa juridike dhe fizike dhe pranimin e së drejtës së bartur.

Detyrimi themelor i palëve kontraktuese - këmbyesve është dorëzimi ndaj njëri-tjetrit të sendit në mënyrën, vendin dhe kohën siç janë marrë vesh me rastin e lidhjes së kontratës. Me aktin e dorëzimit të sendit bëhet kalimi i pronësisë, pasi që dorëzimi i sendit paraqet një akt material që përbëhet nga veprime të caktuara që i mundësojnë titullarit posedimin e sendit të bartur.¹⁶² Kur është fjala për sendet e luajtshme si objekt i kontratës për këmbimin, dorëzimi bëhet në çastin e lidhjes së kontratës, kurse kur objekt i kësaj kontrate është sendi i paluajtshëm, dorëzimi bëhet në vendin e regjistrimit të tij në librat e tokës ose me rastin e dorëzimit të tapisë. Me rastin e dorëzimit të banesës së këmbyer, konsiderohet se dorëzimi është bërë në çastin e vendosjes faktike në banesë.¹⁶³ Kontraktuesit janë të detyruar të bëjnë dorëzimin e sendit në vendin e caktuar me kontratën e lidhur. Shpenzimet e dorëzimit i bartin të dy palët kontraktuese deri në çastin e dorëzimit. Deri në dorëzimin e sendit palët janë të detyruara t'i dorëzojnë edhe frytet e tyre, deri në skadimin e afatit të caktuar për dorëzim. Si çështje me rëndësi për këtë kontratë është bartja e rrezikut të humbjes ose dëmtimit të sendit. Në këtë rast duhet theksuar se çdo palë e bart rrezikun e dëmtimit ose të zhdukjes së sendit deri në dorëzimin e sendit.

Është një detyrim tjetër me rëndësi ai që secili prej këmbyesve duhet të garantojë posedimin e qetë, të papenguar të sendit. Detyrimi i mbrojtjes përfshin mbrojtjen me rastin e mungesave materiale të sendit, si dhe mbrojtja nga shqetësimet juridike (eviksioni).¹⁶⁴

Marrësi i sendit në kontratën për këmbimin ka për detyrim që të ndërmarrë veprime të caktuara për marrjen e sendit të bartur. Në rast se marrësi i sendit refuzon të bëjë ekzekutimin e marrjes së sendit, ai bie në vonesë të kreditorit dhe e bart rrezikun e dëmtimit ose të zhdukjes së sendit dhe ka për detyrë të bëjë shpërblimin eventual të dëmit të shkaktuar.¹⁶⁵

¹⁶² Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 599; Komentar ZOO, Knjiga II, Bg., 1995, fq. 1010.

¹⁶³ Po aty.

¹⁶⁴ Më hollësisht shih efektet e veçanta të kontratës me shpërblim.

¹⁶⁵ Më hollësisht shih kontratën për shitblerjen.

Ruzhdi Berisha

PJESA III KONTRATA PËR DHURATËN

KREU 1 PËRKUFIZIM I PËRGJITHSHËM

Neni 536. Nocioni

- 1. Me kontratën për dhuratën një person (dhuratëdhënësi) merr përsipër që pa shpërblim të bartë të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër tek dhuratëmarrësi apo në ndonjë mënyrë tjetër të pasurojë dhuratëmarrësin nga llogaria e dhuratëdhënësit, si dhe dhuratëmarrësi të jep pëlqimin për një gjë të tillë.**
- 2. Heqja dorë nga një e drejtë konsiderohet si dhuratë, nëse personi i detyruar jep pëlqimin për këtë.**
- 3. Heqja dorë nga një e drejtë në lidhje me të cilën nuk ka ndonjë person të detyruar dhe e cila nuk është kaluar tek ndonjë person i tretë, nuk konsiderohet dhuratë.**

1. Vështrim i përgjithshëm.- Instituti i dhurimit për herë të parë në Kosovë rregullohet me dispozita pozitive me këtë Ligj. Deri në hyrjen në fuqi të LMD, në marrëdhëniet juridike të krijuara mbi bazën e institutit të dhurimit, janë aplikuar rregullat juridike¹⁶⁶. Këto kanë qenë dispozita të nxjerra në territoret e caktuara të ish-Federatës Jugosllave para 6 prillit të vitit 1941.

Në par. 1 të nenit 536 të LMD jepet kuptimi i kontratës për dhuratën në atë mënyrë që përcaktohen elementet kryesore për të, por nuk jepet kuptimi klasik i saj. Në legjislacionin e rajonit jepet përafërsisht një kuptim i ngjashëm i kontratës së dhurimit¹⁶⁷. Kuptimi

.....
166 Lidhur me marrëdhëniet juridike të krijuara përkitazi me dhurimin janë zbatuar si rregulla juridike dispozitat nga par. 938 deri 956 të Kodit të Përgjithshëm Civil (Opšti Građanski Zakonik - OGZ).

167 -Sipas Kodit Civil të R. së Shqipërisë, neni 761 par. 1, “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon”.

-Sipas Kodit të Detyrimeve (Obligaciskog Zakonika) të R. së Slovenisë, “Me kontratën e dhurimit një person (dhuratëdhënësi) detyrohet që t’ia kalojë në pronësi një personin tjetër ose ndonjë të drejtë tjetër pa pagesë ose në ndonjë mënyrë tjetër, duke pasuruar dhuratëmarrësin në ngarkesë të pasurisë së vet, kurse dhuratëmarrësi deklaron se pajtohet me këtë” – neni 533.

-Sipas Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (Zakon o Obveznim Odnosima) të R. së Kroacisë, “Kontrata për dhurimin themelohet atëherë kur dhuratëdhënësi detyrohet t’ia kalojë dhuratëmarrësit pa pagesë sendin apo të drejtën pasurore e dhuratëmarrësi këtë e pranon”.

-Sipas Kodit Civil italian, “Dhurimi është kontrata, me anë të së cilës, si pasojë e shpirtit të bujarisë, njëra palë pasuron tjetrën, duke disponuar në favor të saj ose duke marrë përsipër një detyrim kundrejt së njëjtës palë” – neni 769 (Francesco Galgano, E Drejta Private, “Luarasi”, Tiranë, 1999, f. 869).

i dhurimit është dhënë edhe në Ligjin për Trashëgiminë të Kosovës¹⁶⁸. Edhe nocionet shkencore të dhëna lidhur me kontratën e dhurimit, të cilat janë të shumta, por të ngjashme e me pakë dallime ndërmjet tyre. Duke pasur parasysh faktin se kontratën e dhurimit nuk e ka rregulluar Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve i vitit 1978, i cili është zbatuar edhe në Kosovë deri në hyrjen në fuqi të këtij Ligji, në teorinë juridike të Kosovës të pakta janë shkrimet shkencore lidhur me këtë kontratë. Kuptimi më i pranueshëm për kontratën e dhurimit do të ishte se *dhurimi është kontratë me të cilën njëra palë (dhuratëdhënësi), me dëshirë dhe pa pagesë, ia kalon palës tjetër (dhuratëmarrësit) dobinë pasurore, të cilën ai e pranon*.¹⁶⁹

Karakteristikat juridike të kontratës së dhurimit, sipas kuptimit të dhënë në nenin 536 të LMD, janë se ajo është kontratë me efekt detyrues të njëanshëm. Detyrim për dhënie ka vetëm dhuratëdhënësi. Detyrimi për sjellje të mirë i dhuratëmarrësit ndaj dhuratëdhënësit, apo edhe ndaj të afërmeve të tij, nuk është detyrim për dhënie, prandaj edhe nuk mund të marrë et se kjo kontratë është me detyrime të dyanshme, aq më pak kur me ligj shprehimisht përcaktohet se dhënia e një sendi, përkatësisht kalimi i një të drejte, bëhet pa shpërblim. Është kontratë komutative, pasi që me rastin e kontraktimit duhet të dihet objekti, vëllimi i të drejtave dhe detyrimeve, apo, së paku, ato të jenë të përcaktueshme. Mund të jetë kontratë reale në rastet kur, në momentin e lidhjes së kontratës, dorëzohet edhe sendi i cili është objekt i saj dhe konsensuale, pasi që vlefshmëria e saj nuk varet nga dorëzimi i sendit, përkatësisht dorëzimi i sendit nuk është element qenësor i kësaj kontrate. Fjala është për një kontratë të rreptë formale¹⁷⁰, vetëm në rastet e caktuara me ligj. Mund të jetë me karakteristika të kontratës *inter vivos* ose *mortis causa*. Përkitazi me kohën dhe afatin e përmbushjes së detyrimeve, kjo kontratë mund të jetë me detyrim të përmbushjes së menjëhershme ose me detyrim të përmbushjes periodike, të kohëpaskohshme¹⁷¹.

2. Me rastin e dhënies së nocionit të kontratës për dhuratën, në LMD pasqyrohen elementet qenësore përmbajtësore të kësaj kontrate. Me këtë rast përcaktohet se me këtë kontratë kalohet e drejta e pronësisë apo ndonjë e drejtë tjetër ose në ndonjë mënyrë tjetër pasurohet dhuratëmarrësi nga llogaria e dhuratëdhënësit. Në këtë mënyrë LMD nuk përcakton shprehimisht se çka mundet dhe çka nuk mund të jetë objekt i kësaj kontrate.¹⁷² Duke pasur parasysh këtë raport, kur është fjala për sendet, objekt të kontratës së dhurimit mund të jenë të gjitha sendet, të tashme edhe të ardhshme, të cilat janë në qarkullim publik dhe ndonjë

168 Neni 33 i LTK, “Në kuptim të këtij Ligji “dhurim” konsiderohet çdo heqje dorë nga një e drejtë, falje e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore ose për të themeluar apo për të zgjeruar familjen ose për të ushtruar mjeshtërinë, si dhe çdo disponim tjetër pa shpërblim”.

169 Martin Vedriš – Petar Klarić, Građansko Pravo, Nar. Nov. Zagreb, 1998 (Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 746).

170 Shih nenin 541 të LMD, ku parashikohet forma e shkruar në rastet kur dhuratëdhënësi nuk e bart menjëherë sendin apo të drejtën.

171 Shih nenin 539 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

172 KCRSH bën përkufizim vetëm lidhur me heqjen dorë nga ndonjë e drejtë, siç është heqja dorë nga trashëgimia – neni 761 par. 2, nuk përbën dhurim e mund të dhurohet vetëm pasuria e tashme e jo edhe ajo e ardhshme – neni 762. Ngjashëm kjo është e rregulluar edhe me LMD të R. së Kroacisë – neni 480.

e drejtë, nëse nuk është parashikuar ndryshe me ligj. Objekt i së drejtës së pronësisë dhe i kontratës së dhurimit mund të jetë çdo send, i luajtshëm apo i paluajtshëm dhe të drejtat trupore,¹⁷³ përpos atyre të cilat, për nga karakteristikat që kanë, nuk mund të jenë objekt i së drejtës së pronësisë.¹⁷⁴ Objekt i kontratës së dhurimit mund të jetë edhe ndonjë e drejtë si, p.sh., ndonjë e drejtë sendore, e drejta e servitutit sendor. Me rëndësi është të ekzistojë sendi që është objekt i dhurimit, përndryshe, nuk mund të ekzistojë kontrata e dhurimit të sendit i cili nuk ekziston - “Është vërtetuar se objekt i dhurimit është paluajtshmëria në të cilën është ndërtuar objekti me dy banesa. Fakti që objekti ka qenë dukshëm i dëmtuar gjatë luftës nuk mund të lërë të kuptohet se nuk ekziston objekti i dhurimit në mënyrë që të mos ekzistojë as kontrata e dhurimit.”¹⁷⁵

3. Në nenin 536 të LMD është dhënë kuptimi i kontratës së dhurimit, ashtu që, në par. 1 të tij, është përcaktuar se me këtë kontratë njëra palë, dhuratëdhënësi, merr për detyrim t’ia kalojë palës tjetër- dhuratëmarrësit, të drejtën e pronësisë mbi një send apo ndonjë të drejtë tjetër. Për të qenë diçka dhuratë, duhet të jetë pa shpërblim, gjë që nënkupton se për atë që është dhënie, sipas kësaj kontrate, nga njëra palë, nuk ka kundërdhënie nga pala tjetër. Ky është elementi qenësor i kësaj kontrate. Mirëpo, çdo dhënie pa pagesë nuk është dhuratë si, p.sh., dhënia e një sendi hua është dhënie pa pagesë, por nuk përfaqëson dhuratë. Në këtë mënyrë, për t’u konsideruar dhuratë kalimi i së drejtës së pronësisë të një sendi apo e një të drejte tjetër nga një person te tjetri, medoemos duhet të ekzistojë vullneti për dhurimin e atij sendi, përkatësisht të asaj të drejte, ashtu që, nëse një kontratë e tillë është lidhur në kushte të ekzistimit të presionit dhe detyrimit, mbi dhuratëdhënësin, mund të kërkohet anulimi i asaj kontrate. “Paditësi i cili kërkon anulimin e kontratës së dhurimit të tokës personit juridiko-shoqëror, të lidhur në kohën e zbatimit të masave të kontributit të detyrueshëm të prodhimeve bujqësore nga 10 gushti 1945 deri më 2 gusht 1952, duhet të argumentojë se ai dhurim është bërë në kushtet e ekzistimit të presionit dhe të detyrimit, për t’u aprovuar kërkesa e tij për anulimin e kontratës së dhurimit”.¹⁷⁶

Derisa kalimi i së drejtës së pronësisë së një sendi apo kalimi i ndonjë të drejte tjetër duhet të bëhet pa shpërblim, kjo nënkupton se kjo kontratë është me efekt detyrues të njëanshëm, d.m.th., vetëm për dhuratëdhënësin. Dhuratëmarrësi duhet të sillet ndaj dhuratëdhënësit dhe personave të afërm të tij me mirënjohje.¹⁷⁷ Kërkesa për sjellje të këtyllë nuk mund të konsiderohet detyrim për dhënie, si kusht për ekzistimin e kësaj kontrate, për të cilën arsye edhe nuk quhet kontratë me detyrim të dyanshëm, aq më tepër kur me ligj parashikohet shprehimisht që kjo duhet të bëhet *pa shpërblim*. Në këtë mënyrë, kontrata e dhurimit nuk bën ta parashikojë ndonjë detyrim për dhuratëmarrësin dhe për këtë arsye ajo nuk mund të shkëputet për shkak të mospërmbushjes së ndonjë detyrimi të këtyllë. Nëse eventualisht

173 Shih dispozitat nga neni 8-10 të LPDS.

174 Shih nenin 12 të LPDS.

175 Gjyk. Sup. e Kr. Rev. 760/06 dt. 11.10.2006.

176 Qëndrim juridik i Degës Civile të Gjykatës Supreme të Serbisë i marr në seancën e mbajtur më 23 nëntor 1992.

177 Për pasojat e mosmirënjohjes së thellë të dhuratëmarrësit ose të trashëgimtarëve të tij ndaj dhuratëdhënësit apo personave të afërt të tij, shih nenin 543 të LMD dhe komentnin e dhënë për këtë nen.

kontrata përmban ndonjë element të dhënies së shpërblimit për shkak të kalimit të së drejtës së pronësisë së një sendi apo të ndonjë të drejte tjetër, atëherë kjo lë të kuptohet se, nën formën e kontratës për dhuratën, fshihet ndonjë kontratë tjetër, e cila gjithsesi do të kishte prodhuar efekte të tjera juridike për palët ose eventualisht edhe për personat e tjerë. Kjo edhe mund do të ndodhë për shkak të formës së parashikuar ligjore të njëres apo tjetres kontratë, për shkak të kushteve dhe afateve të parashikuara ligjore për kundërshtim¹⁷⁸ etj. Përpos me kalimin e së drejtës së pronësisë të një sendi apo të një të drejte, ekziston mundësia që me kontratën e dhurimit, në ndonjë mënyrë tjetër, të pasurohet dhuratëmarrësi nga pasuria e dhuratëdhënësit.

Vetë fakti që, sipas kësaj dispozite ligjore, dhuratëdhënësi me këtë kontratë mund ta kalojë të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejte tjetër ose, në ndonjë mënyrë tjetër, ta pasurojë dhuratëmarrësin, lë të kuptohet se objekt i kësaj kontrate mund të jenë të gjitha sendet dhe të drejtat të cilat janë në qarkullim, përpos nëse me ligj nuk parashikohet ndryshe. Nga kjo rrjedh se objekt i kësaj kontrate mund të jenë si sendet e tashme, ashtu edhe sendet e ardhshme (p.sh., frytet e pritura nga një send).

4. Përpos vullnetit të lirë të dhuratëdhënësit, për vlefshmërinë e kontratës së dhurimit kërkohet edhe dhënia e pëlqimit për dhurimin nga ana e dhuratëmarrësit. Nga kjo rrjedh se, edhe pse kjo kontratë është me efekt detyrues të njëanshëm – vetëm për dhuratëdhënësin, për të qenë ajo e vlefshme, duhet përmbushur kushti i përgjithshëm për vlefshmërinë e kontratave – pajtimi i dy vullneteve, në rastin konkret ekzistimi i vullnetit për një gjë të tillë i të dy palëve kontraktuese, edhe në anën e dhuratëmarrësit. Shprehja e vullnetit të këtillë nga dhuratëmarrësi duhet të bëhet me dhënien e pëlqimit për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi një send apo të ndonjë të drejte tjetër ose për pasurimin e tij në ndonjë mënyrë tjetër. Pa dhënien e këtij pëlqimi nga dhuratëmarrësi, nuk ka kontratë për dhuratën. Koha dhe dhënia e pëlqimit nuk është e përcaktuar me ligj, ashtu që, sipas praktikës gjyqësore, lejohet mundësia që dhënia e pëlqimit të bëhet edhe pas vdekjes së dhuratëdhënësit (kjo do të ndodhë në rastet kur dhuratëdhënësi ka bërë një ofertë për dhurim në formën e parashikuar ligjore dhe para marrjes së pëlqimit nga dhuratëmarrësi, vdes).

5. Në par. 1 të nenit 536 të LMD është rregulluar kontrata për dhuratën në bazë të kalimit të së drejtës së pronësisë apo të ndonjë të drejte tjetër ose me pasurimin e dhuratëmarrësit në ndonjë mënyrë tjetër nga dhuratëdhënësi. Kjo nënkupton kontratën e dhurimit me dhënie, përkatësisht me kalimin e një të drejte. Në par. 2 të këtij neni parashikohet mundësia e kontratës së dhurimit kur një person *heq dorë* nga një e drejtë, të cilën një person tjetër e ka detyrim ndaj tij. Në rastet më të shpeshta kjo ndodh me faljen e borxhit nga ana e kreditorit ndaj debitorit. Derisa kreditori, sipas ligjit, ka të drejtë të kërkojë nga debitori kthimin e borxhit, heqja dorë nga kjo e drejtë konsiderohet dhuratë. Për të qenë e vlefshme një kontratë e tillë e dhurimit, edhe në këtë rast është e nevojshme dhënia e pëlqimit për këtë nga personi i cili e ka pasur këtë detyrim.

178 Te të disponuarit pa shpërblim, çfarë është edhe dhurimi, konsiderohet se debitori e ka ditur se me ndërmarrjen e veprimit të disponimit të një sendi apo të një të drejte po i shkakton dëm kreditorit. Prandaj, për kundërshtimin e këtyre veprimeve juridike nuk kërkohet që personi i tretë të ketë ditur për qëllimin e debitorit ose ka mundur të dijë, siç është parashikuar në nenin 262 par. 3 të LMD.

6. Për të ekzistuar dhe për t'u realizuar një e drejtë, duhet të ekzistojë personi i cili ka detyrimin ta përmbushë atë të drejtë, përkatësisht që një detyrim i tillë të ketë kaluar te personi i tretë. Sipas par. 3 të nenit 536 të LMD, nuk konsiderohet dhuratë heqja dorë nga një e drejtë përkitazi me përmbushjen e së cilës nuk ekziston detyrimi i personit të caktuar, përkatësisht ai detyrim nuk ka kaluar mbi personin e tretë. Ekziston mundësia që personi i caktuar të ketë pësuar dëm, nga edhe do të kishte të drejtën e shpërblimit të atij dëmi. Derisa nuk vërtetohet detyrimi për ndonjë bazë ligjore i personit të caktuar për shpërblimin e atij dëmi, heqja dorë nga e drejta e shpërblimit të këtij dëmi nuk mund të konsiderohet kontratë për dhuratën, pasi që nuk ekziston pala tjetër, së cilës i bëhet ky dhurim.

Neni 537. Shpërblimi

Konsiderohet kontratë e dhuratës shpërblimi ose detyrimi moral i dhuratëdhënësit nëse dhuratëmarrësi nuk ka pasur të drejtë të kërkojë lëndën e këtij detyrimi me anë të padisë.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Shpërblimet e ndërsjella mes personave të ndryshëm bëhen në mënyra të ndryshme dhe për arsye të shumta. Veçanërisht kjo ndodh ndërmjet personave në afërsi gjinore, të gjakut, të krushqisë apo civile, por mund të ndodhë edhe ndërmjet personave të tjerë. Karakteristika kryesore e dhurimit është që kalimi i së drejtës së pronësisë apo e ndonjë të drejte tjetër të bëhet pa shpërblim. Mirëpo, për t'u konsideruar dhurim, nuk mjafton vetëm fakti që kalimi të bëhet pa shpërblim ngase çdo dhënie pa shpërblim nuk është dhurim.

2. Në bazë të nenit 537 të LMD, dhurim do të konsiderohet edhe çdo shpërblim, përkatësisht dhënie e dhuratëdhënësit, në qoftë se dhuratëmarrësi nuk ka pasur të drejtë të kërkojë me anë të padisë atë që ka marrë. Kjo nënkupton se, edhe në rastet kur dhuratëdhënësi e kalon një të drejtë të pronësisë mbi një send ose ndonjë të drejtë tjetër te një person i caktuar, duke konsideruar se ka detyrim moral për atë që bën, edhe pse për këtë mungon detyrimi juridik, konsiderohet kontratë e dhurimit. Mbi këtë bazë, nuk përjashtohet mundësia që dikush të nxitet në aktin e dhurimit nga dëshira për të shfaqur një mirënjohje me dhënien e një shpërblimi, p.sh., sepse në një rast është ndihmuar duke iu shpëtuar jeta apo në një rast sëmundjeje. Për këtë dhuratëdhënësi nuk ka pasur kurrfarë detyrimi juridik ndaj dhuratëmarrësit, prandaj edhe atë që ka marrë nuk ka pasur mundësi ta realizojë me padi, prandaj shpërblimi i dhënë në këtë rast dhe për këtë arsye konsiderohet dhurim, ashtu që në këtë marrëdhënie juridike të krijuar do të zbatohen rregullat e parashikuara me ligj për kontratën për dhuratën. Dhënia e ushqimit personit të caktuar nga dhuratëdhënësi që konsideron se e ka detyrim moral këtë, edhe pse për këtë nuk ka pasur detyrim ligjor, do të konsiderohet kontratë e dhurimit.

Në mënyrë të veçantë e ka natyrën e aktit të njëanshëm dhurimi i bërë për shkak të fejesës ose martesës. Ky mund të jetë dhurim i ndërsjellë mes të fejuarve apo bashkëshortëve të

ardhshëm ose dhurimet nga të tretët në favor të tyre. Për ekzistimin e dhurimeve nuk është i nevojshëm pranimi i dhuratëmarrësit; për ekzistimin e këtij dhurimi mjafton vetëm fakti i fejesës, përkatësisht martesës. Duke pasur parasysh faktin se dhurimet e këtilla zakonisht bëhen mbi bazën e detyrimit moral, në bazë të zakoneve të mjedisit, shpërblimet e këtilla konsiderohen dhurime. Nëse fejesa nuk përfundon me martesë, fati i dhurimeve të ndërsjella ndërmjet të fejuarve është rregulluar me Ligjin për Familjen të Kosovës (LFK),¹⁷⁹ ashtu që secili nga ata mund të kërkojë nga tjetri kthimin e dhuratave, të cilat i ka dhënë me rastin e fejesës, në bazë të rregullave për pasurimin pa bazë të këtij Ligji (neni 194 – 202).¹⁸⁰

Në rastet kur detyrimet e këtilla bëhen me rastin e martesës, baza e detyrimeve të këtilla është martesë, si element qenësor i kontratës, kështu që me shkurorëzimin e asaj martesës, bie edhe motivi i cili përfaqëson kauzën mbi të cilën është mbështetur kjo punë juridike, prandaj në kuptim të nenit 39 par. 4 të LMD¹⁸¹, kontrata për dhuratën, në raste të tilla është nule, për të cilën arsye bashkëshortet kanë detyrimin të kthejë në sendet e marra në emër të dhurimit mbi bazën e martesës.

Neni 538. Dhurata e përzier

Nëse me të njëjtën kontratë apo me kontratë tjetër, dhuratëmarrësi detyrohet të pasurojë dhuratëdhënësin¹⁸² do të konsiderohet si kontratë e dhurimit vetëm në lidhje me vlerën shtesë.

1. Vështrim i përgjithshëm.- Subjektet në marrëdhënie të ndryshme afariste të ndërsjella ndërmarrin veprime të ndryshme juridike me qëllim të rregullimit të këtyre marrëdhënieve ndërmjet tyre. Në rastet kur vlera e përmbushjes së detyrimeve të ndërsjella mes palëve është e ndryshme, me rastin e kontraktimit të këtyre marrëdhënieve, mund të paraqitet kontrata për dhuratën bashkë me ndonjë kontratë tjetër me karakter detyrues për të dy palët.

2. Me nenin 538 të LMD rregullohet kuptimi i punëve juridike me detyrim të dyanshëm, në të cilat vlera e detyrimeve të ndërsjella është e ndryshme, ashtu që ndryshimi i vlerës do të konsiderohet dhurim, në qoftë se ka ekzistuar qëllimi dhe vullneti i dhuratëdhënësit për dhurimin e asaj pjese të ndryshimit të vlerës. Kontratat e këtilla për dhuratën mund të paraqiten në të njëjtën kontratë në të cilën janë rregulluar të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve ose në një kontratë tjetër me elemente vetëm të kontratës për dhuratën. Në këtë mënyrë, në një kontratë me detyrime të dyanshme ndërmjet palëve, me dispozitë të veçantë

179 Shih nenin 13 të LFK

180 Shih dispozitat nga neni 194 – 202 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene nga Komentari i LMD (pjesa e përgjithshme).

181 Shih komentin e dhënë për këtë nen në Komentari i LMD (pjesa e përgjithshme).

182 Nga përmbajtja e dispozitës ligjore shihet se në këtë rast gabimisht janë përdorur shprehjet “dhuratëmarrës” dhe dhuratëdhënës”, ashtu që aty ku është thënë “dhuratëmarrës” duhet të qëndrojë “dhuratëdhënës” dhe e kundërta.

në kuadër të saj, mund të parashikohet dhurimi i ndryshimit të vlerës ndërmjet detyrimeve të ndërsjella të palëve kontraktuese. Në këtë rast kjo kontratë me detyrime të dyanshme mes palëve do të konsiderohet si kontratë e dhurimit vetëm në lidhje me ndryshimin e vlerës së detyrimeve të ndërsjella të palëve. Dhurimi i këtillë i ndryshimit nga detyrimet e ndërsjella të palëve kundrejt një marrëdhënieje afariste, mund të rregullohet dhe të parashikohet edhe me një kontratë tjetër të veçantë.

Në të dy rastet kontrata duhet t'i përmbajë elementet qenësore të kontratës së dhurimit dhe kjo nënkupton se duhet patjetër të ekzistojë objekti i dhurimit, qëllimi dhe vullneti i dhuratëdhënësit për dhurimin e ndryshimit të vlerës mes detyrimeve të ndërsjella dhe vullneti i dhuratëmarrësit për pranimin e tij.

Neni 539. Përmbushja periodike

Nëse detyrimet e dhuratëdhënësit përbëjnë përmbushje të kohëpaskohshme, ky detyrim shuhet me vdekjen e dhuratëdhënësit.

1. *Vështrim i përgjithshëm.* - Sa u përket afateve të përmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga kontrata e dhurimit, me këtë kontratë mund të parashikohet përmbushja e menjëhershme, siç ndodh zakonisht, ose përmbushja periodike, e kohëpaskohshme.¹⁸³ Nëse përmbushja e detyrimit do të jetë e përnjëhershme ose periodike, varet nga ajo se si palët merren vesh me kontratë, si dhe nga vetë natyra e objektit të dhurimit.¹⁸⁴ Në nenin 539 të LMD është rregulluar fati detyrimeve periodike të dhuratëdhënësit pas vdekjes së tij.

2. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse detyrimet e dhuratëdhënësit janë periodike, detyrimi në emër të dhurimit duhet përmbushur në afate të caktuara; me vdekjen e dhuratëdhënësit shuhet edhe detyrimet e tij ndaj dhuratëmarrësit. Kjo nënkupton se detyrimet periodike nga dhurimet të cilat duhen përmbushur në afate të caktuara, si rregull, nuk kalojnë te trashëgimtarët, ngase ato shuhet me vdekjen e dhuratëdhënësit. Shtrohet pyetja se çfarë do të ndodhë kur është parashikuar ndryshe në vetë kontratën e dhurimit, përkatësisht nëse me kontratë është parashikuar që detyrimi periodik ndaj dhuratëmarrësit do të vazhdojë edhe pas vdekjes së dhuratëdhënësit? LMD nuk i rregullon situatat e këtilla me një dispozitë ligjore të veçantë.¹⁸⁵ Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se një dispozitë e këtillë kontraktuese nuk është në kundërshtim me ligjin, në raste të tilla përmbushja e detyrimit u kalon trashëgimtarëve të dhuratëdhënësit, ashtu që me këtë ngarkohet trashëgimia e

183 Shih komentin e dhënë lidhur në nenin 536 të LMD.

184 Detyrim me karakter të përmbushjes periodike për shkak të natyrës së objektit të dhurimit do të ishte detyrimi për ushqim, i cili duhet paguar në afate të caktuara (zakonisht çdo muaj), dhënia në shfrytëzim e një sendi për një kohë më të gjatë etj.

185 Kodi Civil i R. së Shqipërisë këtë situatë e ka rregulluar me një dispozitë të veçantë, ashtu që në nenin 763 parashikohet: "Dhurimi, që ka për objekt detyrimet periodike, shuhet me vdekjen e dhuruesit, përveç rasteve kur në kontratë është parashikuar ndryshe".

cila kalon mbi trashëgimtarët. Sipas LTK, trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet që e ngarkojnë trashëgiminë në përpjesëtim me pjesën e tyre dhe deri në vlerën e pjesës së tyre trashëgimore.¹⁸⁶

Neni 540. Përgjegjësia e dhuratëdhënësit për dëmin

- 1. Secili që me dijeni jep sendin e tjetrit si dhe ia fsheh këtë rrethanë dhuratëmarrësit është përgjegjës për dëmin.**
- 2. Nëse sendi i dhuruar ka një të metë apo ndonjë veçori të rrezikshme si pasojë e së cilës i është shkaktuar dëmi dhuratëmarrësit, apo të tretit të dëmtuar, përgjegjës për këtë dëm është dhuratëdhënësi nëse dhuratëdhënësi ka qenë në dijeni apo është dashur të jetë në dijeni për të metën apo veçorinë e rrezikshme dhe për këtë nuk e ka lajmëruar dhuratëmarrësin.**

1. Vështrim i përgjithshëm. - Kontrata për dhurimin është një akt juridik i njëanshëm, me të cilin vetëm njëra palë ka detyrime ndërsa pala tjetër ka vetëm përfitim e jo edhe detyrim.¹⁸⁷ Nisur nga natyra e këtillë e kësaj kontrate, për dallim nga kontrata e shitjes, dhuratëdhënësi nuk ka kurrfarë detyrimi ndaj dhuratëmarrësit për të metat materiale¹⁸⁸ dhe juridike¹⁸⁹ të sendit, i cili ka qenë objekt i dhurimit. Nëse dhuratëdhënësi e ka dhuruar sendin e huaj dhe për këtë gjë nuk ka ditur e as që ka mund të dijë, ai nuk ka përgjegjësi ndaj dhuratëmarrësit; normalisht, ka përgjegjësi ndaj personit të tretë i cili ka ndonjë të drejtë sendore mbi sendin e dhuruar. Në rastet kur dhuratëdhënësi e ka dhuruar sendin e huaj, kurse dhuratëmarrësi për këtë ka ditur apo është dashur të dijë, në atë rast nuk ka as kontratë për dhuratën, ashtu që nuk ekziston as përgjegjësia e dhuratëdhënësit lidhur me atë kontratë. Në këtë mënyrë, dhuratëdhënësi nuk ka përgjegjësi ndaj dhuratëmarrësit për të metat materiale dhe juridike të objektit të kontratës, por ai është përgjegjës për dëmin i cili rrjedh nga kjo arsye, me kusht që, me qëllim ose nga pakujdesia, t’ia ketë dhënë dhuratëdhënësit sendin e rrezikshëm.

Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar përgjegjësia e dhuratëdhënësit ndaj dhuratëdhënësit për dëmin eventual shkaktuar këtij të fundit nga sendi që ka qenë objekt dhurim.

2. Edhe pse kjo dispozitë ligjore përmban dy paragrafë, ata nuk kanë ndonjë ndryshim mes tyre, ashtu që paragrafi i dytë vetëm e plotëson të parin. Ekziston mundësia që dhuratëmarrësi apo ndonjë person i tretë të pësojë dëm nga sendi që ka qenë objekt i dhurimit, për shkak të ndonjë veçorie të rrezikshme që ka ai në krahasim me sendet e tjera të llojit të njëjtë. Përgjegjësia e dhuratëdhënësit në këtë rast kushtëzohet nga fakti nëse ai

¹⁸⁶ Shih nenin 119 të LTK lidhur me atë se çka e ngarkon trashëgiminë. Sipas par. 2 të këtij neni, këtu bëjnë pjesë edhe borxhet personale të trashëgimlënësit. Përmbushja periodike e dhurimit e parashikuar në kontratë përfaqëson borxh të trashëgimlënësit.

¹⁸⁷ Shih nenin 536 dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

¹⁸⁸ Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 461 – 499.

¹⁸⁹ Shih dispozitat nga neni 491 – 498 të këtij Ligji.

ka ditur për këtë rrethanë dhe atë ia ka fshehur qëllimisht dhuratëmarrësit. Pra, paragrafit 1 i këtij neni parashikon në mënyrë të përgjithshme se dhuratëdhënësi është përgjegjës për dëmin që i ka shkaktuar dhuratëmarrësit nga sendi që ka qenë objekt dhurimi, nëse ka qenë në dijeni për mundësinë e shkaktimit të dëmit nga ai send dhe këtë rrethanë ia fsheh dhuratëmarrësit. Nga kjo rrjedh se, për të qenë përgjegjës dhuratëdhënësi për sendin e dhuruar, duhet të ketë ditur për mundësinë e shkaktimit të dëmit nga sendi i dhuruar dhe që atë t'ia ketë fsheh dhuratëmarrësit.

3. Siç u përshkrua më sipër, dhuratëdhënësi nuk mban përgjegjësi për të metat materiale apo juridike të cilat i ka sendi i dhuruar. Mirëpo, nëse sendi i dhuruar ka ndonjë të metë ose ndonjë veçori të rrezikshme, për pasojë të së cilës është shkaktuar dëmi, përgjegjës është dhuratëdhënësi, në qoftë se ka qenë apo është dashur të jetë në dijeni për të metën apo veçorinë e rrezikshme të tij dhe për këtë të mos e ketë njoftuar dhuratëmarrësin. Nëse ka ditur apo është dashur të dijë për të metën dhe veçorinë e rrezikshme të sendit të dhuruar dhe e fsheh atë fakt ndaj dhuratëdhënësit, veprimi i tij nuk është në harmoni me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë¹⁹⁰ dhe me parimin e ndalimit të shkaktimit të dëmit,¹⁹¹ për të cilën arsye ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga ai send. Dëmi nga sendi i dhuruar mund t'i jetë shkaktuar dhuratëmarrësit ose ndonjë personi të tretë. Në rastet e këtilla, dhuratëdhënësi është përgjegjës për dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar qoftë dhuratëmarrësit, qoftë një personi të tretë.

KREU 2 FORMA

Neni 541. Forma

- 1. Nëse dhuratëdhënësi nuk e bartë menjëherë sendin apo të drejtën tek dhuratëmarrësi në mënyrë që dhuratëmarrësi të disponojë me të pa pengesa, atëherë kontrata e dhuratës duhet të jetë në formë të shkruar.**
- 2. Nëse kontrata e dhuratës nuk është lidhur në formën e përcaktuar në paragrafin paraprak, dhuratëmarrësi nuk mund të kërkojë me anë të padisë përmbushjen e saj.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.* - Një nga kushtet për të qenë e vlefshme një punë juridike është që ajo të mos ketë të meta formale. Për punët e caktuara juridike parashikohet *forma e caktuar ligjore*, prandaj puna juridike duhet të lidhet në formën e parashikuar me ligj. Në mungesë të formës së parashikuar me ligj, puna juridike është nule. Kjo rregull vlen edhe për kontratën për dhuratën.

190 Shih nenin 4 të LMD.

191 Shih nenin 9 të LMD.

2. Te kontrata për dhuratën kushtëzimi ligjor i formës së caktuar varet nga mundësia e marrjes në pushtetin faktik, me mundësinë e disponimit pa pengesa të sendit që është objekt i kësaj kontrate. Në këtë mënyrë, nëse dhuratëdhënësi në momentin e lidhjes së kontratës nuk e kalon (në ligj përdoret shprehja “*bartje*”) sendin apo të drejtën të dhuratëmarrësi, në mënyrë që ai ta disponojë atë pa pengesa, kontrata e dhurimit duhet të jetë në formën e shkruar. Nëse një send do të mund të kalojë menjëherë nga një person në posedimin dhe disponimin e personit tjetër, varet nga natyra dhe karakteristikat e atij sendi. Kësisoj, kalimi i menjëhershëm në posedim dhe disponim nga një person në tjetrin është i mundshëm në rastet kur objekt dhurimi është sendi i luajtshëm. Me kalimin e vërtetë të sendeve të luajtshme duhet nënkuptuar kalimi me të cilin dhuratëmarrësi bëhet posedues i vetëm i atij sendi, kurse me faktin e marrjes në posedim fiton edhe të drejtën e pronësisë¹⁹². Pra, në rastet kur objekt dhurimi janë sendet e luajtshme, nëse dhuratëdhënësi ia dorëzon sendin e dhuruar në posedim dhuratëmarrësit, në mënyrë që ai të mund ta disponojë atë send, sipas ligjit, nuk kërkohet forma e veçantë e kontratës. Përndryshe, në rastet kur sendi nuk i dorëzohet në posedim dhuratëdhënësit, kontrata duhet të jetë në formën e shkruar. Kësisoj, sipas kësaj dispozite ligjore, në rastet kur objekt i kontratës së dhurimit është sendi i luajtshëm, vlen rregulla e përgjithshme e joformalitetit të kontratave, gjë që nënkupton se ajo mund të jetë në çfarëdo forme, përveç nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.¹⁹³

Edhe pse shprehimisht nuk është përcaktuar me këtë dispozitë ligjore, në bazë të formulimit të këtillë të kësaj dispozite ligjore rrjedh se, për vlefshmërinë juridike të kontratës për dhurimin e sendeve të paluajtshme, ajo duhet të jetë e formës së shkruar.¹⁹⁴ Kjo rrjedh nga vetë fakti se për kalimin në posedim, me mundësi të disponimit të një sendi të paluajtshëm, parashikohen rregulla të veçanta me ligje të tjera të veçanta, ashtu që kalimi i menjëhershëm i sendit të paluajtshëm nga dhuratëdhënësi me mundësi të disponimit të tij nga ana e dhuratëmarrësit nuk është i mundur. Mundësi për të disponuar një send ka vetëm pronari i atij sendi.¹⁹⁵ Për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send, përpos bazës së vlefshme juridike, është e nevojshme edhe mënyra e fitimit. Derisa te sendet e luajtshme, si mënyrë e fitimit është fakti i dorëzimit të sendit, te sendet e paluajtshme, për kalimin e së drejtës së pronësisë, përpos punës së vlefshme juridike, kërkohet edhe regjistrimi i pronësisë në Regjistrin e të drejtave mbi paluajtshmëritë.¹⁹⁶ Regjistrimi i paluajtshmërisë në Regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme mund të bëhet në bazë të kontratës për kalimin e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent.¹⁹⁷ Nga kjo rrjedh se, sa i përket formës së kontratës së dhurimit në rastet kur objekt i kontratës janë sendet e

192 Sipas nenit 21 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS) për fitimin e pronësisë në një send të luajtshëm është e nevojshme një punë juridike e vlefshme dhe dorëzimi në posedim i sendit te fituesi i pronësisë.

193 Shih nenin 51 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

194 Shih nenin 57 të LMD.

195 Shih nenin 18 të LPDS.

196 Shih nenin 36 të LPDS.

197 Shih nenin 4 të Ligjit nr. 04/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

paluajtshme, si formë e rregullt e kontratës duhet të jetë forma e shkruar, me nënshkrimet të palëve kontraktuese të vërtetuara nga organi kompetent - notari. Derisa me ligj kjo nuk është kërkuar, por kërkohet vetëm të jetë në formë të shkruar, rrjedh se juridikisht është e vlefshme edhe kontrata në formë të shkruar, pa vërtetimin e nënshkrimeve të palëve kontraktuese. Për kalimin e së drejtës së pronësisë, do të duhej iniciuar një kontest i veçantë civil për vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi bazën ligjore të dhurimit. Me KCRSH parashikohet shprehimisht që dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm.¹⁹⁸

3. Kontrata për dhuratën është kontratë me detyrim të njëanshëm. Vetëm dhuratëdhënësi ka detyrim ta përmbushë detyrimin e marrë përsipër me këtë kontratë. Në rastet kur sipas kontratës së dhurimit nuk është bërë dorëzimi i sendit të dhuruar, dhuratëmarrësit i përket e drejta të paditë dhe të kërkojë nga dhuratëdhënësi të përmbushë detyrimin e marrë përsipër me këtë kontratë. Sipas par. 2 të nenit 541, në rastet kur kontrata e dhuratës nuk është lidhur në formën e përcaktuar sipas par. 1 të këtij neni, dhuratëmarrësi nuk mund të kërkojë përmbushjen e saj me padi nëpërmjet të gjykatës, pasi që konsiderohet se kontrata e dhuratës nuk ekziston.

KREU 3 REVOKIMI I KONTRATES SE DHURATES

Neni 542. Revokimi për shkak të varfërimit

- 1. Dhuratëdhënësi i cili pas realizimit të kontratës së dhuratës, bie në pozitë të tillë ku i rrezikohet mbijetesa mund ta revokojë kontratën e dhuratës.**
- 2. Revokimi i përcaktuar në paragrafin paraprak nuk është i mundshëm nëse si pasojë e kësaj dhuratëmarrësi do të jetë në pozitë ku i rrezikohet mbijetesa.**
- 3. Dhuratëmarrësi mund ta mbajë dhuratën nëse dhuratëmarrësi i siguron dhuratëdhënësit mjetet e jetesës.**

1. Vështrim i përgjithshëm.- Si rregull, nuk mund të kërkohet kthimi i asaj që është dhënë në bazë të kontratës për dhuratën. Diçka e këtillë nuk parashikohet shprehimisht në LMD. Mirëpo, ky konstatim rrjedh nga dispozitat e neneve 542,543 dhe 544 të këtij Ligji. Kontrata e dhuratës është një kontratë specifike, ashtu që edhe me dispozitat ligjore të sipërpërmendura janë parashikuar arsyet e veçanta, në praninë e të cilave mund të bëhet revokimi i kësaj kontrate. Me Kodin e Përgjithshëm Civil (OGZ) dispozitat e të cilit janë zbatuar para hyrjes në fuqi të këtij Ligji,¹⁹⁹ kanë qenë të parashikuara disa arsye për të cilat

198 Shih nenin 764 të KCRSH.

199 Shih komentimin e dhënë në vështrimin e përgjithshëm të nenit 536 të LMD.

ka mundur të revokohet dhurimi.²⁰⁰ Me LMD janë parashikuar tri shkaqe për të cilat mund të revokohet kontrata e dhuratës: a. varfërimi, b. mosmirënjohja e thellë dhe c. lindja e fëmijës pas dhurimit. Në bazë të LMD, *varfërimi, mosmirënjohja e thellë dhe lindja e fëmijës së dhuratëdhënësit pas dhurimit, nuk janë arsye për anulimin e kontratës, por përbëjnë arsye për revokimin, përkatësisht për shkëputjen e kontratës së dhurimit.*

2. Në nenin 542 të LMD është parashikuar mundësia e revokimit të kontratës së dhurimit për shkak të varfërimit. Sipas par. 1 të këtij neni, dhuratëdhënësi ka të drejtë ta revokojë kontratën për dhuratën nëse, pas dhurimit të bërë, i keqësohet pozita pasurore dhe ekonomike deri në atë masë saqë i rrezikohet mbijetesa. Kjo nënkupton se revokimi i kontratës së dhurimit për këtë shkak mund të bëhet vetëm në rastet kur dhuratëdhënësi e ka përmbushur paraprakisht detyrimin e përcaktuar në atë kontratë, e ka kaluar të drejtën e pronësisë mbi një send ose ndonjë të drejtë tjetër të dhuratëmarrësi. Në anën tjetër, për të pasur të drejtë ta revokojë dhurimin e bërë, duhet të ketë ndryshuar gjendja materiale e dhuratëdhënësit për të keq, ashtu që të ai të jetë varfëruar deri në atë masë saqë i është rrezikuar mbijetesa, duke mos pasur mjete për ushqim të domosdoshëm, gjë që nënkupton gjërat elementare të jetesës. Shkalla e varfërisë duhet vlerësuar në bazë të kriterit objektiv, që nënkupton mungesën e mundësisë për plotësimin e nevojave të domosdoshme për jetë, pavarësisht nga standardi i jetesës të cilin e ka pasur dhuratëdhënësi para dhurimit të bërë. Rrezikimi i mbijetesës do të përfshinte jo vetëm për dhuratëdhënësin, por edhe anëtarët e familjes të cilët janë të varur nga ai, ndaj të cilëve ka detyrim ligjor për ushqim. Arsyet për të cilat dhuratëdhënësi ka ardhur në këtë gjendje nuk janë me rëndësi; me rëndësi është që ai është varfëruar dhe ka ardhur në këtë gjendje. Nuk është përkufizuar as afati nga dhurimi i bërë, brenda të cilit dhuratëdhënësi mund të kërkojë revokimin e kontratës së dhurimit, ashtu që revokimi i dhurimit mund të bëhet pavarësisht nga koha e kaluar nga dita e dhurimit.²⁰¹ Nga kjo rrjedh se, sipas par. 1 të nenit 542 të LMD, për ta revokuar kontratën për dhuratën për shkak të varfërimit, duhen plotësuar së bashku dy kushte: 1. kontrata të jetë realizuar paraprakisht, dhuratëdhënësi ta ketë përmbushur detyrimin²⁰² dhe 2. që dhuratëdhënësi të jetë varfëruar në atë masë saqë t'i jetë rrezikuar mbijetesa.

200 Sipas Kodit të Përgjithshëm Civil (LPC) – par. 947 deri 954, dhurimi i bërë ka mund të revokohet: a) për shkak të varfërimit të skajshëm (sipas LMD neni 542), b. për shkak të mosmirënjohjes së thellë (sipas LMD neni 543), c. për shkak të lindjes së fëmijës pas dhurimit të bërë (sipas LMD neni 544), ç. për shkak të cenimit të detyrimit për ushqim, d. në rast të anulimit të martesës, nëse dhuratëdhënësi nuk ka ditur për arsyen nga e cila martesë është anuluar ndërsa dhuratëdhënësi ka ditur dhe dh. në rast të shkurorëzimit me fajin e dhuratëmarrësit.

201 Me LMD të R. së Kroacisë 2005 është përfshirë mundësia e revokimit të dhurimit dhe e paraqitjes së kërkesës për kthimin e dhuratës, nëse dhuratëdhënësi e ka sjellë veten në atë gjendje materiale me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë dhe pas kalimit të afatit prej dhjetë vjetësh nga dita e dhënies së dhurimit për sendet e paluajtshme dhe pesë vjet për sendet e luajtshme.

202 Nëse dhuratëdhënësi e ka lidhur kontratën në formën e parashikuar në nenin 541 por nuk është bërë kalimi i sendit apo së drejtës sipas asaj kontrate, dhuratëdhënësi do të kishte të drejtë të kërkonte përmbushjen e saj. Mirëpo, në qoftë se dhuratëdhënësi ndërkohë, para përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në atë kontratë, është varfëruar në atë masë, edhe nëse është kërkuar përmbushja me padi, një kërkesë e tillë nuk do të aprovohej.

3. Derisa në paragrafin e parë të këtij neni revokimi i dhurimit kushtëzohet me gjendjen ekonomike të dhuratëdhënësit, në paragrafin e dytë të tij revokimi i dhurimit kushtëzohet nga gjendja ekonomike e dhuratëmarrësit. Në këtë mënyrë, dhuratëdhënësi nuk ka të drejtën e revokimit të kontratës për shkak të varfërimit të vet, në qoftë se revokimi i kontratës për dhuratën do të kishte për pasojë rrezikimin e mbijetesës për dhuratëmarrësin. E gjithë ajo që u tha në paragrafin paraprak për rrezikimin e mbijetesës së dhuratëdhënësit dhe anëtarëve të familjes, për ushqimin e të cilëve ka detyrim dhuratëdhënësi, sipas këtij paragrafi, në mënyrë analoge vlen edhe për dhuratëmarrësin.

4. Sipas par. 3 të këtij neni, dhuratëmarrësi ka të drejtë ta mbajë, përkatësisht të mos e kthejë dhuratën e marrë, në qoftë se dhuratëdhënësit ia siguron mjetet për përmbushjen e nevojave të domosdoshme. Kjo do të kishte të bënte me rastet kur dhuratëdhënësi është varfëruar në atë masë, siç është parashikuar në par. 1 të këtij neni, kurse dhurata është me vlerë të madhe ose me rëndësi të veçantë për dhuratëmarrësin, për të cilën arsye dhuratëdhënësi ka të drejtë ta mbajë dhuratën, me kusht që t'i sigurojë dhuratëdhënësit mjetet e domosdoshme të jetesës.

5. E drejta për revokimin e kontratës për dhurimin në LMD nuk është kushtëzuar me mundësinë e dhënies së ushqimit ligjor të ushqimdhënësit nga personat të cilët me ligj e kanë këtë detyrim. Për këtë arsye konsiderojmë se, me rastin e marrjes së vendimit, nuk është me ndikim nëse ka ose jo mundësi të kontribuojë për mbijetesën e dhuratëdhënësit dikush nga personat që kanë detyrim ligjor për ushqimin e tij.

Nga praktika gjyqësore

Revokimi i dhurimit për shkak të varfërimit është i arsyeshëm, pasi që është vërtetuar se paditësja në moshën 49 vjeçare ka mbetur pa banesë dhe pa krejt pasurinë që e ka pasur, meqë edhe situata materiale e saj është përkeqësuar në mënyrë drastike në krahasim me gjendjen që ka pasur në kohën kur e ka bërë dhurimin, rrjedhimisht i është rrezikuar mbijetesa.²⁰³

Në situatën kur paditësi, edhe pas lidhjes së kontratës për dhuratën, realizon pensionin si edhe më parë, ndërsa i padituri nuk e ka penguar të banojë në banesën e tij, nuk bëhet fjalë për varfërimin pas lidhjes së kontratës për dhurimin, përkatësisht për varfërim në atë masë sa është rrezikuar mbijetesa e tij, prandaj nuk qëndrojnë arsyet ligjore për revokimin e kontratës së dhurimit.²⁰⁴

Mundësia e revokimit të dhurimit për shkak të varfërimit ekziston jo vetëm në rastet kur bëhet fjalë për humbjen e pasurisë, por edhe në rastet e humbjes së mundësisë për sigurimin e mjeteve të jetesës. Kjo humbje mjeteve të jetesës ekziston, nëse në kontratë është thënë

203 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev-1170/06 dt. 24.10.2007, I. Crnić, ZOO, f. 735, peto izdanje, "Organizator", Zagreb 2012.

204 Si më sipër, f. 736.

se nëna ia fal pasurinë vajzës, në mënyrë që ajo të përkujdeset për të, mirëpo, për shkak të vdekjes së vajzës, nëna ka ngelur pa këtë përkujdesje.²⁰⁵

Neni 543. Revokimi për shkak të mosmirënjohjes së thellë

- 1. Dhuratëdhënësi po ashtu mund ta revokojë kontratën për shkak të mosmirënjohjes së thellë nëse pas lidhjes së sajë dhuratëmarrësi sillet me dhuratëdhënësin apo me ndonjë person të afërt të tij në atë mënyrë që sipas parimeve themelore të moralit do të ishte e padrejtë për dhuratëmarrësin të mbante atë që ka marrë ë me dhuratë.**
- 2. Dhurata po ashtu mund të revokohet nga trashëgimtari për arsye të mënyrës së sjelljes ndaj dhuratëdhënësit**
- 3. Revokimi për shkak të mënyrës së sjelljes së dhuratëmarrësit është i mundshëm edhe për shkak të sjelljes së trashëgimtarit të dhuratëmarrësit.**
- 4. Revokimi nuk është i mundur nëse mosmirënjohja e thellë e dhuratëmarrësit ndaj dhuratëdhënësit ndërpritet.**

1. Vështrim i përgjithshëm.- Mundësia e revokimit të kontratës së dhurimit për shkak të mosmirënjohjes së thellë, sikurse edhe ajo për shkak të varfërimit, ka qenë e parashikuar edhe me Ligjin e Përgjithshëm Civil (OGZ), i cili, si rregull juridike, është zbatuar deri në hyrjen në fuqi të këtij Ligji. Në këtë mënyrë, në marrëdhëniet juridike mbi bazën e dhurimit, të themeluara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të zbatohen ato rregulla juridike. Sipas LMD, një nga tri arsyet ligjore për revokimin e kontratës për dhuratën është edhe arsyeja për shkak të mos mirënjohjes së thellë të dhuratëmarrësit ndaj dhuratëdhënësit.

2. Sipas par. 1 të nenit 543 të LMD, dhuratëdhënësi mund ta revokojë kontratën e dhurimit për shkak të *mosmirënjohjes së thellë* të dhuratëmarrësit jo vetëm ndaj dhuratëdhënësit, por edhe ndaj ndonjë personi të afërm të tij.²⁰⁶ Ligji nuk përcakton nga afër se cilët janë personat e afërm me dhuratëdhënësin. Konsiderojmë se për ta quajtur një person të afërm nuk varet nga shkalla e gjinisë e këtyre personave me dhuratëdhënësin. Nëse do të konsiderohet apo jo një person i afërm me dhuratëdhënësin, gjykata duhet të vendosë për çdo rast konkret, ashtu që, përpos afërsisë gjinore, qoftë asaj të gjakut, të krushqisë apo civile, duhet pasur parasysh edhe lidhjet e tjera të atij personi me dhuratëdhënësin.

Ligji përcakton se për të pasur mundësi dhe të drejtë për të kërkuar revokimin e kontratës së dhurimit për shkak të mosmirënjohjes së thellë, është me ndikim momenti i një sjelljeje të tillë të dhuratëmarrësit. Pra, kontrata e dhurimit mund të revokohet vetëm nëse

²⁰⁵ Gjyk. Sup. e Ser. Rev. 952/78.

²⁰⁶ Me Kodin Civil të R. së Shqipërisë, neni 771 par. 1 shkronja a), të afërmit e dhuruesit shprehimisht përcaktohen në mënyrë që si të tillë konsiderohen: bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit e dhuruesit. Në të njëjtën mënyrë janë të përcaktuar edhe me LMD (ZOO 2008) të R. MZ. Sipas LMD (ZOO 2005) të R. së Kroacisë, si persona të afërm llogariten anëtarët e familjes së ngushtë të dhuruesit.

dhuratëmarrësi sillet në mënyrë mosmirënjohëse pas lidhjes së kontratës. Nga kjo do të rrjedhë se, nëse ka pasur ndonjë sjellje të tillë para lidhjes së kontratës, për të cilën nuk ka ditur dhuratëdhënësi, por për këtë ka mësuar pas lidhjes së kontratës, ajo nuk mund të jetë shkak dhe arsye për revokimin e kontratës së lidhur më vonë. Sjellja mosmirënjohëse, si shkak për revokimin e kontratës së dhurimit, duhet të jetë shkaktuar pas lidhjes së kontratës.

LMD, po ashtu, nuk përcakton nga afër as se çfarë nënkupton *mosmirënjohja e thellë*, përkatësisht cilat sjellje të dhuratëmarrësit do të quheshin mosmirënjohëse.²⁰⁷ Kjo do të vlerësohet sipas rregullave dhe parimeve themelore të moralit, që do të thotë se i lihet gjykatës të vendosë për çdo rast konkret nëse një sjellje e caktuar do të konsiderohet si mosmirënjohje e thellë e dhuratëmarrësit ndaj dhuruesit.

3. Në par. 2 të nenit 543 shprehimisht dhe në veçanti është parashikuar se dhuruesi mund ta revokojë dhurimin e bërë edhe ndaj trashëgimtarit për sjelljet ndaj tij. Edhe pse me ligj nuk është thënë, nisur nga paragrafi paraparak i këtij neni, revokimi në këtë rast mund të bëhet edhe për shkak të sjelljeve ndaj të afërmeve të dhuruesit. Nisur nga marrëdhënia specifike që duhet të ekzistojë ndërmjet personave që kanë të drejtën e trashëgimit dhe personit nga i cili do të trashëgojnë, Ligji në veçanti përcakton mundësinë e revokimit të dhurimit për shkak të sjelljeve të trashëgimtarit.

4. Në paragrafin 3 të këtij neni parashikohet mundësia e revokimit të kontratës së dhurimit edhe për shkak të mosmirënjohjes së thellë, që shprehet me sjelljet e trashëgimtarit të dhuratëmarrësit. Pra, përpos sjelljeve korrekte dhe të mira ndaj dhuruesit nga dhuratëmarrësi, sipas Ligjit, kërkohet që sjellje të këtyra të kanë edhe trashëgimtarët e dhuratëmarrësit ndaj dhuruesit, sepse përndryshe ky i fundit do të mund të kërkojë revokimin e kontratës së dhurimit.

5. Mosmirënjohja e thellë mund të shprehet edhe me sjellje jo të mira të vazhdueshme të dhuratëmarrësit ose të trashëgimtarëve të tij ndaj dhuruesit apo të afërmeve të tij, pa ekzistuar ndonjë sjellje e veçantë që do të përbënte arsye më vete për revokimin e kontratës për dhuratën. Në raste të tilla, sipas par. 4 të këtij neni, nuk mund të kërkojë revokimi i dhurimit pas ndërprerjes së një mosmirënjohjeje të tillë.

Nga praktika gjyqësore.

Pavarësisht nga mungesa e sulmit fizik të dhuratëmarrësit ndaj dhuratëdhënësit, kërcënimet dhe fyerjet e tij gjithmonë nënkuptojnë mungesë falënderimi dhe mosmirënjohjeje, prandaj, në bazë të rregullave juridike (*pra, edhe në bazë të nenit 543 par. 1 të LMD – vër. e aut*), kjo përfaqëson bazë për revokimin e dhurimit.²⁰⁸

207 Sipas Kodit Civil të RSH, neni 771 par. 1 është përcaktuar shprehimisht: a). me dashje ka vrarë ose ka tentuar ta vrasë dhuruesin, bashkëshortin ose fëmijët ose prindërit e tij; b). pa të drejtë nuk i jep dhuruesit ushqim, kur është i detyruar sipas ligjit. Sipas LMD (ZOO) të R. MZ, neni 586, nëse ka kryer vepër penale ndaj dhuruesit apo të afërmeve të tij, nëse ka shkelur rëndë ndonjë detyrim të përcaktuar me ligj apo nëse me qëllim iu ka shkaktuar dëm më të madh. Në të njëjtën mënyrë është rregulluar edhe me LMD (ZOO) të R. së Kr, përveç që nuk parashikohet shkaktimi i dëmit.

208 Gjyk. Sup. e Voj. Rev. 583/86.

Në qoftë se dhuruesi kërkon revokimin e kontratës për dhuratën për shkak të mosmirënjohjes së dhuratëmarrësit, ai duhet patjetër të paraqesë në mënyrë të qartë një kërkesë të tillë. Kërkesa për anulimin e kontratës për dhuratën, për shkak të të metave rreth shprehjes së vullnetit, nuk përmban në vete kërkesë për revokimin e saj për shkak të mosmirënjohjes.²⁰⁹

Qëndron mosmirënjohja e thellë atëherë kur dhuratëmarrësi (nipi) sillet ndaj dhuratëdhënëses, e cila është e sëmurë rëndë dhe në moshën 91 vjeç, në mënyrë shumë fyese, duke e kërcënuar me sulm fizik, duke mos e vizituar, duke mos e përshëndetur dhe duke mos treguar ndonjë kujdes dhe respekt ndaj saj në çfarëdo mënyre tjetër.²¹⁰

Nëse dhuratëdhënësi është varfëruar aq shumë saqë nuk mund të mbijetojë vetë, dhuratëmarrësi mund t'i ofrojë të kontribuojë për ushqimin e tij në vend të revokimit të dhurimit.²¹¹

Kemi të bëjmë me mosmirënjohje të dhuruesit kur mban anën e bashkëshortit të vet, i cili e ofendon, e sulmon fizikisht dhe ia rrezikon jetën dhuratëdhënësit. Një sjellje e këtillë e dhuratëmarrësit përbën bazë për shpëputjen e kontratës së dhurimit.²¹²

Neni 544. Revokimi për shkak të lindjes së pastajshme

Dhuratëdhënësi i cili bëhet me fëmijë pasi që është lidhur kontrata e dhuratës dhe i cili më parë nuk ka pasur asnjë fëmijë, mund ta revokojë dhuratën.

Arsyeja e tretë dhe e fundit e parashikuar ligjore, për të cilën mund të revokohet kontrata e dhuratës, është lindja e fëmijës së dhuruesit (që më parë nuk ka pasur asnjë fëmijë), pas lidhjes së kontratës. Për të pasur të drejtën e revokimit të kontratës së dhurimit, sipas kësaj dispozite ligjore është e nevojshme të jenë plotësuar së bashku (në të njëjtën kohë) këto kushte: a) të jetë lidhur kontrata e vlefshme e dhurimit, b) para lidhjes së saj dhuruesi të mos ketë pasur asnjë fëmijë dhe c) dhuruesi të bëhet me fëmijë pas lidhjes së kontratës së dhurimit.

Sa i përket kushtit të parë, duhet theksuar se vetëm kontrata e dhurimit, juridikisht e vlefshme, mund të revokohet. Nëse kontrata është juridikisht e pavlefshme, konsiderohet se ajo nuk ekziston, prandaj nuk ka nevojë të revokohet, pasi nuk prodhon efekte juridike.

Kusht i dytë, sipas kësaj dispozite ligjore, është që dhuruesi të bëhet me fëmijë. Këtë mundësi ligjvënësi nuk e kushtëzoi me lindjen e fëmijës së dhuruesit, por është shprehur “*bëhet me fëmijë*”. Sipas Ligjit të Familjes të Kosovës, adoptimi mes adoptuesit dhe të adoptuarit

209 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 445/2006 dt. 14.06.2006.

210 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 126/02 dt. 02.06.2004.

211 Gjyk. Sup. e Voj. Rev. 512/89.

212 Gjyk. Sup. e Sr. Rev. 148/82.

themelon të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve.²¹³ Nga kjo rrjedh se një person me fëmijë mund të bëhet me lindjen e fëmijës dhe me adoptim. Duke pas parasysh faktin se me adoptimin e të miturit për adoptuesin krijohen detyrime të njëjta si ndaj fëmijës së lindur, nëse adoptuesi më parë nuk ka pasur fëmijë, si me rastin e ardhjes së fëmijës me lindje ashtu edhe me adoptim, adoptuesi ka të drejtë që, pas lindjes ose adoptimit të fëmijës, të kërkojë revokimin e kontratës së dhurimit.

Revokimi i kontratës së dhurimit nga arsyeja se dhuruesi është bërë me fëmijë mund të bëhet vetëm në rastet kur ai me fëmijë është bërë pas lidhjes së kësaj kontrate.

Neni 545. Pasojat e revokimit

- 1. Me anë të deklaratës së revokimit dhuratëdhënësi duhet të kërkojë kthimin e sendit apo së drejtës apo të pagesës së vlerës me të cilën dhuratëmarrësi është pasuruar në bazë të veprimit të dhuratës.**
- 2. Nëse dhurata ende nuk është përmbushur, revokimi ka për pasojë ndërprerjen e detyrimit të dhuratëdhënësit.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.* - Pavarësisht nga emërtimi i kësaj dispozite ligjore, ajo në radhë të parë rregullon përmbajtjen e kërkesës në deklaratën për revokim, paraqitur nga dhuruesi për revokimin e kontratës së dhurimit. Varësisht nga përmbajtja e deklaratës së revokimit, rrjedh edhe pasoja e tij. Në par. e dytë parashikohet pasoja e revokimit, nëse kontrata nuk është realizuar.

2. Sipas par. 1. të këtij neni, revokimi i kontratës së dhurimit bëhet me anë të një deklaratë të revokimit.²¹⁴ Kjo deklaratë e revokimit do të duhej të bëhej nga dhuruesi i dhurimit, i cili do të duhej të kërkonte me të kthimin e sendit ose të së drejtës, apo pagesën e vlerës në masën sa është pasuruar dhuratëmarrësi me kontratën e dhurimit. Kjo nuk nënkupton se ai duhet medoemos të kërkojë kthimin në tërësi të dhurimit të bërë. Mbetet në vullnetin e tij nëse do të kërkojë kthimin e dhurimit në tërësi apo vetëm një pjesë të tij.

Me rëndësi është që nga përmbajtja e deklaratës të rrjedhë se kërkohet revokimi i kontratës konkretisht të përcaktuar të dhurimit. Kjo do të nënkuptonte se në rastet kur nga deklarata rrjedh se është kërkuar vetëm revokimi i kontratës pa përcaktuar edhe kthimin e sendit apo së drejtës që ka qenë objekt i kontratës, me këtë të jetë kërkuar kthimi i objektit të dhurimit në tërësi. Nëse në deklaratën për revokim është përcaktuar edhe vëllimi i objektit të dhurimit, kthimi i të cilit kërkohet, rrjedh se revokimi ka të bëjë me kthimin e objektit në masën e kërkuar me deklaratën për revokim.

213 Shih nenin 167 dhe dispozitat tjera të LFK lidhur me adoptimin.

214 Revokimi i dhurimit me deklaratë është parashikuar edhe me LMD (ZOO) të R. së Kr. (neni 496), ndërsa me KCRSH (neni 771) parashikohet që kjo të bëhet me padi.

Me LMD nuk është parashikuar forma në të cilën duhet të paraqitet deklarata për revokimin e kontratës së dhurimit. Duke pasur parasysh formën e parashikuar ligjore të kontratës së dhurimit,²¹⁵ e cila duhet të jetë e formës së shkruar, përpos në rastet kur sendi apo e drejta ka kaluar menjëherë të dhuratëmarrësi, në mënyrë që ai ta disponojë atë pa pengesa, rrjedh se *deklarata për revokimin e kontratës së dhurimit, për të qenë juridikisht e vlefshme dhe për të prodhuar pasoja juridike, duhet të jetë në formë të shkruar*. Kjo formë e kontratës kërkohet edhe me qëllim të sigurisë juridike.²¹⁶

3. Në par. e dytë të këtij neni parashikohet pasoja e revokimit të kontratës së dhurimit për rastet kur detyrimi i përcaktuar në kontratë nuk është përmbushur. Pra, në qoftë se detyrimi i përcaktuar në kontratën e dhurimit nuk është përmbushur, *revokimi ka për pasojë ndërprerjen e detyrimit të dhuruesit*. Nëse është fjala për dhurime të menjëhershme, detyrimi ndërpritet. Nëse është fjala për detyrime periodike, detyrimi i dhuruesit ndërpritet nga dita e revokimit, ndërsa dhuratëmarrësi ka detyrimin ta kthejë atë që ka marrë deri atëherë në emër të dhurimit.

Neni 546. Afatet për revokimin

Kontrata e dhuratës mund të revokohet brenda një viti nga dita kur dhuratëdhënësi ka mësuar për arsyet e revokimit.

1. Me nenin 546 është përcaktuar afati brenda të cilit mund të revokohet kontrata e dhurimit. Sipas këtij neni, kontrata e dhurimit mund të revokohet brenda një viti, llogaritur nga dita kur dhuruesi ka mësuar për arsyet e revokimit.²¹⁷ Siç rrjedh nga kjo dispozitë, me Ligj është parashikuar vetëm afati subjektiv, por jo edhe ai objektiv, brenda të cilit mund të revokohet dhurimi, prandaj për revokimin e dhurimit nuk është me rëndësi dita kur është paraqitur arsyeja për revokim dhe koha e kaluar nga ajo ditë, por me rëndësi është dita kur dhuruesi ka mësuar për ekzistimin e saj.²¹⁸

2. Revokimi i dhurimit bëhet me anë të deklaratës, e cila duhet të jetë në formë të shkruar.²¹⁹ Deklarata e revokimit duhet t’i dërgohet dhe t’i dorëzohet dhuratëmarrësit sipas rregullave

215 Shih nenin 541 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

216 Me LMD të R. Kr. 2005 forma me shkrim e deklaratës parashikohet shprehimisht në nenin 496, në par. 2 të të cilit sanksionohet se nënshkrimi i deklaruesit duhet të vërtetohet nga noteri.

217 Në të njëjtën mënyrë është rregulluar dhe është parashikuar i njëjti afat edhe me ligjet e shteteve të tjera të rajonit. Kështu, në nenin 771 par. 2 të KCRSH është parashikuar: “Padia për revokimin e dhurimit duhet të ngrihet brenda një viti nga dita që dhuruesi ka marrë njoftim për shkaqet që i japin të drejtë që të kërkojë revokimin e dhurimit”. Në nenin 497 të LMD (ZOO 2005) parashikohet afati i humbjes së të drejtës për revokimin e dhurimit pas kalimit të afatit prej një viti, kur personi ka mësuar për arsyen e revokimit.

218 Sipas rregullave juridike që janë zbatuar para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, përkritazi me marrëdhëniet juridike të krijuara me dhurim, afati ka qenë 3 vjet nga dita e lidhjes së kontratës së dhurimit ose nga paraqitja e arsyes për shkak të cilit kërkohet revokimi.

219 Shih nenin 545 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me atë nen.

të dorëzimit personal të shkresave, sipas LPK. Konsiderojmë se dërgesa e deklaratës për revokim e bërë me postë rekomande, është në pajtim me rregullat e sipërpërmendura.

3. Duke pasur parasysh përmbajtjen e deklaratës për revokimin e kontratës dhe përmbajtjen e kërkesave që mund të paraqiten me padi, revokimi i dhurimit mund të bëhet edhe me padi.²²⁰ Me padinë e paraqitur mund të kërkohet vetëm shkëputja e kontratës së dhurimit ose, bashkë me këtë kërkesë, të kërkohet edhe kthimi i objektit të kontratës. Nga vullneti i paditësit do të varet nëse ai paraqet kërkesë për kthimin e gjithë objektit të kontratës së dhurimit apo vetëm të një pjese të tij. Te kthimi i objektit të kontratës së dhurimit zbatohen dispozitat e këtij Ligji që kanë të bëjnë me pasurimin pa bazë.²²¹ Njësoj si deklarata, edhe padia për shkëputjen e kontratës së dhurimit duhet të paraqitet në gjykatë brenda një viti, nga dita kur dhuruesi ka marrë në dijeni për shkaqet e revokimit. Padia mund të paraqitet vetëm nga dhuruesi, sepse, sipas të gjitha dispozitave ligjore me të cilat janë parashikuar arsyet e revokimit, kjo e drejtë i njihet vetëm atij. Mirëpo, pas paraqitjes së padisë dhe inicimit të procedurës, trashëgimtarët e dhuruesit mund ta vazhdojnë procedurën sipas rregullave të LPK.²²²

Neni 547. Heqja dorë nga revokimi

Është e pavlefshme heqja dorë nga revokimi.

Dispozitat ligjore me të cilat është rregulluar mundësia e revokimit të kontratës së dhurimit janë dispozita të karakterit të detyrueshëm (imperativ) për palët. Për këtë arsye, edhe me këtë dispozitë ligjore është parashikuar pavlefshmëria e heqjes dorë nga e drejta për revokimin e kontratës së dhurimit. Së këndejmi, edhe nëse dhuruesi ka hequr dorë nga e drejta për të kërkuar revokimin e kontratës së dhurimit, heqja dorë e këtillë është e pavlefshme, prandaj edhe ai, pavarësisht nga heqja dorë, kur paraqitet ndonjëra nga arsyet ligjore për revokim, mund ta bëjë këtë.

.....
220 Sipas nenit 254 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, paditësi mund të kërkojë me padi që gjykata vetëm ta konstatojë ekzistimin, përkatësisht mosekzistimin e ndonjë raporti juridik. Me paraqitjen e arsyeve të caktuara të parashikuara nga nenet 542, 543 dhe 544 të këtij Ligji, dhuruesi mund të kërkojë me padi mosekzistimin, përkatësisht shkëputjen e këtij raporti për shkak të paraqitjes së arsyeve ligjore.

221 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 194 deri 202 dhe komentet e dhëna për këto nene në pjesën e përgjithshme të Komentar i LMD.

222 Shih nenin 277 dhe 280 të LPK.

KREU 4 DHURATA NË RAST TË VDEKJES

Neni 548. Dhurata në rast të vdekjes

Kontrata e dhuratës e cila është për t'u përmbushur pas vdekjes së dhuratëdhënësit është e vlefshme vetëm nëse është bërë në formë të aktit noterial dhe nëse dokumenti për kontratën e lidhur të dhuratës është dorëzuar tek dhuratëmarrësi.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Me dispozitat e këtij Ligji nga neni 536 deri 548 janë parashikuar rregullat përkitazi me kontratën e dhurimit, e cila realizohet ose, së paku, fillon të realizohet gjatë jetës së dhuruesit.²²³ Te kontrata e dhurimit, si rregull, detyrimi përmbushet gjatë jetës së dhuruesit, ashtu që edhe ajo është një formë e rregullt e dhurimit. Me këtë nën është parashikuar një kontratë e veçantë e dhurimit, sipas së cilës, dhurimi duhet të bëhet në rast të vdekjes së dhuruesit.

2. Me nenin 548 rregullohet forma e veçantë e kontratës së dhurimit, më e rreptë në krahasim me kontratën e rregullt. Me këtë kontratë parashikohet përmbushja e detyrimit pas vdekjes së dhuruesit. Për dallim nga forma e kontratës së rregullt, e parashikuar në nenin 541 të këtij Ligji²²⁴, kontrata e dhurimit, në rast të vdekjes, është e vlefshme vetëm në qoftë se është bërë në formë akti noterial. Kjo nënkupton se, përpos formës së shkruar, është e nevojshme që nënshkrimet e palëve kontraktuese të vërtetohen nga notari. Përveç kësaj, për vlefshmërinë e kësaj kontrate është e nevojshme që dokumenti për kontratën e lidhur të dhuratës t'i jetë dorëzuar dhuratëmarrësit.

223 Shih komentin e dhënë lidhur në nenin 539 të këtij Ligji.

224 Shih komentin e dhënë lidhur në nenin 541 të këtij Ligji.

PJESA IV

KONTRATA PËR DORËZIMIN DHE NDARJEN E PASURISË (KONTRATA E DORËZIMIT)

Neni 549. Përkufizimi

Me kontratë të dorëzimit, dorëzuesi merr përsipër të dorëzojë dhe ndajë pronën tek pasardhësit e tij/saj, tek fëmijët e adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, kjo kontratë ka qenë e rregulluar me Ligjin për Trashëgiminë të Kosovës (LTK); ky veprim juridik me atë ligj është emërtuar cedimi dhe pjesëtimi i pasurisë.²²⁵ Në bazë të nenit 1058 par. 4 të LMD, me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, pushojnë së vepruari edhe dispozitat e LTK, me të cilat ka qenë e rregulluar kjo fushë. Kontrata e dorëzimit zakonisht është një kontratë me detyrim të njëanshëm, mirëbërës dhe formal. Në momentin e lidhjes së saj, ekziston detyrimi vetëm në anën e paraardhësit për t'ia dorëzuar pasardhësve pasurinë e cila është objekt i kontratës. Për pasurinë e dorëzuar paraardhësi zakonisht nuk merr kompensim. Përjashtim nga kjo rregull mund të jenë rastet kur paraardhësi ruan për vete, për bashkëshorten/in apo për ndonjë person tjetër të drejtën e uzufruktit mbi pasurinë e dorëzuar ose kur kërkon rentën jetësore.²²⁶ Kjo është një kontratë që lidhet ndërmjet paraardhësit dhe pasardhësve të tij ose edhe fëmijëve të adoptuar, eventualisht edhe bashkëshortit/tes së tij, me të cilën paraardhësi gjatë jetës bën ndarjen dhe dorëzimin e pasurisë së vet. Pasardhës, sipas kësaj dispozite ligjore, konsiderohen të gjithë pasardhësit e dorëzuesit (fëmijët, nipat, stërnipat dhe kështu më tutje), të cilët, në momenti e vdekjes së tij, do të kishin të drejtën e trashëgimit. Si të tillë konsiderohen edhe fëmijët e adoptuar dhe pasardhësit e tyre.²²⁷

2. Nga përmbajtje e dispozitës së nenit 549 të LMD rrjedh se palë kontraktuese duhet të jetë, në një anë, paraardhësi dhe, në anën tjetër, të gjithë pasardhësit e tij, nëse ka fëmijë të adoptuar - edhe ata dhe fëmijët e tyre dhe, në qoftë se dikush nga të adoptuarit ka vdekur më parë, eventualisht edhe bashkëshorti/ja.

Me kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë paraardhësi, si palë kontraktuese, bën ndarjen edhe dorëzimin e një pjese apo të gjithë pasurisë që ka, duke ua kaluar atë pasardhësve të tij si dhe fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të tyre, zakonisht pa ndonjë detyrim për ta. Në këtë mënyrë, kjo kontratë është e afërt me kontratën e dhurimit. Mirëpo, për nga veprimi trashëgimor juridik, kjo kontratë ka karakteristikat e veçanta, pasi që pasuria që është objekt i saj nuk bën pjesë në masën trashëgimore të dorëzuesit,

225 Shih dispozitat e LTK (Ligji nr. 2004/26, rregullore e UNMIK-ut 2005/7 dt. 4 shkurt 2005) nga neni 58 deri 69.

226 Shih nenin 554 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

227 Shih nenin 24 të LTK, sipas së cilit i adoptuari dhe pasardhësit e tij ndaj adoptuesit kanë të drejta të njëjta trashëgimore, sikurse fëmijët e adoptuesit dhe pasardhësit e tjerë të tij.

pra nuk i nënshtrohet efektit të dispozitave juridike trashëgimore; nga ajo nuk mund të kompensohet pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të dorëzuesit dhe, në momentin e hapjes së trashëgimisë së dorëzuesit, ajo nuk mund të llogaritet në pjesën trashëgimore të trashëgimtarëve ligjorë të tij.

Përpos dorëzuesit të pasurisë, palë kontraktuese, në anën tjetër, duhet të jenë të gjithë pasardhësit dhe fëmijët e adoptuar. Mirëpo, kjo nuk nënkupton detyrimin e dorëzuesit për t'ua ndarë pasurinë pasardhësve në pjesë të barabarta dhe as detyrimin që t'ua kalojë pjesët e pasurisë të gjithëve.

Neni 550. Kushtet për vlefshmërinë

- 1. Kontrata është e vlefshme vetëm nëse për të jepet pëlqimi nga pasardhësit, fëmijët e adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar të cilët sipas ligjit do të thirreshin për të trashëguar mbi bazën e kontratës (pasardhësit).**
- 2. Kontrata duhet të lidhet në formë të aktit noterial.**
- 3. Secili pasardhës që nuk e jep pëlqimin, mund ta bëjë atë më vonë në të njëjtën formë.**
- 4. Dorëzimi dhe ndarja mbetet e vlefshme edhe nëse një pasardhës i cili nuk ka dhënë pëlqimin vdes para dorëzimit duke mos lënë ndonjë pasardhës, nëse heq dorë nga trashëgimia, nëse është përjashtuar nga trashëgimia, apo nëse nuk është i denjë të trashëgojë ë.**

1. Vështrim i përgjithshëm.- Pasuria që është objekt i kontratës së dorëzimit dhe ndarjes nuk bën pjesë në pasurinë trashëgimore të dorëzuesit dhe përjashtohet nga ajo. Ky fakt bën të kuptohet se, me kontratën e dorëzimit, zvogëlohet pjesa trashëgimore e trashëgimtarëve të paraardhësit, për të cilën arsye edhe me këtë dispozitë ligjore është parashikuar që kjo kontratë është e vlefshme vetëm nëse për lidhjen e saj e japin pëlqimin të gjithë pasardhësit e dorëzuesit, të cilët, sipas ligjit,²²⁸ në momentin e vdekjes së tij, kanë të drejtë ta trashëgojnë atë. Pëlqimi në kontratën e dorëzimit mund të jepet edhe më vonë, deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit, në të njëjtën formë të parashikuar ligjore, që është parashikuar për kontratën. Dhënia e pëlqimit në kontratë është me efekt për të drejtën e kundërshtimit të kontratës për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme ose për llogaritjen e dhuratave në pjesën trashëgimore, ndërkaq me dhënien e pëlqimit për këtë kontratë, konsiderohet se është hequr dorë nga e drejta për të kërkuar pjesën e domosdoshme.

228 Redaktimi gjuhësor i dispozitës ligjore nga par. 1 i neni 550 është i gabuar, ngase në fund të këtij paragrafi gabimisht janë shkruar fjalët: “mbi bazën e kontratës (pasardhësit)”. Pasardhësit thirren për të trashëguar vetëm në bazë të ligjit, e jo, siç është shkruar gabimisht në fund të kësaj dispozite, edhe “mbi bazën e kontratës”, pasi që mbi bazën e kontratës nuk mund të trashëgohet. Pas fjalës “trashëguar” duhet të jetë pikë dhe aty të përfundojë ky paragraf. Këto fjalë të fundit të sipërsëhuara të këtij paragrafi nuk duhen marrë në konsiderim me rastin e zbatimit të kësaj dispozite.

2. Me nenin 550 të LMD parashikohen kushtet për vlefshmërinë e kontratës së dorëzimit. Sipas par. 1 të këtij neni, vlefshmëria e kontratës së dorëzimit varet nga dhënia e pëlqimit për këtë kontratë nga ana e trashëgimtarëve të mundshëm ligjorë, të cilët mund të paraqiten në trashëgimi në momentin e vdekjes së tij, përpos bashkëshortit/es.²²⁹ Në këtë mënyrë, kontrata e dorëzimit të pasurisë është e vlefshme vetëm nëse për të e kanë dhënë pëlqimin pasardhësit, fëmijët e adoptuar dhe pasardhësit e tyre.

Duke pasur parasysh faktin se objekt i kësaj kontrate mund të jetë vetëm një pjesë nga pasuria e paraardhësit, e cila ekziston në momentin e lidhjes së kontratës dhe jo tërë pasuria të cilën e disponon ai në kohën e lidhjes së saj e as pasuria tjetër që do të krijohet më vonë dhe, si e tillë, do ekzistoj në momentin e vdekjes, dhënia e pëlqimit për këtë kontratë nuk nënkupton heqjen dorë nga drejta e trashëgimisë. Në qoftë se në momentin e vdekjes së paraardhësit ka pasuri tjetër, që nuk ka qenë objekt i kontratës, apo pasuri të fituar pas lidhjes së kontratës, me rastin e shqyrtimit të saj, për vlefshmërinë e kontratës së dorëzimit nuk është me rëndësi madhësia e pjesëve të ndara dhe të dorëzuara pasardhësve me të e as fakti nëse secilit prej pasardhësve i është dorëzuar diçka apo jo; me rëndësi është që për lidhjen e asaj kontrate e kanë dhënë pëlqimin të gjithë pasardhësit e dorëzuesit dhe fëmijët e adoptuar dhe se të gjithë ata do të thirren të deklarohen lidhur me pasurinë që ekziston në momentin e vdekjes së dorëzuesit. Nga kjo do të rrjedhë se një kontratë e dorëzimit, e vlefshme në momentin e lidhjes së saj, nuk do të thotë se do të ngelë e tillë edhe në momentin e vdekjes së pasardhësit, pasi që ajo mund të shndërrohet në kontratë të dhurimit. Vlefshmëria e kontratës së dorëzimit varet nga rrjedha e mëvonshme e situatës përkitazi me mundësinë për trashëgim të pasardhësve dhe fëmijëve të adoptuar në momentin e vdekjes së paraardhësit dhe vlerësohet në bazë të situatës ekzistuese në momentin e vdekjes së tij. Në këtë mënyrë, nëse në momentin e vdekjes së paraardhësit (delacionit) pëlqimin e kanë dhënë të gjithë pasardhësit me të drejtën e trashëgimit, në atë rast kontrata e dorëzimit të pasurisë është e vlefshme dhe prodhon, si e tillë, efekte juridike, pavarësisht nëse pëlqimi është dhënë në momentin e lidhjes së saj apo më vonë. Përndryshe, nëse në momentin e vdekjes së dorëzuesit nuk ekziston pëlqimi i pasardhësve, të cilët janë trashëgimtarë, kontrata e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë shndërrohet në kontratë të dhurimit me të gjitha pasojat juridike trashëgimore të transformimit.²³⁰

3. Përkitazi me mundësinë e dhënies së pëlqimit nga të gjithë pasardhësit, mund të paraqiten dy situata. Kontrata e dorëzimit do të lidhet sipas situatës që ekziston në momentin e lidhjes së saj. Nga kjo rrjedh se në këtë kontratë, në momentin e lidhjes së saj, duhet të përfshihen pasardhësit e dorëzuesit, të cilët e kanë të drejtën e trashëgimisë në momentin e lidhjes së kontratës, pëlqimi i të cilëve edhe kërkohet. Mirëpo, nga momenti i lidhjes së kontratës, deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit të pasurisë, mund të paraqiten ndryshime përkitazi me pasardhësit me të drejtën e trashëgimit. Kontrata e dorëzimit do të ngelë e tillë vetëm në rast se përcillen këto ndryshime, në mënyrë që pëlqimin për të ta japin edhe pasardhësit

229 Përkitazi me të drejtat e bashkëshortit/es, shih nenin 555 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

230 Shih dispozitat e LTK nga neni 47 deri 57.

e paraqitur më vonë me të drejtë trashëgimie, duke dhënë pëlqimin më vonë në formën e parashikuar ligjore për kontratën; përndryshe, në momentin e vdekjes së dorëzuesit, kontrata e dorëzimit të pasurisë shndërrohet në kontratë të dhurimit.

Ndryshimet nga momenti i lidhjes së kontratës deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit të pasurisë përkitazi me pasardhësit me të drejtë trashëgimi, mund të paraqiten në mënyrë që disa persona, të cilët në momentin e lidhjes së kontratës e kanë pasur cilësinë e trashëgimtarit, më vonë ta kenë humbur atë, ndërsa disa persona të cilët nuk e kanë pasur atë cilësi në momentin e lidhjes së kontratës, ta fitojnë atë më vonë, deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit të pasurisë. Nisur nga mundësitë ekzistuese për t'u paraqitur si trashëgimtarë në momentin e lidhjes së kontratës dhe asaj në momentin e vdekjes së dorëzuesit të pasurisë, pasardhësit e dorëzuesit mund të ndahen në tri grupe: 1) Në grupin e parë bëjnë pjesë pasardhësit e dorëzuesit, të cilët në momentin e lidhjes së kontratës kanë pasur të drejtën e trashëgimit dhe atë e kanë ruajtur deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit. Dhënia e pëlqimit të tyre në kontratë vlerësohet sipas momentit të vdekjes së dorëzuesit, pavarësisht nga koha kur e kanë dhënë atë; 2) Në grupin e dytë bëjnë pjesë pasardhësit e dorëzuesit të cilët në momentin e lidhjes së kontratës e kanë pasur cilësinë e trashëgimtarit, por më vonë, deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit, e ka humbur atë qoftë për shkak të vdekjes, paaftësisë ose papërshtatshmërisë për të trashëguar, qoftë për shkak të përjashtimit të tij nga trashëgimia apo për ndonjë arsye tjetër ligjore, ashtu që ekzistimi i pëlqimit të tyre në kohën e lidhjes së kontratës është i parëndësishëm; 3) Në grupin e tretë bëjnë pjesë pasardhësit të cilët në momentin e lidhjes së kontratës nuk e kanë pasur cilësinë e trashëgimtarit, por atë e kanë fituar më vonë atë deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit të pasurisë, qoftë ngase atë e fitojnë sipas së drejtës së përfaqësimit, për shkak se fëmija ka lindur pas lidhjes së kontratës, është pranuar atësia ose ajo është vërtetuar nëpërmjet gjykatës pas lidhjes së kontratës për dorëzim apo për ndonjë arsye tjetër ligjore.

4. Në paragrafin 2 të nenit 550 bëhet fjalë për formën e kontratës për dorëzimin e pasurisë. Sipas kësaj dispozite ligjore, ajo duhet të lidhet në formë të aktit noterial, që nënkupton se nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen nga notari.²³¹ Nga kjo rrjedh se për këtë kontratë parashikohet forma e caktuar ligjore, në mungesë të së cilës kontratat është e pavlefshme.

5. Në par. 3 të nenit 550 parashikohet mundësia e dhënies më vonë të pëlqimit për kontratën, d.m.th., pas lidhjes së kontratës. Kjo mund të bëhet deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit. Pozita juridike e personave, të cilët në momentin e lidhjes së kontratës e kanë pasur cilësinë e trashëgimtarit të dorëzuesit me atë i cili këtë cilësi e ka fituar më vonë, deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit, është e njëjtë. Këta të fundit mund ta japin pëlqimin më vonë, deri në momentin e vdekjes të dorëzuesit të pasurisë. Dhënia e pëlqimit më vonë nënkupton pranimin e efekteve dhe kushteve të kontratës çfarë ishin në momentin e lidhjes së saj. Në qoftë se pasardhësve nuk u pëlqejnë kushtet e kontratës, ata ose munda të ndryshojnë pjesë

231 Me LTK, në nenin 59, parashikohej që marrëveshja duhet të përpilohet me shkrim dhe të vërtetohet nga gjyqtari, pasi t'ua lexojë kontratën dhe t'ua shpjegojë kontraktuesve pasojat e saj.

të caktuara të kontratës me një shtojcë tjetër, e cila duhet bërë sipas të njëjtës procedurë si kontrata dhe për ato ndryshime duhet ta japin pëlqimin edhe pasardhësit e tjerë, të cilët janë pajtuar me variantin e mëparshëm; përndryshe, kontrata e dorëzimit shndërrohet në kontratë të dhurimit.

6. Në paragrafin e 4 është rregulluar mundësia e ngeljes në fuqi të kontratës së dorëzimit edhe nëse dikush nga pasardhësit nuk e ka dhënë pëlqimin për të. Sipas kësaj dispozite ligjore, kontrata e dorëzimit dhe ndarjes mbetet e vlefshme edhe në rast se një pasardhës nuk e ka dhënë pëlqimin, me kusht që ky pasardhës të vdesë para dorëzuesit²³², pa lënë ndonjë pasardhës, nëse heq dorë nga trashëgimia,²³³ nëse është përjashtuar nga trashëgimia apo nëse nuk është i denjë të trashëgojë ë.²³⁴ Duke pasur parasysh faktin se personi që nuk e ka dhënë pëlqimin për dorëzimin e pasurisë edhe ashtu ka vdekur para dorëzuesit, pa lënë ndonjë pasardhës, si dhe faktin se personi i padenjë për të trashëguar dhe ai që është përjashtuar nuk kanë të drejtën e trashëgimit, mosdhënia e pëlqimit nga ana e këtyre personave për kontratën e dorëzimit të pasurisë nuk është me ndikim në vlefshmërinë e saj, prandaj ajo, edhe pa pëlqimin e këtyre pasardhësve, mbetet e vlefshme.

Neni 551. Subjekti (Objekti) i dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë

- 1. Vetëm pasuria ekzistuese e dorëzuesit, pjesërisht ose në tërësi, mund të përfshihet në dorëzim dhe ndarje.**
- 2. Është e pavlefshme dispozita për mënyrën e ndarjes së pasurisë që është pjesë e pronës së përgjithshme të dorëzuesit.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Formulimi gjuhësor dhe redaktimi i emërimit të dispozitës së parashikuar nga neni 551 është i gabuar dhe nuk përkon me përmbajtjen e kësaj dispozite ligjore. Kjo dispozitë ligjore është emërtuar “Subjekti i dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë”, edhe pse në përmbajtjen e saj parashikohen rregullat përkitazi me objektin e dorëzimit dhe të ndarjes së pasurisë. Gabime redaktuese ose gabim në përkthim në gjuhën shqipe ka edhe në paragrafin 2 të këtij neni, për të cilën gjë do të bëhet fjalë në komentimin e dhënë për këtë paragraf.

232 Në ligj, në rreshtin e dytë të par. 4., pas fjalës “para” gabimisht është shkruar “dorëzimit”, sepse, në fakt, në vend të saj duhet të jetë “dorëzuesit”

233 Shih nenet 164 dhe 165 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJ) përkitazi me dhënien e deklaratës trashëgimore dhe heqjen dorë nga trashëgimia.

234 Në bazë të nenit 110.1 të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës, Ligji nr. 2004/26, nuk mund të trashëgojë personi i padenjë për të trashëguar, kurse sipas nenit 114 të të njëjtë Ligj, trashëgimlënësi në testamentin e tij mund ta përjashtojë nga trashëgimi trashëgimtarin të cilit i përket e drejta e pjesës së domosdoshme, kështu që, në bazë të nenit 117 të të njëjtë Ligj, ai trashëgimtar humb të drejtat trashëgimore, kurse të drejtat e personave të tjerë, që mund ta trashëgojnë trashëgimlënësin caktohen sikur i përjashtuari të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

2. Me kontratën e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë paraardhësi e disponon pasurinë e tij që ka në momentin e lidhjes së kontratës në favor të pasardhësve të dhe të adoptuarve të vet, përkatësisht pasardhësve të tyre. Në këtë mënyrë, kjo kontratë nuk është kontratë e trashëgimisë, ashtu që pasardhësit dhe të adoptuarit, të cilët e kanë dhënë pëlqimin për kontratën, ndaj të cilëve edhe kjo kontratë prodhojë efekte juridike, nuk janë suksesorë universalë por suksesorë singularë. Nga kjo kontratë pasardhësit dhe të adoptuarit nuk përfitojnë në të gjitha të drejtat dhe nuk marrin përgjegjësin për të gjitha detyrimet që ka dhe do të ketë në momentin e vdekjes paraardhësi i tyre, por vetëm në të drejtat të cilat i disponon ai në momentin e lidhjes së kësaj kontrate. Për këtë arsye, siç parashikohet në par. 1 të këtij neni, objekt i kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë mund të jetë vetëm pasuria ekzistuese e dorëzuesit, të cilën e disponon ai dhe e cila ekziston në momentin e lidhjes së kontratës. Objekt i kësaj kontrate mund të jetë qoftë tërë pasuria, qoftë vetëm një pjesë e pasurisë ekzistuese në momentin e kontraktimit. Dorëzuesi i pasurisë në çdo kohë mund të lidhë një kontratë tjetër për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, me të cilën do të zgjerohej ajo e mëparshmeja, duke përfshirë pasurinë tjetër, e cila nuk ka qenë objekt i kontratës së mëparshme ose atë që është fituar më vonë. Edhe kjo kontratë e mëvonshme duhet të lidhet në të njëjtën formë si kontrata paraprake. Pëlqimi i pasardhësve kërkohet vetëm për pasurinë që është objekt i kontratës së mëvonshme, përkatësisht që nuk ka qenë e përfshirë në kontratën paraprake. Në rast se dikush nga pasardhësit apo të adoptuarit nuk e ka dhënë pëlqimin për kontratën e mëvonshme, kontrata e lidhur më parë prodhon efekte juridike si kontratë për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, ndërsa ajo e mëvonshme shndërrohet në kontratë të dhurimit.²³⁵

3. Paragrafi 2 i nenit 551 bën fjalë për pavlefshmërinë e kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë përkitazi me objektin që ka. Derisa me paragrafin e parë përcaktohet se çfarë mund të jetë objekt i kësaj kontrate, në paragrafin e dytë parashikohet shprehimisht se janë të pavlefshme dispozitat me të cilat është rregulluar mënyra e ndarjes së pasurisë, e cila do të bëjë pjesë në masën trashëgimore të dorëzuesit në momentin e vdekjes së tij. Duke pasur parasysh faktin se pasuria që ka ekzistuar dhe është objekt i kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë është tjetërsuar me këtë kontratë, ajo nuk bën pjesë në pasurinë trashëgimore të ngelë ur të dorëzuesit, prandaj edhe nëse me ndonjë dispozitë të kontratës është përfshirë pasuria tjetër e dorëzuesit, e cila nuk ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, por është fituar në ndonjë mënyrë më vonë, ajo dispozitë është e pavlefshme, ndërsa pjesët e tjera të kontratës janë të vlefshme dhe prodhojnë efekte juridike.

Neni 552. Pozita e pasurisë së dorëzuar

1. Nëse vdes paraardhësi i cili ka dorëzuar dhe ndarë pasurinë e tij apo saj gjatë kohës sa ka qenë gjallë, pasuria e përgjithshme e tij apo saj përbëhet vetëm nga pasuria që nuk është përfshirë në dorëzim dhe ndarje si dhe nga prona e fituar më pas.

²³⁵ Shih dispozitat nga neni 536 deri 548 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna për këto nene.

2. Pasuria e fituar nga pasardhësit e tij apo saj me anë të dorëzimit dhe ndarjes nuk klasifikohet si pjesë e pasurisë së përgjithshme të tij apo saj si dhe nuk llogaritet gjatë përcaktimit të vlerës së kësaj pasurie të përgjithshme.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Redaktimi gjuhësor edhe i kësaj dispozite sjell paqartësi. Si në paragrafin e parë, ashtu edhe në të dytin, përdoret shprehja “pasuria e përgjithshme” e paraardhësit i cili e ka lidhur kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë. Në të dy paragrafët me këtë shprehje ligjvënësi nënkupton pasurinë e përgjithshme trashëgimore, e cila ekziston në momentin e vdekjes së tij.

Me vdekjen e paraardhësit, i cili ka dorëzuar dhe ka ndarë pasurinë gjatë jetës, nëse ka pasuri trashëgimore në momentin e vdekjes, ajo u duhet ndarë trashëgimtarëve qoftë në bazë të testamentit, nëse ka lënë, qoftë në bazë të ligjit. Me këtë dispozitë ligjore rregullohet ajo se çka hyn në pasurinë trashëgimore dhe nga çka përbëhet ajo si dhe cila pasuri përjashtohet nga pasuria e përgjithshme trashëgimore e ngelur pas vdekjes së trashëgimlënësit, i cili ka lidhur kontratë të vlefshme për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë gjatë jetës.

2. Me lidhjen e kontratës së vlefshme për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë gjatë jetës, pasuria që ka qenë objekt i kësaj kontrate u kalon pasardhësve ose fëmijëve a të adoptuarve të dorëzuesit. Me këtë kontratë dhe mbi këtë bazë ajo tjetërsohet nga ana e paraardhësit. Për këtë arsye, sipas par. 1 të nenit 552, pasuria e trashëgimlënësit, qoftë një pjesë, qoftë në tërësi, e cila me kontratë të vlefshme për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, si objekt i saj, ka kaluar te pasardhësit, nuk llogaritet si pasuri trashëgimore e ngelur pas vdekjes së atij trashëgimlënësi, ashtu që pasuria trashëgimore e tij përbëhet nga pasuria që nuk ka qenë objekt i kontratës për dorëzimin dhe ndarjen dhe nga pasuria që është fituar pas lidhjes së kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë.

3. Me lidhjen e kontratës për dorëzimin dhe ndarjen, pasardhësit apo/edhe fëmijët e adoptuar fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e cila ka qenë objekt i kësaj kontrate nga momenti i lidhjes së saj. Në këtë mënyrë, pas vdekjes së dorëzuesit, pasuria e fituar nga pasardhësit me anë të dorëzimit dhe ndarjes nuk bën pjesë në pasurinë trashëgimore të tij/saj dhe nuk llogaritet me rastin e përcaktimit të vlerës së pasurisë së përgjithshme trashëgimore. Me rastin e vdekjes së paraardhësit, trashëgimia e tij përbëhet nga pasuria dhe të mirat e tjera të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën për dorëzimin dhe ndarjen si dhe të mirat të cilat janë fituar nga paraardhësi pas lidhjes së saj.

Neni 553. Pajtimi i pasardhësve

1. Nëse ndonjëri nga pasardhësit nuk ka dhënë pëlqimin në dorëzimin dhe ndarjen, ato pjesë të pasurisë të dorëzuara tek pasardhësit tjerë do të konsiderohen dhurata dhe pas vdekjes së paraardhësit trajtohen si dhurata që u janë bërë trashëgimtarëve nga paraardhësi.

2. Dispozita e paragrafit paraprak do të zbatohet përshtatshmërisht edhe nëse pas dorëzimit dhe ndarjes, për të cilin është dhënë pëlqimi nga të gjithë pasardhësit, është lindur një fëmijë te dorëzuesi ose një pasardhës i cili është gjetur pas shpalljes për të vdekur.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Një karakteristikë e veçantë e kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë është ajo se, për arsyet dhe në kushtet e parashikuara ligjore, në qoftë se ndonjëri nga pasardhësit nuk e ka dhënë pëlqimin për kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, ajo e humb efektin, si e tillë, ndaj të gjithë trashëgimtarëve dhe konsiderohet si kontratë për dhuratën²³⁶ ndaj të gjithë atyre.

2. Për të qenë e vlefshme dhe për të prodhuar efekte juridike, kontrata për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë është e nevojshme që të gjithë pasardhësit apo/dhe fëmijët e adoptuar të japin pëlqimin për atë dhe mënyrën e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë sipas saj. Sipas par. 1 të këtij neni, nëse dikush nga pasardhësit (apo të adoptuarit) nuk e ka dhënë pëlqimin për dorëzimin dhe ndarjen, pjesët e pasurisë të dorëzuara me atë kontratë pasardhësve të tjerë, do të konsiderohen si dhurata, ashtu që me vdekjen e paraardhësit ato pjesë trajtohen si dhurata që u janë bërë trashëgimtarëve nga paraardhësi.²³⁷ Kjo dispozitë ligjore ka të bëjë me rastet kur, me rastin e vdekjes së paraardhësit, trashëgimtar i mundshëm ligjor është pasardhësi që ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë dhe nuk ka dhënë pëlqimin për lidhjen e asaj kontrate.

3. Përpos rastit nga paragrafi i parë i kësaj dispozite ligjore, mund të paraqiten edhe raste të tjera kur pjesët e pasurisë të dorëzuara dhe të ndara pasardhësve, pas vdekjes së paraardhësit, do të trajtohen si dhurata që u janë bërë atyre. Kështu, sipas par. 2 të këtij neni, si dhurata do të llogariten pjesët nga kontrata edhe në rastet kur, pas dorëzimit dhe ndarjes, për të cilën është dhënë pëlqimi nga të gjithë pasardhësit që kanë ekzistuar në atë kohë, por më vonë dorëzuesit të pasurisë i ka lindur fëmija tjetër ose eventualisht është gjetur pasardhësi i cili, në kohën e lidhjes së kontratës, ka qenë i shpallur për të vdekur.²³⁸

4. Pasuria e dorëzuesit të pasurisë, e cila ka qenë e përfshirë në kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë gjatë jetës, nuk hyn dhe nuk bën pjesë në trashëgimin e tij. Në këtë mënyrë, trashëgimtari i dorëzuesit, i cili nuk e ka dhënë pëlqimin për kontratën, do të trashëgojë vetëm në pasurinë që nuk është përfshirë në kontratë dhe në atë të cilën dorëzuesi e ka fituar pas lidhjes së asaj kontrate. Nga kjo rrjedh se ky pasardhës, si trashëgimtar është i pabarabartë me pasardhësit e tjerë, të cilët e kanë dhënë pëlqimin në kontratë dhe janë shpallur trashëgimtarë të dorëzuesit. Kjo pabarazi rrjedh nga fakti se pasuria që ka qenë objekt i kontratës ka kaluar në pasuri të bashkëtrashëgimtarëve të tij dhe

236 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 536 deri 549 dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

237 Shih nenin 47 dhe nenet tjera në vazhdim të LTK.

238 Shih nenin 550 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

është e përjashtuar nga pasuria trashëgimore e dorëzuesit, kështu që, për aq sa është vlera e saj, është zvogëluar pjesa trashëgimore e pasardhësit i cili nuk e ka dhënë pëlqimin për kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, i cili ka lindur pas lidhjes së kontratës ose në kohën e lidhjes së saj ka qenë i shpallur për të vdekur dhe është gjetur më vonë. Kështu, me qëllim të barazimit të të gjithë pasardhësve të dorëzuesit të pasurisë, të cilët kanë të drejtë të trashëgojnë, sipas kësaj dispozite ligjore, pjesët e pasurisë që u janë dorëzuar pasardhësve të tjerë konsiderohen si dhurata të bëra atyre dhe prandaj edhe vetë kontrata për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë trajtohet si kontratë për dhuratën.

Mbi këtë bazë ligjore, në rast se pasardhësit i cili nuk e ka dhënë pëlqimin për kontratën e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë i është cenuar pjesa e domosdoshme, pasuria që ka qenë objekt i kontratës bën pjesë në vlerën e përgjithshme të llogaritur të trashëgimisë dhe do të shërbejë si pjesë bazë për llogaritjen e pjesës së tij të domosdoshme. Pas kësaj zbatohet rregulla e llogaritjes së dhuratave dhe dorëzimeve në pjesën trashëgimore dhe pasuria që ka qenë objekt i kontratës së dorëzimit dhe ndarjes llogaritet në pjesën trashëgimore të të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të dorëzuesit.²³⁹

Pra, nëpërmjet kësaj dispozite ligjore pasardhësit deri diku mbrohen nga veprimet e papërgjegjshme të paraardhësve të tyre përkitazi me disponimin e pasurisë së tyre.

Neni 554. Ruajtja e të drejtave gjatë dorëzimit

- 1. Gjatë dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë dorëzuesi mund të ruaj për veten e tij apo saj, bashkëshorten apo bashkëshortin e tij apo saj apo për çdo person tjetër të drejtën e uzufuktit mbi të gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë së dorëzuar ose të kërkojë një rentë jetësore me para në dorë apo në vepër, mbajtje të përjetshme ose ndonjë kompensim tjetër.**
- 2. Nëse është arritur marrëveshja mbi uzufuktin ose rentën jetësore për dorëzuesin dhe bashkëshorten apo bashkëshortin e tij apo saj së bashku, atëherë në rast të vdekjes së njërit prej tyre uzufukti apo renta jetësore i takon tjetrit në tërësinë e plotë të saj deri në vdekjen e këtij tjetrit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ose përveç nëse rrjedh ndryshe nga rrethanat e rastit.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Me kontratën e dorëzimit paraardhësi merr për detyrim ta dorëzojë dhe ta ndajë pronën te pasardhësit e tij. Dorëzimi dhe ndarja e pasurisë nga paraardhësi zakonisht bëhet pa ndonjë detyrim nga pasardhësit, prandaj kontrata e dorëzimit është e ngjashme me kontratën e dhurimit.²⁴⁰ Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar mundësia e ruajtjes së disa të drejtave që rrjedhin nga pasuria e dorëzuar ose e drejta e ndonjë kompensimi tjetër për dorëzuesin e pasurisë, për bashkëshorten a për ndonjë person tjetër nga pasardhësit e tij, gjë që nënkupton se me këtë dispozitë ligjore

239 Shih neni 49 të LTK.

240 Shih nenin 549 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

përcaktohen disa raste karakteristike të cilat kontrata e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë merr disa veti të detyrimeve të dyanshme.

2. Sipas par. 1 të nenit 554, me rastin e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë, përpos dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë, gjë që përfaqëson detyrim për paraardhësin, kontraktuesit mund të parashikojnë ndonjë të drejtë të veçantë për paraardhësin apo edhe detyrime për pasardhësit ndaj dorëzuesit të pasurisë. Me kontratën e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë, përpos për pasardhësit, sipas ligjit, shprehimisht mund të parashikohen të drejta edhe për vetë dorëzuesin dhe bashkëshorten/tin e tij. Sipas kësaj dispozite ligjore, përfitimi parashikohet edhe për çdo person tjetër, pa dhënë ndonjë përkufizim, gjë që nënkupton se me këtë kontratë mund të sanksionohet ndonjë e drejtë, përpos për pasardhësit, edhe për çdo person tjetër.

Edhe përkitazi me përfitimet që mund të parashikohen me këtë kontratë për dorëzuesin, bashkëshorten e tij/saj ose për ndonjë person tjetër, ligji shprehimisht parashikon përfitimin e së drejtës së uzufuktit mbi të gjithë pasurinë e dorëzuar apo vetëm mbi një pjesë të saj, të drejtën e rentës për gjithë kohën sa është gjallë dorëzuesi, qoftë në para apo me vepër, gjë që nënkupton dhënien e ushqimit të përhershëm për paraardhësin nga ana e pasardhësve, në para ose në natyrë, ose të drejtën e ndonjë kompensim tjetër. Në një detyrim të këtillë mund të përfshihen të gjithë pasardhësit ose vetëm ndonjëri prej tyre. Në këtë mënyrë, lloji i detyrimit me të cilin ngarkohen pasardhësit nuk është i kufizuar as në aspektin objektiv, as në atë subjektiv. Detyrimi i pasardhësve nuk është i kufizuar vetëm ndaj dorëzuesit të pasurisë dhe bashkëshortit/es të tij/saj, ai mund të parashikohet edhe ndaj ndonjë personit të tretë, por edhe ndaj ndonjërit nga pasardhësit të cilit i është dorëzuar dhe ndarë ndonjë pjesë e pasurisë. Varësisht nga personat në favor të të cilëve është përcaktuar detyrimi me kontratën për dorëzimin e pasurisë, si dhe nga dhënia apo jo e pëlqimit për dorëzimin dhe ndarjen, paraqiten situata të ndryshme me rastin e marrjes së vendimit lidhur me trashëgiminë pas vdekjes së dorëzuesit.²⁴¹ Po ashtu, me kontratë mund të parashikohet detyrimi i pasardhësve në pjesë të barabarta për të gjithë. Mirëpo, kjo nuk është rregull, pasi që detyrimi mes pasardhësve ndaj dorëzuesit mund të jetë jo i barabartë, ashtu që edhe mund të ndodhë të përcaktohen detyrime për vetëm njërin nga pasardhësit (p.sh., pasuria u dorëzohet dhe ndahet dy djemve në pjesë të barabarta, kurse vetëm njëri prej tyre merr detyrimin për ushqim të përhershëm të dorëzuesit dhe bashkëshortit/tës. Llojet e detyrimeve, po ashtu, mund të jenë të ndryshme, ashtu që mund të parashikohet edhe përgjegjësia për borxhet e dorëzuesit të pasurisë.²⁴²

3. Me paragrafin 2 të nenit 554 janë rregulluar të drejtat e dorëzuesit dhe të bashkëshortes/tit të tij/ të saj, në rastet kur e drejta e uzufuktit ose renta jetësore është parashikuar për dorëzuesin dhe bashkëshorten e tij. Sipas kësaj dispozite ligjore, në rastet e tilla, me rastin e vdekjes së njërit nga bashkëshortët, uzufukti apo renta për ushqim gjatë jetës në tërësi i takon bashkëshortit tjetër deri në vdekjen e tij/saj. Kjo është rregull e përgjithshme, e cila

241 Shih nenin 32 të LTK.

242 Shih nenin 556 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

vlen për të gjitha rastet kur nuk është parashikuar ndryshe me kontratën e dorëzimit. Nëse me kontratën e dorëzimit parashikohet shprehimisht se e drejta e uzufuktit apo e rentës për ushqim të përjetshëm i takon vetëm dorëzuesit dhe se me vdekjen e tij ajo pushon, në atë rast kjo e drejtë nuk i kalon bashkëshortit/es. E njëjta gjë do të ndodhë edhe në rastet kur diçka kështu shprehimisht nuk parashikohet me kontratën e dorëzimit, por ashtu rrjedh nga të gjitha rrethanat e rastit.

Neni 555. E drejta e bashkëshortit/es së dorëzuesit/es

- 1. Gjatë dorëzimit dhe ndarjes, dorëzuesi gjithashtu mund të marrë parasysh edhe bashkëshorten apo bashkëshortin. Për ta bërë këtë jetë e nevojshme dhënia e pëlqimit të bashkëshortes apo bashkëshortit.**
- 2. Nëse bashkëshortja apo bashkëshorti nuk janë marrë parasysh, të drejtat e saj apo tij për pjesën e detyrueshme mbeten të pacenuara.**
- 3. Në rastin e tillë, dorëzimi dhe ndarja mbeten të vlefshme, por në përcaktimin e vlerës së pasurisë së përgjithshme në bazë të së cilës është përcaktuar pjesa e detyrueshme e bashkëshortes apo bashkëshortit të pas jetuar, ato pjesë të pasurisë së trashëgimlënësit të dorëzuara tek pasardhësit e tij apo saj do të konsiderohen si dhurata.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Për të qenë e vlefshme kontrata e dorëzimit dhe e ndarjes së pasurisë, duhet të ekzistojë pëlqimi për të i të gjithë pasardhësve, fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të tyre,²⁴³ që nënkupton se të gjithë ata duhet të jenë palë kontraktuese, pavarësisht nga ajo nëse me kontratë të gjithë ata janë përfitues apo jo dhe në çfarë pjesë; përndryshe, kontrata e dorëzimit shndërrohet në kontratë të dhurimit. Për dallim nga pasardhësit, për vlefshmërinë e kontratës nuk është e thënë që palë kontraktuese të jetë edhe bashkëshorti/ja i dorëzuesit të pasurisë. Mirëpo, derisa edhe bashkëshorti, sikurse edhe pasardhësit e dorëzuesit, është trashëgimtar i rendit të parë, me rastin e lidhjes së kontratës së dorëzimit duhet pasur kujdes për ruajtjen e të drejtave të bashkëshortit/es. Me qëllim të pamundësimit që, me kontratën e dorëzimit, pasuria e paraardhësit të kalojë te pasardhësit dhe në këtë mënyrë të cenohen të drejtat trashëgimore të bashkëshortit, me nenin 555 parashikohen dy rregulla mbrojtëse për zgjidhjen e këtij problemi.

2. Sipas par. 1 të këtij neni, me rastin e lidhjes së kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, dorëzuesi mund të marrë parasysh edhe bashkëshorten e tij. Kjo do të ndodhë në atë mënyrë që edhe bashkëshorti të jetë palë kontraktuese, duke dhënë pëlqimin për lidhjen e kësaj kontrate, pavarësisht nëse i është dorëzuar dhe ndarë ose jo edhe asaj/atij një pjesë e pasurisë. Me rëndësi është që edhe bashkëshorti ta ka dhënë pëlqimin për dorëzimin dhe ndarjen sipas kësaj kontrate, e cila në këtë rast do të prodhojë efekte juridike. Në këto raste, pozita e bashkëshortit barazohet me pozitën e pasardhësve të dorëzuesit të pasurisë. Me

243 Shih nenin 550 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

dhënien e pëlqimit në këtë mënyrë, konsiderohet se bashkëshorti ka hequr dorë nga e drejta për të kërkuar pjesën e domosdoshme.

3. Rregulla tjetër mbrojtëse për mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortit parashikohet në par. 2 të këtij neni dhe ka të bëjë me rastet kur bashkëshorti, pavarësisht nga cilat arsye, nuk e ka dhënë pëlqimin për kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë dhe nuk është palë kontraktuese. Në rastet e këtilla e gjithë pasuria e paraardhësit që ka kaluar te pasardhësit e tij do të konsiderohet si dhurim ndaj pasardhësve, vetëm për sa i përket bashkëshortit të gjallë, në funksion të mbrojtjes së interesave trashëgimore juridike të bashkëshortit të dorëzuesit, me të cilin rast edhe mbrohet e drejta e tij mbi pjesën e domosdoshme.

4. Në qoftë se bashkëshorti/ja nuk është marrë parasysh me rastin e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë, kjo lë të kuptohet se ai/ajo nuk ka hequr dorë nga e drejta për të kërkuar pjesën e domosdoshme të trashëgimisë që i takon sipas ligjit, pas vdekjes së dorëzuesit të pasurisë. Në këto raste, kur bashkëshorti/ja nuk është marrë parasysh, dorëzimi dhe ndarja e pasurisë mbeten të vlefshme, por në përcaktimin e vlerës së pasurisë së përgjithshme të dorëzuesit të pasurisë, në bazë të së cilës është përcaktuar pjesa e detyrueshme e bashkëshortit/es të pasjetuar, pjesët e pasurisë së trashëgimlënësit, të cilat u janë dorëzuar pasardhësve, do të konsiderohen si dhurata që u janë bëra atyre.

Neni 556. Borxhet e dorëzuesit

- 1. Pasardhësi të cilit dorëzuesi i ka dorëzuar pasurinë e tij apo saj, nuk është përgjegjës për borxhet e dorëzuesit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshjen e dorëzimit dhe ndarjes.**
- 2. Kreditorët e dorëzuesit mund ta ndalojnë dorëzimin dhe ndarjen sipas kushteve që zbatohen tek ndalimi i disponimit me mirënjohje.**

1. Përpos detyrimit për ushqim të përjetshëm,²⁴⁴ me kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, për pasardhësit të cilëve iu është dorëzuar pasuria mund të parashikohen edhe detyrime të tjera. Sa u përket trashëgimtarëve, ata janë përgjegjës për borxhet që e ngarkojnë trashëgiminë në përpjesëtim me pjesën e tyre dhe deri në vlerën e tyre të pjesës trashëgimore. Kontrata për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë përfaqëson bazën juridike të sukcesionit singular, i cili paraqitet gjatë jetës së dorëzuesit të pasurisë. Nga kjo rrjedh se, si rregull, në rastet kur me kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë nuk është parashikuar ndryshe, te pasardhësi kalojnë vetëm të drejta e jo edhe detyrime. Në këtë mënyrë, për borxhet e dorëzuesit të pasurisë, pasardhësit të cilëve ai ua ka dorëzuar pasurinë, si rregull, nuk janë përgjegjës. Ata janë përgjegjës për borxhet e dorëzuesit të pasurisë vetëm nëse ajo parashikohet me kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë.

244 Shih nenin 554 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

Dispozita e këtillë kontraktuese e ka veprimin e kontratës për marrjen përsipër të borxhit,²⁴⁵ kështu që, kur me të pajtohet kreditori i dorëzuesit, në këtë rast kemi të bëjmë me marrjen përsipër të borxhit.²⁴⁶

2. Paraardhësi mund t'ia kalojë pasardhësit të gjithë pasurinë që ka dhe kështu të ngelë pa mjete nga të cilat kreditorët e tij do të mund të inkasonin borxhet të cilat ua ka ai. Për këtë arsye, në par. 2 të këtij neni parashikohet mundësia e kreditorëve, të cilëve dorëzuesi u ka borxh, ta ndalojnë dorëzimin dhe ndarjen sipas kushteve që zbatohen për ndalimin e disponimit me mirënjohje (pa shpërblim).²⁴⁷ Këtë mund ta bëjnë, duke kundërshtuar kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë varësisht nga ajo sa është kontrata me ngarkesë për pasardhësit. Nëse kontrata është pa shpërblim, pa ndonjë detyrim për pasardhësin, do të vlejë supozimi i parrëzueshëm se dorëzuesi e ka ditur dhe ka dashur që, me lidhjen e kontratës, t'u shkaktojë dëm kreditorëve, ndërsa kreditorët nuk kanë detyrim të argumentojnë se për këtë qëllim kanë ditur pasardhësit dhe bashkëshorti i dorëzuesit.²⁴⁸

Neni 557. Garancia

Detyrimi për garancinë që rrjedh pas ndarjes ndërmjet bashkë trashëgimtarëve duhet të rrjedhë gjithashtu ndërmjet pasardhësve pas dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë të dorëzuar dhe ndarë nga paraardhësi apo prindi adoptues.

Me këtë dispozitë ligjore rregullohet çështja e sigurimit (garancisë) ndërmjet pasardhësve për pasurinë e dorëzuar dhe të ndarë nga paraardhësi apo prindi adoptues. Në këtë mënyrë, sipas nenit 557, detyrimi për garancinë që rrjedh pas ndarjes ndërmjet bashkëtrashëgimtarëve²⁴⁹, vlen edhe ndërmjet pasardhësve, pas dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë nga paraardhësi apo prindi adoptues.

.....
245 Shih nenin 437 të këtij Ligji.

246 Shih nenin 430 të këtij Ligji.

247 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 261 deri 267.

248 Shih nenin 262 par. 3 të këtij Ligji.

249 Në nenit 144 të LTK parashikohet mbrojtja midis trashëgimtarëve, pas ndarjes së pasurisë së trashëguar, ashtu që nëse pas ndarjes:

a. një person i tretë, duke realizuar të drejtën e krijuar para ndarjes, ligjërisht e merr një send që e ka fituar trashëgimtarin me ndarje ose në mënyrë të ligjshme e kufizon ushtrimin e një të drejte që trashëgimtari e ka fituar me ndarje, ose

b. një send i fituar nga trashëgimtari me ndarje ka defekt të fshehur ose

c. një kërkesë që i ka kaluar trashëgimtarit me ndarje nuk ekziston ose nuk mund të nxirret në vlerën e plotë që i ka kaluar atij, *trashëgimtarët e tjerë janë përgjegjës ndaj këtij trashëgimtari për dallimin mes vlerës aktuale të këtij sendi, të drejte ose objekti dhe vlerës së prezumuar të tyre gjatë ndarjes.*

Përgjegjësia e çdo trashëgimtari për çdo kërkesë kufizohet brenda kërkesës që i takon pjesës së tij, në raport me trashëgiminë në tërësi, që nënkupton se rrezikun e mban edhe trashëgimtari në të mirën e të cilit ka ekzistuar e meta juridike apo materiale dhe jo vetëm bashkëtrashëgimtarët tjerë.

Përgjegjësia e pasardhësve të tjerë, sipas kësaj rregulle, ekziston vetëm në rast se plotësohen të gjitha supozimet që janë të nevojshme, sipas LMD, për përgjegjësinë për të metat materiale dhe juridike.²⁵⁰

Neni 558. Revokimi i dorëzimit

- 1. Dorëzuesi mund ta revokojë kontratën për arsye të mosmirënjohjes së thellë nëse pas lidhjes së sajë një pasardhës sillet ndaj dorëzuesit apo ndaj personit të afërt me të në atë mënyrë që sipas parimeve themelore të moralit do të ishte e padrejtë që të mbante atë që është marrë.**
- 2. Dorëzuesi ka të drejtën e njëjtë nëse pasardhësi nuk arrin ti ofrojë atij apo asaj apo personit tjetër, mbajtjen për të cilën janë pajtuar me kontratën e dorëzimit dhe ndarjes ose nuk arrin të paguaj borxhet e dorëzuesit kur kontrata e ka ngarkuar pasardhësin me pagimin e borxheve të tilla.**

1. Vështrim i përgjithshëm. - Shikuar në përgjithësi, kontrata juridikisht e vlefshme prodhon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese. Sa u përket detyrimeve, ato mund të jenë me detyrime vetëm të njëanshme apo të dyanshme. Kontrata për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë mund të jetë me detyrime të njëanshme, vetëm për dorëzuesin e pasurisë²⁵¹, por mund të jetë edhe me detyrime të dyanshme – edhe për pasardhësit apo fëmijët e adoptuar.²⁵² Pra, edhe nga kjo kontratë lindin detyrime të ndërsjella mes palëve, të cilat mund ekzekutohen në mënyrë të dhunshme, nëpërmjet padisë – së pari në procedurën kontestimore dhe pastaj edhe në atë përmbarimore. Derisa në bazë të kësaj kontrate pasardhësi fiton të drejtën detyrimore për të kërkuar nga paraardhësi që ai ta përmbushë detyrimin e përcaktuar me kontratë, edhe paraardhësi i takon e drejta të kërkojë me padi nga pasardhësi i cili, sipas kontratës, ka ndonjë detyrim, që ta përmbushë atë detyrim. *Sipas kësaj dispozite ligjore, ekzistojnë disa detyrime me rëndësi të veçantë për të cilat paraardhësi, përpos të drejtës së përgjithshme për padi me qëllim të përmbarimit të kontratës përkitazi me detyrimet që rrjedhin nga ajo, ka të drejtë edhe për revokimin e saj.*

2. Mundësia e revokimit të kontratës së dorëzimit me këtë dispozitë ligjore parashikohet për dy arsye: për mbrojtjen e interesave të tij morale (mosmirënjohja) ose të atyre ekonomike. Me paragrafin e parë të këtij neni është rregulluar mundësia e revokimit të kësaj kontrate nga paraardhësi, me qëllim të mbrojtjes së interesave të tij morale. Kësisoj, ai mund ta revokojë kontratën për shkak të mosmirënjohjes së thellë, në rastet kur pasardhësi sillet në atë mënyrë që, sipas parimeve themelore të moralit, do të ishte e padrejtë ta mbante atë që ka marrë. Sjellja e tillë e pasardhësit duhet të jetë e orientuar ndaj dorëzuesit ose ndaj personit të afërm me të.²⁵³

250 Shih nenin 103 të këtij Ligji.

251 Shih nenin 549 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

252 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 554 dhe 556 dhe komentet e dhëna për këto nene.

253 Shih komentin e dhënë lidhur me par. 1 të nenit 543 të këtij Ligji.

3. Me kontratën e dorëzimit mund të parashihet detyrimi për pasardhësit ndaj dorëzuesit në dhënien e një rente të përjetshme me para në dorë apo me vepër ose ndonjë kompensim tjetër.²⁵⁴ Sipas par. 2 të nenit 558 të këtij Ligji, të drejtën e revokimit të kontratës së dorëzimit paraardhësi e ka edhe atëherë kur paraardhësi nuk e përmbush detyrimin lidhur me ushqimin e përhershëm të tij apo të personit tjetër sipas kontratës ose kur nuk i paguan borxhet e dorëzuesit, nëse ky detyrim është parashikuar me kontratën e dorëzimit.²⁵⁵

4. Përpos detyrimeve për dhënien e mbajtjes së përjetshme për dorëzuesin apo ndonjë person tjetër dhe pagesën e borxheve të dorëzuesit, me kontratën e dorëzimit mund të parashikohet detyrimi i pasardhësit edhe për dhënien e ndonjë kompensimi tjetër. Sipas par. 3 të këtij neni, në rastet e mospërmbushjes së ndonjë detyrimi tjetër të marrë përsipër nga pasardhësi me kontratën e dorëzimit, dorëzuesi mund të kërkojë revokimin e kontratës dhe kthimin e asaj që ka marrë me të. I mbetet gjykatës të vendosë nëse do ta detyrojë pasardhësin për kthimin e pasurisë së dhënë me kontratë apo për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër me të. Se në cilën mënyrë do të vendosë, varet nga çdo rast konkret, duke pasur parasysh sasinë e borxheve të dorëzuesit dhe rrethanat e tjera të rastit, siç janë gjendja ekonomike, natyra e detyrimit për kompensim etj.

5. Siç shihet nga sa u parashtrua më sipër, e drejta e dorëzuesit për ta revokuar kontratën për shkak të mosmirënjohjes mund të bëhet vetëm në rastet kur kontrata është me detyrim të njëanshëm – për dorëzuesin dhe jo edhe për pasardhësin. Ndërkaq, e drejta për ta revokuar kontratën për shkak të mospagesës së ushqimit të përjetshëm, mospagesës së borxheve ose të ndonjë kompensimi tjetër, do të ekzistojë vetëm në rastet kur kontrata nuk ka vetëm veti bamirëse, por është me detyrime të dyanshme. Pasojat e revokimit janë kthimi i ndërsjellë i asaj që është përfituar me kontratë: pasardhësi ia kthen paraardhësit pasurinë që e ka fituar me kontratë, kurse paraardhësi ia paguan pasardhësit kompensimin për ushqimin e marrë ose për borxhet e paguara deri atëherë.

Revokimi i këtillë i kontratës së dorëzimit dhe kthimi i asaj që është marrë në bazë të asaj kontrate mund të bëhet me marrëveshje mes palëve, në të njëjtën mënyrë dhe formë si kontrata nga rrjedhin ato të drejta dhe detyrime. Në rast të kontestit mes palëve, kërkesat e këtilla realizohen nëpërmjet gjykatës, në kontest civil. Padi tës është dorëzuesi, ndërsa i paditur është pasardhësi. Me padi duhet patjetër të kërkohej revokimi i kontratës, për të kërkuar edhe kthimin e asaj që është marrë sipas kësaj kontrate, ngase derisa ekziston kontrata e vlefshme, nuk mund të kërkohej kthimi i asaj që është marrë sipas saj. Nëse gjatë procedurës vërtetohet ekzistimi i mosmirënjohjes apo mospagesa e borxheve të dorëzuesit ose mosdhënia e ushqimit sipas kontratës, do të duhej aprovuar kërkesa, pa hyrë në vlerësimin e rëndësisë së cenimit të detyrimit kontraktues që ka ai për dorëzuesin.

Derisa palë kontraktuese mund të jetë edhe bashkëshorti/ja, gjithë ajo që është thënë për pasardhësit vlen edhe për bashkëshortin, në rastet kur ai/ajo është palë kontraktuese.

254 Shih nenin 554 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë nen.

255 Shih par. 1 të nenit 556 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

Neni 559. Të drejtat e pasardhësve, fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar pas revokimit

- 1. Pasardhësi i cili është dashur të kthejë tek dorëzuesi atë që është marrë gjatë dorëzimit dhe ndarjes mund të kërkojë pjesën e tij apo saj të detyrueshme pas vdekjes së dorëzuesit, përveç nëse është përjashtuar nga trashëgimia apo nuk është i denjë të trashëgojë nga dorëzuesi, ose përveç nëse ka hequr dorë nga trashëgimia.**
- 2. Gjatë llogaritjes së pjesës së detyrueshme, ato pjesë të pasurisë të dorëzuara dhe shpërndara nga trashëgimlënësi gjatë jetës tek pasardhësit tjerë, konsiderohen si dhurata.**

1. Në bazë të nenit 558 të LMD, kontrata për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë mund të revokohet për tri arsye.²⁵⁶ Pavarësisht nga arsyeja e revokimit e parashikuar në këtë dispozitë ligjore, revokimi i kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë dhe kthimi i asaj që është marrë në bazë të kësaj kontrate, nuk nënkupton padenjësinë e pasardhësit për ta trashëguar paraardhësin i cili e ka revokuar kontratën. Mbi këtë bazë, sipas par. 1 të këtij neni, pasardhësi i cili për shkak të revokimit të kontratës së dorëzimit, qoftë sipas par. 1, 2 apo 3 të nenit 558 të këtij Ligji, është dashur ta kthejë pasurinë e marrë me atë kontratë, ka të drejtë ta trashëgojë pas vdekjes paraardhësin sipas rregullave të përgjithshme të trashëgimisë. Kjo nënkupton se, nëse në momentin e vdekjes dorëzuesi ka pasuri, ai ka të drejtë ta trashëgojë atë. Në qoftë se paraardhësi e ka bërë dorëzimin dhe ndarjen e të gjithë pasurisë gjatë jetës, pasardhësi përkitazi me të cilin është revokuar kontrata dhe i cili e ka kthyer pasurinë pas vdekjes së dorëzuesit, ka të drejtë e pjesës së detyrueshme. Pasardhësi i cili ia ka kthyer dorëzuesit atë që ka marrë në bazë të kontratës së dorëzimit, pas vdekjes së dorëzuesit nuk ka të drejtën e trashëgimit dhe nuk mund të kërkojë pjesën e detyrueshme, vetëm nëse ka hequr dorë nga trashëgimi²⁵⁷ ose kur nuk është i denjë të trashëgojë atë.²⁵⁸

2. Revokimi i kontratës për dorëzimin e pasurisë ka për qëllim dhe për pasojë kthimin e pasurisë që i ka takuar pasardhësit a fëmijës së adoptuar apo bashkëshortit, përkitazi me të cilin kontrata është revokuar. Në këtë mënyrë, në rastet kur kontrata e dorëzimit revokohet përkitazi me njërin nga pasardhësit, ndaj pasardhësve tjerë, nëse palë kontraktuese është edhe bashkëshorti, edhe ndaj saj/tij, kontrata e dorëzimit do të ngelë në fuqi. Sipas par. 2 të këtij neni, me rastin e përcaktimit të pjesës së detyrueshme të atij pasardhësi, pjesët e pasurisë të cilat paraardhësi ua ka dorëzuar pasardhësve të tjerë dhe bashkëshortit, do të konsiderohen dhurime që u janë bërë atyre.

256 Shih nenin 558 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

257 Shih dispozitat nga neni 130 deri 135 të LTK dhe nenin 165 të LPJ.

258 Shih nenin 111 të LTK.

PJESA V KONTRATA PER MBAJTJEN E PERJETSHME

Neni 560. Përkufizimi

- 1. Me anë të kontratës për mbajtje të përjetshme, një palë kontraktuese (dhënësi i mbajtjes) merr përsipër të ndihmojë palën tjetër kontraktuese apo ndonjë person tjetër (marrësin e mbajtjes) dhe pala tjetër kontraktuese deklaron se ai apo ajo do të dorëzojë të parit (dhënësit të mbajtjes) të gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë së tij apo sajë, e përbërë nga pasuria e përgjithshme dhe pasuria e luajtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë e përgjithshme, me ç’rast dorëzimi i tillë shtyhet deri në kohën e vdekjes së dorëzuesit.**
- 2. Kjo kontratë gjithashtu mund të përfshijë edhe pasuri tjetër të luajtshme të marrësit të mbajtjes, e cila duhet të theksohet në kontratë.**
- 3. Kontratat me të cilat arrihet marrëveshja për premtimin e trashëgimit të një bashkimi të përjetshëm apo një bashkim i pasurisë ose një palë kontraktuese pajtohet që të kujdeset dhe të mbrojë palën tjetër, të punoj pronën e tij apo sajë të kryejë të gjitha ceremonitë e funeralit pas vdekjes së tij apo saj, apo çdo gjë tjetër për të njëjtin qëllim duhet të konsiderohen kontrata për mbajtje të përjetshme.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 ka hyrë në fuqi më 20 dhjetor 2013. Deri në hyrjen në fuqi të këtij Ligji, në Kosovë është zbatuar Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Zakon o Obligacionim Odnosima) i ish-Federatës Jugosllave, i zbatueshëm nga 1 tetori 1978.²⁵⁹ Ligji në fjalë i ish-Federatës Jugosllave i vitit 1978 nuk e ka rregulluar dhe nuk ka përmbajtur dispozita për kontratën për ushqimin (mbajtjen) e përjetshme. Në atë kohë, sipas së drejtës pozitive ekzistuese, kjo kontratë ka qenë e rregulluar me Ligjin për Trashëgiminë (“Gaz. Zyr. e KSAK” nr. 43/74), me dispozitat nga neni 105 deri 110, i cili ka qenë i zbatueshëm në Kosovë nga 1 janari 1975. Me Ligjin për Trashëgiminë të Kosovës, nr. 2004/26, i cili ka hyrë në fuqi më 4 shkurt 2005, në një dispozitë të vetme ligjore, vetëm është thënë se kontrata për mbajtje të përjetshme rregullohet nga Ligji për Detyrimet.²⁶⁰ Derisa edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës është zbatuar LMD i ish-Federatës Jugosllave (1978), me të cilin kjo kontratë nuk ka qenë e rregulluar, edhe pas fillimit të zbatimit të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës, nr.2004/26, lidhur me kontratën për mbajtje të përjetshme, janë

.....
259 (“Službeni list SFRJ“ nr. 29/1978).

260 Në kreun e tretë të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës, nr. 2004/26, ku janë rregulluar transaksionet ndërmjet të gjallëve (inter vivos), në nenin 68 emërtohet kontrata për mbajtje të përjetshme dhe thuhet: “ Kontrata e mbajtjes së përjetshme rregullohet nga Ligji për Detyrimet”.

zbatuar dispozitat e Ligjit të Trashëgimisë të KSAK.²⁶¹ Kontrata për mbajtje të përjetshme²⁶² për herë të parë parashikohet dhe rregullohet me ligjin, me të cilin rregullohen marrëdhëniet e detyrimeve, me Ligjin në fuqi Nr. 04/L-077, domethënë, sipas rregullave të së drejtës kontraktore. Kontrata për mbajtje të përjetshme aktualisht nuk është një formë e veçantë e sigurimit të ushqimit të përhershëm.²⁶³ Në këtë aspekt, marrë në përgjithësi, në të drejtën pozitive të R. së Kosovës, e drejta e mbajtjes së përjetshme mund të pasqyrohet në katër mënyra dhe baza ligjore:

- a. me lidhjen e kontratës për mbajtje të përjetshme në bazë të nenit 560 të LMD,
- b. si modalitet i kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë,²⁶⁴
- c. në bazë të testamentit (me caktimin e mbajtjes së përjetshme për personin e caktuar),
- ç. sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile, në harmoni me nenin 2 të LMD.²⁶⁵

2. Në nenin 560 të këtij Ligji është dhënë kuptimi i kontratës për mbajtje të përjetshme dhe janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese dhe të personave të tjerë që mund të dalin prej saj. Sipas këtij Ligji, me kontratën për mbajtje të përjetshme njëra palë kontraktuese merr përsipër ta mbajë (ta ushqejë) palën tjetër kontraktuese apo ndonjë person tjetër, ndërsa pala tjetër kontraktuese deklaron se ia lë të parit gjithë pasurinë që ka ose vetëm një pjesë të saj, e cila përbëhet nga pasuria e paluajtshme dhe pasuria e luajtshme e dedikuar për përdorimin dhe shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme, mirëpo dhënia e pasurisë shtyhet deri në momentin e vdekjes së ushqimmarrësit.²⁶⁶

Nga kuptimi i dhënë në këtë dispozitë ligjore, në radhë të parë vihet re se palë kontraktuese janë, në një anë, ushqimdhënësi dhe, në anën tjetër, ushqimmarrësi. Kur është fjala për

261 Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të Ligjit të Trashëgimisë të Kosovës nuk është parashikuar të mbetet jashtë fuqie Ligji i cili është zbatuar para tij – Ligji i Trashëgimisë i shpallur në “Gaz. Zyr. e KSAK”, 43/74, andaj edhe nuk ka pasur pengesa ligjore të zbatohen dispozitat e këtij të fundit të cilat i përkasin kontratës për mbajtje të përjetshme, pasi që me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve 1978 nuk ka qenë e rregulluar kjo kontratë.

262 Sa i përket shprehjeve gjuhësore përkitazi me emërtimin e kësaj kontrate, në praktikën gjuhësore përdoret si “kontrata për ushqim të përjetshëm” ashtu edhe “kontrata për mbajtje të përjetshme”, ashtu që edhe gjatë komenteve të dhëna me këtë rast do të përdoren të dyja këto shprehje si sinonime. Në versionin shqip të LMD është përdorur kjo e fundit. Duke pasur parasysh faktin se, si rregull, duhet përdorur gjuha e ligjit, atëherë rrjedh se do të duhej përdorur shprehja ligjore, derisa ekziston si e tillë. Me KCRSH, kreu XXI është përdor shprehja “Renta Jetore”.

263 Nisur nga praktika gjyqësore dhe përmbajtja e kontratave për mbajtje të përjetshme, ajo nuk nënkupton vetëm detyrimin e ushqimdhënësit për dhënien e ushqimit, ngase me kontratë, përpos ushqimit mund të parashikohen shumë detyrime të natyrës tjetër, si: mbajtja e higjienës, sigurimi i ngrohjes, kujdesi për shëndetin, nxjerrja në shëtitje, leximi i gazetave, dërgimi për vizita te miqtë dhe përmbushja e shumë nevojave të tjera të ushqimmarrësit, gjatë jetës së tij, kurse me rastin e vdekjes, varrimi dhe mbajtja e ceremonive fetare sipas zakoneve të vendit.

264 Shih nenin 554 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë nen.

265 Shih nenin 2 të këtij Ligji.

266 Ky është kuptimi i kontratës për mbajtje të përjetshme i dhënë sipas këtij Ligji, edhe pse disa shprehje gjuhësore të përdorura në versionin e gjuhës shqipe të kësaj dispozite ligjore mund të sjellin huti në zbatimin e saj, për arsye se disa formulime gjuhësore nuk janë të qarta dhe të precizuara.

ushqimdhënësin, si palë kontraktuese, ai medoemos duhet të jetë personi që duhet të japë dhe të kontribuojë për ushqimin e personit nga kontrata. Zakonisht ky është person fizik, por konsiderojmë se mund të jetë edhe person juridik, nëse, për nga mënyra e organizimit të punës dhe veprimtarisë të cilën e ushtron dhe për të cilën është i regjistruar, mund ta bëjë këtë. Si ushqimdhënës mund të paraqiten dy apo më shumë persona. Në qoftë se për mënyrën dhe sasinë e dhënies apo të veprimit të ushqimdhënësve nuk është parashikuar dhe përcaktuar konkretisht me kontratë, të gjithë ata i përgjigjen solidarisht ushqimmarrësit, pasi që objekti i detyrimit të tyre është i pandarë. Si ushqimdhënës mund të paraqiten edhe të dy bashkëshortët. Nëse kontratën e lidh vetëm njëri prej tyre, kurse detyrimi përmbushet nga pasuria e përbashkët dhe me veprime të përbashkëta, atëherë pasuria e ushqimmarrësit e marrë në emër të kompensimit për këtë, iu takon që të dyve, pasi që konsiderohet se ajo është fituar me kontribut të përbashkët të tyre.

Sa i përket palës tjetër kontraktuese, nuk është e thënë dhe e domosdoshme që ajo të jetë gjithmonë ushqimmarrësi, edhe pse zakonisht ashtu ndodh. Ligji lejon mundësinë e kontraktimit të ushqimit për palën kontraktuese apo ndonjë person tjetër, nga edhe rrjedh se pala tjetër kontraktuese munde ta kontrakttojë dhënien e ushqimit për tjetrin. Në raste të tilla fjala është për kontratë për mbajtje të përhjetshme në dobi të personit të tretë.²⁶⁷ Në qoftë se kontrata për ushqim të përhjetshëm është lidhur në dobi të personit të tretë, në këtë rast ekzistojnë dy palë kontraktuese dhe tre persona: ushqimdhënësi i cili i detyrohet bashkëkontraktuesit se do ta ushqej deri në vdekje personin e tretë. Në këtë aspekt edhe duhen dalluar nocionet bashkëkontraktues i ushqimdhënësit nga ushqimmarrësi. Zakonisht bashkëkontraktuesi i ushqimdhënësit është ushqimmarrësi, por kjo nuk ndodh kur kontrata lidhet në dobi të personit tjetër, në të cilin rast ushqimmarrës është personi i tretë e jo pala kontraktuese.

*“Gjatë procedurës së zhvilluar është vërtetuar se kontrata për mbajtje të përhjetshme është lidhur ndërmjet bashkëshortit të paditëses, tani të ndjerit M.A. dhe të paditurit. Nga pika I, e kësaj kontrate rrjedh se i padituri si ushqimdhënës ka marrë për detyrim të ushqen si të atin e vetë, ashtu edhe nënën – këtu paditësen. Në këtë aspekt i pabazuar është kundërshtimi i të paditurit i paraqitur në revizion se e paditura nuk ka qenë palë kontraktuese, nga e cila arsye edhe nuk mund të kërkojë shkëputjen e kontratës e cila me atë as që është lidhur. Sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit, shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme për shkak të pamundësisë së jetës së përbashkët mund të kërkojë edhe gruaja, pas vdekjes së burrit, në qoftë se burri, me kontratën e lidhur ka kontraktuar dhënien e ushqimit në dobi të gruas”.*²⁶⁸

Sidoqoftë, kur është fjala për palët kontraktuese, këtë kontratë mund ta lidhin të gjithë personat sipas kushteve të përgjithshme për lidhjen e kontratës. Ushqimmarrës, sipas kësaj kontrate, mund të jetë çdo person fizik i cili e ka zotësinë për të lidhur kontratën sipas

267 Shih nenin 131 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

268 Gjyk. Sup. e R. Kr. 934/1996 dt. 26. Lipanj 1996.

rregullave të përgjithshme të së drejtës civile.²⁶⁹ Nga kjo rrjedh se këtë kontratë mund ta lidhin edhe personat në gjini ndërmjet tyre si dhe personat të cilët, sipas ligjit, kanë detyrimin për ushqim të ndërsjellë. Kjo vlen si për personat në gjini të gjakut, ashtu edhe për personat në gjini të krushqisë ose asaj civile.²⁷⁰ Njëherësh, sipas kushteve të përgjithshme për lidhjen e kontratës, edhe te kontrata për mbajtje të përjetshme, palë kontraktuese mund të jenë disa persona, në anën e ushqimdhënësit, dhe disa persona të tjerë, në anën e ushqimmarrësit. Palë kontraktuese si ushqimmarrës mund të jenë edhe të dy bashkëshortët – së bashku ose ndaras.²⁷¹ Në rast se ushqimmarrës është vetëm njëri bashkëshort, ai do të mund ta disponojë vetëm pasurinë personale të veten dhe pjesën e tij në pasurinë e përbashkët.

3. Sipas kuptimit të dhënë për kontratën për ushqim të përjetshëm në këtë dispozitë ligjore, njëra palë kontraktuese (ushqimdhënësi), merr përsipër detyrimin *ta ndihmojë* palën tjetër kontraktuese a ndonjë person tjetër (ushqimmarrësin). Formulimi i këtillë gjuhësor - *ta ndihmojë* – mund të sjellë paqartësi lidhur me detyrimin e ushqimdhënësit, pavarësisht nga fakti që mënyra e kësaj ndihme duhet të përcaktohet në detaje në kontratë. Konsiderojmë se formulimi gjuhësor *ta ndihmojë* nënkupton detyrimin e ushqimdhënësit të kontribuojë për mbajtjen e ushqimmarrësit në të gjitha aspektet e parashikuara me kontratë. Në praktikë, në shumicën e rasteve, në këto kontrata përdoren formulime të përgjithshme siç janë, p.sh.; ushqimdhënësi ka detyrim “të kujdeset dhe ta ushqejë (ta mbajë) deri në vdekje e pas vdekjes ta varrosë sipas zakoneve të vendit” ose “ta ruajë, të përkujdeset dhe të bashkëjetojë”. Me shprehjen *ta ndihmojë* do të nënkuptohej detyrimi i ushqimdhënësit për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për mbajtjen e ushqimmarrësit, përkatësisht për plotësimin e nevojave jetësore të tij, siç janë veprimet e ndryshme me qëllim të sigurimit të artikujve dhe sendeve të tjera të ndryshme të nevojshme për jetë dhe detyrimet morale ndaj tij, siç janë: kujdesi për personalitetin, dalja në shëtitje, dërgimi për vizita te të afërmit, dërgimi për vizita mjekësore, leximi i gazetave etj. U mbetet palëve kontraktuese t’i përcaktojnë llojet, vëllimin, mënyrën e ndërmarrjes, cilësinë dhe vendin e realizimit të këtyre detyrimeve. Në mungesë të dispozitave kontraktuese lidhur me përcaktimin detaj të detyrimeve të ushqimdhënësit, ky ka detyrimin t’i sigurojë ushqimmarrësit kushte për banim, ushqimin e nevojshëm, veshmbathjen, kujdesin në rast sëmundjeje dhe në pleqëri. Vëllimi i detyrimeve të ushqimdhënësit, në mungesë të dispozitës kontraktuese për këtë, duhet të vlerësohet sipas parametrave të nevojave të marrësit të ushqimit dhe mundësive të dhënësit. Nevojat e ushqimmarrësit përcaktohen varësisht nga kushtet e jetës së tij deri para lidhjes së kontratës; sipas rregullës, pas lidhjes së kontratës, ushqimmarrësi nuk mund të ketë kushte më të këqija sesa para lidhjes së saj. Ndërkaq, në mungesë të dispozitave kontraktuese, detyrimet e ushqimdhënësit nuk mund të jenë me cilësi më të dobët nga mesatarja në vendin e përmbushjes së detyrimit.

269 Shih nenin 41 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

270 “Nuk është e pavlefshme kontrata për mbajtje të përjetshme e lidhur ndërmjet fëmijës si ushqimdhënësi dhe prindit si ushqimmarrës” – Gjyk. Sup. e BH Ac. 1712/67 dt. 04.02.1969.

271 “Kontratën për ushqim të përjetshëm mund të lidhin nën plotësimin e e supozimeve të përgjithshme çpër vlefshmërinë e saj edhe personat të cilët kanë detyrim për ushqim të ndërsjellë”. – Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 1518/87 dt. 22.10.1987.

Sa u përket detyrimeve morale të ushqimdhënësit, në tërësi gjen zbatim shprehja e përdorur ligjore “*ta ndihmojë*”, pasi që me këtë lloj të detyrimeve do të duhej nënkuptuar përkuqjesja e ushqimdhënësit për personalitetin e ushqimmarrësit, siç janë: përkuqjesja dhe dhënia e ndihmës së nevojshme, veçanërisht në rast sëmundjeje dhe në pleqëri dhe pas vdekjes ta varrosë sipas zakoneve të vendit ku bëhet varrimi.

Detyrimet kontraktuese duhet të përmbushen nga ushqimdhënësi. Kjo nuk nënkupton përmbushjen e të gjitha detyrimeve personalisht nga ai, pasi që ekziston mundësia ato të përmbushen nga personi tjetër, përpos atyre që nuk mund të përmbushen pa kontaktin e drejtpërdrejtë të palëve kontraktuese.²⁷²

4. Formulimi dhe redaktimi gjuhësor edhe i kësaj dispozite ligjore përkitazi me objektin e kontratës për mbajtje të përjetshme, për të cilin ka detyrim ushqimmarrësi, është i paqartë. Sipas formulimit të versionit në gjuhën shqipe, ushqimmarrësi me këtë kontratë deklaron se do t’i dorëzojë ushqimdhënësit gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë *e përbërë nga pasuria e përgjithshme dhe pasuria e luajtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë e përgjithshme*.

Nga formulimi gjuhësor i kësaj dispozite nuk lihen dyshime për atë se objekt i kontratës mund të jetë e gjithë pasuria apo vetëm një pjesë e saj. Duke pasur parasysh faktin se ligjvënësi nuk e përcakton momentin që duhet marrë për masën e pasurisë ekzistuese si dhe nisur nga praktika e deritashme gjyqësore, konsiderojmë se objekt i kontratës mund të jetë si pasuria që ekziston në momentin e lidhjes së kontratës, ashtu edhe pasuria e mëvonshme, që do të nënkuptonte pasurinë të cilën e ka fituar ushqimmarrësi pas lidhjes së kontratës.²⁷³ Mundësia që objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme të jetë edhe pasuria e ardhshme, rrjedh edhe nga neni 441 par. 3 i LMD, sipas të cilit, objekt i shitjes mund të jetë edhe sendi i ardhshëm.

Problem më vete paraqet formulimi gjuhësor i kësaj dispozite përkitazi me përbërjen e pasurisë, e cila mund të jetë objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme. Sipas formulimit (versioni shqip) të kësaj dispozite, dallohen dy lloje të pasurisë që mund të jetë objekt i kontratës: **a. Pasuria e përgjithshme dhe b. Pasuria e luajtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë e përgjithshme**. Nga përmbajtja e përgjithshme e kësaj dispozite ligjore dhe nga përmbajtja e dispozitave tjera në vazhdim që kanë të bëjnë me këtë kontratë, konsiderojmë se shprehja “*pasuria e përgjithshme*” është përdorur në vend të shprehjes “*pasuria e luajtshme*”.

272 Në një rast gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë për shkëputjen e kontratës për mbajtje të përjetshme me këtë arsytim: Qëndron fakti se ushqimdhënësi ka shkuar në vuajtje të dënimit, mirëpo kjo nuk është arsye të shkëputet kontrata për ushqimin e përjetshme, pasi që detyrimin për ushqim e ka marrë përsipër në tërësi bashkëshortja e tij. – Gjyk. Sup. e R. Maq. Rev. 329/90 dt. 08.05.1990.

273 Objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme mund të jetë edhe pasuria e mëvonshme, ajo të cilën e fiton ushqimmarrësi nga momenti i lidhjes së kontratës deri në momentin e vdekjes – Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 2082/99 datë 21.08.2002.

Në këtë aspekt edhe do të rrjedhë konstatimi se objekt i kontratës për mbajtje të përhjetshme mund të jetë si pasuria që ekziston në momentin e lidhjes së kontratës, s'ashtu edhe ajo e mëvonshme, e fituar pas lidhjes së kontratës deri në vdekjen e ushqimmarrësit. Sipas par. të parë të kësaj dispozite, përcaktohet se objekt i saj mund të jetë pasuria e paluajtshme dhe pasuria e luajtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar atë të paluajtshme.²⁷⁴ Nënkuptohe se, sipas kësaj dispozite, objekt i kontratës mund të jetë edhe vetëm një pjesë e pasurisë, në të cilin rast medoemos duhet përcaktohet cila është ajo.

5. Karakteristikë e veçantë e kontratës për mbajtje të përhjetshme është ajo se dorëzimi i sendit, i cili është objekt i kontratës, shtyhet deri në momentin e vdekjes së ushqimmarrësit. Kjo veçori e kësaj kontrate nuk paraqet kurrfarë problemi në rastet kur marrës i ushqimit është vetë pala kontraktuese. Në rastet e tilla, në tërësi përputhen momenti i kalimit të së drejtës me pushimin e detyrimit, për arsye se, me vdekjen e ushqimmarrësit, pushon detyrimi për dhënien e ushqimit dhe njëherësh nga ky moment fitohet edhe e drejta për kalimin e së drejtës, përkatësisht dorëzimin e sendit që është objekt i kontratës. Problemi zakonisht lind në rastet kur palë kontraktuese me ushqimdhënësin nuk është personi i cili, sipas kësaj kontrate, e merr ushqimin. Çka ndodh në rastet kur vdes pala kontraktuese, e cila është, krahas ushqimdhënësit, në kontratën me të cilën është kontraktuar ushqimi për personin tjetër. Konsiderojmë se me vdekjen e saj, duhet të bëhet edhe dorëzimi i pasurisë e cila është objekt i kontratës, por nëse, eventualisht, ushqimdhënësi nuk e përmbush detyrimin më vonë ndaj shfrytëzuesit të ushqimit, ky i fundit, si palë në dobi të cilit është lidhur kontrata, bashkë me trashëgimtarët e palës që ka qenë palë kontraktuese, si ushqimmarrës, kanë të drejtë të kërkojnë shkëputjen e kësaj kontrate. Përndryshe, nëse nuk veprohet në këtë mënyrë, pas vdekjes së ushqimmarrësit pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij, ndërkaq për kalimin e pasurisë nga trashëgimtarët e ushqimmarrësit te ushqimdhënësi nuk ekziston baza ligjore.

Sipas praktikës gjyqësore, pavarësisht nga fakti që, sipas ligjit, dorëzimi i pasurisë dhe kalimi i pronësisë nga kontrata për ushqim të përhjetshëm, shtyhet deri në vdekjen e ushqimmarrësit, nuk ka paraqitur pengesë për lidhjen e kësaj kontrate, nëse me të është parashikuar që dorëzimi apo kalimi i së drejtës mbi pasurinë e paluajtshme të bëhet menjëherë pas vërtetimit të kontratës në gjykatë (siç ishte dikur), përkatësisht pas notarizimit të saj (siç është tani).

Pasuria që është objekt i kontratës duhet të jetë e individualizuar. Në rast të parashtrimit në kontratë se ushqimdhënësi i kalohet “egjithë pasuria e ushqimmarrësit”, pa kurrfarë individualizimi në ndonjë mënyrë të saj, një kontratë e tillë është nule, pasi që ushqimdhënësi është suksesor singular i ushqimmarrësit dhe jo suksesor universal, siç është trashëgimtari. Kjo ndodh për arsyeja se, në rast se ushqimmarrësi nuk ka trashëgimtarë, kurse të gjithë pasurinë e ka kaluar mbi ushqimdhënësin, atëherë nuk ka kush të përgjigjet për borxhet e

²⁷⁴ “Traktori dhe rimorkio e traktorit në prodhimtarinë bujqësore bashkëkohore janë sende të cilat shërbejnë për shfrytëzimin e paluajtshmërisë, prandaj nuk është e thënë që patjetër të përmenden në kontratën për ushqim të përhjetshëm”. – Gjyk. Sup. e Voj. Rev. 148/91 dt. 27.02.1991.

tij. Nga e gjithë kjo rrjedh se në kontratë duhet pajtjetër të përcaktohen sendet dhe të drejtat të cilat janë objekt i kontratës ose, së paku, ato të jenë të përcaktueshme, përpos atyre që janë të dedikuara për shfrytëzimin sendeve të paluajjtshme.

6. Kontrata për mbajtje të përjetshme është *me detyrime të dyanshme*, ngase me lidhjen e saj, lindin detyrime si për njërën, ashtu edhe për palën tjetër. Përmbushja e detyrimeve në asnjë mënyrë nuk është e thënë të jetë e njëkohshme, ngase, derisa detyrimi për dhënie e ushqimit paraqitet menjëherë me lidhjen e kontratës, ndërkaq pasuria që është objekt i kontratës i kalon ushqimdhënësit në momentin e vdekjes së ushqimmarrësit. Nga vetë formulimi i dispozitës ligjore të nenit 560 par. 1 të LMD, ku jepet kuptimi i saj, rrjedh se kjo kontratë është *kontratë me barrë për të dy palët*. Kjo nënkupton se secila palë kontraktuese merr kompensim për atë që i jep palës tjetër. Njëra palë merr ushqimin për pasurinë e dhënë, kurse tjetra merr pasurinë për dhënie e ushqimit. Ajo është kontratë *aleatore*, pasi që nuk dihet se sa do të zgjasë detyrimi për dhënie e ushqimit, sa do të jetojë ushqimmarrësi.²⁷⁵Nëse në ndonjë mënyrë kufizohet në kohë detyrimi për ushqimin e ushqimmarrësit, më nuk kemi të bëjmë me kontratë për ushqim të përjetshëm, pavarësisht si e kanë emërtuar palët atë. Kjo është *kontratë rreptësisht formale*. Derisa ka qenë e rregulluar me Ligjin e Trashëgimisë, parashikohej të jetë në formë të shkruar dhe e vërtetuar nga gjykata. Me rastin e vërtetimit, është dashur që vetë gjyqtari t'ua lexojë palëve kontratën dhe t'ua tërheqë vërejtjen për pasojat e saj.²⁷⁶Në LMD parashikohet që kontrata për mbajtje të përjetshme duhet të bëhet në formë të aktit noterial.²⁷⁷Fjala është për kontratën me rastin e vdekjes (mortis causa), pasi që kalimi i pasurisë të ushqimdhënësi shtyhet deri në momentin e vdekjes së ushqimmarrësit.

7. Par. 2 i nenit 560 bën fjalë për objektin e pasurisë së kontratës për mbajtje të përjetshme. Në bazë të formulimit të kësaj kontrate të dhënë në par. e parë të këtij neni, konstatojm se objekt i saj mund të jetë një pasuri e caktuar e paluajjtshme dhe pasuria e luajjtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë e paluajjtshme. Përpos kësaj pasurie, sipas par. 2, objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme mund të jetë jo vetëm pasuria e paluajjtshme e dedikuar për ta shfrytëzuar atë të paluajjtshme, por edhe pasuria tjetër e luajjtshme. Si pasuria e paluajjtshme ashtu edhe ajo e luajjtshme duhet medoemos të emërtohet dhe të përmendet në kontratë.

8. Nisur nga praktika e deritashme, kontrata për mbajtje të përjetshme është paraqitur në trajta të ndryshme: si premtim i trashëgimisë, për jetë të përbashkët, për bashkim të pasurisë, për kryerjen e punëve në pasurinë e tjetrit, për angazhim rreth varrimit në rast vdekjeje dhe kryerjen e ceremonive fetare, si dhe në trajta të tjera. Sipas par. 3 të nenit 560 të LMD, të gjitha këto trajta të kontratave dhe kontratat e tjera në trajta të ngjashme, prej

275 “Fakti se tezja e të paditurit ka vdekur për një kohë relativisht të shkurtër, pas lidhjes së kontratës për ushqim të përjetshëm, nuk mund të jetë me rëndësi vendimtare për të vendosur në këtë kontest, për shkak të vetive juridike aleatore të kontratës për ushqim të përjetshëm”. – Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 2138/95 dt. 22 prosinca 1999.

276 Neni 105 par 4 dhe 5 i Ligjit mbi Trashëgiminë (“Gaz. Zyr. e KSAK”, nr. 43/74).

277 Shih neni 561 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

nga rrjedh e drejta e njëres palë për plotësimin e nevojave për një jetë normale dhe detyrimi për të dhënë shpërblim në ndonjë mënyrë për të, do të konsiderohen si kontrata për mbajtje të përjetshme. Kjo nënkupton se nuk është me rëndësi emërtimi i kontratave me të drejta dhe detyrime të këtilla, por me rëndësi janë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese të parashikuara në këto kontrata.

9. Siç rrjedh edhe nga par. 3 i këtij neni, mund të ndodhë që për nga formulimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese, në emër të kompensimit për ushqimin që merr, ushqimmarrësi i premtos ushqimdhënësit “*të drejtën e trashëgimit*” mbi pjesë të caktuara të pasurisë së tij. Në mjaft raste në kontratë thuhet: “në emër të kompensimit për ushqimin e dhënë *ia lë në trashëgimi*”. Pavarësisht nga të gjitha emërtimet dhe formulimet e ndryshme të kontratave për mbajtje të përjetshme, në të cilat përmendet e drejta e trashëgimisë së ushqimdhënësit mbi pasurinë e ushqimmarrësit, e cila është objekt i kontratës, apo me të cilat premtohet trashëgimia, nuk ka kurrfarë dyshimi se *kontrata për mbajtje të përjetshme nuk është kontratë për trashëgiminë*. Ajo është një kontratë me detyrime të dyanshme, të cilën ushqimmarrësi e disponon gjatë jetës me pasurinë e tij. Me këtë kontratë ai e tjetëron pasurinë e cila është objekt i saj, prandaj *pasuria që është objekt i kontratës nuk bën pjesë në masën trashëgimore të ushqimmarrësit, as që mund të shqyrtohet më rastin e shqyrtimit të trashëgimisë së tij, pasi që gjatë jetës është tjetërsuar nga ai, ashtu që në momentin e vdekjes së tij ajo përbën një pasuri në pronësi të tjetrit*.

Neni 561. Forma

Kontrata për mbajtje të përjetshme duhet të bëhet në formë të aktit noterial.

1. Me Ligjin për Trashëgiminë, me të cilin më par është rregulluar kontrata për mbajtje të përjetshme²⁷⁸, përcaktohej forma rigoroze e saj, ashtu që, sipas nenit 105 par. 4 të tij, kërkohet që kjo kontratë të jetë në formë të shkruar dhe e vërtetuar në gjykatë. Sipas paragrafit vijues të këtij neni, me rastin e vërtetimit, gjyqtari duhet t’ua lexonte kontratën palëve dhe t’ua bënte të njohura pasojat e saj. Në të njëjtën mënyrë, edhe sipas LMD, në nenin 561, është përcaktuar forma e kësaj kontrate, pra kërkohet që ajo të bëhet *në formë të aktit noterial*. Kjo nënkupton se për kontratën për ushqim të përjetshëm nuk kërkohet ndonjë formë e veçantë në krahasim me kontratat e tjera, veçanërisht për ato ku objekti i kontratës është paluajtshmëria. Edhe te kjo kontratë duhet vepruar sipas rregullave të përgjithshme për noterizimin e kontratave.

Nga sa u parashtrua rrjedh se forma e parashikuar në LMD është më e butë, në krahasim me atë që parashikohej në Ligjin e Trashëgimisë. Me Ligjin e Trashëgimisë, përpos formës së shkruar, është kërkuar që kontrata t’u lexohet palëve kontraktuese nga gjyqtari dhe njëherësh palët të njoftohen për pasojat e saj. Sipas LMD, kërkohet vetëm forma e aktit

278 Ligji për Trashëgiminë (“Gaz. Zyr. e KSAK, nr. 43/74).

noterial, që nënkupton se kontrata duhet të jetë e noterizuar.²⁷⁹ Me rëndësi është që ajo të jetë në formë të shkruar dhe e nënshkruar nga palët para notarit, i cili edhe i vërteton nënshkrimet e palëve.²⁸⁰

2. Duke pasur parasysh faktin se, përkritazi me formën e kontratës për ushqim të përjetshëm, me ligj nuk janë parashikuar rregulla të tjera të veçanta, përpos *që të jetë në formë të aktit noterial*, rrjedh se edhe për këtë kontratë vlen rregulla e njëjtë si për kontratat e tjera, me të cilat bëhet kalimi apo përvetësimi i pronësisë apo i të drejtave të tjera reale mbi pronën e paluajtshme.²⁸¹ Në mungesë të formës së këtillë të parashikuar ligjore, kontrata për ushqim të përjetshëm është e pavlefshme dhe nuk prodhon efekte juridike që nga fillimi, pra është nule. Duke pasur parasysh faktin se për këtë kontratë kërkohet të ketë formën e aktit noterial, që nënkupton se nuk kërkohet vetëm forma e shkruar, ajo nuk mund të jetë e vlefshme edhe kur palët kontraktuese i kanë përmbushur detyrimet e veta në tërësi ose në pjesën më të madhe të tyre. Kjo është e mundur vetëm për llojet e kontratave për të cilat me ligj kërkohet të jenë vetëm në formë të shkruar e jo edhe forma e aktit noterial, përkatësisht përpunimi i detyrueshëm noterial i dokumentit.²⁸²

Kontrata për ushqim të përjetshëm, me pajtimin e palëve kontraktuese, mund të ndryshohet më vonë, me kalimin e kohës. Përkritazi me formën, rregullat që vlejné për vetë kontratën, vlejné edhe për ndryshimin eventual të saj të mëvonshëm.

Neni 562. Ndalimi i përdorimit në favor të palës mbajtëse

Marrësi i mbajtjes mund të heqë dorë nga përdorimi i pasurisë që është objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme në favor të dhënësit të mbajtjes.

Nga kuptimi i dhënë i kontratës për mbajtje të përjetshme sipas nenit 560 të LMD rrjedh se me këtë kontratë ushqimmarrësi deklaron se ai do t'ia dorëzoj palës tjetër pasurinë e caktuar dhe se *dorëzimi shtyhet deri në momentin e vdekjes së ushqimmarrësit*. Sipas nenit 562 të këtij Ligji, i ushqimmarrësi, me kontratën për mbajtje të përjetshme, mund të heqë dorë nga përdorimi i pasurisë që është objekt i kontratës në dobi të ushqimdhënësit. Kjo nënkupton se kalimi i së drejtës së pronësisë nga ushqimmarrësi te ushqimdhënësi shtyhet deri në vdekjen e ushqimmarrësit, ndërsa në momentin e lidhjes së kontratës e mund të ndodhë edhe më vonë, palët mund të merren vesh që ushqimdhënësit t'i kalojë vetëm e

279 Në kreun VI të Ligjit për Noterinë të Kosovës përcaktohen funksionet noteriale. Në nenin 29 par. 1.6 të këtij Ligji, një nga funksionet që ushtron notari është përpilimi dhe vërtetimi i kontratave. Për kontratën për ushqim të përjetshëm me këtë Ligj nuk parashikohet ndonjë rregull e veçantë. Ndërkaq, në nenin 33 parashikohen të dhënat të cilat duhet t'i përmbajë dokumenti noterial, në të cilën formë dhe mënyrë duhen përpiluar edhe kontrata për ushqim të përjetshëm – shih dispozitat nga neni 29 par. 1.6 dhe neni 33 të Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë.

280 Shih nenin 57 par. 1 të LMD dhe komentimin e dhënë për këtë nen.

281 Shih nenin 30 par. 1 i Ligjit për Noterinë.

282 Shih nenin 58 të LMD.

drejta e përdorimit të pasurisë e cila është objekt i kësaj kontrate. Kalimi i së drejtës së pronësisë së paluajtshmërive, të cilat janë objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme, bëhet në atë mënyrë që, me vdekjen e ushqimmarrësit, ushqimdhënësi duhet të paraqesë kërkesë pranë Zyrës Kadastrale Komunale për kalimin e së drejtës së pronësisë së asaj paluajtshmërie në emër të tij. Për bazë juridike për këtë transferim të së drejtës së pronësisë shërben kontrata për mbajtje të përjetshme, e cila duhet t'i bashkangjitet kërkesës bashkë me certifikatën e vdekjes të ushqimmarrësit. Kjo nuk nënkupton medoemos se deri në momentin e vdekjes ushqimmarrësi e ka pasur edhe të drejtën e përdorimit të pasurisë që ka qenë objekt i kontratës, pasi që ai gjatë jetës ka mundur t'ia kalojë ushqimdhënësit të drejtën e përdorimit të asaj pasurie.

Neni 563. Përgjegjësia për borxhet

Pas vdekjes së marrësit të mbajtjes, dhënësi i mbajtjes nuk është përgjegjës për borxhet e lidhura me të, por në kontratë mund të përcaktohet që dhënësi i mbajtjes do të jetë përgjegjës për borxhet ekzistuese të marrësit të mbajtjes ndaj kreditorëve të caktuar.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Fusha që rregullohet me këtë dispozitë ligjore, para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, ka qenë e rregulluar me nenin 107 të Ligjit të Trashëgimisë.²⁸³ Kjo dispozitë ligjore rrjedh nga vetë fakti se ushqimdhënësi nuk është trashëgimtar i ushqimmarrësit dhe ka për detyrim vetëm atë që është përcaktuar në kontratë. Me rastin e vdekjes së ushqimmarrësit, mbi ushqimdhënësin kalon pasuria që ka qenë objekt i kontratës për mbajtje të përjetshme e lidhur mes tyre, që do të thotë se ushqimdhënësi nuk është suksesor universal, siç është trashëgimtari, por suksesor singular. Trashëgimtar është ai që, në momentin e vdekjes së personit fizik, e ka fituar të drejtën trashëgimore jo vetëm mbi të drejtat, por edhe mbi detyrimet e trashëgimlënësit. Trashëgimtarët, si suksesorë universalë, janë përgjegjës për borxhet që e ngarkojnë trashëgiminë, në përpjesëtim me pjesët e tyre dhe deri në vlerën e pjesës trashëgimore të tyre.²⁸⁴ Ushqimdhënësi është suksesor singular i ushqimmarrësit, prandaj, siç parashikohet shprehimisht me nenin 563 të LMD, ai nuk përgjigjet për borxhet e ushqimmarrësit.

2. Sipas nenit 563 të këtij Ligji, si rregull, ushqimdhënësi, pas vdekjes së ushqimmarrësit, nuk është përgjegjës për borxhet e tij. Vlen të theksohet se edhe te kjo dispozitë ligjore, si tek ajo e nenit 560, nuk bëhet një dallimi preciz i subjekteve të ndryshme në rastet kur kemi të bëjmë me kontrata në dobi të personit të tretë. Siç rrjedh nga neni 560 par. 1, ushqimdhënësi mund të marrë përsipër ta ndihmojë dhe ta mbajë personin e tretë dhe jo palën tjetër kontraktuese. Në raste të tilla është e pakuptimtë që ushqimdhënësi të (mos) përgjigjet për borxhet e personit të tretë, si ushqimmarrës, e jo për borxhet e palës tjetër kontraktuese,

283 Sipas nenit 107 të LT -"Gaz. Zyr. e KSAK, nr. 43/74 përgjegjësia e ushqimdhënësit për borxhet e ushqimmarrësit ka qenë e rregulluar plotësisht në mënyrë identike me këtë dispozitë të LMD.

284 Neni 119 i Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës nr. 2004/2006.

d.m.th., të personit, me rastin e vdekjes së të cilit, pasuria e tij duhet të kalojë në pasurinë e ushqimdhënësit. Në këtë aspekt, në rastet kur ushqimmarrësi nuk është personi i cili ka për detyrim ta kalojë pasurinë që është objekt i kontratës mbi ushqimdhënësin, (mos) detyrimi për borxhet do të duhej të reflektohej ndaj palës kontraktuese dhe jo ushqimmarrësit.

3. Sipas kësaj dispozite ligjore, përjashtimisht mund të kontraktohet që ushqimdhënësi të përgjigjet për borxhet e ushqimmarrësit, të cilat ekzistojnë në momentin e lidhjes së kontratës ndaj kreditorëve të caktuar. Nga kjo rrjedh se nuk mund të kontraktohet për borxhet e ardhshme, të cilat nuk kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, pavarësisht kur është afati i pagesës së tyre dhe nuk lejohet të kontraktohet, përpos nëse nuk është fjala vetëm për kreditorë të caktuar. Në këtë mënyrë, një kontraktim i këtillë përmban elementet e kontratës për marrjen përsipër të borxhit²⁸⁵ ose të marrjes përsipër të përmbushjes.²⁸⁶

Neni 564. Shkëputja e (Anulimi i) kontratës²⁸⁷

- 1. Palët kontraktuese kanë mundësi që kontratën për mbajtje të përjetshme ta shkëpusin me marrëveshje, madje edhe pasi të kenë filluar me përmbushjen e saj.**
- 2. Nëse sipas kontratës për mbajtje të përjetshme, palët kontraktuese jetojnë së bashku dhe marrëdhënia e tyre përkeqësohet deri në atë masë sa që jeta e përbashkët bëhet e patolerueshme, secila palë mund të kërkojë që gjykata ta anulojë kontratën.**
- 3. Secila palë mund të kërkojë shkëputjen e kontratës nëse pala tjetër nuk i përmbushë detyrimet e saj.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Fusha e rregulluar me këtë dispozitë ligjore, para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, ka qenë e rregulluar me nenin 108 të Ligjit të Trashëgimisë.²⁸⁸

285 Shih nenin 430 të LMD dhe komentim të dhënë lidhur me këtë nen.

286 Shih nenet 432 dhe 437 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

287 *Në versionin shqip të LMD, dispozita e nenit 564 nuk është emërtuar në mënyrë adekuate. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se ajo parashikon mundësitë dhe arsyet ligjore për shkëputjen e kontratës, ashtu që konsiderojmë se, në vend të emërimit “shkëputja e kontratës, gabimisht është emërtuar “anulimi i kontratës”, i cili nuk i përgjigjet përmbajtjes së dispozitës. Për këtë arsye në këtë komentim është bërë ndryshim në emërtimin e dispozitës, ashtu që është shtuar fjala “shkëputja”, ndërsa shprehja nga ligji “anulimi” është vënë në kllapa, sa për të dhënë të kuptohet se në ligj përdoret kjo shprehje. Për këtë arsye, edhe gjatë gjithë komentimit të këtij neni do të përdoret shprehja “shkëputja” e jo “anulimi”. Sipas ligjit, instituti i shkëputjes së kontratës gjen shprehje atëherë kur, me rastin e lidhjes së një kontrate, nuk kanë ekzistuar kushte ligjore për ta bërë atë të pavlefshme. Ajo kontratë për një kohë ka prodhuar efekte juridike. Në një moment të caktuar, për shkak të paraqitjes së rrethanave të caktuara ligjore, pushon së prodhuari efekte juridike, ngase janë plotësuar kushtet e parashikuara ligjore. Me vendim të gjykatës konstatohet shkëputja e saj e me këtë ndërpritet kontinuiteti i vlefshmërisë dhe vazhdimi i ekzistimit të saj.*

288 (“Gaz. Zyr, e KSAK”, nr, 43/1974)

Shprehja *shkëputje* është përdorur për arsye se, me rastin e lidhjes kontratës për mbajtje të përjetshme, nuk kanë ekzistuar kushte ligjore për ta bërë atë të pavlefshme, ashtu që ajo për një kohë ka qenë e vlefshme, ka ekzistuar dhe ka prodhuar efekte juridike. Në një moment të caktuar, për shkak të paraqitjes së arsyeve të caktuara ligjore, në bazë të vendimit të gjykatës, kontrata shkëputet, pushon së ekzistuari e me këtë pushon të prodhojë efekte juridike, duke u ndërprerë kështu kontinuiteti i vlefshmërisë së saj, pra edhe vazhdimi i ekzistimit të saj. Siç rrjedh nga kjo dispozitë ligjore, shkëputja e kontratës, përpos kur ajo bëhet me marrëveshje mes palëve, ndodh vetëm me vendim të gjykatës, për dallim nga *zgjidhja* e kontratës e cila bëhet, për shkak të arsyeve të parashikuara ligjore, vetëm me deklarimin ndaj palës tjetër.²⁸⁹ Me këtë dispozitë ligjore janë parashikuar tri mundësi të shkëputjes së kontratës.

2. Sipas par. 1 të nenit 564, palëve kontraktuese u lejohet mundësia që, me marrëveshje, të shkëpusin kontratën për mbajtje të përjetshme, edhe pasi të kenë filluar përmbushjen e saj. Kjo dispozitë mbështetet në parimin themelor të marrëdhënieve të detyrimeve, sipas të cilit pjesëmarrësit në këto marrëdhënie janë të lirë t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullneteve të tyre, me kusht që ato të jenë në pajtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik dhe doket e mira.²⁹⁰ Pra, në bazë të shprehjes së lirë të vullnetit, palët hyjnë në marrëdhënie juridike të mbajtjes së përjetshme dhe, mbi bazën e vullnetit të lirë, ato edhe mund ta shkëpusin këtë marrëdhënie të detyrimeve. Nga kjo dispozitë ligjore rrjedh se shkëputjen e kontratës për mbajtje të përjetshme palët mund ta bëjnë me marrëveshje edhe pasi të kenë filluar përmbushjen e saj. Kësisoj, ligji nuk përmend nëse kjo mund të bëhet apo jo pasi të jetë përmbushur plotësisht kontrata. Pavarësisht nga kjo, duke u nisur nga kuptimi i shkëputjes së kontratës, nga rrjedh se me shkëputje nënkuptohet ndërprerja e vazhdimit të saj, del konstatimi se kontrata për mbajtje të përjetshme nuk mund të shkëputet pas përmbushjes së detyrimeve të palëve kontraktuese.

Për kontratën për ushqim të përjetshëm me ligj kërkohet forma e caktuar ligjore.²⁹¹ Në mungesë të formës së parashikuar ligjore, kontrata është e pavlefshme. Nga kjo rrjedh se ajo mund të plotësohet dhe ndryshohet vetëm në formën e përcaktuar në nenin 561 të këtij Ligji. Mirëpo kur është fjala për shkëputjen e kontratës për mbajtje të përjetshme në bazë të marrëveshjes mes palëve, nuk është e thënë që kjo të bëhet në të njëjtën formë të parashikuar ligjore. Shkëputja e kontratës me marrëveshje mund të bëhet edhe në formë tjetër.²⁹² Nga kjo rregull, ekzistojnë dy përjashtime: a. nëse për rastin e caktuar me ligj parashikohet ndryshe (me LMD për këtë rast nuk parashikohet ndryshe) dhe b. në qoftë se qëllimi për të cilin është parashikuar forma për lidhjen e kontratës kërkon që ajo të shkëputet në të njëjtën formë. Pavarësisht nga fakti që me LMD shprehimisht nuk ndalohej shkëputja e kësaj kontrate në mënyrë joformale, duke pasur parasysh rëndësinë e kontratës për ushqim të përjetshëm për palët kontraktuese si dhe qëllimin për të cilin forma e kësaj kontrate

289 Shih nenin 115 të LMD.

290 Shih nenin 2 par. 1 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

291 Shih nenin 561 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë nen.

292 Lidhur me këtë çështje shih më hollësisht komentet e presentuara në nenin 56 të LMD (Komentari 1).

është përcaktuar me ligj, rrjedh konstatimi se *marrëveshja për shkëputjen e kontratës për ushqim të përjetshëm mund të bëhet vetëm në formën ligjore për lidhjen e kësaj kontrate, parashikuar në nenin 561 të LMD*, përndryshe, marrëveshja e palëve kontraktuese për shkëputjen e kontratës është e pavlefshme.

3. Me par. 2 të nenit 564 është rregulluar shkëputja e kontratës për mbajtje të përjetshme në rastet kur me kontratë është kontraktuar bashkësia e jetës ndërmjet ushqimdhënësit dhe ushqimmarrësit ose ndërmjet ushqimdhënësit dhe personit të tretë, në dobi të të cilit është kontraktuar jeta e përbashkët. Jeta e përbashkët ndërmjet ushqimdhënësit dhe ushqimmarrësit, përkatësisht të personit në dobi të cilit kontraktohet, është një formë e veçantë e mbajtjes së përjetshme. Në rast se marrëdhëniet ndërmjet tyre keqësohen në atë masë sa që jeta e përbashkët bëhet e padurueshme, secila palë kontraktuese mund të kërkojë shkëputjen e kontratës.²⁹³ Kjo arsye për shkëputje nuk vlen për format e tjera të kontratave për mbajtje të përjetshme.

Jeta e përbashkët kërkon marrëdhënie sadopak të harmonizuara ndërmjet personave të asaj bashkësie. Në qoftë se marrëdhëniet ndërmjet palëve kontraktuese keqësohen deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe nuk mund të pritet se do të përmbushen detyrimet e përcaktuara në kontratë – e vetmja gjë e arsyeshme do të ishte shkëputja e kontratës. Arsyet e keqësimit të marrëdhënieve mund të jenë ndër më të ndryshmet. Me rastin e zgjidhjes së këtyre kontesteve për gjykatën është me rëndësi vetëm të vërtetojë se marrëdhëniet janë keqësuar dhe jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Fajësia për keqësimin e këtyre marrëdhënieve nuk është me ndikim për shkëputjen e kontratës, gjë që nënkupton se e keqësimi i marrëdhënieve mund të vijë pa fajin e askujt (për shkak të sëmundjes) ose për fajin e njëjës palë kontraktuese. Mirëpo, kjo nuk do të vlejë në rast se keqësimi i marrëdhënieve është shkaktuar duke u keqpërdorur e drejta, d.m.th., kur kjo është bërë me qëllim që jeta e përbashkët të bëhet e padurueshme dhe në këtë mënyrë të krijohen mundësi ligjore për shkëputjen e kontratës. Padi me kërkesë për shkëputjen e kontratës mund të paraqesë secila palë kontraktues, pavarësisht nga ajo nëse është apo jo fajtorë për keqësimin e marrëdhënieve, ashtu që fajësia për këtë nuk është me ndikim për shkëputjen e kontratës, përpos në rastin e keqpërdorimit të së drejtës, siç u shpjegua më sipër. Pra, mund të paraqesë padi dhe të ketë sukses në kontest për shkëputjen e kontratës për shkak të keqësimit të marrëdhënieve edhe pala që është fajtorë për keqësimin e marrëdhënieve, mirëpo fajësia do të jetë me ndikim për shpërblimin e dëmit eventual të shkaktuar me shkëputjen e kësaj kontrate.

Të drejtën për të kërkuar shkëputje të kontratës për shkak të keqësimit të marrëdhënieve dhe padurueshmërisë së jetës së përbashkët e kanë vetëm palët kontraktuese, çka do të thotë se kjo është e drejtë personale, prandaj një kërkesë e tillë nuk mund të paraqitet pas vdekjes së ushqimmarrësit. Duke pasur parasysh faktin se kontrata për mbajtje të përjetshme është kontratë me detyrime të dyanshme, sipas së cilës të drejtat pasurore kalojnë nga një person te tjetri, në rastet kur ushqimmarrësi pas ngritjes së padisë vdes, para vendosjes në mënyrë

293 Shih komentin e dhënë për nenin 560 të këtij Ligji.

të plotfuqishme, trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të hyjnë në kontest dhe ta vazhdojnë kontestin për shkëputjen e kontratës për shkak të keqësimit të marrëdhënieve. Personi në dobi të të cilit është kontraktuar ushqimarrja, edhe pse nuk është palë kontraktuese, mund të kërkojë shkëputjen e kontratës pas vdekjes së palës kontraktuese, e cila e ka kontraktuar ushqimarrjen në dobi të tij.

4. Kontrata për mbajtje të përhjetshme është kontratë me detyrime të dyanshme. Me të krijohen të drejta dhe detyrime për të dy palët²⁹⁴. Në qoftë se njëra palë nuk e përmbush detyrimin e përcaktuar në kontratë, pala tjetër mund të kërkojë ose përmbushjen e detyrimit, ose ta shkëpusë kontratën me deklaram të njëanshëm.²⁹⁵ Në paragrafin 3 të nenit 564 parashikohet shprehimisht rregulla se te kontrata për mbajtje të përhjetshme secila palë mund të kërkojë shkëputjen e kontratës, nëse pala tjetër nuk përmbush detyrimet e saj. Sipas një rregulle, ushqimdhënësi ka të drejtën e zgjedhjes duke kërkuar nga ushqimarrësi: ose përmbushjen e detyrimit dhe shpërblimin e dëmit, ose shkëputjen e kontratës.²⁹⁶ Me ligj nuk është rregulluar çka ndodh kur ushqimdhënësi nuk e ka përmbushur vetëm një pjesë të parëndësishme të detyrimit. Konsiderojmë se në rastet e tilla ushqimarrësi ka të drejtë të kërkojë vetëm përmbushjen e detyrimit dhe shpërblimin e dëmit eventual; këtu nënkuptohet dëmi gjithmonë kur ai nuk është fajtor për mospërmbushje. Gjatë procedurës së zhvilluar, gjykata vlerëson dhe vërteton nëse ekziston mospërmbushja e kontratës, e cila përfaqëson arsye për shkëputje. Në qoftë se vërtetohet se vetë paditësi, si ushqimarrës, ka refuzuar të pranojë ushqimin nga ushqimdhënësi, në mënyrën si është parashikuar me kontratë, kjo nuk mund të paraqesë arsye për shkëputjen e kontratës për shkak të mospërmbushjes së detyrimit, prandaj edhe në raste të tilla kërkesa duhet refuzuar.²⁹⁷ Duke pasur parasysh faktin se efekti i saj për palët, kur është fjala për kalimin e së drejtës së pasurisë e cila është objekt i kontratës, shtyhet deri në vdekjen e ushqimarrësit, shkëputja e kësaj kontrate nuk mund të bëhet me deklaram të njëanshëm, siç parashikohet në nenin 360 të LMD. Shkëputja e kontratës për mbajtje të përhjetshme bëhet me vendim të gjykatës në kontest civil. Vendimi i gjykatës për shkëputjen e kontratës do të ketë karakter konstituiv, pasi që ndryshohet marrëdhënia që ka ekzistuar ndërmjet palëve, e nuk ka vetëm karakter deklarativ. Kontrata është e shkëputur në momentin që aktgjykimi merr formë të prerë, ashtu që me këtë pushojnë së ekzistuari detyrimet kontraktuese. Nga momenti i shkëputjes së kontratës me aktgjykim të formës së prerë, pushon detyrimi për të dhënë ushqimin për ushqimarrësin, ndërsa pas vdekjes së ushqimarrësit, pasuria që ka qenë objekt i kontratës, nuk do t'i kalojë ushqimdhënësit.

Një efekt tjetër i shkëputjes së kontratës shprehet në kthimin e asaj që është dhënë në emër të saj. Duke pasur parasysh faktin se detyrimi i ushqimarrësit është i shtyrë deri në momentin e vdekjes së tij, kthimin e asaj që është dhënë mund ta realizojë ushqimdhënësi. Detyrimi për kthimin e asaj që është marrë ekziston pavarësisht nga faji për shkëputjen e

294 Shih më hollësisht komentet e presentuara në nenin 560 të LMD.

295 Shih nenin 360 të LMD.

296 Shih nenin 106 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

297 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 476/06 dr. 12,07.2006.

kontratës. Kur bëhet fjalë për dëmin eventual të shkaktuar me shkëputjen e kontratës, do të jetë me ndikim fajësia për shkëputjen e kontratës.

Neni 565. Ndryshimi i rrethanave

- 1. Nëse pas lidhjes së kontratës, rrethanat ndryshojnë deri në atë masë sa përmbushja e kontratës bëhet shumë më e vështirë, atëherë gjykata, me kërkesën e ndonjërit prej palëve, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat, mund të ndryshojë marrëdhëniet e tyre në kontratë ose ta anulojë atë.**
- 2. Gjykata mund të ndryshojë të drejtat e marrësit të mbajtjes në rentë jetësore, nëse kjo gjë është në interes të dyja palëve.**

1. Kontrata për mbajtje të përjetshme lidhet në një moment të caktuar. Në momentin e dhënë të lidhjes së kontratës kanë ekzistuar kushte të caktuara, nën ndikimin e të cilave palët kanë vendosur të lidhin kontratën. Kushtet në të cilat është lidhur kontrata për mbajtje të përjetshme, me kalimin e kohës, mund të ndryshojnë. Për këtë arsye, sipas kësaj dispozite ligjore, palët kontraktuese mund të paraqesin dy lloje kërkesash – mund të kërkojnë që kontrata e lidhur më parë: *a. të ndryshohet ose b. të shkëputet.*²⁹⁸

2. Me par. 1 të këtij neni u mundësohet palëve kontraktuese të ndryshojnë kontratën e lidhur më parë, me supozimin se në të njëjtat kushte (klauzula Rebus Sic Stantibus) do të ndryshohej çdo kontratë tjetër e rregulluar me këtë Ligj.²⁹⁹ Kjo nënkupton se në këtë dispozitë vetëm është përsëritur ajo që do të vrente edhe pa të, çka do të thotë se edhe te këto kontrata zbatohen rregullat e përgjithshme të LMD që kanë të bëjnë me rrethanat e ndryshuara.

Kushti për ndryshimin, përkatësisht shkëputjen e kontratës në bazë të kësaj dispozite ligjore është që, pas lidhjes së kontratës, të kenë ndryshuar rrethanat. Ligji nuk përcakton shprehimisht cilat rrethana duhen ndryshuar, mirëpo ato i përkufizon në atë mënyrë që, për shkak të paraqitjes së tyre, përmbushja e kontratës bëhet shumë më e vështirë. Kështu, keqësimi i gjendjes shëndetësore të ushqimmarrësit nuk është rrethanë që nuk ka mundur të pritej, prandaj ky nuk përbën arsye për shkëputjen e kontratës për ushqim të përjetshëm.³⁰⁰ Në anën tjetër, martesja e ushqimmarrësit, pas lidhjes së kontratës për mbajtje të përjetshme, përfaqëson ndryshim të rrethanave të cilat e arsyetojnë shkëputjen e kontratës, pasi që bashkëshorti mund ta marrë përkujdesjen dhe sigurimin e ushqimit

.....
298 Edhe në këtë rast, në versionin shqip nuk është përdorur formulimi gjuhësor, përkatësisht shprehja adekuate. Shprehja e përdorur “të anulohet” nuk i përgjigjet përmbajtjes së dispozitës dhe është përdorur në vend të shprehjes “shkëputje”. Arsyet e përgjithshme të nulitetit të kontratës janë të parashikuara në nenin 89 të këtij Ligj, ndërsa ato për shkak të të cilave kontrata është e rrëzueshme dhe mund të kërkohet anulimi i saj, në nenin 97 të këtij Ligji. Kjo dispozitë ligjore nuk ka të bëjë as me shkaqet e nulitetit, as me ato të rrëzueshmërisë së kontratës; këtu bëhet fjalë për mundësinë e shkëputjes së kontratës për ushqim të përjetshëm.

299 Shih nenin 116 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

300 Gjyk. Sup. e r. Kr. Rev. 2005/95 dt. 17.08.1995.

ndaj ushqimmarrësit.³⁰¹ Kërkesën për rregullimin e sërishëm të marrëdhënieve ndërmjet palëve kontraktuese për shkak të ndryshimit të rrethanave mund ta paraqesë secila palë kontraktuese. Përkitazi me heqjen dorë nga e drejta për t’iu referuar rrethanave të ndryshuara vlejné rregullat e përgjithshme të LMD, sipas të cilave, palët mund të heqin dorë nga kjo e drejtë me rastin e lidhjes së kontratës,³⁰² përveç nëse kjo është në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.³⁰³

3. Kur është fjala për ndryshimin e kontratës për mbajtje të përrjetshme, në par. 2 të nenit 565 të LMD parashikohet mundësia e ndryshimit të së drejtës së ushqimmarrësit nga forma e mëparshme e dhënies së ushqimit - në rentë jetësore. Renta jetësore nënkupton një shumë të caktuar parash, e cila duhet t’i paguhet ushqimdhënësit gjatë gjithë jetës së ushqimmarrësit, në sasi të barabarta, zakonisht për çdo muaj, por gjykata mund të vendosë edhe për ndonjë periudhë kohore tjetër. Veçori e caktimit të rentës jetësore në këtë mënyrë është fakti se ajo mund të caktohet nëse gjykata gjen se kjo është në interes të dy palëve, gjë që nënkupton se gjykata mund të vendosë në këtë mënyrë, nëse për këtë pajtohen të dy palët. Për caktimin në këtë mënyrë të rentës, në mënyrë analoge mund të vlejné rregullat e parashikuara nga neni 172 dhe 180 të këtij Ligji.³⁰⁴

Neni 566. Shkëputja e kontratës³⁰⁵

1. Nëse dhënësi i mbajtjes vdes, detyrimet nga kjo marrëdhënie transferohen tek bashkëshortja e tij apo bashkëshorti i saj dhe tek pasardhësit, fëmijët e adoptuar dhe pasardhësit e fëmijëve të adoptuar, nëse ata japin pëlqimin për një gjë të tillë.

301 E njëjta gjykatë Rev. 541/91 dt. 03.07.1991.

302 Shih nenin 119 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

303 Shih nenin 4 të LMD.

304 Shih dispozitat e nenit 172 dhe 180 të LMD dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

305 Emërtimi i drejtë dhe adekuat i dispozitës së caktuar ligjore është me rëndësi për të dalluar institutin e caktuar ligjor, i cili gjen zbatim në pjesë të caktuara të ligjit. Normalisht, për të zbatuar drejtë, në vendin e duhur dhe në rastin e duhur, më rëndësi të veçantë është përmbytja e dispozitës e cila edhe çon në emërtimin përkatës adekuat të saj. Konsiderojmë se edhe në këtë rast nuk është bërë emërtimi i drejtë dhe adekuat i dispozitës ligjore të nenit 566 të këtij Ligji. Në komentin e dhënë për dispozitën e nenit 544 të këtij Ligji u konstatua se kjo dispozitë ligjore rregullon *shkëputjen* e kontratës për ushqim të përrjetshëm, prandaj është dashur të emërtohej “*shkëputja e kontratës*”. Shikuar nga përmbytja, me dispozitën ligjore të nenit 566 të këtij Ligji është rregulluar ndikimi i vdekjes së ushqimdhënësit në marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet palëve në bazë të kontratës për mbajtje të përrjetshme. Për nga përmbytja, mënyra e këtillë e rregullimit ligjor ka ekzistuar edhe në Ligjin e Trashëgimisë të zbatueshëm në Kosovë të vitit 1974, me emërtimin “Pushimi i kontratës për mbajtje të përrjetshme”. Në mënyrë plotësisht identike me këtë Ligj, situata e krijuar pas vdekjes së ushqimdhënësit është rregulluar me LMD (ZOO) të Republikës së Kroacisë të vitit 2005, i cili aktualisht është i zbatueshëm, e cila është emërtuar “*Ndikimi i vdekjes së ushqimdhënësit në kontratë*”. Konsiderojmë se një emërtim i këtillë paraqet emërtimin adekuat të dispozitës e cila rregullon situatën e krijuar pas vdekjes së ushqimdhënësit.

2. Në kuptim të paragrafit paraprak, nëse të njëjtit nuk e japin pëlqimin për vazhdimin e kontratës për mbajtje të përjetshme, kontrata zgjidhet dhe ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për mbajtjen e mëparshme.
3. Nëse bashkëshorti apo bashkëshortja, pasardhësit, fëmijët e adoptuar apo pasardhësit e fëmijëve të adoptuar nuk kanë mundësi të përmbushin detyrimet kontraktore ata kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim nga marrësi i mbajtjes.
4. Gjykata përcakton shpërblimin e tillë në bazë të diskrecionit të saj, duke marrë parasysh gjendjen financiare të palës së mbajtur si dhe gjendjen financiare të atyre që janë të thirrur që ta vazhdojnë kontratën për mbajtje të përjetshme.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Fusha që rregullohet me këtë dispozitë ligjore, para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, ka qenë e rregulluar me nenin 110 të Ligjit të Trashëgimisë.³⁰⁶

Qëllimi i lidhjes së kontratës për mbajtje të përjetshme është sigurimi i kushteve normale për jetë të ushqimmarrësit nga ushqimdhënësi, derisa ai të jetë gjallë. Sipas kësaj logjike, supozohet se ushqimmarrësi do të vdesë para ushqimdhënësit. Me këtë dispozitë ligjore rregullohen marrëdhëniet e krijuara ndërmjet palëve kontraktuese në rast të vdekjes së ushqimdhënësit para ushqimmarrësit, (edhe në këtë dispozitë ligjore, nga formulimi i saj, rrjedh se ligjdhënësi është nisur nga situata kur në anën e ushqimdhënësit ekziston vetëm një person fizik).

2. Fakti i vdekjes së ushqimdhënësit para ushqimmarrësit nuk do të nënkuptojë vetvetiu edhe pushimin së ekzistuarit të kontratës për mbajtje të përjetshme. Sipas par. 1 të nenit 566, në rast të vdekjes së ushqimdhënësit, detyrimet që ka pasur ai sipas kontratës i kalojnë bashkëshortes/tit, pasardhësve, fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar, nëse ata e japin pëlqimin për këtë. Në bazë të kontratës për mbajtje të përjetshme, ushqimdhënësi nuk ka vetëm detyrime, por ka edhe të drejta.³⁰⁷ Prandaj, pavarësisht nga ajo që me këtë dispozitë ligjore është thënë se te këta persona kalojnë detyrimet, por nuk përmenden edhe të drejtat, derisa ushqimdhënësi, sipas kontratës, ka edhe të drejta, me vdekjen e tij, mbi trashëgimtarët e tij të rendit të parë³⁰⁸ kalojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Konsiderojmë se në mesin e personave të përmendur në këtë dispozitë ligjore bën pjesë edhe bashkëshorti jashtëmartesor i cili, në kushtet e parashikuara ligjore, barazohet me bashkëshortin martesor.³⁰⁹ Kalimi i të drejtave dhe të detyrimeve kushtëzohet me dhënien e pëlqimit të këtyre personave për marrjen përsipër të të drejtave dhe të detyrimeve, që nënkupton se këta trashëgimtarë mund të mos e japin pëlqimin. Në rastet kur pas vdekjes së ushqimdhënësit kanë ngelur disa trashëgimtarë të rendit të parë, por vetëm disa prej tyre japin pëlqimin për t'i marrë përsipër të drejtat dhe

306 ("Gaz. Zar. E KSAK", nr. 43/1974).

307 Shih nenin 560 të këtij Ligji dhe komentini e dhënë lidhur me këtë nen.

308 Shih nenet 12 dhe 13 të LTK.

309 Shih nenin 11 par. 2 të LTK.

detyrimet e parashikuara në kontratë, të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në kontratën për mbajtje të përjetshme do të kalojnë vetëm mbi ata trashëgimtarë që kanë dhënë pëlqimin për këtë. Duke pasur parasysh faktin se me ligj parashikohet shprehimisht se mbi cilët nga trashëgimtarët mund të kalojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën për mbajtje të përjetshme, rrjedh se trashëgimtarët e radhës së dytë dhe të radhëve tjera si dhe trashëgimtarët testamentalë nuk bëjnë pjesë në mesin e personave të cilët, sipas ligjit, mund të marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë, pavarësisht nga ajo nëse trashëgimtarët e radhës së parë pranojnë ose jo.

3. Sipas par. 2 të këtij neni, në qoftë se trashëgimtarët e radhës së parë të trashëgimisë, për marrjen përsipër të të drejtave dhe të detyrimeve³¹⁰ të ushqimdhënësit të vdekur nuk e japin pëlqimin, edhe pse kanë zotësinë dhe kanë mundësi ta bëjnë këtë, qoftë edhe vetëm dikush prej tyre, kontrata shkëputet sipas ligjit. Në këtë rast ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin e asaj që ka dhënë ushqimdhënësi deri në vdekjen e tij.

4. Rregulla e parashikuar në par. 2 të këtij neni nënkupton rastet kur trashëgimtarët e radhës së parë, pas vdekjes së ushqimdhënësit, nuk e japin pëlqimin për marrjen përsipër të të drejtave dhe të detyrimeve të ushqimdhënësit të vdekur, edhe pse kanë zotësinë për ta bërë këtë. Në rastet kur bashkëshorti/ja, pasardhësit, fëmijët e adoptuar apo pasardhësit e fëmijëve të adoptuar³¹¹ nuk kanë mundësi të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ata kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin nga ushqimmarrësi për atë që ai ka marrë në emër të ushqimit sipas kontratës.

5. Duke pasur parasysh natyrën e detyrimit për ushqim të përjetshëm si dhe format në të cilat ai mund të kontraktohet, posaçërisht paraqet vështirësi caktimi i shpërblimit i cili i duhet kthyer ushqimdhënësit. Në par. 4 të këtij neni parashikohet që caktimi i shpërblimit të bëhet nga gjykata në bazë të vlerësimit të lirë³¹² (diskrecionit), duke marrë parasysh me atë rast në mënyrë kumulative: a). gjendjen pasurore të ushqimmarrësit dhe të atyre të cilët, sipas ligjit, janë të autorizuar t'i marrin përsipër të drejtat dhe të detyrimet e ushqimdhënësit.

310 Konsiderojmë se formulimi gjuhësor në ligj “vazhdimi i kontratës” nuk është adekuat, ngase kontrata në këtë mënyrë nuk mund të vazhdohet dhe se më e drejtë është të përdoret “marrja përsipër e të drejtave dhe e detyrimeve”

311 Derisa numërohen një për një të gjithë personat të cilët nuk kanë mundësi t'i përmbushin detyrimet, konsiderojmë se për të pasur këtë të drejtë nevojitet që asnjëri prej tyre të mos ketë mundësi ta bëjë këtë.

312 Shih nenin 323 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

PJESA VI KONTRATA PËR HUANË

KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 567. Nocioni

- 1. Me kontratën e huas huadhënësi obligohet t'ia dorëzojë huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë.**
- 2. Mbi sendet e marra huamarrësi fiton të drejtën e pronësisë.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Huaja bën pjesë në mesin e kontratave më të rëndësishme të marrëdhënieve kontraktuese. Pas kontratës së shitblerjes, marrëdhëniet më të shpeshta mes subjekteve të ndryshme janë marrëdhëniet në bazë të kontratës për huan, pavarësisht nga format në të cilat mund të paraqitet ajo.

Në nenin 567 jepet kuptimi dhe elementet qenësore të kontratës për huan. Duke pasur parasysh faktin se huaja merret me qëllim të përdorimit dhe shfrytëzimit për një kohë të sendit që është objekt i kontratës, në literaturën juridike kjo kontratë bën pjesë në kontratat për përdorimin dhe shfrytëzimin e sendeve. Mbi sendin e marrë në bazë të kësaj kontrate huamarrësi fiton të drejtën e pronësisë, prandaj ka mundësinë e shfrytëzimit të atij sendi për qëllime të veta a për qëllimet e përcaktuara në kontratë. Derisa fiton të drejtën e pronësisë, ai ka të drejtë edhe ta disponojë atë send. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se objekt i kontratës për huan mund të jetë një shumë e caktuar parash apo sende të caktuara sipas llojit dhe cilësisë, huamarrësi ka detyrimin që, pas një kohe, sendin e të njëjtit lloj, në sasi dhe cilësi të njëjtë, t'ia kthejë huadhënësit, edhe pse lidhur me atë send e ka fituar të drejtën e pronësisë. Duke pasur parasysh qëllimin e marrjes së sendit sipas kësaj kontrate, ai nuk ka detyrimin që, pas një kohe, ta kthejë të njëjtin send, por një send të ngjashëm për nga numri, lloji dhe cilësia. Kjo bën që kjo kontratë të dallohet nga kontrata për huapërdorjen³¹³, sipas së cilës, sendi merret vetëm për përdorim me detyrimin që, pas një kohe, të kthehet i njëjti send.

Nga kuptimi i dhënë në këtë nen për kontratën për huan rrjedh se objekt i kësaj kontrate mund të jenë një shumë e caktuar e parasë ose një sasi e caktuar sendesh të tjera të zëvendësueshme, në mënyrë që, pas kohës së caktuar në kontratë, të kthehet shumta e marrë e parasë apo numri i njëjtë i sendeve për nga sasia dhe i ngjashëm për nga lloji dhe cilësia. Nga kjo rrjedh se *elementet qenësore të kësaj kontrate janë objekti dhe kohëzgjatja,*

313 Shih nenin 577 të LMD (dhe tjerëve në vazhdim lidhur me këtë) dhe komentën e dhënë.

nëse është fjala për kontratën për huan pa shpërblim, përkatësisht edhe shpërblimi, në qoftë se kemi të bëjmë me kontratën e huas me shpërblim.

2. Sipas kuptimit të dhënë në par. 1 të nenit 567 të LMD, me kontratën për huan huadhënësi detyrohet t'ia dorëzojë në pronësi huamarrësit shumën e caktuar të parave ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, qoftë për qëllimin e dhënies të caktuar në kontratë, qoftë të pacaktuar në kontratë, ndërsa huamarrësi detyrohet që, qoftë në afatin e caktuar a të pacaktuar në kontratë, t'ia kthejë huadhënësit shumën e njëjtë të parave, përkatësisht llojin e njëjtë të sendeve në të njëjtën sasi dhe cilësi siç kanë qenë të dorëzuara. Në qoftë se me kontratë nuk është kontraktuar qëllimi i përdorimit të objektit të kontratës, ato mund të përdoren për çfarëdo qëllim, përndryshe duhet të përdoren për qëllimin kontraktues.

Sipas kuptimit të dhënë si më sipër, palë kontraktuese janë huadhënësi dhe huamarrësi. Me ligj nuk përcaktohen kushte të veçanta për atë se kush mund të jetë huadhënës dhe kush huamarrës dhe nga kjo rrjedh se kërkohet plotësimi i kushteve të përgjithshme për lidhjen e kontratave në përgjithësi. Nga kontrata për huan ka rrjedh kontrata për kredinë, sipas së cilës, cilësinë e huadhënësit e ka banka; pikërisht kjo përfaqëson dallimin ndërmjet kontratës për huan në përgjithësi dhe kontratës për kredi, si lloji i veçantë i kontratës për huan.

Nga kuptimi i dhënë ligjor rrjedh konstatimi se kontrata për huan, për nga forma, është një kontratë *konsuesuale*, ngase në këtë dispozitë nuk thuhet: “*kontratë me të cilën huadhënësi ia dorëzon ...*”, kur do të ishte, për nga forma, kontratë reale, por thuhet: “*. . . me kontratë detyrohet t'ia dorëzojë . . .*”, që nënkupton se në momentin e lidhjes së kontratës nuk duhet medoemos të dorëzohet sendi që është objekt i kontratës, por në momentin e lidhjes së kontratës vetëm lind detyrimi për huadhënësin që ta bëjë atë. Sidoqoftë, me ligj nuk kërkohet që kontrata për huan të jetë në formën e shkruar, por këtë mund ta parashikojnë vetë palët, duke kushtëzuar ekzistimin e kontratës apo vlefshmërinë e saj pas hartimit me shkrim të saj.

Sa i përket objektit, me ligj është përcaktuar se objekt i kontratës për huan mund të jenë para dhe sasia e caktuar e sendeve të tjera të zëvendësueshme, të cilat janë të caktuara për nga lloji, sasia dhe cilësia. Sendet e pazëvendësueshme nuk mund të jenë objekt i kontratës. Kjo për arsye se huamarrësi e fiton mbi sendin e marr hua të drejtën e pronësisë dhe ka detyrimin t'ia kthejë huadhënësit të njëjtin lloji të sendeve, në sasi dhe cilësi të njëjtë, gjë që është objektivisht e pamundur te sendet e pazëvendësueshme. Duke pasur parasysh destinimin e sendit për sa i përket përdorimit, rrjedh se objekt i kontratës për huan mund të jenë si sendet e shpenzueshme, ashtu edhe ato të pashpenzueshme. Varësisht nga objekti i detyrimit, siç shihet nga kuptimi i dhënë, huaja mund të jetë në para, në rastet kur huadhënësi merr përsipër detyrimin ta dorëzojë shumën e caktuar të hollave ose në natyrë, kur merr përsipër detyrimin ta dorëzojë sendin e caktuar. Derisa huamarrësi e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin e marrë hua, këtë të drejtë duhet ta ketë pasur paraprakisht

huadhënësi. Nëse ndodh që objekt i kontratës për huan të jetë sendi pronar i të cilit nuk është huadhënësi, të drejtën e pronësisë nuk mund ta fitojë huamarrësi, meqë huadhënësi nuk mund t'i kalojë atij më shumë të drejta sesa që i ka vetë. Në raste të tilla, sipas rregullave të përgjithshme që vlejné për fitimin e së drejtës së pronësisë nga jopronari³¹⁴, një prej tyre është që huaja të jetë me shpërblim; edhe me këtë lloj të huas mund të fitohet pronësia. Pronari i vërtetë në këto raste mund ta paditë huadhënësin. Përndryshe, në rast se nuk janë përmbushur kushtet për fitimin e pronësisë nga jopronari, pronari i atij sendi mund të paraqitet me kërkesë për kthimin e sendit (padia rei vindikacio) kundër huamarrësit e në rast se sendi nuk është individualisht i caktuar, mund të paraqesë kërkesë për begatim të papabazë.³¹⁵

Si element tjetër qenësor i kontratës për huan konsiderohet afati i zgjatjes së huas, edhe pse ekziston mundësia që ky afat të mos caktohet me kontratë; në këtë rast, sikur afati të ishte element qenësor, kjo kontratë nuk do të ishte e vlefshme. Në Ligj thuhet “pas një kohe të caktuar”, që do të nënkuptonte se koha e zgjatjes së huas nënkupton kohën pas kalimit të së cilës huamarrësi duhet ta kthejë huan. Mund të kontraktohet edhe kthimi i huas në këste, përkatësisht për huan natyrale në pjesë. Kthimi i huas mund të kërkohet vetëm pas kalimit të afatit të parashikuar në kontratë për kthimin e saj³¹⁶. “Gjykata nuk do të mund ta detyrojë të paditurin të kthejë pjesët e huas së marr, në qoftë se deri në përfundim të shqyrtimit kryesor nuk ka kaluar afati i parashikuar në kontratë për kthimin e tyre”.³¹⁷

3. Sipas par. 2 të nenit 567 të këtij Ligji, huamarrësi e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendet e marra hua, nga rrjedh se, për pasojë juridike të huas, kemi kalimin e së drejtës së pronësisë nga huadhënësi te huamarrësi. Pavarësisht nga kjo, huamarrësi ka detyrimin t'i kthejë të hollat e marra hua apo sasinë e njëjtë të mallit, me cilësi dhe sasi të njëjtë. Siç shihet, detyrimi i kthimit të huas e anulon pasojën e kalimit të pronësisë mbi objektin e kontratës.

Neni 568. Kamata

- 1. Huamarrësi mund të obligohet që përveç kryegjësë të debitojë edhe kamatën.**
- 2. Në kontratat ekonomike huamarrësi detyrohet të paguaj edhe kamatën, përveç nëse merren vesh ndryshe.**

1. Vështrim i përgjithshëm.- Me nenin 568 të LMD rregullohet çështja e kamatës sipas kontratave për huan.³¹⁸ Edhe pse me dispozitën ligjore ku është dhënë kuptimi i kontratës

314 Shih nenin 32 të LPDS.

315 Shih dispozitat nga neni 194 deri 202 dhe komentin e dhënë në pjesën e përgjithshme të LMD për këto dispozita ligjore.

316 Shih nenin 572 të këtij ligjo dhe komentin e dhënë lidhur me këtë.

317 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 840/99 dt. 18.04.2001.

318 Në përgjithësi lidhur me kamatat, shih dispozitat nga neni 378 deri 381 të këtij Ligji.

për huan shprehimisht nuk përmendet, nga dispozitat në vazhdim të këtij neni rrjedh se kontrata për huan mund të jetë pa shpërblim dhe me shpërblim. Shpërblimi nga huaja mund të jetë i kontraktuar në forma të ndryshme, mirëpo më së shumti dhe më shpesh paraqitet në formë të kamatës. A është me shpërblim apo pa shpërblim, varet nga ajo nëse huamarrësi ka detyrimin ta kthejë vetëm shumën e njëjtë të të hollave, përkatësisht sasinë e njëjtë të sendeve të llojit të njëjtë, siç i ka pranuar (borxhin kryesor), apo përveç tij, duhet të paguajë edhe kamatën. Kamata e parashikuar me këtë nen është kamatë e kontraktuar.³¹⁹ Rregullat lidhur me kamatat zbatohen edhe në rastet kur objekt huaje janë sendet dhe jo vetëm të hollat.³²⁰ Me këtë dispozitë ligjore kjo çështje (kamata) rregullohet ndryshe, varësisht nga ajo nëse bëhet fjalë për kontrata ekonomike (komerciale)³²¹ apo joekonomike (civile juridike).

2. Për huadhëniet ndërmjet qytetarëve, si persona fizikë, zakonisht supozohet se janë pa shpërblim, edhe pse në shoqëritë bashkëkohore huaja pa shpërblim konsiderohet e paarsyeshme. Edhe pse shprehimisht nuk është thënë, sipas formulimit të kësaj dispozite ligjore rrjedh se par. 1 i kësaj dispozite ka të bëjë me kontratat civile juridike për huan. Kjo rrjedh nga par. 2 i këtij neni, me të cilin rregullohet çështja e kamatës te kontratat ekonomike. Duke pasur parasysh faktin se, varësisht nga subjektet kontraktuese, kontratat për huan mund të jenë vetëm civile-juridike dhe ekonomike dhe nuk ka lloj të tretë të tyre, rrjedh konstatimi se në par. 1 të këtij neni fjala është për kontratat civile juridike. Kontrata civile-juridike janë të gjitha kontratat që i lidhin ndërmjet tyre qytetarët si persona fizikë, shoqëritë tregtare³²² me personat fizikë dhe shoqëritë tregtare të cilat nuk janë në lidhje me veprimtarinë që e ushtrojnë ato.

Sipas par. 1 të këtij neni huamarrësi *mund* të detyrohet që, përveç borxhit kryesor, të paguajë edhe kamatën. Formulimi i këtillë gjuhësor i kësaj dispozite lë për të kuptuar se kontrata civile juridike për huan është pa shpërblim, përpos nëse kamata nuk është parashikuar shprehimisht me kontratë. Në qoftë se palët kontraktuese janë pajtuar që, përpos borxhit kryesor, të paguhet edhe kamata, në kontratë, si rregull, duhet caktuar edhe norma e saj. Në rastet kur me kontratë është parashikuar kamata, por nuk është përcaktuar norma e saj, do të duhej paguar kamata vjetore sipas normës prej 6%; kamata rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të borxhit kryesor.³²³

3. Sa u përket kontratave ekonomike, sipas par. 2 të këtij neni, ato janë kontrata me shpërblim, prandaj detyrimi i huamarrësit për të paguar kamatën rrjedh nga momenti i lidhjes së kontratës. Ky detyrim për huamarrësin do të qëndrojë edhe në rastet kur në kontratë nuk bëhet fare fjalë për kamatën. Palët kontraktuese mund të parashikojnë me

319 Shih nenin 385 të këtij Ligji.

320 Sipas nenet 386 të këtij Ligji, dispozitat për kamatën kontraktuese zbatohen përshtatshëmrisht edhe për marrëdhëniet e tjera të detyrimeve të shquara sipas llojit, përkatësisht detyrimet të cilat kanë për objekt sendet e zëvendësueshme dhe të caktuara sipas llojit.

321 Për kuptimin e kontratave ekonomike (komerciale), shih nenin 12 të këtij Ligji.

322 Lidhu me shoqëritë tregtare, shih Ligjin 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

323 Shih dispozitat nga nenet 385 dhe 386 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna për këto nene.

kontratë që të mos paguhet kurrfarë shpërblimi për huan e marrë dhe në atë rast huamarrësi nuk ka detyrim për pagesën e ndonjë kamate. Në rastet kur me kontratë është parashikuar pagesa e kamatës, por nuk është caktuar norma e saj, edhe te këto kontrata vlejnë rregullat e parashikuara nga nenet 385 dhe 386 të këtij Ligji.

KREU 2

DETYRIMET E HUADHËNËSIT

Neni 569. Dorëzimi i sendeve të premtuara

- 1. Huadhënësi ka për detyrë t'i dorëzojë sendet e premtuara në kohën e kontraktuar, e në qoftë se afati i dorëzimit nuk është caktuar, atëherë duhet ta bëjë këtë kur ta kërkojë huamarrësi.**
- 2. E drejta e huamarrësit për të kërkuar dorëzimin e sendeve të caktuara parashkruhet në tre (3) muaj nga vonesa e huadhënësit, e në çdo rast për një (1) vit nga lidhja e kontratës.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.* - Me këtë dispozitë ligjore parashikohen detyrimet e huadhënësit dhe në kuadër të saj bëhet fjalë edhe për realizimin e të drejtave të huamarrësit që rrjedhin nga këto detyrime. Sipas kuptimit të dhënë për kontratën për huan në nenin 567 të këtij Ligji, forma e kësaj kontrate është konsesuale³²⁴, që do të thotë se kjo kontratë është me detyrime të dyanshme. Detyrimi i huadhënësit është dorëzimi i objektit të kontratës, që nënkupton se pas lidhjes së kontratës huadhënësi është debitor i këtij detyrimi, ndërsa huamarrësi kreditor. Pa përmbushjen e detyrimit nga huadhënësi, nuk ka detyrim për huamarrësin. Mirëpo, afatet e përmbushjes së detyrimeve të palëve të përcaktuara në këtë kontratë nuk përputhen ndërmjet tyre, pasi që detyrimi i huadhënësit i paraprinë detyrimit të huamarrësit dhe përfaqëson bazën juridike të tij; këto afate janë rregulluar me këtë dispozitë ligjore.

2. Me nenin 569 rregullohet afati për dorëzimin e objektit të huas nga ana e huadhënësit dhe afatet për realizimin e së drejtës nga huamarrësi. Huadhënësi, në bazë të kontratës për huan, ka detyrimin t'ia dorëzojë huamarrësit në pronësi objektin e kontratës. Duke pasur parasysh faktin se objekti i kontratës duhet të jetë sendi i zëvendësueshëm, ndryshimi i vlerës ndërkohë deri në afatin e parashikuar me kontratë për dorëzim, nuk është me ndikim në këtë detyrim. Edhe në rast të shkatërrimit të sendit që është objekt i kontratës para kalimit të rrezikut të dëmtimit mbi huamarrësin, detyrimi i huadhënësit për dorëzimin e sendit të zëvendësueshëm nuk humbet.³²⁵ Sa i përket mënyrës së dorëzimit të sendit dhe kalimit të pronësisë, ajo duhet të bëhet në mënyrë të zakonshme, varësisht nga objekti i kontratës, zakonisht me dorëzimin e sendit apo të të hollave qoftë në dorë, qoftë nëpërmjet xhirrollogarive bankare, gjë që zakonisht parashikohet në kontratë.

324 Shih nenin 567 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë nen.

325 Përkitazi me rrezikun për shkatërrimin e rastësishëm të sendit duhet zbatuar dispozitat ligjore të neneve 439 dhe 440 të LMD.

Sa i perkat afatit, sipas par. 1 të kësaj dispozite ligjore, huadhënësi ka detyrimin që huamarrësit t'ia dorëzojë sendet që janë objekt i kontratës në afatin e parashikuar në kontratë. Afatet për dorëzimin e objektit të huas zakonisht kontraktohen. Në qoftë se afati për përmbushjen e detyrimit kontraktues nga huadhënësi nuk është caktuar në kontratë, detyrimi duhet të përmbushet kur këtë e kërkon huamarrësi. Konsiderojmë se huamarrësi ka të drejtë ta bëjë këtë menjëherë pas lidhjes së kontratës, ngase me lidhjen e kontratës, pa caktuar afatin e dorëzimit, detyrimi është i arritshëm nga momenti i lidhjes së saj.³²⁶ Ky konstatim rrjedh nga fakti se, me vetë faktin e kontraktimit të huas, zakonisht merret se huadhënësi ka mundësi ta bëjë këtë, për dallim nga detyrimi i huamarrësit për kthimin e huas, i cili mund të mos ketë mundësi ta kthejë huan.

3. Me par. 2 të nenit 569 është rregulluar parashkrimi i kërkesës së huamarrësit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit nga huadhënësi. Përkitazi me parashkrimin e kësaj kërkesë janë parashikuar dy afate, njëri – nga dita kur huadhënësi ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit dhe tjetri – nga dita e lidhjes së kontratës për huan, pavarësisht nga afati për përmbushjen e detyrimit. Përkitazi me dorëzimin e sendit që është objekt i kontratës për huan, afati mund të caktohet në dy mënyra: a) me kontratë, b) sipas kërkesës së huamarrësit (në rastet kur nuk është caktuar me afat). Huamarrësi ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga huadhënësi brenda tre muajve, pas kalimit të afatit brenda të cilit ky i fundit ka pasur detyrimin ta përmbushë atë qoftë sipas afatit të caktuar në kontratë, qoftë sipas datës së paraqitjes së kërkesës nga ana e huamarrësit për dorëzimin e objektit të kontratës. Ky afat fillon të rrjedhë nga dita e parë, pas kalimit të afatit kontraktues për përmbushjen e detyrimit, përkatësisht nga dita e paraqitjes së kërkesës nga huamarrësi, me të cilën ka kërkuar përmbushjen e detyrimit. Këto afate mund të zgjasin më së shumti një vit, llogaritur nga data e lidhjes së kontratës. Kjo do të thotë se afati i kontraktuar për dorëzimin e sendeve nga huadhënësi nuk mund të jetë më i gjatë se 1 vit, nga dita e lidhjes së kontratës, brenda të cilit medoemos edhe huamarrësi duhet të paraqesë kërkesë për dorëzimin e objektit të kontratës për huan, nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndonjë afat. Në qoftë se brenda këtyre afateve huamarrësi nuk paraqet kërkesë për dorëzimin e objektit të huas, kërkesa parashkruhet, ashtu që huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë nëpërmjet gjykatës përmbushjen e detyrimit, prandaj detyrimi shndërrohet në *detyrim natyral*.³²⁷

326 Shih nenin 295 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

327 Detyrimi që ekziston mund të përmbushet në tërësi, mirëpo përmbushja e tij nuk mund të realizohet me padi nëpërmjet të gjykatës. Te debitori ekziston borxhi, por ai për kthimin e tij nuk ka përgjegjësi.

Neni 570. Gjendja e keqe materiale e huamarrësit

- 1. Në qoftë se vërtetohet se gjendja materiale e huamarrësit është e atillë që tregon se është e pasigurt a do të jetë në gjendje ta kthejë huan, huadhënësi mund të refuzojë ta kryejë detyrimin e vet të dorëzimit të sendeve të premtuara, në qoftë se në kohën e lidhjes së kontratës nuk ka ditur, si dhe në qoftë se keqësimi i gjendjes materiale të huamarrësit ka ndodhur pas lidhjes së kontratës.**
- 2. Mirëpo, ai do të ketë për detyrë ta kryejë detyrimin e vet në qoftë se huamarrësi ose ndokush tjetër për të ofron sigurim të mjaftueshëm.**

1. *Vështrim i përgjithshëm.* - Në dispozitën e nenit 570, në një mënyrë, përsëritet përmbajtja e dispozitës së nenit 105 nga pjesa e përgjithshme e LMD dhe përcaktohet kuptimi i kësaj dispozite edhe te kontrata për huan.³²⁸ Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse gjendja materiale e huamarrësit tregon se nuk është e sigurt se do ta kthejë huan, huadhënësi mund ta refuzojë përmbushjen e detyrimit të vet, me kusht që për këtë të mos ketë ditur në kohën e lidhjes së kontratës dhe nëse keqësimi i gjendjes është shkaktuar pas lidhjes së kontratës. Nga kjo rrjedh se huadhënësi ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata. Ndryshe nga kjo dispozitë, sipas nenit 105 të LMD, autorizohet pala kontraktuese ta shtyjë përmbushjen e detyrimit deri në përmbushje ose deri në dhënie të sigurimit nga pala tjetër kontraktuese, por nëse pala tjetër nuk jep siguri për përmbushjen e kontratës brenda një afati të pranueshëm, ai ka të drejtë ta shkëputë kontratën në mënyrë të njëanshme. Në këtë aspekt, konsiderojmë se në situata të tilla të marrëdhënieve të krijuara pas lidhjes së kontratës për huan duhet përdorur edhe dispozita e nenit 105, duke konsideruar se ajo i rregullon në mënyrë më të plotë pasojat e pasigurisë në përmbushjen e detyrimit.

2. Zakonisht forma e kontratës për huan është konsesuale, por mund të ndodhë të jetë edhe ndryshe. Te lidhja e kontratës për huan në formë reale, me rastin e lidhjes duhet dorëzuar edhe sendi që është objekt i kontratës. Deri në momentin e dorëzimit të sendit, huadhënësi mund të heqë dorë nga kontrata kur vlerëson se po i nënshtrohet një rrezikut të madh. Ndryshe nga kjo situatë, te kontrata konsesuale, huadhënësi ka detyrimin ta përmbushë atë që ka marrë për detyrim me kontratë. Mirëpo, sipas par. 1 të këtij neni, huadhënësi mund ta refuzojë përmbushjen e detyrimit të vet për dorëzimin e sendit që është objekt i kontratës, duke hequr dorë kështu prej saj, në qoftë se bindet se gjendja materiale e huamarrësit është e atillë që e bën të pasigurt mundësinë e kthimit të huas. Gjendja e këtillë materiale e huamarrësit ka mundur të jetë e tillë qysh herët dhe të ekzistojë edhe në momentin e lidhjes së kontratës. Për gjendjen jo të mirë materiale flet vetë fakti i marrjes hua nga huamarrësi. Mirëpo, për të pasur të drejtë huadhënësi të heqë dorë nga kontrata, nuk mjafton situata e zakonshme e papëlqyeshëm dhe jo e sa duhet e mirë e huamarrësit, për shkak të së cilës huazon një shumë të hollash apo sendesh të tjera. Por, është e nevojshme që gjendja materiale e huamarrësit të jetë aq e rëndë sa ta bëjë evident rrezikun që huaja nuk do të mund të kthehet.

.....
328 Shih nenin 105 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

Për të pasur të drejtë të mos e përmbushë detyrimin e përcaktuar në kontratën për huan dhe të heqë dorë prej saj, përpos kushtit paraprak - ekzistimit të situatës së këtyre materiale të huamarrësit në kohën e lidhje së kontratës, duhet plotësuar edhe kushti i dytë dhe ky është që huadhënësi të mos ketë ditur për ekzistimin e gjendjes së këtyre të rëndë materiale të huamarrësit. Nëse vërtetohet se ka pasur dijeni për këtë, do të konsiderohet se ai ka marrë përsipër me vetëdije rrezikun për të cilin ka ditur qysh më parë.

3. Sipas par. 2 të këtij neni, huadhënësi është i detyruar ta përmbushë detyrimin e përcaktuar në kontratë, në qoftë se huamarrësi apo dikush tjetër për të, ofron sigurim të mjaftueshëm se huaja do të kthehet. Nga përmbajtje e par. 1 dhe 2 të këtij neni rrjedh se siguria për përmbushjen e detyrimit jepet pasi të jetë bërë e njohur pasiguria në përmbushjen e detyrimit nga huamarrësi dhe pasi paraprakisht huadhënësi ka refuzuar dorëzimin e sendit që është objekt i kontratës. Në rast se huadhënësi, brenda një afati të kuptueshëm të caktuar, nuk merr sigurimin përkatës për kthimin e huas, ai mund ta zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, me një deklaratë, me pasoja të caktuara që parashikohen në ligj.³²⁹

Neni 571. Dëmi për shkak të të metave të sendeve të dhëna hua

- 1. Huadhënësi ka për detyrë t'ia kompensojë huamarrësit dëmin që do t'i shkaktohej për shkak të metave materiale të sendeve të dhëna hua.**
- 2. Mirëpo, në qoftë se huaja është pa shpërblim, ai ka për detyrë ta shpërblejë dëmin vetëm në qoftë se ka qenë në dijeni për të metat e sendit, ose nuk ka mundur të mos dinte për to, ndërsa ai për to nuk e ka njoftuar huamarrësin.**

1. Me këtë dispozitë ligjore rregullohet çështja e shpërblimit të dëmit nga huadhënësi, që i është shkaktuar huamarrësit nga të metat materiale të sendeve të dhëna hua. Përgjegjësia e huadhënësit varet nga ajo nëse huaja është dhënë me shpërblim apo pa shpërblim. Ndërkaq, sa u përket të metave të sendeve të dhëna hua, sipas kësaj dispozite, do të përgjigjej vetëm për të metat materiale të këtyre sendeve. Duke pasur parasysh faktin se objekt i kontratës për huan janë sendet e zëvendësueshme, të cilat nuk janë individualisht të caktuara, por caktohen vetëm sipas llojit të cilit i përkasin, vështirë mund të ndodhë që ato të kenë të meta juridike dhe për këtë arsye ligdhënësi ka parashikuar përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të metat materiale të sendeve të dhëna hua.³³⁰ Kjo nuk do të thotë se me çdo kusht përjashtohet përgjegjësia për shkaktimin edhe të dëmit eventual nga të metat juridike të sendit të dhënë hua. Në anën tjetër, duke u nisur nga dispozita ligjore e pjesës së përgjithshme, sipas nenit 103 të këtij Ligji, pavarësisht që në dispozitën ligjore të nenit 571 nuk përmendet shprehimisht përgjegjësia e huamarrësit për të metat materiale të sendit të cilin duhet ta kthejë, konsiderojmë se edhe ai është përgjegjës ndaj huadhënësit

329 Shih nenin 114 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

330 Përkitazi me të metat materiale të sendeve shih nenet 103, 461 dhe 462 dhe të tjerët në vazhdim lidhur me këtë.

për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të metat materiale, pse jo edhe atyre juridike të sendeve të cilat ia ka kthyer atij.

Në anën tjetër, nëse ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga të metat materiale të sendit si në anën e huadhënësit - me rastin e dorëzimit të sendeve në bazë të detyrimit të marrë përsipër me kontratë, ashtu edhe e huamarrësit - me rastin e kthimit të huas, varet nga ajo nëse kontrata është me shpërblim apo pa shpërblim. Sipas dispozitës së nenit 103 nga pjesa e përgjithshme e këtij Ligji, përgjegjësia për të metat materiale dhe juridike përkufizohet vetëm te kontratat me shpërblim, prandaj do të rrjedhë konstatimi se huadhënësi dhe huamarrësi, sipas kontratës për huan pa shpërblim, nuk mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga të metat e sendeve të dorëzuara, përkatësisht të kthyer, të cilat kanë qenë objekt i kontratës. Megjithatë, duhet pasur parasysh fakti se detyrimi i përgjithshëm i secilit debitor të detyrimit kontraktues është që kontratën ta përmbushë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.³³¹ Në anën tjetër, huamarrësi e merr sendin hua për shkak të vetive që ka ai send, ashtu që, nëse ai ka të meta materiale apo juridike, nuk do të kemi as përmbushje të detyrimit sipas përmbajtjes së tij, gjë që nënkupton se nuk do të arrihet as qëllimi i kontratës. Prandaj, konsiderojmë se pavarësisht nga ajo që thuhet në dispozitën e nenit 103 (“te kontratat me shpërblim”), përgjegjësia për të metat materiale duhet të ekzistojë edhe te kontratat pa shpërblim.

2. Në par. 2 të këtij neni përcaktohen kushtet nga ekzistimi i të cilave varet nëse qëndron përgjegjësia e palëve kontraktuese nga kontrata për huan pa shpërblim. Sipas kësaj dispozite, në rastet kur huaja është pa shpërblim, huadhënësi ka detyrimin t’ia shpërblejë dëmin e shkaktuar huamarrësit, në qoftë se ka ditur për të metat e sendit ose, sipas rrethanave të rastit, nuk ka mundur të mos dinte dhe për këto nuk e ka njoftuar huamarrësin. Edhe pse në këtë dispozitë ligjore kjo nuk thuhet shprehimisht për huamarrësin, konsiderojmë se të njëjtat rregulla vlejné edhe për të me rastin e kthimit të sendeve të cilat paraprakisht i ka marrë hua në bazë të kontratës për huan.

KREU 3

DETYRIMET E HUAMARRËSIT

Neni 572. Afati i kthimit të huas

- 1. Huamarrësi ka për detyrë që në afatin e kontraktuar t’i kthejë sendet e marra hua në sasi e në cilësi të njëjtë.**
- 2. Në qoftë se kontraktuesit nuk kanë caktuar afatin për kthimin e huas dhe as që ky mund të caktohet nga rrethanat e huas, huamarrësi ka për detyrë ta kthejë huan pasi të ketë kaluar afati i arsyeshëm, duke filluar që nga kërkesa e huadhënësit që huaja t’i kthehet e që nuk mund të jetë më i shkurtër se dy (2) muaj.**

.....
331 Shih nenin 245 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me atë.

1. Vështrim i përgjithshëm.- Kontrata për huan është një kontratë me detyrime të dyanshme.³³² Me pranimin e sendit në bazë të kontratës për huan, huadhënësi e përmbush detyrimin e vet dhe huamarrësi bëhet pronar i sendeve që kanë qenë objekt i kontratës. Me vetë lidhjen e kontratës, përkatësisht pranimin e sendeve të përcaktuar në kontratë, për huamarrësin lind detyrimi që huan e marrë ta kthejë dhe ta paguajë shpërblimin, nëse ai është kontraktuar.

2. Dispozita nga neni 572 e LMD rregullon detyrimin e huamarrësit në bazë të kontratës për huan si dhe afatin për përmbushjen e këtij detyrimi. Nëse objekt i huas janë sendet, ato janë sende të zëvendësueshme, prandaj qëllimi i huas është që ato të shpenzohen nga huamarrësi dhe, pas kalimit të afatit të caktuar, ato t'i kthehen huadhënësit. Detyrimi kryesor i huamarrësit, siç parashikohet në par. 1 të këtij neni, është të kthejë llojin e njëjtë të sendeve, siç i ka marrë, si dhe në sasi dhe me cilësi të njëjllota. Nëse huaja është kontraktuar me shpërblim, siç ndodh zakonisht, ai ka detyrimin ta kthejë edhe shpërblimin e kontraktuar. Detyrimi i huamarrësit për kthimin e borxhit nuk është detyrim personal i cili nuk mund t'i kalohet tjetrit, prandaj, edhe në rast të vdekjes së huamarrësit, kalon mbi trashëgimtarët e tij.³³³

3. Një nga elementet qenësore të kontratës për huan është kohëzgjatja e huas, të cilën, si rregull, palët e caktojnë në kontratë si afat kthimi. Në qoftë se në kontratë është caktuar afati i kthimit të huas, kjo do të thotë se është caktuar data e përmbushjes së detyrimit, ashtu që huamarrësi duhet ta përmbushë detyrimin në këtë datë. Nëse nuk përmbushet detyrimi, ai bie në vonesë.

Sipas par. 2 të këtij neni, në qoftë se në kontratë nuk është caktuar afati i kthimit të huas ai, në radhë të parë, duhet të caktohet në bazë të rrethanave të huas për çdo rast konkret. Në këtë rast do të duheshin vlerësuar vetëm ato rrethana për të cilat kanë ditur të dy palët dhe jo vetëm njëra nga këto.³³⁴ Në qoftë se afati i kthimit të huas, në bazë të rrethanave të rastit, nuk mund të caktohet, sipas kësaj dispozite ligjore, huamarrësi ka detyrimin ta kthejë huan pas kalimit të një afati të arsyeshëm, pas parashtrimit të kërkesës nga huadhënësi për kthimin e huas. Ky afat i arsyeshëm është përcaktuar me ligj dhe nuk mund të jetë më i shkurtër se dy muaj. Në rastet kur afati i kthimit të huas nuk është përcaktuar me kontratë dhe huadhënësi, pa parashtruar kërkesë për kthimin e huas ose para kalimit të afatit prej dy muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, paraqet padi në gjykatë për kthimin e huas, padia e paraqitur është e parakohshme, pasi që huamarrësi do të bjerë në vonesë për kthimin e huas me kalimin e afatit prej dy muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Në këtë dispozitë ligjore nuk bëhet fjalë lidhur me vendin e përmbushjes së detyrimeve. Në qoftë se vendi i kthimit është përcaktuar me kontratë, detyrimet e palëve kontraktuese duhet të përmbushen në atë vend. Në situatat kur kjo nuk është caktuar me kontratë, vlejnjë dispozitat e përgjithshme për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara me këtë Ligj.³³⁵

332 Shih nenin 567 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

333 Në bazë të neni 119 par. 1 të LTK, trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet që e ngarkojnë trashëgiminë, në përpjesëtim me pjesën e tyre dhe deri në vlerën e pjesës së vet trashëgimore. Sipas par. 2 të këtij neni, borxhe që e ngarkojnë trashëgiminë janë edhe borxhet personale të trashëgimlënësit.

334 Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 779.

335 Shih dispozitat nga 300 dhe 301 të LMD dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

Neni 573. Zgjedhja me rastin e kthimit të huas

- 1. Në qoftë se nuk janë dhënë hua të hollat, ndërsa është kontraktuar që huamarrësi do ta kthejë huan në të holla, huamarrësi megjithatë jetë i autorizuar që sipas dëshirës së vetë ti kthejë sendet e marra hua ose shumën e të hollave që i përgjigjet vlerës së këtyre sendeve në kohën dhe në vendin e caktuar në kontratë për ti kthyer.**
- 2. E njëjta gjë vlen edhe në rastin kur nuk ka mundësi të kthehet e njëjta sasi sendesh dhe të cilësisë e të llojit të njëjtë.**

“Në qoftë se hua nuk janë dhënë të holla, por sendet (materiali ndërtimor), të cilat kthehen në të holla, huamarrësi ka detyrim të paguajë shumën e parasë, e cila i përgjigjet vlerës së sendeve në kohën në të cilën është dashur të kthehen sendet”³³⁶

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Marrë në përgjithësi, në një marrëdhënie detyrimi debitori duhet të përmbushë detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.³³⁷ Në një marrëdhënie detyrimi të themeluar në bazë të kontratës për huan, huamarrësi ka detyrimin që t’i kthejë sendet e marra hua, të njëjta për nga lloji, me cilësi dhe në sasi të njëjtë.³³⁸ Në këtë mënyrë, sipas kësaj rregulle, asnjëra nga palët kontraktuese nuk mund të kërkojë nga pala tjetër diçka tjetër nga ajo që është kontraktuar.

2. Rregulla e parashikuar në nenin 573 ndryshon nga rregulla e përgjithshme e sipërpërmendur dhe parashikon dy situata lidhur me kontratën për huan, objekti i së cilës nuk janë të hollat, por sendet e zëvendësueshme. Sipas par. 1 të këtij neni, në rast se janë dhënë hua sende të tjera të zëvendësueshme e jo të holla dhe në kontratë është parashikuar që huaja e marrë të kthehet në të holla, duke llogaritur kundërvlerën e atyre sendeve, pavarësisht nga detyrimi i këtyrë i kontraktuar, huamarrësit i lejohet të zgjedhë nëse do t’i kthejë sendet e marra hua të llojit të njëjtë dhe të një cilësie dhe sasi të njëjtë apo shumën e të hollave që i përgjigjet vlerës së sendeve.³³⁹ Në rastet e këtyra, huadhënësi mund të kërkojë vetëm kthimin e sendeve të cilat janë dhënë hua dhe që, sipas kontratës, duhet të kthehen, i mbetet huamarrësit të zgjedhë deri në përfundim të procedurës përbarimore, nëse do t’i kthejë sendet e marra hua apo kundërvlerën e tyre dhe, me përmbushjen e detyrimit në njërin mënyrë, lirohet nga mënyra tjetër e përmbushjes.

Varësisht nga koha dhe vendi, mund të ndryshojë vlera e sendeve të cilat kanë qenë objekt i huas. Në këtë mënyrë, sipas kësaj dispozite ligjore, vlera e tyre do të duhej caktuar sipas vendit dhe kohës së caktuar në kontratë, kur ato është dashur të kthehen, e jo sipas kohës dhe vendit kur ato faktikisht kthehen.

.....
336 Gjyk. Sup. e R. KR. Rev. 1764/89 dt. 18.10.1989.

337 Shih par. 1 të nenit 245 të këtij Ligji dhe komentën lidhur me këtë nen nga komentet e dhëna për këto nene nga pjesa e përgjithshme e LMD.

338 Shih nenin 572 par. 1 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

339 Shih nenin 387 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

3. Rregulla nga par. 1 i këtij neni vlen për rastet kur nuk janë dhënë hua të hollat, por me kontratë është lejuar mundësia e kthimit të kundërvlerës së tyre. Me par. 2 të këtij neni parashikohet mundësia e zbatimit të rregullës së parashikuar nga par. i parë, në rastet kur nuk ka mundësi të kthehet e njëjta sasi e sendeve të cilësisë dhe të llojit të njëjtë. Duke pasur parasysh faktin që, sipas par. 2 të këtij neni, huamarrësi nuk ka mundësi t'i kthejë sendet që kanë qenë objekt i huas, në këtë rast huadhënësi ka të drejtë të kërkojë kundërvlerën e sendeve të marra hua, pasi që edhe ashtu kërkesa për kthimin e sendeve është e përealizueshme.

Neni 574. Heqja dorë nga kontrata

Huamarrësi mund të heqë dorë nga kontrata para se huadhënësi t'i dorëzojë sendet e caktuara por në qoftë se për këtë shkak do të ndodhëte ndonjë dëm për huadhënësin, ka për detyrë ta kompensojë atë.

1. Te kontratat me detyrime mes palëve, zakonisht, nuk përputhet koha e lindjes së detyrimit me afatin e përmbushjes së detyrimit. Si te kontratat e tjera, ashtu edhe te kontrata për huan, të drejtat dhe detyrimet lindin nga momenti i lidhjes së kontratës. Afati i përmbushjes së detyrimeve përcaktohet me kontratë, gjë që nënkupton se, zakonisht, ai nuk përputhet me momentin e lidhjes së kontratës. Marrë në përgjithësi, nga momenti i lindjes së detyrimit nuk lejohet heqja dorë në mënyrë të njëanshme nga kontrata, përveç nëse ajo është parashikuar me kontratë. Nga kjo rregull e përgjithshme përjashtim bën dispozita e nenit 574 i LMD, me të cilën parashikohet mundësia që huamarrësi të heqë dorë nga kontrata para se huadhënësi t'ia dorëzojë atij sendet që janë objekt i kontratës. Heqja dorë nga kontrata nënkupton shkëputjen e njëanshme të saj, me pasojat ligjore të parashikuara për rastet e shkëputjes së kontratës.³⁴⁰

2. Sipas kësaj dispozite ligjore, huamarrësi ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata para se huadhënësi t'ia dorëzojë sendet (dhe kjo i nënkupton edhe të hollat, ngase edhe ato janë sende të zëvendësueshme). Dorëzimi i sendeve të cilat janë objekt i kontratës duhet të bëhet brenda afatit të caktuar me kontratë ose brenda afatit të caktuar ligjor, pas kërkesës së huamarrësit. Mund të ndodhë që vonesa e dorëzimit të objektit nga kontrata për huan të ndodhë për fajin e huamarrësit. Shtrohet pyetja nëse ka të drejtë apo jo huamarrësi të heqë dorë nga kontrata, pas kalimit të afatit për dorëzimin e sendeve të cilat janë objekt i kontratës, në rast se vonesa për dorëzim ka ardhur për fajin e tij? Në rastet e tilla huamarrësi, me vonesën për pranimin e sendeve për fajin e vet, është palë kontraktuese e pandërgjegjshme, prandaj edhe në këto raste nuk do të kishte të drejtë të heqë dorë nga kontrata. Kjo nënkupton se huamarrësi ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata, *para se të bjerë në vonës për fajin e vet për pranimin e sendeve të cilat janë objekt i kontratës.*

340 Shih nenin 114 të LMD dhe komentnin lidhur me këtë nen.

3. E drejta e huamarrësit për të hequr dorë nga kontrata para se huadhënësi t'ia dorëzojë sendet është e kushtëzuar me detyrimin e tij që huadhënësit t'ia shpërblejë dëmin eventual, të cilin do ta pësonte për shkak të mospranimit të sendeve që kanë qenë objekt i kontratës për huan. Në bazë të rregullave të përgjithshme që kanë të bëjnë me dëmin, sipas LMD, “*kush i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e ti.*³⁴¹ Mbi këtë bazë ligjore, huamarrësi është përgjegjës për dëmin eventual shkaktuar huadhënësit, për shkak të heqjes dorë nga pranimi i sendeve të cilat kanë qenë objekt i kontratës.

Neni 575. Kthimi i huas para afatit

Huamarrësi mund ta kthejë huan edhe para afatit të caktuar për kthim, por ka për detyrë ta njoftojë huadhënësin që përpara mbi qëllimin e vet, dhe t'ia shpërblejë dëmin e shkaktuar.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Çështja e përmbushjes së detyrimit para afatit është e rregulluar në mënyrë të përgjithshme në pjesën e këtij Ligji, ku bëhet fjalë për kohën e përmbushjes së detyrimeve.³⁴² Dispozita e nenit 571 është dispozitë speciale, me të cilën është rregulluar kthimi i huas para afatit. Duke pasur parasysh faktin se ekziston mundësia që me kontratën për huan të mos caktohet afati i kthimit të huas,³⁴³ nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ajo vlen vetëm për rastet kur afati i kthimit të huas është i caktuar me kontratë apo, së paku, mund të caktohet nga rrethanat e huas, edhe pse kjo nuk është thënë shprehimisht në ligj, përkatësisht nuk mund të gjejë zbatim për rastet kur afati i kthimit nuk është kontraktuar dhe as që mund të caktohet nga rrethanat e huas. Derisa në këtë dispozitë ligjore nuk përcaktohet lloji i kontratës, varësisht nga ajo nëse është me apo pa shpërblim, si dhe lloji i objektit të saj, rrjedh se ajo gjen zbatim pavarësisht nga lloji i objektit të huas qoftë kjo shuma e caktuar e parasë apo sendet e tjera të zëvendësueshme, si dhe pavarësisht nëse huaja është me apo pa shpërblim.

2. Sipas kësaj dispozite ligjore, huamarrësi *mund* ta kthejë huan edhe para afatit të caktuar për kthim. Shprehja e përdorur “*mund*” lë të kuptohet se dispozita është e karakterit dëshirues e jo detyrues, kështu që lejohet që palët kontraktuese ta përjashtojnë këtë mundësi, në të cilin rast huamarrësi nuk do të kishte të drejtë ta bënte këtë, d.m.th., ta kthente huan para afatit të caktuar të kthimit.

3. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, në rast të kthimit të huas para afatit, për huamarrësin lindin dy detyrime: a) ta njoftojë huadhënësin qysh më parë për qëllimin e vet dhe b) t'ia shpërblejë atij dëmin eventual të shkaktuar.

341 Shih nenin 136 dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen nga pjesa e përgjithshme e LMD.

342 Shih nenin 296 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

343 Shih nenin 572 par. 2 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

Siç shihet, njoftimi paraprak i huadhënësit për kthimin e huas para afatit është detyrim ligjor. Në situatat kur huaja kthehet pa njoftimin paraprak, ekziston mundësia që huadhënësi të pësojë dëm vetëm për shkak të mosnjoftimit me kohë për kthimin e huas para afatit të caktuar (në rast të kthimit të sendeve të tjera të zëvendësueshme e jo të hollave, mund të ndodhë që ato të dëmtohen për shkak të mospërgatitjes së vendit të përshtatshëm për vendosjen e tyre), pavarësisht nga dëmi tjetër për shkak të kthimit të huas para afatit të caktuar me kontratë apo atij që rrjedh nga rrethanat e huas. Njoftimi paraprak do të nënkuptonte një afat të arsyeshëm para kthimit të sendeve, i cili do të krijonte mundësi normale për huadhënësin për t'u përgatitur për këtë veprim të huamarrësit, gjithmonë varësisht nga lloji i objektit të kontratës.

Detyrimi i dytë për huadhënësin është shpërblimi i dëmit në rast se ai është shkaktuar përparojë të kthimit të huas para afatit, pavarësisht nga dëmi që ka mundur të shkaktohet për shkak të mosnjoftimit me kohë të huadhënësit për kthimin e huas. Kjo nënkupton dëmin eventual që ka mundur të pësojë huadhënësi vetëm për shkak të kthimit të huas para kohe. Ligji nuk bën dallim në këtë rast ndërmjet të huas me shpërblim dhe asaj pa shpërblim. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, në praktikë ky dallim mund të ekzistojë. Huadhënësi i huas pa shpërblim zakonisht nuk mund të pësojë dhe të ketë dëm për shkak të kthimit të huas para kohe. Huadhënësi me shpërblim mund të pësojë dëm. Nëse objekt i huas kanë qenë të hollat e shpërblimi ka qenë pagesa e interesit të caktuar në bazë të afatit të parashikuar, huadhënësi ka të drejtën e atij interesi deri në përfundim të afatit të caktuar me kontratë. Në rast se objekt i kontratës kanë qenë sende të tjera, jo të hollat, ai mund të pësojë dëm për shkak të dëmtimit të tyre vetëm për pasojë të kthimit të atyre sendeve para afatit. Në rast se për kohën nga momenti i kthimit të të hollave para afatit, deri në kohën kur ato është dashur të kthehen sipas kontratës, huadhënësi ka marrë kamatë më të vogël se ajo e parashikuar në kontratë, huamarrësi ka detyrimin që, në emër të shpërblimit të dëmit, t'ia paguajë huadhënësit ndryshimin e kamatës mes asaj që e realizon nga momenti i kthimit deri në afatin e caktuar me kontratë dhe asaj që ka qenë e parashikuar në kontratë.

KREU 4 HUAJA ME DESTINIM

Neni 576

Në qoftë se me kontratë është caktuar qëllimi për të cilin huamarrësi mund t'i përdorë të hollat e marra hua ndërsa ai i përdorë për ndonjë qëllim tjetër, huadhënësi mund të deklarojë se e zgjidhë kontratën.

1. Vështrim i përgjithshëm.- Me dorëzimin e sendit në bazë të kontratës për huan huamarrësit, ai fiton të drejtën e pronësisë mbi atë send. Pronësia përbën të drejtën e tërësishme mbi një send. Pronari mund ta disponojë sendin sipas dëshirës së vet, veçanërisht ta posedojë dhe ta përdorë atë, ta ketë në dispozicion të vetin dhe t'i përjashtojë të tjerët nga çfarëdo ndikimi,

nëse kjo nuk kundërshtohet me ligj *ose nga të drejtat e një të treti*.³⁴⁴ Me marrjen e sendit nga huadhënësi në bazë të kontratës për huan, huamarrësi, mbi bazën e së drejtës së pronësisë fiton të drejta të pakufizueshme mbi atë send. Mirëpo, me rastin e lidhjes së kontratës për huan palët kontraktuese mund të kontraktajnë qëllimin e shfrytëzimit të sendeve të huas, duke caktuar edhe destinimin e shfrytëzimit të tyre. Me vetë faktin e përcaktimit të qëllimit të përdorimit të huas në kontratë, kontrata është me destinim. Në këtë mënyrë krijohet mundësia e huadhënësit dhe ai mbi këtë bazë e fiton të drejtën sipas nenit 4 par. 1 të LPDS për ta kontrolluar mënyrën e shfrytëzimit të sendeve të përcaktuara në kontratën e huas, edhe pse huamarrësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi atë send.

Edhe pse në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë vetëm për përdorimin e të hollave të marra hua, nuk ka kurrfarë pengese që ajo të zbatohet edhe në situatat kur objekt i huas janë sendet e tjera të zëvendësueshme, ashtu që ajo duhet zbatuar edhe në situata tjera, kur objekt i huas nuk janë të hollat.

2. Sipas nenit 576 të LMD, në qoftë se me kontratë është caktuar qëllimi i përdorimit të sendeve të marra hua e huamarrësi i përdor për ndonjë qëllim tjetër, huadhënësi mund ta zgjidhë kontratën me një deklaratë të njëanshme. Nga kjo rrjedh se, për ta realizuar huadhënësi të drejtën për ta deklaruar zgjidhjen e kontratës sipas këtij neni, paraprakisht duhet ta mbikëqyrë mënyrën e përdorimit të sendeve të përfshira në kontratën për huan, nëse përdoren apo jo ato ashtu siç është përcaktuar me kontratë. Në rast se objekti i kontratës nuk përdoret për qëllimet siç është kontraktuar, huadhënësi ka të drejtë ta shkëpusë kontratën në mënyrë të njëanshme me një deklaratë e cila duhet t'i drejtohet huamarrësit.³⁴⁵ Shkak i shkëputjes së kontratës në këtë rast është mospërmbushja e kontratës nga njëra palë kontraktuese, kështu që palët kontraktuese lirohen nga detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë dhe lindin të drejta dhe detyrime të tjera për shkak të zgjidhjes së saj.³⁴⁶ Pas kësaj, huamarrësi ka detyrimin që menjëherë t'ia kthejë huadhënësit atë që ka marrë dhe është përgjegjës edhe për dëmin që ka mundur t'i shkaktohet atij.³⁴⁷ Kontratat e këtilla zakonisht lidhen me qëllim të reproduktimit apo për qëllime të tjera prodhuese, siç është ndërtimi i objekteve të ndryshme me qëllim të zgjerimit të kapaciteteve të prodhimit etj.

Nga praktika gjyqësore

*Atëherë kur shërbimi kompetent i huadhënësit ka vërtetuar se huamarrësi nuk i ka shfrytëzuar mjetet e marra sipas qëllimit të caktuar në kontratë, paditësi e ka revokuar kredinë e dhënë. Në bazë të dispozitës ligjore me të cilën është rregulluar huaja me destinim, në qoftë se me kontratë është përcaktuar qëllimi për të cilin huamarrësi duhet t'i përdorë mjetet e marra, pro ai i përdor ato për ndonjë qëllim tjetër, huadhënësi mund ta deklarojë zgjidhjen e kontratës. Për këtë arsye, paditësi ka pasur të drejtë ta shkëputë kontratën dhe të kërkojë nga i padituri kthimin e shumës së marrë të kredisë si dhe kamatën e kontraktuar dhe kamatëvonesën.*³⁴⁸

344 Neni 4 par. 1 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS).

345 Shih nenin 115 të LMD.

346 Shih nenin 114 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen, nga pjesa e përgjithshme e këtij Ligji.

347 Shih dispozitat nga neni 245 deri 252 të LMD.

348 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 825/02 dt. 8.4.204, I. Crnić, ZOO, botimi i pestë, Zagreb, 2012, f. 754. .

Adem Vokshi

PJESA VII KONTRATA PER HUA PERDORJEN

KREU 1 DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 577. Përkufizimi

Me kontratën për huapërdorjen, huapërdordhënësi detyrohet të dorëzojë një send huapërdorëmarrësit në përdorim me mirëbesim dhe huapërdorëmarrësi detyrohet të kthej sendin.

577 Kontrata për huapërdorjen lind kur njëra palë kontraktuese (huapërdordhënësi) i dorëzon palës tjetër (huapërdorëmarrësit) sendin e caktuar për përdorim pa pagesë, e huapërdorëmarrësi detyrohet që ta kthejë atë pas përdorimit.

577. (a) Kontrata për huapërdorjen është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me ligj (neni 577 – 584 të LMD) dhe në qarkullimin juridik ka emër të caktuar; është e njëanshme detyrimore; është kontratë pa shpërblim; është kontratë joformale (konsensuale), ngase lidhet thjesht me arritjen e pëlqimit të vullnetit të palëve. Kontrata për huapërdorjen është kontratë reale, sepse lind vetëm atëherë kur, përveç pëlqimit ekzistues për elementet thelbësore të kësaj kontrate, rrjedh edhe dorëzimi faktik i objektit (sendit të huapërdorjes) huapërdorëmarrësit. Vetëm ekzistimi i deklaratave të pëlqimit të palëve kontraktuese për elementet thelbësore të kontratës për huapërdorjen nuk sjell lindjen e kësaj kontrate, por në këtë rast kemi të bëjmë me parakontratë konsensuale për huapërdorjen³⁴⁹.

577. (b) Subjektet e kontratës për huapërdorjen janë huapërdordhënësi dhe huapërdorëmarrësi (dhënësi dhe marrësi i sendit për huapërdorje). Këta mund të jenë persona fizikë dhe juridikë.

Elementet thelbësore të kontratës për huapërdorjen janë:

- Huapërdorëmarrësi nuk fiton pronësinë në sendin e huazuar, por të drejtën e përdorimit të këtij sendi.
- Huapërdorëmarrësi është i detyruar t'ia kthejë huapërdordhënësit pikërisht atë send që e ka marrë për huapërdorje (kthim individual).
- Huapërdorëmarrësit sendi i është lënë për përdorim pa kompensim.

349 Për parakontratën, shih dispozitën e nenit 33 të LMD dhe komentimin për këtë.

577. (c) Moskompensimi është aq i rëndësishëm për huapërdorjen, saqë me shuarjen e këtij elementi (moskompensimit), shuhet edhe vetë huapërdorja. Nëse kontraktohet kundërveprimi, huapërdorja shndërrohet në qira apo në ndonjë kontratë tjetër me kompensim. Kështu, p.sh. „nëse kontraktohet dhënia e librave për ruajtje me kompensim, apo dhënia e fustanit të nusërisë për përdorim me rastin e martesës, gjithashtu me kompensim – nuk kemi të bëjmë me huapërdorjen, por me qiranë.

Kontrata për huapërdorjen është e natyrës së përhershme, sepse përbushja e efektit të synuar – përdorimi i sendit të huaj për dobi personale – nuk arrihet me vetë faktin e lidhjes së kontratës, siç është, p.sh., te shitblerja, ndërrimi, dhënia. Ky efekt arrihet me kalimin e kohës së caktuar midis lidhjes dhe ndërprerjes së kontratës.

577. (ç) Veçimi i kontratës për huapërdorjen nga kontratat e tjera; Dallimi nga kontrata për qiranë.- Kontrata për huapërdorjen dallohet nga kontrata për qiranë sipas asaj se te kontrata për huapërdorjen sendi i jepet tjetrit për përdorim pa kompensim, kurse te kontrata për qiranë kjo bëhet me pagesën e një kompensimi të caktuar³⁵⁰.

577. (d) Kontrata për huapërdorjen veçanërisht duhet dalluar nga kontrata për huan, sepse në jetën e përditshme këto dy kontrata shpesh barazohen. Dallimet janë si vijon: huapërdorëmarrësi nuk e fiton të drejtën pronësore mbi sendin e marrë për huapërdorje, kurse huamarrësi mbi sendet e marra hua e fiton të drejtën pronësore³⁵¹; huapërdorëmarrësi është i detyruar që t’ia kthejë huapërdorëmarrësit pikërisht atë send që e ka huazuar, kurse huamarrësi është i detyruar t’ia kthejë huadhënësit sasinë e njëjtë të sendit të llojit dhe cilësisë së njëjtë dhe kontrata për huapërdorjen është pa kompensim, kurse kontrata për huan mund të jetë me kompensim ose pa kompensim³⁵².

KREU 2

DETYRIMET E HUAPËRDORËMARRËSIT

Neni 578. Përdorimi i sendit

- 1. Huapërdorëmarrësi mund të përdorë sendin vetëm për qëllimin e përcaktuar me kontratë.**
- 2. Nëse qëllimi i përdorimit nuk është përcaktuar me kontratë, huapërdorëmarrësi mund të përdorë sendin në përputhje me natyrën dhe qëllimin e sendit dhe me kujdesin e një përdoruesi të mirë.**
- 3. Huapërdorëmarrësi që e përdorë sendin në mënyrë jo të lejueshme është përgjegjës për çdo prishje apo shkatërrim të rastësishëm.**

350 Shih nenin 585 e tutje të LMD dhe komentën lidhur me këto nene.

351 Shih nenin 567 e tutje të LMD dhe komentën lidhur me këto nene.

352 Shih nenin 568 e tutje të LMD dhe komentën lidhur me këto nene.

578.1 Për mënyrën e përdorimit të sendit të marrë për huapërdorje, relevante janë në rend të parë dispozitat e kontratës. Mënyra e përdorimit mund të përcaktohet shprehimisht ose mund të nxirret nga qëllimi i kontratës. Kështu, p.sh., nëse huapërdordhënesi jep hua fustanin e vet vetëm si mostër, huapërdorësmarrësi nuk ka të drejtë që këtë fustan edhe ta përdorë.

578.2 Nëse nuk ka dispozita kontraktuese për mënyrën e përdorimit të sendit, huapërdorësmarrësi ka të drejtë ta përdorë sendin në përputhje me cilësitë dhe qëllimin e tij. Me fjalë të tjera, relevante është mënyra e zakonshme e përdorimit të sendit të huazuar. Kështu, p.sh., automjeti personal përdoret vetëm për bartjen e personave, por jo edhe për bartjen e kafshëve, apo materialit ndërtimor. Por, nëse ka mënyra të ndryshme të përdorimit, atëherë lihet në vullnetin e huapërdorësmarrësit se si do ta përdorë sendin e marrë për huapërdorje. P.sh., nëse është fjala për kamionin për bartje të ngarkesave dhe personave, atëherë i lihet huapërdorësmarrësit që ta shfrytëzojë atë sipas vullnetit të vet, por gjithnjë me kujdesin e një përdoruesi të mirë.

578.3 Përdorimi i sendit në mënyrë të palejueshme (në kundërshtim me dispozitat e kontraktuara), përkatësisht përdorimi i sendit në kundërshtim me cilësitë dhe qëllimin e tij, përbëjnë bazën e së drejtës së huadhënësit për shkëputjen e kontratës dhe kthimin e sendit dhe njëherësh të drejtën e tij për të kërkuar shpërblimin e dëmit për prishjen apo shkatërrimin e rastësishëm të sendit.

Neni 579. Mbajtja e sendit

- 1. Huapërdorësmarrësi ngarkohet me shpenzimet e rregullta të mbajtjes së sendit.**
- 2. Huapërdorësmarrësi mund të kërkojë kthimin e shpenzimeve jo të rregullta të mbajtjes së sendit në përputhje me rregullat e mbajtjes. Me shuarjen e huapërdorjes, huapërdorësmarrësi mund t'i ndajë pajisjet që ndahen nga lënda e huapërdorjes.**

579.1 Shpenzimet e rregullta për mbajtjen e sendit të huazuar përballohen nga huapërdorësmarrësi. Kur objekt i huapërdorjes është shtaza, huapërdorësmarrësi i heq edhe shpenzimet e ushqimit, ndërkaq te përdorimi i automjetit, huapërdorësmarrësi i heq edhe shpenzimet e karburantit dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme gjatë përdorimit të automjetit të huazuar. Huapërdorësmarrësi është i detyruar që t'i heqë edhe shpenzimet që janë rregullisht të lidhura me përdorimin e sendit, përkatësisht ruajtjen e tij.

579.2 Shpenzimet jo të rregullta janë ato shpenzime të cilat nuk janë parashikuar, p.sh., shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme në mënyrë që sendet e huazuara të ruhen. Këto shpenzime, (p.sh., shpenzimet e mjekimit të kafshës së huazuar), i heq huapërdordhënesi. Nëse këto shpenzime jo të rregullta i ka paguar huapërdorësmarrësi, atëherë huapërdordhënesi është i detyruar t'ia kompensojë ato sipas rregullave të gjerimit të punëve të huaja pa porosi (neni 203 e tutje i LMD).

Neni 580. Transferimi i përdorimit

Huapërdorëmarrësi nuk mund të transferojë përdorimin e sendit te personi i tretë pa pëlqimin e huapërdordhënesit.

580 Huapërdorja është raport i besueshmërisë. Për këtë arsye, sendi i huazuar nuk mund të jepet hua, nëse këtë huapërdordhënesi nuk e ka lejuar. Nëse huapërdorëmarrësi pa pëlqimin e huapërdordhënesit e ka transferuar përdorimin e sendit te një person i tretë, ai përgjigjet edhe për shkatërrimin apo dëmtimin eventual të sendit³⁵³. Huapërdordhënesi ka të drejtë ta zgjidh kontratën dhe të kërkojë kthimin e sendit, nëse huapërdorëmarrësi, pa lejen e tij, e ka transferuar sendin te një person i tretë³⁵⁴.

Neni 581. Kthimi i sendit

- 1. Huapërdorëmarrësi duhet të kthej sendin në kohën për të cilën janë marrë vesh.**
 - 2. Nëse koha nuk është përcaktuar, kontrata shuhet në momentin kur huapërdorëmarrësi ka realizuar qëllimin e përcaktuar në kontratë apo në fund të periudhës në të cilën mund të bëhet përdorimi i tillë.**
 - 3. Nëse as koha e as qëllimi nuk janë përcaktuar me kontratë, huapërdordhënesi mund të kërkojë sendin në secilën kohë që dëshiron.**
-

581.1 Koha e huapërdorjes duhet të jetë e kufizuar, sepse te huapërdorja bëhet fjalë për përdorim të përkohshëm të sendit të huaj dhe jo për përdorim të përhershëm. Si rregull, kohëzgjatja e huapërdorjes përcaktohet në kontratë. Nëse kohëzgjatja nuk është kontraktuar, ajo përcaktohet sipas qëllimit të përdorimit të sendit të marrë për huapërdorje.

581.2 Kthimi i sendit të marrë për huapërdorje nga huapërdordhënesi është mënyra e rregullt e pushimit të kontratës për huapërdorjen. Dhe, duhet të kthehet pikërisht ai send që është dhënë për huapërdorje (kthimi individual). Me rastin e kthimit, merret parasysh edhe përkeqësimi i sendit i shkaktuar me përdorimin e kontraktuar, përkatësisht me përdorimin e rëndomtë – harxhimi normal i sendit (neni 583 i LMD).

581.2 (a) Për mënyrën e kthimit vlen rregulla që huapërdorëmarrësi duhet t'ia kthejë sendin huapërdordhënesit. Për vendin e kthimit së pari vlejné rregullat e kontratës. Nëse nuk ekzistojné, atëherë ato caktohen sipas qëllimit të kontratës për huapërdorjen, natyrës së detyrimit dhe rrethanave të tjera. Kur as këto nuk japin rezultate, sendi kthehet në vendin në të cilin huapërdorëmarrësi në kohën e lindjes së detyrimit e ka pasur vendbanimin e, në mungesë të vendbanimit, vendqëndrimin e tij. Shpenzimet e kthimit i heq huapërdorëmarrësi.

.....
353 Shih dispozitën e nenit 583 të LM D-së dhe komentin e kësaj dispozite.

354 Shi dispozitën e nenit 582 të LMD dhe komentin për kësaj dispozite.

581.2 (b) Koha e kthimit të sendit të marrë për huapërdorje mund të jetë e caktuar në kontratë ose mund të kuptohet nga qëllimi i huapërdorjes, përkatësisht skadimi i kohës brenda së cilës ky qëllim është e mundur të arrihet. P.sh., te huazimi i kombajnës së korrje-shirjeve, pa afat kontraktues të përdorimit, merret se huapërdorja zgjat gjersa nuk skadon koha e korrje-shirjeve.

581.2 (c) Huapërdorja lidhet në favor të huapërdorëmarrësit. Për këtë arsye, huapërdorëmarrësi, sipas rregullit, nuk është i detyruar ta kthejë sendin e marrë për huapërdorje para skadimit të afatit të përcaktuar. Përrjashtimisht, ai është i detyruar që ta bëjë këtë, nëse sendi, për shkak të rrethanave të paparashikuara, do t'i nevojitej urgjentisht huapërdordhënesit.

581.3 Nëse nuk është kontraktuar as koha, as qëllimi i huapërdorjes, atëherë huapërdordhënesi mund të kërkojë sendin në secilën kohë që ai dëshiron. Në këtë situatë, huapërdorëmarrësi duhet ta kthejë, sendin menjëherë, përndryshe shndërrohet nga posedues i sendit me mirëbesim në posedues të sendit me keqbesim.

Neni 582. Zgjidhja e kontratës

1. Huapërdordhënesi mund të zgjidh kontratën pa njoftim paraprak dhe të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit nëse:

1.1. huapërdorëmarrësi vdes;

1.2. huapërdorëmarrësi përdorë sendin në kundërshtim me kontratën ose e transferon tek personi i tretë pa pasur të drejtë;

1.3. sendi i huapërdorjes i duhet huapërdordhënesit për shkak të rrethanave të paparashikuara.

582.1 Në dispozitën e nenit 582 të LMD parashikohet mundësia kur huapërdordhënesi mund ta zgjidhë kontratën pa njoftim paraprak dhe njëherësh të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit që i ka dhënë për huapërdorje huapërdorëmarrësit.

582.1.1 Situata kur huapërdordhënesi mund ta zgjidhë kontratën pa njoftim paraprak është ajo kur huapërdorëmarrësi vdes. Meqenëse kontrata për huapërdorjen është e lidhur mes dy kontraktuesve, duke u nisur nga personaliteti dhe besimi reciprok i tyre, logjikisht, me vdekjen e huapërdorëmarrësit, ligji i jep të drejtë huapërdordhënesit që të kërkojë zgjidhjen e kontratës pa paralajmërim paraprak dhe njëherësh të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit të dhënë për huapërdorje. Kjo është e drejtë e huapërdordhënesit, të cilën ai mund ta shfrytëzojë, por ai, po ashtu, ka mundësi që, duke marrë parasysh qëllimin dhe natyrën e dhënies së sendit për huapërdorje, të mos e kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës, pavarësisht se huapërdorëmarrësi ka vdekur, dhe të presë përfundimin e punëve për të cilat huapërdorëmarrësi e ka marrë sendin për huapërdorje.

582.1.2 Në situatën kur huapërdorëmarrësi përdor sendin në kundërshtim me kontratën apo kur sendin e marrë për huapërdorje e transferon te personi i tretë, pa pasur për këtë të drejtë, atëherë huapërdordhënësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë kthimin e sendit.

582.1.3 Edhe në rastin kur sendi i dhënë për huapërdorje i duhet huapërdordhënësit për shkak të rrethanave të paparashikuara, ai, po ashtu, ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës pa njoftim paraprak të bashkëkontraktuesit. Rrethanat e paparashikuara, përkatësisht urgjenca e nevojës, vlerësohen në bazë të të gjitha rrethanave të rastit konkret.

Neni 583. Përgjegjësia

Huapërdorëmarrësi nuk është përgjegjës për asnjë përkeqësim apo ndryshim të sendit si rezultat i pasojave të zakonshme të përdorimit të bërë në përputhje me kontratën.

583 Huapërdorëmarrësi duhet ta shfrytëzojë sendin në mënyrën e kontraktuar, përkatësisht në mënyrë të zakonshme. Huapërdordhënësi nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga huapërdorëmarrësi për shkak se sendi i dhënë për huapërdorje është përkeqësuar apo ndryshuar me përdorim të huapërdorëmarrësi, nëse ky e ka përdorur këtë send në mënyrë të zakonshme, (në përputhje me kontratën, përkatësisht në mënyrë të zakonshme).

KREU 3

DETYRIMET E HUAPËRDORDHËNESIT

Neni 584. Dëmi nga të metat

Nëse sendi i cili është objekt i huapërdorjes ka një të metë apo një veçori të rrezikshme si pasojë e së cilës dëmi është shkaktuar tek huapërdorëmarrësi ose te i treti si i dëmtuar, ndërsa huapërdordhënësi, ka qenë në dijeni apo është dasht të ishte në dijeni për metat apo veçorinë e rrezikshme por nuk e ka njoftuar huapërdorëmarrësin, atëherë huapërdordhënësi është përgjegjës për dëmin.

584 Kjo dispozitë e rregullon përgjegjësinë e huapërdorëmarrësit për dëmin e shkaktuar për të metat materiale dhe juridike të sendit të dhënë për huapërdorje.

584. (a) Përgjegjësia për të metat materiale të përmbushjes së tij ka të bëjë me detyrimin e huapërdordhënësit që huapërdorëmarrësit t'ia kalojë sendin pa të meta për shkak të të cilave sendi nuk mund të përdoret. Sendi është me të meta materiale (fizike) kur: sendi nuk ka cilësi të duhura për përdorimin e rregullt ose për qarkullim; sendi nuk ka cilësi të duhura për përdorim të veçantë, për të cilin huapërdorëmarrësi e ka marrë për huapërdorje,

e të cilën mungesë huapërdordhënësi e ka ditur ose ka qenë i detyruar ta dijë. Pra, sendi ka të meta fizike kur nuk ka cilësitë e parashikuara në kontratë, ligj ose cilësi për të cilat është destinuar përdorimi i rregullt i sendit³⁵⁵.

584. (b) E meta juridike ekziston kur në sendin e marrë për huapërdorje ekziston ndonjë e drejtë e palës së tretë, e cila e përjashton, e zvogëlon apo e kufizon të drejtën e huapërdorëmarrësi dhe për ekzistimin e së cilës huapërdorëmarrësi nuk është njoftuar, (p. sh., kur pala e tretë është pronar i sendit të dhënë për huapërdorje)³⁵⁶.

584. (c) Nëse huapërdordhënësi ka qenë në dijeni apo është dashur të ishte në dijeni për të metat apo veçorit e rrezikshme të sendit të dhënë për huapërdorje dhe nuk e ka vënë në dijeni për to huapërdorëmarrësin, ai nuk ka vepruar sipas parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë (neni 4 i LMD), për çka duhet t'i bartë pasojat e caktuara, nëse është shkaktuar dëm të huapërdorëmarrësi apo të personi i tretë, si pasojë e këtyre të metave të sendit.

.....
355 Për të metat materiale, shih më hollësisht nenin 103 të LMD dhe komentin e këtij neni.

356 Edhe për të metat juridike, më hollësisht shih po aty.

PJESA VIII KONRATA PËR QIRANË

KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 585. Nocioni

- 1. Me kontratën për qiranë, qiradhënësi detyrohet t’ia dorëzojë sendin e caktuar qiramarrësit në përdorim, ndërsa qiramarrësi detyrohet t’i paguajë qiranë e kontraktuar.**
- 2. Përdorimi përfshin edhe gëzimin e sendit (vjelja e frutave), në qoftë se nuk rrjedhë diçka ndryshe nga kontrata, ose nga zakoni.**

585. Vështrim i përgjithshëm.- Duke marrë parasysh ekzistimin e llojeve të ndryshme të qirasë, nuk ekziston mundësia e rregullimit unik të të gjitha raporteve të qirasë. Në LMD janë parashikuar vetëm parimet e përgjithshme mbi kontratën për qiranë, të cilat mund të zbatohen te llojet e ndryshme të qirasë, pavarësisht se cilat sende jepen me qira. Me rastin e hartimit të Ligjit, është mbajtur parasysh që në të të inkorporohen aso rregullash që mund të gjejnë një zbatim sa më afatgjatë dhe të cilat nuk kërkojnë intervenime të shpeshta të ligjvënësit në tekstin ligjor. Pra, me këtë Ligj nuk preket në raportet e qiradhënies të rregulluara me ligje të posaçme, d.m.th.. nëse me ligje të posaçme nuk është rregulluar ndonjë raport kontraktues që ka të bëjë me qiranë. atëherë zbatohen dispozitat e LMD.

585.1 Kontrata e qirasë – **locatio conductio operum** – është kontratë e tillë sipas së cilës një person (qiradhënësi) detyrohet që t’ia dorëzojë sendin e caktuar personit tjetër (qiramarrësit) në përdorim, ndërsa ky person (qiramarrësi) detyrohet që për të t’i paguajë shpërblimin e caktuar dhe të njëjtin send t’ia kthejë pas skadimit të afatit të caktuar. Qiradhënës dhe qiramarrës mund të jetë çdo person fizik vendor apo i huaj dhe personi juridik. Qiradhënësi duhet të jetë pronar i sendit të dhënë me qira apo i autorizuar realo - juridik i cili mund ta bartë mbi tjetrin ushtrimin e së drejtës së tij.

585.1 (a) Kjo kontratë ka këto karakteristika: është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me ligj (neni 585- 614 LMD); kontratë me detyrime të dyanshme; kontratë me shpërblim; kontratë konsensuale; kontratë me prestime të vazhdueshme; kontratë jo formale, sepse në LMD nuk kërkohet kurrfarë forme e veçantë për lidhjen e saj. Mirëpo, ajo është edhe kontratë formale në rastet e caktuara me ligj (qiraja e shtëpisë, e lokalit afarist), kauzale dhe e pavarur.

585.1 (b) Kushtet për lidhjen e kësaj kontrate janë kushte të përgjithshme, të cilat janë të domosdoshme për lidhjen e të gjitha kontratave të tjera detyrimore, ndërsa kushtet e veçanta

janë: lënda e kontratës së qirasë (të jetë send i pakonsumueshëm –**res non consumptibiles**), qiraja (e cila caktohet në të holla apo në ndonjë mënyrë tjetër në natyrë) dhe kohëzgjatja e qirasë (në kohë të caktuar apo të pacaktuar).

585.2 Me përdorimin e sendit nënkuptojmë sipas paragrafit 2 të nenit 585 të LMD edhe gëzimin e sendit (vjelja e frutave), kuptohet nëse nuk është kontraktuar diçka tjetër ndërmjet kontraktuesve apo nuk rrjedh nga zakoni.

KREU 2

DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

Neni 586. Dorëzimi i Sendit

Qiradhënësi ka për detyrë t'i dorëzojë qiramarrësit sendin e marrë me qira së bashku me aksesoret dhe pjesët përbërëse të tij.

586. Detyrimi i qiradhënësit është që t'ia dorëzojë qiramarrësit sendin së bashku me aksesoret dhe pjesët përbërëse të tij në gjendjen e caktuar me kontratë e, nëse kjo nuk është caktuar me kontratë, në gjendjen që të mund të përdoret për qëllimin për të cilin është lidhur kontrata. Pra, ky është detyrimi themelor i qiradhënësit. Ky detyrim i qiradhënësit u paraprinë detyrimeve të tjera që i ka qiradhënësi në bazë të kontratës për qiranë: detyrimin të mirëmbajtjes së sendeve (neni 587 i LMD), përgjegjësisë për të metat materiale të sendeve (neni 590 gjer në 596 i LMD) dhe përgjegjësisë për të metat juridike (neni 597 i LMD). Mirëpo, për dallim nga detyrimi i dorëzimit të sendit, detyrimet e tjera të qiradhënësit janë të rëndësishme vetëm nëse qiramarrësi, për shkak të lëshimeve të qiradhënësit lidhur me mirëmbajtjen dhe nevojën për riparime, nuk mund ta shfrytëzojë sendin e dhënë në harmoni me kontratën, nëse të metat materiale të sendit të marrë me qira pengojnë shfrytëzimin e kontraktuar apo të rregullt të tij dhe nëse personi, i cili pretendon ndonjë të drejtë mbi sendin e marrë me qira apo mbi ndonjë pjesë të tij, e konteston shfrytëzimin nga ana e qiramarrësit. Përveç këtyre detyrimeve pozitive, qiradhënësi ka edhe detyrimin i cili qëndron në mosveprim. Lidhur me këtë, qiradhënësi është i detyruar që të durojë të drejtën e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit dhe me veprimet e veta të mos e pengojë këtë. Kjo rregull në të drejtën tonë nuk është formuluar shprehimisht.

586. (a) Dorëzimi i sendit supozon ndërmarrjen e veprimeve të caktuara nga ana e qiradhënësit, me të cilat këtij i mundësohet posedimi i drejtpërdrejtë, që është kusht për fitimin e së drejtës së shfrytëzimit të sendit të marrë me qira. Mënyra e dorëzimit të sendit mund të jetë e ndryshme, gjë që varet nga lloji dhe qëllimi i sendit apo marrëveshja e vetë palëve. Është i mundur dorëzimi fizik, dorëzimi me shenja apo dorëzimi simbolik, (p.sh., dorëzimi i çelësave të banesës, të lokalit afarist apo të automjetit), pastaj dorëzimi me deklaratë (**traditio per declarationem**). Duke marrë parasysh se kontrata për qiranë është konsensuale, vetë akti i dorëzimit të sendit ka rolin e përmbushjes dhe jo lindjes së detyrimit.

586. (b) Dorëzimi i sendit, qoftë kur është fjala për dorëzimin fizik, qoftë për mënyrat e tjera të dorëzimit, mund të kryhet për një moment apo për një kohë më të gjatë, por në asnjë mënyrë nuk zgjat tërë kohën e afatit të qirasë.

586. (c) Sendi nga ana e qiradhënësit duhet të dorëzohet te qiramarrësi në gjendje të rregullt. Konsiderohet se qiradhënësi e ka dorëzuar sendin në gjendje të rregullt, nëse ai u përgjigjet vetive dhe nevojave të kontraktuara për shfrytëzimin e destinuar, por nëse palët kontraktuese kanë lënë pa kontraktuar këtë me dispozita të kontratës, gjendje e rregullt e sendit konsiderohet ajo në të cilën sendi mund t'i shërbejë qëllimit për të cilin është lidhur kontrata. Qiradhënësi mund të provojë që në kontratën për qiranë ta kontraktojë dispozitën sipas së cilës nuk do të ishte i detyruar që sendin ta dorëzojë në gjendje të rregullt, por në gjendjen në të cilën ai gjendet në momentin e lidhjes së kontratës, (p.sh. lokali afarist i cili kërkon të adaptohet).

586. (ç) Sendi i marrë me qira mund të ketë aksesorët dhe pjesët përbërëse të tij, përkatësisht sendet e veçanta të cilat gjenden në raport vartës ndaj sendit të marrë me qira. Duke marrë parasysh se në doktrinën juridike vartësia manifestohet ashtu që pjesët përbërëse ndjekin fatin juridik të sendit kryesor, kontrata për qiranë i përfshin edhe aksesorët dhe pjesët përbërëse të sendit. Mirëpo, kontraktuesit mund t'i shmangen me kontratë këtij parimi dhe të caktojnë dorëzimin e sendit të marrë me qira pa aksesorët dhe pjesët përbërëse të tij.

Neni 587. Mirëmbajtja e sendeve

- 1. Qiradhënësi ka për detyrë t'i mirëmbajë sendet në gjendje të rregullt gjatë kohës së qirasë dhe për këtë arsye të bëjë riparime të nevojshme në të.**
- 2. Ai ka për detyrë t'i kompensojë qiramarrësit shpenzimet që i ka bërë ky për mirëmbajtjen e sendit, e që do t'i kishte për detyrë ky t'i bënte.**
- 3. Shpenzimet e meremetimeve të vogla të shkaktuara nga përdorimi i zakonshëm i sendit, si dhe shpenzimet e vetë përdorimit bien në ngarkim të qiramarrësit.**
- 4. Mbi nevojën e riparimit qiramarrësi ka për detyrë ta njoftojë qiradhënësin.**

587.1 Pas dorëzimit të sendit, qiradhënësi, përveç detyrimit të durimit të shfrytëzimit nga ana e qiramarrësit, ka edhe detyrimin për mirëmbajtjen e sendit të dhënë me qira dhe përgjegjësinë për të metat materiale dhe juridike gjatë tërë kohës së kohëzgjatjes së raportit të qirasë. Obligimi i mirëmbajtjes së sendit nuk duhet doemos të shfaqet në këtë raport juridiko-detyruar, por gjen shprehje vetëm kur ndodh ndryshimi në gjendjen e mëparshme të rregullt të sendit. Për mirëmbajtjen e sendit në gjendje të rregullt, qiradhënësi është i detyruar të bëjë përmirësime të duhura në të.

587.2 Në dy raste qiramarrësi mundet vetë, si kryerës i punëve pa urdhër, t'i qaset riparimit të sendit të marrë me qira. Së pari, në situatën kur bëhet fjalë për riparime të cilat nuk

durojnë pritje, qiramarrësi mundet vetë të bëjë riparimin, por për këtë është i detyruar që sa më parë ta njoftojë qiradhënësin dhe të vazhdojë me riparimin e filluar gjersa ky nuk ndërmer vazhdimin e riparimit. Përveç kësaj, qiramarrësi mund të bëjë riparime të nevojshme edhe në rastin kur e ka njoftuar qiradhënësin, por ky, me gjithë këtë, nuk i ka bërë ato në një kohë të arsyeshme. Në rastet e përmendura qiradhënësi është i detyruar t'ia kompensojë qiramarrësit shpenzimet e riparimit, të cilat ky i ka pasur. Kjo përfshinë të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme dhe shpërblimin e dëmit të pësuar.

587.3 Qiradhënësi nuk është i detyruar të bartë të gjitha shpenzimet. Ekzistojnë shpenzimet e caktuara, të cilat gjatë kohëzgjatjes së qirasë është i detyruar t'i bartë qiramarrësi. Këto janë para së gjithash: shpenzimet e meremetimeve të vogla të shkaktuara nga përdorimi i zakonshëm i sendit dhe shpenzimet e vetë përdorimit. Shpenzimet e meremetimit përfshijnë riparime të rëndësisë së vogël si dhe këmbime të pjesëve të imëta. Shpenzimet e përdorimit të zakonshëm janë ato që paraqiten gjatë shfrytëzimit të sendit. Më së shpeshti në një kontratë konkrete caktohet se çka konsiderohet shpenzim i përdorimit të përditshëm, të cilin e bartë qiramarrësi dhe çka quhet shpenzim i mirëmbajtjes të cilin e bartë qiradhënësi. Nëse palët kanë lënë pa kontraktuar këtë, atëherë zbatohen doket e vendit për llojin e qirasë së caktuar.

587.4 Duke marrë parasysh se sendi i marrë me qira gjendet në posedim të qiramarrësit, qiramarrësi është ai që mund ta vërejë i pari ekzistimin e nevojës së riparimit të dëmtimeve apo të prishjeve. Në përputhje me parimin e detyrimit të veprimit me kujdes (neni 5 i LMD), qiramarrësi është i detyruar ta njoftojë qiradhënësin për nevojën e riparimit të sendit të marrë me qira. Në rast se për nevojën e riparimit paraprakisht nuk e njofton qiradhënësin, ai është përgjegjës për dëmin i cili mund të ndodhë për këtë shkak.

Neni 588. Zgjidhja e kontratës dhe zbritja e qirasë për shkak të riparimeve

- 1. Në qoftë se meremetimet e nevojshme të sendit të marrë me qira pengojnë përdorimin e tij në një masë të konsideruar dhe për një kohë të gjatë, qiramarrësi mund ta zgjidhë kontratën.**
- 2. Ai ka të drejtë në zbritjen e qirasë proporcionalisht me kufizimin e përdorimit të sendit për shkak të këtyre riparimeve.**

588.1 Gjer në momentin e dorëzimit të sendit të marrë me qira, qiramarrësi ka të drejtë vetëm të kërkojë sendin e marrë me qira. Pas dorëzimit të sendit të marrë me qira, qiramarrësi ka të drejtë që, i qetë dhe i papenguar, ta shfrytëzoj sendin e marrë me qira. Në anën tjetër, qiradhënësi është i detyruar që të durojë shfrytëzimin nga ana e qiramarrësit, d.m.th., ai duhet të sillet në mënyrë pasive dhe t'i shmanget çdo veprimi që do të pengonte të drejtën e qiramarrësit në shfrytëzimin e sendit të marrë me qira. Përmbajtja nga pengimi i të drejtës së qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit të marrë me qira ka të bëjë me veprimet dhe punët

e palejuara të qiradhënësit, por edhe me punët e lejuara në meremetimet e nevojshme, nëse këto meremetime pengojnë shfrytëzimin e sendit në masë të konsiderueshme dhe për një kohë më të gjatë. Në rastin kur meremetimet pengojnë apo kufizojnë shfrytëzimin, qiramarrësit në i qëndrojnë në dispozicion dy mjete juridike: e drejta për zgjidhjen e kontratës ose e drejta e zbritjes së qirasë.

588.1 (a) Të drejtën për zgjidhjen e kontratës për qiranë qiramarrësi e ka vetëm në rastin kur në mënyrë kumulative plotësohen dy kushte: kur meremetimet e nevojshme e pengojnë shfrytëzimin e sendit në masë të konsiderueshme dhe kur ky pengim vazhdon për një kohë më të gjatë. Kontrata zgjidhet me deklaratën e njëanshme të qiramarrësit. Shprehjet “në masë të konsiderueshme” dhe “një kohë më të gjatë” duhen shikuar në çdo rast konkret dhe varen nga lloji i meremetimeve, vëllimi i tyre, natyra e sendit dhe të ngjashme. Anasjelltas, përmbushja e vetëm njërit kusht, pavarësisht nga vëllimi i tij, nuk është arsye e mjaftueshme për zgjidhjen e kontratës.

588.1 (b) Mirëpo, edhe në rastin kur meremetimet e konsiderueshme për një kohë më të gjatë pengojnë shfrytëzimin e sendit të marrë me qira, qiramarrësi mund të ketë interes që ta mbajë në fuqi kontratën për qiranë. Në atë rast, në vend të zgjidhjes së kontratës, mund të vendosë që qiradhënësit t’i bëjë kërkesë për zbritjen e qirasë.

588.2 Nëse meremetimet e nevojshme të sendit të marrë me qira nuk e pengojnë shfrytëzimin e sendit në masë të konsiderueshme dhe për një kohë më të gjatë, përkatësisht nëse nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të dy këto kushte, qiramarrësi nuk mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, por ka të drejtë që vetëm të kërkojë zbritjen e qirasë në përpjesëtim me kufizimin e shfrytëzimit të sendit, për shkak të këtyre meremetimeve.

Neni 589. Ndryshimet në sendin e marrë me qira

- 1. Qiradhënësi nuk mundet pa pëlqimin e qiramarrësit të bëjë ndryshime në sendin e marrë me qira gjatë kohës së qirasë, në qoftë kjo do të pengonte përdorimin e sendit.**
- 2. Në qoftë se me ndryshimet e sendit do të zvogëlohej në një farë mase përdorimi i sendit nga ana e qiramarrësit, do të zvogëlohet edhe qiraja në përpjesëtimin përkatës.**

589.1 Ndryshimet në sendin e dhënë me qira mund të jenë të asaj natyre që nuk e pengojnë shfrytëzimin e sendit, por edhe të tilla që e pengojnë shfrytëzimin e kontraktuar. Qiradhënësi që ka për qëllim të bëjë ndonjë ndryshim në sendin e dhënë me qira, është i detyruar që për këtë të sigurojë pëlqimin e qiramarrësit, kur këto ndryshime pengojnë të drejtën e qiramarrësit për shfrytëzim. Nëse qiramarrësi nuk e jep pëlqimin, qiradhënësi nuk do të ketë mundësi t’i bëjë këto ndryshime. Nëse këto ndryshime në sendin e dhënë me qira nuk e pengojnë shfrytëzimin e tij, qiradhënësi mund t’i bëjë ato edhe pa pëlqimin e qiramarrësit. Në rast se qiradhënësi i bën ndryshimet në sendin e dhënë me qira, të cilat

pengojnë shfrytëzimin e tij, përkundër faktit se i është mohuar kjo e drejtë, qiramarrësit i qëndron në dispozicion mundësia e ngritjes së padisë kundër qiradhënësit për shkak të pengimit të posedimit.

589.2 Ndryshimet e bëra për të cilat qiramarrësi e ka dhënë pëlqimin e vet, mund ta zvogëlojnë në masë të konsiderueshme shfrytëzimin e sendit. Gjithashtu, bërja e ndryshimeve nuk duhet të pengojë shfrytëzimin, por mund të ndikojë në shfrytëzimin e mëvonshëm të sendit të marrë me qira. Nëse zvogëlohet vëllimi i shfrytëzimit për shkak të ndryshimeve të bëra (p. sh., zvogëlimi i sipërfaqes së lokalit afarist), qiramarrësi ka të drejtë të kërkojë zbritjen e qirasë në shkallë të duhur.

Neni 590. Përgjegjësia për të metat materiale

- 1. Qiradhënësi i përgjigjet qiramarrësit për të gjitha të metat e sendit të marrë me qira që pengojnë në përdorimin e kontraktuar ose të zakonshëm të tij, pavarësisht nëse ka ditur ose jo për to, si dhe për të metat e veçorive apo të karakteristikave të parashikuara shprehimisht ose heshtazi me kontratë.**
- 2. Nuk merren në konsiderim të metat e një rëndësisë të vogël.**

590.1 Përveç detyrimit të mirëmbajtjes së sendit të dhënë me qira në gjendje të rregullt, qiradhënësi, pas dorëzimit të sendit, ka prapë detyrime që kërkojnë sjellje pozitive të tij. Bëhet fjalë për përgjegjësinë e tij për të metat materiale dhe juridike ndaj sendit të dhënë me qira, e cila ekziston në të gjitha kontratat detyruese, (shih komentin e nenit 103 të LMD). Përgjegjësia e qiradhënësit për të metat materiale nuk u përket pjesëve thelbësore të kontratës për qiranë, për çka është i mundur kufizimi i saj kontraktues apo edhe përjashtimi, (shih komentin e nenit 593 të LMD). Gjithashtu është i mundur edhe zgjerimi kontraktues i përgjegjësisë, (shih komentin e nenit 592 të LMD). Të metat materiale mund të jenë të tilla që e pengojnë shfrytëzimin kontraktues ose shfrytëzimin e rregullt të sendit të marrë me qira.

590.1 (a) Për këto të meta, qiradhënësi përgjigjet vetëm nëse në momentin e lidhjes së kontratës nuk kanë qenë të njohura për qiramarrësin apo nuk kanë mundur të jenë të panjohura (shih komentin e nenit 591 të LMD). Për këtë arsye, kusht i përgjegjësisë së qiradhënësit është ai se kemi të bëjmë me të meta të fshehta, të cilat kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës.

590.1 (b) Lidhur me pasojat juridike, dallohen të metat që e pengojnë shfrytëzimin kontraktues të sendit të marrë me qira dhe të metat të cilat e pengojnë shfrytëzimin e rregullt të sendit të marrë me qira. Nëse me kontratën për qiranë janë parashikuar disa veti të veçanta të sendit të marrë me qira, të cilat nuk janë zakonisht karakteristike për atë send, mungesa e këtyre vetive të veçanta është arsye e mjaftueshme për përgjegjësinë e qiradhënësit. Kështu, sendi mund të jetë pa të meta të cilat e pengojnë shfrytëzimin e rregullt

të tij, por nuk mund të shërbejnë për shfrytëzimin e kontraktuar, për çka konsiderohet se ka të meta. Në anën tjetër, sendi mund të ketë të meta, por nëse kjo nuk e pengon shfrytëzimin e kontraktuar, konsiderohet se ai nuk ka të meta. Nëse vetitë e veçanta të sendit të marrë me qira nuk janë kontraktuar, sendi duhet t'i ketë ato veti që rregullisht supozohen për atë lloj të sendit në kuptim të shfrytëzimit të tij të rregullt.

590.1 (c) Përgjegjësia e qiradhënësit për të metat materiale të sendit të marrë me qira nuk është e kushtëzuar me dijeninë apo mosdijeninë e qiradhënësit për të metat e sendit të marrë me qira. Për këtë arsye, qiradhënësi përgjigjet edhe kur nuk ka qenë në dijeni për këto të meta. Nga kjo mund të nxirret konkludimi se përgjegjësia për të metat materiale nuk është sanksion për qiradhënësin e pandërgjegjshëm, por është mishërim i parimit të ekuivalencës së prestimeve (shih komentin e dispozitës së nenit 7 të LMD). Përgjegjësia është pasojë e mospërmbushjes së detyrimit të dorëzimit të sendit në gjendje të rregullt dhe pamundësisë së shfrytëzimit të sendit të marrë me qira.

590.2 Përgjegjësia e qiradhënësit për të metat materiale nuk ekziston në të gjitha rastet. Qiradhënësi nuk përgjigjet për të metat materiale të sendit të marrë me qira, nëse ato të meta janë të një rëndësie të vogël. Se cilat janë të metat e rëndësisë së vogël, është një çështje faktike e cila varet nga lloji i sendit të marrë me qira dhe shfrytëzimi i kontraktuar. Gjykata me rastin e konstatimit të të metave të rëndësisë së vogël, duhet të kujdeset për rrethanat e rastit konkret dhe zakonet afariste. Çështja e përgjegjësisë së qiradhënësit për të metat e rëndësisë së vogël, megjithatë shtrohet, nëse palët me kontratë e përjashtojnë çdo shmangie nga kontrata, (shih komentin e nenit 592 të LMD). Në këtë rast qiradhënësi përgjigjet edhe për të metat materiale të rëndësisë së vogël.

Neni 591. Të metat për të cilat qiradhënësi nuk përgjigjet

- 1. Qiradhënësi nuk përgjigjet për të metat e sendit të marrë me qira të cilat në momentin e lidhjes së kontratës kanë qenë të njohura për qiramarrësin, ose nuk kanë mundur t'i mbeten të panjohura.**
- 2. Mirëpo, qiradhënësi përgjigjet dhe për te metën e sendit të marrë me qira e cila i ka mbetur e panjohur qiramarrësit për shkak të pakujdesisë së rëndë, në qoftë se ky ka qenë në dijeni për këtë të metë dhe me dashje ka ometuar që për këtë ta njoftojë qiramarrësin.**

591.1 Përveç që nuk përgjigjet për të metat e rëndësisë së vogël (neni 590 par. 2 i LMD), përjashtimisht nga rregulla e përgjithshme mbi përgjegjësinë për të metat materiale, qiradhënësi nuk përgjigjet as për të metat e sendit të marrë me qira, të cilat në momentin e lidhjes së kontratës kanë qenë të njohura për qiramarrësin ose nuk kanë mundur t'i mbesin të panjohura. Bëhet fjalë për atë se qiradhënësi përgjigjet për të metat e sendit të marrë me qira vetëm nëse ato kanë qenë të fshehta, ashtu që qiramarrësi nuk i ka vërejtur në

momentin e lidhjes së kontratës. Konsiderohet se të metat e dukshme materiale kanë qenë të njohura për qiramarrësin ose nuk kanë mundur t'i mbesin të panjohura, nëse ka mundur t'i vërejë ato me një shikim të rëndomtë të sendit të marrë me qira.

591.1 (a) Përgjegjësia e qiradhënësit është e kushtëzuar edhe me ekzistimin e të metave të fshehta, të cilat qiramarrësi nuk i ka zbuluar në momentin e lidhjes së kontratës. Nëse në momentin e lidhjes së kontratës qiramarrësit i kanë qenë të njohura të metat materiale në sendin e marrë me qira dhe ai, me gjithë këtë të metë, e ka lidhur kontratën, qiradhënësi nuk do të përgjigjet. Qiramarrësit e meta i është e njohur, nëse ai vetë e ka vënë re atë apo qiradhënësi e ka njoftuar për të. Bëhet fjalë për atë se qiramarrësi lidh kontratë sepse sendi i marrë me qira i duhet pavarësisht nga e meta e gjetur, duke u supozuar se është pajtuar me ekzistimin e saj për shkak të zbritjes së qirasë.

591.1 (b) Me rastin e konstatimit të të metave, për të cilat qiradhënësi nuk përgjigjet, përveç kriterit subjektiv, merret në konsiderim edhe kriteri objektiv, d.m.th., sipas rrethanave konkrete, qiramarrësi ka qenë i detyruar ta vërejë të metën. Me shikimin e rëndomtë (të zakonshëm) të sendit të marrë me qira, i cili bëhet përpara apo në momentin e lidhjes së kontratës, qiramarrësi duhet të veprojë sipas kriterit objektiv të kujdesit të duhur (të një personi të kujdesshëm me dije mesatare dhe me përvojën e personit të profesionit dhe lëmit të njëjtë, si përfaqësues). Nëse përfaqësuesi e ka bërë shikimin në mënyrë sipërfaqësore, dhe nuk ka vërejtur të metat të cilat me një shikim të rëndomtë nuk kishin mundur t'i jenë të panjohura, qiradhënësi lirohet nga përgjegjësia. Bëhet fjalë për çështje faktike, të cilën gjykata e vërteton, duke marrë parasysh natyrën e sendit të marrë me qira, profesionalizmin e bashkëkontraktuesve dhe rrethanat e tjera relevante. Kështu, p.sh., qiramarrësi i tokës bujqësore duhet ta shikojë tokën me kujdesin e personit që merret vesh në bujqësi, gjë që nëkupton dijen dhe përvojën e bujikut.

591.1 (c) Me rastin e marrjes me qira të anijes, përgjegjësia e qiradhënësit është më e ashpër, sepse ai nuk mund të lirohet nga përgjegjësia as atëherë kur qiramarrësi nuk ka vepruar sipas kriterit të kujdesit të domosdoshëm me rastin e një shikimi të rregullt. Kështu, për dëmin e shkaktuar për të metat që e bëjnë anijen të paaftë apo e zvogëlojnë aftësinë e saj për shfrytëzimin e kontraktuar apo të zakonshëm dhe që kanë ekzistuar në momentin e dorëzimit të anijes qiramarrësit, përgjigjet qiradhënësi, nëse nuk argumenton se këto të meta nuk ka mundur t'i zbulojë me gjithë kujdesin e duhur.

591.2 Lirimi ligjor i qiradhënësit nga përgjegjësia e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 591 të LMD nuk është absolute; ekziston një përjashtim. Në të vërtetë, edhe përkundër asaj se të metat e sendit të marrë me qira në momentin e lidhjes së kontratës nuk kanë mundur të mbesin të panjohura për qiramarrësin, qiradhënësi përgjigjet nëse ka ditur për këtë të metë dhe qëllimisht ka lënë pa e njoftuar për të qiramarrësin. Përgjegjësia e qiradhënësit do të jetë e zgjeruar, nëse ai, përveç kësaj, disponon edhe njohuri dhe përvojë të cilat qiramarrësi nuk i ka, (p.sh., marrja me qira e pajisjeve informative). Ky lloj i përgjegjësisë është pasojë e qëllimit të keq të qiradhënësit që të heshtë për të metat e sendit, gjë që

është në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë (neni 4 i LMD). Konsiderohet se qiradhënësi, i cili ka ditur për të metat dhe qëllimisht nuk e ka njoftuar qiramarrësin, e ka mbajtur qiramarrësin në lajthim në paragjykimin e tij lidhur me gjendjen e sendit të marrë me qira. Në marrëdhëniet detyrimore askush nuk mund t'i referohet pandërgjegjshmërisë së vet (**mala fidae**), për çka qëllimi i qiradhënësit përbën një shkallë më të rëndë të fajësisë sesa mosvëmendja e vrazhdë e qiramarrësit.

Neni 592. Zgjerimi i përgjegjësisë për të metat materiale

Qiradhënësi përgjigjet për të gjitha të metat e sendit të marrë me qira, ne qoftë se ka pohuar se ai nuk ka kurrfarë të metash.

592 Dispozita e nenit 592 të LMD e zgjeron përgjegjësinë e qiradhënësit për të metat materiale të sendit të marrë me qira në rastin kur qiradhënësi ka pohuar shprehimisht se ai nuk ka kurrfarë të metash (**dieta et promissa**). Qiradhënësi që ka pohuar se sendi i dhënë me qira nuk ka kurrfarë të metash, përgjigjet për të gjitha të metat, pavarësisht nga ajo se a e pengojnë ose jo ato shfrytëzimin e kontraktuar apo të rregullt dhe pavarësisht nëse të metat e tilla janë vërejtur ose jo. Pandërgjegjshmëria e qiradhënësit mund të jetë e rëndësishme për vëllimin, por jo edhe bazë e përgjegjësisë, (p.sh., qiradhënësi disponon një dije dhe përvojë të cilën qiramarrësi nuk e ka në raport me sendin e marrë me qira). Arsyeja e zgjerimit të përgjegjësisë së qiradhënësit qëndron në besimin e qiramarrësit në pohimin e tij, për çka ai ka lënë pa vepruar sipas kriterit të kujdesit të duhur me rastin e shikimit të rregullt të sendit të marrë me qira apo edhe, përkundër që ka bërë kontrollin e rregullt, është mbështetur në pohimin e qiradhënësit. Përveç kësaj, garancia e një shkalle të lartë e qiradhënësit e mbështetur në pohimin se sendi i marrë me qira nuk ka të meta, eventualisht mund të ndikojë edhe në caktimin e shumës së qirasë, prandaj është e nevojshme që qiramarrësi të mbrohet në mënyrë plotësuese.

Neni 593. Përjashtimi kontraktues ose kufizimi i përgjegjësisë

- 1. Përgjegjësia për të metat materiale të sendit të marrë me qira mund të përjashtohet ose të kufizohet me kontratë.**
 - 2. Dispozita e kontratës me të cilën kjo përgjegjësi përjashtohet ose kufizohet është e pavlefshme në qoftë se qiradhënësi ka qene ne dijeni për të metat dhe me dashje ka ometuar që për to ta njoftojë qiramarrësin, ose poqëse e meta është e atillë që bën të pamundur përdorimin e sendit të marrë me qira si dhe atëherë kur qiradhënësi ka imponuar këtë dispozitë duke shfrytëzuar pozitën e vet monopoliste.**
-

593.1 Autonomia e vullnetit, dispozitat për përgjegjësin materiale të qiradhënësit lejojnë që të kontraktohet kufizimi i përgjegjësisë së qiradhënësit në mënyra të ndryshme dhe në

vëllim të ndryshëm. Për këtë arsye, bashkëkontraktuesit janë të lirë ta kontraktojnë ndryshe çështjen e përgjegjësisë së qiradhënësi dhe që kontrata për qiranë të mos ndryshojë esencën e saj. Me këtë rast duhet pasur kujdes që kjo bëhet brenda kufijve të lirisë së rregullimit të marrëdhënieve detyruese, (shih komentin e nenit 2 të LMD). Në këtë rast qiramarrësi e merr sendin në gjendjen në të cilën gjendet, por nëse tregohet se sendi ka të meta të caktuara, nuk do të mund t'i përdorte mjetet juridike të cilat zakonisht i janë në dispozicion, (shih komentin e nenit 595 të LMD). Konsiderohet se qiramarrësi është pajtuar në përjashtimin apo kufizimin e përgjegjësisë në këmbim të zbritjes së qirasë apo të ndonjë përfitimi tjetër.

593.2 Pavarësisht na qëndrimi parimor për mundësinë e përjashtimit kontraktues ose kufizimit të përgjegjësisë së qiradhënësit për të metat materiale, me dispozitën detyruese të paragrafit 2 të nenit 593 janë rregulluar tri raste, në të cilat dispozitat e kontratës për përjashtimin ose kufizimin e përgjegjësinë së qiradhënësit janë të pavlefshme:

a) Nëse qiradhënësi ka qenë në dijeni për të metat dhe me qëllim të keq i ka fshehur ato dhe me dashje ka lënë pa e njoftuar për to qiramarrësin;

b) Nëse e meta është e atillë që bën të pamundur përdorimin e sendit të marrë me qira. Qëllimi (kauza) ekonomik i kontratës për qiranë është shfrytëzimi, për çka edhe lidhet kjo kontratë. Në rast të kontraktimit të klauzolës me të cilën tërësisht bëhet i pamundur shfrytëzimi i sendit të marrë me qira, do të humbiste edhe qëllimi ekonomik i kësaj kontrate;

c) Nëse dispozitën për përjashtimin ose kufizimin e përgjegjësisë së qiradhënësit, qiradhënësi e ka imponuar duke shfrytëzuar pozitën e vet monopoliste. Konsiderohet se në këtë rast qiramarrësit, si palës më të dobët, i është imponuar kundër vullnetit të tij dispozita për mospërgjegjësinë e qiradhënësit. Në këtë mënyrë është konkretizuar parimi i barazisë së pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve, (shih komentin e dispozitës së nenit 3 të LMD). Se a është shfrytëzuar qiradhënësi me pozitën monopoliste të qiramarrësit është një çështje faktike që vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit. Me këtë rast duhet marrë parasysh në mos qiradhënësi i ka bërë ndonjë favor qiramarrësit, siç është zbritja e çmimit, kushtet më të volitshme të pagesës etj.

Neni 594. Njoftimi i qiradhënësit mbi të metat dhe rreziqet

- 1. Qiramarrësi ka për detyrë ta njoftojë qiradhënësin pa shtyrje të panevojshme për secilën të metë të sendit të marrë me qira që do të tregohet gjatë kohës së qirasë, përveç në qoftë se qiradhënësi ka ditur për të metën.**
- 2. Ai ka për detyrë gjithashtu ta njoftojë qiradhënësin për çdo rrezik të paparashikuar që do të kanosej gjatë kohës së qirasë, sendit të marrë me qira për të mundur të marrë masa të nevojshme.**

3. Qiramarrësi i cili nuk e njofton qiradhënësin mbi shfaqjen e të metës, ose mbi rrezikun e lindur për të cilën ky nuk ka ditur humb të drejtën e shpërblimit të dëmit që do të pësonte për shkak të ekzistimit të të metës ose rrezikut të paraqitur për sendin e marrë me qira dhe ka për detyrë ta shpërblejë dëmin që do ta pësonte qiradhënësi për këtë arsye.

594.1 Me përmbushjen e detyrimit të vet kontraktues të dorëzimit të sendit, i cili është objekt i qirasë, qiradhënësi humb mbikëqyrjen ndaj sendit ndërsa qiramarrësi fiton posedimin e tij. Qiramarrësi është i detyruar që të silltet ndaj sendit të marrë me qira në harmoni me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë (neni 4 i LMD) dhe parimit të veprimit me kujdesin e një ekonomisti të mirë ose të një shtëpiaku të mirë (neni 5 i LMD). Kjo nënkupton detyrimin e qiramarrësit për njoftim, si për mbrojtjen e interesave të qiradhënësit, ashtu edhe për mbrojtjen e interesave të veta të shfrytëzimit të sendit të marrë me qira. Arsyeja e mbrojtjes së interesave të qiradhënësit qëndron në faktin se qiradhënësi mban përsipër rrezikun në rast të shkatërrimit apo dëmtimit të sendit të marrë me qira gjatë tërë kohëzgjatjes së raportit të qiradhënies. Për këtë arsye, qiramarrësi është i detyruar që ta njoftojë qiradhënësin për secilën të metë të sendit të marrë me qira që do të shfaqej gjatë kohës së qirasë. Ky detyrim i qiramarrësit nuk ekziston, nëse qiradhënësi ka pasur dijeni për këto të meta.

594.2 Qiramarrësi ka për detyrë që ta njoftojë qiradhënësin për të metat dhe rreziqet e paparashikuara që do ta kanosnin sendin e marrë me qira gjatë kohës së qirasë, sepse qiradhënësi më nuk mund të marrë dijeni për ekzistimin e të metave të cilat eventualisht paraqiten gjatë kohës së qirasë (p.sh., fenomeni i lagështisë ose shpenzimi tej mase i rrymës elektrike në lokalitë të marrë me qira, dëmtimi i pullazit nga të reshurat atmosferike në shtëpinë e marrë me qira, kryerja e punëve ndërtimore në afërsi të objektit të marrë me qira etj.). Pa njoftim paraprak nga ana e qiramarrësit, qiradhënësi nuk do të mund të reagojë me kohë për ta mënjanuar të metën e shfaqur apo rrezikun e kanosur.

594.3 Mosnjoftimi është veprim i dëmshëm negativ dhe tërheq dy pasoja juridike për qiramarrësin. Së pari, ai humb të drejtën e shpërblimit të dëmit, të cilin do ta pësonte për shkak të ekzistimit të së metës (shpërblim ky që do t'i takonte sipas nenit 595 të LMD), dhe, së dyti, është i detyruar që ta shpërblejë dëmin të cilin, për shkak të kësaj, do ta pësonte qiradhënësi.

Neni 595. Të drejtat e qiramarrësit kur sendi ka ndonjë të metë

1. Në qoftë se sendi i marrë me qira në momentin e dorëzimit ka ndonjë të metë që nuk mund të evitohet, qiramarrësi mundet sipas dëshirës së vet, ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e çmimit të qirasë.

2. Kur sendi ka ndonjë të metë që nuk mund të evitohet pa ndërlikime të mëdha për qiramarrësin, ndërsa dorëzimi i sendit në afatin e caktuar nuk ka qenë pjesë esenciale e kontratës, qiramarrësi mund të kërkojë nga qiradhënësi ose evitimin e të metës në afatin plotësues, ose zbritjen e çmimit të qirasë.
3. Në qoftë se qiradhënësi nuk e eviton të metën në afatin e ri plotësues që ia ka caktuar qiramarrësi, qiramarrësi mund ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e çmimit të qirasë.
4. Sidoqoftë, qiramarrësi ka të drejtë në shpërblimin e dëmit.

595.1 Kushtet e përgjithshme të ekzistimit të përgjegjësive së qiradhënësit për të metat materiale janë të rregulluara me dispozitën e nenit 590 të LMD, kurse zgjerimi i kësaj përgjegjësie në nenin 592 të LMD, (duhet shikuar gjithashtu edhe nenin 593 të LMD që ka të bëjë me përjashtimin kontraktues ose kufizimin e përgjegjësive). Ekzistimi i të metave materiale pengon shfrytëzimin kontraktues të sendit të marrë me qira, për çka çrregullohet parimi i ekuivalencës së prestimeve, (shih komentin e dispozitës së nenit 7 të LMD). Dispozitat e këtij neni rregullojnë të drejtat e qiramarrësit në rast të të metave të sendit të marrë me qira, përkatësisht përmbushjes së kushteve për përgjegjësinë e qiradhënësit dhe përfaqësojnë konkretizim të dispozitës së përgjithshme për përgjegjësinë për të metat materiale të përmbushjes (neni 103 i LMD) dhe mishërim të parimit të ekuivalencës së prestimeve. Ato zbatohen të të metat në momentin e dorëzimit të sendit të marrë me qira, por edhe kur e meta lind gjatë kohës së qirasë dhe në rastin kur sendi nuk ka ndonjë veti që, sipas kontratës ose zakonisht, duhet ta ketë apo e humb gjatë raportit të qiradhënies. Janë të parashikuara disa të drejta të qiramarrësit, si: a) zgjidhja e kontratës, b) zbritja e çmimit të qirasë, c) mënjanimi i të metave dhe ç) shpërblimi i dëmit. Me këtë rast bëhet dallimi midis ekzistimit të të metave të evitueshme dhe atyre të paevitueshme.

595.2 E meta është e paevitueshme, nëse nuk mund të mënjanohet pa ndërlikime të mëdha për qiramarrësin, ndërsa kur dorëzimi i sendit në afatin e caktuar nuk ka qenë pjesë esenciale e kontratës, qiramarrësi mund të kërkojë nga qiradhënësi ose mënjanimin e të metës në afatin plotësues, ose zbritjen e çmimit të qirasë. Kontrata zgjidhet me deklarimin e njëanshëm të vullnetit të qiramarrësit dhe sipas rregullit vepron **ex nunc**, sepse qiramarrësi veç e ka shfrytëzuar sendin e marrë me qira prandaj nuk është i mundur kthimi në gjendjen e mëparshme (**restitutio in integrum** – shih dispozitën e nenit 90 të LMD). Nëse qiramarrësi dëshiron, me gjithë ekzistimin e të metave të paevitueshme, ta mbajë në fuqi kontratën për qiranë, në vend të zgjidhjes së kontratës, mund të kërkojë zbritjen e qirasë. Nëse bëhet fjalë për një të metë që mund të mënjanohet pa ndërlikime të mëdha për qiramarrësin, qiramarrësi nuk mund ta zgjidhë menjëherë kontratën, përveç përjashtimisht, kur dorëzimi i sendit ka qenë element qenësor i kontratës. Qiramarrësi mund t’ia japë në këtë rast qiradhënësit një afat plotësues për mënjanimin e kësaj të mete. Afati plotësues për mënjanimin e të metave të sendit të marrë me qira nuk është përcaktuar me dispozita

ligjore, sepse kjo është çështje faktike, e cila varet nga rrethanat konkrete (varësisht prej natyrës së sendit, të metës së evidentuar dhe të nevojshme për mënjanim, mundësisë së mënjanimiit sa ma të shpejtë të kësaj të mete etj.).

595.3 Nëse qiramarrësi pajtohet që qiradhënësi ta mënjanojë të metën e sendit të marrë me qira dhe për këtë arrihet marrëveshja për afatin plotësues të mënjanimiit të saj, kurse qiradhënësi nuk e mënjanon të metën e sendit brenda këtij afati, qiramarrësi mund ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e qirasë.

595.4 Të gjitha të drejtat e përmendura në rastet e të metave materiale të sendit të marrë me qira qiramarrësi mund t'i realizojë së bashku me të drejtën e shpërblimit të dëmit. Këtë të drejtë qiramarrësi e ka gjithsesi kur, për shkak të të metave, e ka pësuar ndonjë dëm, pavarësisht nëse bëhet fjalë ose jo për të metat e evitueshme apo të paevitueshme, respektivisht për të meta në momentin e dorëzimit të sendit i cili është objekt i qirasë ose të metave të cilat kanë lindur gjatë kohëzgjatjes së qirasë dhe kur sendi nuk i ka cilësitë e kontraktuar apo cilësitë e rëndomta.

Neni 596. Kur e meta paraqitet gjatë qirasë dhe kur sendi nuk ka veçori të kontraktuar ose të zakonshme

- 1. Dispozitat e nenit paraprak aplikohen edhe në rastin kur gjatë qirasë paraqitet ndonjë e mete në sendin e marre me qira.**
- 2. Ato aplikohen edhe në rastet kur sendi i marrë me qira nuk ka ndonjë veçori që sipas kontratës ose sipas praktikës duhet të kishte, apo kur kjo veçori humbë gjatë qirasë.**

596.1 Në paragrafin 1 të nenit 596 të LMD, parashikohet zbatimi i dispozitës së nenit 595 të LMD edhe në rastin kur, gjatë kohëzgjatjes së qirasë, paraqitet ndonjë e metë në sendin e marrë me qira. Prandaj duhet theksuar vetëm atë se e meta, pavarësisht a paraqitet në momentin e dorëzimit të sendit nga ana e qiradhënësit apo gjatë kohëzgjatjes së raportit të qirasë mes qiradhënësit dhe qiramarrësit, të drejtat e qiramarrësit janë të mbrojtura me dispozitën e nenit 595 të LMD.

596.2 E njëjta gjë vlen edhe në rastin kur sendi i marrë me qira nuk ka ndonjë veçori që, sipas kontratës ose sipas praktikës, duhet ta kishte apo kur kjo veçori e sendit, të cilën e kishte në momentin e dorëzimit të tij nga ana e qiradhënësi, humb gjatë kohëzgjatjes së raportit të qirasë.

Neni 597. Përgjegjësia e qiradhënësit për të metat juridike

- 1. Kur dikush i tretë pretendon që në sendin e marrë me qira, ose në ndonjë pjesë të tij të ushtrorë ndonjë të drejtë dhe i drejtohet me kërkesë të vet qiramarrësit, si dhe në qoftë se arbitrarisht e merr sendin nga qiramarrësi, ky ka për detyrë ta njoftojë për këtë qiradhënësin, përveç nëse ky është tanimë në dijeni për këtë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin.**
- 2. Në qoftë se vërtetohet se personit të tretë i takon ndonjë e drejtë e cila përjashton fare të drejtën e qiramarrësit në përdorimin e sendit, kontrata e qirasë zgjidhet vetvetiu në bazë të ligjit, ndërsa qiradhënësi ka për detyrë që qiramarrësit t'i shpërblejë dëmin e pësuar për këtë arsye.**
- 3. Në rastin kur me të drejtën e personit të tretë vetëm kufizohet e drejta e qiramarrësit, ky mundet sipas dëshirës së vet ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e qirasë, e në çdo rast shpërblimin e dëmit.**

597.1 Në të gjitha kontratat me shpërblim të së drejtës së detyrimeve, përveç për të metat materiale, kontraktuesi përgjigjet edhe për të metat juridike të përmbushjes dhe është i detyruar që palën tjetër ta mbrojë nga të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë, me të cilat e drejta e tij do të përjashtohet apo kufizohet, (shih komentin e dispozitës së nenit 103 të LMD). Me këtë dispozitë ligjore rregullohet mbrojtja e qiramarrësit nga evikcioni dhe nga marrja arbitrare e sendit të marrë me qira. Prezumimi për aplikimin e këtyre dispozitave qëndron kur një i tretë pretendon ndonjë të drejtë mbi sendin e marrë me qira ose mbi ndonjë pjesë të tij ose e merr në mënyrë arbitrare sendin nga qiramarrësi.

597.1 (a) Kur një i tretë pretendon ndonjë të drejtë mbi sendin e marrë me qira apo mbi një pjesë të atij sendi dhe i drejtohet me kërkesë qiramarrësit, apo kur në mënyrë arbitrare ia merr sendin qiramarrësit, qiramarrësi është i detyruar që për këtë ta njoftojë qiradhënësin, të cilit t'i bëjë thirrje t'i ofrojë mbrojtje. Njoftimi nuk do të jetë i nevojshëm në rastet kur kjo i është e njohur qiradhënësit. Mosnjoftimi mund ta ketë për pasojë përgjegjësinë e qiramarrësit për dëmin të cilin mund ta pësojë qiradhënësi që nuk ka pasur dijeni për shqetësimin juridik apo faktik.

597.1 (b) Te kontrata për qiranë, me termin evikcion konsiderohet akti juridik i palës së tretë, me të cilin ajo, në bazë të së drejtës së vet, përjashton ose kufizon të drejtën e qiramarrësit në shfrytëzimin e sendit të marrë me qira. Qiradhënësi është i detyruar t'i hyjë kontestit me personin e tretë, i cili e shqetëson juridikisht qiramarrësin. Nëse lë pa bërë këtë ose e humb kontestin, të drejtat e qiramarrësit varen nga natyra e së drejtës të cilën e disponon pala e tretë (evikcioni i plotë ose i pjesshëm).

597.1 (c) Në mënyrë që qiramarrësi të ketë të drejtën e mbrojtjes nga evikcioni, e meta juridike duhet të ekzistojë para dorëzimit të sendit të marrë me qira qiramarrësit. Qiramarrësi nuk mund të kërkojë mbrojtje nga qiradhënësi, nëse kjo e drejtë është fituar më vonë (p.sh., kur një i tretë pretendon se ka të drejtën e servitutit në bazë të kontratës me qiradhënësin

në kohën kur sendi tashmë i është dorëzuar qiramarrësit). Kur bëhet fjalë për tjetërsimin e sendit i cili tashmë është dhënë me qira, nuk zbatohen dispozitat e këtij neni por dispozitat e nenit 606 të LMD.

597.2 Evikcioni i plotë ekziston kur vërtetohet se personit të tretë i takon ndonjë e drejtë e cila, sipas natyrës së saj, është e tillë që e përjashton tërësisht të drejtën e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit të marrë me qira (p.sh., kur një i tretë e ka të drejtën pronësore mbi sendin e marrë me qira dhe dëshiron ta shfrytëzojë vetë atë send). Duke qenë se me evikcionin e plotë qiramarrësit i pamundësohet shfrytëzimi i sendit të marrë me qira, qëllimi i kontratës për qiranë nuk arrihet. Për këtë shkak, në këto raste kontrata zgjidhet **ipso jure** dhe vendimi eventual gjyqësor nuk ka karakter konstitutiv, por deklarativ. Qiramarrësi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit që e ka pësuar, sepse nuk ka mundur ta shfrytëzojë sendin e marrë me qira, kurse qiradhënësi është i detyruar që këtë dëm ta shpërblejë.

597.3 Evikcioni i pjesshëm ekziston kur vërtetohet se personit të tretë i takon ndonjë e drejtë e cila, sipas natyrës së saj, është e tillë që nuk e përjashton të drejtën e qiramarrësit për ta shfrytëzuar sendin e marrë me qira, por e kufizon këtë të drejtë (p.sh., kur një i tretë ka të drejtën e kalimit nëpër tokën bujqësore të marrë me qira, në bazë të servitutit të themeluar më herët ose ka të drejtë vetëm mbi njërin pjesë të sendit të marrë me qira). Në atë rast qiramarrësi e gëzon të drejtën e zgjedhjes – ta zgjidhë kontratën ose të kërkojë zbritjen e qirasë. Kontrata, pra, nuk zgjidhet sipas vet ligjit, siç është rasti te evikcioni i plotë, por me deklaratë të qiramarrësit për zgjidhjen e kontratës. Nëse vendos ta lërë në fuqi kontratën, mund të kërkojë zbritjen e qirasë në përpjesëtim me vëllimin e kufizimit të shfrytëzimit të sendit të marrë me qira. Pavarësisht nga zgjedhja e tij, atij gjithnjë i takon edhe e drejta e shpërblimit të dëmit³⁵⁷.

KREU 3

DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

Neni 598. Përdorimi i sendeve sipas kontratës

- 1. Qiramarrësi ka për detyrë ta përdorë sendin si ekonomist i mire respektivisht si shtëpiak i mirë.**
- 2. Ai mund ta përdorë vetëm ashtu sikundër është caktuar me kontratë ose me destinimin e sendit.**
- 3. Ai përgjigjet për dëmin e paraqitur nga përdorimi i sendit të marrë me qira në kundërshtim me kontratën ose me destinimin e tij, pavarësisht nëse a e ka përdorur sendin ai ose ndonjë person që punon me urdhër të tij, ose ndonjë person tjetër të cilit ai ia ka bërë të mundur përdorimin e sendit.**

357 Vendimi i Gjykatës Supreme të RK Rev. nr. 1350/91 i datës 17 tetor 1991,

598.1 Kontrata për qiranë është kontratë e dyanshme detyruese dhe detyrimet, përveç në anën e qiradhënësit, ekzistojnë edhe në anën e qiramarrësit. Detyrimet themelore të qiramarrësit, të cilat i përmban kontrata për qiranë, janë: a) shfrytëzimi i sendit të marrë me qira sipas kontratës dhe destinimit të sendit (neni 598 i LMD), b) pagesa e qirasë (neni 600 i LMD) dhe kthimi i sendit të marrë me qira pas mbarimit të qirasë (neni 602 të LMD). Shfrytëzimi i sendit para së gjithash është e drejtë e qiramarrësit, të cilën ai e fiton në momentin kur qiradhënësi, duke përmbushur detyrimin e kontraktuar, ia dorëzon sendin e marrë me qira. Nga momenti i dorëzimit të sendit, e drejta e qiramarrësit nuk ka më karakter të kërkesës që e ka pasur gjer atëherë, por shndërrohet në të drejtë të shfrytëzimit. Me shfrytëzimin e sendit të marrë me qira realizohet qëllimi i qirasë, por kjo nuk do të thotë se qiramarrësi është i detyruar ta shfrytëzojë sendin. Në të vërtetë, kontrata për qiranë nuk e ndryshon vetinë e vet juridike, nëse qiramarrësi nuk e shfrytëzon sendin e marrë me qira, por plotëson detyrime të tjera kontraktuese. Për këtë arsye, me këtë dispozitë ligjore përcaktohet detyrimi i qiramarrësit lidhur me mënyrën dhe vëllimin e shfrytëzimit të saj, por jo edhe detyrimi i shfrytëzimit të vetë asaj. Mirëpo, ekzistojnë rrethana në të cilat qiramarrësi është i detyruar ta shfrytëzojë sendin e marrë me qira: a) kur kjo është kontraktuar shprehimisht (p.sh., qiramarrësi është i detyruar ta vozisë mjetin e marrë me qira dhe për çdo muaj të kalojë një numër të caktuar kilometrash; b) kur kjo rrjedhë nga natyra e vetë sendit (p.sh., lopa e marrë me qira duhet të milet për të mos u sëmure); c) kur kjo është përcaktuar me dispozita urdhëruese (p.sh., me rastin e marrjes me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore lidhur me nenin 10 të Ligjit për Kooperativat)³⁵⁸.

598.2 Duke marrë parasysh se shfrytëzimi i sendit të marrë me qira është para së gjithash e drejtë e qiramarrësit, kjo dispozitë ligjore nuk ka për qëllim imponimin e shfrytëzimit të sendit të marrë me qira, por vendosjen e kornizave brenda të cilave mund të lëvizë e drejta e shfrytëzimit. Qëllimi i kësaj dispozite është ruajtja e sendit të marrë me qira, në mënyrë që, pas skadimit të qirasë, ai të mund ti kthehet i padëmtuar qiradhënësit. Kur e shfrytëzon sendin e marrë me qira, qiramarrësi i ka dy detyrime: që këtë ta bëjë si shtëpiak i mirë, (njeri me vëmendje mesatare të një mjedisi të caktuar në kryerjen e punëve të caktuara), përkatësisht si ekonomist i mirë, (ekonomist me vëmendje mesatare në kryerjen e detyrave të fushëveprimit të tij)³⁵⁹ dhe në harmoni me destinimin e sendit, (në këtë drejtim duhet shikuar edhe komentimi i dispozitës së nenit 8 të LMD për detyrat e përmbushjes së detyrimeve). Vëllimi dhe mënyra e shfrytëzimit të sendit të marrë me qira mund të jetë i përcaktuar me kontratë dhe, në mungesë të një dispozite të tillë kontraktuese, ato përcaktohen sipas destinimit të sendit. Qiradhënësi në çdo moment mund të kontrollojë nëse qiramarrësi është duke e shfrytëzuar ose jo sendin e marrë me qira në harmoni me kontratën.

598.3 Nëse qiramarrësi e shfrytëzon sendin e marrë me qira në kundërshtim me kontratën apo destinimin e sendit dhe nëse nuk e përdor si shtëpiak i mirë apo ekonomist i mirë, ai i përgjigjet qiradhënësit për dëmin që mund të shkaktohet lidhur me këtë. Për dëmin

358 Česić – Gorenc – Kačer Momčinović – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona o Obveznm Odnosima, Zagreb, 2005 faqe 813

359 Shih komentin e dispozitës së nenit 5 të LMD.

e shkaktuar për pasojë të një shfrytëzimi të tillë, qiramarrësi përgjigjet edhe atëherë kur sendin e ka shfrytëzuar ndonjë person tjetër sipas urdhrin të tij, nënqiramarrësi apo ndonjë person tjetër të cilit ia ka mundësuar shfrytëzimin e sendit. Qiradhënësi nuk ka nevojë ta dëshmojë fajin e qiramarrësit për dëmin e shkaktuar, por është i nevojshme argumentimi i shkaktimit të dëmit i cili ka ndodhur për shkak të shfrytëzimit të sendit në kundërshtim me kontratën apo me destinimin e tij.

Neni 599. Denoncimi për shkak të përdorimit në kundërshtim me kontratën

Ne qoftë se qiramarrësi edhe pas paralajmërimit të drejtuar nga qiradhënësi, e përdore sendin në kundërshtim me kontratën ose me destinimin e tij, ose e lënë pas dore mirëmbajtjen e tij, kështu që ekziston rreziku i dëmit të konsideruar për qiradhënësin, ky mund ta denoncoj kontratën pa e dhënë afatin e denoncimit.

599 Me dispozitën e këtij neni rregullohet e drejta e qiradhënësit që të denoncojë kontratën pa e dhënë afatin e denoncimit, për shkak të shfrytëzimit të sendit në kundërshtim me kontratën apo destinimin e tij. Me kushtin që të ekzistojë rreziku i dëmit të konsiderueshëm për qiradhënësin, si arsye për denoncimin e kontratës vihen në dukje këto sjellje të qiramarrësit: a) shfrytëzimi i sendit në kundërshtim me kontratën; b) shfrytëzimi i sendit në kundërshtim me destinimin e tij; c) lënia pas dore e mirëmbajtjes së sendit, (p.sh., qiramarrësi nuk e përmbush pjesën e detyrimit të tij të mirëmbajtjes së sendit të parashikuar nga neni 587 par. 1 i LMD ose nuk e njofton qiradhënësin për nevojën e riparimeve në harmoni me dispozitën e nenit 587 par. 4 të LMD ose në kontratë është parashikuar që ai t'i heqë në tërësi shpenzimet e mirëmbajtjes).

599. (a) Për rrezikun e shkaktimit të dëmit të konsiderueshëm nuk është e nevojshme që ky dëm të jetë shkaktuar, por është e mjaftueshme që të ekzistojë vetëm rreziku për shkaktimin e tij. Në cilat raste, për shkak të arsyeve të përmendura, ekziston rreziku i dëmit të konsiderueshëm, është një çështje faktike që varet nga rrethanat e rastit konkret. Ekzistimi i rrezikut të shkaktimit të dëmit të një intensiteti të vogël nuk përbën arsye të mjaftueshme për zgjidhjen e kontratës.

599. (b) Denoncimi i shfrytëzimit të sendit në kundërshtim me kontratën mund ta goditë dukshëm qiramarrësin. Për këtë arsye, për mbrojtjen e interesave të qiramarrësit, qiradhënësi duhet paraprakisht ta paralajmërojë qiramarrësin që të pushojë nga shfrytëzimi i sendit në kundërshtim me kontratën apo destinimin. Vetëm nëse qiramarrësi, edhe pas paralajmërimit, vazhdon ta përdorë sendin në të njëjtën mënyrë, qiradhënësi mund ta zgjidhë kontratën pa dhënien e afatit të denoncimit, (shih komentin e dispozitës së nenit 612 të LMD).

599. (c) Njësoj ndodh edhe te qiraja e lokaleve afariste, kur qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën për qiranë në çdo kohë, pavarësisht nga dispozitat ligjore apo kontraktuese për

kohëzgjatjen e qirasë, nëse qiramarrësi, edhe pas paralajmërimit me shkrim nga ana e qiradhënësit, e shfrytëzon lokalit afarist në kundërshtim me kontratën apo shkakton dëm të konsiderueshëm, duke shfrytëzuar sendin pa kujdesin e duhur.

Neni 600. Pagimi i qirasë

- 1. Qiramarrësi ka për detyrë ta paguajë qiranë në afatet e caktuara me kontratë ose me ligj e në mungesë të kontratës dhe të ligjit, ashtu siç praktikohet në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit.**
- 2. Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe ose në vendin e dorëzimit të sendit nuk praktikohet ndryshe, qiraja paguhet për çdo gjashtë (6) muaj kur sendi është dhënë me qira për një ose për disa vjet e në qoftë se është dhënë për një kohë më të shkurtër, atëherë pasi të ketë kaluar kjo kohë.**

600.1 Detyrimi i pagesës së qirasë është njëri nga përbërësit thelbësorë të kontratës për qiranë, së bashku me detyrimin e qiradhënësit që të dorëzojë sendin dhe pas kësaj të përmbahet nga cenimi i të drejtës së qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit të marrë me qira. Duke marrë parasysh këtë detyrim, kontrata për qiranë është një kontratë e dyanshme detyruese dhe me pagesë dhe, sipas kësaj, dallohet nga kontrata për huapërdorjen. Qiraja është shpërblimi të cilin qiramarrësi ia paguan qiradhënësit për shfrytëzimin e sendit të marrë me qira, për çka ajo nuk fillon në momentin e lidhjes së kontratës, por vetëm atëherë kur qiradhënësi ia dorëzon sendin qiramarrësit³⁶⁰. Qiraja gjithnjë përfaqëson një vlerë të caktuar pronësore, e cila më së shpeshti shprehet me të holla, por mund të përbëhet edhe nga dorëzimi i sendeve të tjera, (p.sh., dorëzimi i një sasive të caktuar të fryteve të sendit të marrë me qira). Sasia e qirasë gjithnjë duhet të jetë e caktuar; ajo mund të caktohet paraprakisht me një shumën fikse ose në pjesë alikuote nga fitimi i realizuar, (p.sh. ¼ e të hyrave nga toka bujqësore e marrë me qira).

600.1 (a) Palët kontraktuese, si rregull, vetë i caktojnë afatet e pagesës së qirasë. Në këtë rast mund të kontraktojnë pagesën e qirasë në këste të barabarta përpara apo pas periudhave të përcaktuara (muajore, tremujore, gjysmëvjetore, vjetore) ose përnjëherë, në fillim ose pas skadimit të qirasë.

600.1 (b) Nëse afatet e pagesës së qirasë të caktuara me kontratë nuk respektohen, qiraja paguhet ashtu siç është parashikuar me dispozita të veçanta për atë lloj të qirasë. Në rastin kur me dispozita të veçanta nuk janë parashikuar afatet e pagesës së qirasë, zbatohen praktikatat e vendit ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit.

600.2 Nëse palët kontraktuese kanë lënë pa e kontraktuar kohën e pagesës së qirasë dhe kjo nuk është e rregulluar as me ligj të veçantë apo me praktikatat e vendit ku i është dorëzuar sendi qiramarrësit, atëherë gjen shprehje zbatimi i paragrafit 2 të nenit 600 të LMD, i cili

360 Shih aktgjykimin e Gjykatës së lartë Ekonomike në Beograd Ae. Nr. 4001/88,

rregullon pagesën e qirasë në rastin kur kontrata për qiranë është lidhur në kohëzgjatje më të shkurtër se një vit dhe kur ajo një apo më shumë-vjeçare. Kur sendi është dhënë me qira në kohëzgjatje më të vogël se një vit, qiraja paguhet pasi të ketë kaluar kjo kohë. Kur qiraja zgjat një apo më shumë vjet, qiraja paguhet në çdo gjashtë muaj.

600.2 (a) Vendi i pagesës së qirasë në radhë të parë rregullohet me kontratë. Nëse me kontratë nuk është caktuar vendi ku duhet të bëhet pagesa, do të zbatohen praktikat e vendit në të cilin është lidhur kontrata. Nëse vendi i pagesës as atëherë nuk mund të caktohet, qiraja parimisht paguhet në vendin në të cilin qiramarrësi e ka pasur selinë në kohën e lidhjes së kontratës, përkatësisht në vendbanimin e tij e në mungesë të vendbanimit, në vendqëndrimin e tij, (më hollësisht, shih dispozitat e përgjithshme për përmbushjen në nenet 300 dhe 301 të LMD).

600.2 (b) Pavarësisht nga ajo se a është përcaktuar që qiraja të paguhet periodikisht ose njëherësh në sasinë totale, te kërkesat e qirasë zbatohet afati i veçantë i parashkrimit. Kërkesa e qiradhënësit në çdo rast parashkruhet në afat prej tri vjetësh nga arritja e kërkesës (neni 356 i LMD).

Neni 601. Denoncimi për shkak të mospagimit të qirasë

- 1. Qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën e qirasë, në qoftë se qiramarrësi nuk paguan qiranë dhe këtë gjë nuk e bën as në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi qiradhënësi ta ketë ftuar që të kryejë pagesën.**
- 2. Mirëpo, kontrata do të mbetet në fuqi në qoftë se qiramarrësi e paguan shumën e debituar të qirasë para se t'i komunikohet denoncimi.**

601.1 Pagesa e qirasë është detyrimi thelbësor i qiramarrësit. Nëse ai këtë detyrim thelbësor nuk e përmbush, kontrata për qiranë e humb kuptimin e vet. Për këtë arsye, mospagimi i qirasë mund të jetë arsye për denoncimin e kontratës për qiranë. Duke marrë parasysh se zgjidhja e kontratës mund ta godasë rëndë qiramarrësin, për mbrojtjen e interesave të veta, qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën për qiranë vetëm nëse paraprakisht ka ftuar, përkatësisht i ka tërhequr vërejtjen qiramarrësit për ta bërë pagesën. Nëse qiramarrësi nuk e paguan qiranë e mbetur borxh as në afatin prej 15 ditësh, nga dita kur qiradhënësi e ka ftuar ta bëjë pagesën, qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën për qiranë. Duke marrë parasysh se në këtë dispozitë nuk theksohet se denoncimi jepet pa afat denoncimi, mund të përfundohet se qiradhënësi është i detyruar t'i respektojë afatet e denoncimit të parashikuara në kontratë, në ligj ose në praktikat e vendit, (shih komentin e dispozitës së nenit 612 të LMD).

601.2 Qiramarrësi mund ta mbajë në fuqi kontratën për qiranë, nëse qiranë e mbetur borxh e paguan para se t'i komunikohet denoncimi. Në çdo rast, kontrata nuk zgjidhet me skadimin

e kohës sipas vetë ligjit, por vetëm me deklarimin e vullnetit të qiradhënësit në formën e njoftimit të denoncimit. Kjo praktikisht do të thotë që qiramarrësi mund ta mbajë në fuqi kontratën edhe pas skadimit të afatit prej 15 ditësh, nga dita kur qiradhënësi e ka ftuar për pagimin e qirasë së mbetur borxh, nëse ky nuk e ka njoftuar atë për denoncim menjëherë pas skadimit të afatit prej 15 ditësh. Në Shqipëri, p.sh., me kalimin e një muaji nga data e caktuar për likuidimin e qirasë, kontrata konsiderohet e zgjidhur në mënyrë të njëanshme, për faj të qiramarrësit, i cili me kohë nuk ka bërë pagesën e qirasë së kontraktuar (neni 681 i Kodit Civil të Shqipërisë)³⁶¹.

Neni 602. Kthimi i sendit të marrë me qira

- 1. Qiramarrësi ka për detyrë ta ruajë sendin e marrë me qira dhe pas mbarimit të qirasë ta kthejë të padëmtuar.**
- 2. Sendi kthehet në vendin ku është dorëzuar.**
- 3. Qiramarrësi nuk përgjigjet për harxhimin e sendit që krijohet nga përdorimi i tij i zakonshëm, si dhe për dëmtimet që rrjedhin nga vjetrimi i tij.**
- 4. Në qoftë se gjatë kohës së qirasë ka bërë ndonjë ndryshim në send, ka për detyrë ta kthejë në gjendjen në të cilën ndodhej kur i është dhënë me qira.**
- 5. Ai mund t'i marrë me vete shtesat që ka bërë në send, në qoftë se mund të veçohen pa ndonjë dëmtim të tij, por qiradhënësi mund t'i mbajë po qe se ia shpërblen vlerën e tyre në kohën e kthimit.**

602.1 Edhe pse detyrimi i ruajtjes së sendit të marrë me qira është e lidhur me detyrimin e shfrytëzimit të sendit sipas kontratës ose destinimit (shih komentin e dispozitës së nenit 598 të LMD), është e nevojshme që të bëhet dallimi i tyre. Detyrimi i ruajtjes së sendit të marrë me qira ekziston, ndërsa detyrimi i shfrytëzimit mund të mos ekzistojë në çdo rast. Kështu, qiramarrësi është i detyruar ta ruajë sendin e marrë me qira edhe në rastin kur nuk e shfrytëzon, (p.sh., qiramarrësi është i detyruar që ta ajrosë lokalin afarist të marrë me qira, në mënyrë që ta mbrojë nga lagështia edhe atëherë kur nuk e shfrytëzon). Por, kur qiramarrësi e shfrytëzon sendin e marrë me qira, detyrimi i ruajtjes ekziston njëkohësisht me detyrimin e shfrytëzimit të sendit me kujdesin e ekonomistit të mirë, përkatësisht të shtëpiakut të mirë dhe detyrimin e shfrytëzimit ashtu siç është parashikuar në kontratë ose sipas destinimit të sendit.

602.1 (a) Kontrata për qiranë shuhet për arsye të caktuara, të cilat parashikohen në LMD, si: pas skadimit të kohës së caktuar (neni 610 i LMD); me denoncim të kontratës (neni 599, 601 dhe 603 të LMD); me zgjidhje të kontratës (neni 588, 595 dhe 597 të LMD) dhe pas shkatërrimit të sendeve për shkak të forcës madhore (neni 613 të LMD). Pas shuarjes

³⁶¹ Shih Vendimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Shqipërisë nr. 1177 të dt. 16.05.2012,

së kontratës për qiranë, qiramarrësi është i detyruar që sendin e marrë me qira ta kthejë të padëmtuar. Për të qenë në gjendje që ta kthejë sendin të padëmtuar, qiramarrësi duhet atë send ta ruajë, përkatësisht ta shfrytëzojë sipas kontratës (neni 598 i LMD) dhe ta njoftojë qiradhënësin për nevojën e riparimeve (neni 587 par. 4 i LMD).

602.1 (b) Detyrimi i kthimit të sendit të marrë me qira rrjedh nga natyra juridike e kontratës për qiranë, në bazë të së cilës qiramarrësi e ka vetëm të drejtën e shfrytëzimit të sendit të marrë me qira, por jo edhe të drejtën e pronësisë mbi atë send. Nëse qiramarrësi e kthen sendin e dëmtuar, i përgjigjet qiradhënësit për shkak se nuk e ka ruajtur sendin si një ekonomist i mirë, përkatësisht si një shtëpiak i mirë (neni 5 i LMD), apo për shkak se e ka shfrytëzuar sendin e marrë me qira në kundërshtim me kontratën apo destinimin e sendit të marrë me qira. Ai do të përgjigjet për dëmin pavarësisht nga ajo se a e ka shfrytëzuar sendin ai apo ndonjë person tjetër, të cilit ia ka mundësuar shfrytëzimin e tij (neni par. 3 i LMD).

602.2 Nëse kontraktuesit nuk janë marrë vesh ndryshe me kontratën e lidhur për qiranë, sendi kthehet në vendin ku i është dorëzuar qiramarrësit.

602.3 Në rastin kur sendi është shfrytëzuar me kujdesin e duhur dhe në mënyrën e kontraktuar dhe për shkak të përdorimit të rregullt harxhohet dhe pëson dëmtime, të cilat janë pasojë e vjetërimit të tij, qiramarrësi nuk do të përgjigjet. Për këtë arsye, është e nevojshme të merren në konsiderim ato dëmtime të cilat në mënyrë të paevitueshme shkaktohen me kalimin e kohës, edhe atëherë kur sendi i marrë me qira eventualisht nuk shfrytëzohet, shfrytëzohet rregullisht apo për shkak të forcës madhore (shih komentin e dispozitës së nenit 613 të LMD të vlerësimi i përgjegjësisë së qiramarrësit). Për dëmtime të tilla, përkatësisht për vjetrimin e sendit qiramarrësi nuk do të përgjigjet.

602.4 Në qoftë se qiramarrësi gjatë kohës së qirasë ka bërë ndonjë ndryshim në sendin e marrë me qira, ai ka për detyrë ta kthejë atë në gjendjen në të cilën ndodhej në kohën kur është dhënë me qira. Nga kjo dispozitë ligjore nuk mund të shihet se a është fjala për ndryshimet që shkaktojnë përmirësim apo keqësim të sendit të marrë me qira, por, sipas logjikës së çështjes, këtu kemi të bëjmë me ndryshime që shkaktojnë përmirësimin e sendit të marrë me qira. Ndryshimet në kuptim të keqësimit të sendit të marrë me qira do të hynin në kuadër të pjesës që ka të bëjë me shfrytëzimin e sendit në kundërshtim me kontratën, për çka është parashikuar përgjegjësia e qiramarrësit, (nenet 598 dhe 599 të LMD). Në situatën kur qiramarrësi bën ndryshime me qëllim të përmirësimit të sendit, por për këtë e ka të siguar pëlqimin e qiradhënësit, qiramarrësi do të duhej ta kishte të drejtën e shpërblimit të vlerës reale të përmirësimeve të bëra, edhe pse dispozita ligjore lidhur me këtë situatë nuk përmban ndonjë përgjigje konkrete.

602.5 Qiramarrësi është i detyruar që, pas skadimit të afatit të kontratës për qiranë, ta kthejë sendin të padëmtuar. Nëse gjatë kohëzgjatjes së qirasë ka bërë ndonjë ndryshim në sendin e marrë me qira, duke i vënë ndonjë shtesë atij sendi, ai ato shtesa mund t'i

marrë me vete vetëm kur ato mund të hiqen prej sendit pa e dëmtuar atë. Në qoftë se qiramarrësi nuk i merr këto shtesa, qiradhënësi mund t'i mbajë ato, po qe se ia shpërblen atij vlerën e tyre në kohën e kthimit.

602.5 (a) Nëse qiramarrësi nuk i merr këto shtesa, të cilat mund të hiqen pa ndonjë dëmtim të sendit, e qiradhënësi nuk dëshiron t'i mbajë, qiradhënësi mundet që këto shtesa t'i veçojë në ngarkesë të qiramarrësit.

602.5 (b) Me këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar pozita e qiramarrësit në rastin kur shtesat nuk mund të veçohen. Në këtë rast konsideroj se qiramarrësit nuk duhet t'i njihet e drejta e shpërblimit të vlerës së shtuar të sendit, nëse për këto shtesa nuk e ka pasur pëlqimin paraprak të qiradhënësit, posaçërisht nëse qiradhënësit këto shtesa nuk do t'i kontribuonin në shfrytëzimin më efikas të sendit, për shkak të natyrës së vetë sendit dhe shtesave të bëra lidhur me të.

Neni 603. Denoncimi për shkak të nënqirasë së palejueshme

Qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën e qirasë në qoftë se sendi i marrë me qira është dhënë në nënqira pa lejen e tij kur kjo sipas ligjit, ose sipas kontratës është e nevojshme.

603 Sipas rregullës së përgjithshme të LMD për dhënien e sendit me qira, qiramarrësi mund të lidhë kontratë për nënqiranë, nëse me këtë nuk i shkaktohet dëm qiradhënësit. Mirëpo, aplikimi i kësaj dispozite mund të jetë e kufizuar me ligj të veçantë apo me kontratë për qiranë. Në kontratën për qiranë mund të parashikohet klauzola për ndalimin e dhënies me nënqira të sendit të marrë me qira apo klauzola sipas së cilës sendi mund të jepet me qira vetëm nëse paraprakisht sigurohet pëlqimi i qiradhënësit.

603 (a) Në situatën kur me ligj apo me kontratë është përcaktuar që sendi mund të jepet me qira vetëm me lejin e qiradhënësit, qiramarrësi është i detyruar të sigurojë pëlqimin e tij. Nëse qiramarrësi e jep sendin me nënqira pa pëlqimin e qiradhënësit, qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën për qiranë. Edhe pse kjo shprehimisht nuk është parashikuar, qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën për qiranë edhe atëherë kur qiramarrësi, me gjithë faktin se nuk i është dhënë pëlqimi, ia ka dorëzuar sendin nënqiramarrësit, si dhe kur i ka dorëzuar sendin nënqiramarrësit, ndonëse kjo kryesisht i është ndaluar shprehimisht.

603 (b) Nëse nuk është parashikuar në kontratë apo në ligj të veçantë afati i denoncimit, zbatohen rregullat e përgjithshme për kohëzgjatjen e afatit të denoncimit, (neni 612 par. 2 të LMD).

603 (c) Qiradhënësi nuk mund ta zgjidhë drejtpërdrejtë kontratën për nënqiranë, sepse nuk është palë kontraktuese në këtë kontratë. Mirëpo, deklarata e tij për denoncimin e kontratës për qiranë ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndërprerjen e nënqirasë, sepse nënqiraja ndërpritet sidoqoftë kur pushon qiraja.

Neni 604. Kërkesa e drejtpërdrejtë e qiradhënësit

Qiradhënësi mundet për ti arkëtuar kërkesat e veta nga qiramarrësi të krijuara nga qiraja, të kërkojë drejtpërdrejtë nga nënqiramarrësi pagimin e shumës që ky i debiton qiramarrësit ne bazë të nënqiras.

604 Qiradhënësi nuk është palë kontraktuese në kontratën për nënqiranë dhe për këtë, në parim, nuk ka kurrfarë kërkesash juridike ndaj nënqiramarrësit. Mirëpo, në dispozitën e nenit 604 të LMD parashikohet përjashtimi nga ky parim. Nëse qiramarrësi ka rënë në vonesë për pagesën e qirasë dhe kërkesave të tjera të përcaktuara në kontratën për qiranë, qiradhënësi mundet që, me qëllim të inkasimit të këtyre kërkesave, të kërkojë drejtpërdrejt nga nënqiramarrësi pagesën e shumës të cilën ky e ka borxh në emër të nënqirasë, por vetëm gjer në shumën e mbulimit të kërkesave të qiradhënësit, pavarësisht që nënqiramarrësi eventualisht mund t'i ketë më shumë borxh qiramarrësit, por jo më tepër se detyrimet e nënqiramarrësit ndaj vetë qiramarrësit, pavarësisht që detyrimet e mbetura të papaguara të qiramarrësit ndaj qiradhënësit janë më të mëdha. Dispozita e këtij neni e mbron interesin e qiradhënësit, sepse i mundëson që, në vend të qiramarrësit që nuk paguan, t'i parashtrojë drejtpërdrejtë kërkesë për pagesë të shumës së borxhit nënqiramarrësit.

Neni 605. Shuarja e nënqirasë në bazë të vetë ligjit

Nënqiraja shuhet në çdo rast kur shuhet qiraja.

605 Edhe pse nënqiraja është kontratë e cila, në parim, është e pavarur nga kontrata për qiranë, ekzistimi i saj është i varur nga ekzistimi i kontratës për qiranë. Nëse kontrata për qiranë shuhet, pa marrë parasysh shkakun e shuarjes, (p.sh., denoncimi, zgjedhja, shkatërrimi isendit për shkak të forcës madhore etj.), shuhet edhe nënqiraja. Nënqiramarrësi në këto raste nuk mund ta mbajë në fuqi kontratën për nënqiranë, pavarësisht që kjo do të mund të ishte në interes të tij. Kontrata për nënqiranë varet nga ekzistimi i kontratës për qiranë dhe shuhet bashkë me shuarjen e saj.

KREU 4

TJETËRSIMI I SENDIT TË MARRË ME QIRA

Neni 606. Tjetërsimi pas dorëzimit me qira

1. Në rast te tjetërsimit të sendit i cili para kësaj i është dorëzuar ndonjë tjetrit me qira fituesi i sendit zene vendin e qiradhënësit, kështu që pas kësaj, të drejtat dhe detyrimet nga qiraja lindin midis tij dhe për qiramarrësit.

2. Fituesi nuk mund të kërkojë nga qiramarrësi që t ia dorëzojë sendin para se të ketë kaluar koha për të cilën është kontraktuar qiraja e në qoftë se kohëzgjatja e qirasë nuk është caktuar as me kontratë dhe as me ligj, atëherë para skadimit të afatit të denoncimit.

3. Për detyrimet e fituesit nga qiraja ndaj qiramarrësit përgjigjet bartësi si dorzan solidar.

606.1 Me lidhjen e kontratës për qiranë, qiradhënësi nuk e bart të drejtën pronësore të qiramarrësit, por vetëm të drejtën e shfrytëzimit të sendit të marrë me qira. Qiradhënësi mbetet pronar i sendit dhe ka të drejtë që sendin e dhënë me qira ta tjetërsojë. Nëse qiradhënësi e tjetërson sendin e dhënë me qira, shtrohet çështja e konfliktit të të drejtave të qiramarrësit dhe pronarit të ri.

606.1 (a) Kundërshtimi i të drejtës detyruese të qiramarrësit ndaj përfituesit, si palë e tretë, dallohet nga efektet juridike të kontratës. Është rregull e përgjithshme që kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese, (shih komentin e dispozitës së nenit 130 të LMD për efektet e përgjithshme të kontratës). Sipas kësaj rregulle, kontrata nuk prodhon efekte juridike ndaj palëve të treta. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që kontrata ekziston vetëm për palët kontraktuese; ajo ekziston edhe për palët e treta. Gjersa për palët kontraktuese kontrata krijon të drejta dhe detyrime, palëve të treta kontrata vetëm mund t'u ofrohet për kundërshtim. Kjo do të thotë se palët e treta duhet ta njohin dhe ta respektojnë ekzistimin e kontratës, si fakt juridik. Ashtu siç mund të kundërshtohen kontratat nga palët e treta, palëve të treta mund t'u imponohen edhe detyrime të cilat lindin nga kontrata, me kusht që ato të kenë ditur për ekzistimin e këtyre të drejtave. Nga kjo rrjedh detyrimi i palëve të treta që të përmbahen nga veprimet me të cilat do të mund të cenohej e drejte e kreditorit. Për dallim nga të drejtat detyruese, të drejtat reale janë absolute (**erga omnes**) dhe mund t'u imponohen të gjitha palëve të treta, pavarësisht nëse ato kanë ditur ose jo për ekzistimin e të drejtës reale.

606.1 (b) Rregullat nga dispozitat e neneve 606 gjer në 609 të LMD e rregullojnë konfliktin mes qiramarrësit dhe përfituesit tek i cili qiradhënësi e ka tjetërsua sendin e dhënë me qira. Raporti mes qiramarrësit dhe përfituesit varet nga fakti nëse sendi i është dorëzuar: a) qiramarrësit para tjetërsimit ose b) përfituesit, kur përfituesi, të cilit i është dorëzuar sendi, në momentin e lidhjes së kontratës ka pasur dijeni për kontratën për qiranë. Shkurt, për ta konkretizuar atë që u tha më sipër, nëse qiradhënësi lidh dy kontrata - kontratën për qiranë dhe atë për tjetërsimin dhe sendin ia dorëzon qiramarrësit para tjetërsimit, atëherë përfituesi nuk mund t'ia marrë qiramarrësit sendin, por vendoset në vendin e qiradhënësit dhe është i detyruar ta durojë të drejtën e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit gjer në skadimin e afatit për të cilin është lidhur kontrata për qiranë dhe, nëse qiradhënësi lidh dy kontrata, kontratën për qiranë dhe atë për tjetërsimin dhe sendin ia dorëzon përfituesit e jo qiramarrësit, qiramarrësi nuk mund të kërkojë dorëzimin e sendit, përveç nëse përfituesi, në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin ka pasur dijeni për kontratën e qirasë.

606.1 (c) Në të drejtën krahasuese mbizotërojnë dy qëndrime: a) në të drejtën austriake, tjetërsimi i sendit zgjidh kontratën për qiranë (Kauf bricat Parcht. Par. 1120. ABGB), b) te ne dhe në të drejtën gjermane, italiane dhe zvicerane, tjetërsimi i sendit nuk e zgjidh kontratën për qiranë (Verausserung brich nicht Pacht, par. 571, lidhur me nenin 581 par. 2 të BGB, neni 261 OR). Mirëpo, edhe në të drejtën austriake ekziston përjashtimi nga rregulla që tjetërsimi e zgjidhë kontratën për qiranë. Kjo do të kishte të bënte me situatën kur kontrata për qiranë është e regjistruar në librat publike, kur qiramarrësi ka të drejtë ta shfrytëzojë sendin e marrë me qira gjer në momentin e skadimit të kohëzgjatjes së marrëdhënies së qirasë, (par. 1120 fj. 1 ABGB). Nëse sendi duhet të dorëzohet më herët, qiramarrësi është i autorizuar të kërkojë shpërblimin e dëmit nga qiradhënësi (par. 1120 fj. 2 ABGB)³⁶².

606.1 (ç) Me rregullën se tjetërsimi i sendit të dhënë me qira nuk e zgjidh kontratën për qiranë, mbrohet interesi i qiramarrësit dhe forcohet pozita e tij juridike në raport me palët e treta. Përfituesi, të cilit qiradhënësi ia ka tjetërsuar sendin pasi ky i është dorëzuar qiramarrësit, hyn në marrëdhënie vend të qiradhënësit lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën për qiranë. Në këtë mënyrë, konflikti midis dy të drejtave – të drejtës së qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit të marrë me qira dhe të drejtës pronësore të përfituesit të sendit, në parim, është zgjidhur në favor të qiramarrësit. Kushtet e nevojshme për aplikimin e kësaj rregulle janë: a) që të jetë lidhur kontrata për qiranë mes qiradhënësit dhe qiramarrësit, b) që të jetë përmbushur detyrimi i dorëzimit të sendit qiramarrësit para tjetërsimit dhe c) që e drejta e përfituesit të rrjedhë nga e drejta e qiradhënësit. Edhe pse nuk është parashikuar shprehimisht, nga kuptimi i kësaj rregulle rrjedh që të drejtat e veta, lidhur me sendin e marrë me qira, qiramarrësi mund t’ia kundërvërë jo vetëm përfituesit të parë, por edhe përfituesve të tjerë eventuale për tërë kohëzgjatjen e kontratës për qiranë, të cilën e ka lidhur me qiradhënësin. Edhe pse përfituesi, në të shumtën e rasteve fiton të drejtën pronësore nga qiradhënësi me punë juridike në gjallje të tij, (p.sh., kontratat për shitblerje, për ndërrimin, për dhurimin, për mbajtjen e përjetshme), me punë juridike është e mundur të fitohen edhe të drejta të tjera mbi sendin e dhënë me qira. Qiradhënësi mund të parashtrijë të drejtat e tij ndaj personave, të cilët nuk e kanë fituar të drejtën pronësore ndaj sendit të dhënë me qira, por duan që ta marrin apo ta kufizojnë të drejtën e qiramarrësit në shfrytëzimin e sendit.

606.2 Për qiramarrësin është me rëndësi të madhe që qiradhënësi t’ia dorëzojë sendin para se t’ia tjetërsojë përfituesit. Në praktikë, më së shpeshti pronari do të lidhë kontratë për qiranë dhe do t’ia dorëzojë sendin qiramarrësit, kurse pastaj, gjatë kohëzgjatjes së qirasë, të lidhë kontratë për shitjen e sendit apo ndonjë kontratë tjetër për tjetërsimin me personin e tretë dhe t’ia bartë këtij të drejtën e pronësisë mbi sendin e dhënë me qira. Në atë situatë, është jo kontestuese që tjetërsimi ka ndodhur pas dorëzimit të sendit dhe se përfituesi duhet ta durojë të drejtën e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit gjer në skadimin e afatit të kontratës së lidhur për qiranë. Nëse kohëzgjatja e qirasë nuk është e përcaktuar as me

362 Česić – Gorenc – Kačer Momčinić – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005- faqe 823

kontratë, as me ligj, atëherë përfituesi mund të kërkojë kthimin e sendit pas skadimit të afatit të denoncimit. Mirëpo, nëse qiradhënësi ia ka dorëzuar sendin përfituesit dhe jo qiramarrësit, qiramarrësi nuk do të mund t'i kundërvihej përfituesit me të drejtën e tij, por vetëm i ngel në dispozicion e drejta e shpërblimit të dëmit, të cilin do ta pësonte eventualisht.

606.3 Për shkak të faktit se fituesi i merr të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën për qiranë, qiradhënësi që e ka tjetërsua sendin e dhënë me qira pushon të jetë debitor i qiramarrësit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se qiradhënësi – tjetërsuesi del tërësisht nga raporti juridik lidhur me kontratën për qiranë. Nga momenti i lidhjes së kontratës për tjetërsimin e sendit të dhënë me qira, qiradhënësi, si dorëzan solidar, i përgjigjet qiramarrësit për detyrimet e fituesit të përcaktuara në kontratën për qiranë. Kjo do të thotë se përgjegjësia e qiradhënësit – tjetërsuesit është më e ashpër sesa e dorëzimit të thjeshtë, të cilëve kreditori mund t'u drejtohet me kërkesë vetëm atëherë kur debitori kryesor nuk e ka përmbushur atë në afatin e caktuar në ftesën me shkrim (shih nenin 1016 par. 1 të LMD dhe komentin lidhur me këtë paragraf). Qiramarrësi mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit qoftë nga fituesi, si debitor, qoftë nga qiradhënësi – tjetërsuesi ose nga të dy këta njëkohësisht (shih nenin 1016 par. 3 të LMD dhe komentin lidhur me këtë paragraf).

Neni 607. E drejta e çmimit të qirasë

- 1. Ne qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, fituesi i sendit të dorëzuar me qira ka të drejtë në çmimin e qirasë, duke filluar që nga afati i parë i ardhshëm pas fitimit të sendit, nëse bartësi ka pranuar qiranë që më parë, bartësi duhet të njëjtën t'ia ktheje fituesit.**
- 2. Që nga momenti kur është njoftuar mbi tjetërsimin e sendit të marrë me qira, qiramarrësi mund t'ia paguajë çmimin a qirasë vetëm fituesit.**

607.1 Në momentin e tjetërsimit të sendit të dhënë me qira, fituesi që hyn në vend të qiradhënësit, përveç marrjes së detyrimeve të tij, fiton edhe të drejtat të cilat i ka pasur qiradhënësi ndaj qiramarrësit. Të drejtën kryesore që e fiton dhe e cila është edhe element kryesor i kontratës për qiranë, është e drejta e qirasë. Nëse nuk është kontraktuar ndryshe, qiradhënësi ka të drejtën e qirasë gjer në momentin e tjetërsimit të sendit, kurse fituesi nga afati i parë i ardhshëm, pas përfitimit të sendit. Rregullat për pagesën e qirasë janë të natyrës disponibile, për çfarë palët kontraktuese mund të arrijnë marrëveshjen e pagesës së qirasë edhe paraprakisht, (shih komentin e dispozitës së nenit 600 të LMD). Prandaj, nëse qiradhënësi e tjetëron sendin e dhënë me qira gjatë kohëzgjatjes së qirasë, për të cilën kohë tashmë ishte kryer pagesa e qirasë paraprakisht, është i detyruar që t'ia atë kthejë fituesit.

607.2 Për bartjen e të drejtës së qirasë nga qiradhënësi te fituesi nuk është i nevojshëm pëlqimi i qiramarrësit, si debitor, por qiradhënësi është i detyruar ta njoftojë për tjetërsimin (shih komentin e dispozitës së nenit 422 të LMD). Nëse nuk e njofton, qiramarrësi mund

të ia paguajë qiranë qiradhënësit, i cili do ta ketë detyrimin që qiranë t'ia kalojë fituesit, përveç nëse me kontratën e tyre nuk është parashikuar diçka tjetër. Njoftimi për tjetërsimin është i nevojshëm, për shkak se nga ai moment qiramarrësi mund t'ia paguajë qiranë në mënyrë të drejtë vetëm fituesit.

Neni 608. Tjetërsimi i sendit të marrë me qira para se t'i dorëzohet qiramarrësit

- 1. Në qoftë se sendi për të cilin është lidhur kontrata e qirasë i është dorëzuar fituesit, e jo qiramarrësit, fituesi zëne vendin e qiradhënësit dhe merr përsipër detyrimet e tij ndaj qiramarrësit në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin ka qenë në dijeni për ekzistimin e kontratës së qirasë.**
- 2. Fituesi i cili në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin nuk ka qenë në dijeni për ekzistimin e kontratës së qirasë, nuk ka për detyrë t'ia dorëzojë qiramarrësit sendin, ndërsa qiramarrësi mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit nga qiradhënësi.**
- 3. Për detyrimet e fituesit nga dhënia me qira ndaj qiramarrësit përgjigjet bartësi si dorëzan solidar.**

608. Vështrim i përgjithshëm. Tjetërsimi i sendit të dhënë me qira rregullisht ndodh pas ky t'i jetë dorëzuar qiramarrësit, (shih komentin e dispozitës së nenit 606 të LMD). Mirëpo, edhe pse jo aq shpesh, është e mundur që sendi për të cilin është lidhur kontrata për qiranë, t'i dorëzohet fituesit dhe jo qiramarrësit. Meqë në këtë rast sendi është në posedim të fituesit, ai ka mundësi që të drejtën e vet të forcuar me posedim, t'ia kundërvërë qiramarrësit, i cili e ka vetëm të drejtën e kërkesës. Siç është rasti të neni 606 i LMD, ashtu edhe këtu, e drejta e forcuar me posedim ka përparësi kundrejt të drejtës detyruese të palës tjetër. Megjithatë, pasojat e konfliktit mes së drejtës së qiramarrësit nga kontrata për qiranë dhe së drejtës së fituesit nga kontrata për tjetërsimin e sendit të dhënë me qira, varen nga dijenia e fituesit për ekzistimin e marrëdhënies së qirasë.

608.1 Fituesi të cilit qiradhënësi – tjetërsuesi ia ka dorëzuar sendin nuk mund ta ndalë sendin për vete, por është i detyruar t'ia dorëzojë atë qiramarrësit, nëse në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin ka ditur apo, nga rrethanat e rastit, është dashur të dijë për ekzistimin e kontratës për qiranë. Kjo për faktin se fituesi zë vendin e qiradhënësit dhe merr përsipër detyrimet e tij ndaj qiramarrësit. Qiramarrësi në këtë rast mund ta kundërshtojë të drejtën e fituesit të pandërgjegjshëm dhe të pandershëm me të drejtën e vet të shfrytëzimit, edhe pse sendi i është dorëzuar fituesit dhe jo atij. Por, në rast të kontestit, qiramarrësi do të duhej të argumentonte pandërgjegjshmërinë dhe pandershëmërinë e fituesit. Nëse qiramarrësi arrin të argumentojë se fituesi në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin ka ditur apo, nga rrethanat e rastit, do të duhej të dinte për ekzistimin e kontratës për qiranë, fituesi do të jetë i detyruar që t'ia dorëzojë sendin, ta durojë të drejtën e tij për shfrytëzimin e sendit dhe t'i marrë përsipër detyrimet e mirëmbajtjes së sendit dhe përgjegjësinë për të metat materiale dhe juridike të tij.

608.2 Nëse fituesi, të cilit qiradhënësi – tjetërsuesi ia ka dorëzuar sendin në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin, nuk ka ditur e as që është dashur të dinte për ekzistimin e kontratës për qiranë, nuk është i detyruar t’ia dorëzojë sendin qiramarrësit. Qiramarrësi, i cili në atë rast nuk mund ta realizojë të drejtën e tij të shfrytëzimit, mundet të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit nga qiradhënësi.

608.3 Nga momenti i lidhjes së kontratës për tjetërsimin e sendit të dhënë me qira, qiradhënësi, si dorëzanë solidar, i përgjigjet qiramarrësit për detyrimet e fituesit nga kontrata për qiranë. Kusht për përgjegjësinë, si dorëzanë solidar të qiradhënësit, është që fituesi t’ia ketë dhënë sendin e marrë me qira qiramarrësit.

Neni 609. Denoncimi i kontratës për shkak të tjetërsimi të sendit

Kur për shkak të tjetërsimit të sendit të marrë me qira të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit kalojnë në fituesin, qiramarrësi mund ta denoncoj kontratën në çdo rast, duke respektuar afatet ligjore të denoncije.

609. Vështrim i përgjithshëm.- Në rastin kur qiradhënësi e tjetëron sendin të cilin para kësaj ia ka dorëzuar qiramarrësit, e drejta e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit nuk shuhet, (neni 606 i LMD). E drejta e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit nuk shuhet as atëherë kur sendi i marrë me qira i është dorëzuar fituesit, i cili në momentin e lidhjes së kontratës për tjetërsimin ka ditur apo është dashur të dinte për ekzistimin e kontratës për qiranë, (neni 608 i LMD). Në rastet e përmendura, fituesi hyn në vend të qiradhënësit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuar në kontratën për qiranë. Kjo vazhdimësi e kontratës për qiranë, me gjithë tjetërsimin e sendit është parashikuar në interes të qiramarrësit, i cili, në të kundërtën, do të vihej në pozitë të pavoritshme. Posaçërisht kjo ka të bëjë me mbrojtjen e qiramarrësit nga mundësia e pushimit të marrëdhënies së qirasë para skadimit të afatit të kontraktuar.

609 Rregulla sipas së cilës, në rast të tjetërsimit të sendit, marrëdhënia e qirasë vazhdon mes qiramarrësit dhe fituesit, është parashikuar për mbrojtjen e interesave të qiramarrësit, për të cilin supozohet se, në të shumtën e rasteve, është i interesuar për vazhdimin e shfrytëzimit të sendit të marrë me qira. Nëse qiramarrësi, pavarësisht nga arsyeja, nuk ka interes për vazhdimin e kontratës për qiranë me fituesin, i cili hynë në vend të qiradhënësit, ka të drejtë ta denoncojë kontratën për qiranë. Me këtë rast, ai ka për detyrë t’u përmbahet afateve të denoncimit të parashikuara me kontratë apo me ligj, (shih komentin e nenit 612 të LMD).

KREU 5

SHUARJA E QIRASË

Neni 610. Kalimi i kohës së caktuar

- 1. Kontrata e qirasë e lidhur për një kohë të caktuar shuhet me vetë kalimin e kohës për të cilën është lidhur.**
- 2. E njëjta gjë vlen edhe në rastet kur në mungesë të vullnetit të kontraktuesve kohëzgjatja e qirasë është caktuar me ligj.**

610.1 Kontrata për qiranë është e lidhur në kohë të caktuar, kur palët kontraktuese përcaktojnë shprehimisht apo në heshtje kohëzgjatjen e kontratës. Kohëzgjatja e kontratës është përcaktuar shprehimisht, kur palët kontraktuese caktojnë saktësisht kohën e shuarjes së kontratës apo kanë parashikuar që kontrata të zgjatë një kohë të caktuar nga momenti i lidhjes së saj. Nëse palët kontraktuese kanë parashikuar saktësisht kohën e skadimit të kontratës, kontrata shuhet me skadimin e asaj kohe, e nëse në kontratë kanë theksuar se kontrata vlen një kohë të caktuar nga dita e lidhjes së saj, atëherë zbatohen rregullat e përgjithshme për llogaritjen e kohës, (shih komentin e dispozitës së nenit 338 të LMD). Përcaktimi në heshtje i kohës së zgjatjes së kontratës vërtetohet nga vetë natyra, rrethanat, doket e vendit dhe rrethanat e tjera relevante të kontratës konkrete. Marrëdhënia e qirasë e lidhur në kohë të caktuar rregullisht shuhet me kalimin e kohës për të cilën është lidhur. Duke marrë parasysh se për shuarjen e kontratës mjafton kalimi i kohës së kontraktuar, nuk është e nevojshme kurrfarë deklarate e vullnetit apo ndërmarrja e ndonjë veprimi nga asnjëra palë kontraktuese. Pas kalimit të kohës për të cilën është lidhur kontrata për qiranë, qiramarrësi është i detyruar që sendin e marrë me qira t’ia kthejë qiradhënësit (shih nenin 602 të LMD).

610.2 Palët kontraktuese, në parim, janë të lira të caktojnë afatin e kohëzgjatjes së kontratës për qiranë. Mirëpo, me dispozita të veçanta ligjore liria e kontraktimit të kohëzgjatjes së kontratës mund të jetë e kufizuar duke përcaktuar një kohëzgjatje të madhe të qirasë. P.sh., dhënia e pronës së paluajtshme shoqërore që administrohet nga komunat në Kosovë jepet me qira për 99 vjet³⁶³, e cila rregullore ua jep të drejtën komunave në Kosovë për të dhënë me qira paluajtshmëri për një afat prej 99 vjetësh. Një e drejtë e tillë e komunave mbështetet edhe në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale³⁶⁴, në bazë të të cilit, Komuna e Prishtinës ka nxjerrë vendimin për caktimin e kriterëve dhe të procedurës së dhënies së pronës komunale për shfrytëzim³⁶⁵. Një procedurë e ngjashme zhvillohet edhe tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila jep pronën për shfrytëzim për 99 vjet.

.....
363 Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/13 të dt. 04 mars 2005.

364 Shih Ligjin për vetëqeverisje lokale nr. 03/L - 040 (‘Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës’ nr. 28/2008)

365 Shih vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 46-1301 i datës 03.07.2009.

610.2 (a) Kuptimi i kësaj dispozite është si vijon: nëse palët kontraktuese kanë lënë pa përcaktuar një kohëzgjatjen më të shkurtër të qirasë sesa koha e lejuar me ligj të veçantë apo kanë kontraktuar kohëzgjatje më të madhe të qirasë, konsiderohet se kontrata shuhet me kalimin e kohës së lejuar me ligj për kohëzgjatjen e qirasë.

610.2 (b) Ndërkaq, mënyrat e tjera të shuarjes së kontratës për qiranë të lidhur në kohë të caktuar dhe kontratës kohëzgjatja e së cilës është caktuar me ligj, përveç pas skadimit të kohës, qiraja e lidhur në kohë të caktuar mund të shuhet edhe për të gjitha ato arsye për shkak të të cilave mund të pushojnë kontratat e dyanshme detyruese. Për shuarjen e kontratës për qiranë ligji parasheh këto arsye: kalimi i kohës së caktuar (neni 610 i LMD); denoncimi për shkak të përdorimit në kundërshtim me kontratën (neni 599 i LMD); mospagimi i qirasë (neni 601 të LMD), nënqiraja e palejueshme (neni 603 i LMD); zgjidhja e kontratës për shkak të riparimeve (neni 588 i LMD), për shkak të të metave materiale (neni 595 par. 3 i LMD); për shkak të të metave juridike (neni 597 par. 2 e 3 të LMD) dhe për shkak të shkatërrimit të sendit nga forca madhore (neni 613 i LMD).

610.2 (c) Vdekja e qiradhënësit apo qiramarrësit, sipas ligjit, nuk është shkak për shuarjen e kontratës, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.

Neni 611. Përtëritja heshtazi e qirasë

- 1. Kur pasi të ketë kaluar koha për të cilën është lidhur kontrata e qirasë, qiramarrësi vazhdon ta përdorë sendin, ndërsa qiradhënësi nuk e kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontratë e re e qirasë me kohëzgjatje të pacaktuar, në të njëjtat kushte sikurse edhe në ato paraprake.**
- 2. Sigurimet të cilat personat e tretë kanë dhënë për qiranë e parë, shuhen me të kaluar koha për të cilat është lidhur kontrata e parë.**

611.1 Kontrata për qiranë, e cila është lidhur në kohë të caktuar apo kohëzgjatja është parashikuar me ligj, shuhet me skadimin e kësaj kohe, (neni 610 i LMD). Qiramarrësi është i detyruar ta kthejë sendin e marrë me qira, dhe nëse këtë nuk e bën, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, (shih komentin e dispozitës së nenit 602 të LMD). Nëse qiramarrësi, pasi të ketë kaluar koha për të cilën është lidhur kontrata e qirasë, vazhdon ta përdorë sendin, ndërsa qiradhënësi nuk e kundërshton këtë, konsiderohet se në heshtje është lidhur kontratë e re për qiranë e të njëjtit send dhe në të njëjtat kushte, si edhe kontrata paraprake, por në kohë të pacaktuar, duke i përfshirë kushtet lidhur me mënyrën shuarjes së kontratës së re³⁶⁶. Me kalimin e kohëzgjatjes së kontratës, qiradhënësi nuk mund ta realizojë të drejtën e ngritjes së qirasë në mënyrë të njëanshme, (nëse nuk e siguron pëlqimin edhe të qiramarrësit për rritjen e qirasë), por i ai ka të drejtën e denoncimit të kontratës për qiranë,

366 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Vojvodinës, Ae. nr. 475/91,

nëse kontrata në vazhdohet mënyrë automatike³⁶⁷. Për këtë arsye, qiramarrësi ka të drejtë të kërkojë nga qiramarrësi, gjer në lirimin e objektit të qirasë, vetëm shumën e qirasë, e cila ka qenë e kontraktuar me kontratën fillestare, pavarësisht se kjo kontratë, pas kalimit të afatit, është vazhduar në heshtje³⁶⁸.

611.2 Kontrata e ripërtërirë me heshtje, në raport me kontratën e parë, është kontratë e re, edhe pse raportet juridike mes të palëve kontraktuese vazhdojnë në të njëjtat kushte. Megjithatë, ekzistojnë dy dallime qenësore mes të kontratës së ripërtërirë dhe asaj paraprake për qiranë: a) kontrata paraprake është lidhur shprehimisht në kohë të caktuar, kurse kontrata e ripërtërirë, në heshtje, është në kohë të pacaktuar; b) kontrata paraprake shuhet për shkaqet e parashikuara me ligj, (shih komentin e dispozitës së nenit 610 të LMD), ndërsa kontratën e ripërtërirë secili prej kontraktuesve mund ta denoncojë në çfarëdo kohe, pa i përmendur arsyet për këtë, por duke respektuar afatet e parashikuara për denoncimin, (shih komentin e dispozitës së nenit 612 të LMD) dhe c) sigurimet, të cilat personat e tretë i kanë dhënë për kontratën paraprake për qiranë, sipas ligjit, shuhet me të kaluar koha për të cilën është lidhur kontrata e parë dhe nuk vazhdojnë në kontratën e ripërtërirë në heshtje. Nëse dëshirojnë dhënësit e sigurimit që të japin sigurimin për kontratën e ripërtërirë në heshtje të qirasë, duhet që këtë ta kontraktojnë shprehimisht.

Neni 612. Denoncimi

- 1. Kontrata e qirasë kohëzgjatja e së cilës nuk është caktuar dhe as që mund të caktohet nga rrethanat apo nga zakonet e vendit shuhet me denoncim të cilin secila palë mund t'ia japë tjetrës duke respektuar afatin a caktuar të denoncimit.**
- 2. Në qoftë se kohëzgjatja e afatit të denoncimit nuk është caktuar me kontratë ose me ligj apo me zakonet e vendit, ndërsa ajo është tetë ditë por që denoncimi të mos mund të jepet në kohën jo të duhur.**
- 3. Në qoftë se sendet e marra me qira janë të rrezikshme për shëndetin, qiramarrësi mund ta denoncojë kontratën pa e dhënë afatin e denoncimit edhe në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratës e ka ditur këtë.**
- 4. Qiramarrësi nuk mund të heqë dorë nga e drejta e parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni.**

612.1 Kontrata për qiranë është e lidhur në kohë të pacaktuar, në qoftë se palët kontraktuese shprehimisht ose në heshtje, nuk kanë përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës për qiranë dhe nëse kohëzgjatja nuk është përcaktuar sipas ligjit, (shih komentin e dispozitës së nenit 610 të LMD). Gjersa kontrata për qiranë, e cila është lidhur në kohë të caktuar, rregullisht shuhet me kalimin e kohës për të cilën shprehimisht apo në heshtje është parashikuar e kontrata kohëzgjatja e së cilës është përcaktuar me ligj, me kalimin e kohës së parashikuar

367 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Sërbisë, Ae. nr. 105/85,

368 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 402/2008 e dt. 07.10.2011,

me ligj të veçantë, kontrata në kohë të pacaktuar shuhet me denoncim, të cilin secili prej kontraktuesve mund t'ia bëjë bashkëkontraktuesit tjetër.

612.1 (a) Denoncimi është shuarja e rregullt e kontratës për qiranë lidhet në kohë të pacaktuar për shkak të vetë natyrës së saj, sepse, në të kundërtën, një kontratë e tillë do të zgjaste pa kufi. Denoncimi është deklarata e njëanshme e vullnetit të kontraktuesit, me të cilën shuhet qiraja, kur kohëzgjatja e kontratës nuk është përcaktuar shprehimisht apo në heshtje e as me ligj të veçantë³⁶⁹.

612.1 (b) Denoncimi i kontratës për qiranë, e cila është lidhur në kohë të pacaktuar, dallohet nga shuarja e njëanshme e kontratës. Kontrata për qiranë mund të shuhet vetëm për shkaqet e parashikuara në kontratë apo në ligj, (shih komentin e dispozitës së nenit 610 të LMD). Denoncimi i kontratës për qiranë në kohë të pacaktuar mund të jepet pa u vënë në dukje shkaqet dhe pa ekzistimin e çfarëdo përgjegjësie të palës tjetër kontraktuese.

612.2 Për mbrojtjen e interesave të kontraktuesit, të cilit i bëhet denoncimi, ligji parashikon dy kufizime për shuarjen e kontratës për qiranë me denoncim: a) denoncimi mund të jepet në çdo kohë, por jo në kohën jo të duhur dhe b) kontrata për qiranë e denoncuar shuhet vetëm pas skadimit të afatit të denoncimit. Kohëzgjatja e afatit të denoncimit është e përcaktuar në kontratën për qiranë, por nëse kjo nuk është përcaktuar në kontratën për qiranë ose në ligj apo me zakonet e vendit, sipas LMD, ky afat është tetë (8)-ditor dhe llogaritet nga dita kur kontraktuesi është njoftuar për denoncimin e kontratës.

612.2 (a) Afati i denoncimit, në parim, nuk prodhon efekt juridik në momentin e lajmërimit të palës tjetër kontraktuese, por vetëm pas skadimit të afatit të denoncimit. Afati i denoncimit është periudha midis kohës së marrjes së denoncimit dhe shuarjes së kontratës. Afati është parashikuar në mënyrë që palës tjetër kontraktuese t'i mundësohet përgatitja për shuarjen e kontratës, të cilën nuk është dashur apo nuk ka mundur ta parashikojë. Për këtë arsye, kontraktuesi i cili e denoncon kontratën është i detyruar që ta respektojë afatin e denoncimit.

612.2 (b) Dispozitat për denoncimin dhe afatin e denoncimit janë të natyrës disponibile. Pra, palët kontraktuese mund ta përcaktojnë me marrëveshje kohëzgjatjen e afatit të denoncimit. Palët kontraktuese mund ta kontraktojnë shuarjen e kontratës për qiranë me vetë dorëzimin e denoncimit, në të cilin rast praktikisht nuk ekziston afati i denoncimit. Nëse palët nuk kanë kontraktuar kohëzgjatjen e afatit të denoncimit dhe ajo nuk mund të caktohet as sipas ligjit apo zakoneve të vendit në të cilin ndodhet sendi, atëherë do të zbatohet afati i përgjithshëm prej tetë (8) ditësh i parashikuar në dispozitën e nenit 612 par. 2 të LMD.

612.3 Nga rregulla që me rastin e dhënies së denoncimit te kontrata për qiranë kohëzgjatja e së cilës nuk është caktuar, ekzistojnë përjashtime kur kontrata mund të denoncohet pa afat denoncimi. Ky denoncim dallohet nga denoncimi i rregullt. Denoncimi i rregullt mund të jepet pa u vënë në dukje arsyet dhe pa ekzistimin e fajësisë së cilësdo palë kontraktuese

369 Shih aktgjykimin e Gjykatës së Lartë Ekonomike në Beograd Ae. nr. 1142/95,

qoftë, por bëhet fjalë për mbrojtjen e palës së cilës i bëhet denoncimi, prandaj duhet të respektohet afati i caktuar i denoncimit. Denoncimi pa afat të denoncimit, në të vërtetë, është sanksion, për shkak se pala tjetër nuk i përmbush detyrimet e saj kontraktuese dhe mund të jepet pavarësisht se a bëhet fjalë për kontratë të lidhur me afat të caktuar apo për kontratën kohëzgjatja e së cilës nuk është caktuar, për çka është më afër shuarjes sesa denoncimit të rregullt. Pala që e bën denoncimin pa afat denoncimi duhet ti vërë në dukje arsyet për këtë dhe të argumentojë ekzistimin e këtyre arsyeve. Në ligj janë parashikuar rastet kur qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën pa afat denoncimi: denoncimi për shkak të përdorimit në kundërshtim me kontratën, (neni 599 i LMD), për shkak të mospagesës së qirasë (neni 601 i LMD). Qiramarrësi mund ta denoncojë kontratën pa dhënie të afatit të denoncimit, në rast se sendet e marra me qira janë të rrezikshme për shëndetin dhe në rast se ai, edhe në momentin e lidhjes së kontratës, ka pasur dijeni për këtë.

612.4 Për shkak të natyrës së sendeve të rrezikshme për shëndetin, në këtë rast qiramarrësi është i mbrojtur posaçërisht dhe heqja dorë nga e drejta e dhënies së denoncimit nuk ka efekt juridik, sepse në ligj është parashikuar pamundësia e heqjes dorë nga një e drejtë e tillë e qiramarrësit.

Neni 613. Shkatërrimi i sendeve për shkak të forcës madhore

- 1. Marrja me qira pushon në qoftë se sendi i marrë me qira shkatërrohet nga ndonjë rast i forcës madhore.**
- 2. Në qoftë se sendi i marrë me qira shkatërrohet pjesërisht ose vetëm dëmtohet, qiramarrësi mund ta zgjidhë kontratën, ose të mbetet edhe më tej në qiramarrje dhe të kërkojë zbritjen përkatëse të çmimit të qirasë.**

613. Vështrim i përgjithshëm.- Sendi i cili është objekt i kontratës për qiranë mund të shkatërrohet ose të dëmtohet rastësisht nga koha kur është lidhur kontrata për qiranë, gjer në përmbushjen e plotë të saj. Shkatërrimi i rastësishëm apo dëmtimi i sendit të marrë me qira vjen si pasojë e forcës madhore apo e ndonjë rasti për të cilin nuk është fajtorë asnjëra nga palët kontraktuese. Është fjala për shkakun e jashtëm dhe të paparashikuar, që ndodhëj jashtë sendit dhe shfrytëzimit të tij dhe që nuk ka mundur të pengohet, të shmanget ose të mënjanohet. Me dorëzimin e sendit të marrë me qira nuk kalon rreziku nga shkatërrimi ose dëmtimi i rastësishëm të tij tek qiramarrësi, siç është rasti me kalimin e rrezikut te kontrata e shitblerjes. Për këtë arsye rrezikun për shkatërrimin apo dëmtimin e rastësishëm të sendit e bartë qiradhënësi gjatë tërë kohëzgjatjes së raportit qiramarrës. Me këtë dispozitë rregullohet shuarja e kontratës për qiranë për shkak të shkatërrimit të sendit nga forca madhore apo një rast tjetër, për të cilin asnjëra palë kontraktuese nuk është fajtorë, kur: a) sendi i marrë me qira është shkatërruar dhe b) sendi i marrë me qira është shkatërruar pjesërisht ose vetëm është dëmtuar.

613.1 Nëse shkatërrohet sendi i marrë me qira nga forca madhore apo nga një rast për të cilin nuk është përgjegjëse as njëra palë kontraktuese, sendi i marrë me qira fare nuk mund të shfrytëzohet, prandaj raporti i qirasë e humb kuptimin e vet. Për këtë arsye, kontrata për qiranë pushon sipas vetë ligjit. Qiradhënësi nuk është i detyruar t'ia dorëzojë qiramarrësit një send tjetër, kurse qiramarrësi është i liruar nga detyrimi i pagesës së qirasë nga momenti i shkaktimit të rastit, i cili konsiderohet forcë madhore. Nëse ndonjëra palë kontraktuese ka përmbushur diçka nga detyrimi i saj para se ai detyrim të arrinte për përmbushje, mund të kërkojë kthimin, sipas rregullave për kthimin e pasurimit të pa bazë, (shih rregullën e përgjithshme për pamundësinë e përmbushjes, për të cilën nuk përgjigjet asnjëra palë - dispozita e nenit 120 paragrafi 1 i LMD).

613.2 Nëse sendi i marrë me qira është shkatërruar vetëm pjesërisht ose vetëm është dëmtuar, qiramarrësi i ka në dispozicion dy mundësi: a) mund ta zgjidhë kontratën ose b) të kërkojë zbritjen përkatëse të çmimit të qirasë, nëse do që edhe më tej të mbetet në qiramarrje, (të shihet gjithashtu rregulla e përgjithshme për pamundësinë e përmbushjes, për të cilën nuk përgjigjet asnjëra palë – dispozita e nenit 120 paragrafi 2 i LMD). Zgjidhja e kontratës vepron **ex nunc**, sepse qiramarrësi veç e ka shfrytëzuar sendin e marrë me qira gjer në momentin e shkaktimit të forcës madhore apo ndonjë rasti për të cilin nuk përgjigjet asnjëra palë kontraktuese.

Neni 614. Vdekja

Në rast te vdekjes të qiramarrësit ose të qiradhënësit, qiraja vazhdon me trashëgimtarë të tij, po qe se nuk është kontraktuar ndryshe.

614. Sipas natyrës së vet juridike, kontrata për qiranë nuk lidhet nisur nga karakteristikat personale të palëve kontraktuese, (nuk është kontratë e lidhur **intuitu personae**). Për pasojë, me vdekjen e qiradhënësit apo qiramarrësit nuk pushon marrëdhënia e qirasë, por ajo vazhdon me trashëgimtarët e kontraktuesit të vdekur. Gjithashtu, me shuarjen e qiradhënësit apo qiramarrësit, si persona juridikë, të drejtat dhe detyrimet kalojnë mbi pasardhësin e tyre juridik. Mirëpo, kontrata për qiranë do të shuhet kur palët kontraktuese janë marrë vesh që, në rast të vdekjes apo shuarjes së qiradhënësit apo qiramarrësit, të shuhet edhe kontrata. Në këtë rast, mbi trashëgimtarët, përkatësisht pasardhësit juridikë të tyre nuk kalojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën për qiranë.

Nerxhivane Dauti

Neni 615. Kuptimi

Me kontratën për veprën kryerësi i punëve detyrohet të kryejë një punë të caktuar, sikurse është prodhimi ose riparimi i ndonjë sendi ose kryerja e ndonjë pune fizike ose intelektuale e të ngjashme kurse porositësi është i detyruar për atë të paguajë shpërblimin.

Kontrata për veprën është marrëveshje midis kryerësit të punës dhe porositësit, me të cilën kryerësi i punës detyrohet ta kryejë një punë të caktuar, siç janë prodhimi ose riparimi i ndonjë sendi, kryerja e ndonjë punë fizike ose intelektuale etj., kurse porositësi detyrohet që për këtë të paguajë një shpërblim të caktuar (neni 615 i LMD). Kontrata për veprën hyn në grupin e kontratave për shërbimet. Kjo kontratë ka ngjashmëri me kontratën për punën dhe shitjen. Nëse me kontratë caktohet natyra e punës dhe rezultati që realizohet me të, kurse kryerësi i punës është i pavarur në punë, për këtë do të lidhet kontratë për veprën. Ndërkaq, nëse me kontratë nuk është caktuar lloji i punës, por punëtori është i detyruar që gjatë punës të bëjë atë që ia cakton punëdhënësi, atëherë ajo do të jetë kontratë për punën. Në kontratën për punën objekt i kontratës është vetë puna, kurse në kontratën për veprën objekt i kontratës është rezultati i punës. Theksuam se kjo kontratë është e afërt me kontratën e shitjes. Për t'i dalluar këto dy kontrata, vendimtar është karakteri i lëndës së punimit: nëse caktohet se si duhet të punohet lënda, do të kishim kontratë për veprën, kurse nëse bëhet individualizimi sa i përket punimit të lëndës, por ajo prodhohet në mënyrë serike, atëherë kemi të bëjmë me kontratë të shitjes.³⁷⁰ Kontrata për veprën lidhet midis porositësit të punës dhe kryerësit të punës. *Kryerësi i punës* është i detyruar ta kryejë veprimin e caktuar ose të realizojë rezultatin e caktuar. *Porositësi i punës* është i detyruar të paguajë shpërblimin për punën, ose për veprimin e kryer. Kontrata për veprën lidhet me qëllim që të përdoret puna e huaj dhe të arrihet rezultati i caktuar.

Kontrata për veprën e ka gjenezën që në të drejtën romake, ku njihet si **locatio conductio operis**.³⁷¹ Me zhvillimin e bujqësisë e të zejtarisë, kjo kontratë praktikohet shumë shpesh për transportimin e sendeve, për ndërtimin e objekteve, për riparimin e ndonjë sendi, për korrijen e të lashtave bujqësore, për shirjen e tyre etj.³⁷²

Kontratën për veprën e karakterizojnë tipare të caktuara, sipas të cilave ajo është::

- *kontratë me emër* (contractus nominatum), sepse e ka emrin e caktuar dhe rregullativën e caktuar shprehimisht në kodet civile dhe në ligjet për marrëdhëniet e detyrimeve; LMD këtë kontratë e parashikon shprehimisht në nenin 615 të këtij Ligji;

.....
370 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 150, 151; Komentar ZOO, Knjiga II, Bg., 1995, fq. 1080.

371 Dr. R. Stojčević, *Rimsko obligaciono pravo*, Beograd, 1960, fq. 90.

372 Komentar ZOO, Knjiga II, Bg., 1995, fq. 1081.

- *kontratë komutative*, në të cilën të dy palët kontraktuese i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre prej çastit kur lidhet kontrata;
- në përbërje të grupit të *kontratave intuitu personae*, e cila lidhet duke pasur parasysh cilësitë e veçanta personale të kontraktuesve, sepse ekzekutimi i detyrimit është i lidhur ngushtë me cilësitë e kontraktuesve;
- *kontratë kauzale*, në të cilën dihet qëllimi i detyrimit si për palët kontraktuese, ashtu edhe për personat e tretë;
- *kontratë e pavarur*, sepse krijon efekte juridike, pavarësisht nga ndonjë kontratë tjetër;
- *kontratë e dyanshme detyruese dhe me shpërblim*, sepse, pasi të jetë lidhur, krijohen të drejta dhe detyrime për të dy palët kontraktuese. Porositësi për atë që merr nga kryerësi i punës, jep kundërvlerën e caktuar - shpërblimin;
- *kontratë konsensuale (solo consensus)*, e cila lidhet me pëlqimin e thjeshtë të vullnetit të palëve kontraktuese për lëndën e punës që duhet të kryhet dhe për shpërblimin për punën e kryer. Mirëpo, për disa lloje të veçanta të kontratës për veprën është parashikuar domosdoshmëria e lidhjes së tyre në formën me shkrim, p.sh., kontrata për ndërtimin;
- *kontratë e thjeshtë*, që përmban elemente vetëm të një kontrate, (pra vetëm të kontratës për veprën).

Për krijimin e kontratës për veprën, kontraktuesit duhet ta shprehin lirisht vullnetin e tyre për elementet thelbësore (essentialia negotii) të saj. Si elemente thelbësore të kontratës për veprën konsiderohen: puna ose veprimi që duhet të kryhet, shpërblimi që duhet të paguhet dhe kohëzgjatja e kësaj kontrate. Përveç shprehjes së lirë të vullnetit, si kushte kryesore të kësaj kontrate janë edhe aftësia për të vepruar e palëve kontraktuese, lënda dhe baza e kontratës. Puna ose veprimi që duhet të kryhet dhe shpërblimi për punën e kryer përbëjnë lëndën e kontratës për veprën.

Puna ose veprimi që duhet të kryhet paraqet elementin thelbësor të kontratës për veprën. Sipas përmbajtjes së saj materiale, puna e kryerësit të punës mund të jetë qoftë punimi i sendeve (qepja e rrobave, ndërtimi i objekteve të banimit), qoftë ndërmarrja e punëve të dobishme për porositësin (transportimi i udhëtarëve, bartja e sendeve), qoftë kryerja e ndonjë veprimi intelektual (mbajtja e ligjëratave, shfaqja e koncerteve). Në këto punë ose veprime njësoj do të jetë nëse ai do ta kryejë punën duke përdorur ndonjë mjet ndihmës mekanik, apo me fuqinë e vet fizike ose mendore.³⁷³ Lëndë e këtyre veprimeve dhe punëve mund të jetë një send lëndor, një send trupor i luajtshtëm ose i paluajtshtëm, ose send jotrupor. Puna që do të kryhet duhet të jetë e lejuar, e caktuar dhe e mundshme.³⁷⁴

Për sa i përket afatit, porositësi dhe kryerësi i punëve mund ta caktojnë me anë të marrëveshjes kohëzgjatjen e kryerjes së punës së caktuar. Afati i kohëzgjatjes në kontratën

373 Komentar ZOO, Kniga II, Bg., 1995, fq. 1083.

374 Po aty, fq. 1084.

për veprën caktohet shprehimisht me marrëveshjen e palëve, por edhe heshtazi. Paraqiten raste në të cilat afati i kohëzgjatjes sipas kësaj kontrate caktohet suksesivisht, duke i pasur parasysh afatet e punëve të kryera pjesë-pjesë.³⁷⁵ Në rast se afati i kohëzgjatjes nuk është caktuar, atëherë ai caktohet duke pasur parasysh natyrën e punës që duhet të kryhet.

Efektet e kontratës për veprën shprehen në të drejtat dhe detyrimet e kryerësit të punës (veprës) dhe të porositësit të punës.

Kryerësi i punës ka të drejtë të kërkojë:

- t'i paguhet çmimi i shërbimit; shpërblimi caktohet me marrëveshjen e palëve ose në bazë të dispozitës ligjore;
- nga porositësi një material të caktuar për kryerjen e punës ose për të arritur rezultat në punë;
- mënjanimin e mungesave në materiale ose të zëvendësohet sendi me mungesa me sendin pa mungesa;

Porositësi i punës, në bazë të kontratës për veprën, ka të drejtë të kërkojë:

- kryerjen e punës dhe arritjen e rezultatit ashtu siç janë marrë vesh,
- mënjanimin e mungesave nga puna e kryer,
- dorëzimin e veprës së kryer brenda afatit të caktuar dhe
- zgjidhjen e kësaj kontrate, në rast se kryerësi i punës i cenon detyrat e veta.

Përveç të drejtave, kryerësi dhe porositësi i punës kanë edhe detyrime të caktuara.

Neni 616. Raporti me kontratën për shitjen

- 1. Kontrata me të cilën njëra palë detyrohet të prodhojë një send të caktuar të luajtshëm prej materialit të vet konsiderohet në rast dyshimi kontratë për shitje.**
- 2. Kontrata mbetet kontratë për veprën në qoftë se porositësi është detyruar të japë pjesën thelbësore të materialit të nevojshëm për prodhimin e sendit.**
- 3. Në çdo rast kontrata konsiderohet kontratë për vepër, në qoftë se kontraktuesit kanë pas për qëllim veçanërisht punën e kryerësit.**

Raportin e kontratës për veprën me kontratën e shitjes e rregullon neni 616 i LMD. Kur në rastin konkret me kontratën e veprës, me të cilën njëra palë kontraktuese (kryerësi i punës) detyrohet të prodhojë një send të caktuar të luajtshëm prej materialit të vet, në rast se dyshimi kjo konsiderohet kontratë për shitjen. Megjithatë, konsiderohet dhe mbetet kontratë për veprën, në qoftë se porositësi të kontrata për veprën është detyruar të japë pjesën thelbësore të materialit të nevojshëm për prodhimin e sendit të caktuar nga marrëdhënia kontraktore e

.....
375 Po aty.

krijuar. Mirëpo, sipas parag. 3 të nenit 616, kontrata konsiderohet kontratë për veprën, në qoftë se palët kontraktuese, porositësi i punës dhe kryerësi i punës, kanë pasur për qëllim në veçanti punën e kryerësit të punës. (Për këtë çështje, shih dispozitat juridike të nenit 621, 622, 628 të LMD).

Neni 617. Cilësia e materialit të kryerësit

- 1. Në qoftë se është kontraktuar që kryerësi të prodhojë një send prej materialit të vet, ndërsa nuk është caktuar cilësia, sipërmarrësi ka për detyrë të japë material të cilësisë së mesme.**
- 2. Ai i përgjigjet porositësit për cilësinë e materialit njësoj si shitësi.**

Kryerësit të punës materiali për kryerjen e punës duhet t'i dorëzohet në mënyrën, në kohën dhe në vendin ashtu siç janë marrë vesh me kontratë (p.sh., stofin dhe pjesët tjera për qepjen e rrobave rrobaqepësit).

Në qoftë se është kontraktuar që kryerësi të prodhojë një send prej materialit të vet, ndërsa në rastin konkret nuk është caktuar cilësia e materialit, sipërmarrësi ka për detyrë të dorëzojë material të cilësisë së mesme. Kuptimi i *cilësisë së mesme* caktohet sipas standardeve përkatëse, e cila paraqitet si çështje faktike që vlerësohet prej rastit në rast. Cilësia e mesme e një materiali paraqet një material të mirë të cilësisë së mesme – domethënë një material midis të mesmit dhe të dobët.

Kryerësi i punës përgjigjet për cilësinë e materialit njësoj si shitësi. (Parag. 2 i nenit 617 të LMD).

Porositësi ka për detyrë ta kontrollojë veprën e kryer, nëse sipas rrjedhës së rregullt të punës ky kontrollim është i mundur dhe për të metat e konstatuara pa shtyrje ta njoftojë kryerësin e punëve.

Në qoftë se porositësi nuk i përgjigjet ftesës së kryerësit të punës që ta kontrollojë dhe pranojë veprën e kryer pa ndonjë shkak të arsyeshëm, konsiderohet se vepra është pranuar.

Pas kontrollit dhe pranimin të punës së kryer, sipërmarrësi nuk përgjigjet më për të metat që kanë mund të vërehen me kontroll të zakonshëm, përveç kur ai i ka ditur ato të meta dhe nuk e ka njoftuar porositësin. (Neni 629 i LMD).

KREU 2 MBIKËQYRJA

Neni 618. Mbikëqyrja

Porositësi ka të drejtë të bëjë mbikëqyrjen e kryerjes së punës e të japë udhëzime kur kjo i përgjigjet natyrës së punës, ndërsa kryerësi ka për detyrë t'ia bëjë të mundur këtë. 132

Mbikëqyrja te kontrata për veprën rregullohet në nenin 618 të LMD. Sipas Ligjit, porositësi ka të drejtë të bëjë mbikëqyrjen e kryerjes së punës. Porositësi gjithashtu ka të drejtë të japë udhëzime kur kjo i përgjigjet natyrës së punës, ndërsa kryerësi ka për detyrë t'ia bëjë të mundur këtë.

Porositësi është i detyruar ta marrë punën e kryer, kur ajo është kryer sipas dispozitave të kësaj kontrate dhe rregullave të profesionit. Nëse puna e kryer nuk merret nga porositësi për ndonjë shkak i arsyeshëm, atëherë ai vonohet dhe ka pasojat e vonesës së tij. Vonesa e porositësit është vonesë e kreditorit. Pasojat kryesore të kësaj vonese janë se merret se porositësi ka marrë sendin, për këtë arsye nuk mund të bazohet në mungesat e sendit të kryer që kanë mundur të vërehen me kontrollim të rëndomtë. Një pasojë tjetër është ajo se tani kryerësi i punës veprën e mban si ruajtës, gjë që do të thotë se ky tani ka të drejtë të kërkojë shpërblim për ruajtje. Zhdukja dhe dëmtimi i sendit i sjellin pasoja porositësit. Nëse vazhdon mosmarrja e paarsyeshme në dorëzim e veprës së kryer, kryerësi i punëve mund të kërkojë që, me vendimin e gjykatës, t'i besohet sendi për ruajtje një personi tjetër dhe kjo me shpenzime dhe në ngarkim të porositësit.³⁷⁶

KREU 3 LIDHJA E KONTRATËS ME ANË TË ANKANDIT

Neni 619. Ftesa për ankand mbi çmimin e punimeve

- 1. Ftesa e drejtuar numrit të caktuar ose të pacaktuar personash, në kushtet e caktuara dhe me garanci të caktuara, detyron ftuesin të lidhë kontratën për ato punime me atë që ofron çmimin më të ulët, përveç nëse këtë detyrim e ka përjashtuar me ftesën për ankand.**
 - 2. Në rastin e përjashtimit të detyrimit për të lidhë kontratën, ftesa për ankand konsiderohet si ftesë të interesuarve që ata të bëjnë oferta të kontratës sipas kushteve të shpallura.**
-

.....
376 Ivan Bukjaš, Komentar ZOO, II, Zag., 1978, fq. 302; Komentar ZOO, II, Bg. 1980, fq. 95.

Sipas rregullave tradicionale të së drejtës kontraktore, kontratat lidhen me paraqitjen e ofertës dhe pranimin e saj. Këto rregulla i kemi edhe te kjo kontratë. Ofertën zakonisht e bën porositi për kryerësin e punës. Pasi që kontrata për veprën është kontratë konsensuale, edhe oferta bëhet në mënyrë joformale, me gojë, me telefon, me shkrim, me telegram, me teleprinter dhe me lidhje të drejtpërdrejta. Pra, këtu bëhet deklarata e ofertuesit dhe pranimi i saj nga pranuesi, përkatësisht deklarata bëhet nga porositi, kurse pranimi bëhet nga kryerësi i punëve.³⁷⁷

Nga rregulla e lartpërmendur ka edhe përjashtim, sepse LMD ka parashikuar rëndësinë që kjo kontratë të lidhet me ankand publik. Qëllimi kryesor i kësaj lidhjeje është që të kontraktohet një çmim më i ulët për kryerjen e punëve të caktuara. Ftesa u bëhet personave të caktuar ose personave të pacaktuar, në mënyrë publike, për kryerjen e punëve të caktuara me kushte të caktuara dhe me garanci të caktuara. Kjo ftesë e obligon ftuesin që të lidhë kontratën për këto punë me atë që i ofron çmimin më të ulët. Përjashtim nga kjo rregull bëhet kur këtë detyrë e përjashton nga ftesa për ankand (neni 784 i LMD). Në këtë mënyrë, lidhet kjo kontratë për punët me vëllim të madh, për punët që kanë rëndësi kulturore, artistike, ekonomike. Personi që shpallë konkursin, ankandin publik, është i detyruar t'i caktojë kushtet e kryerjes së punëve. Aty zakonisht bëhet përshkrimi i saktë i punëve, mënyra e formimit të çmimeve, dokumentacioni, përshtatshmëria e kryerjes së punëve, afati dhe mënyra e paraqitjes së ofertës, mënyra e verifikimit të saj etj. Kuptohet, në këtë rast dhënësi i ofertës është i detyruar të respektojë këto kushte të cekura në ofertë.³⁷⁸ Nëse oferta u bëhet personave të caktuar, atëherë këto oferta tubohen nga personat ndaj të cilëve është bërë oferta. Pastaj këto oferta shqyrtohen nga komisioni në prani të ofertuesit. Pas shqyrtimit të ofertës, kontrata lidhet me të ofertuarin që ofron çmimin më të ulët. Mirëpo, këtu duhet cekur se në praktikë kontrata nuk lidhet gjithnjë me të ofertuarin që ofron çmimin më të ulët, por që ofron kushtet më të mira për kryerjen e punëve. Me fjalë tjera, kontrata lidhet me të ofertuarin më të përshtatshëm. Ndërkaq, konsiderohet se i ofertuari më i përshtatshëm është ai që ofron çmimin më të ulët, që ka përvojë në kryerjen e punëve, që ka aftësi profesionale, që posedon kuadër profesional dhe teknikë e pajisje të caktuara.³⁷⁹ Nga ana tjetër, ftuesi në ankand është i detyruar të marrë vendimin për dhënien e punëve sipas procedurës së parashikuar në ankand dhe këtë vendim duhet ta arsyetojë. Nëse cenohet kjo procedurë, atëherë kjo tërheq përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit të të ofertuarit. Në qoftë se oferta u bëhet personave të pacaktuar, atëherë bëhet ankandi publik. Ky ankand publik bëhet me shkrim. Kjo gjendje zgjat kështu gjer në skadimin e afatit të caktuar. Pastaj komisioni i zgjedhur mbledh dhe shqyrton ofertat e arritura. Pas kësaj, shpallet ftuesi i ankandit publik, i cili fiton të drejtën ta lidhë kontratën për veprën me atë që ka ofruar çmimin më të ulët. Ftuesi i ankandit merr vendim për lidhjen ose moslidhjen e kësaj kontrate.³⁸⁰ Kur kemi të bëjmë me ndërtimin e objekteve investive, parashikohen

377 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag., 1979, fq. 1934, Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 83, Dr. Ivan Bukljaš: Komentar ZOO II, Zag., 1978, fq. 295.

378 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 85.

379 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II, Zag. 1979, fq. 1898-1900

380 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 83.

dispozita për detyrimin e ankandit publik në këtë rast. Mirëpo, këtu s' duhet harruar se në disa raste të veçanta objekti i ndërtimit mund t'i jepet personit të caktuar edhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

Ka raste kur përjashtohet detyrimi që të lidhet kontrata, sepse ftesa për ankand konsiderohet si ftesë e të interesuarve që ata të bëjnë ofertën e kontratës në kushtet e shpallura. Sikundër shihet, këtu mundësohet të bëhet zgjedhja e ofertuesve për lidhjen e kontratës.³⁸¹

Neni 620. Ftesa për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të punëve të synuara.

Ftesa e drejtuar numrit të caktuar ose të pacaktuar personash për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të punimeve të synuara, detyrojnë ftuesin që sipas kushteve të përmbajtura në ftesë për ankand të lidhë kontratën me pjesëmarrësin e ankandit, zgjedhja e të cilit është pranuar nga komisioni me përbërjen e shpallur që përpara, përveç nëse këtë detyrim e ka përjashtuar në ftesën e ankandit.

LMD në nenin 620 ka parashikuar një dispozitë të veçantë lidhur me ftesën për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të punëve të caktuara. Kjo ftesë u bëhet personave të caktuar ose të pacaktuar për ankand për zgjidhjen artistike ose teknike të punëve të caktuara. Në këtë rast, kjo ftesë obligon ftuesin që në kushtet e parashikuara në ftesën për ankand të lidhi kontratë me pjesëmarrësin në ankand, zgjedhja e të cilit miratohet nga komisioni. Përbërja e komisionit është e caktuar dhe e shpallur që më parë. Ftuesi, sipas këtij neni, nuk është i detyruar të lidhë këtë kontratë, nëse ka përjashtuar obligimin e vet në pjesën për ankand. Siç shihet, këtu nuk është qëllimi që të arrihet çmimi më i përshtatshëm, por qëllimi është që të arrihet zgjidhja artistike ose teknike që është më e përshtatshme për realizimin e veprës.³⁸²

KREU 4

DETYRIMET E KRYERËSIT

Neni 621. Te metat e materialit

1. Kryerësi ka për detyrë ta paralajmërojë porositësin për të metat e materialit që e ka dorëzuar porositësi, që i ka vënë re ose është dashur t'i vërejë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin.

.....
381 Dr. Boris Vizner – Dr. Ivan Bukljaš: Komentar ZOO II, Zag., 1979, fq. 1900, Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 83.

382 Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 84, Dr. Ivan Bukljaš: Komentar Zoo I II Zag. 1978, fq. 295.

2. Në qoftë se porositësi i ka kërkuar që sendi të prodhohet prej materialit për të metat e të cilit kryerësi i'a ka treguar, kryerësi ka për detyrë të veprojë sipas kërkesës së tij, përveç nëse është e qartë se materiali nuk është i përshtatshëm për veprën e porositur ose në qoftë se prodhimi prej materiali të kërkuar do të mund t'i bëjë dëm prestigjit të kryerësit , në të cilin rast kryerësi mund ta zgjidhë kontratën.
3. Kryerësi ka për detyrë ta paralajmërojë porositësin për të metat në urdhrin e tij dhe për rrethana të tjera që ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni të cilat mund të jenë të rëndësishme për veprën e porositur ose për kryerjen në kohë, përndryshe do të përgjigjet për dëmin.

Kryerësi i punës i bartë edhe detyrimet e caktuara nga kontrata për veprën. Kryerësi ka për detyrë ta paralajmërojë porositësin për të metat e materialit që e ka dorëzuar porositësi, që i ka vënë re, përndryshe do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Në qoftë se porositësi ka kërkuar që sendi të prodhohet prej materialit për të metat e të cilit kryerësi i punës i ka treguar, kryerësi ka për detyrë të veprojë sipas kërkesës së tij, me përjashtim të rasteve kur është e qartë se materiali nuk është i përshtatshëm për veprën e porositur ose në qoftë se prodhimi prej materialit të kërkuar do t'i shkaktonte dëm autoritetit të kryerësit të punës, ashtu që në këto raste kryerësi do të kishte të drejtë ta zgjidhte kontratën. LMD parashikon detyrën e paralajmërimit që kryerësi i punës ta lajmërojë porositësin e punës për të metat në urdhrin e tij dhe për rrethana të tjera që ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni, të cilat mund të jenë të rëndësishme për veprën e porositur, përndryshe do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar.

Neni 622. Detyrimi për ta kryer veprën

1. Kryerësi ka për detyrë ta kryejë veprën si është kontraktuar dhe sipas rregullave të punës.
2. Ai ka për detyrë ta kryejë veprën për kohën e caktuar, e në qoftë se kjo nuk është caktuar, atëherë për një kohë të arsyeshme që nevojitet për punë të tilla.
3. Ai nuk përgjigjet për vonesë, të shkaktuar për shkak se porositësi nuk ia ka dorëzuar materialin në kohë, apo për shkak se ka kërkuar ndryshime, apo sepse nuk ia ka paguar paradhënien e kontraktuar dhe në përgjithësi për vonesë të shkaktuar nga sjellja e porositësit.

Kryerësi i punës është i detyruar ta kryejë punën sipas kontratës. “Ai ka për detyrë ta kryejë punën ashtu siç është kontraktuar dhe sipas rregullave të punës” (neni 622 parag. 1 i LMD). Detyra e kryerjes së punës përfshin edhe detyrën e kryerësit të punës që punën ta kryejë me rregull dhe në afat. Kryerja e rregullt e punës do të thotë kryerje sipas të gjitha rregullave profesionale që kërkohen nga subjektet që merren me të. Kryerja e punës me kohë do të thotë kryerje në kohën që është caktuar në kontratë ose që rrjedh nga natyra e

punës. “Nëse ky afat nuk është caktuar, atëherë ai duhet ta kryejë për kohën e cila është e arsyeshme për punën e caktuar” (neni 622 parag. 2 i LMD). Afat i arsyeshëm është afati që kërkohet për t’u përfunduar puna ose afati për kryerjen e pakicës së punëve që kanë ngelur nga detyrimi kryesor. Kryerësi i punës ka për detyrë që t’ia tërheqë vërejtjen porositësit për mungesat e materialit, për cilësinë e dobët të tij. Nëse nuk i përfill këto, do t’i përgjigjet porositësit për dëmin e caktuar. Kryerësi i punës ka për detyrim që personalisht ta kryejë punën (*intuitu personae*), meqenëse në çastin e lidhjes së kontratës për veprën janë pasur parasysh cilësitë e veçanta personale të kryerësit të punës, ashtu që asnjë person i tretë nuk mund ta zëvendësojë, p.sh., është lidhur kontrata për veprën, duke pasur parasysh aftësitë e arkitektit ose aftësitë profesionale të profesorit të caktuar për mbajtjen e ligjëratës në një lëndë të caktuar. Vdekja e kryerësit të punës në këto raste (ose humbja e aftësisë punuese) ka për pasojë shuarjen e kontratës. Porositësi ka të drejtë të kërkojë kthimin e materialit dhe te sendeve të tjera që i janë dorëzuar për ta kryer punën.³⁸³ Kryerësi i punës mundet gjatë kryerjes së punës t’i shfrytëzojë ndihmësit të cilët do të veprojnë sipas urdhrit të tij, por në atë rast për rezultatet e punës do të përgjigjet vetëm kryerësi i punës.

Neni 623. Zgjidhja e kontratës për shkak të shmangies nga kushtet e kontraktuara

- 1. Në qoftë se gjatë kryerjes së veprës tregohet se kryerësi nuk u përmbahet kushteve të kontratës dhe në përgjithësi nuk punon si duhet, kështu që vepra e kryer do të ketë të meta, porositësi mund ta paralajmërojë kryerësin për këtë dhe t’i caktojë afat plotësues që punën e vet t’ua përshtatë detyrimeve të veta.**
- 2. Në qoftë se deri në skadimin e këtij afati kryerësi i punës nuk vepron sipas kërkesës së porositësit, ky mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.**

Rastet më të shpeshta të shuarjes së kontratës për veprën janë ato që shkaktohen për arsye të mosekzekutimit. Ky mosekzekutim i kontratës mund të jetë i plotë ose i pjesshëm. Me këto lloje të mospërbushjes së kontratës kemi të bëjmë kur puna fare nuk është kryer ose puna nuk është kryer në mënyrë të rregullt. Sipas nenit 623 të LMD, në qoftë se gjatë kryerjes së veprës tregohet se kryerësi nuk u përmbahet kushteve të kontratës dhe në përgjithësi nuk punon si duhet, ashtu që vepra e kryer do të ketë të meta, porositësi mund ta paralajmërojë kryerësin për këtë dhe t’i caktojë një afat plotësues që punën e vet t’ua përshtatë detyrimeve të veta. Ky rast i parashikuar i shuarjes ka për qëllim që të diktojë që puna e kryer të bëhet sipas porosisë dhe kontratës. Me respektimin e kushteve të kontratës realizohet qëllimi i saj. Sipas parag. 2 të nenit 623 të LMD, në qoftë se deri në skadimin e këtij afati kryerësi i punës nuk vepron sipas kërkesës së porositësit, ky mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

.....
383 Po aty, fq. 1092.

Neni 624. Zgjidhja e kontratës para kalimit të afatit

- 1. Në qoftë se afati është element thelbësor i kontratës, ndërsa kryerësi është aq në vonesë me fillimin ose me kryerjen e punës, sa që është e qartë se nuk do ta kryejë brenda afatit, porositësi mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.**
- 2. Ai ka këtë të drejtë edhe atëherë kur afati nuk është element thelbësor i kontratës në qoftë se për shkak të vonesës së tillë porositësi qartazi nuk do të kishte interes për përmbushjen e kontratës.**

Sipas nenit 624, ekziston mundësia e zgjidhjes së kontratës para afatit të parashikuar me kontratë. Në qoftë se afati është element thelbësor i kontratës, ndërsa sipërmarrësi është në vonesë me fillimin ose me kryerjen e punës, sa që është e qartë se nuk do ta kryejë atë brenda afatit, porositësi mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblim dëmi. (Për çështjet lidhur me atë se kur lidhet kontrata fikse dhe pasojat e saj, shih më hollësisht nenet përkatëse që i trajtojnë këto çështje).

Sipas parag. 2, porositësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën, edhe atëherë kur afati nuk është element thelbësor i kontratës, në qoftë se për shkak të një vonese të tillë porositësi qartazi nuk do të kishte interes për përmbushjen e kontratës.

Neni 625. Besimi i kryerjes së punës personit të tretë

- 1. Në qoftë se nga kontrata ose nga vetë natyra e punës nuk rrjedh diçka tjetër, kryerësi nuk e ka për detyrë që punën ta kryejë personalisht.**
- 2. Kryerësi edhe me tej i përgjigjet personit për kryerjen e punës edhe kur punën nuk e kryen personalisht.**

Besimi i kryerjes së punës personit të tretë gjen shprehje në nenin 625 të LMD. Si rregull, kontrata për veprën hyn në grupin e kontratave *intuitu personae*, e cila lidhet duke pasur parasysh cilësitë e veçanta personale të kontraktuesve, sepse ekzekutimi i detyrimit është i lidhur ngushtë me cilësitë e kontraktuesve.

Sipas nenit 625, para. 1 i LMD, në qoftë se nga kontrata ose nga vetë natyra e punës nuk rrjedh diçka tjetër, kryerësi nuk e ka për detyrë që punën ta kryejë personalisht. Mirëpo ekziston përgjegjësia, ashtu që kryerësi edhe më tej i përgjigjet personit për kryerjen e punës edhe kur punën nuk e kryen personalisht. Te kontrata për veprën, e drejta e heqjes dorë gjersa vepra nuk është kryer i takon vetëm porositësit. Është kështu sepse këtu bëhet fjalë për besimin se kujt duhet t'i jepet kryerja e punëve e gjithashtu edhe për angazhimin e mjeteve të caktuara të porositësit. Për këtë shkak te kjo kontratë përmbushja e saj për porositësin nuk paraqet detyrë, por të drejtë që të kujdeset sesi po kryhet puna dhe a do të realizohet rezultati i caktuar.

Neni 626. Përgjegjësia për bashkëpunëtorët

Kryerësi përgjigjet për personat të cilët sipas urdhrit të tij kanë punuar në punën që e ka marrë përsipër ta kryejë, sikur ta ketë kryer vet.

Nga ana tjetër kryerësi përgjigjet për personat të cilët, sipas urdhrit të tij, kanë punuar punën që ky ka marrë përsipër ta kryejë sikur ta ketë kryer vetë - neni 626 i LMD. Këtu është rasti kur kryerësi personalisht nuk është i detyruar ta kryejë punën. Atëherë, ai zakonisht ia beson kryerjen e punëve bashkëpunëtorëve të vet, meqë kryerësi përgjigjet për ta. Pra, kryerësi i punëve përgjigjet për punën e punëtorëve të vet dhe të personave të tjerë, të cilëve ua ka besuar pjesërisht ose tërësisht punën. Nëse, p.sh., kryerësi i punëve është organizatë, ajo mund t'i kryejë punët nëpërmjet punëtorëve të vet dhe personave të tjerë, atëherë, si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, kryerësi i përgjigjet porositësit të punës kur shkaktohet ndonjë dëm ose kur s'kryhet puna si duhet.³⁸⁴

Neni 627. Kërkesa e drejtpërdrejtë e bashkëpunëtorëve të kryerësit ndaj porositësit

Për arkëtimin e kërkesave të veta nga kryerësi, bashkëpunëtorët e tij mund t'i drejtohen drejtpërdrejt porositësit dhe të kërkojnë prej tij që t'u paguajë këto kërkesa në ngarkim të shumës të cilën ai në këtë çast i ka borxh kryerësit, në qoftë se këto kërkesa janë pranuar.

Nëse kryerësi i punës kryen dhe dorëzon veprën e porositur në mënyrë të rregullt, atëherë ai fiton të drejtën që të realizojë një kërkesë të caktuar. Kjo çështje është parashtruar në nenin 627 të LMD. Mirëpo, nëse punët i kanë kryer bashkëpunëtorët e kryerësit të punëve, atëherë edhe ata fitojnë të drejtën për realizimin e kërkesës së caktuar. Edhe këtë çështje e rregullon neni 627 i LMD. Pra, bashkëpunëtorët përmbushjen e kërkesave të veta që kanë ndaj kryerësit të punëve mund ta realizojnë duke iu drejtuar drejtpërdrejt porositësit për t'ua paguar kërkesat e veta, që llogariten në kuadër të borxhit që i ka porositësi kryerësit të punëve. Kuptohet se këta mund të realizojnë kërkesat e veta nga porositësi vetëm për borxhin e pohuar të tij ndaj kryerësit të punëve. Qëllimi kryesor i ekzistimit të kësaj dispozite është që të lehtësohet pozita ekonomike e bashkëpunëtorëve të kryerësit të punëve. Këto kërkesa duhet të jenë likuide dhe të pohuara ndaj kryerësit të punës, sikurse edhe borxhi i porositësit ndaj kryerësit të punëve.³⁸⁵

384 Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO, II Zag., 1979, fq. 1911-1912, Komentar ZOO, Beog., 1980, fq. 88.

385 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag. 1979, fq 1911 -1912, Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 88.

Neni 628. Dorëzimi i sendit të prodhuar porositësit

- 1. Kryerësi ka për detyrë që sendin e prodhuar ose të riparuar t'ia dorëzojë porositësit.**
- 2. Kryerësi lirohet nga ky detyrim, në qoftë se sendi që e ka prodhuar ose riparuar shkatërrohet nga një shkak, për të cilin ai nuk përgjigjet.**

Kryerësi i punës duhet ta dorëzojë punën në mënyrën, në kohën dhe në vendin e caktuar në kontratë ose, kur këto nuk janë caktuar në kontratë, sipas natyrës së veprimit të marrë përsipër. Kryerësi i punës lirohet nga kjo detyrë, nëse sendi të cilin e ka prodhuar ose e ka ndrequr zhduket për shkakun për të cilin ai nuk përgjigjet (neni 628 parag. 2 i LMD). Çasti i dorëzimit të sendit është i rëndësishëm për çështjen e fitimit të pronësisë dhe për rrezikun me rastin e shkatërrimit të sendit nga vis maior (fuqia madhore). Kur sendi i është dorëzuar porositësit ose kur ai e refuzon marrjen dhe bën vonesën e kreditorit, kurse sendi shkatërrohet nga fuqia madhore, rreziku i asgjësimit të sendit e godit porositësin si pronar të sendit. Problemet paraqiten kur sendi asgjësohet nga fuqia madhore para se t'i dorëzohet porositësit. Këtu dallohen dy situata: kur kryerësi i punës e jep materialin për punimin e sendit, i cili asgjësohet derisa ndodhet te kryerësi i punës, sepse afati i dorëzimit të tij nuk ka skaduar ende; rreziku i humbjes së sendit i përket kryerësit të punës, si pronar i tij. Nëse porositësi i punës e jep materialin për punimin e sendit, kurse ai zhduket derisa është te kryerësi i punës, rreziku i humbjes së sendit nga ndikimi i fuqisë madhore e godit porositësin e punës, si pronar i sendit, edhe pse humbja është paraqitur derisa ka qene duke u punuar te kryerësi i punës, sipas rregullës tradicionale *res perit domino*. Kryerësi i punës përgjigjet për mungesat e veprës së kryer (nenet 629-635 të LMD). Kryerësi në çdo rast i përgjigjet porositësit të punës për mospërmbushjen e kontratës, pa marrë parasysh se kush e ka materialin për punimin e sendit.

KREU 5

PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT

Neni 629. Kontrollimi i veprës së kryer dhe njoftimi i kryerësit

- 1. Porositësi ka për detyrë ta kontrollojë veprën e kryer, nëse sipas rrjedhës së rregullt të të punës ky kontrollim është i mundur dhe për të metat e konstatuara pa shtyrje ta njoftojë kryerësin.**
- 2. Në qoftë se porositësi nuk i përgjigjet ftesës së kryerësit që ta kontrollojë dhe pranojë veprën e kryer pa ndonjë shkak të arsyeshëm, konsiderohet se vepra është pranuar.**
- 3. Pas kontrollit dhe pranimit të punës së kryer, kryerësi nuk përgjigjet më për të metat që kanë mund të vërehen me kontroll të zakonshme, përveç se ai ishte në dijeni për ato të meta dhe nuk e ka njoftuar porositësin.**

Kryerësi i punëve përgjigjet edhe për mungesat e veprës së kryer. Për këto çështje LMD parashikon dispozita të caktuara në nenin 629 të LMD. Sipas kësaj rregulle, së pari

porositësi është i detyruar ta kontrollojë veprën e porositur kur kjo, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave, është e mundshme, dhe për mungesat pa shtyrje ta lajmërojë kryerësin (neni 629 i LMD). Kontrollimi i veprës së kryer është detyrë e porositësit që duhet të bëhet për të vërtetuar nëse a ka vepra mungesa apo jo. Ai kontrollimin duhet ta bëjë ashtu si është kontraktuar ose, nëse kështu nuk është parashikuar, atëherë ai e bën këtë me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Kontrollimin duhet ta bëjë me kujdesin e ekonomistit të mirë, kur këtë e lejojnë rrjedhat e gjërave. Pasi që në shumicën e rasteve porositësi nuk është ekspert, atëherë këtë e bën komisioni i cili jep në procesverbal mendimin e vet. Koha e kontrollimit të veprës është kur ekziston mundësia objektive për një kontrollim të caktuar. Kur këto mungesa vërtetohen me kompetencë dhe konstatohen në procesverbal, atëherë për këto fakte pa shtyrje duhet ta lajmërojë kryerësin e punëve. Lajmërimi pa shtyrje në praktikë kuptohet kur lajmërimi bëhet në të njëjtën ditë kur është vërtetuar mungesa ose kur lajmërimi bëhet të nesërmen. Mirëpo, palët edhe mund të merren vesh për afatin e reklamimit të mungesave të veprës së kryer. Nëse ndodhë që gjatë kontrollit të jetë i pranishëm kryerësi i punëve, atëherë lajmërimi bëhet aty për aty.³⁸⁶

Nëse ndodh që porositësi të mos i përgjigjet ftesës së kryerësit për ta kontrolluar dhe ta pranohet punën e kryer dhe nuk ndërmerr asgjë pa ndonjë shkak të arsyeshem, atëherë konsiderohet se porositësi ka pranuar punën - neni 629 i LMD. Pasoja e parë është se konsiderohet që porositësi e ka pranuar veprën, edhe pse, në fakt, ende nuk e ka bërë këtë. Prej këtij momenti rrezikun e zhdukjes ose dëmtimit të veprës së kryer e merr përsipër porositësi. Pasoja tjetër është se porositësi ka për detyrë që t'i paguajë shpenzimet e ruajtjes së sendit. Këto pasoja nuk do t'i ketë porositësi, nëse nuk është fajtor për mosndërmarrjen e veprimeve të lartpërmendura. Ndërkaq, nëse ai vonohet për shkaqe të paarsyeshme për kontrollimin e veprës së kryer, ai i heq ato pasoja³⁸⁷.

Pas kontrollit dhe pranimit të veprës së kryer, kryerësi i punëve më nuk përgjigjet për mungesat që kanë mundur të vërehen me kontrollim të rëndomtë, përveç kur ka ditur për mungesën dhe nuk e ka njoftuar për këtë porositësin (neni 629 parag. 3 i LMD). Këtu merret parasysh supozimi ligjor se vepra e kryer nuk ka mungesa. Ky supozim merret edhe në rast se porositësi është vonuar ndaj kreditorit. Kundërshtimet për shkak të mungesave të cilat ka mundur t'i vërejë me kontrollim nuk mund të bëhen më vonë. Në qoftë se kundërshtimet bëhen me vonesë, ato nuk merren parasysh. Neni 629 parag. 3 i LMD bën përjashtim, ngaqë, siç u tha më lart, edhe kryerësi i punëve përgjigjet për mungesat të cilat kanë mundur të vërehen me një kontrollim të rëndomtë, edhe kur porositësi nuk ka bërë kundërshtim me kohë, në rast se kryerësi i punës ka ditur për mungesat me rastin dorëzimit të sendit, por nuk ia ka bërë të ditura ato porositësit.³⁸⁸ Këtu duhet thënë se gjykatësi duhet të ketë parasysh rregullat e parimit të ndershmërisë dhe të ndërgjegjshmërisë.

386 Komentar ZOO II Beogr. 1980, fq. 89-90, Dr. Ivan Bukljas: Komentar ZOO I II Zag. 1978, fq. 299, Dr. Ivan Bukljas: - Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO III Zag. 1979, fq. 1914.

387 Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 89-90, Dr. Ivan Bukljas: Komentar ZOO II, 1978, fq. 299, Dr. Ivan Bukljas – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag. 1979, fq. 1914-1915.

388 Dr. Ivan Bukljas: Komentar ZOO II Zag. 1978, fq. 299, Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 90, Dr. Ivan Bukljas – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag. 1979, fq. 1915-1916.

Neni 630. Të metat e fshehura

- 1. Në qoftë se më vonë konstatohet ndonjë e metë e cila nuk ka mund të zbulohet me kontroll të zakonshëm, porositësi megjithatë mund të thirret në atë me kusht që për këtë ta njoftojë porositësin sa më parë, por jo më vonë se në afatin prej një (1) muaji nga zbulimi i saj.**
- 2. Me kalimin e dy (2) viteve nga pranimi i punës së kryer, porositësi nuk mundet më të thirret në të meta.**

Te kontrata për veprën puna e kryer mund të ketë edhe mungesa të fshehta. Këtë çështje LMD e ka parashtruar në nenin 630. Së pari, nëse ndonjë mungesë shfaqet më vonë, e cila nuk është vërejtur me një kontrollim të rëndomtë, atëherë lejohet që porositësi të mbështetet në këtë mungesë. Në këtë rast ai duhet sa më parë ta lajmërojë kryerësin e punës për mungesën e vërejtur. Ai këtë duhet ta bëjë në afatin prej një muaji, afat ky që rrjedh prej ditës së zbulimit të mungesës - neni 630 paragraf. 1 i LMD. Pra, këtu kemi mungesën e fshehur të veprës së kryer, e cila konsiderohet se ekziston kur ajo zbulohet me përdorim ose me kontrollim, p.sh., kur është riparuar automobili, mungesa mund të vërehet pas një vozitjeje të gjatë ose me përdorim normal. Këtyre mungesave porositësi mund t'u referohet, nëse bën reklamimin me kohë. Këtë reklamim duhet ta bëjë në afat prej një muaji, i cili rrjedh prej momentit të zbulimit të mungesës. Pas skadimit të këtij afati, ai parimisht nuk mund t'i realizojë të drejtat e caktuara. Në të vërtetë, porositësi, pas skadimit të afatit prej dy vjetësh nga pranimi i veprës së kryer, nuk mund të kërkojë mënjanimin e mungesave. Këtu duhet thënë se afati prej një muaji është afat subjektiv, kurse afati dyvjeçar është afat objektiv - neni 630 paragraf. 2 të LMD. Afati i parë fillon të rrjedhë prej ditës së zbulimit të mungesës, kurse afati i dytë prej ditës së marrjes së veprës së kryer. Këto afate gjykatësi nuk i merr parasysh sipas detyrës zyrtare, por sipas kërkesës së palës kontraktuese.³⁸⁹

Neni 631. Shuarja e së drejtës

- 1. Porositësi i cili e ka njoftuar kryerësin me kohë për të metat e veprës së kryer nuk mund të realizojë të drejtën e vet në rrugë gjyqësore pas kalimit të një (1) viti nga njoftimi i bërë.**
- 2. Pas skadimit të këtij afati, porositësi mundet, në qoftë se për të metat e ka njoftuar në kohën e duhur kryerësin e punës, me kundërshtim kundër kërkesës së kryerësit për pagimin e shpërblimit, të theksojë të drejtën e vet për zbritjen e shpërblimit dhe shpërblimin e dëmit.**

LMD ka parashikuar një dispozitë të caktuar për shuarjen e të drejtave në nenin 1, 2. Këtu janë parashtruar çështjet me rëndësi rreth të drejtave të porositësit. Në të vërtetë porositësi i cili kryerësin e punëve e ka lajmëruar me kohë për të metat e punës së kryer, nuk mund ta

389 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO III Zag. 1970, fq. 1917-1918, Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 90.

realizojë të drejtën e vet me anë të gjykatës pas skadimit të afatit njëvjeçar. Ky afat rrjedh prej ditës së lajmërimit për mungesat e punës së kryer - neni 631 parag. 1. Ky afat është afat prekluziv, sepse, pas skadimit të këtij afati, porositësi prekludohet në të drejtat e veta. Këtu porositësi për realizimin e drejtave të veta së pari i drejtohet kryerësit të punëve dhe në qoftë se në këtë mënyrë nuk mund t'i realizojë ato, atëherë i drejtohet gjykatës që nëpërmjet të saj të realizojë të drejtat e veta, duke paraqitur padinë. Mirëpo, këtë mundësi ai do ta humbë, nëse të drejtën e tij nuk e realizon brenda afatit prej një viti, i cili fillon të rrjedhë prej ditës së lajmërimit të veprës së kryer. Nga rregulla e lartpërmendur bën përjashtim neni 631 parag. 2, sepse lejohet realizimi pas skadimit të këtij afati, nëse për mungesat porositësi me kohë e ka lajmëruar kryerësin e punëve, me anë të kundërshtimit kundër kërkesës së kryerësit të punëve për pagimin e shpërblimit, duke paraqitur të drejtën e tij për zvogëlimin e shpërblimit dhe për shpërblimin e dëmit. Këtu zakonisht bëhet kundërshtimi në kontest për pagimin e shpërblimit të kryerësit të punëve. Andaj, mund të thuhet se në këtë rast porositësi, në të vërtetë, vetëm mohon kërkesën jo të bazuar të kryerësit të punëve.³⁹⁰

Neni 632. Rastet kur kryerësi humb të drejtën të thirret në nenet paraprake

Kryerësi nuk mund të thirret në ndonjë dispozitë të neneve paraprake kur e meta ka të bëjë me faktet për të cilat ishte në dijeni ose nuk kanë mund t'i mbeten të panjohura, ndërsa për këto nuk e ka njoftuar porositësin.

Ka raste kur kryerësi i punëve humb të drejtën për t'iu referuar dispozitave të caktuara për mbrojtjen e interesave të veta. Kështu është situata me nenin 631 të LMD. Themi kështu, sepse kryerësi i punës nuk mund të mbështetet në dispozitat e caktuara të LMD, kur e meta e veprës së kryer ka të bëjë me faktin që ka qenë i njohur ose nuk ka mundur të ngelë i panjohur. Meqë pos këtyre rrethanave, këtu kërkohet që kryerësi të mos e ketë njoftuar porositësin për mungesat e veprës. Siç mund të vërehet, kjo dispozitë përbën një rregull të vjetër të së kontraktore, sipas së cilës, askush nuk mund të mbështetet në dolusin (dashjen) e tij. Në të vërtetë, këtu kemi *dolus generalis*, me anë të së cilës nuk i mundësohet kryerësit të punëve që t'u referohet dispozitave të neneve të mëparshme, p.sh., kundërshtimi për realizimin e të drejtave të porositësit bëhet jo me kohë, nëse gjatë kryerjes së punës ka qenë i pandërgjegjshëm. Kështu do të jetë kur kryerësi nuk i bën të njohura ose i fsheh faktet me rëndësi për porositësin.³⁹¹

390 Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 91. Dr. Ivan Bukljas – Dr. Boris Vizner Komentar ZOO III Zag. 1979, fq. 1919 – 1920. Ivan Bukljas: Komentar I, II, Zag. 1978, fq. 300.

391 Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 91. Dr. Ivan Bukljas: Komentar ZOO I II Zag. 1978, fq. 300, Dr. Ivan Bukljas – Dr. Boris Vizner. Komentar ZOO III Zag. 1979, fq. 1920.

Neni 633. E drejta e kërkesës për mënjanimin e të metave

- 1. Porositësi i cili e ka njoftuar me rregull kryerësin se puna e kryer ka ndonjë të metë, mund të kërkojë prej tij që të metën ta mënjanojë dhe për të t'ia caktojë afatin e arsyeshëm.**
- 2. Ai ka të drejtë edhe për shpërblimin e dëmit që pëson për këtë arsye.**
- 3. Në qoftë se mënjanimi i të metës kërkon shpenzime të tepruara, porositësi mund të refuzojë ta kryejë, por me këtë rast porositësit i takon, sipas zgjedhjes së tij, e drejta e zbritjes së shpërblimit ose zgjidhjes së kontratës si edhe e drejta e shpërblimit të dëmit. 135**

Me këtë kontratë, në kushte të caktuara, mund të bëhet mënjanimi i mungesave dhe shpërblimi i dëmit. Kështu, sipas nenit 633 të LMD, porositësi i cili në mënyrë të rregullt ka lajmëruar kryerësin e punëve se vepra e kryer ka ndonjë mungesë, ka të drejtë të kërkojë të mënjanohet mungesa nga puna e kryer dhe për mënjanimin e mungesës porositësi duhet të caktojë afatin plotësues. Që porositësi ta realizojë këtë të drejtë, kërkohet që: 1) vepra e kryer të ketë mungesa dhe ato të jenë të mënjanueshme, 2) mungesa të jetë në sendin individualisht të caktuar, 3) ajo të shfaqet në afat të caktuar, d) për mënjanimin e mungesave të caktohet afati plotësues dhe 4) porositësi të paraqesë kërkesë për mënjanimin e mungesave. Porositësi ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar, ngase vepra ka pasur mungesa - neni 633 parag. 2 i LMD. Shpërblimi i dëmit në këtë rast është e drejtë aksesore e porositësit, i cili mund të kumulohet me çdo të drejtë kryesore të porositësit, për shkak të mungesave të veprës. Ndodh në praktikë ndonjëherë që kryerësi të refuzojë mënjanimin e mungesave. Këtë mund ta bëjë kur mënjanimi i mungesave kërkon shpenzime të mëdha, përkatësisht shpenzime të tepërta. Nëse situata është kështu, atëherë porositësit, sipas opsionit, i lejohe të kërkojë; 1) zvogëlimin e shpërblimit, ose 2) zgjidhjen e kontratës dhe 3) të drejtën për shpërblimin e dëmit - neni 633 parag. 3 i LMD. Këtu quhen “shpenzime të tepërta” për mënjanimin e mungesave ato që janë të pamasë në krahasim me shpërblimin që merr kryerësi i punëve. Ndërkaq zvogëlimi i shpërblimit do të realizohet, nëse vepra e kryer me mungesa mund të përdoret sipas qëllimit të saj. Nëse porositësi nuk dëshiron ta marrë në dorëzim veprën e kryer, atëherë zakonisht kërkon zgjidhjen e kontratës. Në këto dy raste ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, nëse ka pësuar dëm.³⁹²

Neni 634. Zgjidhja e kontratës në rastin e veçantë

Kur puna e kryer ka të metë të tillë sa që veprën e bën të papërdorshme ose është kryer në kundërshtim me kushtet shprehimore të kontratës, porositësi mundet, duke mos kërkuar mënjanimin paraprak të të metave, ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Ka raste kur porositësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të mungesës së veprës së kryer. Sipas nenit 634 të LMD, kjo mund të ndodhë (të zgjidhet kontrata)

392 Dr.Ivan Bukljas, Komentar ZOO I, II, Zagreb 1978 , fq.300.

atëherë kur mungesa e punës së kryer e bën veprën të papërdorshme ose kur puna e kryer është në kundërshtim me kushtet e parashikuara shprehimisht në kontratë. Në këtë rast porositësi mund të mos kërkojë mënjanimin e mungesave, por kërkon zgjidhjen e kontratës, duke kërkuar edhe shpërblimin e dëmit. Që ta realizojë këtë të drejtë, duhet që: 1) vepra e kryer të ketë mungesa që e bëjnë të papërdorshme atë ose vepra të kryhet në kundërshtim me kushtet e kontratës, 2) mungesa të shfaqet brenda afatit të caktuar, 3) të caktohet afati plotësues, 4) pastaj të paraqitet kërkesa për zgjidhjen e kësaj kontrate. Në këtë rast, porositësi duhet t'i jetë besnik kontratës, sepse vetëm pala e ndërgjegjshme mund ta realizojë këtë të drejtë. Në qoftë se nuk dëshiron ta realizojë këtë të drejtë, atëherë mund të realizojë ndonjë të drejtë tjetër, sipas kësaj baze, kurse realizimin e të drejtës së shpërblimit të dëmit duhet ta bëjë për arsye të ekzekutimit të parregullt të kontratës. Këtë të drejtë ai e realizon si të drejtë aksesore, duke bashkuar me ndonjë të drejtë tjetër kryesore për shkak të cenimit të kontratës.³⁹³

Neni 635. E drejta e porositësit në rastin e të metave të tjera të veprës së kryer

- 1. Kur puna e kryer ka të metë, por vepra është megjithatë e përdorshme, respektivisht kur puna nuk është kryer në kundërshtim me kushtet e parashikuara shprehimisht të kontratës, porositësi ka për detyrë ta lejojë kryerësin që ta mënjanojë të metën.**
- 2. Porositësi mund t'i caktojë kryerësit një afat të arsyeshëm për mënjanimin e të metave.**
- 3. Në qoftë se kryerësi nuk e mënjanon të metën deri te kalimi i këtij afati, porositësi mundet sipas zgjedhjes se tij ta kryejë mënjanimin në llogari të kryerësit ose ta zbres shpërblimin ose ta zgjidhë kontratën.**
- 4. Kur është fjala për të metë të parëndësishme, porositësi nuk mund të shërbehet me të drejtën e zgjidhjes së kontratës.**
- 5. Në çdo rast ai ka të drejtë edhe për shpërblimin e dëmit.**

Porositësi mund ta realizojë të drejtën e mënjanimin të mungesave, kur puna e kryer ka mungesa. Kjo çështje është e rregulluar në nenin 644 parag. 1, 2, 3, 4, 5 të LMD. Këtë të drejtë ai mund ta realizojë kur puna e kryer ka mungesa, të cilat e bëjnë veprën të papërdorshme, respektivisht kur puna është kryer në kundërshtim me kushtet e parashikuara shprehimisht të kontratës - neni 635 parag. 1 i LMD. Kjo e drejtë, sikurse edhe të drejtat e tjera, mund të realizohet, nëse plotësohen kushtet e caktuara. Këto kushte që kemi përmendur lidhur me nenin 635 parag. 1, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, përndryshe kjo e drejtë nuk mund të realizohet. Në realizimin e kësaj të drejte, porositësi duhet t'i respektojë rregullat si një *ekonomist i mirë*. Nëse ndodhë që ky të mos respektojë rregullat e “*standardit të sjelljes*”, atëherë do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Nëse ndodh që ky të mos i respektojë rregullat e standardit të sjelljes, atëherë do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Nëse ndodh që kryerësi i punëve të mos i mënjanojë mungesat deri në skadimin e afatit

³⁹³ Kjo e drejtë e komunikimit është e drejtë që kryesisht është e lidhur me një të drejtë tjetër që është kryesore për shkak të mospërmbushjes apo cenimit të kontratës kryesore .

plotësues, atëherë porositësi mundet, sipas opsionit të vet, ta bëjë mënjanimin e mungesave në ngarkim të kryerësit të punëve ose ta zvogëlojë shpërblimin ose ta zgjidhë kontratën - neni 635 parag. 2, 3. Porositësi, nga ana tjetër, nuk mund ta realizojë të drejtën e zgjidhjes së kontratës, nëse mungesa e veprës është e vogël - neni 635 parag. 4. Këtu është fjala për mungesën që nuk pengon përdorimin e rregullt të sendit, pra kur mungesa është pa rëndësi. Kuptohet se në këtë rast porositësi mund të realizojë ndonjë të drejtë tjetër, sikundër është e drejta e mënjimit të mungesave dhe e drejta e zvogëlimit të shpërblimit. Në këto raste porositësi, parimisht, gjithnjë ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e demit - neni 635 parag. 5. Pasi këtu kemi të bëjmë me një cenim të kontratës, duhet thënë se porositësi duhet bazuar në rregullën e fajit të supozuar të palës kontraktuese për shpërblimit e demit.³⁹⁴

Neni 636. Zbritja e shpërblimit

Shpërblimi zbritet në përpjesëtim ndërmjet vlerës së punës së kryer pa të meta në kohën e lidhjes së kontratës dhe vlerës që do të kishte puna e kryer me të meta në atë kohë.

Sipas nenit 636 të LMD, porositësi mund ta zvogëlojë shpërblimin në përpjesëtimin midis vlerës së punës së kryer pa mungesa në kohën e lidhjes së kontratës dhe vlerës së punës së kryer që ka ajo në kohën e kryerjes së punës me mungesa. Konkretisht, zvogëlimi i shpërblimit duhet të bëhet: 1) nëse sendi ka mungesa, 2) nëse mungesa nuk e pengon përdorimin e rregullt të tij, 3) nëse mungesa shfaqet brenda afatit të caktuar, 4) nëse caktohet afati plotësues dhe 5) nëse paraqitet kërkesa për zvogëlimin e shpërblimit. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, përndryshe nuk mund të realizohet kjo e drejtë. Në suaza konkrete, zvogëlimi i shpërblimit domethënë kur, p.sh., shpërblimi i kontraktuar ka qenë 10.000 €, që përbën vlerën e punës pa mungesa në momentin e lidhjes së kontratës, por ndërkohë eksperti vërteton se puna me mungesa në treg vlen 6.000 €, atëherë sasia e shpërblimit do të jetë vetëm 4000 €. Reduktimi i shpërblimit kontraktor te kontrata për veprën është dhe duhet të jetë pasojë e zvogëlimit të vlerës së punës që ka kryer kryerësi i punëve.³⁹⁵

394 Lidhur me këtë çështje shih më hollësisht rregullat për shpërblimin e demit që vlejné për kontratat me shpërblim.

395 Nga kjo rrjedhë se shpërblimi zbritet në përpjestim ndërmjet vlerës së punës së kryer pa të meta në kohën e lidhjes së kontratës dhe vlerës që do të kishte puna e kryer me të meta në atë kohë.

KREU 6

DETYRIMET E POROSITËSIT

Neni 637. Detyrimi i pranimi të punës

Porositësi ka për detyrë ta pranojë punën e kryer sipas dispozitave të kontratës dhe rregullave të punës.

Kontrata për veprën karakterizohet nga detyrime të dyanshme, sepse, përveç kryerësit të punës, edhe porositësi ka detyrime të caktuara. Detyrimet kryesore të porositësit të punës janë: ta marrë në dorëzim punën që e ka kryer kryerësi i punës, të paguajë shpërblimin për punën e kryer, t'ia dorëzojë materialin për kryerjen e punës dhe të bashkëpunojë me kryerësin gjatë kryerjes së punës.

Porositësi i punës është i detyruar ta pranojë punën e kryer sipas kushteve të kontraktuara ose sipas rregullave të kryerjes së saj (neni 637 i LMD). Në rast se kryerësi i punës, me rastin e kryerjes së saj, nuk i përmbahet kontratës dhe rregullave të punës ose e vonon dorëzimin e punës, porositësi i punës mund ta refuzojë pranimin e punës, ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Porositësi, sipas rregullave tradicionale, ka disa detyrime me rëndësi të kjo kontratë. Detyrimet e porositësit janë parashikuar dhe sanksionuar prej nenit 637-642 të LMD. Së pari, porositësi është i detyruar ta pranojë punën e kryer, nëse ajo është kryer sipas dispozitave të kësaj kontrate dhe rregullave të profesionit - nenin 637 i LMD. Nëse puna e kryer nuk pranohet nga porositësi për ndonjë shkak të arsyeshëm, atëherë ai vonohet dhe ka pasoja të vonësës së tij. Vonesa e porositësit është vonesa e kreditorit. Pasoja kryesore e kësaj vonese është fakti se konsiderohet se porositësi ka pranuar sendin, prandaj, për këtë arsye, ai nuk mund të bazohet në mungesat e sendit të kryer që kanë mundur të vërehen me një kontrollim të rëndomtë. Një pasojë tjetër është ajo se tani kryerësi i punës veprën e mban si ruajtës, gjë që do të thotë se ky tani ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për ruajtje. Pastaj, zhdukja dhe dëmtimi i sendit i sjellin pasoja porositësit. Nëse vazhdon mospranimi i paarsyeshëm i veprës së kryer, kryerësi i punëve mund të kërkojë që me vendim të gjykatës t'i besohet sendi për ruajtje një personi tjetër dhe ky me shpenzime dhe në ngarkim të porositësit.³⁹⁶

Neni 638. Caktimi dhe pagimi i shpërblimit

- 1. Shpërblimi caktohet me kontratë, në qoftë se nuk është caktuar me ndonjë tarifë të detyrueshme ose me ndonjë akt tjetër të detyrueshëm.**
- 2. Në qoftë se shpërblimi nuk është caktuar, gjykata cakton shpërblimin sipas vlerës së punës, sipas kohës së nevojshme normalisht për punë të tillë dhe sipas shpërblimit të rëndomtë për këtë lloj të punës.**

.....
396 Dr. Dr. Ivan Bukjaš: Komentar II, I, Zag., 1978, fq. 302, Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 94.

- 3. Porositësi nuk ka për detyrë ta paguajë shpërblimin para se ta ketë kontrolluar dhe lejuar, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.**
- 4. E njëjta gjë vlen në qoftë se është kontraktuar kryerja dhe dorëzimi i punëve pjesë-pjesë.**
-

Shpërblimi për punën e kryer paraqet elementin e dytë thelbësor të kontratës për veprën. Shpërblimi paraqet një kundërvlerë me para, të cilën detyrohet ta paguajë porositësi për punët e caktuara të kryera nga kryerësi i punëve. Shumën e shpërblimit e caktojnë palët kontraktuese me marrëveshje. Në qoftë se shpërblimi është i caktuar me dispozita ligjore detyruese, palët kontraktuese nuk mund të kontraktojnë më shumë se shpërblimin e parashikuar. Në qoftë se “shpërblimi për punën e kryer nuk është caktuar me kontratë, as me ligj, shuma e tij do të caktohet sipas shpërblimeve të rëndomta në vendin e lidhjes së kontratës ose edhe nga ana e gjykatës, duke pasur parasysh vlerën e punës, kohën e nevojshme për kryerjen e punës së caktuar” (neni 638 paragraf. 1, 2 të LMD). Si rregull, shpërblimi paguhet me para, por mund të paguhet edhe me ndonjë vlerë tjetër pasurore. Shpërblimi duhet të jetë i drejtë, real, i mundshëm dhe i lejuar. Nëse shpërblimi do të jetë shumë i lartë ose i ulët, kontrata e tillë mund të sulmohet me dispozitat për dëmtimin e pamasë (laesio enormis).

Kryerësi i punës ka dy detyrime themelore: ta kryejë punën dhe të arrijë rezultatin e caktuar në punë, duke dorëzuar punën e kryer ose rezultatin e punës.

Porositësi është i detyruar të paguajë shpërblimin në mënyrën, në kohën dhe në vendin e caktuar, ashtu siç janë marrë vesh me kontratë. Kontraktuesit mund të merren vesh që shpërblimin ta paguajnë përpara, në afat të caktuar pas lidhjes së kontratës, ose mund të jepet kapar, paradhënie dhe të bëhet sipas punës dhe dinamikës së punëve të kryera. Porositësi nuk është i detyruar ta paguajë shpërblimin para se ta kontrollojë punën e kryer dhe para lejimit të saj” (neni 638 paragraf. 3 të LMD). Shpërblimi caktohet me anë të kontratës e nëse nuk është caktuar, atëherë paguhet me tarifë të obligueshme (neni 640 paragraf. 1 i LMD). Me anë të kontratës shpërblimi dhe sasia e tij caktohen me një shumë fikse ose paushale. Në rast se shpërblimi nuk është caktuar me kontratë, nuk janë parashikuar mënyra dhe afati i pagimit të shpërblimit, është rregull që shpërblimi të paguhet menjëherë, (përveç rastit kur kryerja e punës është ndarë në shumë etapa, prandaj edhe shpërblimi do të paguhet me rastin e pranimit të çdo pjese të punës, gjë që më së shumti praktikohet në ndërtimtari). Kryerësi i punës ka të drejtë të kërkojë nga porositësi t’i paguajë shpenzimet që i ka pasur gjatë kryerjes së punës, duke i dhënë paradhënie kryerësit nga ana e porositësit.

Neni 639. Llogaritja me garanci shprehimore

- 1. Në qoftë se shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes me garanci shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij, ai nuk mund të kërkojë shtimin e shpërblimit as edhe në qoftë se në punim ka dhënë më tepër punë dhe në qoftë se kryerja e punës ka kërkuar më tepër shpenzime se sa është parashikuar.**

- 2. Me këtë nuk përjashtohet zbatimi i rregullave për zgjidhjen dhe ndryshimin e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave**
- 3. Në qoftë se shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes pa garanci shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij dhe gjatë punës tejkalimi i llogarisë tregohet i pashmangshëm, kryerësi duhet për këtë pa shtyrje ta njoftojë porositësin, përndryshe humb çdo kërkesë për shkak të shpenzimeve të shtuara.**

LMD, në nenin 639, parag. 1, 2, 3, ka një dispozitë për rastin kur shpërblimi caktohet me garanci shprehimore të saktësisë dhe lartësisë së tij dhe për rastin e shpërblimit me garanci joshprehimore për saktësinë dhe shumën e tij. Në rastin e parë, kur shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes me garanci shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij, atëherë ai nuk mund të kërkojë rritjen e shpërblimit as atëherë kur kryerja e punës ka kërkuar më tepër shpenzime sesa ishin parashikuar, (neni 639 parag. 1). Kur shpërblimi llogaritet sipas kësaj dispozite, atëherë lartësia e tij konsiderohet definitive. Për këtë arsye sasia e shpërblimit nuk mund të rritet. Nëse ndodh që kryerësi të ketë gabuar në llogaritje, atëherë ai heq barrën e gabimit dhe rrezikun e rastit. Mirëpo, mbasi kjo rregull nuk është një rregull detyruese, porositësi dhe kryerësi i punëve mund të merren vesh që këtë rrethanë ta rregullojnë edhe ndryshe.³⁹⁷ Rrethana e lartpërmendur, edhe pse shpërblimi është llogaritur me lartësi definitive, prapëseprapë nuk e përjashton zbatimin e rregullave për zgjidhjen ose ndryshimin e kontratës për arsye të rrethanave të ndryshuara (neni 639 parag. 2 i LMD). Sikundër mund të vërehet, këtu ligjdhënësi ka parashikuar mundësinë e zbatimit të rregullave të klauzolës rebus sic stantibus. Pra, me këtë rregull ekziston mundësia që kryerësi të kërkojë më tepër shpenzime, sesa janë parashikuar në rastet e ndryshimit të rrethanave të kësaj kontrate prej momentit të lidhjes, deri në momentin e ekzekutimit të saj. Rasti i dytë, që parashikohet në nenin 639, ka të bëjë me shpërblimin e kontraktuar në bazë të llogaritjes pa garanci shprehimore të kryerësit të punëve për saktësinë e tij, por që gjatë punës tregohet se tejkalimi i llogaritjes është i pashmangshëm, atëherë kryerësi i punëve është i detyruar për këtë ta lajmërojë pa shtyrje porositësin, përndryshe ai humb çdo kërkesë që është në lidhje me shpenzimet e rritura. Në këtë rast kërkohet që: 1) të ekzistojë marrëdhënia kontraktore, 2) shpërblimi të jetë llogaritur pa garanci shprehimore për saktësinë e tij, 3) shpenzimet e rritura të jenë të domosdoshme, 4) për këtë rritje të lajmërohet porositësi pa shtyrje dhe 5) të paraqesë kërkesë për rritjen e tyre³⁹⁸. Mirëpo nëse rritja e shpenzimeve shkakton humbjen e interesit të porositësit për ekzistimin e kontratës, ai ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e saj³⁹⁹. Nëse ndodh që kryerësi i punëve ta bëjë tejkalimin e shpenzimeve duke kryer punë pa nevojë, atëherë porositësi mund ta kundërshtojë këtë. Për këtë kundërshtim gjyqtari merr vendim nëse është apo s'është tejkalimi i arsyeshëm apo shpenzimet janë të domosdoshme ose nuk janë etj.

397 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag. 1979, fq. 1930, Komentar ZOO II Beog. 1980. fq. 96

398 Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 96. Dr. Ivan Bukljash – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag. 1979, fq. 1930. Dr. Ivan Bukljaš: Komentar ZOO I II Zag. 1978, fq. 303

399 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris vizner: Komentar ZOO III Zag. 1979, fq. 1930, Komentar ZOO II Beog. 1980, fq. 96

Llogaritja me dorëzani shprehimore gjen shprehje kur shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes me dorëzani shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij, kështu që ai nuk mund të kërkojë shtimin e shpërblimit as edhe kur në punim ka bërë më tepër punë dhe kur kjo ka kërkuar më tepër shpenzime sesa ishte parashikuar. Me këtë nuk do të thotë se nuk përjashtohet zbatimi i rregullave për zgjidhjen dhe ndryshimin e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave prej momentit të lidhjes së kontratës. Në qoftë se shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes pa dorëzani në mënyrë shprehimore të kryerësit për saktësinë e tij dhe gjatë punës tejkalimi i llogarisë del i pashmangshëm, kryerësi duhet për këtë pa shtyrje ta njoftojë porositësin. Në qoftë se nuk e bën këtë, ai humb çdo kërkesë që ka lidhje me shpenzimet e shtuara në këtë rast.

KREU 7

RREZIKU

Neni 640. Kur kryerësi e ka dhënë materialin

- 1. Në rast se kryerësi e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit, kurse sendi dëmtohet ose shkatërrohet për arsye të ndryshme para se t'i dorëzohet porositësit, rrezikun e mban kryerësi dhe nuk ka të drejtë shpërblimin për materialin e dhënë e as për punën e tij.**
- 2. Në qoftë se porositësi e ka kontrolluar punimin e kryer dhe e ka lejuar, konsiderohet se sendi i është dorëzuar, ndërsa te kryerësi ka mbetur në ruajtje.**
- 3. Në qoftë se porositësi është vonuar për shkak të mospranimit të sendit të ofruar, rreziku i shkatërrimit ose i dëmtimit të rastësishëm të sendit kalon në atë.**

Kryerësit të punës materiali për kryerjen e punës duhet t'i dorëzohet në mënyrën, në kohën dhe në vendin ashtu siç janë marrë vesh me kontratë, (p.sh., stofin dhe pjesët e tjera për qepjen e rrobave për rrobaqepësin). Nga përmbushja me kohë e këtyre detyrave nga ana e porositësit të punës varet përmbushja me kohë e detyrës për kryerjen e punës që ka pala tjetër - kryerësi i punës.⁴⁰⁰ Duhet theksuar se kjo detyrë nuk figuron në të gjitha kontratat për veprën. Ai duhet të bashkëpunojë me kryerësin gjatë kryerjes së punës.

Bashkëpunimi i porositësit është i domosdoshëm në shumë raste, sepse prej tij varet kryerja e punës me sukses dhe në kohë. Me rastin e qepjes së rrobave, porositësi është i detyruar të vijë për prove e nëse nuk i përgjigjet thirrjes ose është i parregullt, kjo ndikon në përmbushjen e detyrës.⁴⁰¹

Rasti i parë ka të bëjë me situatën kur porositësi ka dhënë materialin për kryerjen e punës (neni 489 parag. 1, 2, të LMD). Rregulla e parë në këtë rast ka të bëjë me rrezikun e

400 Dr. B. Loza vep. e cit., fq. 160.

401 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 357.

humbjes së rastësishme ose të dëmtimit të sendit, të cilin e ka porositësi, nëse e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit, neni 489 parag. 1. Këtu është vepruar dhe veprohet sipas rregullës tradicionale – *res peri domino*. Mirëpo, nga ana tjetër në doktrinë thuhet se në praktikë shumë rrallë veprohet në këtë drejtim.⁴⁰² Këtu duhet theksuar se porositësi bart rrezikun e dëmtimit ose të humbjes së sendit vetëm për materialin që e ka dhënë për prodhimin e punimit të porositur. Në këtë rast kryerësi i punës ka të drejtën e shpërblimit, nëse sendi është zhdukur ose është dëmtuar, për shkak të vonesës së porositësit ose në rastin kur porositësi nuk i është përgjigj ftesës së rregullt të kryerësit për ta kontrolluar sendin - neni 641 parag. 2 të LMD. Pra këtu, siç shihet, porositësi është vonuar, prandaj edhe i bart pasojat për vonesën e tij.

Rasti i dytë ka të bëjë me situatën e rrezikut nga dhënia pjesë-pjesë. Për këtë rast LMD ka parashikuar një dispozitë të veçantë në nenin 642. Rasti ka të bëjë me kontraktimin që porositësi ta bëjë kontrollimin dhe marrjen e pjesëve të punëve ashtu siç janë kryer; atëherë kryerësi i punës ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e pjesëve që porositësi i ka kontrolluar dhe lejuar. Këtë të drejtë kryerësi i punëve mund ta realizojë edhe në rastin kur, pas kontrollimit, ato zhduken te kryerësi pa fajin e tij. Këtu është fjala për dorëzimin suksesiv të punimit, ashtu siç janë kryer pjesët nga kryerësi i punëve. Andaj, në rastet kur porositësi dhe kryerësi merren vesh që vepra të dorëzohet pjesë-pjesë, pas kontrollimit dhe lejimit nga porositësi. Kryerësi i punës ka të drejtë të kërkojë shpërblimin, edhe pse porositësi nuk e ka marrë sendin ose edhe pse sendi është zhdukur kur ndodhej te kryerësi, por pa fajin e tij.⁴⁰³

Neni 641. Kur porositësi e ka dhënë materialin

- 1. Rrezikun e shkatërrimit ose dëmtimit të rastësishëm e bartë kryerësi, në qoftë se ai e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit.**
- 2. Në këtë rast, kryerësi ka të drejtë të shpërblimit vetëm në qoftë se sendi është shkatërruar ose dëmtuar pas rënies së porositësit në vonesë ose në qoftë se porositësi nuk i është përgjigjur ftesës të bërë me rregull për ta kontrolluar sendin.**

Rasti i dytë ka të bëjë me situatën kur porositësi ka dhënë materialin për kryerjen e punës. Ky rast rregullohet në nenin 641 parag. 1, 2, të LMD. Rregulla e parë në këtë rast ka të bëjë me rrezikun e humbjes së rastësishme ose të dëmtimit të sendit, të cilin e bart porositësi, nëse e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit. Kështu është vepruar dhe veprohet sipas rregullës tradicionale – *res perit domino*. Mirëpo, nga ana tjetër, në doktrinë ceket se në praktikë shumë rrallë veprohet në këtë drejtim ⁴⁰⁴. Këtu duhet theksuar se porositësi bart rrezikun e dëmtimit ose të humbjes së sendit vetëm për sa i përket materialit që ka

402 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 98, Dr. Ivan Bukjaš: Komentar ZOO II, Zag., 1978, fq. 304.

403 Dr. Ivan Bukjaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO III, Zag., 1979, fq. 1932, Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 98, Dr. Ivan Bukjaš: Komentar ZOO I, II, Zag., 1978, fq. 304.

404 Komentar ZOO II Beog. 1980. fq. 98. Dr. Ivan Bukjaš: Kome. ZOO I II Zag. 1978. fq. 304.

dhënë për prodhimin e punimit të porositur. Në këtë rast kryerësi i punës ka të drejtën e shpërblimit, nëse sendi është zhdukur ose është dëmtuar për shkak të vonesës së porositesit ose kur porositesi nuk i është përgjigjur ftesës së rregullt të kryerësit që të kontrollojë sendin - neni 641 parag. 2 të LMD. Pra këtu, siç shihet porositesi, si kontraktues, është vonuar, andaj edhe i bart pasojat e vonesës së tij.

Neni 642. Rreziku në rast të dorëzimit pjesë-pjesë

Në qoftë se është kontraktuar se porositesi do ta bëjë kontrollin dhe pranimin e pjesëve të veçanta ashtu si do të prodhohen, kryerësi ka të drejtë shpërblimi për prodhimin e pjesëve që i ka kontrolluar dhe lejuar edhe në qoftë se ato pas tij do të shkatërroheshin tek ai pa fajin e tij.

Rasti i tretë ka të bëjë me rrezikun kur vepra e porositur dorëzohet pjesë-pjesë. Për këtë rast LMD ka parashikuar një dispozitë të veçantë në nenin 806. Rasti ka të bëjë me kontraktimin që porositesi ta bëjë kontrollimin dhe marrjen e pjesëve të punëve ashtu siç janë kryer; atëherë kryerësi i punës ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e pjesëve që porositesi i ka kontrolluar dhe i ka lejuar. Këtë të drejtë kryerësi i punëve mund ta realizojë edhe në rastin kur, pas kontrollimit ato zhduken te kryerësi, por pa fajin e tij. Këtu është fjala për dorëzimin pjesë-pjesë të veprës, ashtu si janë kryer nga kryerësi i punëve. Pra, në rastet kur porositesi dhe kryerësi merren vesh që punimi të dorëzohet pjesë-pjesë, pas kontrollimit dhe lejimit nga porositesi, kryerësi i punës i ka të drejtë të kërkojë shpërblimin, edhe pse porositesi nuk e ka marrë sendin ose edhe pse sendi është zhdukur, duke qenë te kryerësi i punës⁴⁰⁵

KREU 8 E DREJTA E PENGUT

Neni 643. E drejta e pengut

Për sigurimin e arkëtimit të kërkesave të shpërblimit për punën dhe shpërblimin e materialit të shpenzuar dhe kërkesave të tjera në bazë të kontratës për vepër, kryerësi ka të drejtë pengut në sendet që i ka prodhuar ose riparuar, si dhe në sende të tjera që i'a ka dorëzuar porositesi lidhur me punën e tij, gjithnjë gjersa ato i mban dhe nuk pushon me vullnet t'i mbajë.

LMD në nenin 643 ka parashikuar një dispozitë të veçantë për sigurimin e arkëtimit të kërkesës së kryerësit të punëve. Duke u nisur nga rregulla klasike se pengut është mjet i sigurimit real për realizimin e kërkesës, është parashikuar mundësia e konstituimit të

.....
405 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO II Zag. 1979. fq. 1932. Komentar ZOO II Beog. 1980. fq. 98. Dr. Ivan Bukljaš: Komentar ZOO I, II Zag. 1978. fq. 304.

tij te kontrata për veprën. LMD këtë e ka bërë për arsye se nga natyra e kësaj kontrate rrjedh se kryerësi mund ta ndalë sendin e prodhuar, nëse porositësi nuk e paguan borxhin ndaj tij, ndërsa këtë e bën për punën e bërë dhe materialin e harxhuar. Pra, ai e bën këtë për sigurimin e arkëtimit të kërkesës së shpërblimit për punën e bërë dhe shpërblimit për materialin e harxhuar si dhe të kërkesave të tjera që, sipas bazës së kontratës për veprën, kanë të bëjnë me sendet që i ka riparuar dhe sendet e tjera që ia ka dorëzuar porositësi në lidhje me punën e tij. Këto sende gjersa i mban si peng nuk shuhet, sepse ato i mban vullnetarisht. Siç shihet këtu është konstituuar pengu ligjor në dobi të kryerësit të punës. Ky konstituim ka të bëjë me lëndën e kontratës për veprën. Konstituimi i pengut bëhet mbi sendin e prodhuar ose të ndrequr ose mbi sendet e tjera të porositësit, që i janë dorëzuar kryerësit të punëve. Kjo e drejtë zgjat gjersa sendi është te kryerësi.

KREU 9

SHUARJA E KONTRATËS

Neni 644. Zgjidhja e kontratës me vullnetin e porositësit

Derisa vepra e porositësit nuk është kryer, porositësi mund ta zgjidhë kontratën kur të dojë, por në atë rast ka për detyrë t'i paguajë kryerësit shpërblimin e kontraktuar, të zvogëluar për shumën e shpenzimeve që ky nuk i ka bërë e që do të kishte për detyrë t'i bënte po të mos zgjidhej kontrata si edhe për shumën e fitimit që e ka realizuar në anën tjetër ose që me qëllim e ka lëshuar ta realizojë.

Rastet kryesore të shuarjes së kësaj kontrate janë:

- pas kryerjes së punës dhe arritjes së qëllimit për të cilin është lidhur kontrata;
- me vdekjen e kryerësit ose porositësit të punës, (p.sh. punimi i pikturës nga piktori i caktuar, punimi i skulpturës nga skulptori i caktuar, qepja e rrobave nga rrobaqepësi i caktuar);
- nëse kryerësi i punës me materialin që ia ka dhënë porositësi ka kryer disa punë, trashëgimtarët e tij janë të detyruar që ta dorëzojnë materialin, të kryejnë pagimin e pjesës përkatëse të shpërblimit, i cili i takon kryerësit të punës;
- nëse kryerësi i punës e humb aftësinë punuese, p.sh., nëse rrobaqepësi i humb sytë (verbohet); nëse kryerësi i punës e humb aftësinë punuese pjesërisht ose plotësisht, kontrata do të shuhet, sepse shkaktohet pamundësia faktike që ta kryejë punën;
- porositësi mund ta zgjidhë kontratën nëse afati i kryerjes së veprës është element thelbësor i kësaj kontrate, kurse kryerësi vonohet në kryerjen e punëve (neni 479 parag. 1 e LMD);
- kontrata për veprën mund të zgjidhet nga porositësi ose kryerësi i punës. Porositësi mund ta zgjidhë kontratën për dy shkaqe: nëse kryerësi i punës, me rastin e kryerjes së punës, nuk u përmbahet kushteve të kontratës ose rregullave të punës dhe nëse e vonon kryerjen

e punës, kurse kryerja në afat paraqet kushtin thelbësor të kontratës së lidhur. Kryerësi i punës ka të drejtë ta zgjidhë kontratën, nëse porositësi ia dorëzon materialin me mungesa, me të cilin ai nuk mund të arrijë rezultatin e caktuar, kurse për këtë ia ka tërhequr vërejtjen porositësit, por pa sukses.

Kontrata për veprën mund të zgjidhet me shprehjen e njëanshme të vullnetit të porositësit. Kjo është parashikuar në nenin 644 të LMD. Ai këtë mund ta bëjë gjersa puna e porositur nuk është kryer. Me këtë rast porositësi ka për detyrë që t’ia paguajë shpërblimin e kontraktuar kryerësit të punëve, por të zvogëluar për shumën e shpenzimeve që kryerësi nuk i ka bërë dhe që ka qenë dashur t’i bëjë po të mos zgjidhej kontrata. Porositësi ka detyrimin që të paguajë shpërblimin që kryerësi i punës ka mundur ta realizojë gjetiu, por këtë e ka lëshuar me qëllim që të mos e realizojë. Këtë zgjidhje të këtillë të kontratës porositësi e bënë zakonisht kur nuk ka interes që kontrata të përmbushet. Mirëpo, këtu duhet thënë se këtë nuk mund ta bëjë me qëllim të dëmtimit të interesave të kryerësit të punëve, sepse atëherë mund të cenohet interesi i kryerësit të punëve e gjithashtu edhe barazia e palëve.⁴⁰⁶

.....
406 Dr. I. Bukljaš – Dr. B. Vizner, Komentar ZOO, Zag., 1979, fq. 1934, Komentar ZOO, II, Bg. 1980, fq. 99.

PJESA X KONTRATA PËR NDËRTIMIN

KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 645. Nocioni

- 1. Kontrata për ndërtim është kontratë me të cilën kryerësi detyrohet sipas projektit të caktuar të ndërtojë në afatin e caktuar ndërtesën e caktuar në tokën e caktuar, apo në një tokë të tillë respektivisht në objektin tashmë ekzistues të kryejë punë të tjera ndërtimi, ndërsa porositësi detyrohet që për këtë t'i paguajë çmimin e caktuar.**
- 2. Kontrata për ndërtimin duhet të jetë e lidhur me shkrim.**

Sipas nenit 645, kontrata për ndërtimin është kontratë e veçantë, me të cilën kryerësi detyrohet që, sipas projektit të caktuar, të ndërtojë në afatin e caktuar ndërtesën e caktuar në tokën e caktuar, apo në një tokë të tillë përkatësisht në objektin ekzistues të kryejë punë të tjera ndërtimi, ndërsa porositësi detyrohet që për këtë t'i paguajë çmimin e caktuar.

Si palë kontraktuese në kontratën për ndërtimin paraqiten: 1) kryerësi i punës dhe 2) porositësi i punës. Kontrata për ndërtimin është kontratë e dyanshme, bilaterale, sepse për të dy palët kontraktuese lindin të drejta dhe detyrime të caktuara. Sipas kësaj kontrate, kryerësi detyrohet që, sipas projektit të caktuar, të ndërtojë në afatin e caktuar ndërtesën e caktuar në tokën e caktuar, ndërsa porositësi detyrohet që për këtë t'i paguajë çmimin e caktuar. Karakteristikat e kësaj kontrate, (përveç se është e dyanshme), janë: është kontratë komutative, formale, me ngarkesë dhe është kontratë e thjeshtë.

Është kontratë **komutative**, sepse që në momentin e lidhjes së saj, palët kontraktuese i dinë të drejtat dhe detyrat e tyre dhe ato nuk varen nga ndonjë ngjarje e ardhme dhe e pasigurt.

Është kontratë **e dyanshme detyruese**, sepse detyrimi i kryerësit të punëve duhet të jetë në ekuivalencë të plotë me prestimin e porositësit të punës. Obligimi kryesor i investuesit është që të paguajë çmimin e parashikuar në kontratë, kurse detyrimi themelor i kryerësit të punëve është ndërtimi i objektit të caktuar.

Sipas parag. 2 të nenit 645, kontrata për ndërtimin duhet të jetë e lidhur me shkrim. Nga ky paragraf rrjedh edhe karakteristika tjetër e kësaj kontrate, si kontratë *rreptësisht formale*, që do të thotë se kjo kontratë duhet të lidhet domosdo me shkrim, ku forma e tillë është *formë ligjore (ex lege)*. Forma mund të shërbejë edhe si *formë provuese – forma ad probationem*, që shërben si provë në rast kontesti ndërmjet palëve kontraktuese.

Elementet kryesore të kontratës për ndërtimin janë: a) punët që duhet të kryhen, b) çmimi dhe c) afati i kryerjes së punës.

Neni 646. Objektet ndërtimore

Me fjalën “Objektet ndërtimore” në kuptim të kësaj pjese konsiderohen ndërtesat, digat, urat, ujësjellësi, kanalizimi, rrugët, vijat hekurudhore, tunelet, pusët dhe objekte të tjera ndërtimore, ndërtimi i të cilave kërkon punë më të mëdha dhe më të ndërlikuara.

Neni 646 i LMD, e përcakton nocionin e “godinës”. Sipas ligjit, me fjalën “objekt ndërtimor” konsiderohen ndërtimet, digat, ujësjellësi, kanalizimi, rrugët, vijat hekurudhore, pusët dhe objektet e tjera të ndërtimit, për të cilat, ndërtimi kërkon punë më të madhe, më të ndërlikuar.

Ndërtimi i objektit ndërtimor përfshin kryerjen e punëve ndërtimore, instalimin dhe montimin e pajimeve, makinave si dhe kryerjen e punëve përgatitore dhe të atyre përfundimtare. Objekt i kontratës për ndërtimin mund të jetë ndërtimi i objektit të ri ndërtimor, por edhe rikonstruktimi i objektit ndërtimor ekzistues.

Neni 647. Mbikëqyrja e punimeve dhe kontrolli i cilësisë së materialit

Kryerësi i punës ka për detyrë t’ia bëjë të mundur porositësit mbikëqyrjen e vazhdueshme të punimeve dhe kontrollin e sasisë dhe cilësisë së materialit të përdorur.

Sipas nenit 647 të LMD, kryerësi i punës ka për detyrim t’ia bëjë të mundur porositësit mbikëqyrjen e vazhdueshme të punimeve dhe kontrollin e sasisë dhe cilësisë së materialit të përdorur.

Porositësi ka të drejtë që të ushtrojë mbikëqyrjen mbi punët që e kryen kryerësi. Kjo është një detyrë e kryerësit të punëve që t’i mundësojë mbikëqyrjen e përhershme në punime, me ç’rast ka të drejtë ta kontrollojë edhe cilësinë e materialit dhe vetë materialin të cilin e përdor dhe e inkorporon në objektin ndërtimor.

Neni 648. Shmangie nga projekti

- 1. Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit respektivisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositësit.**
 - 2. Ai nuk mund të kërkojë ngritje të çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë.**
-

Porositësi i punës duhet ta sigurojë projektin dhe dokumentacionin tjetër teknik, pa të cilat nuk do të mund të lidhë kontratën për ndërtim. Projektimi përfshin disa veprime; 1)

programin projektues, 2) ideor dhe 3) kryesor. Projekti në realitet është pjesë përbërëse e kontratës për ndërtimin.⁴⁰⁷ Programi projektues është pjesë e programit investues dhe u përket punëve ndërtimore. Projekti kryesor është analizë detaje e të gjitha punëve në objekt dhe i çmimit. Ky bazohet në projektin ideor dhe i përmban të gjitha elementet, pa të cilat nuk është e mundur të ngrihet objekti. Objekti kryesor duhet të jetë i lejuar nga organet kompetente shtetërore.⁴⁰⁸ Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit apo nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositësit. Ai nuk mund të kërkojë ngritje të çmimit të kontraktuara për punimet që i ka kryer pa këtë pëlqim. (Parag. 2 i nenit 647 të LMD).

Neni 649. Punimet urgjente të paparashikueshme

- 1. Kryerësi mund t'i kryejë punimet e paparashikuara edhe pa pëlqimin paraprak të porositësit, në qoftë se për shkak të urgjencës së tyre nuk ka pasur mundësi ta marrë këtë pëlqim.**
- 2. Punime të paparashikuara janë ato, ndërmarrja e të cilave ka qenë e domosdoshme për shkak të stabilitetit të objektit apo për parandalimin e shkaktimit të dëmit e që janë shkaktuar nga natyra e papritur më e rëndë e tokës me paraqitjen e papritur të ujit ose nga ndonjë ngjarje tjetër e jashtëzakonshme dhe e papritur.**
- 3. Kryerësi ka për detyrë që pa vonesë të njoftojë porositësin për këto fenomene dhe për masat e marra.**
- 4. Kryerësi ka të drejtë për shpërblim të drejtë për punimet e paparashikueshme që është dashur të kryhen.**
- 5. Porositësi mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se për shkak të këtyre punimeve, çmimi kontraktues do të duhej të shtohej konsiderueshëm për të cilën gjë ka për detyrë që pa shtyrje ta njoftojë kryerësin e punimeve.**
- 6. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit të punimeve pjesën përkatëse të çmimit për punimet e kryera, si edhe një shpërblim të drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra.**

Punimet urgjente të parashikueshme janë objekt i rregullimit të nenit 649 të LMD. Sipas ligjit, punime të paparashikuara janë ato punë, ndërmarrja e të cilave ka qenë e domosdoshme për shkak të stabilitetit të objektit apo për parandalimin e shkaktimit të dëmit e që nuk janë shkaktuar nga natyra e papritur e rëndë e tokës, me paraqitjen e papritur të ujit ose nga ndonjë ngjarjeje tjetër që është e jashtëzakonshme dhe e papritur.

Ligji i ofron të drejtën kryerësit (parag. 1 i nenit 649) që t'i kryejë punimet e paparashikuara edhe pa pëlqimin paraprak të porositësit, kur në rastin konkret, për shkak të urgjencës së tyre,

407 Komentar ZOO, II, Kragujevac, 1980, fq. 338.

408 Po aty.

nuk ka pasur mundësi ta marrë këtë pëlqim. Nëse paraqiten fenomenet e lartpërmendura, kryerësi ka për detyrë që, pa vonesë, ta njoftojë porositësin për këto fenomene. Kryerësit i takon e drejta për shpërblim të drejtë për punimet e paparashikueshme që është dashur të kryhen. Në këtë pikëpamje, në mënyrë analoge mund të zbatohen dispozitat juridike për zgjidhjen e kontratës, për shkak të ndryshimit të rrethanave. Kjo bëhet për arsye se punët e paparashikuara paraqesin rrethana të ndryshuara, të cilat palët kontraktuese nuk i kanë parashikuar me rastin e lidhjes së kontratës për ndërtimin.

Porositësi mund ta zgjidhë kontratën, në qoftë se për shkaqe të këtyre punimeve, çmimi kontraktues do të duhej të rritej konsiderueshëm, për të cilën gjë ka për detyrë pa shtyrje – menjëherë ta njoftojë kryerësin e punimeve. Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimi, përkatësisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositësit. Ai nuk mund të kërkojë ngritjen e çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë. (Neni 648 i LMD).

Kur zgjidhet kontrata, porositësi ka për detyrë t'ia paguajë kryerësit të punimeve pjesën përkatëse të çmimit për punimet e kryera si dhe një shpërblim të drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra.

Neni 650. Çmimi i punimeve

Çmimi i punimeve mund të caktohet sipas njësisë së matjes së punimeve të kontraktura (çmimi i njësisë) ose në shumë të tërësishme për tërë objektin (çmimi total i kontraktuar).

Ekziston detyrimi primar i porositësit të punës që për këtë të paguajë çmimin e caktuar. Çmimi mund të caktohet në mënyrën e cila është e përcaktuar me kushtet e porositësit në momentin kur e ka përgatitur dhe dërguar ofertën apo këtë e kanë përcaktuar palët me kontratë. Krahas lartësisë së çmimit, palët kanë mundësi të përcaktojnë edhe mënyrën e pagesës, e cila mund të bëhet përnjëherë edhe kjo rëndom pas kryerjes dhe pranimit të objektit apo edhe në mënyrë sukseseve, që përcaktohet në bazë të fazave të kryerjes së punëve, të cilat mund të jenë mujore të tërësishme. Çmimi i punimeve mund të caktohet sipas njësisë së matjes së punimeve të kontraktuara (çmimi i njësisë) ose në shumë të tërësishme për tërë objektin – çmimi total i kontraktuar.

Neni 651. Ndryshimi i çmimit

1. Në qoftë së me kontratë lidhur me ndryshimin e çmimit nuk është parashikuar diçka tjetër, kryerësi që e ka kryer detyrimin e vet në afatin e parashikuar mund të kërkojë rritjen e çmimit të punimeve në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës e të përmbushjes së saj kanë ndryshuar çmimet e elementeve në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve, kështu që do të duhej që ky çmim të ishte më i madh për më shumë se dy për qind (2%).

- 2. Në rastin kur kryerësi i punimeve me faj të vet nuk i ka kryer punimet në afatin e parashikuar me kontratë, ai mund të kërkojë rritjen e çmimit të punimeve në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe ditës kur sipas kontratës është dashur të përfundoheshin punimet e elementeve në bazë të të cilave është caktuar, kështu që ky do të duhej sipas çmimeve të reja të këtyre elementeve të ishte më i madh për më se pesë për qind.**
 - 3. Në rastet nga paragrafët e mësipërm, kryerësi mund të kërkojë vetëm diferencën në çmimin e punimeve që tejkalon dy (2%) përkatësisht pesë për qind (5%).**
 - 4. Kryerësi nuk mund të thirret në rritjen e çmimit të elementeve në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, në qoftë se deri te rritja e çmimit ka ardhur pas ardhjes së tij në vonesë.**
-

Rregullat juridike për ndryshimin e çmimeve shprehen në nenin 651 të LMD. Pra, ekziston mundësia që palët kontraktuese, porositësi dhe kryerësi i punëve, mund të kërkojnë të përmbushin detyrimet e tyre, ashtu siç theksohen në kontratë, përveç nëse rrethanat nuk kanë ndryshuar. Në qoftë se rrethanat kanë ndryshuar dhe për palët është vështirësuar përmbushja e kontratës, pala e dëmtuar mund t’i referohet *clausa rebus sic stantibus*. (Për këtë çështje, shih më hollësisht rregullat e klauzolës).

Sipas nenit 651, parag. 1 të LMD, në qoftë se me kontratë për sa i përket ndryshimit të çmimit nuk është parashikuar diçka tjetër, pala kontraktuese – kryerësi i punëve, që e ka kryer detyrimin e vet në afatin e parashikuar, mund të kërkojë rritjen e çmimit të punimeve, në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe përmbushjes së saj kanë ndryshuar çmimet e elementeve në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve, ashtu që duhej që ky çmim të ishte më i lartë për më shumë se dy për qind (2%).

Ngritja e elementeve të “çmimeve në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, në praktikë më se shpeshti shprehet me rritje të çmimit të materialit me të cilin kryerësi duhet të bëjë objektin, nëpërmjet rritjes së çmimit të shërbimeve të personave të tretë ose nëpërmjet ngritjes së shpenzimeve jetësore”.⁴⁰⁹

Në rastin kur kryerësi i punimeve, për fajin e vet, nuk i ka kryer punimet në afatin e parashikuar me kontratë, ai mund të kërkojë rritjen e çmimit të punimeve, në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe ditës kur, sipas kontratës, është dashur të përfundoheshin punimet e elementeve në bazë të të cilave është caktuar, kështu që ky do të duhej, sipas çmimeve të reja të këtyre elementeve, të ishte më i madh për më se pesë për qind (parag. 2 i nenit 651).

Sipërmarrësi në këtë rast mund të kërkojë vetëm diferencën e çmimit të punimeve që tejkalon dy përkatësisht pesë për qind.

.....
409 Komentar ZOO, II, Kragujevac, 1980, fq. 345.

Në qoftë se në rastet e parashikuara nga këto nene (651, 652 të LMD) çmimi kontraktues do të duhej të rritej konsiderueshëm, porositësi mund ta zgjidhë kontratën. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit pjesën përkatëse të çmimit të kontraktuar për punimet e kryera gjer atëherë, si edhe shpenzimet e drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra (neni 653 i LMD).

Për t'u zbatuar dispozitat e këtij neni, është e nevojshme që kryerësi i punëve të provojë se janë bërë rritje çmimesh të elementeve në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punëve. Pra, këtu është me rëndësi të jetë fjala për rrethana të cilat janë paraqitur pas momentit të lidhjes së kontratës.

Kryerësi nuk mund t'i referohet rritjes së çmimit të elementeve në mbështetje të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, në qoftë se rritja e çmimit ka ndodhur pas ardhjes së tij në vonesë.

Neni 652. Dispozitat për pandryshueshmërinë e çmimeve

- 1. Në qoftë se është kontraktuar së çmimi i punimeve nuk do të ndryshojë, në rastin kur pas lidhjes së kontratës rriten çmimet e elementeve, në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, kryerësi mund të kërkojë megjithëse ekziston një dispozitë e tillë e kontratës, ndryshimin e çmimit të punimeve, në qoftë se çmimet e elementeve janë rritur në atë masë që çmimi i punimeve do të duhej të ishte më i madh se dhjetë përlind (10%).**
- 2. Mirëpo, edhe në këtë rast kryerësi mund të kërkojë vetëm diferencën në çmimin që tejkalon dhjetë për qind, përveç nëse shtimi i çmimit të elementeve ka ardhur si pasojë e vonesës së tij.**

Çmimi te kontrata për ndërtimin mund të ndryshojë edhe më vonë, pas momentit të lidhjes së saj. Në qoftë se është kontraktuar që çmimi i punimeve nuk do të ndryshojë, në rast se pas lidhjes së kontratës rriten çmimet e elementeve, në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, edhe pse ekziston një dispozitë e tillë juridike në nenin 651 të LMD, kryerësi mund të kërkojë ndryshimin e çmimit të punimeve, kur në rastin konkret çmimet e elementeve janë rritur në atë masë që çmimi i punimeve do të duhej të ishte më i madh se dhjetë për qind. Kjo paraqet një ngjarje të jashtëzakonshme, pasojat e cilës nuk mund të barten personalisht. Kryerësi i punës do të bëjë rritjen e çmimit deri në dhjetë për qind nga çmimi i kontraktuar, ndërsa porositësi edhe më tepër. Në qoftë se në rastet e parashikuara nga neni 651, 651, çmimi kontraktues do të duhej të rritej konsiderueshëm, porositësi mund ta zgjidhë kontratën. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit pjesën përkatëse të çmimit të kontraktuar për punimet e kryera gjer atëherë, si dhe shpenzimet e domosdoshme të bëra (neni 653). Mirëpo, edhe në këtë rast sipërmarrësi mund të kërkojë vetëm diferencën në çmimin që tejkalon dhjetë për qind, përveç kur shtimi i çmimit të elementeve ka ardhur si pasojë e vonesës së tij.

Neni 653. Zgjidhja e kontratës për shkak të rritjes së çmimit

- 1. Në qoftë se në rastet nga nenet paraprake çmimi kontraktues do të duhej të rritej konsiderueshëm, porositësi mund ta zgjidhë kontratën.**
- 2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit pjesën përkatëse të çmimit të kontraktuar për punimet e kryera gjer atëherë, si edhe shpërblimin e drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra.**

Ligji i ofron të drejtën porositësit që ta zgjidhë kontratën, në qoftë se për shkak të këtyre punimeve të paparashikuara urgjente, çmimi kontraktues do të duhej të shtohet konsiderueshëm, për të cilën gjë ka për detyrë që pa shtyrje ta njoftojë kryerësin e punimeve. Në rastin e zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit të punimeve pjesën përkatëse të çmimit për punimet e kryera, si edhe një shpërblim të drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra (neni 549 parag. 5, 6 i LMD).

Në rast të zgjidhjes së kontratës, porositësi ka për detyrë t'i paguajë kryerësit pjesën përkatëse të çmimit të kontraktuar për punimet e kryera gjer atëherë si dhe shpërblimin e drejtë për shpenzimet e domosdoshme të bëra. (Parag. 2 i nenit 653 të LMD).

Porositësi është i obliguar që për qëllimin e tij që të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ta njoftojë kryerësin menjëherë, sapo të ketë mësuar për rritjen e çmimit të elementeve në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve.

Neni 654. E drejta e porositësit për të kërkuar zbritjen e çmimit të kontraktuar

- 1. Në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe përmbushjes së detyrimit të kryerësit janë zbritur çmimet e elementeve në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve për më tepër se dy për qind (2%), kurse punimet janë kryer brenda afatit të kontraktuar, porositësi ka të drejtë të kërkojë zbritjen përkatëse të çmimit të kontraktuar të punimeve mbi këtë përqindje.**
- 2. Në qoftë se është kontraktuar pandryshueshmëria e çmimit të punimeve, ndërsa këto janë kryer në afat të kontraktuar, porositësi ka të drejtë për zbritje të kontraktuar në rastin kur çmimet e elementeve, në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve, janë zbritur aq sa çmimi do të ishte më i vogël për më tepër se dhjetë për qind e pikërisht për diferencën në çmim prej më se dhjetë për qind (10%).**
- 3. Në rastin e vonesës së kryerësit të punimeve, porositësi ka të drejtë për zbritjen proporcionale të çmimit të punimeve për çdo zbritje të çmimit të elementeve, në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve.**

E drejta e porositësit për të kërkuar zbritjen e çmimit të kontraktuar rregullohet në nenin 654 të LMD. Sipas nenit 818, në qoftë se në kohën midis lidhjes së kontratës dhe përmbushjes së detyrimit të kryerësit janë ulur çmimet e elementeve, në bazë të cilave është caktuar çmimi i punimeve, për më tepër se 2 %, kurse punimet janë kryer brenda afatit të kontraktuar të punimeve mbi këtë përqindje, porositësi ka të drejtë të kërkojë zbritjen përkatëse të çmimit.

Kur rasti konkret ka të bëjë me vonesën e përmbushjes së detyrimit nga ana e kryerësit të punimeve, porositësi ka të drejtën të kërkojë zbritjen proporcionale të çmimit të punimeve për çdo zbritje të çmimit të elementeve, të cilat janë marrë parasysh në atë rast dhe në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve.

Te kontrata e ndërtimit, në praktikë ndodh që të kontraktohet pandryshueshmëria e çmimit të punimeve, të cilat janë kryer brenda afatit të kontraktuar. Në këtë rast porositësi ka të drejtën për zbritje të kontraktuar kur çmimet e elementeve, në bazë të të cilave është caktuar çmimi i punimeve janë ulur aq sa çmimi do të ishte më i vogël për më tepër se dhjetë për qind.

KREU 2

KONTRATA PËR NDËRTIMIN ME DISPOZITË TË VEÇANTË

Neni 655. Kontrata për ndërtimin me dispozitë të veçantë

- 1. Në qoftë se kontrata për ndërtimin përmban dispozitën “çelësi në dorë” ose ndonjë dispozitë tjetër të ngjashme, kryerësi detyrohet në mënyrë të pavarur që të kryejë së bashku të gjitha punimet e nevojshme për ndërtimin dhe përdorimin e objektit të caktuar të tërësishtëm.**
- 2. Në këtë rast çmimi i kontraktuar përfshin edhe vlerën e të gjitha punimeve të paparashikuara e të tepricës së punimeve, ndërsa përjashton ndikimin e mungesave të punimeve në çmimin e kontraktuar.**
- 3. Në qoftë se në kontratën “çelësi në dorë” marrin pjesë disa kryerës si palë kontraktuese, përgjegjësia e tyre ndaj porositësit është solidare.**

Me nocionin kontratë e ndërtimit me “dorëzim të çelësave” nënkuptojmë ato kontrata kur kryerësi i punës merr përsipër detyrimin për ndërtimin e objektit me të gjitha punimet e nevojshme dhe, pas kryerjes së ndërtimit, ia dorëzon çelësat porositësit; në fakt e bën dorëzimin e çelësave në mënyrë simbolike. Çmimi i kontraktuar këtu përfshin vlerën e të gjitha punimeve të parashikuara dhe tepricën e tyre. Kështu, në këtë mënyrë përjashtohet ndikimi i mungesës së punimeve në çmimin kontraktues. Rëndom kryerësi ka detyrimin të sigurojë materialin dhe është përgjegjës për cilësinë e atij materiali dhe të objektit, derisa t’ia dorëzojë atë porositësit (njëkohësisht edhe çelësat) për shfrytëzim. Porositësi, sipas

rregullës, nuk ka detyrimin për ta bërë mbikëqyrjen. Çmimin zakonisht e paguan në dy një pjesë: të parën si paradhënie dhe pjesën tjetër pas përfundimit të objektit dhe pranimit të tij.

Sipas parag. 2 të nenit 655 të LMD, çmimi i kontraktuar përfshin edhe vlerën e të gjitha punimeve të parashikuara e të tepricës së punimeve, ndërsa përjashton ndikimin e mungesave të punimeve për çmimin e kontraktuar.

Kur në rastin konkret lidhet kontrata për ndërtimin me “çelësat në dorë”, në të cilën marrin pjesë disa kryerës, si palë kontraktuese, përgjegjësia e tyre ndaj porositësit është solidare.

KREU 3 PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT

Neni 656. Zbatimi i rregullave të kontratës për veprën

Në qoftë se në këtë pjesë nuk është caktuar ndryshe, për përgjegjësinë për të metat e godinës zbatohen dispozitat përkatëse të kontratës për veprën.

Neni 656 i LMD është mjaft shprehimor dhe, sipas tij, për përgjegjësinë për të metat e godinës zbatohen dispozitat përkatëse të kontratës për veprën. (Për këtë çështje, shih hollësisht komentet e paraqitura në kapitullin lidhur me kontratën për veprën).

Neni 657. Kalimi i të drejtave nga përgjegjësia për të metat

Të drejtat e porositësit ndaj kryerësit për shkak të të metave të godinës kalojnë edhe në të gjithë fituesit e mëvonshëm të godinës ose të pjesës së saj, por fituesve të mëvonshëm nuk u rrjedh afati i ri për njoftim dhe padi, por u llogaritet afati i paraardhësve.

Kalimi i të drejtave nga përgjegjësia për shkak të të metave të godinës rregullohet në nenin 657 të LMD. Në këtë nen thuhet shprehimisht se të drejtat e porositësit ndaj kryerësit për shkak të të metave të objektit ndërtimor kalojnë edhe te të gjithë fituesit e mëvonshëm të godinës ose të pjesës së saj. Mirëpo, sa u përket fituesve të mëvonshëm nuk rrjedh një afat i ri për njoftim dhe padi, por në këtë rast atyre u llogaritet afati i paraardhësve. Kalimi i të drejtave prej porositësit te kryerësi i ndërtimit bëhet në bazë të vet ligji, nga momenti kur fituesi e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit, përkatësisht të drejtën e pronësisë. Nuk është i nevojshëm cedimi i kërkesës.

KREU 4 PËRGJEGJËSIA E KRYERËSIT DHE E PROJEKTUESIT PËR SOLIDITETIN E GODINËS

Neni 658. Nga çka përbëhet

- 1. Kryerësi përgjigjet për të metat e ndërtimit të godinës që i përkasin soliditetit të saj, në qoftë se këto të meta do të paraqiteshin për një kohë prej dhjetë (10) vitesh nga dorëzimi dhe pranimi i punimeve.**
- 2. Kryerësi përgjigjet edhe për të metat e tokës në të cilën është ngritur godina, të cilat do të tregoheshin për një kohë prej dhjetë vjetësh nga dorëzimi dhe pranimi i punimeve, përveç nëse organizata e specializuar e ka dhënë mendimin profesional se toka është e përshtatshme për ndërtim, kurse gjatë ndërtimit nuk janë paraqitur rrethana që e vijnë në dyshim bazueshmërinë e mendimit profesional.**
- 3. E njëjta gjë vlen edhe për projektuesin në qoftë se e meta e godinës rrjedh nga ndonjë e metë në plan.**
- 4. Ata janë përgjegjës sipas paragrafëve të mësipërm jo vetëm ndaj porositësit por edhe çdo fituesi tjetër të godinës.**
- 5. Kjo përgjegjësi e tyre nuk mund të përjashtohet e as të kufizohet me kontratë.**

Kontrata e ndërtimit ka për objekt ngritjen e godinave, komplekseve dhe uzinave, urave, tuneleve etj., të cilat janë me interes për porositësin. Ato duhet të ndërtohen në mënyrë solide, me të gjitha kushtet e plota funksionale, pra të jenë pa të meta dhe lëshime (qoftë në aspektin e statikës, qoftë në aspektin projektues ideor). Për të gjitha të metat që paraqiten në objektin ndërtimor gjatë kohës dhjetëvjeçare, përgjigjet kryerësi i punëve. Ky përgjigjet edhe për stabilitetin e tokës së truallit, përveç nëse ndërmarrja e specializuar ka qenë e angazhuar për këtë dhe ajo ka dhënë mendimin profesional për mundësinë e ndërtimit. Sikurse edhe kryerësi i punëve, përgjigjet edhe projektuesi, nëse të metat në objektin ndërtimor janë pasojë e ndonjë mungese në projekt. Këta persona i përgjigjen jo vetëm investuesit – porositësit, por edhe të gjithë personave të tjerë që kanë marrë objektin në bazë të punëve juridike. Përgjegjësia e kryerësit të punëve dhe e projektuesit është përgjegjësi ligjore dhe këta nuk kanë mundësi ta përjashtojnë apo ta zvogëlojnë këtë me kontratë. Përgjegjësia e ndërtuesit ose e projektuesit për shpërblim të dëmit bazohet në rregullat e përgjithshme për përgjegjësinë e debitorit për cenimin e kontratës. Për të pasur mundësi ta realizojë të drejtën mbi këtë bazë, investuesi duhet ta informojë personin përgjegjës në afat prej gjashtë muajsh lidhur me faktin se a i ka vërejtur të meta në objektin ndërtimor. Këtë të drejtë kanë mundësi ta realizojnë edhe përfituesit e tjerë (nga objekti) në afatin prej një viti, pasi të jetë informuar kryerësi i punëve, respektivisht projektuesi lidhur me të metat.

Kryerësi i punëve, sipas rregullit, përgjigjet për dëmin që është shkaktuar ngase ka vepruar sipas kërkesës së investuesit. Kjo përgjegjësi do të pakësohet apo përjashtohet

tërësisht, nëse kryerësi i punëve ia ka tërhequr vërejtjen investuesit se po të veprohet sipas kërkesës së tij, do të shkaktohen situata të dëmshme. Kryerësi i punëve, nëse e ka realizuar shpërblimin e dëmit për mangësitë në objekt, ka të drejtë të kërkojë shpërblim nga projektuesi (ndërmarrja e consalting-inxhinieringut). Masa e këtij shpërblimi do t'i përgjigjet gabimit apo mungesës së projektit.

Të drejtë regresi kryerësi i punëve ka edhe ndaj prodhuesve apo atyre që u është besuar kryerja e një pjese të punëve ndërtimore dhe ai duhet në afatin prej dy muajve të lajmërohet për të metat e paraqitura në objektin ndërtimor, (afati llogaritet nga dita kur kryerësin e punëve e ka lajmëruar investuesi apo porositësi i objektit ndërtimor).

Kryerësi i përgjigjet për të metat e ndërtimit të godinës që i përkasin soliditetit të saj, në qoftë se këto të meta do të paraqiten për një kohë prej dhjetë vjetësh, nga dorëzimi dhe pranimi i punimeve. Kryerësi përgjigjet edhe për të metat e tokës në të cilën është ngritur godina, të cilat do të paraqiteshin për një kohë prej dhjetë vjetësh nga dorëzimi dhe pranimi i punimeve. Kjo vlen edhe për projektuesin, në qoftë se e meta në godinë rrjedh nga ndonjë mungesë në planin e ndërtimit. (Parag. 3 i nenit 658 të LMD).

Neni 659. Detyra e njoftimit dhe humbja e të drejtave

- 1. Porositësi ose fituesi tjetër ka për detyrë që për të metat ta njoftojë kryerësin dhe projektuesin e punimeve në afat prej gjashtë (6) muajsh, prej kur e ka konstatuar të metën, përndryshe humb të drejtën që të thirret në të.**
- 2. E drejta e porositësit ose e fituesit tjetër ndaj kryerësit respektivisht ndaj projektuesit sipas bazës së përgjegjësisë së tyre për të metat shuhet brenda një (1) viti duke llogaritur nga dita kur porositësi respektivisht fituesi e ka njoftuar projektuesin, përkatësisht kryerësin e punimeve për të metën.**
- 3. Kryerësi i punimeve apo projektuesi nuk mund të referohet në dispozitat e paragrafëve të mësipërm nëse defekti ka të bëjë me faktet që kanë qenë të njohura apo nuk kanë mundur të ngelin të panjohura dhe se kanë dështuar të njoftojnë porositësin, respektivisht fituesin tjetër, ose përmes veprimit të tyre ata e kanë keqinformuar porositësin, respektivisht fituesin, në atë mënyrë që ta bëjnë atë të mos ketë mundësi ta shfrytëzojnë këtë të drejtë me kohë.**

Sipas ligjit, porositësi ose fituesi tjetër ka për detyrë që për të metat ta njoftojë sipërmarrësin e punimeve në afat prej gjashtë muajsh. Ky afat vlen prej kur e ka konstatuar të metën. Në qoftë se ky afat nuk respektohet, ai humbë të drejtën t'i referohet asaj. Nga kjo që u tha del se e drejta e porositësit ose e fituesit tjetër ndaj sipërmarrësit, sipas bazës së përgjegjësisë së tyre për të metat, shuhet brenda një viti. Në këtë rast, llogaritet nga dita kur porositësi, përkatësisht fituesi, e ka njoftuar projektuesin, përkatësisht sipërmarrësin e punimeve për të metën.

Afati në kohëzgjatje prej gjashtë muajve për të metat te kontrata për ndërtimin është afat ligjor i parashikuar shprehimisht me parag. 1 të nenit 659 të LMD.

Neni 660. Zvogëlimi dhe përjashtimi i përgjegjësive

- 1. Kryerësi nuk lirohet nga përgjegjësia në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak se gjatë kryerjes së punimeve të caktuara ka vepruar sipas kërkesave të porositësit.**
- 2. Në qoftë se para kryerjes së punës së caktuar sipas kërkesës së porositësit ia ka tërhequr vërejtjen për rrezikun nga dëmi, përgjegjësia e tij zvogëlohet dhe sipas rrethanave të rastit konkret, mundet edhe të përjashtohet.**

Zvogëlimi dhe përjashtimi i përgjegjësive shprehet në nenin 660 të LMD. Ligji parashikon shprehimisht se kryerësi nuk lirohet nga përgjegjësia, në qoftë se dëmi ka ndodhur për shkak se gjatë kryerjes së punimeve të caktuara ai ka vepruar sipas kërkesave të porositësit. Përgjegjësia e porositësit zvogëlohet, në qoftë se ai, para kryerjes së punës së caktuar sipas kërkesës së porositësit, ia ka tërhequr vërejtjen për rrezikun nga dëmi. Përgjegjësia (sipas parag. 2 të nenit 660) mund të zvogëlohet, por, varësisht nga rrethanat e rastit konkret, ajo edhe mundet të përjashtohet.

Neni 661. Regresi

- 1. Kur për dëmin janë përgjegjës kryerësi dhe projektuesi, përgjegjësia e secilit prej tyre caktohet sipas madhësisë së fajit të tij.**
- 2. Projektuesi që e ka hartuar projektin e godinës dhe të cilit i është besuar mbikëqyrja e kryerjes së punimeve të planifikuara përgjigjet edhe për të metat në punimet e bëra të shkaktuara me faj të kryerësit të punimeve, në qoftë se ka mundur t'i vinte re me mbikëqyrjen normale dhe të arsyeshme të punimeve, por ka të drejtë të kërkojë nga kryerësi i punimeve shpërblimin përkatës.**
- 3. Kryerësi i punimeve që e ka shpërblyer dëmin e shkaktuar për shkak të të metave në punimet e kryera ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga projektuesi në masën në të cilën të metat në punimet e kryera rrjedhin prej të metave në projekt.**
- 4. Nëse për të metën është përgjegjës një person, të cilit kryerësi ia ka besuar kryerjen e një pjese të punës, atëherë kryerësi duhet – nëse dëshiron shpërblim prej atij personi - të njoftojë për ekzistimin e të metës në afat prej dy (2) muajsh, duke e llogaritur nga dita kur ai vet ka qenë i njoftuar nga porositësi për të njëjtën të metë.**

Regresi gjen shprehje në nenin 661 të LMD. Nëse në rastin konkret, kur për dëmin e shkaktuar janë përgjegjës kryerësi dhe projektuesi, përgjegjësia e këtyre përcaktohet duke marrë parasysht

shkallën e fajit të tyre. Sipas ligjit, ekziston përgjegjësia e projektuesit që e ka hartuar projektin e godinës dhe të cilit i është besuar mbikëqyrja e kryerjes së punimeve të planifikuara edhe për të metat në punimet e bëra, të shkaktuara për fajin e kryerësit të punimeve.

Kryerësi i punimeve, që e ka shpërblyer dëmin e shkaktuar për të metat në punimet e bëra, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga projektuesi për aq sa të metat rrjedhin nga projekti. Në rastin tjetër, kur për të metën është përgjegjës një person të cilit kryerësi ia ka besuar kryerjen e një pjese të punës, kur kryerësi kërkon shpërblim prej tij, atëherë ky duhet do ta njoftojë këtë person për ekzistimin e mungesës. Njoftimi duhet bërë sipas afatit të parashikuar ligjor në kohëzgjatje prej dy muajsh, i cili llogaritet nga dita kur ai vetë ka qenë i njoftuar nga porositësi për të njëjtën mungesë në ndërtim.

Ruzhdi Berisha**PJESA XI
KONTRATA PËR TRANSPORTIN****KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 662. Nocioni**

- 1. Me kontratën për transportin detyrohet transportuesi që të transportojë në vendin e caktuar ndonjë person ose send, ndërsa udhëtari, respektivisht dërguesi detyrohet që për këtë t'i paguajë shpërblimin e caktuar.**
- 2. Transportuesi sipas këtij Ligji konsiderohet si personi i cili merret me transport si punë të rregullt të tij, ashtu edhe çdo person tjetër i cili detyrohet me kontratë të kryejë transportin me shpërblim.**

1. Vështrim i përgjithshëm.- Pjesa XI e LMD përmban dispozita me të cilat rregullohet transporti. Në nenin e parë (neni 648) të kësaj pjese është dhënë kuptimi dhe elementet qenësore të kontratës për transportin, duke përfshirë si transportin e personave, ashtu edhe të sendeve. Kuptimi i transportit të personave dhe mallit jepet edhe në ligjet e veçanta me të cilat rregullohen llojet e veçanta të transportit. Marrëdhëniet e caktuara juridike mes palëve në kontratat e transportit nuk mund të bazohen e as të zgjidhen vetëm në bazë të dispozitave të LMD. Për zgjidhjen e tyre janë me ndikim edhe dispozitat e ligjeve të caktuara, sipas objektit dhe llojit të transportit, si: transporti i personave apo i mallit, transporti rrugor, ajror apo hekurudhor, transporti i brendshëm apo ndërkombëtar. Secili lloj i transportit të sipërpërmendur i ka veçoritë e veta, prandaj edhe është e pamundur të rregullohen të gjitha marrëdhëniet mes palëve kontraktuese në lëmin e transportit me dispozita të përbashkëta. Në këtë mënyrë, në LMD janë dhënë rregullat e përgjithshme për të gjitha llojet e transportit, ndërsa me ligje të veçanta janë caktuar rregulla të detajuara dhe specifike për llojet e veçanta të transportit. Kështu, transporti, përveç me dispozitat e LMD, është i rregulluar edhe me Ligjin për Transportin Rrugor (Ligji nr. 04/L-179 dt. 16.05.2013), Ligjin për Aviacionin Civil (Ligji nr. 03/L-051 dt. 13 Mars 2008), Ligjin nr. 2004/6 për Transportin e Mallrave të Rrezikshme (Ligji nr. 20014/6), Ligjin për Rrugët (Ligji nr. 2003/11) Konventa për Kontratat lidhur me Transportin Ndërkombëtar të Mallit nëpërmjet Rrugëve (CMR) 1956, Konventa për Kontratat për Transportin Ndërkombëtar të Udhëtarëve dhe Mallit (CVR) 1973).

2. Nga kuptimi i dhënë për kontratën për transportin në nenin 662 të këtij Ligji rrjedh se ajo është kontratë *konsesuale*,⁴¹⁰ që nënkupton se për vlefshmërinë juridike të saj mjafton

410 Shih nenin 15 dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen, nga pjesa e përgjithshme e këtij Ligji.

që palët kontraktuese të jenë pajtuar lidhur me elementet thelbësore të saj. Në këtë mënyrë, përmbushja e detyrimit nuk nënkupton lidhjen e kontratës konsesuale, por realizimin e saj. Ajo është *kontratë me detyrime të dyanshme*.

Elemente thelbësore të saj janë: detyrimi i transportuesit për të transportuar ndonjë person apo ndonjë send deri në vendin e caktuar dhe detyrimi i udhëtarit, përkatësisht dërguesit që për këtë të paguajë shpërblimin e caktuar. Elemente jothelbësore mund të jenë: dispozitat që kanë të bëjnë me mënyrën e transportit, me rrugën, mënyrën e ngarkimit, mënyrën e shkarkimit etj.

Transportuesi ka detyrimin të transportojë ndonjë *person* ose *send*. Siç shihet, *objekt i kësaj kontrate* janë personat ose sendet (mallrat). Varësisht nga objekti, kontratat për transportin mund të ndahen në dy grupe: a. kontratat për transportin e personave dhe b. kontratat për transportin e sendeve. Derisa sipas kuptimit të dhënë, për kryerjen e detyrimeve nga transportuesi, pala tjetër kontraktuese – udhëtarit apo dërguesi ka detyrimin të paguajë shpërblimin e duhur, kjo lë të kuptohet se ajo është kontratë, sipas së cilës, shërbimi i kryer paguhet. Pra, në LMD në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrimet e pjesëmarrësve në transport, por nuk precizohen të drejtat dhe detyrimet e tyre. Këto rregullohen me dispozita të veçanta, varësisht nga lloji i transportit.

Sa i përket formës, me Ligj nuk parashikohet një formë e caktuar, prandaj rrjedh se ajo është *kontratë joformale*, gjë që nënkupton se për lidhjen e kësaj kontrate nuk është e nevojshme ndonjë formë e caktuar, përpos nëse me ligj është caktuar ndryshe.⁴¹¹

Palë kontraktuese janë transportuesi dhe udhëtarit, përkatësisht dërguesi i sendeve, që do të thotë se këto janë *subjekte* të një kontrate për transportin. Në shumicën e rasteve, dërguesi i sendeve nuk është edhe personi që duhet t'i pranojë ato sende, pasi të transportohen në vendin e caktuar. Ndodh që ato të pranohen nga personi i tretë. Në këto raste transportuesi ka detyrime të caktuara edhe ndaj pranuesit të sendeve, edhe pse ai nuk është palë kontraktuese.

3. Në par. 2 të këtij neni përcaktohet se kush konsiderohet transportues sipas këtij Ligji. Sipas kuptimit të dhënë, shihet se në këtë kontratë është përfshij vetëm transporti me pagesë. Transporti i sendeve të veta nuk mund të trajtohet si veprimtari e pavarur ekonomike, e cila është e rregulluar me kontratën për transportin e mallit. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportues konsiderohet vetëm ai që transportin e bën me pagesë. Në këtë mënyrë, si transportues konsiderohet personi që merret me këtë veprimtari, si punë të rregullt të tij. Ligji përcakton se transportues është edhe personi tjetër që është detyruar me kontratë të kryejë transportin me shpërblim.

.....
411 Shih nenin 51 par. 1 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen nga pjesa e përgjithshme e këtij Ligji.

Neni 663. Detyrimet e transportuesit në transportin linjar

1. Transportuesi i cili kryen transportin në një linjë⁴¹² të caktuar (transporti linjar) ka për detyrë që rregullisht dhe në gjendje të rregullt të mbajë linjën e shpallur.
2. Ai ka për detyrë të pranojë për transport çdo person dhe çdo send që përmbushin kushtet e caktuara me kushtet e përgjithshme të shpallura.
3. Në qoftë se mjetet e rregullta të transportit të transportuesit nuk mjaftojnë për kryerjen e të gjitha transporteve të kërkuara, përparësi kanë personat ose sendet për të cilat kjo është parashikuar me dispozita të veçanta, ndërsa përparësia e mëtejshme caktohet sipas radhës së kërkesave, por midis kërkesave të njëkohshme përparësia caktohet sipas gjatësisë më të madhe të transportit.

1. Në nenin paraprak 662 par. 1 të LMD është përcaktuar detyrimi i përgjithshëm i transportuesit dhe udhëtarit, përkatësisht dërguesit të sendit. Në nenin 663 të këtij Ligji përcaktohen detyrimet e transportuesit në *transportin linjor* (e rregullt)⁴¹³, si një lloji të veçantë të transportit,⁴¹⁴ për dallim nga *transporti i lirë*. Kemi të bëjmë me transport të lirë atëherë kur nuk është caktuar qarkullimi i rregullt dhe i përhershëm në kohë dhe relacion të caktuar, ashtu që lidhur me këtë dhe me kushtet e tjera të transportit merren vesh vetë kontraktuesit. Transporti linjor është transporti në relacione të caktuara dhe me orar të caktuar të qarkullimit.⁴¹⁵ LMD nuk përmban rregulla lidhur me transportin e lirë.

Sipas par. 1 të këtij neni, transportuesi që kryen transportin në një linjë të caktuar ka për detyrim që gjithmonë dhe në mënyrë të rregullt ta mbaj linjën e shpallur. Linja e caktuar me orarin e qarkullimit shpallet në vende të dukshme, ku zakonisht lëvizin udhëtarët. Kjo dispozitë ligjore është e natyrës detyruese, ashtu që detyrimi i mbajtjes së orarit të vozitjes dhe kushtet e tjera të transportit janë të rregulluara me ligje të veçanta, të cilat i rregullojnë llojet e veçanta të transportit. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi në transportin linjor ka detyrime të bëjë transportin e personave dhe të sendeve në linjën e caktuar dhe të lejuar të qarkullimit nga njëri vend në tjetrin, sipas orarit paraprakisht të caktuar për qarkullim. Kjo nënkupton se transportuesi që ka pranuar të kryejë transportin linjor nuk bën që, në mënyrë të njëanshme, pa pëlqimin e organit përkatës i cili i ka lejuar atë linjë të transportit, të sillet ndryshe për sa i përket kryerjes së transportit të personave dhe sendeve

412 Kuptimi për linjë të transportit është dhënë në nenin 3 par. 1.22 të Ligjit për Transportin Rrugor, Ligji nr. 04/L-179, dt. 16 maj 2013, sipas të cilit, me linjë nënkuptohet relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;

413 Në nenin 14 të Ligjit për Transportin Rrugor (LTRR) përcaktohen mënyrat e ushtrimit të transportit rrugor të udhëtarëve, ashtu që, sipas kësaj dispozite ligjore, transporti i udhëtarëve ushtrohet: si transport *i rregullt* dhe si transport *i lirë* i udhëtarëve me autobus. Në këtë aspekt shprehja *transporti linjor* sipas LMD nënkupton *transportin e rregullt* sipas LTRR.

414 Në këtë dispozitë ligjore përcaktohen detyrimet vetëm të *transportuesit linjor*, i cili transporton rregullisht persona apo sende në një linjë të caktuar, nga njëri vend në një vend tjetër. Përpos transportit linjor, ekziston edhe *transporti i lirë*, që nënkupton transportin e personave dhe të sendeve nga njëri vend në një vend tjetër, por jo në mënyrë të rregullt, vetëm në rast nevojë për një rast të vetëm.

415 Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 1012.

në kohë dhe vend të caktuar, si, p.sh., për shkak të jorentabilitetit të pushojë së kryeri të transportit në ato linja, të ngrejë çmimet e transportit pa lejen e organit përkatës etj.

2. Për mallra të caktuara të rrezikshme parashikohen rregulla të veçanta sipas Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.⁴¹⁶ Nisur edhe nga kjo arsye si dhe nga shkaqet e tjera të sigurisë së transportit, transportuesi ka detyrimin t'i shpallë në vende më të përshtatshme, me qëllim të informimit të drejtë dhe me kohë, kushtet e përgjithshme të transportit të personave dhe mallrave. Duke u nisur nga fakti se ushtrimi i transportit linjor është një veprimtari specifike, e cila përfaqëson një shërbim publik, në par. 2 të këtij neni parashikohet *detyrimi i transportuesit të pranojë për transport* çdo person dhe çdo send që përmbush kushtet e caktuara nga kushtet e përgjithshme të shpallura. Në këtë aspekt, transportuesi është i detyruar të pranojë të lidhë kontratë për transportin e çdo personi dhe çdo sendi që i përmbush kushtet e caktuara nga kushtet e përgjithshme të shpallura. Sa i përket detyrimit të kontraktimit, në rastet kur me ligj dikush është i detyruar të lidhë kontratë, siç parashikohet me këtë dispozitë, personi i caktuar mund të kërkojë, në këtë rast nga transportuesi, menjëherë të lidhet kontrata.⁴¹⁷ Derisa kjo është dispozitë detyruese, në rast se transportuesi nuk e lidh kontratën menjëherë, në kohën e arsyeshme, është përgjegjës për dëmin eventual të shkaktuar për këtë arsye.⁴¹⁸

Derisa transportuesi ka detyrimin të pranojë për transport *çdo person dhe çdo send*, kjo nënkupton se të gjithë shfrytëzuesit e transportit janë të barabartë në shfrytëzimin e kësaj të drejte. Pavarësisht nga ajo që në këtë dispozitë bëhet fjalë vetëm për transportin linjor, logjikisht rrjedh se kjo rregull medoemos duhet të vlejë edhe për transportin e lirë. Me kushte të përgjithshme të transportit mund të parashikohen përjashtime nga transporti për persona dhe mallra të caktuara, për shkak të paketimit të mallit, natyrës së mallit, gjendjes shëndetësore të personit, sjelljeve të personave të caktuar etj.

3. Detyrimi i transportuesit i parashikuar nga par. 2 i këtij neni për të pranuar çdo person dhe çdo send për transport, ndodh të mos mund të realizohet për shkaqe objektive. Me ligj parashikohet shprehimisht se kjo mund të ndodhë për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme të transportit, që nuk do të thotë se nuk mund të jetë edhe ndonjë arsye tjetër, si, p.sh., kushtet e rrugës, ato klimatike etj. Sipas par. 3 të këtij neni, përzgjedhja e transporteve bëhet sipas tri kritereve. Në rastet e këtilla, kur objektivisht është e pamundur të kryhet transportimi lidhur me të gjitha kërkesat e paraqitura, në radhë të parë kanë përparësi personat ose sendet për të cilat kjo përparësi parashikohet me dispozita të veçanta, qoftë edhe me rregulla të përgjithshme, si, p.sh., personat të cilët janë invalid, apo mallrat me afat më të shkurtër skadence etj. Pas këtyre, përparësia e transportit duhet caktuar sipas radhës së kërkesave, varësisht nga koha e paraqitjes e në rast se disa kërkesa janë paraqitur në të njëjtën kohë, përparësia caktohet sipas gjatësisë së transportit, ashtu që përparësi ka kërkesa me gjatësi më të madhe transporti.

416 Shih nenet 4 dhe 5 të Ligjit për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme nr. 04/L-183 dt.19 Mars 2013.

417 Shih nenin 17 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen në pjesën e përgjithshme të LMD.

418 Shih nenin 167 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen nga pjesa e përgjithshme e LMD.

Neni 664. Denoncimi i kontratës⁴¹⁹

1. Dërguesi, respektivisht udhëtari mund të denoncojë kontratën para se të fillojë përmbushja e saj, por ka për detyrë ta shpërblejë dëmin të cilin transportuesi do ta pësonte për këtë shkak.
2. Kur transportuesi vonon me fillimin e transportit aq sa pala tjetër nuk ka më interes për transportin e kontraktuar, ose kur transportuesi nuk mund ose nuk donë të kryejë transportin e kontraktuar, pala tjetër mund të denoncoj nga kontrata dhe të kërkojë kthimin e shpërblimit të paguar për transportin.

1. Në pjesën e këtij Ligji me të cilën është rregulluar kontrata për transportin, nuk parashikohet mundësia e heqjes dorë nga kontrata e transportuesit. Me dispozitën ligjore të nenit 664 parashikohet mundësia dhe rregullohet heqja dorë nga kontrata e dërguesit të sendeve, përkatësisht udhëtarit. Nga kjo vetvetiu nënkuptohet se personi që heq dorë nga kontrata e lidhur, ka detyrimin që palës tjetër t'ia shpërblejë dëmin eventual të shkaktuar, përndryshe do të cenohej siguria juridike e pjesëmarrësve në marrëdhënie të ndryshme juridike.

2. Në par. 1 të këtij neni parashikohet mundësia që dërguesi i sendit, përkatësisht udhëtari të heqin dorë nga kontrata. Këtë mund ta bëjnë pa ndonjë detyrim për të paraqitur arsye pse e bëjnë këtë, por vetëm para se të fillojë përmbushja e detyrimit sipas kontratës nga ana e transportuesit. Në bazë të kësaj dispozite, përjashtohet mundësia e heqjes dorë pasi të ketë kaluar udhëtari një pjesë të relacionit të udhëtimit, apo të jetë bërë transporti i sendit në një pjesë të relacionit të kontraktuar. Në rast se transportuesi ka pësuar në ndonjë mënyrë dëm për shkak të heqjes dorë nga kontrata, udhëtari është përgjegjës për shpërblimin e atij dëmi. Duke pasur parasysh natyrën e kësaj kontrate, masa e dëmit do të mund të ishte më së shumti deri në shumën e pagesës së çmimit për transport, të cilën është dashur ta paguajë shfrytëzuesi i transportit.

3. Përpos në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, shfrytëzuesi i transportit ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata edhe në rast se fillimi i transportit vonohet aq sa ai më nuk ka interes për transportin e kontraktuar ose kur transportuesi nuk mundet ose nuk do ta kryejë atë transport, siç parashikohet në par. 2 të këtij neni. Pavarësisht nga cila prej këtyre arsyeve shfrytëzuesi i transportit ka hequr dorë nga kontrata dhe ajo në këtë mënyrë është zgjidhur, transportuesi ka detyrimin ta kthejë në këtë rast pagesën e marrë për transport. Me zgjidhjen e kontratës, normalisht, të dy palët lirohen nga detyrimet e ndërsjella që kanë

419 Në këtë dispozitë ligjore përdoret fjala “denoncim” në emërtim të saj, në paragrafin e parë dhe në paragrafin e dytë. Vetë emërtimi i dispozitës është “*Denoncimi i kontratës*”, në paragrafin e parë thuhet “*të denoncoj kontratën*” dhe në paragrafin e dytë “*të denoncoj nga kontrata*”. Shikuar nga përmbajtja e kësaj dispozite dhe qëllimi i saj, konsiderojmë se shprehja “*Denoncim*” nuk është në këtë rast shprehje adekuate. Përmbajtja e dispozitës nënkupton *heqjen dorë nga kontrata*, shprehje kjo që është përdorur për këtë dispozitë në ligjet e shteteve të tjera të rajonit, në gjuhën kroate, serbe dhe malazeze, “*odustanak od ugovora*”. Kësisoj edhe në komentim e dhënë për këtë nen do të përdorim këtë shprehje gjuhësore.

pasur sipas kontratës, përpos detyrimit për dëmshpërblim.⁴²⁰ Edhe pse në par. 2 të këtij neni është parashikuar vetëm detyrimi i transportuesit për kthimin e shumës së paguar për transport dhe jo edhe detyrimi për dëmin eventual shkaktuar shfrytëzuesit të transportit, konsiderojmë se kjo nuk është pengesë që ai ta realizojë shpërblimin e dëmit eventual të shkaktuar me mospërmbushjen e kontratës, ashtu siç parashikohet në neni 106 të LMD.

Neni 665. Shuma e shpërblimit për transport

- 1. Në qofte se shuma e shpërblimit për transport është caktuar me tarifë ose me ndonjë akt tjetër detyrues të shpallur, nuk mund të kontraktohet shpërblimi më i madh.**
- 2. Në qoftë se shuma e shpërblimit për transport nuk është caktuar me tarifë ose me ndonjë akt detyrues tjetër të shpallur e as me kontratë, transportuesi ka të drejtë për shpërblim të zakonshëm për këtë lloj transporti.**
- 3. Në pjesën tjetër në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për shpërblimin të përmbajtura në pjesën e këtij Ligji për kontratën për veprën.**

1. Ushtrimi i veprimtarisë së transportit është një veprimtari specifike, e cila përfaqëson një shërbim publik për qytetarët.⁴²¹ Duke u nisur nga fakti se veprimtaria e transportit është me interes publik, me këtë dispozitë ligjore përcaktohen rregullat themelore përkitazi me shumën e pagesës për transport, nga rrjedh se qëllimi i kësaj rregulle është të mbrojë shfrytëzuesit e transportit, prandaj shuma e pagesës së transportit është nën mbikëqyrjen e shtetit. Kështu, me këtë dispozitë ligjore përcaktohen rregullat bazë përkitazi me shumën e pagesës së transportit; më në detaje ajo rregullohet me ligje të veçanta, varësisht nga lloji i transportit.⁴²² Për arsytet e a mësipërme „shuma e pagesës së transportit, veçmas për transportin e udhëtarëve, është caktuar me tarifë ose me ndonjë akt tjetër të përgjithshëm të shpallur. Për të mos u ndryshuar shpërblimet e caktuara me tarifë apo me ndonjë akt tjetër detyrues në dëm të shfrytëzuesit të transportit, është e ndaluar rritja e shpërblimit me anë të kontratës së lidhur ndërmjet transportuesit dhe shfrytëzuesit të shërbimit. Sipas par. 1 të këtij neni, nuk mund të kontraktohet një shpërblim më i lartë sesa shpërblimi për transport i caktuar me tarifë ose me ndonjë akt tjetër detyrues të shpallur. Kjo vlen vetëm për rastet kur shuma e shpërblimit është e caktuar me tarifë ose me ndonjë akt tjetër detyrues të shpallur. Shuma e shpërblimit, sipas tarifës apo ndonjë akti tjetër detyrues, duhet të shpallet në një vend të dukshëm për shfrytëzuesit e transportit.⁴²³ Kjo do të

420 Shih nenin 106 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në pjesën e përgjithshme të këtij Ligji.

421 Shih komentin e dhënë për nenin 663 të këtij Ligji në pikën 2.

422 Përkitazi me transportin rrugor, kjo është rregulluar në nenin 22 të Ligjit për Transportin Rrugor, ku parashikohet se operatori i transportit përcakton çmimoren për relacionet e caktuara, e cila duhet të vihet në autobusin që qarkullon në atë linjë, në bazë të së cilës duhet të bëhet pagesa. Ministria përkatëse cakton çmimet e transportit për kategori të veçanta të udhëtarëve, siç janë: studentët, invalidët e luftës dhe të punës dhe pensionistët.

423 Sipas neni 31 par. 3 pika 3.3 të LTRR, automjeti me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve duhet të ketë çmimoren e cila duhet të jetë e vendosur në një vend të dukshëm në automjet.

nënkuptonte se shuma e shpërblimit të transportit, në kushte të njëjta, duhet të jetë e njëjtë për të gjithë shfrytëzuesit, përpos kategorive të veçanta. Dispozita nga par. 1 i këtij neni është e karakterit detyrues, prandaj do të jetë nule dispozita e kontratës për transportin, me të cilën është detyruar shfrytëzuesi i transportit të paguajë një shumë më të lartë nga ajo që është caktuar me tarifë apo me ndonjë akt tjetër detyrues të shpallur. Në qoftë se çmimi sipas një kontrate të këtillë nuk është paguar, transportuesi nuk ka të drejtë të realizojë një shpërblim më të lartë, por në rast se shfrytëzuesi i transportit, duke vepruar sipas një kontrate të tillë, ka paguar një shpërblim më të lartë, ka të drejtë të kërkojë nga transportuesi kthimin e ndryshimit të shpërblimit.

2. Me par. 2 të këtij neni janë rregulluar rastet kur shuma e shpërblimit për transport nuk është e caktuar me tarifë ose me ndonjë akt tjetër detyrues të shpallur e as me kontratë. Sipas kësaj dispozite ligjore, në rastet e këtilla, transportuesi ka të drejtën e *shpërblimit të zakonshëm* për këtë lloj transporti. Shpërblimi i zakonshëm do të duhej caktuar nga rasti në rast, duke pasur kujdes për llojin dhe sasinë e mallit, gjatësinë e rrugës, mënyrën e transportit etj⁴²⁴. “Në rast se shpërblimi për transportin rrugor nuk është caktuar as me kontratë, as me tarifë, ai do të caktohet sipas çmimores së organizatës që merret rregullisht me këtë veprimtari në territorin në të cilin është kryer transporti”⁴²⁵.

3. Dispozita e par. 3 të nenit 665 të këtij Ligji është dispozitë referuese, sipas së cilës, për situata të tjera të paraqitura, të cilat nuk janë parashikuar me këtë nen, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat për shpërblimin në pjesën e këtij Ligji që ka të bëjë me kontratën për veprën. Duke u nisur nga fakti se kontrata për transportin e udhëtarëve është një lloj i kontratës për veprën, pasi që përmban disa elemente të kësaj kontrate, par. 3 i këtij neni, në mungesë të kritereve për caktimin e shpërblimit të transportit nga par. 1 dhe 2 të këtij neni, udhëzon në zbatimin përkatës të dispozitave për shpërblim të parashikuara për kontratën për veprën.⁴²⁶ Në rast të kontestit lidhur me shpërblimin e transportit, kur ai nuk është i caktuar, për këtë do të vendosë gjykata, të cilin duhet caktuar sipas vlerës së punës, sipas kohës normale të nevojshme për atë lloj pune dhe sipas shpërblimit të zakonshëm për atë lloj të punës. Në këtë rast gjykata mund të bëjë edhe ekspertizën.⁴²⁷ “Në rastet kur me kontratën për veprën nuk është caktuar shpërblimi, ai do të caktohet nga gjykata, duke pasur parasysh vlerën e punës, kohën e nevojshme për kryerjen e asaj pune dhe shpërblimin e zakonshëm për atë lloj të punës – të gjitha këto sipas rrethanave të cilat kanë ekzistuar në kohën e kryerjes së punimeve”⁴²⁸.

424 Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 1014.

425 Gjuk. Sup. e B e H Ac. 666/89 dt. 09.07.1990.

426 Shih nenin 638 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

427 Ivica Crnić, Zakon o Obveznim Odnosima, botimi i pestë, Zagreb 2012, f. 840.

428 Gjuk. Sup. e R. Kr. Rev-2509/95 dt. 8.4.1995, nga Ivica Crnić, si më para.

Nga praktika gjyqësore:

1. “Me marrjen e dërgesës dhe fletëngarkesës në të cilën është caktuar se pranuesi i sendit paguan transportin, porositësi i transportit lirohet nga ky detyrim sipas kontratës për transportin në komunikacionin rrugor”.⁴²⁹

2. “Në qoftë se çmimi i shërbimit shprehimisht nuk është kontraktuar, shfrytëzuesi i shërbimeve të transportit ka detyrimin të paguaj çmimin të cilin transportuesi, në përputhje me aktin e përgjithshëm normativ të vetin, e ka paguar në kohën kur është krye transporti”.⁴³⁰

Neni 666. Kufizimi i zbatimit të dispozitave të kësaj pjese

Dispozitat e kësaj pjese zbatohen në të gjitha llojet e transportit, në qoftë se me ligj për lloje të veçanta nuk është caktuar ndryshe.

Kreu i parë i pjesës së XI të LMD përmban dispozitat e përgjithshme të kontratës për transportin. Në nenin 666 ndodhet një nga dispozitat e përgjithshme me të cilën parashikohet zbatimi i dispozitave të kësaj pjese të ligjit. Sipas kësaj dispozite ligjore, dispozitat e pjesës XI të LMD, me të cilat është rregulluar transporti, zbatohen në të gjitha llojet e transportit, nëse me dispozita të veçanta për llojet e veçanta të transportit nuk është parashikuar ndryshe. Siç shihet, dispozitat e pjesës XI të LMD kanë karakter të dispozitave të përgjithshme (*lex generalis*) dhe ato do të zbatohen vetëm nëse me ligj të veçantë (*lex specialis*) nuk është parashikuar ndryshe, gjë që nënkupton maksimën tradicionale *lex specialis derogat lex generalis*.⁴³¹

KREU 2

KONTRATA PËR TRANSPORTIN E SENDEVE

NËNKREU 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 667. Dorëzimi i sendeve

Transportuesi ka për detyrë që sendin të cilin e ka pranuar për transport t’ia dorëzojë në vendin e caktuar dërguesit ose personit të caktuar (marrësit).

429 Gjyk. Sup. e B dhe H Ac. 753/89 dt. 26.07.1990, nga bil. i prak. Gjyq. të B H, 4/1990.

430 Gjyk. Sup. e M Z, Ac. 343/91 dt. 08.10.1991.

431 Se cilat janë ligjet veçanta me të cilat rregullohet transporti, shih komentin e dhënë për nenin 662 në pikën I të këtij Ligji.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Objekt i kontratës për transportin mund të jetë *personi* apo *sendi*, prandaj edhe dallojnë kontrata për transportin e udhëtarëve dhe kontrata për transportin e sendeve.⁴³² Nga kjo del se të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese të parashikuara nga kontratat për transportin, dallojnë varësisht nga objekti i kësaj kontrate.

2. Në nenin 667 të LMD parashikohen detyrimet e njëjës palë kontraktuese - transportuesit nga kontrata për transportin e sendeve. Me këtë dispozitë ligjore parashikohen detyrimet e transportuesit të sendit. Detyrimi themelor i transportuesit është që sendin e pranuar për transport ta transportojë nga vendi i pranimi deri në vendin e dorëzimit. Pasi të jetë transportuar sendi deri në vendin e pranimi, ai duhet t'i dorëzohet në vendin e caktuar dërguesit ose personit tjetër të caktuar, i cili duhet ta pranojë atë send. Në Ligj parashikohet detyrimi i transportuesit që sendin e pranuar për transport t'ia dorëzojë dorëzuesit apo pranuesit të atij sendi në vendin e caktuar. Nga ky detyrim vetvetiu rrjedh edhe detyrimi i transportuesit që atë send ta transportoj nga vendi ku e ka pranuar deri në vendin ku duhet dorëzuar, pasi që sendi nuk mund të dorëzohet në vendin e pranimi, nëse paraprakisht nuk është transportuar deri aty nga vendi i dorëzimit. Zakonisht, në kontratë parashikohet edhe afati i transportit, pra transporti duhet të bëhet brenda afatit të parashikuar në kontratë. Nëse afati nuk është caktuar, llogaritet koha e zakonshme normale e nevojshme për transportin e atij sendi, varësisht nga gjatësia e rrugës dhe lloji i transportit.

3. Transportuesi ka detyrimin që sendin ta dorëzojë në vendin e caktuar, ashtu siç e ka pranuar për transport. Për ta dorëzuar në atë gjendje siç e ka pranuar, ai duhet ta ruajë atë dhe të sillet me kujdes të shtuar sipas rregullave të profesionit dhe zakoneve, me një kujdes të shtëpiakut të mirë.⁴³³ Përndryshe, transportuesi përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e sendit të dorëzuar, nëse kjo ndodh nga momenti i i pranimi të sendit deri në momentin e dorëzimit të tij, përpos në qoftë se dëmtimi ose humbja e sendit është shkaktuar nga shkaku i cili e liron transportuesin nga përgjegjësia.

4. Pas transportimit të sendit nga vendi i dorëzimit deri në vendin e pranimi, ai duhet t'i dorëzohet personit të caktuar sipas kontratës. Ky person mund të jetë ose vetë personi që e ka dorëzuar atë send për transport, ose pranuesi tjetër: a) dorëzuesi ose b) pranuesi. Pranuesi i sendit është personi i cili, në bazë të kontratës apo fletëngarkimit, ka për detyrë ta pranojë sendin e transportuar. Ai mund të jetë edhe vetë dorëzuesi i atij sendi.

Neni 668. Detyrat e dërguesit për ta njoftuar transportuesin

1. Dërguesi ka për detyrë ta njoftojë transportuesin për llojin e dërgesës dhe për përmbajtjen dhe sasinë e saj dhe t'i komunikojë se ku duhet të transportohet dërgesa, emrin dhe adresën e marrësit të dërgesës, emrin dhe adresën e vet, si dhe çdo gjë të nevojshme që transportuesi të mund t'i përmbushë detyrimet e veta pa shtyrje dhe pengesa.

432 Shih nenin 662 të LMD dhe komentimin e dhënë lidhur me këtë nen.

433 Shih nenin 5 par. 2 i LMD dhe komentimin e dhënë lidhur me këtë nen.

- 2. Kur në dërgesë ndodhen sende te çmueshme, letra me vlerë ose sende tjera të shtrenjta, dërguesi ka për detyrë që për këtë ta njoftojë transportuesin në momentin e dorëzimit të tyre për transport dhe t'ia komunikojë vlerën e tyre.**
 - 3. Kur është fjala për transportin e sendeve të rrezikshme ose të sendeve për të cilat nevojiten kushte të veçanta të transportit, dërguesi ka për detyrë që për këtë ta njoftojë transportuesin me kohë, kështu që ai do të mund të ndërmerr masa përkatëse të veçanta.**
 - 4. Në qoftë se dërguesi nuk i jep transportuesit të dhënat nga paragrafi 1. dhe 3. të këtij neni, ose i jep gabimisht përgjigjet për dëmin që do të shkaktohej për shkak të kësaj.**
-

1. Transportuesi duhet t'i përmbushë detyrimet e veta në bazë të kontratës për transportin e sendit.⁴³⁴ Këtë duhet ta bëjë brenda afatit dhe kushteve të parashikuara me kontratë. Transportuesi nuk do të mund t'i përmbushë detyrimet e veta në rast se dërguesi i sendit nuk i përmbush paraprakisht detyrimet e veta të parashikuara në nenin 668 të këtij Ligji. Detyrimet e dërguesit të sendit, sipas këtij neni, i përkasin paraqitjes së të dhënave me rëndësi për sendin, për vendin ku duhet dorëzuar sendi, për personin të cilit duhet t'i dorëzohet ai dhe për veten e vet. Disa nga këto të dhëna janë elemente qenësore të kontratës, ashtu që, nëse nuk janë dhënë, nuk ka as kontratë për transportin. Pra, transportuesi duhet të dijë për palën tjetër kontraktuese, kush është dërguesi i sendit, patjetër duhet të jetë i njoftuar se ku duhet ta dorëzojë dhe gjithsesi kujt duhet t'i dorëzohet ai. Për të vepruar sipas kontratës, duhet t'i jepen të dhëna transportuesit edhe për llojin e dërgesës dhe përmbajtjen dhe sasinë e saj, të cilat janë me rëndësi për të ditur nëse dërgesa gjatë transportit mund të thyhet apo prishet shpejt si dhe për shumën e shpërblimit të transportit; megjithatë, edhe pa këto të dhëna për dërgesën, kontrata është e vlefshme.

2. Dërguesi i sendit, për interes të vetin dhe të transportuesit, ka veçanërisht detyrimin që, në momentin e dorëzimit të sendit, ta njoftojë transportuesin se në dërgesë ka sende të vlefshme, letra me vlerë ose sende të tjera të shtrenjta, duke ia komunikuar edhe vlerën e tyre. Transportuesi, në kushtet e parashikuara në këtë Ligj, përgjigjet për humbjen dhe dëmtimin e dërgesës.⁴³⁵ Për këtë arsye transporti i sendeve të vlefshme paraqet rrezik të veçantë për transportuesin, prandaj në rastet kur ai është i njoftuar për vlerën e sendit, angazhohet posaçërisht për ruajtjen dhe mosdëmtimin e tij dhe për këtë arsye kërkon një shpërblim më të madh. Në qoftë se dërguesi i sendit nuk e përmbush detyrimin e parashikuar nga par. 2 i këtij neni, në rast të humbjes apo dëmtimit të dërgesës, transportuesi nuk do ta ketë detyrimin t'ia shpërblejë dëmin sipas vlerës së dërgesës, përpos nëse dëmi është shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia e rëndë.⁴³⁶

.....
434 Shih nenin 667 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

435 Shih nenin 685 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

436 Shih nenin 686 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

3. Sipas par. 3 të këtij neni, në interes të personave të tretë dhe për sigurinë në transport, dërguesi i sendit duhet ta njoftojë transportuesin për dërgesën me sende të rrezikshme, siç mund të jenë: materiet e ndryshme eksplozive, kimikatet e ndryshme, gazrat dhe sendet e tjera, për të cilat kërkohen kushte të veçanta transporti, ashtu që transportuesi duhet të ndër marrë masa të veçanta.

4. Sipas par. 4 të këtij neni, dërguesi përgjigjet për dëmin që i është shkaktuar transportuesit apo personave të tretë, si pasojë e mosinformimit të transportuesit për të dhënat e parashikuara nga par. 1 dhe 3 i këtij neni. Përgjegjësia për shkeljen e detyrimit për informim e parashikuar nga ky nen është shumë më e rreptë sesa përgjegjësia e përgjithshme për mosnjoftim.⁴³⁷ Në këtë rast dërguesi i sendit nuk përgjigjet vetëm për dëmin të cilin e ka pësuar transportuesi për shkak të mosnjoftimit, por përgjigjet edhe për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë.

Neni 669. Fletëngarkesa

1. Kontraktuesit mund të merren vesh që për dërgesën e dorëzuar për transport të përpilohet fletëngarkesa.
2. Fletëngarkesa duhet të përmbajë emrin dhe adresën e dërguesit e të transportuesit, llojin, përmbajtjen dhe sasinë e dërgesës, si dhe vlerën e sendeve të çmueshme dhe sendeve të tjera të shtrenjta, vendin e destinimit, shumën e shpërblimit për transport, respektivisht shënimin se shpërblimi është parapaguar, dispozitën për shumën me të cilën është ngarkuar dërgesa, vendi dhe dita e lëshimit të fletëngarkesës.
3. Në fletëngarkesë mund të futen edhe dispozita të tjera të kontratës për transportin.
4. Fletëngarkesa duhet të jetë e nënshkruar nga të dy kontraktuesit.
5. Fletëngarkesa mund të përmbajë dispozitën “sipas urdhrit” ose të jetë e shënuar në prurësin.

1. *Vështrim i përgjithshëm.*- Duke pasur parasysh faktin se dispozitat e pjesës XI të LMD i përkasin edhe transportit ndërkombëtar, vlen të theksohet se çështja e përpilimit të fletëngarkesës nuk është rregulluar njësoj me LMD-ët që zbatohen në shtetet e rajonit.⁴³⁸ Sipas disa prej këtyre ligjeve, siç rregullohet edhe me këtë Ligj, kontraktuesit mund të merren vesh që për dërgesën e dorëzuar për transport të përpilojnë fletëngarkesën, ndërsa me disa ligje të tjera kontraktuesit janë të detyruar ta përpilojnë atë. Duke u nisur nga fakti

437 Shih nenin 251 të këtij Ligji.

438 Sipas LMD nr. 04/L-077 i R. të Kosovës (neni 669 par. 1), LMD (1978) i cili me disa ndryshime zbatohet në R e Serbisë (neni 655 par. 1), LMD të Malit të Zi (neni 747 par. 1), për vlefshmërinë e kontratës për transportin e sendeve, nuk është i domosdoshëm përpilimi i fletëngarkesës. Sipas LMD të R së Kroacisë (neni 668 par. 1), kontraktuesit janë të detyruar të përpilojnë fletëngarkesën për dërgesën e dorëzuar për transport.

se, sipas kuptimit të dhënë të kontratës për transportin⁴³⁹, ajo është një kontratë joformale, me dhënien e fletëngarkesës ajo nuk bëhet kontratë formale, pasi që fletëngarkesa është dokument transportues, me të cilin transportuesi vërteton se e ka pranuar për transport dërgesën e caktuar. Përndryshe, fletëngarkesa nuk përfaqëson kontratë për transportin, por provën se është lidhur një kontrata e tillë. Ajo përpilohet në tri kopje - për palët kontraktuese dhe palën që duhet ta pranojë dërgesën.

2. Në bazë të par. 1 të nenit 669 të LMD, transportuesi nuk është i detyruar ta lëshojë fletëngarkesën dhe as dërguesi nuk është i detyruar ta kërkojë ose ta plotësojë atë. Transportuesi dhe dërguesi i sendit mund të merren vesh që për dërgesën e dorëzuar për transport të përpilohet fletëngarkesa. Ata nuk janë të detyruar ta bëjnë këtë; sipas ligjit ajo varet nga dëshira e tyre. Lëshimi e fletëngarkesës nuk nënkupton marrëveshjen e palëve kontraktuese se forma e veçantë e kësaj kontrate me përpilim të fletëngarkesës, është kusht për vlefshmërinë e kontratës për transportin e sendeve.⁴⁴⁰

3. Në par. 2 të nenit 669 të këtij Ligji parashikohet se cilat të dhëna duhet t'i përmbajë fletëngarkesa. Ndërkaq, për të qenë e vlefshme kontrata për transportin, nuk është e thënë të përpilohet fletëngarkesa, kurse paraqitja e të dhënave në të, sipas kësaj dispozite ligjore, nuk është e domosdoshme. Në fletëngarkesë mund të jepen edhe më shumë të dhëna nga ato që kërkohen sipas kësaj dispozite, por mundet edhe më pak. E gjithë kjo varet nga vullneti i palëve kontraktuese. Nisur nga fakti se fletëngarkesa mund të shërbejë si provë se kontrata për transportin është lidhur, ajo duhet patjetër t'i përmbajë elementet qenësore të kontratës, përndryshe nuk do të kishte kurrfarë qëllimi.

4. Përpos të dhënave nga par. 2 i nenit 669 të LMD, sipas par. 3 të këtij neni, në fletëngarkesë mund të jepen edhe të dhëna të tjera. Ligji nuk përcakton cilat janë këto të dhëna, pasi që u lihet palëve kontraktuesve t'i paraqesin ato sipas dëshirës së tyre, d.m.th. ato që i shohin të arsyeshme, varësisht nga marrëveshja ndërmjet tyre si dhe mënyra e përcaktimit me ligje të veçanta.

5. Edhe pse fletëngarkesa nuk është kontratë, ajo është një provë se është lidhur kontrata për transportin, prandaj duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese, të cilave duhet t'u dorëzohet nga një kopje.

6. Në bazë të par. 5 të nenit 669 të LMD, fletëngarkesa mund të përmbajë dispozitën "sipas urdhrit" ose të jetë me emër të prurësit, që do të thotë se fletëngarkesa mund të jetë letër me vlerë. Kjo nuk do të thotë se çdo fletëngarkesë është dokument bartës, ngase mund të jetë e tillë vetëm nëse palët janë marrë vesh asisoj. Fletëngarkesa që përmban klauzolën "sipas urdhrit", shndërrohet në letër me vlerë dhe merr vetitë e dokumentit bartës.

.....
439 Shih nenin 662 të këtij Ligji dhe komentini e dhënë lidhur me këtë nen.

440 Shih nenin 54 par. 1 të LMD dhe komentini e dhënë lidhur me këtë nen, nga pjesa e përgjithshme e LMD.

Neni 670. Kontrata për transportin dhe fletëngarkesa

Ekzistimi dhe vlefshmëria juridike e kontratës për transportin janë të pavarura nga ekzistimi i fletëngarkesës dhe nga saktësia e saj.

Fletëngarkesa është dokument transportues me të cilën transportuesi vërteton se e ka pranuar për transport dërgesën e caktuar. Ajo është një dokument që mund të shërbejë si provë për lidhjen e kontratës për transportin e sendeve dhe dorëzimin e dërgesës në transport. Siç shihet, nuk është e thënë që fletëngarkesa të përpilohet për çdo transport të sendeve. Ajo përpilohet vetëm nëse kontraktuesit janë marrë vesh me rastin e lidhjes së kontratës që për dërgesën e dorëzuar për transport të përpilojnë fletëngarkesën. Duke pasur parasysh faktin se përpilimi i fletëngarkesës varet nga vullneti i palëve kontraktuese, nëse për diçka të këtillë do të merren vesh me kontratën e lidhur mes tyre, me dispozitën e nenit 670 të këtij Ligjit parashikohet se mosekzistimi, përkatësisht pasaktësia dhe parregullsia e fletëngarkesës nuk është me ndikim në ekzistimin dhe vlefshmërinë e kontratës për transportin e sendeve, gjë që do të thotë se kontrata e lidhur për transportin e sendeve është e vlefshme edhe kur nuk është përpiluar dhe nuk është lëshuar fletëngarkesa ose kur ajo është lëshuar gabimisht.

Nga praktika gjyqësore:

1. *“Në rastin kur në fletëngarkesë është shënuar gabimisht si dërgues personi nga i cili transportuesi faktikisht e ka pranuar mallin në bazë të urdhrit të porositesit të transportit, i cili edhe e ka lidhur kontratën për transportin e atij malli dhe sipas urdhrit të të cilit transportuesi e ka marrë mallin me qëllim të transportit, a e ka detyrimin të paguajë shpërblimin për transport personi i cili në fletëngarkesë është regjistruar si dërgues? Përgjigja është jo, pasi që palë kontraktuese, dërgues i mallit, është personi që e ka lidhur kontratën për transportin e mallit dhe jo personi i cili në fletëngarkesë është regjistruar gabimisht si dërgues i mallit”.*⁴⁴¹

2. *Në rast se te kontrata për transportin e mallit në transportin rrugor, nuk është dhënë fletëngarkesa ose kur nuk është nënshkruar, si dërgues i mallit konsiderohet personi që faktikisht ia ka dorëzuar mallin transportuesit për transport.*⁴⁴²

441 Takimi i XX koordinues i gjykatave të larta ekonomike, degëve ekonomike të gjykatave supreme të republikave dhe krahinave dhe gjykatave të punës së bashkuar të B dhe H dhe Vojvodinës, i mbajtur më 10.06.1987.

442 Gjyk. Sup. e Voj. Ac. 321/81 dt. 09.12.1981.

Neni 671. Vërtetimi për marrjen në dorëzim për transport

Në qoftë se nuk është dhënë fletëngarkesa, dërguesi mund të kërkojë nga transportuesi që t'i lëshojë vërtetimin për marrjen e dërgesës për transport me të dhënat që duhet t'i përmbajë fletëngarkesa.

Me këtë dispozitë ligjore parashihet mundësia e dërguesit të kërkojë nga transportuesi që t'i lëshojë një vërtetim për pranimin e dërgesës për transport, me të dhënat të cilat duhet t'i përmbajë fletëngarkesa. Në këtë mënyrë vërtetimi do të lëshohet vetëm në rastet kur nuk është përpiluar fletëngarkesa. Ajo dallon nga fletëngarkesa nga se kjo e fundit është dokument i përbashkët i dërguesit dhe e transportuesit të sendit, ashtu që edhe e nënshkruajnë të dy palët. Të përbashkët kanë nga se të dyja mund të përdoren si provë se është lidhur kontrata dhe transportuesi e ka marrë dërgesën. Në fletëngarkesë këtë e vërtetojnë të dy palët, ndërsa në vërtetim këtë e vërteton vetëm transportuesi.

NËNKREU 2

MARRËDHËNIA E DËRGUESIT DHE TRANSPORTUESIT

Neni 672. Paketimi

- 1. Dërguesi ka për detyrë t'i paketojë sendet sipas mënyrës së parashikuar ose të praktikuar, kështu që të mos shkaktohet ndonjë dëm ose të rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave.**
- 2. Transportuesi ka për detyrë të paralajmërojë dërguesin për të metat e paketimit që mund të vihen re, përndryshe përgjigjet për dëmtimin e dërgesës që do të shkaktohej për shkak të këtyre të metave.**
- 3. Transportuesi nuk përgjigjet për dëmtimin e dërgesës në qoftë se dërguesi, megjithëse iu ka tërhequr vërejtja për të metat e paketimit, ka kërkuar që transportuesi ta pranojë dërgesën për transport me këto të meta.**
- 4. Transportuesi ka për detyrë që të refuzojë dërgesën në qoftë se të metat në paketimin e saj janë të tilla sa që mund të rrezikohet siguria e personave ose e të mirave, ose të shkaktohet ndonjë dëm.**
- 5. Për dëmin që për shkak të metës në paketim e pësojnë personat e tretë deri sa sendi ndodhet te transportuesi, përgjigjet transportuesi, ndërsa ky ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga dërguesi.⁴⁴³**

443 *Duke pasur parasysh faktin se në Kosovë, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, më 20 dhjetor 2013, është zbatuar Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve të ish-Federatës Jugosllave, i vitit 1978, i cili është zbatuar edhe në njësitë tjera federale, e në mbështetje të cilit më vonë janë nxjerrë ligjet e marrëdhënieve të detyrimeve në shtetet e tjera të dala nga ish Federata Jugosllave, shembujt nga praktika gjyqësore janë marrë edhe nga gjykatat e shteteve tjera ku është zbatuar ligji i vitit 1978 ose të ligjeve të nxjerra nga shtetet e dala nga ish Federata Jugosllave, aty ku dispozita është e njëjtë.*

Vështrim i përgjithshëm.-- Me këtë dispozitë ligjore janë rregulluar marrëdhëniet ndërmjet dërguesit dhe transportuesit të sendeve përkitazi me paketimin e sendit, detyrimet e tyre përkitazi me këtë si dhe pasojat që mund të lindin lidhur me paketimin. Paketimi i sendeve është me rëndësi për mbrojtjen e tyre, njëherësh lehtëson transportin, pranimin e, nëse ka nevojë, edhe depozitimin e tyre.

1. Përpos detyrimeve të tjera ligjore përkitazi me veprimet që duhet të ndërmarrë transportuesi me rastin e dorëzimit të sendit për transport,⁴⁴⁴ ai duhet edhe ta paketojë sendin, përpos rasteve kur ai transportohet i papaketuar, sipas llojit që i përket, në sasi më të mëdha. Në par. 1 të këtij neni është parashikuar rregulla e përgjithshme për detyrimin e dërguesit lidhur me paketimin e sendit. Sipas kësaj dispozite ligjore, dërguesi ka detyrimin t'i paketojë sendet të cilat i dorëzon për transport. Sa i përket mënyrës së paketimit, ajo mund të bëhet në dy mënyra: a) sipas mënyrës së parashikuar me ligj ose me rregulla të tjera⁴⁴⁵, b) sipas mënyrës së praktikuar të paketimit për llojin e caktuar të sendeve. Nëse bëhet fjalë për sende të rrezikshme, me ligj të veçantë parashikohen rregulla të veçanta për paketimin e tyre. Përndryshe, për sende të tjera, ato duhen paketuara sipas mënyrës së praktikuar, varësisht nga lloji i sendit. Për shkak të mospaketimit në mënyrë të drejtë të sendeve për transport, mund ta shkaktohet dëm për transportuesin apo edhe për persona të tretë ose të rrezikohet siguria e njerëzve ose e të mirave materiale të tyre. Qëllimi i këtij detyrimi të parashikuar me këtë dispozitë ligjore për dorëzuesin e sendeve është që të mos shkaktohet dëm apo të rrezikohet siguria e njerëzve.

2. Secila palë ka për detyrë që, gjatë përmbushjes së detyrimit të vet, të veprojë me kujdes të duhur. i cili kërkohet në qarkullimin tregtar, përndryshe do të përgjigjet për dëmin e shkakuar. Në këtë aspekt, me rastin e vlerësimit të përgjegjësisë për dëmin, merret parasysh edhe kujdesi i veçantë në bazë të rregullave të profesionit, të cilin duhet ta tregojë pala përgjegjëse për atë dëm. Transportuesi ka detyrimin të veprojë me kujdes të shtuar në bazë të rregullave të profesionit dhe zakoneve.⁴⁴⁶ Nisur nga detyrimi i pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve të parashikuar në nenin 5 të LMD, me rastin e pranimit të mallit për transport, transportuesi duhet me kujdes të lartë, sipas rregullave të profesionit, ta kontrollojë paketimin e mallit dhe ta paralajmërojë dërguesin për të metat e paketimit që mund të vërehen, përndryshe, në bazë të par. 2 të nenit 672 të këtij Ligji, ai është përgjegjës për dëmtimin e dërgesës që do të shkaktohet për pasojë të këtyre të metave në paketim.

“Përgjegjësia e transportuesit për humbjen apo dëmtimin e sendeve të dorëzuara për transport supozohet, andaj edhe poseduesi i së drejtës nuk ka detyrimin gjatë kontestit

444 Shih nenin 668 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

445 Me ligj të veçantë është rregulluar transporti i mallrave të rrezikshme (Ligji nr. 2004/06 për Transportin e Mallrave të Rrezikshëm, i cili ka për objekt transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë tokësore dhe hekurudhore (neni 4), ndërsa sipas nenit 20 të tij parashikohet që Ministria e Transportit, nëpërmjet të akteve të veçanta juridike, të nxjerrë rregulla edhe përkitazi me paketimin e veçantë apo të përbashkët të këtyre mallrave.

446 Shih nenin 5 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD

gjyqësor të argumentojë fajësinë dhe lëshimet e transportuesit. Transportuesi mund të lirohet nga përgjegjësia vetëm nëse argumenton se deri te humbja apo dëmtimi i sendeve ka ardhur nga veprimet e personit të autorizuar, vetive të dërgesës apo shkaqeve tjera të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, të evitohen dhe të mënjanohen”⁴⁴⁷.

3. Me të vërejtur të metat në paketim, transportuesi ka detyrimin ta paralajmërojë dërguesin për ato. Ai nuk mund të vendosë për fatin e mëtejshëm të mallit të dhënë për transport. Pasi dërguesi të është lajmëruar, ai është i autorizuar të vendosë nëse dërgesën, pas njoftimit për të metat në paketim, do ta transportojë apo jo. Në rast se dërguesi i mallit, pasi të jetë njoftuar nga transportuesi për të metat në paketim, kërkon nga ai ta pranojë dërgesën për transport me këto të meta, sipas par. 3 të këtij neni, transportuesi nuk përgjigjet për dëmtimin e dërgesës të shkaktuar për këtë arsye.

4. Dërguesi ka të drejtë të vendosë nëse do ta japë për transport mallin me këto të meta me paketim vetëm në rastet kur ky paketim e rrezikon vetëm dërgesën e tij dhe atëherë transportuesi nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga këto të meta. Në qoftë se të metat e paketimit janë të tilla që mund ta rrezikojnë sigurinë e personave ose të të mirave ose të shkaktojnë edhe ndonjë dëm tjetër, sipas par. 4 të këtij neni, transportuesi e ka për detyrë ta refuzojë dërgesën. Nga këto dy nene rrjedh se, në rast se për shkak të metave në paketim, mund të ndodhë shkaktimi i dëmit vetëm në këtë mall të paketuar, se a do të transportohet ose jo ajo dërgesë do të vendosë dërguesi i sendit. Në rastin tjetër, në qoftë se për shkak të këtyre të metave në paketim mund t’i shkaktohet dëm transportuesit apo personave të tretë, për pranimin e dërgesës vendos transportuesi, i cili edhe ka të drejtë ta refuzojë dërgesën.

5. Në par. 5 të nenit 672 rregullohet mbrojtja e personave të tretë në rastet e shkakimit të dëmit nga të metat në paketimin e dërgesës. Sipas kësaj dispozite ligjore, për dëmin që pësojnë personat e tretë derisa sendi ndodhet te transportuesi, nga shkaku i të metave në paketim, përgjigjet transportuesi, i cili ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga dërguesi.

Neni 673. Shpërblimi për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin

- 1. Dërguesi ka për detyrë t’i paguaj transportuesit shpërblimin për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin.**
- 2. Në qoftë se në fletëngarkesë nuk është theksuar se dërguesi paguan shpërblimin për transport dhe shpenzimet e tjera lidhur me transportin, supozohet se dërguesi ka udhëzuar transportuesin që shpërblimin ta arkëtojë nga marrësi.**

Vështrim i përgjithshëm.- Pagesa e shpërblimit për transport është detyrim bazë i dërguesit të mallit për transport.⁴⁴⁸ Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar shpërblimi për transport

447 Gjyk. Sup. e Voj. Ac. 296/90 dt. 18.04.1990.

448 Shih nenin 662 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

dhe shpenzimet në lidhje me transportin. Në bazë të kontratës së lidhur për transportin e rregullt (linjor) zakonisht shpërblimi paguhet paraprakisht, ndërsa kur është fjala për transportin e lirë, shpërblimi zakonisht paguhet pas përfundimit të transportit. Transportuesi ka të drejtën e shpërblimit vetëm nëse e ka kryer transportin sipas kontratës, përndryshe nuk do të ketë të drejtën e shpërblimit. Nëse eventualisht transportuesi nuk e ka kryer në tërësi apo e ka kryer vetëm pjesërisht detyrimin e tij nga kontrata, për fajin e dërguesit (nuk e ka dorëzuar për transport dërgesën sipas kontratës), transportuesi do të ketë të drejtën e shpërblimit të plotë të kontraktuar. Përndryshe, transportuesi i cili e ka lidhur kontratën për transport, nëse me kontratë nuk është parashikuar ndryshe, nuk do të thotë që ai vetë ta përmbushë detyrimin e kontraktuar. Transportuesi kontraktues mund t'ia besojë transportin një transportuesi tjetër.

1. Në bazë të dispozitës së par. 1 të këtij neni, dërguesi ka detyrimin t'i paguajë transportuesit shpërblimin për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin. Siç shihet, ligjvënësi e dallon shpërblimin për transport nga shpenzimet e tjera që shkaktohen lidhur me transportin. Shuma e shpërblimit për transport do të caktohet sipas rregullave të parashikuara në nenin 665 të këtij Ligji.⁴⁴⁹ Përpos shpërblimit për transport, me rastin e transportimit të sendeve, paraqiten edhe shpenzime lidhur me transportin, të cilat dërguesi, po ashtu, ka detyrimin t'ia paguajë transportuesit. Shpenzimet e këtilla mund të shkaktohen lidhur me paketimin në rastet kur në njoftimin dhe vërejtjen për paketimin me të meta, dërguesi insiston për transportimin e mallit e në këtë rast transportuesi ndërmerr veprime të caktuara për paketimin e rregullt të atij malli.⁴⁵⁰ Në këtë rast paraqiten shpenzime të domosdoshme lidhur me transportin e mallit, të cilat janë në dobi të dërguesit të mallit dhe në interes të tij. Si shpenzime të transportit mund të paraqiten edhe shpenzimet e ngarkim – shkarkimit, të doganimit, kontrollimit sanitar apo të ngjashëm të mallit. Përpos shpërblimit për transport, dërguesi i mallit ka detyrimin t'ia paguajë edhe shpenzimet si më sipër, të shkaktuara në lidhje me transportin.

2. Kontrata për transport e sendeve lidhet ndërmjet të dërguesit të sendeve dhe transportuesit të tyre, të cilët hyjnë në marrëdhënie juridike mes tyre, nga edhe lindin të drejta dhe detyrime për ata. Me lidhjen e kontratës për transport dërguesi merr përsipër detyrimin të paguajë shpërblimin dhe shpenzimet e transportit. Mirëpo, në rastet kur në fletëdërgesë nuk është theksuar shprehimisht se dërguesi paguan shpërblimin për transport dhe shpenzimet e tjera lidhur me transportin, që nënkupton se ai shprehimisht nuk e ka marrë përsipër këtë detyrim, *supozohet* se dërguesi e ka udhëzuar transportuesin që shpërblimin ta arkëtojë nga pranuesi i mallit. Në këtë mënyrë, derisa transportuesi e ka pranuar transportin, ai e ka dhënë edhe pëlqimin lidhur me këtë. Në anën tjetër, me marrjen e dërgesës nga fletëngarkesa, në rastet kur ajo është lëshuar, pranuesi i mallit merr përsipër detyrimin që transportuesit t'ia paguajë shpërblimin dhe shpenzimet tjera lidhur me transportin, nëse diçka tjetër nuk është përcaktuar në kontratë apo në fletëngarkesë. Mund të ndodhë që pranuesi i mallit të refuzojë pranimin dhe të kundërshtojë pagesën. Në rastet e këtilla, transportuesi mund ta shfrytëzojë të drejtën

449 Shih komentin e dhënë lidhur me nenin 665 të këtij Ligji.

450 Shih nenin 672 par. 2 dhe 3 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

e pengut,⁴⁵¹ duke shitur dërgesën dhe duke arkëtuar shpërblimin nga ato mjete ose të kërkojë shpërblimin nga dorëzuesi i sendeve, me të cilin ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese dhe i cili me kontratë e ka marrë përsipër këtë detyrim. Në bazë të qëndrimit të nxjerrë nga praktika gjyqësore, në qoftë se në bazë të nenit 673 par. 2 të LMD (vër. e aut.) pranuesi i dërgesës ka detyrimin t'i paguajë transportuesit shpërblimin për transport dhe shpenzimet e tjera lidhur me transportin, kur ai refuzon të kryejë pagesën; me këtë nuk pushon detyrimi i tij ndaj transportuesit për këtë pagesë, ashtu që transportuesi nuk do të mund t'i kërkojë shpërblimin dhe shpenzimet nga dërguesi i mallit, pasi që ai nuk e ka legjitimitetin pasiv.⁴⁵²

Neni 674. Disponimi me dërgesën

- 1. Dërguesi mund të disponojë me dërgesën edhe t'i ndryshojë urdhrat e përmbajtura në kontratë dhe mund t'i urdhërojë transportuesit ta ndalë transportin e mëtejshëm të dërgesës, t'ia kthejë dërgesën, t'ia dorëzojë marrësit tjetër ose ta udhëzojë në një vend tjetër. 145**
- 2. E drejta e dërguesit për t'i ndryshuar urdhrat shuhet pas arritjes së dërgesës në vendin e destinacionit, kur transportuesi i'a dorëzon marrësit fletëngarkesën ose kur transportuesi e fton marrësin që të marrë dërgesën, ose kur marrësi e kërkon vet dorëzimin e saj.**
- 3. Në qoftë se është lëshuar fletëngarkesa sipas urdhrat, respektivisht në prurësin, të dhënat e dërguesit nga paragrafi paraprak i takojnë ekskluzivisht zotëruesit të fletëngarkesës.**
- 4. Personi i autorizuar që shfrytëzon të drejtën e dhënies së urdhëresave të reja transportuesit ka për detyrë t'ia shpërblejë shpenzimet dhe dëmin që i ka pasur për shkak të kësaj dhe që me kërkesën e tij t'i japë dorëzani se shpenzimet dhe dëmi do t'i shpërblehen.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore rregullohet e drejta e disponimit të dërgesës. Kontrata është shprehje e lirë e vullnetit të palëve. Për të lidhur kontratën, duhet të ekzistojë pajtimi i vullneteve mes palëve. Kontrata apo pjesët e caktuara të saj mund të ndryshohen, nëse për këtë ekziston pajtimi i vullneteve të palëve. Me këtë dispozitë ligjore bëhet përjashtim nga rregulla e përgjithshme, pasi që parashikohet ndryshimi i dispozitave të caktuara të kontratës në bazë të shprehjes së njëanshme të vullnetit.

- 1. Sipas par. 1 të nenit 674 të këtij Ligji, duke shfrytëzuar të drejtën e disponimit të dërgesës, dërguesi ka të drejtë t'i ndryshojë urdhrat e parashikuar në kontratën për transport dhe mund t'i urdhërojë transportuesit ta ndalë dhe ta ndërpresë transportin e mëtejshëm të dërgesës, t'ia kthejë dërgesën, dërgesën t'ia dorëzojë pranuesit tjetër ose dërgesën ta udhëzojë në një vend tjetër. Transportuesi ka detyrimin ta transportojë sendin, duke pasur kujdes edhe për**

451 Shih nenin 693 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

452 Gorenc, Vilim, Komentari Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 1019.

ndryshimet eventuale të mëvonshme të urdhrave. Nga kjo, urdhrat e tillë të mëvonshëm të dërguesit, nëse janë dhënë me kohë, nuk mund t'i kundërshtojë transportuesi. Nëse eventualisht transportuesi nuk vepron sipas urdhrat të dhënë me kohë dhe të arsyeshëm, do të jetë përgjegjës ndaj shfrytëzuesit të transportit për dëmin eventuale të shkaktuar. Ky Ligj i përcakton me këtë dispozitë vetëm rregullat e përgjithshme, ndërsa ligjet e veçanta për llojet e veçanta të transportit përmbajnë dispozita me të cilat kjo rregullohet në mënyrë më të detajuar.

2. Duke pasur parasysh faktin se transporti i dërgesës zgjat për një kohë të caktuar, në par. 2 të këtij neni është rregulluar kur pushon e drejta e dërguesit të sendit për t'i ndryshuar urdhrat e përcaktuar në kontratën për transport e sendit. Sipas kësaj dispozite ligjore, e drejta e dërguesit për t'i ndryshuar urdhrat, siç parashikohet në par. 1 të këtij neni, shuhet pas arritjes së dërgesës në vendin e destinacionit të parashikuar në kontratë, në momentin: a) kur transportuesi ia dorëzon marrësit fletëngarkesën, b) kur transportuesi e fiton marrësin që ta marrë dërgesën dhe c) kur pranuesi i sendit kërkon vetë dorëzimin e dërgesës. Nga ky moment pushojnë autorizimet e dërguesit të dërgesës sipas par. 1 i këtij neni, ashtu që transportuesi nga ky moment ka detyrimin ndaj pranuesit të dërgesës. Në rast se transportuesi nuk vepron nga ky moment sipas urdhrat të pranuesit të dërgesës, ai është përgjegjës ndaj pranuesit të dërgesës për dëmin e shkaktuar nga ky veprim.

3. Në par. 3 të këtij neni është rregulluar disponimi i dërgesës në rastet kur fletëngarkesa është letër me vlerë, përkatësisht në qoftë se fletëngarkesa është lëshuar *sipas urdhrat* respektivisht *sipas prurësit*. Në rastet e kësaj lloji poseduesi ligjor i ri i fletëngarkesës e fiton të drejtën e posedimit të sendeve në transport dhe kësaj ai ka të drejtë të ndryshojë urdhrat që përmban kontrata për transport, përkatësisht t'i japë urdhra të rinj transportuesit, të drejtën e të cilëve, sipas par. 1 të këtij neni, e ka dërguesi i sendit.

4. Në tre paragrafët paraprakë parashikohen detyrimet e transportuesit përkitazi me të drejtat e dërguesit, dërguesit të ri apo pranuesit të dërgesës për të ndryshuar urdhrat nga kontrata për transport. Në paragrafin 4 të këtij neni parashikohet e drejta e transportuesit për shpërblimin e shpenzimeve dhe të dëmit si dhe për dorëzimin, ashtu që personi i autorizuar që e shfrytëzon të drejtën e dhënies së urdhrave të reja (dërguesi, dërguesi i ri apo marrësi i dërgesës) ka detyrimin që transportuesit t'ia shpërblejë shpenzimet dhe dëmin të cilin e ka pësuar për shkak të veprimit sipas urdhrave të dhënë. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi ka të drejtë të kërkojë nga personat e autorizuar, të cilët kanë dhënë urdhra ndryshe nga ato që i përmban kontrata për transport, të ofrojnë dorëzimin për kompensimin e shpenzimeve dhe të dëmit. Ai nuk ka detyrimin të veprojë sipas urdhrave derisa nuk jepet dorëzania. Shprehja *dorëzani* e përdorur në këtë rast do të nënkuptonte çfarëdo sigurimi të kërkesës së transportuesit përkitazi me shpenzimet dhe dëmin e pësuar, siç janë: lenia peng e sendeve që kanë qenë objekt transporti, kontrata për dorëzimin,⁴⁵³ deponimi i shumës së caktuar në gjykatë, garancia bankare etj.

453 Shih nenin 1009 dhe tjerët në vazhdim të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

Neni 675. Drejtimi i transportit

- 1. Transportuesi ka për detyrë ta kryejë ë transportin në mënyrën e kontraktuar.**
- 2. Në qoftë se nuk është kontraktuar se në cilën rrugë duhet të bëhet transporti, transportuesi ka për detyrë që ta bëjë në atë rrugë që i përgjigjet më tepër interesave të dërguesit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Dispozita ligjore e nenit 675 të LMD e rregullon drejtimin e rrugës në të cilën do të qarkullojë mjete transportues me të cilin transportohet malli, duke filluar nga pika fillestare deri në pikën përfundimtare të transportit. Palët kontraktuese mund ta rregullojnë me kontratë drejtimin e rrugës në të cilën do të transportohet malli vetëm në transportin e lirë.⁴⁵⁴ Me lidhjen e kontratës për transport të rregullt, në linjën e caktuar, konsiderohet se palët e kanë caktuar edhe drejtimin e rrugës në të cilën do të qarkullojë transportimi.

1. Sipas par. 1 të nenit 675 të këtij Ligji, transportuesi ka për detyrë ta kryejë transportin nëpër rrugën e kontraktuar. Rrugët nëpër të cilat lëvizin mjetet e transportit janë të ndryshme. Ato dallojnë ndërmjet tyre për nga cilësia, përshtatshmëria e terrenit për transportin e llojit të caktuar të sendeve dhe për nga veçori të tjera. Për këtë arsye, për dërguesin apo pranuesin e sendit të dhënë për transport mund të jetë me interes se në cilin drejtim të rrugës do të kryhet transporti. Transportuesi është i detyruar transportin ta kryejë në rrugën e kontraktuar. Atëherë kur drejtimi i rrugës është kontraktuar, transportuesi nuk ka autorizim ta kryejë transportin në një rrugë tjetër edhe atëherë kur konsideron se ajo është në të mirë të dërguesit të dërgesës për transport. Nëse është në interes të dërguesit apo jo, mund të vlerësohet vetëm nga vetë dërguesi, kështu që transportuesi nuk mund të arsyetohet se ndryshimi i rrugës transportuese ka qenë në interes të tij. Për këtë arsye, transportuesi do të jetë përgjegjës për dëmin eventual, të shkaktuar për pasojë të humbjes apo dëmtimit të dërgesës apo vonesës së arritjes, në rast se dëmi është shkaktuar për shkak të mospërfilljes së drejtimin të rrugës së kontraktuar. Në këtë rast do të konsiderohet se transportuesi ka vepruar nga pakujdesia e rëndë,⁴⁵⁵ përveç nëse vërtetohet se ka ndërruar drejtimin e rrugës për shkak të fuqisë madhore. Në rast se transportuesi ka pengesa eventuale gjatë transportit në rrugën e kontraktuar, për këtë duhet njoftuar dërguesi dhe nga ai duhen kërkuar udhëzime për veprim të mëtejshëm, sipas të cilave edhe duhet të vepohet.⁴⁵⁶

2. Në qoftë se në kontratën për transport nuk është përcaktuar drejtimi i rrugës në të cilin duhet kryer transporti, sipas par. 2 të këtij neni, transportuesi ka detyrimin ta bëjë këtë në drejtimin që më së tepërmi i përgjigjet interesave të dërguesit. Si do ta vlerësojë dhe çka do të konsiderojë se është në interes të dorëzuesit, transportuesi duhet t'u përmbahet rregullave të profesionit dhe standardeve të përgjithshme të parimit të ndërgjeshmërisë dhe ndershmërisë, me kujdes të një eksperti dhe shtëpiaku të mirë.⁴⁵⁷ Në këtë rast transportuesi veçanërisht duhet

454 Shih nenin 663 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

455 Shih nenet 685 dhe 689 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna për këto nene.

456 Shih nenin 676 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

457 Shih nenin 5 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen në komentën për pjesën e përgjithshme të LMD.

të ketë kujdes për interesat e dërguesit, të cilat i janë apo kanë mundur t'i jenë të njohura, duke bërë transportin në rrugën më të përshtatshme për atë dërgesë, varësisht nga gjatësia, lloji dhe përshtatshmëria e rrugës (p.sh. ngricat, kryerja e punimeve në rrugë, etj.), pesha e mjetit të vozitjes me ngarkesë, dimensionet e sendit që transportohet e kështu me radhë.⁴⁵⁸

Neni 676. Pengesat gjatë kryerjes së transportit

- 1. Transportuesi ka për detyrë ta njoftojë dërguesin për të gjitha rrethanat që do të kishin ndikim në kryerjen e transportit dhe të veprojë sipas udhëzimeve që i merr nga ai.**
- 2. Transportuesi nuk është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të dërguesit, zbatimi i të cilave do të mund të rrezikonte sigurinë e personave ose të të mirave.**
- 3. Në qoftë se rasti do të ishte i tillë sa të mos mund të priten udhëzimet e dërguesit, transportuesi ka për detyrë të veprojë siç do të veprojë ekonomisti i mirë përkatësisht shtëpiaku i mirë në të njëjtën situatë dhe për këtë ta njoftojë dërguesin e të kërkojë udhëzimet e tij të mëtejshme.**
- 4. Transportuesi ka të drejtë për shpërblimin e shpenzimeve që kanë ndodhur për shkak të pengesave të dala pa fajin e tij.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në nenin 676 të LMD bëhet fjalë për pengesat eventuale gjatë kryerjes së transportit dhe parashikohet: a) detyrimi i transportuesit ta lajmërojë dërguesin për pengesat, b) rastet kur transportuesi nuk është i detyruar të veprojë sipas urdhrit të dërguesit, c) kur transportuesi, për shkak të nevojës për veprim urgjent, mund të veprojë pa pritur urdhrin e dërguesit dhe ç) e drejta e transportuesit t'i paguhen shpenzimet shtesë për shkak të pengesave gjatë kryerjes së transportit. Gjatë kryerjes së transportit mund të paraqiten rrethana të ndryshme, të cilat mund të ndikojnë dhe të pengojnë përmbushjen e rregullt dhe me afat të kontratës për transport. Rrethanat mund të jenë ndër më të ndryshmet, me rëndësi është që të jenë rrethana objektive dhe të mos jenë shkaktuar nga palët kontraktuese.

1. Sipas par. 1 të nenit 676 të këtij Ligji, në rast të paraqitjes së rrethanave që janë me ndikim dhe që pengojnë kryerjen e transportit në mënyrë të rregullt dhe me kohë, transportuesi ka detyrimin që: **a)** ta njoftojë dërguesin për ato rrethana dhe **b)** të veprojë sipas udhëzimeve që i merr nga ai pas këtij njoftimi.

Fakti nëse është fajtor apo jo transportuesi për paraqitjen e rrethanave të këtilla, mund të jetë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit lidhur me dëmin e shkaktuar, mirëpo janë të parëndësishme në detyrimin e tij që gjithmonë, në rastet kur nuk është në gjendje të përmbushë në mënyrë të rregullt detyrimin e përcaktuar në kontratë, për shkak të rrethanave të paraqitura gjatë transportit, për këtë ta njoftojë dërguesin dhe nga ai të kërkojë udhëzime për veprim të mëtejshëm. Rrethana me ndikim mund të jenë moti i keq, ngrica në rrugë, bllokim i rrugës për arsye të ndryshme, edhe për shkak të përplasjes së pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, defektit në mjetin transportues, si dhe për shumë arsye të tjera

⁴⁵⁸ Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 1021.

objektive. Për të gjitha këto, dërguesi duhet njoftuar me kohë nga transportuesi, në mënyrë që të ndërmarrë masa të nevojshme me qëllim të mbrojtjes së interesave të veta dhe evitimit të dëmit. Në rast të pësimit të dëmit për shkak të mosnjoftimit, transportuesi është përgjegjës ndaj dërguesit sipas rregullave të përgjithshme për shkak të mosnjoftimit.⁴⁵⁹

2. Lënia pas dore e detyrimit të njoftimit dhe mosveprimit sipas udhëzimeve të reja të dërguesit, bën që transportuesi të veprojë nga pakujdesia e rëndë, fakt ky që është me ndikim në sasinë e dëmit të shkaktuar.⁴⁶⁰ Kësisoj, si rregull, transportuesi është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të reja të dërguesit të dhëna pas njoftimit për rrethanat që e pengojnë apo e vështirësojnë transportimin e dërgesës sipas kontratës. Në par. 2 të nenit 676 parashikohet përjashtimi nga kjo rregull. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi nuk është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të dërguesit, në qoftë se me zbatimin e tyre do të mund të rrezikonte sigurinë e personave apo të pasurisë.

3. Mund të ndodhë që gjatë transportit paraqiten rrethana të tilla, për shkak të të cilave nuk mund të priten udhëzimet e dërguesit, ngase mund të shkaktohet një dëm më i madh. Duke vepruar si shtëpiak dhe profesionist e ekonomist i mirë⁴⁶¹, transportuesi ka për detyrim të ndërmarrë veprime të caktuara, të cilat gjykon se duhen ndërmarrë në situatën e krijuar dhe për këtë ta njoftojë dërguesin si dhe të kërkojë nga ai udhëzime të mëtejshme. Transportuesi nuk është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të dërguesit edhe në rastet kur shihet qartazi se ato udhëzime janë në kundërshtim me interesat e vetë dërguesit, ashtu që mund të ndërmarrë veprime si, p.sh., për magazinimin e mallit ose kthimin e mallit te dorëzuesi. Vlerësime të këtylla transportuesi mund të bëjë, duke vepruar si shtëpiak dhe ekonomist i mirë.

4. Gjatë kryerjes së transportit, mund të paraqiten pengesa ndër më të ndryshmet. Ato mund të jenë rrethana objektive, të paraqitura pa fajin e transportuesit, por ato mund të vijnë edhe për fajin e tij. Sipas par. 4. të këtij neni, transportuesi ka të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve që kanë ndodhur për shkak të pengesave të dala pa fajin e tij, si dhe për shpenzimet e shkaktuara duke vepruar sipas udhëzimeve të reja të dërguesit. Nuk ka detyrimin për shpërblimin e shpenzimeve në rastet kur transportuesi është përgjegjës për pengesat e shkaktuara.

Neni 677. Shpërblimi në rastin e ndërprerjes së transportit

- 1. Në qoftë se për ndonjë shkak për të cilin përgjigjet transportuesi është ndërprerë transporti ai ka të drejtë në pjesën proporcionale të shpërblimit për transportin e kryer, por ka për detyrë që ta shpërblejë dëmin që do të krijohej për palën tjetër për shkak të ndërprerjes së transportit.**
- 2. Në qoftë se transporti është ndërprerë për ndonjë shkak për të cilin nuk përgjigjet askush nga personat e interesuar, transportuesi ka të drejtë në diferencën midis**

459 Shih nenin 251 dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

460 Shih nenin 685 par. 4 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

461 Shih nenin 5 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

shpërblimit të kontraktuar për transport dhe shpenzimeve të transportit nga vendi ku është ndërprerë transporti deri në vendin e destinimit.

3. Transportuesi nuk ka të drejtë as në një pjesë të shpërblimit, në qoftë se gjatë transportit dërgesa shkatërrohet për shkak të fuqisë madhore.

Vështrim i përgjithshëm.- Transportuesi ka për detyrë që sendin që e ka pranuar për transportim ta transportojë deri në vendin e caktuar ku duhet t'i dorëzohet dërguesit të atij sendi apo një personi tjetër të caktuar.⁴⁶² Për shërbimin e kryer dërguesi ka për detyrë t'ia paguajë transportuesit shpërblimin.⁴⁶³ Neni 677 i LMD rregullon çështjen e shpërblimit të transportit në rastet kur ai ndërpritet pa u përfunduar dhe ky kur ndodh: a) për shkaqet për të cilat është përgjegjës transportuesi, b) për shkaqe për të cilat nuk përgjigjet askush nga personat e interesuar dhe c) në rast se dërgesa është shkatërruar në tërësi nga fuqia madhore. Kjo dispozitë ka të bëjë vetëm me rastet kur gjatë transportit paraqiten rrethana për shkak të të cilave transportuesi nuk mund të vazhdojë me transportin e filluar.

1. Ndërprerja e transportit mund të ndodhë për shkak të paraqitjes së rrethanave të ndryshme pas fillimit të transportit. Paragrafi 1 i këtij neni rregullon çështjen e shpërblimit të transportit për pjesën e kryer të tij, në rastet kur ai është ndërprerë për shkaqe për të cilat është përgjegjës transportuesi. Në rastet e këtilla dy çështje kërkojnë zgjidhje: pjesa proporcionale e shpërblimit për transportin e kryer, shpërblimi i dëmit eventual dërguesit për shkak të ndërprerjes së transportit.

Në këtë marrëdhënie kontraktuese transportuesi, sipas rregullave të përgjithshme, duhet të përmbushë detyrimin që ka marrë përsipër.⁴⁶⁴ Në rast se ndodh ndërprerja e transportit për shkaqe për të cilat është përgjegjës transportuesi, atij i takon e drejta e pjesës proporcionale të shërbimit, d.m.th. për atë që është kryer transporti. Kjo e drejtë e transportuesit rrjedh nga parimi i ekuivalencës së premtimeve të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve, parashikuar nga neni 7 par. 1 i këtij Ligji.⁴⁶⁵ Në këtë mënyrë, transportuesi ka të drejtën e shpërblimit proporcional për pjesën e transportit të kryer, sepse përndryshe do të cenohej parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Pavarësisht nga fakti që transporti është ndërprerë për shkaqe për të cilat është përgjegjës transportuesi, në rast të mospagesës së kësaj pjese të shpërblimit, dërguesi do të pasurohej pa bazë.⁴⁶⁶ Kjo ndodh për arsye se, për pjesën e transportit të kryer, ka përfituar dërguesi. Sasia e shpërblimit varet nga gjatësia e transportit të kryer, përkatësisht nga rruga e kaluar nga vendi i fillimit deri në atë të ndërprerjes.

462 Shih nenin 667 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

463 Shih nenin 673 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

464 Shih nenin 245 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në pjesën e përgjithshme të LMD.

465 Në bazë të parimit themelor të ekuivalencës së premtimeve të rregulluar me nenin 7 të LMD, në krijimin e marrëdhënieve me shpërblim, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke.

466 Shih nenin 194 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

Zakonisht ndodh që dërguesi, për shkak të ndërprerjes së transportit, të pësojë dëm, për shpërblimin e të cilit ka të drejtë. Dëmi, si rregull, paraqitet për shkak të vonesës në transport e mund të shkaktohet edhe për arsye të tjera. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi ka detyrimin t'ia shpërblejë dëmin e shkaktuar dërguesit për shkak të ndërprerjes së transportit. Edhe pse me këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar shprehimisht, konsiderojmë se transportuesi ka detyrimin t'ia paguajë dërguesit edhe shpenzimet lidhur me shkarkimin dhe ngarkimin e mallit në një mjet tjetër transportues dhe ndryshimin e çmimit ndërmjet shpërblimit proporcional të paguar transportuesit për pjesën e kryer të transportit dhe çmimit me të cilin tjetri do ta kryente transportin deri në fund.

Me par. 1 të nenit 677 është rregulluar vetëm situata kur ka ndodhur ndërprerja e transportit për shkaqet për të cilat është përgjegjës transportuesi. Kur është fjala për ndërprerjen e transportit, kjo dispozitë ligjore nuk i parashikon dhe nuk i rregullon rastet kur ndërprerja e transportit ka ardhur për shkaqe për të cilat është përgjegjës dërguesi. Konsiderojmë se në raste të tilla transportuesi ka të drejtën e shpërblimit të plotë nga dërguesi, aq sa është caktuar apo sa duhet të jetë ai deri në fund të transportit.⁴⁶⁷

2. Siç shihet, e drejta e shpërblimit varet nga përgjegjësia për shkaqet e paraqitura, për të cilat ka ndodhur ndërprerja e transportit. Dispozita e par. 2 të këtij neni rregullon të drejtën e transportuesit për shpërblim në rastet kur për ndërprerjen e transportit nuk është përgjegjës asnjëri nga personat e interesuar, pra jo vetëm dërguesi dhe transportuesi, por as personat e tjerë të tretë, të cilët janë të interesuar që transportuesi ta përmbushë detyrimin, siç mund të jetë pranuesi i dërgesës. Në situata të këtilla, kur transporti është ndërprerë për ndonjë shkak për të cilin nuk është përgjegjës askush nga personat e interesuar, transportuesi ka të drejtën e diferencës ndërmjet shpërblimit të kontraktuar për transport dhe shpenzimeve të transportit nga vendi ku është ndërprerë transporti deri në vendin e destinimit. Supozohet se dërgesën nga vendi i ndërprerjes deri në vendin e destinimit e ka transportuar transportuesi tjetër, të cilit i është paguar shpërblimi për atë pjesë të transportit. Për shumën sa i është paguar për transport transportuesit tjetër, e cila gjithsesi është më e vogël se ajo e kontraktuar me transportuesin e parë, zvogëlohet shpërblimi i kontraktuar me transportuesin e parë, i cili pjesërisht e ka bërë transportimin deri në vendin e ndërprerjes. Nga kjo rrjedh se dërguesi e paguan në tërësi transportin, sikur të mos ketë pasur fare ndërprerje. Sasia e shpërblimit të transportuesit të parë varet nga sasia e shpërblimit për transport, që i është paguar transportuesit të dytë pas ndërprerjes. Në këtë mënyrë, dërguesi nuk dëmtohet përkitazi me sasinë e shpërblimit për transport, mirëpo ai duhet ta bartë të gjithë dëmin eventual të shkaktuar me ndërprerjen e transportit për shkaqet për të cilat nuk është përgjegjës askush nga personat e interesuar, gjë që nënkupton se nuk ka të drejtën e shpërblimit të dëmit eventual të shkaktuar në këtë rast.

3. Me paragrafin 3 të këtij neni është rregulluar çështja e shpërblimit të transporti në rast të zhdukjes së dërgesës nga fuqia madhore. Me zhdukjen, përkatësisht dëmtimin e tërësishëm

.....
467 Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005, f. 1022 dhe Blagojević, Krulj, Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima "Savremena Administracija" 1980, f. 663.

nga fuqia madhore e sendit që është dorëzuar për transport, dëmtohet dërguesi ose pranuesi i atij sendi. Për shkak të paraqitjes së fuqisë madhore dhe zhdukjes së dërgesës, transportuesi nuk ka mundësi të përmbushë detyrimin e vet. Duke pasur parasysh se sendi i dhënë për transport është shkatërruar tërësisht nga fuqia madhore, transportuesi nuk është përgjegjës ndaj dërguesit apo pranuesit të atij sendi, por nuk i përket as e drejta e shpërblimit për transport. Në këtë rast, secila palë i mban pasojat e dëmtimit të shkaktuar nga fuqia madhore. Në rast se transportuesit i është paguar paraprakisht shpërblimi, ai ka detyrimin ta kthejë atë.

Neni 678. Kur dërgesa nuk mund të dorëzohet

- 1. Në qoftë se marrësi nuk mund të njoftohet për arritjen e dërgesës ose refuzon ta pranojë dhe në përgjithësi në qoftë se dërgesa nuk mund të dorëzohet ose në qoftë se marrësi nuk i'a paguan transportuesit shpërblimin që e ka për detyrë dhe shumat e tjera që e ngarkojnë dërgesën, transportuesi ka për detyrë ta njoftojë për këtë dërguesin, të kërkojë prej tij udhëzime dhe të ndërmarrë masa të duhura për llogari të tij për ruajtjen e sendit.**
- 2. Në qoftë se brenda afatit të arsyeshëm personi i autorizuar nuk pranon dërgesën, transportuesi ka të drejtë ta shesë dërgesën sipas rregullave për shitjen e sendit në rastin e vonesës së kreditorit dhe të arkëtojë kërkesat e veta nga çmimi i realizuar, ndërsa mbetjen ka për detyrë ta depozitojë në gjykatë për personin e autorizuar.**

Vështrim i përgjithshëm. - Pas përfundimit të transportit në vendin e caktuar, transportuesi ka detyrimin t'ia dorëzojë sendin, të cilin e ka pranuar për transport, dërguesit ose personit tjetër që duhet ta marrë atë send (marrësit).⁴⁶⁸ Siç shihet, pas përfundimit të transportit, dërgesën mund ta pranojë ose dërguesi i saj, ose personi tjetër i caktuar dhe i autorizuar për marrjen e sendit të transportuar. Neni 678 përmban rregulla për situata kur, pas përfundimit të transportit, dërgesën duhet ta pranojë personi i autorizuar për pranim, gjë që nënkupton se ai person nuk do të jetë vetë dërguesi i saj. Në situata të këtilla mund të paraqiten pengesa në transport atëherë kur transporti është përfunduar, sendi është transportuar nga vendi i pranimin deri në vendin e dorëzimit, mirëpo nuk mund të dorëzohet. Nuk është me rëndësi se për cilat arsye dorëzimi nuk mund të bëhet ashtu siç është kontraktuar. Sipas kësaj dispozite ligjore, shkaqet e mosdorëzimit janë ndarë në dy grupe: a) transportuesi nuk mund ta bëjë dorëzimin ngase nuk mund ta gjejë pranuesin e dërgesës ose pranuesi refuzon pranimin apo nuk mund ta bëjë dorëzimin për ndonjë arsye tjetër, b) pranuesi i dërgesës nuk dëshiron t'i paguajë transportuesit shpërblimin e transportit⁴⁶⁹ dhe pagesat e tjera të cilat e ngarkojnë dërgesën.⁴⁷⁰

468 Shih nenin 667 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

469 Shih nenin 673 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

470 Shih nenin 684 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

1. Në paragrafin 1 të këtij neni parashikohet detyrimi i transportuesit, pavarësisht se për cilën arsye të parashikuar në këtë dispozitë ligjore nuk ka mund t'ia dorëzojë dërgesën pranuesit të saj, ta njoftojë menjëherë për këtë dërguesin e dërgesës dhe të kërkojë nga ai udhëzime për veprim si dhe të ndërmarrë masa të nevojshme për interes të tij për ruajtjen e sendit. Kjo nënkupton se duhet të veprojë në të njëjtën mënyrë si kur paraqiten pengesa për kryerjen e transportit, që parashikohen në nenin 676 të këtij Ligji. Derisa nuk merr udhëzime të reja nga dërguesi, transportuesi duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e dërgesës. Gjatë ndërmarrjes së veprimeve në interes të dërguesit, me qëllim të ruajtjes së sendit si para, ashtu edhe pas marrjes së udhëzimeve, transportuesi duhet të veprojë sipas parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë (neni 4 i LMD) dhe me kujdesin e një shtëpiaku dhe eksperti të mirë (neni 5 i LMD). Shpenzimet e ruajtjes së sendit dhe të gjitha shpenzimet e shkaktuara, duke vepruar sipas udhëzimeve të marra, bien në ngarkim të dërguesit. Në situata të tilla të krijuara, transportuesi është i detyruar t'ia shpërblejë dorëzuesit dëmin eventual të shkaktuar: a) në qoftë se nuk e ka njoftuar me kohë dërguesin për mosdorëzimin e dërgesës, pavarësisht nga arsyeja e parashikuar në par. 1 të këtij neni,⁴⁷¹ b) në qoftë se pas njoftimit për këtë, nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të marra nga dërguesi i dërgesës.

2. Siç shihet nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi ka detyrimin ndaj dërguesit ta lajmërojë atë për pengesat e paraqitura rreth dorëzimit të dërgesës pranuesit të saj. Dërguesi i sendit është partner kontraktues me transportuesin dhe jo pranuesi i dërgesës, prandaj, sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi orientohet ta njoftojë për pengesat rreth dorëzimit dërguesin, si partner kontraktues. Për dallim nga par. 1 i këtij neni, dispozita e par. 2 të këtij neni bën fjalë për personin e autorizuar dhe jo për dërguesin e sendit. Sipas par. 2 të këtij neni, pas kalimit të afatit të arsyeshëm nga njoftimi që i është bërë dërguesit se dërgesa nuk është dorëzuar, brenda të cilit personi i autorizuar për pranin nuk ndërmerr asgjë rreth pranimit, transportuesi ka të drejtë ta shesë dërgesën sipas rregullave për shitjen e sendit në rast vonese të kreditorit. Sipas këtyre rregullave, përpos tjerash, sendi mund të shitet në mënyrën e përcaktuar, nëse është i papërshtatshëm për ruajtje, apo në qoftë se për ruajtjen e tij nevojiten shpenzime që nuk janë në përpjesëtim me vlerën e tij.⁴⁷² Nga çmimi i shitjes transportuesi ka autorizim t'ia arkëtojë kërkesat e veta nga kjo marrëdhënie juridike, kurse pjesën e ngelur duhet ta deponojë në gjykatë për personin e autorizuar.⁴⁷³

Neni 679 . Përgjegjësia e transportuesit ndaj dërguesit

Në qoftë se transportuesi ia ka dorëzuar dërgesën marrësit, ndërsa nuk e ka arkëtuar prej tij shumën me të cilën ka qenë i ngarkuar, ka për detyrë t'ia paguaj këtë shumë dërguesit, por ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga marrësi.

471 Shih nenin 251 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen në komentën për pjesën e përgjithshme të LMD.

472 Shih nenin 314 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen nga komentë për pjesën e përgjithshme të LMD.

473 Shih nenet 308 dhe 309 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene nga komentë i dhënë për pjesën e përgjithshme të LMD.

Zakonisht transportuesi bën transportin e një sendi deri në vendin e caktuar, ku ai send duhet t'i dorëzohet vetë dërguesit ose një personi tjetër të autorizuar. Dorëzuesi i dërgesës mundet t'i urdhërojë transportuesit që të transportojë dërgesën dhe t'ia dorëzojë pranuesit me kusht që ai paraprakisht të paguajë shumën e caktuar, për aq sa është e ngarkuar dërgesa dhe që ajo shumë t'ia adresohet pastaj dërguesit. Një urdhër i këtillë zakonisht jepet me shënimin e veçantë të tij në fletëngarkesë.⁴⁷⁴ Për këtë shërbim transportuesi ka të drejtën e shpërblimit të veçantë, i cili nuk mund të llogaritet dhe të përfshihet në kuadër të shpërblimit të transportit. Në rastet e këtilla transportuesi nuk ia dorëzon pranuesit dërgesën derisa ai nuk ia paguan shumën e caktuar me të cilën është e ngarkuar ajo, e cila duhet t'ia adresohet dërguesit.

Në qoftë se transportuesi pajtohet me këtë urdhër, ai është përgjegjës ndaj dërguesit për dëmin e shkaktuar në rast se e dorëzon dërgesën pa e marrë paraprakisht nga pranuesi shumën e caktuar me të cilën është e ngarkuar ajo. Siç shihet, në këtë rast sasia maksimale e dëmit është aq sa ka qenë sasia e ngarkesës së dërgesës. Me pagesën e kësaj shume dërguesit, transportuesi fiton të drejtën të paraqesë padi kthimi ndaj pranuesit, për të kthyer shumën që i ka paguar në emër të dëmit dërguesit të sendit. Nënkuptohe se në këtë rast pranuesi mund t'ia paraqesë të gjitha kundërshtimet që do t'ia paraqiste ndaj dërguesit të sendit. Nisur nga përgjegjësia e transportuesit ndaj dërguesit rrjedh se pranuesi i dërgesës nuk ka të drejtë të kërkojë nga transportuesi dorëzimin e dërgesës pa ia paguar atij shumën me të cilën është ngarkuar ajo. Në anën tjetër, transportuesi ka detyrimin ta përbushë urdhrin e dërguesit për marrjen pagesës për aq sa është ngarkuar dërgesa, dhe këtij nuk i intereson nëse është e bazuar apo jo kërkesa për pagesën e ngarkesës mbi ndonjë bazë të vlefshme juridike.

Në rastet kur në transportin e dërgesës marrin pjesë disa transportues, transportuesi i fundit ka detyrimin ta marrë pagesën me të cilën është e ngarkuar dërgesa.⁴⁷⁵

NËNKREU 3 MARRËDHËNIA E TRANSPORTUESIT DHE MARRËSIT

Neni 680. Njoftimi i marrësit për arritjen e dërgesës

- 1. Transportuesi ka për detyrë ta njoftojë marrësin pa vonesë se dërgesa ka arritur, t'ia vejë në dispozicion si është kontraktuar dhe t'ia paraqesë fletëngarkesën, nëse një fletëngarkesë e tillë është lëshuar.**
- 2. Në rastin kur është lëshuar fletëngarkesa sipas urdhrorit ose në prurësin, ai ka për detyrë të veprojë sipas paragrafit 1. të këtij neni vetëm në qoftë se në fletëngarkesë është shënuar personi në vendin e destinimit se dërgesa ka arritur.**

Vështrim i përgjithshëm. - Dërguesi nuk është gjithmonë edhe pranues i dërgesës. Pranues i dërgesës në vendin ku përfundon transporti dhe ku ajo duhet dorëzuar, mund të jetë personi

⁴⁷⁴ Shih nenin 669 par. 2 të këtij Ligji.

⁴⁷⁵ Shih Komentar ZOO II, Prof. dr. Borislav Blagojević. Prof. Dr. Vrleta Krulj, "Savremena Administracija" Beograd 1980, f. 665.

i tretë, i cili, në fakt, nuk është palë kontraktuese. Pavarësisht nga kjo, në bazë të kontratës për transport krijohen marrëdhënie të veçanta edhe ndërmjet transportuesit dhe pranuesit të dërgesës së transportuar. Si rregull, marrësi i dërgesës nuk është i detyruar ta përcjellë rrjedhën e transportit të sendit, në këtë mënyrë edhe nuk mund të dijë për arritjen e sendit të transportuar në vendin e caktuar.

1. Me të përfunduar transporti dhe me arritjen e dërgesës në vendin e përcaktuar, sipas par. 1 të këtij neni, detyrimi i parë i transportuesit është që, pa vonesë, ta njoftojë marrësin për arritjen e saj dhe t'ia vërë në dispozicion, që të mund ta marrë atë. Shprehja ligjore *pa vonesë* nënkupton se këtë duhet ta bëjë menjëherë, sapo t'i jepet mundësia e parë për këtë. Kjo për arsye se nga momenti i njoftimit ndërpritet afati i transportit dhe fillon të rrjedhë afati i shkarkimit, i cili është me rëndësi me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë për vonesën. Konsiderohet se kontrata për transport nuk është përmbushur në rregull, derisa transportuesi nuk e ka njoftuar marrësin se dërgesa ka arritur dhe t'ia ketë vënë atë në dispozicion ashtu siç është kontraktuar. Në këtë mënyrë, transportuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar për shkak të lënies pa përmbushur të këtij detyrimi, në rast se dëmi i shkaktuar është pasojë e mosnjoftimit me kohë për arritjen, për shkak të veçorive natyrore të mallit të transportuar.

Njoftimi duhet të bëhet në adresë të marrësit të dërgesës të paraqitur nga dërguesi, në mënyrën si është përcaktuar në kontratë ose në fletëngarkesë, nëse ajo është lëshuar. Në rast se mënyra e njoftimit nuk është përcaktuar në kontratë dhe fletëngarkesë, njoftimi duhet bërë në mënyrë të zakonshme qoftë me dorëzim të drejtpërdrejt të njoftimit me shkrim, me dërgesë rekomande nëpërmjet postës, me telefon, me telegram, nëpërmjet mjeteve të tjera elektronike, qoftë në ndonjë mënyrë tjetër të sigurt. Njoftimi konsiderohet i rregullt në qoftë se ndaj subjektit ekonomik është bërë gjatë orarit të punës, ndërsa nda personit fizik në kohë të zakonshme.

Pas njoftimit të marrësit, detyrimi tjetër i radhës i transportuesit është t'ia paraqesë pranuesit të dërgesës fletëngarkesën, nëse ajo është lëshuar, pasi që me pranimin e saj, pranuesi i dërgesës fiton të drejta dhe detyrime të caktuara.⁴⁷⁶ Pranuesi i dërgesës, nga fletëngarkesa mund të konstatojë se në çfarë kushtesh po e pranon dërgesën; me këtë rast ai mund ta pranojë dërgesën, duke pranuar kështu edhe të drejtat dhe detyrimet, ose mund ta refuzojë atë.

2. Në qoftë se është lëshuar fletëngarkesa sipas *urdhrit* ose *sipas prurësit* dhe aty është shënuar personi që duhet njoftuar se ka arritur dërgesa, sipas par. 2 të këtij neni, transportuesi duhet të veprojë sipas par. 1 të këtij neni. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që në fletëngarkesë sipas prurësit apo sipas urdhrit duhet patjetër të shënohet personi i cili duhet njoftuar për arritjen e dërgesës. Në rastet e këtilla, kur në fletëngarkesë nuk ka shënim se kë duhet njoftuar, sipas par. 2 të këtij neni, transportuesi nuk është i detyruar ta njoftojë pranuesin e dërgesës. Duke pasur parasysh faktin se edhe fletëngarkesa bartëse mund të bartet si letrat e tjera me vlerë, sipas prurësit apo sipas urdhrit, në rastet kur gjatë transportit bartet fletëngarkesa, transportuesi nuk mund ta

476 Shih nenin 684 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

dijë se kush është i autorizuar ta disponojë dërgesën e transportuar, ashtu që nuk mund të dijë as kë duhet njoftuar për arrijtjen e dërgesës në vendin e caktuar, pasi që nuk është në dijeni se mbi kë ka kalua fletëngarkesa bartëse.

Neni 681. Dorëzimi i dërgesës kur është lëshuar duplikati i fletëdërgesës

Transportuesi mund të refuzojë ta dorëzojë dërgesën, në qoftë se njëkohësisht nuk i jepet duplikati i fletëngarkesës në të cilën e ka vërtetuar se dërgesa i është dorëzuar.

Fletëngarkesa është dokument i cili shërben si vërtetim për marrjen e dërgesës me qëllim të transportimit.⁴⁷⁷ Ajo përmban të gjitha shënimet lidhur me dërguesin dhe transportuesin, llojin dhe sasinë e dërgesës dhe, nëse ajo është posaçërisht e shtrenjtë, edhe vlerën e saj, vendin e destinimit, vendin dhe ditën e lëshimit si dhe shënime të tjera të nevojshme.⁴⁷⁸ Ajo përpilohet në disa kopje, zakonisht në tri, në mënyrë që një kopje i bashkëngjitet dërgesës, kopjen e dytë e mban dërguesi, ndërsa transportuesi e merr të tretën. Fletëngarkesa, si e këtillë, bëhet në dublikatë, me qëllim që në njërin prej tyre të nënshkruajë pranuesi me rastin e pranimit të dërgesë, pas arrijtjes së saj në vendin e destinimit. Transportuesi përgjigjet për dërgesën deri në momentin kur ia dorëzon atë personit të autorizuar për pranim. Duke pasur parasysh përgjegjësinë që ka, sipas nenit 681 të LMD, transportuesi, pas përfundimit të transportit, nuk është i detyruar ta dorëzojë dërgesën e transportuar, derisa atij nuk i jepet dublikata e fletëngarkesës, në të cilën pranuesi vërteton se e ka pranuar dërgesën. Kjo është me rëndësi për vërtetimin e faktit se dërgesa i është dorëzuar pranuesit dhe për përgjegjësin për dëmin eventual të shkaktuar.

Kjo rregull vlen edhe për rastet kur është dhënë fletëngarkesa bartëse të cilën, poseduesi i saj, duke e vërtetuar pranimin e dërgesës, duhet t'ia japë transportuesit para se t'i dorëzohet dërgesa.

Neni 682. E drejta e marrësit për të kërkuar dorëzimin e dërgesës

- 1. Marrësi mund të ushtrojë të drejtat nga kontrata për transport ndaj transportuesit dhe të kërkojë prej tij t'ia dorëzojë fletëngarkesën dhe dërgesën vetëm pasi që ajo të arrijë në vendin e destinimit.**
- 2. Transportuesi ka për detyrë që me kërkesën e marrësit t'ia dorëzojë dërgesën para se ajo të arrijë në vendin e destinimit, vetëm në qoftë se për këtë e ka autorizuar dërguesi.**
- 3. Marrësi mund të ushtrojë të drejtat nga kontrata për transport dhe të kërkojë nga transportuesi t'ia dorëzojë dërgesën vetëm në qoftë se i plotëson kushtet e parashikuara në kontratën për transport.**

Vështrim i përgjithshëm. - Te kontrata për transport, palë kontraktuese janë dërguesi i sendit për transport dhe transportuesi. Si subjekt me të drejta dhe detyrime të caktuara në këtë

477 Shih nenin 671 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

478 Shih nenin 669 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

kontratë mund të paraqitet edhe marrësi i dërgesës. Me këtë dispozitë ligjore parashikohen të drejtat e marrësit të dërgesës ndaj transportuesit dhe kushtet dhe detyrimet të cilat duhet t'i përmbushë ai për t'i realizuar këto të drejta.

1. Me kontratën për transport mund të parashikohet që dërgesa e transportuar t'i dorëzohet personit të caktuar, që nënkupton se, në bazë të kësaj kontrate, edhe marrësi i dërgesës, edhe pse nuk është palë kontraktuese, mund të realizojë të drejta të caktuara. Qëllimi i lidhjes së kontratës për transport është transportimi i një sendi deri në vendin e caktuar. Pas përfundimit të transportit, transportuesi ka detyrimin që sendin e transportuar t'ia dorëzojë dërguesit ose personit tjetër të caktuar, i cili duhet ta pranojë atë (marrësit).⁴⁷⁹ Dërgesën e ka në dispozicion dërguesi i saj, në këtë mënyrë edhe ai mund të ndryshojë urdhrat e përmbajëtura në kontratë.⁴⁸⁰ Marrësi i dërgesës faktikisht paraqitet në një marrëdhënie të këtyllë juridike, pasi që të ketë përfunduar transporti dhe dërgesa të ketë arritur në vendin e parashikuar në kontratë. Në këtë mënyrë, në par. 1 të këtij neni parashikohet se marrësi i sendit të transportuar mund të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në kontratën për transport ndaj transportuesit, ashtu që të kërkojë nga ai t'ia dorëzojë fletëngarkesën dhe dërgesën, si rregull, *pasi që ajo të arrijë në vendin e caktuar sipas kontratës*. Në bazë të nenit 680 të këtij Ligji, për arritjen e dërgesës në vendin e caktuar, marrësi i saj njoftohet pa vonesë nga transportuesi.

2. Përjashtimit nga rregulla e përgjithshme e parashikuar në par. 1 të këtij neni, sipas par. 2 të këtij neni, pranuesi ka të drejtë të kërkojë nga transportuesi t'ia dorëzojë dërgesën edhe para se ajo të arrijë në vendin e destinimit. Në bazë të një kërkesë të këtyllë të pranuesit, transportuesi ka për detyrë t'ia dorëzojë dërgesën pranuesit edhe para se të arrijë ajo në vendin e destinuar, vetëm në qoftë se për këtë është autorizuar nga dorëzuesi. Kjo nënkupton se, përjashtimisht nga rregulla e përgjithshme e parashikuar nga par. 1 i këtij neni, palët kontraktuese mund të parashikojnë në kontratë të drejtën e pranuesit ta disponojë dërgesën para se ajo të arrijë në vendin e destinimit. Për të realizuar këtë të drejtë, duhet medoemos të ekzistojë autorizimi i dorëzuesit i dhënë pranuesit për këtë dhe që ajo të parashikohet në kontratë. Këtë të drejtë mund ta ketë edhe pranuesi në bazë të fletëngarkesës bartëse sipas urdhrat ose sipas prurësit.

Këtë të drejtë transportuesi mund ta realizojë derisa dërgesa është duke u transportuar. Për ta përmbushur këtë detyrim, transportuesi duhet të jetë njoftuar nga dërguesi për këtë të drejtë të pranuesit. Njoftimi mund të bëhet në mënyra të ndryshme dhe duhet patjetër të jetë shprehimisht i përcaktuar, zakonisht kjo do të ndodhë me shënimin e vërejtjes për këtë në fletëngarkesë. Në rast të mosdorëzimit të dërgesës personit të autorizuar, para se të ketë arritur ajo në vendin e destinimit, transportuesi është përgjegjës për dëmin eventual të shkaktuar pranuesit, pas marrjes së njoftimit për dorëzimin e dërgesës, sikundër që do të përgjigjej ndaj pranuesit edhe me rastin e dorëzimit të dërgesës para përfundimit të transportit deri në vendin e destinimit.

479 Shih nenin 667 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

480 Shih nenin 674 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

3. Pavarësisht nga fakti që pranuesi i dërgesës nuk është palë kontraktuese, në par. 3 të këtij neni parashikohet se ai mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në kontratën për transport, ashtu që të kërkojë nga transportuesi t'i dorëzohet dërgesa, vetëm nëse i plotëson kushtet e parashikuara në kontratën për transport. Në këtë mënyrë, nga momenti i pranimit të dërgesës, pranuesi i saj merr cilësinë e palës kontraktuese me të njëjtat kushte me të cilat e ka lidhur dërguesi. Kushti kryesor dhe më i shpeshtë i parashikuar në kontratë, i cili duhet përmbushur, është pagesa e shpërblimit të transportit dhe shpenzimeve të tjera eventuale të transportit⁴⁸¹. Transportuesi ka të drejtë të mos ia dorëzojë pranuesit dërgesën derisa nuk merr pagesën në emër të shpërblimit të transportit dhe shpenzimeve të shkaktuara gjatë transportit. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi ka të drejtë ta mbajë objektin e dërgesës (të drejtën e retencionit),⁴⁸² derisa pranuesi nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në kontratën për transport. Njëherësh transportuesi, me qëllim të sigurimit të kërkesës rreth pagesës së shpërblimit për transport dhe shpenzimeve të transportit e ka të drejtën e pengut mbi sendet të cilat kanë qenë objekt transporti.⁴⁸³

Arsyet e mospagesës në praktikë më së shumti janë marrëdhëniet e pranuesit me dërguesin e dërgesës, veçanërisht kur ato është dashur t'i paguajë dërguesi. Marrëdhëniet ndërmjet tyre nuk janë me ndikim në realizimin e të drejtave të transportuesit të parashikuara në kontratën për transport, prandaj këtë kundërshtim nuk mund ta bëjë pranuesi i dërgesës, sepse ky marrëdhënie juridike me dërguesin duhet t'i zgjidhë vetë.

Neni 683. Vërtetimi i identitetit dhe i gjendjes së dërgesës

1. **Personi i autorizuar ka të drejtë të kërkojë që me procesverbal të vërtetohet identiteti i dërgesës dhe në qoftë se dërgesa është dëmtuar, në çka qëndron ky dëmtim.**
2. **Në qoftë se vërtetohet se dërgesa nuk është ajo që i është dorëzuar transportuesit ose dëmtimi është më i madh se sa ka pohuar transportuesi, atëherë shpenzimet e vërtetimit i paguan transportuesi.**

Vështrim i përgjithshëm. - Në bazë të kontratës për transport, transportuesi ka për detyrim që dërgesën e pranuar ta transportojë dhe në vendin e caktuar t'ia dorëzojë dërguesit ose pranuesit të saj.⁴⁸⁴ Të dhënat për dërgesën e pranuar për transport duhen shënuar në fletëngarkesë, nëse ajo është lëshuar, nëse jo, dërguesi mund të kërkojë nga transportuesi t'i lëshojë vërtetimin për marrjen e dërgesës për transport, me të dhënat që duhet t'i përmbajë fletëngarkesa.⁴⁸⁵ Të dhënat për dërgesën të shënuara në fletëngarkesë ose në vërtetim, përpos tjerash, janë me rëndësi edhe për vërtetimin e identitetit dhe gjendjes së dërgesës me rastin

481 Shih nenin 673 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

482 Shih nenet 267 deri 270 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene,

483 Shih nenin 693 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

484 Shih nenin 667 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

485 Shih nenin 671 të këtij Ligji.

e pranimit të saj nga personi i autorizuar për pranim. Dërgesa e pranuar për transport duhet dorëzuar dërguesit të saj ose personit të autorizuar për pranimin e saj në gjendjen në të cilën është pranuar për transport. Dispozita e LMD nga neni 683 parashikon të drejtat e personit të autorizuar për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara me qëllim të vërtetimit të identitetit dhe gjendjes së dërgesës së transportuar.

1. Natyra dhe lloji i dërgesës së dorëzuar për transport mund të jetë ndër më të ndryshmet. Pra, ekziston mundësia të vihet në dyshim identiteti i dërgesës së transportuar. Detyra themelore e transportuesit është që personit të autorizuar për pranim t'ia dorëzojë dërgesën të cilën e ka pranuar për transport në gjendjen në të cilën ajo është pranuar. Në bazë të par. 1 të nenit 683 të këtij Ligji, personi i autorizuar ka të drejtë, në radhë të parë, të kërkojë të vërtetohet identiteti i dërgesë. Në rast se dërgesa është dëmtuar gjatë transportit në ndonjë mënyrë, ai ka të drejtë edhe të kërkojë të konstatohet se cilat janë dhe ku qëndrojnë në ato dëmtime.

Dërgesa është identike, në qoftë se transportuesi ia dorëzon pranuesit dërgesën që e ka marrë nga dorëzuesi i saj për ta transportuar. Nëse është identike apo jo, do të vërtetohet sipas shenjave të jashtme, duke i krahasuar ato me të dhënat në fletëngarkesë apo vërtetim. Në rast se transportuesi nuk ia dorëzon pranuesit sendin që e ka pranuar për transport, por një send tjetër, pranuesi ka të drejtë t'ia kthejë atë transportuesit dhe të kërkojë nga ai sendin e dorëzuar për transport. Në rast se transportuesi nuk ia kthen atij sendin që e ka pranuar për transport në afatin e parashikuar për transport, do të konsiderohet se dërgesa ka humbur dhe në këtë rast transportuesi është përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Në rast se personi i autorizuar e pranon dërgesën pa vërejtje, si rregull, eliminohet përgjegjësia e transportuesit. Transportuesi në këtë rast është përgjegjës vetëm kur dëmtimi nuk ka qenë i dukshëm dhe nuk ka mundur të vërehet menjëherë.⁴⁸⁶

Sipas kësaj dispozite ligjore, vërtetimi i identitetit të dërgesës dhe dëmtimit eventual të saj duhet të bëhet me anë të procesverbalit, i cili duhet nënshkruar nga transportuesi dhe pranuesi i dërgesës. Në një kontest eventual të iniciuar lidhur me këtë, ky procesverbal do të jetë prova më bindëse, ndërkaq barra e argumentimit bie mbi transportuesin, i cili duhet t'i argumentojë shkaqet dhe arsyet e shkaktimit të dëmit.

2. Me par. 2 të nenit 683 është rregulluar se kush i paguan shpenzimet e bëra për vërtetimin e gjendjes së dërgesës. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi i paguan shpenzimet e shkaktuara për vërtetimin e identitetit dhe dëmtimeve eventuale të dërgesës vetëm në rastet ku vërtetohet se dërgesa nuk është ajo që i është dorëzuar transportuesit dhe në qoftë se dëmi në dërgesë është më i madh sesa ai që e ka paraqitur transportuesi. Kjo nënkupton se në të gjitha rastet e tjera këto shpenzime i paguan personi i autorizuar për pranimin e dërgesës.

.....
486 Shih nenin 688 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

Neni 684. Detyrimi i marrësit për të paguar shpërblimin për transportin

- 1. Me marrjen në dorëzim të dërgesës dhe të fletëngarkesës, në qoftë se është lëshuar, marrësi detyrohet t'i paguaj transportuesit shpërblimin për transport, në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër në kontratën për transport ose në fletëngarkesën, si dhe t'i paguaj shumat me të cilat është ngarkuar dërgesa.**
- 2. Në qoftë se marrësi konsideron se nuk e ka për detyrë t'i paguaj transportuesit aq sa kërkon ky, ai mund të ushtrojë të drejtat nga kontrata vetëm në qoftë se në gjykatë e deponon shumën kontestuese.**

Vështrim i përgjithshëm.- Dispozita ligjore e nenit 684 të LMD rregullon detyrimin e pranuesit të dërgesës për të paguar shpërblimin për transportin e dërgesës dhe shumën me të cilën është ngarkuar ajo. Çështja e pagesës së transportit dhe e personit që duhet ta bëjë atë, mund të rregullohet me kontratën e transportit ose të parashikohet në fletëngarkesë. Transporti duhet paguar ose nga dërguesi, ose nga pranuesi i dërgesës. Pra, nuk është rregulluar me kontratë ose nuk është parashikuar në fletëngarkesë, por dilema se kush duhet ta bëjë pagesën duhet zgjidhur në bazë të nenit 659 dhe këtij neni.⁴⁸⁷ Për transportuesin nuk janë me ndikim marrëdhëniet ndërmjet dërguesit dhe pranuesit të dërgesës dhe as mënyra e rregullimit të marrëdhënieve të tyre; atij i duhet paguar shpërblimi pas përmbushjes së detyrimit të vet rreth transportit të dërgesës.

1. Pagesa e shpërblimit të transportit duhet bërë në momentin e pranimit të dërgesës, nëse me kontratën për transport nuk është parashikuar ndryshe. Si rregull, pagesa e shpërblimit të transportit është detyrim i marrësit të dërgesës. Në kontratën për transport ose në fletëngarkesë mund të parashikohet ndryshe, përkatësisht që shpërblimi i transportit të paguhet nga dërguesi. Sipas par. 1 të nenit 684 të këtij Ligji, me marrjen në dorëzim të dërgesës, kur duhet dorëzuar edhe fletëngarkesa - nëse është lëshuar ajo, pranuesi i dërgesës ka detyrimin t'i paguajë transportuesit shpërblimin dhe shumën me të cilën është ngarkuar dërgesa, nëse nuk është caktuar ndryshe në kontratën për transport ose në fletëngarkesë. Në bazë të nenit 659 par. 2 të këtij Ligji, marrësi i dërgesës ka detyrimin t'i paguajë transportuesit shpërblimin për transport dhe shpenzimet e tjera të transportit edhe në rastet kur në kontratën për transport është parashikuar që këtë ta bëjë dërguesi, por kjo nuk është shënuar në fletëngarkesë. Në këtë rast supozohet se dërguesi e ka udhëzuar transportuesin ta marrë shpërblimin nga pranuesi i dërgesës. Në përgjithësi, në rastet kur dërguesi nuk është edhe pranues i dërgesës, kemi të krijuara dy marrëdhënie juridike kontraktuese: njëren ndërmjet dërguesit dhe transportuesit dhe tjetrën ndërmjet dërguesit dhe transportuesit. Në qoftë se dispozitat e kontratës së lidhur mes dërguesit dhe pranuesit ndryshojnë nga ato të kontratës së lidhur mes dërguesit dhe transportuesit dhe për këtë arsye pranuesi i dërgesës pëson dëm apo paguan më tepër sesa është marrë vesh me dërguesin, ai këtë problem duhet ta shqyrtojë me dërguesin dhe jo me transportuesin.

487 Shih nenin 659 par. 2 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

Afati i pagesës, sipas kësaj dispozite ligjore, është momenti i marrjes së dërgesës dhe fletëngarkesës, ashtu që, sipas praktikës gjyqësore, nga ky moment marrësi bie në vonesë në rast mospagese. Duke pasur parasysh faktin se pranuesi nuk është palë kontraktuese, me pranimin e dërgesës ai i pranon kushtet që i kanë kontraktuar mes tyre dërguesi dhe transportuesi, ashtu që të drejtat dhe detyrimet e pranuesit të dërgesës janë të njëjta me ato të dërguesit.

Ekziston mundësia që sasia e shpërblimit për transport të mos jetë caktuar me tarifë dhe as me kontratë,⁴⁸⁸ apo atëherë kur fletëngarkesa nuk e përmban shumën e shpërblimit për transport. Në raste të tilla, me marrjen e dërgesës dhe fletëngarkesës, marrësi i dërgesës pranon detyrimin për pagesën e shpërblimit për transport, shuma e të cilit do të caktohet sipas parimeve të përgjithshme për caktimin e tij.⁴⁸⁹ Marrësi i dërgesës është i detyruar të paguajë shpërblimin për transportin e bërë edhe në rastet kur në kontratën për transport dhe në fletëngarkesë nuk është përcaktuar se kush e paguan shpërblimin për transport.

2. Me par. 2 të këtij neni parashikohet që personi i autorizuar për pranimin e dërgesës, duke konsideruar se nuk ka detyrimin t'i paguajë transportuesit, në emër të shpërblimit, shumën që e kërkon ai, mund t'i realizojë të drejtat e parashikuara në kontratë vetëm atëherë kur ta ketë deponuar në gjykatë shumën kontestuese të shpërblimit të transportit. Kjo do të ndodhë, p.sh., në rast se dërgesën e ka dorëzuar për transport shitësi, destinuar për pranim në vendin e caktuar nga ana e blerësit. Sipas kontratës së shitblerjes, shpërblimi i transportit duhet të paguhet nga të dy këta, në pjesë të barabarta. Me rastin e dorëzimit për transport, shitësi ka shënuar në fletëngarkesë konstatimin se shpërblimin për transport e paguan pranuesi, në këtë rast ky është blerësi. Ky i fundit në këtë rast ka të drejtë ta marrë sendin e transportuar vetëm mbasi ta ketë deponuar në gjykatë shumën kontestuese, përkatësisht nuk ka të drejtë të kërkojë nga transportuesi dorëzimin e sendit derisa nuk e deponon në gjykatë shumën kontestuese të shpërblimit për transport. Me deponimin e shumës kontestuese, sigurohet pagesa e kërkesës për transport nga edhe lind e drejta për realizimin e të drejtave nga kontrata.⁴⁹⁰

“Pranuesi i dërgesës, me rastin e pranimit të dërgesës, ka detyrimin t'i paguajë transportuesit shpenzimet e transportit të cilat i kërkon ai. Barra e argumentimit se transportuesi me dërguesin, lidhur me detyrimin e pagesës së transportit dhe pagesave tjera dhe lartësinë e tyre, janë marrë vesh ndryshe, bie në pranuesin e dërgesës, gjë që me pagesë nënkuptohet edhe deponimi i shumës kontestuese në gjykatë. Kjo nga arsyeja sepse, sipas ligjit (nenet 673 dhe 684 të këtij Ligji – shënim i aut.), nëse në fletëngarkesë nuk është theksuar se dërguesi paguan shpërblimin për transport dhe shpenzimet e tjera rreth transportit, është supozim ligjor se dërguesi e ka udhëzuar transportuesin që këto t'i paguajë nga pranuesi i dërgesës).⁴⁹¹

488 Shih nenin 665 par. 2 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

489 Shih nenin 665 të LMD dhe komentin lidhur me këtë, me të cilin është rregulluar mënyra e caktimit të lartësisë së shpërblimit për transport.

490 Shih nenet 308 dhe 309 të LMD dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

491 Qëndrim juridik nga mbledhja e XVIII e Gjykatave të Larta Ekonomike dhe degëve të gjykatave supreme të republikave dhe krahinave për çështje ekonomike, mbajtur në Lubjanë më 06.06.1985, nga Buletini i praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë ekonomike janar – korrik 1986.

NËNKREU 4 PËRGJEGJËSIA E TRANSPORTUESIT PËR HUMBJE, DËMTIM DHE VONESËN E DËRGESËS

Neni 685. Humbja ose dëmtimi i dërgesës

1. Transportuesi përgjigjet për humbjen ose për dëmtimin e dërgesës që do të shkaktoheshin prej çastit të marrjes në dorëzim deri në dorëzimin e saj, përveç nëse i janë shkaktuar me veprimin e personit të autorizuar, nga cilësia e dërgesës ose nga shkaqet e jashtme që nuk kanë mund të parashikohen si edhe të shmangen ose mënjanohen.
2. Janë nule dispozitat e kontratës për transport, të kushteve të përgjithshme të transportit të tarifave ose të ndonjë akti tjetër të përgjithshëm sipas të cilave kjo përgjegjësi zvogëlohet.
3. Por është e plotfuqishme dispozita që cakton shumën më të lartë të shpërblimit, me kusht që mos të jetë në disproporcion të dukshëm me dëmin.
4. Ky kufizim i shumës së shpërblimit nuk vlen në qoftë se dëmin e ka shkaktuar transportuesi me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.
5. Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, shuma e shpërblimit caktohet sipas çmimit të tregut të dërgesës në kohën dhe vendin e dorëzimit për transport.

Vështrim i përgjithshëm. - Në bazë të kontratës për transport e sendeve, detyrimi themelor i transportuesit është që të transportojë sendin (kur bëhet fjalë për sende) deri në vendin e caktuar.⁴⁹² Detyrim tjetër i tij është që sendin të cilin e ka transportuar, t'ia dorëzojë në vendin e caktuar dërguesit ose personit të caktuar.⁴⁹³ Për të kryer këto detyrime, transportuesi për një kohë dërgesën e ka në posedim të vet dhe këtë nga momenti i pranimit të saj për transport, deri në momentin e dorëzimit personit të caktuar. Gjatë kësaj kohe, ai është i detyruar që dërgesën e pranuar për transport ta ruajë dhe të përkujdeset për të kundrejt rreziqeve eventuale të cilat mund ta dëmtojnë atë. Transportuesi ka detyrimin që dërgesën e transportuar ta dorëzojë në atë gjendje në të cilën e ka pranuar, përndryshe përgjigjet për dëmin për shkak të mospërbushjes së kontratës.⁴⁹⁴

Me këtë dispozitë ligjore janë të rregulluara baza dhe parimi i përgjegjësisë së transportuesit për humbje dhe dëmtim të dërgesës gjatë transportit, për mundësitë ligjore për rregullimin nga ana e palëve kontraktuese të kësaj përgjegjësie ndryshe nga ajo që është parashikuar në ligj, mundësinë e caktimit të sasisë maksimale të dëmit dhe mënyrën e caktimit të sasisë së dëmit të shkaktuar.

492 Shih nenin 662 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

493 Shih nenin 667 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

494 Shih nenin 245 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

1. Gjatë transportit dërgesa mund të humbet ose të dëmtohet. Në rast të humbjes, ajo nuk mund t'i dorëzohet asses personit të cilit duhej dorëzuar e në rast të dëmtimit, ulet vlera për shkak të ndryshimit për të keq të gjendjes së saj. Në rast se dërgesa dëmtohet në atë masë sa të humbë vetitë që ka pasur, konsiderohet si e humbur. Si e humbur do të konsiderohet edhe në atë rast kur ajo nuk mund të gjendet ose i është dorëzuar gabimisht dikujt tjetër. Me qëllim të ruajtjes së sendit të pranuar, transportuesi ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha masat për të përfunduar punën që i është besuar. Me këtë rasat ai duhet të sillet si shtëpiak dhe profesionist i mirë i punës që duhet kryer.⁴⁹⁵ Në bazë të praktikës gjyqësore, ai duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të penguar prishjen dhe dëmtimin e sendit të cilin e transporton edhe në rastet kur nuk do të mund të ishte përgjegjës për këtë, kur do të kishte të drejtë t'i kërkojë shpenzimet që ka pasur për ta shpëtuar atë send.

Sipas par. 1 të nenit 685 të LMD, transportuesi është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e dërgesës, shkaktuar nga momenti i marrjes në dorëzim, deri në dorëzimin e saj personit të caktuar. Përgjegjësia e transportuesit përjashtohet vetëm në rastet e parashikuara në këtë dispozitë ligjore dhe kjo në qoftë se humbja apo dëmtimi është shkaktuar: a) me veprimet e personit të autorizuar,⁴⁹⁶ b) për shkak të vetive që ka dërgesa⁴⁹⁷ dhe c) nga shkaqet e jashtme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, të shmangen ose të mënjanohen. Siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, për dëmin e shkaktuar gjatë transportit, transportuesi përgjigjet në bazë të parimit të fajësisë së supozuar. Fajësia e tij nuk argumentohet nga i dëmtuari, pasi që ajo supozohet. Barra e argumentimit bie mbi transportuesin, pasi që ai duhet të argumentojë se nuk është fajtor për dëmin e shkaktuar.⁴⁹⁸ (*"Përgjegjësia e transportuesit për humbjen e pjesshme të dërgesës ose dëmtimin e saj gjatë transportit supozohet, ashtu që personi që e gëzon këtë të drejtë nuk ka detyrimin që në kontestin e iniciuar të argumentojë fajësinë dhe lëshimet e transportuesit. Transportuesi mund të lirohet nga përgjegjësia vetëm nëse argumenton se mungesa apo dëmtimi ka ardhur nga veprimet e personit të autorizuar, vetitë e dërgesës apo shkaqe të tjera, të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, të mënjanohen dhe të evitohen*).⁴⁹⁹ Transportuesi është përgjegjës edhe për dëmin e shkaktuar nga persona të tjerë që kanë vepruar sipas urdhrit të tij, p.sh., kur një pjesë e transportit është krye nga transportuesi tjetër, sipas urdhrit të këtij të parit.⁵⁰⁰ Sa i përket legjitimitetit aktiv për

495 Shih nenin 5 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

496 Dëmtimi mund të shkaktohet nga personi i autorizuar për shkak të paketimit jo në rregull, siç parashikohet në nenin 672 të këtij Ligji, ose mungesës së shenjave të caktuara në dërgesë.

497 Sipas praktikës gjyqësore, transportuesi nuk mund të lirohet çdoherë nga përgjegjësia, duke iu referuar vetive specifike që ka një send. Si profesionist transporti, ai duhet t'i njohë vetitë e dërgesës në raport me rrethanat që mund të paraqiten gjatë transportit, ashtu që, pavarësisht nga ajo nëse i është tërhequr vërejtja apo jo nga dërguesi, ai, me iniciativën e vet, duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që dëmi të evitohet ose të jetë sa më i vogël. Në këtë aspekt transportuesi mund të përgjigjet edhe për dëmin e shkaktuar për pasojë të ngarkimit jo të rregullt të dërgesës, edhe në rastet kur atë e ka ngarkuar dërguesi. Ai, si person profesionist transporti, duhet të kujdeset edhe për ngarkimin e dërgesës, edhe atëherë kur këtë e bën dërguesi.

498 Përkitazi me fajin e supozuar, shih nenin 136 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin nga pjesa e përgjithshme e LMD.

499 Gjyk. Sup. e Voj. Ac. 471/90 dt. 04.10.1990.

500 Shih nenin 690 dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

të paraqitur reklamimin, përkatësisht padinë për dëmin e shkaktuar ndaj transportuesit, konsiderojmë se, si rregull, këtë të drejtë e ka dërguesi derisa e ka të drejtën e disponimit të dërgesës, ndërsa pranuesi nga momenti i pranimit të dërgesës dhe fletëngarkesës.⁵⁰¹ Në rastet kur dërgesa është e siguruar gjatë transportit, personi i autorizuar për të kërkuar dëmin këtë të drejtë mund ta realizojë ose nga transportuesi, në bazë të kontratës për transport ose nga sigurveksi, në bazë të kontratës për sigurimin.

2. Numrin më të madh të transporteve e kryejnë organizatat punuese të specializuara për këtë punë. Kontratat e transportit, si rregull, janë kontrata në bazë të lajmërimit dhe paraqitjes për transport. Ekziston mundësia që transportuesit, në dëm të shfrytëzuesit të transportit, të tentojnë të përjashtojnë apo të zvogëlojnë përgjegjësinë e tyre për dëmin e shkaktuar. Në bazë të rregullave të përgjithshme, përgjegjësia e transportuesit nuk mund të zvogëlohet, gjë që nënkupton se ajo as nuk mund të përjashtohet.⁵⁰² Në bazë të par. 2 të këtij neni, janë nule dispozitat e kontratës për transport, të rregullave të kushteve të përgjithshme të transportit ose të tarifave apo të ndonjë akti tjetër të përgjithshëm, sipas të cilave zvogëlohet përgjegjësia e transportuesit për dëmin e shkaktuar. Siç shihet, dispozita e par. 2 të këtij neni është një dispozitë detyruese (imperative), e cila mbron shfrytëzuesit e transporteve, prandaj palët nuk mund të kontraktojnë apo të parashikojnë, në kushte të përgjithshme të transportit, dispozitën e cila është në dëm të shfrytëzuesit të transportit, përkatësisht me të cilën do të zvogëlohej përgjegjësia e transportuesit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar gjatë transportit.

3. Ndryshe nga ajo që parashikohet në par. 2 të këtij neni, sipas par. 3 të nenit 685 të këtij Ligji, lejohet mundësia që transportuesi paraprakisht të caktojë në kontratë, me kushte të përgjithshme apo me tarifë, shumën më të lartë të shpërblimit për dëmin eventual të shkaktuar gjatë transportit, me kusht që kjo sasi e shpërblimit të mos jetë në disproporcion evident me dëmin.

4. Sipas par. 4 të këtij neni, kushtëzimi i përcaktuar në par. 3 të tij, nuk do të vlejë në qoftë se dëmin e ka shkaktuar transportuesi me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.⁵⁰³ Pra, transportuesi që e ka shkaktuar humbjen apo dëmtimin e dërgesës me veprimin e vet, i cili mund të karakterizohet si dashje ose si pakujdesi ekstreme, nuk ka të drejtë t'i referohet dispozitës së par. 3 të këtij neni. Kjo rregull është në harmoni me dispozitën e nenit 248 par. 1 i këtij Ligji, si rregull e përgjithshme.

5. Me par. 5 të nenit 685 është rregulluar mënyra e caktimit të sasisë së dëmit të shkaktuar me humbjen apo me dëmtimin e dërgesës. Sasia e shpërblimit të dëmit të shkaktuar mund

501 Gjyk. Sup. e Voj. Ac. 296/90 dt. 18.04.1990.

502 Shih nenin 248 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen. Sipas par. 1 të këtij neni përgjegjësia e debitorit për dashjen ose pakujdesinë e rëndë nuk mund të përjashtohet paraprakisht me kontratë. Në bazë të par. 3 dhe 4 të nenit në fjalë mund të caktohet paraprakisht vetëm një shumë më e lartë e shpërblimit të dëmit.

503 Se ç'është dashja dhe pakujdesia, do të caktohet sipas rregullave të përgjithshme – shih nenin 140 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen nga komentë i dhënë për pjesën e përgjithshme të LMD.

të mos jetë caktuar në kontratën për transport. Në këto raste kërkesa e njëjës dhe detyrimi i palës tjetër për shpërblimin e dëmit varen nga përcaktimi i kontraktuar i shpërblimit të dëmit. *Në qoftë se sasia e shpërblimit nuk është e kontraktuar, ajo caktohet sipas çmimit të tregut.* Varësisht nga gjatësia e transportit, çmimi në kohën dhe vendin ku është dorëzuar për transport, dërgesa mund të ndryshojë nga çmimi i saj në vendin dhe kohën ku është dashur të merret ajo. Sipas kësaj dispozite ligjore, çmimi caktohet sipas çmimit të tregut të dërgesës në kohën dhe vendin e dorëzimit për transport. Kjo është rregull e përgjithshme sipas këtij Ligji dhe nuk do të duhej të kishte një zgjidhje tjetër me ligje të veçanta për transportin, e cila do të ishte në kundërshtim me këtë rregull.

Rregullat e parashikuara me këtë dispozitë ligjore përkitazi me shpërblimin për shkak të humbjes apo dëmtimit të dërgesave gjatë transportit, nuk do të zbatohen kur bëhet fjalë për humbjen apo dëmtimin e dërgesave që përmbajnë sende të shtrenjta, pasi që kjo është e rregulluar me një dispozitë tjetër të këtij Ligji.⁵⁰⁴

Neni 686. Humbja ose dëmtimi i dërgesës së sendeve të shtrenjta

- 1. Në rastin e humbjes ose të dëmtimit të dërgesës në të cilën gjendeshin sende të çmueshme, letra me vlerë ose sende të tjera të shtrenjta, transportuesi ka për detyrë të shpërblejë dëmin e shkaktuar, vetëm në qoftë se me rastin e dorëzimit të sendit për transport ka qenë i njoftuar për natyrën e këtyre sendeve dhe për vlerën e tyre, ose në qoftë se dëmin e ka shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.**
- 2. Në qoftë se me sendet e përmendura në dërgesë kanë qenë edhe sende të tjera, për humbjen ose dëmtimin e tyre transportuesi përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë e transportuesit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Shikuar nga këndvështrimi i vlerës së sendeve të dorëzuara për transport, në LMD bëhet dallimi i sendeve të çmueshme, letrave me vlerë ose sendeve të tjera të shtrenjta nga sendet e zakonshme. Varësisht nga natyra e sendeve për nga vlera që kanë, në rast të humbjes ose dëmtimit gjatë transportit të dërgesës së sendeve me vlerë, shpërblimi i dëmit është rregulluar me dispozitë të veçantë për dallim nga shpërblimi për humbjen ose dëmtimin e dërgesave që përmbajnë sende të tjera. Në dispozitën e nenit 686 parashikohen rregullat përkitazi me detyrimin e transportuesit për shpërblimin e dëmit në rast të humbjes ose dëmtimit të dërgesës me sende të çmueshme, letrave me vlerë ose sendeve tjera të shtrenjta, kushtet që duhen përmbushur për të ekzistuar ky detyrim i transportuesit dhe përgjegjësia e transportuesit për humbjen e sendeve të tjera të cilat kanë qenë me sendet me vlerë të madhe.

- 1. Në rast të humbjes ose dëmtimit të dërgesës në të cilën gjenden sende të çmueshme, letra me vlerë ose sende të tjera të shtrenjta, është rregull e përgjithshme se transportuesi ka detyrimin të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Që transportuesi të mund t'i përmbushë detyrimet e veta me kohë dhe pa pengesa, me rastin e dorëzimit të dërgesës për transport,**

504 Shih nenin 686 të këtij Ligji dhe komentën lidhur me këtë nen.

dërguesi ka detyrimin ta njoftojë atë për llojin, përmbajtjen dhe sasinë e dërgesës. Kur në dërgesë ndodhen sende të çmueshme, letra me vlerë ose sende të tjera të shtrenjta, dërguesi ka detyrimin që për këtë ta njoftojë transportuesin në momentin e dorëzimit të tyre për transport, duke ia komunikuar edhe vlerën e tyre.⁵⁰⁵ Në rast të përpilimit të fletëngarkesës për dërgesën e përpiluar për transport, ajo duhet të përmbajë edhe vlerën e sendeve të çmueshme dhe sendeve të tjera të shtrenjta.⁵⁰⁶ Sipas par. 1 të nenit 686 të këtij Ligji, detyrimi i transportuesit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me humbjen ose dëmtimin gjatë transportit të dërgesës në të cilën ka pasur sende të shtrenjta (ari, stoli të ndryshme, letra me vlerë, fotografi, sende tjera me vlerë të veçantë për persona të caktuar etj.) kushtëzohet në dy raste: a) në momentin e dorëzimit të sendit për transport transportuesi ka qenë i njoftuar për natyrën e këtyre sendeve dhe për vlerën e tyre; b) në qoftë se dëmin e ka shkaktuar transportuesi me dashje ose nga pakujdesia ekstreme.

Gjatë transportit të sendeve të shtrenjta, transportuesi duhet të ketë kujdes të veçantë që ato të mos humbin apo dëmtohen. Për ta pasur këtë kujdes, ai duhet të jetë njoftuar për ekzistimin e tyre në dërgesë.⁵⁰⁷ Në rast të njoftimit për këtë, dërguesi ka të drejtën e shpërblimit të plotë të dëmit, por nëse nuk njoftohet ai ka vetëm të drejtën e shpërblimit të dëmit sipas çmimit të tregut të dërgesës në kohën dhe vendin e dorëzuar për transport, siç parashikohet në par. 5 të nenit 685 të këtij Ligji.

Njëherësh transportuesi është përgjegjës për shpërblimin e plotë të dëmit të shkaktuar me humbjen ose dëmtimin e sendeve të shtrenjta edhe në rastet kur nuk ka qenë i njoftuar për përmbajtjen dhe vlerën e kësaj dërgese, por dëmin e ka shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia ekstreme.⁵⁰⁸

2. Në rast se në dërgesën me sende të shtrenjta janë vendosur edhe sende të tjera të zakonshme, për sendet e shtrenjta transportuesi është përgjegjës sipas par. 1 të këtij neni, ndërsa për sendet e tjera në atë dërgesë përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë së transportuesit të parashikuara nga neni 685 par. 5 i këtij Ligji.

Neni 687. Kthimi i shpërblimit të paguar për transport

Në rastin e humbjes së plotë të dërgesës, transportuesi ka për detyrë që përveç shpërblimit të dëmit, dërguesit t'i kthejë shpërblimin për transport në qoftë se ai është paguar.

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar ajo që është përcaktuar dhe parashikuar në kuptimin e dhënë për kontratën për transport.⁵⁰⁹ Nga kuptimi i dhënë

505 Shih nenin 668 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

506 Shih nenin 669 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

507 Shih nenin 266 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen nga komenti për pjesën e përgjithshme të LMD.

508 Lidhur me dashjen dhe pakujdesinë shih nenin 140 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen nga komenti i dhënë për pjesën e përgjithshme të LMD.

509 Shih nenin 648 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

për kontratën për transport rrjedh se transportuesi detyrohet ta transportojë personin ose sendin në vendin e caktuar, ndërsa udhëtari, përkatësisht dërguesi detyrohet që për këtë të paguajë shpërblimin e caktuar. Pavarësisht nga ajo nëse shpërblimi për transport është paguar paraprakisht apo pasi të jetë përfunduar transporti, shpërblimi për transport paguhet për kryerjen e transportit. Nga kjo rrjedh se transportuesi nuk ka të drejtën e shpërblimit, në qoftë se nuk e përmbush detyrimin kontraktues - nuk e transporton personin apo sendin në vendin e caktuar. Në rast të humbjes së dërgesës në tërësi apo edhe pjesërisht, transportuesi nuk e ka përmbushur kontratën, prandaj nuk ka të drejtën e shpërblimit, qoftë në tërësi apo vetëm pjesërisht.

Nën kushtet e parashikuara ligjore transportuesi përgjigjet ndaj dërguesit për dëmin e shkaktuar në rast të humbjes së plotë të dërgesës gjatë transportit.⁵¹⁰ Në bazë të nenit 687 të këtij Ligji, në rast të humbjes së plotë të dërgesës, transportuesi ka detyrimin që, përpos shpërblimit të dëmit, dërguesit t'ia kthejë edhe shpërblimin për transport, në qoftë se ai është paguar. Nga kjo do të rrjedhë konstatimi se kur dërgesa e dorëzuar për transport është dëmtuar pjesërisht, proporcionalisht me pjesën e dëmtuar të dërgesës duhet të kthehet edhe pjesa e shpërblimit të paguar për transport.

Neni 688. Kur marrësi e merr dërgesën pa kundërshtim

- 1. Kur marrësi e merr dërgesën pa kundërshtim dhe i paguan transportuesit kërkesat e tij, shuhet përgjegjësia e transportuesit, përveç nëse dëmtimi është konstatuar me procesverbal para marrjes së dërgesës.**
- 2. Transportuesi mbetet përgjegjës për dëmtimet e dërgesës që (*nuk*) mund të viheshin re në momentin e dorëzimit, në qoftë se marrësi e ka njoftuar për këto dëmtime menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se tetë (8) ditë nga dorëzimi.**
- 3. Transportuesi nuk mund të thirret në dispozitat e paragrafëve paraprake, në qoftë se dëmtimi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.⁵¹¹**

Vështrim i përgjithshëm.- Dispozita ligjore e nenit 688 të LMD rregullon reagimet e mundshme të pranuesit të dërgesës me rastin e marrjes së saj nga transportuesi, veprimet që duhen ndërmarrë në rast të dëmtimit të dërgesës gjatë transportit dhe të drejtat dhe detyrimet e transportuesit dhe marrësit të dërgesës nga momenti i marrjes së saj, veçanërisht nga cili moment dhe në të cilat kushte transportuesi nuk përgjigjet, kur është përgjegjës ai për dëmin e shkaktuar dhe kur është përgjegjës pa kurrfarë kushtëzimi për dëmin e shkaktuar gjatë transportit.

.....
510 Shih nenin 685 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhen lidhur me këtë nen.

511 Kjo dispozitë ligjore i përgjigjet në tërësi dispozitës ligjore të LMD/1978 i cili është zbatuar deri sa ka filluar të zbatohet ky ligj.

1. Me të arritur të dërgesës në vendin e caktuar sipas destinimit të përcaktuar në kontratë, transportuesi ka detyrimin që, pa vonesë, ta njoftojë marrësin se dërgesa ka arritur.⁵¹² Pasi dërgesa të ketë arritur dhe të jetë njoftuar për këtë, personi i autorizuar është i detyruar që, për marrjen e saj, pa vonesë, ta konstatojë identitetin dhe gjendjen e saj.⁵¹³ Në këtë aspekt, marrësi i dërgesës ka detyrimin që, para marrjes së saj, ta kontrollojë atë me qëllim të konstatimit nëse transportuesi e ka kryer në rregull detyrimin e vet themelor - transportin e dërgesës dhe dorëzimin e saj në atë gjendje në të cilën e ka pranuar. Një kontrollim i këtillë duhet bërë në momentin e dorëzimit të dërgesës nga transportuesi dhe pranimit të saj nga pranuesi. Duke pasur parasysh faktin se pranuesi i dërgesës nuk është gjithmonë edhe dërguesi i saj, përkatësisht dorëzuesi i dërgesës për transport, identiteti, sasia dhe gjendja e saj konstatohen në bazë të fletëngarkesës dhe dokumentacionit tjetër përcjellës ekzistues. Pas kontrollimit të bërë, nëse ka dëmtime të dërgesës, duhet konstatuar edhe për çfarë dëmtimi bëhet fjalë, duke konstatuar atë në procesverbalin, të cilin do ta përpilojë bashkë me transportuesin. Sipas praktikës gjyqësore, në rast se dëmtimet nuk janë konstatuar bashkërisht në procesverbal, konsiderohet se pranuesi me kohë ka bërë kundërshtimin dhe reklamacionin ndaj transportuesi, në qoftë se e ka pranuar dërgesën dhe në fletëngarkesë, të cilën ia ka dorëzuar transportuesit, ka konstatuar të metat e konstatuara të dërgesës.⁵¹⁴ Sipas par. 1 të këtij neni, *në qoftë se marrësi e merr dërgesën pa kundërshtim përkitazi me dëmtimet apo me humbjen e pjesshme të dërgesës dhe i paguan transportuesit kërkesat e tij, shuhet përgjegjësia e tij përkitazi me dëmtimet e dukshme të dërgesës*. Përgjegjësia e transportuesit nuk shuhet, në qoftë se dëmtimet janë konstatuar me procesverbal para marrjes së dërgesës ose marrësi i dërgesës, në fletëngarkesë të cilën ia ka dorëzuar transportuesit, i ka shënuar të metat e konstatuara të dërgesës së transportuar.

2. Me par. 2 të këtij neni do të duhej bërë dallimi ndërmjet dëmtimeve të dukshme dhe të padukshme të dërgesës. Për shkak të ndonjë gabimi teknik, me rastin e shtypjes së ligjit, në këtë dispozitë ligjore, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e saj, në rreshtin e parë, para fjalës “mund” duhet të ekzistojë fjala “nuk”. Kur është fjala për dëmtimet e padukshme dhe humbjen e pjesshme të dërgesës, në qoftë se ato nuk kanë mundur të vërehen me shikim të zakonshëm dhe marrësi e ka marrë dërgesën pa kundërshtim dhe ia ka paguar transportuesit kërkesën, ky i fundit është përgjegjës për dëmtimet e fshehta. Sipas par. 2 të këtij neni, transportuesi është përgjegjës për dëmtimet e dërgesës që nuk kanë mundur të vërehen në momentin e dorëzimit, në qoftë se marrësi e ka njoftuar transportuesin për këto dëmtime menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se 8 ditë nga dita e dorëzimit të dërgesës. Dëmtime të dukshme janë ato që mund të vërehen me një kontrollim normal, pavarësisht nëse pranuesi i dërgesës në rastin konkret i ka vërejtur apo jo ato, ndërsa dëmtim i fshehur do të konsiderohet dëmtimi që mund të zbulohet vetëm me një kontrollim profesional.

512 Shih nenin 680 par. 1 i këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

513 Shih nenin 683 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

514 Prof. dr. Borislav T. Blagojevic, Prof. dr. Vrleta Krulj, Komentar ZOO II, “Savremena Administracia” Beograd, 1980, f. 674.

Dëmtimet në dërgesë gjatë transportit, qofshin ato të dukshme apo të padukshme, duhen përcaktuar dhe vërtetuar në mënyrë të besueshme, qoftë me procesverbal të përbashkët të transportuesit dhe pranuesit të dërgesës, qoftë nëpërmjet ekspertit ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Kundërshtimi lidhur me dëmtimet duhet të jetë i qartë, i përcaktuar në dëmtime konkrete dhe të përmbajë të gjitha elementet e nevojshme, në mënyrë që transportuesi të mund të sqarohet lidhur me to dhe të përcillet në mënyrë të sigurt, si: me letër rekomande, me telegram, nëpërmjet postës elektronike dhe në ndonjë mënyrë tjetër të ngjashme.

3. Në bazë të par. 3 të nenit 688 të këtij Ligji, transportuesi nuk mund t'u referohet dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia. Pavarësisht nëse dëmtimet janë të dukshme apo të padukshme dhe pavarësisht nga ajo që pranuesi e ka pranuar dërgesën pa kundërshtim apo që kundërshtimin lidhur me dëmtimet ose humbjen e pjeshme të dërgesës e ka bërë pas afatit të parashikuar ligjor, transportuesi nuk mund të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në dërgesë apo për humbjen e pjeshme të saj, në qoftë se humbjen e ka shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.⁵¹⁵

Neni 689. Përgjegjësia e transportuesit për vonesë

Transportuesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar për shkak të vonesës, përveç nëse vonesa është shkaktuar nga ndonjë fakt që përjashton përgjegjësinë e tij për humbjen ose dëmtimin e sendit.

Vështrim i përgjithshëm. - Afati brenda të cilit duhet përfunduar transporti i një dërgese mund të jetë i kontraktuar, i përcaktuar me ligj të veçantë për llojet e caktuara të transportit, me kushte të përgjithshme apo me tarifa të caktuara. Në qoftë se afati nuk është përcaktuar në asnjë mënyrë, transporti dhe dorëzimi i dërgesës duhet të kryhen në një afat të kuptueshëm dhe të arsyeshëm, i cili do të vlejë për transportuesin e rregullt, duke pasur parasysh veçanërisht kohën e zakonshme për transportin e atij lloji të sendit, llojin e transportit dhe mjetin transportues, gjatësinë e rrugës si dhe rrethanat e tjera me ndikim në kohëzgjatjen e transportit. Transportuesi ka cilësinë e debitorit derisa zgjat transporti, prandaj, sipas rregullave të përgjithshme për vonesën në përmbushjen e detyrimit në afatin e caktuar, në rast të mospërfundimit të transportit dhe mosdorëzimit të dërgesës në afatin e caktuar, ai bie në vonesë në përmbushjen e detyrimit.⁵¹⁶

1. Dispozita e nenit 689 rregullon përgjegjësinë e transportuesit për dëmin e shkaktuar në dërgesën e dorëzuar për transport, për shkak të vonesës së transportit. Sipas kësaj dispozite ligjore, për dëmin e shkaktuar për shkak të vonesës së transportit, përgjigjet transportuesi, përveç kur vonesa është shkaktuar nga ndonjë fakt që e përjashton përgjegjësinë e tij për

515 Lidhur me dashjen dhe pakujdesinë shih nenin 140 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen nga komentit i dhënë për pjesën e përgjithshme të LMD.

516 Shih nenin 305 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

humbjen ose dëmtimin e sendit. Në këtë mënyrë, shikuar nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se *transportuesi përgjigjet për dëmin e bërë për shkak të vonesës së transportit, sipas parimit të përgjegjësisë objektive*. Transportuesi nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga vonesa në transport vetëm kure dëmi është shkaktuar nga policë e personit të autorizuar, ku bëjnë pjesë pranuesi apo dërguesi i dërgesës ose poseduesi i fletëngarkesës bartëse, si dhe nga vetitë që ka dërgesa ose shkaqet e jashtme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, të pengohen apo të mënjanohen.⁵¹⁷

Në rast të vonesës së konsiderueshme të dorëzimit të sendit të transportuar, më nuk është fjala për vonesën, por për humbjen e dërgesës dhe në këtë rast duhen zbatuar rregullat që kanë të bëjnë me përgjegjësin e transportuesit për humbjen e dërgesës dhe jo ato që kanë të bëjnë me dëmtimin për shkak të vonesës. Përndryshe, duhet konsideruar se transportuesi e ka përmbushur detyrimin e vet në rastet kur sendin e ka transportuar brenda afatit deri në vendin e destinimit, por nuk ka mundur t'ia dorëzojë personit që është dashur ta pranojë atë, për shkak të adresës jo të saktë të tij apo për shkak se ka refuzuar ta pranojë.

Neni 690. Përgjegjësia për ndihmësit

Transportuesi përgjigjet për personat që kanë punuar në kryerjen e transportit sipas urdhrit të tij.

Transportuesi është palë kontraktuese në kontratën për transport. Sipas kësaj kontrate, ai është përgjegjës për përmbushjen e rregullt të detyrimeve kontraktuese. Në përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në kontratën për transport marrin pjesë numri më i madh i personave, si: ata që janë në marrëdhënie pune te transportuesi, vozitësit, punëtorët në ngarkim dhe shkarkim, përfaqësuesit dhe ndërmjetësuesit e ndryshëm të transportuesit, speditorët etj. Kontrata për transport përmban elemente të kontratës për veprën,⁵¹⁸ ashtu që në përmbushjen e detyrimeve që dalin prej saj transportuesi mund të angazhojë edhe persona të tjerë që të ndërmarrin veprime të caktuara sipas urdhrit të tij. Për dëmin eventual të shkaktuar gjatë transportit, transportuesi mban përgjegjësi objektive, ashtu që nuk shqyrtohet fajësia e tij; nuk shqyrtohet as nëse ka bërë zgjedhjen e mirë të personave që i ka angazhuar në kryerjen e transportit. Ai është palë kontraktuese dhe është përgjegjës për përmbushjen e rregullt të kontratës për transport. Marrëdhënia ndërmjet transportuesit dhe personave që janë angazhuar nga ai në kryerjen e transportit, është marrëdhënie ndërmjet personave të tretë, pa ndikim në marrëdhëniet mes transportuesit dhe shfrytëzuesit të transportit.

517 Shih nenin 685 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

518 Shih nenin 615 të këtij Ligji dhe të tjerët në vazhdim lidhur me kontratën për veprën.

NËNKREU 5 PJESËMARRJA E DISA TRANSPORTUESEVE NË TRASPORTIN E DËRGESËS

Neni 691. Përgjegjësia solidare

- 1. Transportuesi, i cili ia beson ndonjë transportuesi tjetër kryerjen e transportit të dërgesës tërësisht ose pjesërisht që e ka pranuar për transport mbetet edhe më tej përgjegjës për transportin e saj që nga marrja deri te dorëzimi, por ka të drejtën e shpërblimit nga transportuesi të cilit ia ka besuar dërgesën.**
- 2. Në qoftë se transportuesi tjetër e merr nga transportuesi i parë bashkë me dërgesën edhe fletëngarkesën, ai bëhet palë kontraktuese në transportin me të drejtat dhe detyrat e debitorit solidar dhe të kreditorit solidar, kontributet e të cilit janë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij në transport.**
- 3. E njëjta vlen edhe kur për kryerjen e transportit të ndonjë dërgese detyrohen me të njëjtën kontratë disa transportues, të cilët do të marrin pjesë në transport njëri pas tjetrit.**
- 4. Secili prej disa transportueseve ka të drejtë të kërkojë që të vërtetohet gjendja e dërgesës në momentin kur i dorëzohet për kryerjen e pjesës së tij të transportit.**
- 5. Transportuesit solidarë marrin pjesë në bartjen e dëmit përpjesëtimisht me kontributet e tyre në transport, përveç atij që provon se dëmi nuk është shkaktuar deri sa ai ka transportuar dërgesën.**
- 6. Kundërshtimet e bëra transportuesit të mëvonshëm kanë efekt edhe ndaj transportuesve të mëparshëm.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore rregullohen situatat e mundshme kur disa transportues marrin pjesë në transportimin e një dërgese. Me rastin e transportit të sendeve gjithmonë nuk është e mundur që i njëjti transportues ta transportojë sendin nga fillimi deri në vendin e caktuar ku duhet të përfundojë transporti. Duke pasur parasysh se në mjaftë raste disa transportues marrin pjesë në transportin e një dërgese, kjo dispozitë ligjore i rregullon ato, si vijon: a) kur transportuesi i parë që ka lidhur kontratë me dërguesin ia beson transportin transportuesit tjetër, b) transportuesi i dytë, me pranimin e dërgesës për transport. e merr edhe fletëngarkesën, c) disa transportues detyrohen me të njëjtën kontratë për transportin e një dërgese, ç) të drejtat dhe detyrimet e transportuesve solidarë dhe d) efektet e kundërshtimeve ndaj transportuesve. Marrë në përgjithësi, kjo dispozitë ligjore rregullon përgjegjësinë e transportuesve, të cilët marrin pjesë në transportin e dërgesës për dorëzuesin dhe përgjegjësinë e ndërsjellë të tyre.

1. Siç shihet nga par. 1 i këtij neni, transportuesi me të cilin dorëzuesi e ka lidhur kontratën për transport, nuk është i detyruar ta bëjë vetë transportimin e dërgesës nga fillimi deri në fund. Me këtë dispozitë ligjore janë rregulluar rastet kur transportuesi e lidh kontratën me

dërguesin dhe, pas kësaj, në emër dhe për llogari të veten, lidh kontratën me transportuesin tjetër, të cilit ia beson tërësisht ose vetëm pjesërisht kryerjen e transportit të dërgesës, të cilën ai e ka marrë për ta transportuar. Ligji nuk e përcakton nëse kërkohet apo jo pëlqimi i dërguesit për këtë. Duke pasur parasysh faktin se, sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi që ka lidhur kontratën me dërguesin, edhe pas lidhjes së kontratës me transportuesin tjetër, mbetet përgjegjës për transportin deri në dorëzimin e saj, konsiderojmë se këtë mund ta bëjë edhe pa e marrë pëlqimin nga dërguesi, por jo edhe kundër vullnetit të tij. Kjo veçanërisht nëse dyshohet se me këtë, në ndonjë mënyrë, do të dëmtohet shfrytëzuesi i transportit.

Në raste të tilla kemi të bëjë me dy marrëdhënie kontraktuese: a) marrëdhënien kontraktuese e vendosur në kontratën e lidhur mes transportuesit të parë dhe dërguesit dhe b) marrëdhënien kontraktuese që del nga kontrata e lidhur ndërmjet dy transportuesve. Këto dy kontrata nuk janë të varura nga njëra-tjetra, pasi që secila palë kontraktuese është përgjegjëse ndaj bashkëkontraktuesit të vet. Sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi i parë mbetet përgjegjës për transportin, prandaj shfrytëzuesi i transportit⁵¹⁹ mund të paraqesë kërkesë për kryerjen me rregull të transportit dhe për shpërblimin e dëmit eventuale të shkaktuar vetëm ndaj transportuesit të parë e jo edhe ndaj tjetrit, me të cilin ka kontraktuar ky i pari. Transportuesi i parë është përgjegjës ndaj shfrytëzuesit të transportit jo vetëm për punën e vetë⁵²⁰ dhe të personave që kanë punuar sipas urdhrimit të tij,⁵²¹ por edhe për punën e nëntransportuesit dhe të personave që kanë punuar sipas urdhrimit të tij. Siç shihet, sipas kësaj dispozite ligjore, transportuesi i parë mbetet përgjegjës nga marrja e dërgesës për transport, derisa nuk e dorëzon atë në vendin e destinuar, edhe në rast se transportin ia ka besuar në tërësi transportuesve të tjerë. Dispozitat ligjore me të cilat është rregulluar përgjegjësia e transportuesit,⁵²² zbatohen edhe në rastet kur transportuesi, sipas kontratës së lidhur me dorëzuesin, përgjigjet për nëntransportuesin.

Me par. 1 të nenit 691 të LMD është rregulluar edhe e drejta e transportuesit të parë, i cili ka lidhur kontratën për transport me dorëzuesin e dërgesës, që ta kthejë (regresojë) nga transportuesi të cilit ia ka besuar transportin e dërgesës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ai transportues, të cilin ia ka paguar shfrytëzuesit të transportit.

2. Në bazë të paragrafit të parë të nenit 691 të këtij Ligji, transportuesi që ka lidhur kontratën për transport, me rastin e besimit të transportit në tërësi apo vetëm pjesërisht të transportit ndonjë transportuesi tjetër, me rastin e dorëzimit të dërgesës, si rregull, nuk ia dorëzon atij edhe fletëngarkesën. Sipas par. 2 të nenit 691. disa transportues mund të marrin pjesë në transportin e një dërgese me të njëjtën fletëngarkesë. Në qoftë se transportuesi tjetër e merr nga transportuesi i parë, (nga ai që e ka lidhur kontratën për transport), bashkë me dërgesën edhe fletëngarkesën, ai në atë rast me këtë konsiderohet se e ka pranuar kontratën për transport dhe bëhet palë kontraktuese e kontratës për transport, të cilën e ka

519 Shfrytëzues të transportit janë: dorëzuesi i dërgesës, pranuesi i dërgesës, poseduesi i fletëngarkesës bartëse.

520 Shih nenin 685 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen

521 Shih nenin 690 të këtij Ligji dhe komentin lidhur me këtë nen.

522 Shih nenet 685 deri 690 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

lidhur transportuesi i parë me dorëzuesin, e nëse në këtë mënyrë veprohet në vazhdim të transportit me marrjen e fletëngarkesës, edhe transportuesit e tjerë bëhen palë kontraktuese. Me marrjen e fletëngarkesës, transportuesit në vazhdim bëhen palë kontraktuese lidhur me atë transport, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kreditorit solidar⁵²³ dhe të debitorit solidar.⁵²⁴ Për shpërblimin e dëmit eventual të shkaktuar gjatë transportit, shfrytëzuesi i transportit mund të kërkojë dëmin nga cilido nga transportuesit, pa pasur nevojë të vërtetojë se cili prej tyre është fajtor për dëmin e shkaktuar. Në të njëjtën mënyrë, secili nga transportuesit mund të kërkojë nga shfrytëzuesi i transportit t'ia paguajë atij në tërësi kompensimin për transportin e bërë të dërgesës dhe të gjitha shpenzimet e transportit.

Sa u përket marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet transportuesve solidarë, në rast të shpërblimit të dëmit nga cilido prej tyre, ai ka të drejtë të kërkojë nga secili transportues tjetër t'ia kompensojë pjesën e detyrimit që i takon atij.⁵²⁵ Pjesa e kontributit të çdonjërit prej transportuesve solidarë është në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij në transport, gjë që varet nga gjatësia e transportit të cilin e ka krye ai, nga lloji i transportit, nga vështirësitë në rrugë etj. Pjesëmarrja në transport e transportuesit, varësisht nga lloji i transportit dhe gjatësia e rrugës, mund të parashikohet edhe me kontratë. Përkitazi me caktimin e pjesëve të transportuesve për shpërblimin e dëmit, duhet pasur parasysh rregullat e parashikuara në par. 5 i këtij neni.

Në të njëjtën mënyrë, secili transportues solidar ka të drejtë të kërkojë nga transportuesi që e ka marrë shpërblimin nga shfrytëzuesi i transportit, t'ia japë atij pjesën e shpërblimit që i takon për pjesën e transportit të bërë.⁵²⁶ Duke pasur parasysh faktin se realizimi i të drejtave dhe të detyrimeve që dalin nga kontrata për transport bëhet pas përfundimit të transportit, transportuesi i fundit ka më së tepërmi detyrime. Ai duhet të përkujdeset për realizimin e të drejtave të transportuesve të tjerë dhe të drejtat e pranuesit të dërgesës, sikur të ishte transportues i vetëm.

3. Në par. 3 të nenit 691 parashikohen rregullat në rastet kur me një kontratë disa transportues detyrohen të marrin pjesë njëri pas tjetrit në të njëjtin transport. Pjesëmarrja e disa transportuesve në të njëjtin transport, si transportues solidarë, nuk paraqitet vetëm në rastet kur transportuesi në vazhdim, e merr nga transportuesi i parë, bashkë me dërgesën, edhe fletëngarkesën, siç parashikohet në par. 2 të këtij neni, por mund të paraqitet edhe në bazë të një kontrate të përbashkët, me të cilën parashikohet që në të njëjtin transport të marrin pjesë disa transportues njëri pas tjetrit. Dallimi ndërmjet marrëdhënieve kontraktuese në bazë të këtij paragrafi dhe atij paraparak të këtij neni është vetëm në mënyrën e paraqitjes. Derisa sipas paragrafit paraparak paraqitet nga shkak i dorëzimit të fletëngarkesës bashkë

523 Shih nenet 409 – 4018 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

524 Lidhur me të drejtat dhe detyrimet e debitorit solidar, shih dispozitat e neneve 398-408 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

525 Shih nenin 407 të këtij Ligji.

526 Shih nenin 418 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

me dërgesën transportuesit të radhës, sipas këtij paragrafi ajo lind në bazë të kontratës, pavarësisht nga fletëngarkesa. Palë kontraktuese, në një anë, është shfrytëzuesi i transportit dhe, në anën tjetër, të gjithë transportuesit. Kur është fjala për një kontratë me më shumë transportues (bashkëtransportues), përkritazi me përgjegjësinë e tyre për përmbushjen e rregullt të detyrimit për transport, në tërësi zbatohen rregullat nga par. 2 i këtij neni lidhur me të drejtat dhe detyrimet e debitorit solidar dhe kreditorit solidar.

4. Në par. 4 të nenit 691 të këtij Ligji parashikohet e drejta e secilit nga transportuesit të kërkojë të vërtetohet gjendja e dërgesës në momentin kur e pranon atë për kryerjen e pjesës së tij të transportit. Sipas par. 2 dhe 3 të këtij neni, transportuesit të cilët bashkë me dërgesën e pranojnë edhe fletëngarkesën si dhe ata nga kontrata e përbashkët janë transportues dhe debitorë solidarë. Pjesët e tyre, si debitorë solidarë janë, në përpjesëtim me pjesëmarrjet e tyre në transport. Mirëpo njëherësh, sipas par. 5 të këtij neni, transportuesi solidar mund të lirohet nga përgjegjësia, në rast se provon që dëmi nuk është shkaktuar derisa ai e ka transportuar dërgesën. Kjo nënkupton se në par. 2 dhe 3 të këtij neni bëhet fjalë për fajësinë e supozuar të bashkë transportuesve për dëmin e shkaktuar. Me qëllim të sigurimit të provës nëse dëmi është shkaktuar paraprakisht apo jo, sipas par. 4 të këtij neni, çdonjëri nga transportuesit ka të drejtë të kërkojë gjendjen e dërgesës, të cilën e pranon për transport. Gjendja e dërgesës do të duhej të vërtetohej me procesverbal nga transportuesi i mëparshëm dhe ai që e pranon dërgesën për transport të mëtejshëm. Gjendja e konstatuar të dërgesës duhet krahasuar me gjendjen nga fletëngarkesa dhe dokumentet tjera të cilat e përcjellin dërgesën. Me konstatimin e gjendjes së dërgesës, transportuesi nuk mbron vetëm të drejtat e veta, por edhe të transportuesve të mëvonshëm, pasi që të gjithë ata nuk do jenë përgjegjës për dëmin e shkaktuar para fillimit të transportit nga ana e tyre.

5. Sipas par. 5 të nenit 691 të këtij Ligji, transportuesit e njëpasnjëshëm, përkatësisht bashkëtransportuesit sipas kontratës së përbashkët nga par. 2 dhe 3 të këtij neni, janë përgjegjës solidarë ndaj shfrytëzuesit të transportit për shpërblimin e dëmit, në përpjesëtim me kontributin e tyre në transport.⁵²⁷ Siç shihet, përgjegjësia e tyre është përcaktuar me ligj, mirëpo ndërmjet vete përgjigjen sipas parimit të përgjegjësisë së supozuar. Sipas par. 5 të këtij neni, transportuesi solidar lirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, në qoftë se provon se dëmi nuk është shkaktuar derisa ai e ka transportuar dërgesën.

6. Personi i autorizuar për pranimin e dërgesës ka të drejtë të kërkojë të vërtetohet identiteti i dërgesës dhe, në qoftë se dërgesa është e dëmtuar, ku qëndron ky dëmtim.⁵²⁸ Me rastin e marrjes së dërgesës ai duhet menjëherë të bëjë kundërshtim, në rast se dërgesa është e dëmtuar, përndryshe transportuesi do të lirohet nga përgjegjësia. Te kontratat për transportin me më shumë transportues të njëpasnjëshëm, si rregull, nuk dihet kur është shkaktuar dëmi

⁵²⁷ Kjo rregull bën përjashtim nga rregulla e përgjithshme parashikuar në nenin 407 par. 1 të LMD, sipas së cilës debitori që e ka përmbushur detyrimin ka të drejtë të kërkojë nga secili bashkëdebitor që t'ia kompensojë pjesën e detyrimit që bie mbi të. Çështja e llogaritjes së detyrimit ndërmjet transportuesve të njëpasnjëshëm si debitorë solidarë është zgjidhur ndryshe, ashtu që ata nuk përgjigjen në pjesë të barabarta, por në përpjesëtim me pjesën e transportit të kryer.

⁵²⁸ Shih nenin 683 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

dhe ndaj cilit nga transportuesit duhet bërë kundërshtimi. Duke pasur parasysh faktin se shfrytëzuesi i transportit dërgesën e merr nga transportuesi i fundit, kundërshtimi do të duhej bërë ndaj transportuesit të fundit. Kundërshtimi i këtillë i bërë ndaj transportuesit të fundit vepron edhe ndaj të gjithë transportuesve të tjerë, të cilët kanë marrë pjesë në transportin e asaj dërgese. Në bazë të formulimit gjuhësor të dispozitës së par. 6 të këtij neni rrjedh se kundërshtimet e bëra ndaj njërit nga transportuesit, kanë efekt edhe ndaj transportuesit të mëparshëm. Kjo do të nënkuptonte se, nëse kundërshtimi bëhet ndaj transportuesit të mëparshëm, ai prodhon efekt edhe ndaj të gjithë transportuesve të tjerë. Mirëpo, nëse pranuesi i dërgesës ka bërë kundërshtim ndaj njërit nga transportuesit që nuk ka qenë i fundit në transportin e dërgesës, ai kundërshtim ka efekt vetëm edhe ndaj transportuesit ndaj të cilit është bërë dhe transportuesve të tjerë që kanë qenë para tij e jo edhe ndaj transportuesve të cilët transportin e kanë krye pas tij.

Neni 692. Përgjegjësia e pjesëtuar e transportuesve

Kur në kryerjen e transportit të një dërgese marrin pjesë njëri pas tjetrit disa transportues që i ka caktuar dërguesi, secili prej tyre përgjigjet vetëm për pjesën e vet të transportit.

Në rastet kur transporti i vazhdueshëm i dërgesës nga disa transportues bazohet në një kontratë të vetme apo kur transportuesi i mëvonshëm bëhet palë kontraktuese në kontratën për transport, nga se me marrjen e dërgesës nga transportuesi paraprak, me qëllim të vazhdimit të transportit, e ka marrë edhe fletëngarkesën,⁵²⁹ ndërmjet këtyre transportuesve ekziston një lidhje juridike, qoftë si bashkëkontraktues nga fillimi, qoftë pas pranimit të kontratës në bazë të marrjes së fletëngarkesës bashkë me dërgesën. Në situata të këtilla, të gjithë transportuesit që marrin pjesë në transport janë debitorë dhe kreditorë solidarë.

Neni 692 i LMD rregullon përgjegjësinë e transportuesve në rastet kur vetë dërguesi i cakton disa transportues të marrin pjesë njëri pas tjetrit në kryerjen e transportit të një dërgese. Në situata të këtilla të gjithë ata transportues janë në lidhje juridike me dërguesin, mirëpo jo edhe ndërmjet tyre, pasi që në këtë situatë kemi disa kontrata të veçanta për transport, të lidhura ndërmjet dërguesit dhe çdonjërit nga transportuesit. Derisa mes vete nuk janë në kurrfarë lidhjeje juridike, nuk mund të jenë as debitorë apo kreditorë solidarë. Çdonjëri nga transportuesit përgjigjet për dëmin eventual të shkaktuar në dërgesë gjatë pjesës së vet të transportit që ka kryer. Derisa te transportuesit solidarë shfrytëzuesi i transportit, me rastin e pranimit të dërgesës, kur përfundon transporti, duhet të vërtetojë identitetin e dërgesës dhe të kontrollojë në mos është dëmtuar ajo dhe ku qëndron dëmtimi, për të bërë kundërshtim, kur ka dëmtime, ngase përndryshe transportuesit lirohen nga përgjegjësia, në situatën kur transporti kryhet nga disa transportues të caktuar nga dërguesi, pas përfundimit të pjesës së transportit nga transportuesi i parë, çdonjëri transportues tjetër i radhës, me rastin e pranimit të dërgesës për transport do të duhej të kontrollonte nëse gjendja e dërgesës i përgjigjet të

529 Shih nenet 691 par. 2 dhe 3 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto dispozita.

dhënave të shënuara për atë në fletëngarkesë dhe në dokumentacionin tjetër përcjellës. Në rast se transportuesi i radhës e pranon dërgesën për transport pa bërë kundërshtim, do të konsiderohet se dërgesën e ka pranuar në të njëjtën gjendje në të cilën e ka pranuar edhe transportuesi paraprak. Pra, për të gjitha ndryshimet në dërgesë përgjegjës është transportuesi tek i cili është gjetur dërgesa në momentin kur është konstatuar se ajo nuk i përgjigjet gjendjes në të cilën i është dorëzuar transportuesit të parë.

NËNKREU 6 E DREJTA E PENGUT

Neni 693. Kur transportuesi ka të drejtë pengu⁵³⁰

- 1. Për sigurimin e arkëtimit të shpërblimit për transport e të shpenzimeve të domosdoshme që i ka bërë lidhur me transportin, transportuesi ka të drejtën e pengut në sendet që i janë dorëzuar për transport dhe lidhur me transportin deri sa i mban dhe deri sa ka në dorë dokumentin me ndihmën e të cilit mund të disponojë me to.**
- 2. Kur në kryerjen e transportit kanë marrë pjesë disa transportues njëri pas tjetrit, kërkesat e tyre lidhur me transportin janë të siguruara gjithashtu me këtë peng dhe transportuesi i fundit ka për detyrë, në qoftë se fletëngarkesa nuk përmban diçka tjetër, t'i arkëtojë të gjitha kërkesat sipas fletëngarkesës.**
- 3. Kërkesat e transportuesit të mëparshëm dhe e drejta e tij e pengut kalojnë në transportuesin e mëvonshëm i cili ia ka paguar këto kërkesa.**
- 4. Kjo njësoj vlen në qoftë se transportuesi paguan kërkesat e shpeditërit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar situata kur transportuesi ka të drejtën e pengut mbi sendin e transportuar. Për transportin e kryer, transportuesi ka të drejtën e arkëtimit të shpërblimit. Shfrytëzuesi i transportit, qoftë ky dërguesi apo marrësi i dërgesës, ka detyrimin t'i paguajë transportuesit shpërblimin për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin.⁵³¹ Për realizimin e të drejtës së vet që del nga kontrata për transport, pranuesi i dërgesës së transportuar, pas kryerjes së transportit, ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e dërgesës vetëm pasi të ketë paguar shpërblimin për transport dhe për shpenzimet e transportit. Sipas rregullës së përgjithshme të parashikuar në nenin 267 par. 1 të LMD, kreditori i kërkesës së arritur për pagesë, i cili mban ndonjë send të debitorit, e ka të drejtën e mbajtjes së atij sendi gjersa nuk i paguhet kërkesa.⁵³² Rregulla e përgjithshme e parashikuar në këtë nen është detajuar me dispozitën ligjore të nenit 693 të LMD për

530 Rregullat e përgjithshme të së drejtës së pengut janë dhënë në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, në kapitullin e II-të, nga neni 133-171.

531 Shih nenin 673 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

532 Shih komentin e dhënë lidhur me nenin 267 par. 1 të LMD ku është rregulluar ushtrimi i të drejtës së retencionit.

kërkesat e transportuesve, të cilat i përkasin shpërblimit për transport dhe shpenzimeve të domosdoshme të bëra lidhur me transportin. Derisa sipas rregullës së përgjithshme nga neni 267 par. 1 të këtij Ligji për ushtrimin e të drejtës së retencionit bëhet fjalë vetëm për mundësinë e mbajtjes së ndonjë sendi të debitorit, sipas kësaj dispozite ligjore transportuesi ka të drejtë ta mbajë dërgesën e transportuar, pavarësisht nga fakti se kush është pronar i saj.

1. Sipas nenit 693 par. 1 i LMD, transportuesi e ka të drejtën e pengut mbi sendet të cilat i janë dorëzuar për transport dhe lidhur me transportin. Kjo e drejtë e transportuesit është e bazuar në të drejtën e tij që del nga kontrata për transport për arkëtimin e shpërblimit për transport dhe për shpenzimet e domosdoshme që i ka bërë lidhur me transportin si dhe për detyrimin e shfrytëzuesit të transportit t'ia paguajë transportuesit shpërblimin për transport dhe shpenzimet në lidhje me transportin, parashikuar në nenin 673 të këtij Ligji. Siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, e drejta e pengut e transportuesit mbi sendet e transportuara ka për qëllim arkëtimin e shpërblimit të transportit dhe të shpenzimeve të domosdoshme, të cilat i ka pasur ai gjatë transportit.

Sa i përket kohëzgjatjes, me këtë dispozitë parashikohet e drejta ligjore e pengut për transportuesin mbi sendin e transportuar, e cila ekziston nga momenti i marrjes së sendit për transport, deri në momentin e dorëzimit të sendit marrësit të autorizuar ose posedimit të dokumentit në bazë të të cilit mund ta disponojë atë send të transportuar. Me dorëzimin e dërgesës marrësit të saj, transportuesi e humb të drejtën e pengut mbi atë send dhe nuk mund të kërkojë nga ai kthimin e dërgesës, ngase e ka fituar të drejtën e pengut mbi atë send. Me dorëzimin e dërgesës shuhet edhe e drejta e pengut ligjor mbi atë send.

2. Paragrafi 2 i nenit 693 rregullon sigurimin e kërkesave të shpërblimit dhe shpenzimeve të transportit nëpërmjet të drejtës ligjore të pengut mbi dërgesën të disa transportuesve të cilët kanë marrë pjesë në transportin e asaj dërgese. Në transportin e një dërgese mund të marrin pjesë disa transportues njëri pas tjetrit.⁵³³ Në rastet kur në transportin e një dërgese kanë marrë pjesë disa transportues njëri pas tjetrit, në të njëjtën mënyrë, si në rastin e një transportuesi të vetëm, kërkesat e të gjithë transportuesve lidhur me transportin janë të siguruara me pengun ligjor në dërgesë. Në këtë mënyrë, mbi një send mund të themelohen disa të drejta ligjore të pengut me të cilën sigurohen kërkesat e më shumë transportuesve. Me qëllim të sigurimit të kërkesave të të gjithë transportuesve të tjerë, në rast se në fletëngarkesë nuk është parashikuar diçka tjetër, transportuesi i fundit ka për detyrë që nga pranuesi i dërgesës ta arkëtojë jo vetëm shpërblimin dhe shpenzimet e veta, por edhe shpërblimin dhe shpenzimet e të gjithë transportuesve si dhe shumën me të cilën është e ngarkuar dërgesa, kur kjo ekziston. Në qoftë se pranuesi i dërgesës e përmbush detyrimin vetëm ndaj transportuesit të fundit, por jo edhe ndaj ndonjë transportuesi tjetër, transportuesi i fundit është i detyruar ta mbajë dërgesën me qëllim të sigurimit të transportuesve të pashpërblyer. Transportuesit të fundit i ngel detyrimi ligjor ta realizojë të drejtën e pengut ligjor mbi dërgesën, me qëllim të mbrojtjes së interesave edhe të transportuesve të tjerë që kanë marrë pjesë në transportin e asaj dërgese para tij. Mirëpo, nga një formulimi i këtillë i

533 Shih nenet 691 dhe 692 të këtij Ligji.

kësaj dispozite ligjore rrjedh se çdonjëri nga transportuesit e njëpasnjëshëm e ka të drejtën e pengut ligjor edhe pas dorëzimit të dërgesës transportuesit tjetër të radhës, pasi që ai i fundit ka detyrimin e pengut ligjor mbi dërgesën, me qëllim të sigurimit të kërkesave të transportuesve paraprakë.

Për shkak të mospërmbushjes së detyrimit që del nga kontrata për transport përkitazi me pagesën e shpërblimit dhe shpenzimeve të transportit, transportuesi ka të drejtën e shitjes së dërgesës, si objekt i këtij pengu ligjor, bazuar në të drejtën për shitjen e sendit të lënë peng në bazë të kontratës.⁵³⁴ Sa i përket renditjes së të drejtave të pengut ndërmjet transportuesve, transportuesi i fundit ka të drejtë të shpërblehet i pari nga çmimi i shitjes, pastaj i parafundit dhe kështu me radhë deri tek i pari. Në qoftë se me shitjen e sendit nuk mund të mbulohen të gjitha kërkesat e transportuesve, ata nuk humbin të drejtën e shpërblimit në mënyra të tjera.

Me dorëzimin e dërgesës personit të autorizuar për pranim nga transportuesi i fundit, pushon e drejta e pengut ligjor si për këtë transportues, ashtu edhe për transportuesit e tjerë para tij. Në qoftë se transportuesi i fundit nuk i siguron kërkesat e transportuesve të mëparshëm me mbajtjen e dërgesës, ai është përgjegjës ndaj tyre për dëmin eventual të shkaktuar me këtë lëshim.

3. Dispozita ligjore e par. 3 të nenit 693 të LMD rregullon mundësinë e realizimit të kërkesave për shpërblim dhe shpenzime të transportit ndërmjet transportuesve për transportin e kryer njëri pas tjetrit. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, transportuesi i mëvonshëm mund t'ia bëjë pagesën transportuesit të mëparshëm për transportin e kryer të dërgesës nga ana e tij, të cilën do të duhej t'ia paguante pranuesi i dërgesës. Në këtë mënyrë, në situata të këtilla kërkesa e transportuesit paraprak, të cilën e ka pasur ky ndaj pranuesit në bazë të ligjit, kalon te transportuesi pasues, i cili e ka bërë pagesën. Duke pasur parasysh faktin se kërkesa e transportuesit paraprak bazohet në kontratën për transport, ajo kërkesë edhe ka qenë e siguruar me të drejtën e pengut ligjor. Kjo e drejtë e pengut, në bazë të ligjit, me qëllim të sigurimit të kërkesës, kalon te transportuesi i mëvonshëm, i cili e ka bërë pagesën. Në këtë rast nuk është me rëndësi nëse transportuesi paraprak dhe ai i mëvonshëm e kanë krye transportin në mënyrë të drejtpërdrejt njëri pas tjetrit apo ndërmjet tyre ka pasur transportues tjerë.

4. Gjatë transportit të sendeve, në raste të shumta, me qëllim të realizimit të kontratës për transport, angazhohet speditori.⁵³⁵ Me qëllim të arkëtimit të kërkesave të veta ndaj shfrytëzuesit të transportit, edhe ky e ka të drejtën e pengut ligjor mbi sendet e dorëzuara për speditim.⁵³⁶ Në qoftë se transportuesi ia paguan speditorit kërkesën të cilën duhet t'ia paguante shfrytëzuesi i transportit, kërkesë kjo e siguruar me të drejtën e pengut ligjor,

534 Në bazë të nenit 168 par. 1. të LPDS, përpos tjerash, pengmarrësi mund ta shesë sendin e lënë. Shitja bëhet përmes ankandit publik apo në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Pengmarrësi duhet të përpiqet që të arrijë vlerën e duhur të tregut gjatë shitjes së sendit të lënë peng.

535 Shih nenin 848 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

536 Shih nenin 867 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

të cilën e ka ky ndaj shfrytëzuesit të transportit, e kërkesa e speditorit dhe e drejta e tij e pengut, sipas ligjit, kalojnë te transportuesi i cili e ka bërë pagesën. Gjithë ajo që u tha për kalimin e kërkesës së paguar dhe të drejtën e pengut te transportuesi që ka bërë pagesën e kërkesës së transportuesit paraprak, vlen edhe për rastet kur ndonjëri nga transportuesit e paguan kërkesën e speditorit.

Neni 694. Konflikti i të drejtave të pengut.

- 1. Kur përveç të drejtës së pengut të transportuesit ekzistojnë në të njëjtin send njëkohësisht të drejtat e pengut të komisionarit, të shpeditorit dhe të magazinierit, përparësi arkëtimi kanë kërkesat e atyre kreditorëve të krijuara me shpeditimin ose transportimin dhe atë me rend të kundërt sipas të cilit janë krijuar.**
- 2. Kërkesat e tjera të komisionarëve, të magazinierëve, të shpeditorëve dhe të transportuesit të krijuara nga dhënia e paradhënies arkëtohen vetëm pas pagimit të kërkesave të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni sipas radhës që janë krijuar.**

Vështrim i përgjithshëm.- Për transportimin e një sendi deri në vendin e caktuar sipas kontratës për transport, përveç transportuesit, shpesh marrin pjesë edhe persona të tjerë, siç janë; komisionarët, speditorët dhe magazinierët. Edhe këta persona, si edhe transportuesit, kanë të drejtën e pengut ligjor mbi sendet që i janë dhënë për përmbushjen e detyrimeve kontraktuese, me qëllim të realizimit të kërkesave të tyre që rrjedhin nga kontrata. Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar kush ka të drejtën e pengut ligjor, përveç transportuesit dhe zgjidhja e konfliktit të subjekteve pjesëmarrëse gjatë transportit lidhur me të drejtën e pengut ligjor.

1. Për arkëtimin e shpërblimit kontraktues nga i njëjti send, në bazë të drejtës së pengut ligjor, përveç transportuesit⁵³⁷ kanë të drejtë edhe komisionari,⁵³⁸ speditori⁵³⁹ dhe magazinieri.⁵⁴⁰ Me par. 1 të nenit të nenit 694 të LMD është rregulluar radhitja e tyre në realizimin e kërkesës nëpërmjet të drejtës së pengut ligjor. Përparësia e arkëtimin të këtyre kërkesave nuk llogaritet sipas momentit të krijimit të së drejtës së pengut, as në bazë të statusit të këtyre kreditorëve. Përparësi të arkëtimin kanë kërkesat e atyre kreditorëve të cilat janë krijuar me spedicion ose transport dhe ato me rend të anasjelltë të krijimit. Siç shihet, sipas kësaj dispozite ligjore, kur është fjala për përparësinë e pagesës, bëhet përjashtim nga rregulla e përgjithshme e pagesave nga e drejta e pengut.⁵⁴¹ Renditja nuk bëhet sipas momentit të themelimit të së drejtës së pengut, por me rend të anasjelltë nga ai

.....
537 Shih nenin 693 të këtij Ligji.

538 Shih nenin 800 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

539 Shih nenin 867 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

540 Shih nenin 750 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

541 Sipas par. 2 të nenit 155 të LPDS radhitja e disa të drejtave të pengut të krijuara ndaj të njëjtit objekt të pengut, bëhet sipas kohës kur këto kanë arritur efekte ndaj personave të tretë. Sipas par. 3 të këtij neni, rangi i të drejtave të pengut pa efekt ndaj personave të tretë renditet sipas kohës kur këto të drejta janë bërë të vlefshme ndaj pengmarrësit.

si janë krijuar. Renditja bëhet në këtë mënyrë për shkak se transportuesi i fundit është edhe posedues i drejtpërdrejtë i sendit që është objekt i këtij pengu ligjor, prandaj edhe është e arsyeshme që ai të ketë përparësi, përderisa e posedon sendin.

2. Komisionari dhe magazinieri mund të kenë edhe kërkesa të tjera ndaj debitorit të njëjtë që dalin nga kontrata për komisionarin apo magazinierin, të cilat nuk rrjedhin nga specicioni apo transporti. Edhe këto kërkesa mund jenë të siguruara me të drejtën e pengut ligjor. Mirëpo, renditja e këtyre kërkesa përcaktohet ndryshe, ashtu që ato arkëtohen sipas radhës së paraqitjes së tyre. Në bazë të par. 2 të këtij neni, kërkesat e tjera të komisionarëve, të magazinierëve dhe ato të speditorëve dhe transportuesve, të krijuara nga dhënia e paradhënies, arkëtohen vetëm pas pagimit të kërkesave që dalin nga par. 1 i këtij neni, dhe ato sipas radhës së krijimit të tyre.

KREU 3

KONTRATA PËR TRANSPORTIN E PERSONAVE

Neni 695. Dispozita e përgjithshme

Transportuesi ka për detyrë që transportin e personave ta kryejë në mënyrë të sigurt me atë mjet të transportit që është caktuar me kontratë për transportin dhe me ato kushte komoditeti dhe higjienike të cilat sipas llojit të mjetit transportues përkatës dhe largësisë së rrugës, konsiderohen të domosdoshme.

Vështrim i përgjithshëm.- Transporti i udhëtarëve, nga ana e transportuesit duhet të kryhet me mjetin transportues që është caktuar me kontratë për transportin. Kontrata për transportin e personave është joformale. Ajo lidhet në bazë të vullnetit të lirë të palëve, me blerjen e biletës së udhëtimit. Kontrata për transportin e personave është edhe kontratë në bazë të paraqitjes, përmbajtja e së cilës është e rregulluar me dispozita pozitive, prandaj edhe ajo mund të konsiderohet e lidhur me fillimin e shfrytëzimit të transportit. Operatori transportues, i cili kryen transportin publik të personave, është i detyruar të lidhë kontratën për transport me çdo person, kuptohet në qoftë se ka vende dhe kapacitete të tjera të lira.⁵⁴²

Me nenin 695 të LMD parashikohen detyrimet e transportuesit me rastin e transportit të personave. Ligji parashikon 3 detyrime kryesore të transportuesit: a) sigurinë, b) komoditetin dhe c) higjienën.

542 Shih nenin 663 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

Operatori i transportit të udhëtarëve ka për detyrë që transportin e udhëtarëve ta bëjë me mjetin transportues të përcaktuar në kontratë, në mënyrë të sigurt dhe në harmoni me dispozitat për sigurinë në qarkullimin publik. Me ligje të veçanta për llojet e caktuara të transportit janë të rregulluara detajet e sigurisë së udhëtarëve.⁵⁴³

Varësisht nga mjete transportues i udhëtarëve, transporti i udhëtarëve duhet bërë në mënyrë komode, veçmas të sigurohet vendi i uljes (përpos për ato linja të udhëtimit, ku kjo nuk është e detyruar), drita e mjaftueshme dhe kushte të tjera të domosdoshme për një udhëtim komod, varësisht edhe nga relacioni i udhëtimit.

Sa i përket higjienës, nevojitet ekzistimi i një higjienë standarde për automjetin transportues të caktuar për transportin e udhëtarëve, varësisht edhe nga relacioni i udhëtimit.

Neni 696. E drejta e udhëtarit për vendin e caktuar

Transportuesi ka për detyrë t'i japë udhëtarit atë vend dhe në atë mjet transporti si është kontraktuar.

Kontrata për transportin e personave është joformale dhe zakonisht lidhet me blerjen e biletës. Nëpërmjet biletës së dhënë për udhëtim përcaktohet mjete i udhëtimit e mund të përcaktohet edhe vendi ku do të qëndrojë ë udhëtari gjatë udhëtimit. Në bazë të praktikës së deritashme, caktimi i vendit të saktë në mjetin transportues ku do të qëndrojë udhëtari gjatë udhëtimit, kontraktohet me rezervimin e vendit me rastin e blerjes së biletës. Edhe pse me këtë dispozitë ligjore shprehimisht nuk është thënë, duke pasur parasysh faktin se caktimi i mjetit transportues dhe i vendit në atë mjet parashikohet si detyrim i transportuesit, në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi, ai është përgjegjës për dëmin eventual që do të pësonte për këtë arsye udhëtari. Lloji dhe vëllimi i dëmit të shkaktuar varet nga çdo rast konkret. Mirëpo, sipas rregullës së përgjithshme të parashikuar nga neni 249 par. 1 të këtij Ligji, kreditori ka detyrimin e shpërblimit të dëmit të cilin debitori është dashur ta parashikonte në kohën e lidhjes së kontratës, si pasojë të mundshme e shkeljes së kontratës, duke i marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t'i kishte të njohura.⁵⁴⁴

.....
543 Në nenin 5 të Ligjit nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor është parashikuar detyrimi i veçantë për Ministrinë në Sektorin e Transportit të hartojë dhe të caktojë rregulla në lidhje me operimin e shërbimeve të automjeteve nga ana e drejtuesve të operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve për sigurinë e udhëtarëve.

544 Shih nenin 249 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë për këtë dispozita në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

Neni 697. Përgjegjësia e transportuesit për vonesë

1. Transportuesi ka për detyrë t'i transportojë udhëtarët në vendin e caktuar me kohë.
2. Ai përgjigjet për dëmin të cilin udhëtari do ta pësonte për shkak të vonesës, përveç nëse vonesa ka ardhur nga shkak i cili nuk ka mundur të mënjanohet as me kujdesin e ekspertit.

Vështrim i përgjithshëm.- Në shumicën e rasteve transporti i personave bëhet në transportin linjor për të cilin është paraprakisht i caktuar orari i udhëtimit, që nënkupton edhe kohëzgjatjen e udhëtimit për relacione të caktuara. Transportuesi duhet t'i përmbahet orarit të udhëtimit të caktuar më parë. Në qoftë se nuk bëhet fjalë për transportin linjor, atëherë transportuesi është i detyruar që personin ta transportojë brenda afatit kohor të kontraktuar apo brenda afatit që konsiderohet i pranueshëm për atë lloj transporti, varësisht nga gjatësia e rrugës.

1. Sipas par. 1 të këtij neni, transportuesi ka për detyrë t'i transportojë udhëtarët me kohë deri në vendin e caktuar. Kjo nënkupton fillimin dhe përfundimin e transportit në kohë të caktuar. Vonesa mund të shkaktohet si para momentit të nisjes, ashtu edhe gjatë transportit, ashtu që nuk është me rëndësi momenti dhe vendi i shkakimit të vonesës, me rëndësi është arritja me vonesë në vendin e destinimit. Në qoftë se bëhet fjalë për vonesën me fillimin e transportit, udhëtari ka të drejtë të heqë dorë nga ai udhëtim dhe të kërkojë kthimin e çmimit të paguar për atë udhëtim, nëse fillimi i transportit nis me aq vonesë saqë udhëtari më nuk ka interes për të.⁵⁴⁵

2. Me par. 2. të këtij neni parashikohen pasojat e mundshme të transportuesit në rast të vonesës me transportin e udhëtarëve. Transportuesi është përgjegjës ndaj udhëtarit për dëmin eventual të cilin e ka pësuar ai për shkak të vonesës gjatë udhëtimit. Vëllimi dhe sasia e dëmit duhet caktuar për çdo rast konkret, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara nga nenin 249 i këtij Ligji. Transportuesi mund të lirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e këtij dëmi, vetëm në qoftë se provon se dëmin nuk ka mundur ta mënjanojë as me kujdesin e ekspertit të mirë. Siç shihet, transportuesi përgjigjet në bazë të kriterit të fajësisë rreptësisht të supozuar, pasi që për lirimin nga përgjegjësia kërkohet të provojë se ka vepruar me kujdesin e një ekspertit të mirë.⁵⁴⁶ Kësi lloji të vonesës do të kishte në rast të ndonjë aksidenti në rrugë, pavarësisht nga ajo nëse pjesëmarrës ka qenë ai apo të tjerët, për shkak të të cilit vonesa nuk ka mundur të mënjanohet apo paraqitjes së ndonjë pengese tjetër në rrugë pa fajin e tij.

Me këtë ligj nuk është rregulluar ndërprerja e transportit të udhëtarëve, siç është rregulluar ndërprerja e transportit të sendeve.

⁵⁴⁵ Shih nenin 664 par. 2 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë dispozitë.

⁵⁴⁶ Shih nenin 5 par. 2 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë dispozitë nga komenti i pjesës së përgjithshme të LMD.

Neni 698. Përgjegjësia e transportuesit për sigurinë e udhëtarëve

- 1. Transportuesi përgjigjet për sigurinë e udhëtarëve nga fillimi i transportit deri në mbarim të tij, si në rastin e transportit me pagesë, ashtu edhe në transport falas dhe ka për detyrë që të shpërblejë dëmin që shkaktohet me dëmtimin e shëndetit, lëndimin ose vdekjen e udhëtarit, përveç nëse është shkaktuar me veprimin e udhëtarit ose shkakun e jashtëm i cili nuk ka mundur të parashikohet, të shmanget ose të mënjanohet.**
- 2. Nule janë dispozitat e kontratës dhe të kushteve të përgjithshme të transportit, të tarifës ose të ndonjë akti tjetër të përgjithshëm me të cilat zvogëlohet kjo përgjegjësi.**

Vështrim i përgjithshëm.- Më këtë dispozitë janë parashikuar rregullat e përgjithshme përkitazi me përgjegjësinë e transportuesit për dëmin e shkaktuar udhëtarëve me dëmtimin e shëndetit dhe lëndimin ose vdekjen e tyre. Për dëmin e shkaktuar udhëtarëve, përgjegjësia e transportuesit supozohet, prandaj edhe ai duhet patjetër të provojë se përgjegjës për dëmin është dikush tjetër dhe jo ai, përkatësisht se shkaktuesi i dëmit e përjashton përgjegjësinë e tij.

1. Transporti i udhëtarit mund të bëhet falas ose me pagesë. Nga kuptimi ligjor i dhënë për kontratën për transport⁵⁴⁷ rrjedh se kjo është kontratë me detyrime të dyanshme, ashtu që nuk ka kontratë për transportin në qoftë se transporti kryhet pa shpërblim. Në rast se transporti është pa pagesë, ndërmjet palëve nuk themelohet marrëdhënia juridike që del nga kontrata për transport, por themelohet ndonjë marrëdhënie tjetër juridike. Pavarësisht nga kjo, kjo dispozitë mbron udhëtarët dhe e detyron transportuesin që udhëtarit t'ia shpërblejë dëmin gjithmonë, pavarësisht nëse transporti është krye falas ose me pagesë. Në bazë të par. 1 të nenit 698 të LMD, transportuesi përgjigjet për sigurinë e udhëtarëve nga fillimi i transportit, deri në përfundim të tij, pavarësisht nga fakti nëse bëhet fjalë për transport falas apo me pagesë. Në qoftë se gjatë transportit, (kjo nënkupton edhe shtyrjen në momentin e hyrjes në makinë apo daljes prej saj) ndodh dëmtimi i shëndetit, lëndimi ose vdekja e udhëtarit, transportuesi ka detyrimin t'ia shpërblejë dëmin atij, përkatësisht të afërmeve të tij. Transportuesi në këtë rast, për dëmin e shkaktuar udhëtarit, përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit.⁵⁴⁸ Përgjegjësia e transportuesit, sipas kësaj dispozite ligjore, përjashtohet vetëm në rast se dëmi është shkaktuar nga policë e udhëtarit ose nga shkakun e jashtëm, i cili nuk ka mundur të parashikohet, të shmanget ose të mënjanohet.

“Është vërtetuar se në rastin konkret paditësja është rrëzuar dhe është lënduar për shkak të ngritjes së shpejtë dhe të vrullshme nga vendi ku ka qenë ulur, në momentin kur vozitësi i autobusit, duke vepruar drejtë, ka ndërmarr veprimin për tu kthyer në të majtë, me të cilin rast paditësja nuk është mbajtur për dorëzat mbajtëse në autobus. Vozitësi i autobusit, gjatë drejtimit të autobusit, nuk ka pasur kurrfarë lëshimi i cili

547 Shih nenin 536 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

548 Sipas nenit 136 par. 1 të LMD, ai që i shkaktonte dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë atë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.

do të përfaqësonte vozitje jo të rregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, e cila do të ishte në lidhje shkakësore me dëmin e shkaktuar. Këto janë rrethanat të cilat e lirojnë vozitësin nga përgjegjësia për dëmin që ka pësuar në këtë rast paditësja. Nga të njëjtat arsye në këtë rast nuk ekziston as përgjegjësia e të paditurit si sigurues përkitazi me detyrimin për shpërblimin e dëmit që ka pësuar paditësja”.⁵⁴⁹

Duke pasur parasysh se me këtë dispozitë ligjore nuk përcaktohet asgjë lidhur me llojet dhe sasinë e dëmit,⁵⁵⁰ konsiderojmë se transportuesi në këtë rast është përgjegjës për dëmin e plotë të shkaktuar, si atë material ashtu edhe atë jomaterial.

2. Sipas par. 2 të nenit 698 të këtij Ligji, as palët kontraktuese me kontratën për transport e as transportuesi me kushtet e përgjithshme, me tarifë apo me ndonjë akt tjetër të përgjithshëm, nuk mund ta zvogëlojnë përgjegjësinë e transportuesit për sigurinë e udhëtarit, parashikuar në par. 1 i këtij neni, nga se një dispozitë e tillë do të ishte absolutisht nule, për të cilën gjë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kjo nënkupton se vetëm dispozita me të cilën do të ishte zvogëluar përgjegjësia është nule e jo edhe dispozitat e tjera. Edhe pse me ligj nuk është thënë, deri sa është nule dispozita me të cilën zvogëlohet, gjithsesi absolutisht është nule edhe dispozita me të cilën përjashtohet plotësisht përgjegjësia e transportuesit për dëmin e shkaktuar udhëtarëve.

Neni 699. Përgjegjësia për bagazhin e dorëzuar për transport dhe sende të tjera

- 1. Bagazhin të cilin ia ka dorëzuar udhëtari, transportuesi ka për detyrë ta transportojë në të njëjtën kohë kur edhe udhëtarin dhe t’ia dorëzojë atë pas përfundimit të transportit.**
- 2. Për humbjen dhe dëmtimin e bagazhit që i’a ka dorëzuar udhëtari, transportuesi përgjigjet sipas dispozitave për transportin e sendeve.**
- 3. Për dëmtimin e sendeve që i mban me vete udhëtari përgjigjet transportuesi sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë.**

Vështrim i përgjithshëm. - Me këtë dispozitë ligjore janë përcaktuar detyrimet e transportuesit përkitazi me bagazhin e udhëtarit, përgjegjësia për dëmtimin dhe humbjen e bagazhit të udhëtarit dhe të sendeve që i mban me vete ai. Bagazhi i udhëtarit mund të jetë dy llojesh: a) bagazhi i regjistruar dhe b) bagazhi që e mban me vete udhëtari. Bagazhi i regjistruar është ai të cilin e dorëzon udhëtari për ta ruajtur dhe për ta transportuar ndaras nga ai. Quhet bagazhi i regjistruar ngase regjistrohet,⁵⁵¹ zakonisht në biletën e lëshuar për transport. Bagazhin që e mban me vete udhëtari përbën sendet që i mban udhëtari pranë, të cilat mund

⁵⁴⁹ Gjuk. Sup. e Kr. Rev. 1020/07 dt. 09.10.2008, Ivica Crnic, Zakon o Obveznim Odnosima “Organizator”, Zagreb 2012, f. 898.

⁵⁵⁰ Me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të Kroacisë të vitit 2005, në nenin 697 është përcaktuar detyrimi i transportuesit për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial.

⁵⁵¹ Sipas Ligjit Nr. 03/L-179 për Transportin Rrugor (neni 23 par. 3 pika 3.6), është parashikuar se bileta duhet të përmbajë “dëshmi për bagazhin e udhëtarit”.

t'i fusë brenda mjetit transportues ku është vendosur dhe për të cilat kujdeset dhe i ruan vetë udhëtari. Nga kjo dallon edhe përgjegjësia e transportuesit për bagazhin. Kontrata për transportin e bagazhit është e natyrës aksesore, në krahasim me kontratën për transportin e udhëtarëve, ngase pa kontratën për transportin e udhëtarëve nuk mund të ekzistojë kontrata për transportin e bagazhit. Bagazhi mund të transportohet me shpërblim ose pa shpërblim. Me shpërblim transportohet bagazhi i regjistruar, ndërsa për atë të cilin e mban udhëtari me vete, shpërblimi llogaritet në kuadër të shpërblimit për transportin e udhëtarit.

1. Sipas par. 1 të këtij neni, transportuesi ka detyrimin që bagazhin të cilin ia ka dorëzuar udhëtari, ta transportojë në të njëjtën kohë kur edhe udhëtarin dhe t'ia dorëzojë atë pas përfundimit të transportit. Ky detyrim i transportuesit ka të bëjë me bagazhin e regjistruar. Me rastin e dorëzimit të bagazhit, lëshohet vërtetimi për pranimin e tij (vetëm për bagazhin e regjistruar dhe jo edhe për atë bagazhin që e mban me vete udhëtari), qoftë ndaras nga bileta e dhënë, qoftë të regjistruar në biletë. Ky regjistrim është provë se është lidhur kontrata për transportin e bagazhit. Për bagazhin e regjistruar paguhet një shpërblim i caktuar, ndaras nga shpërblimi për transportin e udhëtarit.

2. Paragrafi 2 i këtij neni rregullon përgjegjësinë e transportuesit për dëmtimin dhe humbjen e bagazhit të dorëzuar nga udhëtari. Përkitazi me transportin e bagazhit, transportuesi ka detyrimin, njësoj si për transportin e sendeve, që atë ta ruajë, ta transportojë dhe t'ia dorëzojë udhëtarit. Për dëmtimin apo humbjen e bagazhit të regjistruar, transportuesi përgjigjet sipas dispozitave për transportin e sendeve.⁵⁵² Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë vetëm për dëmin e shkaktuar me dëmtimin dhe humbjen e bagazhit dhe jo edhe për dëmin e shkaktuar me vonesën e dorëzimit të tij, siç ekzistojnë dispozita të veçanta për dëmin e shkaktuar me vonesën e udhëtarit. Duke pasur parasysh faktin se, sipas par. 2 të këtij neni, për dëmtimin dhe humbjen e bagazhit transportuesi përgjigjet sipas rregullave për transportin e sendeve, kjo jep të kuptohet se ai përgjigjet edhe për dëmin e shkaktuar me vonesën e transportit të bagazhit.

3. Me par. 3 të nenit 699 të këtij Ligji janë parashikuar rregulla të veçanta për dëmtimin e sendeve që i mban me vete udhëtari. Duke pasur parasysh faktin se këto sende nuk i janë dorëzuar për ruajtje transportuesit, ai as nuk ka detyrimin t'i ruajë ato. Ato duhet t'i ruajë vetë udhëtari. Për këtë arsye transportuesi nuk përgjigjet për humbjen e këtyre sendeve, por vetëm për dëmtimin eventual të tyre. Për dëmin e shkaktuar me dëmtimin këtyre sendeve transportuesi përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë, nëse është fajtor për këtë. Barra e argumentimit të fajësisë së transportuesit për dëmtimin e sendeve, të cilat udhëtari i mban me vete, bie mbi vetë udhëtarin.

.....
552 Shih dispozitat e neneve 685 deri 690 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto dispozita ligjore.

Abdulla Aliu

PJESA XII KONTRATA PËR LICENCËN

KREU 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 700. Nocioni

Me kontratën për licencën detyrohet dhënësi i licencës që fituesit të licencës t'ia bartë në tërësi ose pjesërisht të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes, të diturisë teknike, të përvojës, të damkës, të mostrës ose modelit, kurse fituesi i licencës detyrohet t'ia paguajë shpërblimin e caktuar.

XII. Vështrim i përgjithshëm (PJESA E XII).- Pjesa e XII e LMD të Kosovës i përmban dispozitat me të cilat rregullohet kontrata për licencën, duke përfshirë nocionin, formën, kohëzgjatjen e licencës, licencën ekskluzive, kufizimin territorial të së drejtës së shfrytëzimit të licencës, detyrimet e dhënësit të licencës ku bëjnë pjesë dorëzimi i pjesës së licencës dhe dhënia e udhëzimeve dhe njoftimeve, detyrimi i garantimit për licencën, përgjegjësia për të metat juridike, dorëzimi i dhënësit të licencës ekskluzive, pastaj rregullon detyrimet e fituesit të licencës ku bëjnë pjesë shfrytëzimi i objektit të licencës, shfrytëzimi i perfeksionimeve të mëvonshme, ruajtja e objektit të licencës në fshehtësi, cilësia, të shënuarit, shpërblimi, paraqitja e raportit dhe ndryshimi i shpërblimit të kontraktuar.

LMD i Kosovës, gjithashtu rregullon edhe nënlicencën, duke i parashikuar kushtet në të cilat mund të jepet nënlicenca, kur dhënësi mund të refuzojë lejen e dhënësit të nënlicencës, pastaj kërkesën e drejtpërdrejtë të dhënësit të nënlicencës. LMD i Kosovës rregullon në mënyrë të veçantë edhe shuarjen e kontratës së licencës; këtu në veçanti trajton kalimin e një kohe të caktuar si bazë për shuarjen e licencës, pastaj përtritjen e heshtur të licencës, si dhe vdekjen, falimentimin dhe likuidimin si bazë për shuarjen e licencës. Këto përfshihen në nenet 700-725 të LMD të Kosovës. Kjo do të thotë se LMD i Kosovës i kushton një kujdes të veçantë kontratës së licencës. Lidhur me licencën, gjinden dispozita edhe në ligjet e tjera të veçanta, si, p.sh., Ligjin për Patenta⁵⁵³, i cili rregullon licencat e detyrueshme. Kontrata për licencën është kontratë e dyanshme detyruese, është kontratë formale, është kontratë konsensuale. Me kontratën për licencën, vazhdojnë së ekzistuari të drejtat e dhënësit të licencës, në fakt, të drejtat e pronësisë industriale. Me kontratën e licencës vetëm kalohet e drejta e shfrytëzimit të të drejtës së pronësisë industriale përkatësisht të së drejtave të parashikuara në Ligjin për

⁵⁵³ Ligji Nr.04/L-029 për Patenta i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.12, datë 29.09.2011 (këtu e tutje LP).

Patenta të Kosovës, Ligjin për Markat Tregtare⁵⁵⁴, pastaj Ligjin për Dizajnin Industrial⁵⁵⁵ dhe Ligjin për Treguesit Gjeografikë dhe për Emërtimet e Originës⁵⁵⁶.

700. Vështrim i përgjithshëm. - Neni 700 përcakton nocionin e kontratës për licencën, duke përkufizuar se me kontratën e licencës detyrohet dhënësi i licencës, i cili në fakt është, p.sh., titullar i të drejtës së patentës, që fituesit të licencës t’ia kalojë në tërësi ose pjesërisht të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes (zbulimit), të drejtën e diturisë teknike, të drejtën e përvojës, të damkës, të mostrës ose modelit, kurse fituesi i licencës detyrohet t’ia paguajë shpërblimin e caktuar. Kontrata për licencën edhe në literaturën juridike përkufizohet si kontratë e tillë me të cilën dhënësi i licencës detyrohet që fituesit të së drejtës së licencës t’ia kalojë në tërësi ose pjesërisht ndonjë të drejtë nga pronësia industriale, ndërsa fituesi i licencës detyrohet që për atë t’ia paguajë shpërblimin e caktuar⁵⁵⁷. Sipas përmbajtjes së kontratës për licencën, e cila përcaktohet në këtë nen, objekt i kontratës së licencës është e drejta e shfrytëzimit të shpikjes, shfrytëzimit të diturisë teknike, e drejta e shfrytëzimit të përvojës, e drejta e shfrytëzimit të damkës, të mostrës ose modeli. Titullari i së drejtës së pronësisë industriale ia kalon të drejtën e vet me kontratën e licencës fituesit të licencës gjithmonë me shpërblim.

Në Kosovë, pronësia industriale nuk rregullohet me ligj unik, por me ligje të veçanta (LP, LMT, LTGJEO të Kosovës) dhe të drejtat e fituara në bazë të ligjeve të përmendura me një emër quhen *pronësi industriale*, edhe pse pronësia industriale, në fakt, kryesisht ka të bëjë me zbulimin, përkatësisht shpikjen mbi të cilën titullari fiton të drejtën e pronësisë industriale dhe të drejtën e vet e mbron me patentë, ndërsa e drejta e shfrytëzimit të patentës për pronësinë industriale është licenca. Licenca, në fakt, mundëson shfrytëzimin e ndonjë të drejte që mbrohet me patentë. LMD i Kosovës, si të drejta që mund të kalojnë te fituesi i licencës i numëron shprehimisht: të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes, të diturisë teknike, të përvojës, të damkës, të mostrës ose modelit, kështu që do ta trajtojmë veç e veç atë që mund të jetë objekt i kontratës së licencës.

700 (a). E drejta e shfrytëzimit të shpikjes. – Është objekti më i shpeshtë i kontratës së licencës, që do të thotë se fituesi i të drejtës së licencës ka të drejtë që, në pajtim me kontratën, ta shfrytëzojë të drejtën e shpikjes (zbulimit). Shpikja, përkatësisht zbulimi nënkupton zgjidhjen e re të ndonjë problemi teknik që gjen zbatim në industri apo në ndonjë veprimtari tjetër ekonomike⁵⁵⁸. E drejta e shpikjes (zbulimit) mbrohet me patentë, sepse e drejta e patentës i takon vetëm shpikësit ose pasardhësit të tij ligjor. Shpikësi është personi që ka krijuar shpikjen gjatë punës së tij kreative dhe ajo mbrohet me patentë e

554 Ligji Nr.04/026 për Markat Tregtare i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.10, datë 24.08.2011 (këtu e tutje LMT i Kosovës).

555 Ligji Nr.04/L-028 për Dizajnin Industrial i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.9, datë 22.08.2011 (këtu e tutje LDI i Kosovës).

556 Ligji Nr.04/L-150 për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Originës i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.23, datë 04.07.2013 (këtu e tutje LTGJEO i Kosovës).

557 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1039.

558 Aliu, Abdulla, E Drejta Civile, Prishtinë, 2013, fq. 312.

cila pronarit të saj i jep të drejta ekskluzive, ndër to edhe të drejtën t'ua ndalojë palëve të treta që, pa pëlqimin e pronarit të patentës të prodhojnë, të ofrojnë për shitje, të shesin, të përdorin, të eksportojnë ose importojnë dhe të deponojnë për qëllime të tilla produktin e fituar në bazë të shpikjes. Pronari i patentës ka të drejtë që palëve të treta, pa pëlqimin e tij, t'ua ndalojë ofrimin dhe furnizimin me produktin (substancë, përbërje, pjesë e pajisjes), i cili përbën elementin thelbësor të shpikjes së mbrojtur⁵⁵⁹. Kjo do të thotë se e drejta e patentës, me të cilën mbrohet shpikja, mund të përdoret në bazë të kontratës së licencës, por jo pa pëlqimin e pronarit të patentës. Mirëpo, LP i Kosovës njuh edhe raste kur mund të përdoret shpikja pa pëlqimin e pronarit të patentës gjithmonë me shpërblim, p.sh., titullari i patentës nuk mund të ndalojë prodhimin e ndonjë ilaçi të zbuluar nga ai.

Në këtë rast bëhet fjalë për licencën e detyrueshme⁵⁶⁰ dhe jo për licencën e kontraktuar, që është objekt i këtij neni. Lidhur me shpikjen (zbulimin) thuhet se ajo paraqet një zgjidhje të re të ndonjë problemi teknik, që është rezultat i punës krijuese që teknikisht është i realizueshëm dhe mund të zbatohet në industri ose në ndonjë veprimtari tjetër⁵⁶¹ dhe se bartësi i të drejtës së patentës ka të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të shpikjes së mbrojtur, që do të thotë se ka të drejtë t'i përjashtojë të tretët nga shfrytëzimi i patentës, pa lejimin nga ai, mirëpo nëse bartësi i të drejtës së patentës nuk e shfrytëzon vetë shpikjen e patentuar, mundet që të drejtën e shfrytëzimit në tërësi ose pjesërisht t'ia kalojë atë një tjetri me kontratë të licencës⁵⁶². Zbuluesi i shpikjes së mbrojtur me patentë gëzon të drejta materiale dhe morale në krijimtarinë e tij⁵⁶³. Shpikja paraqet një risi, e cila nuk ka ekzistuar në të kaluarën dhe zbatimi i saj është i aplikueshëm në industri dhe në veprimtari të tjera ekonomike dhe kjo e drejtë, që ne e quajmë pronësi industriale, i takon shpikësit dhe i jep të drejtë atij që me kontratë për licencën ta vërë në funksionim përdorimin e saj nga personat që e fitojnë këtë të drejtë në bazë të kontratës për licencën, gjithmonë në kushtet e parashikuara me ligj.

700 (b). Dituria teknike dhe përvoja⁵⁶⁴. – Gjithashtu mund të jetë objekt i kontratës së licencës. Edhe dituria teknike mund të jetë e natyrës teknologjike ose e natyrës së organizimit të veprimtarisë. Know-How (dija dhe përvoja), në kuptimin e ngushtë, nënkupton zbatimin e diturisë teknike, metodat dhe shënimet e nevojshme për realizimin praktik dhe zbatimin e teknikës që shërben për qëllim industrial dhe këto janë të gjitha dituri dhe përvoja që nuk

559 LP i Kosovës, neni 23, paragrafi 2.

560 LP i Kosovës, neni 35, paragrafi 2, ku thuhet “Procedura për dhënien e licencës së detyrueshme bëhet me proces gjyqësor kundër pronarit të patentës ose mbajtësit të certifikatës suplementare, në bazë të një aplikimi për dhënien e licencës së detyrueshme. Gjatë procesit gjyqësor, paditësi çekë të gjitha faktet dhe paraqet dëshmitë e nevojshme në të cilat bazohet kërkesa për licencë të detyrueshme. Gjykata vendos për dhënien e licencës së detyrueshme me vendim”.

561 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1041.

562 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1041.

563 Čavdar, Kiril, Zakon za Obligacionite Odnosi – Komentari, objasnivanja, praktika i predmeten registar, Shkup, 2001, fq. 891.

564 LMD i Kosovës, përdorë fjalët “dituri teknike dhe përvojë” këto dy shprehje janë shumë të afërta me përmbajtjen e kuptimit që ka Know-How.

mund të lajmërohen për fitimin e patentës, por me të cilat duhet të udhëhiqemi që të zbatohet shpikja e zbuluar, përkatësisht teknologjia e re⁵⁶⁵. Shprehja Know-How është një shprehje me prejardhje nga gjuha angleze dhe në përkthim do të thotë “Të dihet se si” dhe qëllimi i saj që ka të bëjë me atë se duhet të dihet se si duhet të bëhet diçka dhe sot paraqet një kuptim integruar që, në konceptin teknik dhe të veprimtarisë qarkulluese, fiton një kuptim kompleks⁵⁶⁶. Objekt i kontratës së licencës është edhe dituria teknike, përkatësisht përvoja e cila, si e tillë, paraqitet edhe si objekt i kontratës Know-How, prandaj shpeshëherë, lidhur me diturinë dhe përvojën, ndodh një ngatërrim midis objektit të kontratës së licencës dhe kontratës Know-How. Dituria teknike mund të kuptohet edhe si përparimi teknik që është objekt i së drejtës së pronësisë industriale, që nënkupton zgjidhjen teknike të realizuar, duke zbatuar në mënyrë racionale mjetet e njohura teknike dhe procedurën teknologjike, me të cilën rritet prodhimi i punës, përmirësohet cilësia e prodhimit, kursehet materiali dhe energjia, më mirë shfrytëzohen makinat dhe instalimet, përmirësohet kujdesi i mbrojtjes në punë⁵⁶⁷.

700 (c). Damka. – Në Kosovë është nxjerrë Ligji për Markat Tregtare⁵⁶⁸, i cili në vend të fjalës “damka”, përdorë shprehjen “markat tregtare” dhe shprehimisht parashikon se “markë tregtare mund të jetë çdo shenjë, e cila mund të paraqitet grafikisht, në veçanti fjalët, përfshirë edhe emrat personal, skicimet, shkronjat, numrat, formën e mallrave apo paketimin e tyre, ngjyrat si dhe kombinimi i gjitha këtyre me kusht që shenjat e tilla të mund të dallojnë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve tjera”⁵⁶⁹ përkatësisht ajo që përbëhet prej shkronjave karakteristike, përkatësisht vizatimeve ose kombinimeve të tyre dhe vihet mbi produktin me qëllim të shënimit se ai produkt ka kualitetin përkatës. Marka tregtare, sipas rregullit, duhet të jetë unike për tërë territorin e shtetit.

Në literaturën juridike gjithashtu thuhet se me damkë të mallit nënkuptohet shenja që përdoret në qarkullimin juridiko-ekonomik për vendosjen në produkte me qëllim të dallimit të produkteve nga njëri prodhues te prodhuesi tjetër⁵⁷⁰. Damka është çdo shenjë e mbrojtur që mund të shprehet në mënyrë grafike, që është e përshtatshme për dallimin e produktit ose shërbimit të një ndërmarrësi nga prodhimi ose shërbimi i ndërmarrësit tjetër⁵⁷¹. Përkatësisht, me damkë nënkuptojmë shenjat e mbrojtura, posaçërisht fjalët, (duke përfshirë emrat e personave, vizatimet, shkronjat, numrat, formën e prodhimit ose paketimin e tyre, format 3D, ngjyrat, si dhe kombinimet e të gjitha shenjave të përmendura)⁵⁷².

565 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1042.

566 Ćavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 893.

567 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1042.

568 Ligji Nr.04/L-026 për Markat Tregtare i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.10, datë 24.08.2011.

569 LMT i Kosovës, neni 5.

570 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, Komentar Zakona o Obligationim Odosima, Knjiga Druga, Beograd, 1995, fq. 686.

571 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 699.

572 Po aty.

700 (d). Mostra. – Është fotografi apo vizatim i cili si dukje mund të bartet në produktin industrial apo zejtar dhe që gëzon mbrojtje juridike⁵⁷³. Në literaturën juridike thuhet se mostra mbron fotografinë apo vizatimin e ri, i cili mund të bartet te një produkt i caktuar industrial apo zejtar, përkatësisht te një pjesë e tij⁵⁷⁴.

700 (e). Modeli. – Është trupi që paraqet prodhimin industrial ose zejtar, i cili juridikisht është i mbrojtur. Në literaturën juridike thuhet se me model mbrohet forma e jashtme e re e produktit të caktuar industrial apo zejtar përkatësisht e pjesës së tij⁵⁷⁵.

Neni 701. Forma

Kontrata për licencën duhet të lidhet në formën me shkrim.

701. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 701, përcakton se kontrata për licencën është e karakterit formal, gjë që nënkupton se, nëse nuk respektohet forma e parashikuar për kontratën e licencës, ajo konsiderohet e pavlefshme. Neni 701 i LMD të Kosovës parashikon se kontrata e licencës duhet të bëhet me shkrim dhe forma literale e saj është element esencial i vlefshmërisë së kësaj kontrate. Në këtë nen kërkohet vetëm forma me shkrim për lidhjen e kontratës së licencës, por nuk parashikohet se a duhet të vërtetohen nënshkrimet nga ana e noterit ose nga një organ tjetër kompetent, kështu që sipas kësaj del se është e mjaftueshme vetëm lidhja e kontratës në formën me shkrim dhe nuk kërkohet vërtetimi i nënshkrimeve të palëve. Forma me shkrim e kontratës së licencës imponohet për shkak të rëndësisë që kanë këto kontrata dhe sigurisë juridike, kur bëhet bartja e licencës përkatësisht kur lejohet përdorimi i patentës. Forma me shkrim e kontratës për licencën në literaturën juridike konsiderohet se ajo ka rëndësi konstitutive, përkatësisht forma e kontratës për licencën paraqet element thelbësor të saj⁵⁷⁶. Forma e kontratës për licencën duhet të jetë me shkrim, për shkak se ajo duhet të përmbajë kohëzgjatjen e licencës, vëllimin, sasinë e shpërblimit për shfrytëzimin e licencës, të drejtën ekskluzive, kufizimin territorial të së drejtës së shfrytëzimit⁵⁷⁷.

Neni 702. Kohëzgjatja e licencës

Licenca për shfrytëzimin e shpikjes së patentuar, të mostrës ose të modelit nuk mund të kontraktohet për një kohë më të gjatë se sa kohëzgjatja e mbrojtjes ligjore të këtyre të drejtave.

702. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 702 i LMD të Kosovës përcakton kohëzgjatjen e licencës, që nënkupton licencën për shfrytëzimin e shpikjes së patentuar, të mostrës ose të

573 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 467.

574 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 891.

575 Po aty.

576 Po aty, fq. 896.

577 Shih: LMD i Kosovës, neni 702-704, dhe komentini e këtyre neneve.

modelit. Neni 70 përcakton se ky lloj i licencës nuk mund të kontraktohet për një kohë më të gjatë sesa kohëzgjatja e mbrojtjes ligjore të këtyre të drejtave. Pra, shfrytëzimi i shpikjes së patentuar mund të kalojë nga shpikësi i patentuar te marrësi i licencës vetëm për kohën sa zgjatë e drejta e shpikjes së patentuar, përkatësisht e mostrës apo modelit. Nëse kalon kohëzgjatja e mbrojtjes ligjore të këtyre të drejtave, është e pavlefshme një kohëzgjatja më e madhe e parashikuar me kontratën për licencën.

Kohëzgjatja e patentës caktohet me Ligjin për Patentat të Republikës së Kosovës⁵⁷⁸, i cili parashikon kohëzgjatjen e patentës që është njëzet (20) vite, nga data e dorëzimit të aplikacionit⁵⁷⁹. Ndërkaq, markat tregtare regjistrohen për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, nga data e paraqitjes së aplikimit. Regjistrimet mund të vazhdojnë për periudha shtesë prej dhjetë (10) vitesh⁵⁸⁰. Kjo dispozitë ligjore është mjaft e qartë, sepse kontrata për licencën mund të ketë për objekt vetëm shpikjen e patentuar, mostrën ose modelin, që gëzojnë mbrojtje juridike. Kur këtyre u kalon afati i mbrojtjes juridike, ato nuk mund të jenë më objekt i asnjë kontrate dhe as i kontratës së licencës. Kohëzgjatja e licencës duhet të parashikohet në kontratën për licencën, e cila autorizon marrësin e licencës për shfrytëzimin e shpikjes së patentuar, të mostrës ose të modelit. Kohëzgjatja e licencës, duhet të përputhet me kohëzgjatjen e mbrojtjes ligjore të shpikjes së patentuar, të mostrës ose të modelit. Kohëzgjatja e licencës për shfrytëzimin e shpikjes së patentuar, të mostrës ose të modelit, mund të jetë për një kohë të caktuar, por jo më gjatë sesa është kohëzgjatja e mbrojtjes ligjore të shpikjes së patentuar, të mostrës ose të modelit.

Neni 703. Licenca ekskluzive

- 1. Me kontratën për licencën fituesi i licencës fiton të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të objektit të licencës, vetëm në qoftë se kjo është kontraktuar shprehimisht (licenca ekskluzive).**
- 2. Mundësitë e tjera të shfrytëzimit të objektit të licencës i mban dhënësi i licencës.**
- 3. Në qoftë se në kontratën për licencën nuk është shënuar se për çfarë licence është fjala, konsiderohet se është dhënë licenca jo ekskluzive.**

703. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 703 përcakton licencën ekskluzive dhe shprehimisht parashikon se fituesi i licencës do ta fitojë të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të objektit të licencës, në qoftë se me kontratën për licencën është kontraktuar shprehimisht licenca ekskluzive.

578 Ligji Nr.04/L-029 për Patentat i Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.12, datë 29.08.2011 (këtu e tutje LP i Kosovës).

579 LP i Kosovës, neni 82.

580 Ligji Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare i Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.10, datë 24.08.2011 (këtu e tutje LMT i Kosovës), neni 45.

703.1. Paragrafi 1 përcakton se licenca ekskluzive nënkupton të drejtën e fituesit të licencës që vetëm ai mund të shfrytëzojë shpikjen e patentuar, përkatësisht mostrën apo modelin. Në qoftë se bartësi i licencës shfrytëzimin e shpikjes së patentuar, mostrës apo modelit, ua ka lënë më shumë personave, të cilët kanë të drejtë t'i përdorin ato të drejta, atëherë bëhet fjalë për licencë joekskluzive.

E drejta ekskluzive e licencës i përjashton personat e tretë në përdorimin e objektit të licencës ekskluzive. Licenca ekskluzive duhet të jetë patjetër e kontraktuar shprehimisht, sepse thuhet se, kur nuk është parashikuar në kontratë se për cilin lloj të licencës bëhet fjalë, konsiderohet se atëherë kemi të bëjmë me licencë joekskluzive⁵⁸¹.

703.2. Paragrafi 2 përcakton se dhënësi i licencës mund të rezervojë mundësi të tjera për shfrytëzimin e objektit të licencës për vete, në qoftë se ato nuk janë përfshirë me të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të objektit të licencës. Shfrytëzimi i shpikjes së patentuar mund të bëhet në mënyra të ndryshme, prandaj është e mundur që për njërin nga mënyrat e shfrytëzimit të shpikjes së patentuar të jepet licenca ekskluzive, pra jo për të gjitha mënyrat e shfrytëzimit të shpikjes së patentuar.

703.3. Paragrafi 3 përmban dispozitën e cila obligon që, për ekzistimin e licencës ekskluzive, ajo duhet të bëhet shprehimisht në kontratë, përndryshe, në qoftë se në kontratën për licencën nuk është shënuar se për çfarë licence është fjala, pra kur nuk është përcaktuar lloji i licencës, atëherë kjo shkon në favor të dhënësit të licencës dhe për këtë arsye konsiderohet se është dhënë licenca joekskluzive. Në këtë rast, dhënësi i licencës ka të drejtë që t'ua kalojë atë edhe personave të tjerë, si licencë joekskluzive.

Neni 704. Kufizimi territorial i të drejtës së shfrytëzimit

- 1. E drejta e shfrytëzimit të objektit të licencës mund të kufizohet territorialisht vetëm në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me dispozitat imperative dhe dispozitat tjera për qarkullimin e mallit dhe shërbimeve.**
- 2. Në qoftë se me kontratën për licencën territorialisht nuk është kufizuar e drejta e shfrytëzimit të objektit të licencës, konsiderohet se licenca territorialisht është e pakufizuar**

704. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 704 rregullon shfrytëzimin e objektit të licencës në aspektin territorial. Licenca për shfrytëzimin e shpikjes së patentuar, mostrës ose modelit, shtrihet në territorin të cilin dhënësi i licencës e ka caktuar në kontratë.

704.1. Paragrafi 1 përcakton shprehimisht se e drejta e shfrytëzimit të objektit të licencës, në parim, është e pakufizuar për nga territori dhe, si përjashtim, dhënësi i licencës mund ta

⁵⁸¹ Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 898.

kufizojë të drejtën e shfrytëzimit të licencës territorialisht, vetëm në rastet kur ky kufizim nuk është në kundërshtim me dispozitat r detyrueshme dhe me dispozitat e tjera për qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve.

Kufizimi i shfrytëzimit të objektit të licencës në aspektin territorial gjen shprehje sidomos kur bëhet fjalë për kontratat ndërkombëtare për licencën, sepse në këto raste marrësit të licencës i caktohet territori ose territoret ku mund të realizohet shfrytëzimi i shpikjes së patentuar, mostrës ose modelit. Nëse normat imperative nuk lejojnë kufizimin territorial të licencës, atëherë dhënësi i licencës nuk mund ta kufizojë territorialisht licencën dhe, nëse e bën këtë, ajo konsiderohet e pavlefshme.

704.2. Paragrafi 2 përcakton rastin se si do të veprohet kur me kontratën për licencën nuk është kufizuar territorialisht e drejta e shfrytëzimit të objektit të licencës. Dispozita parashikon shprehimisht se në këtë rast licenca konsiderohet territorialisht e pakufizuar. Andaj dhënësi i licencës duhet të parashikojë në kontratë shprehimisht se bëhet fjalë për licencë të kufizuar territorialisht, përndryshe ajo konsiderohet licencë territorialisht e pakufizuar. Kur bëhet fjalë për licencën territorialisht të pakufizuar, duhet të kemi parasysh se me këtë dispozitë kihet parasysh shtrirja territorialisht e licencës në hapësirën ku gëzon mbrojtje juridike shpikja e patentuar, mostra ose modeli.

KREU 2

DETYRIMET E DHËNËSIT TË LICENCËS

Neni 705. Dorëzimi i objektit të licencës

- 1. Dhënësi i licencës ka për detyrë që fituesit të licencës t'i dorëzojë brenda afatit të caktuar objektin e licencës.**
- 2. Dhënësi i licencës ka për detyrë që fituesit të licencës t'i dorëzojë edhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për zbatimin praktik të objektit të licencës.**

705. *Vështrim i përgjithshëm.*- Nenet 705, 706, 706, 707, 708 dhe 709 janë pjesë e kreut të dytë të pjesës së dymbëdhjetë të LMD të Kosovës, që rregullojnë detyrimet e dhënësit të licencës, siç janë: dorëzimi i objektit të licencës, dhënia e udhëzimeve dhe njoftimeve, detyrimi i garantimit, përgjegjësia për të metat juridike dhe dorëzimi i dhënësit të licencës ekskluzive. Neni 705 përmban dispozita lidhur me dorëzimin e objektit të licencës, si detyrim i dhënësit të licencës.

705.1. Paragrafi 1 përcakton detyrimin e dhënësit të licencës që fituesit të licencës t'ia dorëzojë objektin e licencës brenda afatit të caktuar. Afati brenda të cilit duhet të bëhet dorëzimi i objektit të licencës nga ana e dhënësit të saj te fituesi i licencës duhet të përcaktohet me kontratën për dhënien e licencës dhe kjo, në fakt, nënkupton njoftimin e

përmbajtjes së licencës, kurse se si do të bëhet kjo është një çështje për të cilën palët merren vesh. Në qoftë se dhënësi i licencës dhe fituesi i licencës nuk janë marrë vesh për afatin e dorëzimit të objektit të licencës, kjo nënkupton afatin që është i arsyeshëm për llojin e licencës. Pra, nuk mundet që dhënësi i licencës të mos e kryejë detyrimin që fituesit të licencës t'ia dorëzojë brenda afatit të caktuar objektin e licencës.

Në literaturën juridike thuhet se, në shumicën e rasteve, nuk bëhet fjalë për dorëzimin fizik të objektit të licencës, por për një mori veprimesh, të cilat fituesit të licencës i mundësojnë që ta marrë dhe ta shfrytëzojë objektin e licencës⁵⁸². Paragrafi 1 i këtij neni, i cili parashikon detyrimin e dorëzimit të objektit të licencës në afatin e caktuar, në fakt, thuhet se është një rregull jo mjaft e qartë⁵⁸³ dhe se, kur afati i dorëzimit të objektit të licencës nuk është caktuar me kontratë, atëherë detyrimi i dhënësit të licencës quhet i arritur menjëherë pas lidhjes së kontratës së licencës⁵⁸⁴. Objekti i licencës duhet të dorëzohet nga dhënësi i licencës te fituesi i saj më së voni nga momenti i paraqitjes së kërkesës së fituesit të licencës që dhënësi i licencës t'ia dorëzojë objektin e licencës.

705.2. Paragrafi 2 përcakton detyrimin e dhënësit të licencës që fituesit të licencës t'ia dorëzojë jo vetëm objektin e licencës, që parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, por edhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për zbatimin, përkatësisht për shfrytëzimin praktik të objektit të licencës. Dorëzimi i dokumentacionit teknik të nevojshëm për zbatimin praktik të objektit të licencës nënkupton që fituesi i licencës të mos ketë kurrfarë pengesash në shfrytëzimin e objektit të licencës, përkatësisht shfrytëzimi i licencës të jetë i plotë, ashtu siç është parashikuar në kontratë.

Në këtë mënyrë realizohet edhe kuptimi i licencës. Në literaturën juridike thuhet se, kur objekti i licencës mund të shfrytëzohet edhe pa dokumentin teknik, dhënësi i licencës nuk do të kishte për detyrim që fituesit të licencës t'ia dorëzonte edhe dokumentin teknik⁵⁸⁵. Dokumentacioni teknik që nevojitet për shfrytëzimin praktik të objektit të licencës, gjithmonë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e objektit të saj, sepse do të ishte e pakuptimtë kontrata për dhënien e licencës, në qoftë se ndodh dorëzimi i objektit të licencës, i cili nuk mund të shfrytëzohet për shkak të mungesës së dokumentacionit teknik.

Neni 706. Dhënia e udhëzimeve dhe njoftimeve

Dhënësi i licencës ka për detyrë që fituesit të licencës t'ia jap edhe të gjitha udhëzimet dhe njoftimet që janë të nevojshëm për zbatimin, shfrytëzimin e suksesshëm të objektit të licencës.

706. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 706 është një dispozitë plotësuese, që ndihmon shfrytëzimin e suksesshëm të objektit të licencës dhe parashikon detyrimin e dhënësit të

582 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 900.

583 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 476.

584 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 476.

585 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 476.

licencës që, me qëllim të lehtësimit të shfrytëzimit të suksesshëm të objektit të licencës, fituesit të licencës t'ia ofrojë edhe të gjitha udhëzimet dhe njoftimet që janë të nevojshme për zbatimin, shfrytëzimin e suksesshëm të objektit të licencës.

Dhënësi i licencës ka për detyrim t'ia japë fituesit të licencës ato udhëzime dhe njoftime që i posedon vetë. Mosdhënia e udhëzimeve dhe njoftimeve që janë të nevojshme për zbatimin, shfrytëzimin e suksesshëm të objektit të licencës, e bëjnë të pamundur ose e vështirësojnë shumë shfrytëzimin e objektit të licencës dhe, në këtë mënyrë, edhe qëllimi i kontratës së licencës nuk mund të realizohet në pajtim me vullnetin e palëve të kontratës së licencës. Se cilat janë udhëzimet dhe njoftimet që mundësojnë zbatimin dhe shfrytëzimin e suksesshëm të objektit të licencës, është një çështje faktike që, në rend të parë, varet nga lloji i objektit të licencës. Me kontratën për dhënie të licencës, palët kontraktuese mund të parashikojnë edhe detyrime të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin e suksesshëm të objektit të licencës, p.sh., trajnimin e personave të fituesit të licencës, të cilët do të mund ta shfrytëzonin në mënyrë më të suksesshme objektin e licencës të cilin dhënësi i licencës ia ka dorëzuar fituesit të licencës.

Neni 707. Detyrimi i garantimit

Dhënësi i licencës i garanton fituesit të licencës zbatueshmërinë dhe përdorshmërinë teknike të objektit të licencës.

707. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 707 përcakton detyrimin e garantimit lidhur me zbatueshmërinë dhe përdorshmërinë teknike të objektit të licencës. Neni 707 kërkon nga dhënësi i licencës që t'ia garantojë fituesit të licencës se objekti i licencës është i zbatueshëm dhe teknikisht i përdorshëm, përndryshe, nëse mungon zbatueshmëria dhe përdorshmëria teknike e objektit të licencës, atëherë do të konsiderohet se ai është dhënë me të meta fizike. Në literaturën juridike thuhet se dispozita e nenit 707 duhet të interpretohet në kuptimin e garantimit të dhënësit të licencës, fituesit të licencës, për zbatueshmërinë teknike dhe përdorshmërinë teknike të objektit të licencës⁵⁸⁶.

Garantimi i zbatueshmërisë dhe përdorshmërisë teknike të objektit të licencës duhet të parashikohet me vetë kontratën e licencës dhe atëherë është e qartë se për çfarë shkalle të garantimit të zbatueshmërisë dhe përdorshmërisë teknike të objektit të licencës bëhet fjalë. Përndryshe, garantimi i zbatueshmërisë dhe përdorshmërisë teknike të objektit të licencës do të duhet të përcaktohet në bazë të rrethanave që zakonisht kërkohen për zbatueshmërinë teknike dhe përdorshmërinë teknike të objektit të licencës. Kjo është e varur nga lloji i objektit të licencës. Në literaturën juridike thuhet se në këto raste do të zbatohen zakonet afariste, standardet teknike, zgjidhjet teknike dhe teknologjike ekzistuese, të cilat janë në përdorim⁵⁸⁷. Dhënësi i licencës ka për detyrim që fituesit të licencës t'ia garantojë përherë se

586 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 477.

587 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 478.

objekti i licencës i përmban të gjitha cilësitë që kërkohen për një objekt të tillë, mbi të cilin ekziston e drejta e shfrytëzimit.

Neni 708. Përgjegjësia për të metat juridike

- 1. Dhënësi i licencës garanton se e drejta e shfrytëzimit që është objekt i kontratës t'i takojë atij, se në të nuk ka barrë dhe se nuk është i kufizuar në dobi të personit të tretë.**
- 2. Në qoftë se objekti i licencës është licenca ekskluzive, dhënësi i licencës garanton, se të drejtën e shfrytëzimit nuk ia ka bartur tjetrit as tërësisht as pjesërisht.**
- 3. Dhënësi i licencës ka për detyrë ta ruajë dhe ta mbrojë të drejtën e bartur fituesit të licencës nga të gjitha pretendimet e personave të tretë.**

708. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 708 përmban dispozitën e cila kërkon nga dhënësi i licencës që objekti i licencës të mos ketë të meta juridike, sepse në rast të ekzistimit të tyre lind përgjegjësia për të metat juridike. E metë juridike do të ishte rasti kur dhënësi i licencës nuk ka të drejtë të bëjë bartjen e licencës ose ai vetë nuk është titullar i pronësisë industriale apo i licencës, kur bëhet fjalë për nënlicenca. Objekti i licencës jo vetëm që duhet të zbatohet dhe të përdoret teknikisht, por kërkohet që edhe mos të pengohet shfrytëzimi i lirë i objektit të licencës. Përgjegjësia për të metat juridike, por edhe garancitë e tjera lidhur me objektin e licencës, parimisht përcaktohen me kontratën për licencën dhe kjo nënkupton se edhe kur nuk është parashikuar me kontratë, duhet të sigurohet një minimum i garancionisë për të metat juridike të objektit të licencës. Neni 708 numëron rastet që konsiderohen detyrime për sigurimin nga të metat juridike të objektit të licencës. Këto janë detyrime të dhënësit të licencës.

708.1. Paragrafi 1 përcakton se dhënësi i licencës ka për detyrim të garantojë se e drejta e shfrytëzimit, që është objekt i kontratës së licencës, i takon atij, pra fituesit dhe se në këtë objekt të licencës nuk ekziston ndonjë barrë, domethënë ndonjë e drejtë e personave të tretë dhe se nuk është e kufizuar në dobi të personit të tretë. Paragrafi 1 kërkon nga dhënësi i licencës që të garantojë se ai është zbuluesi i objektit të licencës ose bartësi i të drejtës së zbulimit, përkatësisht se i takon atij e drejta e formave të tjera të pronësisë industriale, shfrytëzimi i të cilave është objekt i kontratës së licencës, me të cilën këto të drejta i kalohen fituesit të saj.

Dhënësi i licencës garanton se në objektin e licencës nuk ekziston ndonjë barrë që do të thotë ndonjë e drejtë e personave të tretë përkatësisht se objekti i licencës nuk është i ngarkuar me barrë sendore, siç do të ishte rasti kur ekziston e drejta e pengut mbi objektin e licencës. Garantimi për të metat juridike të objektit të licencës nënkupton se ai nuk është i ngarkuar me kurrfarë kufizimesh dhe se në këtë rast objekti i licencës shfrytëzohet nga fituesi i saj në mënyrën absolute. Mirëpo, nëse eventualisht ekzistojnë të meta juridike, ndërsa fituesi i licencës ka qenë në dijeni për to, atëherë ai lirohet nga përgjegjësia për

të metat juridike të objektit të licencës. Dhënësi i licencës përgjigjet në çdo kohë për të metat juridike që kanë ekzistuar në kohën e dhënies së licencës. Dhënësi i licencës me kontratën për licencën nuk e kalon pronësinë mbi të drejtën, por vetëm e bartë të drejtën e shfrytëzimit që, në fakt, konsiderohet objekt i licencës dhe ky mund t'ia kalojë tjetri vetëm ato të drejta që i ka vetë dhe në vëllimin që i ka.

708.2. Paragrafi 2 përcakton se kur bëhet fjalë për licencat ekskluzive, atëherë dhënësi i licencës që ka kontraktuar dhënien e licencës ekskluzive, i garanton fituesit të licencës se të drejtën e shfrytëzimit mbi objektin e licencës nuk ia ka kaluar ndonjë personi tjetër as tërësisht, as pjesërisht. Ky edhe është qëllimi i licencës ekskluzive, pra që t'i përjashtojë të tjerët nga e drejta që ta përdorin objektin e licencës në territorin për të cilin është dhënë ajo ose më gjerë, varësisht prej kontratës së licencës, me të cilën parashikohet shtrirja e shfrytëzimit të objektit të licencës. Fituesi i licencës ekskluzive, mbrojtjen e të drejtave që personat e tretë mos t'ia përdorin licencën e fituar, mund ta bëjë edhe vetë, por kjo nuk do të thotë se e përjashton dhënësin e licencës që të drejtën e licencës së dhënë ta mbrojë vetë kundrejt çdo personi të tretë.

708.3. Paragrafi 3 përmban dispozitën me të cilën përcaktohet se dhënësi i licencës ka detyrim të veçantë që ta ruajë dhe ta mbrojë të drejtën që ia ka kaluar fituesit të licencës nga të gjitha pretendimet e personave të tretë. Në bazë të këtij paragrafi, mbrojtjen e të drejtës së kaluar te fituesi duhet ta bëjë dhënësi i licencës, sepse ky i ka të gjitha provat dhe fituesit të licencës i siguron përdorim të rregullt të objektit të licencës, duke ia ruajtur dhe mbrojtur të drejtën e bartur me licencë nga të gjitha kërkesat eventuale që mund të vijnë nga personat e tretë. Ky është detyrim i secilit dhënës të licencës, sepse bartja e objektit të licencës duhet të jetë pa ngarkesa, p.sh., pa peng, pa shqetësime nga të tjerët.

Nëse dhënësi i licencës nuk e ka njoftuar fituesin e licencës për ndonjë ngarkesë eventuale apo për pretendimet eventuale të personave të tretë, ai jo vetëm që ka për detyrë ta ruajë dhe ta mbrojë të drejtën e bartur te fituesi, por edhe do të përgjigjet, në qoftë se dhënësi i licencës e ka ditur këtë dhe nuk e ka njoftuar fituesin e licencës. Shqetësimin e fituesit të licencës mund ta bëjnë personat e tretë, të cilët paraqesin ndonjë pretendim lidhur me objektin e licencës, të cilin e ka në shfrytëzim fituesi i licencës, të cilin personat e tretë mund ta pengojnë për të mos e realizuar fare ose pjesërisht atë etj. Shqetësimi për ushtrimin e të drejtës së licencës mund të vijë edhe nga dhënësi i licencës, i cili ka për detyrë të mos e pengojë në asnjë mënyrë fituesin e licencës dhe t'i garantojë si për të metat materiale, ashtu edhe për ato juridike. Në këtë rast, vetë fituesi i licencës ka të drejtë të parashtrijë padi për respektimin e kontratës së licencës, në bazë të të cilës është fituar ajo. Në rastet të tjera, e drejta që t'i drejtohet gjykatës i takon dhënësit të licencës. Dhënësi i licencës mund të parashtrijë padi kundër të gjithë personave të tretë, të cilët pretendojnë se kanë ndonjë të drejtë mbi licencën.

Neni 709. Dorëzimi i dhënësit të licencës ekskluzive

Në qoftë se është kontraktuar licenca ekskluzive, dhënësi i licencës nuk mundet në asnjë formë ta shfrytëzojë vet objektin e licencës, as pjesë të veçanta, as t'i besojë ndonjë tjetri në kufijtë e vlefshmërisë territoriale të licencës.

709. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 709 përmban dispozitën me të cilën forcohet pozita e fituesit të licencës ekskluzive. LMD i Kosovës këtë dispozitë e emërton si “dorëzimi i dhënësit të licencës ekskluzive”, që dallon nga LMD i Kroacisë apo LMD i Maqedonisë, të cilat këtë dispozitë e emërtojnë si “detyrimi i dhënësit të licencës ekskluzive”⁵⁸⁸. Mirëpo, përmbajtja e tekstit të kësaj dispozite është e njëjtë edhe në ligjet e përmendura. Neni 709, përcakton shprehimisht se kur kontraktohet licenca ekskluzive, atëherë dhënësi i licencës ka detyrime të veçanta, sipas të cilave, së pari ai nuk mund ta shfrytëzojë vetë, në asnjë formë, objektin e licencës, jo vetëm në tërësi, por as pjesë të veçanta të saj dhe as t’ia besojë ndonjë personi tjetër shfrytëzimin e objektit të licencës në kufijtë e vlefshmërisë territoriale të saj. Kjo nënkupton se kufizimi i tillë, në raport me dhënësin e licencës ekskluzive, vlen vetëm për territorin ku shtrihet vlefshmëria e kontratës së licencës, sepse dhënësi i licencës ekskluzive e ruan gjithmonë të drejtën që edhe vetë ta përdorë zbulimin e vet, por në këtë rast ai vetëm përjashtohet nga territori ku do të shfrytëzohet objekti i licencës ekskluzive.

Me rastin e dhënies së licencës ekskluzive gjithmonë kërkohet që të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e dhënësit të licencës si dhe të drejtat dhe detyrimet e fituesit të licencës. Dispozita e nenit 709 të LMD të Kosovës duket se është e karakterit imperativ, sepse përmban fjalët se dhënësi i licencës nuk mundet në asnjë formë ta shfrytëzojë vetë objektin e licencës madje as në pjesë të veçanta, në kufijtë e vlefshmërisë territoriale të saj. Dhënësi i licencës, me rastin e lidhjes së kontratës për licencën, mund të vendosë nëse do ta japë licencën ekskluzive apo licencën e kufizuar dhe këtu është e drejta e tij që të vendosë se si do të veprojë, por nëse fituesit të licencës ia jep licencën ekskluzive, atëherë ai ka për detyrim që t’i garantojë atij mos përdorimin e saj as nga ai, as nga të tjerët në territorin ku shtrihet e drejta e licencës. Në literaturën juridike thuhet se në bazë të *argumentum a contrario*, jashtë territorit për të cilin vlen kontrata për licencën, dhënësi i saj është i lirë që ta shfrytëzojë vetë objektin e licencës ose shfrytëzimin e saj t’ia besojë ndonjë tjetri⁵⁸⁹. Neni 709 i LMD të Kosovës, që ia ndalon dhënësit të licencës ekskluzive të drejtën që edhe ai në ndonjë formë ta përdorë atë brenda territorit ku vlen kontrata e licencës, duhet shikuar në pajtim me nenin 704 të LMD të Kosovës⁵⁹⁰.

588 LMD i Kroacisë, neni 708; LMD i Maqedonisë, neni 751.

589 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1052.

590 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 704, paragrafi 1, ku thuhet “E drejta e shfrytëzimit të objektit të licencës mund të kufizohet territorialisht vetëm në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me dispozitat imperative dhe dispozitat tjera për qarkullimin e mallit dhe shërbimeve” dhe paragrafi 2 “Në qoftë se me kontratën për licencën territorialisht nuk është kufizuar e drejta e shfrytëzimit të objektit të licencës, konsiderohet se licenca territorialisht është e pakufizuar” – Shih dhe komentnin e këtij neni.

KREU 3

DETYRIMET E FITUESIT TË LICENCËS

Neni 710. Shfrytëzimi i objektit të licencës

Fituesi i licencës ka për detyrë ta shfrytëzojë objektin e licencës në mënyrën e kontraktuar, në vëllimin e kontraktuar dhe në kufijtë e kontraktuar.

710. Vështrim i përgjithshëm.- Kreu 3 i pjesës së njëmbëdhjetë të LMD të Kosovës përmban dispozitat me të cilat përcaktohen detyrimet e fituesit të licencës, të cilat dalin nga kontrata për dhënie e licencës, por edhe nga ligjet me të cilat rregullohet e drejta e licencës. Si detyrime të veçanta të përcaktuara edhe me LMD të Kosovës për fituesin e licencës janë: shfrytëzimi i objektit të licencës, përkatësisht detyrimet që i ka fituesi i licencës gjatë shfrytëzimit të objektit të licencës; shfrytëzimi i perfeksionimeve të mëvonshme bëhet vetëm në bazë të autorizimeve; detyrimi i ruajtjes së objektit të licencës në fshehtësi; detyrimi për ruajtjen e cilësisë së objektit të licencës; detyrimi i të shënuarit të mallit që prodhohet sipas licencës; pagimi i shpërblimit të kontraktuar ndaj dhënësit të licencës; detyrimi i paraqitjes së raportit dhënësit të licencës si dhe detyrimi që të pranojë ndryshimin e shpërblimit të kontraktuar (nenet 710-717).

Neni 710 i LMD të Kosovës përmban dispozitën me të cilën parashikohet se fituesi i licencës ka detyrime lidhur me shfrytëzimin e objektit të licencës. Detyrim i veçantë i shfrytëzuesit të licencës është që shfrytëzimin e objektit të licencës ta bëjë në mënyrën e kontraktuar, pra duhet të respektohet kontrata për dhënie e licencës me rastin e shfrytëzimit të objektit të licencës. Fituesi i licencës, të drejtën e vet duhet ta ushtrojë ashtu siç janë marrë vesh në kontratë dhe në kufijtë e kontraktuar. E drejta e shfrytëzimit të licencës, e fituar në bazë të kontratës për dhënie e licencës, kërkon nga fituesi i licencës që atë ta bëjë vetëm në patjim me kontratën për licencën dhe nuk mund ta shfrytëzojë objektin e licencës sipas dëshirës së vet. Nëse ndodh mosrespektimi i kontratës nga ana e fituesit të licencës, atëherë do të lindë e drejta e dhënësit të licencës që të kërkojë përgjegjësinë e fituesit të licencës për shfrytëzimin e saj në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës. Në literaturën juridike thuhet se në rastet kur fituesi i të drejtës së licencës e shfrytëzon objektin e licencës jashtë mënyrës së kontraktuar, përkatësisht jashtë vëllimit dhe kufijve të kontraktuar, ai e shkel detyrimin e kontraktuar dhe kjo mund të konsiderohet edhe për shkeljen e të drejtës subjektive absolute të pronësisë industriale të dhënësi të licencës, nga e cila është nxjerrë licenca⁵⁹¹. Në marrëdhëniet kontraktuese midis palëve ekzistojnë të drejta dhe detyrime lidhur me objektin e kontratës; e njëjta gjë vlen edhe te kontrata për dhënie e licencës, që do të thotë se si dhënësi i licencës, ashtu edhe fituesi i licencës kanë detyrime të caktuara, të cilat janë të detyruar t'i respektojnë, ndërsa mosrespektimi i detyrimeve që dalin nga marrëdhënia kontraktuese është bazë për të kërkuar përgjegjësinë për mosrespektim të

591 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 905.

kontratës, përkatësisht për mosrespektim të normave ligjore që përcaktojnë detyrimet e dhënësit të licencës dhe detyrimet e fituesit të licencës. Përgjegjësia për mosrespektim të kontratës kërkohet sipas rregullave të parashikuara në LMD të Kosovës, por ajo mund të kërkohet edhe në bazë të një ligji të veçantë si, p.sh., Ligji për Patentat i Kosovës. Zakonisht, këto detyrime duhet të jenë shprehimisht të përcaktuara në vetë kontratën për dhënien e licencës dhe në këtë mënyrë bëhet më i lehtë dallimi i shkeljes së ndonjë detyrimi nga kjo kontratë nga cilado palë.

Neni 711. Shfrytëzimi i përfeksionimeve të mëvonshme

Në qoftë se me kontratë nuk është caktuar ndryshe, fituesi i licencës nuk është i autorizuar të shfrytëzojë përfeksionimet e mëvonshme të objektit të licencës.

711. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 711 i ndalon fituesit të licencës që të shfrytëzojë përsosjet e mëvonshme të objektit të licencës, në qoftë se me kontratë nuk është caktuar ndryshe. Sipas kësaj dispozite, fituesi i licencës nuk ka autorizim a priori që të shfrytëzojë përfeksionimet e mëvonshme të objektit të licencës. Pra, edhe për shfrytëzimin e përfeksionimeve të mëvonshme të objektit të licencës kërkohet leja e dhënësit të licencës, e cila mund të bëhet para se të ndodhë përfeksionimi i mëvonshëm i objektit të kontratës, pra kjo parashikohet në momentin e lidhjes së kontratës për licencën ose dhënësi i licencës me aneks kontrate të mëvonshëm mund t’ia kalojë fituesit të licencës edhe autorizimin që të shfrytëzojë përfeksionimet që janë bërë pas lidhjes së kontratës. Dhënia e autorizimit për shfrytëzimin e përfeksionimeve të mëvonshme të objektit të licencës, e cila nuk është bërë fillimisht në kontratë, nuk nënkupton lidhje të kontratës së re të licencës kur ky autorizim bartet më vonë, por nënkupton thjesht një autorizim shtesë në kuadër të shfrytëzimit të objektit të licencës. Dhënësi i licencës nuk mund të detyrohet që fituesit të licencës t’ia kalojë edhe autorizimin për shfrytëzimin e përfeksionimit të objektit të licencës. LMD i Kroacisë parashikon se autorizimi për shfrytëzimin e përfeksionimeve të mëvonshme të objektit të licencës mund të jetë edhe objekt i ligjit dhe jo vetëm i kontratës. Pra, nëse me ligj parashikohet ndryshe, atëherë fituesi i licencës mund të jetë i autorizuar të shfrytëzojë përfeksionimet e mëvonshme të objektit të licencës⁵⁹². LMD i Maqedonisë, këtë dispozitë e rregullon me nenin 753 dhe është identik me tekstin e nenit 710 të LMD të Kroacisë. Kjo dispozitë shumë qartë përcakton se fituesi i licencës nuk ka të drejtë të shfrytëzojë përfeksionimet e mëvonshme të objektit të licencës, nëse nuk është marrë vesh shprehimisht me rastin e lidhjes së kontratës ose kjo e drejtë nuk parashikohet me ndonjë ligj tjetër të veçantë. Për shfrytëzimin eventual të përfeksionimeve të mëvonshme të objektit të licencës, kur nuk është parashikuar me kontratë, nevojitet autorizim i veçantë nga ana e dhënësit të licencës. Përfeksionimet e mëvonshme për objektin e licencës mund të bëhen zakonisht nga dhënësi i licencës, por ato mund të bëhen edhe nga vetë fituesi i licencës dhe në rastin kur përfeksionimi është rezultat i fituesit të licencës, nuk ka pengesë që ai

⁵⁹² LMD i Kroacisë, neni 710, parashikon se “nëse me ligj ose kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, fituesi i licencës nuk është i autorizuar t’i shfrytëzojë përfeksionimet e mëvonshme të objektit të licencës”.

këto perfeksionime të mëvonshme ta realizojë pa pëlqimin e dhënësit të licencës. Thuhet se është rregull të kontraktohet që palët të marrin detyrim të ndërsjellë që t'i ofrojnë njëri-tjetrit perfeksionimet e mëtutjeshme që mund të ndodhin lidhur me objektin e licencës⁵⁹³. Shfrytëzimi i perfeksionimeve të mëvonshme të objektit të licencës, në rend të parë, janë në të mirën e fituesit të licencës, por gjithsesi edhe në të mirën e dhënësit të licencës, sepse ato vihen në praktikë.

Neni 712. Ruajtja e objektit të licencës në fshehtësi

Në qoftë se objektin e licencës e përbëjnë shpikja e jopatentuar ose dituria dhe eksperiencia teknike e fshehtë, fituesi i licencës ka për detyrë ta ruajë në fshehtësi.

712. Vështrim i përgjithshëm. - Neni 712 përmban dispozitën me të cilën garantohet detyrimi i ruajtjes së objektit të licencës në fshehtësi në disa raste. Kjo dispozitë, kërkon nga fituesi i licencës që të ruajë fshehtësinë për objektin e licencës. Dispozita kërkon shprehimisht ruajtjen e fshehtësisë për disa forma të licencës, përkatësisht parashikon se kur objektin e licencës e përbëjnë shpikja e jopatentuar, pra një shpikje që akoma nuk e ka fituar mbrojtjen me patentë ose dituria dhe eksperiencia e teknike e fshehtë, atëherë fituesi i licencës këtë lloj të objektit të licencës ka për detyrë ta ruajë në fshehtësi. Në këtë rast, norma është e karakterit të detyrueshëm, sepse nuk parashikohet me këtë dispozitë nëse dhënësi i licencës mundet që me kontratë ta heqë detyrimin e ruajtjes së fshehtësisë nga fituesi i licencës. Mirëpo, me që e drejta e pronësisë industriale është e drejtë subjektive absolute, nuk mund të ndalohej që dhënësi i licencës, me gjithë pasojat që mund t'i ketë, ta lirojë fituesin e licencës nga detyrimi i ruajtjes së fshehtësisë qoftë për shpikjen e jopatentuar, qoftë për diturinë dhe eksperiencën teknike të fshehtë. Shpikja e jopatentuar ose dituria dhe eksperiencia teknike e fshehtë konsiderohen objekt i veçantë i licencës dhe nëse nuk ruhet fshehtësia lidhur me t, o dhënësi i licencës mund të ketë pasoja të rënda. Natyrisht, mosrespektimi i kësaj dispozite nga ana e fituesit të licencës krijon bazën jo vetëm të ndërprerjes së licencës, por edhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Ky detyrim i fituesit të licencës ekziston edhe në rastet kur dhënësi i licencës nuk ka kërkuar shprehimisht me kontratë, kjo përbën një obligim ligjor. Kuptimi i nenit 712 në literaturën juridike zgjerohet ashtu që detyra e ruajtjes së fshehtësisë parimisht vlen si për kohëzgjatjen e kontratës, ashtu edhe pas pushimit të kontratës derisa fshehtësia ekziston⁵⁹⁴.

593 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1053.

594 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1053; Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 906, ku thuhet “Ruajtja e fshehtësisë vlen për tërë kohën e zgjatjes së kontratës, madje edhe pas ndërprerjes së kontratës së licencës derisa ajo dijeni dhe eksperiencë nuk bëhet e njohur botërisht”.

Neni 713. Cilësia

1. Në qoftë se me licencë të prodhimit është ceduar edhe licenca e përdorimit të vulës (damkës), fituesi i licencës mund të vejë në qarkullim mallra me këtë vulë (damkë) vetëm në qoftë se cilësia e tyre është e njëjtë si është edhe cilësia e mallit që e prodhon dhënësi i licencës.
2. Marrëveshja e kundërt nuk ka efekt juridik.

713. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 713 rregullon detyrimin e fituesit të licencës kur atij i ka kaluar edhe licenca e përdorimit të vulës (damkës).

713.1. Paragrafi 1 parashikon se në rastet kur dhënësi i licencës, së bashku me licencën e prodhimit e bartë edhe licencën së përdorimit të vulës (damkës), atëherë fituesi i licencës mund të vërë në qarkullim mallra me vulën e ceduar vetëm atëherë kur cilësia e produkteve është e njëjtë si cilësia e mallit që e prodhon dhënësi i licencës. Detyrimi i fituesit të licencës, që të ruajë cilësinë e prodhimit në atë shkallë që e ka edhe malli të cilin e prodhon dhënësi i licencës, siguron mbrojtjen e dhënësit të licencës që një produkt i tillë ta ruajë kualitetin dhe të jetë konkurrent si në tregun ku ai shet mallra të tilla, ashtu edhe në tregun ku vë në qarkullim një produkt të tillë fituesi i licencës.

Dhënia e të drejtës që fituesi i licencës në produktet e bëra në bazë të licencës ta përdorë edhe vulën e dhënësit të licencës, duhet të përcaktohet në kontratë, sepse dhënësi i licencës te fituesi i licencës mund ta kalojë vetëm shfrytëzimin e objektit të licencës, pa dhënie e të drejtës që ta përdorë edhe vulën e dhënësit të licencës në produktin e tij. Vula garanton mallin e kualitetit të njëjtë. Fituesit të licencës vula e dhënësit të licencës i garanton atë sukses në treg të cilin e ka edhe vetë dhënësi i licencës. Ndërkaq, fituesi i licencës ka për detyrim që ta ruajë cilësinë e mallit të prodhuar, sepse ai vihet në qarkullim me vulën e njëjtë të dhënësit të licencës dhe nuk lejohet në treg të ekzistojë një produkt me vulë të njëjtë dhe kualitet të ndryshëm. Konsumatori ka parasysh cilësinë ekzistuese të produktit me vulë të tillë edhe kur malli është nga prodhues të ndryshëm, pra ai konsideron së është kualiteti (cilësia) e njëjtë. Licenca për përdorimin e markës tregtare mund të jepet për disa apo për të gjitha mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar, për tërë apo për një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës dhe licenca mund të jetë ekskluzive dhe joekskluzive⁵⁹⁵.

713.2. Paragrafi 2 përmban dispozitën me të cilën nuk lejohet që palët, përkatësisht dhënësi i licencës dhe fituesi i licencës të lidhin marrëveshje me të cilën mund ta përjashtojnë cilësinë e prodhimit apo cilësia e prodhimit të jetë e ndryshme edhe të përdoret vula (damka) e njëjtë si nga dhënësi i licencës, ashtu edhe nga fituesi i licencës. Në literaturën juridike thuhet se këto dispozita të këtij neni janë të karakterit të detyrueshëm (cogente)⁵⁹⁶. Është e natyrshme që të ndalohet një kontratë ose të konsiderohet e pavlefshme kur ajo shkon

595 LMT i Kosovës, neni 17.

596 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1054.

qëllimisht në dëm të konsumatorëve. E drejta e konsumatorëve është që mallrat me vula të njëjta të kenë cilësinë e njëjtë dhe mos të shkaktohet mashtrimi përmes përdorimit të njëjtë të vulës nga dhënësi i licencës dhe fituesi i licencës në pikëpamje të cilësisë së prodhimit.

Neni 714. Të shënuarit

Fituesi i licencës ka për detyrë që mallin ta shënojë me shënimin për prodhimin sipas licencës.

714. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 714 përcakton detyrimin e fituesit të licencës që mallin ta shënojë me shënimin për prodhimin sipas licencës. Pra, fituesi i licencës nuk mund të vërë në qarkullim produktin pa treguar se ai vihet në qarkullim në bazë të kontratës së licencës. Duhet të dihet kush është dhënësi i licencës dhe cilat janë karakteristikat e produktit që bëhet në bazë të kontratës së licencës. Nëse fituesi i licencës nuk e bën shënimin për prodhimin sipas licencës, atëherë do të duket se fituesi i licencës del në treg si “prodhues origjinal”⁵⁹⁷. Shënimi i mallit se prodhohet sipas licencës është me rëndësi për dhënësin e licencës, sepse ai mund të distancohet nëse kualiteti i mallit të prodhuar sipas licencës dallon nga kualiteti i produktit të dhënësit të licencës⁵⁹⁸.

Shënimi për prodhimin sipas licencës duhet të bëhet në një vend të dukshëm që konsumatori të ketë dijeni se ai produkt nuk është origjinal, por është i prodhuar në bazë të licencës. Shënimi për prodhimin e mallit sipas licencës, edhe pse ky nen parashikon vetëm shënimin e prodhimit të mallit dhe nuk përcakton se si do të bëhet ai, në literaturën juridike thuhet se shënimin për prodhimin e mallit sipas licencës fituesi është i detyruar ta shënojë në mënyrë të shkruar, të qartë dhe të dukshme, ashtu që ai të jetë i padyshimtë dhe i dallueshëm për konsumatorët⁵⁹⁹. Pranimi i origjinalitetit të prodhimit duke shënuar se malli prodhohet sipas licencës, në fakt, e ruan edhe të drejtën e karakterit personal të titullarit të pronësisë industriale.

Neni 715. Shpërblimi

Fituesi i licencës ka për detyrë t’i paguajë dhënësit të licencës shpërblimin e kontraktuar në kohën dhe në mënyrën sikurse është caktuar në kontratë.

715. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 715 përcakton faktin se fituesi i licencës ka për detyrim t’i paguajë dhënësit të licencës shpërblimin e kontraktuar në kohën dhe mënyrën sikurse është caktuar në kontratë. Dihet se e drejta e pronësisë industriale është e karakterit pasuror dhe, si e tillë, ajo mund të kalohet nga një titullar në titullarin tjetër dhe kalimi i së drejtës

597 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1054.

598 Ćavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 907.

599 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1054.

ka të bëjë me komponentin pasuror, andaj fituesi i licencës duhet gjithmonë ta shpërblejë dhënësin e licencës me një shpërblim që është ekuivalent me përfitimet që i nxjerr nga shfrytëzimi i objektit të licencës. Nuk përjashtohet mundësia që dhënia e licencës të bëhet edhe pa shpërblim, por kjo duhet të përcaktohet shprehimisht në kontratë, sepse kur nuk është parashikuar, kjo i jep të drejtë dhënësit të licencës të kërkojë shpërblim në çdo kohë. Qëllimi i dhënies së licencës ë për shfrytëzimin e zbulimit, dëturisë dhe eksperiencës teknike, markës tregtare etj., bëhet me qëllim të përfitimit pasuror dhe shumë rrallë mund të ndodhë dhe kjo për arsye shumë të veçanta që dhënia e licencës të bëhet pa shpërblim. Shpërblimi për dhënien e licencës duhet të kontraktohet dhe, me rastin e kontraktimit, duhet të parashikohet se në çfarë forme do të bëhet shpërblimi, pra a do të jetë në para apo në forma të tjera që shprehen me vlerë pasurore.

Mënyra dhe koha e pagesës janë pjesë përbërëse e çdo kontrate për dhënien e licencës. Shpërblimi për shfrytëzimin e licencës parimisht bëhet vetëm gjatë kohës kur shfrytëzohet licenca. Mirëpo, palët mund të parashikojnë që kohëzgjatja e shpërblimit të licencës të jetë e më e shkurtër ose më e gjatë. Në rastet kur nuk është caktuar afati i pagimit të shpërblimit të caktuar, në literaturën juridike thuhet se dhënësi i licencës fiton të drejtën e shpërblimit të kontraktuar kur e ka përmbushur detyrimin e vet, çka do të thotë se në atë moment kërkesa e tij bëhet e arritshme në aspektin e shpërblimit dhe gjithashtu krijohet edhe detyrimi i fituesit të licencës⁶⁰⁰. Në rast paqartësish lidhur me kohën e pagimit të shpërblimit, përkatësisht me mënyrën e pagimit të shpërblimit, do të respektohen zakonet afariste të vendit ku duhet të kryhet pagimi i shpërblimit⁶⁰¹.

Neni 716. Paraqitja e raportit

Në qoftë se shpërblimi caktohet në varësi nga vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës, fituesi i licencës ka për detyrë t'i paraqesë dhënësit të licencës raportin për vëllimin e shfrytëzimit dhe të bëjë llogarinë e shpërblimit për një (1) vit, në qoftë se me kontratë për këtë nuk është caktuar afati më i shkurtër.

716. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 716 përcakton detyrimin e paraqitjes së raportit të fituesit të licencës lidhur me vëllimin e shfrytëzimit të objektit të licencës. Me këtë dispozitë rregullohet çështja e shpërblimit për shfrytëzimin e objektit të licencës, kur shpërblimi varet nga vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës. Në këtë rast, marrëveshja e shpërblimit është e varur nga vëllimi i shfrytëzimit. Dispozita parashikon se, në rastet kur shpërblimi për shfrytëzimin e objektit të licencës caktohet në vartësi nga vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës, atëherë fituesi i licencës ka për detyrim, sipas ligjit, që dhënësit të licencës t'i paraqesë raport për vëllimin e shfrytëzimit dhe të bëjë llogarinë e shpërblimit për një (1) vit,

600 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 484.

601 Shih: LMD i Kosovës, neni 11, ku thuhet “Doket afariste, uzansat dhe praktika e krijuar ndërmjet palëve duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e sjelljes së kërkuar dhe efekteve të saj në marrëdhëniet e detyrimeve të subjekteve afarist”.

në qoftë se në kontratë për këtë nuk është caktuar një afat më i shkurtër. Fituesi i licencës, i cili shfrytëzon objektin e licencës, duhet të mbajë evidencë të rregullt, pra ai ka librat afariste ku evidencohet sasia e produktit, përkatësisht vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës. Kjo shërben si bazë për të llogaritur shpërblimin për shfrytëzimin e objektit të licencës. Llogaria e shpërblimit bëhet për një vit, kur në kontratë nuk është caktuar ndonjë afat më i shkurtër. Kjo nënkupton se raporti për vëllimin e shfrytëzimit, në bazë të të cilit bëhet llogaritja e shfrytëzimit për një vit, është edhe objekt i kontraktimit me rastin e dhënies së licencës, që do të thotë afati nuk mund të jetë më i gjatë, por mund të jetë më i shkurtër për dhënien e raportit për vëllimin e shfrytëzimit dhe llogarinë e shpërblimit. Detyrimi për paraqitjen e raportit nga ana e fituesit të licencës ekziston gjithmonë në rastet kur është kontraktuar se shpërblimi për shfrytëzimin e licencës caktohet varësisht nga vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës. Kjo do të thotë se sa më shumë shfrytëzohet objekti i licencës, p.sh., sa më shumë që të ketë produkte në bazë të objektit të licencës, aq më i lart është shpërblimi për shfrytëzimin e objektit të licencës. Me kontratën për dhënien e licencës, dhënësi dhe fituesi i licencës duhet të kontraktojnë gjithmonë sasinë e shpërblimit, kur ky varet nga vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës. Pra, kërkohet një kujdes i veçantë se si do të rritet vlera e shpërblimit që varet nga vëllimi i shfrytëzimit të objektit të licencës. Me këtë rast, duhet të përcaktohet në kontratë edhe fakti se si do të krijohet besueshmëria midis dhënësit të licencës dhe fituesit të licencës për të dhënat që i prezanton në raport fituesi i licencës. Këtu mendohet se ato mund të kontraktujnë edhe shikimin e dokumentacionit në çdo kohë ose në mënyrë periodike. Neni 716 parashikon paraqitjen e raportit nga ana e fituesit të licencës për fillimin e shfrytëzimit të objektit të licencës dhe të bëjë llogarinë e shpërblimit për një (1) vit. Mirëpo, këtu nuk është caktuar se në çfarë forme duhet të paraqitet ky raport. Megjithatë, është e qartë se raporti duhet të jetë i përpiluar në formën me shkrim dhe, përveç vëllimit të shfrytëzimit të objektit të licencës, fituesi i licencës do të bëjë edhe llogarinë e shpërblimit për kohën që janë marrë vesh ose për kohën prej një (1) viti që parashikon ky nen dhe raporti, si i tillë, duhet të jetë bindës për dhënësin e licencës, i mbështetur në dokumentacion të saktë, pra kërkohet një raport i saktë dhe i plotë.

Neni 717. Ndryshimi i shpërblimit të kontraktuar

Në qoftë se shpërblimi i kontraktuar është bërë haptazi i papërpjesëtueshëm në krahasim me të ardhurat të cilat fituesi i licencës i ka nga shfrytëzimi i objektit të licencës, pala e interesuar mund të kërkojë ndryshimin e shpërblimit të kontraktuar.

717. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 717 përcakton rastet e ndryshimit të shpërblimit të kontraktuar si pasojë e humbjes së ekuivalencës midis shpërblimit të kontraktuar dhe të ardhurave të fituara nga fituesi i licencës, i cili e ka në shfrytëzim objektin e licencës. Kështu, për shkak të ndërrimit të rrethanave apo interesimit të tregut, mund të ndodhë që fituesi i licencës të krijojë të ardhura nga shfrytëzimi i objektit të licencës në atë masë sa krijon një mospërputhje të dukshëm të vlerave pasurore, pra e prish baraspeshën e vlerave pasurore të kontraktuara. Në këto raste del që shpërblimi është shumë i ulët në

përpjesëtim me të ardhurat që i fiton fituesi i licencës. Dispozita parashikon shprehimisht se, në rastet kur shpërblimi i kontraktuar është bërë qartazi i papërputhshëm me të ardhurat të cilat fituesi i licencës i realizon nga shfrytëzimi i objektit të licencës, p.sh., në rastin e prodhimit të mallit, atëherë pala e interesuar mund të kërkojë ndryshimin e shpërblimit të kontraktuar. Në rastin konkret, ligji nuk përcakton të drejtën për ndryshimin e shpërblimit të kontraktuar në favor të njëjës apo palës tjetër, por përdorë fjalën “pala e interesuar”, por më e drejtë do të ishte “pala e cila ka nevojë për krijimin e baraspeshës midis vlerave të objektit të kontratës”. Kjo dispozitë mbron interesat e të dy palëve kontraktuese – si të dhënësit të licencës, ashtu edhe të fituesit të licencës. Kjo do të thotë se, në rastet kur vlera e kontraktuar është në dëm të dhënësit të licencës, atëherë ai ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kontratës përkatësisht rritjen e shpërblimit për dhënien e objektit të licencës në shfrytëzim. Por, nëse ndodh që fituesi i licencës, fitimin nga shfrytëzimi i licencës ta ketë shumë më të ulët në proporcion me shpërblimin që e jep për shkak të shfrytëzimit të objektit të licencës, ai atëherë ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kontratës, përkatësisht zbritjen e shpërblimit. Në këtë drejtim neni është i paqartë, sepse konsideron se vetëm dhënësi i licencës mund të vijë në pozitën që shpërblimi i kontraktuar të mos jetë në proporcion me të ardhurat të cilat i fiton fituesi i licencës dhe, sipas kësaj, del që fituesi i licencës nuk do të kishte të drejtë të kërkonte ndryshimin e shpërblimit të kontraktuar, pra uljen e shpërblimit, për shkak se shpërblimi është kontraktuar duke i pasur parasysh rrethanat ekzistuese. Kjo rrethanë mund të paraqitet në rastet kur licenca jepet për prodhimin e ndonjë malli që është i panjohur për tregun dhe në këtë rast mundet ose të zvogëlohet fitimi nga shfrytëzimi i objektit të licencës përkatësisht mos të jetë në proporcion me shpërblimin që jepet për të, ose mund të ndodhë që fituesi i licencës nga ky mall të fitojë të ardhura shumë më të larta sesa ato që dhënësi i licencës dhe fituesi i licencës i kanë pasur parasysh në momentin e lidhjes së kontratës. Në literaturën juridike fare nuk është e diskutueshme se kërkesën për ndryshimin e shpërblimit të kontraktuar mund ta bëjnë të dy bashkëkontraktuesit (dhënësi i licencës dhe fituesi i licencës)⁶⁰². Baza e këtij neni, me të cilin përcaktohet ndryshimi i shpërblimit të kontraktuar mbështetet në nenin 7 të LMD të Kosovës, i cili përmban parimin e baraspeshës së prestimeve⁶⁰³. Duhet theksuar se ndryshimi i shpërblimit të kontraktuar për shkak të krijimit të pabarazisë midis shpërblimit për dhënie e licencës dhe të ardhurave nga shfrytëzimi i objektit të licencës nga fituesi i licencës, vjen për shkak se është rritur në mënyrë të dukshme fitimi për njëjës palë dhe ka humbur barasvlera (ekuivalenca) midis shpërblimit dhe fitimit, por kurrsesi nuk bëhet fjalë në këtë rast për klauzolën *Rebus sic Stantibus*, edhe pse ka autorë që mendojnë se bëhet fjalë për këtë rregull. Për shkak se klauzola *Rebus sic Stantibus* është e përgjithshme dhe vlen për të gjitha marrëdhëniet detyimore, kur palët nuk mund ta përmbushin detyrimin për shkak të rrethanave të ndryshuara ose vështirësohet aq shumë përmbushja e detyrimit sa bëhet

602 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1056; Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 485; Ćavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 908.

603 Shih: LMD i Kosovës, neni 7, paragrafi 1, ku thuhet “Në krijimin e kontratave me shpërblim, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënies reciproke” dhe paragrafi 2 “Me ligj përcaktohet se në cilat raste prishja e këtij parimi krijon pasojë juridike”.

e pakuptimtë një përmbushje e tillë⁶⁰⁴, ndërsa ndryshimi i shpërblimit të kontraktuar i parashikuar në këtë nen ka të bëjë vetëm me rastin e kontratave për dhënien e licencës të cilat, në fakt, më së shumti mbrohet dhënësi i licencës, por nuk mund t'i mohohet as e drejta e fituesit të licencës, kur ka mospërputhje midis shpërblimit dhe fitimit. Në literaturën juridike konsiderohet se zgjidhja që parashikon kjo dispozitë, në fakt, është konkretizim i dispozitës së përgjithshme për ndryshimin e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave (neni 116 i LMD të Kosovës)⁶⁰⁵. Kjo dispozitë krijon një bazë të mirë juridike për ruajtjen e vlerave të objektit të kontratës, çka do të thotë të respektohet parimi i baraspeshës së prestimeve dhe të mos krijohet një gjendje pasigurie për ruajtjen e vlerave ekuivalente të kontratës për dhënien e licencës.

KREU 4 NËNLICENCA

Neni 718. Kur mund të jepet

- 1. Fituesi i licencës ekskluzive mund t'ia bartë tjetrit të drejtën e shfrytëzimit të licencës (nënlicenca).**
- 2. Në kontratë mund të parashikohet se fituesi i licencës nuk mund t'i japë tjetrit nënlicencën ose nuk mund t'ua japë pa lejen e dhënësit të licencës.**

718. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 718, kreu 4 i pjesës së njëmbëdhjetë të LMD të Kosovës rregullon institutin juridik të nënlicencës me dispozitat e neneve 718-725. Nënlicenca nënkupton kontratën me të cilën fituesi i licencës ekskluzive ia kalon të drejtën e shfrytëzimit të licencës një personi tjetër (fituesit të nënlicencës). Kjo kontratë gjithashtu rregullohet në bazë të rregullave të përgjithshme që vlejné për kontratat dhe në veçanti për rregullat e përgjithshme që vlejné për kontratën e licencës. Me këtë ligj përcaktohet se në cilat raste mund të konstituohet e drejta e nënlicencës, përkatësisht e shfrytëzimit të licencës që i ka kaluar fituesit të nënlicencës. Krijimi i nënlicencës është domosdoshmëri në qarkullimin ekonomik, sepse në raste të caktuara dhe për arsye të caktuara dhënësi i licencës mund ta kalojë të drejtën e licencës qoftë për prodhimin e produktit, që është objekt i licencës, qoftë për shfrytëzimin e njohurive që janë objekt i licencës.

604 Shih : LMD i Kosovës, neni 116, paragrafi 1, ku thuhet “Në qoftë se pas lidhjes së kontratës krijohen rrethanat që e vështirësojnë përmbushjen e detyrimit të njërës palë, apo në qoftë se për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës, e si në njërën, ashtu edhe në rastin tjetër në atë masë sa që del e qartë se kontrata nuk i përgjigjet më asaj që është pritur nga palët kontraktuese dhe se sipas vlerësimit të përgjithshëm do të ishte e padrejtë të mbahet në fuqi e tillë siç është, pala të cilës i she vështirësuar përmbushja e detyrimit, përkatësisht pala e cila për shkak të rrethanave të ndryshuara nuk mund ta realizojë qëllimin e kontratës, mund të kërkojë që kontrata të zgjidhet apo të ndryshohet”.

605 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 908; Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1056.

Neni 718 përcakton kushtet në të cilat mund të kalohet e drejta e shfrytëzimit të licencës dhe të ndodhë fitimi i të drejtës së nënlicencës.

718.1. Paragrafi 1 është dispozitë që përcakton se cili fitues i licencës, përkatësisht cili lloj i licencës mund t’i kalohet tjetrit për t’u krijuar e drejta e shfrytëzimit të licencës (nënlicenca) dhe në cilat kushte. Ky paragraf përcakton se të drejtën e bartjes së licencës te personi tjetër e ka vetëm fituesi i licencës ekskluzive. Kjo do të thotë se licenca joekskluzive mund të jetë objekt i nënlicencës vetëm kur është kontraktuar kjo mundësi ose kur leja (pëlqimi) jepet më vonë nga dhënësi i licencës. E drejta e fituesit të licencës që të lidhë kontratë për dhënien e licencës me fituesin e nënlicencës është e drejtë e parashikuar me ligj, nëse licenca është ekskluzive dhe nëse nuk janë marrë vesh ndryshe palët në kontratë. Paragrafi 1 i këtij neni duhet të shikohet i lidhur me paragrafin 2 të këtij neni, sepse me paragrafin 2 sqarohet se në cilat kushte mund të krijohet nënlicenca qoftë ekskluzive, qoftë joekskluzive. LMD i Kroacisë e ka më të qartë këtë dispozitë, sepse parashikon shprehimisht se fituesi i licencës ekskluzive të drejtën e licencës mund t’ia kalojë tjetrit (nënlicencën), nëse me kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, kurse paragrafi 2 përcakton se fituesi i licencës nuk mund ta kalojë nënlicencën pa lejen e dhënësit të licencës⁶⁰⁶. Ndërkaq, LMD i RM përmban një dispozitë të ngjashme me LMD të Kosovës⁶⁰⁷. Shfrytëzuesi i objektit të licencës ekskluzive (fituesi i licencës) me kontratë të veçantë, që nënkupton kontratën e nënlicencës, ia kalon personit tjetër të drejtën e licencës, të cilën e ka fituar nga dhënësi i licencës. Dhënia e licencës në shfrytëzim është çështje kontraktuese dhe si e tillë rregullohet me norma të karakterit dispozitiv, pra dhënësi i licencës, i cili është titullar i të drejtës së pronësisë industriale, me rastin e kalimit, mund ta ndalojë dhënien e licencës në nënlicencë. Kur ky ndalim parashikohet shprehimisht në kontratë, atëherë fituesi i licencës nuk mund të krijojë nënlicencë. Kjo mundësi e tij lejohet me ligj vetëm nëse nuk është ndaluar me kontratën midis dhënësit të licencës dhe fituesit të licencës. Mirëpo, edhe në rastet kur ndalohet dhënia e licencës ekskluzive me kontratë, nuk përjashtohet mundësia që, në bazë të lejes së mëvonshme të dhënësit të licencës ekskluzive, fituesi i licencës të fitojë të drejtën që të lidhë kontratën e nënlicencës me fituesin e nënlicencës, i cili i ka të gjitha të drejtat për shfrytëzimin e nënlicencës, të cilat i njihen dhënësit të licencës. Kalimi i pjesëshëm i të drejtës së licencës te fituesi i nënlicencës nuk parashikohet nga ligjdhënësi, por në qoftë se natyra e shfrytëzimit të licencës është e mundur, nuk ka arsye përse nënlicenca të mos jetë edhe e pjesëshme.

718.2. Paragrafi 2 përcakton se dhënësi i licencës ka të drejtë të kontrakttojë mundësinë që fituesi i licencës t’ia japë tjetrit nënlicencën, përkatësisht mund të parashikojë ndalimin e kalimit të së drejtës së licencës nga fituesi i licencës te fituesi i nënlicencës si dhe mund të rezervojë të drejtën në kontratë se fituesi i licencës nuk mund të krijojë nënlicencë pa lejen e dhënësit të licencës. Pra, është e mundur të parashikohet mundësia e dhënies së nënlicencës, ndalimi i dhënies së nënlicencës ose dhënia e nënlicencës vetëm pasi të sigurohet leja e

606 LMD i Kroacisë, NN. 35/05; 41/08 dhe 125/11, neni 717, paragrafi 1 dhe 2.

607 LMD i RM-së, neni 760, paragrafi 1 dhe 2.

dhënësit të licencës. Mirëpo, ligji parashikon mundësinë se, kur në kontratën për dhënie e licencës ekskluzive nuk është ndaluar dhënia e nënlicencës ose nuk është parashikuar kalimi i licencës pa lejen e dhënësit të licencës, atëherë ligji, edhe pse nuk është lejuar shprehimisht me kontratë dhënia e nënlicencës, e konsideron si një të drejtë ligjore të fituesit të licencës dhënie e nënlicencës. Ky paragraf, kur flet për ndalimin e dhënies së nënlicencës nga fituesi i licencës, nuk bën dallim mes llojeve të licencës, sepse nuk përmend as licencën ekskluzive dhe as licencën joekskluzive. Megjithatë, mund të konkludojmë se dhënësi i licencës mund t'ia ndalojë me kontratë fituesit të licencës të drejtën që t'i japë tjetrit nënlicencën si për licencën ekskluzive, ashtu edhe për licencën joekskluzive ose dhënie e nënlicencës ta kushtëzojë me lejen (pëlqimin) e dhënësit të licencës. Fituesi i licencës, kur duhet të krijojë të drejtën e nënlicencës, nëse ajo nuk është parashikuar në kontratë dhe bëhet fjalë për licencën joekskluzive, atëherë patjetër duhet të kërkojë lejen nga dhënësi i licencës për kalimin e shfrytëzimit të objektit të licencës. Ndërkaq, nëse nuk është ndaluar shprehimisht me kontratë dhënia e shfrytëzimit të licencës ekskluzive një personi tjetër (nënlicenca), atëherë ai nuk ka nevojë për lejen (pëlqimin) e mëvonshëm për dhënie e shfrytëzimit të licencës ekskluzive nga dhënësi i licencës te personi tjetër, sepse ligji, paragrafi 1 i nenit 718, mundëson kalimin pa pëlqimin e dhënësit të licencës, kur nuk është kontraktuar ndalimi i licencës ekskluzive.

Neni 719. Kur dhënësi mund të refuzojë lejen

Kur për dhënie e nënlicencës nevojitet leja e dhënësit të licencës ky mund t'ia refuzojë fituesit të licencës ekskluzive vetëm për shkaqe serioze.

719. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 719 parashikon rastin kur dhënësi i licencës mund të refuzojë lejen për krijimin e nënlicencës nga ana e fituesit të licencës. Kjo dispozitë është në favor të fituesit të licencës, sepse dhënësi i licencës, edhe pse ka të drejtë të mos e japë pëlqimin për dhënie e shfrytëzimit të objektit të licencës një personi tjetër (nënlicenca), dhënësi i licencës këtë mund ta bëjë vetëm për shkaqe serioze. Neni 719, përcakton rastin kur dhënësi i licencës me kontratën për dhënie e licencës fituesit të licencës ka kontraktuar shprehimisht jo ndalimin e dhënies së licencës, por ka kontraktuar faktin se nuk mund të bëhet krijimi i nënlicencës pa lejen e dhënësit të licencës. Kjo do të thotë se dhënësi i licencës, me rastin e kontraktimit të shfrytëzimit të objektit të licencës ekskluzive, ka rezervuar të drejtën që, në rast të dhënies së shfrytëzimit të licencës në nënlicencë, patjetër duhet të sigurohet edhe leja (pëlqimi) i dhënësit të licencës. Ndalimi shprehimisht i dhënies në shfrytëzim të objektit të licencës nga ana e fituesit të licencës, është më i rreptë sesa dhënie e lejes nga dhënësi i licencës në rastin konkret. Në këtë rast, dhënësi i licencës duhet të ketë shumë shkaqe serioze për ta refuzuar të drejtën e fituesit të licencës që ta kalojë te personi tjetër shfrytëzimin e objektit të licencës. Ky nen nuk shtjellon se cilat do të ishin shkaqet serioze, të mjaftueshme për refuzimin e lejes për kalimin e licencës ekskluzive te personi tjetër. Në këtë rast parashtrohet pyetja se kush do të vlerësojë se një rrethanë e tillë, në të cilën mbështetet mosdhënie e lejes për krijimin e nënlicencës është rrethanë serioze

për ta ndaluar dhënien e licencës? Ligji duhet të parashikojë se në këto rrethana fituesi i licencës ekskluzive mund t'i drejtohet gjykatës për të vlerësuar nëse rrethana për të cilën nuk jepet leja për krijimin e nënlicencës nuk është e karakterit serioz, të cilën gjë e kërkon neni 719 i LMD të Kosovës. Gjykata, sipas LMD të Kosovës, nuk ka forcë të nxjerrë vendim detyrues për detyrimin e dhënësit të licencës që t'i japë leje fituesit të licencës ekskluzive që ta kalojë shfrytëzimin e objektit të licencës te persona të tjerë (nënlicenca). Mirëpo, vendimi eventual i gjykatës mund të konstatojë se shkak për refuzimin e kërkesës nuk është serioz dhe ky vendim fituesit të licencës mund t'i mundësojë që, për dëmin eventual që i shkaktohet për shkak të mosdhënies së lejes fituesit të licencës, ta kalojë shfrytëzimin e objektit të licencës te personi tjetër (nënlicenca). Vendimi i gjykatës nuk mund ta ketë fuqinë e lejes për dhënien e të drejtës fituesit të licencës që të lidhë kontratë për nënlicencën, por mund të jetë vetëm bazë për të konstatuar se shkak për të cilën refuzohet dhënia e lejes për lidhjen e kontratës së nënlicencës nuk është i natyrës serioze, të cilën e kërkon neni 719 i LMD të Kosovës. Në këto raste, fituesi i licencës mund të lidhë kontratën e nënlicencës dhe kështu mund të përjashtohet e drejta e dhënësit të licencës që ta denoncojë kontratën për licencën ekskluzive, për shkak se nuk i ka dhënë leje fituesit të licencës për të lidhur kontratë të nënlicencës. Në literaturën juridike, si shkaqe serioze vihen në dukje cilësitë e fituesit të nënlicencës dhe aspekti konkurrues që mund të krijohet me rastin e krijimit të nënlicencës⁶⁰⁸.

Neni 720. Denoncimi për shkak të nënlicencës së palejueshme

Dhënësi i licencës mund të denoncojë kontratën për licencën pa afat denoncimi, në qoftë se nënlicenca është dhënë pa lejen e tij, kur kjo sipas ligjit ose sipas kontratës është e nevojshme.

720. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 720 parashikon mundësinë e denoncimit të kontratës për dhënien e licencës për shkak të nënlicencës së palejueshme. Neni 720 shprehimisht parashikon të drejtën e dhënësit të licencës për ta denoncuar kontratën për licencën si ekskluzive ashtu edhe atë joekskluzive të lidhur midis dhënësit dhe fituesit të licencës, e cila është pa afat denoncues. Kjo e drejtë *ex lege* i takon dhënësit të licencës, kur fituesi i licencës, edhe pse është dashur të ketë leje për krijimin e nënlicencës, lidh kontratë të nënlicencës. Denoncimi i kontratës për dhënien e licencës për shkak të nënlicencës së palejueshme, si pasojë e mosdhënies së lejes nga dhënësi i licencës, kushtëzohet që ligji apo kontrata ta konsiderojë si të nevojshme. Pjesa e dytë e nenit 720, që parashikon se denoncimi do të bëhet “kur kjo sipas ligjit ose sipas kontratës është e nevojshme”, tregon se mosdhënia e lejes për lidhjen e kontratës së nënlicencës nuk duhet konsideruar si e drejtë ekskluzive e dhënësit të licencës për çdo rast, sepse ligji kërkon që ky denoncim të jetë i arsyeshëm, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret ose nevoja për denoncimin e kontratës për licencën del e nevojshme nga vetë përmbajtja e kontratës. LMD i Kosovës parashikon se

608 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 909-910; Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 489-490.

“Denoncimi mund të jepet në çdo kohë, por jo në kohë të papërshtatshme”⁶⁰⁹. Prandaj ligji, duke pasur parasysh se denoncimi nuk duhet të bëhet në kohë të papërshtatshme, do të thotë duhet të vlerësohet se çfarë pasojash do të lindin për fituesin e licencës dhe të nënlicencës, nëse denoncimi do të bëhet në kohë të papërshtatshme. Me rastin e denoncimit të kontratës për dhënien e licencës ekskluzive, gjykata gjithmonë duhet të ketë parasysh arsyeshmërinë e ndalimit të dhënies së lejes për krijimin e kontratës së nënlicencës dhe arsyen e krijimit të nënlicencës pa lejen e dhënësit të licencës në pajtim me nenin 719 të LMD të Kosovës⁶¹⁰. Dhënësi i licencës, nëse provon të drejtën e vet për denoncimin e kontratës për licencën për shkak të nënlicencës së palejueshme, ka të drejtë të kërkojë që denoncimi të bëhet menjëherë dhe të kërkojë edhe shpërbimin e dëmit të pësuar për shkak të denoncimit të kontratës. Kjo është rregull që vlen për të gjitha rastet kur denoncimi i kontratës bëhet për fajin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 721. Kërkesa e drejtpërdrejtë e dhënësit të nënlicencës

- 1. Me kontratën për nënlicencën nuk krijohet asnjë marrëdhënie juridike e veçantë midis fituesit të nënlicencës dhe dhënësit të licencës, as atëherë kur dhënësi i licencës e ka dhënë lejen e nevojshme për kontraktimin e nënlicencës.**
- 2. Dhënësi i licencës për arkëtimin e kërkesave të veta nga fituesi i licencës të krijuara nga licenca, mund të kërkojë drejtpërdrejt nga fituesi i nënlicencës pagimin e shumave të cilat ky ia ka detyrim dhënësit të nënlicencës në bazë të nënlicencës.**

721. Vështrim i përgjithshëm.- Neni 721 përcakton se krijimi i marrëdhënies juridike midis fituesit të licencës dhe fituesit të nënlicencës nuk lindin të drejta dhe detyrime për dhënësin e licencës, përveç atyre që ekzistojnë për dhënësin e licencës të parashikuara me kontratën për dhënien e licencës dhe ligjit.

721.1. Paragrafi 1 përmban dispozitën që shprehimisht parashikon se me kontratën për nënlicencën të lidhur midis fituesit të licencës dhe fituesit të nënlicencës për shfrytëzimin e objektit të licencës, nuk krijohet asnjë marrëdhënie juridike e veçantë mes fituesit të nënlicencës dhe dhënësit të licencës. Kjo vlen edhe për ratin kur vetë dhënësi i licencës e ka dhënë lejen e nevojshme për kontraktimin e nënlicencës. Marrëdhënia juridike ekziston vetëm mes fituesit të licencës dhe fituesit të nënlicencës, sepse në këtë rast fituesi i nënlicencës i përgjigjet kryesisht fituesit të licencës, i cili e ka kaluar të drejtën e shfrytëzimit të objektit të licencës në nënlicencë.

721.2. Paragrafi 2 parashikon të drejtën e dhënësit të licencës që arkëtimin e kërkesave të veta nga fituesi i licencës, të krijuara nga licenca, nëse ai nuk mund t’i përmbushë kërkesat që i ka detyrim ndaj dhënësit të licencës, kur ekziston nënlicenca, atëherë dhënësi

.....
609 LMD i Kosovës, neni 339, paragrafi 3.

610 LMD i Kosovës, neni 719, ku thuhet “Kur për dhënien e nënlicencës nevojitet leja e dhënësit të licencës ky mund t’ia refuzojë fituesit të licencës ekskluzive vetëm për shkaqe serioze”.

i licencës mund të kërkojë edhe drejtpërdrejt nga fituesi i nënlicencës pagimin e shumave të cila fituesi i nënlicencës ia ka detyrim (borxh) dhënësit të nënlicencës në bazë të nënlicencës. Pra, edhe pse thuhet se nuk krijohet ndonjë marrëdhënie juridike të kontrata e nënlicencës me dhënësin e licencës, kjo dispozitë e autorizon dhënësin e licencës që t’i drejtohet drejtpërdrejt edhe fituesit të nënlicencës që pagimin e shumave, të cilat i ka borxh për shkak të shfrytëzimit të objektit të dhënë në nënlicencë ndaj fituesit të licencës, t’ia paguajë dhënësit të licencës, natyrisht deri në shumën që fituesi i licencës ka detyrim ndaj dhënësit të licencës, kurse pjesa tjetër, nëse është më e madhë, do t’i paguhet fituesit të licencës, i cili e ka kaluar të drejtën e shfrytëzimit të objektit të licencës te personi tjetër (nënlicencë). Në literaturën juridike, autorët e konsiderojnë si lloj të përgjegjësisë solidare që krijohet në bazë të ligjit⁶¹¹.

KREU 5 SHUARJA E KONTRATËS

Neni 722. Kalimi i kohës së caktuar

Kontrata për licencën e lidhur për një kohë të caktuar shuhet me vet kalimin e kohës për të cilën është lidhur dhe nuk nevojitet të denoncohet.

722. Vështrim i përgjithshëm.- Kreu 5 i pjesës së njëmbëdhjetë të LMD të Kosovës, përmban dispozitat për shuarjen e kontratës së licencës. Në këtë pjesë, si bazë për shuarjen e kontratës së licencës, konsiderohen : kalimi i kohës së caktuar; përtrirja e heshtur e licencës; denoncimi dhe vdekja, falimentimi dhe likuidimi.

Neni 722 i LMD të Kosovës përmban dispozitën me të cilën parashikohet shprehimisht se kontrata për licencën e lidhur për një kohë (afat) të caktuar shuhet me kalimin e kohës (afatit) për të cilën është lidhur dhe nuk është e nevojshme të kërkohej denoncimi. Kjo kontratë shuhet *ex lege* me kalimin e kohës për të cilën është lidhur ajo. Nga kontrata për dhënien e licencës, pushojnë të drejtat dhe detyrimet pas kalimit të kohës së caktuar të parashikuar si kohëzgjatje e kontratës për licencën. Mirëpo, kur bëhet fjalë për kontratën për licencën ekziston mundësia e vazhdimit të saj në mënyrë të heshtur dhe, si e tillë, ajo do të konsiderohet kontratë e re për licencën pa afat, nëse shfrytëzuesi i licencës vazhdon ta shfrytëzojë objektin e licencës, ndërsa dhënësi i licencës këtë nuk e kundërshton. Kjo rregullohet shprehimisht në nenin vijues (723 të LMD të Kosovës).

611 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 911; LMD i Kosovës, neni 399, paragrafi 2, ku thuhet “Debitori solidar mund të bëjë kompensimin e kërkesës së bashkëdebitorit të vet ndaj kreditorit me atë që kreditori i detyrohet, por vetëm për atë sa është pjesa e borxhit e këtij bashkëdebitori në detyrimin solidar”.

Neni 723. Përtëritja e heshtur e licencës

- 1. Kur pas kalimit të kohës për të cilën ka qenë e lidhur kontrata për licencën, fituesi i licencës e vazhdon shfrytëzimin e objektit të licencës, ndërsa dhënësi i licencës nuk e kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontrata e re për licencën për kohë të pacaktuar, nën të njëjtat kushte sikurse edhe paraprakja.**
- 2. Sigurimet që i kanë dhënë personat e tretë për licencën e parë shuhen me skadimin e kohës për të cilën ka qenë e lidhur.**

723. *Vështrim i përgjithshëm.*- Neni 723 përmban dispozitën sipas së cilës lejohet krijimi i kontratës së re për licencën edhe me anë të përtrirjes së heshtur, që do të thotë se nuk konsiderohet vazhdim i kontratës, por krijohet kontrata e re për licencën, gjithsesi në kushte dhe me përmbajtje të njëjtë që kanë ekzistuar edhe te kontrata e mëhershme me shkrim. Të gjithë pajtohen se kjo nuk është vazhdim i kontratës ekzistuese, por krijimi i një kontrate të re për licencën⁶¹², sepse edhe vetë paragrafi 1 i nenit 723 konsideron shprehimisht se bëhet fjalë për lidhjen e kontratës së re për licencën për kohë të pacaktuar dhe në të njëjtat kushte sikurse edhe kontrata e mëhershme për licencën.

723.1. Paragrafi 1 përcakton se nëse ndodh që, edhe pas kalimit të kohës për të cilën ka qenë e lidhur kontrata për licencën, fituesi i licencës të vazhdojë shfrytëzimin e objektit të licencës në mënyrë të njëjtë, sikurse para kalimit të kohës për të cilën ka qenë e lidhur kontrata për licencën, ndërsa dhënësi i licencës nuk e kundërshton shfrytëzimin e objektit të licencës nga ana e fituesit të licencës, atëherë *ex lege* konsiderohet se është lidhur kontratë e re për licencën dhe ajo për kohë të pacaktuar, në të njëjtat kushte me ato që ekzistonin kur ishte lidhur kontrata e mëparshme për licencën. Kjo zgjidhje ligjore përbën përjashtim, sepse një marrëdhënie juridike kaq të rëndësishme mes dhënësit të licencës dhe fituesit të licencës e konsideron të vlefshme vetëm në bazë të veprimeve konkludente dhe nuk kërkon lidhjen me shkrim të kontratës për këtë rast. LMD i Kosovës kërkon shprehimisht që kur lidhet kontrata për licencën, ajo duhet të jetë patjetër me shkrim që të konsiderohet e vlefshme⁶¹³. Në këtë rast “zbutet” forma e kontratës për licencën, sepse mjaftojnë sjelljet reciproke për shfrytëzimin e objektit të licencës që të konsiderohet kontratë e re, e vlefshme për dhënien e licencës dhe kjo në afat të pacaktuar.

723.2. Paragrafi 2 përcakton se, nëse ekzistojnë sigurimet që i kanë dhënë personat e tretë për licencën e parë, shuhen me skadimin e kohës për të cilën ka qenë e lidhur kontrata për licencën. Në këtë rast, nuk vazhdon sigurimi ekzistues i bërë nga personat e tretë, sepse nuk kemi vazhdim të kontratës, por bëhet fjalë për kontratë të re për licencën, e cila krijohet me veprime konkludente ose me sjellje të ndërsjella të dhënësit të licencës dhe fituesit të licencës. Kjo dispozitë i mbron personat e tretë që kanë dhënë ndonjë mjet për sigurimin e kërkesës së dhënësit të licencës për shfrytëzimin e objektit të licencës nga ana e fituesit të licencës. Nëse

612 Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 912; Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 492; Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1060.

613 LMD i Kosovës, neni 701, ku thuhet “Kontrata për licencën duhet të lidhet në formën me shkrim”.

ekziston ndonjë hipotekë eventuale, ajo me kalimin e afatit të kontratës për licencën *ex lege* shuhet dhe dhënësi i sigurimit ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e regjistrimit të hipotekës nga regjistri për regjistrimin e të drejtave mbi paluajtshmërinë, sepse kontrata e re për licencën nuk e obligon personin e tretë, i cili ka dhënë ndonjë sigurim për shfrytëzimin e objektit të licencës në bazë të kontratës së vjetër. Njësoj veprohet edhe kur si mjet sigurimi është dhënë letra me vlerë, kështu që pas kalimit të afatit, mbajtësi i letrës me vlerë nuk mund t’i realizojë të drejtat që dalin nga letra me vlerë, për shkak se kontrata për licencën për të cilën është lëshuar letra me vlerë, si mjet garancie, nuk ekziston më – ka kaluar afati⁶¹⁴.

Neni 724. Denoncimi

1. **Kontrata për licencën, kohëzgjatja e së cilës nuk është caktuar, shuhet me denoncim të cilën secila palë mund t’ia japë tjetrës, duke respektuar afatin e caktuar të denoncimit.**
2. **Në qoftë se afati i denoncimit nuk është caktuar me kontratë, është gjashtë (6) muaj, por dhënësi i licencës nuk mund ta denoncojë kontratën gjatë vitit të parë të vlefshmërisë së saj.**

724. Vështrim i përgjithshëm.– Neni 724 përmban dispozitën se në cilat raste dhe nën cilat kushte mund të bëhet denoncimi i kontratës për licencën dhe të vie deri te shuarja e kontratës për licencën.

724.1. Paragrafi 1 parashikon se edhe kontrata për licencën e lidhur në kohë të pacaktuar, pra për të cilën nuk është caktuar koha e vlefshmërisë, mund të shuhet me denoncim dhe të drejtën e denoncimit e ka secila palë, që do të thotë se secila palë mund t’ia japë tjetrës denoncimin e kontratës, por duke respektuar afatin e caktuar të denoncimit. Zakonisht ky afat caktohet me kontratë, sepse shuarja e kontratës për licencën me denoncim ka pasoja për palët ose në veçanti për njëren palë dhe, nëse ky afat nuk është parashikuar me kontratë, atëherë denoncimi i kontratës për licencës pa afat do të bëhet në bazë të afatit që parashikon ligji. Denoncimi, duhet të bëhet në pajtim me nenin 339 të LMD të Kosovës⁶¹⁵, dhe dispozitave të veçanta të LMD të Kosovës, me të cilat rregullohet kontrata për licencën⁶¹⁶.

614 LMD i Kosovës, neni 217, paragrafi 1, ku thuhet “Letra me vlerë është dokument me shkrim me të cilin emetuesi (lëshuesi) i saj detyrohet se do ta përmbushë detyrimin e shkruar në këtë dokument poseduesit të saj të ligjshëm”.

615 LMD i Kosovës, neni 339, paragrafi 1, ku thuhet “Në qoftë se kohëzgjatja e marrëdhënies së detyrimeve nuk është caktuar, secila palë mund ta ndërpresë me denoncim”, paragrafi 2 “Denoncimi duhet doemos t’i dorëzohet palës tjetër”, paragrafi 3 “Denoncimi mund të jepet në çdo kohë, por jo në kohë të papërshtatshme”, paragrafi 4 “Marrëdhënia e detyrimeve e denoncuar shuhet kur të ketë skaduar afati i denoncimit i caktuar në kontratë, e në qoftë se afati i tillë nuk është caktuar me kontratë, atëherë marrëdhënia shuhet pasi të ketë kaluar afati i caktuar me ligj ose me doke, përkatësisht me skadimin e afatit të arsyeshëm”, paragrafi 5 “Palët mund të kontraktojnë se marrëdhënia e tyre e detyrimeve do të shuhet me vetë dorëzimin e denoncimit, në qoftë se për rastin e caktuar ligji nuk urdhëron diçka tjetër” dhe paragrafi 6 “Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori atë detyrim të arritur, para se detyrimi të jetë shuar me kalimin e afatit ose me denoncim”.

616 LMD i Kosovës, nenet 700 – 725 dhe komentet e këtyre neneve

724.2. Paragrafi 2 përcakton se, në rast se palët kontraktuese nuk kanë caktuar afatin e denoncimit të kontratës në momentin e lidhjes së kontratës për licencën, pra nëse kontrata për licencën nuk përmban afatin e denoncimit, atëherë kjo dispozitë cakton se ky afat i denoncimit është gjashtë (6) muaj; njëkohësisht kjo dispozitë e mbron fituesin e licencës, duke ia kufizuar dhënësit të licencës denoncimin e kontratës, sepse, pa marrë parasysh se parashikohet afati gjashtë (6) - muajor me ligj, ai nuk mund t'i referohet këtij afati gjatë vitit të parë të vlefshmërisë së licencës. Kjo do të thotë se dhënësi i licencës, denoncimin e kontratës për licencën mund ta bëjë vetëm pas kalimit të afatit prej një (1) viti të shfrytëzimit të objektit të licencës dhe pastaj fiton të drejtën që të kërkojë denoncimin e kontratës për dhënien e licencës, por duhet të respektohet afati gjashtë (6)- muajor i parashikuar në këtë paragraf. Faktikisht, dhënësi i licencës nuk mund të fitojë të drejtën e denoncimit të kontratës pa kaluar tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita kur është lidhur kontrata për licencën. Ndërkaq, fituesi i licencës, nëse nuk është parashikuar me kontratë për licencën afati i denoncimit, ai mund të kërkojë denoncimin në afatin prej gjashtë (6) muajsh. Kërkesa për denoncim duhet të bëhet më së paku gjashtë (6) muaj nga dita kur do të ndodhë shuarja e kontratës me denoncim. Nëse me kontratë parashikohet denoncimi në bazë të ndonjë afati tjetër, atëherë kjo vlen si për dhënësin e licencës, ashtu edhe për fituesin e licencës. Kjo dispozitë vlen për kontratat e licencës pa afat dhe nuk ka të bëjë me rastin e denoncimit të kontratës për shkak të nënlicencës së palejueshme⁶¹⁷. Denoncimi i kontratës në pajtim me këtë nen mund të bëhet, duke respektuar afatin kontraktues apo afatin ligjor për denoncim të kontratës për licencën për kohë të pacaktuar dhe nuk ka nevojë të japë arsyetime pse kërkohet denoncimi i kontratës.

Neni 725. Vdekja, falimentimi dhe likuidimi

- 1. Në rast të vdekjes së dhënësit të licencës, licenca vazhdon në trashëgimtarët e tij, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.**
- 2. Në rast të vdekjes së fituesit të licencës, licenca vazhdon në trashëgimtarët e tij, të cilët e vazhdojnë veprimtarinë e tij.**
- 3. Në rast të falimentimit ose të likuidimit të fituesit të licencës, dhënësi i licencës mund ta zgjidhë kontratën.**

725. Vështrim i përgjithshëm. - Neni 725 përmban dispozitën me të cilat rregullohet se si do të veprohet në rastet kur ndodh vdekja e dhënësit përkatësisht e fituesit të licencës pastaj falimentimi dhe likuidimi i fituesit të licencës.

725.1. Paragrafi 1 përcakton se në rast të vdekjes së dhënësit të licencës, përkatësisht subjektit i cili ia ka kaluar të drejtat pasurore shfrytëzuesit të objektit të licencës (fituesi i licencës), atëherë licenca vazhdon te trashëgimtarët e tij, sepse objekti i licencës është gjithmonë i karakterit pasuror dhe, si i tillë, ai është objekt trashëgimie dhe mund t'u

617 LMD i Kosoves, neni 720 dhe komentini e këtij neni.

kalohet personave të tjerë, prandaj me këtë nuk cenohen të drejtat e dhënësit të licencës, por ato vazhdojnë së ekzistuari edhe pas vdekjes së tij. Ky paragraf përmban edhe pjesën tjetër të dispozitës se mund të zgjidhet kontrata për licencën, përkatësisht shuhet e drejta e licencës, në qoftë se palët kanë kontraktuar shuarjen e të drejtës së licencës për shkak të vdekjes së dhënësit të licencës. Në këtë rast, me vdekjen e dhënësit të licencës nuk vazhdon së ekzistuari kontrata për licencën të trashëgimtarët e tij. Trashëgimtarët e dhënësit të licencës i gëzojnë të gjitha të drejtat e dhënësit të licencës, të cilat i ka pasur dhënësi i licencës ndaj fituesit të licencës. Fituesi i licencës vazhdon në mënyrë të njëjtë ta shfrytëzojë objektin e licencës dhe i vetmi dallim është se shpërblimin për shfrytëzimin e licencës ua paguan trashëgimtarëve të dhënësit të licencës. Kjo dispozitë ia bën të mundur fituesit të licencës që të mos lidhë kontratë të re me trashëgimtarët e dhënësit të licencës, por të vazhdojë së shfrytëzuar objektin e licencës, ashtu siç e kanë kontraktuar me kontratën për dhënien e licencës. Trashëgimtarët e dhënësit të licencës, nëse nuk është parashikuar shuarja e kontratës për shkak të vdekjes së dhënësit të licencës, mund të kërkojnë denoncimin e kontratës për dhënien e licencës në kushtet e parashikuara me kontratë apo në pajtim me nenin 724 të LMD të Kosovës, sepse e drejta e denoncimit kalon te trashëgimtarët e dhënësit të licencës.

725.2. Paragrafi 2, përcakton se si do të veprohet në rast të vdekjes së fituesit të licencës. Në rast të vdekjes së fituesit të licencës, licenca vazhdon te trashëgimtarët e tij, ashtu siç ishte rasti me vdekjen e dhënësit të licencës, kur licenca vazhdonte te trashëgimtarët e tij. Ky paragraf, kur bëhet fjalë për vdekjen e fituesit të licencës, parashikon se licenca vazhdon te trashëgimtarët e tij, të cilët vazhdojnë veprimtarinë e tij. Kjo do të thotë se licenca vazhdon vetëm tek ata trashëgimtarë, të cilët e vazhdojnë veprimtarinë e tij, sepse vazhdimi i veprimtarisë është e lidhur edhe me aftësitë profesionale për shfrytëzimin e objektit të licencës. Ky paragraf parashikon se gjithmonë do të vazhdohet licenca te trashëgimtarët e tij, kur vdes fituesi i licencës, sepse nuk parashikohet shprehimisht mundësia që të jetë kontraktuar edhe ndryshe, nëse ndodh vdekja e fituesit të licencës, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni kur ndodh vdekja e dhënësit të licencës. Kjo dispozitë e bën të paqartë se a ka mundur të jetë çështje kontraktuese edhe shuarja e kontratës për licencën për shkak të vdekjes së fituesit të licencës. Kjo nënkupton se trashëgimtarët e fituesit të licencës domosdoshmërisht duhet të vazhdojnë me shfrytëzimin e objektit të licencës ose mund të kërkojnë denoncimin e kontratës për shfrytëzimin e objektit të licencës në kushtet e parashikuara në nenin 724 të LMD të Kosovës. Nëse trashëgimtarët e fituesit të licencës nuk kanë aftësi profesionale për vazhdimin e veprimtarisë në bazë të licencës, atëherë atyre u mbetet të kërkojnë denoncimin e kontratës në kushtet e parashikuara me këtë ligj. Në literaturën juridike thuhet se, pasi që licenca është e lidhur për veprimtarinë e fituesit të licencës, atëherë së paku njëri nga trashëgimtarët patjetër duhet ta vazhdojë veprimtarinë e fituesit të vdekur të licencës, përndryshe licenca shuhet⁶¹⁸. Sipas këtij mendimi, del se *ex lege* do të shuhet kontrata për licencën për shkak të vdekjes së fituesit të licencës, i cili nuk ka trashëgimtarë, por edhe nëse ka trashëgimtarë dhe asnjëri nga trashëgimtarët nuk është i aftë të vazhdojë shfrytëzimin e objektit të licencës dhe kjo nënkupton se nuk kërkohet të bëhet denoncimi ashtu si u përmend më lart. Në rastet kur trashëgimtarët kanë mundësi të vazhdojnë shfrytëzimin e objektit të licencës dhe ata nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë, konsideroj se në këtë rast patjetër duhet të bëhet zgjidhja e kontratës me denoncim dhe jo *ex lege*.

618 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1062.

725.3. Paragrafi 3 përcakton se si do të veprohet kur ndodh falimentimi⁶¹⁹ ose likuidimi⁶²⁰ i fituesit të licencës, që do të thotë se i falimentuar ose likuiduar mund të jetë vetëm fituesi i licencës; në këtë rast dhënësi i licencës mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të falimentimit ose likuidimit të fituesit të licencës, gjë që çon edhe në shuarjen e kontratës. Personat juridikë, në këtë rast shoqëritë tregtare, mbasi nuk vdesin, mund të shuhen dhe shuarja e tyre bëhet në mënyra të ndryshme, gjë që krijon situatën që kërkon të përcaktohet se si do të veprohet kur fituesi i licencës shuhet si subjekt i së drejtës. Ky paragraf parashikon shprehimisht se dhënësi i licencës mund ta zgjidhë kontratën nëse ndodh falimentimi ose likuidimi i fituesit të licencës, kjo është mundësia që të mbrohet dhënësi i licencës nga pasojat e falimentimit përkatësisht likuidimit të fituesit të licencës. LMD i Kosovës parashikon vetëm falimentimin dhe likuidimin e fituesit të licencës, si bazë për zgjidhjen e kontratës nga ana e dhënësit të licencës. Nëse zgjidhja e kontratës për licencën nga ana e dhënësit të licencës nuk është bërë deri në përfundim të procedurës së falimentimit, atëherë thuhet se kontrata do të shuhet në momentin e përfundimit të procedurës së falimentimit, përkatësisht pas mbylljes së likuidimit⁶²¹. Kjo do të thotë se, nëse fituesi i licencës shuhet në ndonjë formë tjetër, p.sh., duke u bashkuar me ndonjë person tjetër juridik, atëherë ekzistimi i licencës vazhdon në favor të personit juridik të cilit i është bashkuar, sepse subjekti juridik të cilit i është bashkuar personi juridik që ka qenë fituesi i licencës i merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i ka pasur subjekti i bashkuar (personi juridik – shoqëria tregtare).

Neni 726. Kuptimi

- 1. Me kontratën për depozitën detyrohet depozitëmarrësi që të pranojë sendin nga depozituesi për ta ruajtur dhe për ta kthyer, kur ky ta kërkojë.**
- 2. Objekt i depozitës mund të jenë vetëm sendet e luajtshme.**

Kontrata për depozitën është kontratë me të cilën një person, që quhet depozitar (ruajtës), detyrohet që sendin, të cilin ia ka dorëzuar personit tjetër, deponentit (lënësit) me rastin e lidhjes së kontratës, ta ruajë dhe t’ia kthejë pas kalimit të kohës së caktuar, pa shpërblim ose, në raste të caktuara, duke kontraktuar shpërblimin adekuat.

Kontraktuesi që detyrohet ta ruajë sendin e caktuar për një kohë të caktuar me shpërblim eventual, quhet depozitar, kurse kontraktuesi i cili detyrohet që sendin t’ia dorëzojë tjetrit për ta ruajtur quhet deponent. Sendi që dorëzohet për t’u ruajtur quhet lëndë e depozitës.

619 Falimentimi i shoqërisë tregtare gjen shprehje kur shoqëria tregtare ka shumë më shumë detyrime sesa të hyra. Pra, falimentim kemi kur shoqëria tregtare bankroton dhe me bankrotim nënkuptojmë përmbyshjen e detyrimeve të kreditorëve me shitjen e pasurisë së përgjithshme të debitorit në falimentim përkatësisht shoqërisë tregtare në falimentim që ka cilësinë e personit juridik

620 Zakon o privrednim društva (“Sl. glasnik RS”, br. 36/2011 i 99/2011), neni 524, ku thuhet “Likuidimi i një kompanie është një proces që kryhet kur kompania ka asete të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e saj”.

621 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1062.

Kontrata për depozitën hyn në grupin e kontratave për shërbimin (nenet 716-743 të LMD). Në kontratën për depozitën, depozitari nuk ka të drejtë ta përdorë dhe ta shfrytëzojë lëndën e depozitës, por vetëm ta ruajë atë. Këtu depozitari nuk fiton të drejtën e pronësisë ndaj sendit që e ka marrë për ta ruajtur.

Kontrata për depozitën ka karakteristika të caktuara juridike si më poshtë:

- Është *kontratë e njëanshme detyruese*, e cila krijon të drejta vetëm në anën e depozitarit (ruajtësit). Ka raste kur kontrata për depozitën mund të lidhet me detyrën e deponentit që t’ia paguajë shpërblimin depozitarit. Në këtë rast kontrata për depozitën është *kontratë e dyanshme detyruese*;
- Është *kontratë me emër*, e cila është e parashikuar shprehimisht me dispozita të veçanta juridike të LMD (nen 726);
- Është *kontratë e pavarur*, sepse lidhet dhe krijon efekte juridike pavarësisht nga ndonjë kontratë tjetër;
- Është *kontratë shkakësore*, në të cilën qëllimi juridik i detyrimit të palëve kontraktuese është i dukshëm, i njohur edhe për persona të tjerë;
- Është *kontratë komutative*, sepse palët kontraktuese që në çastin kur e lidhin kontratën i dinë të drejtat dhe detyrat e tyre;
- Është *kontratë konsensuale*, që lidhet thjesht me vullnetin e palëve kontraktuese - deponentit dhe depozitarit, kurse dorëzimi i sendit konsiderohet si akt i ekzekutimit të kontratës;⁶²²
- Është *kontratë intuitu personae*, që lidhet duke pasur parasysh cilësitë e veçanta dhe besimin e palëve kontraktuese.

Kushtet për lidhjen e kontratës për depozitën

Për tu lidhur kontrata për depozitën duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës: aftësia për të vepruar e palëve kontraktuese, pëlqimi i vullnetit të palëve, lënda dhe baza e kontratës.

Palët kontraktuese, deponenti dhe depozitari duhet të arrijnë pëlqimin e vullnetit lidhur me elementet thelbësore të kësaj kontrate. Si elemente thelbësore të kontratës për depozitën janë: lënda që ruhet, koha sa zgjat ruajtja dhe shpërblimi që duhet t’i paguhet ruajtësit kur kontrata për ruajtjen lidhet si kontratë me shpërblim.

Lënda e kontratës për depozitën mund të jetë një send i luajtshëm dhe jo konsumues. Lëndë e depozitës nuk mund të jenë sendet e paluajtshme (p.sh. ndërtesat, tokat). Në rast se “ndonjë person ia lë banesën e vet për t’ia ruajtur një personi tjetër, atëherë është fjala për kontratë sipas mandatit (urdhrit) ose kontratë për shërbimin dhe jo për kontratë për

622 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 756; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 180.

depozitën”.⁶²³ Lëndë e depozitës duhet të jetë sendi trupor e jo edhe e drejta që rrjedh nga natyra e vetë aktit të dhënies se vetë sendit për ruajtje. Sendi, si lëndë e depozitës, duhet të jetë i mundshëm, i caktuar ose i caktueshëm dhe i lejueshëm.

Palët kontraktuese, deponenti dhe depozitari, me rastin e lidhjes së kësaj kontrate e caktojnë kohën sa zgjat kontrata. Koha e zgjatjes mund të kufizohet me disa ditë (p.sh., 30 ditë), disa muaj (p.sh., 3 muaj) ose deri në një datë të caktuar (p.sh., 1 tetor 2013) ose derisa të paraqitet një ngjarje e caktuar (derisa të kthehet nga pushimi vjetor).⁶²⁴ Përveç me anë të kontratës, koha e zgjatjes së kontratës mund të caktohet edhe duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e lidhjes së saj.

Nëse kontrata për depozitën lidhet si kontratë me shpërblim, deponenti është i detyruar t’ia japë depozitarit shpërblimin e caktuar, si kundërvlerë për ruajtjen e sendit. Shpërblimi caktohet me një shumë të prerë me para ose varësisht nga numri i ditëve kur depozitari i merr sendet për t’i ruajtur (p.sh., shuma e caktuar e të hollave për çdo ditë të ruajtjes së sendit) ose nga lloji i lëndës së depozitës (varësisht nga sasia, vlera dhe numri i sendeve të dhëna për tu ruajtur).

Me lidhjen e kontratës për depozitën krijohen të drejta dhe detyrime të caktuar si për deponentin, ashtu edhe për depozitarin.

Nga kontrata e lidhur për depozitën, për deponentin krijohen të drejta dhe detyrime të caktuara.

Deponenti i ka këto të drejta nga kontrata e lidhur me depozitarin:

- të drejtën të kërkojë t’i kthehet sendi i depozituar pas kalimit të afatit për deponim,
- të drejtën ta ndalë depozitën që ta përdorë sendin, dhe
- të drejtën ta kontrollojë përdorimin e sendit.

Detyrmet e deponentit janë:

- T’i paguajë shpenzimet për ruajtjen e sendit. Ky detyrim ekziston te çdo kontratë për depozitën, në ato raste të depozitës kur lënda e saj nuk mund të ruhet pa bërë ndonjë shpenzim. Këto shpenzime janë shpenzime materiale, të domosdoshme për ruajtjen e sendit. Masën e shpenzimeve e caktojnë palët me marrëveshje;

- Ta shpërblejë dëmin. Për dëmin që e ka pësuar ruajtësi gjatë ruajtjes së sendit në ato raste kur deponenti nuk e ka njoftuar ruajtësin e sendit për vetitë e veçanta të sendit të dhënë për ruajtje, dhe për mungesat fizike, materiale të fshehura.

.....
623 Dr. Komentar ZOO, Knjiga II, Bg., 1995, fq. 1250.

624 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 758.

Neni 727. Depozita e sendit të huaj

- 1. Kontratën për depozitën mund ta lidhë plotfuqishëm personi që nuk është pronar i sendit dhe depozitëmarrësi ka për detyrë t'ia kthejë sendin e këtij, përveç nëse vihet në dijeni se sendi është i vjedhur.**
- 2. Në qoftë se personi i tretë me padi kërkon sendin nga depozitëmarrësi si pronar, depozitëmarrësi ka për detyrë ta informojë gjykatën nga cili person e ka marrë dhe njëkohësisht ta informojë depozitëmarrësin për padinë e paraqitur.**

Depozita e sendit të huaj është objekt i rregullimit të nenit 727 të LMD. Objekt i kontratës për depozitën mund të jetë sendi i luajtshëm dhe jo konsumues. Lëndë të depozitës nuk mund të jenë sendet e paluajtshme, p.sh., ndërtesat, tokat. Lëndë e depozitës duhet të jetë sendi trupor e jo edhe e drejta që rrjedh nga natyra e vetë aktit të dhënies së vetë sendit për ruajtje. Sendi, si lëndë e depozitës, duhet të jetë i mundshëm, i caktuar ose i caktueshëm dhe i lejueshëm.

Sipas paragrafit 1 të nenit 727 të LMD, kontratën për depozitën mund ta lidhë plotfuqishëm personi që nuk është pronar i sendit, dhe depozitëmarrësi ka për detyrë t'ia kthejë sendin e këtij, përveç kur vihet në dijeni se sendi është i vjedhur.

Sipas parag. 2 të këtij neni depozitëmarrësi ka dy detyrime në qoftë se personi i tretë me padi kërkon sendin nga depozitëmarrësi si pronar. Këto dy detyrime janë: së pari, depozitëmarrësi ta informojë gjykatën nga cili person e ka marrë dhe së dyti, njëkohësisht ta informojë depozitëmarrësin për padinë e paraqitur.

NËNKREU 2**DETYRIMET E DEPOZITËMARRËSIT****Neni 728. Detyrimet e ruajtjes dhe të njoftimeve**

- 1. Depozitëmarrësi ka për detyrë ta ruajë sendin si të vetin, e në qoftë se depozita është me shpërblim duhet ta ruajë si ndërmarrës i mirë respektivisht si shtëpiak i mirë.**
- 2. Në qoftë se është kontraktuar vendi ose mënyra e ruajtjes së sendit, depozitëmarrësi mund t'i ndryshojë vetëm në qoftë se këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara, përndryshe përgjigjet edhe për shkatërrimin e rastësishëm ose dëmtimin e rastësishëm.**
- 3. Për të gjitha ndryshimet që do t'i vinte re në sendin dhe për rreziqet që sendet të prishen në cilëndo mënyrë qoftë depozitëmarrësi ka për detyrë të njoftojë depozitëdhënësin.**

Detyrimi i ruajtjes së lëndës së depozitës.- Depozitari nuk ka të drejtë ta përdorë sendin (neni 728 parag. 1 i LMD), të mbledhë frytet e sendit të dhënë për ruajtje ose të nxjerrë ndonjë

dobi nga ai. Lënda e depozitës duhet të ruhet sipas mënyrës së parashikuar me kontratë. Nëse depozita është me shpërblim, ai është i detyruar ta ruajë sendin si ekonomist i mirë, shtëpiak i mirë (neni 728 parag. 1 e LMD). Sendin duhet ta ruajë sipas mënyrës, vendit dhe kohës ashtu siç janë marrë vesh me kontratë. Ai do të përgjigjet për culpa levis in concreto, mirëpo në rastet kur lidhet kontrata për depozitën me shpërblim, ruajtësi do të jetë i detyruar të tregojë kujdesin më të madh. Ai do të përgjigjet për culpa levis in abstracto;

Ai ka për detyrim ta ruajë sendin. Këtë obligim LMD e ka sanksionuar në nenin 728 parag. 1, 2, 3. Detyrimi themelor i depozitarit është ta ruajë sendin e huaj si sendin e vet. Nëse depozita është me shpërblim, atëherë ai është i detyruar ta ruajë sendin si ekonomist i mirë respektivisht si shtëpiak i mirë - neni 728 parag. 1 i LMD. Pra, këtu kërkohet që depozitari të veprojë me kujdes të veçantë. Kujdesi i tij është konkret dhe abstrakt. Në rastin e parë kujdesi është “in concreto”, sepse kërkohet që ai ta ruajë sendin si sendet e veta. Në rastin e dytë kujdesi është “in abstracto”, sepse kërkohet që ta ruajë sendin si shtëpiak i mirë (bonus pater familias), respektivisht ta ruajë sendin si ekonomist i mirë. Kjo domethënë se kujdesi është i shkallës më të lartë. Depozitari në këtë rast duhet t’i respektojë kushtet e ruajtjes që janë parashikuar me kontratë. Për këtë arsye, në qoftë se është kontraktuar vendi i ruajtjes ose mënyra e ruajtjes, ai këtë duhet ta respektojë. Këto mund t’i ndryshojë depozitari vetëm nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara, përndryshe do të përgjigjet për zhdukjen e rastësishme ose për dëmtimin e rastësishëm të ruajtjes së sendit - neni 728 parag. 2 i LMD. Sikundër mund të vihet re, detyrimet e depozitarit janë të rrepta, andaj edhe kërkojnë veprim të caktuar. Themi kështu, sepse ai nuk ka të drejtë ta përdorë sendin, nuk ka të drejtë ta ndërrojë vendin ose mënyrën e ruajtjes së tij. Këto mund t’i ndërrojë vetëm kur këtë e kërkojnë rrethanat e rastit. Nëse këto ndërrime bëhen dhe sendi dëmtohet ose zhduket, ai në këtë rast nuk përgjigjet për këtë. Mirëpo, ai përgjigjet për dëmin e shkaktuar ndaj sendit për ruajtje, për shkak të ndryshimeve të domosdoshme lidhur me mënyrën dhe vendin e ruajtjes. Depozitari ka obligim që për të gjitha ndryshimet që ka hetuar në sendin e ruajtjes si edhe për rreziqet e dëmtimit të sendit, ta lajmërojë deponentin në mënyrën që kërkohet (neni 728 parag. 3 i LMD). Në këtë rast, pas lajmërimit, deponenti mund të caktojë masa të veçanta për pengimin e rreziqeve të dëmshme në llogari të shpenzimeve të veta. Nëse depozitari nuk lajmëron, atëherë ai përgjigjet për dëmin që i shkaktohet sendit të marrë për ruajtje.⁶²⁵ Ai duhet ta ruajë sendin vetë. Ruajtjen duhet ta bëjë në mënyrën, vendin dhe për kohën si janë marrë vesh me kontratë. Nëse nuk janë marrë vesh me kontratë, atëherë depozitari ruajtjen mund ta bëjë duke i pas parasysh rrethanat e rastit konkret.

.....
625 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 203-204, Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO IV, Zag., 1979, fq. 2262-2264.

Neni 729. Dorëzimi i sendit tjetrit për ruajtje

Depozitëmarrësi nuk mundet pa pëlqimin e depozitëdhënësit, ose pa nevojë të domosdoshme t'ia dorëzojë dikujt sendin që i është besuar për ta ruajtur përndryshe përgjigjet edhe për shkatërrimin ose dëmtimin e tij pa dashje.

Dorëzimi i sendit tjetër për ruajtje është objekt i rregullimit të neni 729 të LMD. Depozitëmarrësi nuk mundet, pa pëlqimin e depozituesit ose pa nevojë, t'ia dorëzojë tjetrit sendin që i është besuar për ta ruajtur, përndryshe përgjigjet edhe për shkatërrimin ose dëmtimin e rastësishëm.

Detyrimi themelore e depozitëmarrësit është që ta ruajë sendin si të vetin e në qoftë se depozita është me shpërblim, duhet ta ruajë si ndërmarrës i mirë respektivisht si shtëpiak i mirë.

Në qoftë se depozit[marrësi ka qenë i autorizuar për t'ia dhënë ndonjë personi të tretë për ruajtje, ai i përgjigjet depozituesit për pakujdesinë me rastin e zgjidhjes së këtij personi. Kjo dispozitë juridike është parashikuar në paragrafin 2 të neni 729 të LMD.

Një detyrim tjetër i depozitëmarrësit është që të njoftojë depozitëmarrësin për të gjitha ndryshimet që do t'i vinte re te sendi dhe për rreziqet e dëmtimit të tij në cilëndo mënyrë qoftë (parag. 3 i këtij neni).

Për dëmin që e ka pësuar ruajtësi gjatë ruajtjes së sendit, ekziston detyrimi i shpërblimit të dëmit në ato raste kur deponenti nuk e ka njoftuar ruajtësin e sendit për vetitë e veçanta të sendit të dhënë për ruajtje dhe për mungesat fizike, materiale të fshehura.

Neni 730. Përdorimi i sendit

- 1. Depozitëmarrësi nuk ka të drejtë ta përdorë sendin e besuar për ruajtje.**
 - 2. Në rast të përdorimit të palejuar të sendit, depozitëmarrësi i ka borxh depozituesit shpërblimin gjegjës dhe i përgjigjet për shkatërrimin ose dëmtimin e rastësishëm të sendit i cili do të ndodhte me atë rast.**
 - 3. Kur në depozitë është dhënë ndonjë send i pakonsumueshëm dhe depozitëmarrësit i është lejuar që ta përdorë, në marrëdhëniet e kontraktueseve zbatohen rregullat e kontratës për huapërdorjen, ndërsa për çështjet për kohën dhe vendin e kthimit të sendit rregullat e kontratës për depozitën, në qoftë se kontraktuesit diçka tjetër nuk kanë caktuar.**
-

Përveç të drejtave të lartpërmendura, depozitari ka edhe detyrime të caktuara, siç është detyrimi që ta ruajë lëndën e depozitës. Depozitari nuk ka të drejtë ta përdorë sendin (neni 730 parag. 1 i LMD), të mbledhë frytet e sendit të dhënë për ruajtje ose të nxjerrë ndonjë dobi nga ai. Lënda e depozitës duhet të ruhet sipas mënyrës së parashikuar në kontratë.

Nëse depozita është me shpërblim, ai është i detyruar ta ruajë sendin si ekonomist i mirë, si shtëpiak i mirë. Sendin duhet ta ruajë sipas mënyrës, vendit dhe kohës ashtu siç janë marrë vesh me kontratë. Ai do të përgjigjet për culpa levis in concreto, mirëpo në rastet kur lidhet kontrata për depozitën me shpërblim, ruajtësi do të jetë i detyruar të tregojë kujdesin më të madh. Ai do të përgjigjet për culpa levis in abstracto;

Neni 731. Përdorimi dhe dorëzimi i sendit personit tjetër

Kur depozitëmarrësi, pa pëlqimin e depozituesit dhe pa nevojë të domosdoshme, në kundërshtim me kontratën, e përdorë sendin, e ndryshon vendin ose mënyrën e ruajtjes së tij, ose kur sendi i është dorëzuar për ruajtje personit tjetër, ai nuk përgjigjet për shkatërrimin ose dëmtimin pa dashje të sendit që mund të ndodhnin edhe sikur te ketë vepruar në pajtim me kontratën.

Nëse depozitari nuk i respekton dispozitat e caktuara rreth përdorimit të sendit të ruajtjes, sipas nenit 731 të LMD, krijohet përgjegjësia e depozitarit. Kjo paraqitet në rastin kur depozitari, pa pëlqimin e deponentit dhe pa nevojë dhe në kundërshtim me kontratën, e përdor sendin, e ndërron vendin ose mënyrën e ruajtjes së tij ose sendin ia dorëzon një personi tjetër për ruajtje; ai përgjigjet për zhdukjen ose dëmtimin e sendit dhe duhet ta paguajë shpërblimin. Në qoftë se në këtë rast ai përdor sendin me pëlqimin e depozitarit, edhe nëse përdorimin e bën në përputhje me kontratën ose ndryshon mënyrën e ruajtjes ose ia jep për ruajtje një personit tjetër, në këto raste depozitari nuk përgjigjet as për zhdukjen, as për dëmtimin e sendit të marrë për ruajtje, pra në këto raste ekziston lirimi nga përgjegjësia.

Neni 732. Kthimi i sendit

- 1. Depozitëmarrësi ka për detyrë ta kthejë sendin posa ta kërkojë depozituesi me të gjitha frytet dhe fitimet e tjera që ka pasur nga sendi.**
 - 2. Në qoftë se është caktuar afati për kthimin e sendit, depozitëdhënësi mund të kërkojë që sendi t'i kthehet edhe para kalimit të afatit, përveç nëse afati nuk është kontraktuar ekskluzivisht në interesin e depozitëdhënësit.**
 - 3. Kthimi bëhet në vendin e dorëzimit të sendit depozitëmarrësit, në qoftë se me kontratë nuk është caktuar ndonjë vend tjetër, në të cilin rast depozitëmarrësi ka të drejtë në shpërblimin e shpenzimeve të bartjes së sendit.**
-

Detyrimi për ta kthyer lëndën e depozitës.- Depozitari është i detyruar ta kthejë sendin kur deponenti e kërkon këtë, bashkë me frytet dhe me dobitë e tjerë nga sendi (neni 732 paragraf 1 i LMD). Depozitari është i detyruar ta kthejë sendin e njëjtë që e ka marrë për ruajtje në vendin në të cilin i është dorëzuar. Duke pasur parasysh faktin se kontrata për depozitën

lidhet në interes të deponentit, ai ka mundësi të kërkojë kthimin e sendit edhe para afatit të kontraktuar e kur afati nuk është caktuar, atëherë këtë mund ta bëjë në çdo kohë.

Depozitari ka për detyrë ta kthejë sendin. Këtë çështje LMD e rregullon në nenin 732 parag. 1, 2, 3. Në këtë nen parashtrihen disa çështje me rëndësi. Çështja e parë është se depozitari është i detyruar ta kthejë sendin kur e kërkon deponenti. Ai e kthen sendin me frytet dhe me dobitë e tjera nga sendi - neni 732 parag. 1 i LMD dhe e kthen sendin në gjendje të rregullt, siç e ka marrë nga deponenti. Çështja e dytë që parashtrihet është se kur është caktuar afati i kthimit, deponenti mund ta kërkojë kthimin e tij para skadimit të këtij afati. Kështu nuk mund të veprojë, nëse ky afat ekskluzivisht është caktuar në favor të deponentit - neni 732 parag. 2 i LMD. Sendi i depozituar kthehet në vendin e dorëzimit të sendit depozitarit. Kështu nuk do të veprohet kur palët kanë kontraktuar ndonjë vend tjetër të dorëzimit. Nëse ndodhë kështu, atëherë depozitari ka të drejtën e pagimit të shpenzimeve për bartjen e sendit në atë vend të kontraktuar - neni 949 parag. 3 i LMD. Bartjen e sendit depozitari duhet ta bëjë me kujdesin e shtëpiakut të mirë.

NËNKREU 3 TË DREJTAT E DEPOZITËMARRËSIT

Neni 733. Shpërblimi i shpenzimeve dhe i dëmit

Depozitëmarrësi ka të drejtë të kërkojë nga depozituesi që t'ia shpërblejë shpenzimet e domosdoshme për ruajtjen e sendit dhe dëmin që ka pasur për shkak të depozitës.

Depozitari ka të drejta dhe detyrime të caktuara nga kontrata e lidhur me deponentin.

Depozitari ka këto të drejta:

- të kërkojë nga deponenti t'ia paguajë shpenzimet e domosdoshme, të cilat janë bërë rreth ruajtjes së sendit (neni 733 i LMD)
- të kërkojë shpërblimin e dëmit rreth ruajtjes së sendit.

Neni 734. Shpërblimi

Depozitëmarrësi nuk ka të drejtë në shpërblimin e vet, përveç nëse shpërblimi është kontraktuar, në qoftë se depozitëmarrësi merret me pranimin e sendeve për ruajtje ose në qoftë se shpërblimi ka mundur të pritët duke marrë parasysh rrethanat e punës.

Depozitari ka të drejtë ta kërkojë edhe shpërblimin e dëmit. Për shpërblimin e dëmit mund të diskutohet vetëm në rastin kur kontrata për depozitën është kontratë me shpërblim,

ndërsa kur është kontratë pa shpërblim, atëherë depozitari nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit eventual që ka pësuar nga ruajtja e sendit. Depozitari te kontrata për depozitën pa shpërblim ka të drejtë ta kthejë sendin para afatit të kontraktuar, kur sendit të depozituar i kanoset rreziku i zhdukjes ose dëmtimit ose nëse ruajtja e mëtejme e sendit do të shkaktonte dëm nga sendi i depozituar - neni 735 parag. 1 i LMD. Mirëpo, nëse afati i ruajtjes nuk është kontraktuar, depozitari mund të heqë dorë nga kontrata. Në këtë rast ai, që të realizojë këtë të drejtë, duhet të caktojë afatin plotësues për marrjen e sendit prapa nga ana e deponentit - neni 735 parag. 2 i LMD.

Detyrimi që t'i paguajë shpërblimin për ruajtjen e sendit rrjedh ose nga ligji, ose nga vetë natyra e punës. Zakonisht pagesa e shpërblimit për ruajtjen e sendit jepet me rastin e kthimit të sendit.

Neni 735. Kthimi i sendit në rastin e depozitës falas

- 1. Depozitëmarrësi i cili është detyruar falas ta ruajë sendin për një kohë të caktuar mund t'ia kthejë depozituesit para kalimit të afatit të kontraktuar, në qoftë se vet sendit do t'i kanosej rreziku i shkatërrimit ose i dëmtimit ose në qoftë se ruajtja e tij e mëtejshme do të mund të shkaktonte dëmin.**
- 2. Në qoftë se afati nuk është kontraktuar, depozitëmarrësi nga paragrafi 1 i këtij neni mundet në çdo kohë të denoncojë kontratën, por ka për detyrë që depozituesit t'i caktojë afatin e arsyeshëm për marrjen e sendit.**

Kontrata për depozitën është kontratë e njëanshme detyruese, e cila krijon të drejta vetëm në anën e depozitarit (ruajtësit). Depozitëmarrësit nuk i takon e drejta e shpërblimit të vet, përveç kur ai është kontraktuar, nëse depozitëmarrësi merret me pranimin e sendeve për ruajtje ose kur shpërblimi, sipas rrethanave të punës, ka mundur të pritej.

Pikërisht kthimi i sendit në rastin e depozitës falas është parashikuar dhe rregulluar në nenin 735 të LMD.

Sipas parag. 1 të këtij neni, depozitëmarrësi i cili është detyruar ta ruajë falas sendin për një kohë të caktuar, mund t'ia kthejë atë depozituesit para kalimit të afatit të kontraktuar, në qoftë se vetë sendit do t'i kanosej rreziku i shkatërrimit ose i dëmtimit ose në qoftë se ruajtja e tij e mëtejme do të mund të shkaktonte dëm.

Depozitëmarrësi ka për detyrim ta ruajë sendin si të vetin e në qoftë se depozita është me shpërblim, duhet ta ruajë atë si ndër marrës i mirë respektivisht si shtëpiak i mirë.

Te kontrata për depozitën falas, depozitëmarrësi ka për detyrë t'ia kthejë sendin palës tjetër kontraktuese.

Depozitëmarrësi ka detyrimin ta kthejë sendin sapo ta kërkojë depozituesi, me të gjitha frytet dhe fitimet e tjera që ka pasur nga sendi. Kthimi i bëhet depozitëmarrësit në vendin e dorëzimit të sendit, në qoftë se me kontratë nuk është kontraktuar dhe caktuar ndonjë vend tjetër, në të cilin rast depozitëmarrësi ka të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve të transportimit të sendit.

Sipas parag. 2 të këtij neni, nëse afati nuk është kontraktuar, depozitëmarrësi i përmendur në paragrafin paraprak mundet në çdo kohë të heqë dorë nga kontrata, por ka detyrë që depozituesit t'i caktojë një afat të përshtatshëm për marrjen e sendit.

NËNKREU 4 RASTET E VEÇANTA TË DEPOZITËS

Neni 736. Depozita e parregullt

Kur në depozitë janë dhënë sende të zëvendësueshme me të drejtën që depozitëmarrësi t'i konsumojë dhe me detyrim që t'i kthejë të njëjtën sasi sendesh të të njëjtit lloj, atëherë në marrëdhëniet e tij me depozituesin zbatohen rregullat e kontratës për huan, vetëm lidhur me kohën dhe vendin e kthimit do të zbatohen rregullat e kontratës për depozitë, në qoftë se kontraktuesit nuk kanë caktuar diçka tjetër.

Depozita i parregullt është kur dorëzohen për t'u ruajtur sende të zëvendësueshme dhe konsumuese, me ç'rast ruajtësi këto sende i merr në pronësi, duke u detyruar që pas kalimit të afatit të zgjatjes së ruajtjes t'ia kthejë deponentit sendet e llojit, të cilësisë dhe sasisë së njëjtë (neni 736 i LMD). Te ky lloj i depozitës kemi të bëjmë edhe me rregulla të kontratës për huan.

Neni 737. Depozita e domosdoshme

Kujt i është besuar sendi në rast të ndonjë fatkeqësie, psh. në rast zjarri, tërmeti, vërshimi ka për detyrë t'a ruajë me kujdesin e shtuar.

Depozita e domosdoshme është kur sendi jepet për t'u ruajtur me rastin e paraqitjes së ngjarjeve natyrore, p.sh., tërmete, vërshime, zjarre ose aksidente të trafikut, në të cilat raste deponenti nuk është në gjendje t'i zgjedhë personat, të cilëve do t'ua besonte sendin për ruajtje, por i drejtohet personit të parë që e takon. Ky lloj i depozitës ka qenë e njohur qysh në të drejtën romake. LMD këtë lloj të depozitës e parashikon në nenin 737, në të cilin thuhet: “kujt i besohet sendi në rast nevojë për shkak të zjarrit, tërmetit, vërshimit, ai sendin duhet ta ruajë me kujdes të madh”. Ky lloj i depozitës është pa shpërblim.

KREU 2

DEPOZITA HOTELIERE

Neni 738. Hotelieri si depozitëmarrës

- 1. Hotelieri konsiderohet dispozitëmarrës lidhur me sendet që i kanë sjellë me vete mysafirët dhe përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e tyre, por jo më tepër se deri në shumën prej pesëmijë (5.000) Euro.**
- 2. Kjo përgjegjësi është përjashtuar në qoftë se sendet janë shkatërruar ose dëmtuar për shkak të rrethanave që nuk kanë mundur të shmangen ose të mënjanohen, për ndonjë shkak në vetë sendin, në qoftë se kanë humbur ose janë dëmtuar me sjelljen e vet mysafirit ose me sjelljen e personave që i ka sjellë ai ose që i kanë ardhur në vizitë.**
- 3. Hotelieri ka detyrim shpërblimin e plotë në qoftë se mysafiri ia ka dorëzuar sendin për ruajtje dhe në qoftë se dëmi është shkaktuar me fajin e tij ose të personave për të cilët ai përgjigjet.**

Depozita hoteliere është një kontratë në bazë të së cilës hotelieri merr për t'i ruajtur sendet e mysafirrit - deponentit që ka marrë me vete, në mënyrë që t'i ruajë nga zhdukja ose dëmtimi dhe kur i kërkon, ia jep deponentit (neni 738 i LMD). Kur është fjala për të holla, sende të çmueshme dhe sende të tjera me vlerë të lartë, udhëtari duhet të lidhë kontratë të veçantë për ruajtjen me ndërmarrjen hoteliere. Kontrata për ruajtjen hoteliere në të shumtën e rasteve lidhet si pjesë përbërëse e kontratës për pansionin, si kontratë e përzier.

Neni 739. Detyrimet e hotelierit për ta pranuar sendin për ruajtje

- 1. Hotelieri ka për detyrë t'i pranojë sendet për ruajtje që kanë sjellë mysafirët dhe që dojnë t'ia dorëzojnë për ruajtje, përveç nëse nuk disponon hapësira të përshtatshme për vendosjen e tyre, ose në qoftë se ruajtja e tyre i kapërcen mundësitë e tij për ndonjë shkak tjetër.**
- 2. Në qoftë se hotelieri refuzon pa arsye ta pranojë sendin për ruajtje, paguan shpërblimin e plotë të dëmit të cilin mysafiri e pëson për këtë shkak.**

Hotelieri, sipas nenit 739 parag. 1, 2 të LMD, ka për detyrë t'i marrë sendet për ruajtje të mysafirrit (deponenti). Në nenin 739 parag. 1, 2 parashtrihen dy çështje me rëndësi. Çështja e parë është ajo se hotelieri është i detyruar ta marrë sendin për ruajtje që e sjell mysafiri dhe dëshiron ta dorëzojë për ruajtje. Me këtë përkrahet detyra normale e hotelierit për marrjen e sendeve për ruajtje. Kuptohet, ai duhet t'i marrë sendet që ka sjellë mysafiri dhe i cili dëshiron t'i dorëzojë për ruajtje. Ai duhet t'i marrë sendet për ruajtje, sepse ruajtja bën pjesë në natyrën e veprimtarisë së tij dhe për këtë duhet të posedojë hapësirë të caktuar

për vendosjen e sendeve. Për marrjen e sendeve për ruajtje në garderobë, hotelieri mund të inkasojë një shpërblim të caktuar. Bile, për këtë shërbim duhet ta paraqesë shumën e shpërblimit në një vend të dukshëm. Mirëpo, hotelieri në disa raste nuk është i detyruar t'i marrë sendet e mysafirit për ruajtje, nëse ruajtja e sendeve të mysafirit tejkalon mundësitë e hotelierit. Normalisht, për këto pamundësi të ruajtjes së sendeve të mysafirit hotelieri ka për detyrë të informojë në mënyrë publike.⁶²⁶ Në qoftë se mysafiri ka sende të çmueshme dhe merr të holla, atëherë hotelieri, me kërkesë të tij, duhet t'i marrë për ruajtje dhe për këtë të lëshojë një vërtetim të caktuar. Këto sende hotelieri i ruan në kasafortë të veçantë dhe, në rast nevoje, jep çelësin e kasafortës.⁶²⁷ Një çështje tjetër që parashikohet këtu është përgjegjësia e hotelierit kur pa arsye refuzon ta marrë sendin për ruajtje. Ai në këtë rast e ka detyrimin e plotë për dëmin që ka pësuar deponenti, respektivisht mysafiri. Këtë dëm ai e paguan pa marrë parasysh nëse ai është shkaktuar për fajin e tij apo për fajin e personit për të cilin ai përgjigjet ose për ndonjë arsye tjetër. Pra, ai përgjigjet nëse sendet vidhen ose humbin ose dëmtohen nga një ngjarje tjetër për të cilën hotelieri nuk përgjigjet.⁶²⁸ Sikundër mund të vihet re, këtu është ashpërsuar përgjegjësia e hotelierit.

Neni 740. Detyrimi i mysafirit për ta paraqitur dëmi

Mysafiri ka për detyrë ta paraqesë humbjen ose dëmtimin e sendeve posa të vihet në dijeni për to, përndryshe ka të drejtë shpërblimi vetëm në qoftë se provon se dëmi është shkaktuar me fajin e hotelierit ose të personave për të cilët ai përgjigjet.

Sipas nenit 740 të LMD, mysafiri ka për detyrë ta paraqesë humbjen ose dëmtimin e sendeve sapo të vihet në dijeni për këtë. Në qoftë se mysafiri këtë nuk e bën, ai e humb të drejtën e shpërblimit të dëmit, të cilin e ka si detyrim hotelieri pa marrë parasysh fajin. Mysafiri ka të drejtën e shpërblimit të dëmit vetëm nëse provohet se dëmtimi i sendit është shkaktuar për fajin e hotelierit apo të një personi për të cilin ai përgjigjet. Barra e provës qëndron në anën e mysafirit, sepse mysafiri është i detyruar të reagojë menjëherë pasi i është kthyer sendi i humbur, duke u bazuar në parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë së palëve kontraktuese.

Neni 741. Shpalljet për përjashtimin e përgjegjësive

Nuk kanë kurrfarë efekti juridik shpalljet e theksuara në hapësirat hoteliere me të cilat përjashtohet, kufizohet ose kushtëzohet përgjegjësia e tyre për sendet që i kanë sjellur mysafirët.

Nuk paraqesin kurrfarë efekti juridik shpalljet e theksuara në hapësirat hoteliere, me të cilat përjashtohet, kufizohet ose kushtëzohet përgjegjësia e tyre për sendet që i kanë sjellë mysafirët.

626 Komentar ZOO II, Beog. 1980, fq. 209.

627 Dr. Ivan Bukjlaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO IV, Zag. 1979, fq. 2281-2282.

628 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 208.

Hotelieri konsiderohet depozitëmarrës lidhur me sendet që i kanë sjellë me vete mysafirët dhe përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e tyre jo më tepër se deri në shumën prej 2000 €, e për para, letra me vlerë dhe sende të çmueshme deri në shumën prej 1000 € (Shih nenin 741 parag. 1 i LMD).

Kjo përgjegjësi është e përjashtuar në qoftë se sendet janë shkatërruar ose dëmtuar për shkak të rrethanave që nuk kanë mundur të shmangen ose të mënjanohen, për ndonjë shkak në vet sendin, në qoftë se kanë humbur ose janë dëmtuar me sjelljen e vet mysafirët ose me sjelljen e personave që i ka sjellë ai ose që i kanë ardhur për vizitë.

Për arsyet e mësipërme, nuk kanë efekt juridik shpalljet e theksuara në hapësirat hoteliere, me të cilat përjashtohet, kufizohet ose kushtëzohet përgjegjësia e tyre për sendet që i kanë sjellë mysafirët.

Neni 742. E drejta e mbajtjes (retencionit)

Hotelieri që pranon mysafirët ka të drejtë të ndalë sendet të cilat mysafirët i kanë sjellë deri te arkëtimi i plotë i kërkesave për vendosje dhe shërbime të tjera.

Kontrata për ruajtjen hoteliere në të shumtën e rasteve lidhet si pjesë përbërëse e kontratës për pansionin, si kontratë e përzier. Hotelieri lirohet nga përgjegjësia, nëse provon se dëmi në sendet e ruajtura është shkaktuar me ndikimin e fuqisë madhore, për fajin e vetë mysafirët ose të personave që i vijnë për vizitë ose për shkak të vetive të vetë sendit. Organizata hoteliere ka të drejtë t'i ndalë sendet e mysafirët që ka sjellë deri në inkasimin e plotë të kërkesës së vet për vendosje dhe për shërbimet e tjera, (neni 742 i LMD).

Hotelieri lirohet nga përgjegjësia nëse do të vërtetojë se dëmi në sendet e ruajtura është shkaktuar nën ndikimin e fuqisë madhore, me fajin e vetë mysafirët, ose të personave që i vijnë për vizitë, ose për shkak të vetive të vetë sendit. Organizata hoteliere ka të drejtë t'i ndalë sendet e mysafirët që ka sjellë deri në arkëtimin e plotë të kërkesës së vet për vendosje dhe për shërbimet e tjera, (neni 742 i LMD).

Neni 743. Zgjerimi i zbatimit të dispozitave për depozitën hoteliere

Dispozitat për depozitën hoteliere zbatohen përshtatshëmrisht edhe për spitale, garazhe, vagonë gjumi, kampe të organizuara etj.

Duhet theksuar se dispozitat e kontratës për depozitën hoteliere zbatohen edhe nëpër spitale, garazhe, automjete a vagonë gjumi, kampe të organizuara (neni 743 i LMD).

PJESA XIV KONTRATA PËR MAGAZINIMIN

KREU 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 744. Nocioni

- 1. Me kontratën për magazinimin detyrohet magazinieri që të pranojë dhe ta ruajë mallin e caktuar dhe të marrë masa të nevojshme ose të kontraktuara për ruajtjen e tij në gjendje të caktuar dhe ta dorëzojë me kërkesën e dhënësit (të sendit për magazinim) ose të personit tjetër të autorizuar, ndërsa dhënësi obligohet t'i paguajë shpërblimin e caktuar.**
- 2. Me rastin e dorëzimit të mallit depozitëdhënësi ka për detyrë të japë të gjitha njoftimet e nevojshme për të dhe të deklarojë sa është vlera e tij.**

Kontratë për magazinimin e mallrave quhet një kontrata e tillë për shërbimet tregtare në bazë të së cilës njëra palë (magazinieri) merr përsipër detyrimin që ta strehojë në magazinë dhe ta ruajë mallin që i përket palës tjetër (lënësit të mallit), kurse lënësi detyrohet të paguajë për këtë çmimin e kontraktuar ose shpërblimin e rëndomtë (provizionin).

Kontrata për magazinimin është ka lidhje dhe është zhvilluar nga kontrata e së drejtës civile për depozitën, mirëpo në zhvillimin e vet të mëtejshëm ka fituar edhe karakteristika të tjera specifike, (p.sh., elemente të kontratës për sipërmarrjen, kontratës për mandatin e të tjera), kështu që ajo sot paraqet një punë mjaft komplekse.

Punët e magazinimit të mallit mund t'i kryejnë organizatat ekonomike, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe që janë të regjistruara për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Kjo kontratë është formale, sepse në praktikë lidhet në formularë të posaçëm dhe të përgatitur paraprakisht.

Këta formularë, mbasi plotësohen, kanë vetëm fuqinë e mjetit dëshmues. Këta shërbejnë vetëm “ad probationem”, e jo, “ad solemnitatem”. Roli tyre është i ngjashëm me rolin e aktvendimit të kontrata për shitblerjen, me rolin e fletëngarkesës të disa kontrata të transportimit e të tjera. E meta ose jorregullsia e këtyre dokumenteve nuk ndikon në fatin e kontratës.

Kontrata konsiderohet e lidhur atëherë kur magazinës i dorëzohet malli që është objekt i magazinimit, gjë që do të thotë se, në thelb, ajo bën pjesë në kontratat reale.

Kontrata për magazinimin e mallit paraqet një kontratë të dyanshme me ngarkesë, tek e cila, me lidhjen e saj, lindin disa detyrime si për magazinierin, ashtu edhe për lënësin

e mallit (deponuesin), Këto detyrime mund të krijohen në bazë të kontratës, dispozitave pozitive ose dokeve tregtare.

Objekt të kontratës për magazinimin paraqet vendosja edhe ruajtja e mallit. Ndryshe nga kjo, ruajtja e objekteve të tjera (sendeve të çmueshme, të hollave, sendeve artistike, letrave me vlerë e të tjera) nuk konsiderohet punë e qarkullimit të mallit, por hyn në radhën e punëve bankiere (kontrata për depozitimin), për të cilën do të bëjmë fjalë më vonë.

Neni 745. Detyrimet e magazinierit

- 1. Magazinieri përgjigjet për dëmin në mallin, përveç nëse provon se dëmi është shkaktuar për shkak të rrethanave që nuk kanë mund të shmangen ose të evitohen, ose është shkaktuar me fajin e dhënësit, të metave ose të vetive natyrore të mallit dhe ambalazhit jo të rregullt.**
- 2. Magazinieri ka për detyrë t'ia tërheq vërejtjen depozitëdhënësit për të metat ose cilësitë natyrore të mallit, përkatësisht për ambalazhin e parregullt, për shkak të të cilave mund të vijë deri te dëmtimi i mallit, posa t'i ketë vënë re të metat e përmendura ose është dashur t'i vinte re.**
- 3. Në qoftë se në mall do të ndodheshin ndryshime të tilla të paevitueshme për shkak të të cilave ekziston rreziku që malli të prishet ose të shkatërrohet, magazinieri ka për detyrë, në qoftë se kjo sipas thirrjes së këtij nuk do të mund ta bënte me kohë depozitëdhënësi, ta shesë mallin pa shtyrje në mënyrë më të përshtatshme.**
- 4. Magazinieri ka për detyrë të ndërmarrë veprime për t'i ruajtur të drejtat e depozitëdhënësit ndaj transportuesit që i'a ka dorëzuar mallin për llogari të depozitëdhënësit në gjendje të dëmtuar ose të mangët.**

Në këtë rast fjala është për njërën nga detyrimet themelore të magazinierit që buron nga kontrata për depozitën. Magazinieri është i detyruar që kundrejt mallit të veprjë si ekonomist i mirë, me kujdes të ekspertit, në pajtim me natyrën e vetë mallit.

Magazinieri është përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara në mall, përveç nëse dëmet janë shkaktuar nga fuqia madhore, të metat e vetë mallit, të paketimit ose për fajin e vetë lënësit të mallit, (respektivisht personit për të cilin magazina nuk përgjigjet). Magazinieri lirohet nga përgjegjësia nëse provon që shmangia e dëmit ka qenë e pamundur madje as me kujdesin më të madh të ekspertit. Magazinieri nuk ka të drejtë që me ndonjë klauzolë kontraktuese të lirohet nga përgjegjësia e ruajtjes së mallit.

Nëse malli është dëmtuar, magazinieri është i detyruar t'ia shpërblejë lënësit të mallit dëmin real. Mirëpo, nëse dëmi është shkaktuar me qëllim të keq ose për moskujdes të madh të magazinierit, ai duhet t'ia shpërblejë edhe fitimin e humbur lënësit të mallit, respektivisht tërë dëmin e konstatuar.

Magazinieri është, sipas rregullës, i detyruar që në mënyrë të ndarë ta ruajë mallin e çdonjërit lënës (deponent), përveç nëse kemi të bëjmë me mall që është i caktuar sipas llojit (mallin gjenerik).

Nëse malli fillon të priset, magazinieri duhet menjëherë për këtë ta lajmërojë lënësin e mallit. Nëse lënësi i mallit nuk i paraqet instruksionet (udhëzimet) e reja ose nëse vonesa mund t'ua shkaktojë dëm interesave të lënësit të mallit, magazinieri është i autorizuar (dhe e ka për detyrë) që mallin ta shesë, në mënyrë që të pengohet një dëm më i madh për lënësin e mallit.

Neni 746. Kur ekziston detyra e sigurimit

- 1. Magazinieri ka për detyrë ta sigurojë mallin e marrë për ruajtje vetëm në qoftë se kjo është kontraktuar.**
- 2. Në qoftë se me kontratë nuk është caktuar se cilat rreziqe duhet t'i përfshijë sigurimi, magazinieri ka për detyrë ta sigurojë mallin kundër rreziqeve të zakonshme.**

Magazinieri ka për detyrë ta sigurojë mallin e marrë për ruajtje vetëm në qoftë se kjo është kontraktuar veçanërisht me rastin e lidhjes së kontratës për magazinimin. Qëllimi i paragrafit 1 të nenit 746 të LMD është të përcaktojë detyrimin e sigurimit të mallit nga ana e magazinierit. Këtu është fjala konkretisht për sigurimin e interesit të magazinierit, prandaj ai edhe duhet t'i bartë shpenzimet e sigurimit. Magazinieri ka për detyrë t'ia tërheqë vërejtjen depozitëdhënësit për të metat ose cilësitë natyrore të mallit, përkatësisht për ambalazhin e parregullt, për shkak të të cilave mund të vijë dëmtimi i mallit, posa t'i ketë vënë re të metat e përmendura ose që është dashur t'i vinte re.

Magazinieri ka për detyrë ta sigurojë mallin kundër rreziqeve të zakonshme. Qëllimi i paragrafit 2 të këtij neni është që të përcaktojë se në qoftë se me kontratë nuk është caktuar se cilat rreziqe duhet t'i përfshijë sigurimi, magazinieri ka për detyrë ta sigurojë mallin kundër rreziqeve të zakonshme.

Neni 747. Kufizimi i shpërblimit të dëmit

Shpërblimi i dëmit, të cilin magazinieri e ka për detyrë ta paguajë për shkak të shkatërrimit, zvogëlimit ose dëmtimit të mallit, prej pranimit të tij deri te dorëzimi nuk mund të kalojë vlerën e vërtetë të mallit, përveç nëse dëmin e ka shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

Magazinieri përgjigjet për dëmtimin e mallit, përveç nëse provon se dëmi është shkaktuar nga rrethanat që nuk mund të shmangen ose të mënjanoohen ose është shkaktuar për fajin e dhënësit, të metave ose të vetive natyrore të mallit ose ambalazhit jo të rregullt.

Në qoftë se në mall do të ndodheshin ndryshime të tilla të paevitueshme për shkak të të cilave ekziston rreziku që ai të priset ose të shkatërrohet, magazinieri ka për detyrë, ta shesë mallin pa shtyrje në mënyrën më të përshtatshme, nëse edhe pas thirrjes që i ka bërë depozitëdhënësit, ky nuk do të mund ta bënte me kohë këtë.

Qëllimi i nenit 747 është të përcaktojë kufizimin e shpërblimit të dëmit. Shpërblimi i dëmit, të cilin magazinieri e ka për detyrë ta paguajë për shkak të shkatërimit, zvogëlimit ose dëmtimit të mallit, prej pranimit të tij deri te dorëzimi, nuk mund ta kalojë vlerën e vërtetë të mallit, përveç nëse dëmin e ka shkaktuar me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë.

Këtu është parashikuar përgjegjësia objektive e magazinierit në mbështetje të kontratës së lidhur për magazinimin, por megjithatë këtu është limituar përgjegjësia e magazinierit në vartësi të shkallës së fajit të tij.

Neni 748. Përzierja e sendeve të zëvendësueshme

- 1. Magazinieri nuk mund t'i përziejë sendet e zëvendësueshme të pranuar me sendet e llojit të njëjtë dhe të cilësisë së njëjtë, përveç nëse depozitëdhënësi ka dhënë pëlqimin për këtë ose në qoftë se është e qartë se është fjala për sendet që mund të përzihen pa rrezik nga shkaktimi i dëmit për depozitëdhënësin.**
- 2. Në qoftë se sendet janë përzier, magazinieri mund me kërkesën e personit të autorizuar, pa pjesëmarrjen e personave të tjerë të autorizuar nga përzierja e sendeve të zëvendësueshme, ta ndajë pjesën që i takon.**

Përzierja e sendeve të zëvendësueshme rregullohet me nenin 748 të LMD. Me kontratën për magazinimin detyrohet magazinieri që të pranojë dhe ta ruajë mallin e caktuar dhe të marrë masa të nevojshme ose të kontraktuara për ruajtjen e tij në gjendje të caktuar dhe ta dorëzojë me kërkesën e dhënësit të sendit për magazinim ose të personit tjetër të autorizuar, ndërsa dhënësi detyrohet t'i paguajë shpërblimin e caktuar.

Parag. 1 i nenit 748 të LMD përcakton shprehimisht se magazinieri nuk mund t'i përziejë sendet e zëvendësueshme të pranuar me sendet e llojit të njëjtë dhe të cilësisë së njëjtë, përveç kur depozitëdhënësi ka dhënë pëlqimin për këtë ose në qoftë se është e qartë se është fjala për sende që mund të përzihen pa rrezik nga shkaktimi i dëmit për depozitëdhënësin. Nuk mund të përzihen sendet që janë të një lloji, por me cilësi të ndryshme dhe ato që janë të papjesëtueshme.

Parag. 2 i këtij neni ka për qëllim të përcaktojë të drejtën e personit të autorizuar që nga përzierja e sendeve të zëvendësueshme ta ndajë pjesën që i takon. Në qoftë se sendet janë përzier, magazinieri mundet që, me kërkesë të personit të autorizuar, pa pjesëmarrjen e personave të tjerë të autorizuar, nga përzierja e sendeve të zëvendësueshme ta ndajë pjesën që i takon.

Neni 749. Kontrollimi i mallit dhe marrja e mostrave

Magazineri ka për detyrë t'i lejojë personit të autorizuar ta kontrollojë mallin dhe t'i marrë mostrat prej tij.

Kontrollimi i mallit dhe marrja e mostrave parashikohet në nenin 749 të LMD. Një nga detyrat e magazinierit është që t'i lejojë personit të autorizuar ta kontrollojë mallin dhe t'i marrë mostrat prej tij.

Qëllimi i këtij neni është që të përcaktojë detyrimin e magazinierit që të lejojë personat e autorizuar të bëjnë kontrollimin e mallrave dhe marrjen e mostrave, gjersa malli gjendet për ruajtje te magazinieri, me qëllim të mbrojtjes së interesave të personave të autorizuar.

Neni 750. Kërkesa e magazinierit dhe e drejta e pengut

- 1. Përveç shpërblimit për ruajtje magazinieri ka të drejtë në shpërblimin e shpenzimeve që kanë qenë të nevojshme për ruajtjen e mallit.**
 - 2. Për kërkesat e veta nga kontrata për magazinimin dhe për kërkesat e tjera që rrjedhin në lidhje me ruajtjen e mallit ai ka të drejtën e pengut në këtë mall.**
-

Me kontratën për magazinimin detyrohet magazinieri që të pranojë dhe ta ruajë mallin e caktuar dhe të marrë masa të nevojshme ose të kontraktuara për ruajtjen e tij në gjendje të caktuar dhe ta dorëzojë atë me kërkesën e dhënësit të sendit për magazinim ose të personit tjetër të autorizuar, ndërsa dhënësi detyrohet t'i paguajë atij shpërblimin e caktuar.

Parag. 1 i nenit 750 të LMD ka për qëllim të precizojë kërkesat e magazinierit dhe të drejtat e pengut. Sipas këtij paragrafi, përveç shpërblimit për ruajtje, magazinieri ka edhe të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve që kanë qenë të nevojshme për ruajtjen e sendit. Nga kjo mund të përfundojmë se magazinieri ka dy të drejta: **e para**, shpërblimin për ruajtjen e sendit, dhe **e dyta**, shpërblimin e shpenzimeve të cilat kanë qenë të nevojshme për ruajtjen e sendit.

Shpërblimi i tillë duhet paguar varësisht nga mënyra e kontraktimit me rastin e lidhjes së kësaj kontrate ose sipas tarifave të parashikuara.

Parag. 2 i këtij neni parashikon të drejtën e pengut për kërkesat që rrjedhin nga kontrata për magazinimin. Magazinieri, sipas kontratës së lidhur për magazinimin, për kërkesat e veta të parashikuara në kontratën për magazinimin dhe për kërkesat e tjera që rrjedhin në lidhje me ruajtjen e mallit, ka të drejtën e pengut kundrejt këtij malli. Në këtë rast fjala është për pengun si mjet sigurimi të ekzekutimit të kontratës së lidhur. Me këtë rast zbatohen rregullat analoge për pengun, si mjet sigurimi.

Neni 751. Tërheqja e mallit dhe shitja e mallit të patërhequr

- 1. Dhënësi mund ta tërheqë mallin edhe para afatit të kontraktuar.**
- 2. Në qoftë se depozitëdhënësi nuk e tërheq mallin pas kalimit të afatit të kontraktuar ose pas kalimit të vitit, në qoftë se nuk është kontraktuar afati për ruajtje, magazinieri mund në llogarinë e tij ta shesë mallin në shitje publike, por ka për detyrë ta njoftojë më parë për qëllimin e tij dhe t'i lë afat të ri, jo më pak se prej tetë ditësh që mallin ta tërheqë. 160**

Sipas këtij neni, dhënësi ka të drejtë ta tërheqë mallin edhe para afatit të kontraktuar, në ato raste konkrete kur e ka bërë pagimin e shpërblimit për ruajtje dhe shpërblimin e shpenzimeve që kanë qenë të nevojshme për ruajtjen e mallit. Nga kjo që u tha del se objekti që rregullon neni 751 parag. 1 dhe 2 është tërheqja e mallit dhe shitja e mallit që nuk është tërhequr.

Parag. 2 i këtij neni parashikon rastin tjetër kur depozitëdhënësi nuk e tërheq mallin pas kalimit të afatit të kontraktuar ose pas kalimit të vitit, në qoftë se nuk është kontraktuar afati i ruajtjes, kur magazinieri mund ta shesë për llogari të tij mallin me shitje publike.

Para se të bëhet shitja publike, magazinieri është i detyruar me ligj që paraprakisht ta njoftojë depozitëdhënësin për qëllimin e tij. Një detyrim tjetër i magazinierit është ai që t'i lërë në dispozicion atij një afat të ri jo më pak se prej tetë ditësh për tërheqjen e mallit.

Neni 752. Të metat me rastin e pranimit të mallit

- 1. Marrësi i mallit ka për detyrë ta kontrollojë mallin në çastin e pranimit të tij.**
- 2. Në qoftë se me rastin e pranimit të mallit vë re të metat, pranuesi ka për detyrë ta paralajmërojë menjëherë për këtë magazinierin, përndryshe konsiderohet se malli është pranuar në rregull.**
- 3. Për të metat e mallit që nuk kanë mund të konstatohen në çastin e pranimit, marrësi ka për detyrë në mënyrë të sigurt ta lajmërojë magazinierin brenda shtatë ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të mallit, përndryshe konsiderohet se malli është pranuar në rregull.**

Të metat me rastin e pranimit të mallit rregullohen në nenin 751 të LMD. Ekziston detyrimi ligjor i parashikuar në paragrafin 1 të nenit 751 të LMD, sipas të cilit marrësi i mallit ka për detyrë ta kontrollojë mallin në çastin e pranimit të tij. Magazinieri ka për detyrë t'ia tërheqë vërejtjen depozitëdhënësit për të metat ose cilësitë natyrore të mallit, përkatësisht për ambalazhin e parregullt, për shkak të të cilave mund të ndodhë dëmtimi i mallit, posa t'i ketë vënë re të metat e përmendura ose të cilat është dashur t'i vinte re.

Parag. 2 i këtij neni parashikon situatën kur me rastin e pranimin e mallit pranuesi vë re të metat dhe ai atëherë ka për detyrë ta vërë menjëherë në dijeni për këtë magazinierin, përndryshe konsiderohet se malli është pranuar në rregull. Në qoftë se nuk veprohet kështu, konsiderohet se malli nuk ka të meta të dukshme dhe dëmtime dhe se është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e magazinierit.

Parag. 3 i këtij neni parashikon rastin për të metat e mallit që nuk kanë mundur të konstatohen në çastin e pranimin. Për të metat e mallit që nuk kanë mundur të konstatohen në çastin e pranimin, marrësi ka për detyrë ta lajmërojë në mënyrë të sigurt magazinierin. Lajmërimi duhet bërë në afatin prej shtatë ditësh. Me këtë rast, lajmërimi në afatin shtatëditor bëhet duke llogaritur nga dita e pranimin të mallit, përndryshe ligji përcakton se konsiderohet se malli tjetër është i pranuar në rregull. Këtu duhet theksuar se lajmërimi duhet të paraqitet me shkrim, edhe pse Ligji shprehimisht nuk e përcakton këtë.

Neni 753. Zbatimi i rregullave për depozitën

Në kontratat për magazinimin përshtatshëmrisht zbatohen rregullat për depozitën, në qoftë se me rregullat e magazinimit nuk është rregulluar ndryshe.

Rregullat për depozitën zbatohen përshtatshëmrisht te kontratat për magazinimin, në qoftë se me rregullat e magazinimit nuk është rregulluar ndryshe. (Për këtë çështje, shih komentet e prezantuara te kontrata për depozitën).

KREU 2 FLETËMAGAZINIMI

Neni 754. Detyra e dhënies së fletëmagazinimit

Magazinieri i cili në bazë të ligjit është i autorizuar që për mallin e pranuar për magazinim të lëshojë fletëmagazinimin ka për detyrë t'ia japë depozitëdhënësit me kërkesën e tij.

Neni 754 i LMD parashikon detyrimin e dhënies së fletëmagazinimit. Magazinieri, i cili në bazë të ligjit është i autorizuar që për mallin e pranuar për magazinim ta lëshojë fletëmagazinimin, ka për detyrë t'ia japë këtë depozitëdhënësit me kërkesë të tij.

Neni 755. Pjesët përbërëse dhe përmbajtja e fletëmagazinit

- 1. Fletëmagazini përbëhet nga çertifikata dhe fletëpengu.**
 - 2. Dëftesa dhe fletëpengu përmbajnë këto të dhëna: emërtimin, përkatësisht emrin dhe profesionin e depozitëdhënësit, selinë përkatësisht vendbanimin e përhershëm të tij, emërtimin dhe selinë e magazinierit, datën dhe numrin e fletëmagazinit, vendin ku ndodhet magazina, llojin, natyrën dhe sasinë e mallit, të dhënën se deri në cilën shumë është siguruar malli dhe të dhëna tjera të nevojshme për njohjen e mallit dhe caktimin e vlerës së tij.**
 - 3. Dëftesa dhe fletëpengu duhet t'i referohen njëra-tjetrës.**
-

Lëshimin e fletëmagazinit e bën magazina. Lëshimi i këtij dokumenti bëhet me rastin e pranimit të mallit për ruajtje. Fletëmagazini përbëhet nga çertifikata dhe fletëpengu. Fletëmagazini shërben si provë për lidhjen e kontratës për magazinimin e mallit. Fletëmagazini-dëftesa dhe fletëpengu përmbajnë këto të dhëna: 1) emërtimin, ecurinë dhe profesionin e depozitëdhënësit, 2) selinë, vendbanimin e përhershëm të tij, 3) emërtimin dhe selinë e magazinierit, 4) datën dhe numrin e fletëmagazinit, 5) vendin ku ndodhet magazina, 6) llojin, 7) natyrën dhe sasinë e mallit, 8) shumën e siguruar të mallit, 9) vlerën e tij.

Fletëmagazini lëshohet vetëm në një ekzemplar.

Parag. 3 i këtij neni parashikon shprehimisht se dëftesa dhe fletëpengu duhet t'i referohen njëra-tjetrës.

Neni 756. Fletëmagazini për pjesët e mallrave

- 1. Depozitëdhënësi mund të kërkojë që magazinieri t'i ndajë mallrat në pjesë të caktuara dhe që për secilën pjesë t'i lëshojë fletëmagazini të veçantë.**
 - 2. Në qoftë se ka marrë fletëmagazinin për krejt sasinë e mallit, ai mund të kërkojë që magazinieri t'i ndajë mallrat në pjesë të caktuara dhe në ndërrim të fletëmagazinit që e ka marrë, t'i lëshojë fletëmagazinin për secilën pjesë të veçantë.**
 - 3. Depozitëdhënësi mund të kërkojë që magazinieri t'i lëshojë fletëmagazinin vetëm për një pjesë të mallit të zëvendësueshëm që e ka lënë te ai.**
-

Fletëmagazini për pjesët e mallrave rregullohet në nenin 756 të LMD. Depozitëdhënësi ka të drejtën që të kërkojë që magazinieri t'i ndajë mallrat në pjesë të caktuara. Kjo e drejtë është parashikuar në parag. 1 të nenit 756 të LMD. Përveç kësaj të drejte, depozitëdhënësi ka të drejtë të kërkojë që për secilën pjesë t'i lëshohet fletëmagazini i veçantë. Kjo e drejtë është e parashikuar me qëllim të mbrojtjes më të mirë të interesit të depozitëdhënësit. Parag. 2 i nenit 756 të LMD parashikon mundësitë e caktuara të depozitëdhënësit. **Së pari,**

ai mund të kërkojë që magazinieri t'i ndajë mallrat në pjesë të caktuara, në qoftë se ka marrë fletëmagazinimin për krejt sasinë e mallit; **së dyti**, në qoftë se ka marrë fletëmagazinimin për krejt sasinë e mallit që e ka marrë; **së treti**, depozitëdhënësi ka të drejtë të kërkojë t'i lëshohet fletëmagazinim për secilën pjesë të veçantë.

Paragrafi i këtij neni parashikon të drejtën e depozitëdhënësit të kërkojë që magazinieri t'i lëshojë fletëmagazinimin vetëm për një pjesë të mallit të zëvendësueshëm që e ka lënë tek ai, pra këtu është fjala për sendet e zëvendësueshme res in genere.

Neni 757. Të drejtat e poseduesit të fletëmagazinimit

- 1. Poseduesi i fletëmagazinimit ka të drejtë të kërkojë që t'i dorëzohet malli i shënuar në të.**
- 2. Ai mund të disponojë mallrat e shënuara në fletëmagazinimin me bartjen e fletëmagazinimit.**

Të drejtat e zotëruesit të fletëmagazinimit rregullohen me nenin 757 të LMD. Zotëruesi i fletëmagazinimit ka të drejtë, në bazë të parag. 1 të nenit 757 të LMD, të kërkojë që t'i dorëzohet malli i shënuar në të.

Siç u tha më sipër, lëshimin e fletëmagazinimit e bën magazina. Lëshimi i këtij dokumenti bëhet me rastin e pranimit të mallit për ruajtje. Lëshimi i dublikatës mund të bëhet vetëm në rastin e amortizimit të dokumentit.

Sipas parag. 2, zotëruesi i fletëmagazinimit mund të disponojë mallrat e shënuar në fletëmagazinimin me bartjen e fletëmagazinimit.

Neni 758. Bartja e dëftesës dhe e fletëpengut

- 1. Dëftesa dhe fletëpengu mund të barten me indosament, bashkë ose ndaras.**
- 2. Me rastin e çdo bartjeje, në to duhet të shënohet data.**
- 3. Me kërkesën e pranuesit të dëftesës ose të fletëpengut, bartja në të do të regjistrohet në regjistrin e magazinës, ku do të shkruhet edhe selia përkatësisht vendbanimi i përhershëm i tij.**

Nëse fletëmagazinimi paraqet një dokument unik, bartja e një dokumenti të tillë bëhet duke përpiluar në shpinën e letrës deklaratën për bartje (nëse nuk bëhet fjalë për fletëmagazinimin sipas prurësit).

Nëse fletëmagazinimi përbëhet prej dy pjesëve dhe të dy pjesët barten mbi personin e njëjtë, nuk bëhet ndarja e varantit nga dëftesa, por deklarata për bartjen shënohet në

shpinën e dëftesës dhe me këtë automatikisht bëhet edhe bartja e varantit. Më së shpeshti i tërë fletëmagazinimi bartet mbi personin që ka blerë mallin e lënësit të mallit për ruajtje, derisa malli të gjendet në magazinë.

Nëse kemi të bëjmë me fletëmagazinimin sipas emrit, respektivisht nëse ekziston në të rekta klauzola, bartja bëhet me anën e cesionit juridiko-civil. Fletëmagazinimi sipas urdhrit bartet me anën e indosimit, ku aplikohen rregulla të ngjashme si te kambiali dhe çeku. Është e nevojshme të shënohet edhe data e bartjes.

Bartja e disa pjesëve të fletëmagazinimit gjen shprehje vetëm në rastet kur kjo letër përbëhet prej dy pjesësh. Parimisht, secila nga pjesët e fletëmagazinimit mund të qarkullojë në mënyrë të pavarur, kështu që dëftesa mund të bartet mbi një person, kurse varanti mbi personin tjetër.

Siç është thënë, me bartjen e varantit konstituohet e drejta e pengut mbi mallin në dobi të personit mbi të cilin varanti është ndalur. Për këtë arsye, në shumicën e shteteve bartja e parë e varantit duhet të shënohet në librin e magazinës publike. Në këtë mënyrë magazina lajmërohet për atë se kush është kreditori i pengut dhe në cilën shumë malli është i lënë peng, sepse kjo mund të ketë ndikim të madh në të drejtat e poseduesit të dëftesës. Nëse varanti indosohet, aplikohen rregulla të ngjashme (në pikëpamje të indosamentit), si edhe te kambiali. Në të drejtën tonë të evidencimi i bartjes në librin e magazinës bëhet vetëm me kërkesën e poseduesit të ri të dëftesës ose varantit.

Bartja e dëftesës më së shpeshti bëhet pas bartjes së varantit, por është e mundur edhe situata e kundërt. Nëse dëftesa indosohet pas varantit, konsiderohet se më parë është bërë lënia peng e mallit. Pasi dëftesa të jetë bartur sipas rregullës, me rastin e shitjes së mallit të personit që e ka lënë për ta ruajtur atë në magazinë, nga çmim i blerjes zbritet shuma për të cilën malli është lënë peng. Duhet cekur se e drejta e pronësisë së poseduesit të dëftesës është kufizuar në një masë të duhur me të drejtat e poseduesit të varantit.

Neni 759. E drejta e poseduesit të dëftesës

- 1. Bartja e dëftesës pa fletëpengun i jep marrësit të drejtën të kërkojë që t'i dorëzohet malli vetëm në qoftë se i paguan poseduesit të fletëpengut, ose i depoziton magazinierit për poseduesin e fletëpengut shumën që duhet t'i paguhet në ditën e rrjedhjes për pagesë të kërkesës.**
- 2. Poseduesi i dëftesës pa fletëpeng mund të kërkojë që malli të shitet, në qoftë se me çmimin e realizuar mund të paguhet shuma të cilën ka të drejtë poseduesi i fletëpengut, me kusht që teprica e realizuar t'i dorëzohet atij.**
- 3. Kur është fjala për sendet e zëvendësueshme, poseduesi i dëftesës pa fletëpengun mund të kërkojë që magazinieri t'i dorëzojë një pjesë të mallrave me kusht që t'i depozitojë magazinierit për llogari të poseduesit të fletëpengut shumën përkatëse në të holla.**

Bartja e dëftesës pa fletëpengun i jep marrësit të drejtën të kërkojë që t'i dorëzohet malli vetëm në qoftë se i paguan poseduesit të fletëpengut. Bartja e dëftesës pa fletëpengun i jep marrësit të drejtën që t'i depozitojë magazinierit për poseduesin e fletëpengut shumën që duhet t'i paguhet në ditën e rrjedhjes për pagesë të kërkesës. Kjo e drejtë është parashikuar në paragraf 1 të nenit 759 të LMD.

Në paragraf 2 të nenit 759 të LMD është parashikuar e drejta e zotëruesit të dëftesës pa fletëpeng, i cili mund të kërkojë që malli të shitet. Malli mund të shitet nëse plotësohet kushti që me çmimin e realizuar të mund të paguhet shuma për të cilën ka të drejtë poseduesi i fletëpengut, me kush që teprica e realizuar t'i dorëzohet atij.

Zotëruesi i dëftesës pa fletëpengun mund të kërkojë që magazinieri t'i dorëzojë një pjesë të mallrave, me kusht që t'i depozitojë magazinierit për llogari të poseduesit të fletëpengut shumën përkatëse në të holla. Ky rast është i lidhur me sendet e zëvendësueshme. Një mundësi e tillë është parashikuar shprehimisht në paragraf 3 të nenit 759.

Neni 760. E drejta e poseduesit të fletëpengut

- 1. Bartja e fletëpengut pa dëftesë i jep marrësit të drejtën e pengut të mallit.**
- 2. Me rastin e bartjes së parë në fletëpeng duhet të jenë të shkruara emërtimi, respektivisht emri dhe profesioni i kreditorit, selia e punës së tij afariste, respektivisht vendbanimi, shuma e kërkesës së tij, duke llogaritur edhe kamatën dhe datën e arritjes.**
- 3. Marrësi i parë i fletëpengut ka për detyrë që pa shtyrje t'i paraqes magazinierit se në të është bërë bartja e fletëpengut, ndërsa magazina ka për detyrë ta regjistrojë këtë bartje në regjistrin e vet dhe në vetë fletëpengun të shënojë se ky regjistrim është bërë.**
- 4. Pa kryerjen e veprimeve nga paragrafi paraprak, fletëpengu nuk mund të bartet më tej me indosament.**
- 5. Fletëpengu që nuk përmban shumën e kërkesës së kreditorit të pengut, detyron në dobi të kreditorit të pengut tërë vlerën e sendit të shënuar në të.**

E drejta e poseduesit të fletëpengut është parashikuar në nenin 760 në pesë paragrafe. Sipas paragraf 1 të këtij neni, bartja e fletëpengut pa dëftesë i jep marrësit të drejtën e pengut të mallit. Të drejtën e pengut të mallit e ka çdo person i cili në mënyrë të ndërgjegjshme ka ardhur te kjo e drejtë.

Paragraf 2 parashikon elementet që duhet t'i përmbajë bartja e parë në fletëpeng. Me rastin e bartjes së parë në fletëpeng, duhet të jenë të shkruara: 1) selia ose vendbanimi i përhershëm, 2) shuma e kërkesës së tij, 3) llogaritja e kamatave dhe 4) data e ruajtjes.

Ligji parashikon detyrimin e marrësit të parë të fletëpengut që pa shtyrje t'i paraqesë magazinierit se në të është bërë bartja e fletëpengut. Po ashtu, i njëjti paragraf (i 3-ti^e)

parashikon detyrën e magazinës që ta regjistrojë këtë bartje në regjistrin e vet dhe në vetë fletëpengun të shënojë se ky regjistrim është bërë. Në qoftë se këto veprime nuk janë kryer, Ligji shkon më tutje dhe në parag. 4, parashikon që fletëpengu nuk mund të bartet më tej me indosament. Fletëpengu që nuk përmban shumën e kërkesës së kreditorit të pengut, detyron në dobi të kreditorit të pengut tërë vlerën e sendit të shënuar në të. Kjo dispozitë juridike është parashikuar me qëllim të mbrojtjes së sigurisë juridike në qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve.

Neni 761. Protesta për shkak të mospagimit dhe shitjes së mallit

- 1. Poseduesi i fletëpengut pa dëftesë, të cilit nuk i paguhet brenda afatit kërkesa e siguruar me fletëpeng, ka për detyrë që nën kanosjen e humbjes së të drejtave të kërkojë pagimin nga bartësi, të paraqes protestën sipas ligjit mbi kambialin.**
- 2. Poseduesi i fletëpengut që e ka ngritur protestën mundet pas kalimit të tetë ditëve nga dita e arritjes së kërkesës, të kërkojë shitjen e mallit të lënë peng dhe e njëjta e drejtë i takon edhe bartësit që i ka paguar poseduesit të fletëpengut kërkesën e siguruar me fletëpeng.**
- 3. Nga shuma e realizuar nga shitja ndahet shuma e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të shitjes, të kërkesës së magazinierit nga kontrata për magazinimin dhe e kërkesave të tjera të tij të krijuara lidhur me lënien e mallit, e pastaj paguhet kërkesa e siguruar e poseduesit të fletëpengut , kurse mbetja i takon poseduesit të dëftesës.**

Bartja e varantit do të thotë se malli është lënë peng dhe poseduesi i dëftesës është i detyruar që të paguajë shumën e shënuar në varant, nëse dëshiron ta disponojë mallin. Mirëpo, nëse poseduesi i varantit refuzon ta pranojë pagesën ose nëse nuk është e ditur se te kush gjendet varanti, poseduesi i dëftesës ka të drejtë të deponojë (te gjykata, ndonjë bankë ose magazinë publike) shumën të cilën e ka të shënuar në varant dhe pastaj fiton të drejtën që të tërheqë mallin nga depoja.

Nëse poseduesi i dëftesës refuzon të bëjë pagesën e varantit në kohën e arritjes së detyrimit të tij, poseduesi i varantit duhet të ngrejë protestë për shkak të mospagesës së varantit. Në bazë të protestës së paraqitur, ai fiton të drejtën që nga magazina të kërkojë shitjen publike të mallit, me qëllim të pagesës së kërkesës së tij.

Nëse shuma e fituar me shitje nuk mjafton për ta paguar kërkesën e poseduesit të varantit, ai ka të drejtë t'u drejtohet me kërkesë regresi nënshkruarve të tjerë të varantit. Para kryerjes së regresit, është e nevojshme që poseduesi i varantit ta kryejë edhe notifikimin, d.m.th., t'i lajmërojë nënshkruarit të varantit për protestën e paraqitur dhe arritjen e detyrimit të tyre. Lidhur me notifikimin dhe regresin zbatohen rregulla të ngjashme me ato që aplikohen te kambiali dhe çeku, gjë që gjithashtu vlen edhe për protestën.

Varanti (fletëpengu) nuk mund të bartet më tutje me anë të indosimit, nëse shembulli i parë i fletëpengut (indosatori) nuk e ka njoftuar magazinën se është bartur mbi të fletëpengu (varanti) dhe nëse magazina nuk e ka shënuar në vetë varantin se kjo bartje është kryer.

Që të mund të arkëtohen kërkesat e tij në bazë të fletëpengut, poseduesi i varantit, në kohën e arritjes së varantit, nëse kërkesa nuk i paguhet, duhet më parë të paraqesë protestë sipas dispozitave të së drejtës së kambialit. Në rast të kundërt, poseduesi i varantit humb të drejtën që të kërkojë pagesën nga indosanti i varantit.

Pas paraqitjes së protestës, poseduesi i varantit mund të kërkojë shitjen e mallit të lënë peng në afatin prej 8 ditësh. Nëse ndonjëri nga indosantët e varantit e paguan kërkesën e poseduesit të varantit, mund të kërkojë shitjen e sendit të lënë peng në afatin prej 8 ditësh nga pagesa e varantit.

Protesta të cilën e paraqet poseduesi i varantit, në një kuptim të duhur, ka fuqi suspensive. Në të vërtetë, poseduesi i varantit duhet, pas ngritjes së protestës, të kërkojë shitjen e mallit të lënë peng në afatin e caktuar ligjor, përndryshe do t'i humbë të drejtat e tij të regresit, të drejtat ndaj indosantëve të varantit.

Neni 762. Kërkesa e pagimit nga bartësi i fletëpengut

- 1. Poseduesi i fletëpengut mund të kërkojë pagimin nga bartësi vetëm në qoftë se nuk ka mundë të realizojë pagimin e plotë nga shitja e mallit peng.**
- 2. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në afatin e caktuar në ligjin e veçantë për kambialin për kërkesën kundër indosantëve dhe ky afat fillon të rrjedhë nga dita kur është bërë shitja e mallit.**
- 3. Poseduesi i fletëpengut humb të drejtën për të kërkuar pagimin nga bartësi në qoftë se nuk do të kërkojë shitjen e mallit jo me vonë se brenda një muaji nga data e protestës.**

Kërkesa e pagimit nga bartësi i fletëpengut rregullohet në nenin 762 të LMD.

Sipas nenit 762 të LMD, poseduesi i fletëpengut pa dëftesë, të cilit nuk i paguhet brenda afatit kërkesa e siguruar me fletëpeng, ka për detyrë që, nën kanosjen e humbjes së të drejtave, të kërkojë pagimin nga kreditori, të paraqesë protestën sipas Ligjit për kambialin. Zotëruesi i fletëpengut që e ka ngritur protestën ka mundësi që, pas kalimit të tetë ditëve nga dita e arritjes së kërkesës, të kërkojë shitjen e mallit peng dhe e njëjta e drejtë i takon edhe bartësit që i ka paguar poseduesit të fletëpengut kërkesën e siguruar me fletëpeng.

Në rastet kur zotëruesi i fletëpengut nuk ka mundur të realizojë pagimin e plotë nga shitja e mallit peng, sipas parag. 1 të nenit 762, zotëruesi i fletëpengut mund të kërkojë pagimin nga bartësi vetëm në qoftë se nuk ka mundur të realizojë pagimin e plotë nga shitja e mallit peng. Sipas parag. 2 të nenit 762, kjo kërkesë duhet të paraqitet në afatin e caktuar në Ligjin për kambialin për kërkesën kundër indosentëve. Ky afat fillon të ecë nga dita kur është bërë shitja e mallit.

Për dallim nga parag. i dytë, parag. 3 i këtij neni parashikon një afat jo më vonë se brenda një muaji nga data e protestës. Zotëruesi i fletëpengut humb të drejtën për të kërkuar pagimin nga bartësi, në qoftë se nuk do të kërkojë shitjen e mallit jo më vonë se brenda një muaji nga data e protestës.

PJESA XV KONTRATA PËR URDHËRIN

KREU 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 763. Nocioni

- 1. Me kontratën për urdhrin detyrohet urdhërmarrësi ndaj urdhërdhënësit që për llogari të tij të ndërmerr punë juridike të caktuara.**
- 2. Njëkohësisht autorizohet urdhërmarrësi për marrjen e këtyre punëve.**
- 3. Urdhërmarrësi ka të drejtë në shpërblim për mundin e tij, përveç nëse diçka tjetër është kontraktuar ose rrjedh nga natyra e marrëdhënieve të ndërsjellta.**

Kontrata për urdhrin (dekretin) është kontratë e cila lidhet ndërmjet urdhërdhënësit (dekretdhënësit) dhe urdhërmarrësit (dekretmarrësit), me ç'rast urdhërmarrësi detyrohet ndaj urdhërdhënësit që në llogari të tij të kryejë punë të caktuara.

Si palë kontraktuese te kjo kontratë paraqiten: urdhërdhënësi (dekretdhënësi) dhe urdhërmarrësi (dekretmarrësi).

Te kjo kontratë me rëndësi është urdhri (dekreti) i personit për të cilin shërbimi që duhet t'i kryhet është shumë i nevojshëm. Kontrata për dekretin përfshin kryerjen e punëve faktike ose juridike për tjetrin, pra kryerjen nëpërmjet personit tjetër. Këtu i besohet kryerja e punës juridike ose faktike personit të veçantë, me ç'rast rreziku dhe dobia janë në dobi të dekretdhënësit. Akti vendimtar te kjo kontratë është se dekretmarrësi a e përmbush kontratën për llogari të dekretdhënësit.

Kontrata për dekretin veçohet me karakteristika të caktuara juridike, të cilat do t'i shqyrtojmë në vijim.

Sipas mendimit (teorisë) bashkëkohor të së drejtës së detyrimeve për nocionin e kontratës për dekretin, së pari ajo është *kontratë konsensuale*, e cila krijohet në çastin kur arrihet pëlqimi i vullnetit të palëve kontraktuese (dekretmarrësit dhe dekretdhënësit) për elementet thelbësore të kontratës. Në raste të caktuara kjo kontratë mund të jetë kontratë formale, kur këtë e parashikon ligji me dispozitë të veçantë. Kështu është kur lidhet kontrata për dekretin, në të cilën klienti detyrohet ,duke autorizuar avokatin, që ai ta përfaqësojë para gjykatës. Veç kësaj kjo është:

- *kontratë e dyanshme detyruese*, e cila krijon detyra reciproke për dekretdhënësin dhe dekretmarrësin;

- *kontratë me shpërblim*, sepse dekretmarrësi ka të drejtë për shpërblim për angazhimin e vet;
- *kontratë intuitu personae*, e cila lidhet duke pasur parasysh vetitë e veçanta të palëve kontraktuese, si dhe besimin reciprok të tyre; veçoria intuitu personae e kësaj kontrate mundëson që kjo të shuhet me vdekjen e palëve kontraktuese;
- *kontratë komutative*, sepse palët kontraktuese që në çastin e lidhjes së saj i dinë të drejtat dhe detyrat e tyre;
- *kontratë me emër*, të cilën në mënyrë të veçantë e rregullon ligji me dispozita shprehimore (nenet 763-784 të LMD).

Për t'u lidhur kontrata për dekretin kërkohen të plotësohen këto kushte të përgjithshme: aftësia punues e palëve kontraktuese, pëlqimi i vullnetit të tyre, lënda dhe baza e kontratës.

Zotësia e plotë për të vepruar e dekretmarrësit dhe dekretdhënësit është kusht i përgjithshëm dhe mjaft i rëndësishëm për vlefshmërinë e kësaj kontrate. Palët kontraktuese duhet të merren vesh për elementet thelbësore të saj. Punët që duhet të kryhen, duhet të caktohen me marrëveshje, duke vepruar në suazat e autorizimeve të veta.

Dekretdhënës në kontratën për dekretin mund të jetë personi që ka zotësi të plotë për të vepruar. Dekretdhënësi (si person fizik) mund t'ia besojë dekretmarrësit që ky t'i kryejë punët juridike ose fizike që lejohen me LMD. Dekretdhënësi, (si person juridik), mund t'ia besojë kryerjen e punëve juridike apo faktike një personi tjetër juridik ose fizik, por duke respektuar zotësinë e vet për të vepruar. Autorizimet që i jep dekretdhënësi dekretmarrësit duhet të jenë në suazat e subjektivitetit të vet, sepse, nëse bën tejkalime në këtë drejtim, atëherë veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm.

Dekretmarrësi duhet të ketë zotësi për të vepruar që të mund të ndërmarrë veprime juridike ose faktike në emër të vet dhe për llogari të dekretdhënësit.

Objekt i kësaj kontrate mund të jetë: kryerja e punës juridike ose faktike për tjetrin si dhe shërbimet intelektuale. Këto punë i kryen dekretmarrësi për dekretdhënësin me shpërblim, të cilin duhet ta marrë dekretmarrësi.

Dekretmarrësi i kryen punët në emër të vet dhe për llogari të dekretdhënësit. Pasi që në kryerjen e këtyre punëve rëndom mbrohet interesi i dekretdhënësit, atëherë kërkohet që ky të jetë i informuar për çdo ndryshim.

Dhënia e shpërblimit me kontratën për dekretin është element thelbësor i kësaj kontrate. Dekretmarrësi ka të drejtën e shpërblimit për punën e vet, përveç në qoftë se është kontraktuar ndryshe ose rezulton nga vetë karakteri i marrëdhënieve të ndërsjella.

Shpërblimi në këtë kontratë duhet të jetë adekuat për punën që është kryer. Shuma e shpërblimit caktohet në bazë të kontratës. Nëse nuk është caktuar në bazë të kontratës,

atëherë shpërblimi paguhet me një shumë të rëndomtë. Në rast se për shumën e shpërblimit nuk ekzistojnë doke, atëherë dekretdhënësi ka detyrimin të japë një shpërblim të drejtë. Nëse ndodh që dekretmarrësi të ketë kryer pjesërisht punën, atëherë shpërblimi jepet në harmoni ose në përpjesëtim me punën e kryer. Mirëpo kur shpërblimi është më i madh se puna që ka kryer dekretmarrësi, atëherë shpërblimi zvogëlohet proporcionalisht me rezultatet e punës. Këtë zvogëlim e bënë gjykata me kërkesë të dekretdhënësit.

Neni 764. Personat që kanë për detyrë të përgjigjen në ofertën e urdhrimit

Kush merret me kryerjen e punëve të huaja si profesion ose ofrohet publikisht për kryerjen e këtyre punëve ka për detyrë, në qoftë se nuk do të pranojë dekretin e ofruar që ka të bëjë me këto punë, për këtë shtyrje ta njoftojë palën tjetër, përndryshe përgjigjet për dëmin që do ta pësonte pala për shkak të kësaj. 163

Me nenin 764 të LMD rregullohet detyrimi i subjektit që merret profesionalisht me dhënien e shërbimeve sipas dekretit. Subjekti që merret me kryerjen e punëve të huaja, si profesion, ose ofrohet publikisht për kryerjen e këtyre punëve, ka për detyrë që, kur nuk do ta pranojë dekretin e ofruar që ka të bëjë me këto punë, ta njoftojë për këtë palën tjetër. Në qoftë se këtë detyrim nuk e përmbush, ai përgjigjet për dëmin që do ta pësonte pala për shkak të kësaj.

KREU 2

DETYRIMET E DEKRETMARRËSIT

Neni 765. Zbatimi i urdhrimit sikundër është deklaruar

- 1. Dekretmarrësi ka për detyrë ta kryejë dekretin sipas udhëzimeve të marra me kujdesin e ndërmarrësit të mirë, përkatësisht shtëpiakut të mirë, duke mbetur në kufijtë e tij dhe të kujdeset krejtësisht për interesat e dekretdhënësit dhe të udhëhiqet prej tyre.**
- 2. Kur dekretmarrësi konsideron se kryerja e dekretit sipas udhëzimeve të marra do të ishte e dëmshme për dekretdhënësin, ky ka për detyrë t'ia tërheqë vëmendjen e tij dhe të kërkojë udhëzime të reja.**
- 3. Në qoftë se dekretdhënësi nuk ka dhënë udhëzime të caktuara për punën që duhet ta kryejë, dekretmarrësi ka për detyrë duke u udhëhequr nga interesat e dekretdhënësit, të veprojë si ekonomist i mirë përkatësisht si shtëpiak i mirë, e në qoftë se dekreti është pa shpërblim, ashtu si do të vepronte në rrethana të njëjta në çështjen e vet.**

Përveç të drejtave, dekretmarrësi ka edhe detyrime të caktuara. Detyrat e dekretmarrësit janë:

- 1) të kryejë punën juridike ose faktike sipas udhëzimeve dhe dekretit. Këto punë ai duhet t'i kryejë si ekonomist i mirë, duke pasur parasysh interesin e dekretdhënësit;

- 2) punët e marra përsipër duhet personalisht t'i kryejë dekretmarrësi;
- 3) të paraqesë llogari për punën e kryer;
- 4) me kërkesë të dekretdhënësit, të paraqesë raport për gjendjen e punëve dhe të japë llogari edhe para kohës së caktuar;
- 5) në qoftë se dekretmarrësi ka përdorur për nevojat e veta paratë që i ka marrë për dekretdhënësin, ka për detyrim të paguajë kamatën sipas shkallës më të lartë të lejueshme të kontraktuar, duke llogaritur nga dita e përdorimit, kurse për të hollat e tjera të debituar që nuk i ka dorëzuar me kohë – kamatëvonesën e llogaritur nga dita kur e ka pasur për detyrim t'i dorëzojë ato;
- 6) kur dekretdhënësi konsideron se kryerja e dekretit sipas udhëzimeve të marra do të ishte e dëmshme për dekretdhënësin, ky nuk ka për detyrim t'ia tërheqë vëmendjen dhe të kërkojë udhëzime të reja.

Neni 766. Shmangia nga dekreti (urdhri) dhe udhëzimi

- 1. Nga dekreti dhe udhëzimet e marra dekretmarrësi mund të shmanget vetëm me pëlqimin e dekretdhënësit, e kur për shkak të kohës së shkurtër ose të ndonjë shkakut tjetër nuk ka mundësi të kërkojë pëlqimin e dekretdhënësit, ai mund të shmanget nga dekreti dhe udhëzimet vetëm në qoftë se sipas vlerësimit të të gjitha rrethanave ka mundësi të konsiderojë me bazë se këtë e kërkojnë interesat e dekretdhënësit.**
- 2. Në qoftë se dekretmarrësi tejkalon kufijtë e dekretit ose të largohet nga udhëzimet e marra, jashtë rastit të parashikuar në paragrafin paraparak, nuk do të konsiderohet si dekretmarrës, por si punëdrejtues pa urdhër, përveç nëse dekretdhënësi më vonë jep pëlqimin për atë që ka bërë ky.**

Dekretmarrësi ka këto të drejta:

të kërkojë shpërblim të caktuar për punën e kryer,

t'i shmanget dekretit dhe udhëzimit, në qoftë se, në bazë të vlerësimit të të gjitha rrethanave, atë e ka kërkuar interesi i dekretdhënësit;

t'ia besojë punën dikujt tjetër, nëse për këtë ka dhënë pëlqim dekretdhënësi, kurse këtë e kanë kërkuar rrethanat e rastit konkret.

Neni 767. Zëvendësimi

1. Dekretmarrësi ka për detyrë ta kryejë dekretin personalisht.
2. Ai mund t'ia besojë kryerjen e dekretit tjetrit vetëm në qoftë se dekretdhënësi ia ka lejuar këtë, dhe në qoftë se në këtë ka qenë i shtrënguar nga rrethanat.
3. Në këto raste ai përgjigjet vetëm për zgjedhjen e përfaqësuesit dhe për udhëzimet që ia ka dhënë.
4. Në raste e tjera ai përgjigjet vetëm për punën e zëvendësuesit, si dhe për shkatërrimin e rastësishëm ose të dëmtimit të sendit që do të shkaktoheshin te zëvendësuesi.
5. Dekretdhënësi mundet në çdo rast të kërkojë drejtpërdrejt nga zëvendësuesi kryerjen e detyrimit nga dekreti.

Kontrata për dekretin është kontratë *intuitu personae*, e cila lidhet duke pasur parasysh vetitë e veçanta të palëve kontraktuese dhe besimin reciprok të tyre. Duke marrë parasysh këtë karakteristikë të kontratës, dekretmarrësi ka detyrimin ta kryejë dekretin personalisht. Kjo është parashikuar shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 767 të LMD.

Dekretmarrësi ka mundësi t'ia besojë kryerjen e dekretit një personi tjetër pas plotësimit të këtyre dy kushteve themelore: *së pari*, në qoftë se dekretdhënësi ia ka lejuar këtë dhe, *së dyti*, në qoftë se këtë ka qenë ta bëjë i shtrënguar nga rrethanat.

Në qoftë se plotësohen këto dy kushte, në këto raste, sipas parag. 3, dekretmarrësi përgjigjet vetëm për zgjedhjen e përfaqësuesit dhe për udhëzimet që ia ka dhënë.

Në parag. 4 të këtij neni konstatohet se, në qoftë se nuk respektohen këto dy kushte të përjashtimit, atëherë dekretmarrësi përgjigjet vetëm për zgjedhjen e zëvendësuesit dhe për shkatërrimin e rastësishëm ose të dëmtimit të sendit, që do të shkaktoheshin te zëvendësuesi.

Parag. 5 i këtij neni parashikon të drejtën e dekretdhënësit që në çdo rast të kërkojë drejtpërdrejt nga zëvendësuesi kryerjen e detyrimit që buron nga kontrata e lidhur për dekretin.

Neni 768. Dhënia e llogarive

Për punën e kryer dekretmarrësi ka për detyrë të japë llogari dhe t' dorëzojë pa shtyrje dekretdhënësit gjithçka ka marrë në bazë të kryerjes së punëve të besuara, pavarësisht nëse këto që ka marrë nga dekretdhënësi i ka borxh këtij ose jo.

Dhënia e llogarive për punën e kryer është detyrim i dekretmarrësit. Për punën e kryer dekretmarrësi ka për detyrë të japë llogari dhe t' dorëzojë pa shtyrje dekretdhënësit gjithçka që ka marrë në bazë të kryerjes së punëve të besuara, pa marrë parasysh dhe pavarësisht nëse këto që ka marrë nga dekretdhënësi ia ka borxh këtij ose jo.

Dekretdhënësi ka të drejtë të kërkojë që puna të kryhet sipas marrëveshjes me dekretmarrësin.

Dekretdhënësi ka të drejtë të kërkojë dhënien e llogarisë për punën e kryer, paraqitjen e raportit për gjendjen e punëve, kumatën për mjetet që ka marrë dekretmarrësi dhe përgjegjësinë e dekretmarrësve, nëse kanë shkaktuar ndonjë lëshim ose dëm në kryerjen e punëve.

Neni 769.Paraqitja e raportit

Dekretmarrësi ka për detyrë që me kërkesën e dekretdhënësit, të paraqes raport për gjendjen e punëve dhe të japë llogari edhe para kohës së caktuar.

Dekretmarrësi ka për detyrë të japë llogari për punën e kryer. Kjo çështje është sanksionuar në nenin 769 të LMD. Sipas kësaj dispozite, dekretmarrësi për punën e kryer duhet t'i japë llogari pa shtyrje dekretdhënësit. Përmes kësaj llogarie dekretmarrësi jep raport detaj për punën e kryer, duke dorëzuar çdo gjë që ka marrë sipas bazës së punëve të kryera. Dekretmarrësi punët që kryen sipas kësaj kontrate i bën për llogari të dekretmarrësit, por në emër të tij. Në këto punë ai ka për detyrë gjithnjë ta mbrojë interesin e dekretdhënësit ndaj personave të tretë që ky ka krijuar, duke kryer punët e dekretdhënësit. Këtë raport që e jep, dekretmarrësi zakonisht e bën në formën me shkrim, sepse kështu i jepet në mënyrë më të sigurt llogari dekretdhënësit për punën e kryer. Bile në praktikë për këtë raport ekzistojnë edhe formularë të caktuar.

Neni 770. Përgjegjësia për përdorimin e të hollave të dekretdhënësit

Në qoftë se dekretmarrësi është shërbyer për nevojat e veta me të hollat që i ka marrë për dekretdhënësin, ka për detyrë të paguajë kumatën sipas përqindjes më të lartë të lejueshme të kontraktuar, duke llogaritur nga dita e përdorimit, e për të hollat e tjera që janë borxh, që nuk i ka dorëzuar në kohë, kumatëvonesën, duke llogaritur nga dita kur ka pasur për detyrë ta dorëzojë.

Dekretmarrësi në raste të caktuara është i detyruar të paguajë kumatën për përdorimin e të hollave të dekretdhënësit. Këtë çështje e sanksionon LMD në nenin 770. Pra, këtu është rregull se, nëse dekretmarrësi i ka përdorur për nevojat e veta të hollat e dekretdhënësit, atëherë ai paguan kumatën me përqindjen më të lartë të kontraktuar. Afati i pagimit rrjedh prej ditës kur ka filluar të përdorë këto mjete, kurse për borxhin tjetër në të holla që nuk e ka dorëzuar me kohë, paguan kumatëvonesën, e cila ecën prej ditës kur ka qenë i detyruar t'ia dorëzojë borxhin dekretmarrësi - neni 770 i LMD. Këtu duhet vënë në dukje se, në qoftë se dekretmarrësi është organizatë, atëherë të hollat që ka marrë nga dekretdhënësi shkojnë nëpërmjet xhirollogarisë së vet dhe këto mjete ngelin gjersa i jep llogari dekretdhënësit. Këto mjete ekskluzivisht përdoren për kryerjen e punëve të dekretdhënësit. Përndryshe, në qoftë se i përdorë ato, ai paguan kumatën më të lartë që është lejuar sipas kontratës.

Në qoftë se dekretmarrësi është në vonesë në dorëzimin e të hollave që i ka marrë nga dekretdhënësi, atëherë ai paguan kamatën. Këtë e bën prej momentin kur ka rënë në vonesë gjer në momentin e kthimit të të hollave.⁶²⁹

Sipas rregullave të kësaj kontrate, dekretmarrësi ka për detyrë ta paraqesë raportin për gjendjen e punëve dhe të japë llogari para skadimit të kohës së caktuar. Ky detyrim i dekretmarrësit është sanksionuar në nenin 770 të LMD. Këtë raport mund ta kërkojë edhe vetë dekretdhënësi, prandaj dekretmarrësi duhet t'i japë atij informacion për gjendjen e punëve ose për fazën e kryerjes së tyre. Ky autorizim i dekretdhënësit është i arsyeshëm, sepse ai është i interesuar të kryhet puna me kohë, siç duhet dhe të bëhen sa më pak shpenzime. Sipas rregullave të kësaj kontrate, dekretdhënësi këtu nuk ka nevojë t'i tregojë arsyet për të cilat kërkon raportin për punën që kryhet. Arsyet mund të jenë të lidhura me afarizmin e dobët ose jolikuiditetin e dekretmarrësit ose me dyshimin ndaj kryerjes më rregull të punëve.

Neni 771. Përgjegjësia solidare e dekretmarrësve

Në qoftë se kryerja e ndonjë pune u është besuar disave me dekret të njëjtë për ta kryer bashkërisht, ata përgjigjen solidarisht për detyrimet nga ky dekret, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.

Ka raste kur disa dekretmarrës marrin përsipër kryerjen e punës ose punëve të caktuara. Në këtë rast, nëse bëhet ndonjë cenim i kontratës për dekretin, atëherë këta kanë përgjegjësi solidare. Kjo çështje është sanksionuar në neni 771 të LMD. Aty është fjala për rastin kur kryerja e ndonjë pune u besohet disa personave me dekret të njëjtë, që atë ta kryejnë bashkërisht. Ata, në këtë rast, për cenimin e kësaj kontrate përgjigjen solidarisht, përpos kur me kontratë e kanë parashikuar ose rregulluar ndryshe përgjegjësinë e tyre. Këtu, sikundër shihet, disa dekretmarrës kryejnë në emër të tyre dekretin, por për llogari të dekretdhënësit. Përgjegjësia solidare e tyre është e kufizuar vetëm për detyrat ndaj dekretdhënësit që rrjedhin nga kontrata për dekretin. Nëse njëri prej dekretmarrësve e ka përmbushur detyrën ndaj dekretdhënësit, kur ndodh cenimi i kontratës, atëherë dekretmarrësi që ka përmbushur këtë detyrë ka të drejtën e regresit ndaj dekretmarrësve të tjerë. Dekretmarrësit e tjerë tani këtij dekretmarrësi i përgjigjen sipas shkallës së fajit të tyre. Mirëpo, nëse nuk mund të vërtetohet shkalla e fajit të çdo dekretmarrësi, atëherë çdonjëri prej tyre përgjigjet në pjesë të barabarta ndaj këtij dekretmarrësi.⁶³⁰

629 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: *Vep. e nj.*, fq. 2328, Komentar ZOO II, Beog., fq. 239.

630 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 239-240, Dr. Ivan Bukljaš: Komentar ZOO I II, Zag., 1978, fq. 379, Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: *Vep. e nj.*, fq. 2328-2329.

KREU 3

DETYRIMET E DEKRETDHËNË-SIT

Neni 772. Paradhënia në të holla

Dekretdhënësi ka për detyrë që me kërkesën e dekretmarrësit t'i japë një shumë të caktuar të hollave për shpenzime të parashikuara.

Një ndër detyrimet e dekretdhënësit është dhënia e paradhënies në para. Dekretdhënësi ka për detyrë që, me kërkesë të dekretmarrësit, t'i japë këtij një shumë të caktuar të hollash për shpenzimet e parashikuara.

Këto shpenzime duhet të ndodhin në rastin konkret. Ligji e kushtëzon detyrimin e dekretdhënësit që, me kërkesë të dekretmarrësit, t'i japë një shumë të caktuar të hollash për shpenzime të parashikuara.

Neni 773. Shpërblimi i shpenzimeve dhe marrja e detyrimeve

- 1. Dekretdhënësi ka për detyrë t'i shpërblejë dekretmarrësit, edhe atëherë kur munda i tij pa fajin e tij nuk ka pasur sukses, të gjitha shpenzimet e nevojshme që i ka bërë për kryerjen e dekretit, me kamatë nga dita kur janë bërë.**
 - 2. Ai ka për detyrë të marrë përsipër detyrimet që dekretmarrësi i ka marrë mbi vete, duke i kryer në emër të vet punët e besuara ose në ndonjë mënyrë tjetër ta lirojë prej tyre.**
-

Dekretdhënësi ka edhe detyrime të caktuara, siç janë:

të paguajë shumën e caktuar të të hollave për harxhimet e parashikuara që nevojiten për kryerjen e punës;

t'i paguajë shpenzimet e nevojshme për kryerjen e dekretit;

t'ia shpërblejë dëmin dekretmarrësit që ky e ka pësuar duke kryer dekretin, por pa fajin e vet;

t'i paguajë shpërblimin dekretmarrësit për punën që e ka kryer në mbështetje të kontratës së tyre.

Neni 774. Shpërblimi i dëmit

Dekretdhënësi ka për detyrë t'ia shpërblejë dekretmarrësit dëmin, të cilin ky e ka pësuar pa fajin e vet në kryerjen e dekretit.

Shpërblimi i dëmit të kontrata për dekretin është parashikuar dhe rregulluar në nenin 774 të LMD. Në qoftë se dekretmarrësi ka kryer punën me ndërgjegje, atëherë ai nuk përgjigjet për dëmin eventual që shkaktohet me rastin e përmbushjes së dekretit pa fajin e vet. Në këtë rast konkret, për këtë dëm përgjigjet vetë dekretdhënësi. Sipas parag. 1 të nenit 774, dekretdhënësi ka detyrimin t'ia shpërblejë dekretmarrësit dëmin, të cilin ky e ka pësuar pa fajin e vet gjatë përmbushjes së dekretit. Në këtë rast, për këtë dëm përgjigjet vetë dekretdhënësi. Dekretmarrësi në këtë rast duhet të provojë se dëmi në të vërtetë është shkaktuar dhe se ai është shkaktuar pa fajin e tij.⁶³¹

Ndërkaq, konform parag. 2 të nenit 774, në qoftë se urdhërmarrësi në kryerjen e profesionit ose qarkullimit të mallërave dhe dhënien e shërbimeve, dekretdhënësi përgjigjet vetëm në qoftë se rreziku i paraqitur tejkalon rreziqet e rëndomta, që kryerja e këtij profesioni ose qarkullimi në mënyrë tipike bartë me vete. Pra, këtu kushtëzohet vetëm në qoftë “... se rreziku i paraqitur tejkalon rreziqet e rëndomta”.

Neni 775. Sasia e shpërblimit

Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, dekretdhënësi ka borxh shpërblimin në lartësinë e zakonshme, e në qoftë se mungojnë doket e tilla, atëherë shpërblimin e drejtë.

Palët kontraktuese mund ta caktojnë sasinë e shpërblimit me kontratë. Nëse ndryshe nuk është kontraktuar, dekretdhënësit i jepet shpërblimi i rëndomtë në sasinë që jepet sipas dokeve, e nëse mungojnë doket, atëherë shpërblimi i drejtë (neni 775 i LMD). Në këtë nen parashikohen dispozitat për përcaktimin e shpërblimit, të cilin dekretdhënësi duhet, sipas kontratës për dekretin, t'ia paguajë dekretmarrësit, në rast se ky shpërblim nuk është kontraktuar shprehimisht.

Shpërblimi, përkatësisht provizioni i dekretmarrësit në këtë rast i është nënshtruar rregullave të dokeve afariste, e nëse mungojnë doket afariste, shpërblimi duhet caktuar sipas drejtshmërisë. Shtrohet pyetja se çka kuptohet me “shpërblimin e drejtë”, dhe kush e cakton këtë shpërblim?

Me shpërblim të drejtë nënkuptohet shpërblimi objektiv, real i përcaktuar në treg, përkatësisht shpërblimi që jepet për të njëjtin nivel të punës profesionale të kryer dhe për të njëjtin apo për shpërblimin e ngjashëm.⁶³²

Te kontrata për dekretin, shpërblimin e drejtë duhet ta caktojnë palët kontraktuese, me marrëveshje, për dallim nga një numër i kontratave në ekonomi, të cilat, sipas LMD,

631 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: *Vep. e nj.*, fq. 2331.

632 A. Alishani, *E drejta e detyrimeve*, pjesa e veçantë, Prishtinë, 1990, fq. 330.

shpërblimin e drejtë e cakton gjykata,⁶³³ duke marrë parasysh rrethanat e rastit të punës konkrete juridike.⁶³⁴

Neni 776. Pagimi i shpërblimit

- 1. Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, dekretdhënësi ka për detyrë t'i paguajë dekretmarrësit shpërblimin pas kryerjes së punës.**
- 2. Në qoftë se dekretmarrësi pa fajin e vet e ka kryer urdhrin vetëm pjesërisht, atëherë ai ka të drejtë në pjesën e shpërblimit proporcional.**
- 3. Në rastin kur shpërblimi i parakontraktuar do të ishte në shpërpjesëtim të hapur me shërbimet e bëra urdhërdhënësi mund të kërkojë zvogëlimin e tij.**

Në rast se shpërblimi kontraktues do të ishte në shpërpjesëtim me shërbimet e bëra, dekretdhënësi mund të kërkojë uljen e tij.

Shpërpjesëtimi i dukshëm ndërmjet punës së kryer dhe punës profesionale, në njërën anë, dhe sasisë së shpërblimit në anën tjetër, duhet mënjanuar nga palët kontraktuese, meqenëse LMD në këtë rast nuk parashikon intervenimin e gjykatës. Nëse palët kontraktuese nuk merren vesh, do të ekzistojë nevoja që këtë ulje ta bëjë gjykata.⁶³⁵

Neni 777. E drejta e pengut

Për sigurimin e shpërblimit dhe të shpenzimeve dekretmarrësi ka të drejta të pengut në sendet e luajtshme të dekretdhënësit që i ka marrë në bazë të dekretit, si dhe në shumat në të holla që i ka arkëtuar për llogari të dekretdhënësit.

Për sigurimin e shpërblimit dhe të shpenzimeve, dekretmarrësi ka të drejtën e pengut mbi sendet e luajtshme të dekretdhënësit që i ka marrë në bazë të dekretit, siç janë shumat në të holla që i ka arkëtuar për llogari të dekretdhënësit (neni 777 i LMD).

Nëse ndodh që nga sjellja e dekretdhënësit ose nga afarizmi i tij të rrjedhë një pasiguri e caktuar lidhur me atë se a do t'ia paguajë shpërblimin dhe shpenzimet dekretmarrësit, ligjdhënësi, duke u bazuar në këto dyshime, ka parashikuar të drejtën e pengut. Këtë të drejtë e ka parashikuar në nenin 777 të LMD për sigurimin e pagimit të shpërblimit dhe të shpenzimeve për punën e kryer në bazë të dekretit. Pra, këtu është parashikuar e

633 Komentar ZOO, Knjiga I, Kragujevac, 1980, fq. 563.

634 Hrvoje Momčinović: *Ugovori obaveznog prava*, Pravna knjiga, Zagreb, 1987, fq. 126, Dr. V. Kapor – Dr. S. Carić: *Ugovori robnog prometa*, Beograd, 1983, fq. 192, Ivica Jankovec, *Privredno pravo*, Beograd, 1981, fq. 374.

635 Hrvoje Momčinović, vepra e njejtë, fq. 126.

drejta ligjore e pengut mbi sendet e luajtshme të dekretdhënësit, të cilat dekretmarrësi i ka marrë në bazë të kontratës, si edhe mbi të hollat që ka inkasuar dekretmarrësi në llogari të dekretdhënësit. Me këtë dispozitë është shtuar siguria e inkasimit të shpërblimit dhe të shpenzimeve për kryerjen e punës.⁶³⁶

Neni 778l. Përgjegjësia solidare e dekretdhënësve

Në qoftë se disa prej tyre i kanë besuar dekretmarrësit kryerjen e dekretit, ata i përgjigjen atij solidarisht.

Dekretdhënësi gjithnjë nuk është një subjekt, sepse në praktikë ndodh që disa dekretdhënës t'ia besojnë kryerjen e punës dekretmarrësit. Këtë çështje LMD e ka sanksionuar në nenin 778, ku ka parashikuar përgjegjësinë solidare të dekretdhënësit. Kjo përgjegjësi e tyre është përgjegjësi ligjore. Këtu, sikundër shihet, përgjegjësia solidare e tyre nuk supozohet, por është e përcaktuar me dispozitë ligjore. Kjo përgjegjësi e dekretdhënësve është në interes të dekretmarrësit. Meqë përgjegjësia solidare ligjore nga kjo kontratë mund të përjashtohet, në qoftë se palët janë të ndërgjegjshme. Mirëpo, nëse palët janë të pandërgjegjshme, domethënë nëse përjashtimi rrjedh nga pozita më e fortë ekonomike e dekretdhënësit, atëherë kjo përgjegjësi nuk mund të përjashtohet.⁶³⁷

KREU 4

SHUARJA E DEKRETIT

Neni 779. Heqja dorë e dekretdhënësit nga kontrata

- 1. Dekretdhënësi mund të heq dorë nga kontrata.**
 - 2. Në rastin e heqjes dorë nga kontrata në të cilin dekretdhënësi i takon shpërblimi për punën e tij, dekretdhënësi ka për detyrë t'i paguajë dekretmarrësit pjesën përkatëse të shpërblimit dhe t'ia shpërblejë dëmin që e ka pësuar me heqjen dorë nga kontrata, në qoftë se për heqje dorë nuk ka pasur arsye të bazuara.**
-

Dekretdhënësi mund të heqë dorë nga kontrata. Në rastin e heqjes dorë nga kontrata, kur dekretdhënësi i takon shpërblimi për punën e tij, dekretdhënësi ka për detyrë t'i paguajë dekretmarrësit pjesën përkatëse të shpërblimit dhe t'ia kompensojë atë që ka pësuar nga heqja dorë prej kontratës, në qoftë se për heqjen dorë nuk ka pasur shkaqe të bazuara (neni 779 parag. 1, 2 të LMD).

636 Dr. Vladimir Kapor – Dr. Slavko Carić: *Vep. e nj.*, fq. 179-181, Dr. Martin Vedriš – Dr. Petar Klarić: *Vep. e nj.*, fq. 392-393, Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 246.

637 Dr. I. Bukljaš, Komentar ZOO, I, II, Zag., 1978, fq. 380.

Neni 780. Denoncimi i kontratës nga dekretmarrësi

- 1. Dekretmarrësi mund të denoncojë dekretin kur të dojë, por jo në kohë të papërshtatshme.**
- 2. Ai ka për detyrë t'i shpërblejë dekretdhënësit dëmin që ky e ka pësuar për shkak të denoncimit të dekretit në kohë të papërshtatshme, përveç nëse për denoncim kanë ekzistuar shkaqe të bazuara.**
- 3. Dekretdhënësi ka për detyrë të vazhdojë me kryerjen e punëve, të cilat nuk durojnë shtyrje edhe pas denoncimit të kontratës derisa dekretdhënësi do të mund të merrte kujdesin për to.**

Dekretmarrësi mund ta denoncojë dekretin kurdo që të dëshirojë, vetëm jo në kohë jo të duhur. Ai ka për detyrë t'ia kompensojë dekretdhënësit dëmin që e ka pësuar ky për shkak të renoncimit të dekretit jo në kohën e duhur, përveç kur për renoncim kanë ekzistuar shkaqe të arsyeshme (neni 780 parag. 2 i LMD).

Sipas nenit 780 parag. 2 të LMD, nëse dekretmarrësi denoncon kontratën për dekretin në kohë të pavolitshme dhe me këtë i shkaktohet dëm dekretdhënësit, atëherë ai përgjigjet për dëmin e shkaktuar, ndërsa kur dekretmarrësi ka bërë denoncimin me arsye dhe në kohë të volitshme, atëherë ai nuk përgjigjet për dëmin eventual që i është shkaktuar dekretdhënësit. Arsyeja themelore ose e bazuar për dhënien e denoncimit në praktikën afaristë ekziston kur dekretdhënësi vonohet në pikëpamje të detyrave të veta.⁶³⁸

Ligjdhënësi, nga ana tjetër, ka detyruar dekretmarrësin që, pas denoncimit, të kryejë punët që nuk durojnë shtyrje edhe ato gjersa dekretmarrësi nuk do të jetë në mundësi të kujdeset për kryerjen e tyre, neni 780 parag. 3 i LMD. Në këtë rregull përcaktohet sjellja e dekretmarrësit, pas dhënies së denoncimit, sepse detyrohet dekretmarrësi që t'i kryejë punët që nuk durojnë shtyrje edhe pas denoncimit. Këtë detyrim e ka gjersa dekretdhënësi nuk është në gjendje të kujdeset për këto punë. Këtu është kontestuese se sa kohë duhet të kujdeset dekretmarrësi për kryerjen e punëve që nuk durojnë shtyrje. Përgjigje duhet të jetë se ky afat nuk do të jetë më i gjatë, por duhet të jetë nëse ka mundësi pa shtyrje ose brenda afatit të kuptueshëm (të arsyeshëm). Në këtë rast dekretdhënësi mund t'i marrë t'i kryejë punët vetë ose t'ia besojë një dekretmarrësi tjetër. Por, gjithnjë brenda një afati relativisht të shkurtër.⁶³⁹

638 Dr. Ivan Bukljaš – Dr. Boris Vizner: Komentar ZOO, IV, Zag., 1979, fq. 234-235, Komentar ZOO, II Beog., 1980, fq. 248-249, Dr. Ivan Bukljaš: Komentar ZOO I, II, Zag., 1978, fq. 381, Dr. Vladimir Kapor – Dr. Slavko Carić: *Vep. e nj.*, fq. 180.

639 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 248.

Neni 781. Vdekja, shuarja e personit juridik

- 1. Dekreti shuhet me vdekjen e dekretmarrësit.**
 - 2. Trashëgimtarët e dekretmarrësit kanë për detyrë që për vdekjen e tij ta njoftojnë dekretdhënësin dhe të ndërmarrin çka është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të tij, gjersa nuk është në gjendje vetë të marrë kujdesin për to.**
 - 3. Dekreti shuhet me vdekjen e dekretdhënësit vetëm në qoftë se është kontraktuar kështu ose në qoftë se dekretmarrësi ka marrë urdhër duke marrë parasysht marrëdhëniet e veta personale me dekretdhënësin.**
 - 4. Në këtë rast dekretmarrësi ka për detyrë t'i zgjasë punët e besuara, në qoftë se do të shkaktohej dëmi për trashëgimtarët gjersa këta janë në pamundësi që të kujdesen vetë për to.**
 - 5. Në qoftë se dekretdhënësi ose dekretmarrësi është ndonjë person juridik, dekreti shuhet kur ai person pushon së ekzistuari.**
-

Dekreti shuhet me vdekjen e dekretmarrësit. Trashëgimtarët e dekretmarrësit kanë për detyrë që për vdekjen e tij ta njoftojnë sa më parë dekretdhënësin dhe të ndërmarrin çdo gjë që nevojitet për mbrojtjen e interesave të tij, derisa ai të mos jetë në gjendje të kujdeset vetë për to.

Dekreti shuhet me vdekjen e dekretdhënësit vetëm nëse është kontraktuar që në fillim nga palët kontraktuese. Siç është theksuar edhe në fillim, kjo kontratë është intuitu personae. Në qoftë se dekretdhënësi ose dekretmarrësi është një person juridik, dekreti pushon kur ky person të ketë pushuar së ekzistuari.

Neni 782. Falimentimi, heqja e aftësisë për të vepruar

Dekreti shuhet kur dekretdhënësi ose dekretmarrësi falimenton ose kur i hiqet plotësisht ose pjesërisht aftësia për të vepruar.

Kontrata për dekretin mund të shuhet, nëse dekretmarrësi dhe dekretdhënësi falimentojnë, kur hapet procedura e likuidimit të rregullt të palëve të lartpërmendura, ose kur i hiqet plotësisht ose tërësisht zotësia për të vepruar. Kjo është parashikuar shprehimisht në nenin 782 të LMD-së.

Neni 783. Çasti i shuarjes së dekretit

- 1. Kur dekretdhënësi ka hequr dorë nga kontrata si dhe kur ka vdekur ose ka falimentuar, ose i është hequr plotësisht ose pjesërisht zotësia për të vepruar, dekreti shuhet në çastin kur dekretmarrësi ka mësuar për ngjarjen për shkak të cilës dekreti shuhet.**
 - 2. Kur dekretmarrësit i lëshohet një prokurë me shkrim, ka për detyrë ta kthejë atë pas shuarjes së dekretit.**
-

Kur dekretdhënësi tërhiqet nga kontrata për dekretin, si dhe kur ai ka vdekur ose kur ka falimentuar ose kur është zhveshë pjesërisht ose tërësisht nga zotësia për të vepruar, atëherë dekreti shuhet në momentin kur dekretmarrësi ka kuptuar për ngjarjen nga e cila është shuar dekreti, neni 783 parag. 1 i LMD. Momenti i shuarjes së dekretit është me rëndësi që të vërtetohet, sepse prej këtij momenti ndryshe rregullohen çështjet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar dhe çështjet se kush e ka rrezikun për dëmtimin dhe humbjen e sendit. Kur bëhet shuarja e kontratës për dekretin dekretmarrësi që ka marrë autorizim me shkrim duhet t'ia kthejë atë dekretdhënësit.⁶⁴⁰

Neni 784. Përgjashtimet

Kur dekreti është dhënë që dekretmarrësi të mund të arrijë përmbushjen e ndonjë kërkesë të vet nga dekretdhënësi, dekretdhënësi nuk mund të heqë dorë nga kontrata dhe dekreti nuk shuhet as me vdekjen, as me falimentimin e dekretdhënësit ose dekretmarrësit, as kur njëri prej tyre është privuar plotësisht ose pjesërisht nga aftësia për të vepruar.

Neni 784 parashikon përgjashtimet, duke theksuar se, kur dekreti është dhënë me qëllim që dekretmarrësi të realizojë ndonjë kërkesë të tij nga dekretdhënësi, atëherë dekretdhënësi mund të heqë dorë nga kontrata, pra nëse dekreti është dhënë që dekretmarrësi të mund të arrijë përmbushjen e ndonjë kërkesë të vet nga dekretdhënësi, dekretdhënësi nuk mund të heqë dorë dhe dekreti nuk shuhet as me vdekjen, as me falimentimin e dekretdhënësit ose dekretmarrësit, as kur njëri prej tyre është privuar plotësisht ose pjesërisht nga zotësia për të vepruar.

.....
640 Komentar ZOO II, Beog., 1980, fq. 251-252.

*Sefadin Blakaj***PJESA GJASHTË
KONTRATA PËR KOMISIONIN****KREU 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 785. Nocioni**

- 1. Me kontratën për komisionin, komisionari detyrohet që për shpërblim (provizion) të kryejë në emër të vet dhe për llogari të komitentit një ose më shumë punë që ia ka besuar komitenti.**
- 2. Komisionari ka të drejtë në shpërblim edhe kur ky nuk është kontraktuar.**

785.1. Paragrafi i parë i nenit 785 të LMD jep kuptimin e kontratës për komisionin. Sipas përcaktimit të kuptimit të kësaj dispozite dhe diskutimit në teorinë juridike, kontrata për komisionin konsiderohet një marrëdhënie kontraktuese, e cila themelohet ndërmjet komitentit (urdhërdhënësit) dhe komisionarit (urdhërmarrësit), sipas së cilës komisionari pranon detyrimin që, në emrin e vet dhe për llogarinë e komitentit, të ekzekutojë ose të ndërmarrë një ose më shumë punë (juridike), përkatësisht të lidhë ndonjë kontratë, ndërsa komitenti për këtë ndërmarrje, si kundërvlerë për shërbimin e ofruar, i paguan komisionarit shpërblimin përkatës, përkatësisht provizionin. Vetë dispozita në fjalë saktëson natyrën juridike të kontratës për komisionin, duke specifikuar se komisionari, gjatë kryerjes së punëve juridike për komitentin e tij, vepron në emrin e vet, megjithëse punën juridike e kryen për llogari të komitentit të tij, domethënë, puna juridike që ndërmerret ekzekutohet për llogarinë e komitentit, (duke ngarkuar debinë ose kredinë e tij). Puna që komisionari merr përsipër të ekzekutojë për komitentin kryesisht është një punë - veprim juridik, p.sh., të lidhë një kontratë (shitje, blerje, etj.); megjithatë, krahas ekzekutimit të veprimit juridik - lidhjes së kontratës përkatëse, komisionari merr përsipër që të ekzekutojë edhe një tërësi veprimesh të tjera të nevojshme ligjore ose veprime faktike, të cilat kanë të bëjnë me lidhjen-ekzekutimin e kontratës. Kështu, për shembull, nëse komisionari ka marrë për detyrë të lidhë kontratë të shitjes, krahas lidhjes së kontratës, ai në të shumtën e rasteve merr përsipër pranimin e mallit, mbajtjen e mallit përderisa ai t'i dorëzohet komitentit, detyrimin e kontrollimit të zakonshëm të mallit në momentin e pranimit-dorëzimit, kompletimin e procedurave doganore në rast të importit të mallrave etj.⁶⁴¹

Në teorinë juridike, por edhe në praktikën gjyqësore, bëhet dallimi ndërmjet kontratës për komisionin dhe kontratës për përfaqësimin, (duke përfshirë edhe kontratën për përfaqësimin tregtar). Autor të ndryshëm i referohen shpesh debatit në lidhje me dallimet që ekzistojnë

641 Në lidhje me këtë shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 404.

ndërmjet këtyre dy llojeve të kontratave, sigurisht për shkak të ngjashmërive të shumta që ato kanë ndërmjet tyre. Kështu, thuhet se te kontrata e përfaqësimit, përfaqësuesi (i autorizuari) vepron në emrin e të përfaqësuarit (urdhërdhënësit) dhe për llogarinë e të përfaqësuarit. Nëse përfaqësuesi lidh kontratë me palën e tretë, kjo bëhet në emrin e të përfaqësuarit, (konsiderohet sikur ta ketë lidhur kontratën i përfaqësuari), ashtu që i përfaqësuari paraqitet si palë kontraktuese, kurse efektet e kontratës shkojnë në debinë dhe kredinë e përfaqësuesit. Për ndryshim nga kjo, te kontrata për komisionin, komisionari e kryen veprimin juridik në emrin e tij, gjë që do të thotë se cilësinë e palës kontraktuese e fiton vetë komisionari në kontratat që ai lidh me palët e treta, qëllimi dhe efekti juridik i të cilave është që të shkojnë në debinë, respektivisht në kredinë e komitentit. Në këtë kuptim, në kontratat që lidh komisionari me palët e treta as që paraqitet komitenti si palë, përkatësisht ai qëndron si palë e fshehur në raportin që krijohet ndërmjet komisionarit dhe palëve të treta.⁶⁴²

Kjo rezulton edhe nga dispozita në fjalë e LMD, sipas së cilës, në kontratën për komisionin paraqiten të paktën dy palë - komisionari dhe komitenti. Në praktikën juridike ndodh që në cilësinë e komisionarit, në rastet më të shpeshta, të paraqitet ndonjë ndërmarrje, entitet biznesi, përkatësisht person juridik që ofron shërbimin sipas kësaj kontrate si profesionist. Megjithatë, LMD nuk bën ndonjë dallim ndërmjet mundësisë që në cilësinë e cilësdo palë te kontrata për komisionin të paraqiten edhe personat fizikë.

Në pikëpamje të formës, LMD nuk vendos ndonjë pengesë për kontratën e komisionit, duke cilësuar këtë kontratë si kontratë konsensuale. Megjithatë, në praktikën juridike, në lidhje me kontraktimet në ekonomi, gjithnjë e më tepër kontratat komerciale ekzekutohen në formë të shkruar, përkatësisht në formë elektronike, e cila u mundëson palëve ta ruajnë dhe ta dokumentojnë përmbajtjen e kontratës, duke i përfshirë në këtë dukuri edhe kontratat për komisionin. Ekzekutimi i kontratave në formë shkresore ose në formë të dokumenteve (ose edhe në formë elektronike, ku përmbajtja e kontratës mund të ruhet në një format të përshtatshëm), gjithmonë argumentohet si një domosdoshmëri dhe kulturë juridike, e cila më së miri u shërben interesave të palëve dhe sigurisë së transaksionit, (pasi që me përpikëri ruhet përmbajtja e kontratës, e cila mund të jetë vendimtare gjatë ekzekutimit të detyrimeve reciproke të palëve, por edhe në rast të kontestit eventual, palët mund të përdorin format shkresore me qëllim të verifikimit dhe të të provuarit të përmbajtjes së kontratës).⁶⁴³

785.2. Rëndom, për punën e kryer në lidhje me kontratën për komisionin, komisionarit i takon e drejta e shpërblimit. Paragrafi i parë i nenit në fjalë shtjellon të drejtën e shpërblimit të komisionarit që i takon për punën e bërë sipas kësaj kontrate, përkatësisht të drejtën e shpërblimit ose provizionit si një kundërvlerë që komitenti duhet t'ia paguajë palës tjetër për shërbimin që ka marrë sipas kontratës. Zakonisht, shpërblimin dhe sasinë e tij në rastet më të shpeshta e kontraktajnë palët dhe LMD e respekton plotësisht vullnetin e palëve

642 Në lidhje me këtë shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 404.

643 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1710 - 1713;

në kontraktimin e shpërblimit, (i cili mund të paguhet si kundërvlerë në të holla ose në natyrë) dhe të saktësimit të sasisë së shpërblimit. Madje, paragrafi i dytë i nenit 785 të LMD saktëson se komisionarit i takon e drejta e shpërblimit edhe në qoftë se palët nuk e kanë përfshirë ose nuk e kanë specifikuar atë në kontratë. Mendohet se arsyeja e kësaj zgjidhjeje ligjore bazohet në faktin se kryerja e punëve të komisionarit bazohet në angazhimin e tij profesional dhe këtë shërbim, në të shumtën e rasteve, ai e ushtron si aktivitet afarist - për qëllime fitimi, ashtu që ushtrimi i këtij shërbimi kërkon prej tij një sjellje prej komisionari shumë të kujdesshëm dhe me përgjegjësi të lartë profesionale në ofrimin e shërbimeve ndaj komitentit të tij, kështu që kjo është një nga arsyet që çojnë në supozimin e të drejtës së komisionari për të kërkuar pagimin e shpërblimit për shërbimin e ofruar.

Neni 786. Zbatimi i rregullave për kontratën për dekretin

Në kontratën për komision zbatohen përshtatshmërisht rregullat për dekretin, në qoftë se me rregullat për komisionin nuk është caktuar ndryshe.

786. Kontrata për komisionin ka mjaft ngjashmëri edhe me kontratën për dekretin (kontratën për urdhrin). Kjo për faktin se, në momentin e kontraktimit, komisionari merr një sërë porosish, përkatësisht udhëzimesh ose urdhrash nga komitenti, qëllimi i të cilave është ta udhëzojnë, ta këshillojnë ose ta rregullojnë rrethin e veprimeve juridike (ose edhe faktike), që komisionari mund t'i ndërmarrë me personat e tretë. Prandaj, për këtë qëllim, duke e marrë në konsideratë këtë ngjashmëri të këtyre dy kontratave, neni 786 i LMD ka përcaktuar që, në rast të mungesës së dispozitave për komisionin, për një marrëdhënie të tillë përshtatshmërisht të zbatohen dispozitat e LMD, të cilat vlejnë për kontratën për urdhrin. Sigurisht, aplikimi i dispozitave të kontratës për urdhrin mund të gjejë shprehje vetëm për rastet kur LMD nuk e ka shtjelluar çështjen e dhënë në këto rregulla të kësaj pjese për kontratën për komisionin ose nëse palët çështjen në fjalë nuk e kanë rregulluar ose adresuar me rregulla të kontraktuara. Kjo pasi që, rregullat e kontratës për komisionin janë rregulla kryesisht të natyrës dispozitive, andaj palët sigurisht mund të kontraktojnë edhe ndryshe nga ajo që ka rregulluar LMD/ja për këtë kontratë. Në lidhje me kuptimin e rregullave të kontratës për dekretin, shih komentimin e neneve që kanë të bëjnë me kontratën për dekretin, duke filluar nga neni 763 deri në nenin 784 të LMD.⁶⁴⁴

644 Në lidhje me këtë, p.sh.. LMD, në pjesën ku flitet për kontratën për komisionin, nuk ka parashikuar ose rregulluar mundësinë e shuarjes së kontratës për komisionin; në këtë kuptim, rregullat e shuarjes së kontratës për dekretin mund të gjejnë zbatim edhe në lidhje me shuarjen e kontratës për komisionin (shih nenet 779 - 784 të LMD në pjesën ku flitet për shuarjen e dekretit), sigurisht nëse palët kontraktuese nuk kanë rregulluar diçka tjetër me kontratën e tyre.

Neni 787. Lidhja e punës nën kushte të ndryshme nga ato të dekretit

- 1. Në qoftë se komisionari ka kontraktuar ndonjë punë me kushte jo të favorshme nga ato që janë caktuar në dekret dhe kur ai për këtë nuk ka qenë i autorizuar, ka për detyrë t'ia shpërblejë komitentit diferencën si dhe dëmin e shkaktuar.**
- 2. Në rastin nga paragrafi paraprak komitenti mund të refuzojë të pranojë punën e lidhur, me kusht që për këtë ta njoftojë menjëherë komisionarin.**
- 3. Komitenti humb këtë të drejtë, në qoftë se komisionari tregon gatishmërinë t'ia paguajë menjëherë diferencën dhe të shpërblejë dëmin e shkaktuar.**
- 4. Në qoftë se puna është kontraktuar nën kushte më të përshtatshme nga ata që janë caktuar në dekret, e gjithë dobia e arritur në këtë mënyrë i takon komitentit.**

787.1. Të kontrata për komisionin, një nga detyrimet kryesore të komisionarit është detyrimi që ai i t'u përmbahet urdhrave, përkatësisht udhëzimeve të komitentit. Varësisht nga karakteri juridik i urdhrave të komitentit, përkatësisht nga fakti se si janë konstruktuar kërkesat dhe urdhrat e komitentit në kontratën për komisionin, në teorinë dhe praktikën juridike flitet për tri lloje urdhrash të komitentit: urdhrat imperative (kanë karakter detyrues për komisionarin, ashtu që ai nuk mund t'u shmanget atyre; çdo shmangie ka për pasojë përgjegjësinë e komisionarit për dëmin e pësuar nga komitenti); urdhrat në formë të udhëzimeve të përgjithshme me karakter instruktiv, fakultativ e të ngjashme, (që për nga karakteri i tyre juridik janë më pak detyruese, megjithatë, komisionari mund t'iu shmanget nëse e vlerëson si profesionist se ashtu është më mirë dhe më e favorshme për komitentin; në këtë rast përgjegjësia e komisionarit për lëshimet eventuale, si rezultat i shmangies nga urdhrat e komitentit, është e shtuar, pasi që komisionari i përgjigjet komitentit si profesionist në ofrimin e shërbimeve të komisionit, përkatësisht në kontratat jashtë ekonomisë standardi i sjelljes duhet të vlerësohet me standardin e shtëpiakut të mirë - njeriut të kujdesshëm).⁶⁴⁵

LMD, në paragrafin e parë të nenit 787, ka rregulluar situatën se çka ndodhë në rast se komisionari u shmanget urdhrave të komitentit dhe, për pasojë, ka kontraktuar kushte më të pafavorshme për komitentin. Në kuptim të paragrafit në fjalë, komisionari ka për obligim t'u përmbahet urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna nga komitenti, të saktësuara këto në kontratën për komisionin, të cilat ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve të komisionarit. Pavarësisht nga kjo, supozohet se komisionari gjatë ekzekutimit të urdhrave të komitentit duhet gjithmonë të vlerësojë dhe të mbrojë interesin më të mirë të komitentit e gjithashtu të respektojë edhe standardet më të larta profesionale të tij/saj, (nëse shërbimin sipas kontratave e jep si profesionist), ashtu që, duke përdorur dijeninë dhe përvojën e tij, të mundësojë që sa më mirë të mbrohen interesat e komitentit.

.....
⁶⁴⁵ Në lidhje me këtë, shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 406.

Në rast të shmangies së urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna nga komitenti, paragrafi në fjalë përcakton përgjegjësi për komisionarin. Sigurisht, nëse në kontratën për komisionin shprehimisht është saktësuar se urdhrat janë detyruese dhe nuk lejojnë shmangie, komisionari duhet t'u bindet atyre urdhrave, përndryshe krijon përgjegjësinë e vet ndaj komitentit, të cilit duhet t'i përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga shmangia e urdhrave.

Gjithashtu, paragrafi i parë i nenit në fjalë krijon përgjegjësi për komisionarin edhe për rastet kur ai ka kontraktuar kushte më pak të favorshme për komitentin, për rastet kur urdhrat kanë qenë të dhënë në formë të udhëzimeve ose të instruksioneve. Sigurisht, në rastet e tilla, komisionari, duke shfrytëzuar përvojën e tij më të mirë, duhet të vlerësojë në çdo rast interesin e komitentit dhe zgjedhjet përkatëse t'i bëjë në përputhje me këto interesa. Megjithatë, nëse në rastin konkret vlerësohet se zgjedhjet që janë bërë nga komisionari janë më pak të favorshme për komitentin, nga ato që në realitet ka mundur t'i ofrojë ose t'i ndërmarrë komisionari (dhe kjo të vlerësohet në kuptim të rrethanave të rastit të dhënë), atëherë themelohet detyrimi i komisionarit që komitentit të tij t'ia shpërblejë diferencën ndërmjet asaj që ka arritur dhe asaj që do të mund të arrinte në rastin e dhënë, e gjithashtu edhe shpërblimin e dëmit, nëse eventualisht komitenti ka pësuar ndonjë dëm. Sigurisht, në vlerësimin e asaj se cila do të ishte mundësia e veprimit në interesin më të mirë të komitentit, gjykata do t'i marrë parasysh rrethanat e rastit të dhënë, duke i çmuar si rrethanat subjektive që janë nën kontrollin ose në dorën e komisionarit, ashtu edhe mundësitë objektive të cilat komisionarit i janë ofruar në rastin e dhënë. P.sh., do të mund të supozohej ekzistimi i një situatë që konstituon në përgjegjësinë e komisionarit, nëse në rastin e dhënë ai e shet sendin e komitentit për një çmim më të ulët sesa është përcaktuar me urdhrin e komitentit, përndryshe ka mundur ta shesë sendin në fjalë me një çmim më të lartë, nëse rrethanat e tregut do t'ia mundësonin një gjë të tillë.⁶⁴⁶

787.2. Me qëllim të mbrojtjes së interesit të komitentit, për rastet kur komisionari devijon nga urdhrat e komitentit ose nuk vepron në interesin më të mirë të tij, LMD, në paragrafin e dytë të nenit 787, ka rregulluar mundësinë që komitenti t'i refuzoj fare dobitë ose rezultatin e punës së komisionarit të kontrata për komisionin. Që të ushtrojë këtë mundësi, komitenti duhet menjëherë të njoftojë komisionarin në lidhje me refuzimin e punëve ose të rezultateve të punëve të komisionarit. Pasi që LMD nuk tregon një afat të saktë, domethënë, sa duhet të zgjasë ky afat, në teorinë dhe praktikën juridike është zhvilluar mendimi që ky afat të jetë sa më i shkurtër, përkatësisht që njoftimi për refuzimin e rezultateve të punës t'i bëhet komisionarit menjëherë (ditën e njëjtë kur komitenti pranon rezultatet e punës), ose refuzimi t'i bëhet komisionarit më së largu deri në fund të ditës së nesërme, pas ditës kur komitenti ka pranuar njoftimin për rezultatet e punës nga komisionari.⁶⁴⁷

646 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga zdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1714 - 1715;

647 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1714 - 1715;

787.3. Me qëllim që të mos keqpërdoret mundësia që i është dhënë komitentit për refuzimin e rezultateve të punës sipas paragrafit të dytë të nenit 787 të LMD, por edhe me qëllim të mbrojtjes së drejtshmërisë në marrëdhëniet e detyrimeve, në paragrafin e tretë të nenit 787 të LMD, ligjvënësi ka rregulluar mundësinë që, megjithatë, komitenti të mos mund t'i refuzojë rezultatet e punës që përmban kontrata për komisionin, në qoftë se komisionari tregon gatishmëri të menjëhershme t'ia paguajë komitentit diferencën e fitimit, (përkatësisht të fitimeve që komitenti ka mundur t'i arrijë) dhe t'ia shpërblejë këtij dëmin eventual që ka pësuar.

787.4. Më tej, në nenin 787 të LMD, paragrafi i katërt, parashikohet që, nëse komisionari arrin rezultate më të mira të punës ose realizon kontraktime me kushte më të mira për komitentin, sesa kushtet e përcaktuara në kontratën për komisionin, e tërë dobia pasurore e arritur me këtë rast i takon komitentit (të zotit të punëve). Kjo zgjidhje juridike duket se është e arsyeshme, sepse kjo nënkuptohet edhe nga vetë natyra juridike e marrëdhënies së komisionit, pasi që komisionari vepron për llogarinë e komitentit. Sigurisht, nëse kontraktimi i kushteve më të mira i ka krijuar më shumë shpenzime komisionarit ose i ka marrë më shumë kohë në negociime, për raste të ngjashme komisionari ka bazë të justifikueshme të kërkojë rritje të shpërblimit ose të heqjes së shpenzimeve të cilat i janë shkaktuar për këtë qëllim; megjithatë, si parim, e tërë dobia e realizuar i takon komitentit. P.sh., do të mund të ekzistonte një rast i ngjashëm kur komisionari e blen sendin për komitentin nën çmimin e caktuar në kontratën e komisionit ose me kushte më të mira etj.

Neni 788. Shitja e mallit personit që ka shumë borxh

- 1. Komisionari ka për detyrë ta kryejë punën e marrë me kujdesin e ndërmarrësit të mirë.**
- 2. Komisionari i përgjigjet komitentit për dëmin, në qoftë se e ka zgjedhur personin e pabesueshëm për punën ose në qoftë se i ka shitur mallin personit, për borxhet e të cilit ai ka qenë në dijeni ose ka mundur të jetë në dijeni.**

788.1. Paragrafi i parë i nenit 788 të LMD vendos një standard të sjelljes së komisionarit. Në kuptim të paragrafit në fjalë, komisionari, gjatë ekzekutimit të urdhrave të komitentit, duhet të tregojë kujdesin e ndërmarrësit, përkatësisht të ekonomistit të mirë. Standardi i ekonomistit të mirë nënkupton standardin e sjelljes së një ndërmarrësi, përkatësisht të një profesionisti veçanërisht të kujdesshëm. Ky standard mund të konstitujë përgjegjësinë e komisionarit edhe për lëshimet më të vogla në zbatimin e urdhrave ose të mbrojtjes së interesave të komitentit, lëshime këto që rëndom një ekonomist i mirë nuk do të duhej t'i toleronte. Me fjalë të tjera, komisionari i përgjigjet komitentit me standardin e profesionistit, çka nënkupton edhe përgjegjësinë e tij për veprimet e tij edhe për lëshimet më të vogla. Me fjalë të tjera, ky paragraf kërkon që komisionari të jetë veçanërisht i përgjegjshëm në ndërmarrjet e tij sipas kontratës për komisionin. Sigurisht, në vlerësimin e përgjegjësisë së komisionarit sipas standardit të "ndërmarrësit të mirë", gjykata do t'i ketë në konsideratë veprimet konkrete të komisionarit në rrethanat e rastit konkret, të vëna

në raport me sjelljet që një ndërmarrës (komisionar) i mirë do të duhej t'i shfaqte, sikur të vepronte sipas urdhrave të komitentit në rrethanat e dhëna.

788.2. Duke e pasur parasysh natyrën e kontratës për komisionin si dhe një nivel të besimit që duhet të ekzistojë ndërmjet palëve në kontraktimin e kësaj kontrate, supozohet se komisionari në çdo rast dhe në cilëndo situatë do të duhej të përkujdesej që të mbrojë dhe të veprojë në interesin më të mirë të komitentit. Ashtu si u tha në komentimin e nenit pararendës, ai shtjellonte situatat e përgjegjësishë së komisionarit për rastet kur ky nuk vepron sipas kërkesave të urdhrave të komitentit ose kur shmang urdhrat e komitentit. Megjithatë, konsiderohet se përgjegjësia e komisionarit është edhe përtej detyrimit të zbatimit të thjeshtë të urdhrave të komitentit. Me fjalë të tjera, komisionari në çdo situatë të dhënë duhet të veprojë në interesin më të mirë të komitentit, duke parandaluar mundësinë që ai të pësojë ndonjë dëm eventual. Kjo përfshin detyrimin e komisionarit që të kujdeset edhe për përzgjedhjen e palëve të treta për komitentin. P.sh., nëse bëhet fjalë për komisionin shitës, komisionari nuk duhet të kujdeset vetëm për suksesin e lidhjes së kontratës së shitjes me çmimin më të mirë për komitentin, por edhe për vetë aftësinë paguese të palës së tretë (blerësit eventual), e cila do t'i mundësonte komitentit një arkëtim më të shpejtë dhe më të sigurt të çmimit të shitjes. Në kuptim të kësaj që u tha, LMD në paragrafin e dytë të nenit 788 ka vendosur detyrimin e komisionarit që t'i përgjigjet komitentit të tij për dëmin e pësuar nga ky i fundit, nëse pasoja e shkaktimit të dëmit ka qenë përzgjedhja jo e duhur e palës së tretë, nga veprimi i së cilës varet realizimi i interesave të komitentit. Kështu, komisionari do të përgjigjet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar komitentit të tij, nëse dëmi që ka pësuar ai vjen si pasojë e përzgjedhjes jo të duhur të palës së tretë, përkatësisht sipasojë e përzgjedhjes së një blerësi insolvent (të varfëruar ose para falimentimit ose në falimentim), në qoftë se komisionari ka qenë ose nuk ka mundur të mos ishte në dijeni, (përkatësisht do të duhej të ishte në dijeni) për përzgjedhjen e gabuar (të palës tjetër kontraktuese), që i ka bërë komitentit. Në lidhje me komentimin e këtij paragrafi, mendohet se përgjegjësia e komisionarit për shpërblimin e dëmit komitentit për rastin e parashikuar në këtë paragraf bazohet në fajin e supozuar të komisionarit, që do të thotë se supozohet që komisionari është fajtor dhe duhet të mbajë përgjegjësi për përzgjedhjen e gabuar që i ka bërë komitentit. Megjithatë, komisionari mund të lirohet nga detyra e shpërblimit të dëmit, përveç nëse provon se nuk ka ditur e as që ka pasur mundësi të dinte për përzgjedhjen jo të duhur të palës së tretë. Kështu, barra e të provuarit të argumenteve si më lartë bie mbi komisionarit.⁶⁴⁸ Në kuptim të komentimit si më lartë të këtij paragrafi, megjithatë, mendohet se komisionari nuk do të jetë përgjegjës ndaj komitentit për përzgjedhjen që i ka bërë me rastin e lidhjes së kontratës me palën e tretë, në qoftë se pala e tretë tashmë ka përmbushur detyrimin e saj, gjë që pengon vetë shkaktimin e dëmit komitentit.

648 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1715 - 1716;

Neni 789. Kur vetë komisionari blen mallin e komitentit ose ia shet mallin e vet

- 1. Komisionari të cilit i është besuar shitja ose blerja e ndonjë malli që ka vlerë në bursë ose në treg mundet, në qoftë se ia ka lejuar komitenti, të mbajë mallin për vete si blerës, respektivisht të lirojë si shitës, sipas çmimit në kohën e zbatimit të punës së besuar.**
- 2. Në këtë rast midis komisionarit dhe komitentit lindin marrëdhëniet nga kontrata e shitjes.**
- 3. Në qoftë se çmimi i bursës respektivisht i tregut dhe çmimi të cilin e ka caktuar komitenti nuk pajtohen, komisionari-shitësi, ka të drejtë në çmimin më të ultë nga sa janë këto dy çmime, ndërsa komisionari blerësi ka për detyrë të paguajë çmimin më të lartë.**

789.1. LMD, në paragrafin e parë të nenit 789 ka parashikuar mundësinë që, nëse palët merren vesh, përkatësisht nëse komitenti i lejon komisionarit, kur bëhet fjalë për sende-mallra që kanë një vlerë në bursë, përkatësisht një vlerë të caktuar tregu, mallrat të cilat ia dorëzon komitenti komisionarit për shitje të tretëve, ky i fundit mund t'i mbajë për vete ato si blerës; përkatësisht që mallrat që ka porositur komitenti të blihen, të mund të furnizohen edhe nga sendet-mallrat e komisionarit. Me gjithë faktin se kjo mundësi nuk përkon me natyrën e kontratës për komisionin, LMD e ka parashikuar atë, duke e lejuar si mundësi kur për të njëjtën gjë palët shprehimisht janë pajtuar në kontratën e komisionit, përkatësisht kur mundësia e tillë shprehimisht është parashikuar nga urdhrat e komitentit. Që ky përjashtim të kontrata e komisionit të mundësohet, duhet që mallrat të cilat janë objekt i kësaj marrëdhënie specifike, të kenë një çmim në bursë, përkatësisht një çmim të caktuar tregu; pra, në marrëdhënien e dhënë zbatohet çmimi përkatës që ekziston në momentin e ekzekutimit të shitjes, përkatësisht blerjes ndërmjet komisionarit dhe komitentit. Në komentimin e këtij paragrafi duhet të vëmë në dukje se në rreshtin e tretë të tekstit ligjor të paragrafit të parë të nenit në fjalë është përdorur shprehja “**të lirojë**”, ashtu që duhet të theksojmë se kjo folje nuk përkon me qëllimin e paragrafit në fjalë, prandaj, në vend të saj, sigurisht do të duhej të ishte përdorur folja “**t'i ofrojë**”; ashtu që me rastin e ndonjë ndryshimi eventual të tekstit ligjor të LMD do të duhej të merrej parasysh kjo e metë teknike e këtij paragrafi.

789.2. Më tutje, paragrafi i dytë i të njëjtit nen të LMD përcakton se kur kemi të bëjmë me situatën e rregulluar si në paragrafin e parë të këtij neni, atëherë marrëdhënia që është themeluar ndërmjet komisionarit dhe komitentit konsiderohet (sipas kuptimit të Ligjit) si marrëdhënie e shitblerjes, kështu që ndërmjet komisionarit dhe komitentit zbatohen rregullat e kontratës për shitjen. Varësisht nga raporti i tyre shitës ose blerës, palët nga pozita e komisionarit ose komitentit e marrin rolin e shitësit ose të blerësit, prandaj për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre - të shitësit ose të blerësit, zbatohen rregullat e kontratës së shitjes (në mungesë të dispozitave kontraktuese të miratuara nga vetë palët).

789.3. Për shkak të natyrës së kontratës për komisionin dhe raportit të besimit që duhet të ekzistojë ndërmjet komisionarit dhe komitentit, mundësia që kontrata e komisionit të përfundojë si një kontratë e shitblerjes duhet të shihet vetëm si një përjashtim, pra nëse

janë plotësuar kushtet e komentuara më lart të përfshira në paragrafin e parë të këtij neni. Prandaj, me qëllim që të mbrohen palët nga këto situata, sidomos me qëllim që komisionari të mos keqpërdorë këtë mundësi të ofruar nga komitenti, (të blejëë sendin e komitentit ose anasjelltas), përkatësisht që e njëjta mundësi të shfrytëzohet sa më pak, paragrafi i fundit i nenit 789 të LMD ka parashikuar një rregullim i cili do të jetë i pafavorshëm për komisionarin, në rast se ndryshon çmimi i bursës ose çmimi i tregut, nga çmimi i caktuar prej komitentit për marrëdhënien reciproke. Në kuptim të tekstit ligjor të paragrafit në fjalë, nëse ekziston një shpërpjesëtim ndërmjet çmimi të bursës, respektivisht çmimit të tregut për mallin përkatës, me çmimin e caktuar nga komitenti për aplikim në marrëdhënien e dhënë, atëherë komisionari, nëse ka qenë në rolin e shitësit, ka të drejtë të kërkojë vetëm çmimin më të ulët (në diferencën ndërmjet çmimit të bursës - tregut dhe çmimit të caktuar nga komitenti), ose kur komisionari është në rolin e blerësit, ka për detyrim që të paguajë çmimin më të lartë (në diferencën ndërmjet çmimit të bursës - tregut dhe çmimit të caktuar nga komitenti). Ky legjislacion vendos më shumë presion mbi komisionarin, i cili, duke u ndodhur nën presionin e saj, nuk do të kishte interes subjektiv ta përdorë ose, më saktë, ta keqpërdorë mundësinë e ofruar si në paragrafin e parë të këtij neni.

KREU 2

DETYRIMET E KOMISIONARIT

Neni 790. Ruajtja dhe sigurimi

1. Komisionari ka për detyrë ta ruajë mallin e besuar me kujdesin e ekonomistit të mirë.
2. Ai përgjigjet edhe për shkatërrimin ose dëmtimin e rastësishëm të mallit, në qoftë se ai nuk e ka siguruar mallin edhe pse sipas dekretit ka qenë i detyruar.

790.1. Kontrata për komisionin është kontratë e dyanshme-detyruese, pra ajo prodhon të drejta dhe detyrime si për komisionarin, ashtu edhe për komitentin. Fillimisht le të flasim për detyrimet e komisionarit. Varësisht nga lloji i urdhrit që merr komisionari, ai shpeshherë ndodhet në situatë që t'i pranojë dhe t'i ruajë-mbajë sendet e komitentit. Kjo veçanërisht ndodh si te komisioni shitës, ashtu edhe te komisioni blerës. Si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, komisionari merr për ruajtje sende - mallra të caktuara për komitentit, derisa ato ti dorëzohen palës së tretë (te komisioni shitës) ose derisa t'i dorëzohen përfundimisht komitentit (komisioni blerës). Sigurisht, krahas pranimit të sendeve-mallrave për ruajtje, komisionari ndërmerr edhe një tërësi veprimesh të tjera, të cilat shoqërohen ose ndërliken me pranimin e mallit për ruajtje. Kështu, p.sh., kur komisionari e pranon sendin nga i treti për komitentin e tij, ai ka për detyrë që ta kontrollojë mallin e pranuar, ta kontrollojë cilësinë dhe sasinë e mallit dhe të sigurohet se dorëzimi i mallit është në përputhje me kërkesat e komitentit, në mënyrë që eventualisht të bëjë reklamimin e mallit që ka ndonjë të metë ose të përdorë edhe ndonjë mjet juridik formal me qëllim të mbrojtjes së interesave të

komitentit të tij. Në kuptim të LMD (paragrafi i parë i nenit 790), komisionari ka për detyrë që, kur mban sendet e komitentit, ose kur kryen veprime juridike ose faktike që ndërlidhen me mbajtjen-ruajtjen e sendeve të komitentit, duhet të tregojë kujdesin e “ekonomistit të mirë”. Kjo nënkupton detyrimin e komisionarit që të jetë posaçërisht i kujdesshëm për mbikëqyrjen e sendeve të komitentit, përkatësisht mbrojtjen e interesave të tij. Komisionari do të mbajë përgjegjësi ndaj komitentit edhe për lëshimet më të vogla, të cilat nuk do të duhej t’i lejonte një profesionist, përkatësisht një ekonomist i mirë.⁶⁴⁹

790.2. Te kontrata për komisionin, komisionari ka për obligim që urdhrave të komitentit t’u përmbahet me përpikëri, përkatësisht që në çdo situatë të veprorë në interesin më të mirë të komitentit, (nëse nga përmbajtja e urdhrave, komisionari ka diskrecion në përzgjedhjen e veprimeve që ndërmerret për komitentin). Kur shtrohet çështja e mbajtjes dhe ruajtjes së mallrave për komitentin, shpeshherë mund të shtrohet edhe çështja e sigurimit të mallrave me qëllim të mbrojtjes nga rreziqe të ndryshme. Madje, mund të ketë raste kur nga kuptimi i kontratës për komisionin, përkatësisht nga kuptimi i urdhrave të komitentit, del kërkesa e qartë e komitentit që mallrat që mbahen për të të sigurohen nga rreziqet eventuale. Nëse bëhet fjalë për këtë rast, kjo konsiderohet një kërkesë detyruese, së cilës duhet t’i përmbahet komisionari, përndryshe përgjegjësia e komisionarit për sendet që i mban, rritet. Në këtë kuptim, paragrafi i dytë i nenit 790 të LMD rrit përgjegjësinë e komisionarit për rastet kur ai nuk ka siguruar mallrat e komitentit, duke themeluar përgjegjësinë e vet që të përgjigjet edhe për zhdukjen ose dëmtimin e rastësishëm të sendit, nëse zhdukja ose dëmtimi i sendit vjen nga rreziqet ose pasojat nga të cilat është dashur të sigurohet, ashtu siç ka qenë edhe kërkesa e komitentit. Në këtë kuptim, konsiderohet se komisionari duhet t’i bartë pasojat e mosveprimit të tij që mallin, që mbahet për komisionarin, ta sigurojë nga rreziqet përkatëse, ashtu që komitenti nuk duhet të dëmtohet nga lëshime të tilla të komisionarit, i cili ka qenë edhe i urdhëruar për të vepruar përkatësisht.

Neni 791. Njoftimi për gjendjen e mallit të pranuar

- 1. Me rastin e marrjes së mallit nga transportuesi që ia ka dërguar komitenti, komisionari ka për detyrë të vërtetojë gjendjen e tij dhe pa shtyrje ta njoftojë komitentin për ditën e arritjes së mallit, si edhe për dëmtimet e dukshme ose mungesën, përndryshe përgjigjet për dëmin e cili për shkak të këtij lëshimi do të shkaktohej për komitentin.**
- 2. Ai ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e të drejtës së komitentit ndaj personit përgjegjës.**

791.1. Te kontrata për komisionin, komisionari shpeshherë mund të gjendet në situata të tilla që mallin ta pranojë nga personi i tretë për komitentin e tij. Këtu mund të ndërlidhet shpeshherë edhe rasti i transportimit të mallrave nga transportuesi (përmes kontratës për transportin). Paragrafi i parë i nenit 791 rregullon situatën se si duhet të sillt

649 Në lidhje me këtë, shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 406.

komisionari, në rast të pranimit të mallrave (për komitentin) nga transportuesi dhe cila do të jetë përgjegjësia e tij, në rast se nuk sillet sipas kërkesave të paragrafit në fjalë. Kështu, ky paragraf kërkon që komisionari, sapo ta ketë pranuar mallin nga transportuesi, ka për detyrë ta kontrollojë menjëherë atë, përkatësisht ta verifikojë gjendjen e mallit të pranuar; kjo sigurisht nënkupton se komisionari posaçërisht duhet të kujdeset dhe të jetë i vëmendshëm të kontrollojë nëse malli ka ndonjë mungesë materiale ose ndonjë dëmtim tjetër të dukshëm dhe që, pa humbur kohë, ta njoftojë komitentin për faktin e arritjes dhe pranimit të mallit nga transportuesi, për gjendjen e mallit, ambalazhin (nëse ky është ose jo i përshtatshëm), dëmtimet dhe mungesat materiale eventuale të tij. Ky detyrim i komisionarit edhe nënkuptohet, pasi që ndërmarrja e këtyre masave prej tij është e domosdoshme për mbrojtjen e interesave të komitentit, ashtu që, nëse malli ka ndonjë të metë të dukshme ose paketim të papërshtatshëm, kjo i jep mundësi komitentit që pranimin e mallit ta protestojë ose ta reklamojë menjëherë, (përndryshe, kundërshtimi i ftuesit për të metat e padukshme të sendit-mallit mund të bëhet në një periudhë më të gjatë kohore). Mirëpo, në qoftë se komisionari nuk sillet dhe nuk i respekton kërkesat e këtij paragrafi në kuptim të përkujdesjes dhe kontrollimit të mallit me rastin e pranim-dorëzimit të tij, ai do të mbahet përgjegjës për shpërblimin e dëmit eventual ndaj komitentit, dëm ky që është pasojë e dështimeve të komisionarit që t'u përmbahet kërkesave të paragrafit në fjalë (kërkesave të lartpërmendura).

791.2. Në kuptim të detyrimeve të komisionarit, të themeluara në paragrafin e parë të këtij neni të LMD, paragrafi i dytë i të njëjtit nen vendos detyrimin e komisionarit që të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së interesave të komitentit ndaj personit përgjegjës (transportuesit ose palëve të tjera të treta). Kjo, p.sh. në rast të ekzistimit të të metave të dukshme të mallit ose ambalazhit joadekuat, mund të nënkuptojë mundësinë që komisionari të bëjë ose të ndërmarrë ankesa përkatëse ose të fillojë ndonjë procedurë të nevojshme për vlerësimin e dëmtimit të sendit etj.

Neni 792. Njoftimi për ndryshimet në mall

Komisionari ka për detyrë ta njoftojë komitentin për të gjitha ndryshimet në mall për shkak të të cilave mund të humbë vlera e mallit, e në qoftë se nuk ka kohë për pritje të udhëzimeve të tij, ose në qoftë se ai e ka zvarritur dhënien e udhëzimeve, në rast rreziku të dëmtimit të konsiderueshëm komisionari ka për detyrë ta shesë mallin në mënyrë sa më të volitshme.

792. Ashtu siç thamë edhe më lart, në kontratën e komisionit, komisionari vepron në emrin e vet dhe për llogari të komitentit. Kështu, pasi puna që kryhet nga komisionari afekton direkt në llogarinë e komitentit, për rrjedhojë, komitenti ka të drejtë të dijë dhe të informohet për të gjitha rrethanat e çështjes, përkatësisht gjendjen e sendeve, të cilat eventualisht mund ta afektojnë ose ta rëndojnë llogarinë e komitentit. Në kuptim të kësaj, komitenti ka të drejtë që menjëherë të informohet nga komisionari në rast se mallrat ose

sendet që mbahen prej tij pësojnë ndonjë ndryshim, që mund ta rrezikojë vetë mallin ose që malli që mbahet të mund të humbasë në vlerë. Komisionari duhet ta kryejë këtë detyrë dhe ta informojë komitentit sa më parë që është praktikisht e mundshme si dhe të kërkojë prej tij instruksione se si të veprojë më tutje me këtë mall.

Më tutje, në situatat më emergjente, kur nuk mund të pritët një përgjigje nga komitenti, (për shkak se malli do të dëmtohet ose do të humbasë vlerë) ose kur komitenti vazhdon të mos i përgjigjet komisionarit në lidhje me vërejtjet dhe njoftimet që i kishte bërë në lidhje me gjendjen e veçantë të mallit, në situata të tilla komisionari ka të drejtë edhe ta shesë mallin, ashtu që nga shitja e mallit të arkëtojë çmimin përkatës për komitentit e tij. Shitja e mallit që bëhet në këtë situatë duhet të jetë sa më e përshtatshme për komitentit, ashtu që t'i shkaktojë atij sa më pak humbje në vlerë. Kështu, detyrimi që është vendosur për komisionarin në nenin 792 të LMD, vë në dukje edhe njëherë rrethin e gjerë të punëve dhe përgjegjësive ligjore të komisionarit, të cilat kanë për qëllim ta mbrojnë interesin e komitentit.

Neni 793. Njoftimi i komitentit për emrat e palës kontraktuese

- 1. Komisionari ka për detyrë t'i komunikojë komitentit me cilin person ka kryer punën që ia ka besuar komitentit.**
- 2. Kjo rregull nuk vlen në rastin e shitjes së sendeve të luajtshme që bëhet nëpër shitore të komisionit, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.**

793.1. Ashtu si u tha më lart, në kontratën për komisionin komisionari vepron në emrin e vet, e për llogari të komitentit. Çfarëdo veprimi i komisionarit që është kryer në kuadër të kompetencave të dhëna nga komitenti, ngarkon direkt llogarinë e komitentit. Rrjedhimisht, çdo punë ose veprim juridik që komisionari kryen me të tretin, prek llogarinë e komitentit. Shpeshherë, varësisht nga suksesi i përzgjedhjes së personave të tretë nga komisionari, varet realizimi i interesave të komitentit në afarizëm ose në biznes. Duke e pasur parasysh këtë fakt, ligjvënësi me paragrafin e parë të nenit 793 ka pasur për qëllim të mbrojë interesin e komitentit, duke sanksionuar në interesin e tij të drejtën që komitenti të informohet për personat, përkatësisht subjektet afariste me të cilat komisionari hyn në marrëdhënie juridike për komitentit. Në shikim të parë, kjo detyrë e komisionarit që t'i komunikojë informata komitentit për të tretët, me të cilët hyn në marrëdhënie juridike, duket se paraqet një barrë për komisionarin. Megjithatë, duke pasur parasysh se komisionari vepron në llogari të komitentit, dështimi në përzgjedhjen e palëve të treta e rrezikon direkt interesin juridik të komitentit. Për më tepër, shpeshherë komisionari mund të ndodhet në aso rrethanash të cilat mund të përbëjnë konflikt interesi, (për shkak të interesave subjektive që komisionari mund të ketë me ose ndaj të tretëve), gjendje kjo që mund ta vërë në dyshim objektivitetin e tij për sa i përket përkujdesjes për mbrojtjen e interesave juridike të komitentit në raport me palët e treta. Të gjitha këto mundësi e justifikojnë zgjidhjen ligjore që ka bërë ligjvënësi në paragrafin përkatës, me të cilin saktësohet detyrimi i komisionarit që komitentit të tij t'ia

komunikojë informatat për gjendjen dhe personalitetin e të tretëve, me të cilët ai hynë në marrëdhënie juridike për interesat e komitentit të tij.

793.2. Megjithatë, rregulla e komentuar në paragrafin paraprak ka një përjashtim, kur është fjala për shitjen e sendeve të luajtshme (mallrave) të komitentit në shitoret e komisionarit. Kështu, sipas paragrafi të dytë të nenit 793 të LMD, komisionari nuk ka për detyrë që komitentit të tij t'i sigurojë informata për të tretët, me të cilët ai lidh kontrata, nëse është fjala për komisionin shitës të sendeve të luajtshme, kur shitja e tyre bëhet nga shitorja e komisionarit. Kjo mund të jetë e kuptueshme, kur bëhet fjalë për komisionin shitës të sendeve të luajtshme (për shkak të shpejtësisë që shpeshherë kërkohet në qarkullim), në shitoret e komisionarit, pasi që ai më shumë mund të ushtrojë kontroll për shitjet dhe arkëtimin e çmimit për komitentin e tij. Sigurisht, rregulla e vendosur në këtë paragraf është një rregull e natyrës dispozitive, çka nënkupton se, edhe në këto situata, palët mund të merren vesh ndryshe me kontratë, në të cilën mund të themelohet detyrimi i komisionarit që edhe në këso situatash të sigurojë informata dhe ta njoftojë komitentin për personat e tretë, të cilëve ua shet sendet e komitentit.

Neni 794. Dhënia e llogarisë

- 1. Komisionari ka për detyrë të japë llogarinë për punën e kryer pa shtyrje të panevojshme.**
- 2. Ai ka për detyrë t'ia dorëzojë komitentit në tërësi atë çka ka pranuar në bazë të punës së kryer për llogari të tij.**
- 3. Komisionari ka për detyrë t'ia kalojë komitentit kërkesat dhe të drejtat e tjera që ka fituar ndaj personit të tretë me të cilin ka kryer punë në emër të vet dhe për llogari të tij.**

794.1. Një nga detyrimet kryesore të komisionarit ndaj komitentit të tij është detyrimi i dhënies llogari të komisionarit ndaj komitentit, detyrim ky që, si i tillë, është saktësuar në paragrafin e parë të nenit 794 të LMD. Pasi që komisionari ta kompletoj, punën për të cilën është kërkuar të shërbejë, ai bashkë me rezultatet e punës, i paraqet komitentit edhe një llogari të plotë për rrjedhën e punëve dhe rezultateve përfundimtare të punëve të arritura dhe të dorëzuara komitentit. Dhënia e llogarisë, si detyrim për komisionarin, nuk nënkupton vetëm dorëzimin e thjeshtë të një dokumenti, në formë llogarie, me të cilin ai e njofton komitentin për llogarinë përfundimtare. Në të vërtetë, mendohet se dhënia e llogarisë nënkupton një tërësi veprimesh dhe aktiviteteve të ndërmarra nga komisionari, me qëllim që komitentin e tij ta pajisë me të gjitha informatat, dokumentacionin dhe rrjedhën e punëve të ndërmarra për llogarinë e komitentit, informimin për sukseset e arritura dhe dështimet eventuale, duke i përfshirë edhe shpjegimet adekuate për balancën e shpenzimeve, pagesave, dëmeve eventuale, ngarkesave të ndryshme financiare e të ngjashme, me të cilat është ngarkuar llogaria e komitentit gjatë dhe në lidhje me ofrimin e shërbimit të komisionit, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen dhe dorëzimin e çfarëdolloj dokumenti që

përmban informata për rrjedhën e punëve të ndërmarra nga komisionari ose që është me rëndësi për evidencimin e interesave dhe rezultateve të punëve të komitentit. Në kuptim të paragrafit në fjalë, komisionari obligohet t'i japë llogari komitentit brenda afateve ose ashtu si ata e kanë saktësuar këtë detyrim në kontratën për komisionin ose, në mungesë të shpjegimeve të tilla në kontratën për komisionin, detyrimi i ofrimit të llogarisë bëhet në përputhje me praktikën e aplikuara afariste (ose praktikën e themeluar ndërmjet vetë palëve, nëse nga bashkëpunimi i ndërsjellë i tyre ka rezultuar një praktikë adekuate).⁶⁵⁰ Detyra e dhënies së llogarisë përfundimtare nga komisionari posaçërisht ka rëndësi të madhe për marrëdhënien ndërmjet palëve, pasi që, me dhënien e llogarisë përfundimtare, komisionari bart te komitenti i tij rezultatet e të gjitha ndërmarrjeve - veprimeve të tij (të ndërmarra për llogari të komitentit), duke përfshirë këtu pagesat përfundimtare ose edhe kalimin e pronësisë mbi komitentin të sendeve që eventualisht kanë mundur të jenë objekt i ndërmarrjeve sipas kontratës së komisionit, kështu që dhënia e llogarisë përfundimtare spastron raportet përfundimtare ndërmjet komisionarit dhe komitentit, duke pushuar edhe pushtetin juridik që komisionari ka fituar nga komitenti në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komisionit.

794.2. Më tej, paragrafi i dytë i të njëjtit nen të LMD përcakton se komisionari, krahas dhënies së llogarisë, ka për detyrim që mbi komitentin të bartë në tërësi të gjitha rezultatet që janë arritur në lidhje me kryerjen e punëve për llogari të komitentit, qofshin ato rezultate pozitive negative të realizimit të punëve të ndërmarra. Sigurisht, nga vetë kuptimi i kontratës për komisionin nënkuptohet se rezultatet e punës barten te komitenti, por, megjithatë, LMD përmban këtë rregull sqaruese që është me rëndësi për rastet kur palët në kontratën e komisionit nuk kanë adresuar çështjen e përfitimeve direkte ose indirekte, që komisionari mund t'i nxjerrë gjatë kryerjes së punëve. Sipas kuptimit të dispozitës në fjalë, te komitenti duhet të bartet e tëra ajo që është pranuar ose është nxjerrë nga komisionari gjatë kryerjes së punëve për llogarinë e komitentit (qofshin ato rezultate pozitive direkte apo indirekte nga puna e komisionit). Në kuptim të këtij paragrafi, LMD ka lejuar vetëm një përjashtim, i cili i mundëson komisionarit të përmbahet nga detyrimi i dorëzimit të sendeve të luajtshme për komitentin, me qëllim të sigurimit të pagesës së shpërblimit dhe shpenzimeve të cilat ai eventualisht mund t'i pretendojë ndaj komitentit (e drejta e pengut e komisionarit, më shumë e komentuar në komentimin e nenit 800 të LMD).

794.3. Paragrafi i tretë i të njëjtit nen themelon detyrimin e komisionarit, që t'ia kalojë komitentit edhe të gjitha të drejtat dhe kërkesat eventuale që ka mundur t'i fitojë komisionari në raport me palët e treta gjatë kryerjes së punëve të komisionit. Sigurisht, një detyrimi i tillë, i bazuar në këtë paragraf, është pasojë logjike e detyrimeve të komisionarit, i cili tërë kohën ka vepruar me të tretët për llogarinë e komitentit.

Një pyetje e veçantë e cila mund të shtrohet dhe që ndërlidhet më detyrimin e komisionarit për dhënien llogari ndaj komitentit, e cila si duket nuk është adresuar qartë në dispozitat e këtij neni, ka të bëjë me faktin nëse komitentit i takon e drejta që ndaj komisionarit të

650 Në lidhje me këtë, shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 407.

kërkojë edhe llogari të kohëpaskohshme, para se të jetë përfunduar në tërësi marrëdhënia e komisionit. Kjo pyetje mund të shtrohet vetëm për rastet kur palët kontraktuese as në kontratë nuk e kanë parashikuar ose rregulluar një mundësi të tillë. Sigurisht, përgjigja e kësaj pyetjeje është shumë më rendësi për rastet e marrëdhënies të komisionit, të cilat zgjasin për një periudhë relativisht të gjatë. Mendohet që edhe në këtë rast përgjigja duhet të jetë pozitive, (edhe pse dispozitat e nenit të mësipërm nuk sigurojnë një përgjigje të prerë), dhe se komitentit i takon e drejta të kërkojë informata dhe llogari nga komisionari edhe gjatë ofrimit të shërbimeve të komisionit, përgjatë periudhave të ndryshme, kur komitenti këtë gjë e sheh të nevojshme. Duket se kjo mundësi buron qartë nga neni 769 i LMD (shih komentimin e këtij neni më lart), i cili e rregullon detyrimin e dekretmarrësit që dekretdhënësit t'i dorëzojë raporte dhe t'i japë llogari për kryerjen e urdhrave (gjithashtu, më lart në komentimin e neneve të kontratës për komisionin kemi shpjeguar se LMD lejon mundësinë që për kontratën për komisionin, në rast të zbrazëtirave juridike, të mund të zbatohen rregullat e kontratës për dekretin). Gjithashtu, një qasje e tillë pozitive lidhur me pyetjen e shtruar duket se rrjedh edhe nga vetë nënkuptimi i rregullt i gjërave, pasi që komitenti, gjatë rrjedhës së kryerjes së punëve, ka të drejtë të interesohet lidhur me kryerjen e punëve, të kërkojë informata ose të kërkojë të sigurohet me bilance të caktuara pas ekzekutimit të pagesave të ndryshme ose të informohet në lidhje me gjendjen e llogarisë së tij në lidhje me ekzekutimin ose pranimin e pagesave nga punët që mund t'u referohen shërbimeve të komisionit etj. Këto janë çështje të tilla që justifikojnë interesimin e komitentit dhe kërkimin llogari të tij edhe gjatë kryerjes së punëve të komisionit. Sigurisht, nëse detyra e paraqitjes së raporteve të shpeshta për komisionarin paraqitet një barrë e veçantë, e cila i shkakton edhe shpenzime shtesë, komisionari, si kundërvlerë për shërbimet e tij mbi këtë bazë, mund të kërkojë shpërblim shtesë, respektivisht evitim të shpenzimeve shtesë që i shkaktohen nga kjo bazë.⁶⁵¹

Neni 795. Del credere

- 1. Komisionari përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të palës kontraktuese të vet, vetëm në qoftë se ka garantuar posaçërisht se ai detyrimet e veta do t'i përmbushë (delkredere), në të cilin rast ai përgjigjet solidarisht me te.**
- 2. Komisionari që ka garantuar për përmbushjen e detyrimeve të bashkëkontraktuesit të vet ka të drejtë edhe në shpërblim të veçantë (provizioni delkredere).**

795.1. Një formë e veçantë e kontratës për komisionin është “komisioni del credere” ose në literaturën juridike mund të haset edhe si “komisioni star del credere”. Te kjo formë e komisionit përgjegjësia e komisionarit është esencialisht e shtuar. Ashtu si komentuar edhe më lart, te forma e rregullt e marrëdhënies së komisionit, komisionari i përgjigjet komitentit për zbatimin e urdhrave si ekonomist i mirë, përkatësisht bart përgjegjësi për përzgjedhjen e ndërgjegjshme - profesionale të palës së tretë, me të cilën ka lidhur kontratë

⁶⁵¹ Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1722;

ose ka ndërmarrë një veprim juridik tjetër, përkatësisht bart përgjegjësi që palës së tretë t'i japë udhëzime dhe informata ashtu siç i ka kontraktuar në kontratën e komisionit. Për dallim nga kjo, te forma e komisionit “del credere”, komisionari i përgjigjet komitentit edhe për veprimet konkrete të palës së tretë, përkatësisht për suksesin ose mossuksesin e përbushjes së detyrimeve nga pala e tretë. Një kontraktim i tillë i kontratës së komisionit është mundësuar (si përjashtim) në paragrafin e parë të nenit 795 të LMD, sipas të cilit, kjo formë e komisionit nuk supozohet, por duhet të kontraktohet posaçërisht ndërmjet komisionarit dhe komitentit. Në kuptim të paragrafit në fjalë, komisionari dhe komitenti mund të kontraktojnë ashtu që komisionari të japë garanci (dorëzani) personale për suksesin e përbushjes së detyrimeve të palës së tretë. Në rast të kontraktimit të kësaj forme të komisionit, komisionari bart përgjegjësi solidarë për suksesin e përbushjes së detyrimeve të palës së tretë, (me të cilën ai ka kontraktuar për llogari të komitentit). Kjo nënkupton atë se, në rast se pala e tretë lë pa përbushur detyrimet (për shkak të falimentimit, varfërimit ose për ndonjë shkak tjetër), e tërë përgjegjësia e përbushjes kalon mbi komisionarin, i cili e ka pozitën edhe të bashkëdebitorit solidar në marrëdhënien e detyrimit të themeluar ndërmjet komitentit dhe të tretit. Sigurisht, nëse komisionari bën përbushjen e detyrimit të të tretit (ndaj komitentit të tij), komisionari e fiton të drejtën e regresit ndaj të tretit - pagesën mbrapa të asaj që komisionari ka paguar apo ka përbushur për të tretin (në lidhje me këtë, shih komentimin e rregullave për detyrimet solidarë pasive).

795.2. Nga ajo që u komentua për paragrafin paraprak mund të shihet se kjo formë e kontraktimit të komisionit i ofron siguri të veçantë komitentit në sigurimin e interesave të tij kontraktuese. Kontraktimi dhe marrja përsipër e përgjegjësive për këtë formë të komisionit paraqet rrezik të shtuar për komisionarin. Sigurisht, për shkak të rrezikut të shtuar, në momentin e kontraktimit, komisionari mund të kërkojë me arsye shpërblim më të madh për shërbimin e ofruar. Në kuptim të kësaj, paragrafi i dytë i nenit 795 të LMD lejon mundësinë që për këtë rast palët të kontraktojnë të ashtuquajturin shpërblim të veçantë “shpërblimin del credere”. LMD, në kuptim të kontraktimit të sasisë së kësaj forme të shpërblimit, respekton autonominë e vullnetit të palëve; palët lirshëm saktësojnë në kontratë shpërblimin përkatës për këtë rast. Megjithatë, në kuptim të paragrafit në fjalë, për rastet kur në momentin e kontraktimit ndërmjet palëve nuk është saktësuar sasia e shpërblimit të komisionarit, ky mund t'i referohet paragrafit në fjalë për mundësinë e marrjes së shpërblimit adekuat - të veçantë (si shtesë nga shpërblimi i zakonshëm që do të mund t'i takonte komisionarit).

KREU 3

DETYRIMET E KOMITENTIT

Neni 796. Shpërblimi (provizion)

- 1. Komitenti ka për detyrë t'i paguajë komisionarit një shpërblim, nëse është kryer puna, të cilën komisionari ka pasur ta kryejë, si dhe në qoftë se kryerja e punës pengohet nga ndonjë shkak për të cilin përgjigjet komitenti.**
- 2. Në rastin e kryerjes graduale, komisionari mund të kërkojë pjesën proporcionale të shpërblimit pas secilës përbushje të pjesëshme.**
- 3. Në qoftë se nuk kryhet puna e kontraktuar nga shkak për të cilin nuk përgjigjen as komisionari as komitenti, komisionari ka të drejtë në shpërblimin përkatës për mundin e vet.**
- 4. Komisionari që ka vepruar me mosbesnikëri ndaj komitentit nuk ka të drejtë në shpërblim.**

796.1. Përveç gjenerimit të të drejtave, kontrata për komisionin prodhon edhe detyrime për komitentin. Në ekonomi, shërbimi i komisionimit ofrohet shpeshherë si aktivitet ekonomik i komisionarit, që rëndom kryhet me pagesë. Kjo është rrjedha normale e gjërave edhe në kontratat jashtë fushës së ekonomisë. Kështu, detyra kryesore e komitentit në kontratën për komisionin është detyrimi që të paguajë shpërblimin (provizionin) për komisionarin. Detyra e pagesës së shpërblimit konsiderohet si kundërvlerë për shërbimin që komisionari e kryen për komitentin e tij. Në kuptim të kësaj, edhe LMD (neni 796.1) rregullon që komisionarit i takon e drejta për shpërblim (provizion), kur ai të ketë kryer punën e përcaktuar në kontratën për komisionin. Ky përcaktim ligjor jetësohet edhe në praktikë, nëse palët në kontratë nuk kanë rënë dakord ndryshe. Sigurisht, në kuptim të paragrafit në fjalë, komisionarit do t'i takojë e drejta e shpërblimit vetëm për rastet kur puna të jetë kryer me sukses, përkatësisht për rastet kur komisionari ka dorëzuar-ka kaluar rezultatet pozitive të kryerjes së punëve të komitentit. Kështu, p.sh., te komisioni i shitjes, komisionarit, që t'i takojë shpërblimi, krahas lidhjes së kontratës me të tretin, do të duhej t'i mundësohej arkëtimi i çmimit nga i treti, me fjalë të tjera, që rezultatet e kryerjes së punëve të jenë konkrete.

Shpërblimi që detyrohet komitenti t'i paguajë komisionarit zakonisht kontraktohet, ashtu që sasia e shpërblimit caktohet në mënyrë fikse ose me përqindje. Komisionarit i takon e drejta e shpërblimit edhe në rastet kur palët nuk kanë saktësuar në kontratë nëse shpërblimi duhet të paguhet ose nëse nuk kanë përcaktuar sasinë a kriterin për saktësimin e sasisë së shpërblimit. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve, shpërblimin mund ta caktojë gjykata, duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret (nivelin dhe kohën e angazhimit të komitentit si dhe rezultatet e arritura). Në rastin në fjalë, në përcaktimin e sasisë së shpërblimit gjykata mund të marrë në konsideratë praktikën e themeluar ndërmjet palëve, standardet e ndryshme profesionale, të cilat janë të aplikueshme në qarkullimin përkatës ose edhe doket afariste.

Në kuptim të këtij paragrafi, komisionarit i takon e drejta e shpërblimit përkatës edhe në rastet kur ai nuk ka kryer disa ose nuk i ka kryer të gjitha punët e kërkuara sipas kontratës për komisionin, nëse për moskryerjen e punëve të tilla përgjegjësia kalon te komitenti. Në kuptim të kësaj, nëse komitenti, me veprime të tij, përkatësisht lëshimet ose mosveprimet e tij, pengon ose i bën të pamundur komisionarit që t'i kryejë punët e urdhëruara me kontratën për komisionin, komisionarit do t'i takojë e drejta e shpërblimit-provizioni i plotë edhe në këto situata.

796.2. Në praktikë mund të ekzistojnë situata kur kryerja e punëve të marra përsipër nga komisionari bëhet në një interval më të gjatë; në shtjellim të këtyre situatave, paragrafi i dytë i nenit 796 të LMD parashikon mundësinë që komisionarit t'i takojë suksesivisht pjesa adekuate e shpërblimit, e cila është në përpjesëtim me pjesën e punëve të kryera. Komisionarit, për rastet e tilla, do t'i takojë e drejta e shpërblimit të plotë vetëm kur kryen me sukses të gjitha punët e kontraktuara me komitentin, kurse pagesat e bëra paraprakisht përllogariten në llogarinë përfundimtare të shpërblimit që duhet t'i paguhet komisionarit.

796.3. LMD, në paragrafin e tretë të të njëjtit nen ka rregulluar situatën e shpërblimit për komisionarin në rastet kur për dështimin e kryerjes së punëve nuk është përgjegjës as komisionari, as komitenti. Raste të tilla janë të natyrshme atëherë kur kryerja e punëve pamundësohet nga shkaqet që janë jashtë kontrollit të rregullt të palëve (shkaqe këto që nuk kanë mundur të parashikohen ose të shmangen). Në rastet më të shpeshta këtu bëhet fjalë për forcën madhore, p.sh., për shkak të trazirave në vendet e ndryshme, kur tregjet pësojnë bllokime, ashtu që blerja ose shitja e mallrave në tregje ndërkombëtare ka dështuar etj.). Për raste të tilla e të ngjashme, pasi nuk është kryer puna, komisionarit nuk i takon e drejta e shpërblimit të plotë, ashtu siç është kontraktuar ai (ose ashtu siç rëndom do t'i takonte). Megjithatë, për situatat e tilla LMD ka përcaktuar mundësinë që t'i njihet komisionarit e drejta të kërkojë pjesën e shpërblimit e cila është "përkatëse", ose ekuivalente me mundin që ka bërë ai në lidhje me kryerjen e punëve në fjalë.

796.4. LMD, në paragrafin e katërt të këtij neni ka rregulluar edhe çështjen e shpërblimit për rastet kur komisionari sillet me "mosbesnikëri" ose shfaq mosbesim ndaj komitentit. Për rastet e tilla LMD ka përcaktuar që komisionarit nuk i takon e drejta e shpërblimit përkatës për rastet kur ai sillet me "mosbesnikëri" ndaj komitentit. Ashtu siç është shkruar, nga teksti ligjor i paragrafit në fjalë shprehja "mosbesnikëri" duket se sjellë paqartësi në aplikimin praktik të tij, prandaj kjo shprehje do të duhej t'i nënshtrohej interpretimit. Disa autor me të drejtë mendojnë se, kur flitet për "mosbesnikërinë - mosbesimin" e komisionarit ndaj komitentit, rëndom duhet menduar për standarde të sjelljes së komisionarit (ose të stafit të zyrës së komisionarit), të cilat nuk përkojnë me standardet e sjelljes së profesionistit (ose njeriut të kujdesshëm), përkatësisht nuk përkojnë me sjelljet e ekonomistit të mirë. Për raste të tilla kur komisionari ka vepruar më moskujdes, ose me kujdes jo të duhur, thuhet se komisionarit jo vetëm se nuk do të duhej t'i takonte e drejta e shpërblimit, por përkundrazi, ai mund të mbahet përgjegjës për dëmet dhe lëshimet që ia ka shkaktuar komitentit të tij. Mendohet se kështu siç u shpjegua më sipër do të duhej të përbënte frymën e interpretimit të paragrafit të fundit të nenit 796 të LMD.⁶⁵²

652 Për më shumë në lidhje me një komentim të ngjashëm, shih: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1723 - 1725;

Neni 797. Sasia e shpërblimit

- 1. Në qoftë se shuma e shpërblimit nuk është caktuar me kontratë ose me tarifë, komisionarit i takon shpërblimi sipas punës së kryer dhe rezultatit të arritur.**
- 2. Në qoftë se në rastin e dhënë shpërblimi është përpjesëtimisht i madh në krahasim me punën e kryer dhe rezultatit të arritur, gjykata mundet me kërkesë të komitentit ta zbresë në një shumë të drejtë.**

797.1. Ashtu si u tha edhe më lart, rëndom komisionari ofron shërbime të komisionit me shpërblim përkatës. Në pikëpamje të caktimit të shpërblimi dhe të sasisë së tij, LMD respekton autonominë e vullnetit të palëve. Shpërblimi në rastet më të shpeshta jepet në formë të një shume përkatëse në të holla, mirëpo ai mund të kontraktohet të paguhet edhe në ndonjë formë tjetër (p.sh., në natyrë). Shpërblimi nganjëherë kontraktohet të paguhet edhe me përqindje (në raport me rezultatet e arritura). Mënyra dhe sasia e pagesës së shpërblimit më së shpeshti saktësohet nga palët në kontratë ose me tarifë (sipas tarifës së shërbimeve të komisionarit). Saktësimi i shpërblimit në kontratë ose referimi i tarifës së aplikueshme për shpërblimin në kontratë është mënyra më e zakonshme e kontraktimit të shpërblimit. Me anë të kontratave në ekonomi, komisionarët ofrojnë shërbime në rastet më të shpeshta në bazë të tarifave përkatëse. Aplikimi i tarifave të tilla kontraktohet ose edhe mund të nënkuptohet (në pazë të praktikës së themeluar ndërmjet palëve ose dokeve afariste). Për rastet kur palët nuk saktësojnë sasinë e shpërblimit me kontratë ose me tarifë, LMD (neni 797.1), përcakton që komisionarit megjithatë i takon shpërblimi përkatës, i përlllogaritur në raport me punët e kryera dhe me rezultatet e arritura. Për rastet kur palët nuk kanë caktuar sasinë e shpërblimit dhe kur aplikimi i ndonjë tarife nuk mund të nënkuptohet, në rast të mosmarrëveshjes së palëve lidhur me caktimin e shpërblimit që duhet t'i paguhet komisionarit, gjykata do të ketë në konsideratë rrethanat e rastit konkret, duke i mbajtur parasysh punët të cilat komisionari i ka kryer, kohën dhe angazhimin e tij për kryerjen e këtyre punëve, rezultatet e arritura dhe, sigurisht, edhe rrethanat e tregut aktual.

797.2. Në kuptim të saktësimit të sasisë së shpërblimit që duhet t'i paguhet komisionarit, LMD sanksionon rrethanat për rastet kur komisionari dhe komitenti kontraktojnë një shpërblim shumë të lartë që duhet t'i paguhet komisionarit për shërbimet e tij, i cili është në shpërpjesëtim të dallueshëm ndërmjet punëve të kryera-rezultateve të arritura dhe sasisë së shpërblimit. Duke marrë në konsideratë autonominë e vullnetit të palëve me rastin e kontraktimit të shpërblimit, autorë që janë marrë me komentimin e kësaj dispozite, megjithatë, kanë komentuar rreth argumentit se duhet të përmbahemi nga aplikimi i kësaj dispozite, e cila posaçërisht të gjejë zbatim për rastet kur kontraktimi i shpërblimit keqpërdoret nga pozicioni ekonomik i komisionarit ose kur ky, duke shfrytëzuar pozitën e tij monopoliste në treg, kontraktin një shpërblim shumë të lartë ose në rrethana të tilla të ngjashme, të cilat sasinë e shpërblimit e bëjnë “të padrejtë në marrëdhënien ekzistuese”. Për rastet e tilla, komitenti mund t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë uljen proporcional të

shpërblimit në raport me punët e kryera ose rezultatet e arritura.⁶⁵³

Neni 798. Shpërblimi i shpenzimeve

- 1. Komitenti ka për detyrë t'i shpërblejë komisionarit shpenzimet që kanë qenë të nevojshme për kryerjen e dekretit, me kamatë nga dita kur janë bërë.**
- 2. Komitenti ka për detyrë t'i japë komisionarit shpërblim të posaçëm për përdorimin e depove dhe mjeteve të transportit të tij, në qoftë se ky nuk është përfshirë në shpërblimin për kryerjen e punës.**

798.1. Komisionarit i takon edhe drejta e evitimit (pagesës) të shpenzimeve që i janë shkaktuar gjatë ose në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komisionit. Sigurisht, komisionarit, gjatë ekzekutimit të urdhrave të komitentit, mund t'i shkaktohen edhe shpenzime të ndryshme, p.sh., ai mund të marrë përsipër të bëjë transportimin e mallit për llogarinë e komitentit ose të kompletojë procedurat doganore për mallin e pranuar ose të eksportuar ose të ndërmarrë masa për ruajtjen dhe magazinimin e mallit etj. Sigurisht, në kuptim të paragrafit të parë të neni 898 të LMD, komisionarit i takon edhe drejta e shpërblimit të shpenzimeve të shkaktuara gjatë kryerjes së urdhrave të komitentit. Mirëpo, komisionari nuk ka të drejtë të kërkoj gjithfarë shpenzimesh mbi këtë bazë. Mund të argumentohet baza për të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve për rastet kur shkaktimi i tyre ka qenë i nevojshëm, përkatësisht i arsyeshëm, me qëllim të ekzekutimit të urdhrave të komitentit. Në kuptim të së drejtës së shpërblimit të shpenzimeve të bëra nga komisionari, këtu pikë së pari bëhet fjalë për shpenzime të domosdoshme, përkatësisht për ato që janë shkaktuar direkt ose që janë kushtëzuara nga domosdoshmëria e kryerjes së urdhrave për komitentin.

Përveç shpenzimeve të domosdoshme, komisionari mund të ketë pësuar edhe shpenzime të dobishme, përkatësisht shpenzime të bëra me qëllim që komitentit t'i silltet një përfitim i caktuar në kryerjen e punëve të besuara; p.sh., veprimi për interesin më të mirë të komitentit me qëllim që ai të ketë një dobi më të madhe etj. Sigurisht, nëse komisionari provon se ka qenë në mirëbesim dhe ka vepruar në kuadër të standardit të lartë të sjelljes së komisionarit, ashtu që veprimet i ka ndërmarrë për interesin më të mirë të komitentit, atëherë atij do t'i takojë edhe e drejta e shpërblimit të shpenzimeve të dobishme.

Në paragrafin e parë të këtij neni saktësohet se komisionarit, përveç të drejtës së shpërblimit të shpenzimeve, i takon edhe e drejta e kamatës mbi këto shpenzime që nga dita e shkaktimit të tyre. Megjithatë, paragrafi në fjalë i LMD nuk jep referencë se cili lloj i kamatës do të mund të zbatohet për këto raste (nëse duhet të zbatohet norma e kamatëvonesës e caktuar nga Ligji apo të zbatohet një normë më e saj). Ne mendojmë që zgjidhja më e përshtatshme për situata të tilla është aplikimi i normës së kamatëvonesës të përcaktuar në LMD në lidhje me detyrimet për të cilat palët nuk kanë parashikuar një normë të saktë të kamatës, gjendje

653 Për më shumë në lidhje me një komentim të ngjashëm shih: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1725 - 1726;

këtë që e rregullon neni 385.2 i LMD, (shih në lidhje me këtë nen komentimin në pjesën përkatëse). Është menduar për këtë zgjidhje, pasi që në rastin konkret do të ishte kundër natyrës së kamatëvonesës që ajo të aplikohet në një situatë të tillë, kur ende asnjëra palë në marrëdhënie nuk ka rënë në vonesë, (kjo aq më tepër pasi që shpeshherë çështja e pagesës së këtyre shpenzimeve dhe kamatave shtrohet në momentin kur komisionari i prezanton komitentit llogarinë përfundimtare, gj që ndodh në fund të përmbylljes së marrëdhënies së komisionit, përkatësisht nuk shtrohet fare çështja e vonesës së komitentit në pagesën tyre, e cila kërkohet në një moment më të vonshëm).

798.2. Mund të ndodhë që në marrëdhënien e komisionarit, ky, krahas marrjes përsipër të detyrimit të kryerjes së punëve për komitentin, merr përsipër edhe përdorimin e depove ose të mjeteve të veta të transportit etj. për interesin e komitentit. Sigurisht, ofrimi i këtyre shërbimeve të posaçme rregullohet me kontratën e komisionit dhe për ofrimin e tyre saktësohet pagesa përfundimtare, e cila i takon komisionarit si kundërvlerë për ofrimin e shërbimeve. Megjithatë, LMD, në paragrafin e dytë të nenit 798, ia njuh të drejtën komisionarit për shpërblim shtesë, të posaçëm, në rastet kur ofrimi i këtyre shërbimeve nuk është rregulluar me kontratën për komisionin. Në kuptim të kësaj qasjeje, ekzistojnë edhe mendime se kjo dispozitë duhet të lexohet dhe zbatohet në kuptim të zgjeruar, ashtu që komisionarit t'i takojë e drejta e shpërblimit edhe për shërbimet e tjera të posaçme, të cilat i ndërmerr ai për llogarinë e komitentit. Sigurisht, për këto raste, në lidhje me caktimin e shpërblimit të posaçëm për komisionin, në praktikën juridike më së shpeshti merret për bazë skema e tarifave të shërbimeve të ofruara nga komisionari ose zyra e komisionarit.

Neni 799. Paradhënia e të hollave komitentit

Në qoftë se me kontratën për komisionin nuk është caktuar diçka tjetër, komitenti nuk ka për detyrë t'i japë paradhënie komisionarit në mjete të nevojshme për kryerjen e punës së besuar.

799. Në praktikë, varësisht nga punët që komisionari i merr përsipër t'i kryejë për llogarinë e komitentit, kryerja e tyre mund të nënkuptojë marrjen përsipër edhe të shkaktimit të shpenzimeve të caktuara, që nganjëherë mund të jenë të konsiderueshme. Ndonjëherë, gjatë kryerjes së urdhrave të komitentit, në raste të paparashikueshme, mund të dalin edhe shpenzime të paparashikueshme etj. Për të gjitha këto situata, LMD në nenin 799 ka saktësuar që, lidhur me heqjen e shpenzimeve të tilla (para ose gjatë kryerjes së punëve të besuara), komisionarit nuk i takon e drejta të kërkojë nga komitenti paradhënie me qëllim të kryerjes së punëve ose që kryerjen e punëve të tilla ta kushtëzojë me paradhënie të caktuar. Në kuptim të asaj që u tha edhe më lart, komisionarit i takon e drejta kompensimit të të gjitha shpenzimeve të shkaktuara, si edhe e drejta e nj shpërblimi përkatës, mirëpo atij, përveç nëse është rregulluar ndryshe me kontratën për komisionin, nuk i takon e drejta që të kërkojë paradhënie nga komitenti në emër të kryerjes së punëve të besuara.

KREU 4 E DREJTA E PENGUT

Neni 800. Të drejtat e komisionarit për pengun

- 1. Komisionari ka të drejtë pengu në sendet që janë objekt i kontratës për komisionin gjersa këto sende gjenden te ai ose te ndonjë që i mban për te ose gjersa ai ka në dorë dokumentin me anë të të cilit mund të disponojë me to.**
- 2. Nga vlera e këtyre sendeve komisionari mund të arkëtojë përpara të gjithë kreditorëve të komitentit kërkesat e veta në bazë të të gjitha punëve të komisionit me komitentin, si dhe në bazë të huave e të paradhënieve që i janë dhënë komitentit, pa marrë parasysh nëse janë krijuar ose jo në lidhje me këto sende ose me ndonjë mënyrë tjetër.**
- 3. Të drejtën e përparësisë së arkëtimit e ka komisionari nga kërkesat, të cilat i ka fituar me kryerjen e dekretit për llogari të komitentit.**

800.1. Paragrafi i parë i nenit 800 të LMD vendos të drejtën e pengut të komisionarit mbi sendet ose mallrat e komitentit, të cilat janë objekt i kontratës së komisionarit, me qëllim të sigurimit të së drejtës së komisionarit për pagesën e shpërblimit dhe të shpenzimeve të bëra gjatë kryerjes së punëve për llogarinë e komitentit. Sigurisht, kjo formë e pengut që ekziston për interesin e komisionarit është një formë e pengut ligjor dhe ekziston vetëm mbi sendet-mallrat të cilat janë objekt i kontratës së komisionarit dhe të cilat gjenden në posedimin ose nën kontrollin e komisionarit ose të palës së tretë e cila i mban ato për komisionarin, përkatësisht nëse dokumentet me të cilat mund të disponohet malli gjenden në posedimin e komisionarit. Përveç dispozitave të parashikuara në këtë nen, për realizimin e të drejtës së pengut të komisionarit të themeluar nga kjo bazë, zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës së pengut.

800.2. Paragrafi i dytë i nenit 800 të LMD më tej i njuh të drejtën e përparësisë komisionarit që nga vlera e sendeve të ngarkuara me peng, i pari, para kreditorëve të tjerë eventualë të komitentit, të ketë të drejtën që t'i arkëtojë të gjitha kërkesat e tij të cilat dalin nga kontrata e komisionit (kërkesat në lidhje me pagesën e shpërblimit, të pagesës së shpërblimit të posaçëm, evitimin e shpenzimeve, eventualisht të shpërblimit të dëmit të pësuar e të tjera), si dhe të drejtën e përparësisë që i pari të arkëtojë edhe kërkesat tjera të tij të krijuar jashtë marrëdhënies me komisionarin, përkatësisht kërkesat që kanë për bazë të krijimit të tyre huat ose paradhëniet që eventualisht komisionari ia ka dhënë komitentit, pa marrë parasysh nëse këto të fundit janë krijuar ose jo në lidhje me sendet që janë objekt i komisionit, punët e tjera ndërlidhëse të komisionit ose të krijuara mbi ndonjë bazë tjetër.

800.3. Më tej, paragrafi i tretë i nenit 800 të LMD vendos të drejtën e përparësisë së komisionarit që i pari (para kreditorëve potencialë të komitentit) të inkasoj kërkesat e komitentit, të cilat ai i ka fituar gjatë kryerjes së punëve (dekretit) për llogari të komitentit.

Këtu, p.sh., hyjnë kërkesat e mundshme në të holla nga të tretit (ose edhe kërkesa të tjera pasurore juridike), të cilat do t'i takonin komitentit.

KREU 5 MARRËDHËNIET ME PERSONA TË TRETË

Neni 801. Të drejtat e komitentit në kërkesat nga puna me të tretin

- 1. Komitenti mund të kërkojë përmbushjen e kërkesës nga puna të cilën e ka lidhur komisionari me të tretin dhe për llogari të tij vetëm nëse ai (komisionari) ia ka bartë (ceduar) atij kërkesat.**
- 2. Në pikëpamje të marrëdhënieve të komitentit me komisionarin dhe me kreditorët e tij konsiderohen këto kërkesa si kërkesa të komitentit.**

801.1. Siç u tha edhe më lart, komisionari, në raportet me palët e treta gjatë kryerjes së punëve të komisionit, vepron në emrin e vet dhe për llogari të komitentit. Sipas këtij kuptimi, përderisa komisionari me të tretët lidh kontrata ose ushtron-ndërmerr veprime juridike etj., që të gjitha këto ai i ushtron në emrin e vet personal. Shpesh të tretët nuk kanë dhe as nuk mund të kenë informata se cili është komitenti në të vërtetë, pasi që komisionari mund të paraqitet me ta si pala e vetme kontraktuese. Në kuptim të kësaj është edhe dispozita e paragrafit të parë të nenit 801 të LMD, sipas së cilës komitenti, në fakt, mund të kërkojë përmbushjen e kërkesave të tij ndaj të tretëve, (me të cilët komisionari ka hyrë në marrëdhënie juridike), vetëm nëse paraprakisht ky të t'ia ketë kaluar këto kërkesa komitentit. Rëndom, komisionari ka për obligim t'ia kalojë kërkesat e tilla komitentit, punë kjo që është e rregulluar me dispozitat që shtjellojnë çështjen e llogaridhënies së komisionarit ndaj komitentit, (në lidhje me detyrën e llogaridhënies, shih komentimin e nenit 794 të LMD).

801.2. Megjithatë, pa marrë parasysh rregullimin nga paragrafi parë i nenit 801 të LMD, paragrafi i dytë i të njëjtit nen përcakton se, megjithatë, në raportet juridike që mund të themelohen ose ekzistojnë ndërmjet komitentit dhe komisionarit, si dhe në marrëdhëniet ndërmjet komitentit dhe kreditorëve të komisionarit, të gjitha kërkesat që burojnë nga marrëdhënia e komisionit ndaj palëve të treta konsiderohen si kërkesa të komitentit, në realitet, dhe këto që nga lindja e tyre. Kjo rregull arsyetohet me faktin se komisionari gjithmonë vepron për llogarinë e komitentit dhe, rrjedhimisht, kërkesat e tilla i referohen llogarisë së komitentit. Me fjalë të tjera, këto kërkesa gjithashtu nuk mund të jenë subjekt i përmbartimit me dhunë nga kreditorët e komisionarit.

Neni 802. Kufizimi i të drejtës së kreditorëve të komisionarit

Kreditorët e komisionarit nuk mund për arkëtimin e kërkesave të veta, as në rastin e falimentimit të tij të ndërmarrin masa përmbartimi në të drejtat dhe sendet të cilat komisionari, duke kryer urdhrin i ka fituar në emër të vet dhe për llogari të komitentit, përveç nëse është fjala për kërkesat e krijuara në lidhje me fitimin e këtyre të drejtave dhe të sendeve.

802.1. Pasi që komisionari vepron për llogarinë e komitentit, konsiderohet se të gjitha sendet, kërkesat, të drejtat ose detyrimet shkojnë në llogarinë e komitentit. Në kuptim të kësaj, të gjitha sendet, të drejtat ose kërkesat të cilat ka mundur t'i fitojë komisionari nga të tretët (për llogarinë e komitentit), në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të komitentit, nuk mund të jenë objekt i përmbartimit me dhunë nga kreditorët e komisionarit. Një standard të tillë të kufizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komitentit, në raport me kreditorët e komisionarit (kjo për rastet e varfërimit ose falimentimit të komisionarit ose për rastet tjera, kur pasuria e komisionarit bëhet objekt i ekzekutimit me dhunë), e vendos neni 802 i LMD. Përjashtim nga rregulli i mësipërm përbëjnë rastet kur komisionari ka fituar të drejta kërkesash (përkatësisht të drejtën e pengut) mbi sendet ose të drejtat, të cilat përndryshe do t'i takonin llogarisë së komitentit. Ky përjashtim kryesisht ndërlidhet me të drejtat për kërkesa të komisionarit ndaj komitentit, që kanë të bëjnë me çështjen e pagesës së shpërblimit ose pagesës së shpërblimit të veçantë ose çështjen e pagesës së shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme e të tjera të ngjashme.

Neni 803. Falimentimi i komisionarit

- 1. Në rastin e falimentimit të komisionarit, komitenti mund të kërkojë veçimin nga masa e falimentimit të sendeve që ia ka dorëzuar komisionarit për shitje për llogari të tij, si dhe të sendeve që i ka blerë komisionari për llogari të tij.**
 - 2. Në të njëjtin rast komitenti mund të kërkojë nga i treti, të cilit komisionari ia ka dorëzuar sendet që t'ia paguajë çmimin e tyre, përkatësisht pjesën e papaguar ende.**
-

803.1. Në kuptim të asaj që u komentua në nenin paraprak, paragrafi i parë i neni 803 të LMD më tej përcakton se, në rast të falimentimit të komisionarit, komitenti mundet të kërkojë që të veçohen dhe përjashtohen nga masa e falimentimit të gjitha sendet, të cilat komitenti ia ka dorëzuar komisionarit për shitje për llogarinë e tij, përkatësisht të kërkojë veçimin dhe përjashtimin nga masa e falimentimit të të gjitha sendeve që komisionari i ka blerë për llogarinë e komitentit. Sigurisht, këto janë sende të cilat komisionari i mban për llogarinë e komitentit, ashtu që, rrjedhimisht, komitenti, në kuptim të dispozitës në fjalë, ka të drejtë të kërkojë që këto sende të përjashtohen nga masa - pasuria e komisionarit, e cila është nën masën e falimentimit.

803.2. Më tej, paragrafi i dytë i nenit 803 të LMD lejon edhe një përjashtim tjetër në favor të komitentit, duke ia njohur këtij të drejtën që ta kontaktojë drejtpërdrejt palën e tretë dhe të kërkojë prej saj t'i paguhet çmimi ose pjesa e çmimit, e cila ka ngelur e papaguar për sendet - mallrat që komisionari ia ka dorëzuar palës së tretë. Kjo rregull përbën një përjashtim për komitentin, e cila i jep mundësi t'i kontaktojë drejtpërdrejt palët e treta dhe të kërkojë prej tyre përmbushjen përkatëse lidhur me rastet kur ndaj komisionarit është hapur falimentimi. Sigurisht, që ta gëzojë këtë të drejtë komitenti, nuk është e nevojshme që pala e tretë ta ketë ditur ose jo nëse komisionari ka vepruar ose jo për llogarinë e komitentit. Ky është një përjashtim i cili ka për qëllim të mbrojë interesat e komitentit në rast të falimentimit të komisionarit.

PJESA XVII

KONTRATA PËR PËRFAQËSIMIN TREGTAR

KREU 1

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 804. Nocioni

- 1. Me kontratën mbi përfaqësimin tregtar, përfaqësuesi obligohet të kujdeset vazhdimisht që persona të tretë të lidhin kontrata me urdhërdhënësin e tij dhe që për këtë të ndërmjetësojë midis tyre dhe urdhërdhënësit, si dhe që pas marrjes së autorizimit të lidhë kontrata me persona të tretë në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit, ndërsa ky obligohet që për çdo kontratë të lidhur t'i paguajë shpërblim të caktuar (provizion).**
- 2. Përfaqësuesi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, mund të jetë entitet ligjor apo person fizik i cili në mënyrë të pavarur dhe me qëllim të realizimit të fitimit kryen aktivitete të përfaqësimit si një aktivitet i regjistruar.**
- 3. Përfaqësuesi tregtar mundet po ashtu të lidhë kontratë mbi agjencinë tregtare si një urdhërdhënës.**
- 4. Urdhërdhënësi mund të këtë në të njëjtën zonë dhe për të njëjtin lloj pune disa agjenda, përveç nëse parashihet ndryshe me kontratë.**
- 5. Përfaqësuesi pa pëlqimin e urdhërdhënësit nuk mundet të marrë përsipër obligimin që në të njëjtën zonë dhe për të njëjtin lloj pune ose për të njëjtin rreth klientësh të punojë për një urdhërdhënës tjetër.**

804.1. Paragrafi i parë i nenit 804 jep kuptimin e kontratës për përfaqësimin tregtar. Sipas kuptimit që siguron ky nen, ashtu edhe si nënkuptohet nga teoria juridike, kontrata për përfaqësimin tregtar është një kontratë e lidhur ndërmjet përfaqësuesit tregtar, (që shpesh quhet agjent tregtar, ashtu që në komentimin e kësaj pjese të kësaj kontrate ne do t'i përmbahemi emërtimit: agjent tregtar) dhe urdhërdhënësit (principalit ose pushtetdhënësit), sipas së cilës agjenti tregtar fiton pushtetin-autorizimin ta përfaqësojë urdhërdhënësin, përkatësisht që në “emër” dhe “për llogari të urdhërdhënësit” të mund të lidhë kontrata të ndryshme, të ekzekutojë veprime të tjera juridike (të saktësuara këto në kontratën për përfaqësim tregtar), ndërsa si kundërvlerë për këtë shërbim urdhërdhënësi i detyrohet agjentit t’ia paguajë shpërblimin përkatës. Nga sa vërehet nga marrëdhëniet që krijohen me kontrata për përfaqësim tregtar, mund të përfundohet se ajo krijon dy lloje marrëdhëniesh juridike: e para ka të bëjë me marrëdhëniet që themelohen ndërmjet urdhërdhënësit dhe agjentit tregtar, ndërsa e dyta ka të bëjë me marrëdhëniet të cilat krijohen ndërmjet këtyre dy të parëve dhe palëve të treta, me të cilat agjenti hyn në marrëdhënie kontraktuese ose marrëdhënie juridike të tjera në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit.

Kontrata për përfaqësimin tregtar ka shumë ngjashmëri me kontratën për komisionin (të komentuar më lart). Megjithatë, ato kanë edhe dallime të theksuara. Përderisa te kontrata për komisionin, në raport me palët e treta, komisionari vepron në emrin e vet, (pasi që ai kryesisht i paraqitet të tretit, si pala e vetme kontraktuese), dhe për llogarinë e komitentit, te kontrata për përfaqësimin tregtar, agjenti tregtar gjithmonë vepron “në emrin” e urdhërdhënësit dhe “për llogarinë” e urdhërdhënësit. Me fjalë të tjera, kur agjenti lidh kontratë me palët e treta, ai e bën këtë në emrin e urdhërdhënësit, i cili bëhet drejtpërdrejt palë kontraktuese me palët e treta, në të cilat përfaqësohet nga agjenti.

Nëse e vërejmë me kujdes tekstin ligjor të paragrafit të parë të të njëjtit nen, veçanërisht pjesën e fjalisë në vijim: *“përfaqësuesi obligohet të kujdeset vazhdimisht që persona të tretë të lidhin kontrata me urdhërdhënësin e tij dhe që për këtë të ndërmjetësojë midis tyre dhe urdhërdhënësit”*, nga e cila mund të nxirret konkludimi që LMD në këtë pjesë nuk bën dallim të qartë ndërmjet përfaqësimit tregtar dhe ndërmjetësimit tregtar. Sigurisht, ligjvënësi duket se ka përvetësuar këtë formë të rregullimit për shkak të ngjashmërive që ekzistojnë ndërmjet këtyre dy llojeve të kontratave, sidomos edhe për faktin që shpeshherë agjenti tregtar paraqitet edhe si ndërmjetësues për lidhjen e kontratave ndërmjet urdhërdhënësit dhe të tretëve. Pa marrë parasysh këtë qasje të LMD, në teorinë juridike (e edhe në praktikën juridike) bëhet dallimi ndërmjet kontratës për përfaqësimin tregtar dhe kontratës për ndërmjetësimin (tregtar). Kështu, në kontratën për përfaqësimin tregtar agjenti vepron në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, ashtu që kur vepron, agjenti ka gjithmonë për qëllim t’i mbrojë dhe t’i realizojë qëllimet dhe interesat e urdhërdhënësit. Për dallim prej tij, ndërmjetësuesi në marrëdhënien që ndërmjetëson ka për qëllim që vetëm “t’i vërë palët në lidhje”, të cilat më pas vetë lidhin kontratën, pra roli i ndërmjetësuesit në marrëdhënien juridike është kryesisht neutral, ashtu që kur vepron dhe ofron shërbimin e ndërmjetësimit, ai vepron në emrin e vet dhe për llogari të vet. Përveç këtyre, ka edhe dallime të tjera të ngjashme ndërmjet këtyre kontrata.

804.2. Në kuptim të asaj se kush mund të jetë në rolin-cilësinë e agentit tregtar, LMD nuk bën ndonjë dallim ndërmjet subjekteve të së drejtës. Kështu, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 804 të LMD, në cilësinë e agentit tregtar mund të jetë një entitet ligjor ose një person fizik. Shprehja entitet ligjor duhet të interpretohet gjerësisht dhe të përfshijë entitetet të cilave ligji në fuqi ua njuh një shkallë subjektiviteti në të drejtën dhe ato mund të jenë të organizuara në formë personash juridik ose ligji në fuqi t’ua japë një kualifikim tjetër. Shih, në lidhje me këtë, posaçërisht Ligjin për organizimin e shoqërive tregtare.

804.3. Në praktikën juridike ndodh zakonisht që agjenti tregtar ofron shërbimin e përfaqësimit si një shërbim afarist, me qëllim realizimin e fitimit afarist përkatës. Në kuptim të LMD, përfaqësuesi ose agjenti mund të jetë i organizuar edhe në formë të një entiteti ligjor (ashtu që veprimet juridike për komitentin, në realitet, i ekzekutojnë përfaqësuesit ligjor ose nëpunësit e entitetit ligjor në fjalë). Në kuptim të kësaj, LMD nuk bën ndonjë përjashtim për agentin tregtar, përkatësisht përcakton që agjenti tregtar, i cili ushtron rëndom këtë shërbim si aktivitet të tijin ekonomik, në realitet, mund të jetë edhe urdhërdhënës në punët ose sferat jashtë fushës kontratës për përfaqësimin.

804.4. Te përfaqësimi tregtar përmbajtjen e marrëdhënies së përfaqësimit palët kryesisht e caktojnë me kontratë. Në mungesë të një dispozite të qartë kontraktuese, LMD përcakton që urdhërdhënësi mund të ketë në të njëjtën zonë dhe për të njëjtin lloj të punëve disa agjentë -përfaqësues. Në një rast të tillë, urdhërdhënësi, me pëlqimin e agjentëve, saktëson rrethin e punëve që agjentët duhet të kryejnë në të njëjtën zonë dhe rrethin e njëjtë ose të ngjashëm të punëve që duhet të ndërmarrin ata.

804.5. Duke pasur parasysh që marrëdhënia e përfaqësimit është një marrëdhënie që kërkon një shkallë të lartë të besimit reciprok ndërmjet palëve, veçanërisht një shkallë të lartë të besimit që urdhërdhënësi duhet ta ketë për agjentin për këtë qëllim, e duke synuar mbrojtjen e interesit të urdhërdhënësit nga mundësia që agjenti të keqpërdorë informatat e mësuara nga urdhërdhënësi, ose t'i bëjë konkurrencë urdhërdhënësit, LMD, në paragrafin e pestë të nenit 804, i ka pamundësuar agjentit të marrë përsipër detyrimin që, në të njëjtën zonë dhe për të njëjtin lloj pune ose për të njëjtin rreth klientësh, të punojë për një urdhërdhënës tjetër, pa pëlqimin e urdhërdhënësit fillestar. Sigurisht, mundësia që agjenti të përfaqësojë dy ose më tepër urdhërdhënës në të njëjtën zonë (ekonomike) ose për të njëjtin rreth të punëve, duhet të rregullohet shprehimisht me kontratë dhe, për të njëjtin qëllim, të sigurohet shprehimisht pëlqimi i urdhërdhënësve. Përndryshe, një marrëveshje tjetër e agjentit me një urdhërdhënës të tretë do të paraqiste shkelje thelbësore të detyrimeve kontraktuese të përcaktuara në kontratën për përfaqësimin tregtar, përkatësisht shkelje që mund të çojë në zgjidhjen e kontratës dhe në shpërblimin e dëmit që mund ta kërkojë urdhërdhënësi.

Neni 805. Forma

- 1. Secila palë mund të kërkojë që të hartohet një dokument mbi përmbajtjen e kontratës, duke përfshirë të gjitha ndryshimet më të fundit, dhe që të nënshkruhet nga pala tjetër. Palët nuk mund të heqin dorë nga kjo e drejtë.**
- 2. Përkundër paragrafit të parë të këtij neni, palët mund të merren vesh që forma e shkruar të jetë kusht për vlefshmërinë e kontratës dhe ndryshimeve në të.**

805.1. Në pikëpamje të formës, LMD nuk ka bërë një saktësim të qartë nëse kontrata për përfaqësimin tregtar është formale ose jo. megjithatë, duket se ndërtimi i tekstit ligjor të nenit 805 të LMD është në favor të një forme shkresore të kontratës së agjentit tregtar. Nëse e shikojmë fjalinë e parë të të njëjtit nen, shohim se ligjvënësi e përdor shprehjen “*secila palë mund të kërkojë*” që kontrata të ekzekutohet në një dokument me përmbajtje të caktuar. Shprehja e përdorur “*secila palë mund të kërkojë*”, lejon mundësinë që një kontratë për përfaqësimin tregtar të jetë e vlefshme edhe nëse nuk është ekzekutuar në një formë të caktuar (kontrata joformale), nëse palët kanë pasur për qëllim të kontraktojnë, por duke mos ekzekutuar një formë të përmbajtjes së marrëveshjes së tyre ose një dokument me përmbajtje të caktuar. Me gjithë këtë mundësi, ligjvënësi duket se është në favor të ekzekutimit të një forme të përmbajtjes së kontratës. Ekzekutimi i kontratës ose

marrëveshjes në një formë shkresore u sjel palëve siguri të kënaqshme në transaksion, pasi që në rast të ndonjë çështjeje, palët (ose të tretët që kanë interes juridik), mund t'i referohen lehtë dokumentit shkresor që përmban marrëveshjen e palëve ose që dokumenti shkresor të përdoret para gjykatës edhe si një burim objektiv i informatave për vërtetimin e marrëveshjes së palëve.

805.2. Paragrafi i dytë i të njëjtit nen e rregullon mundësinë që palët të merren vesh që kontrata për përfaqësimin tregtar është e vlefshme vetëm nëse ekzekutohet në formë të caktuar, përkatësisht në formë shkresore. Në një rast të tillë, nëse kjo do të ishte marrëveshja e palëve, atëherë kontrata për përfaqësimin tregtar do të ishte formale, ashtu që mungesa e formës së shkruar do të çonte në pavlefshmërinë e kontratës ose të ndonjë kusht i kontratës së plotësuar-t[ndryshuar ndërkohë.

Neni 806. Lidhja e kontratës në emër të urdhërdhënësit

Përfaqësuesi mund të lidhë kontrata në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit të vet, në qoftë se për këtë ka marrë autorizim të veçantë, apo të përgjithshëm.

806. Sikurse u tha edhe më lart, agjenti vepron në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit (autorizuesit). Që agjenti të mund të veprojë në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, ai duhet të ketë një autorizim me përmbajtje të caktuar (të përgjithshëm ose të veçantë), të dhënë nga urdhërdhënësi. Forma në të cilën materializohet autorizimi i përmbajtjes së caktuar quhet prokurë.

Në lidhje me prokurën dhe përmbajtjen e prokurës, shih rregullat - nenet dhe komentimin e tyre, duke filluar nga neni 77 deri në nenin 82 të LMD. Neni 78 i LMD adreson çështjen e formës së ekzekutimit të prokurës (shih komentimin e të njëjtit nen). Nenet në fjalë të LMD, të cituara në këtë pjesë, shtjellojnë edhe çështjen e autorizimeve të përgjithshme dhe të veçanta, të dhëna nga autorizuesi dhe të materializuara në prokurën përkatëse, (shih komentimin e tyre për një shqyrtim më të përgjithshëm).

Neni 807. Pranimi i përmbushjes

Përfaqësuesi nuk mund të kërkojë dhe as të pranojë përmbushjen e kërkesave të urdhërdhënësit të vet, në qoftë se për këtë nuk është i autorizuar posaçërisht.

807. Kontrata për përfaqësimin tregtar nuk nënkupton që agjenti tregtar, i cili vepron si përfaqësues tregtar i urdhërdhënësit, mund të kërkojë ose të pranojë përmbushjen e kërkesave për urdhërdhënësin e vet. Në fakt, përmes kontratës për përfaqësimin tregtar, te agjenti kalon një rreth i gjerë ose më i ngushtë i punëve, të cilat i kryen ai në emër dhe për

llogari të urdhërdhënësit. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që agjenti edhe mund të kërkojë ose të pranojë përmbushjen e kërkesave për urdhërdhënësin. LMD, në nenin 807 kërkon autorizim të posaçëm për rastet kur agjenti kërkon ose pranon përmbushjen përkatëse për urdhërdhënësin e tij. Kështu, në mënyrë që të mbrojë interesin e urdhërdhënësit e gjithashtu edhe të palës së tretë, LMD në mënyrë eksplicite kërkon që autorizimi i posaçëm të sigurohet nga urdhërdhënësi për këto raste. Madje, në kuptim të kësaj, edhe nëse është siguruar autorizimi i posaçëm që të kërkohej ose pranohet përmbushja specifike, agjenti është i lidhur ngushtë me autorizimet që ia ka dhënë urdhërdhënësi. Kështu, p.sh., agjenti nuk mundet (pa aprovim të veçantë të urdhërdhënësit) që në vend të një përmbushjeje, të pranojë një përmbushje tjetër, (me të cilën e zëvendëson të parën ose me të cilën do ta këmbente përmbushjen e autorizuar me një lëndë tjetër të dorëzuar), ose pa miratimin paraprak të urdhërdhënësit, nuk mund të shtyjë pranimin e përmbushjes etj.⁶⁵⁴

Neni 808. Deklaratat e dhëna përfaqësuesit tregtar për urdhërdhënësin

Kur kontrata është lidhur me ndërmjetësimin e përfaqësuesit tregtar atëherë bashkëkontraktuesi i urdhërdhënësit mundet t'i bëjë në mënyrë të plotfuqishme përfaqësuesit tregtar deklarata që i përkasin të metave të objekteve të kontratës, si dhe deklaratat të tjera lidhur me këtë kontratë, me qëllim të ruajtjes ose të ushtrimit të të drejtave nga kontrata.

808. Në kontratën për përfaqësimin tregtar urdhërdhënësi e ruan cilësinë e palës direkte kontraktuese me të tretin, megjithatë, për rrethin e autorizimeve, ai përfaqësohet nga agjenti tregtar që vepron në emrin dhe për llogarinë e tij. Ashtu siç u pasqyrua në komentimin e nenit paraprak, me qëllim të mbrojtjes së interesit të urdhërdhënësit, agjentit i duhet një autorizimi veçantë për adresimin e disa situatave potencialisht të ndjeshme për urdhërdhënësin. Për ndryshim nga këto situata e më qëllim të mbrojtjes së interesit të personit të tretë (krijimit të një sigurie juridike për personin e tretë), neni 808 i LMD lejon mundësinë që agjenti tregtar të pranojë (në emër dhe për llogari të komitentit) deklarata të caktuara, të cilat kanë të bëjnë me çështjet rreth të metave të objektit të kontratës ose deklarata të tjera, të cila pala e tretë i përdor me qëllim të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave që rezultojnë nga kontrata e lidhur. Për pranimin e deklaratave në fjalë, (përkatësisht edhe për pranimin e efektit juridik të tyre), LMD nuk kërkon autorizim të veçantë nga urdhërdhënësi. Kryesisht, ndërmarrja e deklaratave nga pala e tretë në situata të tilla shihet si fundamentale për sigurimin e një shkalle të sigurisë në marrëdhënien kontraktuese me të tretin, të cilit i mundësohet t'i përdorë në mënyrë efikase të drejtat ose mjetet e tij juridike të përcaktuara në kontratë.

654 Në kuptim të kufizimit të mundësisë së veprimit të agjentit tregtar, përkatësisht të domosdoshmërisë së sigurimit të një autorizimi të veçantë për rastet e kërkimit ose pranimit të përmbushjeve për urdhërdhënësin, shih Kodin civil Italian. Kështu, sipas kuptimit të nenit 1744 të tij, kur përfaqësuesit tregtar i është dhënë autoriteti për të ushtruar pretendimet e faturimit për klientin, në vetvete nuk e nënkupton edhe kompetencën për të miratuar mosekzekutimin ose vonimin e ekzekutimit të detyrave për të cilat ai është i autorizuar. Këto veprime duhet të jenë të përfshira në mënyrë specifike në autorizim, përkatësisht ai duhet për to të autorizohet posaçërisht. Për më shumë në lidhje me këtë, shih Kodin Civil Italian të qasshëm në: <italian-lawyers.com/en/link.html>, dt. 6.10.2013.

Si deklarata të tilla të cilat pala e tretë mund t'ia drejtojë drejtpërdrejt agjentit dhe që ato menjëherë të prodhojnë efekt juridik për urdhërdhënësin, pa nevojën e një miratimi të veçantë, janë p.sh: njoftimi për të metat materiale të sendit, njoftimi për të metat juridike të sendit, njoftimi ose kundërshtimi i sasisë ose cilësisë së mallit të dorëzuar, protestat rreth paketimit dhe transportimit të mallit, njoftimi në lidhje me ushtrimin e të drejtës së mbajtjes (ius retentionis), deklarata për kundërshtimin për mospërbushje të kontratës ose deklarata për përmbushje të padrejtë të kontratës etj.

Neni 809. Deklaratat në emër të urdhërdhënësit

Përfaqësuesi tregtar është i autorizuar që me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të urdhërdhënësit të vet t'i bëjë deklaratë të nevojshme bashkëkontraktuesit të tij.

809. Neni 809 i LMD i përgjigjet rregullimit të nenit paraprak, duke shtjellua posaçërisht mundësinë që agjenti tregtar, pa pëlqim të posaçëm të urdhërdhënësit, të ekzekutojë deklarata ose të përdorë kundërshtime ndaj palës tjetër - të tretë kontraktuese, me qëllim të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të urdhërdhënësit. Përderisa në nenin paraprak rregullohej mundësia që deklaratat-kundërshtimet e ekzekutuara nga pala e tretë dhe të drejtuara agjentit tregtar, të prodhojnë efekt direkt edhe për urdhërdhënësin, si debitor, ky nen rregullon mundësinë që agjenti tregtar, pa nevojën e sigurimit të pëlqimit të veçantë, të mund të ekzekutojë deklarata-kundërshtime për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të urdhërdhënësit si kreditor. Pothuajse të gjitha deklaratat ose kundërshtimet e cituara në komentimin e nenit paraprak, mund të përdoren nga agjenti për interesin e urdhërdhënësit, pa ndonjë miratim të posaçëm të tij.⁶⁵⁵

Neni 810. Masat e sigurimit

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të urdhërdhënësit, përfaqësuesi tregtar mund të kërkojë marrjen e masave të nevojshme të sigurimit.

810. Neni 810 i LMD e autorizon dhe themelon posaçërisht detyrimin ligjor të përfaqësuesit tregtar që të kujdeset për marrjen e masave të përshtatshme të sigurimit për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit. Sigurisht, është detyrim i përgjithshëm i agjentit tregtar që, kur vepron në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, të veprojë në interesin me të mirë të tij dhe t'i ndër marrë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen sa më të mirë të interesave të urdhërdhënësit. Madje, në përkujdesjen për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit, përfaqësuesi tregtar duhet të veprojë me kujdesin e ekonomistit të mirë (të tregojë posaçërisht kujdesin e profesionistit në mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit, pasi që agjenti tregtar e ushtron veprimtarinë e përfaqësimit si një profesionist).

⁶⁵⁵ Për një rregullim të ngjashëm në të drejtën krahasuese, shih në këtë kontekst nenin 1745 në Kodin Civil Italian të qasshëm në: <italian-lawyers.com/en/link.html>, dt. 06.10.2013.

Përkundër këtij detyrimi të përgjithshëm të agjentit tregtar, i cili do të jetë më tej subjekt i diskutimit për nenet në vijim të LMD që kanë të bëjnë me rregullimin e kësaj kontrate, neni 810 e vendos posaçërisht detyrimin e agjentit për të ndërmarrë masat e sigurimit të përshtatshëm për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit. Në kuptim të dispozitës ligjore në fjalë, LMD nuk kërkon ndonjë autorizim të posaçëm për agjentin që të mund t'i ndërmarrë masat në fjalë për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit. Mendohet se autorizimet e agjentit për këtë qëllim burojnë nga dispozita e nenit në fjalë, ashtu që, në përkujdesjen për këtë qëllim dhe detyrim, agjenti duhet të tregojë kujdesin e ekonomistit - profesionistit të mirë në ndërmarrjen e përshtatshme dhe të suksesshme të masës së sigurimit për interesin e urdhërdhënësit.

Kur flitet për masat siguruese që agjenti mund t'i ndërmarrë sipas kuptimit të këtij neni të LMD, mendohet për masa të veçanta të sigurimit, të cilat nuk janë dakorduar posaçërisht ndërmjet palëve, (përndryshe do të zbatoheshin kërkesat e urdhërdhënësit sipas kontratës), por të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e interesit të urdhërdhënësit. Një masë e tillë është, për shembull, ushtrimi i “të drejtës së mbajtjes” për interesin e urdhërdhënësit në raport me palët e treta, sepse përndryshe mosndërmarrja e tyre do t'i dëmtonte interesat e urdhërdhënësit. Në lidhje me të drejtën e mbajtjes – retencionit, shih komentimin e neneve të LMD, duke filluar nga neni 267 deri te neni 270, të cilat i referohen rregullimit juridik të së drejtës së mbajtjes-retencionit të mbajtësit-kreditorit mbi sendet ose të mirat pasurore të debitorit. Përveç kësaj, LMD, në nenet përkatëse, vendos të drejtën ligjore të pengut për mbrojtjen e interesave përkatëse të kreditorit në kontratat si në vijim: kontratën për veprën (neni 643 i LMD), kontratën për urdhrin (neni 777 i LMD), kontrata për komisionin (neni 800 i LMD), kontrata për përfaqësimin tregtar (neni 826 i LMD), kontrata për spedicionin (neni 867 i LMD). Në të gjitha rastet si te kontratat në fjalë, konsiderohet se agjenti tregtar ka autoritet të plotë në ndërmarrjen e masave siguruese adekuate për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit.

Pavarësisht nga autoriteti që neni i mësipërm ia jep përfaqësuesit tregtar, megjithatë mendohet se në disa raste, për ndërmarrjen e masave të posaçme për sigurimin e ekzekutimit të kontratave që agjenti i lidh me të tretët, kërkohet pëlqimi - miratimi i veçantë nga urdhërdhënësi. Këtu mund të theksohen masa të tilla të veçanta, si kontraktimi i kaparit, paradhënies, kushtit penal e të ngjashme.⁶⁵⁶

.....
656 Për më shumë në lidhje me një komentim të ngjashëm, shih: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1745 - 1746;

KREU 2

DETYRIMET E PËRFAQËSUESIT TREGTAR

Neni 811. Kujdesi për interesat e urdhërdhënësit

1. Përfaqësuesi tregtar ka për detyrë të kujdeset për interesat e urdhërdhënësit dhe në të gjitha punët që ndërmerr ka për detyrë të veprjë me kujdesin e ekonomistit të mirë.
2. Në këtë rast ka për detyrë të respektojë udhëzimet që ia ka dhënë urdhërdhënësi.
3. Ai ka për detyrë t'i jep urdhërdhënësit të gjithë njoftimet e nevojshme mbi situatën e tregut, sidomos ato që kanë rëndësi për çdo punë të veçantë.

811.1. Paragrafi i parë i nenit 811 të LMD i kërkon agjentit tregtar që, kur vepron në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, të kujdeset për mbrojtjen e interesave të tij, ashtu që gjatë përkujdesjes për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit ai duhet të praktikojë një standard të lartë të sjelljes dhe kujdesit. Sigurisht, agjenti tregtar gjatë kryerjes së punëve për urdhërdhënësin, pikë së pari ka për qëllim dhe detyrim të ekzekutojë punët dhe veprimet përkatëse në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e siguruar nga urdhërdhënësi. Megjithatë, gjatë kryerjes së punëve dhe veprimeve juridike të miratuara nga urdhërdhënësi, para agjentit shtrohet edhe çështja e ekzekutimit edhe e një sërë veprimesh të tjera juridike ose faktike, të cilat ndërlidhen me kryerjen e veprimeve të para (veprimeve themelore). Paragrafi në fjalë i kërkon urdhërdhënësit që gjatë çdo aktiviteti të përfaqësimit, të mbrojë interesin më të mirë të urdhërdhënësit. Madje, në kuptim të autorizimeve që i ka marrë përsipër, ai duhet të ekzekutojë edhe aso veprimesh përkatëse, (përtej miratimit përkatës nga urdhërdhënësi), nëse ndërmarrja e e tyre është në funksion të mbrojtjes së interesit të urdhërdhënësit, (për mundësinë e fundit në këtë fjalë shihmë lart komentimin e nenit 809 dhe 810 të LMD). Kështu, p.sh. agjenti, duke pasur për qëllim të mbrojë interesin e urdhërdhënësit, i bënë deklarata ose kundërshtime përkatëse urdhërdhënësit, të tilla si njoftimi për të metat materiale ose juridike të sendit, njoftimi ose kundërshtimi i sasisë ose cilësisë së mallit të dorëzuar, protestat rreth paketimit dhe transportimit të mallit, njoftimi në lidhje me ushtrimin e të drejtës së mbajtjes (ius retentionis), pastaj detyrimi i ndërmarrjes së masave siguroese në pajtim me të drejtën e mbajtjes, njoftimi për të metat materiale të sendit, njoftimi për të metat juridike të sendit, njoftimi ose kundërshtimi i sasisë ose cilësisë së mallit të dorëzuar, protestat rreth paketimit dhe transportimit të mallit, njoftimi në lidhje me ushtrimin e të drejtës së mbajtjes (ius retentionis), deklarata për kundërshtimin për mospërbushje të kontratës ose deklarata për përmbushje të parregullt të kontratës” etj. Në praktikën juridike me të drejtë është shtruar një pyetje, e cila ka të bëjë me atë nëse “agjenti tregtar mund ta përfaqësojë dhe ta mbrojë interesin e të dyja palëve njëkohësisht në një transaksion - kontratë? Një shembull i tillë haset të kontrata për ndërmjetësimin, në bazë të secilës ndërmjetësuesi ndërmjetëson te të dyja palët për arritjen e marrëveshjes përkatëse lidhur me objektin e kontratës. Teoria dhe praktika juridike i është përgjigjur pyetjes në fjalë në mënyrë negative, duke i mohuar mundësinë agjentit që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin transaksion juridik të mbrojë interesin e të dyja palëve. Mendohet

se paraqitja e agjentit tregtar në rolin e mbrojtjes së interesit të dy apo më shumë palëve në një transaksion juridik, në vetvete është në kundërshtim me detyrimin e agjentit për mbrojtjen e interesave të palës që përfaqëson, përkatësisht përbën konflikt interesi të agjentit kundrejt mundësisë së mbrojtjes së interesave të kundërta të palëve të ndryshme në një transaksion.⁶⁵⁷

Gjatë kryerjes së veprimeve të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të urdhërdhënësit, paragrafi në fjalë kërkon që agjenti tregtar të tregojë kujdesin e ekonomistit të mirë. Standardi i ekonomistit të mirë nënkupton standardin e sjelljes së një ndërmarrësi - profesionisti veçanërisht të kujdesshëm. Ky standard mund të konstitujë përgjegjësinë e agjentit edhe për lëshimet më të vogla në zbatimin e urdhrave ose të mbrojtjes së interesave të urdhërdhënësit, lëshime këto që rëndom një ekonomist i mirë nuk do të duhej t'i lejonte. Me fjalë të tjera, komisionari i përgjigjet komitentit me standardin e profesionistit, çka nënkupton edhe përgjegjësinë për lëshimet më të vogla të agjentit. Sigurisht, në vlerësimin e përgjegjësisë së agjentit sipas standardit të "ndërmarrësit të mirë", gjykata do të ketë në konsideratë veprimet konkrete të agjentit në rrethanat e rastit konkret, të vëna në raport me sjelljet që një ndërmarrës i mirë do të duhej t'i tregonte sikur të ishte në vendin e agjentit në rrethanat e dhëna.

811.2. Agjenti, gjatë përfaqësimit të urdhërdhënësit, duhet t'i përmbahet urdhrit, përkatësisht udhëzimeve të marra nga urdhërdhënësi. Agjenti bart në vete vetëm atë pushtet të përfaqësimit të urdhërdhënësit sa ky i fundit e ka autorizuar atë. Varësisht nga karakteri detyrues i urdhrave-udhëzimeve të lëshuara nga urdhërdhënësi, pushteti që i ka kaluar agjentit dhe mundësia e veprimit në kuadër të pushtetit të dhënë ndryshon. P.sh., në rastin e urdhrave imperativ, është detyrë e agjentit vetëm t'i përmbahet rreptësisht përmbajtjes së urdhrave të urdhërdhënësit. Për dallim nga kjo, mund të ekzistojnë ashtu situatash kur agjenti urdhërohet-udhëzohet të bëjë zgjedhje të ndryshme diskrecionale në kuadër të urdhrave të marrë nga urdhërdhënësi.⁶⁵⁸

Nëse agjenti vepron përtej përmbajtjes së urdhrave të urdhërdhënësit, konsiderohet se agjenti ka tejkalluar autorizimin, (shih rregullat adekuate të tejkallimit të autorizimit) dhe mund të bartë përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, të cilin eventualisht mund ta shkaktojë me atë rast. Megjithatë, edhe në situata të tilla, urdhërdhënësi mund të lejojë konvalidimin e kontratës për rastet kur pranon, përkatësisht kur jep pëlqimin për tejkallimin e urdhrave të tij në situatën e dhënë, (shih rregullat në lidhje me konvalidimin e kontratës). Në teorinë juridike ekziston mendimi se dhënia e pëlqimit nga urdhërdhënësi për pranimin e tejkallimit të autorizimit nuk duhet të vlejë si përgjigje për konvalidimin edhe të kontratave ose situatave të tjera të përfaqësimit ndërmjet palëve të njëjta. Me fjalë të tjera, pëlqimi në lidhje me tejkallimin e autorizimit duhet të jetë specifik dhe t'i referohet situatës së dhënë ose situatave saktësisht të përcaktuara ndërmjet palëve.⁶⁵⁹

657 Për më shumë në lidhje me një komentim të ngjashëm, shih: Blagojević, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 345 - 347.

658 Për më shumë në lidhje me përmbajtjen dhe llojet e ndryshme të autorizimeve, shih: Dauti, Nerxhivane. *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë, 2004: fq. 309

659 Po aty, fq. 1746 - 1748.

811.3. Në kuptim të paragrafit të tretë të njëjtit nen, LMD vendos detyrimin e agjentit tregtar që urdhërdhënësin ta pajisë me njoftime të nevojshme për situatën në treg ose t'i sigurojë informata të tilla që janë me rëndësi relevante për kryerjen e punëve të veçanta që lidhen me autorizimin, përndryshe, pa paraqitjen e informatave relevante, urdhërdhënësi nuk do të mund të çmonte situatën përkatëse, në të cilën ndodhet agjenti tregtar gjatë përfaqësimit. Sigurisht, gjatë kryerjes së punëve, agjenti u përmbahet urdhrit dhe udhëzimeve të urdhërdhënësit, megjithatë përkujdeset që veprimet që ndërmerret të jenë në interesin e urdhërdhënësit. Nëse ndodh që agjenti të vlerësoj se kryerja e një veprimi përkatës nuk është në interesin më të mirë të urdhërdhënësit, edhe pse urdhërdhënësi e ka kërkuar atë në urdhër, mendohet që në një situatë të tillë agjenti prapëseprapë duhet t'i kërkojë udhëzim përkatës urdhërdhënësit, duke e këshilluar për mangësitë ose rrezikimin e interesave të tij, në rast të kryerjes së veprimeve sipas urdhrit paraprak. Nëse me gjithë njoftimin dhe vërejtjen e agjentit, urdhërdhënësi kërkon kryerjen e urdhrit përkatës, atëherë konsiderohet se agjenti duhet t'i përmbahet urdhrit të urdhërdhënësit në pajtim me parimin e mbrojtjes së interesit të urdhërdhënësit dhe standardeve profesionale të ekonomistit të mirë.⁶⁶⁰

Neni 812. Informatat dhe raportimi

- 1. Përfaqësuesit tregtar duhet ti ofrojë urdhërdhënësit të gjitha informatat e nevojshme mbi situatën e tregut, veçanërisht për informata për secilën punë juridike të kryer.**
- 2. Përfaqësuesi tregtar është i detyruar që ti raportojë mbi punën e tij rregullisht urdhërdhënësit, veçanërisht mbi personat e tretë që kanë dëshirë të negociojnë me urdhërdhënësin apo që të lidhin kontratë me të si dhe për kontratat e lidhura në emër të urdhërdhënësit.**
- 3. Çdo marrëveshje që është në kundërshtim me paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni është e pavlefshme.**

812.1. Paragrafi i parë i nenit 812 të LMD vendos detyrimin e agjentit që urdhërdhënësin vazhdimisht ta mbajë të informuar për situatën dhe kushtet e tregut; këto informata janë të rëndësishme për kryerjen e punëve-veprimeve të veçanta të përfaqësimit. Para së gjithash, është detyrim i agjentit që urdhërdhënësin ta mbajë të informuar në lidhje me rrjedhën e punëve gjatë përfaqësimit. Kështu, ligjvënësi, duke pasur parasysh se agjenti vepron shpeshherë në tregje ose në situata që janë të panjohura për urdhërdhënësin ose vepron me klientelë të cilën ai nuk e njih mirë ose nuk e njih fare, ashtu që me të drejtë kërkohet detyrimi i agjentit që ta njoftojë urdhërdhënësin për gjendjet përkatëse relevante (gjendjen e tregut, kërkesat e klientelës etj.), njoftime këto që urdhërdhënësi i mundësojnë të japë ose të modifikojë udhëzime që i drejtohen agjentit tregtar në lidhje me përfaqësimin. Më tej, në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, agjenti tregtar posaçërisht ka për obligim ta njoftojë urdhërdhënësin për punët juridike të kryera (në emër dhe për llogari të tij), ashtu që, duke njoftuar për kryerjen e punëve, ia kalon atij rezultatet e punëve të kryera apo merr udhëzime përkatëse se si të veprojnë me rezultatet e punëve të kryera ose të arritura.

⁶⁶⁰ Shih në lidhje me këtë edhe: Alishani, Alajdin: *E drejta e detyrimeve*. Prishtinë: 1988: fq. 307.

812.2. Me paragrafin e dytë të këtij neni vendoset detyrimi i agjentit për t'i raportuar rregullisht urdhërdhënësit. Është detyrim themelor i agjentit që urdhërdhënësit t'i japë llogari, përkatësisht t'i paraqesë raport për punët juridike të kryera, punët juridike në procedim (dhe shpjegimin e rrjedhës së tyre), përkatësisht t'i raportojë në lidhje me palët e treta, të cilat kanë për qëllim të lidhin punë juridike me urdhërdhënësin ose me të cilët agjenti tashmë ka lidhur kontrata përkatëse. Sigurisht, raportimi ka të bëjë si me kontratat që janë lidhur me personat e tretë, ashtu edhe me rrjedhën e veprimeve juridike - punëve që janë në proces të zhvillimit ose në lidhje me negociatat që po zhvillohen me palët e treta për lidhjen e kontratave të reja apo edhe për rrethana të tjera për të cilat palët janë pajtuar se duhet të raportohen ose kur nga vetë natyra e rëndësisë së tyre, lind detyrimi i agjentit t'i raportojë ato etj. Raportimi për urdhërdhënësin mund të jetë i kohëpaskohshëm, periodik ose të bëhet sipas fazave paraprakisht të përcaktuara nga palët në kontratë ose përmes mjeteve dhe në formën e dakorduar ndërmjet palëve (p.sh., me shkrim) ose sipas praktikës së themeluar prej tyre apo edhe sipas dokeve afariste përkatëse. Nëse në një rast të dhënë veprojnë dy ose më tepër agjentë për të njëjtin urdhërdhënës, atëherë detyra e dhënies llogari dhe e raportimit aplikohet për secilin agjent në lidhje me rrethin e punëve dhe detyrave të tij të raportimit.⁶⁶¹

812.3. Paragrafi i tretë i të njëjtit nen themelon rregullën që çfarëdo marrëveshjeje ose klauzole-kushti i veçantë në marrëveshje, që do të ishte në kundërshtim me detyrimet e agjentit tregtar, të përcaktuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, do të ishin të pavlefshme dhe nuk do të prodhonin efekte juridike. Si një përjashtim për dispozitat e LMD, nga karakteri i paragrafit të tretë të këtij neni shihet karakteri detyrues i dy paragrafëve paraprak të po të njëjtit nen të LMD, ashtu që në lidhje me përmbajtjen e tyre palët nuk mund të bëjnë ndonjë përjashtim ose kufizim. Sigurisht, në rast të kufizimit me kontratë të përcaktimeve të paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, vetvetiu kontrata për përfaqësim tregtar nuk do të shpallej nule, përkatësisht nule do të duhej të shpallehin vetëm kufizimet që u janë bërë kërkesave të paragrafëve përkatëse dhe, në vend të klauzolave të kontratës, do të duhej të zbatoheshin kërkesat e paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni.

Neni 813. Pjesëmarrja në kontraktimin e punëve

Përfaqësuesit tregtar ka për detyrë të marrë pjesë sipas udhëzimeve të urdhërdhënësit në kontraktimin e punëve deri në përfundimin e tyre të plotë.

813. Një nga detyrimet themelore të agjentit tregtar është ai që agjenti duhet t'i kryejë punët - veprimet juridike përkatëse në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit. Agjenti i kryen punët ashtu si është përcaktuar në kontratë ndërmjet palëve ose, në mungesë të dispozitave kontraktuese, ashtu siç kërkon natyra e punës ose që punën ta kryejë, duke i pasur në konsideratë standardet e caktuara profesionale; (kjo e fundit është e zbatueshme

661 Një interpretim të ngjashëm për detyrimet të autorizuar, në rast të ekzistimit të më shumë të autorizuarve ofrojnë edhe: Vedris, Martin dhe Petar Klaric. *Osnovi imovinskog prava*. Zagreb: 1987: fq. 392.

në mungesë të udhëzimeve në kontratë ose kur natyra e punës nuk nënkupton një sjellje të caktuar për agjentin). Në kuptim të dispozitës së nenit 813 të LMD, agjenti duhet të kujdeset dhe të veprojë në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit gjatë kryerjes së veprimeve juridike, lidhjes së kontratës si dhe përkujdesjes për përmbylljen e efekteve-detyrimeve kontraktuese, përderisa puna juridike të përmbillet dhe rezultatet e punës t'i kalojnë urdhërdhënësit. Fakti se detyrimet e agjentit në marrëdhënien e përfaqësimit përbëjnë një proces që rrjedh për një interval kohor më të gjatë, në kuadër të të cilit agjenti duhet të ndërmarrë (në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit) një tërësi veprimesh juridike ose edhe faktike, e bën kontratën e përfaqësimit tregtar të jetë e ndryshme nga kontrata për ndërmjetësimin (në rastet më të shpeshta të kontrata e ndërmjetësimit detyra e ndërmjetësuesit pushon në momentin kur palët vendosen në kontakt të drejtpërdrejtë dhe lidhin kontratën përkatëse të ndërmjetësuar).

Sigurisht, që nga momenti i parë kur lidhet kontrata për përfaqësimin e deri në përmbylljen e detyrimeve të agjentit, ky rëndom vazhdon të pranojë udhëzime të reja nga urdhërdhënësi, të cilave agjenti duhet t'iu përshtatet, por nën përgjegjësinë e urdhërdhënësit. Kështu, nëse udhëzimet e reja që agjenti i merr nga urdhërdhënësi i ndryshojnë esencialisht detyrimet fillestare të agjentit, ky ka të drejtë që për kontributin shtesë me qëllim të përfaqësimit të kërkojë rritje përkatëse të shpërblimit.

Neni 814. Ruajtja e sekreteve të punës

- 1. Përfaqësuesit tregtar ka për detyrë t'i ruajë sekretet e punës të urdhërdhënësit të tij për të cilat ka mësuar lidhur me punën që i është besuar.**
- 2. Ai përgjigjet po që se i shfrytëzon ose ia zbulon tjetrit edhe pas pushimit të kontratës mbi agjencinë tregtare.**

814.1. Për kontratën për përfaqësimin (duke përfshirë edhe përfaqësimin tregtar) thuhet se është kontratë personale (intuitu personae). Kualitetet personale të palëve, veçanërisht kualitetet personale të agjentit e gjithashtu edhe besimi që ai gëzon te urdhërdhënësi janë një element thelbësor i kontratës. Rëndom kontrata për përfaqësimin tregtar lidhet me agjentë që kanë reputacion dhe besimin e urdhërdhënësit, prandaj ndodh shpesh që gjatë kryerjes së veprimeve të përfaqësimit agjentët të mësojnë informata konfidenciale ose të kenë në duar dokumente konfidenciale. Është detyrim thelbësor i agjentit që të ruajë sekretet afariste dhe informatat konfidenciale, të cilat i ka mësuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përfaqësimit. Detyrimin e ruajtjes së sekretit afarist ose të informatave konfidenciale, si barrë për agjentin, e ka vendosur paragrafi i parë i nenit 814 të LMD.

Gjatë ofrimit të shërbimeve të përfaqësimit, agjenti tregtar rëndom ka edhe një klientelë tjetër që e shërben. Në kuptim të kësaj, agjenti tregtar duhet të përmbahet nga situatat e përdorimit në interesin e tij ose të të tretit të informatave të mësuara nga urdhërdhënësi.

Për shembull, përmbajtja e një dokumentacioni të ofertës nuk do të konsiderohej në vetvete një dokument konfidencial ose sekret afarist, por nëse këto informata do të përdreshin për interesin e agjentit ose të të tretit, (që i treti ose agjenti të fitojë një kontratë të shpallur në një tender publik), atëherë kjo do të paraqiste keqpërdorim të besimit dhe do të cenonte detyrimin e konfidencialitetit të agjentit.⁶⁶²

814.2. Paragrafi në vijim i po të njëjtit nen saktëson detyrimin e agjentit që të vazhdojë të ruajë sekretin ose informatat konfidenciale edhe pas përfundimit të marrëdhënies së përfaqësimit. LMD nuk vendos ndonjë afat të zgjatjes së detyrimi të agjentit për të ruajtur informatat e mësuara në marrëdhënien e përfaqësimit, megjithatë shumë autorë mendojnë se detyrimi i agjentit për të ruajtur informatat konfidenciale vazhdon të jetë i detyrueshëm për të edhe pas shuarjes së kontratës së përfaqësimit dhe ky për aq kohë sa këto informata “kanë në përmbajtjen e tyre rëndësinë e ruajtjes së tyre si fshehtësi afariste”.⁶⁶³

Neni 815. Kthimi i sendeve të dhëna në përdorim

Pas pushimit të kontratës mbi përfaqësimin tregtar, përfaqësuesi tregtar ka për detyrë t’i kthejë urdhërdhënësit të gjitha sendet që ia ka dorëzuar ky për përdorim gjatë afatit të kontratës.

815. Sapo të përmyllet marrëdhënia e përfaqësimit, agjenti tregtar obligohet që urdhërdhënësit të tij t’ia kthejë të gjitha sendet - vlerat pasurore, të cilat i ka marrë në posedim ose përdorim gjatë marrëdhënies së përfaqësimit ose nëse ato ndërlidhen me marrëdhënien e përfaqësimit dhe kanë qenë të destinuara për përdorim për aq sa zgjatë marrëdhënia e përfaqësimit. Rëndom, të tilla ose të ngjashme mund të jenë mostrat (p.sh. të reklamuar ose të përdorura në panairë), materialet reklamuese, mjetet ose pajisjet teknike të përdorura në lidhje me përfaqësimin etj. Te detyrimi i agjentit që t’i kthejë sendet nuk është me rëndësi nëse ato i ka pranuar direkt nga urdhërdhënësi apo ndonjë personi tjetër i cili i ka dhënë ato për urdhërdhënësin. Përfundimisht, agjenti tregtar ka për obligim t’i kthejë sendet, përkatësisht mund t’i mbajë ato në emër të së drejtës së pengut nëse në rastin e dhënë gjen zbatim neni 826 i LMD, (shih komentimin e tij më poshtë).⁶⁶⁴

662 Një përcaktim të ngjashëm të detyrimit të ruajtjes së sekretit afarist në të drejtën krahasuese e rregullon edhe neni 418 d i Kodit Zvicrën të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 18.10.2013.

663 Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 411.

664 Një përcaktim të ngjashëm të detyrimit të ruajtjes së sekretit afarist në të drejtën krahasuese e rregullon edhe neni 418 v i Kodit Zvicran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 18.10.2013.

Neni 816. Rasti i veçantë i përgjegjësishë

- 1. Përfaqësuesi tregtar i përgjigjët urdhërdhënësit për përmbushjen e detyrimeve nga kontrata për kontraktimin e së cilës përfaqësuesi tregtar ka ndërmjetësuar, ose të cilën në bazë të autorizimit ai e ka kontraktuar në emër të urdhërdhënësit, vetëm në goftë se për këtë ka garantuar posaçërisht me shkrim.**
- 2. Sigurimi i përmbushjes në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni do të jetë i mundshëm vetëm për punët e veçanta juridike ose punët juridike me person të veçantë.**
- 3. Përfaqësuesit tregtar i cili i ka ofruar sigurim urdhërdhënësit për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e ndërmjetësuar nga përfaqësuesit tregtar, ka të drejtë edhe në shpërblim të posaçëm (provizion del credere).**

816.1. Ashtu si është komentuar edhe më lart, përfaqësuesi tregtar vepron në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, duke pasur në konsideratë gjatë tërë kohës mbrojtjen e interesit të urdhërdhënësit dhe ushtrimin e veprimeve të përfaqësimit me mirëbesim dhe në pajtim me standardin e ekonomistit të mirë. Përtej këtij kuptimi, agjenti tregtar nuk përgjigjet për mospërmbushjen ose dështimin e palës së tretë në përmbushjen e detyrimeve ndaj urdhërdhënësit. Agjenti tregtar nuk bart përgjegjësi, kur me gjithë kujdesin e mjaftueshëm të treguar, pala e tretë nuk i përmbush detyrimet përkatëse ndaj urdhërdhënësit. Përfundimisht, në rastin e marrëveshjes së përfaqësimit “star del credere”, agjenti tregtar dhe urdhërdhënësi mund të merren vesh shprehimisht që agjenti t’i ofrojë siguri të posaçme urdhërdhënësit për suksesin e përmbushjes së detyrimit të palës së tretë. Kjo formë e kontraktimit dhe e marrjes së përgjegjësishë personale të agjentit duhet posaçërisht të kontraktohet dhe të ekzekutohet me shkrim. Klauzola “star del credere” mund të kontraktohet si kontratë e veçantë ose si një nga kushtet-klauzolat e specifikuar në marrëveshjen e përfaqësimit. Në rast të një kontraktimi të tillë, agjenti tregtar merr përgjegjësi përkatëse, të pakufizuar, në përmbushjen e detyrimit, përkatësisht në shpërblimin e dëmit, nëse pala e tretë lë pa përmbushur detyrimet e saj ndaj urdhërdhënësit.

816.2. Më tej, klauzola “star del credere” në kontratën për përfaqësim tregtar, mund të kontraktohen vetëm punët e veçanta juridike ose punët juridike, të cilat i referohen personit të tretë të veçantë. LMD, në paragrafin e dytë të këtij neni, kërkon nga palët kontraktuese që të sigurojnë më shumë saktësi në marrëveshjen e tyre në lidhje me atë se cilat punë juridike janë të mbuluara me klauzolën në fjalë ose saktësisht të përcaktohet personi i tretë, detyrimet e të cilit sigurohen me klauzolën në fjalë.

816.3. Duke pasur parasysh përgjegjësinë e rritur të agjentit tregtar në rast të kontraktimit të klauzolës “star del credere”, paragrafi i tretë i këtij neni të LMD, agjentit tregtar ia njeh të drejtën e shpërblimit të posaçëm (provizion del credere), si kundërvlerë për masën dhe vëllimin e rrezikut që ai merr përsipër. Sigurisht, nëse palët nuk kanë saktësuar sasinë e tij,

gjykata do ta ketë në konsideratë të drejtën e agjentit për shpërblim shtesë për përgjegjësinë shtesë të tij mbi këtë bazë.⁶⁶⁵

KREU 3. DETYRIMET E URDHËRDHËNESIT

Neni 817. Rregulla e përgjithshme

- 1. Urdhërdhënësi, në marrëdhënien me përfaqësuesit tregtar, duhet të veprojë me sinqeritet dhe me mirëbesim. Urdhërdhënësi duhet të njoftojë përfaqësuesin tregtar nëse urdhërdhënësi nuk do të kryej ndonjë punë juridike me palën e tretë apo nëse pala e tretë nuk ka kryer ndonjë punë juridike.**
- 2. Urdhërdhënësi duhet ti ofrojë përfaqësuesit tregtar në shërbimet e tij të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, shembujt, planet, listat e çmimeve, materialet reklamuese, rregullat dhe kushtet e përgjithshme të biznesit, etj. Shpenzimet e përkthimit dhe shtypjes së materialit reklamues në gjuhën zyrtare në Kosovë mbulohen nga përfaqësuesit tregtar.**
- 3. Urdhërdhënësi duhet ti ofrojë përfaqësuesit tregtar të gjitha informacionet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës mbi agjencinë tregtare.**

817.1. Kontrata për përfaqësimin tregtar është kontratë e dyanshme-detyruese; ajo prodhon të drejta dhe detyrime reciproke për secilën palë. Neni 817 i LMD vendos më tej disa standarde të sjelljes dhe të përgjegjësisë për urdhërdhënësin, i cili duhet t'i ketë në konsideratë në marrëdhënien e përfaqësimit. Fjalja e parë e paragrafit të parë të këtij neni i kërkon urdhërdhënësit që ai, në marrëdhënien e përfaqësimit, të veprojë me sinqeritet dhe mirëbesim. Kjo do të nënkuptonte detyrimin për urdhërdhënësin që ai të përmbahet nga veprimet ose mosveprimet, të cilat do ta vendosnin ose do ta mbanin agjentin në një pozitë të papërshtatshme, që do të mund të çmohej si "veprim me keqbesim i urdhërdhënësit". Më tej, në kuptim të këtij detyrimi, urdhërdhënësi do të duhej ta pajiste agjentin tregtar me të gjitha informatat relevante, të cilat do t'i mundësonin një vlerësim më të përshtatshëm për kryerjen e veprimeve të përfaqësimit në interesin e urdhërdhënësit me sa më pak shpenzime ose ngarkesa.

817.2. Siç u tha edhe më sipër, urdhërdhënësi mund dhe duhet të vërë në dispozicion të agjentit tregtar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, shembujt, planet, listat e çmimeve, materialet reklamuese, rregullat dhe kushtet e përgjithshme të biznesit të tij, si dhe sende, materiale ose informata të tjera të nevojshme për kryerjen me sukses të veprimeve të përfaqësimit. Këtu mund të shtrohet pyetja se çfarë ndodh nëse urdhërdhënësi nuk e

665 Një përcaktim të ngjashëm të detyrimit të mbajtjes së sekretit afarist në të drejtën krahasuese e rregullon edhe neni 418 c. parag. 3 i Kodit Zviceran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 18.10.2013.

përmbush këtë detyrim (që mund të ndodhë ndonjëherë nga pakujdesia)? Sigurisht, në rastin më ekstrem, nëse mospërmbushja e obligimit të urdhërdhënësit sipas kërkesës së këtij paragrafi është esenciale në ekzekutimin me sukses të punëve të përfaqësimit, kjo do të paraqiste shkelje të detyrimeve kontraktuese të urdhërdhënësit, ashtu që kjo gjendje do t'i mundësonte palës tjetër-agjentit të kërkonte zgjidhjen e kontratës dhe eventualisht shpërblimin e dëmit. Gjithashtu, agjenti nuk bart përgjegjësi nëse urdhërdhënësit i është shkaktuar dëm për faktin e mospërmbushjes së këtij detyrimi ndaj tij.

Kur flitet për gjësende dhe dokumentacionin që i dorëzohet agjentit, të gjitha këto dokumente, gjësende, materiale reklamuese, modele ose mostra etj., vazhdojnë të ngelin në pronësinë e urdhërdhënësit, megjithatë agjenti tregtar i mban dhe përdorë ato në mirëbesim përgjatë kohës së përfaqësimit të urdhërdhënësit (për aq sa do të jenë të nevojshme), ashtu që me përmbylljen e kontratës së përfaqësimit, ato duhet t'i kthehen mbrapa urdhërdhënësit, (shih më lart në lidhje me këtë edhe komentimin e nenit 815). Sigurisht, agjenti tregtar nuk do të jetë i obliguar t'i kthejë mbrapa sendet e konsumueshme, të cilat janë konsumuar ose shpenzuar gjatë kryerjes së veprimeve të përfaqësimit dhe gjithashtu ai nuk përgjigjet as për amortizimin e rëndomtë të tyre. Më tej, fjalia e dytë e paragrafit të dytë të këtij neni përcakton se shpenzimet për përkthimin dhe shtypjen e materialit reklamues në gjuhën/gjuhët zyrtare në Kosovë mbulohen nga përfaqësuesi tregtar.

817.3. Një obligim i përgjithshëm i urdhërdhënësit, ashtu siç është vendosur në paragrafin e tretë të këtij neni, është detyrimi i urdhërdhënësit dhe agjentin tregtar ta pajisë me “të gjitha informacionet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës mbi agjencinë tregtare”. Sigurisht, përderisa agjenti vepron “në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit”, agjenti tregtar mund ta përmbyllë me sukses detyrën e përfaqësimit vetëm nëse urdhërdhënësi e ka pajisur me informata të nevojshme dhe relevante për kryerjen e punëve. Ndërkaq, agjenti, përgjatë kryerjes së punëve juridike, vazhdimisht e informon dhe kërkon udhëzime shtesë nga urdhërdhënësi, (nëse e sheh këtë të nevojshme) dhe gjatë tërë kohës duhet të sillet me standardin e ekonomistit të mirë (profesionistit). Në kuptim të kësaj, agjenti tregtar nuk mbanë përgjegjësi, nëse lëshimet e caktuara ose dëmet e shkaktuara gjatë përfaqësimit janë pasojë e keqinformimit ose e lëshimeve në informimin e agjentit tregtar, detyrim këtë që nuk e ka përmbushur ashtu siç duhet urdhërdhënësi.

Neni 818. Detyra e njoftimit

- 1. Urdhërdhënësi mundet sipas dëshirës së vet të pranojë ose të refuzojë lidhjen e kontratës së përgatitur nga ana e përfaqësuesit tregtar, por ka për detyrë të njoftojë pa vonesë përfaqësuesin tregtar mbi vendimin e vet. Urdhërdhënësi duhet të njoftojë përfaqësuesin në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e punëve të kontraktuara me personat e tretë.**
- 2. Urdhërdhënësi ka për detyrë të njoftojë përfaqësuesit tregtar pa vonesë mbi nevojën që volumi i punëve të kontraktuara me ndërmjetësimin e tij të reduktohet në një masë më të vogël nga sa përfaqësuesit tregtar ka mundur të presë në mënyrë të arsyeshme kështu që ky të zvogëlojë në kohën e duhur sipërmarrjen e vet në një masë përkatëse, përndryshe urdhërdhënësi do të përgjigjet për dëmin e pësuar.**

818.1. Duke pasur parasysh se agjenti vepron në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, është krejtësisht e natyrshme e drejta diskrecionale e urdhërdhënësit që të pranojë ose të mos pranojë lidhjen e kontratave të përgatitura nga agjenti tregtar, me kushtin që agjentin tregtar ta informojë pa vonesë për qëllimin e tij të mirëfilltë. E drejta e urdhërdhënësit për diskrecionin e zgjedhjes së lidhjes ose refuzimit të lidhjes së kontratës, përkatësisht detyrimi i tij që pa vonesë ta informojë agjentin për vendimin e vet është pasqyruar në paragrafin e parë të nenit 818 të LMD. Në kuptim të paragrafit në fjalë, urdhërdhënësi do të mund të mbahet përgjegjës nëse dështon ose e neglizhon detyrimin e informimit të agjentit tregtar në lidhje me vendimin e vet, përkatësisht nëse agjenti tregtar pëson shpenzime shtesë ose eventualisht ndonjë dëm për shkak të mosnjoftimit me kohë nga urdhërdhënësi për rrethanat me rëndësi për kryerjen e urdhrat, ashtu që agjenti mbi këtë bazë mund të kërkojë shpërblimin e dëmit, përkatësisht shpërblimin e shpenzimeve të pësuar mbi këtë bazë.

818.2. Më kontratën për përfaqësimin urdhërdhënësi ia kalon përfaqësuesit tregtar “pushtetin” që ky i fundit të kryejë veprime juridike në interesin e tij, prandaj, duke pasur parasysh natyrën e kontratës së përfaqësimit, vëllimi i pushtetit që i kalohet agjentit tregtar vazhdimisht mund të korrigjohet nga urdhërdhënësi, përkatësisht të kufizohet ose edhe të revokohet në tërësi, (shih në lidhje me këtë mundësi komentimin e nenit 80 të LMD që ka të bëjë me revokimin dhe kufizimin e prokurës). Kjo mundësi duket se është pohuar edhe për sa i përket kontratës së përfaqësimit tregtar, kështu që paragrafi i dytë i nenit 818 të LMD shtjellon këtë mundësi dhe vendos detyrimin e urdhërdhënësit që, pa humbur kohë, ta njoftojë agjentin tregtar për ndryshimet përkatëse, të cilat i bën në vëllimin e prokurës-përfaqësimit. Kështu, urdhërdhënësi, pa humbur kohë, duhet ta njoftojë agjentin në lidhje me zvogëlimin e rrethit të autorizimeve, përkatësisht punëve që agjenti mund t’i bëjë, me qëllim që agjenti të adoptojë ndryshime përkatëse në kohën e nevojshme që i duhet për kryerjen e “punëve-rrethit të punëve” të zvogëluara. Sigurisht, paragrafi në fjalë e mban përgjegjës urdhërdhënësin për shpërblimin e dëmit ose të shpenzimeve të shkaktuara agjentit, si rezultat i neglizhimit ose dështimit të përbushjes së detyrimit për njoftimin e agjentit.⁶⁶⁶

.....
⁶⁶⁶ Një përcaktim të ngjashëm në të drejtën krahasuese e rregullon edhe neni 618 f, par.2 i Kodit Zvicrën të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 20.10.2013.

Neni 819. Natyra e detyrueshme e dispozitave

Çdo marrëveshje mes palëve që është në kundërshtim me nenet e mësipërme është e pavlefshme.

819. Neni 819 i LMD pasqyron karakterin imperativ të rregullimit dhe përcaktimit të detyrimeve për urdhërdhënësin në nenet 817 dhe 818. Me fjalë të tjera, palët nuk mund t'i kufizojnë me marrëveshje detyrimet e urdhërdhënësit të vendosura nga dy nenet e mësipërme. Përndryshe, marrëveshjet, përkatësisht dispozitat kontraktuese të palëve që do të ishin në kundërshtim me përcaktimet e neneve në fjalë, nuk do të prodhonin efekt juridik.

Neni 820. Shpërblimi (provizion)

- 1. Urdhërdhënësi ka për detyrë t'i paguajë përfaqësuesit tregtar shpërblimin për kontratat e lidhura me ndërmjetësimin e tij, si dhe për kontratat të cilat vetë agjenti i ka lidhur, në qoftë se për këtë ka qenë i autorizuar.**
 - 2. Përfaqësuesit tregtar ka të drejtë në shpërblimin edhe për kontratat të cilat urdhërdhënësi i ka lidhur drejtpërdrejtë me klientët që i ka gjetur përfaqësuesit tregtar.**
 - 3. Përfaqësuesit tregtar i cili sipas kontratës punon vetëm në një fushë të caktuar apo vetëm me palë të caktuara, ka të drejtë në shpërblimin për këto lloj kontratash të lidhura për urdhërdhënësin me palë nga kjo fushë apo me palët e veçanta edhe nëse janë bërë pa ndërmjetësimin e përfaqësuesit tregtar.**
 - 4. Përfaqësuesit tregtar i ka të drejtë vetëm në provizion për kontratën e lidhur pas përfundimit të marrëdhënies ndërmjet përfaqësuesit tregtar dhe urdhërdhënësit, nëse kontrata e tillë është si rezultat i përpjekjeve të përfaqësuesit tregtar gjatë marrëdhënies me urdhërdhënësin dhe është lidhur pas një kohë të arsyeshme nga përfundimi i kësaj marrëdhënie ose nëse oferta e personit të tretë për lidhjen e kontratës ka ardhur tek përfaqësuesit tregtar apo urdhërdhënësi para përfundimit të marrëdhënies së tyre dhe ka të bëjë me ndonjërin prej kontratave sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni.**
 - 5. Paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni nuk do të zbatohen nëse e drejta në provizion është shfrytëzuar nga përfaqësuesi tregtar i mëparshëm sipas paragrafit 4. të këtij neni, përveç nëse sipas rrethanave do të ishte e drejtë që provizioni të ndahej ndërmjet përfaqësuesve tregtar.**
-

820.1. Kryesisht kontrata për përfaqësimin tregtar është kontratë me shpërblim, prandaj urdhërdhënësi i detyrohet agjentit tregtar t'ia paguajë shpërblimin përkatës. Shpërblimi që i paguhet agjentit nënkupton kundërvlerën përkatëse pasurore, e cila i paguhet atij si shpëgjim për punën, përkatësisht arritjen e rezultateve të kërkuara nga urdhërdhënësi. Agjentit tregtar i takon e drejta e realizimit të shpërblimit si për rastet kur agjenti ka ndërmjetësuar dhe i

ka mundësuar urdhërdhënësin të lidhë kontrata me palët e treta, ashtu edhe në rastet kur kontratat i ka lidhur vetë agjenti në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, (kur për këtë ka qenë i autorizuar). Rëndon, agjentit tregtar i takon e drejta e shpërblimit përkatës edhe për rastet kur ndërmjetësimi për lidhjen e kontratës ose vetë lidhja e kontratës ka dështuar për rrethanat për të cilat është përgjegjës urdhërdhënësi.⁶⁶⁷

820.2. Në kuptim të së drejtës për pagesën e shpërblimit, paragrafi i dytë i të njëjtit nen rregullon se përfaqësuesit do t'i takojë e drejta e shpërblimit-provizionit edhe për rastet kur kontratat përkatëse drejtpërsëdrejti i ka lidhur urdhërdhënësi, nëse ato janë lidhur me klientët të cilët i ka gjetur agjenti tregtar ose kur kontaktimi i palëve të treta është bërë me ndihmën e agjentit tregtar.

820.3. Më tej, paragrafi i tretë i këtij neni rregullon se, megjithatë, për rastet kur, sipas kontratës, agjenti dhe urdhërdhënësi janë marrë vesh që përfaqësimi në kuadër të një fushe të caktuar të punëve ose përfaqësimi i palëve të caktuara, të bëhet vetëm përmes agjentit tregtar përkatës, agjentit tregtar në këso situatash do t'i takonte e drejta e pagesës së shpërblimit edhe për rastet kur agjenti nuk ka ndërmjetësuar në arritjen e kontratave në një fushë të caktuar ose me persona të caktuar. Duket se paragrafi i tretë i këtij neni rregullon të ashtuquajturin “përfaqësim ekskluziv” për punët e caktuara ose për personat-klientelën e caktuar. Në kuptim të kësaj, nëse me marrëveshje të veçantë agjentit tregtar i është dhënë e drejta ekskluzive e përfaqësimit për fushën e caktuar ose klientelën e caktuar, nëse urdhërdhënësi lidh kontratë përkatëse nga kjo fushë ose me personat e klientelës përkatëse, atëherë, pa marrë parasysh ndërmjetësimin e agjentit, atij do t'i takojë e drejta e shpërblimit përkatës në bazë të këtij paragrafi.

820.4. Paragrafi i katërt i nenit në fjalë rregullon situatat kur agjentit tregtar i takon e drejta e provizionit për rastet kur kontrata e urdhërdhënësit me të tretët është lidhur pasi është përmbyllur – ka përfunduar marrëdhënia e agjentit me urdhërdhënësin dhe kjo për rastet kur një kontratë e tillë vjen si rezultat i përpjekjeve të agjentit tregtar. Në kuptim të kësaj, paragrafi në fjalë ia njeh agjentit tregtar të drejtën e provizionit edhe pas përmbylljes së marrëdhënies se agjentit me urdhërdhënësin, nëse lidhja e kontratës së urdhërdhënësit me të tretin ka qenë rezultat i përpjekjeve të agjentit tregtar. Që përfaqësuesi tregtar ta ketë të drejtën e provizionit sipas mbi këtë bazë, kërkohet që lidhja e kontratës me të tretin të ketë ndodhur brenda një kohe të arsyeshme, pas pushimit të marrëdhënies së përfaqësimit të agjentit me komitentin ose që oferta e personit të tretë për lidhjen e kontratës të ketë ardhur tek agjenti tregtar apo urdhërdhënësi para përfundimit të marrëdhënies së agjentit me urdhërdhënësin, gjithashtu që çështja e përfaqësimit t'i adresohet ndonjëherë prej situatave

667 Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 413. Sa për krahasim, në të drejtën krahasuese, Kodi i Detyrimeve i Zvicrës ka saktësuar detyrimin e urdhërdhënësit që përfaqësuesit tregtar t'i paguhet një tarifë që është e përbashkët për të gjitha punët (tërësinë e veprimeve) që agjenti tregtar i ka ndërmarrë në emrin dhe për llogarinë e komitentit; në lidhje me këtë shih: nenin 418.g. të Kodit të Detyrimeve të Zvicrës, (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 29.10.2013.

të përfaqësimit, të shtjelluar në paragrafin e parë ose të dytë të këtij neni, (përkatësisht që të drejtat e agentit tregtar, që burojnë sipas paragrafit të tretë të këtij neni, të jenë të përjashtuara në këtë rast), si dhe që lidhja e kontratës së urdhërdhënësit me të tretin të jetë rezultat i përpjekjeve të përfaqësuesit tregtar gjatë marrëdhënies me urdhërdhënësin.

820.5. Paragrafi i pestë i nenet në fjalë zgjidh konfliktin eventual që mund të paraqitet ndërmjet pretendimeve të më shumë agjentëve tregtarë sipas bazave të parashikuara në paragrafin e dytë dhe të tretë, në raport me paragrafin e katërt të këtij neni të LMD. Sipas kuptimit të këtij paragrafi, paragrafi i dytë dhe i tretë të sipërpërmendur nuk do të zbatohen, nëse në një rast të dhënë është shfrytëzuar e drejta e provizionit e agentit tregtar sipas paragrafi të katërt të këtij neni, (shih më lart komentimin e paragrafëve përkatëse). Përjashtimisht, gjykata mund të urdhërojë që shpërblimi ndërmjet disa agjentëve tregtarë (që buron nga baza të ndryshme nga paragrafët e përmendur më sipër) të mund të ndahet, nëse gjykata, në rastin e dhënë, konkludon se kjo do të ishte në pajtim me parimin e drejtshmërisë në marrëdhënien e dhënë, (sigurisht, pasi t'i ketë vlerësuar rrethanat e rastit të dhënë në raport me rregullat e parimit të drejtshmërisë).

Neni 821. Shuma e shpërblimit

- 1. Në qoftë se shuma e shpërblimit nuk është caktuar me kontratë, ose me tarifë, përfaqësuesi tregtar ka të drejtë në shpërblimin e zakonshëm në fushën në të cilën përfaqësuesi tregtar ka kryer aktivitetin për urdhërdhënësin, duke marrë parasysh natyrën e punëve të agjencisë. Përfaqësuesit tregtar i cili ka ofruar shërbime për urdhërdhënësin në disa fusha ka të drejtë në provizionin e zakonshëm për këtë fushë në vendin ku ndodhet zyra kryesore.**
- 2. Nëse nuk është e mundur të përcaktohet provizioni sipas nenet paraprak, përfaqësuesi tregtar ka të drejtë provizioni në një shumë që i merr parasysh të gjitha rrethanat e punës së kryer, veçanërisht numrin dhe vlerën e punëve juridike të kryera ndërmjet urdhërdhënësit dhe personit të tretë, si dhe natyrën dhe vështirësinë e përpjekjeve të përfaqësuesit tregtar.**
- 3. Në qoftë se në rastin konkret shpërblimi është përpjesëtimisht i madh në krahasim me shërbimin e bërë, gjykata mundet me kërkesën e urdhërdhënësit të zvogëlojë atë në një shumë të drejtë.**

821.1. Përgjithësisht, sasinë e shpërblimit palët e saktësojnë me kontratë për përfaqësimin tregtar ose sasia e shpërblimit saktësohet me tarifën e punës së agentit tregtar. Në mungesë të marrëveshjes për sasinë e shpërblimit ose në mungesë të aplikimit të tarifës përkatëse, do të duhej të merreshin në konsideratë doket tregtare të vendit përkatës. Kontraktimi i shpërblimit - provizionit për shërbimet e përfaqësuesit është rasti më i shpeshtë i saktësisht të sasisë së shpërblimit me marrëveshjen e palëve. Gjithashtu, duke marrë parasysh se

kontrata e përfaqësimit tregtar është kontratë afariste, tek e cila shpeshherë agjenti tregtar (si biznes ose profesionist), ofron shërbimet sipas tarifës përkatëse, për rastet e tilla, kur palët nuk kanë kontraktuar diçka të veçantë, zbatohen tarifatat e agjentit tregtar. Përndryshe, në mungesë të marrëveshjes për sasinë e shpërblimit ose në mungesë të aplikueshmërisë së tarifave përkatëse, sasia e shpërblimit caktohet në pajtim me doket tregtare të vendit përkatës, duke marrë parasysh natyrën e punëve të përfaqësimit. Në vazhdim të kuptimit të paragrafit të parë të të njëjtit nen, fjalia e dytë e tij saktëson se për rastet kur agjenti tregtar ofron shërbimet e përfaqësimit në disa zona (ose rajone të ndryshme), agjentit do t'i takojë shpërblimi përkatës në pajtim me zakonet tregtare të vendit ku ka selinë zyra e agjentit.⁶⁶⁸

821.2. Paragrafi i dytë i nenit 821 të LMD përcakton se, kur sasia e shpërblimit për agjentin tregtar në rastin e dhënë nuk mund të saktësohet sipas kuptimit të paragrafit të parë të të njëjtit nen, (d.m.th., nëse palët me marrëveshje nuk e kanë saktësuar sasinë e shpërblimit ose kur në rastin e dhënë nuk aplikohet një tarifë përkatëse dhe kur shpërblimi nuk mund të saktësohet as në kuptim të zakoneve afariste të vendit përkatës), atëherë sasia e shpërblimit për punën e agjentit duhet të saktësohet, duke i marrë në konsideratë rrethanat në të cilat puna ose përfaqësimi është kryer, veçanërisht duke shqyrtuar dhe vlerësuar numrin e punëve të kryera për urdhërdhënësin (p.sh., numrin e kontratave të lidhura) dhe vlerën e tyre, si dhe duke marrë për bazë edhe natyrën dhe vështirësitë me të cilat agjenti është ballafaquar gjatë përfaqësimit ose gjatë kryerjes së punëve për urdhërdhënësin. Sigurisht, të gjitha këto rrethana të rastit të dhënë duhet të çmohen individualisht nga gjykata në rast të mosmarrëveshjes së palëve në lidhje me sasinë e shpërblimit për agjentin.

821.3. Me qëllim të mbrojtjes së interesit të urdhërdhënësit, veçanërisht për situatat kur ai nuk ka qenë i kujdesshëm ose nuk ka pasur mjaft informata në vlerësimet rreth kontraktimit të shpërblimit për agjentin dhe, për pasojë, ka kontraktuar një shpërblim disproporcionalisht më të lartë, atëherë LMD, në paragrafin e tretë të nenit 821, ka përcaktuar mundësinë që urdhërdhënësi, përmes gjykatës, për rast të arsyeshme, të kërkojë zvogëlimin e shpërblimit, përkatësisht riekivalentimin e shpërblimit në raport me rrethin e punëve dhe shërbimeve të kryera nga agjenti.

668 Nëse lexohet me kujdes fjalia e dytë e paragrafit të parë të nenit 821 të LMD, duket se ajo ka një gabim përmbajtësor dhe nga leximi dhe kuptimi gramatikor, nuk rezulton një kuptim i plotë. Është me rëndësi të konstatohet se gabimi ka mundur të rrjedhë gjatë përkthimit të tekstit ligjor nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, pasi që në disa raste si burim informacioni për hulumtimet e zgjidhjeve ligjore, që ishin bërë nga grupi punues gjatë hartimit të projektit të LMD, ndër të tjera, është shfrytëzuar edhe një version në gjuhën angleze i Kodit sllloven të Detyrimeve, i cili kishte prejardhje dhe zgjidhje shumë të ngjashme ligjore me ato të aplikuar në Kosovë deri te adaptimi i LMD. Kështu, nëse e lexojmë tekstin ligjor të Kodit sllloven për Detyrimet - versioni në gjuhën angleze, fjalia e dytë e paragrafit të parë të nenit 824 të tij parashikon si në vijim: “ *An agent that performed activities for the mandator in several areas shall be entitled to the commission customary in the area where the agent’s head office is located.*”. Nga kjo nënkuptohet se teksti në gjuhën angleze nuk përputhet me përmbajtjen që ka teksti në gjuhën shqipe, kështu që, në rast të spastrimit të të metave teknike të LMD, do të duhej të merrej në konsiderim edhe kjo rrethanë. Për më shumë, shih Kodin Sllloven të Detyrimeve, versioni në gjuhën angleze, i qasshëm në: <uil-sipo.si/fileadmin/upload_folder/zakonodaja/povezano/Obligations-Code_Slovenia_2001.pdf>, dt. 29.10.2013.

Neni 822. Fitimi i të drejtës së pagesës

- 1. Përfaqësuesi tregtar fiton të drejtën në provizion nëse, dhe deri atëherë kur, urdhërdhënësi përmbushë apo do duhej të kishte përmbushur kontratën me personin e tretë ose nëse personi i tillë përmbushë pjesën e detyrimit të tij që rrjedh nga kontrata me urdhërdhënësin.**
- 2. Përfaqësuesi tregtar nuk ka të drejtë në provizion në rastet kur është e qartë që kontrata nuk do të përmbushet dhe se arsyeja për mos përmbushjen e saj nuk është në anën e urdhërdhënësit. Nëse në rastin e tillë provizioni është paguar, atëherë përfaqësuesit tregtar duhet ta kthej atë.**
- 3. Përfaqësuesi tregtar e fiton të drejtën në provizion më së voni në momentin kur personi i tretë përmbushë apo do duhej të kishte përmbushur detyrimet sipas kontratës, nëse urdhërdhënësi ka përmbushur pjesën e urdhërdhënësit.**
- 4. Nëse kontrata ndërmjet urdhërdhënësit dhe personit të tretë është duke u ekzekutuar për një kohë të gjatë, atëherë përfaqësuesi tregtar ka të drejtë në një pjesë pagese paraprake të provizionit.**
- 5. Nuk është e mundur që me anë të kontratës të drejtat e përcaktuara në këtë nen të ndryshohen në dëm të përfaqësuesit tregtar.**

822.1. Neni 822 i LMD, si duket, ka për qëllim të rregullojë dhe të saktësojë momentin se kur agentit tregtar i takon e drejta e shpërblimit përkatës për shërbimin e ofruar. Rëndom, mendohet se agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit në momentin kur puna (shërbimi) është ekzekutuar dhe janë realizuar rezultatet e përfaqësimit. Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni konsiderohet se agjenti tregtar do t'i takojë e drejta e shpërblimit, në qoftë se urdhërdhënësi ka përmbushur ose ka realizuar interesat e tij nga kontrata me personin e tretë; përmbushja e detyrimeve të palëve nga kontratat e lidhura me përfaqësim (p.sh., dorëzimi i sendit të blerë për urdhërdhënësin) dhe kalimi i rezultateve të përfaqësimit tek urdhërdhënësi e rumbullakosin qëllimin e shërbimit dhe detyrimin e përfaqësuesit, kështu që momenti më i thjeshtë kur agjenti ka të drejtën e shpërblimit është momenti kur tashmë janë përmbushur detyrimet përkatëse nga kontratat të cilat janë lidhur në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, ose e drejta e shpërblimit duhet t'i takojë agjentit të paktën në momentin kur pala e tretë tashmë ka përmbushur detyrimet e veta ndaj urdhërdhënësit, (ky mund të jetë një moment më i hershëm sesa momenti i përmbushjes në tërësi të detyrimeve të ndërsjella).

822.2. LMD qartëson se agjentit tregtar nuk i takon e drejta e shpërblimit për rastet kur palët e kanë të qartë se detyrimet nga kontrata nuk do të përmbushen, me kushtin që arsyeja e mos-përmbushjes së detyrimeve të qëndrojë jashtë veprimeve dhe mundësive të kontrollit të urdhërdhënësit. Me fjalë të tjera, që urdhërdhënësi të lirohet nga detyrimi i pagesës së shpërblimit, duhet të provohet se mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në kontratë nuk është pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të urdhërdhënësit, përndryshe veprimet ose mosveprimet eventualisht do të mund ta mbanin urdhërdhënësin përgjegjës për dështimin e ekzekutimit të këtyre detyrimeve (ose dështimin në ekzekutimin e kontratës në tërësi).

Nëse në një rast të tillë (të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në kontratë pa fajin e urdhërdhënësit), nëse urdhërdhënësi tashmë ka paguar shpërblimin ose një pjesë të shpërblimit për agjentin tregtar, urdhërdhënësi ka të drejtë të kërkojë kthimin mbrapa të asaj që ka paguar mbi këtë bazë.

822.3. Në kuptim të asaj çka u tha edhe në komentimin e paragrafit të parë të këtij neni, paragrafi i tretë i tij më tej sqaron se agjentit tregtar i takon e drejta e shpërblimit më së largu në momentin kur personi i tretë ka përmbushur detyrimin e tij ndaj urdhërdhënësit ose në momentin kur personi i tretë do të kishte përmbushur detyrimin e tij, sikur urdhërdhënësi ta kishte përmbushur pjesën e tij të detyrimeve të përcaktuara në kontratë. Pra, ky paragraf sqaron dy momente: momentin e parë, kur personi i tretë i ka përmbushur detyrimet ndaj urdhërdhënësit dhe momentin e dytë, kur urdhërdhënësi i ka përmbushur detyrimet e tij kontraktuese ndaj personit të tretë, nga të cilat kushtëzohet përmbushja e kontratës nga personi i tretë. Nëse përgjigja do të ishte pozitive lidhur me momentet e diskutuara më sipër, agjentit tregtar do t'i takonte e drejta e shpërblimit nga momenti përkatës.

822.4. Në praktikë mund të ekzistojnë situata kur marrëdhënia e përfaqësimit zgjat për një interval kohe më të gjatë, domethënë situata kur derisa kryhen shërbimet e përfaqësimit dhe lidhet-ekzekutohet kontrata me palët e treta, kalon një interval i gjatë kohor. Për rastet e tilla është e arsyeshme që agjenti tregtar të kërkojë një pjesë të shpërblimit që më parë dhe atë para se puna e përfaqësimit të tij të jetë përmbushur (në kuptim të saktësimeve të paragrafët e mësipërm të këtij neni). Këtë mundësi e lejon edhe paragrafi i katërt i nenit 822 të LMD, i cili ka për qëllim ta mbrojë interesin e agjentit në rastet kur detyra e përfaqësimit zgjat për një interval më të gjatë kohor.

822.5. Paragrafi i fundit i këtij neni tregon kuptimin imperativ të dispozitave të paragrafëve të mësipërm të këtij neni në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të agjentit tregtar, duke sanksionuar që me anë të kontratës së përfaqësimit të drejtat e përcaktuara në këtë nen me kontratë nuk mund të ndryshohen në dëm të përfaqësuesit tregtar. Kuptimi i këtij paragrafi lë të kuptohet se palët në kontratën e përfaqësimit tregtar mund të merren vesh edhe ndryshe për atë që është në interesin më të mirë të agjentit tregtar, por jo duke vendosur barrë më të rëndë në dëm të agjentit, në kuptim të detyrimeve të vendosura nga paragrafët e mësipërm të këtij neni.

Neni 823. Pagimi i provizionit

- 1. Urdhërdhënësi çdo tre muaj duhet të përgatis një faturë të provizionit që i takon përfaqësuesit tregtar për secilin muaj ndaras, dhe ta dërgojë. Fatura duhet të përmbajë të gjitha pjesët përbërëse në bazë të të cilave është përgatitur.**
- 2. Urdhërdhënësi është i detyruar të paguaj provizionin për të gjithë periudhën në fund të muajit pas muajit të fundit të periudhës së faturuar. Me anë të kontratës mund të përcaktohet periudha e faturimit më e shkurtër se tre muaj.**

- 3. Me kërkesën e përfaqësuesit tregtar, urdhërdhënësi detyrohet që nga librat e llogarisë ti dorëzojë agentit ekstraktet mbi të gjitha punët për të cilat përfaqësuesit tregtar ka të drejtë provizioni si dhe të njoftojë përfaqësuesit tregtar në lidhje me të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në provizion.**
- 4. Nëse urdhërdhënësi refuzon kërkesën e përfaqësuesit tregtar ose nëse përfaqësuesi tregtar ka dyshime mbi saktësinë e ekstrakteve, atëherë përfaqësuesit tregtar mund të kërkojë që një auditor i certifikuar të inspektojë librat e llogarive dhe dokumentet në lidhje me shifrat e rëndësishme për provizion dhe të raportojë mbi to.**
- 5. Të drejtat e përfaqësuesit tregtar të përcaktuara me këtë nen nuk mund të kufizohen apo hiqen me kontratë.**

823.1. Paragrafi i parë i nenit 823 vendos detyrimin e urdhërdhënësit që, në periudha tremujore, t'i dërgoj agentit një faturë në lidhje me shpërblimin e arritur për shërbimet, ashtu që përshkrimi i faturës të bëhet ndaras për secilin muaj në përputhje me shërbimet përkatëse të ofruara për secilin muaj. Fatura, pasi të përgatitet sipas përshkrimit në fjalë, duke i përfshirë shërbimet e pranuar dhe shumat përkatëse të shpërblimit të arritur për pagesë, duhet t'i dërgohet agentit në fund të periudhave tremujore, (përveç nëse marrëdhënia e përfaqësimit zgjat një kohë më të shkurtër).

823.2. Sipas kuptimit të paragrafit të dytë të këtij neni, urdhërdhënësi ka për obligim t'ia paguajë agentit shumat e faturuara në emër të shpërblimit në fund të muajit vijues, pas përfundimit të muajit të fundit të periudhës së faturimit, kështu që, në vështrim të komentimit të mësipërm të paragrafit pararendës, kur periudha e faturimit bëhet në çdo tremujor, fatura përkatëse duhet të paguhet deri në fund të muajit vijues, që rrjedh menjëherë pas përfundimit të periudhës së faturimit. Në kuptim të këtij paragrafi dhe paragrafit pararendës të këtij neni, kërkesa që periudha e faturimit të zgjasë tre muaj, në realitet, është një kërkesë e karakterit dispozitiv, ashtu që palët mund ta saktësojnë me marrëveshje një periudhë më të shkurtër se tre muaj të faturimit.

823.3. Nëse agjenti tregtar kërkon ashtu, atëherë është detyrim i urdhërdhënësit që agjentin tregtar ta pajisë me ekstraktet e nxjerra nga librat e llogarisë së urdhërdhënësit, duke ia parashtruar të gjitha të dhënat e kërkuara, nga edhe shihen të gjitha punët e realizuara (përkatësisht, shërbimet e ofruara) nga agjenti, të cilit i takon për këto e drejta e shpërblimit përkatëse, ndërkaq urdhërdhënësi, krahas kësaj, duhet t'ia sigurojë agjentin edhe të gjitha informatat tjera relevante që kanë ndikuar në përlllogaritjen e shpërblimit përkatës për agjentin tregtar.

823.4. Në vijim të të drejtave të agjentin tregtar të sanksionuara në paragrafin paraprak, për rastet kur urdhërdhënësi nuk e pajis agjentin tregtar me të dhënat - ekstraktet e kërkuara nga librat-llogaritë e urdhërdhënësit ose për rastet kur agjenti tregtar dyshon në saktësinë e tyre, paragrafi i katërt i këtij neni themelon të drejtën e agjentin tregtar për të kërkuar në raste të tilla që këto libra të llogarive të urdhërdhënësit t'i nënshtrohen inspektimit të një

auditori të certifikuar. Sigurisht, për rastet e tilla, subjekt të auditimit janë llogaritë-librat e urdhërdhënësit, të cilat përmbajnë informata të rëndësishme në lidhje me përlllogaritjen e provizionit të agjentit, i cili ka të drejtë të pranojë raportimin e gjetjeve përkatëse të auditorit që mund të jenë relevante për shpërblimin e tij.

823.5. Paragrafi i fundit i këtij neni flet për karakterin imperativ të dispozitave të paragrafëve të mësipërme të këtij neni në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të agjentit tretar, duke sanksionuar që me anë të kontratës së përfaqësimit të drejtat e përcaktuara në këtë nen, me kontratë nuk mund të ndryshohen në dëm të përfaqësuesit tregtar, (përveç mundësisë së kontraktimit të një afati më të shkurtër të raportimit të faturave nga urdhërdhënësi - shih komentimin e paragrafit 1 dhe 2 më lart). Kuptimi i këtij paragrafi lë të kuptohet se palët në kontratën e përfaqësimit tregtar mund të merren vesh edhe ndryshe për aq sa kjo është në interesin më të mirë të agjentit tregtar, por jo duke vendosur barrë më të rëndë në dëm të agjentit, në kuptim të detyrimeve të vendosura nga paragrafët e mësipërm të këtij neni.

Neni 824. Shpërblim i veçantë

Përfaqësuesit tregtar i cili me autorizimin e urdhërdhënësit ka bërë arkëtimin e ndonjë kërkesë të tij, ka të drejtë në provizion të veçantë nga shuma e arkëtuar.

Shpërblimi i veçantë (ose tarifa për arkëtim) është një formë shtesë e provizionit e cila do t'i takojë agjentit tregtar si pjesë e rritur e shpërblimit bazë për rastet kur ai inkason ndonjë kërkesë të urdhërdhënësit. Sigurisht, agjentit do t'i takojë një e drejtë e tillë e shpërblimit të veçantë, nëse arkëtimi i kërkesës së urdhërdhënësit është përtej asaj që ka qenë objekt i marrëveshjes fillestare të përfaqësimit (kjo si kundërvlerë për një shërbim shtesë). Disa autorë mendojnë se rast tipik kur agjenti ka të drejtën e shpërblimit shtesë është ai kur agjenti ka shërbyer vetëm si ndërmjetësues ndërmjet urdhërdhënësit me të tretin, (pa pasur të drejtë të lidhë kontratë në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit), ashtu që nëse agjenti, me një autorizim të posaçëm, fiton lejen të arkëtojë diçka për llogarinë e urdhërdhënësit, atëherë atij do t'i takojë provizion shtesë, (në emër të shërbimit shtesë). Tutje, mendohet se, kur agjenti që në fillim ka qenë i autorizuar të ndërmarrë të gjitha veprimet e përfaqësimit, (duke përfshirë edhe lidhjen e kontratave me të tretët), në raste të tilla konsiderohet se agjenti nuk do të kishte të drejtën e provizionit shtesë, pasi që konsiderohet se arkëtimi në emër dhe për llogarinë e urdhërdhënësit hyn në kuptimin e rregullt të marrëdhënies së përfaqësimit të themeluar me marrëveshjen bazë.⁶⁶⁹

Nëse palët nuk arrijnë ndonjë marrëveshje se sa do të jetë shpërblimi i veçantë që do t'i takonte agjentit tregtar mbi këtë bazë, ajo do të mund të përcaktohej duke pasur për bazë sistemin e tarifave të aplikueshme nga agjenti për punë të ngjashme ose, në mungesë të

669 Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1757;

tyre, sasia e shpërblimit të veçantë mund të caktohet si një përqindje e drejtë nga tërësia e shumës së shpërblimit ose kur edhe kjo nuk është e aplikueshme, atëherë mund të merren në konsideratë edhe zakonet tregtare.

Neni 825. Shpenzimet

1. Përfaqësuesi tregtar nuk ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve që rezultojnë nga ushtrimi i zakonshëm i punëve të ndërmjetësisimit, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.
2. Mirëpo, ky ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të veçanta që ka bërë në dobi të urdhërdhënësit, ose me urdhër të tij.

825.1. LMD, paragrafi i parë i nenit 825 niset nga supozimi se “**shpenzimet e zakonshme**” që i shkaktohen agjentit tregtar në lidhje me ofrimin e shërbimeve të rregullta të tij në fushën e përfaqësimit tregtar janë të mbuluara me shumën e shpërblimit që rëndom i takon agjentit tregtar, prandaj, në kuptim të këtij supozimi, paragrafi në fjalë nuk i njeh të drejtën e heqjes së shpenzimeve të zakonshme agjentit tregtar. Sigurisht, kjo rregull ka karakter dispozitiv dhe palët në kontratë mund të merren vesh edhe ndryshe. Një rregullim shumë i ngjashëm me këtë paragraf të LMD në të drejtë krahasuese duket se përfaqësohet edhe nga Kodi i Detyrimeve i Zvicrës.⁶⁷⁰ Ligji më tej nuk përcakton ose nuk jep kuptimin e të ashtuquajturave “shpenzime të zakonshme” dhe kjo mbetet barrë e praktikës gjyqësore, përkatësisht dokeve tregtare, në mënyrë që, në kuptim të rrethanave të rastit, të jepet shpjegimi përkatës për këto shpenzime. Në këtë drejtim, p.sh., do të mund të konsideroheshin shpenzime të zakonshme to që ndërlidhen me organizimin e zyrës dhe ofrimin e përditshëm të shërbimeve profesionale, shpenzimet postare, të telekomunikacionit (telefonatat e rregullta), telegramet, shpenzimet për përdorimin e internetit dhe shpenzime të tilla të ngjashme, të cilat hyjnë në kuptimin e rregullt të ushtrimit të profesionit ose organizimit të zyrës së përfaqësuesit.

825.2. Megjithatë, gjatë kryerjes së urdhrave të urdhërdhënësit, agjenti ndonjëherë mund të veprojë edhe përtej përshkrimit dhe kërkesave të urdhrit të urdhërdhënësit ose mund t’i ekspozohet shkaktimit të “shpenzimeve të jashtëzakonshme”. Rasti i parë është, p.sh., kur agjenti tregtar vepron si “punëdrejtues pa porosi” për urdhërdhënësin, ashtu që kryen veprime të caktuara në dobinë ose të mirën e urdhërdhënësit. Sigurisht, në raste të tilla kur dobitë pranohen nga urdhërdhënësi, ai ka për obligim mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara agjentit, (në lidhje me këtë mundësi, shih posaçërisht komentimin e nenit 206 të LMD). Po ashtu, në raste të tjera agjenti gjatë kryerjes së urdhrave mund të ballafaqohet me shpenzime të paparashikuara në lidhje me ngarkesat doganore, sigurimin e licencave të ndryshme për kryerjen e urdhrave (si p.sh., licenca të importit ose eksportit etj.), e

⁶⁷⁰ Shih në lidhje me këtë nenin 418 n. të Kodit Zviceran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 18.10.2013

shpenzime të ngjashme, të cilat do të mund të kualifikoheshin si shpenzime “jo të rregullta”, ashtu që, në kuptim të paragrafit të dytë të të njëjtit nen të LMD, agjentit do t’i takonte e drejta e heqjes së këtyre shpenzimeve.

KREU 4 E DREJTA E PENGUT

Neni 826. E drejta e pengut e përfaqësuesit tregtar

Për sigurimin e arkëtimit të kërkesave të veta të rrjedha për pagesë të krijuara lidhur me kontratën, përfaqësuesi tregtar ka të drejtë pengu në shumat që ka arkëtuar për urdhërdhënësin, sipas autorizimit të tij, si dhe në të gjitha sendet e urdhërdhënësit të cilat lidhur me kontratën i ka marrë nga urdhërdhënësi ose nga ndonjë tjetër, gjersa këto ndodhen tek ai, ose tek ndonjë tjetër që i mban për të, apo gjersa ka në dorë dokumentin me anë të të cilit mund t’i disponojë ato.

826. Me qëllim të sigurimit të kërkesave të veta, të cilat kanë arritur për pagesë ndaj urdhërdhënësit, agjenti tregtar gëzon të drejtën e pengut mbi shumat (mjetet financiare) që agjenti i ka arkëtuar nga personat e tretë, (në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit), sipas autorizimit përkatës, përkatësisht ai gëzon të drejtën e pengut mbi sendet ose mallrat e urdhërdhënësit, të cilat i ka marrë nga urdhërdhënësi ose i ka marrë nga personi i tretë për urdhërdhënësin, kurse e drejta e tij e pengut zgjat për aq kohë sa ato ndodhen në posedimin e agjentit tregtar ose gjersa ndodhen te një person i tretë, i cili i mban (i ruan) për agjentin, përkatësisht gjersa agjenti tregtar ka në posedim dokumentacionin e sendeve-mallrave me anë të të cilit mund t’i disponojë sendet-mallrat në fjalë. Ndryshe kjo formë e pengut ligjor, që krijohet sipas urdhrës të Ligjit, njihet si i ashtuquajtur i peng posedimor, ashtu që agjenti e gëzon të drejtën e përparësisë së arkëtimit të kërkesave të tija të arritura para cilitdo kreditor të urdhërdhënësit. Përveç dispozitave të parashikuara në këtë nen, për realizimin e të drejtës së pengut të agjentit tregtar të themeluar nga kjo bazë zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës së pengut.⁶⁷¹

671 Një përcaktim të ngjashëm të sigurimit të kërkesave të maturuara të agjentit tregtar ndaj urdhërdhënësit në të drejtën krahasuese e rregullon edhe Neni 418.o. i Kodit Zvicëran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 04.11.2013.

KREU 5 SHUARJA E KONTRATËS

Neni 827. Zgjidhja e kontratës së lidhur për një kohë të pacaktuar

1. Kontrata konsiderohet se është lidhur për një periudhë të pacaktuar, përveç nëse palët merren vesh ndryshe.
2. Nëse kontrata është lidhur për një periudhë të pacaktuar, atëherë secila palë mund ta shkëpus kontratën duke dhënë njoftim për shkëputje në përputhje me këtë nen.
3. Koha e dhënies së njoftimit për shkëputje varet nga kohëzgjatja e kontratës dhe duhet të llogaritet nga një muaj për secilin fillim viti gjatë kontratës. Nëse kontrata zgjatë më shumë se pesë (5) vite, koha e dhënies së njoftimit për shkëputje është gjashtë (6) muaj.
4. Palët nuk mund të përcaktojnë me kontratë kohë njoftimi më të shkurtra.
5. Nëse palët pajtohen për kohë lajmërimi më të gjata, koha e tillë duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë si për urdhërdhënësin edhe për përfaqësuesit tregtar.
6. Përveç kur përcaktohet ndryshe me kontratë, koha e lajmërimit fillon ditën e parë të muajit pasues kalendarik dhe mbaron ditën e fundit të muajit të tillë.

827.1. Kontrata për përfaqësimin tregtar mund të lidhet për kohë të caktuar ose për kohë të pacaktuar. Në mungesë të dispozitës në kontratë në lidhje me kohëzgjatjen e saj për përfaqësim tregtar, LMD, në paragrafin e parë të nenit 827, saktëson dhe konsideron se kontrata në fjalë është lidhur për kohë të pacaktuar.

827.2. Tutje, paragrafi i dytë i këtij neni rregullon se, për rastet kur kontrata për përfaqësimin tregtar është lidhur për kohë të pacaktuar, atëherë secila palë mund ta deklarojë shkëputjen e njëanshme të kontratës, me kushtin e njoftimit të palës tjetër kontraktuese për shkëputjen e saj sipas afateve të vendosura më tej në këtë nen.

827.3. Paragrafi i tretë i të njëjtit nen saktëson afatin e njoftimit për shkëputjen e njëanshme të kontratës. Kontrata për përfaqësimin tregtar konsiderohet e zgjidhur vetëm pasi të kalojë afati i njoftimit për shkëputjen e kontratës. Në kuptim të këtij paragrafi, kohëzgjatja e afatit të njoftimit për shkëputjen e njëanshme të kontratës varet nga kohëzgjatja e kontratës për përfaqësimin tregtar. Kështu, për secilin fillimvit, për aq vite sa zgjatë kontrata për përfaqësimin tregtar, afati i njoftimit për shkëputjen e kontratës zgjatet për nga një muaj, me përjashtimin se, nëse kontrata për përfaqësimin tregtar zgjat më tepër se pesë vjet, afati për njoftimin e shkëputjes së kontratës është 6 muaj. Rrjedhimisht, kontrata quhet e shkëputur pasi të ketë kaluar me sukses afati i njoftimit të shkëputjes së kontratës.

827.4. Rregullat për saktësimin e afateve për njoftimin e shkëputjes së kontratës për përfaqësimin tregtar janë rregulla të karakterit imperativ, ashtu që palët nuk mund të saktësojnë me marrëveshje afate më të shkurtra të njoftimit për shkëputjen e kontratës nga ato që janë saktësuar nga paragrafi i tretë i nenit në fjalë.

827.5. Paragrafi i katërt i të njëjtit nen të LMD nuk shprehet në lidhje me atë nëse palët me marrëveshje mund të saktësojnë afate më të gjata për njoftimin e shkëputjes së kontratës për përfaqësimin tregtar; ndërsa paragrafi i pestë i këtij neni duket se lejon mundësinë që palët megjithatë të kontraktjnë një afat më të gjatë të njoftimit të shkëputjes së kontratës, ashtu që në një rast të tillë, kur palët kontraktjnë një afat më të gjatë të njoftimit për shkëputjen e kontratës (nga ato që ka përcaktuar paragrafi i tretë më lart), atëherë një afat i tillë duhet të jetë i barabartë për secilën palë në kontratë, si për urdhërdhënësin, ashtu edhe për agjentin tregtar. Më tej, paragrafi i fundit i LMD saktëson se përveç kur përcaktohet ndryshe me kontratë, koha e njoftimit për shkëputjen e njëanshme të kontratës fillon ditën e parë të muajit pasues kalendarik, ndërsa mbaron ditën e fundit të atij muaji.

Neni 828. Zgjidhja e kontratës së lidhur për një kohë të caktuar

- 1. Kur kontrata mbi agjencinë tregtare është lidhur për një kohë të caktuar, ajo pushon me skadimin e kohës së caktuar.**
- 2. Në qoftë se të dyja palët vazhdojnë të përmbushin kontratën sipas paragrafit të parë, edhe pas kohës për të cilën është lidhur, atëherë konsiderohet si kontratë e lidhur për një kohë të pacaktuar. Në përcaktimin e kohës për njoftim, merret parasysh koha e kaluar që nga momenti i lidhjes së kontratës, ashtu siç zbatohet tek shkëputja e kontratës e lidhur për kohë të pacaktuar.**

828.1. Nëse kontrata për përfaqësimin tregtar lidhet për kohë të caktuar, kontrata shuhet me skadimin e asaj kohe; kështu e rregullon atë paragrafi i parë i nenit 828 i LMD. Pasi që palët kontraktuese e kanë lidhur fatin e kontratës për kohë të caktuar, shuarja e saj vjen natyrshëm me skadimin e asaj kohe, përkatësisht për shuarjen e kontratës në fjalë nuk është e nevojshme të bëhet asnjë njoftim paraprak nga cilado palë kontraktuese në lidhje me shuarjen e saj.⁶⁷²

828.2. Përrjashtimisht nga paragrafi i parë i nenit në fjalë, edhe kur kontrata për përfaqësimin tregtar lidhet për një kohë të caktuar, ajo mund të zgjatet me nënkuptim, nëse që të dyja palët vazhdojnë t'i përmbushin detyrimet e njëjta kontraktuese edhe pas skadimit të kohës-afatit të kontratës. Ky është rasti kur, edhe pas përfundimit të afatit të kontratës, agjenti vazhdon me ekzekutimin e veprimeve të përfaqësimit, ndërsa urdhërdhënësi vazhdon t'i pranojë rezultatet e punës dhe, si kundërvlerë, vazhdon të paguajë shpërblimin përkatës. Një mundësi e tillë është siguruar nga paragrafi i dytë i nenit 828 të LMD. Në një rast të tillë, ky paragrafi siguron

672 Një rregullim shumë të ngjashëm me dispozitën në fjalë të LMD e bën edhe neni 418.p - paragrafi 1 i Kodit Zviceran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 07.11.2013.

kuptimin se në realitet palët kanë ekzekutuar kontratën për përfaqësimin tregtar për kohë të caktuar, ashtu që të ato “heshtazi” kanë lënë të nënkuptohet se kanë lidhur një kontratë të re për përfaqësimin tregtar për kohë të pacaktuar. Moment i lidhjes së kontratës së re konsiderohet momenti kur ka skaduar kontrata e parë e lidhur për kohë të caktuar. Më tej, paragrafi në fjalë përcakton se në lidhje me zgjidhjen e kontratës në fjalë, e cila vazhdohet për një periudhë të pacaktuar, zbatohen rregullat që vlejnë për zgjidhjen dhe njoftimin e zgjidhjes së kontratës për një kohë të pacaktuar, siç u vu në dukje në komentimin e nenit 827 të LMD (më lart). Megjithatë, sipas kuptimit të paragrafit në fjalë, si moment për përlllogaritjen e kohës së njoftimit për shkëputjen e njëanshme të kontratës duhet të merret momenti i lidhjes së kontratës së parë (kontratës së lidhur për kohë të caktuar).⁶⁷³

Neni 829. Zgjidhja e kontratës pa afat denoncimi

- 1. Për shkaqet serioze secila palë mundet duke treguar këto shkaqe të zgjidhë kontratën pa afat denoncimi.**
- 2. Në qoftë se deklarata mbi denoncimin është bërë pa shkaqe serioze do të konsiderohet si denoncim me afat të rregullt denoncimi.**
- 3. Përfaqësuesit tregtar i cili për shkak të denoncimit të pabazuar e ka ndërprerë veprimtarinë e vet ka të drejtë në shpërblimin e dëmit për shkak të provizionit të humbur, e në qoftë se ai e ka denoncuar kontratën në mënyrë të pabazuar e drejta e shpërblimit të dëmit i takon urdhërdhënësit.**
- 4. Denoncimi i pabazuar i jep të drejta palës tjetër të zgjidhë kontratën pa afat denoncimi.**

829.1. Si përjashtim nga nenet 827 dhe 828 të LMD të komentuar më lart, nenin 829 prag. 1 i LMD, ka rregulluar se për shkaqe serioze (të cenimit të detyrimeve kontraktuese nga pala tjetër kontraktuese), secila palë në kontratë, duke iu referuar shkaqeve serioze në fjalë, mund ta deklarojë zgjidhjen e kontratës për përfaqësim tregtar edhe pa afat denoncimi. Paragrafi në fjalë nuk jep më shumë shpjegime se cilat kishin me qenë “shkaqe serioze” të shkeljes së detyrimeve kontraktuese, të cilat do t’i mundësonin palës tjetër deklarimin e zgjidhjes së kontratës; por zhvillimin e tyre LMD ia ka lënë praktikës gjyqësore, e cila vlerëson rrethanat e rastit të dhënë në raport me detyrimet dhe përgjegjësitë kontraktuese të secilës palë, duke i pasur në konsideratë edhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktuese. P.sh., një rast i shkeljes serioze të detyrimeve kontraktuese do të ishte ai kur njëra palë lë pa përmbushur detyrimet e saj kontraktuese brenda afatit të dhënë ose në mënyrën e duhur (mënyrën e kënaqshme), rrethana të cilat (në kuptim të paragrafit në fjalë) do t’i mundësonin palës tjetër deklarimin e zgjidhjes së kontratës edhe pa afat denoncimi.

⁶⁷³ Si duket, për dallim nga paragrafi i parë i të njëjtit nen, Kodi Zviceran i Detyrimeve, për rastin kur palët vazhdojnë të përmbushin kontratën për përfaqësim tregtar edhe përtej afatit të kontraktuar parashikon një rregull tjetër, duke supozuar se në realitet palët kanë lidhur një kontratë të re, por me afat të njëjtë kontraktues si në kontratën e parë, me mundësi të zgjatjes në maksimum edhe për një vit; në lidhje me këtë, shih: neni 418.p - paragrafi 2 i Kodit Zviceran të Detyrimeve (i qasshëm në: <admin.ch/ch/e/rs/2/220.en.pdf>, datë 07.11.2013.

829.2. Në kuptim të paragrafit pararendës, paragrafi i dytë i të njëjtit nen rregullon se, në qoftë se deklarata për zgjidhjen e kontratës është dhënë pa shkaqe të arsyeshme, atëherë deklarata për zgjidhjen e kontratës konsiderohet si njoftim për shkëputjen e njëanshme të kontratës për përfaqësimin tregtar, ashtu që kontrata konsiderohet e zgjidhur nga momenti kur kalon afati i njoftimit (përkatësisht afati i denoncimit).

829.3. Paragrafi i tretë i këtij neni rregullon situatat e pagesës së shpërblimit të dëmit, nëse denoncimi i kontratës është bërë nga cilado palë për shkaqe të pabazuara ose joserioze, sa për të shkaktuar shkëputjen e njëanshme të kontratës pa afat denoncimit. Kështu, nëse për shkak të deklarimit të shkëputjes së kontratës (për shkaqe të pabazuara) nga urdhërdhënësi, agjentit tregtar i është pamundësuar ushtrimi i shërbimeve të kontraktuara, në raste të tilla agjentit tregtar do t'i takojë e drejta që të kërkojë shpërblimin e dëmit që është shkaktuar si rezultat i “humbjes-mospagesës” së provizionit. Ose anasjelltas, për rastet kur shkëputjen e njëanshme të kontratës e ka deklaruar agjenti tregtar (për shkaqe të pabazuara), urdhërdhënësi ka të drejtën e shpërblimit të dëmit i cili eventualisht i është shkaktuar nga mosushtrimi i veprimeve të përfaqësimit nga agjenti tregtar.

829.4. Në kuptim të paragrafëve të mësipërm të komentuar në këtë nen, në rastet kur njëra palë deklaron shkëputjen e njëanshme të kontratës për shkaqe jo të bazuara (në kuptimin e paragrafit të parë të këtij neni), veprimi i tillë i jep të drejtë palës tjetër ta deklarojë shkëputjen e njëanshme të kontratës pa asnjë afat denoncimi.⁶⁷⁴

Neni 830. Shuma e pjesëtuar

- 1. Pas denoncimit të kontratës, përfaqësuesit tregtar ka të drejtë në ndarjen e një shume të përshtatshme parash nëse dhe për aq sa përfaqësuesit tregtar ka siguruar klientë të rinj për urdhërdhënësin ose në mënyrë të dukshme ka rritur numrin e punëve me klientët e mëparshëm dhe pasi kontrata të jetë denoncuar urdhërdhënësi gëzon përfitime të dukshme me klientët e tillë, ose nëse pjesëtimi i shumës dhe pagesa e sajë kërkohet prej rrethanave të veçanta, sidomos nga humbja e provizionit nga punët juridike me klientët e tillë.**
- 2. Në përcaktimin e shumës së pjesëtuar, është e nevojshme që të merret parasysh provizioni i fituar nga përfaqësuesit tregtar për kontratat pas shkëputjes së marrëdhënies me urdhërdhënësin, si dhe çdo pengesë e aktiviteteve konkurruese pas shkëputjes së marrëdhënies me urdhërdhënësin.**
- 3. Shuma e pjesëtuar, sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, nuk mund të tejkalojë mesataren e shumës së provizionit vjetorë gjatë pesë (5) viteve të fundit apo të periudhës më të shkurtër kohore relevante pas lidhjes së kontratës.**

674 Neni në fjalë që shtjellon çështjen e shuarjes së kontratës për përfaqësimin tregtar pa afat denoncimi është një risi (një zgjidhje e re juridike) në krahasim me LMD-ën e vjetër, ashtu që si zgjidhje juridike bashkëkohore është përvetësuar ajo nga modeli sloven i Kodit të Detyrimeve, shih në lidhje më këtë nenin 832 të Kodit Sloven të Detyrimeve, versioni në gjuhën angleze, i qasshëm në: <uil-sipo.si/fileadmin/upload_folder/zakonodaja/povezano/Obligations-Code_Slovenia_2001.pdf>, dt. 07.11.2013.

4. Kur kontrata e lidhur për një kohë të caktuar, shkëputet para përfundimit të kësaj kohe ose kur kontrata e lidhur për një kohë të pacaktuar përfundon para kalimit të pesë (5) viteve nga momenti i lidhjes së kontratës, përfaqësuesit tregtar ka të drejtë në ndarjen e një shumë të përshtatshme parash, shumën e diferencës ndërmjet shpenzimeve që përfaqësuesit tregtar ka pasur në lidhje me prezantimin e produktit në treg dhe të gjitha shpenzimeve tjera në lidhje me përmbushjen e kontratës, dhe diferencës së të ardhurave të përfaqësuesit tregtar të marra nga përmbushja e kontratës si dhe të ardhurave që përfaqësuesit tregtar sipas të gjitha gjasave do të kishte marrë deri në fund të periudhës së kontratës nëse ajo është lidhur për një kohë të caktuar apo për pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës nëse ajo është lidhur për një kohë të pacaktuar.
5. Përfaqësuesit tregtar po ashtu ka të drejtë në pjesëtimin e shumës sipas paragrafit të mëparshëm, nëse ai nuk ka të drejtë në pjesëtimin e shumës sipas paragrafit 1. të këtij neni, ose nëse pjesëtimi i shumës relevante sipas paragrafit 1. të këtij neni do të ishte më e vogël sesa shuma relevante e pjesëtuar sipas paragrafit të mëparshëm.
6. Paga e shumës së pjesëtuar nuk e përjashton të drejtën e përfaqësuesit tregtar për kompensim.

830.1. Paragrafi i parë i nenit 830 të LMD ia njehtë drejtën agentit tregtar për një shpërblim adekuat, në rast të shkëputjes së kontratës për rastet kur urdhërdhënësi, edhe pas shkëputjes së kontratës, vazhdon të gëzojë benefite nga ndërmjetësimi - përfaqësimi i agentit tregtar; kjo për rastet kur urdhërdhënësi, edhe pas zgjidhjes së kontratës, si rezultat i punëve - angazhimeve të agentit tregtar, klientela e tij ka shënuar rritje dhe nëse ajo vazhdon edhe pas zgjidhjes së kontratës ose për rastet kur agjenti tregtar ka ndikuar që klientit dukshëm t'i jetë rritur puna-afarizmi, gjendje pozitive kjo që vazhdon edhe pas zgjidhjes së kontratës; ose për rastet kur klienti humb nga provizionet e caktuara me klientët e tij; ose rrethana të tjera, të cilat duhet të çmohen nga rasti në rast, ashtu që ato do të ishin relevante në kuptimin e bazueshmërisë së të drejtës së agentit për një shpërblim shtesë, kur puna dhe angazhimi i agentit posaçërisht i ka sjellë interesa të caktuara urdhërdhënësit, të cilat përfitime vazhdojnë të mblidhen nga urdhërdhënësi, edhe pas zgjidhjes së kontratës.

830.2. Në lidhje me përcaktimin e shumës shtesë të shpërblimit, (e ashtuquajtura shumë e pjesëtuar e shpërblimit) për agjentin tregtar, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin paraprak të këtij neni, një rrethanë e cila posaçërisht duhet të merret në konsideratë është ajo nëse agjenti tregtar ka fituar ndonjë provizion pas ndërprerjes së marrëdhënies me urdhërdhënësin (në lidhje me kontratat e lidhura për urdhërdhënësin), si dhe rrethana nëse agjenti tregtar ka marrë përsipër vetë detyrimin që të përmbahet ose t'i ndalohe mundësia që të ushtrojë aktivitete të konkurrencës kundrejt urdhërdhënësit (p.sh., nëse agjenti e ka marrë përsipër detyrimin që të përmbahet nga konkurrenca ndaj urdhërdhënësit, kjo do të nënkuptonte një barrë të konsiderueshme për agjentin, gjë që mund të merrej si një faktor relevant në gjetjen e një proporcioni të drejtë të shpërblimit shtesë për agjentin tregtar me mundësinë e themeluar nga paragrafi i parë i këtij neni.

830.3. Paragrafi i tretë i nenit në fjalë përcakton se shuma shtesë e shpërblimit, e cila do të mund t'i takonte agjentit tregtar sipas kuptimit të paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, në asnjë rast nuk do të mund ta tejkalonte "shumën mesatare vjetore" të shpërblimit të fituar gjatë 5 viteve të fundit nga agjenti tregtar, (për rastet kur marrëdhënia e përfaqësimit tregtar ka zgjatur për më tepër se 5 vjet); ndërkaq për rastet kur marrëdhënia e përfaqësimit ka zgjatur për një periudhë më të shkurtër, shuma shtesë e shpërblimit për agjentin nuk mund ta tejkalojë "shumën mesatare" të të ardhurave të fituara për një periudhë më të shkurtër relevante.

830.4. Paragrafi 4 i nenit në fjalë të LMD më tej përcakton se agjentit tregtar i takon e drejta e një shume-shpërblimi shtesë për rastet kur kontrata për përfaqësim tregtar zgjidhet para afatit dhe kjo në rastet kur kontrata për përfaqësimin tregtar është lidhur për afat të caktuar, përkatësisht agjentit tregtar i takon e drejta e një shume-shpërblimi shtesë edhe për rastet kur kontrata për përfaqësim tregtar zgjidhet para afatit prej 5 viteve dhe kjo për rastet kur kjo kontratë është lidhur për kohë të pacaktuar (moskufizimi me kohë i kontratës për përfaqësimin tregtar). Ashtu siç është themeluar më paragrafin në fjalë, nëse ekziston cilitdo rast që u shpjeguan më sipër, agjentit tregtar do t'i takojë e drejta e një shume-shpërblimi shtesë, e cila duhet të paraqesë një shumë adekuate parash, e cila përbëhet nga ndryshimi ndërmjet shpenzimeve që agjenti tregtar ka pasur në lidhje me prezantimin e produktit në treg dhe të gjitha shpenzimeve të tjera në lidhje me përmbushjen e kontratës dhe diferencës së të ardhurave të agjentit tregtar të realizuara nga përmbushja e kontratës dhe të ardhurave që agjenti tregtar, sipas të gjitha gjasave, do të kishte marrë deri në fund të periudhës së kontratës, nëse ajo është lidhur për një kohë të caktuar, apo për pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës kur është lidhur për një kohë të pacaktuar.

830.5. Paragrafi i pestë i nenit në fjalë përcakton se agjenti tregtar ka të drejtë të realizojë "shpërblimin shtesë" sipas bazës së themeluar në paragrafin e katërt të këtij neni, edhe kur agjentit nuk i takon e drejta e "shpërblimit shtesë" sipas përcaktimit të paragrafit të parë të të njëjtit nen, (duke lejuar mundësinë që këto të drejta të agjentit tregtar për shpërblim shtesë, nga sa është saktësuar më lart, mund të kërkohen individualisht); ose agjenti tregtar ka të drejtë të realizojë "shpërblimin shtesë" sipas bazës së themeluar në paragrafin e katërt të këtij neni, nëse shuma relevante sipas paragrafit 1 të këtij neni do të ishte më e vogël, sesa shuma relevante e pjesëtuar sipas paragrafit të mëparshëm.

830.6. Realizimi i të drejtave të agjentit tregtar për shpërblim shtesë (shumë të pjesëtuar), nga sa është themeluar me dispozitat e nenit 830 të LMD, nuk e përjashton ose nuk e afekton të drejtën e agjentit tregtar për kompensim (shpërblim dëmi), nëse për të njëjtin pretendim eventualisht mund të ketë bazë juridike.

Neni 831. Baza për përjashtimin e pjesëtimit të shumës

1. Urdhërdhënësi nuk është përgjegjës të paguaj shumën e pjesëtuar, nëse:

1.1. kontrata është shkëputur nga përfaqësuesi tregtar agjenti. Megjithatë, edhe në këtë rast përfaqësuesit tregtar mund të kërkojë shumën e pjesëtuar nëse arsyeja për shkëputjen e kontratës kanë qenë rrethanat në anën e urdhërdhënësit apo nëse përfaqësuesi tregtar e ka shkëputur kontratën për shkak të moshës apo sëmundjes së përfaqësuesit tregtar e cila do të pamundësonte vazhdimin e marrëdhënies kontraktore.

1.2. urdhërdhënësi ka shkëputur kontratën për shkak të sjelljes me faj të përfaqësuesit tregtar.

1.3. në përputhje me marrëveshjen ndërmjet urdhërdhënësit dhe përfaqësuesit tregtar, urdhërdhënësi lidh kontratë në vend të përfaqësuesit tregtar. Një marrëveshje e tillë nuk është e lejueshme përpara përfundimit të marrëdhënies kontraktore.

831. Neni 831 i LMD rregullon situatat kur agjenti tregtar nuk do t'i takojë e drejta e shpërblimit shtesë (nga ajo çka është themeluar me nenet më sipër për këtë institut), përkatësisht e drejta për “shumën e pjesëtuar”. Situatat në fjalë përfshijnë tri raste, të cilat ligjvënësi posaçërisht i thekson. Në kuptim të kësaj, në rastin e parë, agjenti tregtar nuk do t'i takojë e drejta e shumës së pjesëtuar (shpërblimit shtesë), nëse kontrata për përfaqësimin tregtar shkëputet nga agjenti tregtar, përkatësisht shkëputet me iniciativën e agjentit tregtar. Si përjashtim nga rasti i mësipërm, pavarësisht nëse kontratën e ka shkëputur agjenti tregtar, agjenti ka të drejtën për shumën e pjesëtuar (shpërblimin shtesë), nëse arsyeja e shkëputjes së kontratës nga ana e agjentit ka buruar nga rrethanat, të cilat kanë qenë nën kontrollin ose përgjegjësinë e urdhërdhënësit, përkatësisht agjentit tregtar do t'i takojë e drejta e shumës së pjesëtuar (shpërblimit shtesë) edhe në rastet kur agjenti, për shkak të moshës (në rast pensionimit) ose të sëmundjes, është detyruar të deklarojë se shkëput kontratën për përfaqësim tregtar.

Në rastin e dytë, agjenti tregtar nuk do t'i takojë e drejta e shumës së pjesëtuar (përkatësisht shumës shtesë të shpërblimit) as në rastet kur kontrata për përfaqësimin tregtar është shkëputur nga urdhërdhënësi për rastet “e sjelljes me faj të përfaqësuesit tregtar”. Sigurisht, raste të tilla do të ishin shkëputja e kontratës për shkak të shkeljes së detyrimeve të kontraktuara nga agjenti tregtar, ose mospërbushja, përkatësisht përmbushja e pakënaqshme e detyrimeve kontraktuese nga agjenti tregtar. Sigurisht, në situatat që kanë të bëjnë me këtë rast duhet të vlerësohen “sjelljet e fajshme” të agjentit tregtar në kuptim të detyrimeve kontraktuese të tij.

Në rastin e tretë, agjenti tregtar nuk do t'i takojë e drejta e shumës së pjesëtuar (shpërblimit shtesë) edhe kur, sipas marrëveshjes së agjentit me urdhërdhënësin, një i tretë e zë vendin e agjentit tregtar. Megjithatë, në kuptim të nenit në fjalë, një marrëveshje e tillë (ndërmjet agjentit dhe urdhërdhënësit) nuk mund të arrihet para përfundimit të

marrëdhënies kontraktuese ndërmjet palëve në fjalë, çka nënkupton se fjalë e dytë e pikës në fjalë shpreh karakterin imperativ të dispozitës juridike dhe nuk mund të shmanget me marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 832. Shfrytëzimi i shumës së pjesëtuar

- 1. Drejta në shumën e pjesëtuar rrjedh gjithashtu edhe nëse kontrata është shkëputur për shkak të vdekjes së përfaqësuesit tregtar.**
- 2. Përfaqësuesit tregtar i cili brenda një viti nga momenti i shkëputjes së marrëdhënies kontraktore nuk e informon urdhërdhënësin se do të kërkojë shumën e pjesëtuar e humb të drejtën për shumën e pjesëtuar.**
- 3. Palët nuk mundën që paraprakisht ti heqin apo zvogëlojnë të drejtat në dëm të përfaqësuesit tregtar, në lidhje me shumën e pjesëtuar.**
- 4. Në lidhje me ekstraktet e librave të llogarisë dhe njoftimit mbi rrethanat e dukshme që ndikojnë në përcaktimin e shumës së pjesëtuar, përfaqësuesi tregtar ka të njëjtat të drejta si në rastin e caktimit të provizionit.**

832.1. Paragrafi i parë i nenit 832 të LMD parashikon që drejta e agentit tregtar të kërkojë shumën e pjesëtuar (shtesën e shpërblimit) është në realitet një drejtë “jopersonale” e agentit tregtar, pra ajo rrjedh, përkatësisht mund të kërkojë edhe nga trashëgimtarët e agentit tregtar, në rast të vdekjes së tij.

832.2. Drejta e agentit tregtar që të kërkojë realizimin e të drejtave të tij në lidhje me “shumën e pjesëtuar”, përkatësisht drejta që të kërkojë pagesën e shumës në fjalë parashkruhet nëse agjenti tregtar nuk e informon urdhërdhënësin për qëllimin e tij për të kërkuar këtë shumë brenda afatit prej një viti, afat ky që rrjedh nga momenti i shkëputjes së kontratës ndërmjet agentit tregtar dhe urdhërdhënësit. Në kuptim të paragrafit të dytë të nenit në fjalë, kur agjenti tregtar njofton urdhërdhënësin se ka për qëllim të kërkojë “shumën e pjesëtuar”, atëherë në lidhje me shuarjen e kësaj kërkesë zbatohen rregullat e përgjithshme të parashkrimit, (shih komentimet e neneve të LMD në lidhje me parashkrimin).

832.3. LMD, në paragrafin e tretë të këtij neni parashikon që palët nuk mund t’i kufizojnë ose përjashtojnë më marrëveshje dispozitat e LMD në lidhje me të drejtat e agentit tregtar, që kanë të bëjnë me “shumën e pjesëtuar”, çka jep përshtypjen se në këtë rast bëhet fjalë për rregulla detyruese, të cilat rregullojnë institutin e “shumës së pjesëtuar”, e cila i takon agentit tregtar në bazë të dispozitave të lartpërmendura, ashtu që kufizimi, respektivisht përjashtimi i tyre me marrëveshje ndërmjet palëve nuk do të prodhonte ndonjë efekt juridik ndaj agentit tregtar në lidhje me përmbajtjen e të drejtave të tij, që kanë të bëjnë me “shumën e pjesëtuar”.

832.4. Agjenti tregtar ka të gjitha të drejtat e shqyrtimit - auditimit të pavarur të librave të llogarisë së urdhërdhënësit me qëllim të shqyrtimit të të gjitha rrethanave, të cilat janë relevante ose që ndikojnë në përcaktimin e shumës së pjesëtuar, e cila i takon atij në bazë të përcaktimi të dispozitave të mësipërme. Në këtë kuptim, agjenti tregtar ka të gjitha të drejtat për shqyrtimin e librave të llogarisë, ashtu siç është përcaktuar më lart, edhe për provizionin - shpërblimin (shih në lidhje me këtë komentimin e nenit 823 të LMD).

Neni 833. Ndalimi i konkurrencës pas shkëputjes së kontratës

- 1. Me anë të kontratës mund të përcaktohet se pas përfundimit të kontratës përfaqësuesi tregtar nuk mund të kryejë ndonjë aktivitet që do të konkurronte me aktivitetet e urdhërdhënësit.**
- 2. Një dispozitë e tillë është e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nëse është në të njëjtën fushë, për të njëjtët persona dhe të njëjtat mallra siç janë të përcaktuara në kontratë.**
- 3. Kur kontrata është shkëputur për arsytet e urdhërdhënësit, një dispozitë e tillë është e detyrueshme vetëm për përfaqësuesit tregtar nëse urdhërdhënësi ka paguar shumën e pjesëtuar përkatëse me rastin e shkëputjes së kontratës dhe nëse gjatë ndalesës për konkurrencë urdhërdhënësi paguan kompensimin e përshtatshëm mujorë në një shumë të barabartë me mesataren e provizionit mujorë për gjatë pesë (5) viteve të fundit të kontratës ose për gjatë kohës së kontratës, nëse ajo ka qenë në fuqi për më pak se pesë (5) vite.**
- 4. Një dispozitë e tillë do të detyrojë përfaqësuesin tregtar për të paktën dy (2) vite pas shkëputjes së kontratës.**
- 5. Nëse përfaqësuesi tregtar ka shkëputur kontratën për fajin e urdhërdhënësit dhe ndalesa e konkurrencës pas shkëputjes së kontratës ka qenë pjesë e marrëveshjes në kontratë, përfaqësuesi tregtar mundet që brenda një (1) muaji pas shkëputjes së kontratës ti dorëzojë një deklaratë me shkrim urdhërdhënësit ku e njofton se përfaqësuesi tregtar nuk do ta respektojë ndalesën e konkurrencës.**
- 6. Dispozitat e këtij neni nuk mund të ndryshohen me anë të kontratës në dëm të përfaqësuesit tregtar.**

833.1. LMD, në paragrafin e parë të nenit 833, lejon që palët në kontratën për përfaqësim tregtar mund të pajtohen dhe të themelojnë detyrimin që, pasi të përfundojë kontrata për përfaqësimin tregtar, agjenti tregtar do të përmbahet nga kryerja e ndonjë aktiviteti që do të konkurronte me aktivitetet e urdhërdhënësit. Kështu, në një rast të tillë të kontraktimit, agjenti pranon obligimin kontraktues ndaj urdhërdhënësit që edhe pas shuarjes së kontratës për përfaqësimin tregtar, të përmbahet nga ushtrimi ose të mos ushtrojë aktivitete ose punë të caktuara, të cilat palët i kanë specifikuar në marrëveshje dhe të cilat konsiderohen si “ndalim i konkurrencës ndaj urdhërdhënësit”.

833.2. Urdhërdhënësi dhe agjenti tregtar mund të pajtohen për ndalimin e konkurrencës, ashtu që detyrimi për ndalimin e saj do të jetë i detyrueshëm ndaj agjentit tregtar vetëm nëse për këtë gjë palët pajtohen me një marrëveshje me shkrim, (ku pasqyrohet karakteri formal i një kontraktimi të tillë). Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës, që ka për qëllim të prodhojë efekt pas shuarjes së marrëdhënies së përfaqësimit ndërmjet palëve, mund të kontraktohet në formë të klauzolës-obligimit kontraktues të inkorporuar në kontratën për përfaqësim tregtar ose mund të arrihet në formë të një marrëveshjeje të veçantë me rastin e shuarjes-përmbylljes së raporteve kontraktuese ndërmjet palëve. Më tej, paragrafi i dytë i nenit në fjalë të LMD parashikon se jo vetëm që marrëveshja për ndalimin e konkurrencës duhet të jetë e shkruar, por ajo duhet t'i referohet ose të përmbajë dispozita me të cilat saktësohet ndalimi i konkurrencës së fushës ose rrethit të punëve, të cilat agjenti tregtar i ka ndërmarrë rëndom për urdhërdhënësin, përkatësisht ajo duhet t'u referohet personave të njëjtë ose rjetit të klientelës së urdhërdhënësit (klientelë e krijuar gjatë përfaqësimit tregtar nga agjenti), përkatësisht t'u referohet mallrave ose tregtimit të mallrave të njëjta, në lidhje me të cilat agjenti ka shërbyer si ndërmjetësues ose përfaqësues i urdhërdhënësit.

833.3. Klauzola ose marrëveshja kontraktuese ndërmjet palëve për ndalimin e konkurrencës ndaj urdhërdhënësit nuk do të prodhonte efekt juridik, përkatësisht nuk do të ishte e detyrueshme për agjentin tregtar, nëse marrëveshja për përfaqësim tregtar shkëputet njëanësisht nga urdhërdhënësi dhe për shkaqe të cilat adresojnë interesat ose rëndojnë mbi përgjegjësinë ekskluzive të urdhërdhënësit. Përsjashtimisht, edhe në një rast të tillë agjenti tregtar do të jetë i lidhur me detyrimin e ndalimit të konkurrencës ndaj urdhërdhënësit, me plotësimin e dy kushteve: kushti i parë ka të bëjë me atë nëse agjenti tregtar ka arkëtuar nga urdhërdhënësi “shumën e pjesëtuar” të mjeteve përkatëse (shpërblimi shtesë për agjentin) me rastin e pushimit të kontratës, ashtu si përcaktohet nga dispozitat e komentuara më lart, (shih posaçërisht komentimin e nenit 830 më lartë), kurse kushti i dytë ka të bëjë me të drejtën e agjentit tregtar që të kërkojë nga urdhërdhënësi një pagesë adekuate mujore, (që duhet t'i paguhet si kundërvlerë ndaj detyrimit të tij që të përmbahet nga konkurrenca), vlera e së cilës duhet të përcaktohet me një shumë të barabartë me mesataren e shpërblimit mujor përgjatë pesë viteve të fundit të kontratës ose përgjatë kohës së kontratës, nëse ajo ka qenë në fuqi për më pak se pesë vite.

833.4. Nëse janë plotësuar kushtet ashtu siç janë themeluar me paragrafin e tretë të nenit 833 të LMD, (shih komentimin më lart të paragrafit të tretë), detyrimi ndalesës së të bërit konkurrencë urdhërdhënësit do ta detyrojë agjentin tregtar për një periudhë prej të paktën dy viteve, afat ky që rrjedh pas shkëputjes së kontratës për përfaqësimin tregtar. Sigurisht, në kuptim të paragrafit në fjalë, palët janë të lira të kontraktojnë një afat më të gjatë, me kushte dhe interesa të dakorduara posaçërisht ndërmjet palëve.

833.5. Nëse kontrata për përfaqësimin tregtar është shkëputur për shkak të sjelljeve të fajshme të urdhërdhënësit, (sjellje që ndërliiden me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuese ose përmbushjen e parregullt të detyrimeve kontraktuese e sjellje të ngjashme,

të cilat e bëjnë urdhërdhënësin përgjegjës për dështimin e përmbushjes së detyrimeve të tij të përcaktuara në kontratë), e në qoftë se në kontratën për përfaqësimin tregtar palët kanë inkorporuar klauzolën për “ndalimin e konkurrencës” ndaj urdhërdhënësit, më qëllim që agjenti tregtar të lirohet nga një obligim i tillë kontraktues, (që ndërlihet me detyrimin që të përmbahet nga të bërit konkurrencë urdhërdhënësit), agjenti mundet, brenda afatit prej një muaji, i cili llogaritet nga momenti i shkëputjes së kontratës për përfaqësimin tregtar, përmes një deklarate të ekzekutuar me shkrim, ta njoftojë urdhërdhënësin se nuk do ta respektojë ndalesën përkatëse në lidhje me konkurrencën ndaj urdhërdhënësit.

833.6. Paragrafi i fundit i nenit 833 të LMD parashikon se dispozitat e nenit në fjalë janë detyruese për aq sa garantojnë interesat minimale të sanksionuara me këtë nen në interesin e agjentit tregtar; ashtu që ato nuk mund të kufizohen ose të përjashtohen me ndonjë marrëveshje ndërmjet palëve. Në kuptim të kësaj, palët megjithatë mund të merren vesh me kontratë për më shumë të drejta për agjentin tregtar, nga sa është përcaktuar me dispozitat e këtij neni.

PJESA XVIII KONTRATA PËR NDËRMJETËSIM

KREU 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 834. Kuptimi

Me kontratën për ndërmjetësimin detyrohet ndërmjetësuesi që të përpiqet të gjejë dhe ta vejë në lidhje me urdhërdhënësin personin që do të bisedonte me të për lidhjen e kontratës së caktuar, ndërsa urdhërdhënësi detyrohet t'i paguajë shpërblim të caktuar, në qoftë se kjo kontratë do të lidhet.

834. Neni 834 i LMD-së jep kuptimin e kontratës për ndërmjetësimin. Sipas kuptimit që siguron Neni në fjalë (duke konsideruar edhe diskutimet teorike mbi këtë kontratë), kontrata për ndërmjetësimin nënkupton marrëveshjen ndërmjet ndërmjetësuesit dhe urdhërdhënësit të tij, sipas së cilës ndërmjetësuesi ka pranuar detyrimin që urdhërdhënësin e tij ta vejë në kontakt me palën e tretë, me qëllim që urdhërdhënësin i tij të zhvilloj negociata me të tretin me qëllim të lidhjes së kontratës përkatëse nga fusha e qarkullimit të mallrave dhe dhënies së shërbimeve, ndërsa si kundërvlerë për shërbimin e ofruar nga ndërmjetësuesi, urdhërdhënësi merr detyrimin që të njëjtit t'i paguaj shpërblimin përkatës nëse lidhet kontrata me rastin e ndërmjetësimit. Pra, kontrata për ndërmjetësimin është një lloj kontrate që hynë në kuadër të kontratave për shërbime tregtare-ekonomike, qëllimi i të cilës është që t'ua lehtësoj palëve (urdhërdhënësit) kontaktin e ndërsjellë, zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e kontratës nga fusha e qarkullimit të mallrave dhe dhënies së shërbimeve. Sigurisht, në jetën e përditshme dhe në afarizëm ekzistojnë situata kur kemi persona që dëshirojnë të lidhin kontrata përkatëse, por të njëjtëve iu mungojnë informatat në lidhje me personat të cilëve duhet të iu drejtohen për lidhjen e kontratës, ose iu mungojnë informatat në lidhje me mundësitë që të njëjtëve iu ofron tregu për lidhjen e kontratave përkatëse, ashtu që të njëjtit kërkojnë shërbimin e ndërmjetësuesit, si shërbim profesional, i cili pranon të njëjtëve t'iu propozoj palët e treta potencialisht të përshtatshme për lidhjen e kontratës përkatëse.

LMD nuk bënë ndonjë kufizim ose nuk vendosë ndonjë listë të kontratave duke përcaktuar se cilat kontrata mund të lidhen me ndërmjetësim. Në këtë kuptim duket se LMD respekton autonominë e vullnetit të palëve, ashtu që është në dorën e palëve të referojnë çfarëdo kontrate (çoftë me emër ose pa emër) nga fusha e qarkullimit të mallrave dhe dhënies së shërbimeve që të lidhet përmes ndërmjetësimit. Sigurisht, tani në kohën moderne që karakterizohet nga përshpejtimi i qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, duket se shërbimi i ndërmjetësimit dhe kontrata e ndërmjetësimit ka zënë një vend adekuat në afarizmin tregtar.⁶⁷⁵ Sipas kuptimit që na siguron edhe Neni në fjalë, ndërmjetësuesi me

675 Në lidhje me këtë shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 415.

rastin e ndërmjetësimit pranon detyrimin që të ndërmjetësoj ndërmjet urdhërdhënësit të tij dhe palës së tretë me qëllim që kontrata përkatëse të lidhet; megjithatë, kjo nuk nënkupton asnjë garanci personale të ndërmjetësuesit që kontrata domosdo do të lidhet, pasi që roli dhe detyra e ndërmjetësuesit është vetëm që të udhëheqë me vënie në kontakt dhe lehtësimin e negociatave ndërmjet palëve për lidhjen e kontratës; ashtu që vendimi definitiv për lidhjen e kontratës iu takon vetë palëve kontraktuese. Në këtë kuptim, ndërmjetësuesit i takon shpërblimi vetëm nëse arrihet lidhja e kontratës ndërmjet urdhërdhënësit dhe palës së tretë, ashtu që nëse lidhja e kontratës nuk është e suksesshme atëherë (përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër ndërmjet palëve), nuk lind detyrimi i urdhërdhënësit që t'ia paguaj ndonjë shpërblim ndërmjetësuesit.⁶⁷⁶

Ashtu siç mund të vërehet nga dispozita në fjalë e LMD-së, në kontratën për ndërmjetësimin na paraqitën të paktën dy palë, urdhërdhënësi dhe ndërmjetësuesi. Në praktikën juridike ndodhë që në cilësinë e ndërmjetësuesit në rastet më të shpeshta të paraqitët ndonjë ndërmarrje, entitet biznesor, gjegjësisht person juridik i cili e ofron shërbimin e ndërmjetësimit si profesionist; megjithatë, LMD nuk bënë ndonjë dallim ndërmjet mundësisë që në cilësinë e cilësdo-palë të kontrata për ndërmjetësimin të paraqiten edhe personat fizik.

Në pikëpamje të formës, LMD nuk vendosë ndonjë barrierë për kontratën e ndërmjetësimit, duke e kualifikuar këtë kontratë si kontratë konsensuale. Megjithatë, në praktikën juridike në lidhje me kontraktimet në ekonomi gjithnjë e më tepër kontratat komerciale ekzekutohen në një formë të shkruar, ose edhe në formë elektronike e cila lejon që palët të mund të ruajnë dhe të dokumentojnë përmbajtjen e kontratës; përfshirë në këtë edhe kontratat për komisionin. Ekzekutimi i kontratave në formë shkresore, ose në formë të dokumenteve (ose edhe në formë elektronike, ku përmbajtja e kontratës mund të ruhet në një format të përshtatshëm), gjithmonë po argumentohet se është një domosdoshmëri dhe kulturë juridike e cila më së miri i shërben interesave të palëve dhe sigurisë së transaksionit (pasi që me përpikëri ruhet përmbajtja e kontratës e vila mund të jetë vendimtare gjatë ekzekutimit të detyrimeve reciproke të palëve, apo edhe në rast të kontestit eventual palët mund të përdorin format shkresore me qëllim të verifikimit dhe të të provuarit të përmbajtjes së kontratës).

Neni 835. Zbatimi i dispozitave të ligjit për kontratën për veprën

Kur është kontraktuar se ndërmjetësuesi do të ketë të drejtë në shpërblimin e caktuar dhe në qoftë se përpjekja e tij mbetet pa rezultat, për atë kontratë do të zbatohen dispozitat që vlejnë për kontratën për veprën.

835. Parimisht, detyra e ndërmjetësuesit është të vendosë kontaktin ndërmjet urdhërdhënësit dhe palës së tretë me qëllim që të njëjtit të lidhin kontratën përkatëse; e eventualisht të lehtësoj në bisedimet ndërmjet palëve me qëllim që të njëjtat të arrijnë një marrëveshje

⁶⁷⁶ Shih për këtë edhe: Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1768 - 1774.

finale. Pasi që qëllimi i ndërmjetësuesit është që t'iu shërbej palëve me qëllim që të njëjtat të lidhin një kontratë, atëherë sipas rrjedhës së rëndomtë të gjërave, ndërmjetësuesi i përfundon detyrimin e tij dhe fiton të drejtën në shpërblim pasi që të jetë mundësuar lidhja e kontratës ndërmjet urdhërdhënësit dhe palës së tretë. Megjithatë, në kuptim të Nenit 835 të LMD-së dhe Nenit paraprak, palët në kontratën e ndërmjetësimit mund të merren vesh edhe ndryshe, ashtu që të kontraktojnë se ndërmjetësuesit do t'i takoj e drejta në shpërblim edhe nëse nuk është arritur lidhja e kontratës finale ndërmjet ndërmjetësuesit dhe palës së tretë. Nëse ashtu është kontraktuar nga palët që ndërmjetësuesit ti takoj e drejta në shpërblim edhe nëse ndërmjetësimi nuk qon në lidhjen e kontratës përkatëse, shtrohet pyetja se si mund të përcaktohet momenti deri kur ndërmjetësuesi duhet të bëjë përpjekje dhe ndërmjetësoj për lidhjen e kontratës përkatëse, ose kur mund të konsiderohet se përpjekjet e ndërmjetësuesit për ndërmjetësim nuk kanë qenë të suksesshme, ashtu që i njëjti të pretendoj se është plotësuar kushti për pagimin e shpërblimit. Neni 835 i LMD-së jep përgjigjen se për sigurimin e përgjigjes nga pyetja si më lartë duhet të zbatohen rregullat që vlejné për kontratën për veprën, gjegjësisht se rasti i dhënë duhet të komentohet dhe interpretohet sipas kërkesave të Nenit 622.2 të LMD-së. Në kuptim të kërkesave të këtij Neni, për rastet kur është kontraktuar se ndërmjetësuesit do ti takoj e drejta edhe nëse me sukses nuk lidhet kontrata me palën e tretë, atëherë nëse shërbimet e ndërmjetësimit kanë qenë të lidhura me afat ndërmjetësuesit do ti takoj e drejta në shpërblim në momentin kur afati i kontraktuar për ofrimin e shërbimeve përmyllet; e për rastet kur palët nuk kanë kontraktuar kohëzgjatjen e ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit, atëherë ndërmjetësuesi e fiton të drejtën në shpërblim vetëm nëse ka ndërmjetësuar për aq gjatë sa arsyeshmërishtë nevojitet për lidhjen e kontratave përkatëse.⁶⁷⁷

Neni 836. Pranimi i përmbushjes

- 1. Urdhri për ndërmjetësimin nuk përmban autorizim për ndërmjetësuesin që për urdhërdhënësin të pranojë përmbushjen e detyrimit nga kontrata e lidhur me ndërmjetësimin e tij.**
- 2. Për këtë është e nevojshme një prokurë e veçantë me shkrim.**

836.1. Puna e ndërmjetësuesit përfundon me lidhjen e kontratës përkatëse, lidhja e së cilës është ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi. Rëndom, detyrimi i ndërmjetësuesit pushon me lidhjen e kontratës për ndërmjetësimin, nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe më kontratë. Me lidhjen e kontratës për ndërmjetësimin, parimisht, plotësohet edhe kushti që ndërmjetësuesi të kërkoj pagesën e shpërblimit për shërbimin e dhënë urdhërdhënësit, ashtu që më pagesën e shpërblimit përkatës edhe mund të thuhet se marrëdhënia e ndërmjetësimit është e përmbushur, gjegjësisht është përfunduar ndërmjet palëve.

⁶⁷⁷ Për më shumë në lidhje me kuptimin e Nenit 622.2 dhe mundësinë se si standardet e të njëjtit mund të zbatohen edhe në Kontratën për ndërmjetësimin, kur palët kanë kontraktuar se ndërmjetësuesit I takon e drejta në shpërblim edhe nëse ndërmjetësimi nuk rezulton në lidhjen e kontratës me personin e tretë; shih për këtë komentimin e Nenit 622.2 të LMD-së.

Nga ajo çka nënkuptohet nga kuptimi i kontratës për ndërmjetësimin, si dhe përcaktimi i paragrafit të parë të Nenit 836 të LMD-së, ndërmjetësuesi nuk ka asnjë autorizim të ekzekutoj ndonjë veprim ose të pranoj përmbushjen (ose një pjesë të saj) e detyrimeve nga kontrata që është lidhur me ndërmjetësimin e tij. Duket se ky është edhe përcaktimi i qartë i Nenit 286.1 të LMD-së i cili themelon se përmbushja e detyrimit mund të kërkohet vetëm nga kreditori, ose në vend të tij nga personi tjetër i caktuar me ligj, me vendim të gjykatës, ose me kontratë nga palët.⁶⁷⁸ Në kuptim të këtij përcaktimi, si dhe duke u mbështetur edhe nga natyra e kontratës për ndërmjetësimin, LMD në paragrafin e parë të Nenit 836 ka saktësuar se urdhri për ndërmjetësim, gjegjësisht se përmbajtja e kontratës për ndërmjetësim, konsiderohet se nuk e përmban autorizimin për ndërmjetësuesin që i njëjti të mund ta përfaqësoj urdhërdhënësin në pranimin e përmbushjeve nga pala e tretë në lidhje me kontratën të ndërmjetësuar nga i njëjti, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.

836.2. Përjashtimisht, që ndërmjetësuesi të mund të ushtroj ndonjë veprim juridik në emrin dhe për llogarinë e urdhërdhënësit (ose të ofroj ose pranoj përmbushjen në emrin dhe llogarinë e tij), duhet që për këtë qëllim palët të kenë themeluar - ekzekutuar një prokurë të veçantë me shkrim. Ky është edhe përcaktimi shprehimor i paragrafit të dytë të Nenit 836 të LMD-së. Kërkesa në fjalë e dispozitës së LMD-së e vë theksin në karakterin formal të kësaj kërkesë, pasi që e njëjta kërkon që autorizimi që bartet në ndërmjetësuesi, gjegjësisht prokura të ekzekutohet domosdo me shkrim, dhe kjo pa marrë parasysh nëse kontrata për përfaqësimin tregtar është ekzekutuar me shkrim, me gojë, ose në ndonjë formë tjetër. Sigurisht, klauzola për autorizimin e veçantë të ndërmjetësuesit mund të inkorporohet edhe në kontratën për ndërmjetësimin (nëse palët me rastin e ekzekutimit të kësaj kontrate e kanë plotësuar kushtin e formës), ose të njëjtën e ekzekutojnë në një formë të veçantë (me shkrim). Forma me shkrim vlen edhe për ndryshimet ose plotësimet eventuale të mëvonshme të prokurës së dhënë ndërmjetësuesit.⁶⁷⁹ Rregullat e kontratës për ndërmjetësimin nuk zbatohen në adresimin e raporteve ndërmjet palëve në lidhje me çështjen dhe përmbajtjen e prokurës.⁶⁸⁰ Gjithashtu, duhet theksuar se çfarëdo marrëveshje në ndërmjet palëve që und të inkorporohet në kontratën e ndërmjetësimit dhe që mund të themeloj se prokura e dhënë nuk mund të ndryshohet ose të revokohet nga urdhërdhënësi (prokurë-dhënësi) është e pavlefshme.⁶⁸¹ Përjashtimisht, përmbushja e pranuar nga ndërmjetësuesi mund të konsiderohet si e vlefshme edhe nëse nuk është autorizuar paraprakisht nga urdhërdhënësi, por me kushtin nëse e njëjta është aprovuar ose lejuar nga urdhërdhënësi më vonë.⁶⁸²

678 Shih në lidhje me këtë komentimin e Nenit 286.1 të LMD-së.

679 Në lidhje me këtë të fundit shih edhe komentimin e Nenit 51.2 të LMD-së në lidhje me rregullën e përgjithëshme për formën e ndryshimeve ose të plotësimeve të kontratës formale.

680 Shih në lidhje me këtë komentimin e Nenit 77 të LMD-së.

681 Shih në lidhje me këtë komentimin e Nenit 80.1 të LMD-së.

682 Shih në lidhje me këtë komentimin e Nenit 286.2 të LMD-së.

Neni 837. Revokimi i urdhrit për ndërmjetësim

Urdhërdhënësi mund ta revokoj urdhrin për ndërmjetësim kur të dojë, në qoftë se nga kjo nuk ka hequr dorë dhe me kusht që revokimi nuk është në kundërshtim me mirëbesimin.

837. Kontrata për ndërmjetësimin themelohet me marrëveshjen e palëve dhe rëndom me marrëveshjen e palëve edhe mund të ndryshohet, ose shuhet. Kur shtrohet çështja e shuarjes së kontratës së ndërmjetësimit para afatit të kontraktimit dhe atë çoftë shuarja me marrëveshjen e përbashkët të palëve ose me deklaratën e njëanshme të vullnetit të urdhërdhënësit (revokimi), është mirë që kontrata për raste të tilla të përmbaj dispozita në lidhje me rregullimin e mundësisë dhe të drejtës së ndërmjetësuesit në shpërblim dhe mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara.

LMD, në Nenin 837, themelon se urdhërdhënësi kurdo që dëshiron, sipas zgjedhjes së ti të lirë, mund të revokoj urdhrin për ndërmjetësim (gjegjesisht mund të deklaroj shkëputjen e njëanshme të kontratës për ndërmjetësim). Kështu, urdhërdhënësi me rastin e deklarimit se tërheqë urdhrin për ndërmjetësim, nuk ka detyrim që palës tjetër ti prezantoj ndonjë arsye se përse vepron ashtu. Thjeshtë, mundësia e revokimit të urdhrit për ndërmjetësim e urdhërdhënësit është një mundësi që është themeluar me Ligj në interesin e tij, ashtu që i njëjti mund ta shfrytëzoj këtë mundësi kurdo; me përjashtim të asaj se revokimi i urdhrit për ndërmjetësim (deklarimit të zgjidhjes së njëanshme të kontratës) nga ana e urdhërdhënësit nuk mund të bëhet nëse urdhërdhënësi shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo mundësi, gjegjesisht me kusht që deklarimi i revokimit të urdhrit për ndërmjetësim nga urdhërdhënësi nuk është bërë me keqbesim (duke pasë në konsideratë në rastin e fundit rrethanat e rastit përkatës). Kështu, urdhërdhënësi, me rastin e deklarimit të revokimit të urdhrit (për rastet kur nuk ka kontraktuar heqjen dorë nga kjo mundësi) duhet ti përmbahet rregullave të parimit të “mirëbesimit”, parim i cili duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit konkret.⁶⁸³ Sigurisht, do të mund të konsiderohej se urdhërdhënësi nuk ka vepruar sipas rregullave të mirëbesimit nëse me revokimin e urdhrit për ndërmjetësim bënë përpjekje që ti shmangët detyrimeve të tij ndaj ndërmjetësuesit (psh., detyrimet në lidhje me pagesën e shpërblimit, ose pagesën e shpenzimeve që i janë shkaktuar të njëjtit, e situata të ngjashme); ose një situatë tjetër (e veprimit me keqbesim) do të mund të ekzistonte nëse urdhërdhënësi pasi që ka jep urdhrin për ndërmjetësim ka humbur interesimin për ndërmjetësim (dhe lidhjen e kontratës me të tretin), ashtu që për këtë ndryshim nuk e njofton ndërmjetësuesin me kohë, etj.

Në rast se deklarohet shkëputja e njëanshme e kontratës nga urdhërdhënësi, sipas mundësisë së ofruar nga Neni në fjalë i LMD-së, mund të shtrohet pyetja nëse ndërmjetësuesit do ti takonte e drejta në shpërblim edhe përkundër revokimit të urdhrit. Në përpjekjet për sigurimin e një përgjigjeje për pyetjen e ngritur, teoria juridike adreson dy situata përkatëse. Në situatën e parë, nëse është lidhur kontrata për ndërmjetësim pa afat të caktuar, atëherë ndërmjetësuesi mund ta revokoj kurdo urdhrin për ndërmjetësim dhe ndërmjetësuesit nuk do ti takoj e drejta në shpërblim, pasi që ndërmjetësuesi e fiton të drejtën në shpërblim

683 Shih në lidhje me kuptimin e parimit të mirëbesimit komentimin e Nenit 4 të LMD-së.

vetëm pasi që të jetë lidhur me sukses kontrata për të cilën ka ndërmjetësuar, ashtu që nëse kontrata me të tretin nuk është lidhur, rrjedhimisht edhe nuk i takon e drejta në shpërblim (për të drejtën e shpërblimit të ndërmjetësuesit shih komentimin e Nenit 844 të LMD-së). Për dallim nga kjo, në situatën e dytë, nëse kontrata për ndërmjetësimin është lidhur me afat të caktuar, atëherë mund të konsiderohet se ekzekutimi i urdhrin brenda afatit të caktuar është një element thelbësor i kontratës, ashtu që nëse afati kalon pa sukses, konsiderohet se kontrata ka pushuar sipas forcës së Ligjit.⁶⁸⁴ Rrjedhimisht, në situatën e dhënë, nëse fati i kontratës së ndërmjetësimit është lidhë brenda afatit të caktuar, e më pas (para se të kaloj afati) urdhërdhënësi deklaron revokimin e urdhrin të ndërmjetësimit, atëherë ka autorë që konsiderojnë se ndërmjetësuesi do të duhej ti takoj e drejta në pagesën e plotë të shpërblimit të kontraktuar. Ky qëndrim argumentohet me faktin se të rasti i kontraktimit të kontratës për ndërmjetësimin me afat të caktuar, afati bëhet pjesë thelbësore e kontratës dhe parasupozon mundësinë se ndërmjetësuesi po heq dorë nga e drejta e tij që të mund të revokoj urdhrin për ndërmjetësim para afatit të skadimit të kontratës.⁶⁸⁵

Neni 838. Mungesa e detyrimit për urdhërdhënësin që të lidhë kontratë

Urdhërdhënësi nuk është i detyruar të fillojë bisedime për lidhjen e kontratës me personin të cilin e ka gjetur ndërmjetësuesi dhe as të lidhë kontratë me të nën kushtet që ia ka komunikuar ndërmjetësuesit, por do të përgjigjet për dëmin, në qoftë se ka vepruar në kundërshtim me mirëbesimin.

838. Në vijën e përcaktimeve të Nenit paraprak të LMD-së është edhe Neni 838 i LMD-së, i cili saktëson se urdhërdhënësi nuk është i obliguar të lidhë kontratën më të tretin (gjegjësisht as të hyjë në negociatë) për të cilën ka ndërmjetësuar ndërmjetësi, si dhe i njëjti nuk është i obliguar që të lidhë kontratën më të tretin nën kushtet të cilat ia ka komunikuar ndërmjetësimit; megjithatë, urdhërdhënësi do të mund të përgjigjet për shpërblimin e dëmit (dhe qoftë ndaj ndërmjetësuesit, ose të tretit), nëse sjelljet e urdhërdhënësit janë në kundërshtim me rregullat e mirëbesimit. Si duket, ky përcaktim ligjor është edhe në pajtim më kuptimin dhe qëllimin e shërbimit të ndërmjetësimit, ashtu që në marrëdhënien e ndërmjetësimit urdhërdhënësi e ruan të drejtën që të bëjë zgjedhje përfundimtare autonome (në lidhje me kontraktimin final me palën e tretë), pavarësisht marrëdhënies së ndërmjetësimit të themeluar me ndërmjetësin e tij, e kjo për aq sa veprimet e tij nuk mund të kualifikohen si veprime me keqbesim. Urdhërdhënësi duhet të ruaj të drejtën që të bëjë zgjedhje autonome në pikëpamje të hyrjes në marrëdhënie me të tretin pasi që është urdhërdhënësi ai i cili merr obligime kontraktuese me të tretin, ashtu që fakti që kontrata e tij është ndërmjetësuar me të tretin nuk ndikon aspak në sigurimin e urdhërdhënësit se i treti me sukses do të përmbush obligimet e tija kontraktuese. Si rregull, nëse vendimi përfundimtar i urdhërdhënësit është që të mos hyjë në negociatë, ose të mos e pranoj lidhjen e kontratës me të tretin, rëndom ndërmjetësuesit nuk do ti takoj e drejta në shpërblimin

684 Shih në lidhje me këtë mundësi komentimin e Nenit 107 të LMD-së;

685 Në lidhje me këtë qasje shih Blagojevic, Borislav dhe Vrleta Krulj. *Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II - Druga Izdanje*. Novi Sad: 1983: fq. 1777 - 1779.

përkatës.⁶⁸⁶ Edhe përkundër ekzistimit të të drejtës së urdhërdhënësit që të jetë autonom në vendosjen nëse do të hyje në negociata ose lidhë kontratë me të tretin, ose se cila do të jetë përmbajtja e asaj kontrate, megjithatë, sjellja e urdhërdhënësit duhet të jenë në pajtim me parimin e mirëbesimit. PSh., urdhërdhënësi do të mund të përgjigjet për shpërbimin e dëmit ndaj ndërmjetësuesit, ose palës së tretë, nëse ka hyrë në negociata pa qëllimin e mirëfilltë të lidhjes së kontratës; ose kur papritur ka dal nga negociatat pa arsye të shpjegueshme për rastin kur sjelljet e urdhërdhënësit kanë lënë përshtypjen se kontrata është në procesin e pranimit të pakthyeshem të urdhërdhënësit, etj.⁶⁸⁷

KREU 2

DETYRIMET E NDËRMJETËSUESIT

Neni 839. Detyrimi i kërkimit të rastit

- 1. Ndërmjetësuesi ka për detyrë që, me kujdesin e ekonomistit të mirë, të kërkojë rastin përlidhjen e kontratës së caktuar dhe t'i tregojë për të urdhërdhënësit.**
- 2. Ndërmjetësuesi ka për detyrë të ndërmjetësojë në bisedime dhe të përpiqet që të vejë deri te lidhja e kontratës në qoftë se për të posaçërisht është detyruar.**
- 3. Ai nuk përgjigjet në qoftë se edhe krahas kujdesit nuk ka sukses në përpjekjen e vet.**

839.1. Një nga detyrimet kryesore të ndërmjetësuesit është detyrimi që të hulumtoj për mundësitë në treg me qëllim të gjetjes së rastit të përshtatshëm për urdhërdhënësin e tij (për lidhjen e kontratës), e që për mundësinë e tillë ta njoftoj urdhërdhënësin, e që eventualisht edhe të ndërmjetësojë në fazën e negociatave ndërmjet urdhërdhënësit dhe të tretit përderisa palët të lidhin kontratën. Në lidhje me detyrimin e ndërmjetësuesit që të hulumtoj për gjetjen e rastit të përshtatshëm të urdhërdhënësit, mund të shtrohet pyetja se për sa gjatë ndërmjetësuesi është i detyruar të hulumtoj për gjetjen e një mundësie të përshtatshme për urdhërdhënësin. Në përgjigjen në këtë pyetje duhet të sqarohet nëse kontrata ka qenë e lidhur për afat, ose jo. Në rastin e dytë, e që rëndom është më i shpeshti, detyrimi për ndërmjetësuesin do të zgjas për aq kohë sa është arsyeshmërisht të nevojshme që një ndërmjetësuesi do ti duhej të kompletonte detyrën e tij në rrethanat e dhëna të rastit konkret; çka mbetet detyrë për gjykatën të vlerësojë nëse në rastin e dhënë ndërmjetësuesi arsyeshmërisht ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për kryerjen e urdhrut të urdhërdhënësit. Përveç kuptimit si më sipër, paragrafi i parë i Nenit 839 kërkon që ndërmjetësuesi, gjatë përpjekjeve të tij të gjetjes së rastit të përshtatshëm për ndërmjetësim të urdhërdhënësit të tij, duhet të tregojë kujdesin e “ekonomistit të mirë”. Gjithashtu, shprehja “ekonomistit të mirë” është një nocion abstrakt të cilit gjykata do të duhej ti japë shpirt në secilin rast konkret, dhe atë duke e vlerësuar sjelljen që një ndërmjetësuesi profesionist do të duhej të tregonte

686 Në lidhje me këtë qasje shih komentimin e Nenit 835 të LMD-së më lartë.

687 Në lidhje me këtë shih komentimin e dispozitave të Nenit 20 të LMD-së.

në rrethanat e rastit që vlerësohet; kështu, psh. lehtësisht do të mund të argumentohet se një ndërmjetësues ka dështuar të sillet sipas standardit të ekonomistit të mirë nëse ka ditur ose është dashur të dijë se po ndërmjetëson lidhjen e kontratës me palën e tretë e cila ka rënë në krizë financiare, është pranë falimentimit, ose ka rënë në varfëri; ose nëse ndërmjetësimi është bërë duke e shkelur sekretin afarist të urdhërdhënësit, ashtu që ndërmjetësuesi ia ka komunikuar palës së tretë përmbajtjen e urdhrit për ndërmjetësim, etj. Në kuptim të kësaj, ndërmjetësi ka për detyrim që si profesionist të ndërmerr të gjitha veprimet e mundshme në kuptim të zbatimit të urdhrave të urdhërdhënësit dhe gjetjes së një partneri të përshtatshëm për urdhërdhënësin për lidhjen e kontratës.

839.2. Varësisht nga përmbajtja e urdhrit të urdhërdhënësit, i cili ka mund të pranohet nga ndërmjetësuesi, në kuptim të paragrafit të dytë të Nenit në fjalë, nëse ndërmjetësuesi posaçërisht është urdhëruar, ai mundet edhe të marrë pjesë dhe të negocioj ndërmjet palëve me qëllim të lidhjes së kontratës finale. Në kuptim të kësaj, kur ndërmjetësuesi merr pjesë dhe ndërmjetëson gjatë negociatave, ai sigurisht ka për qëllim që të lehtësoj bisedimet-negotiatat ndërmjet palëve, ashtu që ai mund të bëjë edhe propozime, të jap njoftime, të shprehet në lidhje me pikëpamjet e palëve e kështu të ndikoj të palët që ato të mund të vijnë deri të dakordimi për lidhjen e kontratës finale. Në kuptim të kësaj, për rastet kur ndërmjetësuesi futet në negociata dhe ndërmjetëson që të dyja palët në lidhjen e kontratës, për rastet e tilla mendohet se ndërmjetësuesi ka shkuar përtej sjelljes sipas interesave vetëm të urdhërdhënësit të vet, ashtu që në situata të tilla megjithatë ndërmjetësuesi duhet të tregoj një shkallë të caktuar të objektivitetit; përndryshe, nëse ndërmjetësuesi vepron vetëm për interesin e vetëm njërës palë, ai në realitet vepron si agjent i palës.⁶⁸⁸

839.3. LMD, në paragrafi e tretë të këtij Neni themelon se, megjithatë, ndërmjetësuesi nuk do të mbajë përgjegjësi nëse ndërmjetësimi përfundon pa rezultat (pa lidhjen e kontratës), nëse ndërmjetësimi ka qenë i pasuksesshëm edhe përkundër kujdesit të treguar nga ndërmjetësuesi; rrjedhimisht një dështim i tillë nuk do ta bëjë të njëjtin përgjegjës për shpërblimin e dëmit ndaj urdhërdhënësit (megjithëse të njëjtit nuk do ti takoj e drejta në shpërblim në rast të dështimit në sukses).⁶⁸⁹ Përkundrazi, ashtu si u komentua në paragrafin e parë, ndërmjetësuesi do të përgjigjet urdhërdhënësit për mos-përmbushjen e kontratës së ndërmjetësimit (dhe eventualisht shpërblimin e dëmit), në qoftë se ndërmjetësuesi nuk ishte sa duhet i kujdesshëm në udhëheqjen me ndërmjetësimin.

688 Shih në lidhje me këtë pikëpamje kërkesat e Nenit 846.2 të LMD-së dhe komentimin e të njëjtit më poshtë.

689 Në lidhje me këtë shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 415 - 416.

Neni 840. Detyrimi i njoftimit

Ndërmjetësuesi ka për detyrë ta njoftojë urdhërdhënësin për të gjitha rrethanat, për të cilat ai është në dijeni ose duhej të ishte në dijeni dhe për punën e synuar dhe ato rrethana janë me rëndësi.

840. Ndërmjetësuesi, që të bëjë ndërmjetësimin më të mirë për nevojat e urdhërdhënësit, duhet të jetë i pajisur me informata relevante, e të cilat ai duhet ti ndaj me urdhërdhënësin, me qëllim që urdhërdhënësi të bëjë zgjedhjen e duhur të palës së tretë, ose zgjedhjen e duhur për lidhjen e kontratës që dëshiron. Sot, duke e pas parasysh shpejtësinë e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, e sidomos edhe kompleksitetin e tregjeve, argumentohet se informata e shpejte dhe e saktë është një resurs i madh ekonomik i cili determinon suksesin, çka tregon rëndësinë që ndërmjetësi të ketë qenë i mirinformuar dhe që informatat relevante t'i ketë ndarë me urdhërdhënësin. Kështu, në kuptim të Nenit 840 të LMD-së, ndërmjetësi ka për obligim të njoftojë urdhërdhënësin për të gjitha rrethanat që mund të jetë me interes për atë e më qëllim që ai të bëjë vendime të drejta në lidhje me fatin e punëve juridike ose kontratave që ndërmerr me palë të treta; gjegjësisht ndarjen e informatave me urdhërdhënësin të cilat janë relevante për qëllimin e ndërmjetësimit dhe me interes për urdhërdhënësin. Sigurisht, ka argumente në shkencën juridike që argumentojnë se ndërmjetësi duhet të jetë aktiv në hulumtimin e tregut (gjegjësisht shërbimeve të cilat i ofron) dhe ai nuk mund të thirret në mos-dijeninë e tij për informatat relevante, e të cilat kanë qenë nga fusha e tij e specializimit - shërbimit; me fjalë të tjera do të mund të përfundohet se, megjithatë, ndërmjetësi do të mund të thirret në përgjegjësi edhe për mos-ndarjen e informatave relevante të cilat nuk i ka ditë, por si profesionist ai është dashur të jetë i informuar për të njëjtat (mosveprimi me standardin e ekonomistit të mirë - profesionistit në ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit).⁶⁹⁰

Neni 841. Përgjegjësia e ndërmjetësuesit

- 1. Ndërmjetësuesi përgjigjet për dëmin, të cilin do ta pësonte njëra ose tjetra palë ndërmjet të cilave ka ndërmjetësuar e që do të shkaktohej për arsye se ka ndërmjetësuar për personin e paaftë për punë, për paaftësinë e të cilit ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni, ose për personin për të cilin ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni, se nuk do të mund t'i kryejë detyrimet nga kjo kontratë dhe në përgjithësi për çdo dëm të shkaktuar me fajin e tij.**
 - 2. Ndërmjetësuesi përgjigjet për dëmin që do të shkaktohej për urdhërdhënësin për arsye se pa lejen e urdhërdhënësit e ka njoftuar ndonjë person të tretë për përmbajtjen e urdhrit, për negociata ose për kushtet e lidhjes së kontratës.**
-

841.1. Ashtu si u komentua në nenet më sipër, ndërmjetësuesi duhet të ofroj shërbimin e ndërmjetësimit me standardin e sjelljes së “profesionistit - ekonomistit të mirë” dhe të ruaj

690 Shih në lidhje me këtë edhe: Gigoj, Stojan, Detyrimet, Lubjanë, 1978, fq.696;

konfidencialitetin e palëve. Kjo do të thotë se ndërmjetësuesi gjatë ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit, ose veprimit sipas urdhrave të urdhërdhënësit duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm. Nëse lëshon këtë standard të sjelljes dhe shkakton ndonjë dëm cilëso palë në ndërmjetësim, ai mund të thirret në përgjegjësi për shpërblimin e dëmit. Sigurisht, ndërmjetësuesi përgjigjet për shpërblimin e dëmit nëse veprimet e tij paraqesin sjellje të neglizhencës ose pakujdesi në ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit. Rrjedhimisht, ashtu si saktëson edhe paragrafi i parë i Nenit 841 të LMD-së, ndërmjetësuesi do të përgjigjet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nëse ka ndërmjetësuar me personin e paaftë për të vepruar. Ndërmjetësuesi do të përgjigjet mbi këtë bazë nëse e ka ditë, ose nga rrethanat e rastit ka qenë dashur të dijë se po ndërmjetëson me personin e paaftë për të vepruar; ose që ndërmjetësuesi do të përgjigjet për shpërblimin e dëmit nëse ndërmjetëson dhe e vënë në kontakt urdhërdhënësin me personin e tretë insolvent (ose në prag të falimentimit), ashtu që nga rrethanat e rastit ai ka ditë, ose ka qenë dashur të dijë për pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të palës së tretë ndaj urdhërdhënësit (konsiderohet se ndërmjetësuesi ka obligim që urdhërdhënësi ti propozoj mundësi ose partner të përshtatshëm për lidhjen e kontratave, ose në ushtrimin e punëve të biznesit).

Ndërmjetësuesi do të përgjigjet për shpërblimin e dëmit çoftë urdhërdhënësit, ose çoftë palës së tretë edhe në rastet tjera kur mund të provohet se dëmi ka qenë pasojë e veprimeve të fajshme të ndërmjetësuesit. Kjo do të mund të ishte rasti kur ndërmjetësi vepron në kundërshtim me praktikën e mirë të punës - profesionistit, ose kur veprimet e tij paraqesin pasoja të dëmshme për palët (kur ndërmjetësuesi lëshon standardet e kujdesit të duhur si profesionist në shërbimin e tij). Megjithatë, për situatën kur pretendohet se dëmi është pasojë e veprimeve të fajshme të ndërmjetësimit, ndërmjetësi mund të lirohet nga detyra e shpërblimit të dëmit nëse provon se dëmi nuk ka qenë pasojë e veprimeve të tij, ose që dëmi ka qenë pasojë e rrethanave që nuk kanë qenë nën kontrollin e tij.⁶⁹¹

841.2. Ashtu si u komentua në nenet më sipër, ndërmjetësuesi duhet të ofroj shërbimin për urdhërdhënësin në mirëbesim dhe të mbajë në konfidencë të gjitha informatat e mësuara gjatë ose në lidhje me ndërmjetësimin. Detyra e mbajtjes në konfidencë dhe e ruajtjes së sekreteve të mësuara gjatë ofrimit të shërbimeve është një detyrë e përgjithshme e ndërmjetësuesit, e cila është përtej përcaktimit kontraktual të detyrimeve të ndërmjetësuesit. Ndërmjetësuesi duhet të mbajë këto informata në konfidencë jo vetëm gjatë ekzistimit të raportit kontraktues, por edhe pasi të jetë përfunduar raporti kontraktues i ndërmjetësimit. Paragrafi i dytë i Nenit 841.2 shprehimisht i referohet shkëljes së konfidencialitetit të ndërmjetësuesit në lidhje me përmbajtjen e urdhrave, negociatave, ose zbulimit të paautorizuar të kushteve për lidhjen e kontratës; megjithatë, detyrimi i ndërmjetësuesit shtrihet edhe përtej asaj dhe nënkupton edhe informatat tjera konfidenciale ose sekretin afarist të cilin e ka mësuar nga urdhërdhënësi gjatë ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit. Në kuptim të kësaj, ndërmjetësuesi mund të mbahet përgjegjës nëse ka shkelë detyrimin e konfidencialitetit ndaj urdhërdhënësit dhe rrjedhimisht të përgjigjet edhe për shpërblimin e dëmit të cilin ia ka shkaktuar të njëjtit me këtë rast.

691 Shih në lidhje me mundësinë që ndërmjetësi të provojë se dëmi nuk ka qenë pasojë e veprimeve të tij, për më shumë shih komentimin e Nenit 136.1 të LMD-së.

Neni 842. Ditari ndërmjetësues dhe fleta

Ndërmjetësuesi ka për detyrë në regjistrin e veçantë (ditari ndërmjetësues) t'i shënojë të dhënat thelbësore për kontratën që është lidhur me ndërmjetësimin e tij dhe të lëshojë ekstraktin nga ky regjistër të nënshkruar nga ana e tij (fleta e ndërmjetësimit).

842. Një detyrë e veçantë e ndërmjetësuesit është që në lidhje me ndërmjetësimin të udhëheqë me ditarin e ndërmjetësimit, ditarë në të cilin kryesisht përshkruhen kontratat të cilat janë lidhë me ndërmjetësimin e tij, si dhe karakteristikat kryesore të përmbajtjes së kontratave të ndërmjetësuar; e që në lidhje me përmbajtjen e ditarit të ndërmjetësimit ndërmjetësi ti lëshoj urdhërdhënësit të tij ekstraktin përkatës të pjesës së ditarit të ndërmjetësimit, të nënshkruar nga ndërmjetësi. Në praktikën juridike bisedohet për korrektësinë që ndërmjetësuesi duhet të tregoj në lidhje me udhëheqjen e ditarit të ndërmjetësimit, për faktin që ndërmjetësuesi të pasqyroj rrjedhën e lidhjeve të kontratave në ditarin (regjistrin) e ndërmjetësimit sipas një rendi kronologjik, duke e pajisur me një numër rendorë secilën kontratë ose veprim ndërmjetësimi që e ndërmerr, ashtu që shënimet në ditarin e ndërmjetësimit t'i përgjigjen kohës në të cilën kontratat e ndërmjetësuar janë lidhë, ose punët në lidhje me të cilat janë ndërmarrë. Ditari i ndërmjetësimit jo vetëm që përshkruan faktin se një kontratë është lidhur, por ai duhet të pasqyroj edhe disa të dhëna themelore si psh. informata në lidhje me identitetin e palëve kontraktuese, përshkrim për llojin e mallit - sasinë dhe cilësinë, lartësinë e çmimit dhe mënyrën e pagesës, afatin e liferimit, mjetet siguroese, etj. Krahas që ndërmjetësuesi duhet të mbajë dhe përditësoj ditarin e ndërmjetësimit, ai duhet t'iu lëshoj pjesëmarrësve në ndërmjetësim edhe ekstraktin e ditarit të ndërmjetësimit, e që i njëjti duhet të jetë identik me pjesën e ditarit të ndërmjetësimit ku përshkruhet veprimi i ndërmjetësuar dhe që mbartë edhe nënshkrimin e ndërmjetësuesit. Udhëheqja me ditarin e ndërmjetësimit dhe lëshimi i ekstraktit të ndërmjetësimit për klientin kanë një fuqi të rëndësishme provuese si për faktin se kontrata është lidhë dhe përshkruhet përmbajtja e saj, ashtu edhe për faktin se tregohet se kontrata është lidhë me ndërmjetësim.

KREU 3

DETYRIMET E URDHËRDHËNËSIT

Neni 843. Shpërblimi

- 1. Ndërmjetësuesi ka të drejtë për shpërblim edhe kur ky nuk është kontraktuar.**
- 2. Në qoftë se lartësia e shpërblimit nuk është caktuar as me tarifë ose me ndonjë akt tjetër të përgjithshëm, as me kontratë as me doke, atë do ta caktojë gjykata sipas mundit të ndërmjetësuesit dhe shërbimit të bërë.**

- 3. Shpërblimin e kontraktuar të ndërmjetësimit gjykata mund ta zbresë me kërkesën e urdhërdhënësit, në qoftë se gjen se është tepër i lartë, duke marrë parasysh mundin dhe shërbimin e bërë.**
- 4. Zbritja e shpërblimit të kontraktuar nuk mund të kërkohe në qoftë se i është paguar ndërmjetësuesit pas lidhjes së kontratës për të cilën ai ka ndërmjetësuar.**

843.1. Si kundërvlerë për pranimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, urdhërdhënësi i paguan ndërmjetësuesit shpërblimin përkatës. Kryesisht shpërblimi që i paguhet ndërmjetësit kontraktohet në një shumë të caktuar në të holla, por ai mund të kontraktohet edhe në natyrë (vlera tjera pasurore). Kryesisht, pagesa e shpërblimit është detyrimi themelor i urdhërdhënësit, ashtu që rëndom, si lartësinë, ashtu edhe mënyrën e pagesës palët e saktësojnë me kontratë. Rëndom, për punën e kryer në lidhje me kontratën për ndërmjetësimin, ndërmjetësuesit i takon e drejta në shpërblim. Paragrafi i parë i Nenit 843 të LMD-së saktëson se ndërmjetësuesit i takon e drejta në shpërblim edhe në qoftë se palët të njëjtin nuk e kanë përfshirë në kontratë, ose nëse të njëjtin palët nuk e kanë specifikuar me kontratë. Mendohet se arsyeja e kësaj zgjidhje ligjore bazohet në faktin se kryerja e punëve të ndërmjetësimit bazohet në angazhimin e profesional të ndërmjetësuesit, të cilin shërbim në të shumtën e rasteve ndërmjetësuesi e ushtron si aktivitet afarist - për qëllim të fitimit, ashtu që ushtrimi i këtij shërbimi nga i njëjti kërkon një sjellje të ndërmjetësuesit mjaftë të kujdesshme dhe me përgjegjësi të lartë profesionale në ofrimin e shërbimeve ndaj urdhërdhënësit të tij; kështu që kjo si më lartë është një nga arsyet që shkaktojnë supozimin e të drejtës që ndërmjetësuesi të kërkoj pagimin e shpërblimit për shërbimin e ofruar.

843.2. Shpërblimin, çoftë saktësimin e llojit dhe lartësisë së tij, që rëndom urdhërdhënësi duhet t'ia paguaj ndërmjetësuesit, palët e caktojnë me marrëveshje, ose shpërblimi caktohet me tarifë. në mungesë të marrëveshjes, ose tarifës, gjykata, në lidhje me saktësimin e shpërblimit mund të marr në konsideratë edhe doket afariste të vendit përkatës, duke i konsideruar edhe rrethanat e rastit në kuptim të përcaktimit adekuat të vëllimit të shpërblimit. Për rastet kur shpërblimi nuk caktohet as me kontratë, as me tarifë, e as në bazë të dokeve nuk mund të nënkuptohet lartësia e shpërblimit, atëherë paragrafi i dytë i Nenit në fjalë saktëson se lartësinë e shpërblimit e cakton gjykata sipas mendimit të saj të lirë, e në formimin e mendimit të saj për këtë situatë gjykata duhet të ketë në konsideratë mundin e shpenzuar të ndërmjetësuesit dhe shërbimin e bërë (gjegjësisht rezultatit e arritur, psh. suksesin në lidhjen e kontratës, etj).

843.3. Në parim LMD respekton parimin e lirisë së kontraktimit të palëve në kuptim të caktimit të shpërblimit dhe saktësimin të vëllimit të shpërblimit. Shpeshherë në praktikë ndodhë që shpërblimi të caktohet me tarifën e aplikueshme nga ndërmjetësuesi ose zyra e ndërmjetësuesit për shërbimet përkatëse, ashtu që nganjëherë ka shumë pak hapësirë që urdhërdhënësi të negocioj lartësinë ose vëllimin e shpërblimit. Në rastet e tilla kur shpërblimi caktohet me tarifë, urdhërdhënësi ka të drejtë që shkalla e tarifës të jetë e arsyeshme dhe në përpjesëtim me shërbimet që i ofron ndërmjetësuesi. Në kuptim të kësaj, edhe përkundër

respektimit të vullnetit të palëve në kontraktimin e shpërblimit, LMD përjashtimisht ka rregulluar se me kërkesën e palës (rëndom urdhërdhënësit) gjykata mund ta ulë shpërblimin për rastet nëse mund të argumentohet se shpërblimi është tepër i lartë në raport me mundin e ndërmjetësuesit dhe shërbimin e bërë (rezultatit e arritur).

843.4. Edhe përkundër mbrojtjes ligjore të urdhërdhënësit (në kuptim të lartësisë së shpërblimit) të mundësuar nga paragrafi i tretë i këtij Neni, mbrojtja e ofruar nga paragrafi i tretë i Nenit në fjalë nuk është e aplikueshme nëse veç i është paguar shpërblimi ndërmjetësuesit. Në kuptim të paragrafit të katërt të Nenit 843 të LMD-së, e drejta e urdhërdhënësit në uljen e shpërblimit mund të realizohet vetëm nëse shpërblimi akoma nuk i është paguar ndërmjetësuesit.

Neni 844. Kur ndërmjetësuesi fiton të drejtën e shpërblimit

- 1. Ndërmjetësuesi fiton të drejtën e shpërblimit në momentin e lidhjes së kontratës për të cilën ka ndërmjetësuar, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.**
- 2. Në qoftë se kontrata është lidhur nën kushtin suspensiv (shtytës), ndërmjetësuesi fiton të drejtën e shpërblimit vetëm kur kushti realizohet.**
- 3. Kur kontrata është lidhur nën kushtin zgjidhës, realizimi i kushtit nuk ka ndikim në të drejtën e ndërmjetësuesit në shpërblim.**
- 4. Në rastin e pavlefshmërisë së kontratës, ndërmjetësuesi ka të drejtë në shpërblim në qoftë se për shkakun e pavlefshmërisë nuk ishte në dijeni.**

844.1. Ndërmjetësuesi, në kontratën për ndërmjetësimin, merr detyrimin që për urdhërdhënësin e tij të hulumtoj në gjetjen e një partneri të përshtatshëm kontraktues, e gjithashtu eventualisht të ndërmjetësoj në lidhjen e kontratës përfundimtare. Parimisht, konsiderohet se ndërmjetësuesi e ka përfunduar detyrimin e tij kontraktual në momentin që urdhërdhënësi ka lidhë kontratën e ndërmjetësuar me palën e tretë. Parimisht, momenti i lidhjes së kontratës së ndërmjetësuar është edhe momenti kur ndërmjetësuesi mund të kërkoj pagimin e shpërblimit, përveç nëse palët kanë kontraktuar diçka tjetër. Parimisht, konsiderohet se ndërmjetësuesi nuk e ka kryer detyrën me sukses dhe rrjedhimisht nuk ka të drejtë në shpërblim nëse lidhja e kontratës së ndërmjetësuar ka dështuar. Gjithashtu, ndërmjetësuesi nuk garanton suksesin se pala e tretë me të cilin është lidhë kontrata e ndërmjetësuar do të përmbushë detyrimet e saja (ky mund të jetë rasti vetëm nëse ndërmjetësuesi me rastin e përzgjedhjes së palës së tretë ka lëshuar standardin e kujdesit të ekonomistit të mire - psh. ka ndërmjetësuar lidhjen e kontratës me palën që ka rënë në insolvencë, ndërsa ka ditur ose ka qenë dashtë të dijë për insolvencën e palës).⁶⁹² Megjithatë, LMD (paragrafi 1 i Nenit 844) iu

692 Në teori dhe në legjislacione të ndryshme bëhet fjalë për tri momente të ndryshme për fitimin e të drejtës në shpërblim të ndërmjetësuesit. Sipas mendimit të parë, ndërmjetësuesi e fiton të drejtën në shpërblim me rastin e vënies në kontakt të urdhërdhënësit me palën e tretë (sipas kësaj pikëpamje nuk është me rëndësi nëse bisedimet do të përfundojnë me sukses dhe lidhet kontrata). Sipas pikëpamjes së dytë, për fitimin e të drejtës së ndërmjetësuesit duhen rezultate të caktuara, e kjo është

lejon palëve që të njëjtat të merren vesh me kontratë edhe ndryshe në lidhje me zgjedhjen e çështjes së të drejtës së ndërmjetësuesit në pagimin e shpërblimit.

844.2. Palët mund të hyjnë në një kontratë nën kushtin shtytës, ashtu që të kushtëzojnë efektin e kontratës me plotësimin e kushtit shtytës. Nëse ashtu është kontraktuar, atëherë fati i kontratës dhe efekti i saj varet nga paraqitja ose mos-paraqitja e rrethanës së ardhshme dhe të pasigurt, ashtu që nëse kushti plotësohet kontrata quhet së është lidhë që nga fillimi; në të kundërtën, nëse kushti nuk është plotësuar konsiderohet se kontrata nuk është lidhë fare.⁶⁹³ Një formë e tillë e kontraktimit ka efekt edhe në marrëdhënien me ndërmjetësuesin, nëse kontrata lidhet me ndihmën e ndërmjetësuesit. Nëse është ky rasti, ndërmjetësuesit i takon e drejta në shpërblim vetëm nëse realizohet me sukses kushti; ashtu që nëse nuk ndodh kushti, konsiderohet se kontrata nuk është lidhë fare, si dhe se ndërmjetësimi rrjedhimisht ka qenë i pasuksesshëm.

844.3. Palët mund të hyjnë në një kontratë nën kushtin zgjidhës, ashtu që të kushtëzojnë përfundimin e kontratës me plotësimin e kushtit zgjidhës. Nëse ashtu është kontraktuar, atëherë fati i kontratës dhe efekti i saj varet nga paraqitja ose mos-paraqitja e rrethanës së ardhshme dhe të pasigurt, ashtu që nëse kushti plotësohet kontrata quhet së është zgjidhur.⁶⁹⁴ Për dallim nga rasti nga paragrafi i dytë i të njëjtit Nen, nëse kontrata lidhet nën kushtin zgjidhës, një formë e tillë e kontraktimit nuk ka efekt në marrëdhënien me ndërmjetësuesin. Nëse është ky rasti, ndërmjetësuesit i takon e drejta në shpërblim pavarësisht nëse kushti zgjidhës paraqitet në të ardhmen, ose jo. Konsiderohet se kontrata e ndërmjetësuar me sukses është lidhur, andaj ndërmjetësuesit nga ai moment i takon e drejta në shpërblim, pasi që edhe kontrata nga momenti fillestar fillon të prodhoj efekte juridike. Në këtë kuptim, paraqitja e kushtit zgjidhës në të ardhmen nuk ndikon në të drejtën e ndërmjetësuesit që të kërkoj shpërblimin për shërbimin e dhënë.

844.4. Paragrafi i fundit i Nenit 844 të LMD-së rregullon se ndërmjetësuesit do t'i takoj e drejta në shpërblim edhe për rastet kur kontrata e ndërmjetësuar është anuluar (qoftë kjo shkak i nulitetit absolut ose relativ), me kushtin që ndërmjetësuesi nuk ka pas njohuri për shkakun e pavlefshmërisë. Sigurisht, është princip i secilës palë në marrëdhëniet e detyrimeve të veproj në mirëbesim dhe të jetë e ndërgjegjshme për veprimet e tij/saj; rrjedhimisht konsiderohet se nëse ndërmjetësuesi ka ditë për shkakun e pavlefshmërisë së lidhjes së kontratës, atëherë ndërmjetësuesi nuk do të ketë të drejtë të kërkoj shpërblimin për ndërmjetësimin e ofruar.⁶⁹⁵

ndërmjetësimi në suksesin e lidhjes së kontratës. Ndërsa sipas pikëpamjes së tretë, ndërmjetësuesi e fiton të drejtën në shpërblim vetëm kur pala e tretë përmbushë detyrimet ndaj urdhërdhënësit nga kontrata e ndërmjetësuar. Më shumë në lidhje me këto pikëpamje shih edhe: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 418 - 419.

693 Shih më shumë në lidhje me kontratat që lidhen me kushtin shtytës komentimin e Nenit 59 të LMD-së.

694 Shih më shumë në lidhje me kontratat që lidhen me kushtin zgjidhës komentimin e Nenit 59 të LMD-së.

695 Për më shumë në lidhje me nulitetin e kontratave (qoftë nulitetin absolut ose relativë të kontratave) shih komentimin e Nenit 89 dhe Nenit 97 të LMD-së.

Neni 845. Shpërblimi i shpenzimeve

- 1. Ndërmjetësuesi nuk ka të drejtë në shpërblimin e shpenzimeve të bëra në kryerjen e urdhrat, përveç kur kjo është kontraktuar.**
 - 2. Në qoftë se me kontratë është e njohur e drejta e shpërblimit të shpenzimeve, ai ka të drejtë në këtë shpërblim edhe në rastin kur kontrata nuk është lidhur.**
-

845.1. Ndërmjetësuesi gjatë ekzekutimit të urdhrave të urdhërdhënësit rëndom mund të pësoj edhe shpenzime të caktuara. Konsiderohet se ndërmjetësuesi ushton aktivitetin e ndërmjetësimi si një profesionist, ashtu që në shpërblimin që i paguan urdhërdhënësi ai ka kalkuluar edhe shpenzimet eventuale të cilat do të mund t'i shkaktohen në lidhje me ofrimin e shërbimeve përkatëse të ndërmjetësimi. Në kuptim të këtij qëndrimi, konsiderohet se ndërmjetësuesi nuk ka të drejtë të kërkoj shpërblim të posaçëm për shpenzimet e shkaktuara, përpos shpërblimit të kontraktuar, ose shpërblimit të caktuar për shërbimin e ofruar.

Përfundimisht, në raste të veçanta, ndërmjetësuesi mund të ketë shpenzime që tejkalojnë kostot e zakonshme të shpenzimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimi. Me qëllim të përbalimit të këtyre kostove të veçanta (të larta) palët mund të merren vesh që të njëjtat të paguhen - mbulohen nga urdhërdhënësi (këtë e mundëson edhe paragrafi i parë i Nenit 845 të LMD-së). Marrja përsipër e shpenzimeve të ndërmjetësimi duhet posaçërisht të saktësohet me kontratën e ndërmjetësimi, përndryshe shpenzimet do të ngelin të pa-inkasuara nga ndërmjetësuesi. Në kuptim të këtij përfundimisht, ndërmjetësuesi do të mund të mos ketë të drejtë t'i inkasoj shpenzimet e ndërmjetësimi edhe për rastet kur kjo mundësi shprehimisht është kontraktuar, nëse i njëjti ka vepruar në kundërshtim me urdhrat e urdhërdhënësit, ose në kundërshtim me interesat e urdhërdhënësit punon për palën tjetër.⁶⁹⁶

845.2. Në kuptim të njohjes së të drejtës së ndërmjetësuesit që të kërkoj rimbursimin e shpenzimeve të shkaktuara, kjo përfundimisht nëse palët ashtu kanë kontraktuar, LMD në paragrafin e dytë të të njëjtit Nen rregullon se kjo e drejtë i takon ndërmjetësuesit edhe atëherë kur ndërmjetësimi ka dështuar pa lidhjen e kontratës përfundimtare. Mendohet se kjo zgjidhje juridike është e nënkuptueshme pasi që palët shprehimisht kanë kontraktuar këtë mundësi, duke e pas në konsiderim shpenzimet e mëdha (jo të zakonshme) të cilat do t'i shkaktohen ndërmjetësuesit gjatë ndërmjetësimi.

.....
696 Për më shumë në lidhje me humbjen e të drejtës në shpërblim, gjegjësisht humbjen edhe të së drejtës së mbulimit të shpenzimeve të shkaktuara me ndërmjetësim shih komentimin e Nenit 847 të LMD-së (më poshtë).

Neni 846. Ndërmjetësimi për të dy palët

- 1. Në qoftë se nuk është kontaktuar ndryshe, ndërmjetësuesi që e ka marrë urdhrin për ndërmjetësim nga të dy palët mund të kërkojë nga secila palë vetëm gjysmën e shpërblimit të ndërmjetësit dhe shpërblimin e gjysmës së shpenzimeve, në qoftë se shpërblimi i shpenzimeve është kontraktuar.**
- 2. Ndërmjetësuesi ka për detyrë që me kujdesin e ekonomistit të mirë të kujdeset për interesat e të dy palëve, ndërmjet të cilave ai ndërmjetëson.**

846.1. Vet kuptimi i kontratës për ndërmjetësimin duket se lejon mundësinë që ndërmjetësuesi të veproj si ndërmjetësues i që të dyja palëve që lidhin kontratën, ose që negociojnë në lidhjen e kontratës. Kështu, nëse ndërmjetësuesi vepron sipas urdhrin të të dyja palëve, atëherë që të dyja palët kanë obligim ndaj ndërmjetësuesit që të njëjtit ti paguajnë shpërblimin përkatës, sigurisht nëse janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të neneve të diskutuara më lartë (kryesisht lidhja me sukses e kontratës që ndërmjetësohet). Nëse ky është rasti dhe është lidhë kontrata që ndërmjetësohet, atëherë secili nga urdhërdhënësit (që të dyja palët në kontratë) kanë për obligim që ndërmjetësuesit ti paguajnë nga gjysmën e pjesës në emër të shpërblimit që i takon ndërmjetësuesit (pra, detyrimi në pagesës së shpërblimit ndahet ndërmjet që të dy urdhërdhënësve në pjesë të barabarta). Në kuptim të këtij përcaktimi parimor të Nenit 846.1 të LMD-së duket se është edhe teoria dhe praktika juridike në të cilën janë dhënë argumente se ndërmjetësuesit nuk do të duhej ti takonte shpërblim më i lartë se sa do të ishte shpërblimi përkatës për punën e njëjtë të ndërmjetësuar në rrethanat kur ka ndërmjetësuesi ka vepruar vetëm nën urdhrat e njëres palë. Në kuptim të këtij përcaktimi, për rastet kur shprehimisht është kontraktuar që ndërmjetësuesit t'i kompensohen edhe shpenzimet e shkaktuara me rastin e ndërmjetësit, atëherë që të dy urdhërdhënësit obligohen që në proporcion të barabartë të kompensojnë - paguajnë edhe shpenzimet të cilat i janë shkaktuar ndërmjetësuesit.

846.2. Ndërmjetësuesi, për rastet kur vepron në interesin e të dyja palëve, ka për detyrim që në kryerjen e punëve të ndërmjetësit të tregoj kujdesin e ekonomistit të mirë, ashtu që të përkujdeset për mbrojtjen e interesave të të dyja palëve për të cilët ndërmjetëson njëkohësisht; ashtu që i njëjti gjatë ndërmjetësit duhet të tregohet i paanshëm ndaj cilësdo palë që ndërmjetëson. Ndërmjetësuesi në mënyrë të pavarur kryen aktivitetet e veta në emër të vet dhe për llogari të vet, dhe të gjitha palët të treta me të cilat ndërmjetësuesi bie në kontakt duhet të trajtohen me kujdes të njëjtë. Në rast se ndërmjetësuesi dështon të sillet sipas standardit të kërkuar nga paragrafi i dytë i Nenit 846 i LMD-së, ndërmjetësuesi krijon përgjegjësi për vete që të kompensojë dëmin për palën tjetër (ose për palët e treta), dëm i cili ka rrjedhë si rezultat i mos-kujdesit të duhur të treguar gjatë kryerjes së punëve të ndërmjetësit.

Neni 847. Humbja e të drejtës së shpërblimit

Ndërmjetësuesi i cili në kundërshtim me kontratën ose në kundërshtim me interesat e urdhërdhënësit të vet punon për palën tjetër, humb të drejtën e shpërblimit të ndërmjetësimit dhe të shpërblimit të shpenzimeve.

847. Ndërmjetësuesit nuk do ti takoj e drejta në shpërblim, respektivisht e drejta në pagimin e shpenzimeve (nëse pagimi i shpenzimeve posaçërisht është kontraktuar nga palët), nëse ndërmjetësi, në kundërshtim me dispozitat e kontratës për ndërmjetësimin, ose kundër interesave të urdhërdhënësit të tij, punon për palën tjetër kontraktuese. Ndërmjetësuesi mund të përgjigjet edhe për shpërblimin e dëmit me këtë rast nëse provohet se ai i ka komunikuar palës tjetër (pa autorizimin e urdhërdhënësit) përmbajtjen e urdhrit të urdhërdhënësit të tij, ose informatat të rëndësishme rreth zhvillimit të negociatave, ose i ka komunikuar palës tjetër informata në lidhje me kushtet për lidhjen e kontratës.⁶⁹⁷

.....
697 Në lidhje me detyrimin e ndërmjetësuesit për shpërblimin e dëmit shih komentimin e Nenit 841.2 të LMD-së më lartë.

PJESA XIX

KONTRATA PËR SHPEDITIMIN (DËRGIMI)

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 848. Nocioni

- 1. Me kontratën për shpeditimin detyrohet shpedituesi që me qëllim transporti të sendit të caktuar, të lidhë në emër të vet dhe për llogari të urdhërdhënësit kontratën e transportit dhe kontrata të tjera të nevojshme për kryerjen e transportit, si dhe të kryejë punë dhe veprime të tjera të rëndomta, ndërsa urdhërdhënësi detyrohet t'i paguajë shpërblim të caktuar.**
- 2. Në qoftë se me kontratë është paraparë, shpedituesi mund të lidhë kontratën e transportit dhe të ndërmarrë veprime të tjera juridike në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit.**

848.1. LMD, në paragrafin e parë të Nenit 848 të LMD-së saktëson kuptimin e kontratës për shpedicionin. Ashtu si emërtohen edhe nga dispozita ligjore në fjalë, palë në kontratën për shpedicionin janë shpedituesi dhe urdhërdhënësi, sipas kuptimit të së cilës, shpedituesi (me qëllim të transportimit të sendeve-mallrave të urdhërdhënësit), në emrin e vet dhe për llogarinë e urdhërdhënësit lidhë dhe ekzekuton kontrata për transportin (gjegjesisht edhe kontrata tjera të rëndomta të cilat mund të ndërlidhen me qëllimin e transportit të mallrave-sendeve), ndërsa urdhërdhënësi për këtë qëllim të njëjtit i paguan shpërblimin përkatës.

Kontrata për shpeditimin konsiderohet si një kontratë e veçantë komerciale, e cila ka tiparet e saja karakteristike. Në praktikë, (për shkak të ngjashmërive ose ndërlidhjes së afërt të veprimtarive të shpedituesit dhe transportuesit) nganjëherë kontrata për shpeditimin ngatërrohet me kontratën për transportin e mallrave. Konsiderohet se kontrata për shpedicionin është një kontratë e veçantë e cila dallohet nga kontrata për transportimin e mallrave. Subjekt i rregullimit në kontratën për shpeditimin kryesisht janë çështjet në lidhje me (organizimin) e transportimit të mallrave, veprime të cilat ndërmerren nga shpedituesi me qëllim të transportimit të mallrave të urdhërdhënësit. Thuhet se shpedituesi është vetëm organizuesi i transportit, pasi që ai në realitet nuk ekzekuton vet transportin (pra shpedituesi nuk është transportues); në kuptim të kësaj subjekti i rregullimit në kontratën për shpedicionin në realitet është organizimi i transportimit të mallrave për urdhërdhënësin; dhe rrjedhimisht për këtë qëllim shpedituesi ndërmerr një tërësi të veprimeve juridike dhe faktike në emrin e vet e për llogarinë e urdhërdhënësit, e kjo me qëllim të transportimit të mallrave për urdhërdhënësin.

Ashtu si është saktësuar edhe nga dispozita ligjore, shprehjet më të shpeshta për përcaktimin e palëve të kontrata për shpeditimin janë shpedituesi dhe urdhërdhënësi. Shpedituesi është kryesisht një entitet juridik (entitet biznesor) i cili si profesionist ushtron veprimtarinë e shpeditimit dhe ofron shërbime të shpeditimit për urdhërdhënësit (shërbime që kanë për qëllim organizimin e transportit të mallrave). Ndërsa urdhërdhënësi është një person fizik ose juridik që ka nevojë për transportimin e mallrave, ashtu që i njëjti merr shërbimet e shpedituesit të cilat konsistojnë në organizimin e transportit të mallrave për urdhërdhënësin.

848.2. Kryesisht subjekt i shërbimeve të shpeditimit janë ndërmarrja e një tërësie të veprimeve në emrin e vet e për llogari të urdhërdhënësit, e që kanë për qëllim organizimin e transportit të mallrave për urdhërdhënësin. Jo domosdoshmërishtë subjekt i rregullimit të kontratës për shpeditimin duhet të jetë edhe detyrimi i shpedituesit të lidhë kontratën për transportimin e mallrave me palët e treta transportuese në emrin e vet e për llogari të komitentit. Sigurisht, subjektin e përcaktimit të ofrimit të shërbimeve të shpeditimit palët e caktojnë me marrëveshje në kontratën për shpeditimin. Konsiderohet se ekziston një kontratë për shpeditimin edhe atëherë kur palët në kontratë nuk kanë saktësuar detyrimin e shpedituesit që të lidhë kontratën për transportimin e mallrave për urdhërdhënësin e tij. Megjithatë, në rastet më të shpeshta organizimi i transportit (ose shpeditimi) nënkupton edhe lidhjen e kontratës së transportit me palët e treta në emrin e shpedituesit dhe për llogarinë e urdhërdhënësit, si edhe ndërmarrjen e një tërësie të veprimeve tjera juridike ose faktike që mund të ndërlidhen me organizimin e transportit (për këtë të fundit nëse është dhënë pëlqimi i urdhërdhënësit me kontratë).

Si kundërvlerë për ofrimin e shërbimeve të shpeditimit shpedituesit i takon e drejta në shpërblim adekuat. Në rastet më të shpeshta palët me kontratë saktësojnë lartësinë e shpërblimit dhe mënyrën e pagesës së shpërblimit. Megjithatë, palët mund ta referojnë dhe saktësojnë lartësinë e shpërblimit edhe sipas tarifave të aplikuara (publikuara) nga ndërmarrja shpeditore (kjo pasi që shpesh shpërblimi për punën e shpedituesit tarifohet sipas listës së çmimeve të shpedituesit). Konsiderohet se shpedituesi ka të drejtë në shpërblim edhe për rastet kur palët posaçërisht nuk e kanë kontraktuar shpërblimin fare; kjo pasi që shpedituesi konsiderohet se e ushtron veprimtarinë e shpeditimit për interesin adekuat ekuivalent. Në rastet e tilla në saktësimin e lartësisë së shpërblimit gjykata merr për bazë doket afariste, gjegjësisht praktiken eventuale të themeluar ndërmjet vet palëve, ose edhe rrethanat e rastit konkret (tërësinë e shërbimeve të ofruara për urdhërdhënësin, kohën e shpenzuar nga shpedituesi, etj).

Në pikëpamje të formës, LMD nuk vendosë ndonjë barrierë për kontratën për shpeditimin, duke e kualifikuar këtë kontratë si kontratë konsensuale. Megjithatë, në praktiken juridike në lidhje me kontraktimet në ekonomi gjithnjë e më tepër kontratat komerciale ekzekutohen në një formë të shkruar, gjegjësisht edhe formë elektronike e cila lejon që palët të mund të ruajnë dhe të dokumentojnë përmbajtjen e kontratës; përfshirë në këtë dukuri edhe kontratat për shpeditimin. Ekzekutimi i kontratave në formë shkresore, ose në formë të dokumenteve (ose edhe në formë elektronike, ku përmbajtja e kontratës mund të ruhet në një format të

përshtatshëm), gjithmonë po argumentohet se është një domosdoshmëri dhe kulturë juridike e cila më së miri i shërben interesave të palëve dhe sigurisë së transaksionit (pasi që me përpikëri ruhet përmbajtja e kontratës e cila mund të jetë vendimtare gjatë ekzekutimit të detyrimeve reciproke të palëve, apo edhe në rast të kontestit eventual palët mund të përdorin format shkresore me qëllim të verifikimit dhe të të provuarit të përmbajtjes së kontratës).

Neni 849. Heqja dorë nga kontrata

Urdhërdhënësi mund të heqë dorë nga kontrata sipas vullnetit të vet, por në këtë rast ka për detyrë t'i shpërblejë shpedituesit të gjitha shpenzimet që ka pasur gjer atëherë dhe t'i paguajë pjesën proporcionale të shpërblimit për punën e deriatëhershme.

849. Kontrata për shpeditimin është kontratë e cila në besimin reciprok të palëve kontraktuese, gjegjësisht në besimin të cilin urdhërdhënësi e bartë të shpedituesi, e më qëllim që ky i fundit të ushtroj veprime juridike ose faktike në emrin e vet e për llogari të urdhërdhënësit, e që ndërlidhen me shpedicionin. Në momentin e kontraktimit, varësisht nga emri i mirë i biznesit ose përvoja e mëhershme me shpedituesin, urdhërdhënësi i kalon të njëjtit një shkallë të caktuar të pushtetit që shpedituesi të mund të ushtroj veprime përkatëse juridike për të njëjtin. Gjatë rrjedhës së raportit të ndërsjellë të palëve, urdhërdhënësi mund të vijë në situata të caktuara praktike të cilat e vejnë në dyshim besimin që i njëjti ka pas për shpedituesin. Kjo pasi që urdhërdhënësi ka bartë një dozë të caktuar të pushtetit në shpedituesin, rëndom, të njëjtin pushtet urdhërdhënësi mund ta revokoj në çdo kohë, ashtu që i njëjti të deklaron se heqë dorë nga raporti kontraktues i mëtejme. Të drejtën e urdhërdhënësit që të heqë dorë nga kontrata për shpeditimin në çdo kohë e ka themeluar Neni 849 i LMD-së; megjithatë në një rast të tillë të shfrytëzimit të kësaj të drejte shpedituesit i takon e drejta në mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara deri në momentin e deklarimit të heqjes dorë nga kontrata, si dhe të drejtën e shpedituesit që të kërkoj pagesën proporcionale të pjesës së shpërblimit e që duhet të jetë ekuivalente me punët - shërbimet e gjeratëhershme të ofruara nga shpedituesi.

Neni 850. Zbatimi i rregullave për kontratën e komisionit përkatësisht të përfaqësimit tregtar

Ndaj marrëdhënieve të urdhërdhënësit dhe shpedituesit që nuk janë rregulluar sipas kësaj pjese zbatohen përshtatshëmish rregullat për kontratën e komisionit, përkatësisht të përfaqësimit tregtar.

850. Kontrata për shpeditimin ka mjaft ngjashmëri me kontratën për komisionin dhe kontratën për përfaqësimin tregtar. Pasi që ngjashëm si komisionari që vepron të kontrata për komisionin, edhe shpedituesi të kontrata për shpedicionin vepron në emrin e tij e për llogari të urdhërdhënësit; për shkak të kësaj ngjashmërie kontrata për shpeditimin nganjëherë quhet

në praktikë edhe kontratë për komisionin në transport (ose komisioni për transportimin e mallit). Ngjajshmeitë e kontratës për shpeditimin vërehen edhe në raport të saj me kontratën për përfaqësimin tregtar. Andaj, nën ndikimin e ngjajshmërive ndërmjet kontratave në fjalë, Neni 850 i LMD-së ka rregulluar që, në rast të mungesës së dispozitave për kontratën për shpeditimin, për marrëdhënien e tillë përshtatshëmish të zbatohen dispozitat e LMD-së të cilat vlejné për kontratën për komisionin, respektivisht edhe dispozitat që vlejné për kontratën për përfaqësimin tregtar. Sigurisht, aplikimi i dispozitave të kontratave në fjalë mund të vij në shprehje vetëm për rastet kur LMD nuk ka adresuar çështjen e dhënë në këto rregulla të kësaj pjese për kontratën për shpeditimin, ose nëse palët çështjen në fjalë nuk e kanë rregulluar ose adresuar me rregulla të kontraktuara. Kjo pasi që, rregullat e kontratës për shpeditimin janë rregulla kryesisht të natyrës dispozitive, andaj palët sigurisht mund të kontraktajnë edhe ndryshe nga kjo çka ka rregulluar LMD për këtë kontratë. Në lidhje me kuptimin e rregullave të kontratës për komisionin dhe rregullave të kontratës për përfaqësimin tregtar shih më lartë në pjesën adekuate komentimin e të njëjtave.

KREU 2

DETYRIMET E SHPEDITUESIT

Neni 851. Tërheqja e vërejtjes për të metat e urdhrit

Shpedituesi ka për detyrë t'ia tërheqë vërejtjen urdhërdhënësi për të metat në urdhrin e tij, sidomos për ato që i ekspozojnë të ketë shpenzime më të mëdha ose të pësojë ndonjë dëm.

851. Siç u tha në nenin paraprak kontrata për shpeditimin është kontratë e cila në lidhet me besimin reciprok të palëve kontraktuese, gjegjësisht në besimin të cilin urdhërdhënësi e bartë tek shpedituesi. Në këtë kuptim, Neni 851 i LMD-së themelon përgjegjësinë dhe saktëson detyrimin e shpedituesit që shpedituesi si profesionist të vlerësoj përmbajtjen e urdhrave të urdhërdhënësit, ashtu që posa të vërej ndonjë të metë në urdhrat e tij, e posaçërisht nëse ekzekutimi i urdhrave të urdhërdhënësit ka për pasojë shpenzime (kosto) më të larta, ose ka për pasojë ekspozimin ndaj ndonjë dëmi, për këtë mundësi menjëherë duhet t'ia tërheqë vërejtjen urdhërdhënësit; ashtu që urdhërdhënësit t'i lejohet mundësia që ai edhe njëher të rivlerësoj urdhrat e tij dhe të merr vendime të drejta, gjegjësisht në interesin më të mirë të urdhërdhënësit. Në këtë kuptim shpedituesi është i detyruar që menjëherë të njoftojë urdhërdhënësin për të metat e urdhrit të tij, dhe t'ia tërheqë vërejtjen për dëmet të cilat mund t'i shkaktohen urdhërdhënësit nëse urdhrat e tij ekzekutohen ashtu si është kërkuar nga i njëjti. Në këtë kuptim, shpedituesi menjëherë pas marrjes së urdhrit është i detyruar të bëjë këtë njoftim lidhur me këto të meta, përndryshe në rast të kundërt shpediteri mund të përgjigjet sipas rregullave për shpërblimin e dëmit. Kuptimi i këtij neni kryesisht i është referuar përgjegjësisë së shpedituesit, i cili detyrohet të veprojë me vigjilencë, me kujdesin e ekonomistit të mirë dhe profesionistit të lëmit përkatëse, ashtu që në rastet kur urdhri

përmban mangësi të tilla menjëherë ai do të duhej ta njoftonte urdhërdhënësin. Shpedituesi do të lirohej nga përgjegjësia (dhe do të konsiderohej se ka përmbushur detyrimin e tij sipas këtij Neni), nëse urdhërdhënësi, edhe përkundër njoftimit - tërheqjes së vërejtjes nga shpedituesi, i njëjti insiston në zbatimin urdhrave të tij, nëse ashtu urdhërdhënësi e sheh si të arsyeshme të veprohet nga shpedituesi. Gjithashtu duhet të dihet se urdhrat, direktivat dhe udhëzimet që urdhërdhënësi i jep shpedituesit nuk janë gjithmonë të të njëjtin nivel ose nuk e kanë gjithmonë të njëjtën rëndësi (gjegjësisht të njëjtin karakter detyrues); kështu psh. në rastet kur urdhri i urdhërdhënësit është i natyrës këshillëdhënëse dhe udhëzuese, shpedituesi nuk është i detyruar që të mos devijojë prej atyre. Megjithatë, kur është fjala për urdhrat e karakterit urdhërues të cilat i jep urdhërdhënësi, e të cilët urdhra përmbajnë të meta, ose janë të një natyre të tillë që nuk përkon me interesat e urdhërdhënësit, një shpeditues është i detyruar të këshillojë urdhërdhënësin dhe të njëjtin ta njoftojë dhe t'i tërheqë vërejtjen për të metat e urdhrat të tij.

Neni 852. Tërheqja e vërejtjes për të metat e paketimit

Në qoftë se sendi nuk është paketuar dhe në përgjithësi nuk është bërë gati për transport siç duhet, shpedituesi ka për detyrë t'ia tërheqë vërejtjen urdhërdhënësit për këto të meta, e kur pritja që urdhërdhënësi t'i evitohet do t'i shkaktonte dëm këtij, dërguesi ka për detyrë t'i evitohet në llogari të urdhërdhënësit.

852. Sipas praktikës së punës, në marrëdhëniet reciproke ndërmjet shpedituesit dhe urdhërdhënësit, të njëjtit mund të merren vesh lidhur me punët logjistike të cilat do të kryhen sipas kontratës së shpedicionit. Në këtë kuptim, rëndom me marrëveshje, palët i rregullojnë raportet e tyre reciproke lidhur me udhëzimet dhe këshillat profesionale të shpedituesit në lidhje me mënyrën dhe llojet e paketimit të sendeve, gjithmonë duke pasur parasysh edhe nevojën e transportimit të tyre. Në mungesë të udhëzimeve të qarta në Kontratë, konsiderohet se shpedituesi është person i specializuar dhe profesional në çështjet e organizimit të transportimit të mallrave (përfshirë edhe paketimin e përshtatshëm të mallrave për transportim). Shpedituesi është i obliguar të vlerësojë nëse sendet-mallrat janë paketuar në mënyrë të rregullt, duke vlerësuar kështu nëse paketimi i mallrave mundëson një transport në interesin sa më të mirë të urdhërdhënësit (rëndom, jo vetëm me shpenzime sa më të vogla por edhe të sigurt).

Nga ajo se si është konstruktuar dispozita e Neni 852 të LMD-së, konsiderohet se shpedituesi duhet të marrë mbi vete disa detyrime. Së pari shpedituesi duhet t'i tërheqë vërejtjen urdhërdhënësit për të metat e paketimit të mallit në përgjithësi, ose ta njoftojë urdhërdhënësin për faktin se malli nuk është përgatitur për transport ashtu siç duhet, ashtu që urdhërdhënësin ta këshillojë dhe të merr udhëzime të reja nga i njëjti për evitim të të metave në fjalë. Në rastin e dytë, për rastet kur transportimi i mallrave të urdhërdhënësit nuk duron pritje, ose nëse çfarëdo pritje do të ishte me pasoja të dëmshme për urdhërdhënësin, atëherë shpedituesi, me kujdesin e ekonomistit të mirë - profesionalistit është i detyruar që vet t'i korrigjojë të metat dhe mangësitë e paketimit të sendit-mallit, ose të përgatitjes së mallit për transport.

Në kuptim të përcaktimit të dispozitës ligjore të nenit në fjalë, do të mund të përfundohej se shpedituesi nuk do të barte ndonjë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar në rast të mospaketimit adekuat të mallit, ose mostransportimin e mallit për shkak të mospërgaditjes adekuate të mallit për transport; megjithatë konsiderohet se shpedituesi do të ishte përgjegjës për shpërblimin e dëmit urdhërdhënësit për rastet kur konsiderohet se shpedituesi nuk është sjellë në nivelin e përgjegjësive të nenit në fjalë, gjegjësisht nëse nuk ka bërë njoftimet adekuate për urdhërdhënësin, ose nëse nuk ka ndërmarrë masat emergjente për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit për situatat të tilla që nuk kanë detyruar pritje.

Neni 853. Ruajtja e interesave të urdhërdhënësit

- 1. Shpedituesi ka për detyrë që në çdo rast të veprorë ashtu sikundër e kërkojnë interesat e urdhërdhënësit dhe me kujdesin e ekonomistit të mirë.**
- 2. Ai ka për detyrë ta njoftojë urdhërdhënësin pa shtyrje për dëmtimin e sendeve si dhe për të gjitha ngjarjet me rëndësi për të dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e të drejtave të tij ndaj personit përgjegjës.**

853.1. Shpedituesi, për rastet kur vepron në emrin e vet dhe për llogarinë e urdhërdhënësit ka për detyrim që të kujdeset që veprimet e shpeditimit të kryhen në interesin më të mirë të urdhërdhënësit, ashtu që gjatë ushtrimit të shërbimeve të tija për këtë qëllim duhet të tregoj standardin e kujdesit të ekonomistit të mirë. Ky përcaktim nënkupton detyrimin e shpedituesit që i njëjti, edhe për rastet kur nuk është saktësuar qartë në kontratë se si të veproj, çdoherë është i detyruar të veprorë në përputhje me interesin e urdhërdhënësit; ashtu që si profesionist (ekonomist i mirë) të tregoj kujdes të theksuar për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit. Vlerësimi nëse shpedituesi është sjellë me kujdesin e ekonomistit të mirë çmohet sipas praktikave e mira të biznesit dhe standardeve të sjelljes profesionale të shpedituesit, të njëjtat standarde të çmuara sipas rrethanave të rastit konkret në kuadër të të cilave ka vepruar shpedituesi.

Se cili është interesi më i mirë i urdhërdhënësit, i cili duhet të jetësohet nga shpedituesi, kjo varët shpesh nga përmbajtja e urdhrave të urdhërdhënësit. Urdhërdhënësi është ai i cili e di më së miri se cili është interesi i tij, andaj shpedituesi duhet të veprorë në kuadër të atij interesi. Megjithatë, pasi që shpedituesi është profesionist i organizimit të transportit, ndodhë shpesh që urdhërdhënësi i lenë fleksibilitet të gjerë në përzgjedhjen e veprimeve më të përshtatshme me qëllim të organizimit të transportimit të mallrave për urdhërdhënësin. Në rastin në fjalë, sigurisht, shpedituesi duhet të tregoj kujdesin e profesionistit në vlerësimin se cili është interesi më i mirë i urdhërdhënësit dhe të ndërmarrë veprimet shpedituese nën standardin e kujdesit të ekonomistit të mirë. Shprehja e standardit të sjelljes së shpedituesit, “kujdesi i ekonomistit të mire” është një nocion abstrakt të cilit gjykata do të duhej t’i jap “shpirte” në çdo rast konkret dhe atë duke vlerësuar sjelljen që një shpeditues profesionist do të duhej të ndërmerre në rrethanat e dhëna; kështu psh. lehtësisht mund të argumentohet

që një shpeditues ka dështuar të sillet sipas kujdesit të ekonomistit të mirë nëse ka ditur se rruga nga e cila do të organizohet transporti i sendeve të caktuara është jo e sigurt, ose nëse i njëjti nuk ka treguar kujdes të duhur në uljen e kostos së transportit (edhe pse zgjedhjet e mjeteve tjera transportuese kanë qenë të mundshme), ose nëse mënyra e paketimit të sendeve është bërë në mënyrën jo të përshtatshme për sendet e caktuara etj.

853.2. Përveç detyrimit për të vepruar në përputhje me interesat e klientit sipas paragrafit të parë të Nenit 853 të LMD-së, paragrafi i dytë i të njëjtit Nen themelon detyrimin e shpedituesit që i njëjti menjëherë të informojë urdhërdhënësin për ndonjë dëmtim të pësuar të sendeve të tij, gjegjësisht që të njëjtin ta njoftoj edhe për të gjitha rrethanat dhe aktivitetet të cilat janë me interes të dihen nga urdhërdhënësi; gjegjësisht se shpedituesi mund të veproj dhe të ndërmarrë masa adekuate (për rastet e justifikueshme) për ruajtjen e të drejtave dhe interesave të urdhërdhënësit (kjo përfshirë edhe veprimin e justifikueshëm ndaj personave të tretë). Sa i përket formës së njoftimit, dispozita në fjalë e LMD-së nuk ka saktësuar ndonjë formë të veçantë të ekzekutimit të njoftimit; ashtu që mund të konsiderohet se shpedituesi do ta përmbush këtë detyrim duke ia komunikuar urdhërdhënësit njoftimin në çfarëdo forme të qartë për urdhërdhënësin, e qoftë ajo të jetë ekzekutuar me gojë, më shkrim, ose edhe përmes mjeteve të komunikimit në distancë (psh. telefon, etj.); sigurisht, është e këshillueshme që me qëllim të të provuarit më të lehtë të njoftimit të bërë, është e këshillueshme që shpedituesi të ekzekutoj njoftimet përkatëse në një formë e cila lejon ruajtjen e përmbajtjes së njoftimit, ose lënien e gjurmëve përkatëse nga mund të provohet ai më lehtë. Gjithashtu, me qëllim të mbrojtje së interesave të urdhërdhënësit nga personat e tretë (ose personat përgjegjës siç i quan dispozita ligjore), shpedituesi mund të ushtroj edhe veprime përkatëse juridike ose faktike që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit; të tilla si psh. kundërshtime, ankesa, ndërmarrjen e veprimeve për konstatimin e gjendjes faktike, ndërmarrjen e veprimeve për sigurimin e provave, etj.

Neni 854. Veprimi sipas udhëzimeve të urdhërdhënësit

- 1. Shpedituesi ka për detyrë t'i përmbahet udhëzimeve mbi drejtimin e rrugës, mjeteve dhe mënyrën e transportit, si dhe udhëzimet e tjera të marra nga urdhërdhënësi.**
- 2. Në qoftë se nuk ka mundësi të veprojë sipas udhëzimeve të përmbajtura në urdhër, shpedituesi ka për detyrë të kërkojë udhëzime të reja, e në qoftë se për këtë gjë nuk ka kohë, ose nuk është e mundur shpedituesi ka për detyrë të veprojë sikundër e kërkojnë interesat e urdhërdhënësit.**
- 3. Për çdo shmangie nga urdhëri, shpedituesi ka për detyrë ta njoftojë urdhërdhënësin pa vonesë.**
- 4. Në qoftë se urdhërdhënësi nuk e ka caktuar as rrugën dhe as mjetet, as mënyrën e transportit, dërguesi do t'i caktojë ashtu sikurse e kërkojnë interesat e urdhërdhënësit në rastin konkret.**

5. Në qoftë se shpedituesi i është shmangur udhëzimeve të marra, përgjigjet edhe për dëmin e shkaktuar për shkak të fuqisë madhore, përveç nëse provon se dëmi do të shkaktohej edhe po t'u kishte përmbajtur udhëzimeve të dhëna.

854.1. Duke marrë parasysh se kontrata për shpedicionin është kontratë e cila lidhet në besimin reciprok të palëve kontraktuese, gjegjësisht në besimin të cilin urdhërdhënësi e bartë të shpedituesi, është detyrë themelore që shpedituesi të veprojë sipas urdhrave të cilat i ka marrë nga urdhërdhënësi; detyrimi i përmbajtjes së urdhrave të urdhërdhënësit veçanërisht vije në shprehje në lidhje me çështjet rreth drejtimit të rrugës në të cilën do të organizohet transportimi i mallrave, çështjet në lidhje me përzgjedhjen dhe përdorimin e mjeteve me të cilat bëhet transporti i mallrave, çështjet në lidhje me mënyrën e kryerjes së transportimit të mallrave, si dhe edhe urdhra tjera të marra nga urdhërdhënësi e që kanë të bëjnë me organizimin e transportimit të mallrave, ose vet transportimin e mallrave. Në këtë kuptim shpedituesi do të veprojë konform udhëzimeve të dhëna nga urdhërdhënësi, në rast se diçka tjetër nuk është paraparë me kontratë. Ashtu si u tha më lartë, shpedituesi duhet të tregoj kujdes në vlerësimin e urdhrave të urdhërdhënësit si profesionist, ashtu që menjëherë posa të vërej se në urdhrat e urdhërdhënësit ka të meta të caktuara, ose pasaktësi, gjegjësisht boshllëqe, ai menjëherë është i detyruar t'i tërheqë vërejtjen dhe ta njoftojë urdhërdhënësin për të metat e tilla.⁶⁹⁸

854.2. Paragrafi i dytë i Nenit 854 adreson detyrimin dhe rregullon përgjegjësinë e shpedituesit duke treguar se si duhet të veprohet në situatat e veçanta kur shpedituesi nuk ka mundësi të veproj sipas përmbajtjes së urdhrave të urdhërdhënësit (kjo për rastet kur përmbajtja sipas urdhrave të urdhërdhënësit është e pamundur, ose nuk është në interesin më të mirë të urdhërdhënësit). Sigurisht, në një rast të tillë shpedituesi e informon urdhërdhënësin mbi situatën e krijuar (nëse për këtë e lejojnë kushtet e rastit), ashtu që me këtë rast edhe të kërkoj udhëzime të reja se si të veproj në situatën e krijuar (kërkon udhëzime shtesë në lidhje me rrugën, mjetet dhe mënyrën e organizimit dhe transportimit të mallrave, konform kushteve të reja të paraqitura). Në rastet kur ka mungesë të udhëzimeve nga urdhërdhënësi, ndërsa nuk ka kohë të mjaftueshme për pritjen e udhëzimeve nga urdhërdhënësi (sepse rrethanat e rastit kërkojnë veprim emergjent), shpedituesi si profesionist (ekonomist i mirë) është i obliguar të veprojë në përputhje me praktikën e mira të biznesit në kuptim të mbrojtjes së interesave të urdhërdhënësit. Në kuptim të paragrafit në fjalë, Ligjvënësi sanksionon mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve diskrecionale nga shpedituesi (ashtu që posaçërisht të kujdeset për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit) vetëm për rastet kur i njëjti vlerëson se nuk ka kohë të mjaftueshme për pritjen e udhëzimeve të reja nga urdhërdhënësi.⁶⁹⁹

584.3. Shpedituesi është i detyruar të veprojë sipas kontratës së lidhur me urdhërdhënësin në kuptim të përfilljes dhe zbatimit të urdhrave të marrë nga ky i fundit. Në këtë kuptim

698 Më shumë në lidhje me njoftimin për të metat e urdhërit shih më gjerësisht komentimin e nenit 851, më lartë.

699 Në lidhje me mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit shih më tej komentimin e Nenit 853.1.

shpedituesi është i obliguar që për çdo shmangie nga urdhri, të njoftojë urdhërdhënësin pa vonesë. Palët edhe me kontratë mund të rregullojnë statuat se si të veprohet në rast të shmangies nga urdhrat e urdhërdhënësit, si dhe saktësimin e afatit të njoftimit për shmangjen nga urdhrat. Për rastet kur palët nuk kanë saktësuar afatin e njoftimit në rast të shmangies nga urdhrat e urdhërdhënësit, atëherë LMD themelon se ky njoftim duhet të bëhet pa vonesë. Sigurisht, në çmuarjen nëse njoftimi për shmangjen e nga urdhrat është bërë “pa vonesë”, gjykata merr në konsideratë sjelljet profesionale të shpedituesit (veprimi si ekonomist i mirë), gjegjësisht edhe rrethanat e rastit në të cilat është gjindur ose me të cilat është përballë shpedituesi. Sipas neneve të komentuara më sipër ky njoftim i urdhërdhënësit ka të bëjë kryesisht me organizimin dhe transportimin e sendeve të urdhërdhënësit duke përfshirë llojin dhe mjetin e transportimit, rrugën të të cilën do të bëhet transportimi, në mënyrë që me rastin e njoftimit të urdhërdhënësit t’i bëhet me dije se shpedituesi ka për qëllim mbrojtjen e interesave të tij.

584.4. Siç u tha në paragrafët pararendës shpedituesi gjithmonë duhet të veprojë në cilësinë e profesionistit dhe vlerësuesit të situatës në të gjitha rastet kur këtë e kërkon interesi i urdhërdhënësit. Kështu nëse urdhërdhënësi e ka caktuar rrugën e transportimit shpedituesi ka për detyrë që t’i japë vërejtje dhe ta njoftojë urdhërdhënësin nëse urdhri i këtij të fundit ka të meta. E sidomos sipas këtij paragrafi, në rastet kur urdhërdhënësi nuk e ka caktuar as rrugën dhe as mjetet, as mënyrën e transportit, shpedituesi do t’i caktojë ashtu sikurse e kërkojnë interesat e urdhërdhënësit në rastin konkret (për rastet kur urdhërdhënësi nuk i ka caktuar të njëjtat). Sipas kuptimit të këtij paragrafi përgjegjësia e shpedituesit këtu mund të thuhet se kufizohet vetëm sa i përket zgjedhjes së rrugës së transportit, mjetet me të cilat transportohen sendet si dhe mënyrën e organizimit të transportimit të sendeve.

584.5. Te kontrata e shpedicionit, shpedituesi është i obliguar që të kryejë me përpikëri urdhrat e urdhërdhënësit të caktuara me kontratë. E nëse të njëjtat nuk janë caktuar me kontratë shpedituesi është i detyruar të veprojë në mbrojtje të interesave të urdhërdhënësit për secilin rast kur ai është i detyruar të veprojë në mungesë të një urdhri të tillë. Në këtë kuptim shpedituesi do të jetë përgjegjës në qoftë se i është shmangur udhëzimeve të marra nga urdhërdhënësi, edhe për dëmin e shkaktuar për shkak të *vis major*, përveç nëse shpedituesi paraqet prova që i njëjti dëm do të shkaktojë edhe po t’u kishte përmbajtur udhëzimeve të marra. Nga kjo dispozitë mund të nxirret kuptimi se shpedituesi në këtë rast përpos përgjegjësisë për dëmin e rëndomtë do të përgjigjej edhe në rast të shkatërrimit të sendit si pasojë e ngjarjeve të paparashikueshme, të cilat vijnë si rezultat i mosveprimit të tij sipas urdhrave të dhëna (pra moszbatimi i urdhrave të dhëna të urdhërdhënësit rritë përgjegjësinë e shpedituesit dhe të njëjtin e bënë përgjegjës edhe për veprimet e *vis major*). Përrjashtimisht nga ky rregull i përgjegjësisë shpedituesi mund të lirohet vetën nëse ka prova të mjaftueshme të cilat provojnë se nuk ka asnjë lidhje të ngushtë në mes të dëmit të shkaktuar dhe pamundësisë së shpedituesit që të lajmërojë me kohë urdhërdhënësin e tij. Gjithsesi, edhe pse një gjë e tillë është e vështirë për tu provuar, megjithatë në disa raste të caktuara e njëjta mund të provohet, andaj i mbetet gjykatës të vendosë në raste të caktuara nëse dëmi do të ishte shkaktuar edhe po tu ishte përmbajtur udhëzimeve të urdhërdhënësit (sigurisht duke çmuar të gjitha rrethanat e rastit të dhënë).

Neni 855. Përgjegjësia e shpedituesit për persona të tjerë

- 1. Shpedituesi përgjigjet për zgjedhjen e transportuesit, si dhe për zgjedhjen e personave të tjerë me të cilët në zbatimin e urdhërit ka lidhur kontratën (magazionimi i mallit etj.), por jo edhe për punën e tyre, përveç nëse këtë përgjegjësi e ka marrë mbi vete me kontratë.**
- 2. Shpedituesi i cili ia beson zbatimin e urdhërit shpedituesit tjetër në vend që ta përmbushë urdhërin vet, përgjigjet për punën e tij.**
- 3. Në qoftë se urdhëri përmban autorizimin shprehimor ose heshtazi shpedituesit që t'i besojë zbatimin e urdhërit dërguesit tjetër ose nëse kjo është padyshim në interesin e urdhërdhënësit, ai përgjigjet vetëm për zgjedhjen e tij, përveç nëse ka marrë përsipër përgjegjësinë për punën e tij.**
- 4. Përgjegjësitë nga paragrafet e mësipërme të këtij neni nuk mund të përjashtohen dhe as të kufizohen me kontratë.**

855.1. Siç pamë më lartë, që nga lidhja e kontratës për shpedicionin e deri të përmbushja e së njëjtës, krahas shpedituesit si organizues i transportit, paraqiten edhe persona të tretë me të cilët shpedituesi (sipas urdhrave të urdhërdhënësit) hynë në punë juridike me qëllim të realizimit të transportimit të mallrave për urdhërdhënësin e tij. Kështu shpedituesi për punët për të cilat nuk është në gjendje që vetë t'i përfundojë, me qëllim të realizimit më të mirë të urdhrave të cilët dalin sipas kontratës, hynë në marrëdhënie edhe me persona të tretë. Kështu, shpedituesi përzgjedhë personate e tretë me qëllim të kryerjes së veprimeve transportuese për urdhërdhënësin duke hyrë në marrëdhënie të nduar-ndurshme me të tretët (psh. lidhja e marrëveshjeve me transportuesit direkt, me ndërmarrjet për magazionimin e mallit, me ndërmarrjet ngarkuese dhe shkarkuese të porteve të ndryshme detare, me organizatat e specializuara për kontrollimin e mallrave, me kompanitë e sigurimit të mallrave)⁷⁰⁰, etj., dhe bartë përgjegjësi për përzgjedhjen e tyre (psh. shpedituesi bartë përgjegjësi nëse përzgjedhja e palëve të treta për kryerjen e veprimeve transportuese ka qenë jo e drejtë, ose e dëmshme për urdhërdhënësin, pasi që shpedituesi ka zgjedhë transportuesin pa përvojë, ose me emër të "keq" (e për të cilat rrethana ka ditur ose është dashtë të dij), ashtu që ka dështuar transporti, ose që transportimi i mallit ka përfunduar me dëme për urdhërdhënësin.

Në tërë rastet e përmendura, me rastin e zgjedhjes së personave të tretë të cilët do t'i kryejnë punët e caktuara e të ndërlidhura me transportimin e mallrave për urdhërdhënësin, shpedituesi duhet të veprojë në mënyrë profesionale në përzgjedhjen e tyre. Në këtë kuptim shpedituesi përgjigjet për zgjedhjen e personave të tretë, por jo edhe për punën e tyre, përveç nëse këtë përgjegjësi e ka marrë mbi vete me kontratë. Sipas këtij paragrafi, shpedituesi do të përgjigjet vetëm për përzgjedhjen e tyre edhe nëse kjo nuk është paraparë me kontratë, por jo edhe për punën e tyre nëse kjo e fundit nuk është paraparë me kontratë.

700 Në lidhje me këtë shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 424.

855.2. Paragrafi 2 i Neni 855 të LMD-së rregullon përgjegjësinë e shpedituesit për rastet kur ai ia beson kryerjen e urdhrin të urdhërdhënësit një shpedituesi tjetër (pa lejen ose pajtimin paraprak të urdhërdhënësit). Në këtë kuptim shpedituesi është përgjegjës për punën të cilën ai ia beson shpedituesit tjetër. Në fakt, shpedituesi tjetër mund të jetë ndihmës i shpedituesit në ekzekutimin e urdhrave të urdhërdhënësit, ose mund të jetë bashkëpunëtor i tij; ashtu që shpedituesi përgjigjet ndaj urdhërdhënësit për punën e të njëjtit. Në kuptim diskutimit të mundësisë së delegimit të pushtetit të shpedituesit mund të thuhet se caktimi i shpedituesit tjetër nuk është gjithmonë i duhur (ose i pranueshëm), sepse caktimi i një shpedituesi tjetër nuk nënkupto apriori edhe sigurinë të mjaftueshme për urdhërdhënësin se shpedituesi i fundit me siguri të mjaftueshme do të ekzekutohej në mënyrë të duhur urdhrin e tij (kjo për aq më tepër pasi që palët me rastin e kontraktimit të kontratës për shpedicionin kanë në konsideratë edhe besimin që urdhërdhënësi gëzon për shpedituesin, ashtu që të njëjtit i bartë një pushtet të caktuar në kuptim të kryerjes së disa punëve për llogarinë e tij).

855.3. Për ndryshim nga paragrafi pararendës, ky paragraf adreson përgjegjësinë e shpedituesit për rastet në të cilat urdhri i urdhërdhënësit përmban një autorizim shprehimor ose të heshtur sipas të cilit shpedituesi t'i besojë ekzekutimin e urdhrin një shpedituesi të tretë; ose edhe në rast të mungesës së një urdhri për transferim por kur kjo padyshim është në interesin e urdhërdhënësit. Për rastet ashtu si është themeluar me këtë dispozitë, konsiderohet se shpedituesi nuk përgjigjet për veprimet e shpedituesve pasues, pasi që konsiderohet se edhe shpedituesit pasues janë profesionist në ofrimin e shërbimeve të shpeditimit dhe të njëjtit duhet të tregojnë standarde të larta profesionale në shërbim, si dhe duhet të bartin përgjegjësi individuale për lëshimet e tyre në shërbim; shpedituesit do të mund të përgjigjet në këto situata vetëm për përzgjedhjen e shpedituesit pasues i cili do të bëjë ekzekutimin e atij urdhrin të urdhërdhënësit (psh. shpedituesi do të përgjigjet vetëm nëse përzgjedhjet e shpedituesve pasues nuk kanë qenë të duhura për shkak të rrethanave të cilat ka ditë, ose është dashtë ti dijë shpedituesi). Edhe përkundër këtij kuptimi, përjashtimisht, shpedituesi do të mund të përgjigjet edhe për punën e shpedituesve pasues nëse palët këtë mundësi shprehimisht e kanë parapa me kontratë (ashtu që me kontratë palët kanë vendosë që shpedituesi të ketë përgjegjësi të shtuar).

855.4. LMD, në paragrafin e katërt të këtij Neni saktëson se rregullat e mësipërme të këtij Neni janë të karakterit imperativ, ashtu që palët të njëjtat nuk mund të përjashtohen dhe as të kufizohen me kontratë; në rast të kontraktimit të ndonjë klauzole kontraktuese në kundërshtim me kërkesat e këtij paragrafi, ajo klauzolë e kontratës do të ishte e pavlefshme dhe nuk do të kishte ndikim në kërkesat e themeluara me paragrafët më lartë të këtij Neni.

Neni 856. Veprimet doganore dhe pagimi i doganës

Në qoftë se në kontratë nuk është caktuar ndryshe, urdhëri për dërgimin e sendit përtej kufirit përmban detyrimin për dërguesin që të zbatojë veprimet e duhura doganore dhe të paguajë taksat doganore për llogari të urdhërdhënësit.

856. Në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, kur mallrat duhet të transportohen përtej kufirit nacional, rëndom shtrohet çështja e pagesës së detyrimeve doganore të cilave iu

nënshtrohen mallrat e eksportuara, ose mallrat e importuara. palët me kontratë mund të saktësojnë pozitën dhe përgjegjësinë reciproke në lidhje me shlyerjen e ngarkesave doganore për rastet e importit ose eksportit të mallrave. Ndërsa, në kuptim të Nenit si më lartë, nëse palët nuk kanë saktësuar me kontratë këtë përgjegjësi, atëherë konsiderohet se vet urdhri për transportimin e mallit jashtë kufirit konsiderohet se përmban edhe detyrimin për shpedituesin që i njëjti në emrin e vetë dhe për llogari të komitentit të zbatoj të gjitha veprimet e duhura doganore, si dhe të paguaj të gjitha taksat - ngarkesat doganore që mund të kërkohen në lidhje me transportimin e mallrave përtej kufirit nacional. Sigurisht, shpediterët, të cilët merren me organizimin e transportit të mallrave përtej kufirit nacional, si profesionist të këtyre punëve duhet të kenë mjaftë njohuri për procedurat doganore të cilave iu nënshtrohen, ose për tarifave dhe ngarkesat doganore të cilave iu ekspozohen gjatë eksportit ose importit të mallrave; ashtu që në përlogaritjen e tarifave dhe shpërblimit përkatës shpedituesit kanë parasysh të gjitha këto ngarkesa.

Neni 857. Kur shpedituesi kryen vetë transportin ose punët e tjera

- 1. Shpedituesi mundet edhe vetë të kryejë plotësisht ose një pjesë të transportit të sendeve, dërgimi i të cilave i është besuar, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.**
- 2. Në qoftë se dërguesi e ka kryer transportin vetë ose pjesën e transportit, ka të drejtë dhe detyrime të transportuesit, kështu që në këtë rast i takon edhe shpërblimi përkatës për transport përveç shpërblimit mbi bazën e dërgimit dhe shpërblimit të shpenzimeve në lidhje me shpeditimin.**
- 3. E njëjta gjë vlen lidhur me punët e tjera të përfshira me urdhërin, doket ose me kushtet e përgjithshme.**

857.1. Në komentimin e neneve më lartë në këtë pjesë është thënë se punët e shpedituesit konsistojnë në organizimin e transportit dhe kryerjen e veprimeve tjera rreth organizimit të transportit të mallrave për urdhërdhënësin (e për këtë qëllim ai lidhë në emrin e vetë e për llogari të urdhërdhënësit marrëveshje me palët e treta të cilat kryejnë transportimin e mallrave). Megjithatë, paragrafi i parë i Neni 857 të LMD-së lejon mundësinë që shpedituesi të mund që edhe vetë të kryej transportin e mallit në tërësi, ose pjesërisht (ose të kryej edhe veprime tjera për qëllimin e transportimit të mallrave, si psh. kontrollimin e mallrave, magazinimin e mallrave, etj.); gjegjësisht që krahas punëve të shpeditimit të paraqitet edhe në rolin e transportuesit nëse palët nuk kanë saktësuar diçka tjetër me kontratë.

857.2. Në kuptim të komentimit të paragrafit më lartë të këtij Neni, për rastet kur shpedituesi kryenë plotësisht ose pjesërisht transportimin e mallrave, gjegjësisht për rastet kur i njëjti na paraqitet edhe si transportues, atëherë ndaj të njëjtit në lidhje me pjesën e veprimeve që përfshinë transportimin e mallit zbatohen të drejtat dhe detyrimet që i takojnë transportuesit (gjegjësisht, se veprimet juridike të transportuesit i nënshtrohen rregullave të kontratës për transportin). Në kuptim të kësaj, Shpedituesi i

cili krahas shërbimit të shpeditimit, kryen në tërësi ose pjesërisht transportin e mallrave për urdhërdhënësin, të njëjtit i takon edhe e drejta në pjesën e shpërblimit adekuat për punët e transportimit të mallrave, e kjo krahas të drejtës në shpërblim dhe në evitim të shpenzimeve të shkaktuara në lidhje me kryerjen e punëve të shpeditimit.

857.3. Ajo që është komentuar në lidhje me paragrafin e dytë të këtij Neni vlen edhe për rastet kur shpedituesi kryen edhe punë tjera për urdhërdhënësin, e kjo ashtu si është saktësuar në urdhrin e urdhërdhënësit, doket ose me kushtet e përgjithshme.

Neni 858. Sigurimi i dërgesës

- 1. Dërguesi ka për detyrë ta sigurojë dërgesën vetëm në qoftë se kjo është kontraktuar.**
 - 2. Në qoftë se me kontratë nuk është caktuar se cilat rreziqe duhet t'i përfshijë sigurimi, dërguesi ka për detyrë t'i sigurojë sendet nga rreziqet e rëndomta.**
-

858.1. Ndërmarrja e punëve të shpeditimit dhe të transportimit të mallrave shpesh shtron çështjen e nevojës së sigurimit të dërgesave - mallrave gjatë transportimit. Mund të thuhet se në praktikën e reja të biznesit dhe në qarkullimin e mallrave çdo ditë e më shumë po praktikohet sigurimi i mallrave me qëllim të përmbushjes së kontratës dhe kryerjes së punëve të mirë të shërbimeve. Në këtë kuptim sidomos në dërgesat ndërkombëtare mund të përmenden sigurimet në bazë të klauzolave të INCOTERM-ave. Poashtu ka edhe kompani të mëdha të cilat mund të kontraktohen me qëllim të sigurimit të dërgesave nga rreziqet e mundshme të cilave mallrat mund të iu ekspozohen gjatë transportit, etj.

Në rastin e kontratës së shpeditimit mund të shtrohet pyetja se kush e bënë sigurimin e mallrave gjatë transportit, gjegjësisht se kush ngarkohet me shpenzime shtesë në emër të sigurimit të dërgesës (pasi që ndonjëherë këto shpenzime mund të jenë të konsiderueshme). Paragrafi i parë i Nenit 858 duket se ofron një përgjigje të qartë mbi pyetjen e ngritur. Sipas kuptimit të paragrafit në fjalë shpedituesi ka për detyrë ta sigurojë dërgesën vetëm në qoftë se kjo është kontraktuar. Në vështrim të kësaj dispozite mund të vërehet se ligjvënësi në këtë paragraf lë të nënkuptohet se palët duhet që shprehimisht ta parashohin dhe rregullojnë detyrimin e sigurimit të dërgesës së mallrave të urdhërdhënësit.

858.2. Zakonisht, nëse palët saktësojnë me kontratë detyrimin e sigurimit të mallrave gjatë transportit, palët me kontratë saktësojnë edhe rreziqet potenciale nga të cilat mallrat duhet të sigurohen, ose një gjë e tillë është paraparë në rregullat e përgjithshme të biznesit të shpedituesit (ose të urdhërdhënësit). Rëndom, nëse është përshkruar në kontratë ose në kushtet e përgjithshme të biznesit se ndaj të cilave rreziqe dërgesat duhet të sigurohen, shpedituesi ka për detyrim të përmbahet kërkesave të tilla. Në rast të mungesës së dispozitave në kontratë ose në kushtet e biznesit, në lidhje me përshkrimin e rreziqeve nga të cilat duhet të sigurohen dërgesat, atëherë paragrafi i dytë i Nenit në fjalë urdhëron se shpedituesi ka për detyrë t'i sigurojë sendet nga rreziqet e rëndomta.

Neni 859. Dhënia e llogarisë

- 1. Pas mbarimit të punës shpedituesi ka për detyrë t'i japë llogari urdhërdhënësit.**
 - 2. Sipas kërkesës së urdhërdhënësit shpedituesi ka për detyrë të japë llogari edhe gjatë zbatimit të urdhrit.**
-

859.1. Një nga detyrimet kryesore të shpedituesit ndaj urdhërdhënësit të tij është detyrimi i dhënies llogari të shpedituesit ndaj urdhërdhënësit; i cili detyrim, si i tillë, është saktësuar në Nenin 859 të LMD-së. Pasi që shpedituesi të kompletoj punën për të cilën është kërkuar të shërbej, ai së bashku me rezultatet e punës, i paraqet urdhërdhënësit edhe një llogari të tërësishme mbi rrjedhën e punëve dhe rezultateve përfundimtare të punëve të arritura dhe të dorëzuara urdhërdhënësit. Dhënia e llogarisë, si detyrim për shpedituesin, nuk nënkupton vetëm dorëzimin e thjeshtë të një dokumenti - në formë të llogarisë, ku shpedituesi e njofton urdhërdhënësin për llogarinë përfundimtare. Në realitet, mendohet se dhënia e llogarisë nënkupton një tërësi të veprimeve dhe aktiviteteve të ndërmarrura nga shpedituesi, me qëllim që urdhërdhënësin e tij ta pajis me të gjitha informatat, dokumentacionin, si dhe rrjedhën e punëve të ndërmarrura për llogarinë e komitentit, informimin për sukseset e arritura dhe dështimet eventuale të pësuar, përfshirë në vete edhe shpjegimet adekuate për balancën e shpenzimeve, pagesave, dëmeve eventuale, ngarkesave të ndryshme financiare, e të ngjashme, me të cilat është ngarkuar llogaria e urdhërdhënësit gjatë dhe në lidhje me ofrimin e shërbimit të shpeditimit; përfshirë këtu edhe paraqitjen dhe dorëzimin e çfarëdolloj dokumenti i cili bartë informata për rrjedhën e punëve të ndërmarrura nga shpedituesi, ose është me rëndësi për bartjen e interesave dhe rezultateve të punëve të urdhërdhënësi. Në kuptim të paragrafit të parë të Nenit në fjalë, shpedituesi obligohet t'i ofroj llogari urdhërdhënësit brenda afateve, ose ashtu si të njëjtat e kanë saktësuar këtë detyrim në kontratën për shpeditimin, ose në mungesë të shpjegimeve të tilla në kontratën për shpeditimin, detyrimi i ofrimit të llogarisë bëhet konform praktikave të aplikuara afariste (ose praktikës të themeluar ndërmjet vet palëve, nëse palët nga bashkëpunimi i ndërsjellë kanë themeluar praktikë adekuate). Detyra e dhënies së llogarisë përfundimtare nga shpedituesi posaçërisht ka rëndësi të madhe për raportin e marrëdhënies ndërmjet palëve, pasi që, me dhënien e llogarisë përfundimtare, shpedituesi bartë në urdhërdhënësin e tij rezultatet e të gjitha ndërmarrjeve - veprimeve të tija (të njëjtat të ndërmarrura në llogarinë e urdhërdhënësit), duke përfshirë këtu pagesat përfundimtare, ose edhe dorëzimin e mallrave në urdhërdhënësin, ashtu që dhënia e llogarisë përfundimtare spastron raportet përfundimtare ndërmjet shpedituesit dhe urdhërdhënësit, duke e pushuar edhe pushtetin juridik që shpedituesi e ka fituar nga urdhërdhënësi në lidhje me ofrimin e shërbimeve të shpeditimit.

859.2. Paragrafi i dytë i Nenit në fjalë autorizon urdhërdhënësin, që i njëjti në çdo kohë gjatë ekzekutimit të kontratës së shpeditimit, të mund të kërkoj nga shpedituesi dhënien llogari për shërbimet dhe veprimet juridike që shpedituesi i kryen në emrin e vet, e për llogari të urdhërdhënësit. Kjo është edhe e nënkuptueshme, pasi që bëhet fjalë për autorizime të caktuara që urdhërdhënësi ka bartë në shpedituesin, prandaj, i njëjti

vazhdimisht ka të drejtë të pyes dhe të mbahet i informuar për rrjedhën e punëve të kryera nga shpedituesi. Sigurisht, raportimi i vazhdueshëm i shpedituesit për urdhërdhënësin mund të krijoj rritjen e shpenzimeve për shpedituesin, ashtu që i shpedituesi ka të drejtë të kërkoj nga urdhërdhënësi evitim të shpenzimeve të cilat shkaktohen në lidhje me raportimin e vazhdueshëm ndaj urdhërdhënësit; gjegjësisht kjo mund ta themeloj të drejtën e shpedituesit edhe në shpërblim të veçantë nëse kjo mundësi është e themeluar me tarifën e shpedituesit ose me doket afariste.

KREU 3 DETYRIMET E URDHËRDHËNËSIT

Neni 860. Pagimi i shpërblimit

Urdhërdhënësi ka për detyrë t'i paguajë shpedituesit shpërblimin sipas kontratës, e në qoftë se shpërblimi nuk është kontraktuar, atëherë shpërblimin sipas tarifës ose të ndonjë akti tjetër të përgjithshëm, e në mungesë të këtij, shpërblimin do ta caktojë gjykata.

860. Si kundërvlerë për pranimin e shërbimeve të shpeditimit, urdhërdhënësi i paguan shpedituesit shpërblimin përkatës. Kryesisht shpërblimi që i paguhet shpedituesit kontraktohet në një shumë të caktuar në të holla, por ai mund të kontraktohet edhe në natyrë (vlera tjera pasurore). Kryesisht, pagesa e shpërblimit është detyrimi themelor i urdhërdhënësit, ashtu që rëndom, si lartësinë, ashtu edhe mënyrën e pagesës palët e saktësojnë me kontratë. Rrjedhimisht, për punën e kryer në lidhje me kontratën për shpeditimin, shpedituesit i takon e drejta në shpërblim. Përveç që shpërblimi mund të saktësohet me Kontratë, ai mund të caktohet edhe në formë të tarifës, ashtu që tarifa e shpedituesit aplikohet në caktimin e lartësisë së shpërblimit e cila i takon shpësituesit. Neni 860 i LMD-së saktëson se shpedituesit i takon e drejta në shpërblim edhe në qoftë se palët të njëjtin nuk e kanë përfshirë në kontratë, ose nëse për të njëjtën palët nuk u janë referuar ndonjë tarifë përkatëse; ashtu që në rastet e tilla shpërblimin e cakton gjykata. Mendohet se arsyeja e kësaj zgjidhje ligjore bazohet në faktin se kryerja e punëve të shpeditimit bazohet në angazhimin e profesional të shpedituesit, të cilin shërbim në të shumtën e rasteve shpedituesi e ushtron si aktivitet afarist - për qëllim të fitimit, ashtu që ushtrimi i këtij shërbimi nga i njëjti kërkon një sjellje të shpedituesit mjaftë të kujdesshme dhe me përgjegjësi të lartë profesionale në ofrimin e shërbimeve ndaj urdhërdhënësit të tij; kështu që kjo si më lartë është një nga arsyet që shkakton supozimin e të drejtës që Shpedituesi të kërkoj kundërvlerën përkatëse, gjegjësisht pagimin e shpërblimit për shërbimin e ofruar. Gjykata, në lidhje me saktësimin e shpërblimit mund të marr në konsideratë edhe doket afariste të vendit përkatës, duke i konsideruar edhe rrethanat e rastit në kuptim të përcaktimit adekuat të vëllimit të shpërblimit; sigurisht në formimin e mendimit të gjykatës në lidhje me lartësinë e shpërblimit do të duhej të konsiderohej munda i shpenzuar i shpedituesit për shërbimin e bërë (gjegjësisht rezultatin e arritur, etj).

Neni 861. Kur dërguesi mund të kërkojë shpërblim

Shpedituesi mund të kërkojë shpërblim kur të kryejë detyrimet e veta nga kontrata për shpedicionin.

861. Dispozita në fjalë njih të drejtën e shpedituesit për të kërkuar shpërblimin për punën e kryer, mirëpo kushtimisht potencon se kjo e drejtë i atribuohet atij në momentin e ekzekutimit të detyrimeve të veta, ashtu siç janë përcaktuar në kontratën mbi shpedicionin. Natyrisht shpedituesit do ti takojë shpërblimi i caktuar në proporcion me rolin dhe detyrat e kryera të kontraktuara dhe në proporcion me shpenzimet e transportimit të mallit, doganimit, magazinimit dhe të tjera të ngjashme (nëse shpedituesi i ka bërë shpenzimet në fjalë). Neni 861 i LMD-së përcakton se Shpedituesi fiton të drejtën e shpërblimit atëherë kur kontrata të jetë ekzekutuar, gjegjësisht pasi që shpedituesi ti ketë arritur rezultatet e kërkuara me Kontratë; megjithatë dispozita në fjalë nuk përjashton edhe mundësinë e shpërblimit të shpedituesit kur kontrata mbetet e pa-ekzekutuar nga shkaqet që janë në anën e urdhërdhënësit (gjegjësisht shkaqe të cilat rëndojnë përgjegjësinë e urdhërdhënësit). Këto do të ishin situatat kur urdhërdhënësi me veprimet e tij, gjegjësisht lëshimet ose mos-veprimet e tij, pengon ose pamundëson shpedituesin që të kryej punët e urdhëruara me kontratën për shpeditimin; ashtu që kjo situatë arsyeton të drejtën e shpedituesit që urdhërdhënësi t'i paguaj shpërblimin-provizion e plotë i cili do ti takonte sikur puna të ishte kryer sipas kërkesave të Kontratës.

Neni 862. Shpenzimet dhe paradhënia

- 1. Urdhërdhënësi ka për detyrë t'ia shpërblejë shpedituesit shpenzimet e nevojshme të bëra për zbatimin e urdhrit për dërgimin e sendit.**
 - 2. Shpedituesi mund të kërkojë shpërblimin e shpenzimeve menjëherë posa t'i ketë bërë.**
 - 3. Urdhërdhënësi ka për detyrë që me kërkesën e shpedituesit, t'i japë në formë paradhënie një shumë të nevojshme për shpenzimet që kërkon zbatimimi i urdhrit për dërgimin e sendit.**
-

862.1. Shpedituesi, gjatë kryerjes së punëve rreth shpeditimit mund të bëjë edhe shpenzime (nganjëher të konsiderueshme). Paragrafi i parë i Nenit 862 të LMD-së thekson detyrimin e urdhërdhënësit që i njëjti t'ia kompensoj shpenzimet e bëra shpedituesit, të shkaktuara gjatë, ose në lidhje me kryerjen e punëve të shpeditimit, gjegjësisht zbatimin e urdhrit për dorëzimin e sendit. Kompensimi i shpenzimeve të shkaktuara gjatë kryerjes së punëve të shpeditimit është më se i nënkuptueshëm, pasi që të njëjtat edhe janë shkaktuar në lidhje me dërgimin e sendit të urdhërdhënësit. Sigurisht, në kompensimin e shpenzimeve hyjnë kryesisht shpenzimet e domosdoshme që krijohen gjatë ose ndërliiden me kryerjen e shërbimimeve shpedituese, ashtu që vet kryerja e punëve të shpeditimit ka qenë interesi i urdhërdhënësit; ose nëse shpenzime të dobishme, ashtu që kryerja e punëve të caktuara

shpedituese i ka sjellë dobi interesit të urdhërdhënësit. Këto shpenzime nënkuptojnë kostot e shkaktuara në kursin e zakonshëm të kryerjes së punëve të shpeditimit, ose të njëjtat që janë shfaqur si të nevojshme në një situatë të veçantë. Në kuptimin e shpenzimeve të shkaktuara nuk llogariten vetëm kostot në lidhje me organizimin e transportimit të mallrave, por në shpenzime hyjnë edhe kostot e ndërlidhura me realizimin dërgesës - transportimit të mallrave. Shumë shpesh ndodhë që në shpenzime të tilla përfshihen kostot në lidhje me organizimin e transportit, kostot për kryerjen e transportit, dërgimit, shpenzimet e magazinimit, doganimit dhe të tjera të ngjashme, e që janë edhe kosto bazike për realizimin e veprimtarisë së shpedicionit.

862.2. Paragrafi i dytë i këtij Neni themelon të drejtën e shpedituesit që të kërkoj pagesën-kompensimin e shpenzimeve të shkaktuara, menjëherë posa të njëjtat t'i jenë shkaktuar ose të jenë bërë nga shpedituesi. Në rrjedhën e zakonshme të gjërave, posa të krijohet një shpenzim (psh. posa të paguan ngarkesat doganore, ose posa të paguan shpërblimet për kontrollin e cilësisë së mallrave, etj), shpedituesi e gëzon të drejtën në kompensimin e këtyre shpenzimeve. Sigurisht, shpedituesit i takon e drejta të kërkoj kompensimin e shpenzimeve që në fillim, posa të njëjtat të jenë shkaktuar; megjithatë, në praktikë ndodhë shpesh që shpedituesi kërkon kompensimin e shpenzimeve fare në fund të përmbylljes së punëve të shpeditimit, atëherë kur paraqet llogarinë përfundimtare (kështu, momenti i zgjedhjes së paraqitjes së kërkesës për kompensimin e shpenzimeve mund të jetë një çështje e të drejtës diskrecionale të shpedituesit).

862.3. Paragrafi i tretë i këtij Neni rregullon dhe themelon mundësinë e shpedituesit që i njëjti të kërkoj paradhënie (pagesa paraprake) në emër të mbulimit të shpenzimeve të cilat do t'i shkaktohen në ndërkohë dhe të cilat ndërlidhen me kryerjen e punëve të shpeditimit. Shpedituesi mund të kërkojë "paradhënie" lidhur me mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme, të cilat shpedituesi planifikon se do t'i shkaktohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shpedicionit për urdhërdhënësin. Sigurisht, të gjitha avanset në emër të shpenzimeve të cilat i ka pranuar shpedituesi do të hynë në llogarinë përfundimtare në lidhje me çmuarjen e kostove totale të shpenzimeve të shkaktuara, e të cilat duhet të mbulohen përfundimisht nga urdhërdhënësi.

Neni 863. Kur është kontraktuar që shpërblimin ta paguajë marrësi i sendeve

Në qoftë se është kontraktuar se shpedituesi do t'i arkëtojë kërkesat e veta nga marrësi i sendeve, shpedituesi rezervon të drejtën të kërkojë pagimin e shpërblimit nga urdhërdhënësi, në qoftë se marrësi refuzon t'ia paguajë.

Pasi që në kontratën për shpedicionin si palë kontraktuese paraqiten shpedituesi, si subjekt i obliguar dhe kontraktuar për kryerjen e shërbimeve të shpedicionit dhe urdhërdhënësi- subjekti në favor të të cilit ofrohen shërbimet e shpedicionit, atëherë edhe është e kuptueshme që ndërmjet palëve të krijohet përgjegjësi përkatëse për sigurimin e

përbushjes së detyrime të tërësishme nga marrëdhënia e shpeditimit. Kryesisht, barra e pagimit të shpërblimit për shpedituesin bie në urdhërdhënësin, mirëpo me kontratë palët mund të merren vesh edhe ndryshe duke përcaktuar se detyrimin e pagesës së shpërblimit do ta bëjë marrësi i sendit. Kjo situatë krijohet në bazë të vullnetit të palëve apo dispozicionit të palëve se si ata dëshirojnë të përcaktojnë mënyrën e pagesës së shpërblimit dhe se kë do ta caktojnë si subjekt përgjegjës për pagimin e shpërblimit. Për rastet kur kjo mundësi mund të kontraktohet ndërmjet palëve, nuk mund të përjashtohen edhe situatat kur urdhërdhënësi do të kontraktonte me shpedituesin që shpërblimi të paguhet nga pala e tretë (marrësi i sendeve), detyrim i cili eventualisht ka mund të krijohet për të tretin pa pëlqimin e tij. Në rastet e tilla, i treti i cili nuk ka deklaruar pëlqimin për pagimin e shpërblimit mund të refuzoj pagimin e shpërblimit, ashtu që interesat e shpedituesit për inkasimin e shpërblimit nga pala e tretë do të mund të rrezikoheshin për rastet kur nuk është siguruar që më parë pëlqimi se pala e tretë do të përbushë detyrimin e pagesës së shpërblimit. Me qëllim të sigurimit të interesit të shpedituesit në pagimin e shpërblimit nga pala e tretë (për rastet kur ndërmjet palëve kontraktohet kjo mundësi), Neni 863 i LMD-së ka themeluar përgjegjësinë e urdhërdhënësit që i njëjti edhe më tej të jetë përgjegjësi për pagesën e shpërblimit, përderisa pala e tretë nuk paguan shpërblimin përkatës (gjegjësisht është detyrim i urdhërdhënësit që të paguaj shpërblimin nëse pala e tretë refuzon që shpedituesit t'i paguaj shpërblimin përkatës).

Neni 864. Sendet e rrezikshme dhe të çmueshme

- 1. Urdhërdhënësi ka për detyrë ta njoftojë shpedituesin mbi cilësitë e sendeve me të cilat mund të rrezikohet siguria e njerëzve ose e vlerave apo mbi shkaktimin e dëmit.**
- 2. Kur në dërgesën ndodhen sendet e çmueshme, letrat me vlerë ose sendet e tjera të shtrenjta, urdhërdhënësi ka për detyrë ta njoftojë për këtë shpedituesin dhe t'ia komunikojë vlerën e tyre në çastin e dorëzimit për dërgim.**

864.1. Shpediticioni, ose organizimi i transportimit të mallrave, përfshinë në vete ndërmarrjen e një morie të veprimeve juridike dhe faktike profesionale nga shpedituesi me qëllim që të ekzekutohet transportimi efikas dhe i sigurt i mallrave, ashtu që gjatë transportimit të mallrave të mos vihet në rrezik siguria e njerëzve ose gjëseneve të të tretëve. Që shpedituesi t'i ndërmarr punët e shpeditimit dhe të siguroj se transportimi i mallrave nuk paraqet rrezik për qytetarët dhe pasurinë e të tretëve, ai duhet të njoftohet nga urdhërdhënësi në lidhje me cilësinë e mallrave, ashtu që organizimin e transportit të të njëjtave të ia përshtas sa më mirë vet sigurimit të mallit që transportohet, por edhe që malli që transportohet të mos paraqes rrezik për rrethin.

Mallrat e ndryshme për shkak të përmbajtjes së rrezikshme të të njëjtave mund të paraqesin një kërcënim për sigurinë në transport, qoftë kjo një kërcënim për sigurinë e jetës së qytetarëve, ose edhe sigurinë e vlerave tjera pasurore të palëve të treta. Nëse mallrat e tilla paraqesin rrezik potencial, në proporcion me shkallën e rrezikut shpedituesi duhet të

ndërmarr masa të nevojshme me qëllim që të siguroj se rreziku i mallrave që transportohen është i mengjhuëshëm dhe nuk paraqet kërcënim për jetën e njeriut ose pasurinë e të tretëve. Që shpedituesi të mund t'i ndërmarrë veprimet me qëllim të sigurimit të përshtatshëm të mallrave gjatë transportit, ai duhet të njoftohet për cilësitë e mallrave (gjegjësisht cilësitë e veçanta të mallrave të cilat mund të jenë kërcënuese gjatë transportimit). Detyrimi që shpedituesi të njoftohet për cilësitë e mallrave që dërgohen është një detyrim ligjor i urdhërdhënës, i njëjti i themeluar me paragrafin e parë të Nenit 862 të LMD-së.

Posa të informohet shpedituesi lidhur me cilësinë e tillë të mallrave (për vetitë e rrezikshme të mallrave që transportohen) krijohet detyrimi për shpedituesin që të marr masa të nevojshme tekniko-ligjore lidhur me organizimin e transportimit të mallrave të tilla, ashtu që të njëjtat do ta bënin transportimin e dërgesës të sigurt.

Sigurisht, mos-sigurimi i informatave të nevojshme nga urdhërdhënësi për vlerësimin e cilësive të rrezikshme të mallrave që transportohen themelojnë përgjegjësinë e urdhërdhënësit për shpërblimin e dëmit eventual i cili mund të shkaktohet, e që rezultati i shkaktoimit të dëmit mund të jetë mos-ndërmarrja e masave adekuate për sigurimin e mallrave gjatë transportit. Shpedituesi do të mund të lirohej nga detyra e shpërblimit të dëmit nëse provon se urdhërdhënësi nuk e ka pajisë me informata të nevojshme për vlerësimin e rrezikut të transportimit të mallrave, rrethana të cilat urdhërdhënësi i ka ditë ose është dashtë ta dijë se të njëjtat janë relevante në çmuarjen e rrezikut dhe sigurisë gjatë transportimit të mallrave.

864.2. Ashtu sikurse për sendet e rrezikshme, urdhërdhënësi ka për obligim që të njoftoj shpedituesin edhe për faktin se në dërgesë gjinden sende të çmueshme, letra me vlerë apo sende të tjera të shtrenjta, duke e këshilluar që për të njëjtat duhet të tregoj kujdes të posaçëm gjatë transportit. Ky nen përcakton obligimin e ndërsjellë dhe të përbashkët të urdhërdhënësit dhe shpedituesit lidhur me organizimin e dërgimit të sendeve të tilla. Si të tilla gjësende janë gjërat të cilat në dukje apo në madhësi e peshë janë të vogla, por të njëjtat kanë vlerë të konsiderueshme materiale. Informimi i shpedituesit nga ana e urdhërdhënësit për vlerën e sendeve të çmueshme krijon detyrimin për shpedituesin lidhur me marrjen e masave të duhura për transportimin e tyre, duke kontraktuar transportuesit për përgjegjësi adekuate (që të tregojnë kujdes të posaçëm gjatë transportit), si dhe duke i informuar të njëjtit për cilësitë e sendeve që transportohen, ashtu që përgjegjësia për transportimin e sendeve të tilla me vlerë të kaloj të transportuesit konkret. Transportimi i gjësendeve të tilla me vlerë ndonjëherë determinon edhe ndërmarrjen e masave të veçanta të sigurimit gjatë transportit (psh. sigurimi nga rreziqe të ndryshme, etj), e që ekzistimi i njohurive për të njëjtat është thelbësor në organizimin dhe ndërmarrjen e masave adekuate gjatë transportit. Në kuptim të kësaj si më lartë, Shpedituesi do të mund të lirohet nga detyra e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit, në rast se provon se shpedituesi nuk është njoftuar për rrethana të tilla me rëndësi nga urdhërdhënësi, ashtu që sikur të dinte vetitë ose vlerën e gjësendeve do të siguronte një transportim adekuat dhe përkujdesje adekuate për gjësende të tilla me vlerë.

KREU 4

RASTET E VEÇANTA TË SHPEDITIMIT

Neni 865. Shpeditimi me shpërblimin fiks

- 1. Kur me kontratën për shpeditimin është caktuar një shumë e përgjithshme për zbatimin e urdhërit mbi dërgimin e sendit, në të është përmbajtur shpërblimi për punën e dërguesit, si dhe shpërblimi i shpenzimeve të transportit dhe shpërblimi i të gjitha shpenzimeve të tjera, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.**
- 2. Në këtë rast shpedituesi përgjigjet edhe për punën e transportuesit dhe të personave të tjerë që i ka përdorur me anë të autorizimit nga kontrata.**

865.1. Në praktikë, të determinuar nga nevoja e shpejtë e transportimit të mallrave, hasim në modalitete të ndryshme të kontratës për shpeditimin. Në një kontratë shpeditimi palët mund të merren vesh që punët e shpeditimit dhe të ekzekutimit të transportit të mallrave - dërgesës të bëhen për një shume fikse (të cilën e paguan urdhërdhënësi) dhe qëllimi i të cilës është që të mbuloj si pjesën e shpërblimit e cila i takon shpedituesit, ashtu edhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve tjera përcjellëse për transportimin e mallrave (psh. pagesa për transportues, ngarkesa doganore, etj). Këtë mundësi duket se e njuh dhe e rregullon edhe paragrafi i parë i Neni 865 të LMD-së. Të kjo formë e marrëdhënies së shpeditimit caktohet një “çmim fiks”, përfundimtar, e cila shumë mbulon jo vetëm provizionin-shpërblimin për shpedituesin, por e njëjta mbulon edhe të gjitha kostot në lidhje me shpenzimet në lidhje me organizimin e transportit, kostot e transportit, mbulesën e kostove doganore, premitë e sigurimit, kostot në lidhje me kontrollin e mallrave, etj. Vlen të theksohet se kjo formë e kontraktimit të shpeditimit është një përjashtim nga kontrata e rëndomtë e shpeditimit, ashtu që e njëjta si një përjashtim shprehimisht duhet të kontraktohet. Duket se kjo formë e kontraktimit të shpeditimit ka shumë përparësi ekonomike, pasi që e ofron shërbimin e shpeditimit dhe transportimit të mallrave në një paketë, duke iu mundësuar palëve kursime në kohë, efikasitet në transportimin e mallrave, siguri dhe përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve për transportimin e mallrave (palët me kontratë në mënyrë uniforme rregullojnë transportimin e mallrave, duke themeluar përgjegjësi kontraktuale për suksesin e ekzekutimit të transportimit të mallrave); sigurisht, shpedituesi, i cili e ka barrën tërësore për ekzekutimin e transportimit të mallrave do të jetë më efikas dhe do të përzgjedhë mjete më ekonomike për transportimin e mallrave për urdhërdhënësin.

865.2. Të forma e shpeditimit me shpërblimin fiks, ashtu si u komentua në paragrafin më lartë, shpedituesi merr detyrimin, e njëkohësisht edhe përgjegjësinë për suksesin dhe pasojat e transportimit të mallit në tërësi, deri të vendi i dërgesës, ashtu si është caktuar me kontratë, ose ashtu si rrjedhë nga përcaktimi ligjor. Shpedituesi mund të jetë ndërmarrje e profesionalizime vetëm për shpeditim, ashtu që punët tjera të transportimit dhe dërgimit të mallit t'i nënkontraktoj me ndërmarrje tjera të profesionalizime; ose që vet t'i kryej të gjitha punët rreth shpeditimit dhe transportimit të mallit. Në rastin e

parë, kur shpedituesi ka nënkontraktuar që disa punë rreth transportimit të mallrave të bëhen nga nënkontraktorët, shpedituesi do të mbajë përgjegjësi të plotë për punën dhe veprimet tjera të nënkontraktuesve. Rrjedhimisht, në rast të shkaktimit të dëmit si pasojë e veprimit të nënkontraktuesve, shpedituesi ka përgjegjësi të plotë që ta kompensoj dhe ta mbajë urdhërdhënësin plotësisht të padëmtuar nga veprimet e nënkontraktorve. Ky është edhe përcaktimi ligjor i paragrafit të dytë të këtij Neni, qëllimi i të cilit është që ta mbrojë urdhërdhënësin nga veprimet e nënkontraktuesve të shpedituesit. Mund të ndodhë në praktikë që shpedituesi, me qëllim të kursimit të shpenzimeve, të nënkontrakttoj punë të ndryshme transportuese ose mbikëqyrëse nga nënkontraktues jo-profesional, ashtu që nga jo-profesionalizmi i nënkontraktuesve të shkaktohen dëme në mallrat që transportohen, ose vonesa, etj; ashtu që në kuptim të këtij përcaktimi ligjor shpedituesi do të ngelët përgjegjës për lëshimet eventuale të cilat shkaktohen në lidhje me shpeditimin dhe transportimin e mallrave, përfshirë këtu edhe përgjegjësinë për veprimin e nënkontraktuesve të shpedituesit (e që mund të jenë palët e treta si transportues, organizata për kontrollimin e mallrave, etj.).

Neni 866. Shpeditimi përmbledhës

- 1. Shpedituesi në zbatimin e urdhrave të marra mund të organizojë shpeditimin përmbledhës, përveç nëse me kontratë kjo është përjashtuar.**
- 2. Në qoftë se me shpeditimin përmbledhës realizon diferencën në çmimin e transportit në dobi të urdhërdhënësit, dërguesi ka të drejtë në shpërblimin e veçantë suplementar.**
- 3. Në rastin e shpeditimit përmbledhës shpedituesi përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e sendit të shkaktuar gjatë kohës së transportit që nuk do të shkaktoheshin po mos të kishte qenë dërgimi kompleks.**

866.1. LMD, në paragrafin e parë të Nenit 866, lejon të ashtuquajturin “shpeditimin përmbledhës”, e kjo përveç nëse palët me kontratë nuk e kanë përjashtuar të njëjtin. “Shpeditimi përmbledhës” përfaqëson një nocion të bashkëpunimit të më shumë shpedituesve (ndërmarrjeve shpedituese) të vendit ose edhe ndërkombëtare me qëllim të organizimit të përbashkët të transportit të më shumë mallrave të transportuara të disa urdhërdhënësve (gjegjësisht edhe shfrytëzimin e mjeteve të përbashkëta të transportit dhe ndërmarrjes së veprimeve tjera të përbashkëta shpedituese për të gjitha mallrat e grumbulluara). Në kuptimin ekonomik kjo formë e shpeditimit ofron shërbim më efikas, shumë më të lirë, dhe kursim shume të madh në kohë dhe resurse. Kështu, grumbullimi për transport i më shumë mallrave të më shumë urdhërdhënësve mundëson shfrytëzim shumë më ekonomik të mjeteve të transportit, zbatimin e procedurave të përbashkëta doganore për më shumë dërgesa (kursim në kohë), magazinim të përbashkët të më shumë mallrave (kursime në tarifat e magazinimit të mallrave), etj. Në kuptim të paragrafit që komentohet, palët vetëm shprehimisht mund ta përjashtojnë të ashtuquajturin “shpeditimin përmbledhës”, ashtu që në mungesë të një përjashtimi të tillë shprehimorë, konsiderohet se shfrytëzimi i mundësisë së “shpeditimit përmbledhës” është në dorën e shpedituesit.

866.2. Shpeditimi përmbledhës është një formë e shpeditimit e cila i mundëson edhe urdhërdhënësit nganjëherë realizimin e transportimit të mallrave në një kosto më të ulët. Kështu, në kuptim të paragrafit të dytë të Nenit që komentohet, shpedituesi ka të drejtë në një shtesë - rritje të shpërblimit të tij (shpërblim i veçantë suplementar) nëse realizon diferencën në çmimin e transportit në dobi të urdhërdhënësit (me fjalë të tjera, nëse si rezultat i shpeditimit përmbledhës dukshëm kursen në dobi të urdhërdhënësit nga kostot totale të transportit të parashikuara). Sigurisht, kjo dispozitë nuk jep asnjë sqarim se si do të mund të përllogaritej e drejta e shpedituesit në shpërblim suplementar, megjithatë, në rast mosmarrëveshje të njëjtin do ta caktonte gjykata duke pas në konsideratë lartësinë e kursimeve të realizuara në interesin e urdhërdhënësit, por edhe rrethanat e tjera të rastit konkret.

866.3. Paragrafi i tretë i Nenit që komentohet themelon se shpedituesi do të bartë rrezikun e dëmtimit ose humbjes së sendeve në rast se është shfrytëzuar i ashtuquajtur i shpeditimi përmbledhës, por vetëm për rastet kur provohet se dëmtimi ose humbja e mallit nuk do të shkakttoheshin sikur të mos ishte shfrytëzuar shpeditimi përmbledhës. Shpedituesi do të mund të lirohej nga detyra e shpërblimit të dëmit sikur të mund te provohej se dëmtimi, gjegjësisht humbja e dërgesës nuk ndërlidhet me shpeditimin përmbledhës.

KREU 5 E DREJTA E PENGUT E SHPEDITUESIT

Neni 867. E drejta e pengut e shpedituesit

- 1. Për sigurimin e arkëtimit të kërkesave të veta të krijuara lidhur me kontratën për shpeditimin, shpedituesi ka të drejtë pengut në sendet e dorëzuara për dërgim dhe lidhur me dërgimin gjithnjë gjersa e mban, ose gjersa ka në dorë dokumentin me anë të të cilit mund t'i disponojë ato.**
- 2. Kur në kryerjen e dërgimit ka marrë pjesë edhe dërguesi tjetër, ai ka për detyrë të kujdeset për arkëtimin e kërkesave dhe për realizimin e të drejtës së pengut të dërguesve të mëparshëm.**
- 3. Në qoftë se dërguesi tjetër paguan kërkesat e dërguesit ndaj urdhërdhënësit, këto kërkesa dhe e drejta e pengut e dërguesit i barten këtij në bazë të vet ligjit.**
- 4. E njëjta gjë ndodh po qe se dërguesi tjetër paguan kërkesat e transportuesit.**

867.1. Paragrafi i parë i Nenit 867 të LMD-së vendosë të drejtën e pengut të shpedituesit mbi sendet ose mallrat e urdhërdhënësit, e të cilat janë lëndë e kontratës së shpeditimit (sendet e dorëzuara për dërgim, gjegjësisht sendet e lidhura me dërgimin), me qëllim të sigurimit të të drejtës së shpedituesit në pagesën e shpërblimit dhe të shpenzimeve të pësuara gjatë kryerjes së punëve për llogarinë e urdhërdhënësit. Sigurisht, kjo formë e pengut që ekziston për interesin e shpedituesit është një formë e pengut ligjor dhe ekziston vetëm mbi sendet-mallrat të cilat janë

lëndë e kontratës së shpeditimit dhe të cilat gjinden në posedimin, ose kontrollin e shpedituesit ose palës së tretë e cila i mbanë të njëjtat për shpedituesin, gjegjësisht nëse dokumentet me të cilat mund të disponohet malli gjinden në posedimin e shpedituesit. Përveç dispozitave të parapara në këtë Nen, për realizimin e të drejtës së pengut të shpedituesit të themeluar nga kjo bazë zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës së pengut.

867.2. Paragrafi i dytë i Nenit që komentohet themelon detyrimin e shpedituesit të fundit, që i njëjti (në dorën - kontrollin e të cilit ndodhen sendet ose dokumentet e urdhërdhënësit) të kujdeset për realizimin e të drejtës së pengut të shpedituesve të mëhershëm, nëse është plotësuar kushti nga sa u komentua nga paragrafi i mëparshëm. Shpedituesi i fundit, në kuptim të kësaj dispozite, duhet të ndërmarr të gjitha masat nën kontrollin e tij, e me qëllim të themelimit të së drejtës së pengut për sigurimin e kërkesave të shpedituesve të mëhershëm ndaj urdhërdhënësit. Në situata të tilla, për rastet kur vlera e sendeve të mbajtura nga shpedituesi i fundit nuk mjafton për sigurimin e kërkesave të të gjithë shpedituesve, shtrohet pyetja se cilët nga shpedituesit e kanë radhën e përparësisë në inkasimin e kërkesave të parët. Mendohet se shpedituesi i fundit, i cili është nën kontrollin - zotërimin e sendeve, e ka edhe të drejtën e përparësisë në inkasimin e kërkesave të tija i pari.

867.3. Paragrafi i tretë më tej rregullon situatën kur kërkesat e një shpedituesi ndaj urdhërdhënësit janë paguar nga shpedituesi i tjetër. Në kuptim të paragrafit të tretë të nenit në fjalë, shpedituesi i cili i ka paguar kërkesat e që një shpeditues tjetër i ka ndaj urdhërdhënësit, shpedituesi që ka paguar në raste të tilla e fiton të drejtën e pengut mbi sendet-mallrat e urdhërdhënësit edhe për ato kërkesa për të cilat ka paguar në vend të urdhërdhënësit.

867.4. Në kuptim të paragrafit të katërt të të njëjtit Nen, e njëjta do të vlente edhe sikur një shpeditues paguan kërkesat që transportuesi i mallit i ka ndaj urdhërdhënësit. Në kuptim të kësaj, shpedituesi i cili ka paguar transportuesin në vend të urdhërdhënësit, për pagesat e tilla e ka të drejtën e pengut në kuptim të dispozitave të këtij Neni të komentuar më lartë.

PJESA XX

KONTRATA PËR KONTROLLIN E MALLRAVE DHE TË SHËRBIMEVE

Neni 868. Nocioni

- 1. Me kontratën për kontrollin e mallrave njëra palë kontraktuese (kryerësi i kontrollit) detyrohet të kryejë në mënyrë profesionale dhe të paanshme kontrollin kontraktues të mallrave dhe të lëshojë certifikatë për këtë, kurse pala tjetër (porositësi i kontrollit) detyrohet që për kontrollin e kryer të paguajë shpërblimin e kontraktuar.**
- 2. Kontrolli i mallrave mund të përbëhet nga përcaktimi i identitetit, cilësisë, sasisë dhe të veçorive të tjera të mallrave.**

868.1. Siç mund të vërehet në paragrafin e parë të këtij neni, LMD jep përkufizimin e kontratës për kontrollin e mallrave dhe shërbimeve. Në kuptim të këtij paragrafi kontrata për kontrollimin e mallrave dhe shërbimeve konsiderohet kontrata e tillë në bazë të së cilës njëra palë (ndërmarrja kontrolluese, kontrolluesi) obligohet që në emër për llogarinë e palës tjetër (porositësit të kontrollit, urdhërdhënësit, komitentit) që të kryejë kontrollin e kontraktuar të mallrave dhe shërbimeve, ashtu që kontrolluesi pas kryerjes së kontrollit të lëshojë një certifikatë për kryerjen dhe certifikimin e rezultateve të kontrollit, si dhe pas lëshimit të certifikatës porositësi i kontrollit obligohet që të paguajë shpërblimin e caktuar, gjegjësisht shpërblimin e kontraktuar për këtë shërbim.

Në teorinë juridike ekzistojnë mendime të ndryshme për sa i përket natyrës juridike të kontratës për kontrollin e mallrave dhe shërbimeve. Kështu, shumë shpesh kjo kontratë konsiderohet se ka tipare të kontratës për veprën, për shkak të punës të cilën duhet ta kryejë kontrolluesi dhe për shpërblimin i cili i takon atij. Mirëpo duke i pas parasysh tiparet e veçanta të kësaj kontrate dhe shpeshhtësinë e paraqitjes së saj në qarkullimin e mallrave (dhe shërbimeve), teoria dhe praktika juridike kanë pranuar ekzistencën e kësaj kontrate si një kontratë sui generis (e veçantë) marrëdhënieve të detyrimeve (kryesisht e ndërlidhur me shërbimet në tregtim - marrëdhëniet komerciale). Ndaj, edhe LMD e trajton këtë kontratë si një kontratë të veçantë e cila ka gjet vend të kënaqshëm në radhën e kontratave komerciale. Kjo për arsyen e thjeshtë sepse përmban elementet të cilat e dallojnë këtë kontratë nga kontratat tjera në qarkullimin juridik; e kjo posaçërisht pasi që kërkon nga kontrolluesi sigurimin e një shkallë të kënaqshme të objektivitetit dhe paanshmërisë në kryerjen e kontrollit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe profesionalizmin të cilin duhet ta ushtroj kryerësi i kontrollit gjatë ndërmarrjes së veprimeve për kontrollimin e mallrave. Tek kontrata për kontrollimin e mallrave si palë gjithmonë paraqiten kërkuesi i kontrollimit të mallrave - urdhërdhënësi i cili mund të jetë person juridik ose person fizik (i cili ka nevojë që mallrat e tij të kontrollohen-testohen) dhe i cili ia beson kontrollimin e mallit një personi tjetër i cili në rastet më të shpeshta është një entitet juridik - biznesor; Kontrolluesi i mallrave zakonisht e kryen kontrollin e mallrave në mënyre profesionale, në cilësinë e ekspertit, e i cili është e pajisur kryesisht me ekspertizë të fushave përkatëse dhe me

mjete teknologjike bashkëkohore për kryerjen me sukses të kontrollimit të mallit në mënyrë të shpejtë, efikase dhe me kosto sa më të ulët. Kryesisht, kontrolluesi i mallit e ushtron këtë aktivitet si profesionist, si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike dhe me qëllim të sigurimit të fitimit (kundërvlerës përkatëse) për shërbim. Objekt i kësaj kontrate është kontrollimi i mallrave, ashtu që kryerësi i kontrollit duke shfrytëzuar njohuritë profesionale dhe ekspertizën bënë kontrollin e mallrave dhe lëshon certifikatën përkatëse të kontrollit, për kundërvlerën përkatëse të cilën e paguan porositësi i kontrollit. Në kuptim të saktësisë të elementeve thelbësore të kësaj kontrate, mund të konkludohet se këtë kontratë e karakterizojnë elementet thelbësore si në vijim: detyra e kryerësit të kontrollit që të kontrolloj mallrat përkatëse, detyra e kryerësit të kontrollit që të lëshoj certifikatën e kontrollit, si dhe detyra e porositësit të kontrollit që të paguaj shpërblimin përkatës për këtë shërbim.

868.2. Siç u pa nga paragrafi paraprak objekt i kontratës për kontrollimin e mallrave është kontrollimi i mallrave me qëllim të verifikimit - përcaktimit të identitetit të mallit, cilësisë së mallit, si dhe sasisë dhe të veçorive të tjera të mallrave. Siç mund të shihet nga paragrafi i dytë i nenit 868 të LMD-së, ligji iu mundëson palëve zgjedhje të lirë të qëllimeve të cilat palët dëshirojnë të realizojnë me kontratën për kontrillimin e mallrave si dhe të saktësisë të vëllimit të kontrollimit të mallrave. Kështu psh. sasia e mallit mund të përcaktohet duke bërë matjen e mallit, peshimin e mallit, si dhe numërimin e njësisë të mallit (kur subjekt i kërkesës së kontrollit është edhe përcaktimi I numrit të njësisë të mallit). Identiteti i mallit përcaktohet në bazë të veçorive të mallit i cili është objekt i kontrollit. Kështu kontrolluesi do të kryejë kontrollimin e mallit, të verifikoj veçoritë e mallit - cilësitë e mallit përmes analizave kimike - testimi të mallit (etj.) dhe në fund të lëshoj certifikatën përkatëse në kuptim të certifikimit të veçorive të konstatuara. Lëndë e kontrollimit të mallit mund të jetë edhe verifikimi i vetive të brendshme ose të jashtme të mallit, me qëllim të konstatimit nëse malli që i është nënshtruar kontrollit i përgjigjet mostrës ose modelit të treguar. Sigurisht, rezultati negativ që mund të rezultojë në rast të kontrollimit të mallit dhe konstatimit se malli nuk i përgjigjet mostrës ose modelit rezulton me përgjegjësinë kontraktuale të dorëzuesit (shitësit - moskonformiteti i mallit me mostren ose modelin nënkupton ekzistimin e të metave të brendshme të mallit dhe përgjegjësinë e bartësit-shitësit për mungesat e mallit). Në kuptim të kontrollimit të mallit, nëse palët me kontratë nuk saktësojnë kërkesat për kontrollimin e mallit, atëherë kontrollimi i mallit bëhet në bazë të natyrës së mallit.

Kur kontraktojnë bartjen-shitjen e mallrave, palët në rastet më të shpeshta kontraktojnë edhe cilësinë e tyre. Nganjëherë palët me kontratë fare nuk specifikojnë cilësinë që mallrat e dorëzuara duhet të posedojnë. Edhe në këto raste në të drejtën krahasuese dhe në të drejtën tonë ekzistojnë rregulla për cilësinë që mallrat e dorëzuara duhet të posedojnë. Andaj thuhet se në qoftë se nuk është thënë asgjë në kontratë për sa i përket cilësisë së mallrave, mallrat duhet t'i përgjigjen "qëllimit të zakonshëm", "cilësisë mesatare" ose "cilësisë së mirë" ashtu që të njëjtat të mos jenë nën nivelin e cilësisë së mesatare. Në rastet kur mallrat e kontrolluara nuk i përgjigjen cilësisë së kontraktuar, gjegjësisht cilësisë mesatare, kjo sjellë përgjegjësi kontraktuale për transferuesin - shitësin (shih rregullat e përgjegjësisë për mungesat materiale të mallrave).

Një aspekt tjetër i cilësisë së mallit është edhe pjesa e paketimit të mallit. Cilësia e paketimit të mallit është çështje e rëndësishme për shkak se pala mund të ketë disavantazhe të mëdha në plasimin dhe shitjen e atij malli në treg. Kështu, nëse palët nuk kanë kontraktuar diçka tjetër posaçërisht, subjekt i kontrollit për raste të tilla është vetëm paketimi i mallit (psh. nëse mallrat janë dërguar në paketim origjinal, etj).

Neni 869. Vëllimi i kontrollit

Kryerësi i kontrollit është i detyruar të kryejë kontrollin në vëllimin dhe në mënyrën që janë caktuar në kontratë, e në qoftë se në kontratë asgjë nuk është caktuar, në vëllimin dhe në mënyrën që i përgjigjet natyrës së sendit.

869. Parimisht kryerësi i kontrollit është i obliguar të kryejë kontrollin konform vëllimit dhe mënyrës së caktuar në kontratë. Kjo përbën detyrimin e përmbushjes reciproke të detyrimeve të cilat rrjedhin nga kontrata. LMD në këtë nen tenton të gjejë zgjidhje për rastet për të cilat palët kontraktuese nuk e kanë paraparë me kontratë vëllimin dhe mënyrën e kontrollimit të mallrave. Kështu, në këtë kuptim LMD nuk jep zgjidhje për të gjitha rastet kur kryerësi i kontrollit është i detyruar të kryejë kontrollin por themelon përgjegjësinë e kryerësit të kontrollit që çdoherë të kujdeset për vëllimin dhe mënyrën e kontrollit sipas natyrës së sendit. Andaj, mund të thuhet se kryerësi i kontrollit, në cilësinë e profesionistit dhe ekonomistit të mirë mund të kryejë kontrollin e mallrave konform natyrës së mallrave bazuar në praktikën e mira të biznesit. Sipas formulimit të kësaj dispozite, edhe pse ajo nuk është specifike, ofron zgjidhje të përshtatshme sa i përket ushtrimit të kontrollit sipas “natyrës së sendit”, duke i mundësuar kështu gjykatës zgjidhje në rast të kontestit eventual ndërmjet palëve, pasi që gjykata niset nga supozimi se kryerësi i kontrollit është person i specializuar në atë fushë. Ndërsa sa i përket mënyrës së kontrollit të mallrave-sendeve, mund të themi se bota bashkëkohore ka përparuar shumë sa i përket teknologjisë, ashtu që kompanitë dhe institutet e ndryshme të cilat kryejnë kontrole të mallrave posedojnë teknologji të lartë për të kryer këto shërbime. Kështu mund të thuhet se tanimë kontrollimi bëhet në të gjitha fushat nga të cilat vijnë mallrat, duke bërë kontrollimin e tyre deri në specifikat më të detajuara dhe me një nivel shumë të lartë të ekspertizës.

Neni 870. Nuliteti i disa dispozitave të kontratës

- 1. Janë nule dispozitat e kontratës që i imponojnë kryerësit të kontrollit detyrat që do të mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të kontrollit ose në rregullsinë e dokumentit për kontrollin e kryer (çertifikata).**
 - 2. Kontrolli konsiderohet i kryer vetëm pas lëshimit të çertifikatës.**
-

870.1. Dispozita e paragrafit të parë të këtij neni themelojnë në mënyrë imperative detyrimin e palëve kontraktuese, më saktësisht detyrimin e porositësit të kontrollit që të mos ndikojë

në çfarëdo forme në objektivitetin e kryerjes së kontrollit dhe lëshimin e certifikatës. Në këtë kuptim çfarëdo dispozite e kontratës që mund të bie ndesh me këtë paragraf për sa i përket dy elementeve të përcaktuara me këtë paragraf janë absolutisht të pavlefshme. Kjo për arsye se në fund të rezultateve të kontrollit lëshohet edhe certifikata e kontrollit. Siç mund të shihet ky nen është projektuar për të mbrojtur interesin e përgjithshëm sepse mallrat kryesisht kanë për destinacion të fundit tregun. Andaj për shkak të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm ligji në këtë nen përcakton detyrimin për t'iu përmbajtur standardeve të paanësisë në ushtrimin e kontrollit të mallrave dhe rregullsinë e dokumentit të kontrollit, ashtu që secili përdorues i mallit (ose eventualisht konsumatori), ose titullari i destinacionit të fundit të mallit ka një mendim objektiv për mallin dhe kualitetin e mallit të cilin e përdor; ashtu që kryesisht kryerësi i mallit ushtron veprimtarinë e kontrollit të mallit si profesionist, duke u mbështetur shpeshherë në standardet e përcaktuara me ligj (ligji nganjëherë të mallrat e ndryshme industriale ose të konsumit vendos standarde për kontrollimin e cilësisë ose vetive të mallrave), akte të brendshme të kryerësit të kontrollit dhe praktikatat e mira të biznesit.

870.2. Paragrafi i dytë i këtij neni parasheh se kontrolli konsiderohet i kryer vetëm nëse bëhet lëshimi i certifikatës së kontrollit. Kjo certifikatë shërben si provë se shërbimi i kontrollit është kryer sipas kontratës, gjegjësisht standardeve profesionale dhe natyrës së mallit (nëse asgjë nuk është përkrahur në kontratë për këtë qëllim). Me certifikatën e kontrollit provohet vërtetësia e kontrollimit të mallit dhe cilësive të kontratuara-verifikuara nga kryerësi i kontrollit të mallit. Rëndom, certifikata e kontrollimit të mallit përmban shenjë e objektit të kontrollit, datën dhe vendin e lëshimit, porositesin, rezultatin e kontrollit, nënshkrimin dhe datën e kryerjes së kontrollit⁷⁰¹. Si e tillë, certifikata nuk mund të lëshohet nëse kontrolli nuk është kryer, e nëse e njëjta lëshohet pa u kryer kontrolli nuk ka asnjë efekt juridik. Gjithashtu vlen të theksohet se certifikata nuk është letër me vlerë e po ashtu nuk është as dokument mallor (nuk paraqitet si dokument i mallit).

Neni 871. Ruajtja e mallrave, respektivisht e mostrave

- 1. Mallin të cilin porositesi i kontrollit ia ka dorëzuar kryerësit të kontrollit për kryerjen e kontrollit të kontraktuar, ushtruesi i kontrollit ka për detyrë t'i ruajë dhe t'i sigurojë nga ndërrimi.**
- 2. Kryerësi i kontrollit është i detyruar t'i ruajë mostrat të cilat iu kanë dorëzuar së paku gjashtë (6) muaj, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.**

871.1. Paragrafi i parë i neni 871 të LMD-së themelon detyrimin ndaj kryerësit të kontrollit që i njëjti të tregoj kujdes të duhur për ruajtjen e mallrave të pranuar në kontroll, ashtu që me qëllim të ruajtjes t'i ndërmerret gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim, e që pas përfundimit të kontrollimit të mallrave të njëjtat t'i kthehen porositesit (kryesisht, t'i

⁷⁰¹ Në lidhje me këtë shih: Hetemi, Mehdi J. *E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste*. Prishtinë, 1996: fq. 429.

mbroj mallrat nga mundësia që ato të mund të ndërrohen me mallra të palëve të tjera, e që mund të jenë të ngjashme për nga cilësia dhe karakteristikat). Kjo përcakton përgjegjësinë e kryerësit të kontrollit që të veprojë me kujdesin e ekonomistit të mirë dhe konform praktikave të mira të biznesit në lidhje me këtë detyrim. Detyrimi i kontrolluesit të mallit nga ky paragraf zbatohet njëjtë, si në rastin kur është fjala për mallra gjenerike (res in genere), por edhe për mallra specifike (res in specie).

871.2. Paragrafi 2 i këtij neni rregullon çështjen e ruajtjes së mostrave, të cilat i janë dorëzuar kryerësit për kontrollim. Parimisht palët mund të pajtohen me kontratë që kontrolluesi të bëjë ruajtjen e mostrave për sa kohe që ata pajtohen. Detyrimi për të ruajtur mostrat tregon se në këtë rast kemi të bëjmë me kontroll të mallrave gjenerike, pasi që mostrat shërbejnë për krahasim të mallit me mostrat. Dhe sipas këtij paragrafi kontrolluesi është i obliguar të ruajë mostrat të cilat i janë dorëzuar për kryerjen e kontrollit së paku gjashtë muaj, nëse palët nuk e kanë paraparë këtë shprehimisht me kontratë. Në këtë kuptim, pas kalimit të afatit prej gjashtë muajsh, afat i cili fillon të rrjedhë nga momenti kur mostrat janë pranuar nga kryerësi i kontrollit, humbja ose shkatërrimi i mostrave nuk krijon përgjegjësi për kryerësin e kontrollit.

Neni 872. Detyrimi i lajmërimit të porositësit

Kryerësi i kontrollit ka për detyrë që për të gjitha rrethanat e rëndësishme gjatë kontrollit dhe ruajtjes së mallrave ta lajmërojë porositësin e kontrollit në kohën e duhur, e sidomos për shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme që janë bërë për llogari të tij.

872. Ky nen themelon përgjegjësinë e kryerësit të kontrollit për lajmërimin e porositësit të kontrollit për rrethanat e rëndësishme gjatë kontrollimit të mallrave dhe ruajtjes së tyre, e posaçërisht njoftimin e porositësit për shpenzimet e dobishme dhe të domosdoshme që janë bërë në llogari të porositësit. Sigurisht, ndërmarrja e masave të caktuara në lidhje me kontrollimin e mallrave dhe ruajtjen e tyre (përderisa të njëjtat gjinden të kryerësi i kontrollit), njohuria për ndërmarrjen e masave të tilla, e sidomos nëse është e nevojshme edhe këshillimi me porositësin, kryesisht është me interes për porositësin. Kështu, LMD, në Nenin në fjalë, kërkon nga kryerësi i kontrollit që i njëjti të jetë vigjilent dhe vazhdimisht ta mbaj të njoftuar porositësin për rrethanat me rëndësi në lidhje me masat e ndërmarrja në lidhje me mallin që është dorëzuar për kontroll.

Pasi që rrethanat ose masat e ndërmarrja nga kryerësi i kontrollit janë të shumta dhe mund të jenë nga më të ndryshmet, ligjvënësi në këtë rast nuk ka mundur t'i parasheh të gjitha situatat kur do të themelohej detyrimi i kryerësit të kontrollit për njoftimin e porositësit; por LMD me një përgjithësim i ka quajtur rrethanat të rëndësishme dhe për të njëjtat e ka obliguar kontrolluesin që ta njoftojë porositësin e kontrollit “në kohën e duhur”. Se cilat janë rrethanat “të rëndësishme” për të cilat duhet të njoftohet porositësi dhe se cila është “koha e duhur” e njoftimit të të njëjtave, LMD nuk ka dhënë ndonjë përcaktim të

mëtejme, por kjo është detyrë e teorisë juridike dhe praktikës gjykatësore që të diskutoj se në cilat rrethana të rastit të dhënë do të duhej të zbatoheshin këto standarde ligjore, duke pas gjithmonë në konsideratë detyrimin e kryerësit të kontrollit që në përmbushjen e detyrimeve të tij të sillet si profesionist.

Detyrimi i njoftimit të porositësit posaçërisht është esencial nëse kryerësi i kontrollit shkakton shpenzime shtesë, e të cilat duhet ta ngarkojnë porositësin; qoftë këtu fjala për shpenzime të domosdoshme, ose shpenzime të dobishme. Në rast se kontrollimi i mallrave kërkon shpenzime shtesë, kryerësi i kontrollit është mirë që edhe ta paralajmëroj porositësin, para se ato të jenë shkaktuar, nëse për këtë e lejojnë rrethanat, ose në rrethanat më urgjente që ta njoftoj për të njëjtat sa më shpejtë që është praktikisht e mundshme.

Neni 873. Shpërblimi

- 1. Për kontrollin dhe për ruajtjen e kryer të mallit, kryerësi i kontrollit ka të drejtë për shpërblim të kontraktuar ose të rëndomtë.**
- 2. Kryerësi i kontrollit ka të drejtën e shpërblimit për të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të dobishme, të cilat janë shkaktuar për llogari të porositësit.**

873.1. Përgjithësisht, lartësinë e shpërblimit që porositësi duhet të paguaj palët e saktësojnë me kontratën për kontrollimin e mallit, ose lartësia e shpërblimit saktësohet me tarifën e punës së kryerësit të kontrollit. Në mungesë të marrëveshjes për lartësinë e shpërblimit, ose në mungesë të aplikimit të tarifës përkatëse, në konsideratë do të duhej të merreshin doket tregtare të vendit përkatës, gjegjësisht kompensimi i rëndomtë i kryerësit të kontrollit e që i përgjigjet një kundërvlerë të drejtë të shërbimit të ofruar nga i njëjti. Kontraktimi i shpërblimit - provizionit për kontrollimin e mallrave është rasti më i shpeshtë i saktësimi të lartësisë së shpërblimit me marrëveshjen e palëve. Gjithashtu, duke e marrë në konsideratë se kontrata për kontrollimin e mallrave është kontratë afariste, ku shpeshherë kryerësi i kontrollit (si biznes ose profesionist), ofron shërbimet sipas tarifës përkatëse, për rastet e tilla kur palët nuk kanë kontraktuar diçka të veçantë zbatohen tarifatat e kryerësit të kontrollit. Përndryshe, në mungesë të marrëveshjes për lartësinë e shpërblimit, ose në mungesë të aplikueshmërisë së tarifave përkatëse, lartësia e shpërblimit caktohet në pajtim me doket tregtare të vendit përkatës, e duke marrë në konsideratë natyrën e punëve - shërbimit të ofruar nga kryerësi, duke pas në konsideratë kohen dhe resurset e kryerësit të punëve të shpenzuara për qëllimin e kontrollimit të mallit.

873.2. Paragrafi i dytë i nenit që komentohet njeh të drejtën e kryerësit të kontrollit që i njëjti të rimbursohet për të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të dobishme që janë kryer për llogari të porositësit. Nga formulimi i kësaj dispozite shohim një përgjithësim sa i përket të drejtës së shpërblimit për këto shpenzime, ashtu që kryerësi i kontrollit ka të drejtë që t'i kërkojë shpenzimet të cilat kanë ndodhur dhe janë shkaktuar edhe gjatë kryerjes së

kontrollit por edhe gjatë ruajtjes së mallit (përderisa malli gjendej të kontrolluesi). Siç u tha në nenin 872 më sipër për këto shpenzime kontrolluesi duhet ta njoftojë porositësin në kohën e duhur (në lidhje me detyrimin e lajmërimit shih më sipër komentimin e nenit 872). Në rast të kontestit eventual në lidhje me këto shpenzime kryerësit të kontrollit i bie barra e provës për të argumentuar se këto shpenzime janë bërë në llogari të porositësit të kontrollit si dhe se të njëjtat kanë qenë të nevojshme, respektivisht të dobishme për porositësin.

Neni 874. E drejta e pengut

Për sigurimin e shpërblimit të kontraktuar apo të rëndomtë dhe të shpërblimit të shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme kryerësi i kontrollit ka të drejtë pengu mbi mallin që i është dorëzuar për kontroll.

874. Neni 874 i LMD-së vendosë të drejtën e pengut të kryerësit të kontrollit mbi sendet ose mallrat e dorëzuar për kontroll, e të cilat janë lëndë e kontrollimit sipas kontratës për kontrollimin e mallrave, me qëllim të sigurimit të të drejtës së kryerësit të kontrollit në pagesën e shpërblimit të kontraktuar ose të rëndomtë, si dhe të shpenzimeve të pësura gjatë kryerjes së punëve për kontrollimin dhe ruajtjen e mallrave (përfshirë këtu shpenzimet e domosdoshme dhe shpenzimet e dobishme të shkaktuara kryerësit të kontrollit). Sigurisht, kjo formë e pengut që ekziston për interesin e kryerësit të kontrollit është një formë e pengut ligjor dhe ekziston vetëm mbi sendet-mallrat të cilat janë lëndë e kontratës për kontrollimin e mallrave dhe të cilat gjinden në posedimin, ose kontrollin e kryerësit të kontrollit. Përveç dispozitave të parapara në këtë Nen, për realizimin e të drejtës së pengut të kryerësit të kontrollit të themeluar nga kjo bazë zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës së pengut.

Neni 875. Të besuarit e kontrollit të mallit kryerësit tjetër të kontrollit

- 1. Kryerësi i kontrollit mund t'ia besojë tjetrit kryerjen e kontrollit të kontraktuar të mallit, përveç nëse porositësi i kontrollit ia ka ndaluar këtë shprehimisht.**
 - 2. Kryerësi i kontrollit i përgjigjet porositësit të kontrollit për punën e kryerësit tjetër të kontrollit.**
-

875.1. Sipas formulimit të paragrafit të parë të këtij Neni kontrolluesi mund t'ia bartë të tretit mundësinë e kontrollimit të mallit, gjegjësisht palës së tretë të specializuar për kontrollimin e mallit. Në kuptim të paragrafit në fjalë, kjo mundësi mund të përjashtohet vetëm nëse palët shprehimisht me kontratë janë marrë vesh për të njëjtën. Në rastin e dytë bëhet fjalë për kontratë intuitive personale, ashtu që kryerësi i kontrollit nuk mund të bartë përgjegjësitë e tij kontraktuese në palën e tretë.

875.2. Paragrafi i dytë i nenit 875 të LMD-së themelon përgjegjësinë e kryerësit të kontrollit që në rast se ai ia beson të tretit (nën kontraktuesit të tij) kontrollin e mallit, kryerësi i kontrollit përgjigjet jo vetëm për përzgjedhjen e nënkontraktuesit të tij, por edhe për punën e tij.

Neni 876. Kontrolli i mallit me kryerjen e disa veprimeve juridike

- 1. Në bazë të urdhërit shprehimor të porositësit të kontrollit, kryerësi i kontrollit është i autorizuar që, përpos kryerjes së kontrollit të mallit të ushtrrojë edhe veprime të veçanta juridike në emër dhe për llogari të porositësit të kontrollit.**
- 2. Kryerësi i kontrollit ka të drejtë shpërblimi të veçantë të rëndomtë ose të kontraktuar për kryerjen e veprimeve të veçanta juridike në emër dhe për llogari të porositësit të kontrollit.**

876.1. Paragrafi i parë i nenit 876 të LMD-së thekson shtrirjen e autorizimeve të dhëna nga porositësi i kontrollit edhe në kryerjen e disa veprimeve juridike të veçanta e që ndërlidhen me realizimin e kontrollimit të mallit të porositësit; këtu mbi të gjitha mendohet në marrjen e mallrave (nga palët e treta) në emër dhe llogari të porositësit. Në rastet e tilla nga paragrafi në fjalë kryerësi i kontrollit vepron si agjenti i porositësit, pasi që i njëjti veprimet e tilla juridike i kryen në emër dhe për llogarinë e porositësit, ashtu që i njëjti ka për detyrim që të zbatoj urdhrin e përfaqësimit nga porositësi, gjegjësisht si ekspert dhe ekonomist i mirë ta mbrojë interesin e porositësit të kontrollit në raport me palët e treta.

876.2. Për rastet e lejuara nga paragrafi më lartë I këtij Neni, kur kryerësi i kontrollit ushtron veprime juridike në emër dhe për llogari të porositësit, paragrafi I dytë I të njëjtit nen njuh të drejtën në shpërblim të veçantë të kryerësit të kontrollit. Ky shpërblim I veçantë I cili duhet ti paguhet si shtesë kryerësit të kontrollit rëndom mund të kontraktohet ndërmjet palëve, ose në raste tjera në mungesë të kontraktimit zbatohen tarifrat e kontrolluesit të mallit, gjegjësisht paguhet shpërblim adekuat - i rëndomtë (proporcional me shërbimin e dhënë) në mungesë të tarifave përkatëse.

Neni 877. Kontrolli i mallit me garanci

- 1. Kryerësi i kontrollit mund të garantojë për pandryshueshmërinë e cilësive të mallit të kontraktuar brenda afatit kontraktues.**
- 2. Për garancinë e marrë përsipër në pikëpamje të cilësive të mallit, kryerësi i kontrollit ka të drejtë shpërblimi të veçantë të kontraktuar ose të rëndomtë.**

877.1. Paragrafi i parë i këtij neni lejon mundësinë që kryerësi i kontrollit mund të garantojë për pandryshueshmërinë e cilësive të mallit (i cili i është nënshtruar kontrollit) brenda afatit kontraktues (afati i garancionit). Në kuptim të këtij paragrafi, palët me kontratë

mund të rregullojnë situatën, ashtu që kryerësi i kontrollit i lëshon garancion përkatës porositësit, duke i garantuar të njëjtit cilësinë adekuate të mallit të kontrolluar gjatë afatit të garancionit; në këtë kuptim psh. kryerësi i kontrollit mund t'i verifikoj cilësitë e mallit dhe të lëshoj afat të garancisë se për sa kohë malli i kontrolluar do t'i ruaj cilësitë (tiparet) e vërtetuara me kontroll (kjo mundësi përdoret shumë në industrinë ushqimore, etj). Në kuptim të kësaj kryerësi i kontrollit do të jetë përgjegjës për garantimin e karakteristikave të pandryshueshme të mallrave gjatë periudhës së garancisë.

877.2. Për rastet e lejuara nga paragrafi më lartë i këtij Neni, kur kryerësi i kontrollit lëshon garancion përkatës se malli i kontrolluar do t'i ruaj cilësitë e verifikuara-kontratuara, paragrafi i dytë i të njëjtit nen njih të drejtën në shpërblim të veçantë të kryerësit të kontrollit. Ky shpërblim i veçantë i cili duhet t'i paguhet si shtesë kryerësit të kontrollit rëndom mund të kontraktohet ndërmjet palëve, ose në raste tjera në mungesë të kontraktimit zbatohen tarifatat e kryerësit të kontrolluesit të mallit, gjegjësisht paguhet shpërblim adekuat - i rëndomtë (proporcional me shërbimin e dhënë) në mungesë të tarifave përkatëse.

Neni 878. Kontrolli i shërbimeve dhe i sendeve që nuk janë destinuar për qarkullim

Në qoftë se kontrolli ka të bëjë me shërbime ose me sende që nuk janë destinuar për qarkullim, kryerësi i kontrollit dhe porositësi i kontrollit kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse të kontrolli i mallit.

878. LMD, në Nenin në fjalë saktëson se, dispozita të njëjta për kontrollimin e mallrave, të njëjtat ashtu si u komentuan më lartë në këtë pjesë të LMD-së për kontratën për kontrollimin e mallrave; të njëjta dispozita vlejnë edhe për rastet kur lëndë e kontrollimit të mallrave janë sendet, gjegjësisht mallrat të cilat nuk janë të destinuara për qarkullim; gjegjësisht se kryerësi i kontrollit dhe porositësi kanë të drejta dhe detyrime të njëjta si të rasti i kontratës për kontrollimin e mallrave të destinuara për qarkullim (e që është kryesisht rast shumë më i shpeshtë ky i fundit).

Neni 879. Zgjidhja e kontratës

Porositësi i kontrollit mund të deklarojë se e zgjidhë kontratën gjithnjë gjersa të mos jetë kryer kontrolli i porositur, por në këtë rast ka për detyrë që kryerësit të kontrollit t'i paguajë pjesën proporcionale të shpërblimit dhe shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme që janë bërë, si dhe t'ia shpërblejë dëmin.

879. LMD, në Nenin në fjalë i mundëson të drejtën porositësit të kontrollit që i njëjti të mund të deklarojë se e zgjidhë njëanësisht kontratën gjithnjë gjersa të mos jetë kryer

kontrolli i porositur i mallit të dorëzuar; me të drejtë mendohet se është bërë kjo zgjidhje në LMD, pasi që është porositësi ai i cili duhet të vendosë për fatin e kontratës, interesin e kontrollimit të mallit dhe eventualisht heqjen dorë nga kontrata (përderisa kontrollimi i mallit nuk është përfunduar, ashtu që i njëjti nuk ka nevojë as t'i komunikoj arsyet e heqjes dorë palës tjetër kontraktuese). Megjithatë, për rastet kur porositësi deklaron shkëputje të njëanshme të kontratës, porositësi i kontrollit ka për detyrë që kryerësit të kontrollit t'i paguajë pjesën proporcionale të shpërblimit (nëse një pjesë e kontrollimit të mallit është realizuar), si dhe shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme që janë bërë (në lidhje me mbajtjen dhe ruajtjen e sendeve për kohën sa kanë qëndruar sendet të I njëjti), si dhe t'ia shpërblejë dëmin (nëse i njëjti i është shkaktuar kryerësit të kontrollit).

Abdulla Aliu

Neni 880. Përkufizimi

- 1. Me kontratën mbi organizimin e udhëtimit obligohet organizatori i udhëtimit t'i jap udhëtarit një paketë shërbimesh që përbëhen nga transporti, banimi dhe nga shërbimet e tjera që lidhen me të, kurse udhëtari obligohet që organizatorit ti paguajë një shumë të përgjithshme (paushale).**
- 2. Shitësi i paketës së udhëtimit, të ofruar nga organizatori i udhëtimit, i cili nuk ka zyre kryesore në atë vend, konsiderohet të jetë organizatori i udhëtimit.**

XXI. Vështrim i përgjithshëm. Pjesa e njëzet e një e LMD të Kosovës, rregullon kontratën për organizimin e udhëtimit (Aranzhmanet Turistike) ku përfshihen : rregullat e përgjithshme që vlejné për kontratat për organizimin e udhëtimit; lëshimin e vërtetimit për udhëtimin; detyrimet e organizatorit të udhëtimit; detyrimet e udhëtarit; të drejtat dhe detyrimet e veçanta të palëve kontraktuese; dhe pastaj pjesa e njëzet e dy (XXII) ku përfshihen : kontrata ndërmjetësuese për udhëtimin; pjesa e njëzet e tre (XXIII) kontratën për angazhimin e kapaciteteve të hotelierisë (Kontrata për Allotmanin); detyrimet e agjencisë turistike; detyrimet e hotelierit; si dhe të drejtat e agjencisë turistike për të hequr dorë nga kontrata (nenet 880 – 917). Kontrata për organizimin e udhëtimit është kontratë e veçantë me emër, që rregullohet me LMD të Kosovës, dhe me kontratën për organizimin e udhëtimit, krijohet një marrëdhënie juridiko-detyimore ndërmjet organizuesit të udhëtimit që zakonisht janë agjensione të specializuara dhe përfituesit të shërbimit nga agjensionet e organizuara për udhëtim (udhëtarit). Objekti i kësaj kontrate rregullohet edhe me ligj të veçantë (Ligji për Turizmin i Kosovës, këtu e tutje Ligji për Turizmin)⁷⁰². Dispozitat me të cilat rregullohen marrëdhëniet kontraktuese ndërmjet organizatorit të udhëtimit dhe udhëtarit si shfrytëzues i udhëtimit të organizuar, gjithmonë avancohen për shkak të zhvillimit të fuqishëm të lëmit të turizmit⁷⁰³ sepse ata gjithmonë kërkojnë shërbime të reja për plotësimin e nevojave të tyre. Krijohen rregulla juridike me të cilat përsoset jetësimi i turizmit në ditët e sotme. Në literaturën juridike thuhet se, ligjdhënësi nuk e rregullon ose e rregullon vetëm pjesërisht gjithë materien e marrëdhënieve personale në dhënien e shërbimeve turistike, andaj njerëzit afarist janë të detyruar të kërkojnë zgjidhje plotësuese me të cilat rregullohen këto marrëdhënie turistike siç janë uzansat⁷⁰⁴; doket afariste; kushtet e përgjithshme; kontratat standarde dhe te adezionit dhe duke respektuar etikën profesionale, ndërtojnë të drejtën autonome me të cilat janë zhvilluar edhe kontratat e veçanta tipe⁷⁰⁵. Me kontratën

702 Ligji Nr. 04/L-176 për Turizmin i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.14, datë 10 Maj 2013.

703 Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 3, pika 1.23, ku thuhet “Turizëm – veprimtari e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm për jo më shumë se një (1) vit radhazi për argëtim, punë dhe qëllime të tjera, që nuk lidhen me ushtrimin e ndonjë veprimtarie”.

704 Lidhur me uzansat turistike, shih : Uzansat e veçanta për turizmin të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, Nr. 33/01.

705 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1294.

për organizimin e udhëtimit krijohen marrëdhënie juridike midis dhënësit të shërbimeve turistike dhe shfrytëzuesve të shërbimeve turistike, pastaj marrëdhënia midis agjencionit të udhëtimit dhe shfrytëzuesit të udhëtimit, si dhe marrëdhënia midis dhënësit të shërbimeve dhe agjensive turistike. Emërtimi i kontratës për organizimin e udhëtimit (Aranzhmanet Turistike) të cilën e kemi në LMD të Kosovës, ka qenë edhe në LMD të vitit 1978, dhe në literaturën juridike ofrohen edhe emërtimet e ndryshme nëpër vende të ndryshme kur bëhet fjalë për këtë lloj të kontratës⁷⁰⁶. Ndërsa, lidhur me burimin e dispozitave për kontratën për organizimin e udhëtimit të cilën e ka paraparë edhe ish-LMD i vitit 1978, në literaturën juridike numërohen : Konventat Ndërkombëtare, të cilat kanë ekzistuar para miratimit të LMD të vitit 1978⁷⁰⁷. Me qëllim të unifikimit të përmbajtjes së kontratës për organizimin e udhëtimit është nxjerrë edhe Konventa Ndërkombëtare për kontratën e udhëtimit, e miratuar në Bruksel në vitin 1970⁷⁰⁸. Gjithashtu, ekziston edhe Direktiva e Këshillit të Evropës (90/314/EEC) e datës 13 Qershor 1990, e cila përmban dispozita që janë objekt i kontratës për organizimin e udhëtimit⁷⁰⁹.

880. Vështrim i përgjithshëm. Neni 880 i LMD të Kosovës, përkufizon kontratën mbi organizimin e udhëtimit duke na dhënë kuptimin e përmbajtjes së kontratës mbi organizimin e udhëtimit⁷¹⁰. Lidhja e kontratës për organizimin e udhëtimit bëhet në pajtim me dispozitat

706 Më gjerësisht, shih : Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1295-1296.

707 Më gjerësisht, shih : Ćavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 1023.

708 Konventa Ndërkombëtare për Kontratën e Udhëtimit e vitit 1970, Bruksel, cituar sipas Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1297;

709 Direktiva e Këshillit të Evropës (90/314/EEC) e datës 13 Qershor 1990; LMD i Kosovës, ka përfshirë Direktivat Evropiane që rregullojnë çështje nga fusha e së drejtës detyrimore.

710 Lidhur me kontratën për udhëtimin mbi paketën turistike edhe Ligji për Turizmin i Kosovës, përmban dispozitë ku parashihet, neni 17, paragrafi 1, 1. Duke mos paragjykuar Ligjin përkatës për detyrime, kontrata udhëtimit mbi paketën turistike duhet të përmbajë së paku elementet e listuara më poshtë: 7.1.1. destinacionin e udhëtimit, periudhën e qëndrimit dhe datat e udhëtimit; 1.2. mjetet, karakteristikat dhe kategoritë e transportit që do të përdoren, datat, kohën dhe pikat e nisjes dhe të kthimit; 1.3. kur paketa përfshin akomodimin, vendndodhjen e akomodimit, përfshirë kategorinë turistike, karakteristikat tjera kryesore dhe planin e vakteve ushqimore; 1.4. nëse numri i vendeve për një paketë është i kufizuar për një numër minimal të personave, është e nevojshme dhe duhet informuar konsumatorin për afatin e fundit në rast se vjen të anulimi; 1.5. itinerarin; 1.6. me rastin kur ka vizita, ekskursione apo shërbimet e tjera janë të përfshira në çmimin e përgjithshëm, gjithsesi duhet njoftuar konsumatorin; 1.7. emrin dhe adresën e organizatorit/ndërmjetësuesit dhe kur është e nevojshme edhe të ofruesit të sigurimit; 1.8. çmimin e paketës, njoftimin për mundësinë e rishikimit të çmimeve dhe njoftim për secilin obligim, taks apo pagës për shërbime të caktuara (aterim, hyrje apo dalje nga portet, taksa turistike) kostoja e te cilave nuk është përfshi brenda paketës; 1.9. orarin e pagesës dhe mënyrën e pagesës; 1.10. kërkesa të veçanta të cilat konsumatori i ka komunikuar organizatorit/ndërmjetësuesit në rastin kur është bërë rezervimi dhe palët e përfshira janë pajtuar; 1.11. periudha brenda të cilës konsumatori duhet të bëjë ndonjë ankesë në lidhje me dështimin rreth realizimit apo të një performace jo të duhur të kontratës; 1.12. të gjitha kushtet e kontratës duhet të paraqiten në formë të shkruar apo formë tjetër që është e kuptueshme dhe e kapshme për konsumatorin dhe duhet t'i komunikohen atij përpara lidhjes së kontratës. Konsumatori duhet ti dorëzohet një kopje e këtyre kushteve; 1.13. këto kushte nuk përjashtojnë rastet e rezervimeve apo kontrata që bëhen në minutën së fundit. 2. Në rastin kur konsumatori has në pengesa gjatë procedimit me paketën, ai mund të transferoj rezervimin e tij, pasi ti ketë dhënë organizatorit ose ndërmjetësuesit paraprakisht një njoftim të arsyeshëm për qëllimin e tij para nisjes, te një personi i cili plotëson të gjitha kushtet e zbatueshme për paketë. 3. Transferuesi i paketës dhe pranuesi i transferimit do të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës ndaj organizatorit apo ndërmjetësuesit në kontratë për pagesën e bilancit

e përgjithshme që i përmban LMD i Kosovës për lidhjen e kontratave⁷¹¹.

880.1. Paragrafi 1, përmban dispozitën lidhur me përkufizimin e kontratës për organizimin e udhëtimit⁷¹² dhe shprehimisht parasheh se me kontratën për organizimin e udhëtimit, organizatori i udhëtimit⁷¹³ obligohet që t'i japë udhëtarit një paketë shërbimesh⁷¹⁴ që përbëhet

dhe për shkak të çdo kostoje shtesë që rrjedh nga transferimi i tillë. 4. Çmimet e përcaktuara në kontratë nuk do t'i nënshtrohen rishikimit, përjashtuar rastet kur kontrata shprehimisht parashikon mundësinë e rishikimit dhe konstaton pikërisht se si çmimi i rishikuar duhet llogaritur. Variacionet janë të lejuara vetëm me rastin kur behet fjalë për: 4.1. shpenzimet e transportit, duke përfshirë koston e karburantit; 4.2. detyrimet, taksat ose tarifat e ngarkuara për shërbime të caktuara, si taksat e aterimit, taksat e ngarkimit dhe zbarkimit në porte dhe aeroporte; 4.3. kurset e këmbimit aplikuar në paketë të veçantë. 5. Gjatë njëzet (20) ditëve para datës së përcaktuar të nisjes, çmimi i deklaruar në kontratë nuk duhet të ngritët. 6. Nëse organizatori konstaton para nisjes se, ai është detyruar të ndryshojë ndjeshëm ndonjë prej kushteve thelbësore, të tilla si çmimi, ai duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur konsumatorin në mënyrë që t'ia mundësojë atij për të marrë vendim të përshtatshëm dhe në veçanti: 6.1. të tërhiqet nga kontrata pa dënim, ose; 6.2. të pranojë një konkluzion të kontratës duke specifikuar ndryshimet e bëra dhe ndikimin e tyre në çmim. 7. Konsumatori duhet të informojë organizatorin ose ndërmjetësuesin për vendimin tij sa më shpejt të jetë e mundur. 8. Nëse konsumatori tërhiqet nga kontrata, ose nëse, për çfarëdo arsye, përveç fajit të konsumatorit, organizatori anulon paketën para datës së akorduar të nisjes, konsumatori ka të drejtë: 8.1. të bej zëvendësim të paketës me paketë të cilësisë ekuivalente ose më të lartë, kur organizatori/ndërmjetësuesi është në gjendje të ofrojë atij një zëvendësim të tillë. Nëse paketa e zëvendësuar e ofruar është e cilësisë më të ulët, organizatori duhet t'i kthejë dallimin në çmim konsumatorit, ose; 8.2. t'i kompensohet sa më shpejt të jetë e mundur të gjithë shumën e paguar sipas kontratës. Në një rast të tillë, ai ka të drejtë, nëse është e përshtatshme, që të kompensohet qoftë nga organizatori ose nga ndërmjetësuesi për mos kryerjen e kontratës, përveç kur: 8.2.1. anulimi është për arsye se numri i personave të regjistruar për paketë është më i vogël se numri minimal i kërkuar dhe konsumi është informuar për anulimin, me shkrim, brenda periudhës së përcaktuar në përshkrimin e paketës, ose; 8.2.2. anulimi, është për arsye të forcës madhore, domethënë rrethanave të pazakonta dhe të paparashikueshme jashtë kontrollit të palës prej të cilit është pranuar, pasojat e të cilave nuk mund të ishin shmangur edhe nëse është ushtruar i gjithë kujdesi i duhur. 9. Nëse, pas nisjes (fillimit të realizimit të paketës), një pjesë e konsiderueshme e shërbimeve të kontraktuara nuk jepen ose organizatori kupton se ai nuk do të jetë në gjendje për të blerë një pjesë të konsiderueshme të shërbimeve që do të ofrohen, organizatori obligohet të marr masat e përshtatshme alternative, pa kosto shtesë për konsumatorin për vazhdimin e paketës, dhe kur është e nevojshme t'i kompensojë konsumatorit për dallimin në mes të shërbimeve të ofruara dhe atyre të zbatuara. 10. Në qoftë se është e pamundur për të bërë një marrëveshje të tillë apo kjo është e papranueshme për konsumatorin për një arsye të qëndrueshme, organizatori duhet, kur kërkojnë rrethanat, t'i sigurojë konsumatorit, pa kosto shtesë, transportim ekuivalent në vendin e nisjes, ose në një tjetër pike kthimi me ç'rast konsumatori ka rënë dakord dhe kur kërkojnë rrethanat ta kompensojë konsumatorin.

711 Kontrata për organizimin e udhëtimit konsiderohet se është lidhur nga palët në momentin kur ato merren vesh për elementet thelbësore të kontratës të cilat janë : dispozitat për llojin dhe vëllimin e shërbimeve; për çmimin e shërbimeve; dhe kohën e shfrytëzimit të tyre.

712 Kontrata për organizimin e udhëtimit është kontratë e dyanshme detyruese sepse ka detyrime për të dy palët, pastaj është kontratë barroësore, komutative, dhe në shumicën e rasteve kontratë me shkrim.

713 Organizatori i udhëtimit konsiderohet personi i cili në mënyrë të rregullt ofron organizimin e paketë-aranzhmaneve. Organizatori i udhëtimit është zakonisht agjenci turistike që organizon paketë aranzhmanin turistik dhe paketa udhëtimesh qoftë drejtpërdrejtë, qoftë përmes ndërmjetësuesve/agjentëve të saj (Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 3, pika 1.10); Organizatori i udhëtimit nënkuptohet personi i cili rregullisht organizon paketë-aranzhmane, i shet ose i ofron për shitje drejtpërsëdrejti ose me ndërmjetësimin e shitësit.

714 Paketë Shërbimesh, sipas Ligjit për Turizmin të Kosovës, është : neni 14, paragrafi 1, ku thuhet "Paketa turistike është një kombinim i parapërgatitur shërbimesh që shitet ose ofrohet për shitje dhe mbulon një periudhë për më shumë se njëzet e katër (24) orë ose përfshin një natë akomodimi", paragrafi 2 "Paketa turistike përbëhet prej jo më pak se dy prej shërbimeve të mëposhtme: 2.1.

nga transporti⁷¹⁵, banimi⁷¹⁶, dhe nga shërbimet e tjera që lidhen me të⁷¹⁷, kurse udhëtari obligohet që organizatorit të udhëtimit t'i paguajë një shumë të përgjithshme (paushalle)⁷¹⁸.

transporti; 2.2. akomodimi; 2.3. shërbime të tjera të pavarura nga transporti dhe akomodimi dhe që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të paketës që do të përfshihen në këtë kombinim”, paragrafi 3 “Kur organizatori ofron për shitje paketën turistike, ajo (paketa) duhet ti ofrohet blerësit/konsumatorit e përpiluar në materiale reklamuese dhe njëherit duhet të plotësoj të gjitha kushtet e programit të udhëtimit të parapara me ketë ligj” dhe paragrafi 4 “Çdo çështje shpjeguese në lidhje me paketën turistike të ofruar nga organizatori apo ndërmjetësuesi nuk duhet të përmbaj informata të pasaktë dhe qorientuese kur ka të bëjë me çmimin ose kushtet tjera që ndërlihen me kontratën”; neni 16, paragrafi 1 “Organizatori apo ndërmjetësuesi duhet t’i sigurojë konsumatorit me shkrim ose ndonjë formë tjetër të përshtatshme, para se të lidhet kontrata, informacionin e përgjithshëm mbi pasaporta dhe kërkesat e aplikueshme për viza dhe në veçanti për periudhën e marrjes së tyre, si dhe informacion për formalitetet shëndetësore të nevojshme mbi udhëtimin dhe qëndrimin. 2. Organizatori ose ndërmjetësuesi duhet të siguroj konsumatorin me shkrim ose ndonjë formë tjetër të përshtatshme, informacionin e mëposhtëm në kohë të mjaftueshme para fillimit të udhëtimit: 2.1. për kohën dhe vendin e ndalesave të ndërmjetme dhe lidhjet e transportit, si dhe detajet e vendit që është paraparë për udhëtarin gjatë udhëtimit; 2.2. emrin, adresën dhe numrin e telefonit të organizatorit ose ndërmjetësuesit apo përfaqësuesit, ose në mungesën e tyre, të agjencive lokale në ndihmën e të cilit/ve një konsumator në vështirësi mund të telefonon; 2.3. në mungesën e këtyre përfaqësuesëve, konsumatori duhet gjithsesi të pajiset me një numër të telefonit të urgjencës apo ndonjë informacion tjetër që do t’i mundësojë atij të kontaktoj organizatorin ose ndërmjetësuesin në rast nevojë; 2.4. përgjatë udhëtimeve ose qëndrimit jashtë vendit për të miturit, duhet njoftuar dhe bërë të mundur kontakt të drejtpërdrejtë në mes të prindit ose kujdestarin me fëmijën ose personin përgjegjës në vendin e qëndrimit të fëmijës;

2.5. informacionin mbi polisën e sigurimit për të mbuluar koston e anulimit të udhëtimit nga ana e konsumatorit ose koston e asistencës, përfshirë zhdëmtimin, në rast aksidenti ose sëmundje”.

715 Transporti nënkupton bartjen e udhëtarit të cilit i ofrohet shërbimi turistik nga vendi i nisjes deri te destinacioni dhe anasjelltas, në rastet kur përfshihen edhe transporte tjera në kuadër të paketës turistike, atëherë dhënësi i shërbimit duhet t’i organizojë transport komod, në pajtim me vërtetimin për udhëtimin. Transporti mund të jetë, tokësor, ajror apo detar.

716 Banimi nënkupton vendosjen e shfrytëzuesit të udhëtimit nën kushtet e parapara në vërtetimin e udhëtimit për kohën e paraparë në paketën e udhëtimit. Banimi (vendosja) duhet të bëhet ashtu siç e kanë paraparë palët me kontratë si në kualitetin e hotelit ashtu edhe në kualitetin e dhomës. Me ligj, caktohet çka është dhoma individuale në hotel, çka është apartamenti, etj.

717 Shërbimet e tjera që mund të parashihen në paketën turistike, nënkuptojnë që Organizatori apo ndërmjetësuesi duhet t’i sigurojë konsumatorit me shkrim ose ndonjë formë tjetër të përshtatshme, para se të lidhet kontrata, informacionin e përgjithshëm mbi pasaporta dhe kërkesat e aplikueshme për viza dhe në veçanti për periudhën e marrjes së tyre, si dhe informacion për formalitetet shëndetësore të nevojshme mbi udhëtimin dhe qëndrimin”. Pastaj, Organizatori ose ndërmjetësuesi duhet të siguroj konsumatorin me shkrim ose ndonjë formë tjetër të përshtatshme, informacionin e mëposhtëm në kohë të mjaftueshme para fillimit të udhëtimit: 2.1. për kohën dhe vendin e ndalesave të ndërmjetme dhe lidhjet e transportit, si dhe detajet e vendit që është paraparë për udhëtarin gjatë udhëtimit; 2.2. emrin, adresën dhe numrin e telefonit të organizatorit ose ndërmjetësuesit apo përfaqësuesit, ose në mungesën e tyre, të agjencive lokale në ndihmën e të cilit/ve një konsumator në vështirësi mund të telefonon; 2.3. në mungesën e këtyre përfaqësuesëve, konsumatori duhet gjithsesi të pajiset me një numër të telefonit të urgjencës apo ndonjë informacion tjetër që do t’i mundësojë atij të kontaktoj organizatorin ose ndërmjetësuesin në rast nevojë; 2.4. përgjatë udhëtimeve ose qëndrimit jashtë vendit për të miturit, duhet njoftuar dhe bërë të mundur kontakt të drejtpërdrejtë në mes të prindit ose kujdestarin me fëmijën ose personin përgjegjës në vendin e qëndrimit të fëmijës; 2.5. informacionin mbi polisën e sigurimit për të mbuluar koston e anulimit të udhëtimit nga ana e konsumatorit ose koston e asistencës, përfshirë zhdëmtimin, në rast aksidenti ose sëmundje”.

718 Shuma e përgjithshme (paushalle) e pagesës, nënkupton shpërblimin që duhet t’i paguajë përfituesi i udhëtimit organizatorit të udhëtimit. Kjo pagesë, realizohet në pajtim me kontratën mbi organizimin e udhëtimit.

880.2. Paragrafi 2, përmban dispozitën sipas të cilës shitësi i paketës së udhëtimit, të ofruar nga organizatori i udhëtimit i cili nuk ka zyrë kryesore në atë vend, konsiderohet të jetë organizatori i udhëtimit. Sipas kësaj dispozite, kur shitësi i paketës së udhëtimit⁷¹⁹ nuk ka zyrë kryesore në vendin ku organizohet udhëtimi dhe ky udhëtim është bërë nga organizatori i udhëtimit, atëherë vet shitësi i paketës së udhëtimit konsiderohet organizatori i udhëtimit. LMD i Kroacisë, për dallim nga LMD i Kosovës, e ka më të qartë këtë dispozitë sepse shprehimisht parasheh se organizator i udhëtimit konsiderohet edhe personi që shet paketë-aranzhmane që i ka përgaditur ndonjë person tjetër. LMD i Kroacisë, nuk e përmend se shitësi i paketë-aranzhmanit turistik konsiderohet organizator i udhëtimit nëse nuk ka zyrë kryesore në atë vend⁷²⁰.

Neni 881. Dhënia e vërtetimit mbi udhëtimin

- 1. Organizatori i udhëtimit deri më së largu me rastin e lidhjes së kontratës, i lëshon udhëtarit vërtetimin mbi udhëtimin ose duhet të lidhë kontratë në formë të shkruar e cila përmban të gjitha pjesët e detyrueshme të vërtetimit mbi udhëtimin.**
- 2. Vërtetimi i udhëtimit duhet të përmbajë vendin dhe datën e përdorimit, logon dhe titullin e organizatorit të udhëtimit, emrin e udhëtarit, lokacioni dhe datat e fillimit dhe mbarimit të paketës së udhëtimit, numrin e ditëve të banimit, informatat e nevojshme për oraret, çmimet dhe kushtet e transportit dhe cilësia e llojeve të transportit, informatat e nevojshme për banimin duke përfshirë edhe vendin e banimit si dhe tipin dhe kategorinë e ambienteve të banimit, informatat në lidhje me numrin e shujtave (psh. shujtat e plota, gjysma e shujtave, shtrati dhe mëngjesi) detajet e orareve të udhëtimit dhe informata për shërbimet tjera të përfshira në çmimin e përgjithshëm, informata nëse është i nevojshëm ekzistimi i një minimumi të udhëtarëve në mënyrë që udhëtimi të realizohet si dhe afatin kohor kur do të njoftohet udhëtari për ndonjë anulim, çmimin e përgjithshëm për paketën e shërbimeve të parapara në kontratë, kushtet në bazë të të cilave udhëtari mund të kërkojë anulimin e kontratës, afatet kohore për ankesat dhe kërkesat për zbritje të çmimit për shkak të cilësisë së dobët apo për shërbimet jo të plota, informatat e nevojshme në lidhje me kushtet formale të kufijve dhe doganave, higjienës, rregullat tjera financiare dhe administrative, si dhe informatat tjera të cilat konsiderohen se janë të dobishme nëse përfshihen në vërtetimin e udhëtimit.**

719 Shitësi i paketës së udhëtimit është subjekti i cili shet ose ofron shërbime në paketë të udhëtimeve sipas kërkesave të organizatorit të udhëtimeve. Organizatori i udhëtimit është ai i cili kontraktton paketën e udhëtimit nga shitësi i udhëtimeve ndërsa personat që blejnë paketë-aranzhmanin nga organizatori i udhëtimit janë konsumatorët e udhëtimit. Konsumatori mund të jetë individual ose grup personash. Lidhur me këtë, Direktiva e Këshillimit të Evropës (90/314/EEC) e datës 13 Qershor 1990, në nenin 2, pika 4, parasheh “Konsumator” do të thotë personi i cili merr ose pranon të marrë paketën (‘kontraktori kryesor’), ose çdo personi tjetër për llogari të të cilit kontraktuesi kryesor bie dakord për të blerë paketën (‘përfituesit e tjerë’) ose çdo person, të cilit kontraktuesi kryesor apo ndonjë nga përfituesit e tjerë i transferon paketën (‘marresi’).

720 LMD i Kroacisë, neni 881, paragrafi 3.

3. Në qoftë se para lëshimit të vërtetimit mbi udhëtimin udhëtarit i është dhënë programi i udhëtimit, ku ndodhen të dhënat nga paragrafi paraprak, vërtetimi mbi udhëtimin mund të përmbajë vetëm udhëzimin për këtë program.

881. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 881, përmban dispozitën me të cilën organizatori i udhëtimit obligohet që shfrytëzuesit të udhëtimit t'i ofrojë dokumentin (vërtetimin) mbi udhëtimin.

881.1. Paragrafi 1 i këtij neni, përcakton se organizatori i udhëtimit ka për detyrim që më së voni deri me rastin e lidhjes së kontratës t'i lëshojë udhëtarit vërtetimin mbi udhëtimin i cili vërtetim përmban elementet e nevojshme për realizimin e udhëtimit. Paragrafi vijues, parasheh se çka duhet të përmbajë vërtetimi i udhëtimit. Nëse organizatori i udhëtimit, nuk i ka lëshuar vërtetimin mbi udhëtimin deri me rastin e lidhjes së kontratës ai atëherë duhet të lidhë kontratën në formë të shkruar e cila duhet t'i përmbajë të gjitha pjesët e detyrueshme të vërtetimit mbi udhëtimin. Kjo dispozitë, parasheh detyrimin e organizatorit të udhëtimit që udhëtarit t'i lëshojë vërtetimin mbi udhëtimin ose të lidhë kontratë në formë të shkruar ku do të përfshihen të gjitha pjesët e detyrueshme të vërtetimit mbi udhëtimin. Kontrata e cila zëvendëson vërtetimin e udhëtimit duhet të jetë me shkrim e lidhur ndërmjet organizatorit të udhëtimit respektivisht përfaqësuesit të organizatorit të udhëtimit dhe shfrytëzuesit të udhëtimit.

881.2. Paragrafi 2, përmban dispozitën me të cilën shprehimisht parashihet se çka duhet të përmbajë vërtetimi i udhëtimit. Sipas kësaj dispozite, vërtetimi i udhëtimit të cilën e lëshon organizatori i udhëtimit duhet të përmbajë vendin dhe datën e përdorimit⁷²¹; logon dhe titullin e organizatorit të udhëtimit⁷²²; emrin e udhëtarit⁷²³; lokacionin dhe datat e fillimit dhe mbarimit të paketës së udhëtimit⁷²⁴; numrin e ditëve të banimit⁷²⁵; informatat e nevojshme për oraret⁷²⁶; çmimet dhe kushtet e transportit dhe cilësia e llojeve të

721 Vendi ku lëshohet vërtetimi respektivisht ku organizatori i udhëtimit e ka selinë si dhe datën e lëshimit të vërtetimit respektivisht adresa e saktë e organizatorit të udhëtimit i cili e lëshon vërtetimin e udhëtimit. LMD i Kosovës, në paragrafin 2, përdorë fjalën “datën e përdorimit” ndërsa kjo shprehje duhet kuptuar “data e lëshimit” të vërtetimit nga organizatori i udhëtimit.

722 Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 6, paragrafi 7, ku thuhet “Njësia përkatëse organizative për turizëm dhe Këshilli i turizmit të Kosovës do të kenë një identifikim grafik ose logo që të regjistruarit do të jenë të autorizuar për t'i përdorur pas regjistrimit”. Logoja, është shenja me të cilën identifikohet organizatori i udhëtimit. Ndërsa, titulli i organizatorit të udhëtimit duhet të tregojë veprimtarinë turistike të tij, p.sh., Agjensioni Turistik “Prishtina”.

723 Emri i udhëtarit nënkupton emrin e shfrytëzuesit të paketës turistike (aranzhmanit turistik). Emri duhet të përmbajë : Emrin dhe Mbiemrin; Numrin personal të identifikimit; Vendbanimin (shënimet nga dokumenti zyrtar i tij – Leja e njoftimit/Pasaporta).

724 Lokacioni nënkupton vendin ku do të realizohet paketa turistike (aranzhmani turistik). Ndërsa datat e fillimit dhe mbarimit të paketës së udhëtimit nënkuptojnë ditën e nisjes respektivisht të kthimit pas përfundimit të paketë-aranzhmanit turistik.

725 Numri i ditëve të banimit, nënkupton numrin e ditëve të fjetjes në vendin ku organizohet paketë-aranzhmani.

726 Informatat e nevojshme për oraret nënkupton kohën e nisjes dhe të kthimeve të organizuara për transport, pastaj kohën e fillimit të fjetjes dhe kohën e mbarimit të qëndrimit në hotel, si dhe oraret

transportit⁷²⁷; informatat e nevojshme për banimin duke përfshirë edhe vendin e banimit si dhe tipin dhe kategorinë e ambienteve të banimit⁷²⁸; informatat në lidhje me numrin e shujtave, p.sh., shujtat e plota, gjysma e shujtave, shtrati dhe mengjesi⁷²⁹; detajet e orareve të udhëtimit⁷³⁰; dhe informata për shërbime tjera të përfshira në çmimin e përgjithshëm⁷³¹; informata nëse është i nevojshëm ekzistimi i një minimumi të udhëtarëve në mënyrë që udhëtimi të realizohet si dhe afatin kohor kur do të njoftohet udhëtari për ndonjë anulim⁷³², çmimin e përgjithshëm për paketën e shërbimeve të parapara në kontratë⁷³³, kushtet në bazë të të cilave udhëtari mund të kërkojë anulimin e kontratës⁷³⁴, afatet kohore për ankesat dhe kërkesat për zbritje të çmimit për shkak të cilësisë së dobët apo për shërbimet jo të plota⁷³⁵, informatat e nevojshme në lidhje me kushtet formale të kufijve dhe doganave⁷³⁶,

tjera që janë pjesë e paketës së aranzhmanit turistik. Itinerari, është detyrim ligjor për organizatorin e udhëtimit respektivisht për dhënësin e udhëtimit, këtë e parasheh edhe Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 15, paragrafi 1, pika 1.6.

- 727 Vërtetimi duhet të përmbajë çmimin se sa kushton udhëtimi (aranzhmani turistik), dhe kushtet e transportit dhe cilësia e llojit të transportit që do të thotë se në çfarë kategorie të transportit do të organizohet udhëtimi, p.sh., transporti rrugor; transporti ajror apo transport detar dhe çfarë kualiteti kanë këto mjete të transportit.
- 728 Vërtetimi gjithashtu duhet të përmbajë edhe kategorinë e hotelit dhe të dhomave të hotelit ku shfrytëzuesi i udhëtimit do të vendoset.
- 729 Vërtetimi i udhëtimit, gjithashtu duhet të jetë preciz edhe në pikëpamje të shujtave që do të thotë se sa herë do të ketë ushqim gjatë njëzet e katër (24) orëve të përfshira në paketën turistike, si dhe çfarë kualiteti do të jetë ushqimi që do të sigurohet nga dhënësi i shërbimit turistik.
- 730 Detajet e orareve të udhëtimit nënkuptojnë se si do të organizohet udhëtimi deri në arritjen e destinacionit që do të thotë se a do të jetë p.sh., fluturimi drejtëpërdrejtë apo me ndonjë ndales (ndërrim), a do të jetë udhëtimi me mjet të njëjtë transportues apo do të bëhet me mjete të ndryshme të transportit që do të thotë përfshihet transporti ajror dhe tokësor, etj.
- 731 Vërtetimi, përmban edhe informatat se çka është përfshirë tjetër në çmim përveç atyre që janë standarde (Banimi, ushqimi dhe transporti) p.sh., përdorimi i ëireless internetit; përdorimi i shërbimeve tjera hotelierike, p.sh., shfrytëzimi i bazenit të hotelit, saunës, etj.
- 732 Vërtetimi mbi udhëtimin gjithashtu duhet të përmbajë edhe informacionin se udhëtimi është me kusht që do të thotë se ai do të realizohet vetëm nëse plotësohet numri i nevojshëm për organizimin e udhëtimit. Kështu, konsumatori e ka me dije që në momentin e lëshimit të vërtetimit se mund të ndodhë që mos të organizohet udhëtimi në qoftë se nuk bëhet numri i kërkuar për realizimin e paketës së aranzhmanit turistik.
- 733 Vërtetimi për udhëtimin duhet patjetër të përmbajë çmimin përfundimtar të kostos që duhet të paguajë shfrytëzuesi i udhëtimit. Çmimi është element esencial i kontratës sepse shfrytëzuesi i paketës së udhëtimit duhet t'a dijë se për çfarë çmimi do të realizohet udhëtimi turistik.
- 734 Vërtetimi i udhëtimit, duhet të parasheh edhe rregullën se në çfarë rrethanash shfrytëzuesi i udhëtimit ka të drejtë të kërkojë anulimin e udhëtimit.
- 735 Vërtetimi i udhëtimit, duhet të përmbajë edhe informacionin për afatin brenda të cilit shfrytëzuesi i udhëtimit ka të drejtë të parashtrijë ankesë lidhur me vërejtjet që i ka ndaj organizatorit të udhëtimit për shërbimet e dobëta ose shërbimet jo të plota, respektivisht për shërbimet që nuk përputhen me atë që është paraparë në vërtetimin e udhëtimit. Në këtë rast, ai ka të drejtë të kërkojë ndryshimin (zbritjen) e çmimit ose shpërbllimin e dëmit të pësuar për shkak të shërbimeve të bëra ose mos të bëra në pajtim me vërtetimin e udhëtimit.
- 736 Vërtetimi gjithashtu duhet të përmbajë edhe informacionet e nevojshme për kufijtë që duhet të kalohen, dokumentacionin që kërkohet me rastin e kalimit të kufijve dhe detyrimet eventuale doganore nëpër kufijtë të cilët do të kalohen. Pra, duhet të ketë njohuri të mjaftueshme që shfrytëzuesi i udhëtimit mos të ketë ndonjë pasojë apo vështirësi për shkak të mos informimit të mjaftueshëm. Udhëtari, ka për detyrim që vetë të kujdeset për vlefshmërinë e dokumenteve të tij të udhëtimit dhe të jetë i

higjienës⁷³⁷, rregullat tjera financiare dhe administrative⁷³⁸, si dhe informatat tjera të cilat konsiderohen se janë të dobishme nëse përfshihen në vërtetimin e udhëtimit⁷³⁹.

881.3. Paragrafi 3, përmban dispozitën e cila përcakton se nëse udhëtarit paraprakisht i është dhënë programi i udhëtimit ku ndodhen të dhënat që i përmban vërtetimi për udhëtimin, atëherë vërtetimi për udhëtimin mund të përmbajë vetëm udhëzimin për këtë program. Kjo do të thotë, se në këtë rast nuk shënohen në vërtetimin për udhëtimin krejt ajo çka kërkohet në paragrafin 2 të këtij neni, por organizatori i udhëtimit e udhëzon shfrytëzuesin e udhëtimit në programin të cilin i'a ka dorëzuar më herët respektivisht para se ti lëshohet vërtetimi për udhëtimin. Programi i udhëtimit, gjithësesi i përmban të gjitha të dhënat të cilat duhet t'i shënohen në vërtetimin për udhëtimin ose duhet t'i përmbajë kontrata e veçantë e cila bëhet në formë të shkruar në qoftë se shfrytëzuesit të udhëtimit nuk i është lëshuar vërtetimi për udhëtimin.

Neni 882. Raporti i kontratës dhe i vërtetimit mbi udhëtimin

- 1. Ekzistimi dhe plotfuqishmëria e kontratës mbi organizimin e udhëtimit janë të pavarur nga ekzistimi i vërtetimit mbi udhëtimin dhe nga përmbajtja e tij.**
- 2. Mirëpo organizatori i udhëtimit përgjigjet për krejt dëmin që pëson pala tjetër për shkak të mos dhënies së vërtetimit mbi udhëtimin ose për shkak të pasaktësisë së tij.**

882. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 882, përmban dispozitën me të cilën rregullohet raporti (marrëdhënia) e kontratës dhe vërtetimit mbi udhëtimin. Kjo do të thotë, se çfarë është kuptimi i kontratës për organizimin e udhëtimit në relacion me vërtetimin e udhëtimit.

882.1. Paragrafi 1, parasheh se ekzistimi dhe vlefshmëria e kontratës mbi organizimin e udhëtimit janë të pavarura nga ekzistimi i vërtetimit mbi udhëtimin dhe nga përmbajtja e tij. Kjo do të thotë se, krahas kontratës mbi organizimin e udhëtimit mund të lëshohet edhe vërtetimi i udhëtimit sepse vërtetimi përmban detaje të veçanta. Vërtetimi i udhëtimit, nuk konsiderohet kontratë por është vetëm një provë dokumentuese për përmbajtjen e paketë-aranzhmanit, dhe kjo për shfrytëzuesin e paketë-aranzhmanit është një siguri juridike për

vlefshëm kur shkohet në shtetet e jashtme së paku gjashtë (6) muaj para datës së nisjes.

- 737 Vërtetimi duhet të përmbajë edhe informacionin respektivisht kushtet që duhet të kërkohen për ruajtjen e higjienës në rend të parë kushtet higjienike që duhet t'i sigurojë organizatori i udhëtimit, por edhe detyrimet e klientit (shfrytëzuesit të udhëtimit) për ruajtjen e higjienës në objektin të cilin e shfrytëzojnë.
- 738 Vërtetimi për udhëtimin mund të përmbajë edhe informacionin për shpenzime shtesë që mund të paraqiten gjatë shfrytëzimit të objektit të hotelit, si p.sh., shpenzimet për shfrytëzimin e bazenit, saunës, dhe taksat tjera që nuk janë të përfshira në vërtetimin për udhëtim.
- 739 Vërtetimi i udhëtimit duhet të përmbajë edhe informata tjera të cilat nuk janë të përmendura si të detyrueshme. Këto informata, janë të varura nga natyra e kontratës së paketë-aranzhmanit, dhe vendi ku organizohet aranzhmani turistik, p.sh., pjesët e qytetit të cilat paraqesin rrezik për t'i vizituar, ose informacionin se cilat objekte tjera meritojnë të vizitohen dhe nuk janë pjesë e aranzhmanit turistik. Pastaj, mënyrën e transportit në qytet respektivisht cila mënyrë e transportit është më e lirë në qytet, mënyra e ndërrimit të valutës (parave), etj.

të provuar se çka është dashur të sigurojë organizatori i udhëtimit dhe ku ka dështuar nëse ekziston nevoja t'i drejtohet organizatorit të udhëtimit ose gjykatës për dëmin e pësuar ose për mos respektimin e asaj që është shënuar në vërtetimin e udhëtimit. Kontrata mbi organizimin e udhëtimit është e natyrës joformale por mund të jetë edhe me shkrim nëse palët e kërkojnë këtë.

882.2. Paragrafi 2, përcakton përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit për gjithë dëmin që pëson pala tjetër nëse nuk i është dhënë vërtetim për udhëtimin ose vërtetimi i udhëtimit përmban shënime të pasakta. Në rastet kur nuk i jepet vërtetim për udhëtim ose nuk ekziston kontratë e veçantë me shkrim ku shënohet saktësisht të drejtat e shfrytëzuesit të paketë-aranzhmanit ose këto janë shënime të pasakta ai ka të drejtë të kërkojë përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit për dëmin që ka pësuar. Elementet e vërtetimit për udhëtimin, në fakt janë të natyrës obligative, andaj edhe nëse nuk janë shënuar ose janë shënuar në mënyrë të pasaktë vlejné ato që i kërkon neni 881, paragrafi 2 i LMD të Kosovës. Kontrata për organizimin e udhëtimit pasi që është kontratë joformale konsiderohet se është lidhur kur palët janë marrë vesh për elementet esenciale të kontratës dhe nuk është e varur nga vërtetimi për udhëtimin të cilin e ka detyrim organizatori i udhëtimit t'ia japë shfrytëzuesit të udhëtimit.

Neni 883. Prezumimi i saktësisë së vërtetimit

Konsiderohet se është e saktë ajo që ndodhet në vërtetim gjithnjë gjersa të mos provohet e kundërta.

883. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 883, përmban dispozitën me të cilën prezumohet saktësia për vërtetimin e udhëtimit.

Neni 883 i LMD të Kosovës, parasheh prezumimin e rrëzueshëm se konsiderohet se është e saktë e gjithë ajo që është shënuar në vërtetimin për udhëtimin çdoherë deri sa të mos provohet e kundërta. Kjo do të thotë se, pala e dëmtuar ka të drejtë të provojë të kundërtën e asaj që është shënuar në vërtetimin për udhëtim. Shfrytëzuesi i udhëtimit turistik, i takon të provojë se ajo çka është e shënuar në vërtetimin mbi udhëtimin nuk është e saktë dhe duhet të përcaktojë se për cilin shënim bëhet fjalë, p.sh., në vërtetim thuhet se vendosja është në apartman e në fakt vendosja është në ndonjë dhomë tjetër që nuk i takon standardit të apartmanit.

KREU 2

DETYRIMET E ORGANIZATORIT TË UDHËTIMIT

Neni 884. Mbrojtja e të drejtave dhe e interesave të udhëtarit

Organizatori i udhëtimit ka për detyrë t'ia japë udhëtarit shërbime që kanë përmbajtjen dhe veçoritë e parashikuara me kontratë, me vërtetim, respektivisht me programin

e udhëtimit dhe të kujdeset për të drejtat dhe interesat e udhëtarit, në pajtim me praktikën e mirë afariste në këtë sferë.

884. Vështrim i përgjithshëm. Kreu 2 i pjesës së njëzet e një (XXI) rregullon detyrimet e organizatorit të udhëtimit me nenet (884-891).

Neni 884, përcakton mënyrën e mbrojtjes së të drejtave dhe të interesave të udhëtarit. Kjo dispozitë, parasheh detyrimin e organizatorit të udhëtimit që udhëtarit t'i sigurojë shërbime që kanë përmbajtjen dhe veçoritë e parashikuara me kontratë, me vërtetim për udhëtimin ose me programin e udhëtimit si dhe të kujdeset për të drejtat dhe interesat e udhëtarit në pajtim me ligjin, por edhe me praktikën e mirë afariste në këtë sferë të ekonomisë. Shërbimet, që duhet t'i ofrojë organizatori i udhëtimit ndaj udhëtarit duhet të jenë patjetër në pajtim me atë çka është paraparë në kontratë respektivisht në vërtetimin për udhëtimin dhe nuk lejohet që udhëtarit t'i shkelen të drejtat dhe interesat e tij. Çdo shkelje e të drejtave dhe interesave të udhëtarit të përfshira në kontratën për organizimin e udhëtimit krijon bazë të fuqishme juridike që shfrytëzuesi i udhëtimit të kërkojë mbrojtje juridike në gjykatën kompetente në qoftë se atë nuk mund ta zgjidhë përmes negociatave me organizatorin e udhëtimit.

Neni 885. Detyrimi për të njoftuar

Para lidhjes së kontratës organizatori i udhëtimit, në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër të përshtatshme, duhet ti ofrojë udhëtarit të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me formalitetet kufitare (pasaportat dhe vizat) dhe formalitetet sanitare, të kërkuara gjatë udhëtimit dhe banimit në destinacionin e planifikuar. Organizatori i udhëtimit, para nisjes së udhëtimit, detyrohet të njoftojë udhëtarin për afatet kohore në të njëjtën mënyrë dhe saktësisht të përcaktojë vendin e udhëtarit në mjetet e transportit (p.sh. kabinën apo kuvertën në anije, vendin e ndarë për fjetjen në tren), informatat për adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit lokal të organizatorit të udhëtimit ose të shitësit apo nëse nuk ka përfaqësues lokal, informatat për ndonjë numër emergjence apo çdo lloj informacioni tjetër që do i mundësonte udhëtarit të kontaktojë organizatorin e udhëtimit dhe ose të shitësit, si dhe informata mbi lidhjen opsionale të sigurimit për të mbuluar shpenzimet e anulimit të kontratës dhe sigurimit për mbulimin e shpenzimeve në rast të sëmundjes apo aksidenteve gjatë udhëtimit. Në rastet e udhëtimit apo qëndrimit të të miturve jashtë vendit, organizatori i udhëtimit duhet të ofrojë informata për vendosjen e kontaktit të drejt për drejtë me të miturin apo me zyrtarin përgjegjës të vendit ku është duke qëndruar i mituri.

885. Vështrim i përgjithshëm. Neni 885, përmban dispozitën me të cilën parashihet se organizatori i udhëtimit ka për detyrim njoftimin e shfrytëzuesit të udhëtimit për të gjitha informacionet e nevojshme që duhet t'i ketë shfrytëzuesi i udhëtimit për të hyrë në lidhjen e kontratës për udhëtimin. Pra, organizatori i udhëtimit para se të lidhet kontrata e udhëtimit duhet t'i ofrojë njohuri të mjaftueshme në formë të informacionit me shkrim apo ndonjë

formë tjetër të përshtatshme lidhur me formalitetet që mundësojnë realizimin e suksesshëm të kontratës për organizimin e udhëtimit.

Neni 885, përcakton detyrimin e organizatorit të udhëtimit për t'a njoftuar shfrytëzuesin e udhëtimit lidhur me formalitetet kufitare (pasaporta dhe vizat)⁷⁴⁰; formalitetet sanitare⁷⁴¹ të cilat kërkohen me rastin e kalimit të kufirit – gjatë udhëtimit, apo me rastin e banimit në destinacionin e planifikuar. Organizatori i udhëtimit, para nisjes së udhëtimit respektivisht para lidhjes së kontratës për organizimin e udhëtimit duhet t'a njoftojë udhëtarin për afatet kohore të organizimit të udhëtimit dhe saktësisht të përcaktojë vendin e udhëtarit në mjetet e transportit respektivisht numrin e karrikës, pastaj kur bëhet udhëtimi me anije duhet t'i tregohet se në cilën kabinë do të jetë i vendosur ose nëse udhëtohet me tren vendin e ndarë për fjetje nëse ai e kontraktonte këtë. Detyrimi i organizatorit të udhëtimit, ka të bëjë edhe me njoftimin e shfrytëzuesit të udhëtimit lidhur me adresën (shtetin, qytetin, dhe rrugën) pastaj numrin e telefonit të përfaqësuesit lokal të organizatorit të udhëtimit ose të shitësit të paketë-aranzhmanit, kur nuk ka përfaqësi, pastaj duhet t'i ofrojë njoftime për ndonjë numër emergjent apo numër tjetër që do t'i bënte të mundur udhëtarit të kontaktojë organizatorin e udhëtimit në çdo kohë ose shitësin e paketë-aranzhmanit të udhëtimit.

Detyrim tjetër i organizatorit të udhëtimit është që të informojë shfrytëzuesin e udhëtimit për lidhjen opcionale të sigurimit për të mbuluar shpenzimet e anulimit të kontratës. Pra, se do t'i heqë shpenzimet e bëra për shkak të anulimit të kontratës. Në këtë rast, organizatori i udhëtimit mund të ofrojë më shumë opsione për të mbuluar shpenzimet që do të ndodhin për shkak të anulimit të kontratës. Pastaj, ai duhet të ofrojë njohuri respektivisht informacione për sigurimin e mbulimit të shpenzimeve në rast të sëmundjes eventuale apo aksidenteve gjatë udhëtimit. Në rastet kur bëhet udhëtimi i të miturve jashtë vendit, atëherë organizatori i udhëtimit përfaqësuesit të fëmijëve ose personit që kujdeset për to duhet t'i ofrojë informata të mjaftueshme për vendosjen e kontaktit të drejtëpërdrejtë me të miturin i cili është shfrytëzues i udhëtimit apo me zyrtarin përgjegjës të vendit ku është duke qëndruar i mituri si shfrytëzues i udhëtimit. Neni 885, në fakt krijon bazë juridike që shfrytëzuesi i udhëtimit t'i ketë të gjitha informacionet e siguruar nga organizatori i udhëtimit të cilat informacione i mundësojnë një udhëtim dhe qëndrim komod dhe pa shqetësime.

740 Pasaporta është dokumenti i udhëtimit me të cilën vërtetohet përkatësia shtetësore e mbajtësit të pasaportës (shfrytëzuesi të udhëtimit) dhe identiteti i tij. Ndërkaq, viza është leja e hyrjes në shtetit ku udhëtohet. Disa shtete, lejojnë hyrjen pa viza ose kërkojnë vizë të veçantë të cilën e lëshon Ambasada e shtetit ku udhëtohet (e shtetit në të cilën kërkohet hyrja).

741 Me formalitete sanitare nënkuptojmë kërkesat e shtetit ku udhëtohet lidhur me gjendjen shëndetësore të shfrytëzuesit të udhëtimit, p.sh., vaksinimi për sëmundje të ndryshme ose se nuk ka sëmundje ngjithëse.

Neni 886. Detyrimi i ruajtjes së sekretit

Njoftimin që e merr mbi udhëtarin, mbi bagazhin dhe lëvizjet e tij, organizatori mund t'ua komunikojë personave të tretë vetëm me lejen e udhëtarit ose me kërkesën e organit kompetent.

886. Vështrim i përgjithshëm. Neni 886, përcakton detyrimin e organizatorit të udhëtimit që të ruajë si sekret njoftimet të cilat i merr për udhëtarin, mbi bagazhin⁷⁴² apo lëvizjet e tij. Kjo ndryshe quhet detyrimi i ruajtjes së sekretit. Neni 886, shprehimisht parasheh se organizatori i udhëtimit njoftimin që e merr mbi udhëtarin, mbi bagazhin dhe lëvizjet e tij gjatë udhëtimit, duhet t'i ruajë si sekret dhe këto të dhëna (njoftime) mund t'ua komunikojë personave të tretë pra t'ua bëjë të njohur personave të tretë vetëm me lejen e udhëtarit e cila leje mund të jepet paraprakisht ose më vonë. Njohuritë që i ka organizatori lidhur me udhëtarin, bagazhin dhe lëvizjet e tij, mund t'ua komunikojë personave të tretë edhe në bazë të kërkesës të organit kompetent, p.sh., nëse policia kërkon ndonjë shënim me vendim të organit shtetëror, atëherë organizatori është i detyruar të komunikojë ndonjë dijeni që ka lidhur me udhëtarin, bagazhin apo lëvizjet e tij. Organizatori i udhëtimit nëse nuk e ruan fshehtësinë lidhur me njoftimin që ka për udhëtarin, bagazhin apo lëvizjet e tij, ai mund të përgjigjet për dëmin që i shkakton shfrytëzuesit të udhëtimit dhe dëmi mund të jetë material dhe moral.

Neni 887. Përgjegjësia për organizimin e udhëtimit

Organizatori i udhëtimit përgjigjet për dëmin që i shkakton udhëtarit për shkak të moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve që kanë të bëjnë me organizimin e udhëtimit që parashikohen me kontratën dhe me këtë ligj.

887. Vështrim i përgjithshëm. Neni 887, përmban dispozitën me të cilën përcaktohet përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit për organizimin e udhëtimit. Organizatorit të udhëtimit ashtu siç i takon shpërblimi për organizim të rregullt të udhëtimit respektivisht për paketë-aranzhmanin turistik të cilën e shfrytëzon udhëtari, ai gjithashtu ka edhe përgjegjësinë për organizimin e udhëtimit kur udhëtarit i shkaktohet ndonjë dëm për shkak se organizimi i udhëtimit nuk është përmbushur nën kushtet e parapara në kontratën e udhëtimit respektivisht në pajtim me vërtetimin e udhëtimit.

Neni 887, shprehimisht parasheh se organizatori i udhëtimit përgjigjet për dëmin që i shkakton udhëtarit si pasojë e moszbatimit (realizimit) të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve që kanë të bëjnë me organizimin e udhëtimit, të cilat detyrime të organizatorit të udhëtimit parashikohen me kontratën për organizimin e udhëtimit ose me këtë ligj. Organizatori

742 Bagazhi duhet të ketë peshën të cilën e cakton transportuesi. Përndryshe, nëse është mbipesha për të cilën është i informuar udhëtari ai do të paguajë vetë çmimin për bagazh, p.sh., për transportin ajror bagazhi i dorës në ambientet e brendshme për shkaqe sigurie, është e lejuar një valixhe e dorës për një fluturim. Dimensionet më të mëdha janë 55x40x20 cm., me peshë maksimale 5 kg.

i udhëtimit, gjithmonë përgjigjet për dëmin që i shkakton udhëtarit. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit bëhet në pajtim me dispozitat për përgjegjësinë për dëmin që i shkaktohet tjetrit që i përmban LMD i Kosovës, por edhe në pajtim me nenin 887 të këtij ligji. Organizatori i udhëtimit, mund të jetë vetë fajtor i shkakimit të dëmit se nuk i ka përmbushur detyrimet ashtu siç janë marrë vesh me udhëtarin, por mund që të jetë shkaktuar edhe me veprimin e personit të tretë i cili kryen shërbime për organizatorin e udhëtimit por në të gjitha rastet përgjegjësia i takon organizatorit të udhëtimit. Me nenet vijuese 888 dhe 889 të LMD të Kosovës, përcaktohet përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur vet i kryen shërbimet e kontraktuara me kontratën e organizimit të udhëtimit si dhe përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit kur kryerjen e shërbimeve të veçanta u'a ka besuar personave të tretë.

Neni 888. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur i kryen vetë shërbimet e veçanta Në qoftë se i jep vetë shërbimet e transportit, të strehimit ose shërbimet e tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit të organizuar, organizatori përgjigjet për dëmin që i ka shkaktuar udhëtarit sipas dispozitave që kanë të bëjnë me këto shërbime.

888. Vështrim i përgjithshëm. Neni 888, rregullon përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit kur organizatori i udhëtimit vet i kryen të gjitha shërbimet e veçanta të parapara në kontratën e lidhur midis organizatorit të shërbimeve dhe shfrytëzuesit të shërbimeve.

Neni 888, shprehimisht dhe në mënyrë shumë të qartë përcakton se, në qoftë se organizatori i udhëtimit i jep vetë shërbimet e transportit⁷⁴³, të strehimit ose shërbimet e tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit të organizuar, ai do të përgjigjet për dëmin që i'a ka shkaktuar

743 LMD i Kosovës, neni 677, paragrafi 1, ku thuhet “Në qoftë se për ndonjë shkak për të cilin përgjigjet transportuesi është ndërprerë transporti ai ka të drejtë në pjesën proporcionale të shpërblimit për transportin e kryer, por ka për detyrë që ta shpërblejë dëmin që do të krijohej për palën tjetër për shkak të ndërprerjes së transportit”, paragrafi 2 “Në qoftë se transporti është ndërprerë për ndonjë shkak për të cilin nuk përgjigjet askush nga personat e interesuar, transportuesi ka të drejtë në diferencën midis shpërblimit të kontraktuar për transport dhe shpenzimeve të transportit nga vendi ku është ndërprerë transporti deri në vendin e destinimit”, dhe paragrafi 3 “Transportuesi nuk ka të drejtë as në një pjesë të shpërblimit, në qoftë se gjatë transportit dërgesa shkatërrohet për shkak të fuqisë madhore”; LMD i Kosovës, neni 685, paragrafi 1, ku thuhet “Transportuesi përgjigjet për humbjen ose për dëmtimin e dërgesës që do të shkaktoheshin prej çastit të marrjes në dorëzim deri në dorëzimin e saj, përveç nëse i janë shkaktuar me veprimin e personit të autorizuar, nga cilësia e dërgesës ose nga shkaqet e jashtme që nuk kanë mund të parashikohen si edhe të shmangen ose mënjanoohen”, paragrafi 2 “Janë nule dispozitat e kontratës për transport, të kushteve të përgjithshme të transportit të tarifave ose të ndonjë akti tjetër të përgjithshëm sipas të cilave kjo përgjegjësi zvogëlohet”, paragrafi 3 “Por është e plotfuqishme dispozita që cakton shumën më të lartë të shpërblimit, me kusht që mos të jetë në disproporcion të dukshëm me dëmin”, paragrafi 4 “Ky kufizim i shumës së shpërblimit nuk vlen në qoftë se dëmin e ka shkaktuar transportuesi me dashje ose nga pakujdesia e rëndë”, dhe paragrafi 5 “Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, shuma e shpërblimit caktohet sipas çmimit të tregut të dërgesës në kohën dhe vendin e dorëzimit për transport”; LMD i Kosovës, neni 689, ku thuhet “Transportuesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar për shkak të vonesës, përveç nëse vonesa është shkaktuar nga ndonjë fakt që përjashton përgjegjësinë e tij për humbjen ose dëmtimin e sendit”.

udhëtarit sipas dispozitave që kanë të bëjnë me këto shërbime. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit, në këtë rast është e njohur që në momentin e lidhjes së kontratës dhe ai dëmin e shkaktuar duhet t'a përmbushë në pajtim me dispozitat e kontratës.

Neni 889. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur kryerjen e shërbimeve të veçanta ua ka besuar personave të tretë

1. Organizatori i udhëtimit që u ka besuar personave të tretë kryerjen e shërbimeve të transportit, të strehimit ose të shërbimeve të tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit, i përgjigjet udhëtarit për dëmin e shkaktuar për shkak të moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të këtyre shërbimeve, në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me të.
2. Mirëpo, edhe kur shërbimet janë kryer në pajtim me kontratën dhe me dispozitat që kanë të bëjnë me të, organizatori përgjigjet për dëmin që pëson udhëtari me rastin e kryerjes së tyre, përveç nëse provon se sjellet si organizator i kujdesshëm i udhëtimit gjatë zgjedhjes së personave që e kanë zbatuar.
3. Udhëtari ka të drejtë të kërkojë direkt nga personi i tretë përgjegjës për dëmin, shpërblimin e plotë ose plotësues për dëmin e pësuar.
4. Në masën në të cilën ia ka shpërblyer dëmin udhëtarit organizatori i udhëtimit fiton të gjitha të drejtat që do t'i kishte udhëtari ndaj personit të tretë përgjegjës për këtë dëm (e drejta e regresit).
5. Udhëtari ka për detyrë t'i cedojë organizatorit të udhëtimit dokumente dhe çdo gjë që nevojitet për realizimin e të drejtës së regresit.

889. Vështrim i përgjithshëm. Neni 889, përmban dispozitën me të cilën rregullohet përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur kryerjen e shërbimeve të veçanta u'a ka besuar personave të tretë. Kjo nënkupton se, bartjen e udhëtarëve dhe bagazhet e tyre nuk i kryen drejtëpërsëdrejti vetë organizatori i udhëtimit por kjo bëhet përmes personave të tretë. Kjo dispozitë përmban pesë (5) paragrafe të cilat precizojnë të gjitha rastet e mundshme kur ekziston përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit për dëmin e shkaktuar udhëtarit, por kur shërbimet e veçanta për transportimin, strehimin ose shërbime tjera u'a ka besuar personave të tretë.

889.1. Paragrafi 1, shprehimisht parashihet përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit në rastet kur kryerjen e shërbimeve të transportit, strehimit ose shërbimeve tjera lidhur me udhëtimin u'a ka besuar personave të tretë. Sipas kësaj dispozite, vetë organizatori i përgjigjet udhëtarit për dëmin e shkaktuar për shkak të moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të këtyre shërbimeve, në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me të. Përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit është përgjegjësi objektive sepse në këtë rast ai do të përgjigjet vet për dëmin që u ka shkaktuar udhëtarëve edhe pse ky shërbim u është besuar personave të tretë. Përgjegjësia për dëmin që kanë pësuar udhëtarët për shkak të moszbatimit të plotë apo të pjesshëm të këtyre shërbimeve bëhet në pajtim me dispozitat që i përmban kontrata për organizimin e udhëtimit por në mungesë të tyre edhe në pajtim me dispozitat

e përgjithshme që rregullojnë përgjegjësinë e personave që ushtrojnë veprimtarinë e transportit, strehimit dhe shërbimeve të tjera që ndodhin lidhur me kryerjen e udhëtimit.

889.2. Paragrafi 2, përmban dispozitën me të cilën përcaktohet përgjegjësia e organizatorit edhe kur shërbimet janë kryer në pajtim me kontratën dhe me dispozitat që kanë të bëjnë me të, ai përgjigjet për dëmin që pëson udhëtari me rastin e kryerjes së tyre përveç nëse provon se organizatori i udhëtimit ka qenë i kujdesshëm në zgjedhjen e personave që e kanë zbatuar kryerjen e shërbimeve të transportit, të strehimit dhe shërbimeve të tjera. Kjo paraqet një përjashtim për lirimin nga përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit kur shërbimet janë kryer në pajtim me kontratën dhe me dispozitat që kanë të bëjnë me të nëse provon se ai ka qenë shumë i vëmendshëm, shumë i kujdesshëm me rastin e zgjedhjes së personave të tretë të cilët e kanë zbatuar ose kanë kryer shërbime të veçanta të parapara me kontratën për organizimin e udhëtimit.

889.3. Paragrafi 3 i këtij neni, përcakton të drejtën e udhëtarit që të kërkojë nga personi i tretë përgjegjës për dëmin shpërblimin e plotë ose plotësues për dëmin e pësuar edhe drejtëpërsdrejti do të thotë pa patur nevojë t'i drejtohet organizatorit të udhëtimit. Në këtë rast, udhëtari i drejtohet personit të tretë përgjegjës për dëmin i cili kryen shërbime të kontraktuara me organizatorin e udhëtimit. Në këtë rast, përmbushjen e detyrimit për dëmin e shkaktuar ndaj udhëtarit me rastin e kryerjes së shërbimeve të transportit, të strehimit ose shërbimeve të tjera për kryerjen e udhëtimit e bën personi i tretë. Marrëdhëniet midis organizatorit të udhëtimit dhe personit të tretë janë të rregulluara me kontratë të veçantë dhe se si do të veprohet në rastin konkret është çështje kontraktuese midis palëve respektivisht a mund të kërkojë personi i tretë ndonjë përmbushje (regres) nga organizatori i udhëtimit. Mirëpo, është fakt se ai që ka shkaktuar dëmin nuk mund t'i drejtohet organizatorit të udhëtimit kur ajo është pasojë e veprimit të tij. Nga paragrafi vijues i këtij neni, del se përgjegjësinë për dëmin që i shkaktonte personi i tretë gjatë kryerjes së shërbimeve të transportit, të strehimit ose shërbimeve të tjera lidhur me udhëtimin e bartë vet, sepse nëse këtë dëm i'a shpërblen udhëtarit organizatori, atëherë organizatori e ka të drejtën e regresit ndaj personit të tretë i cili e ka shkaktuar dëmin.

889.4. Paragrafi 4, shprehimisht parasheh se në lartësinë e shumës që i'a ka shpërblyer dëmin udhëtarit për shkak të dëmit të shkaktuar nga personi i tretë gjatë kryerjes së shërbimeve të transportit, të strehimit ose të shërbimeve tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit të kontraktuara me organizatorin e udhëtimit, atëherë organizatori i udhëtimit si subjekt i cili e ka autorizuar personin e tretë për kryerjen e shërbimeve të veçanta, i fiton të gjitha të drejtat që do t'i kishte udhëtari ndaj personit të tretë përgjegjës. Pra, nëse shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj udhëtarit e përmbushë organizatori i udhëtimit edhe pse dëmi është shkaktuar nga personi i tretë i autorizuar për kryerjen e shërbimeve të transportit, strehimit dhe shërbimeve të tjera për udhëtim, atëherë organizatorit të udhëtimit i takon e drejta që të kërkojë nga personi i tretë shumën e parave të dhëna në emër të dëmit të shkaktuar nga ai (kjo nënkupton të drejtën e regresit). Dispozita, përmban një shprehje "se organizatori fiton të gjitha të drejtat që do t'i kishte udhëtari ndaj personit të tretë përgjegjës për këtë

dëm” dhe kjo mund të keqkuptohet për shkak se mund të mendohet se organizatori fiton të gjitha të drejtat që do t’i kishte udhëtari ndaj personi të tretë përgjegjës për këtë dëm edhe kur udhëtari nuk e ka realizuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga personi i tretë. Kjo duhet kuptuar se organizatori i udhëtimit ka të drejtën e regresit ndaj personi të tretë të autorizuar vetëm nëse ai ka bërë shpërblimin e dëmit ndaj udhëtarit. Ndërsa, organizatori i udhëtimit ka shpërblyer dëmin të cilin nuk e ka për detyrim personi i tretë, atëherë nuk mund të realizohet e drejta e regresit në atë pjesë.

889.5. Paragrafi 5, përmban rregullën me të cilën caktohet detyrimi i udhëtarit ndaj organizatorit të udhëtimit që të realizojë të drejtën e regresit ndaj personit të tretë i cili ka shkaktuar dëmin ndaj udhëtarit gjatë kryerjes së shërbimeve të transportit, të strehimit ose shërbimeve të tjera lidhur me udhëtimin dhe të cilin dëm e ka shpërblyer vetë organizatori i udhëtimit. Ky paragraf, shprehimisht parasheh se udhëtari ka për detyrë t’i cedojë (t’i ofrojë, t’i bartë, t’i dorëzojë) organizatorit të udhëtimit, dokumente dhe çdo gjë që nevojitet që organizatori i udhëtimit t’a realizojë të drejtën e regresit, pra të marrë shumën e parave të cilat i’a ka paguar udhëtarit për dëmin që i ka shkaktuar personi i tretë i cili ka qenë i autorizuar (i besuar) me kontratë midis organizatorit të udhëtimit dhe personit të tretë që t’i kryejë shërbimet të transportit, të strehimit ose të shërbimeve të tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit. Kjo ndodhë kur udhëtari shpërblimin e dëmit e kërkon nga organizatori i udhëtimit dhe jo nga personi i tretë i cili e ka shkaktuar dëmin gjatë kryerjes së shërbimeve të transportit, të strehimit dhe të shërbimeve të tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit.

Neni 890. Zbritja e çmimit

1. Në qoftë se shërbimet nga kontrata mbi organizimin e udhëtimit janë kryer në mënyrë jo të plotë ose jo me cilësi, udhëtari mund të kërkojë zbritjen proporcionale të çmimit me konditë që t’i ketë bërë prapësim organizatorit të udhëtimit brenda tetë ditësh nga data e përfundimit të udhëtimit.

2. Kërkesa për zbritjen e çmimit nuk ndikon në të drejtën e udhëtarit që të kërkojë kompensimin e dëmit.

890. Vështrim i përgjithshëm. Neni 890, përmban dispozitën me të cilën lejohet mundësia e zbritjes së çmimit në rastet kur organizatori i udhëtimit nuk e ka realizuar udhëtimin, transportin, banimin dhe shërbimet tjera lidhur me kryerjen e udhëtimit. E drejta e zbritjes së çmimit është e drejtë e udhëtarit si shfrytëzues i shërbimeve nga kontrata për organizimin e udhëtimit. Neni 890, përmban dy paragrafe, në njëërën parashihet e drejta për zbritjen e çmimit ndërsa në tjetrin parashihet e drejta e udhëtarit që të kërkojë shpërblimin e dëmit⁷⁴⁴

744 LMD i Kosovës, i cili në nenin 137, përcakton se çka konsiderojmë “dëm”, ku thuhet “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembsjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”.

edhe kur ekziston kërkesa për zbritjen e çmimit. Me LMD të Kosovës, me dispozita të përgjithshme parashihet edhe kufizimi dhe përjashtimi i përgjegjesisë⁷⁴⁵.

890.1. Paragrafi 1, shprehimisht përcakton se në rastet kur shërbimet nga kontrata për organizimin e udhëtimit janë kryer në kundërshtim me atë çka është paraparë në kontratën mbi organizimin e udhëtimit respektivisht nëse shërbimet janë kryer në mënyrë jo të plotë ose me cilësi më të dobët nga ajo çka është kontraktuar atëherë udhëtari mund të kërkojë zbritjen proporcionale të çmimit me kusht që udhëtari të ketë parashtruar kërkesën kundrejtë organizatorit të udhëtimit brenda tetë (8) ditësh nga data e përfundimit të udhëtimit. Nëse nuk parashtrohet kërkesa në afatin prej tetë (8) ditëve nga data e përfundimit të udhëtimit, udhëtari humb të drejtën që t'a realizojë zbritjen e çmimit. Prandaj, e drejta e udhëtarit që të kërkojë zvogëlimin e çmimit mund të bëhet kur organizatori i udhëtimit nuk e ka realizuar kontratën e udhëtimit në mnyërë të plotë, p.sh., nuk ka realizuar ndonjë pikë të kontratës lidhur me vendin ose llojin e udhëtimit (pra ka mangësi në realizimin e kontratës së udhëtimit), ose kontrata për organizimin e udhëtimit është realizuar por cilësia e shërbimeve të ofruara nuk është e kualitetit për të cilën janë marrë vesh palët. Kushti tjetër që të realizohet zbritja e çmimit është që prapësimi respektivisht kundërshtimi të bëhet në afat të paraparë me këtë ligj e i cili afat është tetë (8) ditë nga data e përfundimit të udhëtimit. Afati tetë ditor i paraqitjes së kërkesës për zbritjen e çmimit për shkak të shërbimeve të ofruara nga organizatori i udhëtimit ose personat e tretë, ka për qëllim që kjo kërkesë kërkon të provuarit nga ana e shfrytëzuesit të udhëtimit, andaj sa më shpejtë që të parashtrohet kërkesa për zbritjen e çmimit aq më lehtë janë çështjet që duhet të provohen për t'u pranuar zbritja e çmimit. Organizatori i udhëtimit, duhet të pranojë zbritjen e çmimit në mënyrë proporcionale që do të thotë nuk mund të kërkojë kthimin e parave për shkak se ai veç e ka realizuar shërbimin të ofruar nga organizatori i udhëtimit por ato kanë qenë të kualitetit jo adekuat që kërkohen në rastet e tilla ose organizatori i udhëtimit apo personi i tretë të cilit i është besuar ndonjë shërbim i veçantë nga ana e organizatorit të udhëtimit. Nëse organizatori i udhëtimit konsideron se në tërësi janë plotësuar detyrimet e parapara në kontratën për organizimin e udhëtimit, atëherë mund të refuzojë kërkesën e parashtruar nga ana e udhëtarit për zbritjen e çmimit. Në këtë rast, udhëtari ka të drejtë që kërkesën e vet t'a realizojë në procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

890.2. Paragrafi 2, përmban dispozitën sipas të cilës kërkesa për zbritjen e çmimit që do të thotë nëse çmimi zbritet për shërbimet jo të plota të organizatorit të udhëtimit, kjo nuk ndikon në të drejtën e udhëtarit që të kërkojë shpërblimin e dëmit nëse e ka pësuar për

745 Shih: LMD i Kosovës, neni 248, paragrafi 1, ku thuhet “Përgjegjësia e debitorit për dashjen ose pakujdesinë e rëndë nuk mund të përjashtohet paraprakisht me kontratë”, paragrafi 2 “Megjithatë, gjykata me kërkesën e palës së interesuar kontraktuese mund ta anulojë edhe dispozitën kontraktuese për përjashtimin e përgjegjesisë për pakujdesinë e rëndomtë, në qoftë se një marrëveshje e tillë ka dalur nga pozita monopoliste e debitorit ose në përgjithësi nga marrëdhënia e pabarabartë e palëve kontraktuese”, paragrafi 3 “Është e vlefshme dispozita e kontratës, me të cilën caktohet shuma më e lartë e shpërblimit, në qoftë se shuma e caktuar kështu nuk është në disproporcion të hapur me dëmin dhe në qoftë se për rastin e caktuar nuk është caktuar diçka tjetër me ligj”, dhe paragrafi 4 “Në rastin e kufizimit të lartësisë së shpërblimit kreditori ka të drejtë në shpërblim të plotë në qoftë se pamundësia e përmbushjes së detyrimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e debitorit”.

shkak të mos realizimit të rregullt të shërbimeve të parapara në kontratën për organizimin e udhëtimit. Andaj, e drejta e shpërblimit të dëmit vjen në shprehje nëse për shkak të mos kualitetit të mjaftuar të shërbimeve ka pësuar edhe ndonjë dëm të veçantë, atëherë shpërblimi i dëmit realizohet ndaras nga zbritja e çmimit. Zbritja e çmimit mund të kërkohet në çdo rast kur ai konsideron se cilësia e shërbimeve respektivisht se shërbimet nuk kanë qenë të plota, ndërsa shpërblimi i dëmit duhet të provohet sepse mund të ndodhë që shërbimi mos të jetë kualitativ por nuk ka shkaktuar ndonjë dëm ndaj udhëtarit, p.sh., vendosja në një dhomë e cila nuk ka qenë e ngrohtë por nuk ka shkaktuar ndonjë sëmundje të udhëtarit, ai ka të drejtë të kërkojë vetëm zbritjen e çmimit për shkak se temperatura e dhomës nuk ka qenë në pajtim me atë çka është paraparë në kontratën për udhëtimin, por nuk mund të kërkojë shpërblimin e dëmit në qoftë se ai nuk ka qenë i detyruar të shkojë në spital ose të ndërmerrë veprime të tjera të cilat kanë shkaktuar shpenzime të veçanta për udhëtarin.

Neni 891. Përfundimi dhe kufizimi i përgjegjësisë së organizatorit të udhëtimit

- 1. Janë nul dispozitat e kontratës mbi organizimin e udhëtimit që përjashtojnë ose pakësojnë përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit.**
- 2. Mirëpo, është e plotfuqishme dispozita e shkruar e kontratës me të cilën parapërcaktohet shuma më e lartë e shpërblimit, me konditë që të mos jetë në shpërpjesëtim të hapur me dëmin.**
- 3. Ky kufizim i shumës së shpërblimit, nuk vlen në qoftë se organizatori e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ekstreme.**

891. Vështrim i përgjithshëm. Neni 891, përmban dispozitën me të cilën rregullohet përjashtimi dhe kufizimi i përgjegjësisë të organizatorit të udhëtimit. Kjo dispozitë kërkon nga organizatori i udhëtimit të respektohet dinjiteti i udhëtarit dhe nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë organizatori i udhëtimit. Në fakt, ndalohet përjashtimi ose kufizimi i përgjegjësisë së organizatorit të udhëtimit me anë të kontratës. Organizatori i udhëtimit, në raste të caktuara kanë interes të përjashtojnë përgjegjësinë e tyre ose t'a zvogëlojnë përgjegjësinë e tyre përmes kontratës ose me programe turistike dhe në këtë mënyrë t'i shmanget rrezikut që mund të ndodhë për shkak të veprimtarisë së tyre. Kjo nënkupton, se ai do të dëshironte të kontraktojë përjashtimin ose kufizimin e përgjegjësisë në raport me udhëtarin, p.sh., mos të përgjigjet për lëndimet eventuale të udhëtarëve që mund të ndodhin gjatë transportit ose gjatë banimit. Prandaj, LMD i Kosovës, me nenin 891 parimisht ndalon përjashtimin ose kufizimin e përgjegjësisë së organizatorit të udhëtimit në bazë të kontratës. Në këtë rast, do të respektohen dispozitat e LMD të Kosovës të cilat përcaktojnë përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit.

891.1. Paragrafi 1, përmban dispozitën të karakterit imperativ sipas të cilës dispozitat e kontratës për organizimin e udhëtimit që përjashtojnë ose pakësojnë (kufizojnë) përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit, janë nule që do të thotë konsiderohet dispozita

absolutisht të pavlefshme. Një kontraktim i përjashtimit të përgjegjësive së organizatorit të udhëtimit me kontratë nuk lejohet fare⁷⁴⁶ dhe nëse rasisht kontraktohet përjashtimi ose kufizimi i përgjegjësive së organizatorit të udhëtimit ajo gjithmonë është e pavlefshme dhe konsiderohet se as që ka ekzistuar.

891.2. Paragrafi 2, përmban përjashtimin sipas të cilit do të konsiderohet e plotfuqishme dispozita e shkruar e kontratës, pra kur ajo bëhet vetëm me shkrim me të cilën parapërcaktohet shuma më e lartë e shpërblimit të dëmit në emër të përgjegjësive së organizatorit të udhëtimit me kusht që të mos jetë në shpërpjesëtim (disproporcion) të hapur me dëmin. Kjo nënkupton se, organizatori i udhëtimit në kontratën për organizimin e udhëtimit mund të parashoh shumën më të lartë të shpërblimit, do të thotë sa është lartësia e shpërblimit që do të paguhet nga ana e organizatorit të udhëtimit në rast se do të shkaktohet dëmi eventual ndaj udhëtarit. Mirëpo, nga organizatori i udhëtimit kërkohet që shuma e parapërcaktuar më e larta nuk duhet të jetë në shpërpjesëtim të hapur me dëmin. Kjo në rend të parë nënkupton që duhet të ruhet ekuivalenca midis dëmit të shkaktuar dhe shpërblimit të dëmit të parapërcaktuar si shumë më e lartë e mundshme për dëmin eventual që mund të dalë gjatë realizimit të kontratës për organizimin e udhëtimit. Udhëtari, nëse konsideron se shuma më e lartë e shpërblimit e paraparë me dispozita të shkruara të kontratës mund të kërkojë përmes rrugës gjyqësore që të vërtetohet se shuma më e lartë e shpërblimit nuk e ka respektuar kushtin që i kërkon paragrafi 2 i këtij neni që kërkohet se shuma më e lartë e shpërblimit e parapërcaktuar të mos jetë në shpërpjesëtim me dëmin. Kur caktohet paraprakisht shuma më e lartë e shpërblimit për dëmin që mund të shkaktohet me rastin e realizimit të kontratës për organizimin e udhëtimit në fakt është një mënyrë me të cilën bëhet e mundur kufizimi i përgjegjësive së organizatorit të udhëtimit. Shuma më e lartë e shpërblimit e parapërcaktuar, ajo jo vetëm që duhet të bëhet në formën me shkrim, pra në kontratë të jetë evidentuar me shkrim, por ajo nuk guxon të jetë dukshëm në shpërpjesëtim me dëmin që është shkaktuar. Shuma më e lartë e shpërblimit për dëmin e parapërcaktuar në fakt është një shumë apriori e caktuar për dëmin që mund të ndodhë, p.sh., për humbjen e bagazhit do të paguhet kjo shumë e të holla si shpërblim i dëmit, ose në rast të lëndimit trupor të lehtë ose të rëndë do të paguhet shuma e caktuar e shprehur në numër konkret paraprakisht. Ky kufizim, nuk vlen në qoftë se dëmi shkaktohet me dashjen e organizatorit të udhëtimit ose nga pakujdesia e madhe e organizatorit të udhëtimit. Kjo shprehimisht parashihet në paragrafin vijues të këtij neni.

891.3. Paragrafi 3 i këtij neni, parasheh se kufizimi i shumës më të lartë të shpërblimit nuk vlen kur organizatori i udhëtimit e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ekstreme. Pakujdesia ekstreme do të thotë se çdokush tjetër nuk do të vepronte ashtu siç ka vepruar organizatori i udhëtimit në rastin konkret. Pra, çdo person që ushtron ndonjë veprimtari do të kuptonte se me veprimin e tillë shkaktohet dëm. Pra, kjo ekziston në rastet kur pakujdesia ka qenë aq e dukshme sa nuk mund të arsyetohet nga rrethanat normale.

.....
746 Shih: LMD i Kosovës, neni 39, paragrafi 4, ku thuhet “Në rast se nuk ka bazë ose baza është e palejueshme, kontrata është nul dhe absolutisht e pavlefshme” dhe komentën e këtij neni.

KREU 3

DETYRIMET E UDHËTARIT

Neni 892. Pagimi i çmimit

Udhëtari ka për detyrë që organizatorit të udhëtimit t'i paguajë çmimin e kontraktuar për udhëtimin në kohën, sikundër është kontraktuar, respektivisht siç praktikohet.

892. Vështrim i përgjithshëm. Kreu 3 i LMD i pjesës së njëzet e një i LMD të Kosovës, përmban dispozitat me të cilat rregullohen detyrimet e udhëtarit ndaj organizatorit të udhëtimit. Detyrimet e udhëtarit, siç janë : pagimi i çmimit; detyrimi i dhënies të të dhënave; përmbushja e kushteve të parashikuara me dispozita; dhe përgjegjësia e udhëtarit për dëmin e shkaktuar, rregullohen me nenet 892-895 të LMD të Kosovës.

Neni 892, përmban dispozitën me të cilën udhëtari ka për detyrë respektivisht detyrohet që organizatorit të udhëtimit t'i paguajë çmimin e kontraktuar për udhëtimin. Kontraktimi i çmimit në bazë të kontratës për organizimin e udhëtimit caktohet në shumë fikse dhe në të janë të llogaritura krejt ajo çka është paraparë me vërtetimin e udhëtimit. Pagimi i çmimit, duhet të bëhet në kohën, sikundër është kontraktuar respektivisht siç praktikohet. Rregull është që koha e pagimit të çmimit duhet të parashihet me vetë kontratën për udhëtimin ndërsa përjashtimisht mund të ndodhë që koha e pagimit të caktohet edhe në bazë të asaj se si praktikohet, si veprohet në rastet e tilla. Me fjalën “siç praktikohet” duhet kuptuar standardin e kohës për realizimin të pagesës nga ana e udhëtarit. Pra, kjo mund të jetë para nisjes së udhëtimit, pas përfundimit të udhëtimit ose në mënyrë suksesive. Natyrisht, kjo është çështje që duhet kontraktuar midis organizatorit të udhëtimit dhe udhëtarit. Por, kur me kontratë nuk është kontraktuar koha e pagimit të çmimit, atëherë duhet shikuar se si veprohet në rastet e tilla nga organizatorët e tjerë të udhëtimit respektivisht merren doket e mira afariste me të cilat vlejnjë për veprimtari turistike. Në literaturën juridike, thuhet se, nëse nuk mund të konstatohet zakoni lokal për pagimin e shërbimit organizatorit të udhëtimit, atëherë mund të zbatohen dispozitat e përgjithshme të të drejtës detyrimore të cilat janë të zbatueshme për përmbushjen e detyrimeve në para⁷⁴⁷. LMD i Kosovës, parashih mundësinë që palët kontraktuese të respektojnë doket e mira afariste në marrëdhëniet e tyre kontraktore⁷⁴⁸. Koha e pagimit të çmimit nga ana e udhëtarit është detyrim i cili mund të konsiderohet edhe si çështje esenciale e kontratës, prandaj mos pagimi i çmimit kur ai kërkohet para fillimit të realizimit të kontratës është bazë e mjaftueshme për zgjidhjen e kontratës. Koha e pagimit të çmimit zakonisht është para fillimit të udhëtimit sepse organizatori i udhëtimit këto para

747 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1317.

748 LMD i Kosovës, neni 4, paragrafi 2, ku thuhet “Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve duhet të veprojnë në pajtim me doket e mira afariste në marrëdhëniet e tyre. Pjesëmarrësit nuk mundin të përjashtojnë ose kufizojnë këtë detyrim”; dhe neni 11, ku thuhet “Doket afariste, uzansat dhe praktika e krijuar ndërmjet palëve duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e sjelljes së kërkuar dhe efekteve të saj në marrëdhëniet e detyrimeve të subjekteve afarist”.

i përdorë për të realizuar përbajtjen e vetë kontratës për organizimin e udhëtimit. Mirëpo, organizatori i udhëtimit mund të sigurojë lehtësime për udhëtarët duke i kredituar ata që do të thotë u mundësohet pagimi i çmimit të udhëtimit të jetë me rata (këste). Në këto raste, pagimi i çmimit nuk është i menjëhershëm por në pajtim me kontratën.

Neni 893. Detyrimi i dhënies të të dhënave

Udhëtari ka për detyrë që me kërkesën e organizatorit, t'i japë në kohën e duhur të gjitha të dhënat e nevojshme për organizimin e udhëtimit, e sidomos për marrjen e biletave të udhëtimit, rezervimin e strehimit, si dhe dokumentet e nevojshme për kalimin e kufirit.

893. Vështrim i përgjithshëm. Neni 893, përmban dispozitën sipas të cilës udhëtari ka për detyrim që t'i përmbushë të gjitha kushtet e parashikuara me dispozita. Udhëtari, nuk mund të ndërmarrë veprime me të cilat vihet ndesh me dispozitat qofshin ato dispozita kontraktore apo dispozita ligjore. Në rast të mosrespektimit të kushteve të parashikuara me dispozita, nëse shkaktohet dëm ndaj udhëtarit, organizatori nuk do të përgjigjet për shkak se udhëtari nuk i ka respektuar ose nuk i ka përmbushur kushtet e parashikuara me dispozita. Neni 893, shprehimisht parasheh se, udhëtari ka për detyrë që me kërkesën e organizatorit t'i ofrojë të gjitha të dhënat e nevojshme për organizimin e udhëtimit. Këto të dhëna udhëtari i ka për detyrim t'i ofrojë në kohën e duhur që do të thotë kohë e mjaftueshme për realizimin e udhëtimit. Si të dhëna të nevojshme për organizimin e udhëtimit është dhënia e shënimeve (emri, mbiemri, data e lindjes, etj) për marrjen e biletës të udhëtimit, shënimet për rezervimin e strehimit si dhe dokumentet e nevojshme për kalimin e kufirit. Shënimet për rezervimin e strehimit nënkuptojnë të dhënat e udhëtarit lidhur me mënyrën e shfrytëzimit të strehimit, kohën e mbërritjes në vendin e strehimit nëse nuk është paraparë me kontratë, pastaj duhet të ofrohet pasaporta në kohë të duhur kur kërkohet sigurimi i vizave nëse këtë e bën organizatori i udhëtimit ose përgaditja e regjistrimit të emrave me udhëtarët në bazë të dokumentit të udhëtimit.

Neni 894. Përmbushja e kushteve të parashikuara me dispozita

Udhëtari ka për detyrë të kujdeset që ai personalisht, dokumentet e tij dhe bagazhi i tij t'i përmbushin kushtet e parashikuara me dispozitat kufitare, doganore, sanitare, monetare dhe me dispozitat e tjera administrative.

894. Vështrim i përgjithshëm. Neni 894, përmban dispozitën me të cilën rregullohet detyrimi i udhëtarit që t'i përmbushë kushtet e parashikuara me dispozita kontraktuese ose ligjore të cilat kërkohen nga ana e organizatorit të udhëtimit. Neni 894, parasheh detyrimin e udhëtarit që të kujdeset që ai vetë personalisht, pastaj dokumentet e tij si dhe bagazhi i tij t'i përmbushin

kushtet e parashikuara me dispozitat kufitare që do të thotë identiteti i tij të jetë ashtu siç figuron në dokumenta dhe mos të dallojë nga dokumenti i udhëtimit të tij, pastaj duhet t'i ketë të gjitha dokumentet që kërkohen për të dëshmuar se është paguar dogana ose nuk ngarkohet me doganë për mallin që e bartë me veti, pastaj duhet t'i ketë edhe dokumentet e nevojshme që kërkohen lidhur me gjendjen sanitare respektivisht shëndetësore të tij, p.sh., çertifikata mjekësore për ndonjë sëmundje ngjitëse respektivisht kartoni shëndetësorë i udhëtarit⁷⁴⁹. Udhëtari i cili posedon shumë të parave me veti duhet të ketë dokumentin për prejardhjen e tyre ose nëse në shtetin ku shkohet kërkohet të ketë para duhet të ketë shumën në lartësinë që nevojitet respektivisht nëse kjo nuk është rregulluar me kontratën për organizimin e udhëtimit. Organizatori i udhëtimit, mund të kryejë shërbime për udhëtarin edhe jashtë asaj që është paraparë me kontratën për organizimin e udhëtimit por duhet udhëtari vetë t'i bartë shpenzimet për to, p.sh., nxjerrja e vizës. Mos përmbushja e kushteve të parashikuara me dispozita nga ana e udhëtarit ose përmbushja jo e plotë e tyre, nëse shkakton dëm të caktuar, atëherë përgjegjës për dëmin e shkaktuar është vetë udhëtari dhe jo organizatori i udhëtimit. Shkaktimi i dëmit, në këto raste mund të jetë kthimi nga kufiri për shkak se dokumentacioni i tij nuk është i rregullt, pra nuk i përgjigjet kërkesave që kërkohen me ratin e kalimit të kufirit respektivisht për hyrjen në shtetin tjetër ose për kalimin nëpër shtetin tjetër. Udhëtari, në qoftë se nuk ka respektuar dispozitën e nenit 894, ai mund t'i shkaktojë dëm vetës së tij por edhe organizatorit të udhëtimit, p.sh., detyrohet të mbetet mjeti i transportit në doganë dhe të humbin lidhjet tjera të planifikuara nga ana e organizatorit, atëherë udhëtari do të përgjigjet për dëmin që i shkaktohet organizatorit të udhëtimit.

Neni 895. Përgjegjësia e udhëtarit për dëmin e shkaktuar

Udhëtari përgjigjet për dëmin që i shkaktonte organizatorit të udhëtimit nga moskryerja e detyrimeve që rezultojnë për të nga kontrata dhe nga dispozitat e këtij ligji.

895. Vështrim i përgjithshëm. Neni 895, përmban dispozitën me të cilën rregullohet edhe përgjegjësia e udhëtarit për dëmin të cilin mund t'ia shkaktojë organizatorit të udhëtimit. Ashtu siç përgjigjet organizatori i udhëtimit për dëmin që mund t'i shkaktojë udhëtarit, gjithashtu edhe udhëtari përgjigjet për dëmin të cilin i'a shkaktonte organizatorit të udhëtimit. Neni 895, shprehimisht e rregullon edhe përgjegjësinë e udhëtarit për dëmin të cilin mund t'ia shkaktojë organizatorit të udhëtimit nëse nuk i përmbushë detyrimet të cilat i ka marrë nga organizatori i udhëtimit në bazë të kontratës për udhëtimin si dhe për detyrimet tjera që dalin nga dispozitat qofshin të karakterit administrativ apo civil. Udhëtari, mundet që me veprimet e veta mos t'i përmbushë kërkesat që kërkohen nga kontrata për organizimin e udhëtimit ose ato t'i përmbushë në mënyrë jo të plotë dhe me një sjellje të tillë i shkaktohet dëm organizatorit të udhëtimit për të cilin do të përgjigjet vetë udhëtari. Udhëtari në rast se shkaktonte dëm organizatorit të udhëtimit, ai duhet t'a shpërblejë dëmin ndaj organizatorit të udhëtimit si dhe nëse organizatori i udhëtimit ka paguar në emër të dëmit të shkaktuar udhëtarëve të tjerë,

⁷⁴⁹ Udhëtari duhet edhe të lajmërojë se për shkak të shëndetit ka nevojë për ushqim të veçantë se ka sëmundje aklergjike, etj.

atëherë udhëtari që ka shkaktuar dëmin ndaj organizatorit do të shpërblejë edhe dëmin të cilin u'a ka paguar organizatori i udhëtimit udhëtarëve të tjerë, p.sh., nëse për shkak të vonimit të autobusit në doganë me fajin e udhëtarit, organizatori i udhëtimit është i detyruar t'i vendosë udhëtarët tjerë në hotel, atëherë këtë shumë do t'a paguajë vetë udhëtari që ka shkaktuar dëmin, drejtëpërsëdrejti ose pas kthimit nga udhëtimi i organizuar. Përgjegjësia e udhëtarit, nëse ka shkaktuar dëm ajo realizohet në pajtim me kontratën për organizimin e udhëtimit por edhe sipas dispozitave të LMD të Kosovës që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrimeve dhe përgjegjësitë për shkak të mospërmbushjes së tyre.

KREU 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E VEÇANTA TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 896. Zëvendësimi i udhëtarit me ndonjë person tjetër

Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, udhëtari mund të caktojë personin tjetër që në vend të tij t'i shfrytëzojë shërbimet e kontraktuara me konditë që ky person t'i plotësojë kushtet e veçanta të parashikuara për udhëtimin e caktuar dhe që udhëtari t'i shpërblejë organizatorit të udhëtimit shpenzimet e shkaktuara nga zëvendësimi.

896. Vështrim i përgjithshëm. Kreu 4 i pjesës së njëzetë e një (XXI), përmban dispozitat me të cilat rregullohen edhe të drejtat dhe detyrimet e veçanta të palëve kontraktuese. Këto të drejta janë rezultat i rrethanave të cilat nuk kanë qenë të njohura në momentin e lidhjes së kontratës për organizimin e udhëtimit ose nuk i kanë paraparë në momentin e lidhjes së kontratës. Të drejtat dhe detyrimet e veçanta të palëve kontraktuese kanë të bëjnë me : zëvendësimin e udhëtarit me ndonjë person tjetër; pastaj rritja ose ulja e çmimit të kontraktuar; e drejta e udhëtarit për të hequr dorë nga kontrata; dhe ndryshimet në programin e udhëtimit (nenet 896-900).

Neni 896, lejon mundësinë që udhëtari nëse nuk është kontraktuar ndryshe mund të caktojë personin tjetër që të realizojë shërbimet e kontraktuara në vend të tij me kusht që personi i caktuar si zëvendësim t'i plotësojë të gjitha kushtet e veçanta të parashikuara për udhëtimin e caktuar ndërsa udhëtari t'i shpërblejë organizatorit të udhëtimit shpenzimet e shkaktuara nga zëvendësimi. Këto shpenzime, i bartë vetë udhëtari i cili ka caktuar personin tjetër që t'i shfrytëzojë shërbimet e kontraktuara në vend të tij. Çështja e zëvendësimit të udhëtarit sipas kërkesës së udhëtarit i cili ka lidhur kontratë me organizatorin e udhëtimit është e karakterit dispozitiv që do të thotë lejohet që palët me marrëveshje të caktojnë mundësinë e zëvendësimit të personit ose të ndalojnë zëvendësimin e udhëtarit me ndonjë person tjetër. Nëse nuk është paraparë ndalimi i zëvendësimit me kontratë atëherë sipas kësaj dispozite organizatori i udhëtimit nuk mund t'ia ndalojë udhëtarit që të caktojë personin tjetër në vend të tij t'i shfrytëzojë shërbimet e kontraktuara nëse zëvendësuesi i plotëson kushtet e veçanta të cilat janë parashikuar për udhëtimin e caktuar dhe nëse i'a paguan organizatorit të udhëtimit të gjitha shpenzimet e reja që shkaktohen për shkak të zëvendësimit. Andaj, pjesa

e dytë e kësaj dispozite tregon se organizatori i udhëtimit është i obliguar t'a respektojë vullnetin e udhëtarit i cili kërkon zëvendësim për shfrytëzimin e shërbimeve nëse nuk është ndaluar me kontratën për organizimin e udhëtimit.

Neni 897. Rritja dhe ulja e çmimit të kontraktuar

- 1. Organizatori i udhëtimit mund të kërkojë rritjen e çmimit të kontraktuar vetëm në qoftë se pas lidhjes së kontratës kanë ndodhur ndryshime, në kursin e këmbimit të valutës apo ndryshime në tarifatat e transportuesve të cilat ndikojnë në çmimin e udhëtimit. Nëse ndryshimet e tilla kanë ndikuar në uljen e çmimit të udhëtimit, atëherë organizatori i udhëtimit duhet të kthejë diferencën në çmimit tek udhëtarit.**
- 2. Organizatori i udhëtimit mund ta përdori të drejtën e rritjes së çmimit të kontraktuar ose detyrohet të pranojë uljen e çmimit të përcaktuar në paragrafin e mësipërm, nëse ndryshimi i çmimit pas lidhjes së kontratës dhe metoda e llogaritjes së ndryshimit janë të parapara në vërtetimin e udhëtimit. Çmimi i udhëtimit mund të rritet vetëm deri në njëzet ditë para fillimit të udhëtimit.**
- 3. Nëse rritja e çmimit të kontraktuar kalon shumë prej dhjetë për qind (10%), udhëtarit mund të tërhiqet nga kontrata pa pasur detyrim për shpërblimin e dëmit.**
- 4. Në rastin e fillimit të udhëtimit ka të drejtën që t'i kthehet shuma që i ka paguar organizatorit të udhëtimit.**

897. Vështrim i përgjithshëm. Neni 897, rregullon njëzëri ndër çështjet më të ndishme siç është rritja dhe ulja e çmimit të kontraktuar. Kjo dispozitë lejon mundësinë që çmimi i kontraktuar për shërbimet që ofrohen nga kontrata për organizimin e udhëtimit të mund të rritet ose të zvogëlohet. Andaj, nuk është rregull rritja ose ulja e çmimit të kontraktuar sepse kjo krijon një pasiguri si për organizimin e udhëtimit ashtu edhe për realizimin e udhëtimit. Kjo dispozitë përmban katër paragrafe me të cilat krijohet baza juridike për rritjen dhe uljen e çmimit të kontraktuar.

897.1. Paragrafi 1 i këtij neni, shprehimisht parasheh se organizatori i udhëtimit mund të kërkojë rritjen e çmimit të kontraktuar dhe atë vetëm nëse pas lidhjes së kontratës ka ndodhur ndryshime në kursin e këmbimit të valutës që do të thotë ose është rritur ose është zvogëluar disproporcioni i valutës së shtetit ku organizatori e ka selinë me valutat e shteteve tjera p.sh., ku do të realizohet udhëtimi apo kanë ndryshuar tarifatat e transportuesve dhe në këtë mënyrë ndikojnë drejtëpërsëdrejti në çmimin e udhëtimit. Në këto raste, organizatorit i lejohej të kërkojë rritjen e çmimit të kontraktuar, ndërsa udhëtarit ka të drejtë të pajtohet me rritjen e çmimit ose të kërkojë zgjidhjen e kontratës. Kjo dispozitë parasheh edhe mundësinë që udhëtarit t'i kthehet diferenca e çmimit nëse ndryshimet me kursin e këmbimit të valutës apo ndryshimet e tarifave të transportuesve janë zvogëluar. Sipas kësaj dispozite organizatori i udhëtimit nën kushtet e parapara me këtë dispozitë ka të drejtë të kërkojë rritjen e çmimit të kontraktuar, që udhëtarit të paguajë më shumë se sa e ka kontraktuar udhëtimin, por ka edhe detyrim që nën kushtet e parapara me këtë dispozitë ai duhet t'i kthejë udhëtarit diferencën e çmimit kur ka ndodhur zvogëlimi i çmimit për

shkak të ndryshimit të kursit valutor ose tarifës së transportuesve. Kjo dispozitë ligjore është decidive dhe lejon rritjen e çmimit kontraktues nga ana e organizatorit të udhëtimit vetëm për shkak të ndryshimit valutor dhe tarifës së transportuesve ndërsa nuk ka të bëjë me rritje tjera eventuale që e përcjellin programin e udhëtimit respektivisht kontratën për organizimin e udhëtimit. Kjo nënkupton se rritjet eventuale të çmimeve për çështjet tjera nuk janë bazë juridike për rritjen e çmimit të organizimit të udhëtimit, p.sh., rritja e çmimit të ushqimit. Rritja apo zvogëlimi i çmimit të kontraktuar është gjithmonë vetëm përjashtim sepse rregull është që kontrata për organizimin e udhëtimit të përmbushet ashtu siç janë marrë vesh palët. Pra, edhe çmimi i udhëtimit të jetë ai për të cilin palët janë marrë vesh me kontratë. Rritja dhe ulja e çmimit të kontraktuar sipas kësaj dispozite duhet të ndodhë para se të fillojë realizimi i udhëtimit në bazë të kontratës për organizimin e udhëtimit.

897.2. Paragrafi 2, shprehimisht parasheh se organizatori i udhëtimit mund t'a përdorë të drejtën e rritjes së çmimit të kontraktuar ose të detyrohet nga udhëtarët të pranojë uljen e çmimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nëse ndryshimi i çmimit pas lidhjes së kontratës dhe metoda e llogaritjes së ndryshimit janë të parapara në vërtetimin e udhëtimit. Pra, nuk do të njihet e drejta e rritjes apo uljes së çmimit nëse ndryshimi i çmimit pas lidhjes së kontratës dhe metoda e llogaritjes së udhëtimit nuk janë të parapara në vërtetimin e udhëtimit. Ky paragraf, përmban edhe rregullën sipas të cilës çmimi i udhëtimit mund të rritet deri në njëzet ditë (20) ditë para fillimit të udhëtimit. Organizatori i udhëtimit, sipas këtij paragrafi të drejtën e rritjes apo uljes së çmimit nën kushtet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, mund t'a realizojë deri në kohën 20 ditë para fillimit të udhëtimit si dhe nëse kjo është paraparë në vërtetimin e udhëtimit (në kontratën për organizimin e udhëtimit).

897.3. Paragrafi 3, parasheh të drejtën e udhëtarit që të mund të tërhiqet nga kontrata pa pasur detyrim për shpërblimin e dëmit nëse rritja e çmimit të kontraktuar e kalon shumë prej 10% nga çmimi i kontraktuar, p.sh., ka qenë 100 EURO, bëhet më shumë se 110 EURO. Në këtë rast, udhëtari i cili heqë dorë nga kontrata respektivisht tërhiqet nga kontrata nuk ka për detyrim të paguajë shpërblimin e dëmit ndaj organizatorit të udhëtimit nëse për arsye të tërheqjes nga kontrata është shkaktuar dëmi. Udhëtari, ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës në çdo rast kur ajo rritet pa marrë parasysh lartësinë e rritjes por nëse kjo nuk është më shumë se 10%, atëherë udhëtari ka për detyrim që organizatorit të udhëtimit t'i shpërblejë dëmin të cilin e ka pësuar për shkak të zgjidhjes së kontratës nga ana e udhëtarit. Organizatori i udhëtimit, duhet të kujdeset që mos të ketë rritje të çmimit në krahasim me atë çka është kontraktuar. Çmimi i udhëtimit (aranzhmanit) i caktuar me kontratë, ditën e lidhjes së kontratës i obligon palët kontraktuese. Mirëpo, neni 897 i LMD të Kosovës, lejon mundësinë që si përjashtim organizatori i udhëtimit mund t'a rrisë çmimin e udhëtimit ose t'a pranojë uljen e çmimit nën kushtet e parapara me këtë nen. Me rastin e ndërrimit të çmimit organizatori i udhëtimit duhet t'i njoftojë udhëtarët me shkrim ose me gojë sa më shpejtë dhe t'i njoftojë me arsyet pse ka ardhur deri te rritja e çmimit. Udhëtari, pasi të njoftohet me shkrim ose me gojë është i detyruar të deklarojë se kundërshton këtë ndryshim të çmimit dhe heqë dorë nga kontrata konsiderohet se është pajtuar me çmimin e ri.

897.4. Paragrafi 4, parasheh të drejtën e udhëtarit që t'i kthehet shuma që i ka paguar organizatorit të udhëtimit kur ka ndodhur rritja e çmimit të kontraktuar më shumë se 10%

nga çmimi i kontraktuar. Kjo dispozitë, nuk kërkon arsyetim të veçantë nga ana e udhëtarit për shkak të tërheqjes nga kontrata por vetëm thuhet se udhëtari ka të drejtën që t'i kthehet shuma që i ka paguar organizatorit të udhëtimit. Me rastin e rritjes së çmimit kontraktues më shumë se 10% përgjegjësia për këtë rritje e cila është në pajtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, bie mbi organizatorin e udhëtimit ndërsa udhëtari nuk ka kurrfarë përgjegjësie. Në literaturën juridike ka mendime se udhëtari për t'u tërhequr nga kontrata pa pasur detyrim për shpërblimin e dëmit si dhe t'i kthehet shuma që ka paguar ndaj organizatorit të udhëtimit duhet të provojë se ekzistojnë rrethanat për shkak të të cilave është tërhequr nga udhëtimi dhe se ai mund të lirohet nga të provuarit e rrethanave që kanë ndikuar në tërheqjen nga kontrata vetëm nëse siguron zëvendësimin e tij me ndonjë person tjetër⁷⁵⁰. Konsiderojë se ky qëndrim nuk mund të arsyetohet për shkak se dispozita e nenit 897, paragrafi 3 dhe 4 i LMD të Kosovës, janë shumë të qarta që do të thotë e drejtë për tërheqje nga kontrata pa pasur detyrim për shpërblimin e dëmit është vetëm fakti se çmimi kontraktues i rritur kalon shumë prej 10% nga çmimi kontraktues dhe në këtë rast udhëtari nuk ka detyrim për shpërblimin e dëmit por e gëzon të drejtën sipas paragrafit 4 që t'i kthehet shuma të cilën i'a ka paguar organizatorit të udhëtimit para rritjes së çmimit kontraktues.

Neni 898. E drejta e udhëtarit për të hequr dorë nga kontrata

- 1. Udhëtari në çdo moment mund të heqë dorë nga kontrata, plotësisht ose pjesërisht.**
- 2. Në qoftë se udhëtari para fillimit të udhëtimit heq dorë nga kontrata në një afat të arsyeshme që caktohet duke marrë parasysh llojin e aranzhmanit (heqja dorë në kohën e duhur), organizatori i udhëtimit ka të drejtë vetëm në shpërblimin e shpenzimeve administrative.**
- 3. Në rast të heqjes dorë jo në kohën e duhur nga kontrata, organizatori i udhëtimit mund të kërkojë nga udhëtari shpërblimin në përqindje të caktuar të çmimit të kontraktuar, që përcaktohet përpjestimisht me kohën që mbetet deri në fillim të udhëtimit dhe që duhet të justifikohet ekonomikisht.**
- 4. Organizatori i udhëtimit ka të drejtë vetëm në shpërblimin e shpenzimeve të bëra në qoftë se udhëtari ka hequr dorë nga kontrata për shkak të rrethanave që nuk ka mundur t'i evitojë ose t'i shmangë dhe që, po të ekzistojnë në kohën e lidhjes së kontratës, do të përbënin shkak të bazuar që kontrata të mos lidhet, si dhe në rastin kur udhëtari e ka siguruar zëvendësimin përkatës apo zëvendësimin e ka gjetur vetë organizatori.**
- 5. Në qoftë se udhëtari heq dorë nga kontrata pas fillimit të udhëtimit, kurse shkak për këtë nuk janë rrethanat nga paragrafi paraprak i këtij neni, organizatori ka të drejtë në shumën e plotë të çmimit të kontraktuar të udhëtimit.**

898. Vështrim i përgjithshëm. Neni 898, përmban dispozitat me të cilat rregullohen të drejtat e udhëtarit për të hequr dorë nga kontrata e që caktohet në bazë të drejtave dhe

⁷⁵⁰ Čavdar, Kiril, vepra e cituar, fq. 1035.

detyrimeve të veçanta të palëve kontraktuese. Palët kontraktuese, kanë të drejtë në raste të caktuara të heqin dorë nga kontrata nën kushtet e parapara me kontratë ose me ligj. E drejta e heqjes dorë e udhëtarit nga kontrata rregullohet me nenin 898 të LMD të Kosovës, ndërsa e drejta e organizatorit të udhëtimit për të hequr dorë nga kontrata rregullohet me nenin 899 të LMD të Kosovës. Heqja dorë nga kontrata do të jetë e mundur vetëm në rastet e caktuara sepse rregull është përmbushja e rregullt e kontratës midis palëve e në rastin konkret midis organizatorit të udhëtimit në njërën anë dhe udhëtarit në anën tjetër si palë kontraktuese. Kjo dispozitë ligjore, është pasojë e rrethanave dhe përjashtimeve të veçanta sipas të cilave palëve në rastet e caktuara u mundësohet shmangje nga kontrata. Heqja dorë nga kontrata krijon edhe shuarjen e vetë kontratës. Shuarja e kontratës për organizimin e udhëtimit shuhet edhe sipas mënyrave të tjera të parapara në pjesën e përgjithshme për shuarjen e kontratave. Dispozitat e këtij neni lidhur me heqjen dorë nga kontrata krijojnë mundësinë që udhëtari të heqë dorë në mënyrën më të thjeshtë të mundshme dhe kjo bëhet për shkak se kontrata për organizimin e udhëtimit është e natyrës së veçantë. Realizimi i kësaj kontrate kërkon një kohë më të gjatë. Heqja dorë nga kontrata, mund të bëhet para fillimit të realizimit të kontratës por edhe për arsye të caktuara edhe gjatë realizimit të kontratës për organizimin e udhëtimit. Kjo dispozitë ligjore, i mundëson udhëtarit të heqë dorë nga kontrata në çdo moment dhe atë plotësisht ose pjesërisht. Neni 898, përmban pesë paragrafe me të cilat hollësisht rregullohet e drejta e heqjes dorë të udhëtarit nga kontrata si dhe të drejtat dhe pasojat që lindin për shkak të heqjes dorë nga kontrata.

898.1. Paragrafi 1, përmban dispozitën mjaft të qartë dhe atë të karakterit të përgjithshëm sipas të cilit udhëtari në çdo moment mund të heqë dorë nga kontrata plotësisht ose pjesërisht. Pra, ky paragraf, përcakton të drejtën të pakushtëzuar të heqjes dorë nga kontrata dhe kjo mund të jetë plotësisht ose pjesërisht. Paragrafet tjera në vijim, përcaktojnë se çka do të ndodhë kur udhëtari heqë dorë nga kontrata para fillimit të udhëtimit në një afat të arsyeshëm, të drejtën e organizatorit të udhëtimit që të kërkojë nga udhëtari të drejtën e shpërblimit të çmimit të caktuar kontraktues, të drejtën e organizatorit të udhëtimit në shpërblimin e shpenzimeve të bëra kur udhëtari ka hequr dorë nga kontrata për shkak të rrethanave që nuk ka mundur t'i evitojë, etj. Udhëtari, edhe pse ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata plotësisht ose pjesërisht në çdo moment ai heqjen dorë nga kontrata duhet t'a bëjë në formë të përshtatshme që organizatori të dijë heqjen dorë të udhëtarit nga kontrata dhe atë a është e plotë apo e pjesërishtme si dhe momentin që konsiderohet kohë e heqjes dorë nga kontrata për shkak se nga koha e heqjes dorë nga kontrata organizatori i udhëtimit nuk ka të drejtë të kërkojë shpenzime administrative të bëra lidhur me udhëtarin. Heqja dorë nga kontrata duhet të bëhet në formën edhe në të cilën është lidhur kontrata për organizimin e udhëtimit. Kjo do të thotë se kur kontrata për organizimin e udhëtimit është me shkrim atëherë edhe heqja dorë do të jetë me shkrim. Nëse heqja dorë nuk bëhet me shkrim nuk do të thotë se udhëtari mund të detyrohet në realizimin e kontratës për udhëtimin por mund të përballet me pasojat e shpërblimit të dëmit për shkak të paqartësisë së plotë për heqjen dorë nga kontrata. Heqja dorë e udhëtarit nga kontrata për udhëtimin është çështje që rregullohet me kontratë dhe ligji nuk parasheh formalitet por nëse nuk është bërë me kontratë forma e heqjes dorë nga kontrata për organizimin e udhëtimit ajo duhet të bëhet në atë formë që e kërkojnë rrethanat për rastin konkret.

898.2. Paragrafi 2, shprehimisht parasheh se nëse udhëtari para fillimit të udhëtimit heqë dorë nga kontrata në një afat të arsyeshëm që caktohet duke marrë parasysh llojin e aranzhmanit (heqja dorë në kohën e duhur), organizatori i udhëtimit ka të drejtë të kërkojë prej udhëtarit i cili ka hequr dorë në kohën e paraparë me kontratë respektivisht në kohën e duhur që mund të jetë kohë e cila nuk është caktuar me kontratë ose mund të caktohet sipas dokeve të mira afariste, vetëm shpërblimin e shpenzimeve administrative. Në këtë rast, organizatori nga udhëtari që ka hequr dorë para fillimit të udhëtimit mund të përbushë vetëm shpenzimet administrative të cilat i ka bërë organizatori i udhëtimit për udhëtarin me qëllim të lidhjes së kontratës dhe të përbushjes së saj. Shpenzime administrative, do të ishin pagimi i taksave të ndryshme, telefonatave, etj.

898.3. Paragrafi 3, përmban dispozitën sipas të cilës nëse udhëtari heqë dorë jo në kohën e duhur nga kontrata atëherë organizatori i udhëtimit mund të kërkojë nga udhëtari shpërblimin në përqindje të caktuar të çmimit kontraktues që përcaktohet përpjestimisht me kohën që mbetet deri në fillim të udhëtimit dhe që duhet justifikohet ekonomikisht. Në shumicën e rasteve, organizatorët e udhëtimit me kontratë parashohin shkallën e shpërblimit në proporcion me çmimin e përgjithshëm, p.sh., udhëtari do të paguajë 5% të vlerës së çmimit paushall për udhëtimin e kontraktuar nëse heqjen dorën nga kontrata për udhëtimin e ka bërë në kohën prej 50 ditësh para fillimit të udhëtimit ose do të paguajë 90% të vlerës së çmimit për udhëtimin e kontraktuar nëse heqjen dorë nga kontrata për udhëtimin e ka bërë dy (2) ditë para udhëtimit që nuk konsiderohet heqje dorë në kohën e duhur. Me këtë dispozitë, mbrohet organizatori i udhëtimit që pasojat nga heqja dorë e udhëtarit nga kontrata, në kohën jo të duhur të zvogëlohen respektivisht të qëndrojnë në ekuivalencë të përqindjes së caktuar në raport me çmimin kontraktues dhe kjo përqindje duhet të justifikohet ekonomikisht që do të thotë organizatori i udhëtimit nuk mund të dënojë udhëtarin pse ka hequr dorë nga kontrata por gëzon të drejtën e mbrojtjes së dëmit që i shkaktohet për shkak të heqjes dorë nga kontrata në kohën jo të duhur nga ana e udhëtarit. Programet e udhëtimeve shpeshëherë përcaktojnë se udhëtari i cili heqë dorë në një afat më pak se dyzet e pesë (45) ditë para udhëtimit që është shumë afër heqjes dorë nga kontrata në kohën e duhur të paguhet shuma prej 5% e vlerës së çmimit të kontraktuar, ndërsa 10% nëse heqja dorë nga udhëtimi bëhet dyzet e katër (44) ditë deri në tridhjetë (30) ditë para nisjes së udhëtimit, ndërsa 20% nëse heqja dorë bëhet njëzet e nëntë (29) ditë deri në njëzet (20) ditë para fillimit të udhëtimit; 40% nëse heqja dorë bëhet nëntëmbëdhjetë (19) ditë deri pesëmbëdhjetë (15) ditë para nisjes së udhëtimit; 80% nëse heqja dorë bëhet katërmëdhjetë (14) ditë deri dhjetë (10) ditë para fillimit të udhëtimit; 90% nëse heqja dorë nga udhëtimit bëhet nëntë (9) ditë deri në gjashtë (6) ditë para fillimit të udhëtimit dhe 100% e çmimit të vlerës së udhëtimit nëse heqja dorë bëhet pesë (5) ditë deri zero (0) ditë para fillimit të udhëtimit ose gjatë udhëtimit. Këtë bazë organizatorët e udhëtimit e gjejnë në vetë dispozitën e paragrafit 3 të këtij neni. Skema e prezantuar është nxjerrë nga më shumë burime që përmbajnë programet e udhëtimeve të agjensioneve turistike.

898.4. Paragrafi 4, përmban dispozitën sipas të cilës organizatori i udhëtimit kur vjen deri te heqja dorë e udhëtarit nga kontrata për shkak të rrethanave që nuk ka mundur t'i evitojë ose t'i

shmangë dhe të njëjtat po të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës do të konsideroheshin shkak i mjaftueshëm që kontrata të mos lidhet, atëherë organizatorit të udhëtimit i takon e drejta vetëm në shpërblimin e shpenzimeve të bëra. Organizatorit të udhëtimit i takon vetëm e drejta e shpërblimeve të bëra edhe në qoftë se udhëtari i cili ka hequr dorë nga kontrata e ka siguruar zëvendësimin përkatës apo zëvendësimin e ka gjetur vetë organizatori. Kjo dispozitë, përbëhet prej dy pjesëve në bazë të të cilave organizatorit të udhëtimit i takon vetëm e drejta e shpërblimit për shpenzimet e bëra, e para ishte kur udhëtari heqë dorë nga kontrata për shkak të rrethanave që nuk ka mundur t'i evitojë ose t'i shmange dhe këto janë rrethana të tilla të cilat edhe sikur të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës do të ishin bazë e mjaftueshme që kontrata mos të lidhet fare, pra rrethanat të cilat kanë kushtëzuar heqjen dorë nga kontrata nga ana e udhëtarit janë të asaj natyre që konsiderohen të pa evitueshme respektivisht të pa shmangshme dhe këto rrethana janë të atilla që as kontrata e udhëtimit nuk do të ishte lidhur po të kishin qenë të njohura në momentin e lidhjes së kontratës. Pjesa e dytë e këtij paragrafi, ka të bëjë me rastin kur udhëtari ose vetë organizatori i udhëtimit arrin të sigurojë zëvendësimin e tij, atëherë organizatorit të udhëtimit gjithashtu i takon vetëm e drejta në shpërblimin për shpenzimet e bëra. Se shkaqet për të cilat bëhet heqja dorë nga kontrata nga ana e udhëtarit janë të tilla që duhet të pranohen edhe nga ana e organizatorit të udhëtimit duhet që udhëtari të provojë se ato shkaqe janë të natyrës së paevitueshme dhe bazë e mjaftueshme edhe për mos lidhjen e kontratës kur ato janë të njohura që në momentin e lidhjes së kontratës. Kontrata për organizimin e udhëtimit duhet shprehimisht t'i numërojë rastet që konsiderohen të mjaftueshme për t'a përjashtuar përgjegjësinë për dëmin që i shkakton udhëtari për shkak të heqjes dorë nga kontrata, dhe në këtë rast organizatori i udhëtimit nëse ndodhë heqja dorë nga kontrata nga ana e udhëtarit, organizatori i udhëtimit ka vetëm të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve të bëra. Si shkaqe të arsyeshme për heqjen dorë nga kontrata nga ana e udhëtarit konsiderohen : sëmundja, vdekja e anëtarit të familjes, angazhimi në ushtrimet ushtarake, etj.

898.5. Paragrafi 5, përmban dispozitën sipas të cilës në rastet kur udhëtari heqë dorë nga kontrata pas fillimit të udhëtimit, që do të thotë pasi të ketë filluar realizimi i udhëtimit ndërsa shkak për këtë heqje dorë nga kontrata nuk janë rrethanat të cilat nuk ka mundur t'i evitojë ose t'i shmangë dhe që po të ekzistonin ato rrethana në kohën e lidhjes së kontratës do të përbënin shkak të bazuar që kontrata të mos lidhet (rrethanat e parapara në paragrafin 4 të këtij neni), organizatori i udhëtimit ka të drejtë në shumën e plotë të çmimit të kontraktuar të udhëtimit. Kjo do të thotë, kur udhëtimi ka filluar dhe udhëtari heqë dorë nga udhëtimi i filluar, atëherë nëse arsyet e heqjes dorë nuk janë të natyrës që lirojnë udhëtarin nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar ndaj organizatorit të udhëtimit, atëherë udhëtari i cili ka hequr dorë nga udhëtimi i filluar do të paguajë shumë e plotë të çmimit të kontraktuar të udhëtimit. Në këtë rast, nuk parashihet mundësia e zëvendësimit të udhëtarit me kërkesën e udhëtarit që të krijohet mundësia që përgjegjësia e udhëtarit që ka hequr dorë nga kontrata e udhëtimit të ketë të bëjë vetëm me shumën e cila është humbur deri sa është siguruar zëvendësimi qoftë nga udhëtari ose nga vetë organizatori. Nëse organizatori i udhëtimit do të siguronte zëvendësimin e udhëtarit për pjesën e mbetur të udhëtimit dhe në anën tjetër do të realizonte çmimin e kontraktuar nga udhëtari i cili ka hequr dorë nga

udhëtimi duhet të konsiderohet se është shkaktuar pasurimi pa bazë juridike i organizatorit të udhëtimit. Pasurimi pa bazë juridike, i organizatorit të udhëtimit ka të bëjë në raport me personin i cili ka hequr dorë nga udhëtimi për shkak të rrethanave si të atyre që nuk ka mundur t'i evitojë e që do të ishin shkak i mjaftueshëm po të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës që kontrata të mos lidhej por edhe nëse shkaqet janë të natyrës tjetër, nuk është e drejtë që organizatori i udhëtimit për të njëjtën bazë juridike të realizojë dy të hyra respektivisht dy çmime për udhëtimin e kontraktuar.

Neni 899. E drejta e organizatorit të udhëtimit për të hequr dorë nga kontrata

- 1. Organizatori i udhëtimit mund të heqë dorë nga kontrata, plotësisht ose pjesërisht, pa detyrimin e shpërblimit të dëmit, në qoftë se përpara ose gjatë kohës së zbatimit të kontratës lindin rrethana të jashtëzakonshme që nuk kanë mundur të parashikohen dhe as të shmangen ose të mënjanoen e që po të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës, do të përbënin shkak të bazuar për organizatorin e udhëtimit që të mos e lidhë kontratën.**
- 2. Organizatori i udhëtimit mund të heq dorë nga kontrata pa detyrimin e shpërblimit të demit edhe kur numri minimal i udhëtarëve i parashikuar në vërtetimin mbi udhëtimin nuk është grumbulluar me konditë që për këtë rrethanë udhëtari të jetë njoftuar brenda afatit të caktuar që nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë para ditës kur udhëtimi është dashur të fillonte.**
- 3. Në rastin e heqjes dorë nga kontrata para zbatimit të saj, organizatori duhet të kthejë ne tërësi atë që ka marrë nga udhëtari.**
- 4. Në qoftë se organizatori ka hequr dorë nga kontrata gjatë kohës së zbatimit të saj ka të drejtë të marrë shpërblim të drejtë për shërbimet e realizuara të kontraktuara, kurse ka për detyrë të marrë të gjitha masat e domosdoshme për ruajtjen e interesave të udhëtarit.**

899. Vështrim i përgjithshëm. Neni 899, përmban dispozitën me të cilën përcaktohet se në cilat raste organizatori i udhëtimit ka të drejtën për të hequr dorë nga kontrata. Heqja dorë nga kontrata e udhëtimit nga ana e organizatorit të udhëtimit krijon pasoja më të mëdha se sa kur bëhet fjalë për heqjen dorë nga kontrata e udhëtarit. Andaj, edhe LMD i Kosovës, në mënyrë restriktive e lejon të drejtën e organizatorit të udhëtimit për të hequr dorë nga kontrata. Heqja dorë nga kontratat është e mundur në çdo rast por kur ajo bëhet për rastet që nuk i parasheh ligji atëherë edhe përgjegjësia për shkaktimin e dëmit palës tjetër është e evidente. Me këtë dispozitë shprehimisht rregullohet se në cilat raste organizatori i udhëtimit mund të heqë dorë nga kontrata plotësisht ose pjesërisht dhe mos të ekzistojë detyrimi i shpërblimit të dëmit. Heqja dorë nga kontrata nga ana e organizatorit të udhëtimit jo vetëm që mund të jetë plotësisht ose pjesërisht por ajo mund të bëhet si para kohës ashtu edhe gjatë kohës së zbatimit të kontratës nën kushtet e parapara me ligj që përjashtojnë përgjegjësinë e organizatorit të udhëtimit për dëmin e shkaktuar.

899.1. Paragrafi 1, përmban dispozitën sipas të cilës organizatori i udhëtimit ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pra mund të heqë dorë nga kontrata dhe heqja dorë nga kontrata mund të jetë plotësisht apo pjesërisht dhe atë pa detyrimin për shpërblimin e dëmit, pra organizatori i udhëtimit nuk do të jetë i detyruar të shpërblejë dëmin në rastet kur përpara ose gjatë kohës së zbatimit të kontratës lindin (krijohen) rrethana të jashtëzakonshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të shmangen ose të menjahohen e të cilat rrethana sikur të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës do të ishin bazë e mjaftueshme respektivisht shkak i bazuar për organizatorin e udhëtimit që të mos e lidhë kontratën e udhëtimit. Rrethanat e jashtëzakonshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen dhe janë të natyrës që krijojnë bazë që edhe vetë kontrata e udhëtimit mos të lidhet nga ana e organizatorit të udhëtimit kur ato ekzistojnë në kohën e lidhjes së kontratës. Rrethana të jashtëzakonshme e që nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen zakonisht është ndikimi i *vis mayor-it*, p.sh., rrënimi i objektit për shkak të tërmetit, ndërprerja e punës në ajroporte dhe mos flutirimi i ajroplanëve për shkak të borës së madhe, paraqitja e sëmundjes ngjyëse në shtetit ku duhet të udhëtohet, etj. Kjo nënkupton se, nëse këto rrethana do të kishin ekzistuar edhe në rastin e lidhjes së kontratës e jo të paraqiten para ose gjatë realizimit të kontratës janë shkak i mjaftueshëm për të hequr dorë nga kontrata nga ana e organizatorit të udhëtimit sepse nuk mund të organizohet udhëtimi për shkaqet e jashtëzakonshme që pengojnë realizimin e rregullt të udhëtimit. Në këto raste, edhe pse organizatori i udhëtimit heqë dorë nga kontrata dhe e bën të pamundur udhëtimin e udhëtarëve të cilët kanë lidhur kontratë me organizatorin e udhëtimit, organizatori i udhëtimit në këto raste nuk ka detyrim të shpërblejë dëmin udhëtarëve i cili mund t'u shkaktohet për shkak të mos udhëtimit respektivisht për shkak të heqjes dorë nga kontrata nga ana e organizatorit të udhëtimit. Në literaturën juridike, si rrethana të jashtëzakonshme të cilat i bëjnë të mundur organizatorit që të heqë dorë nga kontrata konsiderohen : ndërrimi i madh i kursit valutor, turbullirat e brendshme në shtet, grevat, epidemitë, fatkeqësitë elementare, njoftimi i vonuar i dhënësit të shërbimeve se nuk mund t'a plotësojë kontratën, etj⁷⁵¹.

899.2. Paragrafi 2, gjithashtu përmban dispozitën që i mundëson organizatorit të udhëtimit të heqë dorë nga kontrata pa detyrimin e shpërblimit të dëmit edhe në rastet kur numri minimal i udhëtarëve i parashikuar në vërtetimin mbi udhëtimin nuk është siguruar respektivisht nuk është grumbulluar por që të lirohet organizatori i udhëtimit për këtë shkak të heqjes dorë nga shpërblimi i dëmit duhet të plotësohet kushti që kjo rrethanë respektivisht se mund të heqet dorë nga kontrata nëse nuk sigurohet numri minimal i udhëtarëve i parashikuar kërkohet që udhëtari të jetë njoftuar brenda afatit të caktuar e i cili afat nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë (5) ditë para ditës kur udhëtimi është dashur të fillonte. Numri i udhëtarëve i planifikuar nëse nuk përmbushet dhe kjo është paraparë në vërtetimin për udhëtimin si kusht për heqjen dorë nga kontrata dhe njoftimi i udhëtarit në afatin e duhur e i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë (5) ditë para ditës kur udhëtimi është dashur të fillonte janë shkaqe respektivisht bazë që organizatori i udhëtimit të heqë dorë nga kontrata para fillimit të udhëtimit pa patur detyrim shpërblimin e dëmit që mund t'u shkaktohet udhëtarëve për shkak të heqjes dorë nga kontrata nga ana

751 Cesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1327.

e organizatorit të udhëtimit. Kjo dispozitë, edhe pse lejon heqjen dorë e organizatorit të udhëtimit nga kontrata krijon përgjegjësi më të fortë për organizatorin e udhëtimit se sa për udhëtarin për shkak të heqjes dorë nga kontrata e udhëtimit. Udhëtari, mund të heqë dorë nga kontrata e udhëtimit edhe për më shumë shkaqe ndërsa organizatori i udhëtimit vetëm nëse ekziston rrethanë që barazohet me vis mayor dhe nëse numri i personave nuk është grumbulluar aq sa është paraparë me vërtetimin për udhëtimin. Shkaqet për të cilat heqë dorë organizatori i udhëtimit duhet t'i provojë respektivisht t'i arsyetojë vetë ndaj udhëtarëve. Edhe në literaturën juridike, thuhet se organizatori i udhëtimit patjetër është i detyruar të provojë ekzistimin e rrethanave të tilla e gjithashtu duhet të provojë se ajo rrethanë do të konsiderohej arsye e mjaftueshme të mos lidhej kontrata konkrete për organizimin e udhëtimit dhe nëse nuk provon këto rrethana do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar të cilin e ka pësuar udhëtari për shkak të heqjes dorë të organizatorit të udhëtimit nga kontrata për organizimin e udhëtimit⁷⁵². Në këtë rast, organizatori i udhëtimit nuk përgjigjet për dëmin që ka shkaktuar por do të jetë i detyruar t'i kthejë udhëtarit krejt atë çka ka marrë prej tij në bazë të kontratës për organizimin e udhëtimit e nga e cila kontratë organizatori i udhëtimit ka hequr dorë. Udhëtari, gjithmonë ka të drejtë që mos t'a kundërshtojë arsyetimin e heqjes dorë nga kontrata e organizatorit të udhëtimit dhe për këtë mund t'i drejtohet gjykatës që të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të heqjes dorë nga kontrata e organizatorit të udhëtimit për shkaqe të cilat sipas tij nuk janë të natyrës që e lirojnë organizatorin e udhëtimit nga përgjegjësia për dëmin që u ka shkaktuar udhëtarëve.

899.3. Paragrafi 3, përmban detyrimin e kthimit në tërësi të asaj që ka marrë organizatori i udhëtimit nga udhëtari në qoftë se organizatori i udhëtimit heqë dorë nga kontrata para zbatimit të saj. Ky detyrim i organizatorit të udhëtimit, që të kthejë në tërësi atë që ka marrë nga udhëtari vlen vetëm në rastet kur heqja dorë nga kontrata është bërë vetëm për shkak të paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen dhe as të shmangen ose të menjahohen e të cilat po të ekzistonin në kohën e lidhjes së kontratës do të përbënin shkak të bazuar për organizatorin e udhëtimit që të mos e lidhë kontratën.

899.4. Paragrafi 4, rregullon rastin kur organizatori i udhëtimit ka hequr dorë nga kontrata jo para zbatimit të kontratës por gjatë kohë së zbatimit të saj dhe se në këtë rast organizatori i udhëtimit ka të drejtë të marrë shpërblimin e drejtë për shërbimet e realizuara të kontraktuara. Pra, atij do t'i takojë shpërblimi nga ana e udhëtarëve për ditët e shfrytëzuara të udhëtimit dhe ky shpërblim që duhet ta pagujnë udhëtarët duhet të jetë i drejtë do të thotë ekuivalentë me shërbimet të cilat organizatori i udhëtimit u'a ka ofruar udhëtarëve. Me këtë paragraf, është paraparë se organizatori i udhëtimit ka të drejtë në shpërblimin e drejtë për shërbimet e realizuara të kontraktuara por gjithashtu ka për detyrë që të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për ruajtjen e interesave të udhëtarit. Kjo do të thotë se organizatori i udhëtimit duhet të ketë parasysh interesat e udhëtarit. Organizatori i udhëtimit duhet t'u mundësojë udhëtarëve që pasojat e ndërprerjes së kontratës të jenë me më pak shpenzime respektivisht mos të pësojnë dëm ose të pësojnë sa më pak dëm për shkak të ndërprerjes së kontratës nga ana e organizatorit

752 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 742.

të udhëtimit. Mbrojtja e interesave të udhëtarit nga ana e organizatorit të udhëtimit do të ishte interesimi i tij që me rastin e ndërprerjes së kontratës t'u sigurohet transporti më i lirë për kthimin ose vendosje në hotel me kushte të favorshme deri sa të realizohet kthimi i tyre në vendin ku është paraparë me kontratën për organizimin e udhëtimit.

Neni 900. Ndryshimet në programin e udhëtimit

- 1. Ndryshimet në programin e udhëtimit mund të behën vetëm në qoftë se janë shkaktuar nga rrethanat e jashtëzakonshme që organizatori i udhëtimit nuk ka mundur t'i parashikojë t'i shmangë ose t'i mënjanojë.**
- 2. Shpenzimet që janë krijuar për shkak të ndryshimit të programit i përballon organizatori i udhëtimit, ndërsa pakësimi i shpenzimeve shkon në dobi të udhëtarit.**
- 3. Zëvendësimi i strehimit të kontraktuar mund të bëhet vetëm me përdorimin e objektit të së njëjtës kategori, apo në ngarkim të organizatorit me përdorimin e objektit të kategorisë më të lartë dhe në vendin e kontraktuar të strehimit.**
- 4. Në qoftë se në programin e udhëtimit janë bërë ndryshime esenciale pa ndonjë shkak të arsyeshëm organizatori i udhëtimit duhet të kthejë tërësisht atë që ka marrë nga udhëtari i cili për këtë arsye ka hequr dorë nga udhëtimi.**
- 5. Në qoftë se janë bërë ndryshime esenciale në programin gjatë kohës së zbatimit të kontratës, udhëtari në rast të heqjes dorë përballon vetëm shpenzimet efektive të shërbimeve të realizuara.**

900. Vështrim i përgjithshëm. Neni 900, rregullon mundësinë e lejimit të ndryshimeve në programin e udhëtimit që do të thotë ndryshimet e relacionit të udhëtimit ose të vendosjes. Rregull është se organizatori i udhëtimit duhet t'a respektojë në tërësi atë çka është paraparë me vërtetimin e udhëtimit dhe atë si në realizimin e plotë të asaj ashtu edhe cilësor⁷⁵³. Mirëpo, për shkaqe të justifikueshme të cilat janë pjesë e trajtimit në këtë nen mund të ndodhë edhe ndryshimi në programin e udhëtimit nga ana e organizatorit të udhëtimit. Ndryshimi i programit të udhëtimit mund të jetë vetëm përjashtim dhe jo rregull e veprimtarisë së organizatorit të udhëtimit.

900.1. Paragrafi 1 i nenit 900 të LMD të Kosovës, rregullon mundësinë e ndryshimit të programit të udhëtimit⁷⁵⁴ nga ana e organizatorit të udhëtimit dhe ndryshimet në programin

753 LMD i Kosovës, neni 884, ku thuhet "Organizatori i udhëtimit ka për detyrë t'i japë udhëtarit shërbime që kanë përmbajtjen dhe veçoritë e parashikuara me kontratë, me vërtetim, respektivisht me programin e udhëtimit dhe të kujdeset për të drejtat dhe interesat e udhëtarit, në pajtim me praktikën e mirë afariste në këtë sferë", dhe komentin e këtij neni.

754 Përmbajtja e programit të udhëtimit caktohet edhe me Ligjin për Turizmin të Kosovës, neni 15, paragrafi 1 "Materiali reklamues i cili i ofrohet konsumatorit, në formë fizike apo elektronike ku përshkruhet programi i udhëtimit për paketën turistike duhet të tregoj në mënyrë të lexueshme, të kuptueshme dhe të saktë çmimin dhe informatat adekuate në lidhje me: 1.1. emrin dhe adresën e agjencisë turistike – organizatore; 1.2. vendin, datën dhe kohën e nisjes dhe kthimit të udhëtimit; 1.3. destinacionin, periudhën

e udhëtimit sipas këtij paragrafi mund të bëhen vetëm në rastet kur ekzistojnë rrethanat e jashtëzakonshme pra kur janë shkaktuar rrethanat e jashtëzakonshme të cilat organizatori i udhëtimit nuk ka mundur t'i parashikojë t'i shmange ose t'i menjanjojë. Kjo dispozitë, në fakt e vështirëson pozitën e organizatorit të udhëtimit lidhur me ndryshimet në programin e udhëtimit sepse kërkon të ndodhin rrethanat e jashtëzakonshme të cilat vetë organizatori i udhëtimit nuk ka mundur t'i parashikojë, t'i shmange ose t'i menjanjojë. Ky paragraf, nuk e sqaron se çka konsiderojmë rrethanë të jashtëzakonshme në bazë të të cilës organizatori i udhëtimit mund t'a ndryshojë programin e udhëtimit por duhet kuptuar ajo çka vllente edhe për heqjen dorë nga kontrata nga ana e organizatorit të udhëtimit. Mirëpo, këtu duhet të konsiderohen si shkaqe të jashtëzakonshme edhe ato të cilat e bëjnë të pamundur përmbushjen e kontratës respektivisht të programit të udhëtimit ose e vështirësojnë atë që shumë realizimin e programit që nuk ka kurrfarë kuptimi përmbushja e tij nga ana e organizatorit të udhëtimit, p.sh., prishja e mjetit transportues e cila nuk ka mundur të parashikohet për shkak se mjete i transportit ka qenë i ri dhe nuk ka mundur të shmanget ose të menjanohet prishja e tillë ose mos ndodhja e prishjes. Edhe pse nëse ka mundësi të bëhet zëvendësimi i mjetit transportues atëherë do të realizohet por bëhet fjalë për rastet kur kjo është e pamundur për shkak të rrethanave të caktuara. Në këtë mënyrë, nuk mund të arrihet në vendin e caktuar ashtu siç është planifikuar andaj duhet të ndodhë ndryshimi i programit të udhëtimit. Ndryshimi i programit të udhëtimit mund të ndodhë edhe para nisjes së udhëtimit gjithashtu për shkaqe që janë rrethana të jashtëzakonshme që organizatori i udhëtimit nuk ka mundur t'i parashikojë, t'i shmangë ose t'i menjanjojë, p.sh., ndalimi i hyrjes në kufirin e caktuar apo në shtetin e tranzitit, atëherë organizatori i udhëtimit për t'a realizuar programin e udhëtimit duhet të bëjë ndryshime në programin e udhëtimit për shkak se ai nuk ka mundur t'a dijë se do të vijë p.sh., deri te mbyllja e udhëtimit nëpër shtetin të cilin duhet kaluar. Me ndryshimin e programit të udhëtimit krijohen shpenzime të cilat mund të jenë të shtuara ose mund të zvogëlohet çmimi i programit të udhëtimit, p.sh., nuk mund të vizitohet një shtet të cilin është paraparë të vizitohet. Shpenzimet e tilla rregullohen me paragrafin vijues të këtij neni.

900.2. Paragrafi 2, përmban dispozitën me të cilën rregullohet çështja e shpenzimeve të cilat krijohen për shkak të ndryshimit të programit të udhëtimit nga ana e organizatorit të udhëtimit. sipas këtij paragrafi shpenzimet e shtuara të cilat kanë ndodhur për shkak të ndryshimit të programit të udhëtimit i përballon organizatori i udhëtimit, pra duhet t'i bartë organizatori i udhëtimit ndërsa pakësimi i shpenzimeve që mund të ndodhë për shkak të

e qëndrimit, detajet tjera nëse udhëtimi është i ndarë në pjesë, mënyrën e udhëtimit, karakteristikat dhe kategoritë e llojit të transportit të përdorur; 1.4. llojin e akomodimit, vendndodhjen, kategorinë ose shkallën e rehatisë dhe karakteristikat kryesore të tij si dhe klasifikimin e tij turistik; 1.5. koha e ushqimit; 1.6. itinerarin; 1.7. informacione të përgjithshme mbi kërkesat për pasaporta dhe viza dhe formalitetet shëndetësore të nevojshme për udhëtim dhe qëndrim; 1.8. shumën monetare ose përqindjen e çmimit që duhet paguar në llogari, si dhe orarin për pagesën e bilancit; 1.9. në qoftë se numri minimal i personave është i nevojshëm për organizimin e paketës, dhe nëse po, te dihet dhe potencohet data e fundit për te informuar konsumatorin me rastin e anulimit; 1.10. të dhënat e përfshira në materialin reklamues janë të detyrueshme për organizatorin ose ndërmjetësuën, përveç nëse: 1.10.1. ndryshimet në veçoritë e tilla janë komunikuar në mënyrë të qartë te konsumatori para lidhjes së kontratës, në të cilin rast në mënyrë specifike do të jenë të theksuara në materialin e reklamës; 1.10.2. ndryshimet kanë ndodhur më vonë pas arritjes së marrëveshjeje mes palëve në kontratë”.

ndryshimit në programin e udhëtimit shkon në dobi të udhëtarit. Në këtë rast, udhëtarit kur çmimi është më i lartë se shpenzimet për shkak të ndryshimit në programin e udhëtimit atëherë do të ndodhë zvogëlimi i çmimit të udhëtimit. Sepse, udhëtari në këtë rast, e ruan ekuivalencën e vlerave ekonomike të kontrata për organizimin e udhëtimit. Në literaturën juridike thuhet se, kjo dispozitë e destimulon organizatorin e udhëtimit që mos të ndërmarrë veprime për ndryshimin e programit të udhëtimit sepse në shumicën e rasteve ai duhet të përmbushë shpenzimet të cilat rriten për shkak të ndryshimit të programit të udhëtimit dhe në anën tjetër në qoftë se ato shpenzime janë më të dobëta shkojnë në favor të udhëtarit dhe jo në favor të organizatorit të udhëtimit⁷⁵⁵. Rregullë është që mos të vjen deri te ndryshimi i programit të udhëtimit sepse kontrata duhet të përmbushet ashtu siç palët janë marrë vesh.

900.3. Paragrafi 3, përmban dispozitën sipas të cilës nëse ndryshimi në programin e udhëtimit ka të bëjë me zëvendësimin e strehimit të kontraktuar atëherë ky ndryshim mund të bëhet vetëm me përdorimin e objektit të së njëjtës kategori apo me shpenzimet e organizatorit me përdorimin e objektit të kategorisë më të lartë dhe në vendin e kontraktuar të strehimit. Kjo dispozitë është njëqartë e qartë sepse ndryshimi i programit të udhëtimit më së shpeshti ndërron në strehimin e udhëtarëve që shpeshëherë organizatori i udhëtimit është i detyruar të bëjë ndryshime për vendosjen e udhëtarëve në hotel qoftë për shkak të zënies së vendeve në hotel e cila ka mundur të jetë pasojë e ndonjë mosmarrëveshjeje ose për shkak të sjelljes jo korrekte të dhënësit të strehimit. Mirëpo, nëse kjo ndodhë ligji mundëson zëvendësimin e strehimit por vetëm për kategori të njëjtë që do të thotë për kushte të njëjta dhe në vendin e njëjtë, pra nuk pranohet ndryshimi i strehimit në qytet tjetër, dhe nëse kjo ndodhë udhëtarit ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit për të. Në rast se nuk mund të sigurohet strehimi ashtu siç është kontraktuar respektivisht nuk mund të sigurohet zëvendësimi në hotel të kategorisë së njëjtë, organizatori i udhëtimit mund t'a bëjë ndryshimin e strehimit të kontraktuar edhe duke ofruar strehim në kategori më të lartë dhe në këtë rast ai i bartë vetë shpenzimet për të siguruar këtë lloj të strehimit. Udhëtarit, nuk mund t'i kërkojen mjete shtesë për shkak të ndryshimit të kategorisë së hotelit për strehimin e tyre.

900.4. Paragrafi 4 i këtij neni, përmban dispozitën sipas të cilës përcaktohet përgjegjësia e organizatorit të udhëtimit në qoftë se në programin e udhëtimit janë bërë ndryshime esenciale pa ndonjë shkak të arsyeshëm, atëherë organizatori i udhëtimit duhet të kthejë tërësisht atë që ka marrë nga udhëtari i cili për këtë arsye ka hequr dorë nga udhëtimi. Çka konsiderohet ndryshim esencial në programin e udhëtimit është çështje faktike e cila varet drejtpërsëdrejti jo nga organizatori i udhëtimit por nga shfrytëzuesit e organizimit të udhëtimit respektivisht nga udhëtarët. Këtu e rëndësishme është cili ka qenë qëllimi kryesor i udhëtarit me rastin e lidhjes së kontratës për udhëtimin që do të thotë përndryshe nuk do ta kishte lidhur këtë kontratë po t'a dinte se nuk do të realizohej ajo që ka qenë qëllimi i tij me rastin e lidhjes së kontratës. Në këtë rast, për udhëtarin ndryshimi i programit është i karakterit esencial, p.sh., është planifikuar vizita e një shteti me sigurimin e biletave të lojës së futbollit, dhe nëse programi ndryshon ashtu që bëhet e pamundur shikimi i ndeshjes së futbollit, për udhëtarin kjo paraqet ndryshim esencial sepse ai fare ndoshta nuk do të lidhte

755 Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 744.

kontratë për udhëtimin po t'a dinte se nuk do t'i realizohej shikimi i ndeshjes futbollistike. Në këtë rast, dispozita e detyron organizatorin e udhëtimit që udhëtarit t'ia kthejë tërësisht atë që ka marrë nga udhëtari i cili për këtë arsye ka hequr dorë nga udhëtimi. Kjo do të thotë duhet t'ia kthejë të hollat respektivisht duhet t'i kthejë tërësisht atë që ka marrë nga udhëtari i cili për këtë arsye ka hequr dorë nga udhëtimi i tij. Kur ekziston ndryshimi esencial i programit të udhëtimit, udhëtari ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata për udhëtimin ose të kërkojë nga organizatori i udhëtimit shpenzimet e shtuara t'i bartë ai ndërsa nëse zvogëlohet ato të jenë në favor të udhëtarit. Organizatori i udhëtimit, ka për detyrim që t'a njoftojë udhëtarin për ndryshimet e programit të udhëtimit në kohë të caktuar, njëkohësisht edhe udhëtari nëse heqë dorë nga kontrata e udhëtimit ose pranon ndryshimin e udhëtimit duhet t'a bëjë në afatin e caktuar. Koha e caktuar është ajo që vlenet edhe për heqjen dorë nga kontrata nga ana e udhëtarit ose organizatorit të udhëtimit.

900.5. Paragrafi 5, rregullon rastin kur ndryshimet esenciale në programin e udhëtimit, organizatori i udhëtimit i bën gjatë kohës së zbatimit të kontratës. Kjo do të thotë se, realizimi i programit të udhëtimit është duke ndodhur, duke u zbatuar, atëherë udhëtari ka të drejtë të heqë dorë nga vazhdimi i realizimit të programit dhe përmbushë ose i përballon vetëm shpenzimet efektive të shërbimeve të realizuara. Udhëtari në këtë rast, ka të drejtën e heqjes dorë nga kontrata e filluar për udhëtimin e cila ndryshon dhe ky ka për detyrim të bartë vetëm shpenzimet reale për shpenzimet e realizuara deri atëherë deri në momentin e heqjes dorë nga kontrata për udhëtimin e ndryshuar gjatë zbatimit. LMD i Kroacisë, parasheh edhe mundësinë se nëse nuk është e mundur që të ndryshojë programin e udhëtimit në mënyrë të përshtatshme ose nëse udhëtari nuk e pranon ndryshimin për shkaqe të arsyeshme, organizatori i udhëtimit është i detyruar që me shpenzimet e veta t'i mundësojë udhëtarit kthimin me mjetin transportues të përshtatshëm, në vendin e nisjes ose në ndonjë vend tjetër nëse udhëtari me këtë pajtohet dhe t'i shpërblejë udhëtarit dëmin të cilin me këtë rast e ka pësuar⁷⁵⁶. Ky paragraf i LMD të Kroacisë, në mënyrë shumë të qartë tregon se si do të veprohet kur udhëtari tërhiqet nga realizimi i mëtutjeshëm të programit të udhëtimit. Ndërsa, në LMD të Kosovës, kur udhëtari heqë dorë nga kontrata e ndryshuar gjatë zbatimit nuk parasheh shprehimisht detyrimin e organizatorit të udhëtimit që t'i paguajë biletën e kthimit ose t'i sigurojë mjetin transportues për kthim në vendin e nisjes dhe sipas këtij paragrafi del se kjo mund të llogaritet në zvogëlimin e çmimit nëse organizatori i udhëtimit nuk i siguron mjetet për kthimin e udhëtarit në vendin e nisjes.

756 LMD i Kroacisë, neni 903.

PJESA XXII

KONTRATA NDËRMJETËSUESE PËR UDHËTIMIN

Neni 901. Nocioni

Me kontratën ndërmjetësuese për udhëtimin, ndërmjetësuasi detyrohet që në emër dhe për llogari të udhëtarit, të lidhë qoftë kontratën për organizimin e udhëtimit qoftë edhe kontratën për kryerjen e një ose të disa shërbimeve të veçanta, që bëjnë të mundur realizimin e ndonjë udhëtimi ose qëndrimin, kurse udhëtari detyrohet të paguajë për këtë shpërblim.

901. Vështrim i përgjithshëm. Pjesa e njëzet e dytë (XXII) e LMD të Kosovës, rregullon kontratën ndërmjetësuese për udhëtimin si një lloj i veçantë i kontratës për udhëtimin. Në këtë pjesë rregullohen : nocioni i kontratës ndërmjetësuese për udhëtimin; detyrimi i dhënies së vërtetimit; veprimi sipas udhëzimeve të udhëtarit; zgjedhja e personave të tretë; dhe zbatimimi përkatës i dispozitave të kontratës për organizimin e udhëtimit. Kontrata ndërmjetësuese për udhëtimin është kontratë e veçantë me emër⁷⁵⁷.

Neni 901, i cili përkufizon kontratën ndërmjetësuese për udhëtimin, sipas të cilës kontratë ndërmjetësuasi detyrohet që në emër dhe për llogari të udhëtarit, të lidhë qoftë kontratën për organizimin e udhëtimit qoftë edhe kontratën për kryerjen e një ose të disa shërbimeve të veçanta, që bëjnë të mundur realizimin e ndonjë udhëtimi ose qëndrimin, kurse udhëtari detyrohet të paguajë për këtë shpërblim. Kjo kontratë, në fakt është një kontratë që i mundëson udhëtarit që të shfrytëzojë shërbimet të cilat i jep dhënësi i shërbimeve. Ndërmjetësuasi në fakt kryen punë në emër dhe për llogari të udhëtarit. Ndërmjetësuasi, për shpërblim të caktuar do të lidhë kontratën për organizimin e udhëtimit ose kontratën për kryerjen e një ose disa shërbimeve të veçanta me të cilën i mundësohet udhëtarit realizimi i ndonjë udhëtimi ose qëndrimin në ndonjë vend dhe udhëtari ka për detyrim që ndërmjetësuesit t'i paguajë shpërblimin. Kontrata për ndërmjetësimin e udhëtimit për nga definimi nuk është adekuat sepse me ndërmjetësim kuptojmë vetëm gjetjen e dhënësit të shërbimit për udhëtarin dhe pastaj udhëtari dhe dhënësi i shërbimit duhet të lidhin vetë kontratë për shërbimin e caktuar. Mirëpo, këtu vetë ndërmjetësuasi e lidhë kontratën në emër dhe për llogari të udhëtarit me dhënësin e shërbimit. Këtë detyrim, e bën ndërmjetësuasi për shpërblim të caktuar nga ana e udhëtarit, p.sh., rezervimi i biletës së udhëtimit, dhe pagimi i saj te agjensioni turistik i cili me marrëveshje të veçantë me dhënësin e shërbimeve ka të drejtë të shesë bileta udhëtarëve që i drejtohen agjencionit turistik. Në këtë nen, fjala ndërmjetësim më shumë i afrohet kuptimit të fjalës përfaqësim sepse përfaqësuesi është ai i cili kryen punë në emër dhe për llogari të tjetër kujt. Kontrata ndërmjetësuese për udhëtimin e lidhur midis udhëtarit dhe kryesit të ndërmjetësimi është e karakterit joformal

757 Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 3, pika 1.11, ku thuhet “Agjencia turistike ndërmjetësuese - agjenci turistike që shet ose blen paketë aranzhmanin që ka përpiluar organizatori i udhëtimit ose që ofron shërbime të tjera ndërmjetësimi të përcaktuara me këtë ligj”.

dhe linden dy detyrime për ndërmjetësuesin jo vetëm që të ndërmjetësojë por edhe të lidhë kontratën për organizimin e udhëtimit ose kryerjen e ndonjë detyrimi të veçantë me të cilën mundësohet udhëtimi i udhëtarit që do të thotë kontrata lidhet në emër dhe për llogari të udhëtarit gjithmonë me shpërblim. Te kontrata ndërmjetësuese për udhëtimin palë kontraktuese janë udhëtarit dhe ndërmjetësuesi i udhëtimit sepse dhënësi i shërbimit ka kontratë tjetër të veçantë me ndërmjetësuesin. Udhëtarë është personi i cili kërkon nga ndërmjetësuesi që në emër dhe për llogari të tij të lidhë kontratën për organizimin e udhëtimit dhe në këtë rast si udhëtar mund të jetë personi fizik i cili lidhë kontratën në emër të vetë me ndërmjetësuesin ose e lidhë kontratën në emër të personit juridik si përfaqësues i tij. Ndërmjetësues, gjithmonë është agjensioni turistik i cili ka marrëdhënie kontraktuese edhe me dhënësin e shërbimeve, p.sh., me kompanitë transportuese.

Neni 902. Detyrimi i dhënies së vërtetimit

- 1. Kur me kontratën ndërmjetësuese për udhëtimin merret përsipër detyrimi i lidhjes së kontratës për organizimin e udhëtimit, ndërmjetësuesi ka për detyrë që me rastin e kontraktimit të lëshojë vërtetimin për udhëtimin, që përpos të dhënave të cilat kanë të bëjnë me vet udhëtimin, shenjën dhe adresën e organizatorit të udhëtimit, duhet të përmbajë shenjën dhe adresën e ndërmjetësuesit, si dhe të dhënat që tregojnë se ai paraqitet në këtë status.**
- 2. Në qoftë se në vërtetimin për udhëtimin nuk e shënon statusin e ndërmjetësuesit, ndërmjetësuesi në organizimin e udhëtimit konsiderohet si organizator i udhëtimit.**
- 3. Në rastin kur kontrata ndërmjetësuese për udhëtimin ka të bëjë me lidhjen e kontratës për ndonjë shërbim të veçantë, ndërmjetësuesi ka për detyrë të lëshojë vërtetimin që ka të bëjë me këtë shërbim duke theksuar shumën që paguhet për këtë shërbim.**

902. Vështrim i përgjithshëm. Neni 902, përmban dispozitën e cila parasheh detyrimin e ndërmjetësuesit i cili kur t'a lidhë kontratën për ndërmjetësimin e udhëtimit duhet të lëshojë vërtetimin që i përmban të dhënat e kërkuara nga udhëtarit respektivisht përmban të dhënat lidhur me udhëtimin për të cilat udhëtarit ka paguar shpërblimin e caktuar.

902.1. Paragrafi 1, përcakton detyrimin e ndërmjetësuesit kur ai ka marrë detyrim nga udhëtarit që të lidhë kontratën për organizimin e udhëtimit në bazë të kontratës ndërmjetësuese për udhëtimin, që udhëtarit t'i lëshojë vërtetimin për udhëtimin ku do të përfshihen të gjitha të dhënat të cilat kanë të bëjnë me vetë udhëtimin⁷⁵⁸ dhe ky vërtetim i udhëtimit duhet të përmbajë edhe shenjën dhe adresën e ndërmjetësuesit që nënkupton logon dhe adresën e ndërmjetësuesit që nënkupton selinë e ndërmjetësuesit si dhe të dhënat që tregojnë se lëshuesi i vërtetimit paraqitet si ndërmjetësues pra nuk është organizatori i udhëtimit e as dhënësi i shërbimeve por vetëm kryen shërbime në emër dhe për llogari të udhëtarit. Nëse nuk do të shënohet cilësia e ndërmjetësuesit me rastin e lidhjes së kontratës

⁷⁵⁸ Lidhur me vërtetimin e udhëtimit, shih më gjerësisht komentimin e nenit 881 të këtij ligji.

për organizimin e udhëtimit për udhëtarin, atëherë ndërmjetësuesi në pajtim me dispozitën vijuese do të konsiderohet si organizator i udhëtimit. Prandaj, vërtetimi i udhëtimit i lëshuar nga ndërmjetësuesi për udhëtarin duhet t'i përmbajë të gjitha shënimet të cilat i shënon edhe organizatori i udhëtimit kur lidhet kontrata drejtëpërsëdrejti me organizatorin e udhëtimit si dhe adresën e ndërmjetësuesit dhe të dhënat që tregojnë cilësinë e ndërmjetësuesit.

902.2. Paragrafi 2, përmban dispozitën sipas të cilës në rastet kur ndërmjetësuesi e lëshon vërtetimin për udhëtimin dhe nuk e shënon statusin e vërtetuesit në vërtetim atëherë ndërmjetësuesi në organizimin e udhëtimit konsiderohet si organizator i udhëtimit. Në këtë rast, do të vlejnë rregullat të cilat vlejnë edhe për organizatorin e udhëtimit dhe jo rregullat për ndërmjetësuesin e udhëtimit, ndërmjetësuesi do të përgjigjet si organizator i udhëtimit dhe jo si ndërmjetësues për udhëtimin.

902.3. Paragrafi 3, parasheh se në rastin kur kontrata ndërmjetësuese për udhëtimin nuk ka të bëjë me detyrimin e lidhjes së kontratës për organizimin e udhëtimit por ka të bëjë me lidhjen e kontratës për ndonjë shërbim të veçantë atëherë ndërmjetësuesi ka për detyrë të lëshojë vërtetim që ka të bëjë me këtë shërbim të veçantë dhe në këtë rast duhet të caktohet konkretisht shërbimi, kohëzgjatja e shërbimit si dhe shuma që duhet të paguhet për këtë shërbim. Ndërmjetësuesi, ka për detyrim të lëshojë vërtetimin si me rastin e lidhjes së kontratës për organizimin e udhëtimit duke theksuar se ka cilësinë e ndërmjetësuesit si dhe me rastin kur kontrata e ndërmjetësuesit ka të bëjë për ndonjë shërbim të veçantë të cilin e ka kërkuar udhëtarin. Ky vërtetim i lëshuar nga ndërmjetësuesi dallon nga vërtetimi i lëshuar nga organizatori i udhëtimit sepse këtu theksohet si dhënësi i vërtetimit vetë ndërmjetësuesi dhe në këtë mënyrë garantohet mbrojtje më e fuqishme për udhëtarin.

Neni 903. Veprimi sipas udhëzimeve të udhëtarit

- 1. Ndërmjetësuesi ka për detyrë të veprojë sipas udhëzimeve që ia ka dhënë në kohë udhëtarit, në qoftë se ato janë në pajtim me kontratën, me ushtrimin e veprimtarisë së rëndomtë të ndërmjetësuesit dhe me interesat e udhëtarëve tjerë.**
- 2. Në qoftë se udhëtarin nuk jep udhëzime të nevojshme, ndërmjetësuesi ka për detyrë të punojë sipas mënyrës që në rrethanat konkrete është më e përshtatshme për udhëtarin.**

903. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 903, përmban dispozitën me të cilën përcaktohet se ndërmjetësuesi duhet të ketë parasysh udhëtarin dhe t'i mbrojtë interesat e udhëtarit e kjo më së miri realizohet nëse ai vepron sipas udhëzimeve të udhëtarit. Neni 903, shprehimisht kërkon veprimin e ndërmjetësuesit sipas udhëzimeve të udhëtarit. Kjo dispozitë përmban dy paragrafe me të cilat precizohet detyrimi i ndërmjetësuesit që të veprojë sipas udhëzimeve të udhëtarit. Ndërmjetësuesi, lidhë kontratën për ndërmjetësimin e udhëtimit me udhëtarin si subjekt i kualifikuar për shërbime të tilla. Pra, bëhet fjalë për agjensionin turistik që veprimtari të veten e ka ofrimin e shërbimeve personave të cilët i drejtohen (udhëtarëve).

903.1. Paragrafi 1, përcakton se ndërmjetësuesi ka për detyrim që të veprojë sipas udhëzimeve që i'a ka dhënë udhëtari. Mirëpo, udhëzimet e udhëtarit duhet të jenë në pajtim me kontratën për ndërmjetësimin pastaj me ushtrimin e veprimtarisë së rëndomtë të ndërmjetësuesit dhe me interesat e udhëtarëve të tjerë. Udhëtari, konsiderohet personi i cili është më i interesuari për realizimit e udhëtimit në mënyrë më të suksesshme. Andaj, kërkon ndaj ndërmjetësuesit, që t'i respektojë udhëzimet e udhëtarit, p.sh., llojin e transportit respektivisht vendin e buajtjeve gjatë udhëtimit, etj. Kërkesat e udhëtarit nuk mund të dalin përtej asaj çka janë marrë vesh me rastin e lidhjes së kontratës për ndërmjetësimin e në bazë të së cilës ndërmjetësuesi ka lidhur kontratë me organizatorin e udhëtimit. sepse udhëzimet e mëvonshme të udhëtarit ndaj ndërmjetësuesit janë të pamundshme të zbatohen në rastin konkret por udhëzimet duhet të jenë të natyrës që brenda marrëveshjes për ndërmjetësim, si dhe ushtrimin të veprimtarisë së rëndomtë të ndërmjetësuesit dhe duke mos i dëmtuar interesat e udhëtarëve të tjerë të realizohet kërkesa e udhëtarit përmes ndërmjetësuesit. Udhëtari nuk mund të kërkojë nga ndërmjetësuesi, p.sh., t'i sigurojë që udhëtimi të jetë vetëm ditën kur kjo nuk mund të realizohet nga kontrata për organizimin e udhëtimit sepse kjo i cënon edhe interesat e udhëtarëve të tjerë ose t'i lejohet të bartë me veti ndonjë material që nuk lejohet të transportohet bashkë me udhëtarin p.sh., për shkak të erës të pakëndshme. Ndërmjetësuesi mund t'i realizojë vetëm udhëzimet e udhëtarit të cilat janë në pajtim me kontratën ose janë të mundshme për realizim dhe udhëtari sipas rregullës të gjitha udhëzimet duhet t'i bëjë të njohura në momentin e lidhjes së kontratës dhe atij mund të merrë përgjigjen se çka mund të përfshihet në kontratën e udhëtimit.

903.2. Paragrafi 2, përcakton rastin kur udhëtari nuk i ka dhënë ndërmjetësuesit udhëzimet e nevojshme lidhur me udhëtimin, atëherë ndërmjetësuesi ka për detyrë të punojë dhe të veprojë sipas mënyrës që në rrethanat konkrete është më e përshtatshme për udhëtarin. Kjo nënkupton se, ndërmjetësuesi *ex lege* ka për detyrim kur nuk është paraparë ndryshe të kujdeset që të drejtat e udhëtarit të realizohen në mënyrën më të përshtatshme për udhëtarin respektivisht në mënyrën më të favorshme për udhëtarin. Udhëtari, me rastin e zgjedhjes së ndërmjetësuesit ka parasysh kualitetin e tij si subjekt profesionistë andaj vetë ndërmjetësuesi duhet të silltet me kujdes të veçantë në raport me shërbimet që i kontrakton udhëtarit në bazë të kontratës për ndërmjetësimin e udhëtimit.

Neni 904. Zgjedhja e personave të tretë

Ndërmjetësuesi është i detyruar që me ndërgjegje ta zgjedhë personin e tretë, i cili duhet t'i kryejë shërbimet e parapara me kontratë dhe i përgjigjet udhëtarit për zgjedhjen e tyre.

904. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 904, përmban dispozitën me të cilën ndërmjetësuesi detyrohet në zgjedhjen e personit të tretë respektivisht kur lidhë kontratë për organizimin e udhëtimit ose për kryerjen e shërbimeve të veçanta ndaj udhëtarit ai duhet të ketë kujdes të veçantë në zgjedhjen e personit të tretë i cili i kryen shërbimet ndaj udhëtarit respektivisht ndaj klientit të tij.

Neni 904, lidhur me zgjedhjen e personit të tretë nga ana e ndërmjetësuesit shprehimisht parasheh se ndërmjetësuesi ka për detyrim që me ndërgjegje t'a zgjedhë personin e tretë, i cili duhet t'i kryejë shërbimet e parapara me kontratë dhe se ndërmjetësuesi i përgjigjet udhëtarit për zgjedhjen e personave të tretë. Dihet se, ndërmjetësuesi kryen veprime në emër dhe për llogari të udhëtarit e detyrat e caktuara nga udhëtari mund të jenë lidhja e kontratës për udhëtimin ose lidhja e kontratës për kryerjen e shërbimeve të caktuara. Andaj, ndërmjetësuesi si subjekt i specializuar duhet të zgjedhë personin e tretë i cili është më i përshtatshëm për përmbushjen e kërkesave të klientit të tij të parapara me kontratën për ndërmjetësimin e udhëtimit. Ndërmjetësuesi, i përgjigjet udhëtarit për të gjitha dëmet që mund të shkaktohen për shkak të zgjedhjes së gabuar të personit të tretë si dhënës i shërbimeve të udhëtimit ndaj udhëtarit. Kjo do të thotë se përgjegjësia e ndërmjetësuesit për dëmin që i shkaktohet udhëtarit ka të bëjë vetëm me zgjedhjen e personit të tretë ndërsa përgjegjësitë tjera për dëmin që i shkaktohet i bartë vetë dhënësi i shërbimeve respektivisht organizatori i udhëtimit. Nuk mundet që ndërmjetësuesi të zgjedh një person të tretë i cili nuk i ka kualitetet që të përmbushë kërkesat e udhëtarit. Zgjedhja e personit të tretë jo vetëm që duhet të jetë e bërë me ndërgjegje të veçantë nga ana e ndërmjetësuesit por edhe lidhja e kontratës për udhëtimin apo kontratës për shërbimet e veçanta për udhëtarin duhet të jetë e qartë dhe e plotë që udhëtari mos të ketë vështirësi për shkak të mos precizitetit të kontratës për udhëtimin të cilin e ka lidhur ndërmjetësuesi me personin e tretë në emër dhe për llogari të udhëtarit.

Neni 905. Zbatimi përkatës i dispozitave të kontratës për organizimin e udhëtimit

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me kontratën për organizimin e udhëtimit, zbatohen përshtatshëmrisht për kontratën ndërmjetësuese për udhëtimin, në qoftë se me dispozitat e kësaj pjese nuk është caktuar ndryshe.

905. Vështrim i përgjithshëm. Neni 905, përmban dispozitën me të cilën përcakton se cilat dispozita do të vlejné për këtë lloj të kontratës për ndërmjetësimin e udhëtimit në qoftë se nuk ekzistojné në vetë kontratën për ndërmjetësimin e udhëtimit dispozita konkrete. Ky nen, udhëzon që në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me kontratën për organizimin e udhëtimit dhe kjo nënkupton se kontrata për ndërmjetësimin e udhëtimit është një kontratë i llojit të veçantë dhe nuk është pjesë e kontratës për organizimin e udhëtimit.

Neni 905, shprehimisht parasheh se, dispozitat e LMD të Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me kontratën për organizimin e udhëtimit do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe për kontratën ndërmjetësuese për udhëtimin, gjithmonë në qoftë se me dispozitat e kësaj pjese nuk është caktuar ndryshe që do të thotë nëse me nenet 901-905 nuk është paraparë diçka tjetër.

PJESA XXIII

KONTRATA PËR ANGAZHIMIN E KAPACITETEVE TË HOTELIERISË (KONTRATA PËR ALOTMANIN)

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 906. Nocioni

1. Me kontratën për alotmanin detyrohet hotelieri që gjatë kohës së caktuar t'i vë në dispozicion agjencisë turistike një numër shtretërish të caktuar në objektin e caktuar, t'u jape shërbime hoteliere personave që i dërgon agjencia dhe t'i paguajë provizion të caktuar, kurse kjo detyrohet që të përpiqet t'i plotësojë, përkatësisht të njoftojë brenda afateve të caktuara se kjo nuk është e mundur, si dhe të paguajë çmimin e shërbimeve të bëra në qoftë se ka shfrytëzuar angazhimin e kapaciteteve të hotelit.
2. Në qoftë se me kontratë nuk është caktuar ndryshe, konsiderohet se kapacitetet e strehimit të hotelierisë janë vënë në dispozicion për një (1) vit.

906. *Vështrim i përgjithshëm.* Pjesa e njëzet e tretë (XXIII) e LMD të Kosovës, rregullon kontratën për angazhimin e kapaciteteve të hotelierisë (kontratën për alotmanin) dhe atë me nenet 906-917 ku përfshihen : Kreu 1, dispozitat e përgjithshme, nocioni dhe forma e kontratës; Kreu 2 ku përfshihen detyrimet e agjencisë turistike ku përfshihen detyrimet e njoftimit, detyrimi i respektimit të çmimeve të kontraktuara, detyrimi i pagimit të pagimit të shërbimeve të hotelierisë, detyrimi i dhënies së dokumentit të veçantë me shkrim; ndërsa Kreu 3, përcakton detyrimet e hotelierit ku përfshihet detyrimi i vënies në përdorim të kapaciteteve strehimi të kontraktuara, detyrimi për trajtim të barabartë të personave, detyrimi i hotelierit që të mos i ndryshojë çmimet e shërbimeve, detyrimi i pagimit të provizionit agjencisë turistike; ndërsa Kreu 4 i kësaj pjese rregullon të drejtën e agjencisë turistike për të hequr dorë nga kontrata dhe atë të drejtën për të hequr dorë nga kapacitetet e angazhuara të strehimit, dhe detyrimin e agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara me kontratën për alotmanin. Në literaturën juridike, thuhet se kontrata për alotmanin është kontratë e pavarur, tipike, me emër, konsensuale, e dyanshme, e pagueshme, dhe formale⁷⁵⁹.

Neni 906, përkufizon kontratën për alotmanin respektivisht kontratën për angazhimin e kapaciteteve hoteliere dhe sipas këtij neni, kontrata për alotmanin është kontratë ndërmjet agjencionit turistik dhe hotelierisë për angazhimin e kapaciteteve hotelierike. Te kjo kontratë, sigurohet vendosja e personave që i dërgon agjencioni dhe si subjekt të kontratës për alotmanin janë hotelieri, agjencioni turistik dhe personin të cilin e dërgon agjencioni, i cili shfrytëzon shërbimet hotelierike. Kontrata për alotmanin, është kontratë e veçantë

⁷⁵⁹ Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1342.

dhe u mundëson palëve kontraktuese që vetë të vendosin se në cilat raste mund të heqin dorë nga kontrata për alotmanin ose të ndalohej heqja dorë nga kontrata për alotmanin respektivisht pa u përgjegjur për dëmin e shkaktuar. Neni 906 përmban dy paragrafe me të cilat sqarohet nocioni i kontratës për alotmanin.

906.1. Paragrafi 1, shprehimisht parasheh se, me kontratën për alotmanin detyrohet hotelieri që gjatë kohës së caktuar me kontratë t'i vë në dispozicion agjencisë turistike një numër shtretërisht të caktuar në objektin e caktuar, pastaj t'u japë shërbimeve hoteliere personave që i dërgon agjencia dhe t'i paguajë provizion të caktuar agjencisë turistike, ndërsa agjencioni turistik ka për detyrim që të angazhohet të përpiqet t'i plotësojë, përkatësisht të njoftojë brenda afateve të caktuara se kjo nuk është e mundur plotësimi i kapaciteteve si dhe të paguajë çmimin e shërbimeve të bëra në qoftë se agjencioni turistik ka shfrytëzuar angazhimin e kapaciteteve hotelierike nga personat të cilët i ka dërguar agjencioni turistik. Ky definicion në fakt përmban elementet që e bëjnë kontratën për shfrytëzimin e kapaciteteve hotelierike (kontratën për alotmanin) si dhe përcakton detyrimet e agjencionit turistik si dhe të dhënësit të shërbimeve hoteliere. Kontrata për alotmanin⁷⁶⁰ është kontratë specifike e lidhur midis agjencionit turistik në njërin anë dhe hotelierit në anën tjetër. Hotelieri ka për detyrim që në kohën e caktuar t'i vë në dispozicion agjencisë turistike një numër shtretërisht të caktuar për vendosjen e personave të cilët i dërgon agjencioni si dhe atyre t'u jep shërbime hotelierike dhe agjencioni turistik t'i paguajë provizionin e caktuar në bazë të kontratës, ndërsa agjencioni turistik ka për detyrim të përpiqet të plotësojë kapacitetet e kërkuara brenda mundësive dhe nëse rastësisht pas përpjekjeve të tij nuk mund të sigurojë persona për plotësimin e numrit të shtretërve të kontraktuar në objektin e caktuar në bazë të kontratës së alotmanit ai duhet t'a njoftojë hotelierin brenda afateve të caktuara me kontratë se nuk ka mundësi të sigurojë persona që të plotësohen shtretërit e kontraktuar.

906.2. Paragrafi 2, përcakton kohëzgjatjen e vënies së shtretërve respektivisht kapaciteteve të strehimit të hotelierisë në dispozicion. Ky paragraf, shprehimisht përcakton se në qoftë se me kontratë palët nuk janë marrë vesh ndryshe pra nuk kanë caktuar ndonjë afat për shfrytëzimin e kapaciteteve të hotelierisë, atëherë konsiderohet se kapacitetet e strehimit të hotelierisë janë vënë në dispozicion për një (1) vit. Kjo do të thotë se agjencioni turistik kur nuk ka caktuar afat tjetër ka për detyrim që kapacitetet e strehimit hotelierik t'i plotësojë për një (1) vitë, e ky vit fillon të rrjedh nga momenti kur është nënshkruar kontrata nëse nuk është paraparë diçka tjetër me kontratë. Rregull është që të përcaktohet kohëzgjatja e objektit të kontratës për alotmanin që plotësimi i kapaciteteve të bëhet ashtu siç kanë dashur edhe vetë palët kontraktuese.

.....
760 Në literaturën juridike, thuhet se fjala "alotman" rrjedhë nga fjala frënge "allotment" që do të thotë "ndarje e dhomave" (kapaciteteve).

Neni 907. Forma e kontratës**Kontrata për alotmanin duhet të lidhet në formën me shkrim.**

907. Vështrim i përgjithshëm. Neni 907, përcakton formën e kontratës për alotmanin. Neni 907, shprehimisht parasheh se kontrata për alotmanin duhet të lidhet në formën me shkrim. Kjo e bën që kjo kontratë të quhet kontratë formale dhe në rast të mos respektimit të formës me shkrim të kontratës ajo konsiderohet e pavlefshme. Forma e kontratës për alotmanin që kërkohet të jetë me shkrim nënkupton se forma është element esencial i kontratës dhe nuk do të ketë kontratë për alotmanin në qoftë se nuk është respektuar forma me shkrim. Forma me shkrim e kontratës për alotmanin, do të thotë që palët kontraktuese t'a nënshkruajnë kontratën për alotmanin ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese. Forma me shkrim kushtëzon vlefshmërinë e kontratës së alotmanit⁷⁶¹. Për lidhjen e kontratës për alotmanin jo vetëm që duhet të jetë forma me shkrim për kontratën kryesore por me shkrim duhet të jetë edhe oferta si dhe kundër oferta, kjo nënkupton se është me shkrim edhe kur dërgohet me mjete të telekomunikimit, p.sh., me internet.

KREU 2**DETYRIMET E AGJENCISË TURISTIKE****Neni 908. Detyrimet e njoftimit**

- 1. Agjencia turistike ka për detyrë ta njoftojë hotelierin për procesin e mbushjes së kapaciteteve të strehimit.**
- 2. Në qoftë se nuk ka mundësi t'i plotësojë të gjitha kapacitetet e rezervuara të strehimit, agjencia turistike ka për detyrë që brenda afateve të kontraktuara ose të rëndomta ta njoftojë hotelierin për këtë dhe t'i dërgojë listën e mysafirëve dhe në njoftim të caktojë afatin, deri te i cili hotelieri mund të disponojë lirisht me kapacitetet e rezervuara.**
- 3. Kapacitetet e hotelierisë që në listën e mysafirëve nuk janë theksuar si të plotësuara, konsiderohen të lira, që nga dita e marrjes së kësaj liste nga ana e hotelit për periudhën me të cilën ka të bëjë lista.**
- 4. Pasi të ketë kaluar ky afat, agjencia turistike fiton përsëri të drejtën e plotësimit të kapaciteteve të rezervuara të strehimit.**

908. Vështrim i përgjithshëm. Kreu 2 i pjesës së njëzet e tre (XXIII) të LMD të Kosovës, përcakton detyrimet e agjencisë turistike e cila është palë kontraktuese te kontrata për alotmanin krahas hotelierit si palë tjetër kontraktuese. Detyrimet e agjencisë turistike

⁷⁶¹ Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 751; Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 1343.

numërohen: detyrimet e njoftimit të hotelierit; detyrimi i respektimit të çmimeve të kontraktuara; detyrimi i pagimit të çmimit të hotelierisë; dhe detyrimi i dhënies së dokumentit të veçantë me shkrim (nenet 908-911).

Neni 908, përcakton detyrimin e njoftimit të agjencionit turistik ndaj hotelierit dhe përmban kater paragrafe me të cilat rregullohen detyrimet e njoftimit.

908.1. Paragrafi 1, përcakton detyrimin e agjencionit turistik që t'a njoftojë hotelierin për procesin e mbushjes së kapaciteteve të strehimit⁷⁶². Agjencioni turistik është i vetëdijshëm që përmbushja e kapaciteteve të kontraktuara me hotelierin është çështje e pasigurtë aq më tepër kur bëhet fjalë për llojin e kontratës që është i karakterit më të gjatë kohor që mund të jetë edhe një (1) vitë, por nuk përjashtohet mundësia që me kontratë të jetë edhe më shumë, atëherë merret parasysh me rastin e lidhjes së kontratës për alotmanin edhe mundësia e mirëkuptimit nga ana e hotelierit për mos përmbushjen e kapaciteteve të strehimit nga ana e agjencionit turistik ashtu siç kanë paraparë dhe për këtë ekziston detyrimi që agjencioni turistik t'a njoftojë hotelierin se si shkon aktiviteti i plotësimin të kapaciteteve të strehimit respektivisht i mbushjes së kapaciteteve të strehimit me persona që i dërgon agjencioni turistik. Hotelieri është i interesuar që kapacitetet e strehimit të kontraktuara me agjencionin turistik të mbushen ashtu siç janë marrë vesh dhe në rast se kjo nuk ndodhë, atëherë kontraktohet edhe përgjegjësia e agjencionit turistik ose kontraktohet lirimi nga përgjegjësia për mos plotësimin të kapaciteteve të strehimit të kontraktuara me hotelierin.

908.2. Paragrafi 2, përcakton se në rastet kur agjencioni turistik nuk ka mundësi t'i plotësojë të gjitha kapacitetet e rezervuara të strehimit ka për detyrë që brenda afateve të kontraktuara me kontratën për alotmanin ose afateve të rëndomta t'a njoftojë hotelierin për pamundësinë e plotësimin të të gjitha kapaciteteve të rezervuara të strehimit dhe t'i dërgojë hotelierit listën e musafirëve që do të shfrytëzojnë kapacitetet e rezervuara të strehimit dhe në njoftim të caktojë afatin, kohën deri kur hotelieri mund të disponojë lirisht me kapacitetet e rezervuara të strehimit që kanë mbetur të pa plotësuara (të pambushura) nga agjencioni turistik. Ky paragraf, në fakt i mundëson agjencionit turistik si palë kontraktuese dhe hotelierit si palë tjetër kontraktuese që të zvogëlojnë pasojat e mos plotësimin të kapaciteteve të strehimit të rezervuara. Hotelieri, ruan raportin me agjencionin turistik duke zbutur shpenzimet e agjencionit turistik për nga kapacitetet e rezervuara të strehimit e të pa plotësuara duke u angazhuar që ato kapacitete të rezervuara të strehimit t'i disponojë lirshëm duke gjetur persona tjerë për kapacitetet e rezervuara por të pambushura nga agjencioni turistik. Hotelieri, duhet të jetë i informuar (i njoftuar) me kohë nga ana e agjencionit turistik. Ky njoftim duhet të bëhet gjithmonë brenda afateve të kontraktuara midis palëve në qoftë se nuk është bërë kontraktimi i afatit ajo do të caktohet në bazë të

762 Nëse me kontratë nuk është paraparë ndryshe varësisht nga shprehitë e Rajoneve të veçanta turistike, agjencioni është i detyruar të fillojë t'a njoftojë hotelierin gjatë plotësimin të kapaciteteve të angazhuara më së voni në kohën prej tridhjetë (30) deri në gjashtëdhjetë (60) ditë para fillimit të zbatimit të kontratës për alotmanin dhe të vazhdojë lidhur me të të dërgojë njoftimë çdo pesëmbëdhjetë (15) ditë (Uzansa Nr.94 – Posebne Uzanse u Turizmu SG. RS Nr.33/01).

dokeve afariste të cilat parashohin se çka është afat i rëndomtë për njoftimin e hotelierit për pamundësinë e plotësimit të kapaciteteve të strehimit nga ana e agjencionit turistik.

908.3. Paragrafi 3, përcakton se kapacitetet e hotelierisë të cilat kanë mbetur të pa plotësuara respektivisht në listën e musafirëve janë theksuar si të pa plotësuara konsiderohen të lira dhe atë nga dita e marrjes së kësaj liste nga ana e hotelit për periudhën me të cilën ka të bëjë lista. Pra, agjencioni turistik me dorëzimin e listës të musafirëve precizon jo vetëm vendet e zbrazëta të pa plotësuara por edhe kohëzgjatjen se sa do të konsiderohen të zbrazëta për periudhën me të cilën ka të bëjë lista. Gjatë kësaj kohe, kapacitetet e kontraktuara të strehimit nga ana e agjencionit turistik për shkak të mos plotësimit me musafir konsiderohen të lira dhe hotelieri ka të drejtë të disponojë lirisht më kapacitetet e rezervuara të strehimit që do të thotë në vend të listës së prituri të musafirëve nga agjencioni turistik të vendosë musafirë të tjerë të cilët i ka gjetur vetë hotelieri. Natyrisht, nëse vjen deri të plotësimi i kapaciteteve të zbrazëta për shkak të mos plotësimit nga ana e agjencionit turistik zvogëlohet përgjegjësia e agjencionit turistik për vendet e zbrazëta të kontraktuara.

908.4. Paragrafi 4, përcakton të drejtën e agjencionit turistik që pasi të kalojë afati për të cilën kapacitetet e rezervuara konsiderohen të lira, fiton përsëri të drejtën e plotësimit të kapaciteteve të rezervuara të strehimit sipas kontratës për alotmanin. Gjithësesi, e drejta e plotësimit të kapaciteteve të rezervuara të strehimit për agjencionin turistik vlen vetëm pas datës ta kalimit të afatit. Pra, vlen për në të ardhmen. Kjo nuk ndalon marrëveshjet eventuale midis hotelierit dhe agjencionit turistik nëse agjencioni turistik ka siguruar persona për t'i dërguar te hotelieri dhe kapacitetet e strehimit janë të lira, mund të vazhdojë edhe para këtij afati e drejta e plotësimit të kapaciteteve të rezervuara të strehimit.

Neni 909. Detyrimi i respektimit të çmimeve të kontraktuara

Agjencia turistike nuk mund t'u llogarisë personave që i dërgon në objektin e hotelierisë çmime më të larta për shërbimet e hotelierisë nga ato që janë parashikuar me kontratën mbi alotmanin ose me listën e çmimeve të hotelierisë.

909. Vështrim i përgjithshëm. Neni 909, përmban dispozitën me të cilën palët kontraktuese hotelieri dhe agjencioni turistik detyrohen që të respektojnë çmimet e kontraktuara me kontratën për alotmanin. Nëse palët nuk e respektojnë detyrimin e respektimit të çmimeve të kontraktuara mund të vjen deri te zgjidhja e kontratës apo deri te përgjegjësia për dëmin e pësuar për shkak të mos respektimit të detyrimit të çmimeve të kontraktuara.

Neni 909, shprehimisht përcakton se agjencioni turistik nuk mund të llogarit në personat që i dërgon në objektin hotelierisë çmimet më të larta për shërbimet e hotelierisë nga ato që janë parashikuar me kontratën mbi alotmanin ose me listën e çmimeve të hotelierisë. Ky nen, në fakt mbron interesat e personave që i dërgon agjencioni turistik, dhe në këtë mënyrë ndalohet që agjencioni turistik në rastet e caktuara, pra kur ka kërkesa të tepërta të caktojë çmim më të lartë se sa është kontraktuar me kontratën për alotmanin. Agjencioni turistik

ka vetëm të drejtën në provizion nga hotelieri në bazë të kontratës për alotmanin. Çmimi real i caktuar nga dhënësi i shërbimeve në këtë rast nga hotelieri është bazë për krijimin e partneritetit me agjencionin turistik por edhe me personat e dërguar nga agjencioni turistik dhe çdo rritje e çmimit nga ana e agjencionit turistik e prish ekuivalencën e vlerave midis çmimit dhe shërbimeve të cilat i ofrohen personit të dërguar nga hotelieri.

Neni 910. Detyrimi i pagimit të shërbimeve të hotelierisë

1. Në qoftë se me kontratë nuk është caktuar ndryshe, çmimin e shërbimeve të dhëna të hotelierisë ia paguan hotelierit agjencia turistike pas kryerjes së shërbimeve.

2. Hotelieri ka të drejtë të kërkojë pagimin e paradhënieve përkatëse.

910. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 910, përmban dispozitën me të cilën përcaktohet detyrimi i pagimit të shërbimeve të hotelierisë. Në këtë rast, ky detyrim sipas rregullit është i agjencionit turistik sepse ky është personi që ka kontraktuar kapacitetet e strehimit dhe të shërbimeve tjera nga hotelieri. Është rregull që personi i cili ka kontraktuar edhe të sigurojë pagimin e shërbimeve hotelierike.

910.1. Paragrafi 1 i nenit 910, në mënyrë të qartë përcakton se në rastet kur me kontratë nuk është caktuar ndryshe, pra kur palët nuk janë marrë vesh se kush duhet t'a bëjë pagimin e çmimit për shërbimet e dhëna, pra shfrytëzuesi i shërbimeve apo agjencioni turistik, atëherë me këtë dispozitë parashihet se çmimin e shërbimeve të dhëna të hotelierisë i'a paguan hotelierit agjencia turistike dhe atë pas kryerjes së shërbimeve të ofruara personave të cilët i ka dërguar agjencioni turistik. Agjencioni turistik, nga personat e dërguar i merrë pagesat për shërbimet e parapara në kontratën për alotmanin dhe në marrëveshjen midis agjencionit turistik dhe personave të cilët i dërgon ky agjencion te hotelieri për shfrytëzimin e kapaciteteve të strehimit.

910.2. Paragrafi 2, parasheh se hotelieri ka të drejtë të kërkojë pagimit e paradhënieve përkatëse nga ana e agjencionit turistik. E drejta e hotelierit që të kërkojë pagimin e paradhënieve përkatëse ekziston për shkak se ai duhet të bëjë përgaditjet e nevojshme për sigurimin e kapaciteteve të strehimit dhe të shërbimeve hotelierike. E drejta e hotelierit, që të kërkojë pagimin e paradhënieve përkatëse duhet të rregullohet me kontratë sepse kjo dispozitë nuk parasheh pasojat për agjencionin turistik nëse e drejta për kërkimin e paradhënieve nuk është bërë me kontratë. Natyrisht, hotelieri çdo të drejtë që i'a garanton ligji pra edhe të drejtën që të kërkojë pagimin e paradhënieve përkatëse kur kjo nuk është e paraparë me kontratë mund t'a kërkojë përmes rrugës gjyqësore. Në rastet kur agjencioni është i detyruar të paguajë paradhënie përkatëse gjithësesi kjo shkon në dëm të shfrytëzuesve të kapaciteteve të strehimit sepse atëherë edhe agjencioni turistik do t'i realizojë fillimisht pagesat nga ana e personave që i shfrytëzojnë kapacitetet e strehimit dhe shërbimet tjera hotelierike.

Neni 911. Detyrimi i dhënies së dokumentit të veçantë me shkrim

- 1. Agjencia turistike ka për detyrë që personave të cilët i dërgon në bazë të kontratës për alotmanin t'u japë dokumentin e veçantë me shkrim.**
- 2. Dokumenti i veçantë me shkrim është në emër ose në grupin e caktuar, është i pabartshëm dhe përmban urdhërin drejtuar hotelierit që t'i japë shërbimet të cilat janë theksuar në të.**
- 3. Dokumenti i veçantë me shkrim shërben si provë se personi është klient i agjencisë turistike që ka lidhur kontratën me hotelierin për alotmanin.**
- 4. Në bazë të dokumentit të veçantë me shkrim bëhet përlllogaritja e kërkesave reciproke midis agjencisë turistike dhe hotelierit.**

911. Vështrim i përgjithshëm. Neni 911, rregullon detyrimin e agjencionit turistik që personave të cilët i dërgon në bazë të kontratës për alotmanin t'u sigurojë (t'u jep) dokumentin e veçantë me shkrim me të cilën personit të siguar i mundësohet e drejta e shfrytëzimit të kapaciteteve të strehimit dhe të shërbimeve të tjera hotelierike.

911.1. Paragrafi 1, përmban dispozitën me të cilën agjencionit turistik ka për detyrë që personave të cilët i dërgon në bazë të kontratës për alotmanin t'u japë dokumentin e veçantë me shkrim⁷⁶³ i cili dokument me shkrim personave të dërguar nga agjencionit turistik u mundëson që ky dokument me shkrim të konsiderohet si mjet për pagimin e shfrytëzimit të kapaciteteve të strehimit dhe të shërbimeve të tjera hotelierike të cilat duhet t'i ofrohen personave të dërguar nga ana e agjencionit turistik. Dokumenti me shkrim, si dokument i veçantë të cilin e lëshon agjencionit turistik është mjet provues se personi është i dërguar nga agjencionit turistik se përputhet identiteti i tij me emrin që përmban dokumenti i veçantë me shkrim. Dokumenti me shkrim, është edhe provë për realizimin e shumës së provizionit nga ana e agjencionit turistik. Personi i dërguar patjetër duhet të ketë këtë dokument me shkrim sepse në të kundërtën ai mund të refuzohet nga hotelieri dhe nuk i lejohet shfrytëzimi i kapaciteteve të strehimit dhe shërbimeve të tjera hotelierike.

911.2. Paragrafi 2, përcakton se dokumenti i veçantë me shkrim duhet të jetë me emër ose në grupin e caktuar⁷⁶⁴ pra duhet të figurojë emri i personit të cilit i është dhënë ose emrat e grupit të caktuar të shënuar në dokumentim e veçantë me shkrim, pastaj dokumenti i veçantë me shkrim është i pabartshëm që nënkupton se nuk mund t'i kalohet dikujt tjetër

763 Dokumenti i veçantë me shkrim do të thotë shkresa ku shënohet emri i personit të dërguar që është e pabartshme dhe me urdhërin drejtuar hotelierit që t' jap shërbimet të cilat janë theksuar në këtë dokument të veçantë me shkrim, që provon identitetin e personit se është klient i agjencionit turistik dhe është bazë për llogaritjen e kërkesave reciproke midis agjencisë turistike dhe hotelierit, prandaj kjo shkresë me shkrim duhet të ketë formë të veçantë dhe numër të veçantë që të dihet se në çfarë numri rendor është lëshuar.

764 Grupin e përbëjnë numri i caktuar i personave të cilët udhëtojnë bashkërisht që agjencionit turistik dhe hotelier i konsiderojnë tërësi e veçantë respektivisht me grup të musafirëve kuptojmë grupin prej së paku 15 vetësh që arrijnë dhe shkojnë bashkë të cilët agjencionit turistik dhe hotelieri i konsiderojnë tërësi.

por vlen vetëm për personin që është shënuar në të ose personi i cili është anëtarë i grupit që është shënuar në dokumenti ne udhëtimit, si dhe dokumenti i veçantë me shkrim të cilin e ka lëshuar agjencioni turistik përmban urdhërin drejtuar hotelierit që t'i jap shërbimet të cilat janë theksuar në të.

911.3. Paragrafi 3, përcakton se dokumenti i veçantë me shkrim është mjet provues me të cilën provohet se personi i shënuar në dokument është klient i agjencisë turistike që ka lidhur kontratën për alotmanin me hotelierin. Dokumenti i veçantë me shkrim, klientit të agjencionit turistik i jep të drejtë që t'i drejtohet hotelierit që t'i ofrohet strehimi i kontraktuar dhe të gjitha shërbimet hotelierike.

911.4. Paragrafi 4, përcakton se në bazë të dokumentit të veçantë me shkrim të cilën personit të dërguar i'a lëshon agjencioni turistik, bëhet edhe përlllogaritja e kërkesave reciproke midis agjencisë turistike dhe hotelierit gjithnjë në pajtim me kontratën për alotmanin të lidhur midis agjencionit turistik dhe hotelierit.

KREU 3

DETYRIMET E HOTELIERIT

Neni 912. Detyrimi i vënies në përdorim të kapaciteteve strehimi të kontraktuara

- 1. Hotelieri merr përsipër detyrimin definitiv dhe të parevokueshëm që brenda afatit të caktuar të vejë në përdorim numrin e kontraktuar të shtretërve dhe t'u japë personave që i dërgon agjencia turistike shërbime të theksuara në dokumentin e veçantë me shkrim.**
- 2. Hotelieri nuk mund të kontraktojë me agjencinë tjetër turistike angazhimin e kapaciteteve që janë rezervuar në bazë të kontratës mbi alotmanin.**

912. *Vështrim i përgjithshëm.* Kreu 3 i pjesës së njëzet e tre (XXIII) të LMD të Kosovës rregullon detyrimet e hotelierit të cilat i ka ndaj agjencionit turistik e cila është palë në kontratën për alotmanin. Detyrimet e hotelierit siç janë : detyrimi i vënies në përdorim të kapaciteteve strehimi të kontraktuara; detyrimi për trajtim të barabartë; detyrimi i hotelierit që të mos i ndryshojë çmimet e shërbimve; dhe detyrimi i pagimit të provizionit.

912.1. Paragrafi 1, përcakton detyrimin e hotelierit⁷⁶⁵ edhe atë si detyrim definitiv dhe të parevokueshëm të cilin e ka marrë në bazë të kontratës për alotmanin që brenda afatit të caktuar të vë në përdorim numrin e kontraktuar të shtretërve dhe t'u japë personave që i dërgon agjencia turistike shërbime të theksuara në dokumentin e veçantë me shkrim. Kjo

.....
⁷⁶⁵ Hotelieri është personi juridik apo fizik që ushtron veprimtari hoteliere gjegjësisht ofron shërbime të strehimit, përgaditjen dhe shërbimin e ushqimit dhe pijeve.

dispozitië është e karakterit obligativ ndaj hotelierit sepse detyrimi i marrur përsipër që të sigurojë numrin e kontraktuar të shtretërve dhe t'u japë personave që dërgon agjencia turistike është definitiv do të thotë përfundimtarë dhe i parevokueshëm. Hotelieri, nuk mund të ndryshojë respektivisht të revokojë kontratën për sigurimin e shtretërve të kontraktuar dhe të shërbimeve të cilat duhet të ofrohen. Mos respektimi i këtij paragrafi nga ana e hotelierit, i jep të drejtë agjencionit turistik të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar.

912.2. Paragrafi 2, përcakton se hotelieri nuk mund të kontrakttojë me agjencinë tjetër turistike angazhimin e kapaciteteve që janë rezervuar në bazë të kontratës për alotmanin. Kjo nënkupton se detyrimi i hotelierit që të ruajë numrin e kontraktuar të shtretërve është i karakterit definitiv dhe nuk mund që hotelieri t'a kontrakttojë me agjencinë tjetër turistike angazhimin e kapaciteteve që janë rezervuar në bazë të kontratës për alotmanin. Nëse vjen deri te kontraktimi i kapaciteteve të rezervuara me ndonjë agjenci tjetër turistike, atëherë hotelieri i përgjigjet agjencionit turistik me të cilin ka lidhur kontratën për alotmanin për dëmin e shkaktuar.

Neni 913. Detyrimi për trajtim të barabartë

Hotelieri duhet t'u ofron shërbime të njëjta personave që dërgohen nga agjencia e turizmit, sikurse personave me të cilët ka lidhur kontratë direkte mbi shërbimet e hotelierisë.

913. Vështrim i përgjithshëm. Neni 913, përcakton detyrimin e hotelierit për trajtim të barabartë të të gjithë klientëve të cilët shfrytëzojnë kapacitetet e strehimit në objektin hotelier, pa marrë parasysh mënyrën se përmes kujt janë vendosur në këtë objekt hotelierik. Neni 913, parasheh se hotelieri ka për detyrim që t'u ofrojë shërbime të njëjta personave që dërgohen nga agjencia e turizmit (vërejtje: në këtë nen përdoret shprehja “agjencia e turizmit” dhe dallon nga nenet tjera ku përdoret shprehja “agjencionit turistik”)⁷⁶⁶, ashtu si u ofrohen shërbime edhe personave me të cilat hotelieri ka lidhur kontratë të drejtëpërdrejtë mbi shërbimet e hotelierisë. Me këtë dispozitë ndalohet sjellja e hotelierit në mënyrë të pabarabartë ndaj klientëve të vendosur në objektin hotelier. Hotelieri, nuk mund të ofrojë beneficione për klientët të cilët i ka siguruar vetë në raport në klientët të cilët kanë ardhur përmes agjencionit turistik. Kështu sigurohet barazia e shfrytëzuesve të kapaciteteve të strehimit dhe të shërbimeve hoteliere që ofron hotelieri. Nuk mendohet për dallimet që janë rezultat i çmimit por këtu bëhet fjalë për trajtim të barabartë të personave nën kushtet e barabarta, pra të cilët kanë kontraktuar kapacitetet e strehimit dhe shërbimet e tjera⁷⁶⁷ me

⁷⁶⁶ Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 3, pika 1.10, ku thuhet “Agjencia turistike organizatore - agjenci turistike që organizon paketë aranzhmanin turistik dhe paketa udhëtimesh qoftë drejtpërdrejtë, qoftë përmes ndërmjetësuesve/agentëve të saj”; dhe pika 1.11, ku thuhet “Agjencia turistike ndërmjetësuese - agjenci turistike që shet ose blen paketë aranzhmanin që ka përpiluar organizatori i udhëtimit ose që ofron shërbime të tjera ndërmjetësimi të përcaktuara me këtë ligj”.

⁷⁶⁷ Shih: Vendimin e Gjykatës së Apelit të Novi Sadit, GZ 3992/11, datë 11.04.2012, në arsyetimin e të cilit parashihet se edhe shërbimet ndaj turistit për gjueti janë pjesë e kontratës për alotmanin sepse shprehimisht thuhet “Sipas konstatimit të Gjykatës së shkallës së dytë, kjo kontratë (mendohet

çmim të njëjtë. Kjo dispozitë ligjore, nuk mund të kontraktohet ndryshe midis agjencionit turistik dhe hotelierit sepse trajtimi i barabartë është i detyrueshëm për hotelierin.

Neni 914. Detyrimi i hotelierit që të mos i ndryshojë çmimet e shërbimeve

- 1. Hotelieri nuk mund t'i ndryshojë çmimet e kontraktuara, në qoftë se për të nuk e njofton agjencinë turistike të paktën gjashtë muaj përpara, përveç në rastin e ndryshimit të kursit të këmbimit të valutave që ndikojnë në çmimin e kontraktuar.**
- 2. Çmimet e reja mund të zbatohen pasi të ketë kaluar një muaj nga dërgimi i tyre agjencisë turistike.**
- 3. Çmimet e reja nuk do të zbatohen ndaj shërbimeve për të cilat është dërguar lista e klientëve.**
- 4. Sidoqoftë, ndryshimet e çmimit nuk kanë efekt ndaj rezervimit që e ka konfirmuar hotelieri.**

914. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 914, përcakton detyrimin e hotelierit që të mos i ndryshojë çmimet e shërbimeve të kontraktuara. Nëse kjo do të ndodhë në rastet e caktuara ajo duhet të bëhet në një afat të konsiderueshëm e që ligji këtë afat e konsideron të paktën gjashtë (6) muaj përpara. Ndryshimi i çmimeve të kontraktuara krijon pasiguri si për agjencionin turistik ashtu edhe për personat të cilët i dërgon agjencionin turistik. Hotelieri, duhet të respektojë çmimin e kontraktuar dhe kjo është në shërbim të afarizmit të ndershëm që do të thotë nuk mund t'a ndryshojë çmimin e shërbimeve për shkak se është rritur oferta por çmimi i kontraktuar mbetet i pandryshueshëm për palët kontraktuese.

914.1. Paragrafi 1, shprehimisht përcakton se hotelieri nuk ka të drejtë të ndryshojë çmimet e kontraktuara në qoftë se për të nuk e njofton agjencinë turistike të paktën gjashtë (6) muaj përpara që konsiderohet kohë e mjaftueshme për të mos hyrë në obligime me klientët e tij për çmime fikse. Hotelieri, mund të ndryshojë çmimet e kontraktuara edhe në afat më të shkurtë se gjashtë (6) muaj në rastin e ndryshimit të këmbimit të valutave që ndikojnë në çmimin e kontraktuar. Ndryshimi i çmimit nuk mund të jetë çështje e vullnetit të hotelierit nëse ajo bëhet në kohë më të shkurtër se gjashtë muaj. Mirëpo, lejohet si përjashtim ndryshimi i çmimit kur kjo është e varur nga një ngjarje për të cilën hotelieri nuk ka mundur të dijë as t'i shmanget e as t'a menjanojë e kjo rrethanë për ndryshimin e çmimit është vetëm ndryshimi i këmbimit të valutave që drejtëpërsëdrejti ndikon në rritjen e çmimit kur ajo shkon në dëm të hotelierit. Mirëpo, LMD i Kosovës nuk e parasheh rastin nëse ndërrimi i këmbimit të valutave është i favorshëm për hotelierin a do të ketë zbritje të çmimit për agjencionin turistik apo do të mbetet e njëjta që ka ekzistuar më herët.

për kontratën e turistëve gjuetarë) sipas natyrës së vet juridike është kontratë për alotmanin dhe se ndërmjetësuesi i agjencionit turistik sipas nenit 889 të LMD-së ka për detyrim të paguajë çmimin e shërbimeve turistike ashtu siç ka kontraktuar me paditësin, sipas fakturës së paditësit?.

914.2. Paragrafi 2, përcakton se çmimet e reja të cilat i cakton hotelieri më herët se gjashtë muaj mund të zbatohen pasi të ketë kaluar një (1) muaj nga dërgimi i tyre agjencisë turistike. Kjo nënkupton se, çmimet ekzistuese do të vlejnjë edhe një muaj nga dita e dërgimit të çmimores së re agjencionit turistik sepse me këtë dispozitë shprehimisht parashihet se çmimet e reja mund të zbatohen vetëm pas kalimit të një muaji nga dërgimi i tyre agjencisë turistike.

914.3. Paragrafi 3, përmban përjashtimin se çmimet e reja nuk do të zbatohen lidhur me shërbimet për të cilat është dërguar lista e klientëve. Kjo nënkupton se, pa marrë parasysh se realizimi i udhëtimit do të bëhet më vonë se një muaj nga dita e dërgimit të çmimores së re te agjencionit turistik, çmimet për personat e përfshirë në listën e klientëve do të mbeten të njëjta.

914.4. Paragrafi 4, gjithashtu është një përjashtim sipas të cilit ndryshimet e çmimit nuk kanë efekt edhe ndaj rezervimit që e ka konfirmuar hotelieri. Kjo nënkupton nëse agjencionit turistik ka bërë rezervimin dhe të njëjtin e ka konfirmuar hotelieri atëherë edhe personat e përfshirë në këtë rezervim, shërbimet hoteliere do t'i kenë me çmimin e kontraktuar.

Neni 915. Detyrimi i pagimit të provizionit

- 1. Hotelieri ka për detyrë që agjencisë turistike t'i paguajë provizionin për qarkullimin e realizuar në bazë të kontratës për alotmanin.**
- 2. Provizioni caktohet në përqindje prej çmimit të shërbimeve hoteliere të kryera.**
- 3. Në qoftë se përqindja e provizionit nuk është caktuar me kontratë, agjencisë turistike i takon provizioni i caktuar me kushtet e përgjithshme të ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë turistike, ose në qoftë se këto nuk ekzistojnë sipas praktikës afariste.**

915. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 915 i LMD të Kosovës, përcakton edhe detyrimin e pagimit të provizionit agjencisë turistike për dërgimin e personave në hotel⁷⁶⁸.

915.1. Paragrafi 1, shprehimisht parasheh se hotelieri ka për detyrë që agjencisë turistike t'i paguajë provizionin (shumën e parave) për qarkullimin e realizuar në bazë të kontratës për alotmanin. Provizioni, është shuma e parave e cila paguhet në përqindje (%) në bazë të qarkullimit të realizuar. Provizioni gjithmonë parashihet me kontratën për alotmanin të lidhur ndërmjet hotelierit dhe agjencisë turistike. Pagesa e provizionit është çështje esenciale e kontratës për alotman. Provizioni nëse nuk është caktuar ajo nënkuptohet vetëm se lartësia e provizionit duhet të bëhet në bazë të dokeve afariste respektivisht në bazë të uzansave ekzistuese tregtare.

⁷⁶⁸ Kur përdoret fjala “hotel” mendohet në objektin ku janë të rezervuara shtretërit si dhe shërbimet tjera hoteliere; Ligji për Turizmin i Kosovës, neni 3, ku bëhet përkufizimi i nocioneve lidhur me turizmin ndër të tjera: hoteli, moteli, bujtinat, fshati turistik, kampet, etj. Hotel në kuptimin e këtij ligji nënkuptohet “objekti që ka jo më pak se gjashtë (6) dhoma për akomodim duke përfshirë ushqimin dhe fjetjen“ (neni 3, pika 1.16).

915.2. Paragrafi 2, përcakton se provizioni caktohet në përqindje p.sh., 5%, 10%, etj., prej çmimit të shërbimeve hoteliere të kryera. Kjo nënkupton se provizioni gjithmonë shprehet në përqindje dhe jo në mënyrë paushalle siç është rasti me kontratën për organizimin e udhëtimit. Përqindja caktohet në bazë të çmimit të shërbimeve hoteliere të kryera respektivisht nga qarkullimi që ka patur hotelieri nga klientët e agjencisë turistike. Koha e pagimit të provizionit gjithashtu është çëshjte që duhet kontraktuar me kontratën për alotmanin por nëse kjo nuk është bërë atëherë agjencia turistike ka të drejtë të kërkojë pagimin e provizionit pas çdo liste të dërguar hotelierit respektivisht pas përfundimit të shërbimeve hotelierike. Në fakt, agjencia turistike është e favorizuar lidhur me kohën e pagimit të provizionit sepse ajo është pala që paguan hotelierit shumën e të hollave për kapacitetet e strehimit dhe shërbimet tjera hotelierike dhe jo klientët. Me rastin e realizimit të pagesave ndaj hotelierit, agjencia turistike ka të drejtë që provizionin t'a llogarisë në momentin e pagimit të shumave të hotelierit.

915.3. Paragrafi 3, rastin kur përqindja e provizionit nuk është caktuar me kontratë atëherë agjencionit turistik i takon provizioni i caktuar me kushtet e përgjithshme të ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë turistike ose në qoftë se këto nuk ekzistojnë sipas praktikës afariste. Kjo dispozitë, mund të krijojë paqartësi për shkak se dallon interesi i hotelierit lidhur me lartësinë e përqindjes së provizionit nga interesi i agjencisë turistike për lartësinë e provizionit që i takon agjencisë turistike. Prandaj, fjalët “i takon provizioni i caktuar me kushtet e përgjithshme të ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë turistike” duhet kuptuar se edhe në këtë rast agjencionit turistik do t'a realizojë lartësinë e provizionit ashtu si edhe në rastet tjera për shërbimet turistike tjera. Nëse nuk mund të caktohet përqindja e provizionit në bazë të kushteve të përgjithshme të ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë turistike atëherë përqindja e provizionit mund të caktohet edhe sipas praktikës afariste. Mund të mbështetemi edhe në uzansat tregtare të cilat ekzistojnë në vendin ku agjencia turistike ka selinë.

KREU 4

E DREJTA E AGJENCISË TURISTIKE PËR TË HEQUR DORË NGA KONTRATA

Neni 916. E drejta për të hequr dorë nga kapacitetet e angazhuara të strehimit

- 1. Agjencia turistike mund të heqë dorë përkohësisht nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit dhe me këtë të mos e zgjidhë kontratën për alotmanin dhe as të krijojë për vete detyrimin e shpërblimit të dëmit hotelierit, në qoftë se në afatin e kontraktuar dërgon njoftimin për heqjen dorë nga shfrytëzimi.**
- 2. Në qoftë se afati i njoftimit mbi heqjen dorë nuk është caktuar me kontratë, përcaktohen në bazë të dokeve afariste në hotelieri.**
- 3. Kur njoftimi mbi heqjen dorë nuk është dërguar në afatin e parashikuar, hotelieri ka të drejtë në shpërblimin e dëmit.**

4. Agjensia turistike mund të heqë dorë nga kontrata tërësisht pa detyrimin e shpërblimit të dëmit në qoftë se njoftimin mbi heqjen dorë e dërgon brenda afatit të kontraktuar.

916. Vështrim i përgjithshëm. Kreu 4 i pjesës së njëzet e tre (XXIII) të LMD të Kosovës, rregullon të drejtën e agjencisë turistike për të hequr dorë nga kontrata ku numërohen : e drejta për të hequr dorë nga kapacitetet e angazhuara të strehimit dhe detyrimi i agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara.

Neni 916, parasheh mundësinë si përjashtim që edhe agjencia turistike të ketë të drejtë për të hequr dorë nga kapacitetet e angazhuara të strehimit, përkohësisht. Kjo dispozitë ligjore, përmban katër paragrafe me të cilat shprehimisht parashihet si e drejta e agjencionit turistik për të hequr dorë nga kapacitetet e angazhuara të strehimit përkohësisht dhe kushtet nën të cilat lejohet heqja dorë si dhe pasojat eventuale që mund të paraqiten për shkak të heqjes dorë e agjencionit turistik nga kapacitetet e angazhuara të strehimit.

916.1. Paragrafi 1, shprehimisht parasheh se agjencia turistike mund të heqë dorë përkohësisht që do të thotë jo përgjithmonë, nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit dhe me këtë të mos konsiderohet se është zgjidhur kontrata për alotmanin dhe as të krijojë për vete detyrimin e shpërblimit të dëmit hotelierit, në qoftë se në afatin e kontraktuar dërgon njoftimin për heqjen dorë nga shfrytëzimi. Kjo dispozitë, përcakton se e drejta e agjencisë turistike pa krijuar detyrimin e shpërblimit të dëmit hotelierit që të heqë dorë përkohësisht nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit është e mundur vetëm në qoftë se në afatin e kontraktuar agjencioni turistik i dërgon njoftimin për heqjen dorë nga shfrytëzimi hotelierit. Agjencioni turistik ka të drejtë të heqë dorë përkohësisht nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit edhe nëse nuk është paraparë me kontratë afati por ky afat mund të caktohet edhe në bazë të dokeve afariste në hotelieri, të cilën e parasheh paragrafi vijues i këtij neni.

916.2. Paragrafi 2, përcakton zgjidhjen se si do të veprohet nëse afati i njoftimit mbi heqjen dorë nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit nuk është caktuar me kontratë. Ky paragraf, parasheh se në këtë rast se afati i njoftimit mbi heqjen dorë do të përcaktohet në bazë të dokeve afariste në hotelieri. Kjo do të bëhet në bazë të dokeve afariste respektivisht uzansave për veprimtarinë në hotelieri.

916.3. Paragrafi 3, përcakton rastin se si do të veprohet nëse njoftimi mbi heqjen dorë nuk është dërguar në afatin e paraparë me kontratë ose në bazë të dokeve afariste. Në këtë rast, hotelieri ka të drejtë në shpërblimin e dëmit nga agjencioni turistik i cili ka hequr dorë përkohësisht nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit për shkak se njoftimi mbi heqjen dorë nuk është dërguar në afatin e parashikuar.

916.4. Paragrafi 4, përmban dispozitën me të cilën parashihet se agjencia turistike mund të heqë dorë nga kontrata për alotmanin tërësisht pa detyrimin e shpërblimit të dëmit që do

të thotë pa qenë i detyruar të shpërblejë dëmin në qoftë se njoftimin mbi heqjen dorë nga kontrata e dërgon brenda afatit të kontraktuar. Pra, dispozita e paragrafit 4 i jep të drejtë agjencisë turistike të heqë dorë jo vetëm përkohësisht nga shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara të strehimit që parashihet në paragrafin 1 të këtij neni, por edhe nga kontrata tërësisht dhe atë pa detyrimin e shpërblimit të dëmit ndaj hotelierit me kusht që njoftimi mbi heqjen dorë t'i dërgohet hotelierit brenda afatit të kontraktuar e nëse ky afat nuk është i kontraktuar në mënyrë analoge do të respekohet paragrafi 2 edhe për heqjen dorë nga kontrata tërësisht.

Neni 917. Detyrimi i agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara

- 1. Me kontratën për alotmanin mund të parashihet detyrimi i veçantë i agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara të hotelierisë.**
- 2. Në qoftë se në këtë rast nuk i plotëson kapacitetet e angazhuara të hotelierisë, agjencia turistike ka për detyrë t'i paguajë hotelierit shpërblimin për çdo shtrat të pashfrytëzuar dhe për çdo ditë.**
- 3. Agjencia turistike atëherë nuk ka të drejtë që me anë të njoftimit të bërë në kohën e duhur ta denoncojë kontratën pjesërisht ose tërësisht.**

917. *Vështrim i përgjithshëm.* Neni 917, përcakton detyrimin e agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara në bazë të kontratës për alotmanin. Kjo është detyrë kryesore e agjencisë turistike ndaj hotelierit sepse shfrytëzimi i kapaciteteve të angazhuara krijon mundësinë e afarizmit të suksesshëm të hotelierit por edhe të vetë agjencisë turistike.

917.1. Paragrafi 1, parashih se me kontratën për alotmanin mund të parashihet detyrimi i veçantë i agjencisë turistike për t'i plotësuar kapacitetet e angazhuara të hotelierisë. Në këtë rast, agjencia turistike ka detyrim që pa marrë parasysh rrethanat për shkak se vetë është obliguar duke u pajtuar për këtë të bëjë plotësimin e kapaciteteve të angazhuara të hotelierisë dhe nëse ato nuk plotësohen nga ana e agjencisë turistike për hotelierin konsiderohen të plotësuara. Kjo kontratë për alotmanin zakonisht quhet “kontratë për alotmanin me garancion” që do të thotë se është e sigurt se do të paguhet çdo shtrat i rezervuar.

917.2. Paragrafi 2, përcakton se kur agjencionin turistik nuk arrin t'i plotësojë kapacitetet e angazhuara të hotelierisë atëherë ai ka për detyrë t'ia paguajë hotelierit shpërblimin për çdo shtrat të pashfrytëzuar dhe për çdo ditë. Kjo nuk konsiderohet shpërblim i demit në mënyrë klasike sepse kjo është çështje e kontraktuar dhe palët janë marrë vesh që të kenë siguri të plotë lidhur me kapacitetet e angazhuara të hotelierisë. Kjo dispozitë, e favorizon hotelierin por me siguri edhe çmimi kontraktues për shkak të kësaj klauzole⁷⁶⁹ është më i

.....
769 Te kontratat turistike kjo klauzole quhet “E plotë për të zbrazët” që do të thotë edhe nëse nuk plotësohet konsiderohet se është shfrytëzuar shtrati i kontraktuar.

ulët në raport me rastet tjera. Kur kontrahetohet detyrimi i agjencisë turistike që të paguajë hotelierit për çdo shtrat të pashfrytëzuar dhe për çdo ditë përjashtohet edhe mundësia e heqjes dorë nga kontrata pjesërisht ose tërësisht nga ana e agjencisë turistike. Sepse nuk prodhon efekt njoftimi për heqjen dorë. Në rastin kur agjencioni turistik për shkak të mos përmbushjes së kapaciteteve të angazhuara të hotelierisë duhet të paguajë çdo shtrat të rezervuar dhe për çdo ditë, kjo nuk i jep të drejtë hotelierit që mos të bëjë përpjekje që ai të sigurojë plotësimin e kapaciteteve të kontraktuara nga agjencioni turistik dhe në këtë mënyrë dëmi i shkaktuar për hotelierin të jetë më i vogël. Pra, gjithmonë kërkohet ndërshtëmëria dhe ndërgjegjshmëria e palëve kontraktuese. Do të ishte e pandershme dhe e pandërgjegjshme që hotelieri edhe përkundër mundësive që vet t'i plotësojë kapacitetet e angazhuara dhe këtë nuk e bën për shkak se është i sigurtë se shpërblimi i shtretërve të angazhuar do të bëhet nga agjencioni turistik i cili ka rezervuar kapacitetet e angazhuara të strehimit. Agjencioni turistik, ka gjithmonë të drejtë edhe pse është bërë kontraktimi të thirret në parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë me qëllim të zvogëlimit të detyrimit ndaj hotelierit.

917.3. Paragrafi 3, parasheh se agjencioni turistik në rastet kur ka kontraktuar pagimin e shpërblimit për çdo shtrat të pashfrytëzuar dhe për çdo ditë për shkak të mos plotësimin të kapaciteteve të angazhuara të hotelierisë, ai nuk ka të drejtë që me anë të njoftimit të bërë në kohën e duhur t'a dënonojë të kërkojë zgjidhjen e kontratës pjesërisht ose tërësisht. Sipas këtij paragrafi, agjencisë turistike në këtë i mohohet e drejta që të denoncojë kontratën pjesërisht ose tërësisht edhe në rast se njoftimin për dënoncimin e kontratës e ka bërë në kohën e duhur.

Ruzhdi Berisha

Neni 918. Nocioni

Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguaj një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguaj të siguruarit (siguruesit)⁷⁷⁰ apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë ë diçka tjetër.

Vështrim i përgjithshëm.- Pjesa e XXIV e LMD i rregullon çështjet e sigurimit. Shikuar nga aspekti ekonomik, sigurimi është veprimtari ekonomike, në kuadër të së cilës u ofrohet siguria të gjithë të interesuarve, interesat pasurore ose integriteti trupor i të cilëve mund t'u rrezikohet me nga rreziqe të ndryshme. Kjo mbrojtje realizohet me lidhjen e kontratës së sigurimit dhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera juridike të nevojshme përkitazi me sigurimin. Në aspektin juridik, sigurimi është një marrëdhënie juridike që themelohet në bazë të kontratës ose ligjit, me të cilën detyrohet kontraktuesi i sigurimit që, në bazë të parimeve të reciprocitetit dhe solidaritetit, të paguajë shumën e caktuar (preminë e sigurimit) në shoqërinë e sigurimit (siguruesi), kurse kjo e fundit detyrohet që, në qoftë se ndodh ngjarja, që paraqet rast të siguruar, t'i paguajë siguruesit ose personit të tretë (shfrytëzuesit të sigurimit) shpërblimin (shumën e kontraktuar) ose të kryejë diçka tjetër për të (të riparojë sendin e dëmtuar, apo diçka ngjashëm).⁷⁷¹ Siç shihet nga kuptimi i dhënë më sipër për sigurimin, ai përfaqëson një marrëdhënie juridike me detyrime të dyanshme që përmban elemente të caktuara, siç janë: a) rreziku, b) interesi i sigurimit, c) rasti i siguruar, ç) shumta e sigurimit, d) premia e sigurimit dhe e) shpërblimi i sigurimit. Varësisht nga lloji i sigurimit, mund të ketë edhe elemente të tjera.

a) Rreziku nënkupton tërësinë e mundësive të paraqitjes së një ngjarjeje të ardhshme, e cila e rrezikon pasurinë ose personin (zjarri, vërshimet, përplasjet, dëmtimet trupore, vdekja etj.), nga paraqitja e së cilës do të shkaktohet dëm material ose dëmtim i integritetit trupor të ndonjë personi. Nga paraqitja apo mosparaqitja e kësaj ngjarjeje varet edhe detyrimi i siguruesit. Për të qenë i përshtatshëm për sigurim, duhet të jetë i mundshëm, i pasigurt, i pavarur nga vullneti i siguruesit dhe të siguruarit, të shkaktojë pasojat të dëmshme dhe të jetë i lejuar me ligj (nuk lejohet sigurimi nga pasojat e përgjegjësisë penale të ndonjë personi).

b) Interesi i sigurimit përfaqëson marrëdhënien ekonomike të siguruesit ndaj objektit të sigurimit, interes që të mos ndodhë rasti i siguruar.⁷⁷² Interesi i sigurimit duhet medoemos

770 Duke u nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore përkitazi me kuptimin e kontratës për sigurimin, në rreshtin e katërt të dispozitës është bërë gabim shtypi, ashtu që në vend të fjalës “të siguruarit”, gabimisht është shkruar fjala “siguruesit”. Në komentin e dhënë është përdorur shprehja adekuate që është dashur të përdorej në tekstin ligjor, “të siguruarit”.

771 Shih nocionin e dhënë për kontratën për sigurimin në nenin 918 të këtij Ligji.

772 Komentari ZOO II, “Savremena Administracija” Beograd, 1980, f. 434.

të ekzistojë te siguruesi apo shfrytëzuesi i sigurimit në momentin e paraqitjes së rastit të siguruar. Mbi një send mund të ketë më shumë interesa, kështu që me rastin e tjetërsimit të sendit të siguruar, interesi i sigurimit kalon te personi i cili e ka marrë sendin, bashkë me kontratën e sigurimit. Me pushimin e ekzistimit të interesit të sigurimit, pushon së ekzistuari edhe kontrata e sigurimit.

c) Rast i siguruar është ngjarja e paramenduar. Ajo është jo e sigurt. Me paraqitjen e kësaj ngjarjeje, lind detyrimi i siguruesit të paguajë shpërblimin nga sigurimi.

ç) Shuma e sigurimit është shuma e të hollave e parashikuar në kontratë ose në ligj, e cila përfaqëson shumën më të madhe të mundshme të shpërblimit nga sigurimi, që do të duhej t'i përgjigjej vlerës së objektit të sigurimit.

d) Premia e sigurimit është shuma e të hollave të cilën duhet ta paguajë kontraktuesi i sigurimit, pasi që ai është palë kontraktuese, brenda afatit të caktuar. Premia është element qenësor i kontratës për sigurimin, prandaj edhe është detyrim i kontraktuesit të sigurimit ta paguajë atë. Nuk ka sigurim pa pagesë. Shuma e premisë të sigurimit ndryshon, varësisht nga rasti i sigurimit dhe varet nga rreziku, shuma e sigurimit dhe zgjatja e sigurimit.

e) Shpërblimi i sigurimit është vlerë e caktuar, zakonisht një shumë e shprehur në para, për të cilën i detyrohet siguruesi t'i paguajë të siguruarit ose shfrytëzuesit të sigurimit në momentin e paraqitjes së rastit të sigurimit e që është sa sasia e shumës së siguruar në bazë të kontratës.

1. Në marrëdhënien juridike nga sigurimi si palë kontraktuese mund të paraqiten: 1. kontraktuesi i sigurimit, 2. siguruesi, 3. I siguruari dhe 4. shfrytëzuesi i sigurimit.

- Kontraktuesi i sigurimit është personi i cili, në emër të vetin, e lidh kontratën me siguruesin. Kontraktues i sigurimit mund të jetë çdo person me aftësi për të vepruar. Ai ka ndaj siguruesit të drejtat dhe detyrimet e veta, pavarësisht nga të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, si, p.sh., të paguajë preminë e sigurimit, në tërësi dhe me saktësi të plotë të paraqesë të gjitha rrethanat me rëndësi me rastin e lidhjes së kontratës etj. Çfarëdo lëshimi i kontraktuesit të sigurimit me rastin e lidhjes së kontratës, shkon në dëm të personit në favor të të cilit është lidhur sigurimi. Në rast të shkaktimit të dëmit nga marrëdhënia e sigurimit, në marrëdhënie kontraktuese janë siguruesi dhe i siguruari. Në shumicën e rasteve kontraktues i sigurimit dhe i siguruar është i njëjti person. Zakonisht i siguruari e lidh vetë kontratën për sigurimin dhe me atë e siguron interesin e vet. Ndodh që dikush të lidhë ë sigurimin në interes të personit të tretë. Në këto raste personi që lidh sigurimin është kontraktues i sigurimit, kurse personi në interes të cilit bëhet sigurimi është i siguruari.
- Siguruesi është personi i cili, me kontratën e sigurimit, detyrohet ndaj kontraktuesit të sigurimit se të siguruarit ose shfrytëzuesit të sigurimit do t'i paguajë shpërblimin e sigurimit, në rast të paraqitjes së rastit të sigurimit.
- I siguruari është palë nga kontrata për sigurimin, e cila ka të drejtë të kërkojë nga siguruesi shpërblimin për dëmin që ka pësuar apo shumën e siguruar në rast të paraqitjes

së rastit të siguruar. Në sigurimet e dëmeve i siguruar është personi që, pavarësisht nga fakti që mund të marrë shpërblimin e sigurimit, ka interes material që të mos paraqitet rasti i siguruar. Te sigurimet e jetës dhe sigurimet nga pasojat e fatkeqësive, i siguruari është personi për jetën e të cilit është lidhur sigurimi e mund t'i dedikohet edhe sigurimit të jetës së ndonjë personi të tretë. Në rastet kur i siguruari dhe kontraktuesi i sigurimit nuk janë personi i njëjtë, për vlefshmërinë e kontratës nevojitet pëlqimi me shkrim i të siguruarit për shumën e sigurimit.

- Shfrytëzues i sigurimit mund të jetë çdo person fizik dhe juridik, ndaj të cilit, në bazë të kontratës për sigurimin, siguruuesi ka detyrimin t'i paguajë shpërblimin e sigurimit apo në ndonjë mënyrë tjetër të përmbushë detyrimin e vet të kontraktuar. Shfrytëzuesi i sigurimit mund edhe të mos jetë palë kontraktuese, ai gjithmonë përfiton nga kontrata për sigurimin dhe dallimi ndërmjet tij dhe të siguruarit më së miri vërehet te kontratat për llogari të tjetrit. Në raste të tilla, si shfrytëzues i sigurimit caktohet personi i tretë, ndaj të cilit siguruuesi ka detyrimin t'ia paguajë shumën e sigurimit, gjë që dallon nga kontraktuesi i sigurimit.

Kontrata e sigurimit krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese dhe, si rregull, nuk prodhon efekte ndaj personave të tretë. Përfundimisht, kontrata e sigurimit prodhon efekte edhe ndaj personave të tretë në rastet kur është lidhur në favor të personave të tretë apo në rastet e tjetërsimit të sendit të siguruar si dhe në rastet e sigurimit të sendeve në lidhje me përdorimin e të cilave është lidhur kontrata sigurimit nga përgjegjësia.

2. Marrëdhënia e sigurimit themelohet në bazë të kontratës ose në bazë të ligjit. Pjesa e XXIV e LMD rregullon sigurimin e pasurisë dhe të personave në bazë të kontratës për sigurimin. Në nenin 918 të LMD është dhënë kuptimi i kontratës për sigurimin, sipas të cilit, në sistemin tonë juridik kontrata për sigurimin është e rregulluar me ligj. Kontrata për sigurimin e përcaktuar sipas këtij neni zbatohet në të gjitha llojet e sigurimeve, përveç sigurimeve të cilat vetë Ligji i përjashton nga zbatimi i këtyre dispozitave, si dhe sigurimet të cilat janë rregulluar me ligje të veçanta.⁷⁷³ Dispozitat e kësaj pjese të LMD zbatohen për të gjitha marrëdhëniet dhe institutet për të cilat ekzistojnë norma juridike specifike në këtë pjesë. Duke pasur parasysh faktin se normat juridike përkitazi me sigurimin të kësaj pjese të LMD janë pjesë e sistemit të përgjithshëm të së drejtës kontraktuese pasurore, për të gjitha çështjet për të cilat nuk ekziston norma specifike juridike në këtë pjesë të LMD (apo edhe në dispozita të tjera të veçanta për sigurimet), duhen zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës kontraktuese të përfshira në LMD si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga R. e Kosovës, që u përkasin sigurimeve.

3. Në bazë të kuptimit të dhënë në nenin 918 të LMD, me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit t'i paguajë shumën e caktuar shoqërisë së sigurimit - siguruësit. Ky detyrim i kontraktuesit të sigurimit bazohet mbi parimet e *reciprocitetit* dhe *solidaritetit*. Vetë marrëdhënia e sigurimit mbështetet në parimin e reciprocitetit. Personat të cilëve u kërcënohet rreziku i njëjtë, edhe pse ata paraprakisht nuk janë në kurrfarë lidhjeje juridike

773 Shih nenin 920 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

mes tare, nëpërmjet pagesës së premisë të sigurimit, i bashkojnë mjetet në shoqërinë e sigurimit, me qëllim që nga ato mjete t'i paguhet dëmi atij që është goditur nga rasti i siguruar. Këta persona, me bashkimin e mjeteve nëpërmjet të pagesës së premisë, evitojnë pasojat pa kriter të realizimit të rrezikut nëpërmjet shoqërisë së sigurimit. Parimi i solidaritetit gjën shprehje nëpërmjet pagesës së premisë në shoqërinë e sigurimit, duke treguar gatishmëri për shpërblimin e pasojave të dëmshme të të siguruarve të tjerë, pa prituri ndonjë kundërpagesë për këtë pjesëmarrje. Sipas kuptimit të dhënë për kontratën për sigurimin në këtë nen, shoqëria e sigurimit ka detyrimin, në qoftë se ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë të siguruarit a ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër.

Siç shihet, në këtë dispozitë ligjore janë paraqitur kuptimi dhe elementet qenësore të kontratës për sigurimin. Siç shihet nga kuptimi i dhënë, kontrata për sigurimin është një kontratë me detyrime të dyanshme: kontraktuesi i sigurimit, në emër të premisë, ka detyrimin të paguajë shumën e caktuar, ndërsa shoqëria e sigurimit, nëse ndodh ngjarja që paraqet rast të siguruar, të paguajë shpërblimin e kontraktuar. Ajo është kontratë konsensuale⁷⁷⁴, ngase për vlefshmërinë juridike të saj mjafton që palët kontraktuese të jenë pajtuar për elementet qenësore të kontratës. Kjo nënkupton se përmbushja e detyrimit nuk bën pjesë në aktin e lidhjes së kontratës konsensuale, por në realizimin e saj. Është kontratë aleatore, pasi që me rastin e kontraktimit nuk dihet vëllimi i të drejtave dhe detyrimeve, por varet nga e ardhmja.

Neni 919. Rasti i siguruar

- 1. Ngjarja, duke marrë parasysh se për cilën kontraktohet sigurimi (rasti i siguruar) duhet të jetë i ardhshëm, e pasigurt dhe e pavarur nga vullneti ekskluziv i kontraktuesve.**
- 2. Kontrata e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se në momentin e lidhjes së saj ka ndodhur rasti i siguruar, apo në qoftë se ky ka qenë në krijim e sipër, apo ka qenë e sigurt se do të vijë, ose po që se që atëherë ka pushuar mundësia që ai të ndodhë.**
- 3. Në qoftë se është kontraktuar, se me sigurimin do të përfshihet periudha e caktuar që vjen para lidhjes së kontratës, kontrata do të jetë nule vetëm në qoftë se në momentin e lidhjes së saj pala e interesuar e ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, përkatësisht se që atëherë është shuar mundësia që ai të ndodhë.**

Vështrim i përgjithshëm.- LMD, në nenin 919 par. 1, përcakton rregullat se çfarë duhet të jetë rasti i siguruar, duke dhënë në këtë mënyrë edhe kuptimin e tij. Nisur nga neni 918 i këtij Ligji, rasti i siguruar është ngjarja që përfaqëson rrezikun e realizuar, nga i cili i siguruari është siguruar. Derisa rreziku nga i cili bëhet sigurimi, nga një ngjarje jo e evidente, për të cilën nuk do të duhej të dihej, nëse do të ndodhte apo jo, rasti i siguruar nënkupton dhe

⁷⁷⁴ Shih nenin 15 të këtij Ligji dhe komentimin e dhënë lidhur me këtë nen, në komentimin për pjesën e përgjithshme të LMD.

përfaqëson rastin e realizuar. Rasti i siguruar është pasojë e rrezikut të siguruar, nga i cili shkaktohet, dhe që ka për pasojë, në rastet e sigurimit të pasurisë, zhdukjen apo dëmtimin e objektit të siguruar, ndërsa te sigurimi i personave, dëmtimin trupor ose vdekjen. Pra, rast i siguruar është vetëm ngjarja që është shkaktuar nga rreziku i siguruar, pasi që çdo ngjarje jo evidente, e cila ka për pasojë zhdukjen ose dëmtimin e objektit të siguruar, nuk është rast i siguruar. Kështu, në qoftë se kemi sigurimin e një objekti nga zjarri, i cili në këtë rast përfaqëson rrezikun e siguruar, në rast të dëmtimit të objektit nga vërshimet gjatë kohës sa ka zgjatur sigurimi nga zjarri, vërshimet në këtë rast nuk përfaqësojnë rrezikun e siguruar, prandaj shfrytëzuesi i sigurimit nuk do ta ketë të drejtën e shpërblimit të sigurimit. Siguruesi në këtë rast ka detyrimin vetëm për dëmin e shkaktuar nga zjarri. Rasti i siguruar parashikohet paraprakisht në kontratën për sigurimin ose me ligj të sigurimit ligjore. Me paraqitjen e tij lind detyrimi i siguruesit që t'ia shpërblejë të siguruarit dëmin e shkaktuar, përkatësisht t'ia paguajë shumën e kontraktuar te sigurimi i personave.

1. Sipas par. 1 të nenit 919 të këtij Ligji, ngjarja që paraqitet si pasojë e rrezikut përkitazi me të cilën kontraktohet sigurimi (rasti i siguruar)⁷⁷⁵ duhet të jetë: a) *e ardhshme*, b) *e pasigurt* dhe c) *e pavarur nga vullneti ekskluziv i kontraktuesve të sigurimit*.

Realizimi i rrezikut nëpërmjet paraqitjes së ngjarjes (rastit të siguruar) duhet patjetër të ketë ndodhur pas hyrjes në fuqi të kontratës për sigurimin, pasi që ngjarja, në momentin e sigurimit duhet medoemos të mos ketë ekzistuar dhe të jetë e ardhshme. Kërkesa që rasti i siguruar të jetë ngjarje e ardhshme nënkupton karakteristikën tjetër të kërkuar me ligj - që ai të jetë i pasigurt dhe jo evident. Për të qenë rasti i siguruar i përshtatshëm për sigurim, duhet patjetër realizimi i tij të jetë jo i sigurt, në mënyrë që, sipas rrjedhave normale të situatës, ai duhet të jetë ngjarje e jashtëzakonshme. Pasiguria e paraqitjes së rastit të sigurimit nënkupton pamundësinë që, në rrethana normale, paraprakisht të parashikohet nëse do të ndodhë ngjarja dhe kur do të ndodhë. Pasiguria e ndodhjes së ngjarjes nga rasti i sigurimit duhet të ekzistojë në momentin e lidhjes së kontratës. Për të qenë i përshtatshëm për sigurim, rasti i sigurimit nuk duhet të jetë i varur nga vullneti ekskluziv i palëve kontraktuese. Vullneti i kontraktuesve nuk duhet të jetë me ndikim në mundësinë e paraqitjes apo mosparaqitjes së rastit të siguruar.

2. Në par. 2 të nenit 919 të këtij Ligji parashikohen arsyet ligjore përkitazi me karakteristikat e dhëna në paragrafin e mëparshëm të këtij neni, për shkak të të cilave kontrata e sigurimit është e pavlefshme. Duke pasur parasysh faktin se rasti i siguruar duhet të jetë i ardhshëm, domethënë që ai të mos ketë ndodhur në momentin e lidhjes së kontratës për sigurimin; në rast të lidhjes së kontratës së sigurimit pasi ka ndodhur rasti i siguruar ose në qoftë se ai ka qenë në krijim e sipër, kontrata e sigurimit është e pavlefshme. Kontrata e sigurimit të objektit nga vërshimet është e pavlefshme në qoftë se ajo lidhet pasi është vërshuar objekti i siguruar ose pasi ai ka filluar të përmbijet. Parashtrimet e mësipërme rrjedhin nga

775 Me LMD si rasti i siguruar konsiderohet ngjarja që është pasojë e rrezikut nga i cili është kontraktuar sigurimi. Në këtë mënyrë, edhe ngjarjes i vishen karakteristikat që duhet t'i ketë rreziku nga i cili bëhet sigurimi.

.....

karakteristika e parashikuar ligjore për rastin e siguruar - që ai të jetë *i ardhshëm*. Në të njëjtën mënyrë kontrata e sigurimit është e pavlefshme në rast se vërtetohet se ka qenë e sigurt se do të ndodhë rasti i siguruar ose në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit ka pushuar mundësia që ai të ndodhë. Kjo rregull rrjedh nga karakteristika tjetër ligjore e rastit të sigurimit, sipas së cilës ai duhet të jetë *i pasigurt*.

3. Par. 3 i nenit 919 të LMD paraqet përjashtim nga rregulla e përgjithshme, sipas së cilës, kontrata e sigurimit lidhet për rreziqet që do të ndodhin në të ardhmen, duke llogaritur nga momenti i lidhjes së saj. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, lejohet mundësia të kontraktohet që sigurimi të përfshijë një periudhë të caktuar kohore para lidhjes së kontratës⁷⁷⁶. Një kontratë e këtillë do të anulohet vetëm në qoftë se vërtetohet se, në momentin e lidhjes së kontratës, pala e interesuar për lidhjen e saj ka ditur se rasti i siguruar tashmë ka ndodhur (kjo vlen për të siguruarin), përkatësisht se në kohën e lidhjes së saj është shuar mundësia që ai të ndodhë (kjo vlen për siguruesin). Kjo veçanërisht mund të ndodhë në rastet e sigurimit të transportit, atëherë kur transporti i sendeve zgjat për një kohë më të gjatë, në mënyrë që kontrata të lidhet pasi ka filluar transporti, kurse në periudhën kohore të sigurimit të përfshihet koha nga momenti i fillimit të transportit. Nga kjo mund të konstatohet se, sipas kësaj dispozite ligjore, *me sigurim mund të mbulohen edhe dëmet e shkaktuara para lidhjes së kontratës për sigurimin, me kusht që në momentin e lidhjes së kontratës, kontraktuesi i sigurimit dhe i siguruari nuk kanë ditur e as që kanë mundur të dinin se rasti i siguruar ka ndodhur*.

3(a). Sa i përket fatit të kontratës së sigurimit pas paraqitjes së rastit të siguruar, për afatin kohor deri në përfundim të saj, kjo varet nga ajo nëse rreziku është realizuar në tërësi apo vetëm pjesërisht, përkatësisht nëse objekti i siguruar është dëmtuar tërësisht apo është dëmtuar vetëm pjesërisht. Në rastet kur me paraqitjen e rastit të siguruar objekti i siguruar me kontratë është dëmtuar tërësisht, ashtu që më, si i tillë, nuk ekziston, me këtë edhe kontrata e sigurimit pushon dhe nuk do të ekzistojë më. Kjo do të ndodhë në rastet e sigurimit të detyrueshëm nga auto- përgjegjësia, atëherë kur dëmi në automjet llogaritet si dëm total, me këtë pushon edhe kontrata, ashtu që ajo më nuk prodhon efekte juridike për periudhën kohore që ka ngelur, deri në skadimin e saj. Përndryshe, në rast se objekti i siguruar, me paraqitjen e një rasti të siguruar, është dëmtuar vetëm pjesërisht, sigurimi do të vazhdojë për periudhën kohore të ngelur nga kontrata, kurse sa i përket shumës së sigurimit, ajo do të jetë deri në nivel të sigurimit të tërësishëm të objektit.⁷⁷⁷

3(b). Me paraqitjen e rastit të sigurimit, i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i sigurimit, ka të drejtën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar. Siguruesi mban përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ai rast i sigurimit. Për të realizuar shpërblimin e sigurimit, duhet provuar paraqitja e rastit të siguruar. Për të realizuar të drejtën e shpërblimit nga sigurimi

.....

776 Redaktimi gjuhësor i kësaj dispozite sjell paqartësi me fjalët: “periudha kohore që vjen para lidhjes së kontratës”. Fjala është për periudhën kohore të caktuar para lidhjes së kontratës, duke e llogaritur periudhën kohore të kaluar deri në momentin e lidhjes së saj, që nënkupton periudhën kohore të kaluar e jo të asaj që vjen.

777 Shih nenin 946 par. 6 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë dispozitë.

duhen provuar faktet vendimtare, të cilat arsyetojnë realizimin e kërkesës. Fakt vendimtar për realizimin e kësaj të drejte është paraqitja e rasti të siguruar. Barrën e të provuarit të paraqitjes së rasti të sigurimit e ka i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i sigurimit. Ai në këtë rast duhet të provojë: a) cilësinë e të siguruarit apo të shfrytëzuesit të sigurimit, b) se është paraqitur dhe realizuar rasti i siguruar, që nënkupton shkaktimin e dëmit gjatë periudhës kohore sa ka zgjatur sigurimi dhe c) vëllimin dhe sasinë e dëmit. Provimi i fakteve vendimtare bëhet me prezantimin e dokumentacionit të nevojshëm, varësisht nga rasti i siguruar, me qëllim që të provohen edhe rrethanat në të cilat ka ndodhur rasti, si, p. sh., për rastet në trafik kërkohet procesverbali policor ose aktgjykimi i gjykatës. Siguruesi nuk ka detyrimin të paguajë shpërblimin nga sigurimi derisa nuk i dorëzohen provat e nevojshme për vërtetimin e detyrimit të tij nga kontrata e sigurimit. Në rast kontesti lidhur me kërkesën për dëmshpërblim, vendos gjykata e rregullt ose ajo e arbitrazhit.

Neni 920. Përjashtimi i disa sigurimeve

- 1. Dispozitat e kësaj pjese nuk do të zbatohen në sigurimet e lundrimit, si dhe në sigurimet të tjera për të cilat zbatohen rregullat e sigurimit për lundrimin.**
- 2. Dispozitat e përmendura nuk do të zbatohen as në sigurimin e kërkesave, as në marrëdhëniet e risigurimit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Pjesa e XXIV e LMD përmban rregullat përkitazi me sigurimet. Dispozitat e kësaj pjese të Ligjit nuk zbatohen në të gjitha sigurimet. Neni 920 i LMD përcakton sigurimet në të cilat nuk do të zbatohen dispozitat e kësaj pjese të Ligjit. Në bazë të një parimi të përgjithshëm juridik, ligji special ka përparësi në zbatim ndaj ligjit të përgjithshëm (*lex specialis derogat legi gjenerali*). Ky parim i përgjithshëm i së drejtës gjen shprehje në të drejtën e sigurimit nëpërmjet kësaj dispozite ligjore, ashtu që te disa sigurime të parashikuara me këtë dispozitë ligjore nuk zbatohen dispozitat e kësaj pjese të Ligjit, pasi që ato janë të rregulluara ose me ligje të veçanta, ose për ato aplikohen rregulla të veçanta.

1. Sipas par. 1 të këtij neni, dispozitat nga pjesa e XXIV e LMD, me të cilat rregullohen sigurimet, nuk do të zbatohen te të ashtuquajturat sigurime të lundrimit dhe te sigurimet e tjera ndaj të cilave zbatohen rregullat e sigurimit për lundrimin. Kjo dispozitë ligjore është plotësisht e njëjtë me dispozitën ligjore të parashikuar nga neni 899 i LMD të ish-Federatës Jugosllave i vitit 1978. Si e tillë ekziston, edhe pse deri më tash në R. e Kosovës nuk ka ligje të veçanta me të cilat të jenë rregulluar sigurimet e lundrimit.⁷⁷⁸

778 Në Kodin Civil të R. së Shqipërisë, neni 1133 par. 2 parashikohet: “ Sigurimi në lundrimin detar rregullohet nga Kodi i Lundrimit Detar”. Plotësisht e njëjta dispozitë me atë të LMD ekziston në nenin 996 të LMD (ZOO) të Malit të Zi, ndërsa sigurimet e lundrimit janë të rregulluara me Kodin Detar (Pomorski Zakonik- 2004). Dispozitë e ngjashme me atë nga neni 920 të LMD ekziston edhe në LMD (Zakon o Obveznim Odnosima – 2005) të R. së Kroacisë, në nenin 923, ndërsa sigurimi i lundrimit detar është rregulluar me Kodin Detar - 2004.

2. Në par. 2 të këtij neni janë përcaktuar edhe dy lloje të tjera të sigurimeve, për të cilat nuk zbatohen dispozitat e LMD me të cilat janë rregulluar sigurimet dhe këto: a) *për sigurimin e kërkesave* dhe b) për *marrëdhëniet e risigurimit*.

Me kontratën e sigurimit detyrohet shoqëria e sigurimit t'i paguajë siguresit ose ndonjë personit të tretë shpërblimin e caktuar në kontratë, nëse ndodh ngjarja e cila paraqet rast të sigurimit. Përkitazi me kërkesat e ndryshme ekzistuese mes palëve, nuk zbatohen dispozitat përkitazi me sigurimet e parashikuara nga LMD. Përkitazi me kërkesat mes palëve nuk mund të qëndrojë ngjarja e cila paraqet rastin e siguruar. Sigurimi i kërkesave mund të bëhet vetëm nga të ashtuquajturat "rreziqe politike" dhe atyre "komerciale", që nënkupton rreziqet nga situatat e ndryshme politike dhe komerciale të krijuara në një vend. Realizimi i këtyre llojeve të sigurimit do të duhej të bëhet nga organizatat e specializuara të sigurimeve ose nga organizatat speciale qeveritare të themeluara enkas sipas rregullave të sigurimit, të cilat i përcaktojnë këto organizata.

Me LMD (par. 2 i nenit 920) përjashtohet zbatimi i dispozitave me të cilat rregullohen marrëdhëniet nga sigurimet edhe të marrëdhëniet nga risigurimet. Risigurimi paraqet një marrëdhënie juridike më vete. Kjo marrëdhënie juridike është e ndarë nga marrëdhënia juridike e sigurimit dhe nuk është e lidhur me të. Palë kontraktuese janë siguresi dhe risiguresi e jo edhe i siguruari dhe për themelimin e kësaj marrëdhënieje kërkohet një kontratë e re që dallon nga ajo për sigurimin. Duke pasur parasysh faktin se kontrata e risigurimit është një kontratë tjetër e re në krahasim me atë të sigurimit dhe se marrëdhëniet e rregulluara mes këtyre palëve nuk krijojnë marrëdhënie detyruese juridike edhe për të siguruarin, përjashtohet zbatimi i dispozitave të këtij Ligji përkitazi me sigurimet në marrëdhëniet e risigurimit.

Neni 921. Shmangia nga dispozitat e kësaj pjese

- 1. Me kontratë mund të shmanget vetëm nga ato dispozita të kësaj pjese, në të cilat kjo shmangie është lejuar shprehimisht, si dhe ato që u ofrojnë kontraktuesve mundësinë që të veprojnë siç dëshirojnë.**
- 2. Shmangia nga dispozitat e tjera, po qe se nuk është e ndaluar me këtë ose me ndonjë ligj tjetër, lejohet vetëm në qoftë se është në interesin e padyshtimtë të të siguarve.**

Vështrim i përgjithshëm.- Një nga parimet themelore të së drejtës së detyrimeve është autonomia e vullnetit.⁷⁷⁹ Sipas këtij parimi, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë që, në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre (*Parimi i disponimit të lirë*). Siç shihet nga parimet themelore, parashikohet liria e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e

⁷⁷⁹ Shih nenin 2 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin e pjesës së përgjithshme të LMD.

detyrimeve, e kufizuar me dispozitat urdhëruese të këtij Ligji, normalisht edhe me ato të rendit publik dhe dokeve të mira. Nga neni 921 të LMD rrjedh se dispozitat përkitazi me sigurimet janë të detyrueshme (kogente) për palët.

1. Në par. 1 të nenit 921 të LMD parashikohet karakteri detyrues (imperativ) i dispozitave të këtij Ligji, të cilat kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit. Sipas kësaj dispozite ligjore, në marrëdhëniet nga sigurimet të cilat zbatohen dispozitat e LMD, përjashtohet parimi i disponimit të lirë të palëve, përpos në rastet kur shmangia nga këto dispozita parashikohet shprehimisht me ligj. Kontraktuesit në rregullimin e marrëdhënieve me kontratën e sigurimit duhet t'u përmbahen dispozitave të pjesës së këtij Ligji për sigurimet. Në këtë aspekt, sipas kësaj dispozite ligjore, dispozitat e këtij Ligji, me të cilat rregullohen marrëdhëniet e sigurimeve, janë të karakterit detyrues. Shmangia nga këto dispozita, në bazë të parimit të përgjithshëm të së drejtës së detyrimeve për disponimin e lirë të palëve, lejohet vetëm për dy arsye: a) atëherë kur shmangia është e lejuar shprehimisht me dispozitën ligjore të kësaj pjese ose b) atëherë kur dispozita u ofron mundësinë kontraktuesve të veprojnë siç dëshirojnë, edhe ndryshe nga ajo që është përcaktuar me atë dispozitë. Me disa dispozita të kësaj pjese të Ligjit, si, p.sh. te dëmet e shkaktuara nga të metat e sendit të siguruar (neni 951) parashikohet përgjegjësia e sigurvecit për dëmin që rrjedh nga të metat e sendit të siguruar, *përveç nëse është rregulluar ndryshe*. Siç shihet, në këto dispozita mundësia e shmangies nga dispozita detyruese parashikohet shprehimisht me vetë atë dispozitë.⁷⁸⁰ Në rastet tjera, si, p.sh., te nënsigurimi (neni 957) apo te kalimi i kontratës mbi përfituesin e sendit të siguruar (neni 958 par. 1), u lejon kontraktuesve të kontraktjnë siç dëshirojnë dhe nëse nuk janë përcaktuar, do të vlejë rregulla e parashikuar me atë dispozitë ligjore.⁷⁸¹ Ose në rastin tjetër, përkitazi me kohëzgjatjen e sigurimit (neni 943), në par. 1 lejohet mundësia që kontraktuesit të rregullojnë kohëzgjatjen e kontratës së sigurimit, ndryshe nga ajo që është parashikuar me këtë dispozitë, kurse në par. 2 ofrohet mundësia, sipas dëshirës, të mos parashikohet dhe të rregullohet fare me kontratë kohëzgjatja e sigurimit.⁷⁸²

2. Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet mundësia e shmangies edhe nga dispozitate tjera ligjore, të cilat janë të karakterit detyrues, aty ku nuk parashikohet shprehimisht mundësia e shmangies ose ku dispozita nuk iu mundëson kontraktuesve të marrëdhënieve të sigurimit të veprojnë ndryshe. Derisa sipas par. 1 të këtij neni shmangia lejohej me vetë dispozitën ligjore e cila zbatohet, sipas dispozitës nga par. 2 i këtij Ligji, shmangia mund të bëhet edhe nga dispozitat e tjera ligjore të karakterit detyrues me dy kushte: a) shmangia të mos jetë e ndaluar me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër,⁷⁸³ b) shmangia nga dispozita me karakter detyrues të jetë në interesin e padyshimtë të të siguruarve.

780 Shih nenet 951 dhe 952 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna për këto dispozita ligjore.

781 Shih nenet 957 dhe 958 të këtij Ligji dhe komentet e dhëna lidhur me këto dispozita ligjore.

782 Shih nenin 943 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

783 Të pakta janë rastet në LMD kur shprehimisht ndalohet çfarëdo mundësie e shmangies nga dispozitat e tij, siç është rasti me nenin 941, ku është rregulluar përjashtimi i përgjegjësive së sigurvecit në rastin e paramendimit dhe të mashtrimit, ashtu që rregullimi ndryshe me kontratë nga kjo dispozitë, nuk ka efekt juridik. Siç shihet, shprehimisht përjashtohet shmangia me kontratë të sigurimit nga kjo dispozitë ligjore.

NËNKREU 2

LIDHJA E KONTRATËS

Neni 922. Kur është e lidhur kontrata

1. Kontrata për sigurimin është e lidhur kur kontraktuesit nënshkruajnë policën e sigurimit ose listën e mbulesës.⁷⁸⁴
2. Oferta me shkrim që i është bërë të siguruarit për lidhjen e kontratës për sigurimin detyron ofertuesin, në qoftë se ky nuk ka caktuar ndonjë afat më të shkurtër, për një kohë prej tetë ditësh nga data kur oferta t’i ketë arritur siguresit, e në qoftë se nevojitet kontrolli mjekësor, atëherë për një kohë prej tridhjetë ditësh.
3. Në qoftë se siguresi në këtë afat refuzon ofertën e cila nuk largohet nga kushtet në të cilat ai ushtron sigurimin e propozuar, do të konsiderohet se e ka pranuar ofertën dhe se kontrata është lidhur.
4. Në këtë rast kontrata quhet e lidhur kur oferta t’i ketë arritur siguresit.

Vështrim i përgjithshëm.- Përkitazi me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për palët nga kontrata për sigurimin, me rëndësi të veçantë është momenti kur konsiderohet se kontrata është e lidhur. Me ndikim të veçantë për përcaktimin e kësaj rrethane është forma e parashikuar ligjore për lidhjen e saj. Me këtë dispozitë ligjore janë rregulluar momenti kur konsiderohet se kontrata për sigurimin është e lidhur, forma e parashikuar ligjore për këtë kontratë, rëndësia e ofertës dhe afatet kohore, me kalimin e të cilave konsiderohet se kontrata për sigurimin është lidhur.

1. Shikuar në përgjithësi, në të drejtën e detyrimeve marrëdhënia juridike mes palëve krijohet nga momenti i lidhjes së kontratës. Në këtë mënyrë, edhe në momentin e lidhjes së kontratës për sigurimin themelohet marrëdhënia juridike detyruese e sigurimit. Për këtë arsye, në marrëdhëniet e ndërsjella të palëve nga kontrata e sigurimit është me rëndësi të veçantë momenti i përfundimit të saj, pasi që nga ai moment, zakonisht, lindin të drejtat dhe detyrimet për palët. Për të siguruarin lind detyrimi për pagimin e premisë të sigurimit, ndërsa për siguresin lind detyrimi për shpërblimin e dëmit, të cilin e pëson i siguruari nga rasti i siguruar. E drejta e shpërblimi të dëmit që del nga kontrata për sigurimin, në kuptim të nenit 922 të LMD, do të vlerësohet sipas kushteve të përgjithshme të sigurimit, të cilat kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës e jo në momentin e paraqitjes së rastit të sigurimit. Nëse do të duhej paguar apo jo shpërblimi për rastin e siguruar, varet nga ajo nëse shpërblimi është paraqitur gjatë kohës së sigurimit. Aq më tepër, në rastet kur në momentin e lidhjes së kontratës rasti i sigurimit ka ekzistuar, kontrata për sigurimin është nule. Për këto arsye, me

⁷⁸⁴ Për policën e sigurimit dhe për listën e mbulesës, në KCRSH (neni 1115) përdoret shprehja e përbashkët e vetme “dëshmia e sigurimit”, ashtu që edhe gjatë zbatimit të LMD për këto dy dokumente apo për ndonjë dokument tjetër të ngjashëm të sigurimit do të mund të përdorej kjo shprehje si shprehje adekuate për këto dokumente pa u përcaktuar cili është ai.

rëndësi është forma e parashikuar ligjore e shprehjes së vullnetit të palëve për lidhjen e kësaj kontrate, përkatësisht forma e parashikuar ligjore e kontratës për sigurimin.

Me par. 1 të këtij neni rregullohet momenti i lidhjes së kontratës për sigurimin dhe forma e saj. Përkitazi me formën e kontratës, në të drejtën e detyrimeve në përgjithësi vlen liria e formës së lidhjes së kontratës, ashtu që lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.⁷⁸⁵ Kjo rregull e përgjithshme e lirisë së formës nuk vlen për kontratën për sigurimin. Sipas par. 1 të këtij neni, *kontrata për sigurimin është e lidhur atëherë kur kontraktuesit e nënshkruajnë policën e sigurimit ose listën e mbulesës*. Nga kjo rrjedh se kontrata për sigurimin është kontratë konsesuale dh jo reale dhe se për të qenë ajo e vlefshme me ligj kërkohet forma e caktuar. Kontrata e sigurimit është e lidhur dhe prodhon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese nga momenti kur ato e nënshkruajnë policën e sigurimit ose listën e mbulesës, që do të thotë se nënshkrimi i policës ose mbulesës së sigurimit është forma detyruese ligjore e kontratës për sigurimin. Nga momenti i nënshkrimit të tyre, lindin shumë të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese, por edhe për persona të tretë, kur kjo është parashikuar në kontratë. Për këtë arsye, me ligj është përcaktuar edhe çka duhet të përmbajë polica e sigurimit dhe çfarë duhet të jetë pjesë përbërëse e policës së sigurimit.⁷⁸⁶

2. Par. 2 i nenit 922 të LMD rregullon detyrimin e paraqitësit të ofertës me shkrim të siguruarit për lidhjen e kontratës për sigurimin, brenda afateve të caktuara. Edhe për ofertën për të lidhur kontratën për sigurimin do të vlejnjë rregullat e përgjithshme të përcaktuara me këtë Ligj për lidhjen e çfarëdo kontrate tjetër. Në këtë mënyrë, ofertë për lidhjen e kontratës për sigurimin është propozimi i siguruesit për lidhjen e kontratës për sigurimin, e cila duhet të përmbajë të gjitha elementet thelbësore të kontratës së sigurimit, me pranimin e së cilës do të mund të lidhë ej kontrata.⁷⁸⁷ Sipas rregullave të përgjithshme për ofertën, ajo mund të jetë me gojë ose në formë të shkruar. Me këtë dispozitë ligjore është përcaktuar shprehimisht se detyrim për ofertuesin për lidhjen e kontratës për sigurimin paraqet vetëm oferta e bërë me shkrim, gjë që bën përjashtim nga rregullat e përgjithshme për ofertën, pasi që, si rregull, nuk kërkohet forma e shkruar, e cila nevojitet vetëm në rastet kur parashikohet me ligj.⁷⁸⁸ Në anën tjetër, duke pasur parasysh faktin se kontrata për sigurimin duhet lidhur në bazë të kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga siguruesi, të cilat nuk janë të përkufizuara në numrin e caktuar të personave e as në personin e caktuar, konsiderojmë se detyrim për ofertuesin për lidhjen e kësaj kontrate paraqet edhe oferta e përgjithshme, drejtuar një numri të pacaktuar të personave.⁷⁸⁹

785 Shih nenin 51 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të këtij Ligji.

786 Shih nenin 923 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen

787 Shih nenin 22 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

788 Shih nenin 27 të këtij Ligji.

789 Shih par. 3 të nenit 22 të LMD.

Sa u përket afateve brenda të cilave, duke e llogaritur nga data kur është bërë oferta, i ofertuari mund të kërkojë lidhjen e kontratës; me këtë dispozitë është konkretizuar rregulla e përgjithshme për ofertën, ashtu që janë përcaktuar afatet brenda të cilave oferta prodhon detyrime për ofertuesin për të lidhur kontratën e sigurimit. Në rastet kur në ofertë nuk është caktuar ndonjë afat më i shkurtër, afati i fundit brenda të cilit ofertuesi dëshiron të lidhë kontratën për sigurimin nëpërmjet ofertës së vet me shkrim, është 8 ditë, nga dita kur i siguruari e ka marrë ofertën. Në rastet e lidhjes së kontratës për sigurimin e jetës me kontrollë mjekësore afati është më së shumti 30 ditë. Siç shihet, ligji lejon mundësinë e caktimit në ofertë të afateve më të shkurtra nga ato që janë parashikuar me këtë dispozitë ligjore. Në qoftë se i siguruari e pranon brenda këtij afati ofertën dhe njoftimi për këtë i arrin ofertuesit, do të konsiderohet se kontrata për sigurimin është lidhur.

3. Dispozita ligjore e par. 3 të këtij neni përmban gabime gjuhësore, të cilat kanë bërë që në versionin në gjuhën shqipe të jetë e pakuptueshme. Sipas dispozitës ekzistuese rrjedh se ajo rregullon rastet kur ofertuesi, brenda afatit të parashikuar nga paragrafi paraprak i këtij neni, *e refuzon* ofertën. Dispozita e dhënë kësaj është e paqartë, e pakuptimtë dhe pa domethënie. Konsiderojmë se redaktimi gjuhësor i kësaj dispozite ligjore është i gabuar dhe se ajo rregullon rastet kur oferta për lidhjen e kontratës për sigurimin i paraqitet siguresit nga i siguruari. Kontrata për sigurimin, në parim, lidhet mbi baza të vullnetit të lirë të palëve. Në qoftë se një palë *e refuzon* ofertën, ai nuk mund të detyrohet dhe të lidhë kontratë kundër vullnetit të vet. Kjo dispozitë ligjore ka të bëjë me rastet kur, *brenda afateve të parashikuara nga par. 2 i këtij neni, siguruari nuk e refuzon (gabimisht është shkruar “refuzon”) ofertën e paraqitur nga i siguruari, e cila, sipas kushteve të propozuara, nuk dallon shumë nga ato kushtet sipas të cilave ai e ushtron sigurimin, do të konsiderohet se e ka pranuar ofertën dhe se kontrata është lidhur.*

Sipas kësaj dispozite ligjore, bëhet përjashtim nga rregulla e përgjithshme përkitazi me heshtjen e të ofertuari të parashikuar nga neni 30 par. 1 i këtij Ligji, sipas së cilës heshtja e të ofertuarit nuk nënkupton pranimin e ofertës. Përjashtimisht nga rregulla e përgjithshme, dispozita e par. 3 të këtij neni gjen zbatim vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara ligjore, të cilat janë: a) që personi i interesuar për lidhjen e kontratës t'i ketë dërguar siguresit ofertën me shkrim, b) që oferta e formës së shkruar që i përcillet siguresit të mos dallojë nga kushtet dhe rregullat në bazë të cilave ai bën sigurimin dhe c) që për kohën sa është heshtur, të ketë kaluar afati ligjor prej 8, përkatësisht 30 ditësh.

4. Paragrafi 4 rregullon momentin nga i cili do të konsiderohet se kontrata është lidhur në bazë të kushteve ligjore të parashikuara në par. 3 të këtij neni. Në këtë mënyrë, në rastet kur oferta i është paraqitur siguresit nga i siguruari e ai nuk e refuzon atë brenda afatit të caktuar ligjor prej 8, përkatësisht 30 ditësh, konsiderohet se kontrata është lidhur nga momenti kur oferta i ka arritur siguresit. Kjo rregull vlen në bazë të rregullave të përgjithshme të së drejtës kontraktuese.⁷⁹⁰

790 Shih nenin 30 par. 5 të LMD në të cilën bazohet rregulla e parashikuar në par. 4 të kësaj dispozite ligjore.

Nga praktika gjyqësore.

“Paditësja e ka siguruar automjetin te kompania e paditur e sigurimeve, sipas policës së sigurimeve KASKO, nga aksidenti dhe vjedhja, në lartësi të shumës së siguruar prej 17.000€, për periudhën prej 3.12.2003 deri më 2.12.2003. Më datën 16.02.2004 është vjedhur vetura. Tek organet e rendit publik vjedhja është paraqitur më 8.4.2004, në orën 16,00, kurse te kompania e paditur më 09.4.2004. Gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazë. Në kuptim të nenit 901 par. 1. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (sipas LMD në fuqi neni 922 – vër. e aut.) kontrata e sigurimeve është lidhur kur kontraktuesit e kanë nënshkruar policën e sigurimit, ndërsa, pjesë përbërëse e kontratës që parashikojnë kushtet e përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet e këtij lloji të sigurimeve, janë të shtypura në faqen e prapme të policës së sigurimit KASKO, e cila në kapitullin XII pika 1 parashikon se në rastin e vjedhjes apo grabitjes, lajmërimi apo denoncimi pranë organeve të rendit publik duhet të bëhet brenda 34 orëve, nga konstatimi i rastit të sigurimit. Në pikën 2 të këtij kapitulli parashikohet se kopja e dëshmisë së lajmërimit dhe denoncimit vihet në dispozicion te siguresit jo më vonë se 72 orë nga momenti i ndodhjes së ngjarjes dhe në pikën 3 është parashikuar që, në rast se i siguruari nuk i respekton afatet e mësipërme, atëherë siguresit i lihet e drejta të çlirohet nga detyrimet për shlyerjen e dëmit”.⁷⁹¹

Neni 923. Polica dhe lista e mbulesës

1. Në policë duhet të shkruhen palët kontraktuese, sendi i siguruar, respektivisht personi i siguruar, rreziku i përfshirë nga sigurimi, kohëzgjatja e sigurimit dhe periudha e depozitës, shuma e sigurimit ose se sigurimi është i pakufizuar, premia ose kontributi, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese.
2. Lista e mbulesës në të cilën është përshkruar pjesa esenciale e kontratës mundet të zëvendësojë përkohësisht policën e sigurimit.
3. Në qoftë se kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit nuk janë të shtypura në vet policën, siguruari është i detyruar ta paralajmërojë kontraktuesin e sigurimit se kushtet e tilla janë pjesë përbërëse të kontratës dhe t'i dorëzojë tekstin e tyre.
4. Zbatimi i detyrimeve nga paragrafi paraprak duhet të konstatohet në policë.
5. Në rastin e mospajtimit të ndonjë dispozite të kushteve të përgjithshme ose të veçanta dhe të ndonjë dispozite të policës do të aplikohet dispozita e policës, e në rastin e mospajtimit të ndonjë dispozite të shtypur në policë e të ndonjë dispozite të saj të dorëshkrimit, do të vihet në zbatim kjo e fundit.
6. Sipas marrëveshjes së kontraktuesve, polica mund të mbajë emrin e caktuar, të jetë sipas urdhrorit ose sipas prurësit.

791 Gjyk. Sup. e R. Kos. Rev. 154/2007 dt. 01.06.2010.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 923 i LMD rregullon policën e sigurimit dhe listën e mbulesës, duke parashikuar se çfarë duhet të përmbajë polica, cili është roli dhe rëndësia e listës së mbulesës si dhe çështjet me rëndësi përkitazi me kushtet e përgjithshme dhe atyre të veçanta të sigurimit. Sipas LMD, kontrata për sigurimin konsiderohej e lidhur atëherë kur kontraktuesit nënshkruajnë policën e sigurimit ose listën e mbulesës.⁷⁹² Kjo nënkupton se me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit zakonisht lëshohet një dokument. Dokumentet e këtilla zakonisht janë në formë të policës së sigurimit, listët së mbulesës e mund të ndodhë të jetë edhe ndonjë vërtetim për lidhjen e kontratës së sigurimit. Të gjitha këto ose ndonjë dokument tjetër i mundshëm, vërtetojnë lidhjen e kontratës, që do të thotë se, në radhë të parë polica ose ndonjë dokument tjetër, përfaqëson dokumentin në formën e shkruar për lidhjen e kontratës së sigurimit. Me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit zakonisht lëshohet polica e sigurimit. Kjo lëshohet pas përfundimit të kontratës, marrëveshjes së arritur lidhur me kushtet kontraktuese.

1. Në par. 1 të nenit 923 parashikohet çfarë duhet të përmbajë polica e sigurimit. Në policë të sigurimit duhen shënuar: palët kontraktuese (siguruesi dhe kontraktuesi i sigurimit), sendi i siguruar (nëse është fjala për sigurimin e pasurisë) apo personi i siguruar (nëse është fjala për sigurimin e personave), rreziku i përfshirë nga sigurimi (zjarri, vërshimet, aksidenti në trafik etj), afati i sigurimit dhe kohëzgjatja e depozitës, shuma e sigurimit ose konstatimi se sigurimi nuk është i kufizuar, premia e sigurimit, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese. Përpos këtyre të dhënave të rëndësishme të sipërhënuara, në policën e sigurimit mund të shënohen edhe elemente të tjera përbërëse të parëndësishme, si: emri i shfrytëzuesit të sigurimit, afatet për pagesën e premisë, dispozitën për vlerën e kontraktuar, dispozitën për bartjen e të drejtës që del nga kontrata në rast të tjetërsimit të sendit dhe të tjera.⁷⁹³ Konsiderojmë se polica është e vlefshme edhe kur nuk janë përfshirë në detaje të gjitha këto të dhëna. Do të mjaftonte që vetëm disa nga të dhënat kryesore të jenë shënuar në pika të shkurtra, kurse përkitazi me pjesët e tjera të ekzistojë konstatimi në policë se të dhënat e tjera janë përfshirë në kushtet e caktuara të sigurimit, që rregullohen në detaje. Një përfundim i këtillë rrjedh edhe nga par. 3 i këtij neni, sipas të cilit, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit janë pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit. Në këtë mënyrë, të drejtat dhe detyrimet e palëve, përpos me policën e sigurimit, përcaktohen edhe me kushtet e kontraktuara të sigurimit. Kushtet e kontraktuara të sigurimit kanë përparësi për gjithë atë që nuk është parashikuar në kontratë. Siç është përcaktuar me ligj, janë dy lloje të kushteve të sigurimit: a) të përgjithshme dhe b) të veçanta. Me kushtet e përgjithshme të sigurimit rregullohen çështjet e përbashkëta për disa lloje të ngjashme të sigurimit, siç janë kushtet e përgjithshme për sigurimin e pasurisë. Me kushtet e veçanta të sigurimeve rregullohen çështjet specifike lidhur me llojet e caktuara të sigurimeve, siç janë kushtet për sigurimin nga zjarri ose nga ndonjë rrezik tjetër i caktuar. Pra, siç ndodh më së shpeshti në praktikë, kontratën e sigurimit e përbëjnë: polica e sigurimit, kushtet e përgjithshme përkatëse dhe kushtet e veçanta përkatëse të sigurimit.⁷⁹⁴

792 Shih nenin 922 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë dispozitë.

793 Sipas nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, polica e sigurimit nga autopërgjegjësia duhet të jetë unike në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe përmbajtja dhe forma e saj përcaktohet nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

794 Shih Prof. dr. B. Blagojeviq dhe Prof. dr. Vrleta Krulj, Komentar ZOO II, "Savremena Administracia" 1980 Beograd, f. 451.

2. Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohen efekti dhe vlera e listës së mbulesës në mungesë të përkohshme të policës së sigurimit. Sipas kësaj dispozite ligjore, *lista e mbulesës është dokument i sigurimit, me të cilën përkohësisht zëvendësohet polica e sigurimit*. Si polica e sigurimit, ashtu edhe lista e mbulesës, duhet të nënshkruhen nga palët kontraktuese.⁷⁹⁵ Me nënshkrimin e saj nga ana e sigurvearit, si edhe te polica e sigurimit,, konsiderohet se kontrata është lidhur, me kusht që kontraktuesi tjetër i sigurimit vullnetin ta shprehë me ndonjë deklaratë tjetër të përcaktuar për këtë qëllim për palën tjetër.⁷⁹⁶ Lista e sigurimit zakonisht jepet me qëllim të sigurimit të palëve, në situata kur nuk dihen të gjitha elementet e kontratës së sigurimit. Ajo është me karakter të përkohshëm, zakonisht derisa nuk përcaktohen të gjitha të dhënat për përpilimin e policës së sigurimit ose derisa palët nuk merren vesh për ndonjë element të kontratës, për të cilin deri atëherë ka pasur mospajtime. Në këtë mënyrë, lista e mbulesës do ta zëvendësojë përkohësisht policën e sigurimit. Për të prodhuar efekte të këtilla juridike, lista e mbulesës duhet të përmbajë elementet esenciale të kontratës për sigurimin dhe të dhënat e tjera kryesore, të cilat i përmban polica, siç është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni. Me hartimin dhe paraqitjen e policës së sigurimit, lista e mbulesës e humb vlefshmërinë që ka pasur deri atëherë.

3. Par. 3 i nenit 923 të LMD rregullon detyrimet e sigurvearit në rastet kur kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit nuk i përmban polica e sigurimit. Kushtet e përgjithshme të sigurimit gjejnë zbatim në punët e sigurimit dhe përfaqësojnë detyrim për kontraktuesin tjetër të sigurimit me kusht që të plotësohen kushtet e parashikuara nga rregullat e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve dhe dispozitat e veçanta të së drejtës së sigurimeve. Rregull e përgjithshme është se kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese vetëm në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratave formale, ajo ka ditur për to ose është dashur patjetër të kenë qenë të njohura për të.⁷⁹⁷ Sa u përket dispozitave të veçanta të së drejtës së sigurimeve, konsiderohet se kushtet e sigurimit i janë të njohura palës e cila e pranon kontratën, nëse ato kanë qenë të shpallura në mënyrë të zakonshme ose i janë dorëzuar me rastin e lidhjes së kontratës. Me nënshkrimin e policës konsiderohet se është lidhur kontrata e sigurimit. Polica duhet t'i përmbajë kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta të sigurimit. *Sipas par. 3 të këtij neni, në rast se në policën e sigurimit nuk janë të shënuara kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit, sigurveari duhet patjetër ta paralajmërojë kontraktuesin e sigurimit⁷⁹⁸ me këto kushte janë pjesë përbërëse e kontratës dhe t'ia dorëzojë tekstin e tyre.*

4. Kontrata për sigurimin konsiderohet e lidhur me nënshkrimin e policës së sigurimit, e cila duhet t'i përmbajë kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta të sigurimit, përndryshe sigurveari i detyrimit *është i detyruar ta paralajmërojë kontraktuesin e sigurimit se ato janë*

795 Shih nenin 922 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

796 Shih nenin 57 par. 4 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

797 Shih nenin 124 par. 3 të LMD, sipas të cilit kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese, në rast se kanë qenë të njohura për të ose është dashur patjetër t'i njihje me rastin e lidhjes së kontratës.

798 Këtë detyrim e ka sigurveari vetëm ndaj kontraktuesit e jo edhe ndaj shfrytëzuesit të sigurimit, ngase ky i fundit nuk është palë kontraktuese.

pjesë përbërëse e kontratës dhe t'ia dorëzojë tekstin e tyre. Shikuar nga ky aspekt, me nënshkrimin e policës së sigurimit, kontraktuesi i sigurimit, në një anë, vërteton faktin se është i pajtimit për lidhjen e kontratës së sigurimit dhe, në anën tjetër, me nënshkrimin e vet vërteton faktin se nga siguruasi i ka pranuar edhe kushtet përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit. Për këtë arsye në par. 4 të LMD është përcaktuar se në policën e sigurimit duhet patjetër të konstatohet zbatimi i detyrimit nga par. paraprak i këtij neni, përkatësisht se siguruasi ia ka dorëzuar kontraktuesit të sigurimit kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit, të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin.

- Sipas par. 3 të këtij neni të LMD, siguruasi është i detyruar ta njoftojë kontraktuesin e sigurimit se kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta të sigurimit janë pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit dhe t'ia japë tekstin e tyre, nëse ato kushte nuk janë të shtypura në vetë policën e sigurimit, gjë që dëshmon se i padituri, si siguruasi, ka vepruar në bazë të kësaj dispozite ligjore. Në par. 4 të këtij neni është përcaktuar se përmbushja e detyrimit të përcaktuar në par. paraprak duhet patjetër të jetë i konstatuar në policë. Rrethana që polica në fjalë e sigurimit nuk e përmban një konstatim të këtyllë, nuk mund të ketë për pasojë mosaplikimin e tabelës së të paditurit për caktimin e përqindjes së invaliditetit të përhershëm nga rasti i fatkeqësisë.⁷⁹⁹

5. Në policën e sigurimit duhet të jenë të shtypura kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta të sigurimit, gjë që zakonisht edhe ndodh. Përfundimisht, në rast se ato në policë nuk janë shtypur, patjetër duhet të shënohet konstatimi se ato janë pjesë përbërëse e policës. Paragrafi 5 i këtij neni përcakton se çfarë duhet të zbatohet në rastet kur ndonjë dispozitë e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta nuk pajtohet me dispozitën përkatëse të policës dhe çfarë duhet zbatuar në rast të mospajtit të dispozitës së shtypur në policë dhe asaj përkatëse në dorëshkrim. Në rastin e parë, kur ka mospajtime të ndonjë dispozite të kushteve të përgjithshme apo të veçanta dhe ndonjë dispozite të policës, duhen zbatuar dispozitën që e përmban polica. Në rastin tjetër, në rast të mospajtit ndërmjet ndonjë dispozite të shtypur në policë dhe dispozitës përkatëse me dorëshkrim, do të zbatohet kjo e fundit.

*“Atëherë kur të siguruarit i janë dorëzuar kushtet e përgjithshme të sigurimit të cilat e përfshijnë shpërthimin nga eksplodimi, e nuk i është dorëzuar klauzola e veçantë, e cila e përjashton këtë sigurim, siguruasi ka detyrimin të paguajë shpërblimin e kontraktuar për dëmin nga eksplodimi”.*⁸⁰⁰

6. Në paragrafin e 6 të nenit 923 të LMD janë përcaktuar llojet e policës së sigurimit. Varësisht nga marrëveshja e palëve caktohet edhe lloji i policës, ashtu që në bazë të marrëveshjes mes palëve polica mund të jetë: a) në emër të personit të caktuar; b) sipas urdhrit; c) sipas prurësit. Në emër të personit të caktuar është polica e sigurimit në të cilën i siguruari është i përcaktuar me emër. Ajo gjen zbatim në të gjitha llojet e sigurimit. Te polica sipas urdhrit, i siguruari përcaktohet sipas urdhrit të siguruasit apo të kontraktuesit

799 Gjyk. Sup. e R.Kr. Rev. 9/04 dt. 27.01.2005.

800 Gjyk. Sup. e R.Kr. Rev-485/01 dt. 27.03.201.

të sigurimit. Gjen zbatim të siguresit e pasurisë dhe të sigurimet e jetës. Te policia sipas prurësit, i siguruari është personi që e sjell policën. Nuk mund të gjejë zbatim të sigurimet e jetës, pasi që i siguruari nuk mund ta sjellë. Aplikohet të sigurimi i pasurisë.

Neni 924. Sigurimi pa policë

Me kushtet e sigurimit mund të parashikohen rastet nën të cilat marrëdhënia kontraktuese nga sigurimi krijohet nga vetë pagimi i premisë.

Si rregull, kontrata për sigurimin është e lidhur kur kontraktuesit nënshkruajnë policën e sigurimit apo listën e mbulesë.⁸⁰¹ Kjo nënkupton se, sipas rregullit të përgjithshëm, në këtë mënyrë krijohet edhe marrëdhënia e sigurimit. Nga kjo rregull e përgjithshme parashikohet një përjashtim me dispozitën e nenit 924 të këtij Ligji, me të cilin është rregulluar sigurimi pa policë. Me këtë dispozitë lejohet që marrëdhënia e sigurimit, në raste të caktuara, kur asisoj parashikohet me kushtet e sigurimit, themelohet vetëm me faktin e pagesës së premisë të sigurimit, pa nënshkrimin dhe pa dhënien e policës së sigurimit. Kjo rregull bën përjashtim edhe nga natyra formale e kontratës së sigurimit. Derisa kontrata e sigurimit është kontratë formale, me këtë formë të sigurimit përjashtohet forma e kësaj kontrate, pasi që marrëdhënia e sigurimit themelohet pa lidhjen e ndonjë kontrate formale, me vetë faktin e pagesës së premisë të sigurimit. Forma e këtillë e themelimit të marrëdhënies së sigurimit duhet të jetë e parashikuar me kushtet e sigurimit. Raste të këtilla paraqiten kur bëhet sigurimi i jetës gjatë udhëtimit me mjete të caktuara transporti, në rastet kur premia paguhet bashkë me biletën e udhëtimit. Për t'u krijuar marrëdhënia e sigurimit, duhen plotësuar këto kushte: a) me kushtet e përgjithshme duhet të jetë e parashikuar kjo mënyrë e sigurimit, me pagesën e premisë të sigurimit, b) kontraktuesi i sigurimit duhet patjetër të paguajë preminë për sigurimin përkatës.

Neni 925. Lidhja e kontratës në emër të tjetrit pa autorizim

- 1. Kush lidh kontratën e sigurimit në emër të tjetrit pa autorizim të tij i përgjigjet siguresit për detyrimet nga kontrata, gjersa ky në emër të të cilit është lidhur kontrata të mos e miratojë.**
 - 2. I interesuari mund të lejojë kontratën edhe pasi të ketë ndodhur rasti i siguar.**
 - 3. Në qoftë se pëlqimi është refuzuar, kontraktuesi i sigurimit ka borxh preminë për periudhën e sigurimit në të cilën siguresi është njoftuar për refuzimin e pëlqimit.**
 - 4. Punëdrejtuesi pa porosi, i cili e ka njoftuar siguresin se paraqitet pa autorizim në emër dhe për llogari të tjetrit nuk përgjigjet për detyrimet nga sigurimi.**
-

801 Shih par. 1 të nenit 922 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë dispozitë ligjore.

Vështrim i përgjithshëm.- Rregull e përgjithshme është që, në bazë të autorizimit, të ndërmerren punët e ndryshme juridike në emër të tjetrit. Neni 925 i LMD rregullon rastet e lidhjes së kontratës së sigurimit në emër të tjetrit, pa pasur autorizim nga ai për këtë punë juridike. Në punët juridike në përgjithësi, ka raste kur një person lidh kontratë në emër të tjetrit, pa pasur autorizim për këtë. Kjo mund të ndodhë edhe në punët juridike të sigurimit. Në jetën praktike kjo zakonisht ndodh në rastet kur një palë, edhe pse në aspektin formal nuk ka autorizim, me lidhjen e kontratës në emër të tjetrit, ka për qëllim mbrojtjen e interesave të tij. Kjo mund të ndodhë, p.sh., në rastet kur transportuesi, edhe pse nuk ka autorizim ta sigurojë dërgesën, me qëllim të mbrojtjes së interesave të dorëzuesit të dërgesës, në momentin kur e ka parë të arsyeshme këtë, e bën sigurimin e saj. Një veprim i këtillë paraqet kryerjen e punëve juridike të sigurimit pa porosi. Në këtë mënyrë, përkitazi me çështjet të cilat me këtë nen veçanërisht nuk janë rregulluar, edhe lidhur me kontratën e sigurimit të lidhur pa autorizim në emër të tjetrit do të vlejnjë rregullat e përgjithshme për kryerjen e punëve të huaja pa porosi.⁸⁰² Me këtë nen janë parashikuar edhe pasojat juridike të lidhjes së kontratës në emër të tjetrit pa autorizim.

1. Sipas rregullës parimore të përgjithshme nga marrëdhëniet e kontraktuese, kontrata e lidhur nga personi i paautorizuar, krijon detyrime për personin në emër të cilit është lidhur kontrata, vetëm nëse ai më vonë e pranon kontratën si të veten.⁸⁰³ I njëjti parim vlen edhe për kontratat e sigurimeve. Në par. 1 të nenit 925 të këtij Ligji shprehimisht parashikohet se ai që e lidh kontratën e sigurimit në emër të tjetrit pa autorizim, mban përgjegjësinë ndaj siguresit për detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Duke pasur parasysh faktin se kontraktuesi e ndërmerr këtë veprim me qëllim të mbrojtjes së interesave të personit në emër të cilit e lidh kontratën, ai, si rregull, më vonë e miraton atë kontratë. Sipas kësaj dispozite ligjore, kontraktuesi pa autorizim është përgjegjës derisa shfrytëzuesi i sigurimit nuk e miraton atë kontratë.

2. Miratimi i kontratës nga personi në emër të cilit është lidhur kontrata, zakonisht bëhet para se të ndodhë rasti i siguruar. Në par. 2 të këtij neni shprehimisht është parashikuar se personi në emër të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, mund ta miratojë kontratën edhe pasi të ketë ndodhur rasti i sigurimit. Sipas praktikës gjyqësore, do të konsiderohet se e ka pranuar dhe lejuar lidhjen e kontratës, për të cilën nuk e ka dhënë paraprakisht autorizimin, në rast se ia paraqet kërkesën siguresit për pagesën e shpërblimit kundrejt sigurimit pa autorizim. Sidoqoftë, kontraktuesi i sigurimit në emër të tjetrit pa autorizim ka përgjegjësi ndaj siguresit, si palë tjetër kontraktuese, për pagesën e premisë dhe detyrimeve të tjera që dalin nga kontrata, derisa ai nuk e miraton atë kontratë. Duke pasur parasysh se në këtë rast është fjala për ndërmarrjen e punëve të huaja pa autorizim me kontratë sigurimi, pasi me këtë nen nuk janë rregulluar detaje të tjera, gjejnë zbatim rregullat e përgjithshme lidhur me kryerjen e punëve të huaja pa porosi, ashtu që, në qoftë se personi që e ka lidhur kontratën për sigurimin, ka vepruar ashtu si duhet dhe ashtu siç kanë kërkuar rrethanat e rastit, ai ka të drejtë të kërkojë

802 Shih nenin 203 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

803 Shih nenin 76 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

nga personi, në emër të cili është lidhur kontrata, t'i marrë përsipër të gjitha detyrimet që dalin nga kontrata e lidhur në emër të tij dhe t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet që kanë qenë të nevojshme dhe të dobishme, duke përfshirë edhe preminë e sigurimit.⁸⁰⁴

3. Redaktimi gjuhësor i par. 3 të nenit 925 të LMD në versionin në gjuhën shqipe, po ashtu, e bën këtë dispozitë të paqartë dhe të pakuptueshme. Me këtë dispozitë ligjore rregullohet detyrimi për pagesën e premisë në situatat kur personi në emër të cilit është lidhur kontrata pa autorizim, refuzon miratimin e kontratës. Nga dispozita, ashtu siç është paraqitur, nuk mund të kuptohet për cilën periudhë kohore ka detyrimin të paguajë preminë kontraktuesi i sigurimit në rastet kur refuzohet miratimi i kontratës. Me të mësuar për refuzimin e miratimit të kontratës, me qëllim të ndërprerjes së rrjedhës së detyrimeve të mëtejshme të tij si palë kontraktuese, kontraktuesi i sigurimit doemos e njofton për këtë rrethanë siguruesin. Për periudhën nga dita e kontraktimit deri në momentin kur e njofton siguruesin se personi në emër të cilit është lidhur kontrata refuzon ta miratojë atë, kontraktuesi i detyrimit ka detyrimin ta paguajë preminë, kurse nga dita e njoftimit ai lirohet nga detyrimi ndaj siguruesit për pagimin e premisë për periudhën e ardhshme deri në përfundim të afatit të sigurimit. Në këtë aspekt, po të shikohet kjo dispozitë në lidhje me paragrafët e tjerë të këtij neni, dhe duke krahasuar me dispozitën përkatëse të ligjeve të shteteve të tjera të rajonit, redaktimi më i përshtatshëm dhe kuptimplotë do të ishte: *Në qoftë se miratimi (dhënia e pëlqimit) është refuzuar, kontraktuesi i sigurimit ka detyrimin të paguajë preminë për periudhën kohore deri në ditën kur e ka njoftuar siguruesin për refuzimin e miratimit.*

4. Me rastin e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk ka mundësi dhe as ka nevojë të interesohet dhe të pyesë nëse kontraktuesi i sigurimit ka autorizim apo jo për lidhjen e kontratës. Në këtë aspekt, rregullat që dalin nga paragrafët e sipërm të këtij neni kanë të bëjnë me rastet k, në momentin e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk ka ditur për faktin se kontraktuesi i sigurimit nuk ka autorizim nga personi në emër të cilit lidhet kontrata. Par. 4 i nenit 925 të LMD rregullon situatat kur punëdrejtuesi pa porosi e ka njoftuar siguruesin se po paraqitet në emër dhe për llogari të tjetrit pa autorizim. Në lidhje me rregullën e par. 3 të këtij neni, sipas par 4, punëdrejtuesi pa porosi, i cili e ka njoftuar siguruesin se paraqitet pa autorizim në emër dhe për llogari të tjetrit, nuk përgjigjet për detyrimet që dalin nga sigurimi.

Neni 926. Sigurimi për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket

1. Në rastin e sigurimit për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket, detyrimet e pagimit të premisë dhe detyrimet e tjera nga kontrata ka për detyrë t'i zbatojë kontraktuesi i sigurimit, por ky nuk mund të ushtrojë të drejtat nga sigurimi as edhe kur mban policën pa pëlqimin e personit, interesi i të cilit është siguruar dhe të cilit ato i përkasin.

.....
804 Shih nenin 206 të këtij Ligji dhe komentën lidhur me këtë nen në komentën e dhënë për pjesën e përgjithshme të LMD.

2. Kontraktuesi i sigurimit nuk ka për detyrë t'i dorëzojë policën personit të interesuar gjersa të mos i shpërblehen premitë që i ka paguar siguruesit, si dhe shpenzimet e kontratës.
3. Kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë arkëtimi prioritar të këtyre kërkesave nga shpërblimi që është borxh, si dhe të drejtën për të kërkuar pagimin e tyre të drejtpërdrejt nga siguruesi.
4. Siguruesi mund t'i paraqesë secilit shfrytëzues të sigurimit për llogarinë e huaj të gjitha kundërshtimet, të cilat në bazë të kontratës i ka ndaj kontraktuesit të sigurimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Si çdo kontratë tjetër, edhe kontrata për sigurimin mund të lidhet personalisht ose nëpërmjet të autorizuarit. Në rastet kur kontrata lidhet nëpërmjet të autorizuarit, ajo është lidhur në emër të tjetrit (të autorizuesit) dhe për llogari të tij. Për dallim nga ato kontrata, neni 926 i LMD rregullon marrëdhëniet juridike të krijuara me sigurimin për llogari të huaj dhe për llogari të cilit i përket. Kontraktuesi i sigurimit, në cilësinë e palës kontraktuese, mund të lidhë kontratë për llogari të veten apo për llogari të huaj. Nga kjo varet edhe kush do të jetë shfrytëzues i sigurimit. Nëse kontraktuesi i sigurimit e lidh kontratën në emër dhe për llogari të veten, ai njëherësh është edhe shfrytëzues i sigurimit. Në situatat kur kontraktuesi i sigurimit e lidh kontratën qoftë vetë, qoftë nëpërmjet të autorizuarit, për llogari të tjetrit, shfrytëzues i sigurimit është personi tjetër. Personi në llogari të cilit lidhet kontrata mund të jetë i përcaktuar ose i papërcaktuar. Varësisht nga kjo, sipas kësaj dispozite ligjore, dallojmë dy lloje kontratash të sigurimit të lidhura për llogari të personit tjetër: a) për llogari të personit të tretë të përcaktuar (sigurimi për llogari të huaj) dhe b) për llogari të personit të papërcaktuar (sigurimi për llogari të personit të cilit i përket).

Zakonisht, te kontratat e sigurimit paraqiten si palë kontraktuese siguruesi dhe kontraktuesi i sigurimit, me të drejta dhe detyrime të ndërsjella. *Sigurimi për llogari të huaj* nënkupton kontratën e sigurimit të cilën e lidh një person në emër të vetin e për llogari të një personi tjetër. Në këtë mënyrë, te këto kontrata ndaj siguruesit paraqiten dy persona me të drejta dhe detyrime të veçanta, të cilët janë: *kontraktuesi i sigurimit* -personi që e ka lidhur kontratën në emër të vet dhe *shfrytëzuesi i sigurimit* - personi për llogari të cilit është lidhur kontrata. *Sigurimi për llogari të cilit i përket* nënkupton sigurimin tek i cili kontraktuesi i sigurimit e ka lidhur kontratën me siguruesin për llogari të personit të tretë që nuk është i përcaktuar me kontratë, por mund të përcaktohet më vonë. Edhe te kjo kontratë paraqiten tre persona: a) *Siguruesi* – me lidhjen e kontratës për llogari të cilit i përket, merr për detyrim të paguajë shumën e kontraktuar, nëse ndodh rasti i siguruar; b) *kontraktuesi i sigurimit* – me lidhjen e kontratës, merr përsipër detyrimin të paguajë preminë e sigurimit dhe detyrimet e tjera eventuale që mund të paraqiten në bazë të kontratës; c) *shfrytëzuesi i sigurimit* – personi i tretë i cili ka të drejta që dalin nga kontrata, nuk është i përcaktuar, por mund të përcaktohet.

Kontrata për llogari të tjetrit dhe ajo për llogari të të cilit i përket, posaçërisht paraqiten te transporti i mallrave. Gjatë zgjatjes së udhëtimit dhe sigurimit për sa zgjat udhëtimi, shpesh

ndodh të ndërrohet bartësi i rreziku për objektin e siguruar, pasi rastis që malli edhe gjatë transportit të bëhet objekt i transaksioneve të ndryshme, pra edhe pronë e pronarëve të ndryshëm. Në këtë mënyrë, në momentin e lidhjes së kontratës, zakonisht nuk dihet se cili person do të ketë interesin e sigurimit në momentin e paraqitjes së rastit të sigurimit. Për këtë arsye në policën e sigurimit medoemos duhet shënuar nëse është fjala për sigurimin për llogari të personit të tretë apo për sigurimin për llogari të personit të cilit i përket. Kjo është me rëndësi, pasi përmbajtja e kontratës për sigurimin mund të provohet jo vetëm nga të dhënat në policën e sigurimit, por edhe me mjete të tjera provuese.⁸⁰⁵

Me kontratën e sigurimit për llogari të tjetrit dhe atë për llogari të personit të cilit i përket krijohen marrëdhënie juridike ndërmjet personave që paraqiten si palë kontraktuese dhe atyre për llogari të cilëve lidhet kontrata apo për llogari të cilit i përket. Në këtë mënyrë krijohen: a) *marrëdhënia juridike ndërmjet kontraktuesit të sigurimit dhe të siguruarit*; b) *marrëdhënia juridike mes siguruesit dhe shfrytëzuesit të sigurimit – të siguruarit dhe* c) *marrëdhënia juridike ndërmjet kontraktuesit të sigurimit dhe shfrytëzuesit të sigurimit.*

1. Nisur nga krijimi i marrëdhënieve juridike ndërmjet personave të përfshirë në kontratën e sigurimit për llogari të huaj dhe atë për llogari të cilit i përket, në par. 1 të nenit 926 parashikohen shprehimisht detyrimet e kontraktuesit të sigurimit dhe mundësia e tij për realizimin e të drejtave që dalin nga sigurimi. Sipas kësaj dispozite ligjore, kontraktuesi i sigurimit për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket, ka detyrimin të paguajë preminë si dhe t'i përmbushë detyrimet e tjera që dalin nga kontrata. Se cilat janë detyrimet e tjera që dalin nga kontrata varet nga marrëdhënia e krijuar për çdo rast konkret të sigurimit, si, p. sh., detyrimi i paraqitjes së rrethanave me rëndësi me rastin e lidhjes së kontratës,⁸⁰⁶ lajmërimi i rrezikut të shtuar,⁸⁰⁷ detyrimi i paraqitjes së rastit të sigurimit⁸⁰⁸ e të tjera. Në bazë të këtyre llojeve të kontratave, e drejta që del nga sigurimi i takon të siguruarit, i cili është personi për llogari të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, ashtu që, sipas par. 1 të këtij neni, kontraktuesi i sigurimit nuk mund t'i realizojë të drejtat që dalin nga sigurimi, as kur e mban policën, pa pëlqimin e personit interesi i të cilit është siguruar dhe të cilit ato i përkasin. Në këtë aspekt, në rast të sigurimit për llogari të huaj, kontraktuesi i sigurimit nuk e ka legjitimitetin aktiv për të kërkuar pagimin e shpërblimit që del nga sigurimi, pa pëlqimin e të siguruarit. Në rast se i është dhënë pëlqimi, kontraktuesi i sigurimit do të paraqitet si i autorizuar i të siguruarit dhe jo si palë kontraktuese.

2. Nga sigurimi për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket krijohet një marrëdhënie juridike e veçantë ndërmjet kontraktuesit të sigurimit dhe shfrytëzuesit të sigurimit. Marrëdhënia juridike mes tyre zakonisht mbështetet në ndonjë marrëdhënie tjetër juridike, e cila i ka paraprirë lidhjes së kontratës së sigurimit, si, p.sh., kontrata për transport (neni 662), kontrata për depozitën (neni 726) etj. Marrëdhëniet mes kontraktuesit të sigurimit

805 Gjyk. Sup. e Kr. Rev. 1074/87 datë 18.05.1988.

806 Shih nenin 928 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

807 Shih nenin 935 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen,

808 Shih nenin 938 të këtij Lidhi dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

dhe shfrytëzuesit të sigurimit nuk janë të rregulluara me kontratë. Sipas par. 2 të këtij neni, kontraktuesi i sigurimit nuk ka detyrimin ta dorëzojë dhe ta japë policën e sigurimit, derisa nuk i kompensohet premia të cilën ia ka paguar sigurveit dhe shpenzimet e kontratës. Siç shihet, me këtë dispozitë ligjore mbrohet sigurvei për pagesën e premisë dhe shpenzimeve për lidhjen e kontratës me mbajtjen e policës së sigurimit.

3. Në kontratat e sigurimit për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket, shfrytëzuesi i sigurimit nuk është palë kontraktuese. Për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket sigurohet interesi dhe për këtë arsye vetëm shfrytëzuesi i sigurimit ka të drejtë të kërkojë nga sigurvei shpërblimin që del nga sigurimi. Kontraktuesi i sigurimit, si palë kontraktuese, e ka paguar preminë dhe eventualisht shpenzimet e tjera lidhur me sigurimin. Mbi këtë bazë, sipas par. 3 të nenit 926 të këtij Ligji, kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë që paraprakisht të bëjë pagesën e një borxhit të këfillë në emër të pagesës së premisë dhe shpenzimeve të tjera lidhur me sigurimin. Njëherësh ai ka të drejtë të kërkojë pagesën e borxhit drejtpërdrejt nga sigurvei.

4. Në bazë të kontratës për sigurimin, sigurvei i sigurimit ka të drejtë të paraqesë kundërshtime ndaj kontraktuesit të sigurimit, ngase ata janë palë kontraktuese. Në bazë të parimit të përgjithshëm të drejtës së detyrimeve, me ndryshimin e subjektit në anën e debitorit, kreditori nuk mund të sillet në pozitë më të pafavorshme. Nisur nga ky parim, sipas par. 4 të nenit 926 të LMD, sigurvei mund t'i paraqesë secilit shfrytëzues të sigurimit për llogari të huaj të gjitha kundërshtimet të cilat, në bazë të kontratës ka të drejtë t'i paraqesë ndaj kontraktuesit të sigurimit. Nga kundërshtimet të cilat sigurvei ka të drejtë t'i ngrejë ndaj kontraktuesit të sigurimit, mund të jenë: se nuk është paguar premia e sigurimit, se nuk është njoftuar nga kontraktuesi për rrethanat me rëndësi për vlerësimin e rrezikut, se për dëmin e shkaktuar është fajtor kontraktuesi i sigurimit e të ngjashme.

Neni 927. Përfaqësuesi i sigurimit

- 1. Kur sigurvei autorizon ndokënd që ta përfaqësojë, ndërsa nuk cakton vëllimin e autorizimeve të tij, përfaqësuesi është i autorizuar që në emër dhe për llogari të sigurveit të lidhë ë kontrata për sigurimin, të kontraktojë ndryshimet e kontratës ose zgjatjen e afatit të tyre, të lëshojë policë sigurimi, të arkëtojë premitë dhe të pranojë deklarata të drejtuara sigurveit.**
- 2. Në qoftë se sigurvei i ka kufizuar autorizimet e përfaqësuesit të vet, ndërsa kjo për kontraktuesin e sigurimit nuk ka qenë e njohur, konsiderohet sikur këto kufizime të mos kenë ekzistuar.**

Vështrim i përgjithshëm.- Pavarësisht nga emërtimi, neni 927 i LMD përmban rregulla vetëm lidhur me *përfaqësuesit e sigurveit*.⁸⁰⁹ Për kryerjen e punëve të sigurveve në R.

⁸⁰⁹ Në nenin 925 dhe 926 të këtij Ligji rregullohen situatat kur kontraktuesi i sigurimit e lidh kontratën në emër të tjetrit pa autorizim dhe kur sigurimi bëhet për llogari të huaj dhe për llogari të cilit i përket, që nënkupton se në emër të të siguruarit, përkatësisht të shfrytëzuesit të sigurimit paraqitet personi tjetër.

e Kosovës mund të angazhohen vetëm kompanitë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK).⁸¹⁰ Kompanitë e sigurimeve janë persona juridikë të cilët punët e sigurimeve i kryejnë nëpërmjet ndërmjetësuesve të autorizuar të tyre, me qëllim të përfaqësimit në kryerjen e punëve të sigurimit. Të drejtat dhe autorizimet e tyre janë të përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/25 dt. 5 tetor 2001 për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësimit të Sigurimeve. Për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore zbatohen rregullat e përgjithshme të këtij Ligji që kanë të bëjnë me përfaqësimet.⁸¹¹ Në këtë mënyrë, përfaqësues të sigurimeve mund jenë personat fizikë ose juridikë, të cilët, në bazë të kontratës, kryejnë punë për siguruesin.

1. Përfaqësuesi mund t'i ndërmarrë vetëm ato punë juridike për të cilat është i autorizuar.⁸¹² Në paragrafin 1 të nenit 927 janë përshkruar veprimet që mund t'i ndërmarrë përfaqësuesi i sigurimit në rastet kur nuk është caktuar vëllimi i autorizimeve të tij. Në situata të këtilla, sipas kësaj dispozite, ai ka autorizimin që, *në emër dhe për llogari të siguresit, të lidhë ë kontrata për sigurimin, të kontraktojë ndryshimet e kontratës, qoftë edhe për zgjatjen e afateve të sigurimit, të lëshojë policën e sigurimit, të arkëtojë premitë si dhe të pranojë deklarata nga kontraktuesi i sigurimit që i drejtohen siguresit.* Me vetë faktin se përfaqësuesi ka të drejtë të lidhë kontratën për sigurimin dhe të lëshojë policën e sigurimit, jep të kuptohet se ai ka detyrimin që të siguruarit t'ia dorëzojë kushtet e sigurimit. Në këtë mënyrë përfaqësuesi ka gjithsesi detyrimin t'u përmbahet kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të sigurimit. Çdo veprim i përfaqësuesit në kundërshtim me kushtet e sigurimit përfaqëson tejkalim të autorizimit. Përfaqësuesi i autorizimit të gjitha veprimet sipas autorizimit të dhënë i ndërmerr në emër dhe për llogari të siguresit. Edhe pse ka të drejtë ta arkëtojë preminë, ai nuk ka legjitimitetin pasiv për paraqitjen e kërkesave ndaj të siguruarit, përpos nëse është për këtë i autorizuar me autorizim të veçantë.

2. Në paragrafin e parë të këtij neni është parashikuar rregulla për rastet kur përfaqësuesit të siguresit nuk i është caktuar vëllimi i autorizimeve. Nga kjo rrjedh se siguresi mundet edhe t'ia kufizoj autorizimet përfaqësuesit të tij. Në par. 2 të këtij neni është rregulluar situata kur siguresi i ka kufizuar autorizimet e përfaqësuesit të vet. Në rastet e këtilla mund të paraqiten dy situata: a) kontraktuesi i sigurimit nuk ka qenë në dijeni se siguresi i ka kufizuar autorizimet e përfaqësuesit dhe b) kontraktuesi i sigurimit ka ditur apo do të duhej të dinte për këtë fakt. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit nuk ka ditur, supozohet sikur këto kufizime të mos kenë ekzistuar, ashtu që veprimi i ndërmarrë konsiderohet juridikisht i vlefshëm dhe do të paraqesë detyrim për siguruesin. Edhe pse me këtë dispozitë ligjore shprehimisht nuk është thënë, nga vetë përmbajtja e dispozitës rrjedh se, në të kundërtën, kur për këtë kufizim të autorizimit kontraktuesi i sigurimit ka ditur apo do të duhej të dinte, veprimi i ndërmarrë është i juridikisht pavlefshëm.

810 Me nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 dt. 5 tetor 2001 për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësimit të Sigurimeve është parashikuar se askush nuk mund të angazhohet në punët e sigurimeve në Kosovë, përpos kompanive të sigurimit të licencuara nga BPK.

811 Shih dispozitat nga neni 72 – 84 të LMD.

812 Shih nenin 79 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

NËNKREU 3

DETYRIMI I SIGURUESIT, PËRKATËSISHT I KONTRAKTUESVE TË SIGURIMIT

I. LAJMËRIMI I RRETHANAVE TË RËNDËSISHME PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT

Neni 928. Detyra e lajmërimit

Kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë t'i lajmërojë siguruesit kur lidhë kontratën të gjitha rrethanat e rëndësishme të cilat janë të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut, të cilat i janë të njohura ose nuk kanë mundur të mbeten të panjohura.

Vështrim i përgjithshëm.- Me lidhjen e kontratës për sigurimin krijohet një marrëdhënie juridike e veçantë me të drejta dhe detyrime specifike për palët kontraktuese. Rreziqet kundrejt të cilave bëhet sigurimi janë të ndryshme. Ka rreziqe të tilla kundrejt të cilave nuk mund të bëhet sigurimi, sikundër që ka edhe objekte që nuk mund të sigurohen. Varësisht nga rreziku kundrejt të cilit bëhet sigurimi, objekti i siguruar dhe rrethanat e tjera që dalin nga marrëdhënia e sigurimit caktohet edhe premia e sigurimit. Duke i pasur parasysh specifikat e marrëdhënieve të sigurimit, me LMD janë rregulluara veçmas detyrimet e të siguruarit, përkatësisht kontraktuesit të sigurimit dhe veçmas ato të siguruesit. Detyrimet themelore që i përkasin të siguruarit, përkatësisht kontraktuesit të sigurimit, në rast të mospërbushjes së të cilave ai mban përgjegjësinë, janë: a) detyrimi që t'i lajmërojë të gjitha rrethanat e rëndësishme me ndikim në vlerësimin e rrezikut (neni 928-932); b) detyrimi për pagesën e premisë së sigurimit (neni 933-934); c) detyrimi për njoftimin i siguruesit për ndryshimet e rrezikut (neni 935-937; dhe ç) detyrimi për paraqitjen e rastit të sigurimit (938-939).

Një nga parimet themelore të së drejtës së detyrimeve është parimi i ndërgjegjshmërisë dhe i ndershmërisë, sipas të cilit, si në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve, ashtu edhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që dalin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen këtij parimi.⁸¹³ Duke i pasur parasysh specifikat e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, edhe pse në dispozitat me të cilat rregullohen marrëdhëniet e sigurimit shprehimisht dhe në veçanti nuk është parashikuar, palët kontraktuese në marrëdhëniet e tyre reciproke duhet të sillen sipas parimit të besimit të ndërsjellë, ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë. Bazuar në këtë parim, sipas nenit 928 të LMD, me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit, kontraktuesi i sigurimit është i detyruar ta lajmërojë siguruesin për të gjitha rrethanat e rëndësishme, të cilat janë me ndikim për vlerësimin e rrezikut, të cilat i janë të njohura ose nuk kanë mundur t'i ngelin të panjohura.

Varësisht nga pesha e rrezikut, përcaktohen edhe kushtet e sigurimit. Pesha e rrezikut varet nga rrethanat e rastit. Duke pasur parasysh faktin se kontrata e sigurimit lidhet vetëm në

813 Shih nenin 4 të LMD.

bazë të të dhënave të paraqitura nga kontraktuesi i sigurimit dhe në bazë tyre siguroesi merrpërsipër detyrimin e mbulesës së rrezikut dhe vendos edhe për sasinë e premisë së sigurimit, kontraktuesi i sigurimit është i detyruar ta njoftojë siguroesin në mënyrë objektive dhe në tërësi për të gjitha faktet që janë thelbësore për marrjen e vendimit për lidhjen e kontratës së sigurimit dhe për vlerësimin e peshës së rrezikut. Faktet dhe rrethanat me ndikim për kushtet e lidhjes së kontratës së sigurimit mund të jenë të ndryshme dhe të shumta, ashtu që, nëse është apo jo një rrethanë e rëndësishme, varet nga lloji i sigurimit për çdo rast konkret, si, p.sh., me rastin e sigurimit të jetës, me rëndësi është mosha e njeriut; me rastin e sigurimit të një objekti nga zjarri, me rëndësi është materiali me të cilin ai është i ndërtuar etj. Zakonisht ndodh që për çdo rast konkret të sigurimit siguroesi të pyesë dhe të kërkojë përgjigje nga kontraktuesi i sigurimit për rrethanat me rëndësi.⁸¹⁴

Kontraktuesi i sigurimit mund mos të jetë në dijeni për të gjitha ato rrethana me ndikim për lidhjen e kontratës së sigurimit. Ai është i detyruar ta njoftojë siguroesin për të gjitha rrethanat *të cilat i janë të njohura ose nuk kanë mundur t'i ngelin të panjohura*. Nëse i siguroari ka mundur të dinte ose jo për ato rrethana, varet nga çdo rast konkret. Edhe për këtë rrethanë ligji nuk jep shpjegime në këtë pjesë, ashtu që lidhur me këtë duhen përdorur rregullat e parashikuara për marrëdhëniet e krijuara nga shitblerja (neni 463).⁸¹⁵ Heshtja ose njoftimi jo i drejtë për ndonjë rrethanë me rëndësi për lidhjen e kontratës së sigurimit është në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë. Me këtë siguroesi silltet në lajthim përkritazi me faktet vendimtare për lidhjen e kontratës, gjë që edhe do të ketë pasoja të parashikuara në dispozitat në vijim të këtij Ligji, në nenin 929 dhe 930.

Neni 929. Lajmërimi i pasaktë i bërë me dashje ose lënia në heshtje

- 1. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit ka bërë me dashje lajmërimin e pasaktë ose me dashje e ka lënë në heshtje ndonjë rrethanë të një karakteri të tillë, sa që siguroesi nuk do të lidhë të kontratën po të kishte ditur për gjendjen e vërtetë, siguroesi mund të kërkojë anulimin e kontratës.**
- 2. Në rastin e zgjidhjes të kontratës për shkaqe të cekura në paragrafin paraprak, siguroesi mban për vete premittë e arkëtuara dhe ka të drejtë të kërkojë pagimin e premisë për periudhën e sigurimit në të cilën ka kërkuar anulimin e kontratës.**
- 3. Siguroesi duhet të paraqesë padi për anulimin e kontratës mbi sigurimin në afat prej tre muajsh nga koha kur ka marrë njohuri për pasaktësinë e lajmërimin ose të lënies në heshtje.**

814 Sipas nenit 1117 par. 2 të KCRSH “Quhet se kanë rëndësi thelbësore të gjitha rrethanat për të cilat siguroesi ka pyetur me shkresë të siguroarin”.

815 “Konsiderohet se nuk ka mundur t’i mbeten të panjohura blerësit ato të meta të cilat personi i kujdesshëm, me dituri dhe përvojë mesatare i profesionit të blerësit, do të mundej lehtë t’i vërente me rastin e kontrollimit të zakonshëm të sendit – shih nenin 463 par. 2 të LMD dhe komentnin lidhur me këtë nen nga Komentin për pjesën e përgjithshme të këtij Ligji.

Vështrim i përgjithshëm.- Rreziku i siguruar duhet patjetër të jetë i ardhshëm, joevident dhe i pavarur nga vullneti i kontraktuesit të sigurimit dhe siguruesit,⁸¹⁶ përndryshe kontrata e sigurimit është nule⁸¹⁷, siç është rregulluar në parë 2 dhe 3 të nenit 919 të këtij Ligji. Me dispozitën e nenit 929 janë parashikuar rastet kur kontrata është rrëzueshme.⁸¹⁸ Me paraqitjen e pasaktë ose të heshtjes së ndonjë rrethane me rëndësi për vlerësimin e rrezikut, siguruesi sillet në lajthim përkitazi me faktet me rëndësi për lidhjen e kontratës. Siguruesi në këtë rast merr vendim për lidhjen e kontratës në bazë të një pasqyre të gabuar të gjendjes së vërtetë faktike, dhe kjo bën që edhe në anën e tij të ketë të meta në shprehjen e vullnetit të lirë, gjë që është me ndikim në vlefshmërinë e kontratës. Me këtë dispozitë njëherësh parashikohen edhe pasojat për kontraktuesin e sigurimit⁸¹⁹, për shkak të lajmërimit të pasaktë ose heshtjes me qëllim të rrethanave të rëndësishme, të cilat janë me ndikim për vlerësimin e rrezikut si dhe të drejtat e siguruesit në këto raste dhe mundësia, kushtet dhe afatet për realizimin e këtyre të drejtave.

1. Përkitazi me pasojat juridike për shkak të lajmërimit të pasaktë apo të heshtjes së ndonjë rrethane të rëndësishme, sipas par. 1 të nenit 929 të LMD, me rëndësi vendimtare është: a) nëse këtë e ka bërë kontraktuesi i sigurimit me dashje apo pa qëllim dhe b) ky lëshim i kontraktuesit të sigurimit ka të bëjë ose jo me rrethanat që kanë mundur të kenë ndikim në lidhjen e kontratës, ashtu që, sikur siguruesi të dinte për to, nuk do ta lidhte kontratën. Sipas kësaj dispozite ligjore, në situatat kur kontraktuesi i sigurimit e ka bërë me dashje lajmërimin e pasaktë të ndonjë rrethane ose e ka heshtur me qëllim ndonjë rrethanë, përndryshe siguruesi nuk do ta lidhte kontratën sikur ta dinte gjendjen e vërtetë, *siguruesi ka të drejtë të kërkojë anulimin e saj*. Kjo nënkupton se, në qoftë se i siguruari, me rastin e lidhjes së kontratës, e ka heshtur ndonjë rrethanë për të cilën, sikur siguruesi të dinte, nuk do ta lidhte kontratën, si, p. sh., pronësia kontestuese e automobilit, kjo nuk nënkupton në vetvete pasojën e nulitetit, se ajo me vetë këtë fakt është nule, por kjo nënkupton të drejtën e mëtejshme të siguruesit të kërkojë anulimin e kontratës. Nëse ajo do të anulohet apo jo, varet nga fakti nëse siguruesi do të paraqesë në gjykatë një kërkesë të tillë apo jo. Duke pasur parasysh faktin se kontratat e këtilla janë relativisht nule, me padi do të kërkohej anulimi i kontratës për arsyet e sipërshënuara dhe jo për të vërtetuar se ajo është nule.

Për të ekzistuar dashja për këtë në anën e kontraktuesit të sigurimit, do të duhej që ai të kishte ditur për ekzistimin e asaj rrethane, e cila ka qenë me rëndësi dhe me ndikim për vlerësimin e rrezikut. Barra e provimit të ekzistimit të arsyeve dhe kushteve edhe përkitazi me ekzistimin e dashjes, bie mbi siguruesin. Ai duhet të provojë se kontraktuesi i sigurimit e ka bërë me qëllim lajmërimin e pasaktë të rrethanave ose ka heshtur me qëllim për ekzistimin e një rrethane me rëndësi.

816 Shih par. 1 të nenit 919 të këtij Ligji.

817 Shih dispozitat nga neni 89-96 të këtij Ligji.

818 Shih dispozitat nga neni 97-102 të këtij Ligji.

819 Në të gjitha rastet kur në pjesën e këtij Ligji dhe komenteve të dhëna për kontratën e sigurimit bëhet fjalë për palët kontraktuese, për njërën palë në anën e siguruesit përdoret shprehja përkatëse “siguruesi”, ndërsa për palën tjetër përdoret shprehja “kontraktuesi i sigurimit”, ku mund të jetë vetë i siguruari ose personi tjetër i cili lidh kontratën në emër të të siguruarit ose për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket.

2. Në paragrafin 2 të nenit 929 të këtij Ligji parashikohen pasojat juridike të anulimit të kontratës së sigurimit për arsyet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni. Sipas paragrafit të parë të këtij neni, siguruksi, në rast të përmbushjes së kushteve ligjore, ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës. Në bazë të kushteve të parashikuara ligjore, për shkak të të cilave mund të kërkohej anulimi, rrjedh se fjala është për nulitet relativ,⁸²⁰ përkatësisht për kontratë të rrëzueshme. Kontrata absolutisht nule nuk prodhon efekte juridike nga fillimi. Përkundër kësaj, kontrata relativisht nule, e rrëzueshme prodhon efekte juridike si ajo e vlefshmja, derisa nuk anulohet, gjë që nënkupton se siguruksi ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që një kontratë e tillë të anulohet, pasi që gjykata nuk e sheh këtë sipas detyrës zyrtare. Është rregull e përgjithshme se, në rast të anulimit të kontratës me detyrime të dyanshme, secila palë kontraktuese duhet ta kthejë atë që ka marrë.⁸²¹ Në bazë të kësaj dispozite ligjore, bëhet përjashtim nga rregulla e përgjithshme, pasi që pasojat janë të tjera. Në rast të zgjidhjes së kontratës për shkaqet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, siguruksi i mban për vete premitë e arkëtuara deri në momentin e anulimit të kontratës, njëherësh ka të drejtë të kërkojë pagimin e premisë për të gjithë periudhën e sigurimit sipas kontratës për sigurimin.

3. Të drejtën për paraqitjen e padisë për anulimin e kontratës së sigurimit për shkaqet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, e ka siguruksi dhe jo edhe kontraktuesi i sigurimit, pasi që ky i fundit është përgjegjës për anulimin e kontratës. Padia për anulim mund të paraqitet brenda tre muajsh. Afati fillon të rrjedhë nga dita kur siguruksi ka mësuar për pasaktësinë e lajmërimit. Siç shihet, ky afat është më i shkurtër në krahasim me afatin e përgjithshëm, sipas të cilit e drejta për paraqitjen e padisë për anulimin e kontratës së rrëzueshme humbet pas kalimit të afatit prej një viti, nga dita kur të jetë mësuar shkaku i rrëzueshmërisë.

Ndodh që me një kontratë për sigurimin të jenë përfshirë disa objekte të sigurimit. Në rastet kur kontraktuesi i sigurimit e ka bërë me qëllim lajmërim të pasaktë, përkatësisht i ka heshtur me qëllim rrethanat me rëndësi për sigurimin e vetëm të ndonjërit nga objektet e sigurimit, konsiderojmë se kontrata duhet të ngelë në fuqi përkitazi me objektet të cilat nuk janë përfshirë me shkeljen e këtij detyrimi.⁸²²

Neni 930. Pasaktësia e paparamenduar ose lajmërimi jo i plotë

1. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit ka bërë lajmërim të pasaktë ose ka bërë lëshim të jap njoftim që ka për detyrë, ndërsa këtë nuk e ka bërë me dashje, siguruksi mundet sipas dëshirës së vet brenda një muaji nga data kur të ketë mësuar për pasaktësinë ose për lajmërimin jo të plotë të lajmërimit, të deklarojë se e zgjidhë kontratën ose të propozojë shtimin e premisë në përpjesëtim me rrezikun më të madh.

820 Shih nenin 98 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

821 Shih nenin 99 par. 1 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

822 Derisa me LMD një situatë e këtillë nuk është rregulluar me ndonjë dispozitë të veçantë, me LMD (Zakon o Obveznim o Odnosima) të R. së Kroacisë të vitit 2005, i cili është në fuqi, kjo është rregulluar shprehimisht në par. 4 të nenit 932, që parashikon: “Në qoftë se me sigurim janë përfshirë më shumë objekte të sigurimit, kontrata mbetet në fuqi për ato objekte të sigurimit me të cilat nuk ka të bëjë lajmërimi i pasaktë i bërë me dashje ose heshtja e rrethanave nga kontraktuesi i sigurimit?”.

2. Kontrata në këtë rast shuhet pasi të kenë kaluar katërbëdhjetë (14) ditë që kur siguruesi t'ia ketë komunikuar deklaratën e vet mbi zgjidhjen kontraktuesit të sigurimit, e në rastin e propozimit të siguruesit që premia të shtohet, zgjidhja shkaktohet sipas ligjit, në qoftë se kontraktuesi i sigurimit nuk e aprovon propozimin brenda katërbëdhjetë ditësh nga koha që kur e ka marrë.
3. Në rastin e zgjidhjes, siguruesi ka për detyrë ta kthejë pjesën e premisë, e cila i përket kohës deri në fund të periudhës së sigurimit.
4. Në qoftë se rasti i siguruar ka ndodhur para se të ishte vërtetuar pasaktësia ose lajmërimi jo i plotë, apo pas kësaj, por para zgjidhjes së kontratës, përkatësisht para arritjes së marrëveshjes për shtimin e premisë, shpërblimi zvogëlohet në përpjesëtim ndërmjet shkallëve të premive të paguara dhe shkallës së premive që do të duheshin të paguheshin në bazë të rrezikut faktik.⁸²³

Vlerësim i përgjithshëm. Përpos cenimit me qëllim, me dashje të detyrimit të lajmërimit të rrethanave me rëndësi për sigurim, siç është parashikuar në nenin paraprak, cenimi i këtij detyrimi mund të bëhet edhe pa qëllim. Moslajmërimi i paqëllimshëm i rrethanave mund të bëhet nga dy arsye: a) kontraktuesi i sigurimit nuk ka ditur fare se ekzistojnë rrethana të rëndësishme, me ndikim për vlerësimin e rrezikut; b) kontraktuesi i sigurimit e ka ditur se ka rrethana, por nuk e ka ditur se ato janë me rëndësi dhe me ndikim për vlerësimin e rrezikut. Në bazë të detyrimit ligjor që ka, kontraktuesi i sigurimit do t'i lajmërojë rrethanat për ekzistimin e të cilave është në dijeni. Moslajmërimi i rrethanave për ekzistimin e të cilave nuk ka ditur, nuk është bërë me qëllim. Me qëllim nuk është bërë as moslajmërimi i rrethanave për ekzistimin e të cilave kontraktuesi i sigurimit ka ditur, por nuk ka ditur se janë të rëndësishme dhe me ndikim për vlerësimin e rrezikut. Me nenin 930 të LMD janë rregulluar pasojat juridike të situatave kur kontraktuesi i sigurimit nuk i ka lajmëruar saktësisht dhe në tërësi rrethanat të cilat *kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës* dhe janë me ndikim në vlerësimin e rrezikut, por këtë nuk e ka bërë me qëllim. Me ligj nuk është bërë dallimi, prandaj nuk është me rëndësi nëse është fjala për rrethana të cilat do të ishin me ndikim në vendimin për lidhjen e kontratës apo vetëm për vlerësimin e rrezikut. Njëherësh fare nuk bëhet fjalë, (që do të thotë se nuk është me rëndësi), për shkallën e fajësisë së kontraktuesit të sigurimit, me rëndësi është vetëm se ai këtë nuk e ka bërë me qëllim.

823 Edhe te kjo dispozitë ligjore redaktimi gjuhësor sjell dilema dhe paqartësi, veçanërisht në par. 4, ashtu që në të ardhmen do të duhej rregulluar në këtë aspekt, kjo veçanërisht me rastin e përdorimit të shprehjeve të caktuara, si “shkallëve”.

1. Në par. 1 të nenit 930 janë rregulluar të drejtat e siguruesit në rastet kur kontraktuesi i sigurimit ,me rastin e plotësimit të deklaratës së sigurimit, ka paraqitur të dhëna të pasakta apo nuk ka bërë lajmërimin e të gjitha rrethanave që ka pasur për detyrë ta bënte dhe këtë nuk e ka bërë me qëllim.⁸²⁴ Në situatat të këtilla, siguruesi, sipas kësaj dispozite ligjore, ka dy mundësi të zgjedh njërën prej tyre, sipas dëshirës: a) të deklarojë në mënyrë të njëanshme se e zgjidh kontratën ose b) të propozojë shtimin e premisë në përpjesëtim me rrezikun ekzistues më të madh. Siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, pasi diçka e tillë nuk parashikohet në ligj, siguruesi nuk ka të drejtë, për shkak të lëshimeve të sipërshënuara të kontraktuesit të sigurimit, të refuzojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga rasti i siguruar. Për këto veprime nga ana e siguruesit ligji ka përcaktuar afatin prej një muaji nga dita kur siguruesi ka mësuar për pasaktësinë ose për paraqitjen jo të plotë. Fjala është për afat ligjor, me lëshimin e të cilit siguruesi humb të drejtat e parashikuara me këtë nen.

2. Në par. 2 të këtij neni është rregulluar se në cilat raste do të ndodhë zgjidhja e kontratës. Sipas paragrafit paraprak, siguruesi kishte të drejtë të zgjedhë nëse do ta deklaronte zgjidhjen e kontratës apo do ta bënte rritjen e premisë në përpjesëtim me rrezikun ekzistues më të madh. Me rastin e deklarimit të zgjidhjes së kontratës, pasi të ketë kaluar afati prej 14 ditësh nga dita kur siguruesi t’ia ketë komunikuar deklaratën kontraktuesit të sigurimit për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, kontrata zgjidhet sipas fuqisë së ligjit. Rrjedha e afatit do të llogaritet nga dita kur kontraktuesi i sigurimit ka pranuar deklaratën. Sa i përket formës së dhënies së deklaratës, duke pasur parasysh faktin se kontrata e sigurimit është formale, me shkrim, konsiderojmë se edhe deklarata e zgjidhjes së kontratës, për të njëjtat arsye, duhet të jetë me shkrim.

Zgjidhja e kontratës do të ndodhë edhe në rastin tjetër - kur siguruesi ia ka bërë kontraktuesit të sigurimit propozimin të rritet premia dhe ai nuk e aprovon atë brenda 14 ditësh, nga dita kur e ka pranuar këtë propozim. Se propozimi për rritjen e premisë në përpjesëtim me rrezikun më të madh nuk është aprovuar, konsiderohet si në rastin kur kontraktuesi i sigurimit është deklaruar se nuk e pranon atë, ashtu edhe në rastin kur ai, brenda afatit të sipërshënuar, nuk i përgjigjet fare këtij propozimi të paraqitur nga siguruesi. Kështu, nëse nuk aprovohet propozimi, ndodh shkëputja e kontratës sipas ligjit, por në rastet kur kontraktuesi i sigurimit e pranon propozimin, kontrata ngel në fuqi, me detyrimin e kontraktuesit të sigurimit të paguajë preminë e rritur në përpjesëtim me rrezikun ekzistues më të madh.

3. Qoftë në bazë të deklaratës së bërë nga siguruesi. qoftë për shkak të mosmiratimit të propozimit për rritjen e premisë për shkak të ekzistimit të rrezikut më të madh, zgjidhja e kontratës do të ndodhë. Në situatat e këtilla paraqiten pasoja të tjera për palët kontraktuese. Në bazë të par. 3 të nenit 930 të këtij Ligji, në rastin e zgjidhjes së kontratës për shkaqet e sipërshënuara, siguruesi ka për detyrim t’ia kthejë kontraktuesit të sigurimit pjesën e

824 Dispozita ligjore flet për ekzistimin e qëllimit për ndërmarrjen e një veprimi, përkatësisht mosndërmarrjen e veprimeve nga kontraktuesi i sigurimit. Derisa fjala është për ekzistimin, përkatësisht mosekzistimin e qëllimit (për ta mashtruar siguruesin), në Ligj nuk bëhet fare fjalë dhe nuk është me rëndësi shkalla e fajësisë për këtë, me rëndësi është që të mos ketë ekzistuar qëllimi për dhënien e informatave të pasakta ose lënia e qëllimitë e tyre në harresë.

premisë për kohën e ardhshme, deri në fund të periudhës së sigurimit. Kjo nënkupton se siguruuesi do ta mbajë pjesën e premisë, llogaritur nga fillimi i periudhës së sigurimit, deri në ditën e shkëputjes së kontratës, derisa ka mbajtur pasojat e dëmshme për realizimin e rastit të sigurimit.

4. Pasaktësia ose lajmërimi jo i plotë i rrethanave të rëndësishme me ndikim në vlerësimin e rrezikut mund të konstatohen jo vetëm para paraqitjes së rastit të siguruar, por edhe pas paraqitjes së tij. Sipas par. 4 të këtij neni, përkitazi me uljen e shpërblimit për këtë arsye, kjo rrethanë nuk është me rëndësi. Me rëndësi është që pasaktësia ose lajmërimi jo i plotë është vërtetuar gjatë ekzistimit të kontratës, përkatësisht para se të zgjidhet ajo dhe para arritjes së marrëveshjes për rritjen e premisë. Në rastet kur vërtetohet pasaktësia e lajmërimit ose lajmërimi jo i plotë i rrethanave me rëndësi për sigurimin, qoftë para ose pas paraqitjes së rastit të sigurimit, gjithmonë para zgjidhjes së kontratës, shpërblimi i kontraktuar në emër të sigurimit zvogëlohet në përpjesëtim me dallimin ndërmjet shumës së premive të paguara sipas shkallës së rrezikut të paraqitur dhe shumës që do të duhej të paguante sipas rrezikut real. Në rastet e këtilla është plotësisht normale që kjo premi të jetë më e vogël nga ajo që do të ishte caktuar në bazë të të gjitha elementeve ekzistuese reale.

Neni 931. Zgjerimi i fushës së zbatimit të neneve paraprake

Dispozitat e neneve paraprake për pasojat e lajmërimit të pasaktë ose të lënies në heshtje të rrethanave me rëndësi për çmuarjen e rrezikut zbatohen edhe në rastet e sigurimit të kontraktuar në emër dhe për llogari të tjetrit, ose në dobi të të tretit, ose për llogari të huaj, ose për llogari të cilës i përket, në qoftë se këta persona kanë ditur për pasaktësinë e lajmërimit ose për lënien në heshtje të rrethanave me rëndësi për çmuarjen e rrezikut.

Edhe dispozita ligjore e nenit 931 të LMD është dispozitë referuese. Sipas kësaj dispozite, zbatimi i rregullave për detyrimin e lajmërimit të rrethanave të rëndësishme parashikuar në nenet 929 dhe 930 zbatohen edhe në rastet e sigurimit të kontraktuar në emër dhe për llogari të tjetrit, në dobi të tretit, për llogari të huaj ose për llogari të cilit i përket. Për të gjithë këta persona, domethënë për personin në emër të të cilit është lidhur kontrata, në dobi të të cilit është lidhur, për llogari të të cilit është lidhur apo të cilit i përket, do të paraqiten pasojat juridike të parashikuara nga nenet paraprake, në qoftë se ata kanë ditur për pasaktësinë e lajmërimit ose për heshtjen e ekzistimit të rrethanave me rëndësi për vlerën e rrezikut. Me këtë dispozitë ligjore njohuritë e këtyre personave lidhur me rrethanat e rëndësishme me ndikim në vlerën e rrezikut barazohen me njohuritë e kontraktuesit të sigurimit. Barra e provimit të faktit se shfrytëzuesi i sigurimit ka pasur njohuri për pasaktësinë e lajmërimit ose heshtjen e ekzistimit të rrethanave me rëndësi, të cilat janë me ndikim në vlerësimin e rrezikut, bie mbi siguruuesin. Përgjegjësia e shfrytëzuesve të sigurimit është veçanërisht e rëndësishme, për shkak të keqbesimit të mundshëm të tyre me rastin e dhënies së informatave për lidhjen e kontratës së sigurimit.

Neni 932. Rastet në të cilat siguruesi nuk mund të thirret në pasaktësinë ose lajmërimin jo të plotë

- 1. Siguruesi, i cili në çastin e lidhjes së kontratës ka ditur ose nuk ka mundur të mos ketë qenë në dijeni për rrethanat që kanë rëndësi për vlerësimin e rrezikut, e të cilat kontraktuesi i sigurimit i ka lajmëruar në mënyrë jo të saktë ose i ka lënë në heshtje, nuk mund të thirret në pasaktësinë e lajmërimit ose lënien në heshtje.**
- 2. E njëjta gjë vlen në rastin kur siguruesi të ketë mësuar për këto rrethana gjatë kohës së sigurimit, e që nuk i ka shfrytëzuar autorizimet ligjore.**

Vështrim i përgjithshëm.- Kontraktuesi i sigurimit, ma rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit, ka detyrimin ta njoftojë siguruesin për të gjitha rrethanat e rëndësishme, për të cilat është në dijeni, përkatësisht që nuk kanë mundur t'i mbeten të panjohura e të cilat janë me ndikim në vlerësimin e rrezikut. Mbi këtë rregull, në rast të lajmërimit të pasaktë apo heshtjes së qëllimtë, bazohet edhe e drejta e siguruesit të kërkojë anulimin e kontratës, ndërsa kur kjo ndodh pa qëllim nga kontraktuesi i sigurimit, siguruesi ka të drejtë të deklarojë se e zgjidh kontratën ose të propozojë shtimin e premisë në përpjesëtim me rrezikun ekzistues më të madh.⁸²⁵ E gjithë kjo ndodh në situatat kur siguruesi nuk ka ditur dhe as që ka mundur të dinte për ekzistimin e rrethanave me rëndësi për vlerësimin e rrezikut dhe për lajmërimin e tyre të pasaktë apo heshtjen e tyre. Në nenin 932 të LMD janë parashikuar rastet kur siguruesi, në momentin e lidhjes së kontratës, ka ditur për ekzistimin, përkatësisht nuk ka mundur të mos jetë në dijeni për to dhe kur ai ka mësuar për to gjatë kohës së sigurimit. Të drejtat e siguruesit në rastet e këtilla varen nga momenti kur ai ka qenë në dijeni, përkatësisht kur ka mundur të jetë në dijeni për to. Në këtë mënyrë, me këtë dispozitë ligjore rregullohen dy situata: a) rasti kur siguruesi, në momentin e lidhjes së kontratës, ka ditur për rrethanat me rëndësi për vlerësimin e rrezikut dhe b) rasti kur siguruesi për këto rrethana ka mësuar gjatë kohës së sigurimit.

1. Në rast se siguruesi edhe pse, në momentin e lidhjes së kontratës, ka ditur apo nuk ka mundur të mos ishte në dijeni për ekzistimin e rrethanave me rëndësi për vlerësimin e rrezikut dhe se kontraktuesi i sigurimit i ka lajmëruar ato në mënyrë jo të saktë ose i ka heshtur, nuk është e arsyeshme t'i lejohet atij më vonë që t'u referohet rregullave për pasojat e pasaktësisë dhe lajmërimit jo të plotë të tyre. Nisur nga kjo arsye, sipas par. 1 të nenit 932 të LMD, siguruesi nuk mund t'i referohet pasaktësisë së paraqitjes së rrethanave të rëndësishme, të cilat janë me ndikim në vlerësimin e rrezikut, nëse për ekzistimin e tyre ka ditur, përkatësisht nuk ka mundur të mos ishte në dijeni si dhe për faktin se kontraktuesi i sigurimit i ka paraqitur ato jo të sakta dhe jo të plota. Ai do të duhej që, në momentin e lidhjes së kontratës, t'ia tërhiqte vërejtjen kontraktuesit të sigurimit se paraqitja e tij nuk është e saktë dhe e plotë, njëherësh t'i propozonte plotësimin e saj me rrethanat ekzistuese. Pra, në këto raste siguruesi nuk mund të realizojë të drejtat e parashikuara në dispozitat e neneve 929 dhe 930 të LMD.

.....
825 Shih nenet 929 dhe 930 të këtij Ligji.

2. Ekziston mundësia që siguruesi, në momentin e lidhjes së kontratës, të mos ketë ditur që kontraktuesi i sigurimit rrethanat me rëndësi i ka paraqitur në mënyrë të pasaktë dhe jo të plotë, mirëpo për këtë ka mësuar më vonë, *gjatë kohës së sigurimit*. Në këtë rast, me të kuptuar për këtë, ai ka të drejtë t'i përdorë të drejtat e parashikuara nga nenet 929 dhe 930 të LMD, në mënyrë që të kërkojë anulimin e kontratës ose rritjen e premisë në përpjesëtim me rrezikun më të madh ekzistues. Sipas par. 2 të këtij neni, siguruesit i mbetet të zgjedhë nëse do t'i përdorë ose jo këto të drejta. Siguruesi humb të drejtat e parashikuara me ligj për shkak të lajmërimit të pasaktë dhe jo të plotë të rrethanave me rëndësi për sigurimin, nëse nuk i shfrytëzon autorizimet e parashikuara ligjore për rastet e këtilla. Me këtë dispozitë ligjore nuk janë përcaktuar afatet brenda të cilave siguruesi do të mund t'i përdorte autorizimet ligjore; konsiderojmë se as që ka pasur nevojë për këtë, pasi që do të duhej të vlenin afatet ligjore të parashikuara nga nenet paraprake, të cilat i parashikojnë këto të drejta (929 dhe 930).

II. PAGIMI I PREMISË

Neni 933. Detyra e pagimit dhe e marrjes së premisë

1. **Kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë të paguaj preminë e sigurimit, por siguruesi ka për detyrë të pranojë pagimin e premisë prej secilit person që ka interes juridik që ajo të paguhet.**
2. **Premia paguhet në afatet e kontraktuara, e në qoftë se duhet të paguhet përnjëherë, atëherë paguhet me rastin e lidhjes së kontratës.**
3. **Vendi i pagimit të premisë është vendi në të cilin kontraktuesi i sigurimit ka selinë ose vendbanimin e vet, në qoftë se në kontratë nuk është caktuar ndonjë vend tjetër.**

Vështrim i përgjithshëm.- Premia e sigurimit është shuma e caktuar e të hollave, të cilën duhet ta paguajë i siguruari, përkatësisht kontraktuesi i sigurimit si kundërpaguesë për shpërblimin e sigurimit, t i cili do të bëhet në rast se paraqitet rasti i sigurimit. Ajo është elementi thelbësor i kontratës për sigurimin.⁸²⁶ Pa detyrim të pagesës së premisë së sigurimit nuk ka as kontratë të sigurimit. Ajo duhet patjetër të jetë e shprehur në para, e sasia e saj mund të jetë fikse, e caktuar në bazë të marrëveshjes mes palëve apo sipas tarifave të caktuara paraprakisht. Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar se kush ka detyrimin të paguajë preminë, afatet e pagesës dhe vendi i pagesës së saj.

1. Te kontrata e sigurimit, përpos siguruesit, palë kontraktuese është edhe i siguruari apo personi tjetër për të cilin është përdorë shprehja kontraktues i sigurimit. Me par. 1 të këtij neni parashikohet detyrimi i kontraktuesit të sigurimit të paguajë preminë e sigurimit. Ai është palë kontraktuese, prandaj e ka këtë detyrim, pavarësisht nga ajo nëse është

⁸²⁶ Shih nenin 918 të LMD dhe komentimin e dhënë lidhur me këtë nen.

edhe i siguruar apo jo. Në bazë të rregullave të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve, detyrimin kontraktues mund ta përmbushë jo vetëm debitori, por edhe personi i tretë.⁸²⁷ Kjo rregull e përgjithshme lidhur me përmbushjen e detyrimeve vlen edhe te kontrata për sigurimet. Në këtë mënyrë, sipas par. 1 të nenit 933 të LMD, preminë e sigurimit ka për detyrë ta paguajë kontraktuesi i sigurimit, por këtë mund ta bëjë edhe personi tjetër, ashtu që, sipas kësaj dispozite, siguruasi ka detyrimin të pranojë pagimin e premisë edhe nga çdo person tjetër. Pagesa e premisë së sigurimit nga persona të tjerë, sipas rregullave të përgjithshme,⁸²⁸ është e kushtëzuar me ekzistimin e ndonjë interesi juridik të atij personi që detyrimi të përmbushet. Kjo rregull vlen edhe te kontrata e sigurimit, ashtu që në par. 1 të këtij neni shprehimisht parashikohet detyrimi i siguruasit të pranojë preminë e sigurimit prej secilit person tjetër që ka interes juridik që ajo të paguhet. Kontraktuesi i sigurimit nuk është gjithmonë edhe i siguruari. Në rastet kur kontrata e sigurimit lidhet për llogari të tjetrit, nënkuptohet se personi i tretë është shfrytëzues i sigurimit. Në këtë mënyrë, i siguruari është personi që ka interes juridik për lidhjen e kontratës së sigurimit; interes juridik ka edhe trashëgimtari i të siguruarit dhe çdo person tjetër që mund të presë ndonjë interes material në bazë të kontratës së sigurimit. Nëse preminë e sigurimit nuk e paguan kontraktuesi i sigurimit, kushdo që ka interes juridik mund ta bëjë këtë, kurse është detyrim i siguruasit të pranojë pagesën e premisë prej secili prej tyre, mirëpo, “*siguruasi nuk ka detyrimin ta lajmërojë personin e tretë, siç është i siguruari ose shfrytëzuesi i sigurimit që ka interes juridik, se kontraktuesi i sigurimit nuk e ka përmbushur detyrimin, duke e paguar preminë dhe të kërkojë nga ai ta bëjë këtë*”.⁸²⁹

2. Në par. 2 të këtij neni është rregulluar afati i pagesës së premisë. Në këtë dispozitë ligjore parashikohen dy mundësi përkitazi me afatin e kësaj pagese. Me kontratën e sigurimit palët kontraktuese mund të merren vesh dhe t’i parashikojnë edhe afatet e pagimit të premisë. Kjo rrjedh nga pjesa e parë e këtij paragrafi ku thuhet se premia paguhet në afatet e kontraktuara, gjë që nënkupton se palët kontraktuese mund të merren vesh për afatet e pagesës së saj. Nga pjesa e dytë e kësaj dispozite rrjedh se, në qoftë se premia duhet të paguhet me një herë (jo në këste), atëherë ajo paguhet me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit. Si do që të jetë, duke u nisur nga pjesa e parë e kësaj dispozite, sipas së cilës premia paguhet në afatet e kontraktuara, le të kuptohet se palët kontraktuese mund t’i rregullojnë me kontratë afatet e pagesës së premisë, pa kurrfarë kufizimi ligjor, pra kjo çështje u lihet në dispozicion palëve.

3. Me par. 3 të këtij neni është rregulluar çështja e vendit të pagesës së premisë së sigurimit. Sa i përket rregullës së përgjithshme përkitazi me vendin e përmbushjes së detyrimeve monetare, këto detyrime duhet të përmbushen në vendin ku kreditori e ka selinë, përkatësisht vendbanimin.⁸³⁰ Detyrimi për pagesën e premisë së sigurimit

827 Shih nenin 277 par. 1 të këtij Ligji dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen në komentën për pjesën e përgjithshme të LMD.

828 Shih par. 2 të nenit 277 të këtij Ligji.

829 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 748/06 dt. 28.02.2008.

830 Shih nenin 301 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

është detyrim monetar. Sipas rregullës së përgjithshme, rrjedh se premia e sigurimit duhet paguar sipas selisë, përkatësisht vendbanimit të siguresit, pasi që në këtë rast kreditor është ai. Dispozita nga par. 3 i këtij neni përfaqëson përjashtim nga rregulla e përgjithshme e sipërshënuar, pasi që, sipas kësaj dispozite, vendi i pagimit të premisë është vendi në të cilin e ka selinë ose vendbanimin kontraktuesi i sigurimit e jo siguresi. Me këtë dispozitë ligjore lejohet përjashtimi edhe nga kjo rregull, ashtu që palët kontraktuese nga kontrata e sigurimit, lidhur me vendin e pagesës së premisë së sigurimit, mund të merren vesh edhe ndryshe.

Neni 934. Pasojat e mospagimit të premisë

1. Në qoftë se është kontraktuar që premia të paguhet me rastin e lidhjes së kontratës, detyrimi i siguresit për të paguar shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë fillon ditën e ardhshme nga data e pagimit të premisë.
2. Në qoftë se është kontraktuar që premia të paguhet pas lidhjes së kontratës, detyrimi i siguresit për të paguar shpërblimin ose shumën e përcaktuar me kontratë fillon nga data e caktuar me kontratë si ditë e fillimit të sigurimit.
3. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit nuk e paguan preminë që ka arritur për pagesë pas lidhjes së kontratës deri në skadimin e saj, dhe as që e bën këtë ndonjë person i interesuar, kontrata për sigurimin shuhet sipas ligjit, në bazë të drejtës pas skadimit të kohës prej tridhjetë ditësh nga data kur kontraktuesit të sigurimit i është dorëzuar letra e porositur e siguresit me njoftimin për arritjen për pagesë të premisë, por me kusht që ky afat të mos mund të skadojë para se të kenë kaluar tridhjetë ditë nga data e arritjes për pagesë të premisë.
4. Pas kalimit të afatit kohorë të përcaktuar në paragrafin e tretë të këtij neni, në qoftë se kontraktuesi i sigurimit është në vonesë për të paguar preminë që ka arritur për pagesë pas lidhjes së kontratës, siguresi mundet të denoncojë kontratën e sigurimit pa paralajmërim, në atë mënyrë që denoncimi i kontratës është efektiv me kalimin e afatit kohorë të përcaktuar në paragrafin e tretë të këtij neni dhe mbarimi i mbulesës së sigurimit në qoftë se kontraktuesit të sigurimit i është dorëzuar letra e porositur e siguresit me njoftimin për mospagesën e pagesës së arritur dhe se mbulesa e sigurimit do të mbarojë.
5. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit paguan preminë pas afatit të specifikuar në paragrafin 3. të këtij neni, por brenda një (1) viti që kur premia kishte arritur për pagesë, siguresi do të ketë për detyrim pagimin e shumës së siguruar, gjegjësisht shpërblimin e dëmit në rast të paraqitjes së rastit të siguruar që nga mesnata pasi që premia dhe kamatëvonesa të jetë paguar.
6. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në sigurimin e jetës apo të shëndetit.

Vështrim i përgjithshëm. - Kontrata për sigurimin është kontratë me detyrime të dyanshme. Palë kontraktuese janë në një anë kontraktuesi i sigurimit, ku mund të jetë vetë i siguruari

apo personi tjetër i cili e lidh kontratën në llogari të shfrytëzuesit të sigurimit dhe në anën tjetër siguruesi. Në kontraktuesin e sigurimit qëndron detyrimi të paguajë preminë e sigurimit ndërsa në siguruesin që të paguajë shpërblimin, përkatësisht shumën e sigurimit. Detyrimet e palëve kontraktuese nga kjo kontratë janë të kushtëzuara mes tyre, ashtu që pa përmbushjen e njërit detyrim, ashtu siç parashikohet në kontratë, nuk ka përmbushje të detyrimit tjetër. Neni 934 rregullon pasojat e mundshme juridike në rast të mospërmbushjes së detyrimit nga kontraktuesi i sigurimit, mospagimit të premisë së sigurimit. Sipas kësaj dispozite ligjore, varësisht nga koha e kontraktuar për pagesën e premisë së sigurimit, pasojat për shkak të mospagimit janë të ndryshme. Varësisht nga koha e kontraktuar për pagesën e premisë, në këtë nen janë parashikuar dy mundësi marrëdhëniesh të krijuara: a) në par. 1 rregullohen marrëdhëniet në rastet kur premia duhet paguar me rastin e lidhjes së kontratës, b) në par. 2 dhe 3 rastet kur premia duhet paguar pas lidhjes së kontratës.

1. Me kontratën e sigurimit palët kontraktuese, përpos tjerash, e parashikojnë edhe kohën e pagesës së premisë së sigurimit. Në par. 1 të nenit 934 parashikohet koha kur fillon detyrimi i siguruesit për të paguar shpërblimin atëherë kur premia duhet paguar me rastin e lidhjes së kontratës. Sipas kësaj dispozite ligjore, *në rastet kur në kontratë është parashikuar pagimi i premisë me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit*, detyrimi i siguruesit për të paguar shpërblimin fillon ditën e nesërme pas pagimit të premisë. Në këto raste, kur është kontraktuar që premia të paguhet me rastin e lidhjes së kontratës, konsiderohet se premia është paguar në tërësi në momentin që është lidhur kontrata e sigurimit, pasi që kjo nënkupton përmbushjen e njëkohshme të detyrimeve të palëve kontraktuese. Në bazë të këtij konstatimi, fillimi i detyrimit të siguruesit për të paguar shumën e sigurimit në rast të ndodhjes së rastit të sigurimit, është i lidhur me pagimin e premisë së sigurimit e jo me lidhjen e kontratës. Kështu, *në rast se kontrata e sigurimit është lidhur në bazë të saj, premia është dashur të paguhet me rastin e lidhjes së kontratës, prandaj sigurimi nuk do të fillojë të rrjedhë derisa nuk paguhet premia e sigurimit*. Kjo nënkupton se në rast të lidhjes së një kontrate të këtillë ku është kontraktuar pagesa e premisë me rastin e lidhjes së kontratës, por premia nuk paguhet, kurse ndërkohë, para pagimit të premisë, ndodh rasti i sigurimit i parashikuar në kontratë, siguruesi nuk ka detyrimin ta paguajë shumën e kontraktuar të sigurimit. Kjo rregull gjen mbështetje në rregullën e përgjithshme të parashikuar nga neni 104 i LMD, sipas të cilit asnjëra palë nuk është e obliguar ta përmbushë detyrimin, nëse pala tjetër nuk e përmbush detyrimin e vetë.⁸³¹

Te kontratat e këtilla ku është kontraktuar që premia të paguhet me rastin e lidhjes së kontratës, në bazë të par. 1 të këtij neni, detyrimi i siguruesit për të paguar shpërblimin ose shumën e caktuar në kontratë *fillon ditën e ardhshme pas datës së pagimit të premisë*. Siç u tha më sipër, pagimi i shpërblimit është i lidhur me pagimin e premisë, ashtu që mbulesa e sigurimit fillon të rrjedhë nga fillimi i ditës së ardhshme, pas dit[ës së pagimit të premisë, duke filluar nga ora 0,00. Kjo nënkupton se në ditën e lidhjes së kontratës së sigurimit, i siguruari nuk e gëzon të drejtën e mbulesës së sigurimit. Në rast se rasti i sigurimit ndodh të njëjtën ditë kur është lidhur ky lloj i kontratës, qoftë edhe pas pagesës së premisë së

831 Shih nenin 104 par. 1 të LMD.

sigurimit, siguruesi nuk ka detyrimin të paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar në kontratë, përpos nëse ajo ditë është e mbuluar me kontratën e sigurimit të mëhershme.

Duke pasur parasysh faktin se kjo dispozitë ligjore gjithnjë mbështet në kontratën e lidhur mes palëve, ekziston mundësia që palët kontraktuese këtë ta rregullojnë ndryshe. Lejohet mundësia që të merren vesh që mbulesa e sigurimit të fillojë të rrjedhë të njëjtën ditë, d.m.th., nga momenti i lidhjes së kontratës dhe pagesës së premisë, duke caktuar kohën e saktë kur është lidhur kontrata dhe është paguar premia e sigurimit (zakonisht kjo bëhet në policën e sigurimit).⁸³²

Mund të ndodhë që të lidhet kontrata e sigurimit në kohë të caktuar, p.sh., për një vit, sipas së cilës kontraktuesi i sigurimit ka pasur detyrimin të paguajë preminë me rastin e lidhjes së kontratës, por vonohet disa ditë me pagesën, ashtu që mbulesa e sigurimit ka filluar për aq ditë më vonë, atëherë kur është paguar premia. Në një situatë të këtillë, edhe pse kontrata është lidhur për një vit, për aq ditë sa nuk ka qenë e paguar premia, i siguruari nuk e ka gëzuar mbulesën e sigurimit. Shtrohet pyetja nëse ka të drejtë apo jo i siguruari për vazhdimin e kontratës për aq ditë sa është vonuar me pagesën e premisë, për të cilat nuk e ka gëzuar të drejtën e sigurimit. Duke pasur parasysh rregullat e sigurimit në përgjithësi, konsiderojmë se ai nuk ka të drejtë për vazhdimin e kontratës për aq ditë, derisa të përmbushet afati prej një viti nga momenti i pagesës së premisë. Kjo për arsye se premia nuk është paguar për shkak të lëshimit të kontraktuesit të sigurimit dhe jo të siguruarit.

“Te kontrata për sigurimin, premia e sigurimit paguhet në afatet e kontraktuara, por nëse duhet paguar menjëherë në tërësi, ajo paguhet me rastin e lidhjes së kontratës. Në rastet kur premia nuk është paguar në këtë mënyrë, atëherë nuk është paraqitur dhe nuk ekziston as detyrimi i të paditurit si sigurues që të paguajë shumën e kontraktuar të sigurimit, pasi që ky shpërblim arrin për pagesë ditën e ardhshme pas ditës së pagesës së premisë”⁸³³

2. Në par. 2 të këtij neni është rregulluar situata e mundshme në rastet kur është kontraktuar që *premia e sigurimit të paguhet pas lidhjes së kontratës*. Në situata të këtilla kur është kontraktuar që premia e sigurimit të paguhet pas lidhjes së kontratës së sigurimit, fillimi i mbulesës së sigurimit nuk varet nga pagesa e premisë (siç ishte rasti nga par. 1 i këtij neni). Sipas par. 2 të nenit 934 të LMD, në situatat kur është kontraktuar që premia të paguhet pas lidhjes së kontratës, detyrimi i siguruarit për të paguar shpërblimin ose shumën e caktuar në kontratë fillon nga data e caktuar në kontratë, si ditë e fillimit të sigurimit. Siç shihet, fillimi i bartjes së rrezikut nga ana e siguruarit përcaktohet në kontratë, ashtu që caktohet dita kur fillon sigurimi dhe dita kur ai përfundon. Nga dita e përcaktuar në kontratë, siguruesi ka detyrimin të paguajë shumën e sigurimit, në rast se ndodh rasti i sigurimit, edhe atëherë kur ende nuk e ka paguar preminë. Në rastet kur me kontratë është përcaktuar dita e fillimit

832 Shmangia e këtillë nga rregulla e parashikuar në par. 1 të nenit 934 është e mundur në bazë të nenit 921 par. 1 të LMD, pasi që me këtë do të mbroheshin interesat e të siguruarit, ashtu që palëve kontraktuese u lejohet mundësia të veprojnë siç dëshirojnë.

833 Gjyk. Sup. e R. Sr. Rev. 136/95 dt. 05.04.1995.

të sigurimit pas lidhjes së kontratës, sigurimi nis nga fillimi i ditës së nesërme pas ditës së caktuar në kontratë për fillimin e sigurimit, duke filluar nga ora 0.00.

3. Në rastet kur në kontratë është parashikuar që mbulesa e sigurimit të fillojë nga lidhja e kontratës, kjo nënkupton nga fillimi i ditës së nesërme duke filluar nga ora 0.00, ndërsa pagimi i premisë është parashikuar të bëhet pas lidhjes së kontratës, në afatin e caktuar, kontraktuesi i sigurimit ka detyrimin ta paguajë preminë brenda afatit të kontraktuar. Në rast të vonesës me pagimin e premisë së sigurimit, siguroesi ka të drejtë të zgjedh njërën nga këto kërkesa:

- ta shkëpusë kontratën e sigurimit për shkak të mospërbushjes së detyrimit,
- të kërkojë nga kontraktuesi i sigurimit ta përmbushë detyrimin kontraktues,
- ta kompensojë shumën e premisë nga shpërblimi i sigurimit.

E drejta e siguroesit për shkëputjen e kontratës së sigurimit për shkak të mospagesës së premisë pas lidhjes së kontratës, në afatin e kontraktuar, është rregulluar me par. 3 të nenit 934 të LMD. Rregulla e kësaj dispozite është e bazuar në rregullën e përgjithshme për shkëputjen e kontratës për shkak të mospërbushjes, në rastet kur përmbushja e detyrimit brenda afatit nuk është element qenësor i kontratës.⁸³⁴ Sipas kësaj rregulle, debitori mban të drejtën ta përmbushë detyrimin edhe pas kalimit të afatit të kontraktuar për përmbushje, ndërsa kreditori ka të drejtë ta shkëpusë kontratën, pasi t'ia ketë lënë debitorit një afat të arsyeshëm plotësues për përmbushjen e detyrimit. Sipas dispozitës nga par. 3 i këtij neni, nëse premia e kontraktuar për përmbushje pas lidhjes së kontratës nuk paguhet nga kontraktuesi i sigurimit ose nga personi tjetër i interesuar, kontrata e sigurimit zgjidhet sipas ligjit, pas kalimit të afatit prej 30 ditësh nga dita kur kontraktuesi i sigurimit është njoftuar me letër-rekomande për arritjen për pagesë të premisë. Nga kjo rrjedh se kusht për zgjidhjen e kontratës sipas ligjit, për shkak të mos pagesës së premisë, është që siguroesi me letër-rekomande ta njoftojë kontraktuesin për kohën e arritjes për pagesë të premisë.⁸³⁵ Ky njoftim me letër-rekomande mund të bëhet para ose pas arritjes së afatit për pagesë të premisë. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit është njoftuar me letër-rekomande para arritjes për pagesë të premisë, afati 30-ditor nuk mund të kalojë dhe nuk mund të zgjidhet kontrata para se të kenë kaluar 30 ditë nga data e arritjes për pagesë të premisë.

*“Kontrata e sigurimit pushon sipas ligjit, në rast se kontraktuesi i sigurimit nuk e paguan preminë pas lidhjes së kontratës, edhe pas kalimit të afatit prej 30 ditësh pasi siguroesi e ka njoftuar me letër-rekomande për arritjen e premisë për pagesë. Kontratën në këtë rast nuk mund ta shkëpusë kontraktuesi i sigurimit, cili nuk e ka përmbushur detyrimin e arritur për pagesë. Kjo e drejtë i takon vetëm siguroesit, nga i cili varet nëse do ta realizojë apo jo atë”.*⁸³⁶

834 Shih nenin 108 të LMD.

835 Shih nenin 112 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të LMD.

836 Nga praktika gjyqësore krahasuese në rajon.

Në situatat kur rasti i sigurimit ndodh në këtë afat plotësues, para se të jetë paguar premia e sigurimit, siguruksi ka detyrimin për të paguar shumën e kontraktuar të sigurimit, ndërsa kontraktuesi i sigurimit ka detyrimin të paguajë preminë e kontraktuar. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit nuk e paguan preminë as në këtë afat plotësues, me kalimin e afatit plotësues, zgjidhet kontrata e sigurimit, kur kontraktuesi i sigurimit nuk ka të drejtën e mbulesës së sigurimit; ai e ka detyrimin për të paguar pjesën proporcionale të premisë për kohën derisa është zgjidhur kontrata.

3(a). Edhe pse me këtë dispozitë ligjore nuk parashikohet shprehimisht, në situata të këtilla kur premia që është dashur të paguhet në afatin e caktuar pas lidhjes së kontratës, nuk është paguar brenda këtij afati, siguruksi ka të drejtë të kërkojë me padi, nëpërmjet gjykatës, që kontraktuesi i sigurimit ta përmbushë detyrimin kontraktues ndaj tij. Me paraqitjen e kësaj kërkesë, siguruksi jep të kuptohet se, edhe pse premia e sigurimit nuk është paguar, ai dëshiron që kontrata të ekzistojë dhe të prodhojë efekte juridike. Në këto raste siguruksi, përpos premisë, do të ketë edhe të drejtën e kamatën ndëshkuese, nga dita e arritjes për pagesë të premisë.

3(b). Një pasojë tjetër juridike për shkak të mospagimit të premisë brenda afatit të kontraktuar pas lidhjes së kontratës së sigurimit, është kompensimi i shumës së premisë nga shuma e kontraktuar e sigurimit. Bazuar në rregullën e përgjithshme për të drejtën e kompensimit të kërkesave ndërmjet dy palëve, siguruksi ka të drejtë ta kompensojë preminë për aq sa i ka borxh kontraktuesi i sigurimit, nga shuma e kontraktuar e sigurimit.⁸³⁷ Kështu, në qoftë se ndodh rasti i sigurimit dhe kontrata e sigurimit nuk është zgjidhur më herët për shkak të mospagimit të premisë së sigurimit, siguruksi ka të drejtë që nga shpërblimi i sigurimit ta marrë preminë në shumën që i ka borxh kontraktuesi i sigurimit, me kamatën përkatëse.

4. Redaktimi gjuhësor e bën të paqartë edhe par. 4 të nenit 934. Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar mundësia e denoncimit të kontratës së sigurimit, e cila do të ketë për pasojë edhe pushimin së ekzistuarit të mbulesës së sigurimit. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit është në vonesë për të paguar preminë e sigurimit, që ka arritur për pagesë pas lidhjes së kontratës, pas kalimit të afatit të parashikuar në par. 3 të këtij neni, siguruksi ka të drejtë ta denoncoj kontratën pa paralajmërim. Denoncimi i bërë i kontratës në këtë rast bëhet efektiv pas kalimit të afatit që është rregulluar në par. 3 të këtij neni, ashtu që, me kalimin e afatit prej 30 ditësh nga dita kur kontraktuesit të sigurimit i është dorëzuar letra-rekomande, me të cilën është njoftuar për arritjen për pagesë të premisë, pushon edhe mbulesa e sigurimit, përkatësisht detyrimi i siguruksit për pagesën e shpërblimit të sigurimit. Me këtë i siguruari më nuk ka detyrimin të paguajë shpërblimin e detyrimit që del nga kontrata e sigurimit.

5. Edhe në paragrafin 5 të nenit 934 bëhet fjalë për kontratën e sigurimit, me të cilën është kontraktuar pagimi i premisë pas lidhjes së kontratës. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, ekziston mundësia e pagimit të premisë së sigurimit pas afatit të përcaktuar në par. 3 të këtij neni, por brenda afatit prej 1 viti nga dita kur premia ka arritur për pagesë. Në

⁸³⁷ Shih nenin 317 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen në komentin për pjesën e përgjithshme të këtij neni.

situata të këtilla, siguruesi ka detyrimin të paguajë shpërblimin e dëmit, shumën e siguruar, në rast të paraqitjes së rastit të sigurimit, nga fillimi i ditës së nesërme, që nga ora 0.00, pasi të jetë paguar premia me kamatëvonesë. Siç shihet, kjo vlen vetëm për ato raste kur premia paguhet para kalimit të afatit prej 1 viti, nga dita kur premia ka arritur për pagesë. Pas kalimit të afatit prej 1 viti nga dita kur premia ka arritur për pagesë, siguruesi nuk ka kurrfarë detyrimi ndaj kontraktuesit të sigurimit.

6. Rregullat e parashikuara me këtë nen nuk vlejnë për të gjitha llojet e sigurimit. Kështu, në bazë të par. 6 të nenit 934, dispozitat e këtij neni nuk zbatohen te sigurimi i jetës apo të shëndetit, por zbatohen te llojet e tjera të sigurimit.

III. NJOFTIMI I SIGURIMIT PËR NDRYSHIMET E RREZIKUT

Neni 935. Rritja e rrezikut

1. Kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë, që kur është fjala për sigurimin e pasurisë, ta njoftojë siguruesin për çdo ndryshim të rrethanës që mund të ketë rëndësi për vlerësimin e rrezikut, e kur është fjala për sigurimin e personave, atëherë vetëm në qoftë se rreziku është shtuar për shkak se personi i siguruar ka ndryshuar profesionin.
2. Ai ka për detyrë ta njoftojë pa vonesë siguruesin për rritjen e rrezikut, në qoftë se rritja e rrezikut ka ndodhur pa veprimin e tij, atëherë ka për detyrë ta njoftojë brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pasi të ketë mësuar për këtë.
3. Në qoftë se rritja e rrezikut është aq sa që siguruesi nuk do ta lidhte kontratën po të kishte ekzistuar një gjendje e tillë në momentin e lidhjes së saj, ai mund ta zgjidhë kontratën.
4. Në qoftë se shtimi i rrezikut është aq i madh, sa që siguruesi do ta lidhte kontratën vetëm me ndonjë premi më të madhe, po të kishte ekzistuar një gjendje e tillë në çastin e lidhjes së kontratës, ai mund t'i propozojë kontraktuesit të sigurimit shkallën e re të premisë.
5. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit nuk pranon shkallën e re të premisë brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të propozimit të shkallës së re, kontrata shuhet në bazë të ligjit.
6. Kontrata mbetet në fuqi dhe siguruesi nuk mund t'i shfrytëzojë më autorizimet që t'i propozojë kontraktuesit të sigurimit shkallën e re të premisë ose ta zgjidhë kontratën në qoftë se nuk i shfrytëzon këto autorizime brenda një (1) muaji nga data kur të ketë mësuar në cilëndo mënyrë qoftë për rritjen e rrezikut, apo në qoftë se edhe para skadimit të këtij afati shprehet në ndonjë mënyrë se është i pajtimit me zgjatjen e kontratës (në qoftë se pranon preminë, paguan shpërblimin për rastin e siguruar që ka ndodhur pas kësaj rritje e të ngjashme).

Vështrim i përgjithshëm.- Me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit, një nga detyrat e kontraktuesit të sigurimit është ta njoftojë siguroesin për të gjitha rrethanat e rëndësishme për të cilat është në dijeni, përkatësisht që nuk kanë mundur të jenë të panjohura për të e të cilat janë me ndikim për vlerësimin e rrezikut.⁸³⁸ Me rastin e shprehjes së vullnetit për të lidhur kontratën e sigurimit, palët i kanë parasysh të gjitha këto rrethana që kanë ekzistuar dhe për të cilat kanë ditur në momentin e lidhjes së kontratës dhe në bazë të të cilave vendosin nëse do ta lidhin kontratën apo jo dhe me çfarë kushtesh. Mirëpo, ekziston mundësia që gjatë afatit të kontraktuar të ndryshojnë rrethanat që kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës. Për shkak të ndryshimeve të këtyre rrethanave, ndryshon edhe pesha e rrezikut që ka ekzistuar në momentin e kontraktimit dhe kjo nënkupton ndryshimin e rrezikut. Për shkak të ndryshimit të rrethanave, rreziku mund të ndryshohet: duke u rritur⁸³⁹(përkeqësuar), duke u përmirësuar apo duke mos ekzistuar më. Në nenin 935 të LMD janë parashikuar detyrimet e kontraktuesit të sigurimit apo të të siguarit që ta njoftojnë siguroesin në rastet kur gjatë afatit të sigurimit kanë ndryshuar rrethanat e sigurimit, gjë që ka çuar në përkeqësimin e rrezikut dhe për pasojat në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi. Nëse shikohet përmbajtja e kësaj dispozite del se detyrimi për njoftimin e siguroesit për ndryshimin e rrethanave i përket kontraktuesit të sigurimit. Mirëpo, për ndryshimin e rrethanave, përkatësisht përkeqësimin e tyre, mund ta njoftojë siguroesin edhe shfrytëzuesi i sigurimit nga kontrata e sigurimit për llogari të huaj apo në interes të tjetrit, pasi që të gjitha detyrimet që i përkasin kontraktuesit të sigurimit kanë të bëjnë edhe me të siguarin, përkatësisht shfrytëzuesin e sigurimit. Kjo veçanërisht është me rëndësi edhe me qëllim të mënjanimin të pasojave të mundshme ligjore.⁸⁴⁰

1. Në par. 1 të nenit 935 të LMD parashikohet detyrimi i kontraktuesit të sigurimit (gjithmonë mendohet edhe për të siguarin) ta njoftojë siguroesin për ndryshimin e rrethanave me ndikim për vlerësimin e rrezikut. Me këtë dispozitë ligjore bëhet dallimi mes detyrimit të kontraktuesit të sigurimit në rastet e sigurimit të pasurisë, nga ato të sigurimit të personave. Kështu, kur kemi të bëjmë me sigurimin e pasurisë, kontraktuesi i sigurimit duhet ta njoftojë siguroesin për çdo ndryshim të rrethanave që mund të kenë rëndësi në vlerësimin e rrezikut. Se cilat janë rrethanat me rëndësi, varet si nga objekti, ashtu edhe nga rreziku i siguar. Me një konstatim të përgjithshëm do të mund të thuhej se të rëndësishme janë rrethanat për ekzistimin e të cilave në momentin e lidhjes së kontratës kontraktuesi i sigurimit ka pasur detyrimin ta lajmërojë siguroesin, duke konsideruar se nga ato varet vlerësimi i rrezikut dhe shuma e premisë.⁸⁴¹ Ndërkaq, nga dispozitat e tjera të këtij neni, të parashikuara në par. 3 dhe 4, mund të vihet në përfundimin se cilat rrethana do të konsiderohen me rëndësi për vlerësimin e rrezikut.

838 Shih nenin 928 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

839 Rritje të rrezikut përfaqëson rritja e shkallës së mundësisë së paraqitjes së rastit të sigurimit apo intensitetit të tij.

840 Shih nenin 936 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

841 Shih nenin 928 të këtij Ligji.

*“Rritje e rrezikut ndodh atëherë kur me automjetin, i cili është siguruar si automjet për nevoja personale, ushtrohet profesioni taksi. Për këtë rritje të rrezikut paditësi nuk e ka lajmëruar të paditurin, gjë që ka qenë i detyruar ta bënte”.*⁸⁴²

Kur është fjala për sigurimin e personave, kontraktuesi i sigurimit ka detyrimin ta njoftojë siguresin vetëm në qoftë se rreziku është shtuar për shkak se personi i siguruar e ka ndërruar profesionin që e ka pasur me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit. Edhe në rast të ndërrimit të profesionit njoftimi duhet të bëhet vetëm në rastet kur, me ndërrimin e profesionit, ndodh rritja e rrezikut.

2. Rritja e rrezikut mund të ndodhë: a) nga veprimet apo mosveprimet (lëshimet) e të siguruarit ose b) nga faktorët e jashtëm mbi të cilët i siguruari nuk ka pasur mundësi të ndikojë. Në par. 2 të nenit 935 të këtij Ligji parashikohen afatet brenda të cilave duhet njoftuar siguresi nga kontraktuesi i sigurimit për ndryshimin e rrethanave. Për të pasur kontraktuesi i sigurimit të drejtën e mbulesës nga rreziku i rritur, ai duhet ta njoftojë siguresin për këtë brenda afateve të caktuara ligjore. Në situatat kur rritja e rrezikut ka ndodhur me veprimin e kontraktuesit të sigurimit, përkatësisht me mosndërmarrjen e një veprimi i cili është dashur të ndërmerret, ai ka detyrimin ta njoftojë *pa vonesë*⁸⁴³ siguresin për rritjen e rrezikut. Përndryshe, në qoftë se rritja e rrezikut ka ndodhur pa veprimin e kontraktuesit të sigurimit, ai ka detyrimin ta njoftojë për këtë siguresin brenda 14 ditësh, nga dita kur ka mësuar apo është dashur të dinte për këtë.⁸⁴⁴

3. Në par. 3 të nenit 935 parashikohet e drejta e siguresit në rast të rritjes së rrezikut, varësisht nga intensiteti i rritjes së tij. Për vlerësim të intensitetit të rrezikut të sigurimit merret vetëm vlerësimi i rritjes nga njëra palë kontraktuese, sjellja e siguresit në rast të pranisë së kësaj rrethane në momentin e lidhjes së kontratës. Sipas kësaj dispozite ligjore, siguresi ka të drejtën ta zgjidhë kontratën, në qoftë se rritja e rrezikut është e tillë që do të bënte që ai nuk do ta lidhte kontratën, sikur të kishte ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës. Në bazë të këtij autorizimi ligjor, ai mund ta zgjidhë kontratën me një deklaratë të njëanshme, pa ndonjë afat të caktuar revokimi. Kontrata pushon së prodhuari efekte juridike nga momenti kur siguresi ia ka komunikuar kontraktuesit të sigurimit deklaratën për shkëputjen e kontratës. Nëse do ta shfrytëzojë këtë të drejtë apo jo, varet nga vetë ai. Në rast të zgjidhjes së kontratës, siguresi do të duhej ta kthente pjesën e premisë së paguar që nga zgjidhja e kontratës, deri në fund të afatit të sigurimit⁸⁴⁵

4. Edhe në par. 4 të këtij neni parashikohen të drejtat e siguresit në rast të rritjes së rrezikut, duke u bazuar, po ashtu, në intensitetin e rritjes së tij. Sipas kësaj dispozite ligjore, në rast se rreziku është shtuar në masën sa që siguresi, sikur të kishte ekzistuar një gjendje e tillë në momentin e lidhjes së kontratës, kontratën do ta lidhte vetëm

842 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 2517/96 dt. 26.03.1997.

843 Shprehja ligjore “*pa vonesë*” nënkupton menjëherë pas paraqitjes së rrethanës nga e cila është rritur rreziku

844 Shih nenin 928 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

845 Shih nenin 930 par. 3 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë dispozitë.

me ndonjë premi më të madhe nga ajo që është kontraktuar. Në këtë situatë, siguruesi mund t'i propozojë kontraktuesit të sigurimit një shkallë tjetër të premisë, gjithsesi më të madhe nga ajo që është kontraktuar. Në rast se siguruesi propozon një premi tjetër që dallon nga ajo e kontraktuar, ai më nuk ka të drejtë të shkëpusë kontratën derisa kontraktuesi i sigurimit të sqarohet lidhur me propozimin apo derisa të kalojë afati i parashikuar ligjor i sqarimit. Kontraktuesi i sigurimit duhet të vendosë nëse e pranon propozimin apo jo. Në rast se e pranon shumën e re të premisë, kontrata vazhdon të ekzistojë me premi të sigurimit të ndryshuar nga dita e pranimit.

5. Në par. 5 të nenit 935 të LMD është parashikuar afati brenda të cilit kontraktuesi i sigurimit duhet të sqarohet lidhur me shkallën e re të premisë të propozuar nga siguruesi, për shkak të rritjes së rrezikut, si dhe për pasojat juridike në rast të mospranimit të propozimit. Afati ligjor për sqarim lidhur me propozimin është 14 ditë nga dita e pranimit të propozimit. Në rast se kontraktuesi i sigurimit nuk e pranon brenda këtij afati shkallën e re të premisë sipas propozimit të siguruesit, kontrata pushon sipas ligjit. Kontrata pushon sipas ligjit si në rastet kur kontraktuesi brenda afatit të sipërsëhënuar deklaron se nuk e pranon preminë e re të propozuar, ashtu edhe kur nuk sqarohet fare brenda afatit të parashikuar prej 14 ditësh.

6. Edhe siguruesi mund t'i përdorë vetëm brenda afatit të caktuar autorizimet e parashikuara ligjore për shkak të rritjes së rrezikut. Në rast se gjatë afatit të sigurimit ndryshojnë rrethanat e rëndësishme që e rrisin rrezikun, siguruesi mund të propozojë brenda një (1) muaji një shkallë të re të premisë ose ta zgjidh kontratën. Nëse këtë nuk e propozon brenda afatit prej një muaji nga dita kur në çfarëdo mënyre ka mësuar për rritjen e rrezikut, ai e humb të drejtën t'i propozojë kontraktuesit të sigurimit një shkallë të re të premisë ose ta zgjidhë kontratën. Këto autorizime nuk mund t'i shfrytëzojë siguruesi edhe në rast se para kalimit të këtij afati prej një muaji, nga dita kur ka mësuar për rritjen e rrezikut, me veprime konkludente e shpreh vullnetin e vet për mbajtjen e kontratës në fuqi. Kjo ndodh kur gjatë afatit prej një muaji, nga dita kur ka mësuar për rritjen e rrezikut, kërkon vazhdimin kontratës, pranon preminë, e paguan shumën e sigurimit për rastin e sigurimit kur ai ka ndodhur pas rritjes së rrezikut etj.

Neni 936. Kur rasti i siguruar ndodh ndërkohë

Në qoftë se rasti i siguruar ka ndodhur para se siguruesi të jetë njoftuar për shtimin e rrezikut ose pasi të jetë njoftuar për shtimin e rrezikut, por para se ta ketë zgjidhur kontratën ose të ketë arritur marrëveshjen me kontraktuesin e sigurimit për rritjen e premisë, shpërblimi zvogëlohet në përpjesëtim ndërmjet shkallës së premive të paguara dhe premive që do të duheshin të paguhen sipas rritjes së rrezikut.

Të gjitha situatat e rregulluara në nenin paraprak kanë të bëjnë me rastet kur siguruesi është njoftuar për ndryshimin e rrezikut para se të ndodhë rasti i siguruar. Në nenin 936 bëhet fjalë për dy situata të krijuara pasi ka ndodhur rasti i sigurimit. Në të parën, kur

rrethanat e rëndësishme të sigurimit me ndikim në rrezikun e sigurimit kanë ndryshuar, ashtu që rreziku është rritur dhe, para se të njoftohet për këtë siguruesi, ka ndodhur rasti i sigurimit. Në situatën tjetër, kontraktuesi i sigurimit e ka njoftuar siguruesin për rritjen e rrezikut dhe ndërkohë, pas këtij njoftimi, por para se të jetë zgjidhur kontrata ose para se të arrihej marrëveshja për rritjen e premisë, ka ndodhur rasti i sigurimit. Për të dy këto situata Ligji nuk bënë dallime, ashtu që në të dyja situatat shpërblimi i sigurimit zvogëlohet në përpjesëtim me dallimin ndërmjet premive të paguara dhe premive që do të duheshin paguar sipas rrezikut të shtuar.⁸⁴⁶ Çështja duhet zgjidhur në këtë mënyrë, pavarësisht nga ajo nëse rasti i sigurimit është shkaktuar nga rreziku i shtuar më vonë, për të cilin siguruesi nuk ka qenë i njoftuar, apo nga ndonjë rrezik tjetër, me të cilin rreziku i shtuar nuk ka pasur lidhje.

Neni 937. Zvogëlimi i rrezikut

- 1. Në rastin kur pas lidhjes së kontratës për sigurimin të ketë ndodhur zvogëlimi i rrezikut, kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë të kërkojë zvogëlimin përkatës të premisë, duke logaritur që nga dita kur për zvogëlimin ta ketë njoftuar siguruesin.**
- 2. Në qoftë se siguruesi nuk është pajtuar me zvogëlimin e premisë, kontraktuesi i sigurimit mund ta zgjidhë kontratën.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit merren parasysh të gjitha rrethanat me rëndësi për vlerësimin e rrezikut të lajmëruara nga kontraktuesi i sigurimit. Në bazë të këtyre rrethanave edhe caktohet sasia e shumës së siguruar dhe sasia e premisë së sigurimit. Gjatë kohës së sigurimit, këto rrethana mund të ndryshojnë. Në rastet kur me ndryshimin e tyre rritej rreziku, ishte detyrim i kontraktuesit të sigurimit që pa vonesë të lajmëronte për këtë siguruesin, duke lindur kështu pasojat e caktuara juridike.⁸⁴⁷ Neni 937 rregullon situatën kur, pas lidhjes së kontratës, gjatë afatit të sigurimit, ndryshojnë rrethanat që kanë ekzistuar me rastin e lidhjes së kontratës, ashtu që, me ndryshimin e tyre, pakësohet zvogëlohet.

1. Në rast se ndryshimi i rrethanave pas lidhjes së kontratës çon në zvogëlimin e rrezikut, kontraktuesi i sigurimit duhet ta lajmërojë për këtë siguruesin, pasi që fiton të drejtën të kërkojë zvogëlimin e premisë. Me par. 1 të këtij neni është rregulluar edhe momenti nga i cili do të zvogëlohet premia për shkak të zvogëlimit të rrezikut, ashtu që pavarësisht nga momenti kur janë paraqitur rrethanat për shkak të cilave është zvogëluar rreziku, premia do të zvogëlohet nga momenti kur kontraktuesi i sigurimit e ka njoftuar për këtë siguruesin. Derisa te rritja e rrezikut premia rritej në përpjesëtim me shkallën e rritjes së rrezikut, edhe në këtë rast premia zvogëlohet në proporcion me shkallën e zvogëlimit të rrezikut. Edhe në këtë rast nuk është me rëndësi dhe nuk shqyrtohet shkaku i paraqitjes së rrezikut, veçanërisht nëse kjo ka ndodhur në bazë të ndonjë veprimi të kontraktuesit të sigurimit apo në ndonjë mënyrë tjetër.

846 Rasti duhet zgjidhur në mënyrë të ngjashme sikur te rastet e parashikuara nga neni 930 par. 4 të LMD – shih këtë nen dhe komentën e dhënë lidhur me të.

847 Shih nenin 935 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

2. Për zvogëlimin e premisë për shkak të zvogëlimit të rrezikut nevojitet pëlqimi i siguruesit. Siguruesi mund të mos e pranojë propozimin e kontraktuesit të sigurimit që të zvogëlohet premia për shkak të zvogëlimit të rrezikut. Nuk është me rëndësi arsyeja e refuzimit të këtij propozimi. Zakonisht kjo bëhet për shkak se ai konsideron se nuk ka ndodhur zvogëlimi i rrezikut ose se zvogëlimi nuk është i asaj mase që do të çonte në zvogëlimin e premisë. Sipas par. 2 të këtij neni, nëse siguruesi nuk pajtohet ta zvogëlojë preminë, kontraktuesi i sigurimit mund ta zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën. Nëse kontrata zgjidhet në këtë mënyrë dhe për këtë arsye, siguruesi ka detyrimin t'ia kthejë kontraktuesit të sigurimit pjesën e premisë që i përgjigjet pjesës së afatit të kontraktuar të sigurimit, i cili nuk ka kaluar deri atëherë. Në këtë dispozitë ligjore përmendet vetëm kontraktuesi i sigurimit, mirëpo, duke i pasur parasysh të drejtat dhe detyrimet e palëve që dalin nga kontrata për sigurimin, këtë të drejtë e ka edhe vetë i siguruari.

Neni 938. Detyrimi i njoftimit për paraqitjen e rastit të sigurimit

- 1. Kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë, përveç në rastin e sigurimit të jetës ta njoftojë siguruesin për paraqitjen e rastit të sigurimit jo më vonë se tri (3) ditë që kur ai vihet në dijeni për këtë.**
- 2. Në qoftë se nuk e kryen këtë detyrim të vet brenda kohës së caktuar, ai ka për detyrë t'ia shpërblejë siguruesit dëmin, të cilin siguruesi do ta kishte për këtë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në nenin 938 të LMD bëhet fjalë për detyrimin e *kontraktuesit të sigurimit* pas ndodhjes së rastit të sigurimit dhe për pasojat e mundshme në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi. Edhe te kjo dispozitë ligjore bëhet fjalë për detyrimin e kontraktuesit të sigurimit dhe jo për të siguruarin a shfrytëzuesin e sigurimit. Pavarësisht nga ajo që, sipas kësaj dispozite, ky detyrim parashikohet për kontraktuesin e sigurimit, konsiderojmë se këtë mund ta bëjë edhe i siguruari ose shfrytëzuesi i sigurimit dhe se ky është detyrim themelor i tyre, sepse vetëm i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i sigurimit, mund të paraqesë kërkesë ndaj siguruesit për shpërblimin e dëmit dhe të pranojë shpërblimin e sigurimit, për të cilën arsye atyre edhe u përkasin detyrimet përkitazi me paraqitjen e rastit të sigurimit. Me njoftimin për shkaktimin e dëmit, i mundësohet siguruesit që sa më parë të vërtetojë nëse me të vërtetë dëmi është shkaktuar nga rreziku i siguruar apo bëhet fjalë për ndonjë ngjarje tjetër që ka qenë e siguruar, përkatësisht të vërtetojë shkakun, natyrën dhe sasinë e dëmit si dhe të ndërmarrë masa adekuate për zvogëlimin e tij.

1. Sipas par. 1 të nenit 938 të LMD, *kontraktuesi i sigurimit* ka për detyrë, përveç në rast të sigurimit të jetës, ta njoftojë siguruesin se ka ndodhur rasti i sigurimit, duke bërë këtë brenda tri (3) ditësh nga dita kur ka mësuar për ndodhjen e tij. Konsiderojmë se redaktimi gjuhësor i kësaj dispozite ligjore përkitazi me subjektin që e ka këtë detyrim, është i gabuar. Siç u theksua edhe në vështrimin e përgjithshëm të kësaj dispozite, detyrimi për ta njoftuar siguruesin për ndodhjen e rastit të sigurimit i përket *të siguruarit*. Kjo mund

të shpjegohet me faktin se, në rastet kur kontraktuesi i sigurimit dhe i siguruari janë dy persona, kontraktuesi i sigurimit nuk është i interesuar në atë masë sa është i siguruari për ta njoftuar siguruesin se është paraqitur rasti i sigurimit. I siguruari duhet ta pranojë shpërblimin nga sigurimi, përkatësisht shumën e sigurimit për dëmin e pësuar dhe për këtë arsye ai është i interesuar që siguruesi të njoftohet për shkaktimin e dëmit, prandaj edhe detyrimi për ta njoftuar siguruesin për ndodhjen e rastit të sigurimit i përket atij.⁸⁴⁸ Dispozita ligjore, e këtillë siç është, me këtë detyrim të parashikuar për *kontraktuesin e sigurimit*, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të neni 939 të këtij Ligji, sipas së cilës është nule dispozita e kontratës së sigurimit, me të cilën parashikohet humbja e të drejtës së shpërblimit të sigurimit, në qoftë se *i siguruari* nuk e përmbush ndonjë detyrim të parashikuar me ligj apo me kontratë.⁸⁴⁹ Siç del nga kjo dispozitë, ky detyrim i përket të siguarit dhe jo kontraktuesit të sigurimit. Sidoqoftë, në të gjitha ligjet e shteteve të rajonit, në dispozitat përkitazi me detyrimin për njoftimin e ndodhjes së rastit të sigurimit, ky detyrim i përket *siguruesit*,⁸⁵⁰ pra mendojmë kjo çështje duhet rregulluar në të njëjtën mënyrë edhe me këtë Ligj.

Detyrimi për ta njoftuar siguruesin se ka ndodhur rasti i sigurimit, përpos në këtë dispozitë ligjore, zakonisht parashikohet edhe në kushtet e sigurimit.

“Në rastet kur në kushtet e sigurimit është parashikuar se kontraktuesi i sigurimit, i siguruari apo shfrytëzuesi i sigurimit janë të detyruar të lajmërojnë çfarëdo dëmi në afat prej tri ditësh, nga dita e kur ka ndodhur rasti, përkatësisht nga dita kur ka mësuar për dëmin dhe ka mundur ta paraqesë atë, konsiderohet se detyrimi është përmbushur atëherë kur cilido nga këta persona dëmin e lajmëron brenda afatit të caktuar dhe në këtë rast nuk është me rëndësi përse personat tjerë këtë nuk e kanë lajmëruar atë.”⁸⁵¹

Afati i caktuar ligjor prej tri ditësh, nga dita kur i siguruari ka mësuar, përkatësisht është dashur të dinte për ndodhjen e rastit të sigurimit, mund të kontraktohet ndryshe nga ana e palëve kontraktuese dhe ai të jetë më i gjatë se tri ditë. Në rast se kontraktuesit parashikojnë një afat më të gjatë se tri ditë, edhe pse nuk është në pajtim me ligjin, ai është i vlefshëm, ngase është në interes të të siguarit.⁸⁵²

Për ndodhjen e rastit duhet njoftuar drejtpërdrejt siguruesi ose përfaqësuesi i sigurimit ose i autorizuari, në mënyrën siç është parashikuar në kontratë apo në kushtet e sigurimit.⁸⁵³ Me ligj nuk është përcaktuar as përmbajtja e njoftimit dhe cilat të dhëna duhet të përmbajë ai.

848 Në të gjitha LMD-ët e shteteve të rajonit, të dala nga ish-Federata Jugosllave, ky detyrim parashikohet për të siguarin e jo për kontraktuesin e sigurimit:

849 Shih nenin 939 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

850 KCRSH, neni 1126 parashikon: “Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, *i siguruari* detyrohet të njoftojë siguruesin brenda afatit të parashikuar në kontratë”. Ky detyrim i *të siguarit* parashikohet edhe në nenin 1014 të LMD të MZ (2008), në nenin 941 të LMD të R. Kr. (2005), në nenin 917 të LMD të R. Sr. (1978).

851 Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. nr. 1578/00 dt. 6 tetor 2001.

852 Shih nenin 921 par. 2 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

853 Shih nenin 927 të LMD.

Edhe kjo çështje duhet parashikuar në kontratë, përkatësisht në kushtet e sigurimit.

2. Në par. 2 të nenit 938 të LMD janë parashikuar pasojat juridike për shkak të mospërbushjes së detyrimit të lajmërimit me kohë, siç parashikohet në paragrafin e parë të kësaj dispozite ligjore. Sipas kësaj dispozite ligjore, në qoftë se nuk e përmbush këtë detyrim brenda afatit të caktuar, ai ka detyrimin që siguruiesit t'ia shpërblejë dëmin të cilin e ka pësuar për shkak të moslajmërimit me kohë. Siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, në rast të moslajmërimit brenda afatit të parashikuar, siguruiesi nuk lirohet nga detyrimi për pagesën e shumës së sigurimit duke iu referuar lëshimin e të siguruarit për ta lajmëruar siguruiesin për dëmin e shkaktuar për këtë arsye.⁸⁵⁴ Afati i parashikuar ligjor nuk është afat prekluziv, kështu që siguruiesi nuk lirohet nga detyrimi i kontraktuar për shkak të vonesës së siguruiesit për ta lajmëruar ndodhjen e rastit të sigurimit. Ai ka të drejtën e shpërblimit të dëmit të pësuar për këtë arsye, i cili mund të jetë pasojë e mosndërmarrjes me kohë të masave për zvogëlimin e tij dhe kjo ka bërë që ai të rritet në një masë, për shkak të zvogëlimit të efektit të masave të shpëtimit etj. Sasinë e këtij dëmi të pësuar për shkak të moslajmërimit me kohë siguruiesi mund ta kompensojë nga shuma e sigurimit të cilën duhet t'ia paguajë shfrytëzuesit të sigurimit.

Rregullat e parashikuara me dispozitën ligjore të nenit 938 të LMD nuk kanë të bëjnë me rastet e sigurimit të jetës, për shkak të specifikave që ka ky lloj i sigurimit. Te ky lloj i sigurimit, siguruiesi nuk mund të pësojë dëm për shkak të mosnjoftimit me kohë, pasi koha e lajmërimit të këtij rasti të sigurimit nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë dhe se detyrimi i tij është i përcaktuar në kontratë në mënyrë fikse.

Neni 939. Nuliteti i dispozitave për humbjen e të drejtave

Janë nule dispozitat e kontratës që parashikojnë humbjen e të drejtave në shpërblim ose në shumën e sigurimit, në qoftë se i siguruari pas shkaktimit të rastit të siguruar nuk i përmbush ndonjë nga detyrimet e parashikuara ose të kontraktuara.

Detyrimet e të siguruarit, në përgjithësi, dhe ato pas ndodhjes së rastit të sigurimit, në veçanti, mund të parashikohen në ligj ose të kontraktohen. Detyrimi për njoftimin e ndodhjes së rastit të sigurimit brenda afatit të caktuar nga neni 938 është një nga detyrimet që mund të ketë i siguruari pas ndodhjes së rastit të sigurimit. Sipas LMD, i siguruari ka detyrime të tjera, siç janë angazhimi për pengimin e paraqitjes së rastit të sigurimit dhe ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për shpëtimin e objektit të siguruar. Të kontraktuara mund jenë edhe shumë detyrime të tjera për të siguruarin, si: ndërmarrja e masave të shpëtimit, denoncimi i dëmit tek organet kompetente shtetërore, vërtetimi i dëmit etj. Me këtë dispozitë ligjore përkufizohet liria e përcaktimit të marrëdhënieve kontraktuese mes palëve, pas ndodhjes së rastit të sigurimit.

⁸⁵⁴ KCRSH, në nenin 1126 parashikon humbjen e të drejtës së pagesës së shpërblimit të sigurimit apo shumës së sigurimit (“Në qoftë se i siguruari nuk e bën këtë njoftim, siguruiesi ka të drejtë të mos e paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit”).

Sipas kësaj dispozite ligjore, janë nule dispozitat e kontratës me të cilat parashikohet humbja e të drejtës së shpërblimit ose të drejtë së shumës së sigurimit, në qoftë se *i siguruari*, pas ndodhjes së rastit të siguruar, nuk e përmbush ndonjëherë nga detyrimet e parashikuara me ligj ose nga ato që janë kontraktuar. Një nga detyrimet e të siguruarit është edhe lajmërimi për ndodhjen e rastit të sigurimit, brenda tri ditësh nga dita kur ai ka ndodhur, përkatësisht nga dita kur i siguruari ka mësuar për ndodhjen e tij. Pra, edhe nëse me kontratë të sigurimit kontraktuesit janë marrë vesh mes tyre që i siguruari ta humbë të drejtën e shpërblimit të sigurimit ose të shumës së siguruar, në qoftë se nuk e njofton siguresin për ndodhjen e rastit të sigurimit brenda afatit të caktuar, kjo megjithatë nuk do të ndodhë, pasi që kjo dispozitë e kontratës, sipas kësaj dispozite ligjore, është nule.

NËNKREU 4

DETYRIMET E SIGURUESIT

Neni 940. Pagimi i shpërblimit ose i shumës së kontraktuar

- 1. Kur paraqitet rasti i siguruar, siguresi ka për detyrë të paguaj shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë në afatin e kontraktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se katërmëdhjetë (14) ditë, duke llogaritur që nga data kur siguresi të ketë marrë njoftimin se ka ndodhur rasti i siguruar.**
- 2. Mirëpo, në qoftë se për caktimin e ekzistimit të detyrimit të siguresit ose të shumës së tij nevojitet një kohë, ky afat fillon të rrjedhë nga dita kur është vërtetuar ekzistimi i detyrimit të tij dhe shuma e tij.**
- 3. Në qoftë se shuma e detyrimit të siguresit nuk vërtetohet brenda afatit të caktuar në paragrafin 1. të këtij neni, siguresi ka për detyrë, me kërkesën e personit të autorizuar, ta paguaj shumën e pjesës jokontestuese të detyrimit të vet në emër të paradhënies.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në bazë të kuptimit të dhënë në këtë Ligj për kontratën e sigurimit,⁸⁵⁵ kontraktuesi i sigurimit ka detyrimin t'ia paguajë siguresit shumën e caktuar (preminë), ndërsa siguresi ka detyrimin, *nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar*, t'ia paguajë të siguruarit ose shfrytëzuesit të sigurimit shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas kontratës së sigurimit, paraqiten me rastin e lidhjes së kontratës, gjatë kohës sa zgjat sigurimi dhe pas ndodhjes së rastit të siguruar. Siç shihet, detyrimi kryesor i siguresit është pagesa e shpërblimit ose shumës së caktuar në kontratën e sigurimit, që duhet përmbushur pas paraqitjes së

855 Shih nenin 918 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

rastit të siguruar. Me këtë nen rregullohen detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit, përkatësisht shumën e sigurimit, afati i pagesës dhe pagesa e paradhënies. Kjo dispozitë ligjore ndodhet në pjesën e Ligjit ku ndodhen dispozitat e përgjithshme me të cilat rregullohet kontrata e sigurimit, prandaj edhe ajo ka të bëjë si me sigurimin e pasurisë, ashtu edhe me sigurimin e personave.

1. Qëllimi ekonomik dhe juridik i kontratës së sigurimit është pagesa e shumës së sigurimit të siguruarit nga ana e siguresit, në rast se ndodh ngjarja e cila përfaqëson rastin e siguruar. Ky është detyrimi kryesor i siguresit që del nga kontrata e sigurimit. Në par. 1 të nenit 940 të LMD është caktuar afati brenda të cilit siguresi duhet ta përmbushë këtë detyrim. Me paraqitjen e rastit të siguruar, siguresi ka detyrimin ta paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar me kontratë në afatin e kontraktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 14 ditë. Kjo lë të kuptohet se ligji përcakton detyrimin e siguresit të bëjë pagesën brenda *afatit të kontraktuar*, sikurse edhe afatin e fundit brenda të cilit duhet paguar shpërblimi ose shuma e kontraktuar. Siç shihet, sipas kësaj dispozite ligjore, në kontratën e sigurimit mund të parashikohet një afati më i shkurtër, në të cilin rast do të vlejë ai afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 14 ditë. Nga kjo shihet se me këtë dispozitë mbrohet i siguruari dhe pengohet zvarritja e paarsyeshme dhe e qëllimtë e zgjidhjes së kërkesave të paraqitura pas ndodhjes së rastit të siguruar. Afati i përcaktuar me këtë dispozitë ligjore fillon të rrjedhë nga dita kur siguresi e ka marrë njoftimin se ka ndodhur rasti i sigurimit.⁸⁵⁶ Duke pasur parasysh faktin se ky detyrim i siguresit është detyrim monetar, në rast se pagesa nuk bëhet brenda afatit të kontraktuar, përkatësisht atij ligjor, siguresi ka detyrimin të paguajë edhe kamatëvonesën e parashikuar me këtë ligj.⁸⁵⁷ *“Kur ndodh rasti i siguruar, siguresi është i detyruar të paguajë shumën e caktuar në kontratë brenda afatit të kontraktuar. Në rast të vonesës, i siguruari ka të drejtën e kamatëvonesës, por jo edhe të drejtën e revalorizimit të kërkesës”*.⁸⁵⁸

2. Për ta përmbushur në afatin e kontraktuar ose atë ligjor detyrimin rreth pagesës së parashikuar në kontratën për sigurimin, siguresi duhet medoemos të disponojë dokumentacionin dhe provat e tjera të nevojshme nga të cilat rrjedh detyrimi kontraktues. Në mjaftë raste, qoftë për shkaqe objektive ose subjektive, është e pamundur që ato të sigurohen brenda afatit ligjor prej 14 ditësh. Për vërtetimin e sasisë së dëmit pasuror të shkaktuar nga një rast konkret i siguruar, zakonisht nevojiten ekspertiza të ndryshme, të cilat nuk mund të përfundohen brenda këtij afati. Në par. 2 të këtij neni është parashikuar që, nëse për caktimin e ekzistimit të detyrimit të siguresit ose të sasisë së detyrimit nevojitet më tepër kohë, afati për pagesë i parashikuar në par. 1 të këtij neni, fillon të rrjedhë nga dita kur është vërtetuar ekzistimi i detyrimit dhe shuma e tij. Siç shihet, me par. 2 të këtij neni zgjatet afati prej 14 ditësh i parashikuar në par. paraprak. Ligjvënësi në

856 Lidhur me detyrimin e të siguruarit që ta njoftojë siguresin për paraqitjen e rastit të sigurimit mënyrën dhe afatin e lajmërimit si dhe pasojat e moslajmërimit brenda afatit, shih nenin 938 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

857 Shih nenin 382 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

858 Gjyk. L.T. e R Kr. Ac. 1712/96 dt. 3.12.1996.

këtë rast nuk përcakton ndonjë afat tjetër brenda të cilit do të duhej përfunduar vërtetimi i ekzistimit të detyrimit dhe sasisë së tij. Konsiderojmë se me këtë dispozitë, nën mbulesën ligjore se “ *i nevojitet kohë*”, siguruesi ta zvarritë qëllimisht marrjen e vendimit përkitazi me kërkesën për dëmshpërblim në bazë të sigurimit në afat të pacaktuar. Me Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia (LSDAP) afatet e pagesës mbi këtë bazë të sigurimit janë caktuar më të gjata, por ajo që është me rëndësi, është parashikuar afati brenda të cilit duhet medoemos të shqyrtohet kërkesa e paraqitur.⁸⁵⁹ Ky ligj, në krahasim me LMD konsiderohet si ligj special, prandaj edhe te ky lloj i sigurimit duhen zbatuar dispozitat e ligjit special.⁸⁶⁰

3. Në par. 3 të këtij neni është rregulluar çështja e pagesës së paradhënies për shumën e siguruar. Sipas kësaj dispozite ligjore, në rast se siguruesi i referohet të drejtës së vet të parashikuar nga par. 2 i këtij neni, me arsyetimin se shuma e detyrimit të tij nuk mund të vërtetohet brenda afatit të parashikuar në par. 1, i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i sigurimit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për pagesën e pjesës jokontestuese të detyrimit, në emër të paradhënies. Sipas kësaj kërkesë të shfrytëzuesit të sigurimit, siguruesi është i detyruar të paguajë shumën jokontestuese të detyrimit të vet, në emër të paradhënies. Siç shihet, siguruesi e ka këtë detyrim vetëm në rastet kur *shuma e detyrimit* nuk vërtetohet brenda afatit të parashikuar në par. 1 të këtij neni, që nënkupton se ekzistimi i detyrimit nuk është kontestues. Me këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar detyrimi për kamatëvonesën. Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia e ka parashikuar këtë, ashtu që, sipas nenit 26 par. 6 të këtij Ligji: “*Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit për pagesën e paradhënies të parashikuar nga paragrafi 4 i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përbushjen e detyrimit për dëmshpërblimin, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në me normën prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim*”.⁸⁶¹ Te këto raste të sigurimit është zgjidhur dilema rreth fillimit të afatit të llogaritjes së kamatës. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, te këto lloje të sigurimit, kamatëvonesa do të llogaritet nga dita kur siguruesi e ka pranuar kërkesën për dëmshpërblim.

859 Me nenin 26 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashikohet: “*Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me: 1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse; 2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit*”

860 Në nenin 28 par. 2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashikohet zbatimi i LMD vetëm nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe. “*Në përbushjen e detyrimeve të dëmshpërblimit dhe në kontratën e sigurimit, zbatohet legjislacioni me të cilin rregullohen marrëdhëniet e detyrimeve nga shkaktimi i dëmit dhe kontrata e sigurimit, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe*”.

861 Shih nenin 26 të LSDAP.

Neni 941. Përjashtimi i përgjegjësishë së sigurveesit në rastin e paramendimit dhe të mashtrimit

Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit, i siguruari ose shfrytëzuesi e ka shkaktuar rastin e siguruar me dashje ose me mashtrim, sigurveesi nuk është i detyruar të japë asgjë dhe dispozita e kundërt kontraktuese nuk ka efekt juridik.

Vështrim i përgjithshëm.- Edhe kjo dispozitë ligjore është plotësisht e njëjtë me dispozitën e nenit 920 të LMD/1978, i cili është zbatuar derisa ka hyrë në fuqi ky Ligj, dhe ajo i përket përjashtimit të përgjegjësishë së sigurveesit. Neni 941 i LMD përmban rregullën e përgjithshme nga e drejta e sigurimit se *rast i sigurimit nuk mund të jetë ngjarja të cilën i siguruari e ka shkaktuar me qëllim*. Sipas LMD në fuqi, kjo rregull zbatohet në bazë të kuptimit të dhënë për rastin e sigurimit, ku është përcaktuar se ngjarja, për të cilën kontraktohet sigurimi, *duhet të jetë e ardhshme, e pasigurt dhe e pavarur nga vullneti i ekskluziv i palëve*.⁸⁶²

1(a). Me këtë dispozitë ligjore rregullohen rastet kur ngjarjen për të cilën është kontraktuar rasti i sigurimit e ka shkaktuar me dashje ose me mashtrim vetë kontraktuesi i sigurimit, i siguruari ose shfrytëzuesi i sigurimit si dhe pamundësia e rregullimit ndryshe me kontratë të situatave të këtilla. Sipas kësaj dispozite ligjore, në qoftë se kontraktuesi i sigurimit, i siguruari apo shfrytëzuesi i sigurimit, e kanë shkaktuar rastin e sigurimit me qëllim ose me mashtrim, sigurveesi nuk ka kurrfarë detyrimi nga ajo kontratë e sigurimit ndaj sigurveesit, nuk ka detyrimin të japë asgjë në bazë të sigurimit. Sigurimi është një marrëdhënie juridike, një nga elementet e së cilës është edhe rreziku nga paraqitja e ngjarjes e cila përfaqëson rast të sigurimit.⁸⁶³ Rreziku nënkupton ngjarjen e ardhshme joevidente, ndodhja e së cilës nuk duhet të varet nga vullneti i të siguruarit. Me paraqitjen e ngjarjes për të cilën edhe është kontraktuar rasti i siguruar, vjen shkaktimi i dëmit. Shkaktimi i rastit të siguar me dashje ka për pasojë shkaktimin me dashje të dëmit. Shkaktimi i dëmit me dashje është pasojë vetëm e vullnetit të të siguruarit, prandaj rreziku i tillë nuk mund të sigurohet. Rastin e siguar mund ta shkaktojnë me qëllim vetëm personat fizikë, prandaj kjo dispozitë ligjore ka të bëjë vetëm me kontraktuesit e sigurimeve dhe të siguruarit apo me shfrytëzues të sigurimit të cilët janë persona fizikë, të cilët e kanë shkaktuar me qëllim paraqitjen e rastit të siguar.

“Sigurveesi përgjigjet për dëmin të cilin e ka pësuar këmbësorja për shkak të përplasjes me automjetin, edhe pse vozitësi dëmin e ka shkaktuar me qëllim. Në të vërtetë, pavarësisht nga ajo që automjeti është shfrytëzuar si mjet për kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë, qëndron fakti se paditësja si person i tretë është dëmtuar me përdorimin e automjetit në lëvizje. Për këto dëme të shkaktuara përgjigjet i padituri si sigurvees. Në fakt, ndërmjet përdorimit të automjetit në lëvizje dhe lëndimit të paditëses ekziston lidhja shkakësore. Ky është supozim për ekzistimin e përgjegjësishë së të paditurit për dëmin e shkaktuar paditëses. Është çështje tjetër

862 Shih nenin 919 par. 1 të këtij Ligji.

863 Shih nenin 918 dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

kthimi i dëmshpërblimit që i është paguar paditëses. Në të vërtetë, rrethana e vërtetuar e lëndimit të qëllimshëm të paditëses me përdorimin e automjetit në lëvizje përfaqëson bazën juridike sipas së cilës i padituri, si sigurues, mund ta kthejë (regresojë) shumën e paguar. Fakti që dëmi është shkaktuar me qëllim përjashtohet nga sigurimi. Sigurimi është një marrëdhënie juridike mes siguruesit dhe të siguruarit, e cila nuk ka të bëjë me paditësen si person i tretë”.⁸⁶⁴

1(b). Me këtë dispozitë ligjore, me qëllimin e të siguruarit, barazohet edhe veprimi mashtrues i tij që ka për qëllim realizimin e shumës së sigurimit. Mashtrimi në sigurim nënkupton veprimet nëpërmjet të cilave siguruesi sillet me qëllim në lajthim nga i siguruari, për sa u përket elementeve thelbësore, duke sjellë atë në situatën që të lidhë kontratë të sigurimit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore mbi bazën e sigurimit. Sjellja e të siguruarit, për t’i pasur karakteristikat e mashtrimit, duhet të jetë veprim mashtrues i ndërmarrë me vetëdije dhe të ketë ndikuar në siguruesin të marrë vendim për pagimin e shpërblimit. Barra e provimit të mashtrimit bie mbi siguruesin.

1(c). Dispozita ligjore nga neni 941 është me karakter detyrues, ashtu që palët kontraktuese nuk mund të merren vesh ndryshe dhe në kundërshtim me atë. Në pjesën e dytë të këtij neni parashikohet se çdo dispozitë kontraktuese e cila është në kundërshtim me natyrën e kësaj dispozite nuk prodhon efekte juridike.

Neni 942. Kundërshtimet e siguruesit

- 1. Kundër kërkesës së prurësit të policës, si dhe të kërkesës së ndonjë personi tjetër që e invokon atë, siguruesi mund të theksojë të gjitha kundërshtimet që ka lidhur me kontratën ndaj personit me të cilin ka lidhur kontratën mbi sigurimin.**
- 2. Përjashtimisht, kundër kërkesës së personit të tretë në rastin e sigurimit vullnetar nga përgjegjësia dhe të kërkesës së titullarëve të të drejtave të caktuara në sendin e siguar, e drejtë kjo që ka kaluar në bazë të vetë ligjit në bazë të së drejtës, me asgjësimin ose me dëmtimin e sendit të siguar në shpërblimin nga sigurimi, siguruesi mund të paraqesë vetëm kundërshtime që janë paraqitur para se të ketë ndodhur rasti i siguar.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me rastin e lidhjes së kontratës për sigurimin, palë kontraktuese janë, në njërin anë, siguruesi dhe, në anën tjetër, kontraktuesi i sigurimit. Kontraktuesi i sigurimit nuk është gjithmonë edhe i siguruari. Siguruesi nuk mund të ndikojë mbi kontraktuesin e sigurimit, nëse ai do ta lidhë kontratën e sigurimit për llogari të veten apo në llogari të tjetrit, në favor të vetes apo në favor të personit të tretë. Pra, kontratën e sigurimit e lidhin siguruesi dhe kontraktuesi i sigurimit, mirëpo, në anën e kundërt të siguruesit, përkatësisht në anën e kontraktuesit të sigurimit mund të paraqiten disa persona. Të gjithë këta persona të tjerë i realizojnë të drejtat e veta të sigurimit në bazë të kontratës,

⁸⁶⁴ Gjyk. Sup. e R. Kr. Rev. 1470/94 dt. 14.04.1999, marr nga Ivica Crnić. Zakon o Obveznim Odnosima, peto izdanje, Zagreb 2012, f. 1034.

të cilën e ka lidhur kontraktuesi i sigurimit. Për këtë arsye, siguruesi ndaj të gjithë këtyre personave që janë në anën e kundërt të tij, mund t'i parashtrijë ato kundërshtime që do të mund t'i paraqiste ndaj kontraktuesit të sigurimit.

1. Par. 1 i nenit 942 të LMD rregullon të drejtën e siguruesit për të kundërshtuar kërkesën e prurësit të policës, të siguruarit apo shfrytëzuesve të tjerë të sigurimit. Në rast se polica e sigurimit i ka kaluar një personi të tretë apo në rastet kur sigurimi është lidhur për llogari të huaj ose në favor të personit të tretë, siguruesi ka të drejtë kundërshtimi lidhur me kontratën, ndaj kërkesës së paraqitur nga cilido prej tyre, sikur që ka të drejtë ndaj kontraktuesit të sigurimit. Të gjithë ata e realizojnë të drejtën që del nga kontrata të cilën e ka lidhur kontraktuesi i sigurimit, prandaj siguruesi kundërshtimet që do t'i paraqiste lidhur me kontratën ndaj kontraktuesit, mund t'i paraqesë edhe ndaj prurësit të policës, të siguruarit ose shfrytëzuesit tjetër të sigurimit. Parimi i përgjithshëm i së drejtës së detyrimeve se *me ndërrimin e kreditorit debitori nuk mund të vihet në pozitë më të pafavorshme*, vlen edhe në të drejtën e sigurimit. Kështu, siguruesi mund të paraqesë ndaj shfrytëzuesit të ri të sigurimit jo vetëm kundërshtimet që ka mundur t'ia paraqesë kontraktuesit të sigurimit, por edhe kundërshtimet që ka personalisht ndaj tij. Të gjitha ato kundërshtime duhet të jenë të lidhura me kontratën e sigurimit. Kundërshtimet mund të jenë të ndryshme – se kontrata e sigurimit është nule, ngase në momentin e lidhjes së saj ka ekzistuar rasti i siguruar,⁸⁶⁵ se nuk i është paguar premia,⁸⁶⁶ se dëmi i shkaktuar është pasojë e veprimeve qëllimkëqija të të siguruarit të mëparshëm ose kontraktuesit të sigurimit, se dëmi është pasojë e rrezikut të përjashtuar si dhe të gjitha kundërshtimet e mundshme lidhur me policën.

2. Në par. 2 të nenit 942 të LMD parashikohen përjashtimet nga e drejta themelore përkitazi me kundërshtimet e siguruesit të parashikuara në paragrafin paraparak të këtij neni. Përjashtimet e parashikuara në këtë dispozitë u përkasin: a) *sigurimit vullnetar nga përgjegjësia*; b) *kërkesave të titullarëve të të drejtave të caktuara në sendet e siguruara*.

2(a) Në rast se shkaktuesi i dëmit ka qenë i siguruar në mënyrë vullnetare nga përgjegjësia, personi i tretë i dëmtuar mund të kërkojë drejtpërdrejt nga siguruesi shpërblimin për dëmin që ka pësuar nga ngjarja për të cilën përgjigjet i siguruari.⁸⁶⁷ Në këtë mënyrë, personi i tretë i dëmtuar ka të drejtë të paraqesë drejtpërdrejt padi ndaj siguruesit, me qëllim të realizimit të të drejtave që dalin nga kontrata e sigurimit, të cilat i përkasin të siguruarit. Në këtë rast siguruesi ka të drejtë që ndaj personit të tretë të dëmtuar të paraqesë: a) të gjitha kundërshtimet që mund t'i paraqesë i siguruari ndaj të dëmtuarit, si parashkrimin e kërkesës, fajësinë e tij për dëmin e shkaktuar etj., b) të gjitha kundërshtimet të cilat siguruesi mund t'i bëjë ndaj të siguruarit sipas kontratës së sigurimit. E drejta e siguruesit për këto kundërshtime është e kufizuar në kohë. Personi i tretë i dëmtuar ka të drejtë të paraqesë vetë kërkesë ndaj siguruesit, nga dita kur ka ndodhur rasti i siguruar. Për këtë arsye, ndaj

865 Në bazë të nenit 929 par. 1 të këtij Ligji, siguruesi mund të kërkojë anulimin e kontratës nëse kontraktuesi i sigurimit e ka heshur me dashje ndonjë rrethanë me rëndësi, ashtu që siguruesi nuk do ta lidhte kontratën sikur të kishte ditur për atë rrethanë.

866 Shih nenin 934 par. 1 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

867 Shih nenin 962 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

kërkesës së personit të tretë të dëmtuar, siguruesi nuk mund t'i paraqesë kundërshtimet që ka mundur t'i paraqesë ndaj të siguruarit, të cilat kanë të bëjnë me rrethanat e paraqitura pas ndodhjes së rastit të siguar, si, p.sh., nuk mund të bëjë kundërshtim se i siguruari nuk e ka lajmëruar menjëherë se ka ndodhur rasti i siguar dhe që për këtë arsye dëmi është rritur.⁸⁶⁸ Siguruesi mundet që ndaj personit të tretë të dëmtuar të bëjë kundërshtime vetëm lidhur me rrethanat që kanë ekzistuar para se të ndodhte rasti i siguar, siç është ajo se kontraktuesi i sigurimit nuk e ka lajmëruar për rritjen e rrezikut.

2(b) Rregulla e sipërhënuar vlen edhe për kundërshtimet e siguruesit ndaj kërkesave të titullarëve të të drejtave të caktuara, të cilat i kanë fituar në bazë të ligjit mbi sendet e siguruara të zhdukura apo të dëmtuara, si, p.sh., e drejta e pengut. Në rast të dëmtimit të sendit të lënë peng i cili ka qenë i siguar, titullari i së drejtës së pengut, pas ndodhjes së rastit të siguar, ka të drejtë të paraqesë vetë kërkesë për shpërblimin e sigurimit ndaj siguruesit⁸⁶⁹. Edhe në këtë rast siguruesi mund të paraqesë vetëm kundërshtimet që kanë të bëjnë me rrethanat e paraqitura para ndodhjes së rastit të siguar.

NËNKREU 5

KOHËZGJATJA E SIGURIMIT

Neni 943. Fillimi i efektit të sigurimit

- 1. Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe kontrata mbi sigurimin ka efektet e veta duke filluar që nga mesnata e ditës kur është shënuar në policë si ditë e fillimit të kohëzgjatjes së sigurimit e deri në mbarim të ditës së fundit të afatit për të cilin është kontraktuar sigurimi. Kohëzgjatja e sigurimit konsiderohet që nuk është përcaktuar nëse palët nuk e shkëpusin kontratën para kohës së pagimit të premisë të përcaktuar në kushtet e sigurimit dhe nëse ekziston një kohëzgjatje në kontratën e sigurimit me mundësi të vazhdimit të kontratës edhe për një kohë të njëjtë.**
- 2. Në qoftë se afati i kohëzgjatjes së sigurimit të pasurisë nuk është caktuar me kontratë, secila palë mund të denoncojë kontratën në ditën e arritshmërisë së premisë, duke njoftuar me shkrim palën më së voni tre (3) muaj para arritshmërisë së premisë.**
- 3. Në qoftë se sigurimi është lidhur në afatin më të gjatë se tri (3) vite, pas kalimit të këtij afati secila palë mundet të denoncojë kontratën, duke e lajmëruar palën tjetër me shkrim në periudhën prej tre (3) muajve.**
- 4. Nuk është e mundur që me anë të kontratës të përjashtohet e drejta e palëve për tu tërhequr nga kontrata, ashtu siç është përcaktuar në paragrafët e mëparshëm.**
- 5. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në sigurimin e jetës apo të shëndetit.**

868 Shih nenin 938 të këtij Ligji.

869 Shih nenin 959 par. 1 të këtij Ligji.

Vështrim i përgjithshëm.- Pavarësisht nga emërtimi i kësaj dispozite, ajo rregullon jo vetëm fillimin, por edhe përfundimin e efektit të sigurimit. Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar koha gjatë së cilës kontrata e sigurimit prodhon efekte juridike dhe gjatë së cilës palët kanë detyrimin t'i përmbushin detyrimet kontraktuese. Në këtë dispozitë nuk përcaktohet afati i zgjatjes së sigurimit, ngase ai caktohet në kontratë. Varësisht nga afati i zgjatjes, kontrata e sigurimit mund të jetë: *a) në kohë të caktuar, b) në kohë të pacaktuar.* Kjo dispozitë ligjore duhet shikuar e lidhur me dispozitën ligjore të nenit 934⁸⁷⁰ të këtij Ligji, përkritazi me pasojat e mospagimit të premisë, e cila është rrethanë me rëndësi për fillimin e prodhimit të efekteve të kontratës dhe kohëzgjatjen e kontratës së sigurimit.

1. Në par. 1 të nenit 943, në pjesën e parë të tij, është rregulluar fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit të lidhur në kohë të caktuar, ndërsa në pjesën e dytë të tij, parashikohet mundësia e vazhdimit të kontratës edhe për një afat siç ka qenë i kontraktuar.

1(a). Rregullat e përcaktuara në par. 1 të këtij neni, përkritazi me fillimin dhe përfundimin e kohëzgjatjes së sigurimit, vlejnë vetëm atëherë kur në kontratën e sigurimit palët nuk e kanë caktuar shprehimisht kohën gjatë së cilës ajo prodhon efekte juridike, duke e caktuar edhe orën e fillimit dhe të mbarimit të sigurimit. Kjo nënkupton se palët kontraktuese kanë mundësi ligjore të përcaktojnë saktësisht fillimin dhe mbarimin e afatit të kontraktuar. Siç shihet, në kontratat e sigurimit për kohë të caktuar përcaktohet koha e zgjatjes së kontratës, duke përcaktuar në kontratë ditën e parë dhe të fundit të sigurimit. Në kontratë palët mund të përcaktojnë edhe orën e saktë të ditës së caktuar kur sigurimi do të fillojë dhe kur do të mbarojë. Në qoftë se në këtë mënyrë kjo çështje nuk është rregulluar me kontratë, vlen rregulla e përcaktuar në pjesën e parë të par. 1 të këtij neni, sipas së cilës *kontrata e sigurimit prodhon efekte juridike të veta nga përfundimi (mesnata) i ditës e cila në kontratë është caktuar si ditë e fillimit të kohëzgjatjes së sigurimit, deri në përfundim të ditës së fundit të afatit për të cilin është kontraktuar sigurimi.* Nga kjo rrjedh se dita në të cilën është lidhur kontrata nuk është përfshirë në sigurim. Në rast se dëmi është shkaktuar në ditën e lidhjes së kontratës, deri në përfundim të orës 24, ai dëm nuk është i mbuluar me sigurim, edhe pse në policë ajo ditë është e caktuar si ditë e fillimit të sigurimit. Në ligj përcaktohet: *“nga mesnata e ditës kur është shënuar në policë”*, pra dita e nënshkrimit të policës njëherësh nënkupton ditën e lidhjes së kontratës,⁸⁷¹ prandaj me nënshkrimin e policës edhe konsiderohet se është lidhur kontrata e sigurimit.

1(b) Palët kontraktuese mund të parashikojnë në kontratën e sigurimit mundësinë e vazhdimit të saj edhe për një kohë të njëjtë për të cilën është lidhur ajo. Sipas pjesës së dytë të paragrafit të parë të nenit 943, në praninë e një konstatimi të tillë në kontratë, konsiderohet se kohëzgjatja e sigurimit nuk është përcaktuar në rast se palët kontraktuese nuk e shkëpusin kontratën para se të kalojë koha e parashikuar për pagimin e premisë së sigurimit. Në bazë të kësaj, konsiderohet se kontrata e sigurimit është zgjatur edhe për një afat, për aq sa ka qenë afati në kontratën e lidhur paraprakisht mes palëve.

870 Shih nenin 934 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

871 Sipas nenit 922 të këtij Ligji “Kontrata për sigurimin është e lidhur kur kontraktuesit e nënshkruajnë policën e sigurimit ose listën e mbulesës”.

2. Kontrata e sigurimit është e lidhur në kohë të pacaktuar atëherë kur afati i zgjatjes së sigurimit nuk është caktuar paraprakisht me kontratë. Në par. 2 të këtij neni është rregulluar koha e përfundimit të kontratës së sigurimit të lidhur në kohë të pacaktuar. Në kontratat e sigurimit në kohë të pacaktuar zakonisht parashikohet edhe mënyra e shkëputjes së tyre. Këto kontrata zakonisht shkëputen me marrëveshje mes palëve apo në mënyrë të njëanshme, duke iu përmbajtur afatit të shkëputjes të parashikuar në kontratë. Sipas par. 2 të këtij neni, në qoftë se afati i zgjatjes së sigurimit nuk është përcaktuar në kontratë, *secila palë mund ta denoncojë kontratën në ditën kur ka arritur pagesa e premisë*. Kusht për shkëputjen e kontratës në këtë mënyrë është që pala e cila duhet ta denoncojë kontratën, është dashur ta kishte njoftuar për këtë palën tjetër me shkrim, më së voni 3 (tre) muaj para se të ketë arritur pagesa e premisë së sigurimit. Në rast se të drejtën për shkëputje në këtë mënyrë nuk e shfrytëzon asnjëra palë, efekti i kontratës vazhdohet nga viti në vit. Kontraktuesi i sigurimit ka detyrimin të paguajë preminë edhe për vitin e ardhshëm, por në rast se nuk e përmbush këtë detyrim, kontrata zgjidhet në bazë të nenit 934 par. 3 të LMD.⁸⁷²

3. Redaktimi gjuhësor i par. 3 të nenit 943 të LMD, po ashtu, sjell huti në zbatimin e drejtë të saj dhe e bën atë të paqartë. Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për revokimin e kontratës së lidhur për periudhën prej tri viteve. Në dispozitë nuk është sqaruar afati i revokimit dhe ai gabimisht paraqitet si “afat i lajmërimit të palës tjetër”. Sigurimi mund të lidhet edhe për një periudhë kohore prej disa viteve. Shkëputja e kontratës së lidhur për kohë të caktuar mund të ndodhë në bazë të marrëveshjes mes palëve ose në bazë të revokimit të njëanshëm, siç është rregulluar me këtë dispozitë ligjore. Rregulla e parashikuar në këtë dispozitë bën përjashtim nga rregulla e përgjithshme si dhe rregulla nga paragrafi i parë i këtij neni, sipas së cilës kontrata e sigurimit në kohë të caktuar zgjat deri në kalimin e kohës për sa është lidhur. Revokimi është një deklaratë e njëanshme e njëres palë kontraktuese, me të cilën përfundon kontrata. Për të pasur të drejtën e revokimit, si rregull, ajo duhet të jetë e kontraktuar. Në par 3 të këtij neni parashikohet e drejta e revokimit të kontratës, e cila është e lidhur për afatin prej më tepër se tri vjetësh. Kjo dispozitë ligjore duhet kuptuar ashtu që, *në rastet kur kontrata e sigurimit është lidhur për një periudhë kohore më gjatë se tri vite, pas kalimit të afatit kontraktues, secila palë, duke lënë afatin revokues prej 3 muajve, mund ta njoftojë me shkrim palën tjetër se e revokon kontratën*. Nga kjo rrjedh se, për të qenë revokimi i vlefshëm, duhet medoemos të ketë kaluar afati i sigurimit prej tri vjetësh dhe të lihet afati i revokimit prej tre muajve nga dita kur atë, të përpiluar me shkrim, e ka pranuar pala tjetër.

4. Kur është fjala për shkëputjen me marrëveshje të kontratës, palët mund të merren vesh për mundësinë e revokimit, duke caktuar ndryshe afatin revokues, edhe para kalimit të afatit prej tri viteve. Në këtë aspekt, në par. 4 të këtij neni, sigurohet e drejta e tërheqjes nga kontrata e sigurimit. Siç shihet, dispozitat e këtij neni përkritazi me zgjatjen e kontratës janë me karakter detyrues (imperativ), përpos dispozitës e cila rregullon të drejtën e zgjidhjes së kontratës. Sipas kësaj dispozite ligjore, *me kontratë nuk mund të përjashtohet e drejta e çdonjërës palë ta zgjidhë, përkatësisht të tërhiqet nga kontrata, siç është parashikuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni*. Një dispozitë e këtillë në kontratë, sipas së cilës ndonjëra nga palët heq dorë nga kjo e drejtë, është nule.

.....
872 Shih nenin 934 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

5. Në par. 5 të këtij neni vetëm konstatohet se dispozitat e këtij neni nuk mund të zbatohen në sigurimin e jetës apo të shëndetit, që nënkupton se ato zbatohen vetëm te kontratat për sigurimin e pasurisë.

Neni 944. Ndikimi i falimentimit mbi sigurimin

- 1. Në rastin e falimentimit të kontraktuesit të sigurimit, sigurimi vazhdon, por secila palë ka të drejtë ta zgjidhë kontratën për sigurimin brenda tre (3) muajsh nga data e hapjes së falimentimit, në të cilin rast masës së falimentimit të kontraktuesve i takon pjesa e premisë së paguar që i përgjigjet kohës së mbetur të sigurimit.**
- 2. Në rastin e falimentimit të sigurvecit, kontrata për sigurimin shuhet pasi të kenë kaluar tridhjetë (30) ditë nga data e hapjes së falimentimit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore janë rregulluar pasojat juridike të hapjes së procedurës së falimentimit ndaj ndonjëres nga palët kontraktuese nga kontrata e sigurimit. Kontrata e sigurimit është kontratë me të drejta dhe detyrime të dyanshme. Falimentimi përfaqëson një nga format e pushimit të ekzistimit të palëve kontraktuese. Përkitazi me vlefshmërinë e kontratës së sigurimit, me rëndësi është falimentimi i kontraktuesit të sigurimit dhe sigurvecit, ndërsa falimentimi i të siguruarit nuk është me ndikim në kontratën e sigurimit; për këtë arsye edhe me këtë nen janë rregulluar në veçanti pasojat juridike të falimentimit të kontraktuesit të sigurimit dhe sigurvecit.

1. Dispozita e par. 1 të nenit 994 ka të bëjë me rastet e falimentimit të kontraktuesit të sigurimit. Sipas kësaj dispozite ligjore, në qoftë se falimenton kontraktuesi i sigurimit, sigurimi nuk ndërpritet sipas fuqisë së ligjit, por ai vazhdon. Secila nga palët kontraktuese në këtë rast ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e sigurimit brenda 3 (tre) muajsh, nga data e hapjes së falimentimit. Kontratën mund ta zgjidhë administratori i falimentimit ose sigurveci. Në rast të zgjidhjes së kontratës, masës së falimentimit të kontraktuesve të sigurimit u takon pjesa e premisë së paguar, e cila i përgjigjet pjesës së ngulur të kohës të sigurimit. Sipas kësaj rregulle, sigurveci ka detyrimin të paguajë në masën e falimentimit të kontraktuesit të sigurimit shumën proporcionale të premisë së paguar e të pashfrytëzuar të sigurimit. Derisa në ligj thuhet se kontratën ka të drejtë ta zgjidh secila palë, kjo lë të kuptohet se kontratën ka të drejtë ta zgjidhë edhe sigurveci. Sigurveci në këtë rast nuk ka të drejtë të kërkojë pagesën e premisë, e cila nuk është paguar deri atëherë. Nëse ndodh rasti i siguruar, sigurveci ka të drejtë ta mbajë pjesën e shumës së sigurimit deri në shumën e premisë e cila nuk është paguar, përkatësisht të cilën ia ka borxh kontraktuesi i sigurimit.

2. Në par. 2 të këtij neni janë parashikuar pasojat juridike në kontratën e sigurimit në rast të falimentimit të sigurvecit. Sipas kësaj dispozite ligjore, në rast të falimentimit të sigurvecit, kontrata për sigurimin shuhet, pasi të kenë kaluar 30 (tridhjetë) ditë, nga data e hapjes së falimentimit. Me falimentimin e sigurvecit ai e humb zotësinë për veprim ekonomik, prandaj në këto rrethana mbajtja në fuqi e kontratës nuk ka as arsyeshmëri ekonomike, as juridike.

Adem Vokshi

KREU 2

SIGURIMI I PASURISË

NËNKREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 945. Interesi i sigurimit

- 1. Sigurimi i pasurisë mund të kontraktohet nga secili person që ka interes që të mos ndodhë ndonjë rast i siguruar, sepse përndryshe do të pësonte ndonjë dëm material.**
- 2. Të drejta nga sigurimi mund të kenë vetëm personat të cilët në momentin e shkakimit të dëmit kanë pasur interes material që rasti i siguruar të mos ndodhë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Dispozitat e nenit 945 sjellin rregullën e përgjithshme për interesin e sigurimit si parakusht thelbësore për rregullsinë e kontratës së sigurimit e pasurisë (shpërblimin). Me këto dispozita rregullohen këto çështje: personat të cilët duhet të kenë interes për sigurim, natyra juridike e raportit mes titullarit të interesit dhe objektit të siguruar; koha gjatë së cilës është e nevojshme të kihet interes për sigurimin.

1. Rregulla për interesin e sigurimit.- Është rregull themelore e sigurimit të pasurisë bashkëkohore që të drejtat që dalin nga sigurimi mund t'i realizojnë vetëm personat të cilët, në momentin e shkakimit të dëmit, kanë pasur interes mbi sendin e siguruar. Me këtë denjësisht zbatohet parimi i shpërblimit të dëmit, si parim themelor i punës juridike të sigurimit të pasurisë. Personi që nuk është i interesuar materialisht që të realizohet rasti i siguruar, nuk ka interes për sigurimin. Këtë interes e përcaktojmë me nocionin e interesit të sigurimit (interesi për t'u siguruar), kurse nga këndvështrimi i mundësisë së lidhjes së kontratës së sigurimit – me nocionin interes i siguruar. Arsyeja për zbatimin e këtij parimi të sigurimit kompensuese dhe të parimit të shpërblimit të dëmit, në përgjithësi, rrjedh nga interesi publik që sigurimi të mos shndërrohet në lojë fatit dhe bast dhe që i siguruari të mos nxitet apo të vihet në sprovë që të shkaktojë dëmin me qëllim, duke synuar realizimin e shpërblimit nga sigurimi. Për këtë arsye, në sigurim ekziston ndalesa e përgjithshme e lidhjes së kontratës për bastin apo lojën e fatit.

1. (a) Te sigurimet e pasurisë (sigurimi i pasurisë, sigurimi nga përgjegjësia) interesi rrjedh nga mundësia e ndodhjes së ndonjë rreziku kur i siguruari pëson dëm pronësor për shkak të humbjes apo dëmtimit të sendit të siguruar apo për shkak të përgjegjësisë qytetare juridike për shpërblimin e dëmit. Prandaj, titullari i interesit mbi sendin e siguruar është i interesuar që, duke lidhur kontratën e sigurimit, në rast të ndodhjes së rrezikut të siguruar (rasti i siguruar), të realizojë shpërblimin që del nga sigurimi dhe me këtë ta kompensojë

materialisht humbjen e pësuar. Nëse nuk do të ekzistonte interesimi i ndonjë personi që të shkaktohet rasti i sigurimit, kjo do të kishte të bënte me bastin apo lojën e fatit. Kushti juridik për ekzistimin e interesit në anën e sigurveesit është i rregulluar me të drejtën e sigurimit. Zbatimi i parimit për interesin e sigurimit është vendimtar me rastin e vlerësimit nëse ndonjë person përgjithësisht ka ose jo të drejtën e kërkesës ndaj sigurveesit.

1. (b) Interesi për sigurim.- Në marrëdhëniet te sigurimi janë relevante vetëm ato interesa të cilat janë të “sigurveeshme”. Nuk është secili interes, qoftë ai edhe material, i sigurveeshëm. Interes i sigurveeshëm është ai që është juridikisht i lejueshëm për t’u siguruar. Juridikisht i lejueshëm është secili interes që nuk është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat e tjera detyruese dhe moralin e shoqërisë (neni 39 i LMD). Prandaj, me interesin e sigurveeshëm kuptojmë interesimin e ndonjë personi që të mos i ndodhë rasti i siguruar, ndërsa sipas rendit juridik është e lejueshme që ky interes të sigurohet.

1. (c) Në mënyrë që interesi që rrjedh nga ndonjë punë juridike i një personi ndaj sendit të jetë i përshtatshëm për sigurim, është e nevojshme që si tërësi të përmbushen këto parakushte: a) që interesi të jetë i arsyeshëm “juridikisht i lejuar” dhe b) ai të jetë material (neni 945 par. 1 dhe 2 i LMD). Interesi është i arsyeshëm nëse është ligjor, përkatësisht nëse ka mbështetje në normat e rendit juridik, pra nëse është i lejuar me ato norma. Kjo nuk do të thotë vetëm ndonjë e drejtë e mbështetur në ndonjë dispozitë të veçantë ligjore, por edhe çdo interes tjetër i cili juridikisht nuk është i ndaluar. Për shembull, interesi nuk do të ishte i ligjshëm në raport me: transportimin e mallit qarkullimi i të cilit është i ndaluar, kontrabanda e arit apo monumenteve historike, ndërmjetësimi i palejuar e të ngjashme. Interesi është material nëse ecuria e ngjarjes së siguruar i ndodh (shkaktohet) titullarit të interesit të sigurimit, i cili do të pësonte dëm pronësor përkatësisht dëm që mund të vlerësohet me të holla. Kjo do të thotë se duhet të ekzistojë interesi ekonomik që të ruhet sendi nga shkatërrimi, dëmtimi apo humbja e vlerës materiale. Ndodh e kundërta te sigurimi i jetës, tek i cili në të drejtën tonë dhe në numrin më të madh të sistemeve krahasuese ligjore elementi i interesit nuk është i rëndësishëm.

1. (ç) Dispozitat për interesin sigurvees janë të natyrës juridike kogente, prandaj palët në këtë drejtim nuk kanë lirinë e kontraktimit. Ky parim mbi interesin sigurvees është i parashikuar edhe në shumicën e sistemeve krahasuese ligjore. P. sh. ,Ligji Francez për Sigurimin (neni L. 121-6), Ligji Gjerman për Sigurimin, VVG (neni 68), Ligji Austriak për Sigurimin Vers VG (neni 68), Ligji Civil Italian, CC (neni 1904).

2. Zbatimi i parimit të interesit të sigurveeshëm në sigurimet e pasurisë i ka këto efekte themelore ligjore: ekzistimi i interesit të sigurveeshëm është elementi thelbësor i cilësisë së të sigurvearit (neni 945 par. 1 i LMD); vlera e interesit të sigurvees është kriter për caktimin e vlerës së sendit të sigurvees, relevante për raportet që dalin nga sigurimi (shuma e sigurvees). Vlerën e sendit të sigurvees për nevojat e sigurimit palët mund ta përcaktojnë edhe me marrëveshje dhe atëherë bëhet fjalë për vlerën e kontraktuar të sendit të sigurvees (neni 946 par. 7 dhe neni 957 par. 2 i LMD). Nga parimi i interesit të sigurveeshëm rrjedh se kontrata e sigurimit nuk mund të jetë kontratë për fatin, prandaj në të drejtën e sigurimit ekziston

ndalesa e policave (kontratave) të bastit. Veçoria thelbësore e kontratave të bastit është ajo se asnjëra palë nuk ka interes (apo nuk mund të presë me arsye se do ta fitojë). Kontrata e lidhur me qëllim të bastit apo bixhozit është nule. Te sigurimet e pasurisë, ekzistimi i interesit të sigurueshëm është parakusht i rregullsisë së kontratës së sigurimit.

2. (a) Interesi është element qenësor e vetisë së të siguruarit.- Ekzistimi i dëmit është parakushti thelbësor për realizimin e të drejtës së shpërblimit nga sigurimi, që d.m.th. se personi i cili kërkon mbi bazë të sigurimit, duhet të ketë pësuar dëm material. Me shkaktimin e rastit të sigurimit duhet të jetë cenuar interesi i tij ekonomik ndaj sendit të siguruar. Nga kjo del parimi themelor i sigurimeve të dëmit, të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni: i siguruar mund të jetë vetëm personi që ka ose pret të ketë interes të justifikuar që të mos ndodhë rasti i siguruar, sepse në të kundërtën do të pësonte një dëm material. Nëse një person nuk e ka këtë interes apo nuk mund të presë me arsye se do ta ketë në të ardhmen, në aspektin konceptual as që mund të pësojë humbje materiale, prandaj nuk ekziston baza juridike për çfarëdo kërkesë mbi bazë të sigurimit. Përndryshe do të kishim të bënim me pasurim të pabazë (neni 194 i LMD).

2. (b) Sipas kësaj dispozita ligjore, për cilësinë e të siguruarit do të jetë e mjaftueshme që personi i interesuar mund të presë që këtë interes ta fitojë pastaj. Kjo rregull është karakteristike te sigurimi detar, por zbatimi i saj është logjik dhe te sigurimet e pasurisë. Interesi në vetvete nuk ekziston. Me pushimin e raportit përkatës juridik, pushon edhe interesi për sigurimin, p.sh., me skadimin e afatit në të cilin është lidhur kontrata për qiranë e ndonjë paluajtshmërie etj. Për ekzistimin e interesit nuk është me rëndësi vetëm raporti faktik i një personi ndaj sendit, p.sh., e mban ai në posedim atë apo jo. Interesi ekziston nëse ky person e mban sendin në posedim në bazë të një pune të rregullt juridike. E drejta ndaj sendit të siguruar duhet të ekzistojë realisht dhe nuk bën të jetë e kushtëzuar, d.m.th., duhet të bëhet fjalë për punë ekzistuese juridike të pranuar.

2. (c) Gama e marrëdhënieve të mundshme ligjore nga të cilat rrjedh interesi për sigurim është shumë e gjerë. Interesi për sigurim mund të rrjedhë nga çfarëdo raporti juridik, nëse në bazë të këtij raporti një person do të pësonte dëm për shkak të humbjes apo dëmtimit të sendit, përkatësisht nëse nga kjo do të rridhte përgjegjësia e tij dhe është fjala për interes të pranuar juridik. Prandaj, objekt i këtyre marrëdhënieve juridiko pronësore mund të jenë sendet apo veprimet. Interesin për sigurimin e sendit, para së gjithash, e ka pronari i sendit, por interesin për sigurimin e sendit mund ta ketë edhe titullari i ndonjë të drejte reale mbi sendin e huaj (e drejta e posedimit, frytgëzuese - neni 218 i LPDTS): titullari i së drejtës së servitutit, kreditori nga kontrata e hipotekës, titullari i së drejtës së ndërtimit etj.}. Është e gjerë lista e raporteve juridiko-pronësore nga të cilat rrjedh interesi për sigurimin. P.sh., interes ka bartësi i rrezikut kundrejt mallit gjatë kohës së bartjes (transportit) së tij, qiramarrësi, kryerësi i punëve, huadhënësi i kreditit etj. Interesin për sigurim në raport me të njëjtin send njëkohësisht mund ta kenë disa persona, p.sh., bashkëpronarët e një paluajtshmërie etj. Këta persona mund të kenë interes të llojit të njëjtë, por këto interesa mund të jenë edhe të ndryshme. Ngjashëm me këtë, lidhur me të njëjtin send i njëjti person mund të ketë disa interesa të ndryshme për sigurimin, p.sh., sigurimin e sendit dhe sigurimin e përgjegjësisë. Si raste tipike të

interesit të një personi, të cilat janë të padiskutueshme, legjitime, mund t'i veçojmë: 1. sigurimin e jetës personale dhe fatkeqësisë, 2. sigurimin nga përgjegjësia ndaj personave të tretë, 3. sigurimin e pasurisë personale nga humbja apo dëmtimi, 4. sigurimin e fitimit të pritur nga afarizmi dhe 5. sigurimin e përgjegjësive nga veprimtaria.

2. (ç) Koha në të cilën është e nevojshme për të pasur interes.- Në zbatimin e parimit të interesit për sigurim është rregull themelore që interesi duhet të ekzistojnë momentin e shkaktimit të dëmit. Ky parim themelor e vë në dukje vetë thelbin e sigurimit të pasurisë. Fakti se interesi ekziston në momentin e lidhjes së kontratës nuk e krijon supozimin për ekzistimin e tij në momentin e shkaktimit të dëmit. Nëse gjatë kohëzgjatjes së sigurimit pushon interesi i siguresit në raport me sendin e siguruar, me këtë njëkohësisht humb edhe cilësinë e siguresit. Interesi nuk mundet në asnjë mënyrë të fitohet më vonë. Ekzistimin e interesit të sigureshëm në momentin e shkaktimit të dëmit është i detyruar ta dëshmojë siguresi. Kjo rrjedh nga parimi i shpërblimit të dëmit, sipas të cilit ekzistimi i dëmit është supozim themelor juridik i ekzistimit të së drejtës së shpërblimit.

Neni 946. Qëllimi i sigurimit të pasurisë

- 1. Me sigurimin e pasurisë sigurohet shpërblimi për dëmin që do të ndodhte në pasurinë e të siguruarit për shkak të paraqitjes së rastit të siguruar.**
- 2. Shuma e shpërblimit nuk mund të jetë më e madhe nga sa është dëmi që ka pësuar i siguruari nga paraqitja e rastit të siguruar.**
- 3. Në sigurimin e të mbjellave dhe të frutave e të produkteve të tjera të tokës shuma e dëmit përcaktohet duke marrë parasysh vlerën që do të kishin në kohën e kumulimit, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.**
- 4. Të vlefshme janë dispozitat e kontratës me të cilën shuma e shpërblimit kufizohet në një shumë më të vogël nga sa është shuma e dëmit.**
- 5. Në rastin e vërtetimit të shumës së dëmit merret në konsiderim fitimi i humbur vetëm në qoftë se kjo është kontraktuar.**
- 6. Në qoftë se gjatë së njëjtës periudhë të sigurimit ndodhin disa raste të siguruara njëri pas tjetrit, shpërblimi nga sigurimi për secilin prej tyre caktohet dhe paguhet tërësisht duke marrë parasysh krejt shumën e sigurimit, pa zbritjen e saj për aq sa është shuma e shpërblimeve të mëparshme të paguara në atë periudhë.**
- 7. Në qoftë se me kontratën e sigurimit vlera e sendit të siguruar është përcaktuar në marrëveshje, shpërblimi caktohet sipas kësaj vlere, përveç nëse siguresi provon se vlera e kontraktuar është shumë më e madhe nga sa është vlera efektive dhe në qoftë se për këtë diferencë nuk ekziston ndonjë arsye e bazuar (si për shembull, sigurimi i sendit të përdorur në vlerën e sendit të tillë të ri, ose sigurimi i vlerës subjektive).**

1. Qëllimi juridik dhe ekonomik i lidhjes së kontratës së sigurimit.- Qëllimi juridik dhe ekonomik i lidhjes së kontratës së sigurimit e pasurisë qëndron në detyrimin themelor

të siguruesit të marrë përsipër me kontratë se të siguarit ose shfrytëzuesit të sigurimit do t'ia kompensojë dëmin ose, në ndonjë mënyrë tjetër, do ta përmbushë detyrimin e tij të kontraktuar, nëse ndodh rasti i siguar. Në dispozitën hyrëse të këtij neni theksohet: “Me sigurimin e pasurisë, sigurohet shpërblimi për dëmin që do të ndodhte në pasurinë e të siguarit, për shkak të paraqitjes së rastit të siguar”. Qëllimi ekonomik i shpërblimit të dëmit është që vlera e pasurisë së të siguarit të kthehet në gjendjen para shkakimit të dëmit. Shpërblimi caktohet në bazë të sasisë së dëmit të pësuar ose sipas kritereve kontraktuese ose të përcaktuara, prandaj kuptimi “shpërblimi i dëmit” nuk mund të merret fjalë për fjalë. Te sigurimet e pasurisë, kontrata, sipas natyrës së vet juridike, është kontratë për shpërblimin e dëmit vetëm në kufijtë e asaj që është kontraktuar ose që është përcaktuar. Praktikisht, kontrata e sigurimit nuk do ta ketë gjithnjë rezultatin e shpërblimit të tërë dëmit, por shpërblimi gjithnjë mbështetet në kontratë. Për këtë arsye, është më e përshtatshme që kontrata ta emërtohet si kontratë e shpërblimit për dëmin, kurse shpërblimi nga sigurimi - shpërblim për dëmin ose primi i sigurimit, e jo shpërblimi i dëmit. Kjo veçori themelore juridike e kontratës së sigurimit ilustron dhe shpjegon parimin e shpërblimit të dëmit dhe parimin e interesit për siguri i cili rrjedh nga parimi i shpërblimit të dëmit. Këto dy parime janë në ndërveprim të ndërsjellët, shpjegohen dhe kushtëzohen reciprokisht. Prandaj në zbatimin e dispozitave kontraktuese duhen marrë në reciprocitetin dhe kuptimin e tyre të tërësishëm. P.sh., raporti mes siguruesit dhe të siguarit vlerësohet në bazë të rregullave të cilat rregullojnë kontratën e sigurimit dhe jo në bazë të rregullave mbi shkaktimin e dëmit. Për këtë arsye, siguruesi është i detyruar t'i paguajë të siguarit ose ndonjë personi të tretë shpërblimin përkatësisht, shumën e kontraktuar, ose të kryejë diçka tjetër në përputhje me kontratën e jo të shpërblejë dëmin. (Shih vendimin e GjLE, AE-1317/93 e dt. 4 janar 1994, Praxis 2/59.)

1. (a) Parimi i shpërblimit të dëmit.- Parimi i shpërblimit të dëmit është parim themelor i punës juridike të sigurimit. Në këtë parim është inkorporuar tërësisht raporti juridik që del nga sigurimi, prandaj ai është kriter për vlerësimin e së drejtës dhe detyrimit të palëve kontraktuese, posaçërisht së drejtës për shpërblimin nga sigurimi. Me zbatimin e parimit të shpërblimit të dëmit, sigurohet kuptimi i kontratës së sigurimit dhe përcaktohet fizionomia juridike si kontratë e shpërblimit për dëmin. Parimi i shpërblimit të dëmit zbatohet në të gjitha sigurimet me shpërblim, pavarësisht nëse është fjala për sigurimin e pasurisë (në kuptimin e ngushtë), sigurimin detar apo për sigurimin nga përgjegjësia. Nuk zbatohet te sigurimet e personave (sigurimet pa shpërblim). Mënyra dhe vëllimi i zbatimit të këtij parimi është përcaktuar me të drejtën e sigurimit, kurse zbatimi i saj është siguar me dispozitat kogente ligjore. Kjo më hollësisht shpjegon natyrën juridike të detyrimit kontraktues të siguruesit për pagimin e sigurimit dhe ofron kriteret për caktimin e gjerësisë dhe sasisë së këtij detyrimi.

1. (b) Janë dy veçori themelore të parimit të shpërblimit të dëmit: a) shpërblimin nga sigurimi mund ta realizojë vetëm personi i cili, për shkak të paraqitjes së rastit të siguar, ka pësuar humbje materiale, b) i siguarit nuk mund të realizojë një shumë më të madhe të shpërblimit nga shuma e dëmit të cilin e ka pësuar me ndodhjen e rastit të siguar.

1. (c) janë dy arsye themelore të cilat arsyetojnë zbatimin e parimit të shpërblimit të dëmit: a) rreziku i shkakimit të qëllimshëm të dëmit, kur do të lejohej që shpërblimi nga sigurimi

të jetë më i madh se dëmi real i pësuar, b) rreziku që për shkak të pasigurisë së ndodhjes së rrezikut, në të cilin nuk mund të ndikohet me vullnet, sigurimi të shndërrohet në lojë fati dhe bast, që nuk është roli burimor dhe kuptimi i sigurimit, si punë ekonomiko-juridike.

1. (ç) Për zbatimin e parimit të shpërblimit të dëmit, ekzistimi i dëmit është parimi themelor për realizimin e të drejtës së shpërblimit nga sigurimi. Personi që kërkon shpërblimin nga sigurimi duhet të ketë pësuar dëm material. Me fjalë të tjera, me paraqitjen e rastit të siguruar duhet të jetë cenuar interesi i tij në raport me sendin e siguruar. Pasoja duhet të jetë, si edhe tek ekzistimi i dëmit në përgjithësi, zvogëlimi i pasurisë së personit të interesuar ose pengimi i rritjes së saj. Dëmi mund të shfaqet në formë të humbjes ose dëmtimit të sendit të siguruar ose në formë të fitimit të humbur (të munguar).

1. (d) Janë të shumta efektet juridike dhe institutet e së drejtës së sigurimit, të cilat burojnë nga parimi i shpërblimit të dëmit, siç janë: parimi i interesit për sigurim; kontrata e sigurimit nuk mund të jetë kontratë për fatin, mbisigurimin e pajustificueshëm, i siguruari nuk mund të realizojë fitimin me zbatimin e sigurimit të disa sigurve (sigurimi i dyfishtë); i siguruari nuk mund të realizojë shpërblim të dyfishtë – një herë nga sigurve e herën tjetër nga personi përgjegjës për dëmin (ekziston ndalimi i kumulimit të shpërblimit nga sigurimi dhe raportet juridiko-detyruese për dëmin); braktisja e sendit të siguruar; subrogimi i të siguarit.

1. (dh) Te zbatimi i parimit të shpërblimit të dëmit shtrohen këto çështje specifike: baza juridike e detyrimit kontraktues të sigurve për shpërblimin e dëmit, mënyra e shpërblimit të dëmit, vëllimi dhe sasia e dëmit, efektet e tjera juridike të zbatimit të parimit të shpërblimit të dëmit (ndalimi i kumulimit të shpërblimit, braktisja e sendit të siguruar, sigurimi i shumëfishtë, subrogimi); interesi për sigurim, si element thelbësor i cilësisë së të siguarit.

1. (e) Është bazë juridike e zanafillës së detyrimit të sigurve për pagesën e shpërblimit (**tulus iuris**) fakti se për ekzistimin e këtij detyrimi janë realizuar faktet e parashikuara në kontratë. Sigurve “përgjigjet” në bazë të parimit të bartjes së rrezikut. Ekzistimi i rastit të siguruar është kërkesë ligjore për ekzistimin e detyrimit të sigurve për pagesën e shpërblimit. Dëmi në marrëdhëniet nga sigurimi shpërblehet në dy mënyra: a) me rivendosje të gjendjes së mëparshme (restitucioni natyral), b) me pagimin e shpërblimit në të holla. E drejta e restitucionit nuk është parashikuar me ligj, por mund të parashikohet me kontratë ose me kushtet kontraktuese të sigurimit. Sigurve mund ta përmbushë detyrimin e tij kontraktues edhe në atë mënyrë që për sendin e asgjësuar apo të humbur të blejë sendin e njëjtë të ri dhe t’ia japë të siguarit, në vend të shpërblimit me të holla (restitucioni venerik). Shpërblimi në të holla është mënyrë (formë) e zakonshme e shpërblimit të dëmit të sigurimet. Shpërblimi në të holla të punët e sigurimit nuk synon rivendosjen e asaj gjendjeje faktike që ka ekzistuar para se të ndodhte rasti i siguruar, por me shpërblimin e shumë të caktuar të të hollave, të caktuar sipas kriterëve të parashikuara apo të kontraktuara, përmbushet detyrimi themelor kontraktues dhe vlera e pasurisë së të siguarit, në rastin ideal kthehet në gjendjen në të cilën ka qenë para shkaktimit të dëmit. I siguruari nuk është i detyruar që shpërblimin e realizuar në të holla ta shfrytëzojë për

riparimin e sendit të dëmtuar, i cili ka qenë i siguruar. Lidhur me vëllimin e shpërblimit të dëmit, nga sigurimi shpërblehet vetëm dëmi i rëndomtë (**damnum emergens**), kurse fitimi i humbur **lucrum cessans**) vetëm nëse kjo është kontraktuar në mënyrë të veçantë, (shih komentin e paragrafit 5 të këtij neni). Me sigurimin e pasurisë është mbuluar vetëm humbja fizike ose dëmtimi i sendit të siguruar. Pasojat e dëmit nuk janë të mbuluara me sigurimin, përveç nëse kjo nuk është kontraktuar në mënyrë të veçantë, (p.sh. humbja e fitimit afarist, tregut, qirasë etj.). Nga sigurimi i sendit nuk ofrohet shpërblimi as për dëmin jomaterial, p.sh., për dhimbje, frikë, shëmtim etj. Sasia e shpërblimit të dëmit është vlera e dëmit e shprehur në të holla, e cila i njihet të dëmtuarit në emër të riparimit të dëmit. Te sigurimet e pasurisë tri janë rregullat themelore për caktimin e sasisë së shpërblimit nga sigurimi: a) sasia e shpërblimit nuk mund të jetë më e madhe sesa dëmi të cilin e ka pësuar i siguruari me paraqitjen e rastit të siguruar, b) shuma e siguruar është kufiri më i lartë i detyrimit të siguresit që del nga sigurimi, c) shpërblimi nga sigurimi nuk mund të jetë më i lartë se dëmi real ose i kontraktuar i sendit të siguruar. Këto kritere nuk zbatohen për secilin prej tyre veç e veç, pavarësisht nga ndikimi i zbatimit të kritereve të tjera, prandaj duhet shikuar ndikimi i ndërlidhur i zbatimit të tyre. Për ndryshim nga sigurimi i pasurisë, te sigurimi nga përgjegjësia dëmi, për nga vëllimit dhe sasia, vërtetohet sipas parimit të përgjegjësive deliktore, d.m.th., që në shpërblimin që i jepet të dëmtuarit mund të përfshihet jo vetëm dëmi material, por edhe ai jo material ose shpenzimet, kurse shpërblimi i dëmit, përveç dëmit të drejtpërdrejtë, mund të përfshijë edhe pasojat e shkaktuara nga dëmi i pësuar.

2. Sasia e dëmit të pësuar është kufiri më i lartë i detyrimit të siguresit.- Kriteri themelor për caktimin e sasisë së shpërblimit të dëmit nga sigurimi është sasia e dëmit të pësuar. Pra, shuma e shpërblimit të dëmit nuk mund të jetë më e madhe sesa është dëmi që ka pësuar i siguruari nga paraqitja e rastit të siguruar. Nëse shuma e siguruar është më e madhe se sasia e dëmit, nga sigurimi shpërblehet shuma në nivel të dëmit të pësuar dhe jo në nivel të shumës së siguruar.

2. (a) Pasojat e dëmshme nga paraqitja e rastit të siguruar vërtetohen në bazë të gjendjes në momentin e shkaktimit të dëmit. Janë relevante vetëm ato dëme të cilat janë shkaktuar si pasojë e drejtpërdrejtë e paraqitjes së rastit të siguruar. Dëmi mund të paraqitet në formë të humbjes, dëmtimit, shpenzimeve apo përgjegjësive ndaj të tjerëve (personave të tretë). Vlera e dëmit për caktimin e shpërblimit nga sigurimi caktohet në bazë të kritereve specifike të së drejtës së sigurimit, të cilat mund të jenë të parashikuara apo të kontraktuara.

2. (b) Është parim i përgjithshëm se i dëmtuari nuk mund të realizojë një shpërblim më të lartë se vlera e dëmit të pësuar, pra nuk mund të realizohet përfitime për faktin se është paraqitur rasti i siguruar. Nëse i siguruari realizon shpërblimin nga sigurimi, ai humb të drejtën e kërkesës së shpërblimit nga personi përgjegjës për dëmin dhe, anasjelltas, nëse i siguruari fiton shpërblimin e plotë nga personi përgjegjës për dëmin, nuk mund të realizojë edhe një shpërblim nga sigurimi. Për aq sa janë të gjitha vlerat eventuale të realizuara nga personat e tretë, për aq do të ulet shpërblimi nga sigurimi. I siguruari mban të drejtën e kërkesës së shpërblimit të dëmit nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit vetëm për

atë pjesë të dëmit të cilin nuk e ka realizuar nga sigurimi. Ndalea e kumulimit të shpërblimit është shembull eklatant i zbatimit konsekuent të parimit të shpërblimit të dëmit. Instituti i subrogimit të të siguruarit është pasojë logjike e zbatimit të këtyre parimeve. Ngjashëm me këtë, në rast të dëmtimit të tërësishëm të sendit të siguruar, i siguruari nuk ka të drejtë të mbajë mbetjet e sendit të siguruar dhe nga siguruesi të kërkojë pagesën e shumës së tërësishme të sigurimit (dëmit total). mbi këtë parim mbështetet instituti i lëshimit të sendit të siguruar (më hollësisht për këtë në komentin e dispozitës së nenit 948 të LMD)⁸⁷³.

3. Paragrafi 3 i nenit 946 të LMD ka parashikuar kriteret për caktimin e sasisë së shpërblimit të dëmit për dëmin të sigurimi i të mbjellave dhe të fryteve e produkteve të tjera të tokës. Sasia e dëmit përcaktohet duke marrë parasysh vlerën që do të kishin prodhimet në kohën e kumulimit. Kjo dispozitë është e natyrës dispozitive, prandaj palët mund të merren (kontraktjnë) vesh ndryshe. Ligji për këto sende të siguruara përcakton vetëm kohën e vërtetimit të dëmit. Kuptimi i kësaj dispozite është se në shpërblimin për dëmin përfshihet jo vetëm dëmi i thjeshtë por edhe fitimi i humbur, prandaj edhe bën përjashtim nga parimi i përgjithshëm. Dispozitë me përmbajtje të ngjashme gjejmë edhe në Kodin Civil Italian (neni 1908 par. 4). Kjo çështje parashikohet rregullisht në kontratë apo në kushtet e veçanta kontraktuese të sigurimit.

4. Dispozitat kontraktuese për kufizimin e shpërblimit për dëmin.- Në paragrafin e 4 të këtij neni është rregulluar çështja e vlefshmërisë juridike të dispozitave të kontratës, me të cilat shuma e shpërblimit reduktohet në një shumë më të vogël nga sa është sasia e dëmit. Shpërblimi nga sigurimi nuk mund të jetë më i madh nga sa është sasia e dëmit, por mund të jetë më i vogël. Kjo është përcaktuar në dispozitën e këtij paragrafi. Rregullat (standardet) për llogaritjen e dëmit përcaktohen në kontratë (kushtet e kontraktuara të sigurimit), në ligj ose zbatohen në bazë të zakoneve (dokeve) apo praktikës së standardizuar. Dëmi real i pësuar shpesh është vetëm njëri prej elementeve, përkatësisht kriteri për vërtetimin e shpërblimit nga sigurimi. Në kushtet e sigurimit rregullisht janë të parashikuar klauzolat për përjashtimin e disa dëmeve nga sigurimi ose për kufizimet në mbulimin e dëmit që shprehet në caktimin e sasisë së shpërblimit nga sigurimi. Këto klauzola janë juridikisht të vlefshme, prandaj janë të vlefshme edhe ato me të cilat shpërblimi kufizohet në një shumë më të vogël nga sa është shuma e dëmit. Këtu vlen të theksohet, gjë që nuk është më pakë e rëndësishme, se ekzistojnë forma të ndryshme të pjesëmarrjes së të siguruarit në dëmin i cili sigurohet me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit (vetëpërmbajtja e të siguruarit, llojet e ndryshme të franshizës), gjë që gjithashtu, në masë të konsiderueshme, varet sasia e shpërblimit nga sigurimi.

5. Sigurimi i fitimit të humbur.- Vëllimi i shpërblimit nga sigurimi (tërësia e llojit të dëmit) përcaktohet në bazë të rregullave të së drejtës së sigurimit e jo në bazë të rregullave të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve. Nga sigurimi shpërblehet vetëm dëmi i rëndomtë,

873 I siguruari i cili shumë e dëmit real në automobil e ka inkasuar në bazë të sigurimit kasko nuk është i autorizuar që të njëjtin dëm ta inkasoj edhe në bazë të sigurimit të detyrueshëm në qarkullim – Vs. Rev. 383/88 e dt. 5 tetor 1988, PSP-46/95.

kurse fitimi i humbur vetëm nëse ky është kontraktuar posaçërisht. Ky qëndrim kryesisht është adaptuar edhe në sistemet krahasuese. P.sh. Ligji Gjerman për Kontratat e Sigurimit – VVG (par. 53), Ligji Austriak për Kontratat e Sigurimit – Vers VG (par. 53), ai italian CC (neni 1905). Përveç në rastet e veçanta, kur ky kontraktohet posaçërisht, sigurimi i fitimit të humbur veçanërisht është cilësi e ca kontratave, siç janë, p.sh.: sigurimi i të mbjellave dhe frutave si dhe të produkteve të tjera të tokës, sigurimi i manifestimeve të ndryshme e të ngjashme. Ky parim vlen edhe te sigurimi detar, por është e lejuar që, me rastin e vlerësimit të vlerës së anijes apo mallit, për sigurimin të merret për bazë edhe fitimi i arsyeshëm i pritur. Te sigurimi i mallit në transport është e zakonshme që, përveç vlerës së mallit, të sigurohet edhe fitimi i pritur. Kufiri i lartë deri ku mund të arrijë sigurimi i fitimit të pritur është vlera e interesit të siguruar. Kjo është vlera reale e interesit e shprehur në të holla, i cili juridikisht është i lejuar të sigurohet. P.sh., në sigurimin e mallit është e zakonshme që, në emër të fitimit të pritur, të rritet vlera e sigurimit të mallit për 10%, por kjo mund të jetë edhe më e madhe, nëse mund të arsyetohet. (Sipas shprehjes së CIF dhe CIP INCOTERMS 2000, shitësi është i detyruar ta sigurojë mallin në vlerën e kontraktuar të mallit /CIF, CIP vlera/ e rritur për 10%).

6. Shpërblimi për dëmet e njëpasnjëshme (sukseseve).- Me paragrafin e 6 të këtij neni është rregulluar e drejta e të siguruarit për shpërblimin e dëmit të njëpasnjëshëm. Është parim i përgjithshëm që siguroesi është i detyruar që, për dëmin e mbuluar me sigurim, të japë shpërblimin vetëm deri te sasia e përcaktuar në kontratë ose në policën e sigurimit. Shuma e siguruar aplikohet për secilin dëm individual (rast). Kriter për aplikimin e shumës së sigurimit është rasti i siguruar (rasti i shkaktuar si pasojë e rrezikut të siguruar). Gjatë periudhës së sigurimit mund të ndodhin disa raste të siguruara njëri pas tjetrit. Pasojë e tyre mund të jetë: a) humbja e totale e sendit të siguruar, b) humbja e pjesshme apo dëmtimi i sendit të siguruar. Nëse sendi i siguruar ka humbur ose është shkatërruar, siguroesi është i detyruar ta paguajë shpërblimin për aq sa është sasia e shumës së siguruar dhe me këtë kontrata shuhet. Te dëmet e pjesshme, megjithatë, kontrata vazhdon dhe lind çështja e të drejtës së shpërblimit në rast se gjatë së njëjtës periudhë të sigurimit sendi i siguruar ka pësuar disa herë dëme të njëpasnjëshme. Në të drejtën bashkëkohore të sigurimit është provuar rregulla që, në raste të tilla, shuma e siguruar nuk zvogëlohet (zbritet) për shumën e shpërblimeve të mëparshme të paguara në atë periudhë, kurse i siguruari ka të drejtë që për secilin dëm t'i realizojë shpërblimet e posaçme në tërësi (duke marrë parasysh të gjithë shumën e sigurimit), pavarësisht nga pagesa e shpërblimeve të mëparshme. Me fjalë tjera, shpërblimi paguhet edhe kur sasia e tërësishme e shpërblimit për dëmet e mbuluara e tejkalon shumën e siguruar. Nëse në kontratë apo në kushtet e kontratës së sigurimit do të ishte parashikuar një zgjidhje tjetër, kjo dispozitë kontraktuese do të ishte nule.

7. Vlera e sendit të siguruar e përcaktuar në marrëveshje.- Palët me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit mund ta përcaktojnë në marrëveshje vlerën në të cilën lidhet kontrata. Kjo quhet vlerë e kontraktuar, kurse policat me vlerë të përcaktuar kontraktuese quhet policë e valutuar. Kur vlera e sendit të siguruar nuk është përcaktuar me marrëveshje, bëhet fjalë për policat të pavalutuara. Policat e pavalutuara, përveç shumës së siguruar, nuk kanë nevojë të përmbajnë edhe shenjë e vlerës reale të sendit të siguruar. Policat

e valutuara zakonisht i ndeshim te sigurimi i sendeve të cilat për pronarin e tyre kanë një vlerë subjektive. Në kontratë ose policë shprehimisht duhet të theksohet se është fjala për vlerën e përcaktuar me marrëveshje. Do të jetë e mjaftueshme që përkrah shumës së siguruar, të vihet shënimi “vlerë e kontraktuar”.

7. (a) varësisht nga ajo se a është vlera e sendit të siguruar e kontraktuar apo jo, e drejta e sigurimit i njeh dy sisteme për caktimin e vlerës së sendit të siguruar kompetente për vlerësimin e dëmit: 1. vlera e kontraktuar, 2. vlera e pa kontraktuar. Vlera e kontraktuar e sendit të siguruar e theksuar në kontratë apo policë të sigurimit i detyron të dy palët kontraktuese. Kjo vlerë është përcaktuese për vërtetimin e detyrimit nga sigurimi. Vlera e kontraktuar i detyron palët, pavarësisht nëse ajo i përgjigjet ose jo vlerës reale të sendit të siguruar në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit dhe pavarësisht nga ndërrimi i vlerës reale të sendit të siguruar gjatë kohës së zgjatë sigurimi, përveç nëse bëhet fjalë për përjashtimin, kur kjo vlerë është e mundur të kontestohet. Nëse është kontraktuar që sendi i siguruar ka vlerën e shënuar në kontratë, kjo vlerë është përcaktuese dhe definitive për të dy palët kontraktuese pa verifikim të mëvonshëm. Shpërblimi për dëmin përcaktohet sipas vlerës së kontraktuar, pavarësisht nëse ajo i përgjigjet ose jo dëmit real të pësuar.

7. (b) Është e mundur të provohet nga ana e siguresit që vlera e kontraktuar është shumë më e madhe nga sa është vlera efektive, përveç nëse ekziston ndonjë arsye e bazuar (si, p.sh., sigurimi i sendit të përdorur në vlerën e sendit të tillë të ri, ose sigurimi i vlerës subjektive). Prandaj i siguruari është i detyruar, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të veçanta të tejkallimit të konsiderueshëm të vlerës së sendit të siguruar, që ta njoftojë siguresin në përputhje me parimin e besimit të mirë për ekzistimin e këtyre shkaqeve. Ky fakt është rrethanë e pakontestueshme, të cilën kontraktuesi i sigurimit është i detyruar ta bëjë të ditur me rastin e lidhjes së kontratës. Vlera e kontraktuar nuk do të zbatohet në këto raste: në rast gabimi evident me rastin e përcaktimit të vlerës; në rast mashtrimi (kur kontraktuesi, duke përdorur mashtrimin, kontrakton një vlerë më të lartë nga ajo që është reale); nëse kontraktuesi, me rastin e lidhjes së kontratës, nuk e ka lajmëruar realisht vlerën e sendit të siguruar, (siguresi ka të drejtë ta anulojë kontratën, sepse është fjala për “një rrethanë të rëndësishme”); nëse vlera e kontraktuar tejkallon dukshëm vlerën interesit të siguruar, (në atë rast sigurimi do të merrte karakter të lojës së fatit, që është në kundërshtim me parimin e shpërblimit të dëmit). Me fjalë të tjera, në këto raste të veçanta siguresi ka të drejtë ta kontestojë vlerën e siguruar.

Neni 947. Parandalimi i rastit të siguruar dhe shpëtimi

- 1. I siguruari ka për detyrë të marrë masa të parashikuara, të kontraktuara dhe të gjitha masat e tjera të nevojshme për të parandaluar paraqitjen e rastit të siguruar, e në qoftë se rasti i siguruar shkaktohet, atëherë ka për detyrë të marrë çdo gjë që varet prej tij për të bërë që të kufizohen pasojat e dëmshme të tij.**
- 2. Siguruesi ka për detyrë t'i shpërblejë shpenzimet, humbjet si dhe dëmet e tjera të shkaktuara nga orvatja e arsyeshme për të mënjanuar rrezikun e drejtpërdrejtë të shkaktimit të rastit të siguruar, si dhe me tentimin që të kufizohen pasojat e dëmshme të tij edhe atëherë kur këto tentime kanë qenë pa sukses.**
- 3. Siguruesi ka për detyrë ta japë këtë shpërblim, edhe në qoftë se ky së bashku me shpërblimin e dëmit nga rasti i siguruar tejkalon shumën e sigurimit.**
- 4. Në qoftë se i siguruari nuk e përmbush detyrimin e vet të parandalimit të rastit të siguruar ose detyrimin e shpëtimit, ndërsa se për këtë nuk ka justifikim, detyrimi i siguresit zvogëlohet aq sa është paraqitur dëmi më i madh për shkak të kësaj mospërmbushje.**

Vështrim i përgjithshëm.-- Është detyrë e përgjithshme në përmbushjen e detyrimeve të tyre që pjesëmarrësit, në marrëdhëniet e detyrimeve, të veprojnë me kujdesin që kërkohet në qarkullimin juridik të llojit përkatës të marrëdhënies së detyrimit. Në marrëdhëniet nga sigurimi ky detyrim i përgjithshëm veçanërisht gjen shprehje në detyrimet e tyre për parandalimin e shkaktimit të rastit të sigurimit dhe për zvogëlimin e dëmit. Në këtë dispozitë parashikohen detyrimet e të siguruarit për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e dëmit; sanksionet në rast të mospërfilljes së këtij detyrimit dhe e drejta e të siguruarit për shpërblimin e këtyre shpenzimeve nga sigurimi.

1. Detyra primare e të siguruarit që gjatë kohëzgjatjes së sigurimit të kujdeset me kujdesin e një ekonomisti të mirë për sendin e siguruar.- Zbatimi i këtij parimi shprehet në detyrimin e të siguruarit që të ndërmarrë masa për shmangien ose zvogëlimin e dëmet. Ky detyrim është i parashikuar në paragrafin 1 të nenit 947. Në këtë dispozitë dallohen detyrimet para dhe pas shkaktimit të rastit të siguruar. I siguruari ka për detyrë të marrë masat e parashikuara, të kontraktuara dhe të gjitha masat e tjera të nevojshme për të parandaluar paraqitjen e rastit të siguruar. Pas paraqitjes së rastit të siguruar, i siguruari është i detyruar të ndërmarrë çdo gjë që varet prej tij për të bërë që të kufizohen pasojat e dëmshme të tij.

2. Shpërblimi i shpenzimeve të të siguruarit për shpëtimin.- Me detyrimin e të siguruarit për të ndërmarrë masa për parandalimin dhe zvogëlimin e dëmit, ndërlidhet edhe detyrimi i siguresit që, në rrethanat e caktuara, këto shpenzime edhe t'ia shpërblejë atij. Këto dy detyrime të palëve kontraktuese që dalin nga marrëdhëniet e sigurimit mes tyre janë të kushtëzuara. Specifika e këtij lloji të shpenzimeve, në raport me llojet e tjera të dëmit, qëndron në atë se ato i ndërmerr vetë i siguruari. Kuptimi i pranimit të tyre nga sigurimi qëndron në dëshirën që i siguruari të nxitet për të ndërmarrë veprime të shpëtimit, sepse

këto edhe ashtu synojnë mbrojtjen e sendit të siguruar dhe janë në interes të të sigurvearit. Për këtë arsye, për pranimin e tyre nga sigurimi, vlejnë rregulla të veçanta. Këto rregulla i përmban paragrafi 2 i nenit 947 të LMD. Sipas kësaj dispozite, sigurveari ka për detyrë t'i shpërblejë shpenzimet, humbjet si dhe dëmet e tjera të shkaktuara nga përpjekja e arsyeshme: a) për të mënjeluar rrezikun e drejtpërdrejtë të shkakimit të rastit të sigurvearit, b) të kufizohen pasojat e dëmshme të tij. Për detyrimin e sigurvearit të parashikuar nga kjo dispozitë, janë dy supozime: a) duhet të jenë përmbushur kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni ose b) masat e parandalimit të jenë marrë sipas urdhrit ose me pëlqimin e sigurvearit. Me këtë supozim, sigurveari është i detyruar t'ia paguajë shpenzimet e të sigurvearit në përpjekjet për shpëtim, pavarësisht nëse ato kanë rezultuar të suksesshme ose jo. Sigurvearin e ngarkon detyrimi i shpërblimit edhe në rastin kur përpjekjet kanë ngelur të pasuksesshme. Kjo është njëra prej karakteristikave thelbësore të sigurimit të këtyre shpenzimeve dhe, në parim, vlen për të gjitha sigurimet e pasurisë. Në këtë pikë ekziston pëlqimi i sistemeve krahasuese. Sipas dispozitave të këtij neni, i sigurveari nuk e ka vetëm të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve të shpëtimit, por edhe të shpërblimit të humbjeve dhe dëmeve të tjera të shkaktuara gjatë përpjekjeve të shpëtimit. Dispozita e këtij neni i rregullon marrëdhëniet mes palëve nga kontrata e sigurimit, prandaj palët e treta nuk mund t'u referohen atyre. Për marrëdhëniet e palëve të treta dhe palëve nga kontrata e sigurimit vlejnë parimet e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve.

3. Detyrimi i shpërblimit nga sigurimi mbi shumën e sigurvearit. Shpenzimet e jashtëzakonshme të të sigurvearit për shpëtimin të parashikuar nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni shpërblehen nga sigurimi edhe atëherë kur ky, së bashku me shpërblimin e dëmit nga rasti i sigurvearit, tejkalon shumën e sigurimit. Prandaj këto shpenzime paguhet nga sigurimi jo vetëm pavarësisht nga rezultati i dobishëm, por edhe kur së bashku me shpërblimin e dëmit tejkalon shumën e sigurvearit. Kjo shprehimisht është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni. Ky është përjashtimi nga parimi i përgjithshëm që sasia e shpërblimit nga sigurimi është e kufizuar me shumën e sigurvearit. Arsyeja për këtë zgjidhje është e njëjtë si edhe për pranimin e këtyre shpenzimeve nga sigurimi. Në rrethanat e jashtëzakonshme të shpëtimit është e pamundur të vlerësohet nëse shpenzimet e shpëtimit së bashku me shpërblimin e dëmit do të tejkalojnë ose jo shumën e sigurvearit. Vetë fakti i ekzistimit të detyrimit të shpëtimit imponon zgjidhjen që këto shpenzime, edhe në pikëpamje të sasisë, duhet të kenë trajtim të veçantë.

3. (a) Me dispozitat e LMD, përveç që është parashikuar se shpenzimet e shpëtimit shpërblehen edhe atëherë kur, së bashku me shpërblimin, e tejkalojnë shumën e sigurvearit, nuk janë vënë kufijtë e epërm të detyrimit të sigurvearit për këto shpenzime. Kjo do të thotë se këto shpërblehen nga sigurimi pa kufizim. Kjo është e dyfishtë: a) shpenzimi duhet të jetë i arsyeshëm; b) kufiri i epërm i këtyre shpenzimeve nuk mund të jetë më i madh se shumta e sigurvearit.

3. (b) Për vlerësimin e arsyeshmërisë së ndërmarrjes së veprimeve të shpëtimit është përcaktuese sasia e shumës së sigurvearit, d.m.th. vlera e interesit të sigurvearit. Nuk është e arsyeshme të ndërmerret aksioni i shpëtimit kur është evidente se ai do të rriste, e jo të zvogëlonte detyrimin e sigurvearit. Secili shpenzim i bërë mbi shumën e sigurvearit nuk është i arsyeshëm.

4. Zvogëlimi i detyrimit të siguruesit në rast të mosveprimit të të siguruarit.- Paragrafi 4 i këtij neni parashikon sanksionin kur i siguruari nuk e përmbush detyrimin e vet të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni. Në këtë situatë, detyrimi i siguruesit zvogëlohet në përpjesëtim me rritjen e dëmit për shkak të kësaj mospërmbushjeje. Ky është një lloj i veçantë i shpërblimit të dëmit në favor të siguruesit. Për zbatimin e dispozitave të këtij paragrafi është e nevojshme të plotësohen këto kushte. a) të ekzistojë mosveprimi i të siguruarit, b) të jetë rritur dëmi në krahasim me rrethanat normale dhe c) të ekzistojë lidhja shkakësore mes mosveprimit dhe rritjes së dëmit. Mosveprimin e të siguruarit është i detyruar ta provojë siguruesi. Ligji nuk bën fjalë për shkallën e përgjegjësisë me të cilën i siguruari duhet ta ketë cenuar detyrimin e vet për zbatimin e kësaj dispozite, përkatësisht a ka vepruar ai me pakujdesi të rëndomtë apo me pakujdesi ekstreme. Nga kjo rrjedh se, për zbatimin e kësaj dispozite, nuk është përcaktuese shkalla përkatëse e fajit. Është relevante vetëm ajo nëse janë plotësuar prezumimet e duhura.

Neni 948. Lënia e sendit të dëmtuar që është siguar

Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, i siguruari nuk ka të drejtë që pas paraqitjes së rastit të siguar t'ia lejë siguruesit sendin e siguar të dëmtuar dhe të kërkojë prej tij pagimin e shumës së plotë të sigurimit.

Instituti i lënies së sendit të siguar. Lënia e sendit të siguar te siguruesi pas paraqitjes së rastit të siguar, zbatohet në rastin e dëmtimit të tërësishëm të sendit të siguar. Sipas këtij instituti, në rastin e dëmtimit të tërësishëm të sendit të siguar, i siguruari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit nga sigurimi, sikur të ketë ndodhur humbja totale e sendit të siguar, me kusht që siguruesit t'ia lërë dispozicion sendin e dëmtuar e të siguar. I siguruari nuk mund ta realizojë shpërblimin nga sigurimi për humbjen totale dhe ta mbajë sendin e siguar që është dëmtuar. Supozohet, në të vërtetë, se këto mbetje kanë një vlerë të caktuar, kështu që po t'i mbante ato i siguruari, në këtë pjesë ai do të realizonte një përfitim të pabazë, gjë që, me institutin e lënies, synohet të pengohet, duke marrë parasysh se kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e shpërblimit të dëmit. Shpallja e lënies së sendit të siguar është e drejtë e të siguruarit, por jo edhe detyrë e tij. Për realizimin e kësaj të drejte, nuk ka nevojë për kontratë. Në vend që t'ia lërë sendin e siguar siguruesit, i siguruari mund të kërkojë që dëmi të trajtohet si dëm i pjesshëm. Shpërblimi nga sigurimi atëherë vërtetohet sipas rregullave të cilat vlejné për dëmet e pjesshme.

a) Me pagimin e dëmit të tërësishëm, në bazë të pranimit të lajmërimit të lënies së sendit të siguar, të gjitha të drejtat që i ka pasuri siguruari mbi sendin e siguar kalojnë te siguruesi. Ndër këto të drejta, mbizotëruese është ajo e pronësisë. Me pagimin e shumës së sigurimit për humbjen totale, siguruesi bëhet pronar i mbetjes së sendit të siguar. Me pranimin e lajmërimit të lënies te siguruesi, përveç të drejtave, kalojnë edhe të gjitha detyrimet dhe, eventualisht, përgjegjësit lidhur me sendin e siguar.

b) Lënia e sendit të siguruar është instituti i përgjithshëm i pranuar në të drejtat krahasuese të sigurimit detar. Dispozitat ligjore janë të natyrës juridike disponibile, prandaj palët mund të kontraktjnë edhe ndryshe nga ç'është parashikuar në ligj. Atëherë do të vlejë ajo që është kontraktuar mes palëve. Për këtë arsye, dispozitat për humbjen totale shpesh janë të parashikuara në kushtet e standardizuara të sigurimit, gjë që e karakterizon zbatimin e kritereve të ndryshme me rastin e përcaktimit të humbjes së tërësishme.

c) Instituti i lënies në sigurimin e pasurisë.- Instituti i lënies së sendit të dëmtuar të siguruar në favor të sigurvecit në sigurimin e pasurisë zbatohet vetëm nëse kjo është kontraktuar shprehimisht. Sipas dispozitave të këtij neni, i siguruari nuk ka të drejtë që, pas paraqitjes së rastit të siguruar, t'ia lërë sigurvecit sendin e siguruar të dëmtuar dhe nga ai të kërkojë pagimin e shumës së plotë të sigurimit. Me fjalë tjera, pjesët e shpëtua, përkatësisht sendet e dëmtuara ngelin tek i siguruari, kurse sigurveci e kalkulon rregullisht vlerën e këtyre sendeve në llogarinë përfundimtare të dëmit. Që në këtë drejtim të mos ketë kurrfarë mëdyshjesh, kushtet standarde për sigurimin e pasurisë në këtë drejtim përmbajnë dispozita të qarta.

ç) Një dispozitë e tillë, p.sh., ka këtë formulim: “Nëse nuk është kontraktuar ndryshe, pjesët e shpëtua, përkatësisht të dëmtuara i mbesin të siguruarit. ...Vlera e sendeve të shpëtua, përkatësisht të dëmtuara dhe/ose pjesëve të tyre kalkulohet sipas çmimeve të tregut në vendin e shkakimit të dëmit sipas gjendjes në ditën e paraqitjes së rastit të siguruar” (këto janë kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë të shumicës së bashkësive të sigurimit në Kosovë).

Neni 949. Shkatërrimi i sendit për shkak të ngjarjes që nuk është parashikuar në policë

- 1. Në qoftë se sendi i siguruar, ose sendi i lidhur me përdorimin e të cilit është kontraktuar sigurimi nga përgjegjësia, shkatërrohet gjatë periudhës së sigurimit për shkak të ndonjë ngjarjeje që nuk është parashikuar në policë , kontrata nuk ka më fuqi dhe sigurveci ka për detyrë t'i kthejë kontraktuesit të sigurimit pjesën e premisë në përpjesëtim me kohën e mbetur.**
- 2. Kur një nga disa sende të përfshira me një kontratë shkatërrohet për shkak të ndonjë ngjarjeje që nuk është parashikuar në policë , sigurimi mbetet në fuqi edhe më tutje për sa i përket sendeve të tjera kundrejt ndryshimeve të nevojshme për shkak të zvogëlimit të objektit të sigurimit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Shkatërrimi i sendit të siguruar (humbja e tërësishme) mund të jetë pasojë e: a) paraqitjes së rastit të siguruar, b) shkakut që nuk është përfshirë me sigurim ose në kontratë është përjashtuar nga sigurimi. Nëse shkatërrimi i sendit të siguruar ka ndodhur për shkak të rrezikut të siguruar të krijuar nga rasti i siguruar, sigurveci është i detyruar ta paguajë shpërblimin e dëmit në sasi të shumës së siguruar. Duke marrë

parasysh se sendi, në raport me të cilin është lidhur sigurimi, më nuk ekziston, pushon edhe marrëdhënia juridike nga sigurimi. Atëherë kontrata e sigurimit shuhet. Kjo është njëra prej mënyrave të jashtëzakonshme të shuarjes së kontratës së sigurimit. Siguruesi ka të drejtën e premisë për tërë kohëzgjatjen e sigurimit. Objekt rregullimi i kësaj dispozite, megjithatë, nuk është ky rast, por ai i përmendur në pikën b), përkatësisht sendi i siguruar gjatë periudhës së sigurimit shkatërrohet për shkak të ndonjë ngjarjeje që nuk është e parashikuar në policë. Lidhur me pasojat juridike, në ligj janë parashikuar dy situata: a) është i siguruar një send dhe ai shkatërrohet, b) janë të siguruara disa sende dhe shkatërrohet vetëm njëri prej tyre.

1. Shuarja e kontratës për shkak të shkatërrimit të sendit të siguruar.- Nëse sendi i siguruar ose sendi për përdorimin e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit nga përgjegjësia, shkatërrohet gjatë kohëzgjatjes së sigurimit për shkak të ndonjë ngjarjeje që nuk ka qenë e parashikuar në kontratën e sigurimit, kontrata pushon të vlejë në ditën e shkatërrimit të sendit. Arsyeja është e njëjtë si edhe në rastin e shkatërrimit të sendit për shkak të rrezikut të siguruar. Pasojat juridike, në raport me preminë e sigurimit, nuk janë të njëjta në të dy rastet. Nëse kontrata shuhet për arsyet e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, siguruesi është i detyruar t'ia kthejë kontraktuesit të sigurimit pjesën e premisë në përpjesëtim me kohën e mbetur të kohëzgjatjes së sigurimit. Kjo rregull ruan parimin e ndarjes së premisë, sipas së cilës premia paguhet vetëm për atë kohë gjatë së cilës siguruesi mban rrezikun. Nëse siguruesi e ka paguar preminë për tërë kohëzgjatjen e sigurimit, p.sh., për një vit, dhe pas kalimit të një të katërtës së kësaj kohe, ndodh shkatërrimi i sendit të siguruar, siguruesi është i detyruar t'ia kthejë tre të katërtat e premisë së paguar. Si raste të papërfshira në kontratë, duhet kuptuar secili rast i pasiguruar (dëmi është pasojë e rrezikut të pasiguruar; dëmi me kontratë është përjashtuar nga sigurimi). Dispozitat e këtij paragrafi për kthimin e premisë së sigurimit nuk do të zbatohen as në rastin kur shkatërrimi i sendit të siguruar ka ndodhur me veprimin e qëllimshëm të kontraktuesit të sigurimit, siguruesit apo shfrytëzuesit të sigurimit.

2. Shkatërrimi i njërit prej disa sendeve të siguruara.- Nga disa sende të përfshira në një kontratë, mund të shkatërrohet vetëm njëri prej tyre nga ngjarja e cila nuk është e mbuluar me sigurim. Në këtë situatë, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, kontrata vazhdon lidhur me sendet të cilat nuk janë shkatërruar kundrejt ndryshimeve të nevojshme për shkak të zvogëlimit të objektit të sigurimit. Në këtë rast jemi përpara dy gjërave: lidhur me sendin e shkatërruar, kontrata shuhet; për sendet tjera, kontrata mbetet në fuqi, por ajo, lidhur me shumën e sigurimit dhe premisat e sigurimit, ndryshohet duke iu përshtatur gjendjes së re të krijuar.

NËNKREU 2 KUFIZIMI I RREZIQEVE TË SIGURUARA

Neni 950. Dëmet e mbuluara nga sigurimi

1. Siguruesi ka për detyrë t'i shpërblejë dëmet e shkaktuara rastësisht ose për faj të kontraktuesit të sigurimit të siguruarit ose të shfrytëzuesit të sigurimit, përveç nëse për dëmin e shkaktuar ky detyrim i tij është përjashtuar shprehimisht me kontratën e sigurimit.
2. Ai nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje nga këta persona, kështu që është nule dispozita në policë që do të parashikonte përgjegjësinë e tij edhe në këtë rast.
3. Në qoftë se do të realizohet rasti i siguruar, siguruesi ka për detyrë ta shpërblejë secilin dëm të shkaktuar nga ana e ndonjë personi, për veprimet e të cilit i siguruari përgjigjet mbi cilëndo bazë qoftë, pavarësisht nëse dëmi është shkaktuar ose jo nga pakujdesia ose me dashje.

Vështrim i përgjithshëm.- Kreu 2 nënkreu II – SIGURIMI I PASURISË emërtohet Kufizimi i rreziqeve të siguruara. Në këtë kapitull janë të parashikuar dëmet të cilat, sipas dispozitave të këtij Ligji nuk janë të mbuluara me sigurim. Dëmet e përjashtuara nga sigurimi përbëjnë një kategori të veçantë të dëmeve. Për dëme të përjashtuara nga sigurimi bëhet fjalë kur pasoja e caktuar (lloji i dëmit) përgjithësisht është e mbuluar me sigurim, por nga sigurimi është i përjashtuar, nëse pasoja në ligj apo në kontratë e shkaqeve të parashikuara është e sanksionuar. Këto dëme duhen dalluar nga ato që janë të shkaktuara nga rreziqe të pasiguruara. Këto dëme duhen dalluar edhe nga dëmet të cilat sigurimin në përgjithësi, nuk i mbulon, edhe kur kemi të bëjmë me pasojat e rrezikut të siguruar, siç janë dëmet me pasoja të ndryshme të natyrës financiare, përveç kur kjo nuk është kontraktuar në mënyrë të veçantë. Nga sigurimi i sendit nuk ofrohet shpërblim as për dëmin jo material, p.sh., për dhimbje, frikë, integritet fizik dhe jo për të gjitha dëmet që i pëson i siguruari nga ndodhja e rastit të siguruar. Përveç kësaj, këto dëme janë shkaktuar si pasojë e largët e realizimit të rrezikut të siguruar. Dëmet e përjashtuara nga sigurimi mund të jenë: a) të parashikuara, b) të kontraktuara. Në sistemet krahasuese, në përgjithësi, është aprovuar qëndrimi që, në bazë të vetë ligjit, disa dëme, përkatësisht rreziqe, janë të përjashtuara nga sigurimi. Disa nga këto përjashtime janë të rregulluara me rregulla dispozitive dhe mund të sigurohen veçanërisht, ndërsa të tjerat nuk mund të sigurohen as me dispozita eksplicite kontraktuese. Këto janë ato rreziqe që janë në kundërshtim me themelet e rendit juridik. P.sh., dëmet e shkaktuara qëllimisht nuk mund të sigurohen fare. Sipas LMD, nga sigurimi janë të përjashtuara dëmet që shkaktohen si pasojë e: a) veprimit të qëllimshëm të kontraktuesit të sigurimit, të siguruarit ose të shfrytëzuesit të sigurimit, b) mungesës së sendit të siguruar, c) operacioneve luftarake dhe kryengritjeve. Brenda dispozitave të lejuara me ligj, palët mund t'i sigurojnë shprehimisht dëmet e përjashtuara nga sigurimi. Nëse në këtë drejtim asgjë e veçantë nuk kontraktohet, nga sigurimi janë të përjashtuara ato dëme që janë të parashikuara me rregulla.

1. Dëmet e shkaktuara rastësisht dhe me faj.- Kur dëmi është pasojë e fajit të të siguararit, faji mund të jetë i shkallëve të ndryshme. Në sigurimet bashkëkohore është përgjithësisht e pranuar se moskujdesi i rëndomtë nuk përbën arsye të mjaftueshme për përjashtimin ligjor nga sigurimi. Me ligje nga sigurimi zakonisht përjashtohen dëmet të cilat kanë lindur si pasojë e veprimit të qëllimshëm ose pakujdesisë ekstreme (p.sh. VVG gjerman – neni 61, zviceran VVG-neni 14, austriak – Vers VG –neni 61). Për dallim nga dëmi i shkaktuar me qëllim, dëmet e shkaktuara nga pakujdesia ekstreme mund të sigurohen. Në këtë mënyrë, të drejtën e sigurimit është braktisur vetëm rregulla juridike, sipas së cilës pakujdesia ekstreme ka qenë e barazuar me qëllimin (**Culpa lata dolo aequiparatur**). Paragrafi 1 i nenit 950 të LMD shprehimisht përcakton që siguroesi është i detyruar t’ia shpërblejë të siguararit ose të shfrytëzuesit të sigurimit dëmin e shkaktuar rastësisht ose për faj të kontraktuesit të sigurimit. Kjo dispozitë është e natyrës juridike dispozitive, prandaj me kontratën e sigurimit këto dëme është e mundur të përjashtohen nga sigurimi. Ligji nuk definon termin “rastësisht”, por e thekson fajin e siguroesit si shkaktar i dëmit, duke mos përcaktuar më hollësisht se për çfarë shkalle të fajësisë mendon. Duke marrë parasysh se me paragrafin vijues qëllimi është përjashtuar shprehimisht nga sigurimi, me faj të personave përgjegjës në kuptim të kësaj dispozite duhet kuptuar pakujdesia e thjeshtë dhe ajo ekstreme. Kjo do të thotë se në ligj janë të mbuluara dëmet e shkaktuara për pakujdesi të thjeshtë dhe ekstreme të të siguararit, përveç nëse nuk është kontraktuar ndryshe.

2. Dëmi i shkaktuar me qëllim.- Nga sigurimi gjithnjë janë të përjashtuara dëmet që janë shkaktuar drejtpërdrejt ose tërthorazi, për shkak të veprimit të qëllimshëm të të siguararit. Qëllimi (**dolus**) ekziston kur i dëmtuari veprimin kundërligjor e ndërmer me qëllim, i vetëdijshëm se me këtë veprim do të shkaktojë ose mund t’i shkaktojë tjetrit dëm dhe, përkundër kësaj, do që kjo të ndodhë ose është pajtuar që kjo të ndodhë. Këto dëme nuk mund të sigurohen fare. Dëmet e shkaktuara qëllimisht nuk bien në kuptimin e rrezikut në vështirësi të së drejtës për sigurim, sepse shkaktohen me vullnetin ekskluziv të të siguararit. Për këtë arsye, të gjitha sistemet juridike këto dëme janë përjashtuar nga sigurimi. Dispozitat për përjashtimin e tyre janë të natyrës juridike, prandaj nuk është e mundur të sigurohen as me dispozita shprehimore kontraktuese. Ky parim është përmbahet në paragrafin 2 të këtij neni. Shprehimisht theksohet se secila dispozitë kontraktuese e cila do ta detyronte siguroesin për këto dëme, do të ishte nule.

3. Personi fajtor për veprimet e të cilit përgjigjet i siguruari.- Është rregull e përgjithshme që për veprimet dhe lëshimet e personave me të cilët shërbehet në veprimtarinë e vet, lidhur me kryerjen e detyrave të tyre, punëdhënësi (personi përgjegjës) përgjigjet si për punët dhe lëshimet e veta. Zbatimi i kësaj rregulle në marrëdhëniet nga sigurimi do të thoshte që nga sigurimi të përjashtohen dëmet e shkaktuara nga veprimi i qëllimshëm i të punësuarit të të siguararit ose nga personi për të cilin i siguruari kujdeset (fëmijët e mitur, pasardhësit e retarduar etj.). Kjo rregull nuk vlen në marrëdhëniet nga sigurimi, sepse përjashtimi i qëllimit të të siguararit ka të bëjë vetëm me atë personalisht, kur bëhet fjalë për person fizik, por nëse është fjala për person juridik, atëherë veprimet e personit juridik që kryen ndonjë detyrë udhëheqëse ose ndonjë detyrë tjetër të rëndësishme, do të konsiderohen

veprime të të siguarit (**alter ego**). Veprimet ose lëshimet e personave me të cilët i siguruari shërbehet gjatë veprimtarisë nuk lindin “me vullnetin ekskluziv” të të siguarit, por vetëm me vullnetin e tyre dhe kjo nuk është relevante për palët kontraktuese. Prandaj, në paragrafin 3 të këtij neni parashikohet që siguruesi ka për detyrë ta shpërblejë secilin dëm të shkaktuar nga ana e ndonjë personi, për veprimet e të cilit i siguruari përgjigjet mbi cilëndo bazë qoftë. Nuk është me rëndësi me këtë rast nëse dëmi është shkaktuar ose jo nga pakujdesia ose me dashje. Me fjalë tjera, qëllimi i këtyre personave është i mbuluar me sigurimin. Ligji fletë për “secilin dëm”, prandaj nuk është e qartë se për cilat lloje të dëmeve mendohet. Siguruesi është i detyruar t’ia shpërblejë të siguarit vetëm ato lloje të dëmit dhe në atë sasi sa ato janë të mbuluara me kontratën e sigurimit. Kjo ka të bëjë me të gjitha dëmet, pra a edhe me ato që i kanë shkaktuar personat e të siguarit.

Neni 951. Dëmet e shkaktuara nga të metat e sendit të siguar

Siguruesi nuk përgjigjet për dëmin në sendin e siguar që rrjedh nga të metat e tij, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.

Humbja ose dëmtimi i sendit të siguar mund të jetë shkaktuar edhe me ndonjë të metë të apo veti të tij natyrore, p.sh. përdorimi i gjatë, gabimi i fabrikës, e meta e brendshme, e meta e fshehur, vetia e thyerjes së lehtë, vetëndezja, prishja, eksploziviteti etj. Një karakteristikë e përgjithshme e këtyre shkaqeve është se veprojnë nga vetë sendi i siguar. Për këtë arsye, nuk janë të përfshirë me kuptimin “rrezik” në vështrim të së drejtës së sigurimit. Ato nuk hyjnë as në kuptimin “të gjitha rreziqet”, pavarësisht nga fakti se në disa sigurime edhe këto rreziqe mund të sigurohen. Rreziku është një rrethanë e pasigurt, e cila në sendin e siguar vepron nga jashtë dhe shfaqja e tij në raport me ecurinë e rregullt të ngjarjes është e jashtëzakonshme. Nga kjo rrjedhë se këto rreziqe nuk përfshihen në mbulesat standarde të sigurimit të pasurisë, prandaj me rregullat juridike dhe kushtet e sigurimit rregullisht janë të përjashtuara nga sigurimi.

a) Për sigurimin e këtyre rreziqeve është i nevojshëm një specifikim shprehimor kontraktues. Kjo mundësi në sigurimin e pasurisë është dukshëm e kufizuar. Në sigurimin e mallit në qarkullim është karakteristike që, përkrah mbulesës standarde “të të gjitha rreziqeve”, mund të sigurohen edhe rreziqet e shumta, të cilat lindin me gjithë rrethanat normale të zhvillimit të qarkullimit, (dekompozimi, rrjedhja, mungesa, ndryshku, oksidimi, korrozioni, nxehtësia, djersitja, vetëndezja etj.).

b) Me këtë dispozitë vërtetohet rregulla e përgjithshme e të drejtës së sigurimit, duke parashikuar që siguruesi nuk përgjigjet për dëmin që pëson sendi i siguar nga të metat e tij. Ligji nuk shpjegon se çka nënkupton me termin “të meta”. Konsiderohet se ky term përfshin vetitë natyrore dhe të metat e sendit. Për sigurimin e dëmeve që rrjedhin nga të metat e sendit të siguar, supozimi është se këto të meta nuk kanë qenë të njohura për të siguarin në kohën e përfundimit të sigurimit. Dijenja e të siguarit se ekzistojnë këto rrethana do ta bënin të pavlefshme kontratën. Barra e provës bie mbi sigurusin.

Neni 952. Dëmet e shkaktuara nga operacionet e luftës dhe kryengritjet

- 1. Siguruesi nuk ka për detyrë t'i shpërblejë dëmet e shkaktuara nga operacionet e luftës ose kryengritjet, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.**
 - 2. Siguruesi ka për detyrë të provojë se dëmi është shkaktuar nga ndonjë prej këtyre ngjarjeve.**
-

1. Në të gjitha sigurimet e sendeve, rreziqet e luftës janë të përjashtuara nga sigurimi. Kjo është aprovuar në përgjithësi në sistemet krahasuese. Të gjitha kushtet për sigurimin e pasurisë dhe sigurimin detar përmbajnë dispozita me të cilat nga sigurimi përjashtohen rreziqet e luftës dhe ato politike. Në praktikë, sigurimi i rreziqeve të luftës zbatohet ndaras nga sigurimi i vetë sendeve. Gjer në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, rreziqet e luftës kanë qenë të përfshira në sigurimin e rregullt të sendeve. Arsyet themelore për trajtimin e ndarë janë: realizimi i rreziqeve të luftës mund të shkaktojë dëme të përmasave të mëdha; në afat më të gjatë, është e pamundur të parashikohet shkaktimi i tyre, zgjatja dhe zonat e zhvillimit, përmasat që do t'i arrijnë, pastaj palët ndërluftuese etj.. Për shkak të të gjitha këtyre, nuk është e mundur që rreziku të vlerësohet me anë të metodave statistikore. Rreziqet e luftës, sipas natyrës së tyre, janë dukshëm më të ndryshme sesa rreziqet tokësore dhe detare. Ngjashëm me ligjet për sigurimin të sistemeve të tjera juridike, LMD, me dispozitat e këtij neni, shprehimisht përjashton nga mbulesa dëmet e shkaktuara nga operacionet luftarake dhe kryengritjet. Dispozita është e natyrës juridike dispozitive, prandaj palët mund t'i sigurojnë veçanërisht rreziqet e luftës. Ligji më hollësisht nuk përcakton se çka konsiderohet operacion i luftës dhe kryengritje. Kjo i është lënë ta zgjidhë, para së gjithash, praktika gjyqësore.

2. Me rastin e shpërblimit të dëmit sipas kërkesës së të siguruarit, siguruesi, për t'u liruar nga detyrimi i shpërblimit të dëmit, duhet të provojë se dëmi është shkaktuar nga ndonjëra prej këtyre ngjarjeve, nëse me të siguruarin nuk kanë parashikuar në kontratë se edhe në rast të shkaktimit të dëmit nga operacionet e luftës dhe kryengritjeve, të siguruarit do t'ia shpërblejë dëmin shkaktuar. Ndërkaq, sa u përket dispozitave ligjore në raport me rreziqet e luftës dhe rreziqet politike, ato në përgjithësi janë të mangëta, ndërsa në praktikë rregullisht përjashtimi i këtyre rreziqeve nga sigurimi, në mënyrë precize rregullohet me dispozita kontraktuese ose me kushte të sigurimit. Veçanërisht kjo ndodh pas paralajmërimeve më të reja të gjendjeve të luftës dhe të akteve terroriste.

NËNKREU 3 MBISIGURIMI DHE KONTRATA ME DISA SIGURUES

Neni 953. Mbisigurimi

1. Në qoftë se kur lidhet kontrata njëra palë përdorë mashtrimin dhe në këtë mënyrë kontrakton shumën e sigurimit më të madhe nga sa është vlera efektive e sendit të siguruar, pala tjetër mund të kërkojë anulimin e kontratës.
2. Në qoftë se shuma e kontraktuar e sigurimit është më e madhe nga sa është vlera e sendit të siguruar, ndërsa asnjëra nga palët nuk ka vepruar në mënyrë të pandërgjegjshme dhe të pandershme, kontrata mbetet në fuqi, shuma e sigurimit zbritet deri në shumën e vlerës efektive të sendit të siguruar, kurse premitë zvogëlohen përpjesëtimisht.
3. Në të dy rastet siguruesi i ndërgjegjshëm mban premitë e marra dhe ka të drejtë në preminë e pazvogëluar për periudhën vijuese.

Vështrim i përgjithshëm.- Nënkreu 3 i kreut II rregullon marrëdhëniet e palëve në rastin e mbisigurimit, sigurimit të shumëfishtë, sigurimit të dyfishtë dhe bashkësigurimit. Vihen rregulla për caktimin e sasisë së shpërblimit të dëmit në këto raste. Në sigurimet e pasurisë janë tri kritere themelore për caktimin e sasisë së shpërblimit nga sigurimi: sasia e dëmit të pësuar, sasia e shumës së siguruar dhe vlera e sendit të siguruar. Këto kritere nuk aplikohen të veçanta, secili për vete, pavarësisht nga efektet e kriteret e tjera, prandaj duhen shikuar marrëdhëniet reciproke të ndikimit të aplikimit të tyre. Në këtë dispozitë bëhet fjalë për efektet e mbisigurimit, por fillimisht duhet të njihemi edhe me format e tjera të marrëdhënieve të shumës së siguruar me vlerën e sendit të siguruar. Sigurimi mund të aplikohet në vlerë reale, në vlerë më të madhe apo më të vogël nga vlera reale e sendit të siguruar (vlera e interesit të siguruar). Gjithashtu edhe shuma e siguruar mund të jetë e njëjtë, më e madhe ose më e vogël nga vlera e sendit të siguruar, e cila është përcaktuar me marrëveshje në kontratën e sigurimit - vlera e kontraktuar). Nëse sigurimi është aplikuar në vlerën reale, atëherë kemi të bëjmë me sigurim të plotë. Po qe se zbatohet sigurimi në vlerë më të madhe nga vlera reale, kemi të bëjmë me mbisigurimin. Nëse sigurimi është aplikuar në vlerë më të vogël nga vlera reale e sendit të siguruar, bëhet për nënsigurimin. Të sigurohet ka mundësi edhe pjesa e vlerës së kontraktuar të sendit të siguruar dhe atëherë kemi të bëjmë me sigurimin e pjesshëm. Për secilin prej këtyre rasteve, e drejta e sigurimit i njej rregullat e veçanta për caktimin e sasisë së shpërblimit nga sigurimi. Në rastin e mbisigurimit, është rregull themelore që nga sigurimi të shpërblehet dëmi në sasinë e vlerës reale të sendit të siguruar. Askush nuk mund të realizojë fitim nga mbisigurimi. Këtu shihet zbatimi konsistent i parimit të shpërblimit të dëmit. Ngjashëm me këtë, nëse vlera e sendit të siguruar është kontraktuar dhe shuma e siguruar është më e madhe se ajo vlerë, nga sigurimi shpërblehet vetëm vlera e kontraktuar. Mbisigurimi mund të ndodhë: a) në momentin e lidhjes së kontratës, b) më vonë, gjersa sigurimi është i vlefshëm. Rasti nën b) është i rregulluar me dispozitën e nenit 954 të LMD.

1. Mbisigurimi mashtrues.- Shkaqet e mbisigurimit mund të jenë të ndryshme. Sipas dispozitës së këtij neni, pasojat juridike të mbisigurimit varen nga fakti nëse pala, me rastin e lidhjes së kontratës, ka vepruar ose jo me vetëdije. Shkalla më e lartë e pandërgjegjshmërisë shihet te mbisigurimi mashtrues. Mashtrimi me rastin e lidhjes së kontratës ekziston kur kontraktuesi vepron me mashtrim në paraqitjen e vlerës së sendit të siguruar, duke synuar përfitimin kundërligjor të dobisë pasurore në rast të shkaktimit të dëmit. Kjo sjellje është juridikisht e palejueshme, prandaj ligjvënësi, duke parashikuar sanksione me rregulla të veçanta, përpiqet t'i pengojë këto dukuri. Këtë rregull e përmban paragrafin 1 i këtij neni, në të cilin thuhet: “Në qoftë se kur lidhet kontrata njëra palë përdor mashtrimin dhe në këtë mënyrë kontraktin shumë e sigurimit më të madhe nga sa është vlera efektive e sendit të siguruar, pala tjetër mund të kërkojë anulimin e kontratës. Kjo zgjidhje e të drejtës sonë është në përputhje të plotë me zgjidhjen që e kanë sistemet krahasuese.

2. Pasojat juridike kur kontraktuesit janë të ndërgjegjshëm.- Në paragrafin 2 të këtij neni janë rregulluar pasojat juridike të mbisigurimit, kur asnjëra nga palët nuk ka vepruar në mënyrë të pandërgjegjshme dhe të pandershme. Me këtë dispozitë është vënë rregulla e veprimit në rast të mbisigurimit. Pasojat juridike mund të shikohen në raport me: a) kontratën, b) shumë e siguruar dhe c) preminë e sigurimit. Mbisigurimi nuk ndikon në rregullsinë e kontratës së sigurimit. Kontrata edhe më tej prodhon efekte kontraktuese. Shuma e sigurimit zbritet deri në shumë e vlerës efektive të sendit të siguruar, kurse premitë zvogëlohen përpjesëtimisht. Me kontratë ose me kushtet e sigurimit mund të parashikohet një zgjidhje që do të ishte më e volitshme për të siguruarin. Një dispozitë e tillë kontraktuese do të ishte juridikisht e vlefshme. Ligji nuk thotë se për çfarë tejkalmi të vlerës duhet të bëhet fjalë, në mënyrë që të zbatohen rregullat e mbisigurimit. Vlera e sendeve në treg, me kalimin e kohës, ndryshojnë, gjë që tregon për vështirësitë me rastin e zgjedhjes së kriterëve për zbatimin e kësaj dispozite. Tejkalimet e vogla, për këtë arsye, nuk e bëjnë të mundur të drejtën e zbatimit të rregullave për mbisigurimin. Tejkalmi duhet të jetë i konsiderueshëm dhe i pajustificueshëm.

3. Paragrafi 3 i këtij neni parashikon: “Në të dy rastet, siguroesi i ndërgjegjshëm mban premitë e marra dhe ka të drejtën e premisë e pazvogëluar për periudhën vijuese”. Ky paragraf në raport me paragrafin 1 të këtij neni është në rregull, por ai është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me paragrafin 2, me të cilin parashikohet që shuma e sigurimit të zbritet deri në shumë e vlerës efektive të sendit të siguruar, kurse premitë të ulen përpjesëtimisht, ndërkaq në paragrafin 3 i jepet e drejta siguroesit të mbajë premitë e marra dhe të ketë të drejtën e premisë së pazvogëluar për periudhën vijuese. Konsideroj se ky paragraf, sa i përket rastit të parë që ka të bëjë me paragrafin 1 të këtij neni, është në rregull, ndërsa te paragrafi 2 i këtij neni nuk do të duhej të gjente zbatim në praktikë, duke marrë parasysh dispozitën e nenit 4 dhe 7 të LMD (parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë dhe parimin e ekuivalencës së prestimeve).

Neni 954. Zvogëlimi i mëvonshëm i vlerës

Në qoftë se vlera e siguruar zvogëlohet për kohën e afatit të sigurimit, secila palë kontraktuese ka të drejtë në zbritjen përkatëse të shumës së sigurimit dhe të premisë, duke filluar nga data kur ia ka komunikuar palës tjetër kërkesën e vet për zbritje.

Vlera e sendit të siguruar gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, për arsye të ndryshme, mund të zvogëlohet (me rënien e shpejtë të vlerës së tregut, me shkatërrimin e njëres prej shumë sendeve të siguruara nga neni 949 i LMD etj.). Në këtë rast, shuma e siguruar më nuk i përgjigjet vlerës reale të sendit të siguruar, kështu që ato rezultojnë të mbisiguruara. Në këtë nen janë rregulluar pasojat juridike të kësaj forme të mbisigurimit. Fakti i mbisigurimit i jep të drejtë secilës palë për zvogëlimin e shumës së sigurimit dhe të premisë. Zvogëlimi nuk shkaktohet automatikisht. Për zvogëlim është e nevojshme që palës tjetër t'i parashtrohet një kërkesë e tillë. Zvogëlimi llogaritet nga dita kur njëra palë ia ka komunikuar palës tjetër kërkesën për zbritje.

Neni 955. Sigurimi i shumëfishtë dhe i dyfishtë

1. Në qoftë se ndonjë objekt është siguruar pranë dy ose më tepër siguruesve kundër të njëjtit rrezik për të njëjtin interes dhe për të njëjtën kohë, kështu që shuma totale e sigurimit nuk tejkalon vlerën e këtij sendi (sigurimi i shumëfishtë), secili sigurues përgjigjet për zbatimin në tërësi të detyrimeve të krijuara nga kontrata që ka lidhur ai.
2. Në qoftë se shuma totale e sigurimit e tejkalon vlerën e sendit të siguruar (sigurimi i dyfishtë), ndërsa kontraktuesi i sigurimit nuk ka vepruar me ndërgjegje, të gjitha këto sigurime janë të vlefshme dhe secili sigurues ka të drejtë në preminë e kontraktuar për periudhën e sigurimit në vazhdim, ndërsa siguruesi ka të drejtë të kërkojë prej secilit sigurues të veçantë shpërblimin sipas kontratës së përfunduar me të, por gjithsej jo më tepër se sa është shuma e dëmit.
3. Kur ndodh rasti i siguruar, kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë ta njoftojë për këtë secilin sigurues të të njëjtit rrezik dhe t'i komunikojë emrat dhe adresat e siguruesve të tjerë, si dhe shumat e sigurimit të kontratave të veçanta të përfunduara me këta.
4. Pasi shpërblimi t'i paguhet të siguruarit, secili sigurues përballon pjesën e shpërblimit në përpjesëtimin në të cilin qëndron shuma e sigurimit në të cilën është detyruar ai ndaj shumës totale të sigurimit, kështu që siguruesi që ka paguar më tepër ka të drejtë të kërkojë nga siguruesit e tjerë shpërblimin për shumën e paguar më tepër.
5. Në qoftë se ndonjë kontratë është lidhur pa e treguar shumën e sigurimit, ose kundrejt mbulimit të pakufizuar, konsiderohet si kontratë e lidhur kundrejt shumës më të lartë të sigurimit.
6. Për pjesën e siguruesit i cili nuk mund të paguajë, përgjigjen siguruesit e tjerë përpjesëtimisht me pjesët e tyre.

- 7. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit ka lidhur kontratën e sigurimit me të cilën është krijuar sigurimi i dyfishtë, duke mos ditur për sigurimin e përfunduar më parë, ai mundet, pavarësisht nëse sigurimin e mëparshëm e ka lidhur ai apo ndokush tjetër, brenda një muaji nga dita kur ka mësuar për këtë sigurim, të kërkojë zbritjen përkatëse të shumës së sigurimit dhe të premisë së sigurimit të mëvonshëm, por siguresi mban premitë e marra dhe ka të drejtë në preminë për periudhën vijuese.**
- 8. Në qoftë se sigurimi i dyfishtë është realizuar për shkak të zvogëlimit të vlerës së objektit të sigurimit gjatë kohës së afatit të sigurimit, kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë në zbritjet përkatëse të shumave të sigurimit dhe të premive, duke filluar që nga dita kur ia ka komunikuar siguresit kërkesën e vet për zbritje.**
- 9. Në qoftë se gjatë krijimit të sigurimit të dyfishtë kontraktuesi i sigurimit ka vepruar në mënyrë të pandërgjegjshme, secili sigures mund të kërkojë anulimin e kontratës, të mbajë premitë e marra dhe të kërkojë preminë e pazvogëluar për periudhën vijuese.**

Vështrim i përgjithshëm.- Është rregull themelore e të drejtës së sigurimit që shpërblimi për dëmin nuk mund të jetë më i madh nga dëmi të cilin i siguruari e ka pësuar me shkaktimin e rastit të siguruar (neni 946 par. 2 i LMD). Zbatimi i kësaj rregulle ndalon që i siguruari të realizojë përfitim me sigurim te disa sigures, njësoj siç nuk mund të realizojë shpërblim të dyfishtë – një herë nga siguresi dhe herën e dytë nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit (rregulla mbi kumulimin e shpërblimit). Këtu qëndron zbatimi konsistent i parimit të shpërblimit të dëmit, si parim themelor i sigurimit të pasurisë. Kjo dispozitë i rregullon raportet në rastet kur një send është i siguruar te dy apo më shumë sigures nga rreziku i njëjtë, për interesin e njëjtë, për kohën e njëjtë dhe për të njëjtin të siguruar. Lidhur me shumën e sigurimit janë të mundshme dy situata: a) shuma e të dy sigurimeve nuk e tejkalon vlerën totale të atij sendi (sigurimi i shumëfishtë), b) shuma e tërësishme e sigurimit tejkalon vlerën totale të sendit të siguruar (sigurimi i dyfishtë). Nëse shuma totale e sigurimeve nuk tejkalon vlerën e sendit të siguruar, nuk është parashikuar parimi i shpërblimit të dëmit. Por, nëse shuma totale e sigurimit e tejkalon vlerën e sendit të siguruar (sigurimi i dyfishtë), me të drejtën e sigurimit është parashikuar një sistem i veçantë, me të cilin, në ato raste, sigurohet zbatimi i parimit të shpërblimit të dëmit.

1. Me termin sigurim i shumëfishtë i LMD, nënkuptohet rastin kur një send është i siguruar te dy apo më shumë sigures për të njëjtin rrezik, për të njëjtin interes, për të njëjtën kohë dhe për të njëjtin të siguruar, kurse shuma totale e sigurimit nuk tejkalon vlerën e këtij sendi. Në këtë rast, secili sigures përgjigjet për përmbushjen e tërësishme të detyrimeve të krijuara nga kontrata që ka lidhur ai. Këtu është fjala për kontrata tërësisht të pavarura dhe mes tyre juridikisht të ndara. I njëjti parim do të vlente edhe po të mos ishte normuar.

2. Sigurimi i dyfishtë, i cili përmendet në paragrafin 2 të këtij neni, në të vërtetë, ka të bëjë me sigurimin e shumëfishtë, me rastin e të cilit sigurim shuma totale e sigurimit tejkalon vlerën e sendit të siguruar. Lidhur me pasojat juridike, Ligji bënë dallimin nëse kontraktuesi ka vepruar me: a) ndërgjegje ose b) pa ndërgjegje.

2. (a) Nëse kontraktuesi i sigurimit me rastin e lidhjes së kontratës ka vepruar me ndërgjegje dhe, me gjithë këtë, ka ndodhur sigurimi i dyfishtë, të gjitha këto sigurime të lidhura janë të vlefshme dhe secili sigures ka të drejtën e premisë së kontraktuar për kohën e sigurimit në vijim, ndërsa i siguruari ka të drejtë të kërkojë prej secilit sigures të veçantë shpërblimin sipas kontratës së përfunduar me të, por gjithsej jo më tepër se sa është shuma e dëmit.

2. (b) Nëse kontraktuesi i sigurimit, me rastin e lidhjes së kontratës, ka vepruar pa ndërgjegje, secili kontraktues ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës (paragrafi 9 i këtij neni). Më dispozitat e mëparshme ligjore parashikohet që, në atë situatë, siguresi të ketë të drejtë t'i mbajë premittë e paguara dhe të kërkojë premittë e pazvogëluara për kohën vijuese. Me dispozitat ligjore në fuqi kjo nuk është parashikuar shprehimisht, por sipas analogjisë, kështu që, duke marrë parasysh dispozitën e nenit 953 të LMD, siguresi do të kishte të drejtën e premisë gjer në ditën e ushtrimit të kërkesës për anulim, por është i detyruar ta shpërblejë edhe sigurimin në kufijtë e shumës së siguruar, veçse jo më shumë sesa shuma e dëmit, nëse gjer në atë ditë shkaktohet rasti i siguruar.

3. Kur në rastin e kontratës së vlefshme të dyfishtë ndodh rasti i siguruar, kontraktuesi i sigurimit është i detyruar ta njoftojë për këtë secilin sigures të të njëjtit rrezik dhe t'ia komunikojë: a) emrat dhe adresat e siguresve të tjerë dhe b) shumat e sigurimit të kontratave të veçanta të lidhura me këta sigures.

4. Parim themelor i të drejtës së sigurimit në rast të sigurimit të dyfishtë është ai që të gjithë siguresit janë të detyruar ta përballojnë dëmin në përpjesëtim me shumën të cilën e kanë marrë me rastin e sigurimit. Për këtë arsye, siguresit të cilët me kërkesë të të siguruarit e kanë shpërblyer dëmin, kanë të drejtën e regresimit nga siguresit e tjerë në përpjesëtim me detyrimet e tyre të marra përsipër në bazë të kontratës së sigurimit. Kështu, nëse kanë paguar më tepër sesa detyrimi i tyre i përpjesëtuar me detyrimet e siguresve të tjerë, ata kanë të drejtë të regresohen nga siguresit e tjerë për këtë shumën e paguar më tepër.

5. Në rastin kur ndonjë kontratë është lidhur pa e treguar shumën e sigurimit ose me mbulesë të pakufizuar, konsiderohet se kontrata është lidhur për shumën më të lartë të sigurimit. Kjo kontratë mund të lidhet me të gjithë ose me ndonjë sigures. Nëse këso kontrate është lidhur me të gjithë siguresit, atëherë që të gjithë këta e përballojnë dëmin në pjesë të barabarta, kurse i siguruari ka të drejtë që nga secili prej tyre të kërkojë shumën totale të sigurimit.

6. Kur ndonjë sigures nuk mund ta përmbushë detyrimin e vet që del nga kontrata, lind përgjegjësia e ndërsjellë e siguresve. I siguruari në këtë rast është i autorizuar të kërkojë pagesën e sigurimit nga njëri apo më shumë sigures të tjerë, gjer në shumën e detyrimit të tyre kontraktues. Ndërkaq për pjesën e detyrimit të siguresit, i cili nuk mund të paguajë, përgjigjen siguresit e tjerë në përpjesëtim me pjesët e tyre.

7. Me ligj është parashikuar edhe situata kur kontraktuesi i sigurimit ka lidhur kontratë sigurimi me të cilën është krijuar sigurimi i dyfishtë, duke mos ditur për sigurimin e lidhur

më parë. Në këtë rast ai mundet, pavarësisht nëse sigurimin e mëparshëm e ka lidhur ai apo ndokush tjetër, që brenda një muaji, nga dita kur ka mësuar për këtë sigurim, të kërkojë zbritjen përkatëse të shumës së sigurimit dhe të premisë së sigurimit të mëvonshëm, por siguresi mban premitë e marra dhe ka të drejtën e premisë për periudhën vijuese.

8. Sigurimi i dyfishtë mund të ndodhë edhe për shkak të zvogëlimit të vlerës së objektit të sigurimit gjatë kohës së afatit të sigurimit, për shkaqe objektive. Në atë rast, kontraktuesi i sigurimit ka të drejtën e zbritjes përkatëse të shumave të sigurimit dhe të premive. Kontraktuesi i sigurimit ka të drejtën e zbritjeve përkatëse, duke filluar që nga dita kur ia ka komunikuar siguresit kërkesën e vet për zbritje.

9. Në situatën kur, me rastin e krijimit të sigurimit të dyfishtë, kontraktuesi i sigurimit ka vepruar në mënyrë të pandërgjegjshme, atëherë, sipas ligjit, secili sigures mund të kërkojë anulimin e kontratës, të mbajë premitë e marra dhe të kërkojë preminë e pazvogëluar për periudhën vijuese.

Neni 956. Bashkësigurimi

Kur kontrata e sigurimit është lidhur me disa sigures që janë marrë vesh mbi përbashkimin dhe shpërndarjen e përbashkët të rrezikut, secili sigures i shënuar në policën e sigurimit përgjigjet para të siguruarit për shpërblimin e plotë.

Kuptimi i bashkësigurimit.- Bashkësigurimi është një formë e shpërndarjes së barabartë të rrezikut, në të cilin kontrata e sigurimit lidhet me dy apo më shumë sigures që janë marrë vesh për përbashkimin dhe mbulimin e përbashkët të rrezikut. Bashkësigurimi nga ana e disa siguresve merr pjesë në sigurimin e sendit të njëjtë sigures, nga rreziqet e njëjta, për të njëjtën kohë dhe në favor të të njëjtit sigures. Secili prej siguresve pjesëmarrës dhe sasia e pjesëmarrjes së tij në shumën e siguruar është e shënuar në policë ose në shtojcën e policës. Shumat totale të sigurimit nuk e tejkalojnë shumën e kontraktuar apo reale të sendit të siguruar. Ka dy sisteme bazë të përgjegjësisë së siguresit për pagesën e dëmshpërblimit: a) secili sigures i shënuar në policën e sigurimit, pavarësisht nga sasia e pjesëmarrjes së tij, i përgjigjet të siguruarit për shpërblimin e tërësishëm, b) secili sigures i shënuar në policën e sigurimit është i detyruar ta shpërblejë dëmin vetëm në përpjesëtim me pjesën e tij. Sipas LMD, sistemi nën a) është miratuar dhe ai zbatohet te sigurimet e pasurisë. Bashkësiguresi që e ka paguar shpërblimin e plotë e ndan shumën e paguar me të gjithë bashkësiguresit, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre të përcaktuar me marrëveshje.

NËNKREU 4 NËNSIGURIMI

Neni 957. Nënshigurimi

1. Kur të vërtetohet se në fillim të periudhës respektive të sigurimit vlera e sendit të sigurimit ka qenë më e madhe nga sa është shuma e sigurimit, shuma e shpërblimit që ka borxh siguruasi zvogëlohet përpjesëtimisht, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.
2. Siguruasi ka për detyrë të japë shpërblim të plotë deri në shumën e sigurimit, në qoftë se është kontraktuar që raporti midis vlerës së sendit dhe shumës së sigurimit të mos ketë rëndësi për caktimin e shumës së shpërblimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Nënshigurimi ekziston kur shuma e sigurimit është më e vogël nga vlera e sendit të siguruar. Nënshigurimi është rast i kundërt me mbisigurimin. Gjersa mbisigurimi në të drejtën e sigurimit është i ndaluar, ngase është në kundërshtim me parimin e shpërblimit të dëmit, nënshigurimi juridikisht është i lejuar. Në përgjithësi, janë juridikisht të vlefshme dispozitat e kontratës me të cilën shuma e shpërblimit kufizohet në një shumë më të vogël nga sa është shuma e dëmit (neni 946 par. 4 i LMD). Nënshigurimi mund të ekzistojnë momentin e lidhjes së kontratës ose mund të krijohet me vonë, gjersa sigurimi është në vazhdim. Nënshigurimi mund të ndodhë me vullnetin e të siguruarit (lidhja e qëllimshme e kontratës me një shumë më të vogël nga shuma reale) ose pa vullnetin e tij (ritja e vlerës së sendit të siguruar gjatë kohëzgjatjes së sigurimit për arsye të tregut apo ndonjë arsye tjetër). Për zbatimin e rregullave të nënshigurimit është irelevante se për çfarë shkaqesh ka ndodhur nënshigurimi. Pasojat juridike të ekzistimit të nënshigurimit dallojnë nga pasojat juridike në rast të mbisigurimit. Nënshigurimi nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitës kontraktuese mbi vlerën e siguruar. Me këtë dispozitë, megjithatë, mund të ndërrohet ekuivalenca e prestimeve të palëve kontraktuese, prandaj e drejta e sigurimit njihet të drejtën e veçantë e cila e korrigjon atë. Me këtë rregull korrigjohet shpërpjesëtimi mes vlerës të cilën i siguruari e merr nga siguruasi në emër të sigurimit dhe vlerës të cilën i siguruari e paguan siguruasit në emër të premisë së sigurimit. Për këtë arsye kjo rregull quhet rregull e proporcionit. Me zbatimin e kësaj rregulle dhëniet dhe marrjet reciproke të palëve kontraktuese çojnë në një marrëdhënie të përputhshme. Kjo rregull është e pranuar edhe në sistemet krahasuese, sikurse edhe në sistemin tonë (neni 957 i LMD). Pasojat juridike të nënshigurimit, në përputhje me rrethanat, shprehen me rastin e vendosjes së sasisë së shpërblimit nga sigurimi. Shpërblimi nga sigurimi, në raport me dëmin e pësuar, vihet në të njëjtin raport në të cilin gjendet vlera e sendit të siguruar kundrejt shumës së siguruar. Me rastin e caktimit të shpërblimit nga sigurimi janë të mundshme dy situata: a) sendi i siguruar të ketë pësuar tërësisht (dëmi total), b) sendi i siguruar të ketë pësuar humbje ose dëmtim të pjesshëm (dëmi i pjesshëm). Në rastin e dëmit total, nga sigurimi shpërblehet vlera me të cilën ai send është siguruar, d.m.th., shuma e siguruar. Parimi i proporcionit zbatohet në rastin e dëmit të pjesshëm. Nga sigurimi shpërblehet dëmi proporcionalisht dhe ky në raport me shumën e siguruar dhe vlerën e sendit të siguruar.

1. Koha e vërtetimit të nënsigurimit.- Me rastin e vërtetimit të nënsigurimit krahasohet shuma e siguruar dhe vlera e sendit të siguruar. Me këtë rast është një çështje e rëndësishme ajo se në cilin moment do të vlerësohet vlera e sendit të siguruar. A është ky momenti i lidhjes së kontratës, apo momenti i shkaktimit të dëmit? Çështja është me rëndësi të madhe teorike dhe praktike. Sipas sistemeve juridike krahasuese, për sigurimet jodetare kryesisht është miratuar zgjidhja që kjo vlerë të vlerësohet sipas vlerës reale, të cilën sendi i siguruar e ka në momentin e shkaktimit të dëmit. Zbatimi i këtij parimi arsyetohet me parimin se sendi i siguruar, gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, normalisht se humb nga vlera. Me fjalë tjera, dëmi real për shkak të shkaktimit të dëmit është i barabartë me vlerën e sendit në momentin e shkaktimit të dëmit, prandaj në përputhje me parimin e shpërblimit të dëmit nga sigurimi, nuk mund të shpërblehet më shumë nga vlera reale e dëmit, pavarësisht nga sasia e shumës së siguruar (neni 946 par. 2 i LMD). Do të mund të thuhet se kjo është zgjidhja në përputhje me të drejtën e shpërblimit, ku sasia e shpërblimit të dëmit vlerësohet sipas çmimeve në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor (neni 173 par. 2 i LMD).

1. (a) Në paragrafin 1 të këtij neni, kur të vërtetohet se në fillim të periudhës përkatëse të sigurimit vlera e sendit të sigurimit ka qenë më e madhe nga sa është shuma e sigurimit, shuma e shpërblimit që ka borxh siguroesi zvogëlohet përpjesëtimisht me vlerën e sendit të siguruar në momentin e sigurimit.

1. (b) Kjo rregull zbatohet në rrethanat kur vlera e sendit të siguruar nuk është kontraktuar. Nëse vlera e sendit të siguruar mes palëve është përcaktuar me marrëveshje, atëherë vlera e kontraktuar merret si vlerë e sendit të siguruar, prandaj me rastin e vlerësimit nëse ekziston ose jo nënsigurimi, krahasohet shuma e siguruar dhe vlera e kontraktuar (neni 946 par. 7 i LMD). Nëse shuma e siguruar është më e vogël nga vlera e sendit të siguruar, ekziston nënsigurimi, përkatësisht sigurimi i pjesshëm dhe dëmi shpërblehet proporcionalisht.

2. Përfshirjet nga parimi i proporcionalitetit.- Në paragrafin 2 të këtij neni janë parashikuar përfshirjet nga zbatimi i parimit të nënsigurimit. Rregulla mbi nënsigurimin është e natyrës dispozitive juridike, prandaj palët mund të kontraktojnë që raporti mes vlerës së sendit dhe sasisë së shumës së siguruar nuk ka rëndësi për caktimin e shumës së shpërblimit. Në këtë rast, siguroesi është i detyruar të paguajë sigurimin e plotë deri në shumën e sigurimit. Me fjalë të tjera, nuk zbatohet rregulla e proporcionit. Zbatimi i kriterit të vlerës reale të sendit në momentin e shkaktimit të dëmit, të siguruarit, si rregull, financiarisht nuk i mundëson restitucionin natyror të sendit të shkatërruar apo të dëmtuar. Janë modelet e ndryshme kontraktuese, me të cilat shmanget zbatimi i parimit të proporcionit. P.sh., sigurimi në vlerë të re, sigurimi në vlerë më të madhe, sigurimi në rrezikun e parë, sigurimi në bazë të faktorit të nënsigurimit, klauzolës së përfshirimit të parimit të proporcionit, klauzolës së tolerancës etj.

NËNKREU 5 KALIMI I KONTRATËS DHE PAGIMI I SHPËRBLIMIT NGA SIGURIMI TJETRIT

Neni 958. Kalimi i kontratës në përfituesin e sendit të siguruar

- 1. Në rastin e tjetërsimit të sendit të siguruar si dhe të sendeve lidhur me përdorimin e të cilave është kontraktuar sigurimi nga përgjegjësia, të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit të sigurimit kalojnë vetvetiu në bazë të ligjit në përfituesin, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.**
- 2. Në qoftë se është tjetërsuar vetëm një pjesë e sendeve të siguruara, të cilat lidhur me sigurimin nuk përbëjnë tërësi të veçantë, kontrata e sigurimit pushon në bazë të ligjit lidhur me sendet e tjetërsuara.**
- 3. Në rastin kur për shkak të tjetërsimit të sendeve shtohet ose zvogëlohet mundësia e paraqitjes së rastit të siguruar, zbatohen dispozitat e përgjithshme mbi shtimin ose mbi zvogëlimin e rrezikut.**
- 4. Kontraktuesi i sigurimit, i cili nuk e njofton siguruesin se sendi i siguruar është tjetërsuar, mbetet në detyrim për pagimin e premive që rrjedhin për pagesë edhe pas ditës së tjetërsimit.**
- 5. Siguruesi dhe përfituesi i sendit të siguruar mund të heqin dorë nga sigurimi me afat denoncimi prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh me kusht që denoncimin ta kenë për detyrë ta paraqesin jo më tepër se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur të kenë mësuar për denoncimin.**
- 6. Kontrata e sigurimit nuk mund të zgjidhet në qoftë se policia e sigurimit është lëshuar në prurësin ose sipas urdhrat.**

Vështrim i përgjithshëm.- Kontrata e sigurimit, si çdo kontratë tjetër e dyanshme detyruese, juridikisht është e mundshme të transferohet, përveç nëse kjo mundësi nuk është përjashtuar shprehimisht me kontratë ose me policën e sigurimit. Duhet dalluar: a) transferimi (bartja) e kontratës, b) kalimi i të drejtave nga kontrata. Të transferohen munden të gjitha të drejtat nga kontrata (me kalimin e policës së sigurimit) ose vetëm disa kërkesa transferuese, p.sh. e drejta e pagesës së shpërblimit të dëmit nga sigurimi. Në të drejtën e sigurimit janë të rëndësishme këto forma të kalimit të kontratës ose të drejtave nga kontrata: a) kalimi i kontratës së sigurimit me kalimin e të drejtës së pronësisë mbi përfituesin e sendit të siguruar, b) kalimi i të drejtave nga kontrata (transferimi i policës së sigurimit), c) kalimi i kërkesës nga kontrata e sigurimit.

a) Për secilën nga këto forma të kalimit vlejnjë rregulla të veçanta dhe efekti i tyre ligjor është i ndryshëm. Me kalimin e kontratës ose me kalimin e policës së sigurimit ndërrohen subjektet e marrëdhënies juridike-detyruese, kurse me dorëzimin e kërkesës, palët

kontraktuese ngelin të njëjta. Për kalimin e kontratës ose kalimin e të drejtave nga kontrata mund të flitet për të gjitha llojet e sigurimeve. Kalimi bëhet sipas rregullave të së drejtës së sigurimit. Për ato forma të kalimit, për të cilat nuk ekziston ndonjë normë specifike ligjore, zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve. Te raportet mes parimeve të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve dhe të drejtës së sigurimeve lidhur me kalimin e kontratës ose të drejtave nga kontrata në të drejtën e sigurimeve, te këto kalime, zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve; zbatimi i rregullave të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve është e kufizuar me të drejtën e sigurimeve.

b) Të drejtat dhe detyrimet nga kontrata e sigurimit mund t'i transferojnë të dy palët kontraktuese: siguruesi dhe i siguruari. Kalimi i të drejtave të siguruesit nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë me të drejtën pronësore të sigurimit. Tek e drejta e sigurimeve, vëmendje qendrore i kushtohet kalimit të të drejtave të të siguarit. Kjo çështje juridikisht është më atraktive dhe ekonomikisht më e rëndësishme. Ajo është e rëndësishme për shkak se me kalimin e të drejtave kalon edhe statusi kontraktues i të siguarit, si shfrytëzues i sigurimit, veçanërisht e drejta e tij për shpërblimin nga sigurimi.

c) Kalimi i të drejtave nga kontrata mund të jetë: a) vullnetar, b) ligjor. Te kalimi vullnetar, vendimin për kalimin e marrin vetë palët kontraktuese në mënyrë të pavarur. Një kësi kalim tipik i bartjes është: kalimi vullnetar i policës së sigurimit te përfituesi i të drejtës mbi sendin e siguar. Kalimi ligjor paraqitet në mënyrë automatike (ipso iure), kur përmbushen prezumimet ligjore. Për vlefshmërinë e kalimit nuk është i nevojshëm pëlqimi i siguruesit; për kalimin nuk është parashikuar as një formë e caktuar. P.sh., me vdekjen e të siguarit, në vend të tij në marrëdhënien kontraktuese në bazë të vet ligjit, (me suksesionin universal), vjen trashëgimtari i tij me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata; në rast të ndryshimeve statusore të personave juridikë (bashkimit, përvetësimit, falimentimit), me suksesionin të përgjithshëm në bazë të ligjit ndërrohen subjektet e raportit juridik nga sigurimi. Është një formë specifike e kalimit ligjor të kontratës: kalimi i kontratës te përfituesi i ri i sendit të siguar.

ç) Kalimi i kontratës te përfituesi i sendit të siguar.- Në situatën kur sendi i siguar shitet apo tjetërsohet në ndonjë mënyrë tjetër, shtrohet pyetja më thelbësore: me kalimin e të drejtave pronësore mbi sendin e siguar te pala e tretë, a kalojnë automatikisht edhe të drejtat nga sigurimi apo për këtë nevojitet pëlqimi i palëve? Këtë efekt mund ta shikojmë me zbatimin e: a) parimeve të përgjithshme, b) parimeve të së drejtës së sigurimit. Kalimi i të drejtave pronësore, sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve, nuk ka efektin e kalimit të kontratës ose të drejtës nga kontrata e sigurimit te pala e tretë – pronari e ri i sendit të siguar. Prandaj lidhur me këtë duhet përkujtuar se të drejtat që rrjedhin nga sigurimi i pasurisë mund t'i kenë vetëm personat të cilët, në momentin e shkakimit të dëmit, kanë interes material që rasti i siguar të mos ndodhë (945 par. 2 i LMD). Me fjalë të tjera, ekzistimi i interesit për sigurim është element thelbësor i cilësisë së të siguarit. Nga zbatimi i këtij parimi varet efekti i kalimit të së drejtave pronësore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese janë të përcaktuara në kontratën e sigurimit dhe ajo vepron vetëm

mbi marrëdhëniet e tyre reciproke (inter partes). Asnjë person tjetër, përveç të siguruarit, nuk ka të drejtën e shpërblimit nga sigurimi, përveç nëse nuk është kontraktuar ndryshe. Me zbatimin e këtyre parimeve, situata është si në vijim: nëse i siguruari, me tjetërsimin e sendit të siguruar e humb në tërësi interesin për sigurim në raport me atë send, sipas parimit të shpërblimit të dëmit, ai nuk do të mund ta realizonte shpërblimin për dëmin i cili i shkaktohet atij sendi, sepse dëmin as që e ka pësuar. Të drejtën nga kontrata e sigurimit nuk e ka as përfituesi i ri i këtij sendi (blerësi), nëse e drejta nga kontrata e sigurimit nuk i ka kaluar atij. Me këtë prezumim, përfituesi i ri i sendit nuk është palë e kontratës së sigurimit, prandaj kontrata e lidhur paraprakisht për atë do të thotë **res inter alios acta**. Përndryshe, nëse siguruasi me kalimin e të drejtës mbi sendin e siguruar nuk humb në tërësi interesin për sigurim, nuk e humb as cilësinë e të siguruarit.

1. Në paragrafin 1 të këtij neni kalimi i sendit të siguruar, të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit të sigurimit i kalojnë vetvetiu përfituesit në bazë të ligjit. Me këtë dispozitë është përfshirë edhe kalimi i sendeve lidhur me përdorimin e të cilave është kontraktuar sigurimi nga përgjegjësia. Kalimi i kontratës së sigurimit ndodh në bazë të vetë faktit se sendi i siguruar është tjetërsuar. Kur realizohet ky prezumim, në bazë të vetë ligjit njëkohësisht dhe automatikisht pronarit të ri të sendit të siguruar i kalojnë edhe të drejtat dhe detyrimet nga kontrata e sigurimit. Për vlefshmërinë e kalimit të kontratës së sigurimit nuk është i nevojshëm kurrfarë deklarimi i palëve, sikurse as pëlqimi i siguruasit. Megjithatë, kontraktuesi ka detyrimin që për tjetërsimin e sendit ta njoftojë siguruasin. Siguruasi dhe përfituesi i sendit të siguruar, në rast tjetërsimi, mund të heqin dorë nga kontrata. Dispozita ligjore për kalimin e kontratës në rast tjetërsimi të sendit të siguruar, sipas natyrës së saj, nuk zbatohet te sigurimi “për llogari të huaj ose për llogari të të cilit i përket” (neni 926 i LMD), duke marrë parasysh se personi në favor të të cilit është lidhur sigurimi është siguruasi burimor dhe të drejtat e tij ndaj siguruasit nuk rrjedhin nga të drejtat e siguruasit të mëparshëm, prandaj këtu nuk kemi të bëjmë me kalim të kontratës.

1. (a) Ligji i përmend vetëm të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit të sigurimit, prandaj duhet parë që ajo që ka të bëjë me të drejtat mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit, mund të ketë të bëjë vetëm me të drejtat e të siguruarit, sepse kontraktuesi i sigurimit, nëse njëkohësisht nuk është edhe i siguruar, nuk ka kurrfarë të drejtash nga sigurimi.

1. (b) Me kalimin e të drejtës pronësore kalon ipso iure pozicioni kontraktues i pronarit të mëparshëm nga kontrata e sigurimit. Në vend të pronarit të mëparshëm, në marrëdhënie kontraktuese nga sigurimi hyn përfituesi i së drejtës së pronësisë mbi sendin e siguruar. Përfituesi bëhet i siguruar. Kjo nënkupton se ai bëhet titullar i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Ai përfiton të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit nga sigurimi, në rast të shkaktimit të dëmit, por edhe detyrimin e pagesës së premive të sigurimit. Dispozita ligjore për kalimin e kontratës në rast të kalimit të së drejtës së pronësisë, është e natyrës juridike dispozitive, kurse palët mund të kontraktojnë edhe ndryshe. Nga kjo rrjedh se kjo çështje mund të rregullohet edhe në mënyrë të veçantë, me kushte të sigurimit. Kështu, p.sh., kushtet e sigurimit kasko të automjeteve rregullisht përmbajnë dispozitën për pushimin e kontratës në rast të tjetërsimit të automjetit të siguruar.

2. Tjetërsimi i vetëm një pjesë të sendeve të siguruara.- Zgjidhja ligjore e kalimit të kontratës së sigurimit zbatohet vetëm tek ato raste kur sendet e siguruara janë tjetërsuar tërësisht. Nëse janë tjetërsuar vetëm një pjesë e sendeve të siguruara, të cilat lidhur me sigurimin nuk përbëjnë një tërësi të veçantë, kontrata e sigurimit pushon në bazë të ligjit lidhur me sendet e tjetërsuara. Me fjalë të tjera, nëse pjesa e sendeve të tjetërsuara nga aspekti i sigurimit përbën një tërësi të veçantë, sigurimi nuk pushon, por në bazë të ligjit i kalon përfituesit të atyre sendeve.

3. Tjetërsimi i kontratës dhe ndryshimi i peshës së rrezikut.- Me tjetërsimin e pronësisë së sendit të siguar te personin tjetër, mund të përkeqësohen ose zvogëlohen rreziqet e përfshira në sigurim, d.m.th., mund të shtohet ose zvogëlohet mundësia e paraqitjes së rastit të siguar. Duke marrë parasysh se në dispozitat e LMD tashmë ekzistojnë norma të veçanta për rastin e shtimit ose zvogëlimit të rrezikut, është logjike që Ligji me dispozitën e paragrafit 3 të këtij neni përcakton që këto dispozita të përgjithshme të zbatohen edhe te rasti kur, për shkak të tjetërsimit të sendit, shtohet ose zvogëlohet mundësia e paraqitjes së rastit të siguar.

4. Detyrimi i njoftimit të siguruesit. Pagesa e premisë.- Moment i përkufizimit të raporteve të ndërsjella të palëve sipas nenit 958 të LMD është momenti i fitimit të së drejtës së pronësisë ose kalimit të rrezikut. Preminë e sigurimit gjer në momentin e tjetërsimit, normalisht, e përballon tjetërsuesi, ndërsa preminë e arritur pas kësaj është i detyruar ta përmbushë përfituesi i së drejtës. Preminë e arritur dhe të papaguar gjer në momentin e kalimit të pronësisë është i detyruar ta paguajë kontraktuesi i sigurimit, sepse ky është detyrim i tij kontraktues, përveç nëse nuk bëhet fjalë për suksesionin trashëgimor të së drejtës, kur trashëgimtari hyn në tërësi në pozitën juridike-pronësore të përfituesit ose për suksesion të përgjithshëm te ndryshimet statusore të personave juridikë, p.sh. te bashkimi ose shkrirja e shoqërive tregtare. Meqë në këto raste mund të ketë vështirësi praktike për konstatimin e borxhit real të palëve në pagesën e premisë së sigurimit, shumë ligjvënës kanë parashikuar detyrimin solidar të tjetërsuesit dhe përfituesit. Kur premia nuk është paguar në tërësi gjer në momentin e tjetërsimit, kurse kontraktuesi i sigurimit ka lënë siguruesin pa e njoftuar për tjetërsimin, ai është i detyruar ta bëjë pagesën e premive, të cilat arrijnë edhe pas ditës së tjetërsimit. Tjetërsuesi në këtë rast paraqitet si garantues ligjor për preminë. Kjo zgjidhje arsyeton rrethanën që, në mungesë të njoftimit për tjetërsimin e sendit të siguar, për siguruesin nuk do të ishte e njohur se kush është personi debitor për mospagesën e premisë.

5. Zgjidhja e kontratës.- Duke qenë se personit tjetër i ka kaluar e drejta pronësore mbi sendin e siguar dhe, me këtë, në bazë të vetë ligjit i ka kaluar edhe kontrata e sigurimit, atëherë siguruesi dhe përfituesi i të drejtës së pronësisë mund të heqin dorë nga kontrata e sigurimit. Kontrata mund të denoncohet më së voni në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e njoftimit për tjetërsimin (në Ligj, në fund të paragrafit 5 të nenit 958, fjalia e fundit, në vend të *tjetërsimin*, gabimisht thuhet *denoncimin*). Sipas kësaj, kontrata mund të denoncohet edhe menjëherë. Deklarata për denoncimin duhet t'i dërgohet palës tjetër. Ligji, në pikëpamje

të afatit, nuk bën kurrfarë dallimi mes siguruesit dhe përfituesit të së drejtës. Afati prej 30 ditësh për përfituesin e sendit, sipas natyrës së sendit, do të duhej të ishte llogaritur nga dita kur është bërë kalimi i pronësisë, (sepse nga kjo ditë këtij i është bërë e njohur kjo rrethanë), ndërsa siguruesit nuk është e thënë që ajo t'i jetë bërë e ditur menjëherë. Afati i parashikuar denoncues është pesëmbëdhjetë ditë. Kjo ditë llogaritet nga dita kur është bërë denoncimi. Me skadimin e afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh, kontrata quhet e zgjidhur. Sigurimi pushon me kalimin e 24 orëve nga dita kur skadon afati denoncues.

6. Policat sipas prurësit ose sipas urdhrit.- Kontrata e sigurimit nuk mund të zgjidhet në qoftë se policat e sigurimit është lëshuar “sipas prurësin” ose “sipas urdhrit”. Këto policat, sipas natyrës së çështjes, përmbajnë edhe mundësinë e kalimit të tyre. Kalimi është një veçori thelbësore e tyre. Përdoren kur është e pritshme se sendi i siguruar, në bazë të ndonjë pune juridike, do ta ndërrojë pronarin ose titullarin e rrezikut, prandaj policat këtu paraqiten si instrument i kalimit të së drejtës që rrjedh nga kontrata e sigurimit. I autorizuar lidhur me një policë të tillë është personi që provon legjitimitetin e tij formal dhe faktin se ka pasur interes për sendin e siguruar në momentin e shkaktimit të dëmit, përkatësisht se ka pësuar dëm. Përfituesi i së drejtës së pronësisë ose titullari i rrezikut, me përdorimin e këtyre policave, fiton të drejtën origjinare ndaj siguruesit. Prandaj, parashikimi i mundësisë së zgjidhjes së kontratës edhe të këto policat do të ishte në kundërshtim me vetë natyrën juridike të tyre dhe qëllimin e përdorimit, prandaj është logjike që Ligji të këto policat bën përjashtim nga parimi i përgjithshëm.

Neni 959. Akordimi i shpërblimit titullarëve të pengut dhe të të drejtave të tjera

- 1. Pas paraqitjes së rastit të siguruar, të drejtat e pengut dhe të drejtat e tjera që kanë ekzistuar më përpara në sendin e siguruar kanë si objekt shpërblimin në borxh si në rastin e sigurimit të sendit vetjak, ashtu edhe në rastin e sigurimit të sendeve të huaja për shkak të detyrimit të ruajtjes e të kthimit të tyre, kështu që siguruesi nuk mund t'ia paguajë shpërblimin të siguruarit pa pëlqimin e titullarëve të këtyre të drejtave.**
- 2. Këta persona mund të kërkojnë drejtpërdrejt nga siguruesi, që në kuadrin e shumës së sigurimit dhe sipas radhës ligjore t'u paguajë kërkesat e tyre.**
- 3. Në qoftë se në çastin e pagesës, siguruesi nuk ishte në dijeni dhe as që duhet të dinte për këto të drejta, pagesa e bërë e shpërblimit siguruesit mbetet e vlefshme.**

1. Të drejtat e kreditorëve të pengut në shpërblim.- Sipas dispozitave të këtij neni, të drejtat e pengut dhe të drejtat e tjera që kanë ekzistuar më përpara mbi sendin e siguruar në rast të realizimit të rastit të siguruar për mbrojtjen e këtyre të drejtave, shtrihen edhe në këtë sigurim. Palët e treta kanë mundësi që, me ndonjë punë juridike, me vendim gjyqësor ose në bazë të ligjit, të fitojnë ose themelojnë mbi sendin e siguruar të drejtën e pengut ose ndonjë të drejtë tjetër. Në situatën e realizimit të rastit të siguruar, siguruesi ka detyrimin që t'ia bëjë pagesën e shpërblimit siguruesit ose shfrytëzuesit të sigurimit. Rrethana e ekzistimit

të pengut ose e ndonjë të drejte tjetër mbi sendin e siguruar nuk duhet t'i jetë e njohur. Me pagimin e shpërblimit të siguruarit, të drejtat e palëve të treta sigurisht do të cenoheshin, sepse ato nuk do të mund të përmbushin më kërkesën e siguruar me peng nga vlera e sendit të lënë peng, sepse nga shfaqja e rastit të siguruar ky send ose do të asgjësohej, ose do të humbte në vlerë. Për këtë arsye, duke synuar mbrojtjen e drejtës së pengut ose të ndonjë të drejtë tjetër mbi sendin e siguruar (për shkak të detyrimit të ruajtjes dhe kthimit të tyre), rendi juridik i ofron mbrojtje kreditorit, duke parashikuar shtrirjen e të drejtës së pengut edhe mbi shpërblimin nga sigurimi (të kalojnë mbi shpërblimin i cili është borxh nga sigurimi). Efekti juridik i kësaj dispozite është që të detyrohet siguruasi që shpërblimin nga sigurimi, në vend siguresit, t'ia paguajë titullarit të pengut ose siguresit me pëlqimin e titullarit të së drejtës së pengut ose të ndonjë të drejte tjetër. Kjo vlen për sigurimin e sendeve të huaja, por edhe për sigurimin e sendeve personale. Dispozitat e këtij neni janë të natyrës juridike detyruese dhe palët nuk e kanë mundësinë që të kontraktojnë ndryshe.

2. E drejta e titullarit të së drejtës mbi kërkesën e drejtpërdrejtë ndaj siguresit.- Titullarët e së drejtës së pengut ose të drejtave tjera, në mbështetje të vetë ligjit, fitojnë të drejtën për të kërkuar drejtpërdrejt ndaj siguresit që, brenda kufijve të shumës së siguruar dhe sipas radhës ligjore, t'ua paguajë kërkesat e tyre. Me fjalë tjera, ata kanë të drejtën e padisë së drejtpërdrejtë ndaj siguresit. Ndërkaq, kundër kërkesave të këtyre personave, siguruasi vetëm mund t'i potencojë kundërshtimet që kanë lindur para realizimit të rastit të siguruar.

3. Njoftimi i siguresit.- Për zbatimin e dispozitave të këtij neni, kusht ligjor është që siguresit, para se të bëjë pagesën e shpërblimit, t'i ketë pasur dijeni ose do të duhej të kishte dijeni për ekzistimin e së drejtës së pengut ose ndonjë të drejtë tjetër të palës së tretë mbi sendin e siguruar. Në qoftë se në çastin e pagesës siguruasi nuk ishte në dijeni dhe në mirëbesim i ka bërë pagesën të siguruarit, pagesa e shpërblimit mbetet e vlefshme. Në këtë situatë titullarëve të pengut dhe të drejtave të tjera u ngel vetëm mundësia që mbrojtjen e të drejtave ta realizojnë me mjete të rregullta juridike.

NËNKREU 6

KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN (SUBROGIMI)

Neni 960. Subrogimi

- 1. Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.**
- 2. Në qoftë se për faj të të siguruarit është bërë i pamundur ky kalim i të drejtave në sigures tërësisht ose pjesërisht, siguruasi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të siguruarit.**

3. **Kalimi i të drejtave nga i siguruari në sigurues nuk mund të jetë në dëmin e të siguararit, kështu që në qoftë se shpërblimi të cilin e ka marrë i siguruari nga siguruesi për cilindo shkak qoftë është më i vogël nga sa është dëmi që ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që prej pasurisë së personit përgjegjës t'i paguhet mbetja e shpërblimit përpara kërkesës së siguruesit në bazë të të drejtave që janë kaluar në të.**
4. **Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të siguararit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të siguararin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të siguararit, përveç nëse këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje.**
5. **Në qoftë se dikush nga personat e përmendur në paragrafin paraprak ka qenë i siguar nga përgjegjësia, siguruesi mund të kërkojë nga siguruesi i tij shpërblimin e shumës që i ka paguar të siguararit.**

Vështrim i përgjithshëm. Kuptimi i subrogimit.- Te punët juridike të sigurimit, kuptimi i subrogimit të siguruesit përcaktohet e drejta e siguruesit që me pagimin e shpërblimit për dëmin të hyjë në pozitën juridike të të siguararit lidhur me dëmin për të cilin është bërë pagesa e shpërblimit. Veçoria më e rëndësishme e hyrjes në pozitën juridike të të siguararit është ajo që siguruesi e fiton të drejtën e të siguararit mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit nga personat e tretë, të cilët janë plotësisht apo pjesërisht përgjegjës për shkaktimin e dëmit, të cilin siguruesi ia ka shpërblyer të siguararit. Në bazë të kësaj të drejte, siguruesi është i autorizuar ta shpërblejë plotësisht apo pjesërisht humbjen të cilën e ka pësuar me pagimin e shpërblimit për dëmin. E drejta e siguruesit që me pagimin e shpërblimit nga sigurimi të hyjë në pozitën juridike të të siguararit, LMD shprehimisht e quan **subrogim**. Fjala është për një formë të veçantë të subrogimit personal ligjor, me të cilin siguruesi t i kalon e drejta e të siguararit ndaj personave të tretë përgjegjës. Në këtë mënyrë bëhet dallimi i qartë mes të subrogimit ligjor dhe sesionit të së drejtës juridiko pronësore. Nuk ekziston detyrimi i siguruesit që të shërbehet me të drejtën e fituar me subrogim.

a) E drejta e subrogimit të siguruesit arsyetohet me dy shkaqe themelore juridike: a) Është parim i përgjithshëm juridik që i dëmtuari (i siguruari) nuk mund të realizojë dëm më të madh nga vlera e dëmit të pësuar. Për këtë i dëmtuari (i siguruari) nuk ka mundësi që dy herë ta arkëtojë dëmin e njëjtë – një herë nga siguruesi e herën tjetër nga personi përgjegjës për dëmin, pra ekziston ndalimi i kumulimit të shpërblimit nga sigurimi dhe marrëdhënies civile-juridike të përgjegjësive; b) Personat e tretë nuk mund të kenë dobi nga fakti se ekziston kontrata e sigurimit, brenda së cilës ata nuk e kanë cilësinë e palëve kontraktuese.

b) Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi sipas ligjit gjer në sasinë e shpërblimit të paguar, të drejtat e të siguararit kalojnë te siguruesi, prandaj i siguruari nuk mund të kërkojë të njëjtin shpërblim nga personi përgjegjës për dëmin, pavarësisht nëse siguruesi do të kërkojë ose jo shpërblimin e shumës së paguar nga personi përgjegjës për dëmin

e shkaktuar. E njëjta gjë do të vlejë edhe kur i siguruari e realizon shpërblimin e dëmit nga personi përgjegjës për dëmin e shkaktuar; ai nuk do të ketë të drejtë të kërkojë shpërblimin e të njëjtit dëm nga siguruasi.

c) Palët e treta i ngarkon detyrimi i riparimit të dëmit, pavarësisht nëse i dëmtuari (i siguruari) ka marrë ose jo shpërblimin nga sigurimi. Me lidhjen e kontratës së sigurimit, nuk pushon marrëdhënia juridike-detyruese e personave të tretë për dëmin. Në këtë raport njëra palë është e detyruar ta riparojë dëmin, ndërsa pala tjetër është e autorizuar të kërkojë riparimin e dëmit. Përndryshe, personi përgjegjës për dëmin e shkaktuar do të pasurohej pa bazë⁸⁷⁴. Në anën tjetër, me hyrjen në pozitën juridike të të siguarit, d.m.th., me shndërrimin në kreditor, nuk ndryshon fare pozita juridike e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Pala e tretë nuk mundet që, për shkak të faktit se është zbatuar sigurimi, të sillet në pozitë më të vështirë juridike, prandaj siguresit mund t'ia paraqesë të gjitha kundërshtimet të cilat ka pasur mundësi t'ia paraqesë edhe të siguarit gjer në momentin e pagesës së shpërblimit nga sigurimi. Prandaj subrogimi është institut juridik, me anën e të cilit sigurohet zbatimi i parimeve themelore të rendit juridik mbi përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar.

ç) Subrogimi i siguresit në të drejtën e të siguarit nuk ka për qëllim kalimin e kontratës. Ngjashëm me këtë, me subrogim nuk ndodh ndërrimi subjekteve në marrëdhëniet juridike-reale. Në bazë të institutit të subrogimit, te siguruasi nuk kalon e drejta e pronësisë mbi sendin e siguar, siç është rasti me institutin e lënies së sendit të siguar, (shih komentin e nenit 948 të LMD). Me ndërrimin e subjektit në anën e kreditorit në bazë të subrogimit, nuk ndërrohet as identiteti i marrëdhënies juridike-detyruese të përgjegjësive për dëmin. Në procedurën e siguresit kundër personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, përgjegjësia e personit përgjegjës vlerësohet sipas të njëjtave rregulla të cilat zbatohen edhe në raportet mes të të siguarit dhe shkaktarit të dëmit. Kështu, p.sh., LMD përmban një dispozitë të veçantë, duke parashikuar që parashkrimi i kërkesës që i takon siguresit ndaj personit të tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të sigurimit, fillon të rrjedhë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguarit ndaj këtij personi dhe mbaron në të njëjtin afat (neni 362 par. 6 i LMD).

d) Nga natyra e çështjes rrjedh se e drejta e subrogimit të siguresit zbatohet vetëm te sigurimet e pasurisë. E drejta e subrogimit i është mohuar siguresit te sigurimi i personave (shih komentin e nenit 969 të LMD). Subrogimi i siguresit gjithashtu është i përjashtuar edhe te sigurimi nga përgjegjësia, kur siguruasi lajmërohet në rolin e të dëmtuarit dhe ku sendi i siguar është pikërisht përgjegjësi e të siguarit, përveç nëse me ligj apo me kushte të sigurimit nuk është parashikuar ndryshe.

1. Subrogimi lind me pagimin e shpërblimit nga sigurimi.- Sipas dispozitave të LMD, me pagimin e shpërblimit nga sigurimi, te siguruasi, sipas vetë ligjit, deri në shumën e shpërblimit të paguar kalojnë të gjitha të drejtat e të siguarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin, por më së shumti gjer në shumën e shpërblimit të paguar.

874 Shih aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac. nr. 868/2006 të dt. 14.02.2008 dhe aktvendimin e Gjyk. Supr. të Kos. Prishtinë, Rev. I. nr. 278/2008,

1. (a) Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi, te siguruasi kalojnë të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personave përgjegjës për dëmin deri në sasinë e shpërblimit të paguar. Me subrogim siguruasi hyn në pozitën juridike të të siguruarit, d.m.th., siguruasi të drejtat e tij i nxjerrë nga të drejtat e të siguruarit, prandaj te siguruasi kalon kërkesa në masën dhe sasinë të cilën e ka pasur edhe i siguruari. Subrogimi, kështu, nuk është mënyrë origjinare por derivative e fitimit të së drejtës. Siguruasi ka të drejtë të kërkojë nga shkaktari i dëmit shpërblimin e të gjitha llojeve të dëmit, të cilat ka pasur të drejtë t'i kërkojë edhe i siguruari lidhur me dëmin e siguar, për të cilin është paguar shpërblimi.

1. (b) Me këtë janë përfshirë kërkesat nga marrëdhëniet kontraktuese dhe jokontraktuese. Me këtë rast siguruasi nuk mund të kërkojë shpërblimin e dëmit nga baza juridike mbi të cila nuk e ka bërë shpërblimin. E drejta e siguresit në bazë të subrogimit, për nga sasisa, është e kufizuar në: a) shumën e shpërblimit të paguar, b) shumën të cilën personi përgjegjës ia ka borxh të siguruarit, sipas dispozitave të cilat do të zbatohen në marrëdhëniet juridike-detyruese të përgjegjësisë për dëmin. Në këtë drejtim, efektet e subrogimit dallojnë nga efektet e lënies së sendit të dëmtuar që është i siguar, kur siguruasi fiton të drejtën e pronësisë mbi mbetjet e tij. Realizimi i së drejtës së pronësisë nuk është i kufizuar me asgjë, prandaj siguruasi, për dallim nga subrogimi, mund të realizojë dhe të mbajë për vete edhe më shumë se shuma e shpërblimit të paguar të siguruarit.

1. (c) Në sistemin tonë juridik, me pagimin e shpërblimit nga sigurimi, i siguruari humb ndërsa siguruasi fiton mbi sasinë e shpërblimit të paguar legjitimitetin aktiv juridik-detyrues ndaj shkaktarit të dëmit. Me këtë siguruasi bëhet edhe me legjitimitet aktiv procedural, d.m.th., fiton autorizimin që të iniciojë procedurë kundër shkaktarit të dëmit (**legitimatío ad processum**). Këtë pozitë juridike të siguresit e njohin një numër i madh i sistemeve juridike.

1. (ç) Për subrogimin e siguresit duhet të plotësohen këto prezumime juridike: a) që siguruasi ta ketë paguar shpërblimin nga sigurimi në bazë të kontratës së sigurimit, b) që i siguruari të ketë të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit ndaj palës së tretë, (i siguruari duhet të ketë kërkesë materiale-juridike ndaj personit të tretë, d.m.th., të ketë cilësinë e kreditorit në marrëdhënien juridike të përgjegjësisë për dëmin), c) që të ekzistojë përgjegjësia e personit të tretë për dëmin për të cilin është bërë pagesa e shpërblimit. Nëse janë plotësuar këto kushte, për legjitimitetin aktiv të siguresit në sistemin tonë juridik nuk është e nevojshme të bëhet sesioni i së drejtës. Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi në bazë të vetë ligjit, siguruasi fiton legjitimitetin aktiv ndaj shkaktarit të dëmit. Në këtë rast siguruasi duhet të provojë: a) se e ka bërë pagesën e shpërblimit për dëmin konkret, b) se e ka bërë pagesën e shpërblimit në bazë të kontratës së sigurimit.

2. Pasojat juridike të lëshimit të të siguruarit që siguresit t'ia ruajë të drejtën e subrogimit. Një prej detyrave themelore të të siguruarit, në rast të ndodhjes së rastit të siguar, është që siguresit t'ia ruajë të drejtën e shpërblimit të dëmit nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit. I siguruari, me veprimet e veta, mund t'ia bëjë të pamundur

siguruesit tërësisht ose pjesërisht të drejtën e shpërblimit të dëmit ose mund të lërë pa ndërmarrë veprimet e duhura për sigurimin e kësaj të drejte (p.sh. nuk ndërmerr veprimet e duhura për sigurimin e provave, lejon që të skadojë afati i parashkrimit, lidh marrëveshje pa lejen e siguruesit, heq dorë nga e drejta e shpërblimit të dëmit etj.). Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohen pasojat juridike të një lëshimi të tillë, nëse kjo ndodh për fajin e të siguruarit. Siguruesi, në realizimin e të drejtave të veta, mund të pengohet në tërësi ose pjesërisht. Sipas dispozitës së këtij paragraf, siguruesi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të siguruarit, nëse për faj të të siguruarit i është pamundësuar realizimi i të drejtave të siguruesit nga subrogimi. Kjo praktikisht do të thotë që siguruesi ka të drejtë që nga shuma e siguruar të zbresë shumën deri në sasi të dëmit të cilin e ka pësuar për shkak të lëshimit të të siguruarit. Nga kjo rrjedh se këtë të drejtë nuk e ka nëse nuk ka pësuar kurrfarë dëm, me gjithë lëshimet e të siguruarit. LMD vë në dukje fajin e të siguruarit, duke mos përcaktuar shkallën e tij. Nga kjo rrjedh se pasojat juridike të parashikuar në këtë paragraf lindin edhe në rast të fajit të thjeshtë të të siguruarit.

3. Mbrojtja e të drejtave të të siguruarit.- Subrogimi i siguruesit nuk mund të jetë në dëm të të siguruarit (**nemo contra se subrogasse censetur**). Ky parim është i parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni. Edhe pse e ka realizuar shpërblimin nga sigurimi, i siguruari nuk humb të drejtën që të kërkojë nga shkaktari i dëmit shpërblimin e dëmit për të cilin nuk ka marrë shpërblimin nga sigurimi, p.sh., mosrealizimin e shpërblimit të dëmit për shkak të franshizës së kontraktuar, fitimin e humbur, (sepse nuk ka qenë i siguruar) etj. Sipas dispozitës së këtij paragrafi, nëse shpërblimi të cilin i siguruari e ka realizuar nga siguruesi për çfarëdo shkaku është më e vogël nga dëmi të cilin e ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që nga mjetet e personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit t'i paguhet mbetja e shpërblimit para pagesës së kërkesës së siguruesit nga e drejta, e cila ka kaluar tek ai. Kërkesa e të siguruarit për pagesë ka përparësi në raport me kërkesën e siguruesit në bazë të së drejtës së subrogimit.

4. Personat ndaj të cilëve siguruesi nuk ka të drejtën e subrogimit.- Përjashtimi nga e drejta e subrogimit është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni. Në përjashtim janë përfshirë personat e afërt të të siguruarit. Ndaj këtyre personave siguruesi përjashtimisht nuk fiton me subrogim të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit. Ligjvënësi këtu nisat nga prezumimi se për veprimet e këtyre personave siguruesi edhe ashtu përgjigjet dhe se kërkesa për shpërblim ndaj këtyre personave, në të vërtetë, do ta dëmtonte vetë të siguruarin. Në përjashtim janë përfshirë këto kategori të personave: a) personat në gjini në vijë të drejtë me të siguruarin, b) personat për veprimet e të cilëve përgjigjet vetë i siguruari, c) personat të cilët bashkëjetojnë me të siguruarin në të njëjtën ekonomi shtëpiake, d) personi që është punëtor i të siguruarit. Veçanërisht përmendet personi që është punëtor i të siguruarit, edhe pse ai bën pjesë në rrethinë e personave për të cilët i siguruari (punëdhënësi) përgjigjet ligjërisht (neni 152 i LMD). Kjo rregull, në themel, është miratuar nga sistemet juridike krahasuese. Përjashtimi vlen vetëm për rastin kur këta persona nuk e kanë shkaktuar dëmin me dashje (me qëllim). Për dëmet e shkaktuara me dashje nuk ka përjashtim, çka do të thotë se siguruesi, në atë rast, në bazë të së drejtës së subrogimit ka të drejtën e shpërblimit të

dëmit ndaj këtyre personave. As me sigurim nuk mund të mbulohen dëmet e shkaktuara me dashje (neni 950 par. 2 i LMD). Kjo gjen shprehje edhe te parimet themelore të së drejtës së detyrimeve për përgjegjësinë për dëmin. Edhe pse për veprimet dhe lëshimet e punonjësit ndaj personit të tretë përgjigjet punëmarrësi (neni 152 par. 1 i LMD), pala e tretë e dëmtuar mund të kërkojë riparimin e dëmit edhe drejtpërsëdrejti nga punonjësi, nëse dëmin e ka shkaktuar me dashje (neni 152 par. 2 i LMD).

5. Kërkesa ndaj siguruesit të përgjegjësisë.- Personat e përmendur në paragrafin e mësipërm, për të cilët është parashikuar përjashtimi nga e drejta e subrogimit, mund të kenë sigurimin nga përgjegjësia, me të cilin është përfshirë edhe dëmi për të cilin siguruesi ka paguar shpërblimin e siguruar, p.sh., sigurimi nga auto-përgjegjësia. Siguruesi në këtë rast nuk ka të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit ndaj shkaktarit të dëmit, por, sipas dispozitës së paragrafit 5 të këtij neni, ka të drejtë të kërkojë nga siguruesi i tij shpërblimin e shumës të cilën ia ka paguar të siguruarit. Përndryshe, për shkak të përjashtimit të parashikuar nga paragrafi paraprak, siguruesi që e ka siguruar përgjegjësinë e këtyre personave kishte me u liruar nga detyrimi i pagesës së shpërblimit për sigurimin çka nuk kishte me qenë e arsyeshme.

NËNKREU 7

SIGURIMI NGA PËRGJEGJËSIA

Neni 961. Përgjegjësia e siguruesit

1. Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, siguruesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga rasti i siguruar vetëm në qoftë se personi i tretë i dëmtuar kërkon shpërblimin e tij.
2. Siguruesi përballon në kuadrin e shumës së sigurimit shpenzimet e kontestit për përgjegjësinë e siguruesit.

Vështrim i përgjithshëm. Kuptimi i sigurimit nga përgjegjësia.- Me kontratën e sigurimit nga përgjegjësia, siguruesi, duke arkëtuar preminë e sigurimit, detyrohet ndaj të siguruarit që në kufijtë e shumës së siguruar do t'ia shpërblejë shumat të cilat i ka paguar ose është i detyruar t'ua paguajë personave të tretë lidhur me përgjegjësinë e tij të mbuluar me sigurim. Sigurimi nga përgjegjësia u përket sigurimeve kompensuese pronësore. LMD e klasifikon në sigurimin e pasurisë, kurse Ligji për sigurimin në sigurime që s'kanë të bëjnë me jetën. Në doktrinë ekziston edhe mendimi se ky sigurim, për shkak të natyrës juridike specifike të tij, duhet trajtuar si një lloj i veçantë i sigurimit. Në historinë e zhvillimit të sigurimit, sigurimi nga përgjegjësia është aplikuar më së voni. Format e para të këtij lloji të sigurimit kanë qenë sigurime nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara me përdorim të mjeteve motorike dhe sigurimet nga përgjegjësia për dëmet nga përplasjet e anijeve. Sigurimi nga auto-përgjegjësia në gjysmën e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë

me ligj përcaktohej si detyrues. Gjer atëherë, sigurimi nga përgjegjësia është konsideruar në kundërshtim me parimin e normave morale dhe me anë të gjykatës ka qenë i ndaluar. Fuqizimi i së drejtës kompensuese në funksion të riparimit të dëmit dhe mbrojtjes së palës më të dobët, si dhe zbatimi në praktikë i formave të ndryshme të socializmit të rrezikut, kanë kontribuar në zhvillimin më të hovshëm të sistemit të sigurimit nga përgjegjësia. Për shkak të interesit publik për rivendosjen e shpejtë dhe të sigurt të gjendjes së mëparshme, sot shumë forma të sigurimit nga përgjegjësia me ligj janë parashikuar si të detyrueshëm, duke përfshirë të drejtën e personave të tretë për padi të drejtpërdrejtë kundër sigurvecit (shih komentin e dispozitës së nenit 962 të LMD).

a) Rreziku i përfshirë në këtë sigurim rrjedh nga përgjegjësia civile-juridike e të siguruarit. Përgjegjësia penale nuk është objekt i këtij sigurimi. Objekt i sigurimit është detyrimi i të siguruarit, me cilësi të debitorit, nga ndonjë marrëdhënie juridike-detyruese të përgjegjësishë për dëmin, që nga vlera e pasurisë së tij të tërësishme ta shpërblejë personin e tretë – kreditorin për dëmin të cilin ky e ka pësuar. Dëmi mund të shkaktohet si pasojë e vdekjes, dëmtimit të trupit, dëmtimit të shëndetit, dëmtimit a shkatërrimit të sendit të personit të tretë. Interesi për sigurim rrjedh nga fakti që, nga përdorimi i ndonjë sendi, marrja me ndonjë veprimtari ndërmarrëse, raporti juridik ose cilësia e rrezikshme e ndonjë sendi, mund të lindë përgjegjësia për dëmin ndaj personave të tretë. Titullari i përgjegjësishë për dëmin nuk është e thënë të jetë detyrimisht edhe pronar i sendit. Me lidhjen e kontratës së sigurimit nga përgjegjësia, titullari i përgjegjësishë nuk e siguron përgjegjësishë si të tillë, por e mbron interesin e tij personal në rast se, për shkak të mundësisë së përgjegjësishë së tij, do të jetë i detyruar ta shpërblejë dëmin, i cili i është shkaktuar personit të tretë. Përndryshe, ky person nuk do të kishte prej kujt t’i kompensonte pagesat e bëra në emër të përgjegjësishë për dëmin, por këto shuma do të detyrohej t’i përballojë vetë nga pasuria e tij e tërësishme. Gjersa në sigurimin e pasurisë detyrimi kryesor i sigurvecit për ta kompensuar të siguruarin për dëmin që e ka pësuar për shkak të humbjes ose dëmtimit të sendit të siguruar, në sigurimin e përgjegjësishë sigurveci i ofron të siguruarit sigurinë (mbrojtjen) se nuk do të pësojë dëm pronësor, nëse ndodh rasti i siguruar, sepse dëmin, në vend të tij, do ta përballojë ai vetë – sigurveci. Këtu shihet veçoria kompensuese e këtij sigurimi.

b) Vlera e sendit të siguruar nuk është e mundur të vërtetohet paraprakisht. Sigurimi lidhet me një shumë të caktuar. Shuma e siguruar është kufiri i epërm i detyrimit të sigurvecit, pavarësisht nga ajo se sa është sasia e dëmit të shkaktuar. Përgjegjësia e sigurvecit vërtetohet sipas rregullave të Ligjit në fuqi mbi përgjegjësishë. Me këtë term nuk kuptohet përgjegjësia të cilën një person e merr përsipër me kontratë ndaj personit tjetër kontraktues, e cila është më e ashpër nga ajo e parashikuar me Ligjin në fuqi, përveç nëse me kontratën e sigurimit nuk është parashikuar ndryshe. Pra, bëhet fjalë për përgjegjësishë ligjore si objekt i këtij sigurimi.

c) Për dallim nga sigurimi i pasurisë, në sigurimin nga përgjegjësia, dëmi për nga sasia vërtetohet sipas parimeve të përgjegjësishë deliktore, çka do të thotë se shpërblimi që duhet t’i paguhet personit të dëmtuar, mund të përfshijë jo vetëm dëmin material, por edhe atë

jomaterial ose shpenzimet, kurse shpërblimi i dëmit, përveç dëmit të drejtpërdrejtë, mund t'i përfshijë edhe pasojat e këtij dëmi. Përkundër këtij parimi të përgjithshëm, në sigurimet detyruese ligjore nga përgjegjësia, në sistemin tonë juridik janë parashikuar kufijtë financiarë brenda të cilëve shoqëritë e sigurimit janë të detyruara ta shpërblejnë dëmin mbi bazë të sigurimit nga përgjegjësia.

ç) Kontratën e sigurimit mund ta lidhë secili person që mund të jetë bartës i përgjegjësisë për dëmin. Të sigurohen kanë mundësi: a) përgjegjësia jashtëkontraktuese, b) përgjegjësia kontraktuese. Përgjegjësia jashtëkontraktuese e të siguruarit rrjedh nga delikti civil. Siç janë, p.sh., aksidenti i trafikut, përplasja e anijeve etj. Detyrimi i shpërblimit të dëmit lind në bazë të vetë ligjit. Në marrëdhëniet detyruese nga përgjegjësia, i siguruari e ka pozitën e shkaktarit të dëmit, kurse i dëmtuari është person jashtëkontraktues (nuk është pjesëmarrës i kontratës së lidhur), pra është person i tretë. Për këtë arsye, kjo formë e përgjegjësisë quhet përgjegjësi ndaj personave të tretë. Përgjegjësia kontraktuese e të siguruarit lind me cenimin e përmbushjes së detyrimit të kontraktuar, p.sh., nga kontrata e punës, kontrata për bartjen e mallit e të ngjashme.

d) Sigurimi nga përgjegjësia mund të jetë: a) vullnetar dhe b) i detyrueshëm. Sigurimet e detyrueshme nga përgjegjësia mund të jenë sigurime të detyrueshme ligjore dhe sigurime të detyrueshme kontraktuese. E drejta jonë e njeh sistemin e sigurimit të detyrueshëm kontraktues për të gjitha format e sigurimit të detyrueshëm. Sigurimet e detyrueshme janë të parashikuara me Ligjin për Sigurimin dhe me ligje të veçanta për disa profesione (p.sh., neni 15 i Ligjit për Noterin⁸⁷⁵, neni 7 par. 1 i Ligjit për Avokatin⁸⁷⁶ etj.). Sigurimi nga përgjegjësia nuk është perkufizuar më hollësisht në ligj. Në fushën autonome janë formuluar forma të ndryshme të këtij sigurimi. Ndarja e tyre themelore është: a) sigurimi nga përgjegjësia e përgjithshme, b) sigurimi i përgjegjësisë nga veprimtaria. Për këto sigurime ekzistojë kushte të përgjithshme dhe kushte të veçanta.

1. Kushti për lindjen e detyrimit të siguresit për pagimin e shpërblimit nga sigurimi.-

Me dispozitën e nenit 962 të LMD janë vendosur rregullat themelore për përgjegjësinë e siguresit në këtë sigurim. Në paragrafin 1 të nenit 961 rregullohen kushtet për lindjen e detyrimit për pagimin e shpërblimit nga sigurimi.

1. (a) Në marrëdhëniet juridike të sigurimit nga përgjegjësia përfshihen tre persona: a) siguresi, b) i siguruari dhe c) i dëmtuari. Me ndodhjen e rastit të siguar, në rrethin e personave të interesuar hyn edhe i dëmtuari (personi i tretë), me të drejtat dhe detyrimet e veta personale. Me këtë ai fiton të drejtën e kërkesës së drejtpërdrejtë ndaj siguresit. Për këtë arsye është një çështje specifike ajo se kur do të konsiderohet se ka ndodhur

875 Ligji për Noterinë 03/L-010 i dt. 17.10.2008 i dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekretin DL-053 -2008 të dt. 06.11.2008 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Noterinë 04/L-002 i dt. 21.07.2011,

876 Ligji për Avokatinë 04/L-193 i dt. 02.05.2013 i dekratuar nga ana e PRK me dekretin DL-25-2013 të dt. 21.05.2013,

rasti i siguruar. A është ky momenti i shkaktimit të ngjarjes së dëmshme, momenti i parashtrimit të kërkesës për shpërblim apo atëherë kur me marrëveshje apo kur gjykata vërteton se ekziston përgjegjësia e sigurvearit? Në këtë aspekt, ligjet e sistemeve juridike krahasuese nuk janë të unifikuara. Baza juridike e përgjegjësive për dëmin, me të cilën lidhet detyrimi i sigurvearit, është ngjarja e dëmshme. Si rast i sigurimit për këtë merret veprimi i dëmshëm i dëmtuesit, me të cilin i shkaktohet dëmi i dëmtuarit, me çka rendi juridik lidh ekzistimin e marrëdhënies juridike-detyruese të përgjegjësive për dëmin. Konsiderohet se rasti i siguruar ka ndodhur kur ka filluar të shkaktohet dëmi. Nëse nuk ekziston rasti i dëmshëm, nuk ekziston as marrëdhënia juridike e përgjegjësive për dëmin. Nga stilizimi i dispozitës së nenit 961 par. 1 të LMD do të mund të përfundohej se edhe ligjvënësi ynë qëndron në këtë pozicion.

1. (b) Me vetë realizimin e rastit të siguruar, sigurveari nuk është automatikisht i detyruar të paguajë shpërblimin për dëmin. Detyrimi i sigurvearit nuk ndodh derisa nuk është parashtruar kërkesa për shpërblim e personit të tretë nga marrëdhënia juridike e përgjegjësive për dëmin. Për këtë arsye, LMD me arsye përcakton se sigurveari përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga rasti i siguruar vetëm në qoftë se personi i tretë i dëmtuar kërkon shpërblimin e tij. Kjo zgjidhje është në përputhje me zgjidhjen e sistemeve krahasuese juridike. Përveç kësaj, për detyrimin e sigurvearit është e nevojshme të plotësohet edhe një kusht: sipas rregullave të së drejtës së detyrimeve, duhet të ekzistojë edhe përgjegjësia e personit të siguruar ndaj të dëmtuarit (personit të tretë). Me fjalë tjera, duhet të ekzistojë detyrimi i tij për shpërblimin e dëmit ndaj personit të tretë.

1. (c) Derisa nuk konstatohet dhe vërtetohet përgjegjësia e të sigurvearit, sigurveari nuk është i detyruar ta paguajë shpërblimin, pavarësisht se i sigurveari, para kësaj, mund të pësojë dëm material. Nga kjo rrjedh se sigurveari i përgjegjësive është i detyruar të bëjë pagesën e dëmit vetëm nëse janë plotësuar këto dy kushte: a) që të ekzistojë kërkesa për shpërblimin e dëmit e personit të tretë nga marrëdhënia juridike e përgjegjësive për dëmin, b) që në bazë të rregullave të së drejtës së detyrimeve, i sigurveari të jetë i detyruar t'ia shpërblejë dëmin personit të tretë lidhur me përgjegjësinë e tij të mbuluar me sigurim. Sa i përket kërkesës nën b), ekzistimi i detyrimit ligjor të të sigurvearit që t'ia shpërblejë dëmin personit të tretë, mund të vërtetohet edhe në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit ose me marrëveshje të palëve, pas zbatimit të analizës profesionale të lëndës. Për detyrimin e sigurvearit që të paguajë shpërblimin, sipas kësaj, nuk është kusht që përgjegjësia ligjore të jetë vërtetuar në procedurë gjyqësore dhe as që i sigurveari paraprakisht t'ia ketë paguar shpërblimin personit të tretë.

1. (ç) Sigurimi nga përgjegjësia sipas sasisë është i kufizuar. Vetëm përjashtimisht ofrohet sigurimi nga përgjegjësia pa kufizime në mbulesë. Kriter për aplikimin e shumës së sigurimit është një rast i dëmshëm (rasti i siguruar). Shumë dëme të kohëpaskohshme përbëjnë një rast sigurimi, nëse dëmet janë bërë për të njëjtin shkak. Shuma më e lartë e detyrimit të sigurvearit, sipas rastit, mund të jetë e kontraktuar ose e rregulluar. Palët mund të kontraktojnë edhe detyrimin më të lartë të sigurvearit për një kontratë njëvjeçare, pavarësisht nga numri i rasteve të ndodhura. Te sigurimet detyruese nga përgjegjësia janë

parashikuar, p.sh., shuma më të vogla të përgjegjësive për një rast të siguruar. Palët mund të kontraktjnë edhe shuma më të larta nga të parashikuarat.

1. (d) Duke marrë parasysh se sigurimi nga përgjegjësia është sigurim për shpërblim, dikur është konsideruar se i siguruari nuk ka pësuar dëm derisa nuk ia ka bërë pagesën e dëmit të dëmtuarit. Vetëm pas pagesës së shpërblimit që i ka bërë personit të tretë, i siguruari fiton të drejtën e kërkesës ndaj siguresit. Qëndrimi bashkëkohor është se, për ekzistimin e detyrimit të siguresit, nuk është kusht që i siguruari paraprakisht t'ia bëjë pagesën e dëmit personit të tretë (të dëmtuarit). Është qenësore nëse, sipas rregullave të së drejtës së detyrimeve, ekziston ose jo përgjegjësia e siguresit për dëmin dhe a është ai dëm i konstatuar në mënyrë relevante. Në kontratën e sigurimit, megjithatë, mund të parashikohet që siguresi nuk është i detyruar të paguajë shpërblimin derisa i siguruari paraprakisht nuk e ka kompensuar personin e tretë. Duhet theksuar që kjo mundësi ekziston vetëm te kontratat e sigurimit jo detyruës nga përgjegjësia.

2. Shpenzimet e vërtetimit të përgjegjësive së të siguruarit dhe shpenzimet e mbrojtjes juridike.- Në sigurimet nga përgjegjësia siguresi, përveç mbrojtjes ekonomike, rregullisht të siguruarit i ofron edhe mbrojtje juridike qoftë ta mbrojë vetë, qoftë t'ia heqë shpenzimet e kontestit. Në interesin e siguresit është që i siguruari të mbrohet sa më me sukses nga kërkesat e pabazuara dhe të parashtruara tej mase. Për këtë arsye, nga sigurimi shpërblehen shpenzimet e këtyre masave.

Neni 962. E drejta personale e të dëmtuarit dhe padia e drejtpërdrejtë

- 1. Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, personi i dëmtuar mund të kërkojë drejtpërdrejt nga siguresi shpërblimin e dëmit që ka pësuar nga ngjarja për të cilën përgjigjet siguresi, por jo më tepër se deri në shumën e detyrimit të siguresit.**
- 2. Personi i dëmtuar ka të drejtën personale në shpërblimin nga sigurimi që nga momenti kur ka ndodhur rasti i siguruar, kështu që çdo ndryshim i mëvonshëm për të drejtat e të siguruarit ndaj siguresit nuk ka ndikim në të drejtën e personit të dëmtuar në shpërblim.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në marrëdhëniet kontraktuese nga sigurimi prej përgjegjësive gjenden edhe siguresi, edhe i siguruari. Personi që ka pësuar dëmin nga marrëdhënia kontraktuese apo jokontraktuese juridike-detyruese e përgjegjësive për dëmin, nuk është palë e kontratës së sigurimit nga përgjegjësia, në të cilën personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit ka pozitën e të siguruarit. Pala e dëmtuar nuk ka të drejtë që të kërkojë drejtpërsëdrejti nga siguresi i përgjegjësive shpërblimin e dëmit, të cilin e ka pësuar me ngjarjen për të cilën përgjigjet i siguruari. E njëjta gjë vlen edhe për siguresin i cili ia ka shpërblyer dëmin personit të dëmtuar dhe në bazë të subrogimit fiton të drejtën e kërkesës juridike-detyruese ndaj siguresit të përgjegjësive së personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

a) Në zhvillimin më të ri të së drejtës së sigurimit është vendosur përjashtimi nga ky parim i përgjithshëm, ashtu që është parashikuar mundësia ligjore që personi i dëmtuar ta realizojë të drejtën e shpërblimit të dëmit drejtpërsëdrejti nga siguruesi i përgjegjësishë. Në këtë mënyrë, personi i dëmtuar fiton të drejtën personale të shpërblimit nga sigurimi dhe kësaj të drejte siguruesi nuk mund t'i kundërvihet. Kjo nënkupton se i dëmtuari në pikëpamje procedurale bëhet me legjitimitet aktiv, çka do të thotë se fiton autorizimin për të hapur kontest kundër siguruesit të përgjegjësishë (padia e drejtpërdrejtë). Në këtë rast, në bazë të ligjit themelohet marrëdhënia juridike-detyruese mes të dëmtuarit dhe siguruesit, në të cilën i dëmtuari ka pozitën juridike të kreditorit për kërkesën e pagesës së shpërblimit të dëmit. Personi i tretë bëhet kështu subjekt i marrëdhënies kontraktuese. Nga kjo rrjedh që autorizimi juridik-procedural në padinë e drejtpërdrejtë mbështetet në ligj, por mbështetja juridike e kërkesës, me shfrytëzimin e institutit të padisë së drejtpërdrejtë, është një veprimi i dëmshëm i të siguarit, domethënë bëhet fjalë për përgjegjësinë e tij për dëmin e shkaktuar personit të tretë. Veprimi i dëmshëm, për të cilin është përgjegjës i siguruari, është fakti qenësor në të cilin lidhet gjeneza e së drejtës subjektive për shpërblimin e dëmit. Përgjegjësia juridike- pronësore e të siguarit është prezumim i detyrimit të siguruesit në marrëdhëniet që dalin nga padia e drejtpërdrejtë. Kjo ka të bëjë me bazën juridike, vëllimin dhe shkallën e përgjegjësishë. Në këtë drejtim, situata juridikisht është e njëjtë si edhe në marrëdhëniet e personit të dëmtuar me të siguarin, përveç nëse me kontratën e sigurimit nuk është parashikuar ndryshe. Nëse me kontratën e sigurimit është parashikuar shuma e siguar, detyrimi i siguruesit ndaj personit të tretë është e kufizuar me sasinë e kësaj shume (neni 962 i LMD). Kjo do të thotë që detyrimi i siguruesit të përgjegjësishë është i kufizuar dyfish: a) me rregullat e të drejtës së detyrimeve mbi sasinë dhe shkallën e përgjegjësishë, b) me sasinë e kontraktuar të detyrimit të siguruesit.

b) Me gjithë të drejtën ligjore që kërkesën për shpërblimin e dëmit t'ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit, personi i dëmtuar nuk e humb të drejtën që shpërblimin për dëmin ta kërkojë nga i siguruari. Personi i dëmtuar nuk mund të realizojë një shpërblim më të madh nga vlera e dëmit të pësuar. Edhe këtu, në përputhje me parimin e përgjithshëm juridik, ekziston ndalesa e kumulimit të shpërblimit nga sigurimi dhe marrëdhëniet juridike-detyruese të përgjegjësishë për dëmin. Personi i dëmtuar, si kreditor në rrethin e marrëdhënieve të përgjegjësishë për dëmin, ka të drejtë të zgjedhë. Me fjalë të tjera, ai mund të kërkojë shpërblimin e dëmit ose nga siguruesi, ose nga personi përgjegjës për dëmin. Nëse i dëmtuari e realizon shpërblimin nga sigurimi, ai humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit dhe, anasjelltas, nëse i dëmtuari merr shpërblimin e plotë nga personi i përgjegjës për shkaktimin e dëmit (i siguruari), nuk mund ta realizojë edhe një shpërblim nga siguruesi. Të dëmtuarit i është lënë zgjedhja e lirë nëse do ta përfshijë me padi, përveç siguruesit, edhe të siguarin – shkaktarin e dëmit. Në atë rast, siguruesi dhe i siguruari ndaj personit të tretë përgjigjen në mënyrë solidare. Nga kjo rrjedh se personi i dëmtuar mund të padisë siguruesin dhe të siguarin në mënyrë alternative - suksesive dhe kumulative.

c) Shkaqe të shumta e arsyetojnë vënien në sistemin juridik të së drejtës së personit të tretë për kërkesë të drejtpërdrejt ndaj siguruesit të përgjegjësishë: a) siguria më e madhe e pagesës, b) thjeshtimi i procedurës, c) shpejtësia në realizimin e shpërblimit, ç) përmbushja e kërkesës së rendit publik që, sa ma parë që të jetë e mundur, të rivendoset gjendja e mëparshme e çrregulluar me veprimin e dëmshëm, d) pamundësia e lajmërimit që i siguruari (dëmtuesi) ta mbajë sigurimin e realizuar e të mos ia kalojë të dëmtuarit, dh) shmangia e mundësisë së marrëveshjeve me keqdashje mes të dëmtuarit dhe të siguruarit.

ç) Interesi publik për rivendosjen e shpejt dhe të sigurt të gjendjes së mëparshme është gjithsesi i shprehur në sigurimet detyruese nga përgjegjësia. Ky interes përfundimisht e ka kushtëzuar qenien të detyrueshme të tyre. Me vënien e institutit të padisë së drejtpërdrejtë vendoset mbrojtja shtesë e të dëmtuarit. E drejta e personit të tretë për padi të drejtpërdrejtë duhet të jetë e parashikuar, duke marrë parasysh se personi i tretë, siç kemi vërejtur, nuk është në kurrfarë marrëdhëniesh kontraktuese ose jokontraktuese me siguruesin ose risiguruesin.

1. E drejta e kërkesës së drejtpërdrejtë.- Në paragrafin 1 të këtij neni është themeluar e drejta e personit të tretë të dëmtuar për kërkesë të drejtpërdrejtë ndaj siguruesit të përgjegjësishë për shpërblimin e dëmit. Nga kjo dispozitë rrjedh: a) që e drejta e kërkesës së drejtpërdrejtë të mos jetë e kushtëzuar me pamundësinë e arkëtimit nga personi përgjegjës (p.sh., për shkak të falimentimit ose gjendjes së vështirë materiale), b) që detyrimi i siguruesit ndaj të dëmtuarit të jetë brenda kufijve të detyrimit të siguruesit ndaj të siguruarit, c) që e drejta e kërkesës së drejtpërdrejtë të jetë e parashikuar në të gjitha sigurimet nga përgjegjësia, pavarësisht nëse ato janë detyruese ose jodetyruese (sipas vullnetit të lirë). Kjo është me rëndësi të vërehet për shkak të pozitës së pabarabartë të personit të dëmtuar ndaj siguruesit në këto sigurime. Aplikimi i së drejtës së padisë së drejtpërdrejtë në të gjitha sigurimet nga përgjegjësia, pa përjashtim, arsyetohet me ekzistimin e tendencës së përgjithshme në të drejtën krahasuese për socializimin e përgjegjësishë me anë të sigurimit. Këtij qëndrimi i është bashkuar edhe ligjvënësi ynë.

2. Që në momentin e ndodhjes së rastit të siguruar, vendosen të drejtat e palëve nga marrëdhënia detyruese, kështu që çdo ndryshim i mëvonshëm lidhur me të drejtat e të siguruarit ndaj siguruesit, nuk ka ndikim në të drejtën e personit të dëmtuar për shpërblim.

2. (a) Pozita juridike e të dëmtuarit.- Te raportet nga padia e drejtpërdrejtë ndodh ndarja e marrëdhënies juridike e të dëmtuarit ndaj siguruesit nga marrëdhënia juridike e të siguruarit ndaj siguruesit. Shkalla e kësaj ndarjeje nuk është e njëjtë si te sigurimet nga përgjegjësia detyruese, si tek ajo jodetyruese, nga e cila qenësisht varet pozita juridike e të dëmtuarit në raportet që rrjedhin nga padia e drejtpërdrejtë. Kjo veçanërisht gjen shprehje në të drejtën e siguruesit për kundërshtimet të cilat mund t'ia parashtrijë të dëmtuarit. Te sigurimet kontraktuese nga përgjegjësia është parashikuar jo vetëm e drejta e kërkesës së drejtpërdrejtë, por me vetë ligjin është rregulluar edhe raporti i të dëmtuarit me të siguruarin në bazë të të cilit i dëmtuari ndaj siguruesit ka pozitë të pavarur juridike për sa i përket marrëdhënies mes siguruesit dhe të siguruarit. Me

ligj parashikohet shprehimisht se siguruesi nuk mund t'ia parashtrijë të dëmtuarit ato kundërshtime që do të kishte pasur mundësi t'ia parashtronte të siguararit, si palë e kontratës së sigurimit (neni 942 par. 2 i LMD).

2. (b) Prandaj, te sigurimi i detyrueshëm nga përgjegjësia, për sa i përket raportit juridik mes të dëmtuarit dhe siguruesit të përgjegjësishë, është parashikuar me ligj marrëdhënia e shpërblimit të dëmit nga sigurimi dhe jo marrëdhënia nga kontrata e sigurimit (shih komentin e dispozitës së nenit 942 të LMD). Të drejtat personale nga padia e drejtpërdrejtë i dëmtuari i nxjerr nga të drejtat kontraktuese të të siguararit. I dëmtuari, në bazë të ligjit, hyn në pozitën juridike të të siguararit në raport me dëmin e mbuluar me sigurimin nga përgjegjësia. Për këtë arsye, pozita e tij juridike, në raport me siguruesin e përgjegjësishë, nuk është e pavarur dhe autonome në raport me kontratën e sigurimit. Për marrëdhënien e tyre reciproke, vlejné dispozitat e kontratës së sigurimit, siç vlejné edhe në marrëdhëniet e të siguararit dhe siguruesit. I dëmtuari nuk mund të jetë në pozitë më të favorshme sesa i siguarari për vetë faktin që ai ka të drejtën personale për padi të drejtpërdrejtë, sikurse edhe siguruesi që për këtë shkak nuk mund të vihet në pozitë më të pafavorshme. Për shkak të gjithë sa u tha më sipër, siguruesi personit të dëmtuar mund t'ia parashtrijë: a) të gjitha kundërshtimet e bazuara, të cilat siguruesi i ka ndaj personit të tretë (p.sh. parashkrimin, fajin personal për dëmin etj.), b) të gjitha kundërshtimet e bazuara, të cilat siguruesi (gjer në momentin e shkaktimit të dëmit) i ka ndaj të siguararit nga kontrata e sigurimit. E drejta e siguruesit për kundërshtime te sigurimet vullnetare është e kufizuar në kohë, gjer në paraqitjen e rastit të siguar.

KREU 3

SIGURIMI I PERSONAVE NËNKREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 963. Përcaktimi i shumës së siguar

Në kontratat për sigurimin e personave (sigurimi i jetës dhe sigurimin ndaj rastit të fatkeqësisë), shuma e sigurimit të cilën siguruesi ka për detyrë ta paguajë kur lind rasti i siguar, përcaktohet në policë sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese.

Vështrim i përgjithshëm.- Në kreun 3 pjesa 24 rregullohen marrëdhëniet juridike te sigurimi i personave. Sigurimi i personave klasifikohet në sigurim të jetës dhe sigurim të rastit të fatkeqësisë. Ligji nuk i definon këto sigurime, prandaj edhe me këto sigurime vlen përkufizimi i kontratës së sigurimit sipas nenit 918 i LMD. Sigurimi i jetës, sipas Ligjit për Sigurimin, u përket sigurimeve jetësore, kurse sigurimi për rastet e fatkeqësisë u përket sigurimeve jo jetësore.

a) Me kontratën e sigurimit të jetës, siguruesi detyrohet që të siguararit ose personit të cilin ai e përcakton t'ia paguajë shumën e siguar ose rentën, në rast të vdekjes së shfrytëzuesit të

sigurimit ose mbijetesës për një kohë të caktuar. Format kryesore të sigurimit të jetës janë: sigurimi për rastin e mbijetesës së afatit të kontraktuar (ku ekziston pasiguria e shkaktimit të rastit të siguruar) dhe sigurimi në rast të vdekjes (ku shkaktimi i rastit të siguruar është i pritshëm, por nuk dihet se kur do të ndodhë). Kontratat për raste të vdekjes mund të jenë: a) afatshkurta, b) me afat të caktuar (afat fiks), c) për krejt jetën. Te sigurimi nga pasojat e rastit të aksidentit, siguruesi paguan shumë e siguruar, nëse ndodh vdekja ose invaliditeti i personit të siguruar, shkaktuar nga rasti aksidental. Në sigurim përfshihen edhe shpenzimet e mjekimit, shpërblimet ditore për kohën e paftësisë së përkohshme për punë, shpërblimet ditore për qëndrimin në spital, shpenzimet e shpëtimit e të tjera. Rast aksidental konsiderohet secila ngjarje e befasishme dhe e pavarur nga vullneti i të siguruarit, e cila, duke vepruar kryesisht jashtë dhe rrufeshëm në trupin e të siguruarit, ka për pasojë vdekjen e tij, invaliditetin e pjesshëm apo të plotë, paftësinë e përkohshme për punë ose dëmtimin e shëndetit që kërkon trajtim mjekësor. Sigurimi mund të lidhet për një të siguruar (individual) ose për më shumë persona (kolektiv). Rreziku i jetës dhe rreziku i fatkeqësisë mund të sigurohen me kontrata të veçanta të sigurimit ose sigurimi për pasojat nga fatkeqësia mund të bëhet si sigurim plotësues me sigurimin e jetës.

b) Për dallim nga sigurimi i pasurisë, sigurimi i personave nuk i ka karakteristikat e shpërblimit të dëmit. Ajo lidhet në një shumë të caktuar, e cila shënohet në policën e sigurimit, prandaj ky sigurim i përket sigurimit kapital (shuma e përcaktuar paraprakisht). Shuma e kontraktuar në policën e sigurimit i obligon që të dyja palët kontraktuese. Në rast të paraqitjes së rastit të siguruar (ngjarjes së siguruar), nga sigurimi paguhet shpërblimi i përcaktuar në bazë të shumës së siguruar dhe jo në bazë të dëmit të pësuar. Kjo pozitë e këtyre sigurimeve rrjedh nga bindja se jeta personale e njeriut e ka vlerën më të madhe. Kjo vlerë nuk mund të matet me para. Gjithashtu për ndonjë person është e pavlerësueshme vlera e prindërve, fëmijëve të tij, bashkëshortit dhe personave të tjerë të afërm. Marrëdhënia e tyre, para së gjithash, ka vlerë sentimentale (subjektive) dhe jo ekonomike. Për këtë arsye, në kuptimin ekonomik kjo vlerë nuk është e mundur të sigurohet ashtu si sigurohen sendet në vlerën e tyre reale. Derisa qëllimi i sigurimit të pasurisë është që, me shpërblimin nga sigurimi, me të holla, të kompensohet humbja e ndodhur, sigurimi i jetës nuk e ka këtë veçori të shpërblimit. Kjo rrethanë e bën të veçantë sigurimin e jetës në raport me sigurimet e pasurisë. Kriter për caktimin e shumës së sigurimit të sigurimi i pasurisë është vlera e interesit për sigurim. Te sigurimi i jetës kjo vlerë përcaktohet me marrëveshje, me rastin e lidhjes së kontratës, dhe detyrimisht evidencohet në policën e sigurimit. Si kriter për vërtetimin e kësaj vlere nuk merret sasia e dëmit të mundshëm. Këtë shumë është i detyruar ta paguajë siguruesi kur të lindin rrethanat e parashikuara në kontratë (lëndimi, vdekja, mbijetesë). Çështja e dëmit të pësuar me atë rast është plotësisht e parëndësishme. Baza juridike e detyrimit të siguruesit të këto sigurime nuk është dëmi i pësuar, por fakti se kanë lindur rrethanat e parashikuara në kontratë. Veçoria e këtij lloji të sigurimit është ajo se është e vlefshme edhe kur realizimi i rastit të siguruar është i pritshëm (p.sh. vdekja në rast të sigurimit “për tërë jetën” nga vdekja), por nuk është e ditur se kur do të ndodhë. Në këtë rast detyrimi i siguruesit nuk është i kufizuar në kohë, por arrihet me vetë faktin e

realizimit të rastit të siguruar. Me rastin caktimit të sasisë së shumës së siguruar, edhe te këto sigurime ndonjëherë merret parasysh ekuivalenti monetar i rrezikut të siguruar. Për dallim nga sigurimi i pasurisë, këtu dëmi i pësuar nuk është kriter që merret në konsiderim me rastin e caktimit të shpërblimit nga sigurimi.

c) Për këto arsye, te këto sigurime nuk zbatohet parimi i shpërblimit të dëmit dhe as pasojat juridike të zbatimit të këtij parimi. Te sigurimi i personave, ndryshe nga sigurimet pronësore, siguruuesi, pas pagesës së shumës së siguruar, nuk ka të drejtën e subrogimit, do të thotë nuk i përket e drejta e kërkesës ndaj personit përgjegjës për shkaktimin e rastit të siguruar; i siguruari mund ta realizojë shpërblimin edhe nga më shumë siguruues (nuk zbatohet parimi për sigurimin e dyfishtë); i siguruari mund ta grumbullojë shpërblimin nga siguruuesi dhe nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit, (nuk ka ndalim të kumulimit të shpërblimit); nuk zbatohet parimi i vlerës së interesit të siguruar (mbisigurimi, nënsigurimi).

ç) Për dallim nga sigurimi i jetës, te sigurimi nga pasojat e aksidentit mund të ekzistojnë në elementet e sigurimit kompensues. P.sh., sigurimi i shpenzimeve të mjekimit (që është shpenzim tipik i siguruar) i ka karakteristikat e sigurimit kompensues, sepse shpërblimi nga sigurimi përcaktohet në bazë të sasisë së shpenzimeve reale. Në këta kufij, edhe për sigurimet nga pasojat e fatkeqësisë, vlejnë parimet e shpërblimit të dëmit si edhe për sigurimet e pasurisë. Mirëpo, nëse në kontratën e sigurimit nga pasojat e fatkeqësisë është përfshirë edhe shpërblimi ditor fiks për mjekimin spitalor ose për paaftësinë e përkohshme për punë, atëherë një shpërblimi i tillë nuk i ka karakteristikat e sigurimit kompensues, sepse nuk përcaktohet në bazë të shpenzimeve reale, por në bazë të shumës së kontraktuar paraprakisht. Duke marrë parasysh se elementet e sigurimit kompensues nuk janë mbizotëruese te sigurimi nga pasojat e rastit të aksidentit dhe lidhen me jetën e njeriut, ky sigurim, bashkë me sigurimin e jetës, me arsye është vendosur te sigurimi i personave

d) Interesi për sigurimin e personave.- Me sigurimin e jetës me interes nënkuptojmë interesin e kontraktuesit të sigurimit që të sigurojë jetën personale ose jetën e ndo një personi të tretë. Kjo i përket edhe sigurimit ndaj rastit të fatkeqësisë. Personin për të cilin është lidhur sigurimi e quajmë shfrytëzues të sigurimit të jetës. Ndryshueshmëria e natyrës juridike të personave te sigurimet e pasurisë shprehet edhe në çështjen e interesit të sigurimit. Te sigurimet e pasurisë është logjike që interesi duhet të jetë i natyrës ekonomike dhe juridikisht i arsyeshëm. Te sigurimet e jetës, megjithatë, interesi normalisht nuk e ka shenjën mbizotëruese ekonomike, por me intervenimin e ligjvënësit edhe te këto sigurime vlefshmëria e kontratës mund të kushtëzohet me ekzistimin e interesit ekonomik, siç është bërë kjo, p.sh., në Ligjin për Sigurimin të vitit 1774 në Angli, i cili ende është në fuqi. Sipas këtij Ligji, personi që lidh kontratë për sigurimin e jetës duhet të ketë interes të sigurueshëm në raport me jetën e personit të siguruar. Nëse interesi mungon, kontrata është nule⁸⁷⁷. Pavarësisht nga vërejtjet e përgjithshme, nuk mund të mohohet që edhe interesi te sigurimet e jetës, ndonjëherë përmban element ekonomik. Ky interes është i lidhur me personin -shfrytëzuesin e sigurimit, prandaj sigurohet jeta e tij në rast vdekjeje, invaliditeti

877 Neni 1 i **Life Insurance Actu** i vitit 1774

etj. Në thelbin e këtij interesi është interesi material në mënyrë që, në rast të ndodhjes së rastit të siguruar, të fitohet një shpërblimi monetar, i cili, supozohet, do të ndihmojë që më lehtë të përballohen pasojat e dëmshme të tij. Elementet ekonomike i gjejmë edhe te lidhja e kontratës për kursimin, pensionin plotësues etj. Vështirë është, megjithatë, të merret me mend që dikush do të luajë me jetën personale apo integritetin e vet shëndetësor me synimin që të realizojë shpërblim nga sigurimi ose ta sigurojë personin e tretë, të cilin mendon më vonë ta privojë nga jeta ose t'ia cenojë integritetin trupor. Pavarësisht nga ajo se elementi i interesit material te sigurimi i jetës nuk është mbizotërues, nevoja që të mbrohet rendi juridik nga mundësia e përfitimit pa të drejtë fitimi me anë të sigurimit të jetës i ka udhëhequr gjatë historisë disa ligjvënës që edhe për sigurimet jetësore shprehimisht të parashikojnë detyrimin e ekzistimit të interesit të siguroreshëm në kuptimin material. Ky është njëri nga shkaqet kryesore që ka bërë që sigurimi i jetës të zhvillohet relativisht vonë (nga fundi shekullit 17) dhe që gjatë historisë ishte edhe i ndaluar ose i kufizuar. Për shkak të zhvillimit të tillë të së drejtës së sigurimit të jetës, sistemet krahasuese sot karakterizohen nga dy zgjidhje themelore: a) ekzistimi i interesit nuk është supozimi për vlefshmërinë e kontratës së sigurimit të jetës, b) për vlefshmërinë e kontratës duhet të ekzistojë interesi material juridikisht i lejuar i kontraktuesit të sigurimit ndaj personit të siguruar (përveç nëse ky interes nuk supozohet). Në të drejtën tonë, ekzistimi i interesit te sigurimi i personave nuk është prezumim i vlefshmërisë së kontratës së sigurimit. Për sigurimin e personit të tretë nuk kërkohet kurrfarë interesi ekonomik në anën e kontraktuesit të sigurimit dhe as të ekzistojë ndonjë marrëdhënie, p.sh. farefisnore, mes kontraktuesit dhe shfrytëzuesit të sigurimit. Kjo zgjidhje në sistemet krahasuese sot është mbizotëruese dhe merret si më bashkëkohore në krahasim me zgjidhjen e grupit tjetër. Liria në zgjedhjen e personit të tretë si shfrytëzues të sigurimit megjithatë është e kufizuar me pëlqimin e shfrytëzuesit të sigurimit, (shih komentin e dispozitës së nenit 967 të LMD).

dh) Sasia e kontraktuar e shumës së sigurimit në policën e sigurimit.- Shuma e siguruar është element qenësor i kontratës së sigurimit të personave. Sigurimi personal është sigurim i shumës dhe shuma e siguruar është elementi thelbësor i marrëdhënies së sigurimit. Derisa te sigurimet e pasurisë mund të vërtetohet shuma e sigurimit edhe në bazë të vlerës së sendit të siguruar, te sigurimi personal, për arsyet e theksuara, kjo nuk është e mundur. Për këtë arsye, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar shprehimisht që sasia e shumës së siguruar të përcaktohet në policë sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese. Lidhur me sasinë e shumës së siguruar, nuk ka kufizim, përveç nëse kjo nuk është parashikuar në ligj të veçantë. Kësi rasti të kufizimit kemi te sigurimi i detyrueshëm i udhëtarëve në qarkullimin publik nga pasojat e fatkeqësisë. Ligji përmend vetëm policën e sigurimit për të përcaktuar sasinë e shumës së sigurimit, por shuma e kontraktuar do të jetë ligjërisht detyruese, nëse është përcaktuar edhe në ndonjë dokument tjetër për kursimin, e cila e zëvendëson përkohësisht policën e sigurimit.

Neni 964. Polica e sigurimit të jetës

- 1. Përpos pjesëve përbërëse që duhet t'i ketë çdo policë, në policën e sigurimit të jetës duhet të shënohen: emri dhe mbiemri i personit në jetën e të cilit shtrihet sigurimi, datëlindja e tij, ngjarja ose afati nga i cili varet paraqitja e të drejtës për të kërkuar pagimin e shumës së siguruar.**
- 2. Polica e sigurimit të jetës mund të jetë e shënuar në personin e caktuar, të jetë e shënuar sipas urdhrin, por nuk mund të shënohet në prurësin.**
- 3. Për vlefshmërinë e indosamentit të policës sipas urdhrin nevojitet të përmbajë emrin e shfrytëzuesit, datën e indosimit dhe nënshkrimin e indosantit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Kontrata e sigurimit të personave është kontratë formale. Sipas LMD, kontrata e sigurimit është punë juridike joformale, (shih komentin e dispozitës së nenit 922 par. 1 të LMD – **forma ad probationem**). Përrjashtimisht nga ky parim i përgjithshëm, te sigurimi i personave është parashikuar forma e shkruar, si kusht për lindjen dhe vlefshmërinë e kontratës së sigurimit. Në përputhje me dispozitën e nenit 922 të LMD, kontrata e sigurimit të personave është e lidhur kur palët nënshkruajnë policën e sigurimit (par. 3 i nenit 922 të LMD). Kjo do të thotë se polica e sigurimit është formë detyruese e lidhjes së kontratës (**forma ad solemnitatem**). Nënshkrimi i policës nga ana e palëve ka kuptimin konstitutiv për lindjen e kontratës. Kjo dispozitë është e natyrës juridike detyruese, prandaj palët nuk e kanë lirinë të kontraktojnë ndryshe.

1. Përbërësit e veçantë të policës.- Në paragrafin 1 të këtij neni parashikohen përbërësit e veçantë të policës së sigurimit të jetës. Në policën e sigurimit të jetës, përveç pjesëve përbërëse që duhet t'i ketë çdo policë sipas dispozitave të nenit 923 të LMD, duhet të shënohen: a) emri dhe mbiemri i personit në jetën e të cilit shtrihet sigurimi, b) datëlindja e tij, c) ngjarja ose afati nga i cili varet paraqitja e rastit të siguruar. Emri dhe mbiemri i personit mund të ketë të bëjë me personin kontraktues të sigurimit ose me ndonjë person të tretë (shih kom. e nenit 967 par. 1 të LMD), varësisht nga ajo se me cilin ka të bëjë sigurimi. Nëse është siguruar personi i tretë, për vlefshmërinë e kontratës është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij (shih pra. 3 të nenit 967 të LMD). Shënimi i datëlindjes së shfrytëzuesit të sigurimit është fakt jashtëzakonisht i rëndësishëm te sigurimi i personave. Nga kjo drejtpërdrejt varet rrezikshmëria e kontratës konkrete, por edhe tarifa e siguresit mbështetet në vitet e jetës së personit, me të cilin ka të bëjë sigurimi. Rëndësinë e këtij elementi të kontratës e vërteton edhe fakti që, nga saktësia e paraqitjes së moshës së të siguarit varet edhe vlefshmëria juridike e kontratës së sigurimit, (shih komentin e nenit 965 të LMD. Nga polica e sigurimit duhet të shihet qartë lloji i sigurimit, përkatësisht ngjarja lidhur me të cilën lidhet kontrata. Kjo mund të jetë, p.sh., përjetimi i një dite të caktuar të të siguarit, vdekja e të siguarit, e gjithë jeta (personale ose e tjetrit), renta, vdekja e të siguarit ose lëndimi për shkak të aksidentit.

2. Polica e sigurimit nuk mund të jetë sipas prurësit.- Në paragrafin 2 të këtij neni, polica e sigurimit të jetës mund të jetë në emër të një personi të caktuar ose sipas urdhrin

por nuk mund të jetë në emër të prurësit. Te sigurimi i jetës polica është e lidhur me persona konkretë, prandaj është në kundërshtim me natyrën dhe qëllimin e sigurimit, me interesin e palëve, që ajo të jetë në qarkullim të lirë. Për këtë arsye, polica e sigurimit në emër të prurësit është përjashtuar nga sigurimi i jetës. Po për këto arsye, nuk është e lejuar as bartja e policës sipas urdhrit blanko me indosament (par. 3 i këtij neni).

Kalimi i policës së sigurimit të jetës.- Polica e sigurimit të jetës mund të jetë sipas emrit ose sipas urdhrit. Nga kjo varet edhe forma e kalimit. Policat sipas emrit kalojnë (barten) me sesionin juridiko-civil, kurse policat sipas urdhrit me indosament. Lidhur me formën dhe performancën e indosamentit, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e së drejtës së kambialit. Indosament është deklarata e personit të siguruar, me të cilën ai të drejtat e veta nga polica ia kalon një personi tjetër. Policën e indosueme personi i autorizuar ia dorëzon shfrytëzuesit të ri, në mënyrë që t'ia mundësojë realizimin e të drejtës që rrjedh nga polica. Polica mund të kalohet deri në momentin e paraqitjes së rastit. Me mundësinë e kalimit të policës së sigurimit të jetës mund të realizohen efekte të ndryshme ekonomike, p.sh., me indosament polica mund të lihet peng (shih nenin 977 të LMD), me policë mund të realizohet e drejta e fitimit të huas etj.

3. Kushtet për vlefshmërinë e indosamentit.- Për vlefshmërinë e indosamentit të policës sipas urdhrit, ai duhet të përmbajë: a) emrin e shfrytëzuesit, b) datën e indosimit dhe c) nënshkrimin e indosantit. Kushti që indosamenti të ketë nënshkrimin e indosantit e pamundëson kalimin e policës së sigurimit në mënyrë të rregullt juridike me indosament blanko. Kur në policën e sigurimit nuk është shënuar se me urdhrin e kujt është caktuar shfrytëzuesi, konsiderohet se është caktuar sipas urdhrit të kontraktuesit të sigurimit, përkatësisht të të siguruarit, nëse ai është përmend në policë përkrah siguresit. Te kalimi i policës te personi tjetër përbën një çështje të rëndësishme mundësia e kundërshtimit të siguresit ndaj atij personi. Edhe në rrethin e marrëdhënieve që dalin nga ky sigurim vlen rregulla se siguresi mund t'ia parashtrojë indosatarit (shfrytëzuesit të indosamentit) të gjitha kundërshtimet që dalin nga kontrata e lidhur, të cilat mund t'ia parashtrojë personit me të cilin ka lidhur kontratën, domethënë jo vetëm kundërshtimet të cilat rrjedhin nga polica, por edhe ato nga kontrata konkrete në përgjithësi. Lidhur me kalimin e policës së sigurimit lind edhe pyetja nëse polica e sigurimit është ose jo letër me vlerë? Kjo policë, sipas kuptimeve juridike, është më e afërt me cilësitë e letrës me vlerë, sesa polica te sigurimet e pasurisë, megjithatë as polica e sigurimit të jetës nuk është letër me vlerë. Këtë veçori e dëshmon edhe fakti se ajo është e kalueshme dhe se shumica e siguar është caktuar në mënyrë fikse dhe është relevante për palët kontraktuese, pavarësisht nga rrethanat jashtë dokumentit (interesi, sasia e dëmit). Liria e kalimit të kësaj police ligjërisht është e kufizuar. Ajo nuk mund të jetë në emër të prurësin. Për kalimin e të drejtës mbi shumën e siguar është i nevojshëm pëlqimi me shkrim i kontraktuesve të sigurimit ose i personit të siguar (neni 983 i LMD); kontraktuesi i sigurimit mund ta revokojë dispozitën e policës me të cilën dobia nga sigurimi i caktohet personit të caktuar (neni 980 i LMD); kur kontraktuesi i sigurimit të jetës, që përfshin krejt jetën e të siguruarit, ushtron kërkesë për blerjen e policës, siguresi është i detyruar t'ia paguajë vlerën e riblerë të policës; në këtë mënyrë pushon edhe e drejta e shfrytëzuesit mbi shumën e siguar (neni 975 i LMD). Kundër kërkesës së poseduesit

të letrës me vlerë, dhënësi i saj mund të parashtojë, sipas rregullit, vetëm kundërshtimet të cilat rrjedhin nga letra, derisa te polica e sigurimit, siç kemi vënë re, siguruesi mund të parashtojë edhe kundërshtime jashtë dokumentit. Krejt kjo vërteton saktësinë e përfundimit se polica e sigurimit të jetës nuk i ka të gjitha veçoritë e letrës me vlerë.

Neni 965. Paraqitja e pasaktë e moshës së të siguarit

1. Përrjashtimisht nga dispozitat e përgjithshme të këtij kreu mbi pasojat e paraqitjes të pasakta dhe mbi lënien në heshtje të rrethanave me rëndësi për çmuarjen e rrezikut, për kallëzime të pasakta mbi moshën në kontratat mbi sigurimin e jetës vlejnjë këto rregulla:

1.1. kontrata e sigurimit të jetës është nule dhe siguruesi ka për detyrë që në çdo rast t'i kthejë të gjitha premittë e marra, në qoftë se me rastin e lidhjes së saj është kallëzuar në mënyrë të pasaktë mosha e të siguarit, ndërsa mosha faktike e tij kalon kufirin e moshës deri ku siguruesi sipas kushteve të veta dhe tarifave bën sigurimin e jetës;

1.2. në qoftë se është paraqitur në mënyrë jo të saktë se i siguruari ka më pak vjet, ndërsa mosha faktike e tij nuk e kalon kufirin deri ku siguruesi bën sigurimin e jetës, kontrata është e vlefshme, ndërsa shuma e siguar zvogëlohet në përpjesëtim me preminë e kontraktuar dhe me premittë e parashikuara për sigurimin e jetës së personave të moshës së personit të siguar;

1.3. kur i siguruari ka më pak vjet nga sa është paraqitur me rastin e lidhjes së kontratës, premia zvogëlohet në shumën përkatëse, ndërsa siguruesi ka për detyrë ta kthejë diferencën midis premive të marra dhe premive në të cilat ka të drejtë.

Vështrim i përgjithshëm.- Mosha e të siguarit si rrethanë e rëndësishme me rastin e lidhjes së kontratës. Me rastin e lidhjes së secilës kontratë të sigurimit, pra edhe të kontratës së sigurimit të personave, kontraktuesi është i detyruar ta njoftojë plotësisht dhe saktësisht siguruesin për rrethanat e rëndësishme, (shih komentin e nenit 928 të LMD). Të rëndësishme janë ato rrethana që mund të ndikojnë dukshëm në marrjen e vendimit për lidhjen e kontratës dhe kushteve të sigurimit ose mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e peshës së rrezikut. Në të drejtën e sigurimit janë parashikuar pasojat juridike në rast të lënies pas dore të këtij detyrimi, (shih komentin e neneve 929 e 930 të LMD). Në sistemet krahasuese juridike, heshtja e rrethanave të rëndësishme merret si arsye për anulimin e kontratës së sigurimit. P.sh. Ligji gjerman për Sigurimin – VVG (neni 16), Ligji austriak për Sigurimin – Vers VG (neni 16), Ligji francez për Sigurimin – Code des assurances (neni L.172-2), Kodi Civil italian (neni 1892), zviceran ABVT rregullat (r. 17), anglez Marine Insurance Act (neni 17).

Rregullat e përgjithshme për detyrimin e lajmërimit të rrethanave të rëndësishme dhe për pasojat juridike të heshtjes së këtij detyrimi vlejnjë edhe për sigurimin e jetës. Veçoritë e këtij sigurimi, megjithatë, kanë kërkuar që detyrimi i lajmërimit të rrethanave të rëndësishme

të rregullohet me dispozita plotësuese të veçanta. Te këto sigurime, si rrethanë veçanërisht e rëndësishme me rastin e lidhjes së kontratës paraqitet mosha e personit të siguruar. Kjo rrethanë mund të jetë e rëndësishme për marrjen e vendimit mbi lidhjen e kontratës nga ana e siguruesit ose për vlerësimin e masës së rrezikut. Kushteve dhe tarifave të parashikuara të siguruesit u janë përcaktuar kufijtë e moshës, në kuadër të të cilave siguruesi është i gatshëm për të lidhur kontratën. Përveç kësaj, nga mosha e personit të siguruar varet rreziku i mbulimit dhe kjo rrethanë ndikon në shumën e premisë. Për këtë arsye, rregullat e veçanta kanë të bëjnë vetëm me paraqitjen jo të saktë të moshës në kontratat e sigurimit të jetës. Për të gjitha çështjet e tjera lidhur me lajmërimin e rrethanave të rëndësishme, vlejnë rregullat e përgjithshme. E rëndësishme është për t'u theksuar se zbatimi i rregullave të veçanta nuk varet nga shkalla e fajësisë së kontraktuesit të sigurimit, domethënë nëse ato janë heshtur me qëllim apo pa të, gjë që varet te zbatimi i rregullave të përgjithshme. Përrjashtimisht nga rregullat e përgjithshme, për pasojat e lajmërimeve jo të sakta ose heshtjes së rrethanave të rëndësishme, me këtë dispozitë janë nxjerrë rregulla të veçanta për lajmërimin jo të saktë të moshës te sigurimi i jetës (neni 965 i LMD).

1. Pasojat juridike të paraqitjes së pasaktë të moshës së të siguruarit.- Ligji rregullon tri rrethana të mundshme në rast të paraqitjes së pasaktë: a) mosha faktike e të siguruarit kalon kufirin e moshës së parashikuar, të kushteve dhe tarifave të siguruesit, b) mosha faktike e të siguruarit nuk kalon kufirin e parashikuar për sigurimin e jetës dhe është lajmëruar një moshë më e vogël sesa mosha faktike, c) i siguruari ka më pak vjet nga sa është paraqitur.

1.1. Nëse me rastin e lidhjes së kontratës është lajmëruar jo saktësisht mosha e të siguruarit, kurse mosha faktike kalon kufirin e moshës së parashikuar të kushteve dhe tarifave të siguruesit, kontrata e sigurimit është nule dhe siguruesi ka detyrimin që në çdo rast t'i kthejë të gjitha premitë e marra. Pavlefshmëria e kontratës paraqitet në bazë të vetë ligjit. Me këtë rast është e parëndësishme nëse i siguruari ka vepruar me ndërgjegje ose jo me rastin e lidhjes së kontratës. Sipas rregullave të përgjithshme, në atë rast siguruesi do të kishte të drejtë që ta ndalte preminë e paguar. Në këtë rast është parashikuar përjashtimi nga rregulla e përgjithshme, për shkak të elementit të theksuar të kursimit te sigurimi i jetës. Pavlefshmëria e kontratës e liron edhe siguruesin nga detyrimi i pagesës së shumës së siguruar, prandaj parashikimi i detyrës së kthimit të premisë mund të arsyetohet me faktin që siguruesi më nuk është i detyruar as atëherë kur ndodh rasti i sigurimit. Zbatimi i dispozitave të këtij neni nuk e përjashton të drejtën e siguruesit që, eventualisht, të kërkojë shpërblimin e dëmit, të cilin e ka pësuar për shkak të paraqitjes së pasaktë të moshës së të siguruarit.

1.2. Nëse është paraqitur se i siguruari ka më pak vjet sesa ka realisht, ndërsa mosha faktike e tij nuk e kalon kufirin e parashikuar në kushtet dhe tarifave të siguruesit për sigurimin e jetës, kontrata është e vlefshme dhe vetëm përshtatet shuma e siguruar me moshën faktike të personit të siguruar. Shuma e siguruar zvogëlohet në përpjesëtim me preminë e kontraktuar dhe me premitë e parashikuara për sigurimin e jetës së personave të moshës së personit të siguruar. Në këtë situatë, merret parasysh interesi i palëve për mbajtjen në fuqi të kontratës, prandaj siguruesit nuk i jepet e drejta e kërkesës për zgjidhjen e kontratës për

shkak të heshtjes së të siguarit. Ulja proporcionale e shumës së siguar mund të ndodhë përpara ose pas paraqitjes së rastit të siguar.

1.3. Nëse është lajmëruar se i siguari ka moshë më të madhe sesa ka realisht, premia zvogëlohet në shumën përkatëse, kurse siguruesi ka detyrimin ta kthejë diferencën midis premive të marra dhe premive për të cilat ka të drejtë, duke i marrë parasysh vitet faktike të jetës së të siguarit. Kontrata mbetet e vlefshme. Palët, në vend të zbritjes së premisë, mund të kontraktjnë rritjen e shumës së siguar në përpjesëtim me preminë e paguar, që pa dyshim do të ishte në interes të të siguarit (neni 921 par. 2 i LMD).

Neni 966. Pasojat e mospagimit të premisë dhe zvogëlimi i shumës së siguar

- 1. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit të jetës nuk paguan ndonjë premi kur rrjedh për pagesë, siguruesi nuk ka të drejtë që pagimin e saj të kërkojë në rrugë gjyqësore.**
- 2. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit me ftesën e siguruesit, e cila i duhet dorëzuar me letër të porositur, nuk e paguan preminë e arritur për pagesë brenda afatit të caktuar në këtë letër, e që nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) muaj, duke llogaritur që nga dita kur i është dorëzuar letra, dhe as që e bën këtë ndonjë person tjetër i interesuar, siguruesi mundet vetëm, në qoftë se gjer atëherë janë paguar të paktën tri (3) premitë vjetore t'i deklarojë kontraktuesit të sigurimit se e zvogëlon shumën e siguar në shumën e vlerës riblerëse të sigurimit, e në rastin e kundërt se e zgjidh kontratën.**
- 3. Në qoftë se rasti i siguar ka ndodhur përpara zgjidhjes së kontratës ose zvogëlimit të shumës së siguar, konsiderohet sikundër të jetë zvogëluar shuma e siguar, respektivisht sikur kontrata të jetë zgjidhur, varësisht nga fakti nëse premitë janë paguar të paktën për tri (3) vjet ose jo.**

1. Pagesa e premisë nuk mund të realizohet përmes gjykatës.- Sipas dispozitës së nenit 934 par. 5 të këtij Ligji, rregullat themelore për pasojat juridike të mospagimit të premisë nuk zbatohen te sigurimi i jetës. Ligjvënësi ka vlerësuar në mënyrë të qartë se rregullat e përgjithshme nuk korrespondojnë me këto sigurime, për shkak të natyrës së tyre specifike juridike dhe praktikave specifike të biznesit dhe se kjo çështje duhet zgjidhur me rregulla të veçanta në kuadër të kapitullit të sigurimit të personave. Sa i përket sigurimit të jetës, këto rregulla të veçanta janë të parashikuara në dispozitën e nenit 966 të LMD. Rregullat e veçanta dallojnë rrënjësisht nga ato të përgjithshme, për shkak se ndalojnë pagesën e premisë së sigurimit përmes gjykatës. Pra është theksuar shprehimisht se siguruesi nuk ka të drejtë që preminë e sigurimit, e cila nuk është paguar apo është vonuar për pagesë, ta kërkojë në rrugë gjyqësore. Arsyeja themelore për një trajtim të tillë përjashtues të këtij sigurimi shihet në faktin se sigurimi i jetës është në funksion të kursimit, i cili mbështetet në vullnetarizëm. Mospagimi i premisë e dëmton vetë të siguarin. Kjo zgjidhje është miratuar edhe në sistemet krahasuese juridike (p.sh. Codes des assurances – neni 132-20).

Kjo nuk do të thotë se mospagimi i premisë nuk shkakton kurrfarë pasojash juridike, por zbatohen vetëm ato që janë parashikuar (shih par. 2 të këtij neni).

2. Pasojat juridike të mospagesës së premisë.- Te sigurimi i jetës nuk zbatohen rregullat e përgjithshme për pasojat e mospagesës së premisë së sigurimit, por rregullat e veçanta të parashikuara në paragrafët 2 e 3 të këtij neni. Fillimisht është e nevojshme të shihen veçoritë e këtij sigurimi, që shprehen edhe në lidhje me pasojat juridike të mospagesës së premisë. Te ky sigurim, kompania e sigurimit, nga mjetet e primeve të mbledhura, është e detyruar t'i kalkulojë matematikisht ato nëse kanë karakteristika të kursimit. Këto mjete mbahen në llogari të veçantë. Ato nuk mund të përdoren dhe mbi to nuk mund të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm për mbulimin e detyrimeve të cilat nuk rrjedhin nga sigurimi i jetës. Që të mund të realizohet funksioni ligjor i këtyre mjeteve, është e nevojshme mbledhja e mjeteve në shumën përkatëse. Është qëndrim i ligjvënësit tonë se tri premi vjetore përbëjnë vlerën minimale e cila siguron të drejtën mbi këto mjete, prandaj pasojat juridike për mospagesën e premisë varen nga ajo nëse janë paguar ose jo tri premi vjetore. Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet që siguruksi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën për shkak të mospagesës së premisë, vetëm kur kontraktuesi nuk ka paguar të paktën tri premi vjetore të sigurimit. Në rast të vonesës në pagimin e premisë, siguruksi duhet me letër të porositur (rekomandë) ta ftojë kontraktuesin e sigurimit ta bëjë pagesën e premisë së arritur në afatin e caktuar në këtë letër. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj, duke llogaritur nga dita kur i është dorëzuar letra. Nëse në këtë afat kontraktuesi i sigurimit nuk e paguan preminë e arritur për pagesë, e këtë nuk e bën as ndonjë person tjetër i interesuar dhe gjer atëherë nuk janë paguar tri premi vjetore, siguruksi mund t'i deklarojë kontraktuesit të sigurimit se e zgjidh kontratën. Nëse gjer atëherë janë paguat tri premi vjetore, siguruksi mundet vetëm t'i deklarojë kontraktuesit të sigurimit se e ul shumën e siguruar në shumën e vlerës riblerëse të policës së sigurimit. Në kushtet e sigurimit mund të parashihet që kapitalizmi të shfaqet automatikisht. Pasojat e mospagesës së premisë, të parashikuara në këtë paragraf, nuk kanë të bëjnë, sipas natyrës së çështjes, me sigurimin nga pasojat e fatkeqësisë.

3. Pasojat juridike në rast të lindjes së rasti të siguar.- Të drejtat e parashikuara në paragrafin paraprak të këtij neni siguruksi mund t'i shfrytëzojë deri në momentin e shkakimit të rasti të siguar. Nëse rasti i siguar ka ndodhur përpara zgjidhjes së kontratës ose para zvogëlimit të shumës së siguar, do të konsiderohet se shuma e siguar është zvogëluar ose sikur kontrata të jetë zgjidhur, varësisht nga fakti se a janë paguar premitë të paktën për tri (3) vjet ose jo.

Neni 967. Sigurimi i personit të tretë

- 1. Sigurimi i jetës mund të shtrihet në jetën e kontraktuesit të sigurimit, por mund të shtrihet edhe në jetën e ndonjë personi të tretë.**
- 2. E njëjta gjë vlen edhe për sigurimin kundër rastit të fatkeqësisë.**
- 3. Në qoftë se sigurimi shtrihet në rastin e vdekjes së ndonjë të treti, për vlefshmërinë e kontratës nevojitet pëlqimi i dhënë me shkrim prej tij i shënuar në policë ose në dokumentin e veçantë, në rastin e nënshkrimit të policës duke shënuar shumën e siguruar.**

1. Sigurimi i personit të tretë.- Te sigurimi i personave është pranuar në përgjithësi që sigurimi i jetës mund të lidhet jo vetëm për jetën e kontraktuesit të sigurimit por edhe jetën e ndonjë personi të tretë. Personi i tretë është i ndryshëm nga kontraktuesi i sigurimit. Në policën e sigurimit duhet të përmendet personi me jetën e të cilit ka të bëjë sigurimi, prandaj personi i tretë përcaktohet nga polica e sigurimit, (shih komentin e dispozitës së nenit 964 par. 1 i LMD). Gjatë historisë, ky sigurim ka qenë i kufizuar ose i ndaluar për shkak të mundësisë së shkaktimit të qëllimshëm të rastit të siguruar me synime përfitim. Në konceptin bashkëkohor të këtij sigurimi, ky rrezik është shmangur duke kërkuar pëlqimin e personit të tretë për përfundimin e sigurimit. Ai nuk është në kundërshtim as me parimet themelore të sigurimit, sepse te sigurimi i personave në sistemin tonë juridik nuk kërkohej që kontraktuesi i sigurimit të ketë interes të arsyeshëm ekonomik për lidhjen e kontratës.

2. Edhe sigurimi kundër rastit të fatkeqësisë mund të shtrihet jo vetëm ndaj kontraktuesit të sigurimit, por edhe ndaj ndonjë personi të tretë. Dispozita e paragrafit 2 të këtij neni heq çdo dykuptimësi edhe lidhur me këtë sigurim, pasi që edhe ky sigurim është parashikuar shprehimisht në këtë paragraf.

3. Pëlqimi i personit të tretë, si kusht për vlefshmërinë e kontratës. Nëse kontraktohet sigurimi i jetës së personit të tretë, në rast të vdekjes së tij, kontrata është e vlefshme vetëm nëse ai person e ka dhënë pëlqimin për këtë sigurim. Kjo rregull është miratuar edhe në sistemet krahasuese juridike (gjerman VVG-par. 159, italian CC - neni 1919, austriak Vers VG-par. 159, francez neni 132-2). Lidhur me pëlqimin paraqiten dy çështje: mënyra e pëlqimit dhe koha e dhënies së pëlqimit. Për pëlqimin është parashikuar forma e shkruar. Dhënia e pëlqimit me gojë ose premtimi i një pëlqimi të tillë nuk është i mjaftueshëm. Pëlqimi me shkrim mund të shprehet përmes policës së sigurimit ose përmes një dokumenti të veçantë. Pëlqimi duhet të përmbajë shënimin e shumës së siguruar. Sa i përket kohës së dhënies së pëlqimit, ai duhet të jepet “me rastin e nënshkrimit të policës së sigurimit”, domethënë, në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit. Në zbatimin e ligjit tonë, pëlqimi i më vonshëm, qoftë edhe ai i dhënë edhe në formë të shkruar, nuk është juridikisht i vlefshëm. Pasojat juridike të mungesës së pëlqimit të vlefshëm në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit shprehen në Pavlefshmërinë e kontratës. Kontrata nuk prodhon efekt juridik, sikur të mos ishte lidhur fare (**ex tunc**). Lidhur me Pavlefshmërinë e saj, gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Neni 968. Sigurimi në rastin e vdekjes së personit të mitur dhe personit me aftësi të kufizuar për të vepruar

1. Është i pavlefshëm sigurimi për rastin e vdekjes së personit të tretë me moshë nën katërbëdhjetë (14) vjeç si dhe i personave të paaftë për të vepruar, kështu që siguruesi ka për detyrë t'i kthejë kontraktuesit të sigurimit të gjitha premittë e marra në bazë të kontratës së këtillë.
2. Për vlefshmërinë e sigurimit për rastin e vdekjes së personit të tretë më të vjetër se katërbëdhjetë (14) vjeç nevojitet pëlqimi me shkrim i përfaqësuesit të tij ligjor si dhe pëlqimi me shkrim i çdo personi të siguruar.

1. Pavlefshmëria e kontratës.- Me dispozitën e paragrafit 1 të këtij neni përjashtohet mundësia e sigurimit të jetës për rastin e vdekjes për: a) personin më të ri se katërbëdhjetë vjeç, b) personin plotësisht të privuar nga zotësia e veprimit. Kontrata e lidhur me këta persona juridikisht është nule. Konsiderohet sikur kontrata të mos jetë lidhur fare. Arsytet e Pavlefshmërisë së këtyre kontratave rrjedhin nga paaftësia e veprimit të këtyre personave, prandaj, me anulimin e kontratës së sigurimit, mbrohen parimet themelore të rendit juridik dhe normat morale të shoqërisë. Këta persona nuk kanë aftësi për të vepruar në mënyrë që, me shprehjen e vullnetit të tyre personal, të fitojnë të drejta dhe detyrime, prandaj kjo vlen edhe për dhënien e pëlqimit për sigurimin e lidhur. Pa pëlqimin e personit të siguruar, janë të mundura keqpërdorimet e sigurimit, prandaj është logjike që këta persona janë përjashtuar nga mundësia që jeta e tyre, për rastin e vdekjes, të jetë e siguruar nga ana e ndonjë personi tjetër. Aq më tepër që është fjala për persona të mitur ose personat me paaftësi plotë veprimi. Këta persona, edhe sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve, nuk e kanë zotësinë e veprimit (neni 41 i LMD). Pëlqimin për lidhjen e kontratës së sigurimit me ndikim të përshtatshëm nuk mund ta japin as përfaqësuesit ligjorë, as kujdestarët e këtyre personave. Ajo është e natyrës rreptësisht personale dhe këtu nuk vlejnë rregullat e përgjithshme (neni 41 i LMD). Nëse do të ndodhte lidhja e një kontrate të tillë, Pavlefshmëria e saj lind **ex lege**, kurse siguruesi është i detyruar që kontraktuesit të sigurimit t'ia kthejë të gjitha premittë e arkëtuara në bazë të kësaj kontrate. Përjashtimi i parashikuar në këtë dispozitë ka të bëjë vetëm me sigurimin e jetës për rastin e vdekjes së personit të tretë, që do të thotë se format e tjera të sigurimit të personave do të ishin juridikisht të vlefshme, pavarësisht nëse personat e siguruar janë të mitur ose persona me paaftësi të plotë të veprimit.

2. Sigurimi i jetës së personit me aftësi të kufizuar të veprimit.- Arsytet të cilat ekzistojnë në përjashtimin nga sigurimi i jetës të personave të tretë për rastin e vdekjes së të miturit ose personit me paaftësi të plotë të veprimit nuk ekzistojnë kur bëhet fjalë për personin me aftësi të kufizuar të veprimit (i mituri që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç). Këta persona, edhe sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve, mund të lidhin në shkallë të kufizuar punë të vlefshme juridike. Prandaj, për këta persona është parashikuar një rregull e veçantë në paragrafin 2 të këtij neni. Për vlefshmërinë juridike të sigurimit të jetës për rastin e vdekjes të personave të tretë

më të vjetër se katërmbëdhjetë vjeç, kërkohet: a) pëlqimi me shkrim i përfaqësuesit të tij ligjor, b) pëlqimi me shkrim i personit të siguruar. Konsiderohet se dispozitat ligjore për sigurimin e jetës së personave të tretë kanë të bëjnë vetëm me sigurimin e jetës për rastin e vdekjes, por jo edhe për sigurimin nga pasojat e rastit të fatkeqësisë, siç do të mund të përfundohej pas një interpretimi gramatikor të dispozitave ligjore.

Neni 969. Kumulimi i shpërblimit dhe i shumës së siguruar

- 1. Në sigurimin e personave, siguruesi që ka paguar shumën e siguruar nuk mund të ketë në asnjë bazë të drejtë në shpërblim nga personi i tretë përgjegjës për shkaktimin e rastit të siguruar.**
- 2. E drejta në shpërblim nga personi i tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të siguruar i takon siguruesit respektivisht shfrytëzuesit, pavarësisht nga e drejta e tij në shumën e siguruar.**
- 3. Dispozitat e paragrafëve paraprake nuk shtrihen në rastin, kur sigurimi kundër pasojave të rastit të fatkeqësisë është kontraktuar si sigurim kundër përgjegjësisë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me lidhjen e kontratës së sigurimit nuk pushon marrëdhënia juridike-detyruese e përgjegjësisë së personave të tretë për dëmin. Personat e tretë i ngarkon detyrimi i riparimit të dëmit, pavarësisht nga ajo se i dëmtuari (i siguruari) e ka realizuar shpërblimin nga sigurimi. Përndryshe, personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit do të përfitonte padrejtësisht. Për këtë arsye, personi i dëmtuar (kreditori nga marrëdhënia juridike-detyruese e përgjegjësisë për dëmin) ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga dy raporte juridike të pavarura dhe të veçuara nga njëra-tjetra: kontrata e sigurimit dhe marrëdhënia juridike-detyruese e përgjegjësisë për dëmin. Pasoja juridike të kësaj situate juridike janë të ndryshme, varësisht fakti se kontrata e sigurimit është e natyrës juridike kompensuese apo jo. Te sigurimet kompensuese (sigurimet e pasurisë) i dëmtuari nuk mund të realizojë shpërblim më të madh nga vlera e dëmit të pësuar; është zbatim i parimeve të përgjithshme të rendit juridik. Është e parëndësishme me atë rast nëse ai e ka realizuar shpërblimin nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit ose nga kontrata e sigurimit. Të dëmtuarit me këtë rast i takon e drejta të zgjedhë se prej cilit do të kërkojë shpërblimin e dëmit. Nëse realizon shpërblimin nga sigurimi, humb të drejtën e kërkesës së dëmit nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit. Dhe, anasjelltas, nëse realizon shpërblimin e tërësishëm nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit, nuk mund ta realizojë edhe një shpërblim nga sigurimi. Me këtë i dëmtuari nuk e humb të drejtën që të kërkojë nga dëmtuesi shpërblimin e atyre shumave të dëmit të pësuar për të cilat nuk e ka realizuar dëmin nga sigurimi (franshizën, nënsigurimin, rrezikun e pasiguar etj.). Zbatimi i këtyre parimeve te sigurimet e pasurisë sigurohet me anë të institutit të subrogimit të siguruesit dhe ndalimin e kumulimit të shpërblimit nga sigurimi dhe marrëdhënia juridike e përgjegjësisë për dëmin (shih komentin e nenit 960 të LMD). Ky parim nuk zbatohet te sigurimi i personave. Me fjalë të tjera, te ky sigurim nuk ndalohet kumulimi i shpërblimit.

Sigurimi i personave nuk ka karakteristika të zhdëmtimit, prandaj personi i dëmtuar (i siguruari) mund ta realizojë shpërblimin mbi të dy bazat juridike: nga siguruasi dhe nga dëmtuesi, që do të thotë se mund t'i kumulojë (t'i grumbullojë) që të dy këto shpërblime dhe të arkëtojë edhe më shumë se vlera e dëmit të pësuar. Ky parim të sigurimi i jetës zbatohet plotësisht, kurse të sigurimi nga rasti i fatkeqësisë, pjesërisht. Me dispozitat e këtij neni rregullohet çështja e së drejtës së kumulimit (grumbullimit) të shpërblimit të sigurimi i personave (neni 969 i LMD).

1. Ndalimi i të drejtës së subrogimit të siguruasit.- Siguruasi të sigurimi i personave, pasi ta ketë paguar shumën e siguruar, nuk ka të drejtën të kërkojë mbi asnjë bazë shpërblimin e paguar nga personi i tretë përgjegjës për shkaktimin e rastit të siguruar. Në këtë rregull është përfshirë sigurimi i jetës. E drejta e shpërblimit nga personi i tretë përgjegjës i takon vetëm të siguarit - shfrytëzuesit, pavarësisht nga e drejta e tij për shumën e siguruar. Arsyetja për mohimin e të drejtës së siguruasit për subrogim mbështetet në bindjen se, me pagimin e shpërblimit nga sigurimi, personit të dëmtuar (të siguarit) nuk i është shpërblyer i tërë dëmi, sepse ai, duke marrë parasysh se është fjala për jetën e njeriut, ekonomikisht është i pavlerësuar (nuk mund të vlerësohet). Nëse siguruasi do t'i lejohej e drejta e subrogimit, dëmtuesi do të detyrohej të paguajë dy herë: personit të dëmtuar dhe siguruasit, gjë që gjithashtu do të ishte në kundërshtim me themelet e rendit juridik. Në këtë parim është përfshirë vetëm shumën e siguruar, por jo edhe harxhimet reale të të siguarit për disa shpenzime, p.sh., për shpenzimet spitalore. Sigurimi i këtyre shpenzimeve ka veçoritë e sigurimit zhdëmtues dhe shpërblimi për këto shpenzime mund të realizohet vetëm një herë.

2. E drejta e kumulimit të shpërblimit.- Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet parimi themelor i të drejtës së sigurimit të personave, i cili do të thotë përjashtim nga ndalesa e të drejtës së kumulimit: e drejta e shpërblimit nga personi i tretë përgjegjës për shkaktimin e rastit të siguruar i takon të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit, pavarësisht nga e drejta e tij për shumën e siguruar. Me arsye përmenden i siguruari dhe shfrytëzuesi i sigurimit, sepse këta mund të jenë persona të ndryshëm. E drejta e kumulimit të shpërblimit arsyetohet me këto shkaqe: a) i siguruari nuk e realizon dy herë shpërblimin për dëmin e njëjtë, sepse shumën e siguruar të ky sigurim nuk ka veçori të shpërblimit të dëmit, por pagimin e shumës së kontraktuar të të hollave kur shkaktohet rasti i siguruar, b) me realizimin e shpërblimit nga sigurimi, të drejtat e personit të dëmtuar nga marrëdhënia juridike-detyruese e përgjegjësisë ngel e paprekur, sepse përndryshe sigurimi i personave do të ishte në funksion të sigurimit nga përgjegjësia e dëmtuesit.

3. Përjashtimi nga e drejta e kumulimit të shpërblimit.- Në paragrafin e 3 të këtij neni është parashikuar përjashtimi nga e drejta e kumulimit të shpërblimit të sigurimi i personave. Ajo ka të bëjë me rastet kur sigurimi nga pasojat e rastit të fatkeqësisë është kontraktuar si sigurim kundër përgjegjësisë. Kësi rasti ekziston kur një person siguron përgjegjësinë e vet për cenimin e integritetit trupor të personit të tretë. Në rastin klasik, punëdhënësi e siguron përgjegjësinë e vet ndaj punonjësve për rastin e vdekjes dhe invaliditetit për shkak të rastit të fatkeqësisë. Pala e tretë nuk ka të drejtën e kumulimit të shpërblimit nga siguruasi dhe shkaktari i aksidentit (të siguarit nga marrëdhënia e sigurimit të përgjegjësisë).

-Në të kundërtën sigurimi nga përgjegjësia kishte me qenë i pakuptimtë. Interesi për sigurimin nga përgjegjësia mu nisët nga mundësia që i siguruari përgjigjet për cenimin e integritetit trupor të personit të tretë p.sh. të punësuarit. Përveç kësaj, sigurimi nga përgjegjësia është sigurim pronësor për të cilin vlen ndalesa e kumulimit të të drejtave. Ligji me arsye i jep përparësi kontratës së sigurimit, sepse nuk mund të thuhet se ajo është e dëmshme për të dëmtuarin vetëm për shkakun se i bën të pamundur realizimin e shpërblimit të dyfishtë.

NËNKREU 2 RREZIQET E PËRJASHTUARA

Neni 970. Vetëvrasja e të siguruarit

- 1. Me kontratën e sigurimit për rastin e vdekjes nuk është përfshirë rreziku i vetëvrasjes të të siguruarit, në qoftë se ka ndodhur në vitin e parë të sigurimit.**
- 2. Në rastin kur vetëvrasja ka ndodhur brenda tre (3) vjetësh nga data e lidhjes së kontratës, siguruari nuk ka për detyrë t'i paguajë shfrytëzuesit shumën e siguruar, por vetëm rezervën matematikore të kontratës.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në pjesën XXIV, kreu 3, nënkreu 2, janë parashikuar rreziqet e përjashtuara nga sigurimi i personave. Përjashtimet ose kufizimet e mbulimit të sigurimit të personave mund të jenë: a) të rregulluara me ligj dhe b) të kontraktuara. LMD përmban këto përjashtime nga mbulimi: rreziku i vetëvrasjes së të siguruarit (neni 970), vrasja me dashje e të siguruarit (neni 971), shkaktimi me dashje i rastit të fatkeqësisë (neni 972) dhe operacionet e luftës (neni 973). Me kontratën e sigurimit për rastin e vdekjes ose rastin e fatkeqësisë mund të përjashtohen nga sigurimi edhe rreziqet e tjera (neni 974). Kjo liri ligjore në përjashtimin e disa rreziqeve nga sigurimi mundëson që, me dispozita kontraktuese ose kushte të sigurimit, të parashikohen edhe rreziqe të tjera të përjashtuara, gjë që po veprohet në praktikë.

Kuptimi i vetëvrasjes.- Vetëvrasja është definuar si akt i njeriut, i cili, me vullnetin e lirë, vendos të privohet nga jeta. Qëllimi është elementi thelbësor i vetëvrasjes nga aspekti i sigurimit. Arsyet për të cilat ky rrezik është përjashtuar nga sigurimi janë evidente: a) në përgjithësi vetëvrasja konsiderohet si akt në kundërshtim me rendin juridik, shoqërisht i dëmshëm dhe në kundërshtim me moralin e normave shoqërore, b) dëmet e shkaktuara me dashje në përgjithësi nuk janë të mbuluara me sigurim, sepse nuk janë të përfshira në kuptimin e rrezikut (neni 918 i LMD). Përjashtimi i këtij rreziku nga sigurimi është i kufizuar në kohë. Pas kalimit të kohës prej tri vjetësh nga data e lidhjes së kontratës, rreziku i vetëvrasjes është rrezik i mbuluar me sigurim. Në disa sisteme juridike (franceze, gjermane) bëhet dallimi mes vetëvrasjes me vetëdije dhe pa vetëdije. Në sistemin juridik francez vetëvrasje, p.sh., nuk është kur vdekja vjen si pasojë e pakujdesisë, vetëflijimit,

shmangies nga mjekimi etj. Te ne nuk bëhet ky dallim. Për të gjitha format e vetëvrasjes vlen e njëjta rregull. E vetmja rrethanë relevante është koha e kaluar nga dita e lidhjes së kontratës. Varësisht nga gjatësia e kohës së kaluar, dëmi është ose tërësisht i përjashtuar nga sigurimi, ose me të drejta të pjesshme nga sigurimi, ose me të drejta të plota nga sigurimi.

1. Përjashtimi i tërësishëm nga sigurimi.- Në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, në kontratën e sigurimit për rastin e vdekjes nuk është përfshirë rreziku i vetëvrasjes, nëse ajo ndodh në vitin e parë të sigurimit. Në atë rast siguruasi nuk është i detyruar të paguajë kurrfarë shpërblimi dhe as rezervat e mbledhura matematikore. Afati prej një viti është ajo kohë minimale në të cilën do të duhej të shprehej marrëdhënia psikike vullnetare e personit të siguruar ndaj një akti të tillë dhe qëllimit të tij eventual që, me vetëvrasje, të tentojë që dikujt t’ia mundësojë një fitim. Merret se mjetet e grumbulluara nga rezerva matematikore në vitin e parë janë të vogla dhe se nuk janë relevante për detyrimin e siguruasit.

2. Pagesa vetëm e rezervës matematikore.- Veçoria e këtij sigurimi është se ekziston sistemi i parashikuar ligjor i formësimit dhe ruajtjes së mjeteve të rezervës matematikore. Kjo rrethanë ndikon edhe në detyrimin e siguruasit, në rast të vetëvrasjes së të siguruarit. Ligji në këtë drejtim dallon të drejtën e shumës së siguruar nga e drejta e rezervës matematikore. Shuma e siguruar i nënshtrohet rregullës së përjashtimit nga sigurimi, derisa detyrimi i pagesës së rezervës matematikore varet nga numri i viteve të kumulimit, duke marrë parasysh se duhet një kohë e caktuar për t’u grumbulluar mjete në një shumë relative. Për këtë qëllim, Ligji parashtron afatin prej tre vjetësh. Nga kjo rrjedh kjo zgjidhje: nëse vetëvrasja ka ndodhur në afat prej tre vjetësh, nga dita e lidhjes së kontratës, siguruasi nuk është i detyruar t’ia paguajë shfrytëzuesit shumën e siguruar, por vetëm rezervën matematikore të kontratës. Kështu, për vetëvrasjen e kryer pas tre vjetësh, nga dita e lidhjes së kontratës, paguhet shuma e plotë e siguruar. Afati prej tre vjetësh mund të shkurtrohet me kontratë, sepse kjo është në interes të të siguruarit (shih komentin e dispozitës së nenit 921 par. 2 të LMD). Në praktikë, siguruasit rregullisht e bëjnë këtë përmes dispozitave të kushteve të tyre të sigurimit, duke shkurtuar afatin në dy vjet, madje edhe në një vit.

Neni 971. Vrasja me dashje e të siguruarit

Siguruasi lirohet nga detyrimi që shfrytëzuesit t’i paguajë shumën e siguruar, në qoftë se ky e ka shkaktuar me dashje vdekjen e të siguruarit, por ka për detyrë në qoftë se deri atëherë janë paguar të paktën tri (3) premi vjetore, të paguajë rezervën matematikore të kontratës kontraktuesit të sigurimit, e në qoftë se ky është i siguruari atëherë trashëgimtarëve të tij.

Vështrim i përgjithshëm.- Vrasja me dashje e të siguruarit nga ana e shfrytëzuesit të sigurimit është një rrezik i cili është në kundërshtim me bazat e rendit juridik dhe normat morale të shoqërisë. Është e kuptueshme që ligji e liron nga detyrimi siguruasin që nga kontrata e sigurimit të jetës t’ia paguajë shfrytëzuesit (vrasësit) shumën e siguruar. Në raport me rezervën

matematikore, njësoj si edhe te vetëvrasja e të siguruarit, për shkak të trajtimit të veçantë të këtyre mjeteve, kontrata prodhon me këtë nen ecurinë e parashikuar. Edhe këtu merret afati minimal prej tre vjetësh për realizimin e të drejtës mbi rezervën matematikore.

a) Kusht për zbatimin e dispozitave të këtij neni është që shfrytëzuesi i sigurimit ta ketë shkaktuar me dashje vdekjen e të siguruarit. Ai mund të jetë kryerës i veprës së vrasjes ose pjesëmarrës në krim. Nuk është e domosdoshme që në procedurë penale të jetë i shpallur fajtor. Me këtë rast, nuk është i rëndësishëm motivi i vrasjes. Tentimi i vrasjes nuk është relevant. Vepra nuk ka nevojë të jetë kryer për realizimin e shpërblimit nga sigurimi dhe as që shfrytëzues është bërë nga shkak se është trashëgimtar ligjor ose në bazë të kontratës. Vrasja me dashje e të siguruarit është përjashtuar nga sigurimi edhe në sistemet juridike krahasuese (fr. Code des ass. – neni L. 132-24; italian CC – neni 1922, gjerman VVG – par. 170, njësoj edhe austriak).

b) Dispozitat e këtij neni zbatohen kështu: kur kontraktuesi i sigurimit është njëkohësisht edhe i siguruar, shfrytëzuesi i cili e ka shkaktuar vdekjen e tij nuk ka kurrfarë të drejtash nga sigurimi, por trashëgimtarët e të siguruarit kanë të drejtën e rezervës matematikore nga kontrata, me kusht që sigurimi të ketë zgjatur së paku tri vjet; kur kontraktuesi dhe i siguruari janë persona të ndryshëm, ndërsa shfrytëzuesi i sigurimit e privon nga jeta të siguruarin, atëherë rezerva matematikore i takon kontraktuesit të sigurimit, përkatësisht trashëgimtarëve të tij ligjorë (natyrisht, nëse askush prej tyre nuk është kryerës i veprës penale). Nëse ka më shumë shfrytëzues dhe vetëm njëri shfrytëzues është vrasës me dashje, konsiderohet se pjesa e tij e shumës së siguar duhet t'i takojë pasurisë së kontraktuesit të sigurimit (neni 985 i LMD).

Neni 972. Shkaktimi me dashje i rastit të fatkeqësisë

Siguruesi lirohet nga detyrimi i kontratës së sigurimit kundër rastit të fatkeqësisë, në ofhtë se i siguruari e ka shkaktuar me dashje rastin e fatkeqësisë.

Me këtë dispozitë ligjore janë rregulluar pasojat juridike të shkaktimit me dashje të rastit të siguar te sigurimet nga pasojat e fatkeqësisë. Dashja, si shkak i ndodhjes së rastit (ngjarjes) të siguar, është përjashtuar edhe sipas dispozitave të përgjithshme të nenit 941 të këtij Ligji. Kuptimi i kësaj dispozite të veçantë qëndron në atë se ajo ka të bëjë me sigurimet nga pasojat e rastit të fatkeqësisë dhe rregullon rastin kur i siguruari e lëndon vetveten. Derisa në dispozitën e nenit 941 të këtij Ligji janë përfshirë kontraktuesi i sigurimit, i siguruari dhe shfrytëzuesi i sigurimit, në këtë nen përmendet vetëm i siguruari. Mirëpo, nëse kontraktuesi i sigurimit dhe i siguruari janë persona të ndryshëm, kurse kontraktuesi i sigurimit me qëllim e lëndën të siguruarin, kjo nuk e përjashton të drejtën e të siguruarit për shumën e siguar. Duke marrë parasysh se në këtë sigurim nuk ekziston rezerva matematikore, nuk ekziston as dispozita për detyrimin e siguresit lidhur me këto mjete. Kjo dispozitë ligjore është e natyrës juridike-detyruese, prandaj shkaktimi me dashje

i lëndimit nuk është e mundur të mbulohet as me dispozita shprehimore të kontratës. Një dispozitë e tillë kontraktuese do të ishte nule.

Neni 973. Operacionet e luftës

- 1. Në qoftë se vdekja e të siguruarit është shkaktuar nga operacionet e luftës, siguruesi, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, nuk ka për detyrë t'i paguajë shfrytëzuesit të sigurimit shumën e siguruar, por ka për detyrë t'i paguajë rezervën matematikore nga kontrata.**
- 2. Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, siguruesi lirohet nga detyrimi prej kontratës së sigurimit kundër rasti të fatkeqësisë, në qoftë se rasti i fatkeqësisë është shkaktuar nga operacionet e luftës.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me dispozitën e këtij neni nga sigurimi janë përjashtuar pasojat e dëmshme nga operacionet e luftës në integritetin trupor të të siguruarit, njësoj siç është bërë edhe te sigurimi i pasurisë (neni 952 të LMD). Ligji edhe këtu përdor shprehjen *operacione të luftës si rrezik i përjashtuar*. Termi *operacionet e luftës* duhet kuptuar si akt luftarak – ngjarje e shkaktuar nga ana e njëres palë ndërluftuese kundër tjetrës, në kushte të gjendjes së luftës. Në këtë dispozitë nuk flitet për kryengritjet, siç përmenden në dispozitën e nenit 952 të LMD për sigurimin e pasurisë, prandaj termi *operacione luftarake* duhet interpretuar sipas kuptimit të shprehjeve të përdorura dhe jo përgjithësisht në kuptim të rrezikut luftarak (neni 952 i LMD). Sipas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, kushtet e sigurimit vetëm mund ta zbërthejnë kriterin themelor të përjashtimit nga neni 976 të LMD të Kroacisë, domethënë që dëmi duhet të jetë pasojë pikërisht e operacioneve të luftës dhe kryengritjeve; me atë rast “përjashtimi nga përgjegjësia nuk mund të zgjerohet, por mbi siguresin bie barra e provimit se dëmi është shkaktuar nga pasojat e operacioneve të luftës ose kryengritjeve, të cilat mund të shikohen vetëm konkretisht, në një rajon të caktuar, i cili është i përfshirë me këto ngjarje dhe nuk mund të zgjerohen në rajone më të gjëra, në të cilat ngjarje të tilla nuk ka pasur”, (vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë nr. U-III-1006/1998 të dt. 14 qershor 2001., Nar. Nov., nr. 58 të dt. 29 qershor 2001.)⁸⁷⁸.

a) Me kushtet e përgjithshme të sigurimit mund të përpunohen kriteret për lirimin nga përgjegjësia të siguresit për dëmet e shkaktuara me operacione të luftës dhe kryengritjeve, por lirimi nuk mund të zgjerohet në rreziqe të tjera, të cilat nuk konsiderohen operacione të luftës dhe kryengritje⁸⁷⁹.

878 Česić, Gorenc dhe të tjerë – Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb 2005 – faqe 1499,

879 Shih vendimin e Vs, Rev – 3009/2000-2 të dt. 4 shkurt 2004., izbor, 2/2004,

b) Për përjashtimin ligjor nga sigurimi, vdekja duhet të jetë e shkaktuar me operacione të luftës, që do të thotë se duhet të ekzistojë lidhja shkakësore mes operacioneve të luftës dhe vdekjes, përkatësisht lëndimit trupor⁸⁸⁰.

c) Vetëm rrethana se automjeti ka qarkulluar me drita të fikura për shkak të rrezikut nga sulmi i armikut, nuk do të thotë se bëhet fjalë për dëmin e shkaktuar nga operacionet e luftës⁸⁸¹.

1. Sigurimi i jetës.- Te sigurimi i jetës, nëse vdekja e të siguruarit është shkaktuar nga operacionet luftës, siguruari nuk është i detyruar t'ia paguajë shfrytëzuesit të sigurimit shumën e siguruar, por rezervën matematikore nga kontrata. Barra e provimit se vdekja e të siguruarit është shkaktuar nga operacionet luftarake bie mbi siguruarin. Është interesant të theksohet që, lidhur me rezervën matematikore, Ligji nuk parashikon kufizimin kohor prej tre vjetësh, siç bën te rreziku nga vetëvrasja, gjë që do të thotë se rezerva matematikore paguhet pavarësisht nga vitet e mbledhura (neni 970 i LMD). Dispozita mbi përjashtimin e rrezikut nga operacionet luftarake është e natyrës juridike dispozitive, prandaj palët mund të kontraktojnë edhe ndryshe. Është lënë kjo në dispozicion të palëve kontraktuese.

2. Sigurimi i fatkeqësisë.- Te sigurimi nga pasojat e fatkeqësisë, siguruari është i liruar nga detyrimi kontraktues, nëse rasti i fatkeqësisë është shkaktuar nga operacionet e luftës. Si edhe në rastin paraprak, palët mund të kontraktojnë edhe ndryshe. Kjo vë në dukje rëndësinë e kushteve të sigurimit. Në kushtet e sigurimit rregullisht janë parashikuar përjashtimet dhe kufizimet nga sigurimi, nëse vdekja ose rasti i fatkeqësisë është shkaktuar për pasojë të operacioneve të luftës. Me kushtet e sigurimit të siguruarëve për sigurimin e fatkeqësive si, p.sh., sigurimi Croatia, janë parashikuar si rreziqe të luftës këto situata: ngjarjet e luftës, armiqësitë ose veprimet e ngjashme të luftës, lufta qytetare, revolucioni, kryengritja, rebelimi, trazirat qytetare që shkaktohen nga këto ngjarje, sabotimi ose terrorizmi i shkaktuar për motive politike, dhuna ose ngjarjet e ngjashme në të cilat merr pjesë i siguruari. Pra, janë bashkëngjitur edhe ca rreziqe që nuk kanë të bëjnë fare me rreziqet e luftës e të ngjashme. Kjo do të thotë se te sigurimi nga pasojat e fatkeqësisë me legjislacion autonom, që ka të bëjë me rreziqet e luftës, në mënyrë të konsiderueshme është ngushtuar mbulesa në raport me standardin ligjor. Këto përjashtime janë ligjërisht të vlefshme në bazë të dispozitave të nenit 974 të LMD.

Neni 974. Përjashtimi kontraktues i rrezikut

Me kontratën e sigurimit për rastin e vdekjes ose të rastit të fatkeqësisë mund të përjashtohen nga sigurimi dhe rreziqet e tjera.

880 Shih vendimin e Vs. Rev 1070/98 të dt. 17. 12.2001, izbor 2/2002, sipas të cilit vendim vdekja e të siguruarit nuk është shkaktuar me operacionet e luftës kur ai është dëmtuar duke hasur në min pas përfundimit të operacioneve të luftës.

881 Shih vendimin e Vs. Rev 119/1997 të dt. 28.01.1998, izbor 1/1998

Te sigurimi i jetës për rastin e vdekjes dhe sigurimi nga rasti i fatkeqësisë, përveç përjashtimeve dhe kufizimeve ligjore (rreziqet luftarake, vetëvrasja e të siguruarit, vrasja me dashje e të siguruarit, shkaktimi me dashje i rastit të fatkeqësisë), nga sigurimi mund të përjashtohen me kontratë edhe rreziqet e tjera. Mundësia e tillë është parashikuar shprehimisht në këtë dispozitë ligjore. Liria në kontraktimin e rreziqeve të përjashtuara është parashikuar vetëm te sigurimet e jetës – nga rasti i vdekjes dhe nga rasti i fatkeqësisë. Për të gjitha format e tjera të sigurimit vlen rregulla e përgjithshme e parashikuar nga neni 921 i LMD. Në kushtet e sigurimit të siguresve tanë hasim si përjashtime edhe një numër tjetër të rreziqeve, përveç atyre të përjashtuar me ligj. P.sh., veprimtaritë e rrezikshme ose ushtrimi i aktiviteteve të rrezikshme rekreative (parashutizmi, drejtimi i aeroplanit e të tjera), rekreacionet sportive, garat sportive, trajnimet, personat me rrezik jonormal (për shkak të sëmundjes kronike, sëmundjes së rëndë, me të meta të lindura apo të fituara më vonë).

NËNKREU 3

TË DREJTAT E KONTRAKTUESIT TË SIGURIMIT PARA SHKAKTIMIT TË RASTIT TË SIGURUAR

Neni 975. Riblerja

1. Me kërkesën e kontraktuesit të sigurimit të jetës, të përfunduar për tërë jetën e të siguruarit, siguresi ka për detyrë t'i paguajë vlerën riblerëse të policës, në qoftë se gjer atëherë janë paguar të paktën tri (3) premitë vjetore.
2. Në policë duhet të shënohen kushtet në të cilat kontraktuesi mund të kërkojë pagimin e vlerës së saj riblerëse si dhe mënyrën se si të përlllogaritet kjo vlerë në pajtim me kushtet e sigurimit.
3. Të drejtën e kërkesës së riblerjes nuk mund ta ushtrojnë kreditorët e kontraktuesit të sigurimit si dhe shfrytëzuesit e sigurimit, por vlera riblerëse do t'i paguhet shfrytëzuesit me kërkesën e tij, në qoftë se caktimi i shfrytëzuesit është e parevokueshëm.
4. Përjashtimisht nga paragrafi paraprak, riblerja e policës mund të kërkohet nga kreditori të cilit polica i është dorëzuar në peng, në qoftë se kërkesa për sigurimin e së cilës është dhënë pengu nuk paguhet në afatin e rrjedhjes së saj për pagesë.

Vështrim i përgjithshëm.- Veçori e sigurimit të jetës është se ajo, përveç komponentit të sigurimit, e ka edhe komponentin e kursimit. Rregullorja për sigurimin e jetës vë në dukje shprehimisht që mjetet e sigurimit të jetës kanë karakteristikën e kursimit⁸⁸². Kjo veçori realizohet me formimin e fondit të veçantë, i cili quhet rezervë matematikore. Ky fond formohet nga premitë e paguara për sigurimin e jetës. Në përgjithësi, sasia e premisë së sigurimit përcaktohet në bazë të peshës së rrezikut. Te sigurimi afatgjatë i jetës kjo do të thotë se premia

882 Shih Rregulloren për sigurimin e jetës të nxjerrë nga ana e BQK të R. Kos. me dt. 17.12.2007,

e sigurimit duhet të rritet nga viti në vit, duke marrë parasysh se rreziku është gjithnjë e më i madh. Një mënyrë e tillë e caktimit të premisë nuk është në interesin e palëve, prandaj te ky sigurim nuk zbatohet. Është miratuar praktika e përgjithshme në këtë sigurim që, me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit, premia e sigurimit për tërë kohëzgjatjen e sigurimit të jetë unike dhe e pandryshueshme. Ajo caktohet ashtu që në vitet e para të sigurimit paguhet premia mbi rrezikun real, kurse në vitet e mëvonshme, kur me rritjen e rrezikut premia normalisht do të duhej të rritej, nën këtë rrezik real. Prandaj, te sigurimi afatgjatë i jetës paguhet premia mesatare. Kjo praktikisht do të thotë se në vitet e para të sigurimit, nga teprica e premisë është e mundshme të vendoset një fond i veçantë monetar, i cili nuk është i ngarkuar me detyrime. Ai formësohet në aspektin monetar me zbatimin e metodës së veçantë matematikore, prej ku rrjedh edhe emërtimi i këtij fondi – rezerva matematikore. Sipas definicionit ligjor, rezerva matematikore e sigurimit të jetës përbën dallimin mes vlerës së tanishme të të gjitha detyrimeve të ardhshme të siguroesit ndaj kontratave nga sigurimi i jetës dhe vlerës së tanishme të të gjitha detyrimeve të ardhshme të kontraktuesit të sigurimit ndaj atyre kontratave. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'ia japë formën e duhur rezervës matematikore të sigurimit të jetës. Është detyrim ligjor i kompanisë së sigurimit, e cila merret me sigurimin e jetës, që, me rastin e themelimit të saj, të nxjerrë aktin mbi formën, administrimin dhe shfrytëzimin e rezervës matematikore, i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes së organit kompetent shtetëror (aktualisht në Kosovë këtë mbikëqyrje e bënë BQK). Në këtë mënyrë, rezervat matematikore kanë cilësinë e sigurimit dhe të siguruarit fitojnë të drejta të caktuara në raport me atë fond monetar. Të drejtat e parashikuara realizohen para se të ndodhë rasti i siguruar. E drejta e kontraktuesit të sigurimit në raport me mjetet e rezervës matematikore shprehen në këto forma: a) e drejta për pagesën e rezervës matematikore në bazë të dispozitave mbi rreziqet e përjashtuara, b) zvogëlimi i shumës së siguruar, c) riblerja e sigurimit, ç) paradhënia, d) lënia peng e policës.

1. Kuptimi dhe qëllimi i riblerjes. - Kontraktuesit të sigurimit, i cili për shkaqe të ndryshme nuk dëshiron ta mbajë në fuqi kontratën e sigurimit të jetës me kushtet e kontraktuara, më së shpeshti për shkak të nevojës për mjete monetare, i ofrohen dy mundësi: a) Zvogëlimi i shumës së siguruar me ndërprerjen e pagesës së mëtejme të premisë. Kusht është që gjer atëherë të jenë paguar së paku tri premi vjetore. Ligjvënësi konsideron se tri premi vjetore janë të mjaftueshme për formimin e rezervës matematikore, nga e cila para së gjithash do të mund të mbuloheshin shpenzimet e përgjithshme të të siguruarit. Në këtë rast, kontrata vazhdohet me shumën e zvogëluar të sigurimit; b) Riblerja e vlerës së sigurimit. E drejta për riblerjen e vlerës së sigurimit e plotëson të drejtën e kërkesës për zvogëlimin e shumës së siguruar. E drejta e zgjedhjes i takon kontraktuesit të sigurimit. Duke marrë parasysh se këto të drejta të kontraktuesit janë parashikuar me ligj, për zbatimin e tyre, nëse janë plotësuar kushtet e duhura, nuk është i nevojshëm pëlqimi i siguroesit, i cili as që ka mundësi ta kundërshtojë kërkesën e kontraktuesit të sigurimit. Riblerja e policës prandaj është akt i njëanshëm i kontraktuesit të sigurimit, i cili çon në shuarjen e kontratës së sigurimit të jetës. Për riblerjen e vlerës së sigurimit është e nevojshme të plotësohen këto kushte: a) riblerja është e mundur vetëm te sigurimi i jetës, i lidhur ky për tërë jetën e të siguruarit; b) duhet të ekzistojë kërkesa e kontraktuesit të sigurimit të jetës; c) duhet të jenë të paguara së paku tri premi vjetore, ç) duhet të përmbushen kushtet e theksuara në policën e sigurimit

në të cilat kontraktuesi mund të kërkojë pagesën e vlerës riblerëse të saj. Me riblerjen e policës, kontrata e sigurimit shuhet. Kjo është njëra prej mënyrave të jashtëzakonshme të shuarjes së kontratës. Konsiderohet se të drejtat dhe detyrimet e kontratës shuhen nga momenti i kërkesës për riblerje dhe jo nga momenti i pagesës së vlerës riblerëse. Kjo është me rëndësi të vihet në dukje, sepse kur rasti i siguruar ndodh pas parashtrimit të kërkesës dhe para se të kryhet pagesa, shfrytëzuesi nuk do të ketë të drejtën për shumën e siguruar, por vetëm për shumën e vlerës riblerëse. Riblerja e policës së sigurimit nuk do të thotë se kontraktuesit të sigurimit i paguhet e tërë shuma e rezervës matematikore. Kjo shumë zvogëlohet në përpjesëtim me shpenzimet e siguruesit. Mënyra e llogaritjes duhet të përcaktohet në policën e sigurimit. Dispozitat ligjore për të drejtat e të siguruarit janë të natyrës juridike dispozitive, prandaj mund të kontraktohen edhe përfitime të tjera për të siguruarin (neni 921 i LMD). Kontraktuesi i sigurimit nuk mund të heqë dorë nga e drejta e riblerjes, prandaj një dispozitë e kundërt kontraktuese do të ishte juridikisht nule.

2. Kushtet e riblerjes dhe mënyra e vërtetimit të vlerës riblerëse.- Në kontratën e sigurimit duhet të shënohen kushtet në të cilat kontraktuesi i sigurimit mund të kërkojë pagesën e vlerës së saj të riblerë dhe mënyrën se si ajo vlerë përlllogaritet. Më lart u theksua se, me rastin e riblerjes, nuk paguhet e tërë shuma e rezervës, por ajo zvogëlohet në përpjesëtim me shpenzimet e siguruesit. Vetë ligji u referohet në këtë drejtim kushteve të sigurimit. Nga kjo rrjedh se në kushtet e sigurimit duhet të parashikohen edhe kushtet dhe mënyra se si përlllogaritet vlera për riblerje. Me lidhjen e kontratës, këto kushte janë pjesë përbërëse e saj dhe gjatë zbatimit kanë përparësi ndaj çdo gjëje që me policë nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë. Siguruesit në praktikë rregullisht e shfrytëzojnë këtë mundësi dhe në kushtet e sigurimit parashikojnë kushte në të cilat bëjnë riblerjen e vlerës së policës. Është dukuri e përgjithshme që këtë mundësi e kufizojnë në numrin më të vogël të rasteve.

3. Përfshirja e kreditorëve dhe shfrytëzuesve.- E drejta e riblerjes së policës është e drejtë rreptësisht personale e kontraktuesit të sigurimit. Që në këtë drejtim të mos ketë kurrfarë dykuptimësie, paragrafi i 3 i këtij neni ka parashikuar personat të cilët nuk kanë të drejtë ta bëjnë riblerjen. Këta, në radhë të parë, janë kreditorët e kontraktuesit të sigurimit. Po t'u jepej kreditorëve e drejta e riblerjes, kjo do të thoshte tërthorazi se këta do të kishin mundësi ta revokonin shfrytëzuesin e sigurimit, të drejtë këtë që e ka vetëm kontraktuesi i sigurimit. Përfshirja e kreditorit, riblerjen e policës mund ta kërkojë personi të cilit polica i është lënë peng, por këtë të drejtë ai e realizon në bazë të së drejtës së pengut (shih paragrafin 4 të këtij neni). Të drejtën e riblerjes nuk e kanë as shfrytëzuesit e sigurimit, përveç kur caktimi i shfrytëzuesit është i përvokueshëm, gjë që do të thotë se e ka pranuar përfitimin që del nga kontrata. Në atë rast shfrytëzuesit, me kërkesë të tij, do t'i paguhet vlera riblerëse (paragrafi 3). Përndryshe, shfrytëzuesi i sigurimit nuk ka të drejtë ta ndryshojë kontratën. Këtë të drejtë e ka vetëm kontraktuesi i sigurimit. Përveç kësaj, kontraktuesi i sigurimit, gjër në shkaktimin e rastit të sigurimit, mund ta revokojë dispozitën për shfrytëzuesin e sigurimit. Kur shfrytëzuesi deklaron se e pranon dobinë që rrjedh nga kontrata e sigurimit të jetës, caktimi i shfrytëzuesit është i përvokueshëm dhe në atë moment shfrytëzuesi ka të drejtën e riblerjes së vlerës së policës (shih komentin e dispozitës së nenit 980 të LMD).

4. Përjashtimi për kreditorin pengmarrës.- Me dispozitën e paragrafit 4 të këtij neni është parashikuar përjashtimi nga rregulla e përgjithshme mbi përjashtimin e kreditorit nga rrethi i personave që kanë të drejtën e kërkesës për riblerjen e vlerës së policës. Përjashtimi ka të bëjë me kreditorin të cilit polica i është dorëzuar si peng. Kusht është që kërkesa për sigurim e së cilës është dhënë pengu nuk paguhet në afatin e rrjedhjes së saj për pagesë (shih komentin e dispozitës së nenit 977 të LMD). Në këtë mënyrë realizohet kuptimi dhe qëllimi i lënies peng të policës së sigurimit. Riblerja kështu paraqitet si mënyrë e përmbushjes së kërkesës së arritur ndaj kontraktuesit të sigurimit.

Neni 976. Paradhënia

- 1. Me kërkesën e kontraktuesit të sigurimit të jetës, të përfunduar për krejt jetën e të siguruarit, siguruasi mund t'i parapaguajë pjesën e shumës së siguruar deri në shumën e vlerës riblerëse të policës, të cilën kontraktuesi i sigurimit mund ta kthejë më vonë.**
- 2. Mbi paradhënien e marrë kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë të paguajë kamatë të caktuar.**
- 3. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit vonon me pagimin e kamatës së arritur për pagesë do të veprohet sikundër të ketë kërkuar riblerje.**
- 4. Në policën e sigurimit duhet të shënohen kushtet e dhënies së paradhënies, mundësia që shuma e marrë në emër të paradhënies t'i kthehet siguruasit, shuma e shkallës së kamatës, pasojat e mospagimit të kamatës së arritur për pagesë, sikundër është caktuar në kushtet e sigurimit.**

1. Një veçori tjetër e sigurimit të jetës është ajo se, përveç riblerjes dhe lënies peng të policës, njih edhe paradhënien e shumës së siguruar. Ky institut gjithashtu mbështetet në komponentin e kursimit të sigurimit të jetës. Zbatimi i tij në ligj është kufizuar vetëm te sigurimi për tërë jetën (ose kontrata e sigurimit të jetës për rastet e vdekjes dhe mbijetesës). Derisa me riblerjen e policës së sigurimit kontrata e sigurimit shuhet, me paradhënie sigurimi ngel në fuqi sipas kushteve të kontraktuara. Çka është paradhënia te sigurimi i jetës. Paradhënie do të thotë pagesa e pjesshme e shumës së siguruar, e cila jepet paraprakisht deri në sasinë e vlerës riblerëse të policës së sigurimit. Për pagesën e paradhënies është e nevojshme që kontraktuesi i sigurimit t'ia parashtojë një kërkesë të tillë siguruasit. Marrjen e paradhënies kontraktuesi mundet ta kthejë më vonë dhe sërish ta rrisë shumën e zvogëluar të sigurimit me shumën fillestare. Të drejtën për të kërkuar paradhënien e ka vetëm kontraktuesi i sigurimit, që do të thotë se kjo e drejtë nuk i takon kreditorit dhe as shfrytëzuesit. Sipas analogjisë së nenit të mëparshëm, shfrytëzuesi i sigurimit e fiton të drejtën e paradhënies nga momenti kur ajo është caktuar në mënyrë të paravokueshme (shih nenin 980 të LMD). Nga ky moment pushon e drejta kontraktuesit të sigurimit të kërkojë paradhënien. Siguruasi nuk është i detyruar ta pranojë kërkesën për pagesën e paradhënies. Kjo padyshim rrjedh nga stilizimi i paragrafit 1 të këtij neni, i cili thekson se siguruasi mund ta paguajë paradhënien. Ai do të jetë i detyruar ta bëjë këtë, nëse kjo

është kontraktuar në mënyrë të posaçme ose është parashikuar në kushtet kontraktuese të sigurimit. Siguruesi gjithashtu nuk është i detyruar ta kthejë shumën e parapaguar. Në këtë pikë ky institut dallon nga huaja. Nëse siguruesi nuk e kthen shumën në afat ose vonohet me pagimin e kamatës së arritur për pagesë, lindin pasojat juridike të parashikuara ose të kontraktuara (shi paragrafin 3 të këtij neni).

2. Pagesa e kamatës.- Në paragrafin 2 të këtij neni mbi paradhënien e marrë kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë të paguajë një kamatë të caktuar. Kamatat janë shpërblim për shfrytëzimin e mjeteve monetare të siguruesit. Ligji asgjë nuk flet për normën e kamatës, por kjo është njëra nga çështjet që duhet të jenë përfshirë në policë. Me fjalë tjera, norma e kamatës kontraktohet me rastin e lidhjes së kontratës ose është e parashikuar në kushtet kontraktuese të sigurimit.

3. Pasojat juridike të mospagesës së kamatës i parashikon paragrafi 3 i këtij neni. Nëse kontraktuesi i sigurimit vonon me pagimin e kamatës së arritur për pagesë, do të veprohet sikundër ta ketë kërkuar riblerjen e vlerës së policës. Prandaj, lindin pasojat juridike të parashikuara për riblerjen, çka do të thotë se kontrata shuhet. Për faktin se e drejta e riblerjes së vlerës së policës mund të realizohet me kusht që të paguhet së paku tri premi vjetore, përfundohet se ky kusht vlen edhe për paradhënien.

4. Kushtet e dhënies së paradhënies.- Me paragrafin 4 të këtij neni parashikohet që në policën e sigurimit duhet të shënohen kushtet e dhënies së paradhënies, kthimit të saj, norma e kamatës dhe pasojat e mospagesës së kamatës së arritur për pagesë. Këto dispozita kontraktuese duhet të jenë në përputhje me kushtet e sigurimit, gjë që do të thotë se në nuk duhet të përmendën edhe formalisht në policën e sigurimit, nëse janë parashikuar në kushtet kontraktuese të sigurimit, sepse ato janë pjesë e kontratës, prandaj edhe të policës së sigurimit.

Neni 977. Lënia peng e policës

1. Polica e sigurimit të jetës mund të lihet peng.

2. Lënia peng e policës ka efekt ndaj siguruesit vetëm në qoftë se është njoftuar me shkrim se polica i është lënë peng kreditorit të caktuar.

3. Kur polica është shënuar sipas urdhrorit, lënia peng bëhet me indosament.

1. Lënia peng e policës si garanci. Pengu i policës së sigurimit të jetës do të thotë themelimi i të drejtës së pengut mbi policën e sigurimit të jetës. Në paragrafin 1 të këtij neni theksohet shprehimisht se polica e sigurimit të jetës mund të lihet peng. E drejta e pengut mbi policën e sigurimit fitohet me lidhjen e kontratës së pengut për lënien peng të policës. Polica i jepet peng, si garanci, kreditorit më së shpeshti për pagesën e borxhit të kredituar. Kreditori me këtë fiton sigurinë se do të paguhet nga shuma e siguruar e sigurimit të jetës të debitorit

kreditor, në rast të vdekjes së debitorit para skadimit të afatit në të cilin polica është lënë peng. Siguria më e madhe e kreditorit realizohet me lënien peng të policës së sigurimit të tërë jetës së të siguruarit. Ligji nuk kufizon mundësinë e lënies peng vetëm të kësaj police. Kjo mund të jetë policë e çfarëdo forme të sigurimit të jetës. Ligji e përmend vetëm policën e sigurimit të jetës, çka do të thotë se polica e sigurimit nga rasti i fatkeqësisë nuk mund të lihet peng në kuptim të dispozitave të këtij neni.

Kur kreditori në favor të të cilit është deponuar polica e merr policën, pengun nuk mund revokohet. Kontraktuesi i sigurimit mund ta lërë peng policën e sigurimit deri te shkaktimi i rastit të siguruar. Në këtë mënyrë, kontraktuesi e përcakton përkohësisht shfrytëzuesin e ri të sigurimit. Policën mund ta lërë peng edhe shfrytëzuesi i sigurimit nga momenti kur kontraktuesi i sigurimit e ka humbur të drejtën për revokim të shfrytëzuesit (neni 980 të LMD). Kreditori pengmarrës mban cilësinë e shfrytëzuesit deri në pagesën e kërkesës së siguruar ose deri te skadimi i afatit për të cilin polica është lënë peng. Nëse i siguruari – debitori kreditor (borxhliu i kreditit) nuk e paguan rregullisht preminë e sigurimit, këtë në vend të tij mund ta bëjë kreditori pengmarrës, duke qenë se ka të drejtë të kërkojë kthimin e këtyre mjeteve nga i siguruari. Siguruesi është i detyruar ta kompensojë borxhin e siguruar me policën e lënë peng vetëm deri te sasia e shumës së siguruar. Një prej çështjeve që shtrohet është ajo se a ka të drejtë kreditori pengmarrës ta riblejë policën e sigurimit. Është rregull e përgjithshme që kreditorët e kontraktuesit nuk e kanë këtë të drejtë (neni 975 par. 3 i LMD). Përgjithimisht, këtë të drejtë e ka kreditori të cilit polica i është lënë peng, në qoftë se kërkesa për sigurimin e së cilës është dhënë pengun nuk paguhet në afatin e arritjes së saj për pagesë (shih komentin e dispozitës së nenit 975 par. 4 të LMD).

2. Njoftimi i siguruesit. Në mënyrë që lënia peng e policës ta ketë efektin përkatës ndaj siguruesit, është e nevojshme që ai të jetë i informuar me shkrim për faktin se polica është lënë peng dhe për personin në favor të të cilit është lënë peng (kreditorit pengmarrës). Kjo rrjedh nga paragrafi 2 i këtij neni. Kushtet e përgjithshme të sigurimit rregullisht kërkojnë që njoftimi për lënien peng të policës të jetë në formën dhe përmbajtjen e parashikuar dhe t'i ketë arritur siguruesit para shkaktimit të rastit të siguruar.

3. Forma e lënies peng të policës.- Polica e sigurimit të jetës, përveç sipas urdhrit, mund të jetë edhe sipas personit të caktuar (neni 964 par. 2 i LMD). Polica nuk mund të jetë sipas prurësit (shih komentin e nenit 964 të LMD). Lënia peng e policës sipas urdhrit bëhet me indosament, ashtu siç bëhet (me indosament) edhe kalimi i saj. Për vlefshmërinë e indosamentit sipas urdhrit është e nevojshme të përmbajë emrin e shfrytëzuesit, datën e indosimit dhe nënshkrimin e indosantit, që do të thotë se indosamenti i policës sipas urdhrit nuk mund të jetë indosament blanko (neni 964 par. 3 i LMD).

NËNKREU 4

SIGURIMI I JETËS NË DOBI TË PERSONIT TË TRETË

Neni 978. Caktimi i shfrytëzuesit

1. Kontraktuesi i sigurimit të jetës mundet në kontratë si edhe me ndonjë veprim juridik të mëvonshëm qoftë edhe me testament ta caktojë personin të cilit do t'i takojnë të drejtat nga kontrata.
2. Në qoftë se sigurimi shtrihet në jetën e ndonjë personi tjetër për caktimin e shfrytëzuesit nevojitet edhe aprovimi i tij me shkrim.
3. Shfrytëzuesi nuk nevojitet medoemos të caktohet sipas emrit, por mjafton në qoftë se akti përmban të dhënat e domosdoshme për caktimin e tij.
4. Kur si shfrytëzues janë caktuar fëmijët ose pasardhësit, dobia u takon edhe të paslindurve, ndërsa dobia e destinuar bashkëshortit i takon personit që ka qenë në martesë me të siguruarin në çastin e vdekjes së tij.

Vështrim i përgjithshëm.- Është rregull e përgjithshme e të drejtës sonë të detyrimeve se kontrata mund të lidhet në emrin personal dhe në dobi të personit të tretë. Është tipar themelor i kësaj kontrate që personi në dobi të të cilit është lidhur kontrata të fitojë të drejtën personale dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, nëse nuk është kontraktuar diçka tjetër (neni 131 i LMD). Zbatimin më të shpeshtë dhe më të rëndësishëm të këtij parimi të përgjithshëm në praktikën kontraktuese të biznesit e gjejmë në institutin specifik të së drejtës së sigurimit të jetës me emërtimin: sigurimi i jetës në dobi të personit të tretë. Për shkak të rëndësisë së këtij sigurimi dhe çështjeve të shumta specifike të cilat lajmërohen në zbatimin e tij, ky sigurim është rregulluar gjerësisht në nënkreu 4, të kreut III, pjesa 26 e LMD (nenet 978 deri në 986).

1. Kuptimi i sigurimit të jetës në dobi të personit të tretë.- Me termin *sigurim i jetës në dobi të personit të tretë* e konsiderojmë kontratën e sigurimit të jetës, me të cilën siguruuesi obligohet që shumë e siguruar të kontraktuesit të sigurimit do t'ia paguajë personit të cilin e cakton ai. Personi të cilin kontraktuesi e cakton fiton cilësinë e shfrytëzuesit të sigurimit, çka do të thotë se atij i takojnë të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të jetës. Shfrytëzuesi i sigurimit është personi jashtë rrethit të palëve kontraktuese, d.m.th. është person i tretë, prandaj, sipas kësaj karakteristike, i tërë sigurimi quhet sigurimi në dobi të personit të tretë. Te kontratat në rast të mbijetesës kontraktuesi mund të jetë njëkohësisht edhe shfrytëzues i sigurimit, por te kontratat në rast të vdekjes është e nevojshme edhe pala tjetër – shfrytëzuesi i sigurimit. Efekti bazë ligjor i kontraktimit të sigurimit në dobi të personit të tretë është ai që shfrytëzuesi i sigurimit fiton të drejtën personale dhe të drejtpërdrejtë ndaj siguruessit për pagesën e shumë së siguruar. Kjo e drejtë është e revokueshme vetëm gjer në vdekjen

e kontraktuesit të sigurimit (shih komentin e dispozitës së nenit 980 të LMD). E drejta e shfrytëzuesit të sigurimit është burimore. Ajo lind me vetë lidhjen e kontratës. Për lindjen e kësaj të drejte nuk është e nevojshme që shfrytëzuesi ta pranojë atë. Është me rëndësi që të mos e refuzojë. Gjithashtu është e parëndësishme kur është deklaruar pranimi. Kjo mund të bëhet në çdo kohë, derisa nuk revokohet. Deklarimi mund t'i jepet edhe pas shkaktimit të rastit të siguruar. Prandaj, këtu e drejta e shfrytëzimit nuk realizohet në bazë të së drejtës së trashëgimit ose dhurimit. Edhe kur si shfrytëzues të sigurimit janë caktuar trashëgimtarët e kontraktuesit të sigurimit, ata kërkesën e tyre ndaj siguresit nuk e mbështesin në të drejtën trashëgimore, por në dispozitat e kontratës së sigurimit. Për këtë arsye është parashikuar se shumica e sigurimit nuk hyn në masën trashëgimore të kontraktuesit, as atëherë kur shfrytëzues janë përcaktuar trashëgimtarët e tij (neni 981 i LMD). Nëse në kontratë nuk është përcaktuar shfrytëzuesi ose dispozita kontraktuese është pa efekt, konsiderohet se kontrata është lidhur në dobi të kontraktuesit të sigurimit (neni 988 i LMD). Mundësia e lidhjes së kontratës në dobi të personit të tretë me ligj është parashikuar për sigurimin e jetës në përgjithësi dhe nuk është e kufizuar te ndonjë formë të sigurimit të jetës. Prandaj, duhet kuptuar se një kontratë e tillë mund të lidhet te të gjitha format e sigurimit të jetës (sigurimin për rast të vdekjes, sigurimi për mbijetesë, sigurimi i përzier). Në praktikë megjithatë më së shpeshti paraqitet sigurimi për rast vdekjeje.

a) Caktimi i shfrytëzuesit të sigurimit.- E drejta e caktimit të shfrytëzuesit të sigurimit është e drejtë ligjore e kontraktuesit të sigurimit. Gjithashtu vetëm kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë ta revokojë dispozitën për caktimin e shfrytëzuesit (shih nenin 980 të LMD). Ajo është rreptësisht e drejtë e tij personale. Për këtë arsye, nuk u lejohet kreditorëve të tij ose trashëgimtarëve të ndërrojnë shfrytëzuesin e sigurimit. Me këtë rast nuk i rëndësishëm raporti i kontraktuesit të sigurimit ndaj personit të tretë dhe i çfarë karakteri është interesi i kontraktuesit të sigurimit për të lidhur kontratë në dobi të ndonjë personi të tretë. Ky interes mund të rrjedhë nga çfarëdo marrëdhënie qoftë, si: familjare, shoqërore ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Në sistemin tonë juridik interesi nuk duhet të jetë ekonomik; ai mund të jetë edhe i natyrës sentimentale, me kusht të respektimit të rregullave të moralit shoqëror (neni 89 i LMD). Shfrytëzues mund të jetë secili person juridik apo fizik. Për personin fizik është e mjaftueshme ta ketë zotësinë juridike. Nuk është e nevojshme që ta ketë edhe zotësinë e veprimit. Ky mund të jetë edhe fëmijë i palindur – **nasciturus (nasciturus pro iam nato habitur...** = fëmija i zënë konsiderohet si i lindur)⁸⁸³.

b) Kontraktuesi i sigurimit mund ta caktojë shfrytëzuesin në kontratën e sigurimit, d.m.th., me rastin e lidhjes së kontratës, por edhe me ndonjë punë të mëvonshme juridike e edhe me testament. Shfrytëzuesi i sigurimit është e mundur të caktohet deri në momentin e shkaktimit të rastit të siguruar. Nëse shfrytëzuesi caktohet me rastin e lidhjes së kontratës, emri i tij shënohet në policën e sigurimit. Në rast të caktimit të mëvonshëm të shfrytëzuesit, parashtrahet shtojca e policës ose caktohet në ndonjë formë tjetër të shkruar, p.sh. në formë të dokumentit noterial. Caktimi i shfrytëzuesit në policën sipas urdhrorit bëhet në

883 Shih nenin 126.2 të Ligjit për Trashëgimin të Kosovës, i cili parashikon se fëmija i zënë në çastin e hapjes së trashëgimit do të konsiderohet si i lindur, në qoftë se lind i gjallë.

formë të indosamentit. Për vlefshmërinë e indosamentit, polica duhet të përmbajë emrin e shfrytëzuesit, datën e indosimit dhe nënshkrimin e indosantit. Kur shfrytëzuesi caktohet me testament, kjo deklaratë ka rëndësinë e kontratës në dobi të të tretit dhe jo të deklaratës së vullnetit të fundit, prandaj ajo prodhon efekt edhe kur shfrytëzuesi heq dorë nga trashëgimia. Caktimi i shfrytëzuesit është akt i njëanshëm i kontraktuesit të sigurimit dhe për vlefshmërinë e tij nuk është i nevojshëm pëlqimi i siguresit, por kërkohet që siguresi të njoftohet për personin që është shfrytëzuesi i sigurimit (neni 986 i LMD).

2. Pëlqimi i të siguarit.- Kur sigurimi i jetës nuk ka të bëjë me kontraktuesin e sigurimit, por me jetën e ndonjë personi tjetër (personi i siguar), për caktimin e shfrytëzuesit është i domosdoshëm edhe aprovimi i tij (të siguarit) me shkrim. Aprovimi i personit të siguar është i domosdoshëm jo vetëm për lidhjen e kontratës, por edhe për secilin ndryshim të mëvonshëm të shfrytëzuesit, p.sh., revokimi, caktimi i shfrytëzuesit të ri. I njëjti parim zbatohet edhe te sigurimi i jetës në rastin e vdekjes së ndonjë personi të tretë. Për vlefshmërinë e një kontrate të tillë është i domosdoshëm aprovimi me shkrim i personit të tretë (shih nenin 967 par. 3 të LMD). Kushti për aprovimin me shkrim i parashikuar nga neni 967 dhe ky nen (978 par. 2) është futur për pengimin keqpërdorimeve të mundshme në sigurimin e jetës. Pasojat juridike të mungesës së aprovimit me shkrim në të dy këto raste nuk janë të njëjta. Te sigurimi i personit të tretë (neni 967 i LMD), kjo ka për pasojë Pavlefshmërinë e kontratës, kurse mungesa e aprovimit me shkrim e siguresit në emërimin e personit të tretë, si shfrytëzues të sigurimit sipas dispozitave të këtij neni, nuk e bën kontratën nule. Kontraktuesi i sigurimit mund ta emërojë atëherë një shfrytëzues tjetër. Nëse këtë nuk e bën, shuma e siguar nga sigurimi i jetës i takon kontraktuesit të sigurimit (neni 985 i LMD).

3. Mënyra e caktimit të shfrytëzuesit të sigurimit.- Shfrytëzuesi mund të caktohet: a) me emër, b) me paraqitjen e të dhënave të domosdoshme për caktimin e tij. Shfrytëzuesi prandaj mund të jetë i caktuar ose i caktueshëm. Nëse nuk është përmendur emri i shfrytëzuesit të sigurimit, ai duhet të jetë i shënuar në mënyrën në të cilën është e mundur të vërtetohet identiteti i tij. Në praktikë shfrytëzuesit, në vend se me emër, shpeshherë përcaktohen me shprehjet: bashkëshortja, bashkëshorti, fëmijët, pasardhësit, trashëgimtarët dhe të ngjashme. Në këso rastesh lind pyetja se a duhet këta persona ta kenë shënuar cilësinë në momentin e caktimit.

4. Ligji për fëmijët dhe pasardhësit parashikon se dobia u takon edhe atyre që kanë lindur më vonë. Përjashtimisht, dobia nuk do të ju takojë fëmijëve të lindur më vonë, nëse fëmijët e mëparshëm janë caktuar si shfrytëzues me emrin e tyre. Në atë rast, dobia u takon vetëm atyre. Shtesa eventuale “fëmijë” para apo pas shënimit të emrit nuk është relevante. Kjo shtesë i referohet vetëm marrëdhënies familjare, kurse të drejtat e tyre dobiprurëse ata i nxjerrin nga kontrata e sigurimit. Dhe, anasjelltas, nëse është shënuar vetëm shprehja “fëmijët” (pa emra të tyre), dobia u takon të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga ajo se a kanë lindur para apo pas lidhjes së kontratës, përkatësisht caktimit të shfrytëzuesit, sepse ata të gjithë e kanë statusin juridik të fëmijës. Duke marr parasysh se pas lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës mund të ndodhin ndryshime personale, kështu që nëse thuhet edhe

bashkëshortit, lind pyetja interesante se cilit person në atë rast i takon dobia, partnerit të vjetër martesor apo të riut, kur shfrytëzuesi nuk është caktuar me emër por vetëm me shprehjet, p.sh. bashkëshorti, burri, gruaja etj. Ligji këtë dualizëm e ka zgjidhur në mënyrë të padiskutueshme: dobia e destinuar bashkëshortit (ose bashkëshortes) i takon personit që ka qenë në martesë me të siguarin (kontraktuesin) në çastin e vdekjes së tij.

Neni 979. Pjesëtimi i dobisë midis disa shfrytëzuesve

Kur si shfrytëzues janë caktuar fëmijët, pasardhësit dhe në përgjithësi trashëgimtarët, në qoftë se kontraktuesi i sigurimit nuk ka caktuar se si do të bëhet pjesëtimi midis tyre, pjesëtimi do të bëhet përpjesëtimisht me pjesët e tyre trashëgimore, e në qoftë se shfrytëzuesit nuk janë trashëgimtarë, shuma e siguruar do të pjesëtohet në pjesë të barabarta.

Me këtë dispozitë është rregulluar pjesëtimi i dobisë midis disa shfrytëzuesve të caktuar me kontratën e sigurimit të jetës, kur kontraktuesi i sigurimit nuk ka caktuar se si do të bëhet pjesëtimi midis tyre. (Përndryshe pjesëtimi do të bëhet në mënyrën siç e ka caktuar kontraktuesi i sigurimit). Me këtë rast bëhet dallimi në mes të: a) shfrytëzuesit – trashëgimtarit (fëmijët – pasardhësit) dhe b) shfrytëzuesve të tjerë.

a) Pjesëtimi në mes të trashëgimtarëve do të bëhet përpjesëtimisht me pjesët e tyre trashëgimore. Kjo rregull vlen për rrethanën kur me kontratën e sigurimit ose me ndonjë punë të mëvonshme juridike trashëgimtarët janë caktuar si shfrytëzues në mënyrë të përgjithshme. Ata trashëgimtarë që janë caktuar me emër mbajnë dobinë në pjesën të cilën e ka caktuar kontraktuesi dhe norma dispozitive e këtij neni nuk zbatohet. Kjo vërteton vërejtjen e mëparshme që shfrytëzuesit të drejtën e tyre mbi dobinë që rrjedh nga kontrata e sigurimit të jetës e nxjerrin nga kontrata e sigurimit e jo nga e drejta trashëgimore.

b) Nëse si shfrytëzues janë caktuar personat që nuk e kanë cilësinë e trashëgimtarëve, shuma e siguruar do të pjesëtohet në pjesë të barabarta.

Neni 980. Revokimi i dispozitës për caktimin e shfrytëzuesve

- 1. Dispozitën me të cilën dobia nga siguri i caktohet personit të caktuar mund të revokohet vetëm nga kontraktuesi i sigurimit, dhe këtë të drejtë të tij nuk mund ta ushtrojnë as kreditorët e tij dhe as trashëgimtarët ligjorë të tij.**
- 2. Kontraktuesi i sigurimit mund ta revokojë dispozitën mbi dobinë gjithnjë gjersa shfrytëzuesi të mos deklarojë në cilëndo mënyrë qoftë se e pranon, kur ajo bëhet e përvokueshme.**
- 3. Kontraktuesi mund ta revokojë dispozitën mbi dobinë edhe pas deklaratës së shfrytëzuesit se e pranon, në qoftë se shfrytëzuesi ka tentuar vrasjen e të siguarit, e në qoftë se dobia është akorduar pa shpërblim, për revokim vlejné edhe dispozitat mbi revokimin e dhuratës.**

4. Konsiderohet se shfrytëzuesi e ka refuzuar dobinë që i është destinuar, në qoftë se pas vdekjes së kontraktuesit të sigurimit me thirrjen e trashëgimtarëve të tij nuk deklarohet brenda një muaji se a pranon.

1. E drejta e revokimit.- Në paragrafin 1 të këtij neni është rregulluar e drejta e revokimit e dispozitës kontraktues për shfrytëzuesit nga kontrata e sigurimit të jetës në dobi të personit të tretë (sipas nenit 978 të LMD). Kontraktuesi i sigurimit, siç ka të drejtë ligjore ta emërojë shfrytëzuesin nga kontrata e sigurimit të jetës në dobi të personit të tretë, po ashtu, ka të drejtë edhe ta revokojë dispozitën për emërimin e shfrytëzuesit. Kontraktuesi në vendimin për ndërrimin ose revokimin e vendimit mund të jetë i nxitur nga ndryshimet e rrethanave jetësore ose arsye të tjera. Janë shumë mundësi për këtë. Në vend të shfrytëzuesit ekzistues, ai mund të emërojë shfrytëzues të rinj; përkrah ekzistuesit mund të emërojë edhe shfrytëzues të tjerë, siç edhe mund ta revokoj vendimin e të mos emëroj shfrytëzues të rinj. Revokimi është akt i njëanshëm i kontraktuesit të sigurimit. E drejta e revokimit është e natyrës rreptësisht personale dhe i takon vetëm kontraktuesit të sigurimit. Për këtë arsye, në paragrafin 1 të këtij neni theksohet shprehimisht se këtë të drejtë nuk e kanë as kreditorët e tij, as trashëgimtarët e tij ligjorë. Për vlefshmërinë e revokimit nuk është i nevojshëm pëlqimi i siguruesit dhe as i shfrytëzuesve të emëruar më parë, por kontraktuesi është i detyruar ta njoftojë siguruesin për revokimin që ka bërë. Nuk është parashikuar forma e revokimit, por ajo mund të jetë e kontraktuar. Shfrytëzuesi mund të revokohet shprehimisht - me deklaratën për revokim ose në mënyrë të tërthorët - me emërimin e shfrytëzuesit të rinj. Kjo mund të bëhet edhe në çfarëdo mënyre tjetër, me të cilën në mënyrë të qartë shprehet qëllimi i kontraktuesit për revokimin e shfrytëzuesit të emëruar më parë.

Pasojat juridike të revokimit varen nga ajo se a është caktuar shfrytëzuesi i ri ose jo. Nëse është caktuar shfrytëzuesi i ri, ai fiton të drejtën mbi dobinë që rrjedh nga kontrata. Nëse me revokimin e shfrytëzuesit të vjetër nuk është caktuar shfrytëzuesi i ri, shfrytëzues është vetë kontraktuesi i sigurimit, gjë që do të thotë se shumica e sigurimit hyn në kuadër të pasurisë së tij (shih komentin e dispozitës së nenit 985 të LMD).

2. Shuarja e të drejtës së revokimit.- Është rregull e përgjithshme juridike që kontraktuesi i dobisë për të tretin mund ta revokojë ose ta ndryshojë vendimin e vet, derisa i treti nuk deklaron se e pranon atë që është kontraktuar në favor të tij (neni 132 par. 1 i LMD). Atëherë kërkesa e kontraktuar në dobi të personit të tretë bëhet e përvokueshme. Kjo rregull e përgjithshme, me disa përjashtime, vlen edhe te sigurimi i jetës. Kjo rregull është përmbajtur në paragrafin e 2 të këtij neni ku është parashikuar se kontraktuesi i sigurimit mund ta revokojë dispozitën për dobinë gjithnjë gjersa shfrytëzuesi të mos deklarojë në cilëndo mënyrë qoftë se e pranon atë. Pas pranimit të emërimit, dispozita kontraktuese për dobinë bëhet e përvokueshme. Pranimi mund të shprehet në çfarëdo mënyre qoftë, prandaj për vlefshmërinë e tij nuk është e nevojshme të jetë i paraqitur në formë të shkruar. Deklarata për pranimin mund të jepet në çfarëdo kohe, deri në revokimin e vendimit mbi emërimin e shfrytëzuesit. Deklarata për pranimin nuk e ka rëndësinë konstitutive.

Shfrytëzuesi këtë të drejtë e fiton në mënyrë burimore dhe drejtpërdrejt në bazë të vetë kontratës, nga momenti i lidhjes së saj.

3. Përjashtimet nga rregulla për parevokueshmërinë e emërimit të shfrytëzuesit.- Pasi vendimi mbi emërimin e shfrytëzuesit të bëhet i parevokueshëm, kontraktuesi i sigurimit megjithatë, në rastet e jashtëzakonshme të parashikuara me ligj, mund ta revokojë dispozitën për dobinë. Në paragrafin 3 të këtij neni, si raste të jashtëzakonshme janë parashikuar: a) në qoftë se shfrytëzuesi ka tentuar vrasjen e të siguruarit, b) nëse ekzistojnë shkaqe për revokimin e dhuratës (kur dobia është akorduar pa shpërblim).

a) Kontraktuesi sipas vullnetit të vet të lirë vendos nëse do ta revokojë shfrytëzuesin i cili ka tentuar vrasjen e të siguruarit. Këtë të drejtë ai e ka edhe kur kontrata është lidhur për jetën e tij si edhe kur ekziston i siguruari, domethënë kur kontraktuesi i sigurimit dhe i siguruari janë persona të ndryshëm. Tërthorazi në revokim mund të ndikojë edhe i siguruari, sepse për emërimin e shfrytëzuesit të sigurimit është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij (neni 978 par. 2 i LMD), dhe këtë pëlqim, në rast të tentimit të vrasjes, mund ta revokojë. Nëse shfrytëzuesi ka bërë vepër penale të vrasjes së të siguruarit, atëherë ai është i privuar nga çdo e drejtë që rrjedh nga kontrata (neni 971 i LMD).

b) Nëse personit të emëruar dobia nga kontrata i është akorduar pa shpërblim, domethënë nëse i është dhuruar ajo, vlejnë rregullat e të drejtës së detyrimeve për revokimin e dhuratës. Arsyet për revokimin e vendimit në ato raste do të mund të ishin: varfërimi, mosmirënjohja, cenimi i detyrimit të mbajtjes (shih komentin e pjesës së 3, neni 542 etj të LMD).

4. Refuzimi i dobisë.- Është rregull e përgjithshme e të drejtës së detyrimeve që personi i tretë në kontratën në dobi të tij, mund ta refuzojë dobinë që i është destinuar. Në përputhje me këtë parim të përgjithshëm, shfrytëzuesi nga kontrata e sigurimit të jetës në dobi të personit të tretë nuk është i detyruar ta pranojë dobinë e dedikuar për të. Ai mund ta refuzojë atë. Nëse këtë nuk e bën dhe ndërkohë kontraktuesi vdes, për trashëgimtarët e kontraktuesit është shumë e rëndësishme çështja se a e pranon personi i emëruar dobinë apo jo. Për eliminimin e pasigurisë juridike, me dispozitën e paragrafit 4 të këtij neni është parashikuar që trashëgimtarët kanë të drejtë ta ftojnë shfrytëzuesin e emëruar që, në afat prej një muaji, të deklarojë lidhur me këtë rrethanë. Nëse shfrytëzuesi nuk deklarojë brenda këtij afati, lind supozimi ligjor se shfrytëzuesi e ka refuzuar dobinë që i është dedikuar. Me supozimin se nuk ka shfrytëzues të tjerë, shuma e siguruar, siç është theksuar, i takon pasurisë së kontraktuesit të sigurimit (shih nenin 985 të LMD).

Neni 981. E drejta personale dhe e drejtpërdrejtë e shfrytëzuesit

- 1. Shuma e siguruar, e cila duhet t'i paguhet shfrytëzuesit nuk hyn në pjesën trashëgimore të kontraktuesit të sigurimit dhe as atëherë kur si shfrytëzues janë caktuar trashëgimtarët e tij.**
- 2. E drejta në shumën e siguruar i takon vetëm shfrytëzuesit, e pikërisht nga lidhja e kontratës së sigurimit dhe pavarësisht se si dhe kur është caktuar si shfrytëzues, e pavarësisht nëse ka deklaruar aprovimin e vet përpara ose pas vdekjes së të siguruarit, kështu që mund t'i drejtohet drejtpërdrejt siguruesit me kërkesën që t'i paguhet shuma e siguruar.**
- 3. Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit ka caktuar si shfrytëzues fëmijët e vet, pasardhësit ose trashëgimtarët e vet, në përgjithësi secili shfrytëzues, të caktuar kështu, i takon e drejta në pjesën përkatëse të shumës së siguruar megjithëse heq dorë nga trashëgimia.**

Vështrim i përgjithshëm.- Te ky sigurim (sigurimi i jetës në dobi të personit të tretë), për shtjelluar kuptimin dhe qëllimin e lidhjes së tij, do të ishte më se e nevojshme që, në masë të konsiderueshme, t'u shmangemi parimeve të përgjithshme të së drejtës trashëgimore dhe për këtë qëllim LMD njezh zgjidhje specifike. Ato janë të përmbajtura në dispozitat e disa neneve vijuese.

1. Shuma e siguruar nuk hyn në masën trashëgimore të kontraktuesit.- Nga pikëpamja e zbatimit të rregullave të së drejtës trashëgimore të marrëdhëniet nga sigurimi i jetës dy janë rrethana të mundshme: a) shfrytëzuesi nuk është i caktuar dhe b) shfrytëzuesi është i caktuar.

a) Nëse në kontratën e sigurimit nuk është caktuar shfrytëzuesi ose dispozita për caktimin e shfrytëzuesit, për çfarëdo arsye, është pa efekt, shuma e siguruar i takon kontraktuesit të sigurimit (neni 985 i LMD). Konsiderohet se sigurimi është lidhur në dobi të kontraktuesit e jo në dobi të personit të tretë. Në rastin e ndodhjes së rastit të siguruar (vdekjes së kontraktuesit), shuma e siguruar i takon pasurisë së kontraktuesit dhe, bashkë me të drejtat e tjera, kalon te trashëgimtarët e tij. Trashëgimtarët e tij nuk paraqiten si shfrytëzues të sigurimit në dobi të personit të tretë. Ata nuk kanë të drejtë të pavarur ndaj siguruesit, por as për padë të drejtpërdrejtë. Kreditorët e kontraktuesit, në raport me shumën e siguruar, kanë të njëjtat të drejta si edhe ndaj pasurisë tjetër të kontraktuesit. Shuma e siguruar mund të jetë objekt i konfiskimit, sigurimit të pagesës etj.

b) Te sigurimi i jetës në dobi të personit të tretë është rrethanë tipike që shfrytëzuesi të jetë i caktuar. Në rast të vdekjes së kontraktuesit të sigurimit, shuma e siguruar nuk hyn në trashëgimin e tij dhe i takon vetëm shfrytëzuesit (shfrytëzuesve). Shfrytëzuesi ka të drejtën e kërkesës së drejtpërdrejtë ndaj siguruesit. Është situatë e njëjtë kur si shfrytëzues është caktuar personi me të drejtë trashëgimore (p.sh., pasardhësi i kontraktuesit të sigurimit). Në atë rast bëhet ndarja e shumës së siguruar nga masa trashëgimore. Të drejtën e kërkesës së drejtpërdrejtë ndaj siguruesit, trashëgimtari i kontraktuesit të sigurimit e fiton në bazë të kontratës së sigurimit dhe jo në bazë të së drejtës trashëgimore. Për këtë arsye, në paragrafin

1 të këtij neni është parashikuar që shuma e siguruar nuk hyn në masën trashëgimore të kontraktuesit të sigurimit as atëherë kur si shfrytëzues janë caktuar trashëgimtarët e tij (neni 981 par. 1 i LMD). Trashëgimtarëve (shfrytëzuesve) u takon e drejta e shumës së siguruar edhe kur heqin dorë nga trashëgimia (neni 981 par. 3 i LMD). Për dallim nga situata nën a), kreditorët e kontraktuesit të vdekur të sigurimit nuk kanë të drejtë të kërkojnë që nga shuma e siguruar t'u paguhen kërkesat e tyre (neni 982 i LMD). Kontraktuesi i sigurimit, në momentin e vdekjes, as e ka pasur këtë të drejtë, sepse atë ia kishte kaluar shfrytëzuesit, prandaj atë që s'e ka pasur vetë, nuk ka mundur që, përmes të drejtës trashëgimore, t'ia kalojë tjetrit (trashëgimtarit).

2. E drejta e shfrytëzuesit mbi kërkesën është personale dhe e drejtpërdrejtë.- Me paragrafin 2 të këtij neni është vendosur parimi themelor për të drejtën e shfrytëzuesit të sigurimit nga e cila rrjedh edhe dispozita e paragrafit paraprak, e cila u shpjegua në paragrafin e 2 – se të drejtën e shumës së siguruar e ka vetëm shfrytëzuesi i emëruar. Ndaj siguresit ai ka të drejtën e kërkesës së drejtpërdrejtë për pagesën e shumës së siguruar. Këtë të drejtë ai e ka që nga momenti i lidhjes së kontratës së sigurimit, pavarësisht si dhe kur është caktuar si shfrytëzues. Është e parëndësishme edhe ajo se a e ka deklaruar pranimin e tij para apo pas vdekjes së të siguarit.

3. Kur shfrytëzuesit janë trashëgimtarë të kontraktuesit.- Siç u vu në dukje në komentimin e dispozitës së nenit 978 par. 4 të LMD, kontraktuesi i sigurimit nga kontrata e sigurimit të jetës ka mundësi që, në dobi të personit të tretë, si shfrytëzues t'i caktojë edhe trashëgimtarët e vet ligjorë, që në praktikë përbën rastin më të shpeshtë. Në paragrafit 3 të këtij neni secilit shfrytëzues të caktuar në mënyrë të tillë i takon e drejta e pjesës përkatëse të shumës së siguruar, megjithëse heq dorë nga trashëgimia. Kjo dispozitë është pasojë e dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni, sipas së cilës shuma e siguruar nuk hyn në masën trashëgimore të kontraktuesit të sigurimit edhe atëherë kur si shfrytëzues janë caktuar trashëgimtarët e tij. Heqja dorë nga trashëgimia nuk do të thotë heqje dorë edhe nga shuma e siguruar. Këtu vihet re zbatimi konsekuent i parimit të ndarjes së shumës së siguruar nga masa trashëgimore. Për të njëjtat arsye nuk ekziston e drejta e trashëgimtarëve ligjorë për pjesën e domosdoshme mbi shumën e siguruar. Shuma e siguruar i takon vetëm shfrytëzuesit i cili është caktuar me kontratë, me policë ose me një dokument tjetër.

Neni 982. Kreditori i kontraktuesit të sigurimit dhe të siguarit

- 1. Kreditorët e kontraktuesit të sigurimit dhe të të siguarit nuk kanë asnjë të drejtë në shumën e siguruar të kontraktuar për shfrytëzues.**
- 2. Në qoftë se premitë që i ka derdhur kontraktuesi i sigurimit kanë qenë përpjesëtimisht shumë të mëdha në krahasim me mundësitë e tij në çastin kur janë derdhur, kreditorët e tij mund të kërkojnë që t'u dorëzohet pjesa e premisë e cila tejkalon mundësitë e tij, nëse janë përmbushur kushtet në të cilat kreditorët kanë të drejtë në kundërshtimin e veprimeve juridike të debitorit.**

1. Kreditorët e kontraktuesit nuk e kanë të drejtën e shumës së siguruar.- Te marrëdhëniet që rrjedhin nga sigurimi i jetës në dobi të personit të tretë të drejtën e shumës së siguruar e ka vetëm shfrytëzuesi i sigurimit dhe këtë të drejtë mund ta realizojë drejtpërdrejtë nga siguroesi (neni 981 i LMD). E drejta e tij është burimore dhe e pavarur. Ajo mbështetet në kontratën e sigurimit, prandaj kjo është e natyrës kontraktuese. Pavarësia e së drejtës së shfrytëzuesit mbi shumën e siguruar i përjashton nga kjo e drejtë të gjithë të tjerët. Mbi shumën e siguruar nuk kanë të drejtë as kontraktuesi, as i siguruari (personi i siguruar), dhe shuma e siguruar nuk hyn as në pasurinë, as në masën trashëgimore të tyre. Prandaj është e logjikshme që të drejtën e shumës së siguruar nuk mund ta kenë as kreditorët e tyre. Në paragrafin 1 të këtij neni kjo në mënyrë shprehimore konfirmohet. Sipas kësaj dispozite, kreditorët e kontraktuesit të sigurimit dhe të siguruarit nuk kanë asnjë të drejtë mbi shumën e siguruar të kontraktuar për shfrytëzuesin. Me ndalesën e konfiskimit të shumës së siguruar, sigurohet që shumën e siguruar ta marrë ai person të cilit i është dedikuar ajo, d.m.th., shfrytëzuesit të sigurimit.

2. E drejta përjashtuese e kreditorit mbi pjesën e premisë.- Në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar një përjashtim nga dispozita e paragrafit 1 i këtij neni. Përjashtimi ka të bëjë me preminë e sigurimit të jetës. Me pagimin e premisë së sigurimit të jetës në dobi të personave të tretë nga ana e kontraktuesit të sigurimit, mund të dëmtohen kreditorët e kontraktuesit të sigurimit, sepse për shumën e premisë zvogëlohet pasuria e tij nga e cila ata do të mund t'i arkëtonin kërkesat e tyre. Në kufijtë e të dalave normale për këtë sigurim, kreditorët nuk kanë të drejtë të bëjnë kurrfarë kundërshtimi. Mirëpo, nëse janë plotësuar prezumimet e përgjithshme për kundërshtimin e punëve juridike të ndërmarra nga ana e debitorit në dëm të kreditorit, parashikuar nga rregullat e përgjithshme të së drejtës së detyrimeve (pjesa e III, nënkreu i 2., nenet 261 deri 266 të LMD), kreditorët, në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, kanë të drejtë të kërkojnë dorëzimin e pjesës së premisë. Sipas dispozitës së paragrafit 2 të këtij neni ata këtë të drejtë e fitojnë nëse premitë të cilat i ka paguar kontraktuesi i sigurimit kanë qenë përpjesëtimisht shumë të mëdha në krahasim me mundësitë e tij në çastin kur janë paguar. Në atë rast kreditorët kanë të drejtë të kërkojnë nga siguroesi që t'u dorëzohet pjesa e premisë e cila tejkalon mundësitë e kontraktuesit. Sipas rregullave të përgjithshme, konsiderohet se puna juridike është ndërmarrë në dëm të kreditorit, nëse për shkak të kësaj debitori nuk ka mjete të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së kreditorit (neni 261 par. 2 i LMD). Me normën juridike të këtij neni, ligjvënësi në mënyrë të qartë nisat nga supozimi se, në rrethana të jashtëzakonshme jetësore, veprimi i dëmshëm për kreditorin është e mundur të bëhet me lidhjen e kontratës së sigurimit me premi disproporcionale të sigurimit. Në mënyrë që kreditorët të mund t'i referohen këtij neni, është e nevojshme që, për shkak të pagesës së premive, debitori të mos ketë qenë në gjendje të përmbushë detyrimet e veta ndaj tyre. Barra e provimit të veprimit të dëmshëm i përket kreditorit. Punën juridike të debitorit ata mund ta atakojnë me padi ose me kundërshtim (shih komentin e dispozitës së nenit 265 të LMD).

Neni 983. Kalimi i shumës së siguruar

Të drejtën e vet në shumën e siguruar shfrytëzuesi mundet t'ia kalojë tjetrit edhe përpara rastit të siguruar, por për këtë i nevojitet pëlqimi me shkrim i kontraktuesve të sigurimit, ku duhet të shënohet emri i personave të cilëve u kalohet e drejta, e në qoftë se sigurimi shtrihet në jetën e ndonjë personi tjetër, atëherë nevojitet i njëjti pëlqim edhe i këtij personi.

Të drejtën e pagesës së shumës së siguruar shfrytëzuesi mundet t'ia kalojë tjetrit përpara dhe pas shkaktimit të rastit të siguruar. Vetëm kalimi i së drejtës para shkaktimit të rastit të siguruar është specifik për punën juridike të sigurimit. Pas shkaktimit të rastit të siguruar, kërkesën për pagesën e shumës së siguruar shfrytëzuesi mund t'ia kalojë tjetrit si edhe çdo kërkesë tjetër me kalimin juridiko-detyrues të së drejtës. Për këtë, LMD me dispozitën e këtij neni parashikon mundësinë e kalimit të së drejtës para ndodhjes së rastit të siguruar si dhe kushtet për vlefshmërinë e kalimit. Ato rrjedhin nga natyra e marrëdhënies që del nga ky sigurim. Nga aspekti i kalimit të së drejtës, janë dy situata të mundshme: a) kontraktuesi dhe i siguruari (personi i siguruar) janë persona të njëjtë, b) kontraktuesi dhe i siguruari janë persona të ndryshëm. Në rastin nën a), për vlefshmërinë e kalimit është i nevojshëm pëlqimi i kontraktuesit të sigurimit në formë të shkruar, ku duhet të shënohet emri i personit të cilit i kalohet e drejta. Nëse sigurimi ka të bëjë me jetën e ndonjë personi (rasti nën b), përveç pëlqimit me shkrim të kontraktuesit të sigurimit, është i nevojshëm edhe pëlqimi me shkrim i të siguarit (neni 983 i LMD). Për vlefshmërinë e kalimit të shumës së siguruar, sipas dispozitave të këtij neni, nuk kërkohet pëlqimi i siguresit, por, sipas rregullave të përgjithshme për kalimin e kërkesave, kërkohet që siguresi të njoftohet për ndërrimin e kreditorit (neni 422 i LMD). Arsyeja është e njëjtë sikurse edhe te rregullat e përgjithshme. Nëse shfrytëzuesi i sigurimit nuk e njofton siguresin lidhur me kalimin, përmbushja e borxhit ndaj shfrytëzuesit është e vlefshme dhe e liron debitorin – siguresin nga detyrimi i pagesës së shumës së siguruar ndaj kreditorit të ri (shih komentin e dispozitës së nenit 422 par. 2 të LMD).

Neni 984. Kur shfrytëzuesi i caktuar vdes përpara rrjedhjes së shumës për pagesë

Kur personi i cili pa shpërblim është caktuar si shfrytëzues vdes para arritjes së shumës së siguruar apo të rentës, dobia nga sigurimi nuk u takon trashëgimtarëve të tij, por shfrytëzuesit pasardhës, e në qoftë se ky nuk është caktuar, atëherë pasurisë së kontraktuesit të sigurimit.

Te marrëdhëniet nga sigurimi i jetës në dobi të personit të tretë, normalisht, supozohet se shfrytëzuesi i sigurimit do ta mbijetojë kontraktuesin e sigurimit. Kjo nuk duhet të jetë kështu, prandaj lind pyetja se cilës palë siguresi është i detyruar t'ia paguajë shumën e siguruar. Sipas dispozitave të këtij neni, kjo varet nga ajo se a ka qenë shfrytëzuesi i caktuar: a) pa shpërblim apo b) me shpërblim.

a) Kur personi i caktuar si shfrytëzues pa shpërblim vdes para arritjes së shumës së siguruar apo të rentës, dobia nga sigurimi nuk u takon trashëgimtarëve të tij, por shfrytëzuesit pasardhës dhe, në qoftë se ky nuk është caktuar, dobia i takon kontraktuesit të sigurimit. Dispozita e këtij neni bën përjashtim nga parimet e përgjithshme të së drejtës trashëgimore, sipas të cilave, e drejta e shfrytëzuesit të sigurimit do të duhej t'u kalonte trashëgimtarëve të tij. Shpjegimi për këtë përjashtim qëndron në bindjen se marrëdhëniet nga ky sigurim janë të natyrës personale, posaçërisht kjo rrjedh nga fakti se kontraktuesi e ka caktuar ndonjë person si shfrytëzues pa kurrfarë shpërblimi. Për këtë arsye, është logjike që ajo që vlen për marrëdhëniet e tyre reciproke, nuk vlen për marrëdhëniet e kontraktuesit të sigurimit ndaj trashëgimtarëve të tij, prandaj ata nuk mund t'i referohen të drejtës nga sigurimi i cili ka qenë i kontraktuar për paraardhësin e tyre. Në këtë situatë, konsiderohet se shfrytëzuesi as që ka ekzistuar, prandaj është parashikuar një pasojë e njëjtë juridike sikurse edhe te sigurimi për rast të vdekjes, kur shfrytëzuesi fare nuk është i caktuar (neni 985 të LMD). Dobia nga sigurimi i takon kontraktuesit të sigurimit si ta kishte kontraktuar dobinë për vete, përkatësisht për trashëgimtarët e vet.

b) Nëse shfrytëzuesi i sigurimit është caktuar me shpërblim, nuk zbatohet dispozita e këtij neni, por dobia nga sigurimi u kalon trashëgimtarëve të shfrytëzuesit të sigurimit. Kjo nuk është parashikuar shprehimisht në ligj, por me zbatimin e rregullave të përgjithshme mund të përfundohet si më sipër. Shihet qartë se këtu është fjala për punën juridike në bazë të së cilës shfrytëzuesi ka fituar të drejtën e plotë mbi shumën e siguruar në momentin e lidhjes së kontratës, prandaj ajo u kalon trashëgimtarëve sikurse edhe çdo e drejtë tjetër e tij.

Neni 985. Sigurimi për rast vdekjeje pa shfrytëzues të caktuar

Në qoftë se kontraktuesi i sigurimit për rastin e vdekjes nuk e cakton shfrytëzuesin, apo në qoftë se dispozita mbi caktimin e shfrytëzuesit mbetet pa efekt për shkak të revokimit, apo për shkak të refuzimit të personit të caktuar, ose cilido shkak tjetër, ndërsa kontraktuesi i sigurimit nuk cakton shfrytëzues tjetër, shuma e siguruar i takon pasurisë së kontraktuesit të sigurimit dhe si pjesa e saj kalon me të drejtat e tjera të tij në trashëgimtarët e tij.

Për sigurimin e jetës për rastin e vdekjes në dobi të personit të tretë, ekziston mundësia që kontraktuesi i sigurimit të vdesë, d.m.th. të ndodhë rasti i siguruar, ndërsa për arsye të ndryshme të mos ekzistojë shfrytëzuesi. Në atë situatë lind pyetja, sikurse edhe te neni i mëparshëm, se cilit person do t'i takojë dobia nga sigurimi (shuma e siguruar). Si arsye për të cilat mund të mos ekzistojë shfrytëzuesi, ligji i përmend këto: kontraktuesi nuk e ka caktuar shfrytëzuesin; dispozita për caktimin e shfrytëzuesit është pa efekt (për shkak të revokimit, refuzimi i personit të caktuar që ta pranojë dobinë ose cilido shkak tjetër). Me supozimin se kontraktuesi i sigurimit nuk e ka caktuar shfrytëzuesin tjetër, shuma e siguruar i takon kontraktuesit të sigurimit, domethënë trashëgimtarëve të tij. Konsiderohet si edhe në nenin paraprak, se kontraktuesi e ka kontraktuar dobinë për vete, përkatësisht për trashëgimtarët e vet.

Neni 986. Pagimi i ndërgjegjshëm i shumës së siguruar personit të paautorizuar

1. Kur siguroesi ia paguan shumën e siguruar personit i cili do të kishte të drejtë në të po të mos ta kishte caktuar shfrytëzuesin kontraktuesi i sigurimit, ky lirohet nga detyrimi prej kontratës së sigurimit në qoftë se në momentin e kryerjes së pagesës nuk ka ditur dhe as që ka mundur ta dinte se shfrytëzuesi është caktuar me testament ose me ndonjë akt tjetër, i cili nuk i është dorëzuar, ndërsa shfrytëzuesi ka të drejtë të kërkojë kthimin nga personi që ka pranuar shumën e siguruar.

2. E njëjta gjë vlen në rastin e ndërrimit të shfrytëzuesit

1. Caktimi i shfrytëzuesit të sigurimit është një e drejtë e pavarur dhe personale e kontraktuesit të sigurimit. Siç ka të drejtë ta caktojë një person për shfrytëzues, kontraktuesi ka të drejtë që në vend të tij ta caktojë një person tjetër ose më shumë sish. Ai këtë mund ta bëjë me një akt juridik ose me testament. Është detyrim kontraktuesi i kontraktuesit të sigurimit që për emërimin e një personi për shfrytëzues të sigurimit ose për ndërrimin e personit të shfrytëzimit ta njoftojë siguroesin, në mënyrë që ky të ketë dijeni se, në rast të ndodhjes së rastit të siguruar, cilit person ka për detyrë t'ia paguajë shumën e siguruar. Kjo është në përputhje edhe me parimin e mirëbesimit në sigurim. Me dispozitën e këtij neni mbrohet siguroesi i ndërgjegjshëm, i cili ia ka bërë pagesën e shumës së siguruar personit të cilit do t'i përkiste ajo (pagesa), sikur kontraktuesi i sigurimit të mos e kishte caktuar ose ndërruar shfrytëzuesin dhe për këtë të mos e ketë njoftuar siguroesin. Sipas dispozitave të këtij neni, në raste të tilla, siguroesi është i liruar nga detyrimi që del nga kontrata e sigurimit, në qoftë se në momentin e kryerjes së pagesës nuk ka ditur dhe as ka mundur të dinte se shfrytëzuesi është caktuar me testament ose me ndonjë akt tjetër, i cili nuk i është dorëzuar këtij nga ana e kontraktuesit të sigurimit. Duke marrë parasysh se të drejtën e shumës së siguruar e ka vetëm shfrytëzuesi i sigurimit, pavarësisht nga ajo se si dhe kur është caktuar për shfrytëzues, në rast të pagesës së shumës së siguruar personit tjetër, shfrytëzuesi është i autorizuar që nga ky person të kërkojë kthimin e shumës së sigurimit të marrë nga ana e tij (neni 986 i LMD). Kjo është në përputhje me rregullën e përgjithshme për fitimin e dobisë pa bazë (neni 194 i LMD)⁸⁸⁴.

2. Nëse siguroesi bënë pagesën e shumës së siguruar personit për të cilin ka ditur ose ka mundur të dinte se nuk është shfrytëzues i autorizuar, kurse siguroesi i vërtetë nuk mund të arrijë të kompensohet nga ai, në përputhje me dispozitën e këtij neni, siguroesi i përgjigjet shfrytëzuesit të vërtetë për shpërblimin e dëmit të pësuar në këtë mënyrë (neni 136 i LMD).

884 Shih aktgjykimin e Gjykatës Komunale Prishtinë, C. nr. 815/2002, dt. 31.03.2006,

Nerxhivane Dauti

Neni 987. Nocioni

Ortakëria është bashkim me kontratë i dy ose më shumë personave (ortakëve) për arritjen e ndonjë qëllimi të përbashkët të lejuar nga e drejta, me punë ose mjete të përbashkëta të caktuara me kontratë.

Kontrata për ortakërinë bën pjesë në grupin e kontratave për formimin e bashkësisë së pasurisë dhe të punës. Me kontratë për ortakërinë kuptojmë atë kontratë me anë të së cilës dy ose më shumë subjekte, që quhen ortakë, hyjnë në detyrimin të bashkojnë pjesë të caktuara të pasurisë së tyre ose punën e tyre me qëllim të realizimit të ndonjë dobie pasurore, ekonomike.⁸⁸⁵ Kjo është kontratë e rregulluar me dispozitat juridike të Ligjit për Detyrimet të Kosovës, konkretisht me nenet 826-863.

Subjektet që e lidhin këtë kontratë, përkatësisht subjektet që hyjnë në detyrimin për të bashkuar pjesë të caktuara të pasurisë ose punën e tyre me qëllim që të arrijnë ndonjë qëllim ekonomik, quhen ortakë (të bashkuar). Bashkësia e dy ose më shumë subjekteve të lidhura me kontratë quhet ortakëri ose shoqëri. Pasuria ose puna që e bashkojnë ortakët quhet pjesë e ortakërisë, kurse pasuria e përbashkët e tyre është kryegjëja e ortakëve.⁸⁸⁶

Edhe pse behet bashkimi i pasurisë, i punës ose i kapitalit të ortakëve në atë bashkësi, pasuria e ortakërisë nuk i ka vetitë e veçanta të personit juridik.

Karakteristikat kryesore të kontratës për ortakërinë janë:

- është *kontratë detyruese e dyanshme*, e cila krijon detyrime të caktuara për secilin ortak. Secili prej ortakëve është i detyruar të bashkojë një vlerë të caktuar pasurore në ortakëri. Të gjithë ortakët marrin detyrim reciprokisht;
- është *kontratë konsensuale*, e cila lidhet me pëlqimin e thjeshtë të vullnetit të ortakëve lidhur me elementet qenësore të saj. Mirëpo, në ato raste kur qytetarët bashkohen me qëllim të ndërtimit të banesës së përbashkët, kontrata për ortakërinë duhet të lidhet me formë të shkruar dhe me vënien e nënshkrimeve të kontraktuesve që vërtetohen nga organi kompetent.⁸⁸⁷
- ajo ka *elemente të aleatorësisë*, sepse këtu është e pasigurtë se sa do të marrë secili ortak pas arritjes së qëllimit të caktuar. Ka mundësi që secili ortak të marrë me pak sesa që ka dhënë, ose të mos marrë asgjë për shkak të afarizimit të dobët ose për shkak të zhdukjes së objektit të ortakërisë.⁸⁸⁸

.....
885 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 374; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 193.

886 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 193.

887 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 375.

888 Po aty.

- është kontratë që bazohet në besimin e palëve kontraktuese (**intuitu personae**). Ata krijojnë bashkësinë në të cilën duhet të sillen në mënyrë vëllazërore ndaj njëri-tjetrit.

Kontrata për ortakërinë është kontratë e vjetër e së drejtës së detyrimeve. Në të drejtën klasike romake kontrata për bashkësinë ose ortakëllëqet, *societas omnium bonorum*, ishte kontratë konsensuale e dyanshme ose e shumanshme, e cila krijohej me shprehjen e pajtuar të vullnetit të anëtarëve të bashkësisë (**socii**) që të krijojë pasurinë e përbashkët, që me atë pasuri të zotërojnë bashkërisht dhe që së bashku ta ndajnë fitimin e realizuar me ekonomizim të përbashkët.⁸⁸⁹ Ortakëllëqet krijoreshin në tri raste: si *societas quaestus*, si *societas negotiationis* dhe si *societates unis rei*. Detyrimi themelor i çdo anëtari të bashkësisë ishte që në bashkësi të futë ose tërë pasurinë (*omnium bonorum*), ose pjesën e kontraktuar të pasurisë. Detyrimi i dytë i çdo anëtari të bashkësisë ishte që të merrte pjesë në administrimin dhe në zotërimin e sendeve të përbashkëta. Detyrimi i tretë i çdo anëtari të bashkësisë ishte që t'u linte në dispozicion anëtarëve çdo fitim (*communicatio lucris*) të realizuar, duke i ekonomizuar sendet e bashkësisë, në mënyrë që ai të mund të ndahej midis të gjithë anëtarëve sipas kuotës që ishte kontraktuar me rastin e themelimit të bashkësisë. Për realizimin e të drejtave që i pranoheshin secilit anëtar të bashkësisë, mund të përdorej **actio pro socio**. Kur shuhej bashkësia dhe shoqërohej me mospajtime rreth ndarjes së pasurisë së përbashkët, përdorej **actio de communi dividundo**.⁸⁹⁰

Kjo kontratë ka pasur rëndësi të madhe në kapitalizëm, në të cilin bashkësia pasurore ose puna e ortakëve përfshinte kapitalin e tyre për arritjen e qëllimit të caktuar ekonomik. Në kapitalizëm ortakëria ka statusin e personit juridik.

Në të drejtën bashkëkohore kjo kontratë nuk e ka rëndësinë që e kishte më parë, por ka raste të shpeshta të lidhjes së saj ndërmjet qytetarëve që bashkohen me qëllim të ndërtimit të objekteve banesore të përbashkëta, me ç'rast bashkohen mjetet dhe puna për realizimin e qëllimit të kontraktuar.

Për t'u lidhur kontrata për ortakërinë duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme për lidhjen e saj: pajtimi i vullnetit, objekti dhe baza e kontratës.

Ortakët duhet ta pajtojnë vullnetin e tyre përkitazi me pjesët e ortakëve, qëllimin që dëshirojnë ta arrijnë dhe kohëzgjatjen e ortakërisë. Këto paraqesin edhe elementet thelbësore të kësaj kontrate.

Kontrata për ortakërinë me qëllim ndërtimin e përbashkët të ndërtesave për banim duhet të përmbajë:

- rregullat për sasinë e shumës në para ose të pasurisë tjetër, të cilën disa ortakë e futin në ortakëri,

.....
889 Dr. I. Puhan, vep. e cit., fq. 357.

890 Po aty, fq. 359.

- rregullat për të drejtat dhe detyrimet e ortakëve,
- rregullat për udhëheqjen e punëve të ortakëve,
- autorizimin për lidhjen e punëve me personat e tretë,
- rregullat për atë se cilat banesa ose lokale punuese do të jenë në pronësinë e ortakut të caktuar,
- rregullat për shuarjen e ortakërisë dhe likuidimin e marrëdhënieve ndërmjet ortakëve.

Në rast se ndonjëra prej këtyre rregullave nuk përfshihet në kontratë, ajo nuk mund të regjistrohet në kuvendin komunal për çështje banesore.⁸⁹¹

Në vazhdim do t'i analizojmë elementet thelbësore të kësaj kontrate.

Me lidhjen e kontratës për ortakërinë, ortakët synojnë realizimin e një qëllimi të caktuar. Qëllimi i ortakërisë është qëllim ekonomik, i cili duhet të realizohet me bashkimin e pasurisë dhe të punës të ortakëve. Qëllimi ekonomik, që synohet të realizohet me këtë kontratë, duhet të jetë i lejuar dhe në pajtim me normat e moralit shoqëror.

Koha e zgjatjes së kësaj kontrate është e kufizuar. Se sa do të zgjasë kontrata për ortakërinë, varet nga kontrata dhe realizimi i qëllimit të përcaktuar në kontratë. Nëse ortakëria është lidhur për kohë të caktuar, ajo shuhet me skadimin e asaj kohe. Nëse koha e zgjatjes së kontratës varet nga realizimi i qëllimit ekonomik, atëherë ajo do të shuhet me realizimin e këtij qëllimi.

Përparësia e kontratës për themelimin e ortakërisë rregullohet me nenin 827 të LMD. Ky nen është shprehimor dhe mjaft konciz. Sipas këtij neni, marrëdhëniet juridike të ortakëve rregullohen me kontratën për themelimin e ortakërisë. (Lidhur me kontratën për ortakërinë, kemi paraqitur komente në nenin 826).

Neni 988. Kontributet

- 1. Në ortakëri, secili ortak është i detyruar të kontribuojë për atë që është përcaktuar në kontratë (kontributi).**
- 2. Kontributi mund të jetë në para, send, e drejtë, kërkesë, ose shërbim, e ardhur apo lejimi i vlerës së pajisjeve.**
- 3. Ortakët përveç kur parashikohet ndryshe me kontratë, kanë për detyrë të japin kontribut të barabartë.**
- 4. Në formë të kontributit në ortakëri, mund të jepet edhe prona për përdorim dhe shfrytëzim.**
- 5. Nëse ndonjërit prej ortakëve i sigurohen vetëm përfitime pa detyrimin që të ofrojë kontribut, atëherë kjo kontratë nuk konsiderohet ortakëri. 216**

.....
891 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 197.

- 6. Nëse është e nevojshme ruajtja e mjeteve të ortakërisë apo për të shmangur dëmin, secili ortak është i detyruar të kontribuojë në pjesë proporcionale të asaj që është e nevojshme për ruajtjen e mjeteve apo parandalimin e dëmit, përveç kontributit të përcaktuar në kontratë.**
 - 7. Secili ortak është përgjegjës si shitësi për të metat juridike dhe materiale të kontributit të tij.**
-

Pjesa e pasurisë që bashkohet në ortakëri është pjesë alikuote e çdo ortaku. Kjo pjesë do të varet nga qëllimi që dëshiron ta realizojë çdo ortak. Kryesore është që çdo ortak ta bashkojë pjesën e tij në ortakëri. Ndonjëherë mund të ndodhë që ortaku ta bashkojë një pjesë të pasurisë së vet, por mund ta bashkojë edhe tërë pasurinë e vet. Ortaku mund ta bashkojë edhe punën. Puna këtu mund të jetë thjesht fizike, por mund të jetë edhe thjesht profesionale. Te puna, me rëndësi është që ajo të ketë vlerë pasurore.⁸⁹²

Te kontrata për ortakërinë, çdo ortak bashkon pasurinë e tij ose punën e tij. Ky bashkim nuk është i njëjtë. Themi kështu sepse, ndonjëherë, ortaku bashkon një sasi të pasurisë së tij, një të tretën e pasurisë ose krejt pasurinë. Kur ai bashkon punën, atëherë duhet thënë se nëse bashkon punën fizike, duhet të dihet se sa veta e kryejnë atë punë. Kur bashkohet puna profesionale, atëherë duhet të çmohet vlera e asaj pune profesionale dhe roli i saj në realizimin e qëllimit të kontratës së ortakërisë. Kur është fjala për pjesën e çdo ortaku, duhet thënë se kjo pjesë caktohet në mënyrë precize në kontratë, sepse sipas kësaj pjesë ose sipas punës fizike apo profesionale, ortaku realizon edhe profitin e caktuar. Nëse ndodh që të harxhohet pasuria e ortakërisë, ortakët merren vesh për bashkimin e pjesëve të tjera të pasurisë ose të punës.

Sipas parag 2 të nenit 988, të drejtat që hyjnë në ortakëri, në rast dyshimi, konsiderohen pasuri e përbashkët e ortakëve. Ndërkaq, sipas parag. 3, kontributi i një ortaku mund të jetë edhe në dhënie të shërbimeve.

Pjesët e ortakëve paraqesin kontributin e palëve kontraktuese të dhënë në bashkësinë për krijimin ose arritjen e dobisë së përbashkët materiale. Pjesët e ortakëve paraqesin objektin e kontratës për ortakërinë. Pjesë të ortakëve mund të jenë: sendet, të drejtat ose puna e subjektit që është ortak.

Pjesët e ortakëve as nga cilësia, as nga sasia nuk është e domosdoshme të jenë të barabarta. Pjesa e njërit ortak mund të jetë në para, e tjetrit në tokë, e të tretit në makina për kryerjen e punës, e të katërtit në punë, e të pestit edhe sende edhe punë etj.⁸⁹³

892 Enciklopedija imovinskog prava i prava udruženog rada, Beog., II, 1978, fq. 692. Pravna enciklopedija, Beog., 1979, fq. 896.

893 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 376.

Sendi ose e drejta, si pjesë e ortakëve, duhet të kenë vlerë pasurore dhe të cedohen. Edhe puna, si pjesë e ortakëve, duhet të ketë vlerë pasurore. Puna mund të jetë fizike, (p.sh. mihja e tokës), intelektuale (punimi i projektit të ndërtesës për banim), pozitive (veprimi) ose edhe negative (mosveprimi).⁸⁹⁴

Lartësia e pjesës së ortakëve caktohet saktësisht me kontratë nga palët kontraktuese (neni 988 parag. 1, 2, 3 të LMD).

Neni 989. Vendimet e ortakëve dhe udhëheqja

- 1. Secili ortak ka një votë. Me anë të kontratës mund të përcaktohet që ortakët të kenë numër të ndryshëm votash.**
- 2. Për punët e ortakërisë, ortakët marrin vendimet në mënyrë unanime. Sipas kësaj mënyre, ortakët vendosin sidomos për përdorimin e fitimit dhe përfitimeve tjera, për mënyrën se si të mbulohet humbja, për pranimin e një ortaku të ri apo përjashtimin e ndonjë ortaku ekzistues, për kërkesat e secilit ortak në lidhje me dëmet ndaj ortakërisë, shkarkimin e udhëheqjes, shkëputjen e kontratës dhe për çështjet e tjera në lidhje me udhëheqjen.**
- 3. Me anë të kontratës mund të përcaktohet se për çështjet e përcaktuara në paragrafin e mëparshëm, ortakët vendosin me shumicë votash. Në rastin e tillë, për marrjen e vendimit kërkohen shumica e votave apo të paktën dy të tretat e votave.**
- 4. Ortakët duhet të organizojnë udhëheqjen së bashku dhe në mënyrë të barabartë.**
- 5. Me anë të kontratës mund të përcaktohet që secili prej ortakëve kryen udhëheqje në mënyrë të pavarur, ose që udhëheqja të kryhet vetëm nga disa prej ortakëve, ose nga një apo më shumë persona të emëruar nga ortakët me unanimitet.**
- 6. Mbi baza të justifikueshme, ortakët mund të përjashtojnë udhëheqjen nga ndonjëri prej ortakëve.**
- 7. Natyra e dispozitave të këtij ligji mbi kontratën për urdhrin zbatohen në lidhje me udhëheqjen.**
- 8. Nëse parashikohet me kontratë, udhëheqësi ka të drejtë në pagesë për punën e tij.**
- 9. Secili ortak ka të drejtë që të jetë i informuar për të gjitha punët dhe çështjet e ortakërisë.**

Ortakët duhet të pajtohen për bashkimin e punës dhe të mjeteve me qëllim të lidhjes së kontratës për ortakërinë. Ata së paku duhet të merren vesh për elementet esenciale të kësaj kontrate. Ndërsa elementet esenciale të saj janë; 1) pjesa e çdo ortaku që bashkon ortakërinë, 2) qëllimi që dëshiron të arrijë dhe 3) zgjatja e ortakërisë. Këtu ortakët duhet të japin veç e veç pëlqimin e tyre për lidhjen e kësaj kontrate. Çdo ortak paraqet vullnetin e vet se përse

⁸⁹⁴ Enciklopedia imovinskog prava i prava udruženog rada, Beograd, II, 1978, fq. 692.

është i interesuar të dijë për pozitën e vet në këtë kontratë. Ky pëlqim i ortakëve nevojitet edhe për ndryshimin e përmbajtjes së kësaj kontrate. Për detyrimet që krijohen në bazë të kontratës për ortakërinë, ortakët përgjigjen me tërë pasurinë që kanë. Për këtë ortakët jo vetëm që duhet të kenë pasuri, por edhe duhet të kenë zotësi për të vepruar. Kuptohet se vullneti i ortakëve, si edhe në rastet jashtë kësaj kontrate, duhet të jetë serioz, duhet të jetë i mundshëm, duhet të mos ketë mungesa dhe duhet të drejtohet në diçka që është e lejuar.

Sipas nenit 989 parag. 1 i LMD, vendimet e ortakëve merren me pajtimin e vullnetit të të gjithë ortakëve, në qoftë se me kontratën për themelimin nuk është caktuar ndryshe. Në rastet konkrete, kur sipas kontratës për themelimin e ortakërisë, vendimet merren me shumicë votash, shumica llogaritet sipas numrit të përgjithshëm të ortakëve. (parag. 2 i nenit 833 të LMD).

Neni 990. Ushtrimi i të drejtave dhe detyrimeve në ortakëri

- 1. Secili partner duhet t'i kryej punët e ortakërisë dhe detyrimet tjera në lidhje me të me kujdesin dhe sipas mënyrës që i kryen punët e veta.**
- 2. Nëse qëllimi i ortakërisë është i lidhur me aktivitetet e ortakëve apo profesionin e tyre, ata janë të detyruar të veprojnë me kujdesin e ekonomistit të mirë apo me kujdesin e ekspertit të mirë.**
- 3. Ortaku nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim që do të rrezikonte arritjen e qëllimit të përbashkët.**

Detyrimet e ortakëve janë:

- të futin në ortakëri pjesë të caktuara (sende, të drejta ose punë të caktuara), që kanë vlerë pasurore,
- të udhëheqin ortakërinë kur nuk është i caktuar punëdrejtuesi i ortakërisë. Udhëheqjen e ortakërisë ortakët mund t'ia besojnë njërit ose disave prej ortakëve ose një personi të tretë, të cilët e marrin cilësinë e punëdrejtuesit të ortakërisë,
- të paraqesin raport dhe të japin llogari për punët që i kanë ndërmarrë në emër të ortakërisë. Raporti për punën dhe deponimi i llogarive për punët e ortakërisë bëhen në afatin e caktuar në kontratë, por nëse nuk është parashikuar në kontratë, jepen në fund të vitit,
- të marrin pjesë në ndarjen e humbjeve, nëse nuk do të realizojnë sukses në punën e tyre të përbashkët,
- të përgjigjen solidarisht për borxhet e ortakërisë ndaj personave të tretë.
- Këto detyrime përmbushen nga pasuria e ortakërisë, por nëse me të nuk arrihet përmbushja e kreditorëve, kreditori mund të marrë borxhin prej cilitdo ortak. Këtu ekziston përgjegjësia solidare e ortakëve dorëzanë për borxhet e ortakërisë.

Neni 991. Fitimi dhe humbja

- 1. Përveç kur përcaktohet ndryshe me kontratë, secili ortak ka të drejtë në pjesën e fitimit të arritur në ortakëri.**
- 2. Secili partner është i detyruar të marr përsipër pjesën e humbur që ka ndodhur nga funksionimi i ortakërisë.**
- 3. Ortakët marrin pjesë në fitim në fitim dhe humbje në mënyrë të barabartë në përpjesëtim me pjesët e tyre të kontributit, përveç kur përcaktohet ndryshe me kontratë.**

E drejtë themelore e të gjithë ortakëve është pjesëmarrja në ndarjen e fitimit të realizuar me bashkimin e pasurisë dhe të punës. Në ndarjen e fitimit të realizuar duhet të marrin pjesë të gjithë ortakët. Se në çfarë mase do të marr pjesë secili prej ortakëve në ndarjen e fitimit, varet prej marrëveshjes së palëve kontraktuese. Ortakët mund ta caktojnë përqindjen e pjesëmarrjes së secilit ortak në ndarjen e fitimit, në pjesë të barabarta ose të pabarabarta. Nëse palët nuk e kanë caktuar me marrëveshje mënyrën e ndarjes së fitimit, konsiderohet se secili ortak ka të drejtën e pjesës së barabartë të masës së fitimit, pa marrë parasysh vlerën e pjesëve të tij dhe pa marrë parasysh që autorizimi ka qenë pjesa e tyre e përbërë nga sendet, të drejtat ose puna e caktuar.⁸⁹⁵

Sipas nenit 991, ortakut i takon e drejta e shpërblimit të shpenzimeve dhe humbjeve. Shpenzimet duhet të jenë të nevojshme. Në qoftë se ortaku në punët e ortakërisë ka pasur shpenzime që konsiderohen të nevojshme ose ka pësuar humbje drejtpërdrejt me udhëheqjen e punëve të tij, ortakët e tjerë janë të detyruar t'ia shpërblejnë shpenzimet e shkaktuara. Ortakët e tjerë janë të detyruar t'ia shpërblejnë shpenzimet proporcionalisht me pjesët e tyre dhe me këtë rast paguhet edhe kamata ligjore nga çasti i shkaktimit të tyre.

Në rastin tjetër, në qoftë se ortaku në punët e ortakërisë ka pësuar humbje drejtpërdrejt me udhëheqjen e punëve të tij ose nga rreziqet që drejtpërdrejt janë të lidhura me to, ortakët e tjerë janë të detyruar t'ia shpërblejnë shpenzimet proporcionalisht me pjesët e tyre.

895 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 378; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 203.

Neni 992. Paraqitja tek personat e tretë

- 1. Ortaku apo udhëheqësi që paraqitet në emër të vetë dhe për llogari të ortakërisë kundrejt personave të tretë, të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me personin e tretë i bartin vet.**
- 2. Në qoftë se ortaku lidh punët me ndonjë person të tretë në emër të ortakërisë ose të të gjithë ortakëve, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji mbi përfaqësimin.**
- 3. Për rastet e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni të gjithë ortakët bëhen kreditor apo debitor të përbashkët dhe të ndarë dhe dispozitat e këtij ligji për përgjegjësinë e përbashkët dhe të ndarë do të zbatohen. Marrëveshja ndërmjet ortakëve që përcakton diçka tjetër nga mësipër nuk ka efekt ligjor ndaj personave të tretë.**
- 4. Me shpërndarjen e ortakërisë, detyrimet e ortakëve ndaj personave të tretë, sipas këtij neni, nuk shuhen.**

Përfaqësimi gjen shprehje në nenin 992 të LMD. Përfaqësimi paraqitet në rastet kur ortaku lidh punët me ndonjë person të tretë për llogari të ortakërisë, në emrin personal, kur bëhet vetë i autorizuar dhe i detyruar ndaj personit të tretë.

Sipas parag. 2 të këtij neni të LMD, në qoftë se ortaku lidh punë me ndonjë person të tretë në emër të ortakërisë ose të të gjithë ortakëve, ortakët e tjerë bëhen të autorizuar dhe të detyruar ndaj personit të tretë sipas dispozitave për përfaqësimin.

Kur në rastin konkret ortakut i takon autorizimi për udhëheqjen e punëve, konsiderohet se është i autorizuar të përfaqësojë ortakërinë ose të gjithë ortakët. (Parag. 3 i nenit 992 të LMD). Sipas nenit 992 parag. 4 i LMD, e njëjta gjë vlen përshtatshëm për caktimin e personit të tretë si punëdrejtues.

Neni 993. Pasuria e ortakërisë

Përveç nëse parashikohet ndryshe me kontratë, ortakët kanë të drejta të barabarta mbi bashkëpronësinë dhe pjesët tjera të përbashkëta që kanë ardhur nga kontributet e ortakëve apo veprimtaria e ortakërisë.

Pasuria e ortakërisë rregullohet shprehimisht me nenin 993 të LMD.

Pjesët e ortakëve paraqesin kontributin e palëve kontraktuese të dhënë në bashkësi për krijimin ose arritjen e dobisë së përbashkët materiale. Pjesët e ortakëve paraqesin objektin e kontratës për ortakërinë. Pjesë të ortakëve mund të jenë: sendet, të drejtat ose puna e subjektit që është ortak.

Pjesët e ortakëve as për nga cilësia, as për nga sasia nuk është e domosdoshme të jenë të barabarta. Pjesa e njërit ortak mund të jetë në para, e tjetrit në tokë, e të tretit në makina për kryerjen e punës, e të katërtit në punë, e të pestit në sende edhe punë etj.⁸⁹⁶

Sendi ose e drejta, si pjesë e ortakëve, duhet të kenë vlerë pasurore dhe të cedohen. Edhe puna, si pjesë e ortakëve, duhet të ketë vlerë pasurore. Puna mund të jetë fizike (p.sh. mihja e tokës), intelektuale (punimi i projektit të ndërtesës për banim), pozitive (veprimi) ose edhe negative (mosveprimi).⁸⁹⁷

Masa e pjesës së ortakëve caktohet saktësisht me kontratë nga palët kontraktuese.

Sipas parag. 2 të nenit 993 të LMD, pasuri e ortakërisë është edhe ajo që fitohet në bazë të ndonjë të drejte, e cila i takon pasurisë së ortakërisë ose si shpërblim për shkatërrimin, dëmtimin ose marrjen e ndonjë objekti që i takon pasurisë së ortakërisë. Kërkesat e ortakërisë veprojnë kundër debitorit nga momenti kur ai vihet në dijeni ose është dashur të vihet në dijeni se kërkesat i takojnë pasurisë së ortakërisë.

Neni 994. Marrëdhënia ndërmjet ortakëve

- 1. Ortakët janë të detyruar që në pjesë të barabarta, t'i mbulojnë shpenzimet për detyrimet ndaj personave të tretë, nëse nuk mund të mbulohen nga pasuria e ortakërisë, përveçse ndryshe parashikohet me kontratë.**
- 2. Ortaku i cili ndaj personave të tretë, për zbatimin e kontratës ka mbuluar ndonjë shpenzim apo ndonjë detyrim të ortakërisë, që tejkalon shumë për të cilën sipas kontratës ka qenë i detyruar ta mbulojë, ka të drejtë të kërkojë kthimin në pjesë proporcionale nga ortakët e tjerë.**

Sipas nenit 994, ortakut i takon e drejta e shpërblimit të shpenzimeve dhe humbjeve. Shpenzimet duhet të jenë të nevojshme. Në qoftë se ortaku në punët e ortakërisë ka pasur shpenzime që konsiderohen të nevojshme ose ka pësuar humbje drejtpërdrejt me udhëheqjen e punëve të tij, ortakët e tjerë janë të detyruar t'ia shpërblejnë shpenzimet e shkaktuara. Ortakët e tjerë janë të detyruar t'ia shpërblejnë shpenzimet proporcionalisht me pjesët e tyre dhe me këtë rast paguhet edhe kamata ligjore nga çasti i shkaktimit të tyre.

Në rastin tjetër, në qoftë se ortaku në punët e ortakërisë ka pësuar humbje drejtpërdrejt me udhëheqjen e punëve të tij ose nga rreziqet që janë të lidhura drejtpërdrejt me to, ortakët e tjerë janë të detyruar t'ia shpërblejnë shpenzimet proporcionalisht me pjesët e tyre.

896 Dr. Lj. Milošević, Vep. e cit, fq. 376.

897 Enciklopedija imovinskog prava – prava udruženog rada, Bg., II, fq. 692.

Detyrë e ortakëve është të marrin pjesë në ndarjen e humbjeve, nëse nuk do të realizojnë sukses në punën e tyre të përbashkët. Ata përgjigjen solidarisht për borxhet e ortakërisë ndaj personave të tretë. Këto detyra përbushen nga pasuria e ortakërisë, por në rast se me të nuk arrihet përbushja e kreditorëve, kreditori mund të marrë borxhin prej cilitdo ortak. Këtu ekziston përgjegjësia solidare e ortakëve si dorëzanë për borxhet e ortakërisë. Në qoftë se ortakët bashkërisht ose me përfaqësim kanë marrë detyrime ndaj personit të tretë, përgjigjen edhe me tërë pasurinë e tyre si debitorë solidarë.

Konsiderohet se një marrëveshje e kundërt është e pavlefshme ndaj personave të tretë.

Neni 995. Ndërrimi i ortakëve

- 1. Ortakërisë mund ti shtohet ortaku i ri nëse kontrata e lejon një gjë të tillë.**
- 2. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me kontratë, ortaku i ri që hyn në ortakëri është i detyruar që të japë kontributin e njëjtë sikur partnerët tjerë si dhe ka të drejtë në përfitimin që është realizuar pas hyrjes së tij në ortakëri.**
- 3. Ortaku i ri është përgjegjës ndaj personave të tretë vetëm për detyrimet që rrjedhin pas hyrjes së tij si ortak.**
- 4. Ortaku nuk mund t'ia kalojë pozitën e tij personit të tretë, por mund ta kalojë atë tek një ortak tjetër dhe vetëm nëse kontrata e lejon një gjë të tillë dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.**

Ekziston mundësia që ortakërisë t'i shtohet ortaku i ri. Ortaku i ri që hyn në ortakëri është i obliguar që të japë kontribut të njëjtë me partnerët e tjerë dhe ka të drejtë të marrë pjesë në fitimin që është realizuar pas hyrjes së tij në ortakëri. Sipas LMD, ortaku i ri është përgjegjës ndaj personave të tretë vetëm për detyrimet që rrjedhin pas hyrjes së tij si ortak. Ligji parashikon mundësinë që ortaku nuk mund t'ia kalojë pozitën e tij një personi të tretë, por mund ta kalojë atë te një ortak tjetër dhe vetëm nëse kontrata e lejon një gjë të tillë dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Neni 996. Përjashtimi i ortakut

- 1. Me anë të padisë ortakët mund të kërkojnë përjashtimin e ndonjë partneri nëse për këtë ekzistojnë arsye të mjaftueshme. Kontrata mund të përcaktojë se ortakët mund të vendosin vet për përjashtimin e një ortaku. Në një rast të tillë përmes padisë ortaku i larguar mund të kërkojë anulimin e një vendimi të tillë nëse mendon se është marrë në mënyrë të padrejtë.**

- 2. Ortaku i përjashtuar ka të drejtë për pjesët e kontributit të tij në shumën e vlerës së tregut që këto pjesë kanë në momentin e përjashtimit.**
 - 3. Ortakët e tjerë duhet të paguajnë këtë shumë brenda tre (3) viteve nga momenti i përjashtimit.**
 - 4. Nëse ortakët tjerë kërkojnë kompensim nga ortaku i përjashtuar, ata mund të ndalin vlerën e pjesës së partnerit të përjashtuar derisa vendimi gjyqësor të marrë formën e prerë apo derisa të arrihet një marrëveshje me ortakun e përjashtuar.**
-

Ligji parashikon në nenin 996 parag. 1, 2 mundësinë e përjashtimit të ortakut nga ortakëria. Ortaku mund të përjashtohet nga ortakëria, në qoftë se për përjashtimin e tij ekzistojnë shkaqe të arsyeshme. Si shkaqe më të rëndësishme të përjashtimit të ortakut janë: së pari, cenimi thelbësor i detyrimit të kontratës për ortakërinë, së dyti, humbja e plotë ose e pjesshme e zotësisë për të vepruar dhe, së treti, humbja e besimit për shkak të kryerjes së veprës penale. Këto shkaqe janë parashikuar në nenin 996 parag. 1 i LMD.

Lidhur me përjashtimin e ortakut nga ortakëria, duhet të merret vendim për një përcaktim të tillë. Vendimi për përjashtim merret "... njëzëri nga ortakët e tjerë" (parag. 2 i nenit 996). Vendimi për përjashtim ka efekt nga dita e komunikimit ortakut të përjashtuar.

Neni 997. Shuarja e Ortakërisë

1. Ortakëria shuhet:

- 1.1. me kalimin e kohës për të cilin është themeluar;**
- 1.2. me përmbushjen e qëllimit të kontraktuar ose kur arritja e këtij qëllimi bëhet e pamundshme;**
- 1.3. me vendim të ortakëve;**
- 1.4. me vdekjen e një ortaku apo me humbjen e kapacitetit të tij kontraktorë, ose nëse ndaj ortakut si tregtarë i vetëm kanë filluar procedurat për falimentim, likuidim apo shpërbërje;**
- 1.5. nëse një ortak pushon së ekzistuari si person juridik për shkak të ndryshimit të statusit apo nëse ndaj tij ka filluar procedura për falimentim likuidim apo shpërbërje;**
- 1.6. nëse pas zbatimit të tyre, pjesët e kontributit janë marrë nga një person i tretë;**
- 1.7. nëse me vendim të autoritetit publik ortakut i është ndaluar ushtrimi i aktiviteteve të cilat janë qenësore për arritjen e qëllimit të përbashkët;**
- 1.8. Nëse ortaku e denoncon kontratën.**

- 2. Kontrata konsiderohet e lidhur për një periudhë të pakufizuar nëse ortakët vazhdojnë të përmbushin kontratën e ortakërisë edhe pas kalimit të periudhës së përcaktuar në nën-paragrafin 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni.**
 - 3. Kontrata e ortakërisë vazhdon të jetë në fuqi për ortakët e mbetur edhe pasi që një ortak nuk merr pjesë më në ortakëri për arsyet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.4. deri 1.8. së bashku të paragrafit 1. të këtij neni, nëse një gjë e tillë është e përcaktuar me kontratë.**
-

Kontrata për ortakërinë shuhet në këto mënyra:

- me marrëveshjen e përbashkët të ortakëve,
- me skadimin e kohës së caktuar për zgjatjen e saj,
- me pamundësinë e kryerjes së punës që është qëllimi i ortakërisë,
- me humbjen e pasurisë së ortakëve,
- me vdekjen e ortakëve, në rast se kontrata është lidhur si intuitu personae;
- me heqjen dorë të ortakëve, si shprehje e njëanshme e vullnetit, së paku tre muaj para skadimit të afatit të rregullt të llogaritjes,
- me humbjen e zotësisë për të vepruar të ortakëve,
- me falimentimin e ortakëve ose të njërit prej ortakëve; ndodh shuarja e kontratës, sepse ai më nuk mund të përgjigjet për detyrat e ortakërisë.

Kur në rastin konkret ortaku del nga ortakëria, pjesa e tij në pasurinë e ortakërisë kalon në dobi të ortakëve të tjerë përpjesëtimisht me pjesët e tyre në pasuri.

Ortakët e tjerë në ortakëri kanë për detyrë që ortakut të larguar t'ia kthejnë objektet. Për objektin i cili rastësisht ka humbur ose keqësuar ai mund të kërkojë shpërblim. Ortakët e tjerë kanë për detyrë që ortakut të larguar t'ia kthejnë objektet, të cilat ia kishte kaluar ortakërisë për shfrytëzim dhe t'ia paguajnë atë që do të merrte me rastin e ndarjes, në qoftë se ortakëria do të shuhej në kohën e daljes së tij nga ortakëria e krijuar.

Nëse detyrimet e përbashkëta nuk janë bërë të arritshme dhe nëse në rastin konkret vlera e pasurisë së ortakërisë nuk është e mjaftueshme për mbulimin e detyrimeve dhe pjesëmarrjeve të përbashkëta, ortaku që largohet nga ortakëria është i detyruar që ortakëve të tjerë t'ua japë shpërblimin për shumën që mungon, në përpjesëtim me pjesën e tij në humbje. Nëse detyrimet e përbashkëta nuk janë bërë të arritshme, ata mund t'i ofrojnë siguri ortakut që largohet, në vend që ta lirojnë nga detyrimi.

Neni 998. Shkëputja e kontratës

- 1. Ortaku mund të shkëpus kontratën, nëse kjo është e përcaktuar në kontratë.**
- 2. Ortaku mund të shkëpus kontratën e lidhur për një kohë të pakufizuar, pa marrë parasysh paragrafin e mësipërm. Në rastin e tillë njoftimi për shkëputje duhet të bëhet tre muaj përpara.**

3. Ortaku për arsye të rëndësishme, mund të kërkojë shkëputjen e kontratës së lidhur për periudhë të caktuar edhe para përfundimit të kësaj periudhe si dhe pa njoftim paraprak, përmes padisë gjyqësore.

Denoncimi nga ana e ortakut rregullohet me nenit 998 të LMD. Denoncimi është mënyrë e shuarjes së ortakërisë. Sipas parag. 1 të nenit 998 të LMD, në qoftë se ortaku nuk është themeluar për kohë të caktuar, çdo ortak mund të denoncojë në çdo kohë. Denoncimi është shprehje e njëanshme e vullnetit të njëres palë kontraktuese – ortakut, drejtuar palës tjetër për shuarjen e kontratës për ortakërinë. Afati i denoncimi në këtë rast nuk është parashikuar shprehimisht me ligj, por theksohet se “çdo ortak mund të denoncojë në çdo kohë”. Ligji përcakton shprehimisht në parag. 1 të nenit 847 të LMD se denoncimi nuk mund të bëhet në kohë jo të përshtatshme, përveç nëse ekzistojnë arsye të rëndësishme. Denoncimi nuk mund të paraqitet në kohë të papërshtatshme, p.sh., në acar të madh, në kohën e ndonjë tërmeti, vërshimi ose të ndonjë fatkeqësie tjetër.

Kur në rastin konkret denoncimi paraqitet në kohë të papërshtatshme pa arsye të justifikueshme, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashikon detyrimin e ortakëve të tjerë t’ua shpërblejnë dëmin që shkaktohet prej saj.

Denoncimi mund t’i bëhet kontratës për ortakërinë e lidhur për kohë të caktuar (parag. 2 i nenit 998), para skadimit të asaj kohe për shkaqe të rëndësishme të parashikuara shprehimisht në këtë nen. Këto shkaqe janë: 1) cenimi thelbësor i detyrimit nga kontrata për ortakërinë të shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e ortakut tjetër; 2) pamundësia e përmbushjes së këtij detyrimi; 3) vdekja; 4) dalja e ortakut nga i cili në pjesën më të madhe është varur kryerja e punëve të ortakërisë. Sipas parag. 3 të këtij neni, ortaku që ka fituar zotësinë për të vepruar mund ta denoncojë kontratën për ortakërinë më së voni në afatin prej 3 muajsh, nga momenti kur është vënë në dijeni për pozitën e tij të ortakut.

Kontrata për ortakërinë e lidhur për kohë të pacaktuar, për të cilën është parashikuar afati i denoncimit, mundet të denoncohet duke mos iu përmbajtur afatit. (parag. 4 i nenit 998). Sipas Ligjit të Detyrimeve, parag. 5 i nenit 998, konsiderohet nule marrëveshja me të cilën e drejta e denoncimit përjashtohet ose kufizohet në kundërshtim me këto dispozita.

Neni 999. Likuidimi

- 1. Nëse ortakëria shuhet, ortakët detyrohen të kryejnë likuidimin sidomos në atë mënyrë që të kryhen detyrimet ndaj personave të tretë, që ortakët të kompensohen për shpenzimet dhe pagesat që i kalojnë shumën e detyrimit që ata kanë sipas kontratës, dhe që pjesa tjetër e pasurisë të ndahet ndërmjet ortakëve në pjesë të barabarta të kontributeve të dhëna. Kontrata mund të përcaktojë pjesë tjera, të ndryshme nga kontributet.**
 - 2. Nëse pasuria e ortakërisë nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet dhe detyrimet, pjesa e mbetur mangët duhet të mbulohet nga ortakët në përpjesëtimin që zbatohet tek kontributet.**
-

Neni 999 i LMD parashikon likuidimin e ortakërisë. Likuidimi i ortakërisë është rregulluar edhe me ligjin nr. 2003/4 “Për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim”, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më datën 13 mars 2003. Ky ligj përcakton kushtet dhe procedurat për likuidim apo riorganizim të personave juridikë në falimentim dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet për palët që marrin pjesë apo janë të prekur nga një procedurë e tillë.

Ky ligj rregullon falimentimin e personave juridikë, që përfshin ortakërinë e përgjithshme, ortakërinë e kufizuar, kompanitë me stoqe të përbashkëta dhe kompanitë me përgjegjësi të kufizuar.

Ky ligj nuk aplikohet për bizneset personale, kompanitë e sigurimeve, institucionet financiare, ofruesit e pensioneve dhe ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe publike që nuk janë transferuar ende në persona juridikë. (Lidhur me këtë çështje, shih: Evis Bozo Daum/ Nerxhivane Dauti; Komentari juridik i Ligji për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim, Prishtinë, 2004).

Sipas parag. 1 të nenit 999 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, pas shuarjes së ortakërisë, bëhet edhe likuidimi.

Ortakët punëdrejtues ose administratori i emëruar si punëdrejtues kanë këto detyra: 1) të kryejnë punët në vazhdim, 2) të arkëtojnë kërkesat, 3) ta shpërndajnë pasurinë e mbetur dhe 4) t’i përmbushin detyrimet ndaj kreditorëve.

Autorizimi për përfaqësim të likuidatorit, sipas ligjit, nuk është i kufizuar në qëllimin e likuidimit.

Caktimi i likuidatorit nga gjykata është objekt trajtimi i nenit 855 të LMD. Në qoftë se midis ortakëve ndodh konflikti lidhur me likuidimin, me kërkesë të ortaku, mund të merret vendim gjyqësor. “Gjykatë” do të thotë gjykata që është kompetente për rastin e falimentimit në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 2003/4 “Për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë

në falimentim”. Sipas kërkesës, Gjykata mund ta emërojë likuidatorin. Kjo vlen edhe kur askush nga ortakëria nuk është i gatshëm të kryejë likuidimin. (Për këtë çështje, shih më hollësisht veprën e cituar të autorëve; E. Daun/N. Dauti, fq. 14, 15, 16 dhe 17).

Objektet që ortaku ia ka kaluar ortakërisë për shfrytëzim, sipas rregullit, duhet t’i kthehen atij. Me regjistrimin e kërkesës themelohet pasuria e bankrotimit, që përbëhet nga e gjithë pasuria e mbledhur nga administratori në emër të debitorit, gjatë kohës së procedurës së rrjedhës normale të biznesit. Kjo pasuri përfshin të gjithë pasurinë e luajtshme, të paluajtshme, materiale dhe jomateriale kudo që gjendet qoftë në administrim të debitorit, qoftë të personave të tretë.⁸⁹⁸

Ai nuk mund të kërkojë shpërblim për objektin i cili rastësisht ka humbur ose është keqësuar.

Nga pasuria e ortakërisë prioritet të përmbushjes kanë së pari ato detyrime të përbashkëta që përfshijnë edhe detyrimet që, sipas kreditorëve, janë të ndara ndërmjet ortakëve ose për të cilat një ortaku, ortakët tjerë i përgjigjen si debitor.

Kur në rastin konkret, në qoftë se pasuria e ortakërisë nuk është e mjaftueshme për pagimin e detyrimeve të përbashkëta dhe kthimin e pjesëmarrjes, ortakët duhet ta shpërblejnë shumën që mungon sipas asaj marrëdhënie mbi të cilën duhet të bartin atë mungesë.

Pas pagimit të detyrimeve, do të kthehen pjesëmarrjet që rrjedhin nga pasuria e ortakërisë. Për pjesëmarrjet që nuk kanë konsistuar në para, shpërblehet ajo vlerë të cilën nuk e kanë pasur në kohën e futjes në ortakëri. Kur në rastin konkret pasuria e ortakërisë nuk është e mjaftueshme për pagimin e detyrimeve të përbashkëta dhe kthimin e pjesëmarrjes, ortakët kanë për detyrë ta shpërblejnë shumën që mungon sipas asaj marrëdhënie mbi të cilën duhet ta bartin atë mungesë. Në qoftë se nga njëri nga ortakët nuk mund të merret kontributi që bien mbi të, ortakët e tjerë kanë për detyrë ta bartin atë mungesë sipas së njëjtës marrëdhënie.

.....
898 Për këtë çështje, shih edhe komentet e paraqitura në nenin 27, 28, 29, 30 të ligjit nr. 2003/4 “Për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim”.

Sefadin Blakaj

PJESA XXVI BASHKËSIA

Neni 1000. Përkufizimi

Nëse një e drejtë u takon disa personave së bashku, dispozitat e këtij kreu zbatohen, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj.

1000. Neni në fjalë i LMD-së parashikon se, kur një e drejtë u takon disa personave (dy ose më shumë syresh), në qeverisjen e marrëdhënieve juridike ndërmjet tyre në lidhje me të drejtën (që është objekt i marrëdhënies juridike) do të zbatohen rregullat e institucionit të bashkësisë, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, (nënkuptohet, me ligj të veçantë). Kryesisht, qëllimi i zbatimit të rregullave të këtij instituti është rregullimi i marrëdhënieve juridike të dy ose më shumë subjekteve të së drejtës, nëse dy ose më shumë subjekte të së drejtës, në një marrëdhënie juridike, janë titullarë të përbashkët të ndonjë të drejte; në këtë kontekst bëhet fjalë për titullarë të ndonjë të drejtë pasurore (ose, në instancë të fundit, objekti i së drejtës të ketë interes pasuror), me kushtin që, kur e drejta përkatëse, që është objekt i interesit të përbashkët, të mos jetë rregulluar ndryshe me dispozita të tjera ligjore; p.sh., rregullat e këtij instituti nuk zbatohen në lidhje me rregullimin dhe administrimin e bashkëpronësisë dhe pjesëve të bashkëpronarëve ose të pronës së përbashkët etj., pasi që këto institute juridike rregullohen me legjislacion të veçantë juridik (ligje të veçanta). Ndryshe, instituti në fjalë, në kuptim të LMD, quhet bashkësi dhe ka për qëllim të rregullojë interesat pasurore dhe të administrimit të të drejtave, titullarë të së cilave janë dy ose më shumë subjekte të së drejtës.

Neni 1001. Pjesët

- 1. Në rast të paqartësive, secili anëtar i bashkësisë ka pjesë të barabartë për të drejtën që është objekt i bashkësisë.**
 - 2. Secili anëtar i bashkësisë mund të disponoj lirshëm me pjesën e tij të bashkësisë.**
 - 3. Nëse një anëtar i bashkësisë ia transferon pjesën e tij personit tjetër, të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të bashkësisë të mëparshëm i zbatohen për anëtarin e bashkësisë tjetër.**
 - 4. Të gjithë anëtares të bashkësisë së bashku disponojnë me lëndën e bashkësisë si tërësi.**
-

1001.1. LMD parashikon se secili nga anëtarët e bashkësisë ka pjesë të barabartë në të drejtën që është pjesë e bashkësisë, nëse pjesa e titullarëve të së drejtës, si lëndë e bashkësisë,

nuk është specifikuar ndryshe (p.sh., nëse pjesët e pjesëmarrjes së titullarëve të së drejtës, si lëndë e bashkësisë, nuk janë saktësuar ose përcaktuar ndryshe në kontratë ose punë të tjera juridike ose ndryshe nuk është saktësuar me një akt tjetër juridik ose me ligj).

1001.2. LMD parashikon se secili nga anëtarët e bashkësisë mund ta disponojë lirshëm të drejtën e tij, që është lëndë e bashkësisë. Këtu mendohet që lëndë e bashkësisë mund të jetë një e drejtë e karakterit pasuror, prandaj, në kuptimin e parimit të lirisë së qarkullimit të vlerave pasurore, edhe pjesa nga e drejta, si lëndë e bashkësisë, mund të jetë lirish e disponueshme.

1001.3. Nëse kalohet pjesa e një anëtari të bashkësisë te personi i tretë - fituesi (qoftë ai person i tretë jashtë kuadrit të bashkësisë ose edhe njëri nga anëtarët e tjetër të bashkësisë), fituesi i pjesës përkatëse të lëndës së bashkësisë (të së drejtës) fiton plotësisht pozitën e paraardhësit, duke përfshirë në këtë kuptim kalimin e tërësisë së të drejtave dhe detyrimeve mbi fituesin.

1001.4. Lëndën e bashkësisë (të drejtën përkatëse pasurore), si tërësi, mund ta disponojnë së bashku të gjithë anëtarët e bashkësisë.

Neni 1002. Detyrimet e anëtarëve të bashkësisë

- 1. Anëtarët e bashkësisë e përdorin dhe e shfrytëzojnë lëndën e bashkësisë dhe vendosin mbi çështjet e përbashkëta në mënyrë të përshtatshme me natyrën dhe qëllimin e lëndës së bashkësisë dhe me menaxhimin e zakonshëm.**
- 2. Secili anëtar i bashkësisë mund t'i kërkojë gjykatës që me aktvendim të emërojë një administrator i cili do të merrte vendimet mbi çështjet e përbashkëta, kur anëtarët e bashkësisë nuk veprojnë në përputhje me paragrafin e parë ose nuk arrijnë marrëveshje për çështjet e përbashkëta.**

1002.1. Neni 1002 i LMD ka për qëllim ta adresojë çështjen e menaxhimit të lëndës së bashkësisë dhe administrimin e interesave të përbashkëta në lidhje me lëndën e bashkësisë. Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, anëtarët e bashkësisë vendosin në lidhje me përdorimin e lëndës së bashkësisë dhe administrimin e saj (duke përfshirë edhe menaxhimin e mirëmbajtjes ose përkujdesjes për interesa të përbashkëta në lidhje me lëndën e bashkësisë), kryesisht me marrëveshje, duke pasur në konsideratë natyrën e lëndës së bashkësisë ose qëllimin (që shërben ose që është themeluar) e lëndës së bashkësisë.

1002.2. Më tej, paragrafi i dytë i këtij neni parashikon të drejtën që secili nga anëtarët e bashkësisë të mund t'i drejtohen gjykatës, e cila mund ta emërojë me aktvendim administratorin e lëndës së bashkësisë, ndërkaq qëllimi i administratorit do të jetë administrimi i interesave të lëndës së bashkësisë në përputhje me kërkesat e shtjelluara në paragrafin e parë të këtij neni. Anëtarët e bashkësisë mund t'i drejtohen gjykatës për emërimin e administratorit gjithmonë

kur shfrytëzimi dhe administrimi i lëndës së bashkësisë nuk bëhet me marrëveshje ose kur ka shmangie nga kërkesat e paragrafit të parë të nenit të mësipërm, (nëse shfrytëzimi i lëndës së bashkësisë ose perkujdesja për çështjet e përbashkëta të bashkësisë nuk bëhet në përputhje me natyrën dhe qëllimin e lëndës së bashkësisë).

Neni 1003. Përdorimi dhe shfrytëzimi

- 1. Nëse lënda e bashkësisë mund të ndahet në natyrë, secili anëtar përdorë dhe shfrytëzon pjesën e tij si anëtar, por vetëm deri në atë masë sa nuk i pengon anëtarët tjerë apo nuk dëmton vet lëndën e bashkësisë.**
- 2. Secili anëtar mund ta përdorë dhe gëzojë lëndën e bashkësisë që nuk mund të ndahet në natyrë, dhe i cili është i përcaktuar për të gjithë anëtarët , sipas qëllimit të përcaktuar të lëndës së bashkësisë dhe në atë mënyrë që nuk shkakton dëm në përdorimin në të njëjtën kohë nga anëtarët tjerë apo që nuk shkakton dëm në vet lëndën e bashkësisë si të tillë.**
- 3. Nuk është e mundur kufizimi i të drejtës së anëtarëve sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, pa dhënien e pëlqimit për një gjë të tillë.**

1003.1. Neni 1003 i LMD rregullon mundësinë e përdorimit dhe shfrytëzimit të lëndës së bashkësisë. Paragrafi i parë i tij lejon mundësinë që, nëse lënda e bashkësisë mund të pjesëtohet në natyrë, atëherë gjithsecili nga anëtarët e bashkësisë e shfrytëzon dhe e përdor pjesën e tij në kuadër të lëndës së bashkësisë. Megjithatë, mundësia e shfrytëzimit të pjesës së bashkësisë së gjithsecilit anëtarë nuk mund t'i pengojë të drejtat e anëtarit tjetër të bashkësisë (në shfrytëzimin e lëndës së bashkësisë). Po ashtu, shfrytëzimi i pjesës së anëtarit të bashkësisë nuk mund dhe nuk duhet të jetë në dëm të lëndës së bashkësisë, si tërësi.

1003.2. Paragrafi i dytë i nenit në fjalë rregullon mundësinë e shfrytëzimit të lëndës së bashkësisë për rastet kur ajo nuk mund të pjesëtohet (ndahet) në natyrë. Në kuptim të paragrafit në fjalë, lënda e bashkësisë mund të shfrytëzohet nga anëtarët e bashkësisë sipas qëllimit të përcaktuar për shfrytëzim ose sipas destinimit përkatës të paracaktuar, ashtu që shfrytëzimi i lëndës së bashkësisë nga anëtarët ose njëri nga anëtarët e bashkësisë të mos i shkaktojë dëm ose të jetë në dëm të shfrytëzimit të saj nga anëtarët e tjerë të bashkësisë për kohën e njëjtë të shfrytëzimit ose që shfrytëzimi i lëndës së bashkësisë të mos jetë në dëm të vetë lëndës së bashkësisë.

1003.3. Anëtarët e bashkësisë nuk mund të privohen ose kufizohen nga të drejtat ashtu siç janë përcaktuar ato në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni neni, përveç nëse anëtarët e bashkësisë kanë dhënë pëlqimin për heqjen dorë ose kufizimin e ndonjëres së drejtë mbi lëndën e bashkësisë.

Neni 1004. Marrja e vendimeve për çështjet e përbashkëta

- 1. Secili anëtar ka numrin e votave në përputhje me pjesën e tij në bashkësi.**
- 2. Për administrimin e zakonshëm dhe për përdorimin dhe shfrytëzimin e lëndës së bashkësisë, vendimet i marrin anëtarët e bashkësisë me shumicë votash.**
- 3. Anëtarët me dy të tretat (2/3) e votave mund të vendosin për përmirësimin e lëndës së bashkësisë, për përdorimin e saj më të mirë apo për masat e rëndësishme për rritjen e vlerës së objektit. Nëse një vendim i tillë kufizon të drejtat e ndonjë anëtari apo nëse ka shpenzime të larta për anëtarët e bashkësisë, ai vendim duhet të merret me unanimitet.**
- 4. Anëtarët e bashkësisë mund të pajtohen që për çështjet e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni mund të vendosë një anëtar i vetëm, vetëm disa nga anëtarët apo një person i tretë. Anëtarët e tillë apo personat e tretë zgjedhën me shumicën e votave.**
- 5. Pa marrë parasysh paragrafin e dytë, secili anëtar mund të bëjë çfarëdo që është e nevojshme për shmangien e ndonjë kërcënimi direkt për dëmtimin e lëndës së bashkësisë, nëse masat e tilla nuk janë marrë nga anëtarët apo personat e tretë sipas paragrafit 2. dhe 4. të këtij neni.**
- 6. Anëtarët nuk mund të kërkojnë apo të vendosin për ndryshime shumë të mëdha të lëndës së bashkësisë. Një kërkesë apo vendim i tillë konsiderohet të jetë kërkesë apo vendim për të shkëputur bashkësinë.**

1004.1. Neni 1004 i LMD rregullon marrjen e vendimeve për çështjet me interes të përbashkët në lidhje me lëndën e bashkësisë. Kështu, paragrafi i parë i këtij neni parashikon se pesha e të drejtës së votës, përkatësisht e numrit të votave, të një anëtari të bashkësisë varet nga pjesa e pjesëmarrjes së anëtarit të bashkësisë në tërësinë e lëndës së bashkësisë. Pjesëmarrja më e madhe e anëtarit të bashkësisë në lëndën e bashkësisë siguron një numër më të madh votash dhe anasjelltas.

1004.2. Anëtarët e bashkësisë vendosin me shumicë votash në çështjet që lidhen me administrimin e zakonshëm dhe përdorimin e shfrytëzimin e lëndës së bashkësisë. Pasi që LMD në këtë paragraf përdor vetëm shprehjen *me shumicë votash*, këtu, në realitet, duket se mendohet për shumicën e thjeshtë të votave. Paragrafi në vijim kërkon shumicën e kualifikuar të votave të anëtarëve të bashkësisë për vendimmarrje në raste të veçanta.

1004.3. Paragrafi i tretë i nenit në fjalë rregullon situatat e veçanta kur vendimi adekuat kërkon shumicën e kualifikuar të votave të anëtarëve të bashkësisë, që duhet të përfshijë shumicën prej 2/3 (dy të tretave) të numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të bashkësisë. Rastet në të cilat kërkohet shumica e kualifikuar e votave për vendimmarrje janë çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e lëndës së bashkësisë, të cilat lidhen me mundësinë e përdorimit të saj në një formë më të mirë dhe me mundësinë e ndërmarrjes së masave të tjera të rëndësishme me qëllim të rritjes së vlerës së bashkësisë. Vendimet

e tilla mund të merren me shumicën e kualifikuar të votave vetëm atëherë kur ato nuk e kufizojnë të drejtën e ndonjë anëtarit të bashkësisë ose kur ndërmarrja e tyre nuk krijon shpenzime të larta për anëtarët e bashkësisë. Në rast të ekzistimit të këtyre dy shkaqeve të fundit (dëmtimi i ndonjë interesi - të drejte të anëtarit të bashkësisë ose shpenzimet e larta), vendimet përkatëse të parashikuara nga ky paragraf mund të ndërmerren vetëm me unanimitetin e të gjithë anëtarëve të bashkësisë.

1004.4. Ndonjëherë shkaqet e efikasitetit kërkojnë që disa ose të gjitha vendimet e anëtarëve të bashkësisë, të specifikuara më lart në paragrafin e dytë të këtij neni, të merren nga anëtarit i vetëm, disa anëtarë të caktuar ose nga personi i tretë (p.sh., administratori i caktuar nga palët). Një vendimi i tillë mund të ndërmerret më shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të bashkësisë.

1004.5. Anëtarët e bashkësisë kanë të drejtë të ndërmarrin veprime përkatëse për mbrojtjen e lëndës së bashkësisë. Kështu, anëtarët e bashkësisë mund të ndërmarrin çfarëdo mase që është në dorën e tyre, me qëllim që ta shmangun ose ta evitojnë ndonjë kërcënim direkt për dëmtimin e lëndës së bashkësisë, kur këto masat të domosdoshme nuk janë ndërmarrë nga personat përgjegjës të caktuara sipas kuptimit të paragrafit të dytë ose të katërt të këtij neni, që u komentuan më lart.

1004.6. Paragrafi i fundit i këtij neni parashikon që anëtarët e bashkësisë nuk mund të kërkojnë ose të vendosin për ndryshime të mëdha (esenciale) të lëndës së bashkësisë; nëse ndonjëri prej tyre kërkon ndërmarrjen e një veprimi përkatës, ky veprim, në realitet, konsiderohet si kërkesë, respektivisht vendim për shkëputjen e bashkësisë.

Neni 1005. Shpenzimet e bashkësisë

- 1. Shpenzimet e lëndës së bashkësisë , sidomos ato që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen, administrimin dhe përdorimin e përbashkët, barten nga secili anëtar në përpjesëtim me pjesën e tij të bashkësisë.**
- 2. Secili anëtar është i detyruar të bartë pjesën e përpjesëtuar të shpenzimeve që rrjedhin nga vendimi për përmirësimin e lëndës së bashkësisë , për përdorimin më të mirë të tij, apo për marrje të rëndësishme për rritjen e vlerës së bashkësisë.**

1005.1. Shfrytëzimi, mirëmbajtja, administrimi etj., i lëndës së bashkësisë shkakton shpenzime të caktuara. Paragrafi i parë i neni 1005 i LMD parashikon se shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mirëmbajtjen, administrimin, shfrytëzimin e lëndës së bashkësisë (duke përfshirë edhe shpenzime të tjera të mundshme), ndahen dhe përballohen proporcionalisht me pjesën-pjesëmarrjen (në përqindje) të secilit anëtar të bashkësisë, në raport me tërësinë totale të lëndës së bashkësisë. Anëtarët e bashkësisë me pjesëmarrje më të madhe mbulojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të bashkësisë dhe anasjelltas.

1005.2. Përpjesëtimi i përballimit të shpenzimeve të bashkësisë ndërmjet anëtarëve të bashkësisë edhe për sa u përket shpenzimeve që shkaktohen në lidhje me vendimet për përmirësimin e lëndës së bashkësisë, për përdorimin më të mirë të saj apo për ndërmarrje të rëndësishme për rritjen e vlerës së bashkësisë – që të gjitha këto ndahen ndërmjet anëtarëve të bashkësisë në përpjesëtim me pjesën e pjesëmarrjes së gjithsecilit anëtar të bashkësisë.

Neni 1006. Kërkesa për mbarim

- 1. Secili anëtar mund të kërkojë mbarimin e bashkësisë në çdo kohë.**
- 2. Anëtarët kanë mundësi që me marrëveshje, për një periudhë të caktuar apo për gjithmonë, ta përjashtojnë të drejtën e kërkesës për mbarimin e bashkësisë apo të përcaktojnë një kohë për paralajmërim për një gjë të tillë.**
- 3. Për rastet e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, është gjithashtu e mundshme që të kërkohet mbarimi i bashkësisë, nëse ekzistojnë arsye të mjaftueshme për një gjë të tillë.**
- 4. Administratori i emëruar nga gjykata po ashtu mund të kërkojë mbarimin e bashkësisë sipas paragrafëve të parë dhe të tretë.**
- 5. Pa marrë parasysh paragrafin 2. të këtij neni, anëtarët në çdo moment mund të vendosin me unanimitet për mbarimin e bashkësisë**
- 6. Bashkësia mbaron gjithashtu kur anëtarët e tjetërsojnë lëndën e bashkësisë si tërësi apo nëse lënda e bashkësisë nuk ekziston më.**
- 7. Kufizimi i të drejtave të anëtarëve apo të administratorit të përcaktuara në paragrafin 1. 3. dhe 4. të këtij neni nuk është e mundur të bëhet në kontratë.**

1006.1. Pasi që lëndë e bashkësisë janë të drejtat që, në instancë të fundit, kanë karakter pasuror, atëherë palët mund t'i disponojnë lirshëm këto vlera pasurore. Në kuptim të këtij konstatimi rrjedh arsyeshmëria e kërkesave të paragrafit të parë të nenit 1006 të LMD, sipas të cilit, secili anëtar i bashkësisë mund të kërkojë mbarimin e bashkësisë në çdo kohë, duke i mundësuar anëtarit të saj të drejtën e disponimit të lirë të pjesës së tij mbi lëndën e bashkësisë.

1006.2. Në kuptim të së drejtës së parashikuar nga paragrafi i mësipërm i këtij neni, paragrafi në vijim u mundëson anëtarëve të bashkësisë që lirisht të heqin dorë përherë nga e drejta e kërkesës për mbarimin e bashkësisë ose që heqja dorë nga mbarimi i bashkësisë të jetë e kufizuar vetëm brenda afatit përkatës të caktuar nga palët. Gjithashtu palët mund ta saktësojnë me marrëveshje një afat njoftimi për mbarimin e bashkësisë, afat ky që u mundëson anëtarëve të tjerë të bashkësisë të njihen me qëllimin e anëtarit që dëshiron ta braktisë bashkësinë dhe atë para se mbarimi i bashkësisë të jetë efektiv.

1006.3. Paragrafi në vijim (paragrafi i tretë) lejon mundësinë që edhe për rastet përjashtuese të parashikuara nga paragrafi i dytë, megjithatë bashkësia të shuhet pas paraqitjes së shkaqeve të arsyeshme nga anëtarët e bashkësisë. Se cilat do të mund të ishin raste të arsyeshme për mbarimin e bashkësisë edhe në situata të tilla, LMD nuk parashikon

ndonjë kriter, megjithatë kjo ngel detyrë e praktikës juridike për të komentuar më shumë. Megjithatë gjykata, në rastet të tilla, merr parasysh rrethanat e rastit konkret, duke i pasur në konsideratë edhe doket përkatëse.

1006.4. Përveç anëtarëve të bashkësisë, mbarimin e bashkësisë mund ta kërkojë edhe administratori i bashkësisë i emëruar nga gjykata, nëse ai kërkon shuarjen e bashkësisë për shkaqet e pasqyruara më sipër në paragrafin e parë dhe të tretë.

1006.5. Paragrafi i pestë i nenit në fjalë parashikon mundësinë që, pa marrë parasysh kufizimet e shkaqeve për mundësinë e shuarjes së bashkësisë të parashikuara sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë të këtij neni, megjithatë, bashkësia mund të përfundojë në çdo kohë në mbështetje të vendimit unanim të të gjithë anëtarëve të bashkësisë. Kjo sigurisht nënkuptohet, pasi titullarët e bashkësisë në çdo kohë mund të vendosin për fatin e bashkësisë, kur vendimi i tyre është unanim.

1006.6. Bashkësia, më tutje, përfundon ndërmjet anëtarëve edhe në rrethanat kur lënda e bashkësisë tjetërsohet si tërësi, duke i kaluar fituesit – palës së treta ose në rastet kur lënda nuk ekziston më, (p.sh., zhdukja e saj në rrethana të fuqisë madhore).

1006.7. Për nga karakteri juridik, rregullat e paragrafëve 1, 3 dhe 4 të këtij neni janë rregulla detyruese, ashtu që të drejtat e anëtarëve të bashkësisë ose të administratorit (të caktuar nga gjykata), që dalin nga këta paragrafë, nuk mund të kufizohen ose të përjashtohen me marrëveshje -kontratë ndërmjet anëtarëve të bashkësisë. Në rast të kufizimit ose të përjashtimit të rregullave të paragrafëve në fjalë më marrëveshjen e anëtarëve të bashkësisë, një marrëveshje e tillë ose një pjesë e saj do të jetë pa efekt juridik në kuptim të gëzimit të të drejtave të anëtarëve të bashkësisë ose të administratorit, të cilat saktësohen në këta paragrafë.

Neni 1007. Pasojat e mbarimit

- 1. Pas mbarimit të bashkësisë bëhet ndarja në natyrë e lëndës së bashkësisë , nëse një gjë e tillë është e mundshme pa dëmtuar vlerën e tij.**
- 2. Kur lënda e bashkësisë nuk mund të ndahet në natyrë, ai shitet. Nga shitja së pari duhet të shlyhen detyrimet e përbashkëta ndaj personave të tretë dhe të anëtarëve që kanë shlyer detyrimet në llogari të anëtarëve tjerë. Pjesa e mbetur ndahet ndërmjet anëtarëve në përputhje me pjesët përkatëse të tyre.**
- 3. Nëse lënda e bashkësisë është pasuri e paluajtshme, ai shitet në ankand publik.**
- 4. Një apo disa anëtarë, kanë të drejtën e parablerjes në blerjen e bashkësisë sipas paragrafit të dytë dhe të tretë, nën kushtet e njëjta me blerësit e tretë.**
- 5. Po ashtu, paragrafi i dytë apo i tretë zbatohet edhe nëse mbarimi i bashkësisë ndodhë për shkak se anëtarët e kanë tjetërsuar lëndën e bashkësisë në tërësi apo nëse lënda e bashkësisë nuk ekziston më.**
- 6. Nëse shitja nuk ka sukses atëherë bashkësia nuk mund të mbarojë.**

1007.1. Nëse bashkësia mbaron (shuhet) në cilindro rast të parashikuar nga neni 1006 i LMD, shtrohet çështja e ndarjes së objektit-lëndës së bashkësisë. Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, nëse shtrohet çështja e ndarjes së lëndës së bashkësisë, gjithmonë përparësi ka e ashtuquajtura “ndarje në natyrë” (ose pjesëtimi fizik) e lëndës së bashkësisë. Ndarja në natyrë e lëndës së bashkësisë mund të jetë e aplikueshme vetëm kur ajo, me pjesëtimin fizik të saj, nuk humb asgjë nga vlera e tërësishme që ka.

1007.2. Kur ndarja në natyrë (pjesëtimi fizik) e lëndës së bashkësisë nuk është e mundur pa-humbur diçka nga vlera e saj, paragrafi i dytë i këtij neni lejon të ashtuquajturin “pjesëtim civil”. Pjesëtimi civil i lëndës së bashkësisë realizohet me shitjen e lëndës së bashkësisë. Së pari, nga çmimi i realizuar i shitjes së lëndës së bashkësisë duhet të shlyhen të gjitha detyrimet e përbashkëta të bashkësisë, që ekzistojnë ndaj personave të tretë, kurse më pas, nga çmimi i realizuar, duhet të kompensohen edhe ata anëtarë të bashkësisë që kanë paguar për pjesën e borxheve të përbashkëta të anëtarëve tjerë të bashkësisë dhe, nëse diçka akoma mbetet nga çmimi shitës i realizuar, atëherë pjesa e mbetur ndahet ndërmjet anëtarëve të bashkësisë në përpjesëtim adekuat me pjesën që secilit anëtar i bashkësisë e ka në tërësinë e lëndës së bashkësisë.

1007.3. Nëse lënda e bashkësisë përbën një send të paluajtshëm (i cili nuk mund të pjesëtohet fizikisht), atëherë shitja e tij duhet të bëhet në ankand publik, duke iu nënshtruar rregullave të shitjes së paluajtshmërive në ankande publike.

1007.4. Paragrafi i katërt i këtij nenit parashikon të drejtën e parablerjes së anëtarëve të bashkësisë, kur lënda e bashkësisë i nënshtrohet shitjes (ashtu siç është përcaktuar nga paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë, të komentuar më lart). E drejta e parablerjes së anëtarëve të bashkësisë nënkupton të drejtën e anëtarit që të blejë lëndën e bashkësisë para cilësdos palë të tretë me kushtet dhe çmimin e shitjes. Në kuptim të kësaj, sigurisht, nëse pala e tretë ofron kushte më të mira kontraktuese ose një çmim më të lartë sesa ka dhënë cilido anëtar i bashkësisë, shitja do t’i bëhet palës së tretë.

1007.5. Paragrafi i pestë parashikon se, megjithatë, kërkesat e paragrafit të dytë dhe të tretë të këtij neni do të zbatohen (për sa është praktikisht e mundur) edhe në situatat kur mbarimi i bashkësisë ndodh për shkak se anëtarët e kanë tjetërsuar lëndën e bashkësisë në tërësi apo nëse ajo nuk ekziston më.

1007.6. Nëse shitja e lëndës së bashkësisë nuk mund të realizohet sipas kuptimit të dispozitave të nenit 1007 të LMD, (aq më pak kur pjesëtimi fizik i lëndës së bashkësisë nuk mund të bëhet), atëherë, në kuptim të paragrafit 6 të këtij neni, bashkësia nuk mund të mbarojë.

Neni 1008. Themelimi i ortakërisë

- 1. Bashkësia mund të mbarojë edhe nëse anëtarët themelojnë ortakëri sipas dispozitave të këtij ligji apo sipas dispozitave të ligjit tjetër në fuqi.**
 - 2. Kur bashkësia mbaron sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse lënda e bashkësisë si tërësi investohet në ortakëri, atëherë nuk kryhet ndarja e bashkësisë.**
 - 3. Anëtarët e bashkësisë janë përgjegjës ndaj personave të tretë edhe pas themelimit të ortakërisë ashtu siç kanë qenë para themelimit të saj. Detyrimet e përbashkëta të ndodhura gjatë ekzistimit të bashkësisë mund të rregullohen ndryshe me anë të kontratës së ortakërisë.**
-

1008.1. Përveç mundësisë së mbarimit të bashkësisë sipas dispozitave të nenit 1008 të LMD-së (të komentuar më lart), bashkësia mund të mbarojë edhe në rastet kur anëtarët e saj parashikojnë ortakërinë sipas dispozitave të Ligjit në fuqi, qoftë ai LMD ose ndonjë ligji tjetër në fuqi (në lidhje me kontratën për ortakërinë, shih më lart komentimin e dispozitave të neneve nga 987 deri 999).

1008.2. Kur anëtarët e bashkësisë pajtohen të themelojnë ortakërinë edhe për rastet kur e tërë lënda e bashkësisë investohet në ortakëri, atëherë nuk kryhet ndarja e lëndës së bashkësisë (në paragrafin e dytë të këtij neni është përdorur shprehja “ndarja e bashkësisë”, ndonëse, në realitet, kemi të bëjmë me ndarje të lëndës së bashkësisë, mbasi bashkësia, si institucion dhe marrëdhënie e veçantë ndërmjet anëtarëve të saj, shuhet dhe konsumohet nga ortakëria).

1008.3. Pavarësisht nëse anëtarët e bashkësisë themelojnë ortakërinë dhe nëse lëndën e bashkësisë e investojnë në ortakëri, edhe më tutje secili anëtar i saj vazhdon të jetë përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve ndaj personave të tretë, ashtu siç ishin ato në momentin e themelimit të ortakërisë. Megjithatë, detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të bashkësisë (qofshin edhe ato ndaj personave të tretë), mund të jenë objekt rregullimi në kontratë, ashtu që ata detyrimet dhe përgjegjësitë përkatëse që kanë pasur ndaj bashkësisë mund t'i rregullojnë ndryshe në kontratën për ortakërinë.

PJESA XXVII KONTRATA PËR DORËZANINË

KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1009. Nocioni

Në kontratën mbi dorëzanimë obligohet dorëzani ndaj kreditorit se do ta përmbushë detyrimin e plotfuqishëm të debitorit të rrjedhur për pagesë, në qoftë se ky nuk e bën këtë.

Dorëzania, si institut juridik i rëndësisë së veçantë në marrëdhëniet kontraktuese, si mjet personal i sigurimit të ekzekutimit të kontratës, është e hershme. Edhe në të kaluarën, kontratat kanë përmbajtur klauzola të veçanta për dorëzanimë, por, natyrisht, përmbajta e tyre ka qenë më ndryshe nga ajo që është tani, në kohën bashkëkohore.⁸⁹⁹ Në të drejtën moderne, kontrata për dorëzanimë zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e mjeteve të ndryshme për forcimin e kontratave (sigurimin e detyrimeve që dalin nga kontratat) dhe është një instrument shumë i shpeshtë juridik që po zbatohet në industrinë bankare edhe në vendin tonë. Në kontratën për dorëzanimë (deklarimin e veçantë të dorëzani mbi dorëzanimë), dorëzani merr përsipër që të jetë përgjegjës, me gjithë pasurinë e tij, për detyrimet e debitorit kryesor të dala nga kontrata-marrëdhënia kryesore (kontrata detyrimet e debitorit të së cilës janë siguruar me dorëzanimë e dorëzani), po qe se debitori kryesor bie në vonesë ose shmang përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj kreditorit. Në kuptim të kësaj, dorëzania kualifikohet si mjet personal për sigurimin e ekzekutimit të detyrimeve të debitorit kryesor, pasi që, në momentin e lidhjes së kontratës për dorëzanimë, mjet për sigurimin e detyrimeve të debitorit kryesor është premtimi personal i dorëzani, i cili pranon detyrimin që të zërë vendin e debitorit kryesor, nëse ky i fundit bie në vonesë. Parimisht, nëse palët nuk kontraktajnë diçka tjetër posaçërisht në kontratën e dorëzani, dorëzani e fiton pozitën e debitorit subsidiar ose pozitën e debitorit të rendit të dytë. Kjo nënkupton atë që debitori nga marrëdhënia ekzistuese akoma vazhdon të ngelë debitori kryesor në marrëdhënie, ashtu që qëllimi i dorëzani dhe dorëzani nuk është zëvendësimi i debitorit kryesor. Në kuptim të kësaj, nëse palët nuk kanë kontraktuar diçka posaçërisht, detyrimi ndaj dorëzani rrjedh në momentin ka dështuar t'i arkëtojë kërkesat e tij ndaj debitorit kryesor.

Dorëzania, duke kryer funksionin e mjetit personal për sigurimin dhe garantimin e përmbushjes së kërkesës së kreditorit, krijon përgjegjësinë e dorëzani për të përmbushur detyrimin e debitorit me pasurinë e tij vetjake, me kusht që detyrimi i debitorit të jetë i vlefshëm, kurse detyrimi i dorëzani duhet të ketë përmbajtje të njëjtë me detyrimin e debitorit kryesor.

⁸⁹⁹ P.sh., të drejtat e vjetra përmbanin edhe klauzola personale, përtej qëllimit pasuror të sigurimit të detyrimeve të debitorit kryesor, të atilla si: huamarrësi nuk do të largohet nga pallati dhe nuk do të vihet nën mbrojtjen e një fisniku, as nuk do të kapet nga armiku dhe nuk do të bëhet i paaftë për të punuar. Në kohërat e hershme kreditorët, përveç dorëzani dhe pengut, përdornin edhe instrumente të ndryshme shumë të ashpra për t'i siguruar pretendimet e tyre, si: betimin në emër të Zotit apo Perandorit, pastaj marrëveshjen për prejen e dorës, prejen e gishtërinjve, sklavërimin e kontraktuar etj.

Instituti i dorëzaniës themelohet me anë të kontratës, domethënë me deklarimin e vullnetit të dyanshëm të kreditorit dhe dorëzaniës dhe shuhet pasi të jetë ekzekutuar detyrimi kryesor. Kontrata për dorëzaniën mund të kontraktohet në formë të një kontrate të veçantë ose r dorëzania të inkorporohet në formë klauzole në tekstin e kontratës kryesore. Në cilëndo formë të kontraktuar, ajo paraqitet si një marrëveshje-kontratë aksesore, e cila është në shërbim dhe e ndanë fatin me kontratën kryesore, së cilës i shërben. Vlefshmëria e detyrimeve të dorëzaniës dhe dorëzaniës varet nga vlefshmëria e detyrimeve të debitorit kryesor; me fjalë të tjera, vlefshmëria e detyrimeve të debitorit kryesor paraqitet si një “conditio sine qua non” për vlefshmërinë e detyrimeve të dorëzaniës që dalin nga kontrata për dorëzaniën. Rrjedhimisht, dorëzani do të pushojë të jetë i detyruar, nëse në çfarëdo rrethane detyrimi i debitorit kryesor është shpallur i pavlefshëm, është kompensuar me kërkesat që debitori kryesor i ka ndaj kreditorit ose kur detyrimet e debitorit kryesor kanë pushuar së ekzistuari në çfarëdo forme tjetër. Me fjalë të tjera, dorëzania e mbron kreditorin nga paaftësia paguese (insolvenca) ose mosgatishmëria e debitorit kryesor për t’i përmbushur detyrimet ndaj kreditorit. Megjithatë, dorëzania në asnjë rrethanë nuk e mbron kreditorin në rast të pavlefshmërisë ose shuarjes së borxhit që debitori kryesor e ka ndaj kreditorit.

Parimisht, detyrimi i dorëzaniës është i lidhur ngushtë me detyrimin e debitorit kryesor. Detyrimi i dorëzaniës asnjëherë nuk mund të jetë përtej ose më i madh sesa detyrimi i debitorit kryesor. P.sh., dorëzani mund të marrë përsipër detyrimin që, nëse debitori kryesor nuk e përmbush ose nuk e dorëzon për përmbushje sasinë dhe cilësinë e sendeve të zëvendësueshme ose sasinë e të hollave, atëherë detyrimin do ta përmbushë dorëzani. Por, me dorëzani mund të sigurohen edhe detyrimet individuale, përkatësisht detyrimet e lidhura me personalitetin e debitorit kryesor. Në rastet nga shembulli i dytë, te detyrimet që kanë për objekt sendet individualisht të caktuara ose detyrimet personale, dorëzani mund të marrë përsipër detyrimin që, nëse debitori kryesor nuk e bën përmbushjen, atëherë dorëzani do të paguajë shumën e caktuar të të hollave ose që dorëzani do të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar etj. Nga kjo e fundit del se, në realitet, detyrimi i dorëzaniës nuk është të zëvendësojë detyrimin e debitorit kryesor, por të shërbejë si mjet për sigurimin e detyrimeve të debitorit kryesor, (nëse debitori kryesor nuk përmbush në kohë ose lë pa përmbushur fare detyrimet që dalin nga kontrata).

Neni 1010. Forma

Në kontratën mbi dorëzaniën obligohet dorëzani vetëm në qoftë se deklaratiën mbi dorëzaniën e ka bërë me shkrim.

Parimisht, LMD, duke vlerësuar parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në marrëdhëniet kontraktuese, vendos vetëm kërkesa minimale, të cilat do ta kufizonin lirinë kontraktuese të palëve. Kjo zgjidhje e LMD duket se është pasqyruar edhe në lidhje me formën e kontratave, mbasi konsensualizmi dhe liria e palëve në përzgjedhjen e formës së kontratës i është lënë autonomisë së vullnetit të palëve. Përfundimisht, forma, si materializim i përmbajtjes së

kontratës, paraqet një element thelbësor për vlefshmërinë e kontratave; ky kufizim duket se vlen edhe për kontratën e dorëzarisë. Ligji parashikon shprehimisht formën me shkrim, si kusht qenësor për vlefshmërinë e kësaj kontrate. Kontrata për dorëzanimin bën pjesë në grupin e kontratave formale, ashtu që forma e saj është ligjore, pasi që LMD (neni 1010) kërkon shprehimisht plotësimin e formës me shkrim për vlefshmërinë e dorëzarisë. Rrjedhimisht, kontrata për dorëzanimin bën pjesë në grupin e kontratave formale, ashtu që forma është element konstitutiv i saj; pra, detyrimi joformal (gojor) i dorëzimit se do të marrë përsipër detyrimet e debitorit kryesor nuk prodhon efekte juridike dhe nuk parashikon detyrime të dorëzarisë për deklaruesin.

Neni 1011. Zotësia për të vepruar e dorëzimit

Vetëm personi me zotësi të plotë për të vepruar mund të detyrohet në kontratën për dorëzani.

Ekzistimi i zotësisë për të vepruar i dorëzimit është element qenësor për vlefshmërinë e kontratës së dorëzarisë. Kontrata e dorëzarisë munda ta ngarkojë vetëm subjektin që ka zotësi të plotë për të vepruar, duke përfshirë gatishmërinë e tij të vetëdijshme dhe të vullnetshme për të marrë përsipër detyrimet e dorëzimit, lidhur me përmbushjen e detyrimit të debitorit kryesor. Të miturit (qofshin ata të mituri të rinj apo të mituri të rritur - të mitur që kanë arritur moshën mbi 14 vjeç), personat madhorë pa zotësi për të vepruar dhe personat madhor me zotësi të kufizuar për të vepruar, (këta të fundit, ngaqë, për shkak të të metave psikofizike janë të zhveshur pjesërisht ose plotësisht nga zotësia për të vepruar), nuk mund të jenë subjekte të kontratës së dorëzarisë dhe nuk mund të ushtrojnë asnjë veprim në lidhje në kontratën e dorëzarisë. Kjo dispozitë ligjore e parashikuar në këtë nen është themeluar për arsye të mbrojtjes së interesave të tyre më vitale dhe ligjore, ngase subjektet e tilla nuk janë në gjendje dhe nuk kanë zotësinë për të vlerësuar, përkatësisht nuk mund ta vlerësojnë arsyeshmërinë e veprimeve të tyre dhe pasojave apo efekteve ligjore që mund të kenë ato.

Neni 1012. Dorëzania për personin e paaftë për të vepruar

Kush obligohet si dorëzanë për detyrimin e ndonjë personi të paaftë për të vepruar, i përgjigjet kreditorit njësoj sikur dorëzani i personit të aftë për të vepruar.

Në praktikë mund të ndodhin situata kur një palë e tretë merr përsipër detyrimin e dorëzimit ndaj debitorit që nuk ka aftësi për punë, përkatësisht që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar. Raste të tilla të ngjashme mund të ndodhin kur personi që ka aftësi të pjesshme për punë lidh kontratë me “lejen” ose “pëlqimin” e përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit. Në raste të tilla ose në raste të tjera të ngjashme, kur pala e tretë ka pranuar detyrimin e dorëzimit ndaj detyrimeve të palës e cila nuk ka zotësi për të vepruar, atëherë dorëzani nga këto marrëdhënie bart përgjegjësinë e plotë që del nga pozita e dorëzimit dhe përgjigjet njëjtë

sikur edhe të rastet kur debitori kryesor është personi me zotësi për të vepruar. Duket se kjo zgjidhje juridike është e arsyeshme, sepse dorëzani në këto marrëdhënie pranon me vetëdije rrezikun të cilit i ekspozohet me marrëveshje të dorëzarisë.

Neni 1013. Objekti i dorëzarisë

- 1. Dorëzania mund të jepet për çdo detyrim të vlefshëm pavarësisht nga përmbajtja e tij.**
- 2. Mund të hyhet dorëzanë edhe për detyrimin e kushtëzuar, si dhe për detyrimin e caktuar të ardhshëm.**
- 3. Dorëzania për detyrimin e ardhshëm mund të revokohet para se të lind detyrimi, në qoftë se nuk është parashikuar afati në të cilin ai duhet të lind.**
- 4. Dorëzania mund të jepet edhe për detyrimin e ndonjë dorëzani tjetër (dorëzani i dorëzani).**

1013.1. Duke iu referuar dispozitave të këtij neni, shihet qartë se objekt i dorëzarisë mund të jenë detyrimet e vlefshme, pavarësisht nga përmbajtja e detyrimit. Në qoftë se detyrimi i debitorit është i pavlefshëm, kontrata e dorëzarisë nuk mund të themelohet, kjo ngase dorëzania e siguron kreditorin nga paaftësia paguese e debitorit dhe jo nga pavlefshmëria e detyrimit. Krejt ajo që mund të jetë objekt i detyrimit si, p.sh.: ndonjë dhënie (*dare*), ndonjë veprim (*facere*), ndonjë mosbërje (*et non facere*) apo pësim (*pati*), mund të jetë edhe objekt i sigurimit me dorëzani, me kusht që objekti i detyrimit të jetë i vlefshëm. Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, objekt i sigurimit me dorëzani mund të jenë, p.sh., jo vetëm detyrimet e shitësit ose transferuesit të mallit, por edhe të qiradhënësit ose qiramarrësit, detyrimet e shërbim-dhënësit, ose detyrimet e kryerësit të veprës; ndërkaq, objekt i sigurimit me dorëzani nuk janë vetëm detyrimet që rrjedhin nga kontrata, por edhe detyrimet e tjera që mund të rrjedhin nga ndonjë punë tjetër e vlefshme juridike; objekt i sigurimit me dorëzani mund të jetë edhe çështja e shpërblimit të dëmit të shkaktuar në marrëdhëniet kontraktuese, gjë që mund të ndodhë kur njëra palë ka shkelë detyrimet e saj që dalin nga kontrata etj. (e ashtuquajtura dorëzani për shpërblimin e dëmit.)

1013.2. Objekt i sigurimit me dorëzani mund të jenë si detyrimet e kushtëzuara, ashtu edhe detyrimet e ardhshme (detyrimet që planifikohen të ndodhin ose që mund të ndodhin në të ardhmen). Objekt i detyrimit të siguruar me dorëzani mund të jetë si detyrimi lindja e të cilit varet nga kushti shtytës ose shkëputës, ashtu edhe detyrimi që do të paraqitet me siguri në të ardhmen (afatizimi i paraqitjes së lindjes së detyrimit).

1013.3. Për rastin e detyrimeve të kushtëzuara, detyrimet lindja e të cilave varet nga një rrethanë e ardhshme dhe e pasigurte, paragrafi i tretë i këtij neni lejon mundësinë që detyrimi i dorëzani për këto raste të revokohet. Revokimi i detyrimeve të tilla lejohet derisa ato të lindin (paraqiten); ndërkaq lindja e tyre konsumon mundësinë e revokimit të dorëzarisë së tyre. Gjithashtu, nuk mund të revokohen as detyrimet, lindja e të cilave është parashikuar të ndodhë brenda një afati të caktuar (të ashtuquajturat detyrime të afatizuara).

1013.4. Paragrafi i katërt i nenit në fjalë lejon mundësinë që objekt i dorëzarisë të jetë edhe sigurimi i detyrimit të dorëzantit; është rasti kur ekzekutimi i detyrimit të një dorëzani sigurohet me një dorëzani vijuese (e ashtuquajtura dorëzani e dorëzantit). Te rasti i sigurimit të ekzekutimit të detyrimeve të dorëzantit, me dorëzani vijuese kemi disa subjekte përgjegjëse për sigurimin ndaj kreditorit, ashtu që fillimisht kjo do jetë përgjegjësi e debitori kryesor për përmbushjen e detyrimit të tij dhe, më pas, nëse ai nuk është në gjendje ta përmbushë atë, detyrimin e përmbushjes e bart dorëzani, por nëse edhe në këtë rast kreditori nuk mund ta arkëtojë kërkesën e tij, do të gjejë shprehje dorëzani i dorëzantit, pra subjekti i tretë përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve. Dorëzani i dorëzantit është subjekti që do të jetë përgjegjës ndaj kreditorit për përmbushjen e detyrimit të dorëzantit. Nëse dorëzani i dorëzantit (dorëzani i fundit) e përmbush obligimin e dorëzantit të parë, ai merr statusin e dorëzantit të kreditorit dhe në këtë rast për të lind e drejta që të kërkojë nga debitori kryesor (përkatësisht dorëzani paraprak) çdo gjë që ka dhënë në emër të kompensimit për përmbushjen e detyrimit që ka ekzekutuar.

Neni 1014. Volumi i përgjegjësisë së dorëzantit

- 1. Detyrimi i dorëzantit nuk mund të jetë më i madh nga sa është detyrimi i debitorit kryesor, e në qoftë se është kontraktuar që të jetë më i madh, ai reduktohet në masën e detyrimit të debitorit.**
- 2. Dorëzani përgjigjet për përmbushjen e krejt detyrimit për të cilin ka qenë dorëzani, në qoftë se përgjegjësia e tij nuk është e kufizuar në ndonjë pjesë të tij, ose në ndonjë mënyrë tjetër I është nënshtruar kushteve më të lehta.**
- 3. Ai ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet e nevojshme që i ka bërë kreditori për arkëtimin e borxhit nga debitori kryesor.**
- 4. Dorëzani përgjigjet edhe për çdo shtim të detyrimit i cili do të krijohet nga vonesa e debitorit ose për faj të debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.**
- 5. Ai përgjigjet vetëm për atë kamatë të kontraktuar e cila ka rrjedhur për pagesë pas lidhjes së kontratës mbi dorëzantinë.**

1014.1. Qëllimi i nenit në fjalë është të rregullojë vëllimin e përgjegjësisë së dorëzantit, nëse debitori kryesor lë pa përmbushur detyrimin e tij të maturuar në kohë ose e përmbush atë në mënyrë jo të duhur. Argumenti i parë, i cili shtjellon çështjen e vëllimit të përgjegjësisë së dorëzantit, nisat nga konstatimi se detyrimi i dorëzantit nuk mund të jetë më i madh se detyrimi i debitorit kryesor; pasi që, në realitet, dorëzani është debitor i rendit të dytë, i cili në kontratën e dorëzarisë ka marrë vetëm aq përgjegjësi sa ka qenë vëllimi i detyrimeve të debitorit kryesor. Nëse palët kanë kontraktuar në kontrate një sasi më të madhe të detyrimit të dorëzantit sesa është detyrimi i debitorit kryesor, atëherë, sipas forcës së ligjit, sasia e dorëzantit reduktohet në masën e detyrimit të debitorit kryesor. Paragrafi i parë i nenit që komentohet tregon karakterin detyrues të kësaj rregulle juridike.

1014.2. Rrjedhimisht, dorëzani përgjigjet për tërësinë e detyrimeve të debitorit kryesor, për aq sa debitori kryesor ka pasur borxh ndaj kreditorit. Megjithatë, në kontratën për dorëzanimin palët mund të parashikojnë kushte më të lehta dhe më të favorshme për dorëzanimin. Nëse palët në kontratën për dorëzanimin kanë parashikuar kushte më të lehta për dorëzanimin, atëherë pozita më e lehtë për dorëzanimin është e aplikueshme.

1014.3. Dorëzani, po ashtu, bart edhe përgjegjësinë e pagimit të shpenzimeve, të cilat i janë shkaktuar kreditorit për shkak të veprimeve që i ka kryer lidhur me arkëtimin e borxhit nga ana e debitorit. Këto shpenzime nuk përfshijnë vetëm shpenzimet që i ka bërë kreditori me rastin e mospërbushjes së detyrimit apo përbushjes së parregullt të detyrimit, por përfshijnë edhe shpenzimet e tjera që i janë shkaktuara kreditorit lidhur me njoftimin e debitorit për detyrimin e përbushjes së detyrimit, ashtu që kjo do të inkorporonte dërgimin e njoftimit debitorit për përbushje të detyrimit dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore të iniciuar etj.

1014.4. Dorëzani gjithashtu është përgjegjës edhe për shtimin e detyrimit të debitorit kryesor, i cili krijohet për shkak të mospërbushjes me kohë ose përbushjes së parregullt të detyrimeve nga debitori kryeso. Këtu, para së gjithash mendohet për normat e interesit shtesë që debitori duhet të paguajë për vonesën ose zbatimin e klauzolave të kushtit penal - dënimit të kontraktuar, aplikimi i të cilave zgjeron gamën e detyrimeve të debitorit kryesor.

1014.5. Dorëzani nuk përgjigjet për kamatat e akumuluar, të cilat janë krijuar para momentit të themelimit të dorëzanimin, përkatësisht dorëzani përgjigjet vetëm për ato kamata të kontraktuara që kanë rrjedhë pas themelimit të kontratës për dorëzanimin.

Neni 1015. Kalimi i të drejtave të kreditorit në dorëzanimin (subrogimi)

Në dorëzanimin i cili e ka plotësuar kërkesën e kreditorit kalon kjo kërkesë me të gjitha të drejtat aksesore dhe me garancitë e përbushjes së saj.

Në momentin kur dorëzani e përbush borxhin ose detyrimin të cilin e ka debitori kryesor ndaj kreditorit, vjen nga *ex lege* deri te subrogati; ashtu që në momentin e njëjtë kur edhe kryen përbushjen, dorëzani fiton të gjitha kërkesat që kreditori ka kundër debitorit kryesor, me të gjitha të drejtat e lidhura dhe mjetet siguroese përkatëse. Në kuptim të kësaj, në rast të përbushjes së detyrimit nga dorëzani, konsiderohet se objekti i detyrimit ngelet i njëjtë, por vetëm bëhet ndryshimi në kuadër të subjekteve të marrëdhënies, kështu që vendin e kreditorit e zë dorëzani që ka përbushur detyrimin.

Ashtu si u komentua edhe më lart, mbi dorëzanimin që ka paguar në vend të debitorit kryesor, kalojnë të gjitha kërkesat dhe mjetet për sigurimin e kërkesave që kreditori i kishte ndaj debitorit kryesor. Kështu, për shembull, te dorëzani, krahas të drejtës që të kërkojë nga debitori kryesor atë që ka paguar, kalon edhe e drejta që të kërkojë pagimin në emër të

kamatës së kontraktuar, të drejtën për shpërblimin e dëmit të pësuar, të drejtën e pagimit të shpenzimeve të shkaktuara etj; veç këtyre, te dorëzani kalojnë edhe të gjitha të drejtat mbi mjetet për sigurimin e kërkesave që kreditori i kishte ndaj debitorit kryesor, si p.sh., e drejta e pengut, e drejta e paradhënies, e drejta për të mbajtur gjërat ose letrat me vlerë etj.

KREU 2

RAPORTET E KREDITORIT DHE TË DORËZANËSIT

Neni 1016. Format e dorëzarisë

- 1. Prej dorëzanit mund të kërkohet përmbushja e detyrimit vetëm pasi debitori kryesor të mos e përmbush brenda afatit të caktuar në thirrjen e drejtuar me shkrim (dorëzania subsidiare).**
- 2. Mirëpo, kreditori mund të kërkojë përmbushjen nga dorëzani megjithëse nuk e ka thirrur më përpara debitorin kryesor në përmbushjen e detyrimit, në qoftë se s'ka dyshim se prej mjeteve të debitorit kryesor nuk mund të realizohet përmbushja e detyrimit apo në qoftë se debitori kryesor ka rënë në falimentim.**
- 3. Në qoftë se dorëzarisë është obliguar si dorëzanë pages, i përgjigjet kreditorit si debitori kryesor për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij si nga debitori kryesor ashtu edhe nga dorëzani apo nga të dy njëkohësisht (dorëzania solidare).**
- 4. Dorëzani për detyrimin e lindur nga kontrata në ekonomi përgjigjet si dorëzanë pages, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.**

1016.1. Paragrafi 1 i nenit 1016 të LMD-së rregullon format më të shpeshta të paraqitjes së marrëdhënies së dorëzarisë, nga të cilat është e ashtuquajtura “dorëzania subsidiare”. Të kjo formë e dorëzarisë, detyrimi i dorëzanit që të paguajë borxhin lind vetëm kur debitori nuk ka përmbushur detyrimin e tij të maturuar ndaj kreditorit, as atëherë kur i ishte bërë thirrje me shkrim që të ofrojë përmbushjen, (duke i mundur me këtë rast debitorit kryesor një afat plotësues për ta ofruar përmbushjen). Te dorëzania subsidiare, dorëzani paraqitet si debitor i rendit të dytë. Fillimisht kreditori duhet të bëjë përpjekje që kërkesën e tij ta arkëtojë nga debitori kryesor. Pas kësaj, kreditori ka të drejtë t'i drejtohet dorëzanit për pagesë vetëm atëherë kur përpjekjet e kreditorit ndaj debitorit kryesor nuk kanë dhënë ndonjë rezultat.

1016.2. Megjithatë, pavarësisht nga kërkesa ligjore e parashikuar nga paragrafi paraprak, sipas së cilës kreditori së pari duhet t'i drejtohet për pagesë debitorit kryesor, përjashtimisht ai mund t'i drejtohet dorëzanit për pagesë edhe drejtpërdrejt, (pa pasur nevojë që së pari t'i drejtohet debitorit kryesor), për rastet kur debitori kryesor ka rënë në falimentim ose kur kreditori e ka fare të qartë se nga gjësendet që gjenden në pronësi (dispozicion) të debitorit kryesor nuk mund të inkasohen kërkesat e tij. Në rastet e tilla, kreditori mund

të kërkojë drejtpërdrejt nga dorëzani përmbushjen e detyrimit, edhe nëse më parë nuk i ka bërë një thirrje të tillë debitorit, sepse nga rrethanat dhe situatat e ndryshme në të cilat ndodhet debitori, mund të kuptohet dhe vihet në përfundim se debitori nuk është në gjendje ta përmbushë detyrimin e tij. Janë të tilla disa situata që e rëndojnë pozitën e debitorit dhe determinojnë pamundësinë e përmbushjes së detyrimit nga ana e tij, të cilat e arsyetojnë mosdrejtimin e kreditorit fillimisht te debitori, por drejtpërsëdrejti te dorëzani. Sigurisht, debitori do të jetë i paaftë për përmbushjen e detyrimeve të veta, në qofte se gjendet në një situatë tejet të vështirë financiare ose kur është zhytur në borxhe apo është në prag të falimentimit ose tashmë është hapur procedura e falimentimit, situata këto që i japin të drejtën kreditorit që ti drejtohet drejtpërsëdrejti dorëzanit për përmbushje të detyrimit.

1016.3. Paragrafi i tretë e vë në dukje të drejtën e kreditorit që të kërkojë përmbushjen e kërkesës së tij te cilido – te debitori kryesor apo te dorëzani ose te që të dy njëkohësisht. Kjo formë e dorëzansë, kur kreditori kërkesën për pagesë mund t'ia drejtojë cilësdo palë - qoftë dorëzanit, qoftë debitori kryesor, në teorinë dhe praktikën juridike njihet si dorëzani paguese ose dorëzani solidarë. Të kjo formë e dorëzansë i është lënë kreditorit që t'ia drejtojë kërkesën për pagesë debitorit kryesor, dorëzanit apo që të dyve njëkohësisht.

1016.4. Në kontratat në ekonomi (të ashtuquajturat kontratat e lidhura ndërmjet entiteteve afariste), forma e dorëzansë paguese, (ashtu si është themeluar në paragrafin e tretë të këtij neni), supozohet. Kjo do të thotë. se palët vetëm shprehimisht duhet ta kontraktojnë përjashtimin e kësaj forme të dorëzansë.

Neni 1017. Solidariteti i dorëzanësve

Disa dorëzanë të një borxhi përgjigjen solidarisht, pavarësisht a kanë hyrë dorëzanë bashkërisht ose secili prej tyre ka marrë përsipër detyrimin ndaj kreditorit veç e veç, me përjashtim kur në kontratë përgjegjësia e tyre është rregulluar ndryshe.

1017. Neni 1017 ka përkufizuar përgjegjësinë solidarë të disa dorëzanëve për detyrimet e debitorit kryesor, në qoftë se të gjithë ata kanë marrë përsipër bashkërisht detyrën e dorëzansë ose edhe kur secili veç e veç ka kontraktuar me kreditorin një detyrim të tillë. Sipas kuptimit të kësaj dispozite, solidariteti i dorëzanit supozohet, ashtu që ai mund të përjashtohet vetëm kur është parashikuar një mundësi e tillë në kontratë. Ky nen krijon përgjegjësinë solidarë të të gjithë dorëzanëve kundrejt detyrimeve të debitorit kryesor, ashtu që shumë persona, me cilësi të dorëzanit, dorëzanojnë për borxhin e debitorit kryesor, përveç nëse në kontratë palët nuk kanë përcaktuar diçka më ndryshe apo përveç kur palët kanë përcaktuar më ndryshe përgjegjësinë e dorëzanëve në kontratë. Ndryshe kjo formë e dorëzansë njihet edhe si bashkëdorëzani. Bashkëdorëzania ofron një siguri më të madhe për kreditorin në lidhje me realizimin e kërkesave të tij, ashtu që në këtë rast, në pozitën e dorëzanit do të qëndrojnë më tepër subjekte, gjë që, në njëfarë mënyre krijojnë garanci më

të madhe për kreditorin për realizimin e kërkesës së tij. Solidariteti i dorëzanëve veçanërisht aplikohet në rastet e lidhjes së kontratave ekonomike, të cilat kërkojnë një shkallë më të lartë të sigurisë për përmbushjen e detyrimeve të debitorit.

Neni 1018. Humbja e të drejtës në afat

Në qoftë se debitori e ka humbur të drejtën në afat të caktuar për përmbushjen e detyrimit të tij, kreditori megjithatë nuk mund të kërkojë përmbushjen nga dorëzani para skadimit të këtij afati, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.

1018. Si një rregull e përgjithshme në marrëdhëniet e detyrimeve, (duke përfshirë edhe marrëdhëniet kontraktuese), kreditori nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve të debitorit para se ato të kenë arritur për përmbushje (maturiteti i detyrimit). Me gjithë këtë rregull parimore, LMD, në neni 297, ka rregulluar disa situata të cilat i lejojnë kreditorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit edhe para afatit të maturitetit të tij.⁹⁰⁰ Me gjithë këtë përjashtim të parashikuar në LMD për rastet kur kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit edhe para afatit të maturitetit, këtë ai nuk mund ta kërkojë edhe ndaj dorëzanit. Në kuptim të nenit 1018 të LMD, përmbushja e detyrimit të debitorit kryesor nga dorëzani nuk mund të kërkohej para se të arrijë detyrimi për pagesë, përkatësisht të ketë kaluar koha ose afati, kalimi i të cilit e bënë detyrimin të maturuar ose të gatshëm për pagesë. Kjo rregull, sipas së cilës detyrimi ndaj dorëzanit nuk mund të kërkohej para maturitetit të tij, gjen zbatim, përveç nëse palët në kontratën e dorëzansisë merren vesh edhe ndryshe.

Neni 1019. Falimentimi i debitorit kryesor

- 1. Në rastin e falimentimit të debitorit kryesor, kreditori ka për detyrë t'i lajmërojë kërkesat e veta në falimentim dhe për këtë gjë ta njoftojë dorëzanin, ndryshe i përgjigjet dorëzanit për dëmin të cilin do ta pësonte ky për këtë gjë.**
- 2. Pakësimi i detyrimit të debitorit kryesor në procedurën e falimentimit ose në procedurën e kompensimit nuk pas sjell edhe pakësimin përkatës të detyrimit të dorëzanësit, kështu që dorëzani i përgjigjet kreditorit për krejt shumën e detyrimit të vet.**

1019.1. Në rast të hapjes së falimentimit të debitorit kryesor, kreditori ka për obligim që ta njoftojë dorëzanin për hapjen e falimentimit të debitorit kryesor; po ashtu, është detyrim i kreditorit që në procedurën e falimentimit të paraqesë kërkesa përkatëse ndaj debitorit kryesor, me qëllim që në këtë procedurë të arkëtojë atë që është e mundur nga kërkesat që ka ndaj debitorit kryesor. Këtë detyrim e saktëson paragrafi i parë i nenit 1019 i LMD, ashtu që qëllimi i tij është që të rregullojë dëmin dhe detyrimin e gatishmërisë ta vërë mbi kreditorin,

⁹⁰⁰ Për më shumë në lidhje me të drejtën e kreditorit që të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit të maturitetit të tij, shih komentimin e nenit 297 të LMD-së.

në mënyrë që ky të jetë vigjilent dhe t'i arkëtojë kërkesat e tij ose një pjesë të këtyre kërkesave në procedurën e falimentimit, nëse debitori tashmë ka rënë në falimentim. Në rast se kreditori nuk do të vepronte sipas detyrimit të këtij paragrafi, atëherë do të mbahet përgjegjës ndaj dorëzantit për shpërblimin e dëmit, të cilin dorëzani do ta pësonte në këtë rast për shkak se kreditori ka lënë pa përdorur mundësinë që kërkesat ose një pjesë të kërkesave të tij ndaj debitorit kryesor t'i realizojë në procedurën e falimentimit.

1019.2. Paragrafi i dytë i të njëjtit nen më pas parashikon se, pavarësisht nëse kreditori ka realizuar një pjesë të kërkesave të tij ndaj debitorit kryesor në procedurën e falimentimit ose në procedurën e kompensimit të detyrueshëm (të borxhit), ky fakt nuk rezulton automatikisht me pakësimin përkatës të detyrimit të dorëzantit ndaj kreditorit, kështu që dorëzani vazhdon t'i përgjigjet kreditorit për krejt shumën e detyrimit të vet, për të cilin ka vënë dorëzani.

Neni 1020. Rasti i përgjegjesisë së zvogëluar të trashëgimtarit të debitorit

Dorëzani përgjigjet për krejt shumën e detyrimit për të cilën ka hyrë dorëzanë edhe në rastin kur nga trashëgimtari i debitorit do të mund të kërkohej pagimi vetëm i asaj pjese të tij që i përgjigjet vlerës së pasurisë të trashëguar.

1020. Neni 1020 i LMD ka për qëllim të tregoj se detyrimi i dorëzantit është një detyrim i pavarur i tij i lidhur ngushtë me dështimin e debitorit kryesor që të përmbushë detyrimet e tij. I njëjti nen parashikon se dorëzani përgjigjet për tërësinë e detyrimit të debitorit kryesor, (nëse atë e ka pranuar me dorëzani), edhe për rastet kur, pas lidhjes së kontratës së dorëzantisë, të ketë vdekur debitori kryesor dhe një pjesë e borxhit të debitorit kryesor mund të kërkohej nga trashëgimtari, në përpjesëtim me vlerën e masës trashëgimore (të drejtave pasurore) që trashëgimtari ka trashëguar nga debitori kryesor (trashëgimlënësi). Megjithatë, në një situatë të ngjashme, kur dorëzani ka paguar në tërësi detyrimin e debitorit kryesor, i cili ka vdekur pas themelimit të kontratës së dorëzantisë, dorëzani gëzon të drejtën e regresit ndaj trashëgimtarit ligjor të debitorit kryesor, në përpjesëtim me vlerën pasurore që trashëgimtari i debitorit kryesor ka trashëguar nga debitori kryesor (trashëgimlënësi). Në lidhje me bazën juridike të të drejtave të regresit të dorëzantit shih dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës.

Neni 1021. Kundërshtimet e dorëzantit

- 1. Dorëzani mund të ushtroj kundër kërkesës së kreditorit të gjitha kundërshtimet e debitorit kryesor, duke përfshirë edhe prapësimin e kompensimit, por jo edhe kundërshtime të tjera thjesht personale të debitorit.**
- 2. Heqje dorë e debitorit nga kundërshtimet, si dhe njohja e tij e kërkesave të kreditorit, nuk ka efekt ndaj dorëzantit.**

3. Dorëzani mund të ushtroj kundër kreditorit edhe kundërshtimet e veta personale, për shembull, nulitetin e kontratës mbi dorëzanimë, parashkrimin e kërkesave të kreditorit ndaj tij, prapësimin e kompensimit të kërkesave reciproke.

1021.1 Neni në fjalë rregullon kundërshtimet, përkatësisht mjetet juridike që mund t'i ushtrojë dorëzani ndaj kreditorit, qëllimi i të cilave është të mbrohen interesat e dorëzantit në marrëdhënien juridike të themeluar në kontratën për dorëzanimë. Ashtu siç është thënë edhe më lart, në marrëdhënien e dorëzantisë mund të flitet për tri lloje raportesh juridike: i pari, raporti ndërmjet kreditorit dhe debitorit kryesor; i dyti, raporti ndërmjet dorëzantit dhe kreditorit dhe i treti, raporti ndërmjet debitorit kryesor dhe dorëzantit. Pasi që kontrata e dorëzantisë është kontratë aksesore e cilën e ndjek fati i marrëdhënies kryesore dhe është raport ndërmjet kreditorit dhe debitorit kryesor, atëherë, në këtë kuptim, pozita juridike e dorëzantit nuk mund të jetë asnjëherë më e pavolitshme sesa ajo e debitorit kryesor, pra dorëzani mund të ushtrojë çfarëdo mjeti juridik, përkatësisht kundërshtimi juridik të cilin mund ta shfrytëzojë edhe debitori kryesor, duke përfshirë në këtë kuptim edhe kundërshtimin për kompensimin e kërkesave (ndërmjet kreditorit dhe debitorit kryesor). Të tilla mund të jenë, p.sh., kundërshtimi për mospërbushje me arsyetimin se borxhi i debitorit kryesor është parashkruar ose se borxhi i debitorit kryesor është falur nga kreditori (prandaj ka pushuar edhe detyrimi i dorëzantit) ose se i tërë borxhi a një pjesë e borxhit të debitorit kryesor është kompensuar me kërkesat që debitori kryesor i ka pasur ndaj kreditorit etj. Në këtë kuptim, dorëzani mund t'i shfrytëzojë të gjitha kundërshtimet në fjalë, të cilat mund t'i shkojnë përshat edhe debitorit kryesor, me përjashtim të kundërshtimeve thjesht personale, të cilat janë të lidhura me personalitetin e debitorit dhe mund të ushtrohen vetëm nga debitori.

1021.2 Mjetet juridike, përkatësisht kundërshtimet e debitorit kryesor (ndaj kreditorit), të cilat mund t'i shfrytëzojë dorëzani, ashtu siç u komentua më lart në lidhje me paragrafin e parë të këtij neni, dorëzani mund t'i ushtrojë pavarësisht nga pozita dhe qëndrimet e debitorit kryesor; madje ai mund t'i ushtrojë ato edhe kur debitori kryesor ka heqë dorë nga shfrytëzimi i kundërshtimeve në fjalë (në marrëdhënien e tij me kreditorin); njohja e kërkesave të kreditorit nga debitori kryesor, në situata të tilla, nuk e shtrin efektin juridik edhe ndaj dorëzantit.

1021.3 Përveç kundërshtimeve që mund t'i nxjerrë nga marrëdhënia kryesore, të cilat mund t'i ushtrojë ndaj kreditorit, dorëzani mund të ushtrojë edhe kundërshtime ose prapësime të cilat rrjedhin nga raporti individual i dorëzantit me kreditorin; p.sh., kundërshtimi se kontrata e dorëzantisë nuk është e vlefshme, (prandaj nuk prodhon detyrime për dorëzanimin) ose se detyrimi i dorëzantit që rrjedh nga kontrata e dorëzantisë është parashkruar, (pasi afati i parashkrimit të detyrimeve të dorëzantit është kryesisht më i shkurtër se parashkrimi i detyrimeve të debitorit kryesor) ose se dorëzani mund të ushtrojë prapësimin e kompensimit të kërkesave të tij me kërkesat e kreditorit etj.

Neni 1022. Detyrimi i njoftimit të dorëzimit mbi ometimin e debitorit

Në qoftë se debitori nuk përmbush detyrimin e vet në kohë, kreditori ka për detyrë që për këtë gjë ta njoftojë dorëzimin, përndryshe do t'i përgjigjet për dëmin të cilin dorëzimi do ta pësonte për këtë.

1022. LMD ka parashikuar në këtë dispozitë mundësinë e mbrojtjes së interesave të dorëzimit, në situatat kur ato vihen në rrezik për shkak të lëshimeve apo mosveprimeve të subjekteve të tjera të kontratës së dorëzimit. Në nenin e mësipërm është përcaktuar detyrimi i kreditorit për njoftimin e dorëzimit lidhur me dështimet-lëshimet apo mosveprimet e debitorit kryesor, lidhur me përmbushjen e detyrimit të tij në afatin e caktuar, përkatësisht në mënyrën e caktuar. Kjo për arsye se, në rast se kreditori nuk e përfill obligimin e vet për ta njoftuar dorëzimin për mospërmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit kryesor, kjo do të krijonte përgjegjësi për kreditorin për dëmet që mund t'i shkaktohen dorëzimit për shkak të mosnjoftimit të tij. Detyrimi i kreditorit për njoftimin e dorëzimit lidhur me mospërmbushjen e detyrimit nga debitori në afatin e caktuar i shërben qëllimit të ofrimit të mbrojtjes së interesave të dorëzimit. Në këtë situatë, dorëzimi i bëhet e mundur të ushtrojë disa veprime me qëllim të mbrojtjes së interesave të tij dhe mbrojtjes nga vështirësimi i pozitës së vet, ashtu që ai do ta ketë të drejtën të kërkojë nga debitori kryesor që të japë siguri për ndonjë dëm eventuale që mund t'i shkaktohet atij, kur dorëzimi do ta përmbushte detyrimin ndaj debitorit kryesor; ose, dorëzimi do të mund të mblidhte informata për astete e debitorit kryesor ose mundësinë e kundërshtimit të punëve juridike që debitori kryesor i lidh me të tretët në rast të cenimit të interesave të dorëzimit etj.

Neni 1023. Shkarkimi i dorëzimit për shkak të vonesës së kreditorit

- 1. Dorëzimi shkarkohet nga përgjegjësia në qoftë se kreditori, me thirrjen e tij pas rrjedhjes për pagesë të kërkesës, nuk kërkon përmbushjen nga debitori kryesor brenda një (1) muaji nga data e kësaj thirrjeje.**
 - 2. Kur afati i përmbushjes nuk është caktuar, dorëzimi shkarkohet nga përgjegjësia në qoftë se kreditori, me thirrjen e tij pas skadimit të një (1) viti nga lidhja e kontratës mbi dorëzimin, nuk bën brenda një (1) muaji nga data e kësaj thirrjeje deklaratë të nevojshme për caktimin e datës së përmbushjes.**
-

1023.1. Është rregull që detyrimet të përmbushen me kohë. Vonesa e palëve në përmbushjen e detyrimeve vështirëson pozitën e palës e cila ka rënë në vonesë. Nëse kreditori ka rënë në vonesë (nuk i mundëson debitorit përmbushjen e detyrimit), ajo e rëndon pozitën juridike të kreditorit në marrëdhënien e detyrimeve. Vonesa e kreditorit shkakton efekte juridike të caktuara edhe në raport me detyrimet e dorëzimit. Paragrafi i parë i nenit 1023 autorizon dorëzimin që t'i bëjë thirrje kreditorit për pranimin e objektit të detyrimit, (në rast se detyrimi është maturuar), nëse kreditori, për çfarëdo arsye, nuk i mundëson debitorit përmbushjen e detyrimit. Në një rast të tillë, detyrimi i dorëzimit ndaj kreditorit do të

shuhet kur kreditori, me gjithë thirrjen e dorëzimit, nuk kërkon përmbushjen nga debitori kryesor brenda një (1) muaji, (afat që fillon të ecë nga dita kur dorëzani i ka bërë thirrje kreditorit që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga debitori kryesor).

1023.2. Në marrëdhëniet e detyrimeve të paafatizuara, kur afati i maturitetit të kërkesave të kreditorit nuk është saktësuar, konsiderohet se dorëzani është i autorizuar të kërkojë nga kreditori që ky i fundit të përkujdeset për arkëtimin e kërkesave të tij brenda afatit prej një viti, i cili fillon të rrjedhë nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzimit; në këtë rast, nëse ka kaluar afati prej një viti (nga lidhja e kontratës së dorëzimit), dhe atëherë dorëzani i ka bërë thirrje kreditorit që të kërkojë nga debitori përmbushjen e detyrimit, dorëzani do të lirohet nga detyrimi i dorëzimit ndaj kreditorit, nëse ky i fundit nuk i bën thirrje debitorit kryesor për përmbushjen e detyrimeve as në afatin prej 30 ditësh, i cili fillon të rrjedhë nga dita e njoftimit-thirrjes që është bërë nga ana e dorëzimit.

Neni 1024. Lirimi i dorëzimit për shkak të heqjes dorë nga mjetet e sigurimit

- 1. Në qoftë se kreditori heq dorë nga pengu ose cilado e drejtë tjetër me të cilën ka qenë siguruar përmbushja e kërkesës së tij, ose e humb nga pakujdesia dhe në këtë mënyrë bën të pamundur kalimin e kësaj të drejte në dorëzanim, ky shkarkohet nga detyrimi i vet ndaj kreditorit për aq sa do të mund të fitonte nga ushtrimi i kësaj të drejte.**
- 2. Rregulla e paragrafit paraprak vlen si në rastin kur është fjala për të drejtën e lindur para lidhjes së kontratës mbi dorëzanimin, ashtu edhe në rastin kur ka lindur pas kësaj.**

1024.1. Në qoftë se, me gjithë ekzistimin e sigurimit të kërkesës së kreditorit me peng, hipotekë, ose me mjete të tjera juridike për sigurimin e kërkesës së tij (qofshin ato mjete reale ose personale), kreditori heq dorë nga të gjitha ose nga cilado qoftë prej tyre; ose, në rast se kreditori i ka humbur ato për shkak të pakujdesisë së tij, (ashtu që, duke e humbur atë mjet me vetëdije ose nga pakujdesia, ia ka pamundësuar dorëzimit kalimin e kësaj të drejte të dorëzimit), të gjitha rastet e tilla ose të ngjashme krijojnë situatën në të cilën LMD parashikon lirimin e dorëzimit nga detyrimi për përmbushjen e kërkesës së kreditorit, për aq sa është vlera e sendeve të lëna peng (në rast se ka humbur pengun) ose për aq sa është vlera e të drejtave a mjeteve të tjera sigurorese të humbura nga kreditori.

1024.2. Rregullat nga paragrafi i parë i nenit 1024 i LMD vlejnjë pavarësisht nga fakti nëse mjetet e tilla sigurorese ose të drejtat në dobi të sigurimit të kërkesave të kreditorit janë krijuar para lidhjes së kontratës së dorëzimit ose pas lidhjes së kontratës së dorëzimit.

Në këto rrethana, në qoftë se kreditori do të hiqte dorë apo do të humbiste nga pakujdesia pengun apo mjete të ngjashme sigurimi, përgjegjësi e dorëzimit ndaj kreditorit në lidhje me përmbushjen e detyrimit të debitorit kryesor, do të zvogëlohej në përpjesëtim me vlerën e mjeteve sigurorese, të cilat kreditori i ka pasur në dispozicion, nga të cilat ka hequr dorë vullnetarisht ose nga pakujdesia.

KREU 3

RAPORTET E DORËZANËSIT DHE TË DEBITORIT

Neni 1025. E drejta për të kërkuar kompensimin nga debitori

- 1. Dorëzani që ka përmbush detyrimin ndaj kreditorit, mund të kërkojë nga debitori t'ikompensojë të gjitha ato që i ka paguar në llogari të tij si dhe kamatën nga data e pagesës.**
- 2. Ai ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të krijuara në konteste me kreditorin që nga momenti kur e ka njoftuar debitorin mbi këtë konteste, si dhe në shpërblimin e dëmit në qoftë se ka ekzistuar.**

1025.1. Më sipër është thënë se kontrata e dorëzansë krijon detyrim personal dhe të pakufizuar për dorëzanin, ashtu që, nëse debitori kryesor nuk përmbush detyrimin e maturuar (tërësisht ose pjesërisht), ose kur nuk e përmbush atë në mënyrën e duhur, për përmbushjen e tij lind detyrimi i dorëzanit. Më sipër u tha, po ashtu, se marrëdhënia e dorëzansë krijon tri lloje marrëdhëniesh juridike, njëra nga të cilat është marrëdhënia ndërmjet dorëzanit dhe debitorit kryesor. Kjo marrëdhënie themelohet në momentin kur dorëzani përmbush diçka (pjesërisht ose tërësisht) ndaj kreditorit dhe kjo përmbushje detyrimi ishte borxh i debitorit kryesor. Këtë raport e rregullon posaçërisht neni 1025 i LMD, i cili parashikon se, kur dorëzani ka përmbushur diçka nga detyrimi i debitorit kryesor, atëherë ai e ka të drejtën e regresit ndaj debitorit kryesor, prej të cilit ka të drejtë të kërkoj pagesën e krejt asaj që ka përmbushur për kreditorin (ose kompensimin e saj) si dhe ka të drejtë të kërkojë pagesën e kamatës, e cila fillon të ecë nga dita kur dorëzani ka dhënë përmbushjen për kreditorin.

1025.2. Përveç të drejtës që të kërkojë t'i kthehet prapa ajo që ka paguar për detyrimet e debitorit si dhe kamatat përkatëse mbi pagesat e bëra, dorëzanit i takon edhe e drejta e shpërblimit të shpenzimeve të shkaktuara lidhur me përdorimin e mjeteve juridike, kundërshtimeve ose kontesteve të zhvilluara me kreditorin; këtë shpërblim të shpenzimeve të bëra dorëzani ka të drejtë ta kërkojë nga debitori kryesor vetëm në qoftë se për to, përkatësisht për kontestet e paraqitura, e ka njoftuar debitorin kryesor. Përveç të drejtës së shpërblimit për përballimin e shpenzimeve të shkaktuara, në çdo rast dorëzanit i takon edhe e drejta e shpërblimit të dëmit, nëse ka pësuar ndonjë dëm me rastin e përmbushjes së detyrimit në vend të debitorit kryesor.

Neni 1026. E drejta e dorëzanit të një debitori solidar

Dorëzani i një prej disa debitorëve solidarë mund të kërkojë prej cilido prej tyre që t'i kompensojë aq sa i ka paguar kreditorit, si dhe shpenzimet.

1026. Detyrimet solidarë pasive (marrëdhënie detyrimi me shumë debitorë dhe një kreditor), krijojnë detyrimin e secilit debitor që të përgjigjet për tërësinë e borxhit që kanë ata ndaj kreditorit. Nëse një subjekt ka qenë në pozitën e dorëzimit për sigurimin e detyrimit të më shumë debitorëve solidarë dhe nëse atë e ka përmbushur dorëzani, atëherë ky fiton të drejtën e kërkesës (përkatesisht zë vendin e kreditorit) ndaj të gjithë debitorëve solidarë. Solidariteti detyrimor ndërmjet debitorëve solidarë vazhdon të mbahet edhe pas përmbushjes së detyrimit nga dorëzani, i cili, në qoftë se ka përmbushur detyrimin në vend të debitorëve solidarë, ka të drejtë të kërkojë nga secili debitor solidar tërësinë e asaj që ka paguar në llogarinë e tyre, duke përfshirë në të njëjtën kërkesë edhe kompensimin e shpenzimeve të shkaktuara. Po në këtë kuptim, të gjithë debitorët solidarë, secili veç e veç, i përgjigjet dorëzimit për tërësinë e kërkesës, përkatesisht tërësinë e së drejtës së regresit të dorëzimit).

Neni 1027. E drejta e dorëzimit në sigurimin paraprak

Edhe para se ta përmbush kërkesën e kreditorit, dorëzani që është obliguar me dijen ose me pëlqimin e debitorit, ka të drejtë të kërkojë nga debitori t'i japë sigurim të nevojshëm për kërkesat e tij eventuale në rastet që vijojnë: në qoftë se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e vet në afatin e rrjedhjes për pagesë, po që se kreditori ka kërkuar në rrugë gjyqësore arkëtimin nga dorëzani dhe në qoftë se gjendja pasurore e debitorit është keqësuar mjaft pas lidhjes së kontratës mbi dorëzanimin.

1027. Ligji, me qëllim të mbrojtjes së pozitës së dorëzimit nga insolvenca e debitorit dhe disa veprime të kreditorit, ka parashikuar mundësinë që dorëzani, gjatë ekzistimit të kontratës së dorëzimit, të kërkojë nga debitori ofrimin e disa sigurimeve (ose mjeteve të sigurimit) të përshtatshme ndaj tij. Te tilla sigurime do të kërkoreshin në rastin kur debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij në afatin e arritjes së saj për përmbushje, po që se kreditori ka hapur procedurë gjyqësore për ta realizuar kërkesën e tij ndaj dorëzimit dhe në qoftë se gjendja financiare e debitorit është rënduar mjaft shumë pas lidhjes së kontratës së dorëzimit sa që situata e krijuar do të mund të paraqiste kërcënim serioz për dorëzanimin, nëse ofron përmbushjen e detyrimit në vend të tij. Mjetet që mund ta siguronin dorëzanimin do të mund të ishin, p.sh., themelimi i së drejtës së pengut në llogari të dorëzimit, themelimi i së drejtës së hipotekës, garancitë bankare ose çfarëdo mjeti tjetër juridik i përshtatshëm, që do të mund të themelohej në favor të dorëzimit. Këto mjete siguroese dorëzani mund t'i kërkojë nga debitori kryesor edhe para përmbushjes së kërkesës së kreditorit si dhe për rastet kur dorëzania është themeluar me dijeninë ose pëlqimin e debitorit kryesor.

Neni 1028. Humbja e të drejtës së kompensimit

- 1. Debitori mund të përdorë kundër dorëzantit, i cili pa dijen e tij ka bërë pagimin e kërkesës së kreditorit, të gjitha mjetet juridike me të cilat në momentin e kësaj pagese ka mundur të refuzojë kërkesën e kreditorit.**
- 2. Dorëzani që ka paguar kërkesën e kreditorit, ndërsa për këtë gjë nuk e ka njoftuar debitorin, kështu që edhe ky në padijeni për këtë pagesë e ka paguar përsëri të njëjtën kërkesë, nuk mund të kërkojë kompensim nga debitori, por ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që t'ia kthejë atë që ia ka paguar.**

1028.1. Paragrafi 1 i nenit 1028 përcakton detyrimin e dorëzantit që ta njoftojë debitorin dhe të këshillohet me të para se ai të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit. Kjo për arsye se kreditori mund të jetë në dijeni dhe mund të heshtë për ndonjë rrethanë relevante, lidhur me të cilën debitori do të kishte pasur mundësi të paraqiste kundërshtimet e veta ndaj tij. Të tilla kundërshtime do mund të ishin: kundërshtimi se borxhi është falur, është zvogëluar, është shpërblyer tërësisht ose pjesërisht apo kundërshtime të tjera. Në raste të ngjashme, kur i ofron përmbushjen e detyrimit kreditorit pa dijeninë e debitorit kryesor, dorëzani e humb të drejtën e regresit nga debitori kryesor për krejt ato vlera pasurore, për të cilat debitori kryesor do të mund të ushtronte mjete juridike kundrejt refuzimit të pagesave ose përmbushjeve ndaj kërkesave të kreditorit.

1028.2. Paragrafi i dytë rregullon situatën kur dorëzani i ofron përmbushjen kreditorit, por pa e njoftuar debitorin kryesor, i cili, për pasojë të mosnjoftimit, e përmbush edhe ky detyrimin ndaj kreditorit. Paragrafi i dytë i nenit që diskutohet vendos rregullën se dorëzani, në një situatë të tillë, për përmbushjen e detyrimit të tij nuk e njofton debitorin kryesor, nuk ka të drejtë të kërkojë rimbursim ose të drejtën e regresit nga debitori kryesor; megjithatë, dorëzani ka të drejtë që pagesën në emrin e asaj që ka paguar ta kërkojë nga kreditori (duke iu referuar rregullave të përgjithshme të pasurimit të pabazë). Kjo zgjidhje juridike do të thotë se të gjitha subjektet e së drejtës janë të detyruara të mbajnë pasojat e rregullave për veprimet e veta; po me këto pasoja duhet të ballafaqohet edhe dorëzani, i cili i ka lënë pas dore detyrimin për ta njoftuar debitorin për veprimet e veta.

Neni 1029. E drejta për kthimin e pjesës së paguar

Dorëzani i cili pa dijen e debitorit e ka paguar kërkesën e kreditorit, e cila më pas me kërkesën e debitorit është anuluar ose shuar me anë të kompensimit, mund vetëm të kërkojë nga kreditori kthimin e pjesës së paguar.

1029. Për rastet e parashikuara nga neni 1029 i LMD, kur dorëzani, pa dijeninë e debitorit kryesor, i paguan ose i ofron përmbushjen e detyrimit kreditorit, detyrime të debitorit këto që më pas janë anuluar ose janë kompensuar (janë shuar me kompensim) me kërkesën e debitorit, në një situatë të tillë, ai (dorëzani) mund t'i kërkojë vetëm kreditorit kthimin e

asaj që është paguar për këtë rast prej tij, kështu që një sjellje e ngjashme e dorëzanit nuk krijon detyrim shtesë për debitorin kryesor.

KREU 4 REGRESI I PAGUESIT NDAJ DORËZANËVE TË TJERË

Neni 1030. E drejta e kompensimit nga dorëzanët tjerë

Kur ekzistojnë disa dorëzanë, ndërsa njëri prej tyre paguan kërkesën e rrjedhur për pagesë, ai ka të drejtë të kërkojë prej dorëzanëve të tjerë që secili prej tyre t'ia kompensojë pjesën që i takon atij.

1030. LMD, në rastin e bashkëdorëzansë, mbron të drejtën e njërit prej bashkëdorëzaneve që ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, që ta ketë të drejtën e regresit ndaj bashkëdorëzaneve të tjerë në përpjesëtim me pjesën e borxhit që i takon secilit bashkëdorëzan. Kjo është e kuptueshme, meqenëse në bashkëdorëzani secili dorëzan garanton solidarisht përmbushjen e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, prandaj është më se e arsyeshme që, kur njëri nga ata e paguan tërë borxhin ndaj kreditori, ai ka të drejtën e regresit ndaj bashkëdorëzaneve të tjerë, në përpjesëtim me pjesët e detyrimit - borxhit që i takonte secilit bashkëdorëzan.

KREU 5 PARASHKRIMI

Neni 1031

- 1. Me parashkrimin e detyrimit të debitorit kryesor shuhet edhe detyrimi i dorëzanit.**
 - 2. Kur afati për parashkrimin e detyrimit të debitorit kryesor është më i gjatë se dy (2) vjet, detyrimi i dorëzanit parashkruhet pasi të kenë kaluar dy (2) vjet nga afati i rrjedhjes për pagesë të detyrimit të debitorit kryesor, përveç nëse dorëzani përgjigjet solidarisht me debitorin.**
 - 3. Ndërprerje e parashkrimit të kërkesave ndaj debitorit kryesor ka efekt edhe ndaj dorëzanit vetëm në qoftë se ndërprerja është shkaktuar nga ndonjë veprim i kreditorit para gjykatës kundër debitorit kryesor.**
 - 4. Ngecja e parashkrimit të detyrimit të debitorit kryesor nuk ka efekt ndaj dorëzanit.**
-

1031.1. Më lart u vu në dukje se kontrata për dorëzanimë është kontratë aksesore, çka nënkupton se kontrata për dorëzanimë ndjek fatin e kontratës kryesore. Ky parim do të

thotë se, me parashkrimin e detyrimit të debitorit kryesor të dalë nga kontrata kryesore, parashkruhet edhe detyrimi i dorëzimit.

1031.2. Pavarësisht nga rregulla e vendosur në paragrafin e parë të nenit 1031 të LMD, detyra e dorëzimit parashkruhet në afatin më të shkurtër prej dy (2) vjetësh në çdo rast, nëse detyrimi i debitorit kryesor parashkruhet në një afat më të gjatë. Afati prej dy vjetësh për parashkrimin e detyrimeve të dorëzimit fillon të ecë nga momenti i maturimit të detyrimit të debitorit kryesor (nga momenti kur detyrimi i debitorit kryesor ka arritur për pagesë). Nga kjo rregull ka vetëm një përjashtim, që ka të bëjë me rastet kur dorëzimi përgjigjet solidarisht me debitorin kryesor, ashtu që përgjegjësia solidare e dorëzimit nënkupton një pozitë të njëjtë juridike të tij me debitorin kryesor, duke i përfshirë këtu edhe afatin e njëjtë të parashkrimit të detyrimeve të tyre.

1031.3. Ndërprerja e parashkrimit ndaj debitorit kryesor, e shkaktuar me veprimet e kreditorit, e shtrin efektin edhe ndaj dorëzimit, por vetëm në rastet kur ndërprerja e parashkrimit është shkaktuar nga ndonjë veprim i kreditorit që ka ndërmarrë para gjykatës kundër debitorit kryesor. Në këtë rast, nëse shkaktohet ndërprerja e parashkrimit, edhe për dorëzimin rifillon të ecë afati i parashkrimit.

1031.4. Ndryshe nga rregulla për ndërprerjen e parashkrimit ndaj dorëzimit, e komentuar më lart, ngecja (siç e quan Ligji) ose ndalja e parashkrimit të detyrimit të debitorit kryesor nuk ka efekt ndaj dorëzimit.

PJESA XXVIII

KONTRATA PËR DËRGIMIN (ASIGNACIONI)

KREU 1

NOCIONI I KONTRATËS

Neni 1032. Nocioni i kontratës

Me anë të asignacionit, një person, asignanti autorizon tjetrin, asignatin që në llogari të tij t'i kryejë diçka të caktuar personit të tretë, marrësit të asignacionit asignatarit, dhe e autorizon këtë që të pranojë këtë kryerje në emër të vet.

1032. Neni 1032 i LMD përcakton kuptimin e kontratës për dërgimin (asignacionin). Sipas formulimit të kësaj dispozite, vërejmë se formulimi nga ligjdhënësi është bërë, duke përdorur terma juridiko-teknik, për të sqaruar efektet e detyrimeve ndërmjet tri subjekteve kryesore në kontratën për dërgimin, më saktësisht raportet ndërmjet dërguesit (asignantit), të dërguarit (asignatit) dhe marrësit të dërgimit (asignatarit). Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, asignacioni paraqet deklaratën e njërit person, me të cilën e dërgon dhe e autorizon personin tjetër për t'i kryer diçka të caktuar personit të tretë dhe këtë të fundit e udhëzon dhe e autorizon që ta pranojë atë veprim. Kështu, sipas formulimit të kësaj dispozite, efektet e asignacionit shfaqen te ndërrimi i debitorit në marrëdhëniet e detyrimeve, ashtu që asignanti është debitori i vjetër, asignati është debitori i ri, ndërsa asignatari është kreditor.

Pra, asignacioni është një operacion i përbërë, në të cilin marrin pjesë, siç thamë, tre persona: ai që e jep urdhrin që të kryhet një veprim i caktuar (dërguesi, asignanti); ai që dërgohet dhe autorizohet që ta kryejë veprimin (i dërguari, paguesi, asignati) dhe ai që autorizohet që ta pranojë veprimin (marrësi i dërgimit, shfrytëzuesi, asignatari). Objekti i dërgimit (asignacionit) mund të jenë të hollat, letra me vlerë (çeku, kambiali, letra e kredisë) dhe sende të tjera të zëvendësueshme. Dërgimin (asignacionin) te ne më së shumti e shfrytëzojnë personat juridikë –entitetet e biznesit, të cilat zakonisht marrin kredi në bankë me rastin e blerjes së mallrave, duke ndërmarrjet shitëse paguhen nga banka (e blerësit) për çmimin e shitjes.

KREU 2

MARRËDHËNIET MIDIS DËRGUESIT DHE TË DËRGUARIT

Neni 1033. Aprovimi nga ana e dërguesit

- 1. Asignatari fiton të drejtën që të kërkojë nga asignati përmbushjen vetëm kur ky të deklarojë se e pranon asignacionin (dërgimin).**
 - 2. Aprovimi i dërgimit nuk mund të revokohet.**
-

1033.1. Siç u vërejt nga neni paraprak, marrëdhënia e dërgimit (asignacionit) prezumon themelimin e tri marrëdhënieve juridike, më saktësisht, marrëdhënieve juridike ndërmjet dërguesit, të dërguarit dhe marrësit të dërgimit. Në këtë kuptim, të tria këto marrëdhënie janë marrëdhënie të ndara dhe të pavarura juridike. Kështu, paragrafi i parë i këtij neni parashikon të drejtën e asignatarit për të kërkuar nga asignati përmbushjen e detyrimit vetëm kur asignati të ketë deklaruar se e pranon asignacionin (dërgimin). Kjo, pasi që asignati, si debitori i ri, duhet të ofrojë një përmbushje ose të ekzekutojë një veprim për asignatarin, gjë që kërkon sigurimin e pelqimit të tij paraprak për sigurimin se përmbushja ndaj asignatarit do të realizohet.

1033.2. Siç u tha në paragrafin paraprak, asignati duhet të deklarojë se e pranon dërgimin me kusht që të përmbushet kërkesa. Mirëpo për rritjen e sigurisë juridike, ligjvënësi ynë ka parashikuar rregullën që aprovimi i dërgimit (nga asignati) të mos mund të revokohet. Shtrohet çështja nëse kjo rregull është detyruese? Mund të thuhet se kjo rregull është detyruese, të cilën palët nuk mund ta përjashtojnë në kontratë, për shkak se një përjashtim i tillë do të mund të sillte pasiguri juridike të shumë instrumente të pagesave, si të pagesat kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu dhe të shumë veprime të tjera bankare.

Neni 1034. Kundërshtimet e dërguesit

- 1. Me pranimin e dërgimit midis marrësit të dërgimit dhe dërguesit formohet marrëdhënia e borxhit, i pavarur nga raporti midis dërguesit dhe të dërguarit, si dhe nga raporti midis dërguesit dhe marrësit të dërgimit.**
 - 2. Dërguesi që e ka pranuar dërgimin mund t'i theksojë marrësit të dërgimit vetëm kundërshtimet që kanë të bëjnë me vlefshmërinë e aprovimit, kundërshtimet që bazohen në përmbajtjen e aprovimit ose në përmbajtjen e vetë asignacionit, si dhe kundërshtimet që ka personalisht ndaj tij.**
-

1034.1. Fillimisht duhet të tërhiqet vërejtja se në këta dy paragrafë, për dallim nga ish-LMD, i cili në nenet përkatëse përdorte termin “asignati”, LMD i tanishëm, në vend të termit “asiganti” përdor termin “dërguesi” dhe, në këtë kuptim, ne do të përdorin

terminologjinë aktuale ligjore. Marrëdhëniet që krijohen ndërmjet marrësit të dërgimit dhe dërguesit tregojnë se si marrëdhëniet e pranimit të dërgimit reflektohen në këto subjekte. Kështu, me pranimin e asignacionit, asignati dhe asignatari krijojnë marrëdhënie juridike. Në këtë kuptim, nëse asignati (dërguesi) pranon dërgimin (asignacionin) që në llogari të asignantit t'i paguajë diçka asignatarit (marrësit të dërgimit) ose të kryejë një veprim të caktuar në llogari të asignantit, atëherë fillojnë të rrjedhin detyrime të reja ndërmjet asignatit dhe asignatarit. (Alishani, S Alajdin, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 875., Prishtinë, 1988). Në këtë kuptim, me pranimin e asignacionit, ndërmjet asignatarit dhe asignatit themelohet marrëdhënia e borxhit, e cila është e pavarur nga marrëdhënia ndërmjet asignantit dhe asignatit si dhe marrëdhënia ndërmjet asignatit dhe asignatarit. Siç u tha në komentimet e mësipërme, secila marrëdhënie juridike ndërmjet tri subjekteve kryesore të dërgimit është marrëdhënie e veçantë juridike. Në këtë kuptim, kjo marrëdhënie e re është marrëdhënie kreditor-debitor dhe është e ndarë nga raportet e tjera të përmendura më lart.

1034.2. Paragrafi i dytë i këtij neni rregullon të drejtën e kundërshtimit ose prapësimeve, të cilat ka të drejtë t'i bëjë asignati (dërguesi). Në këtë kuptim, sipas këtij paragrafi, dërguesi (asignati) i cili e ka pranuar asignacionin, mund t'i paraqesë kundërshtime asignatarit vetëm për sa i përket çështjes së plotfuqishmërisë dhe vlefshmërisë së aprovimit të dërgimit, kundërshtimet që dalin nga përmbajtja e vetë dërgimit dhe kundërshtimet të cilat i ka personalisht ndaj tij. Gjatë kryerjes së punëve, janë të shpeshta rastet kur asignanti paguan çmimin e shitjes, kryesisht nëpërmjet asignatit që është banka. Në këtë kuptim, asignati këto veprime i kryen në llogari të asignantit dhe efekti ekonomik i këtyre veprimeve është i shprehur në favor të asignantit.

Neni 1035. Kalimi i asignacionit

- 1. Marrësi i asignacionit mund ta bëjë kalimin e dërgimit në një tjetër edhe përpara aprovimit nga ana e dërguesit, ndërsa ky mund ta bëjë kalimin më tej, përveç kur nga vetë dërgimi ose nga rrethanat e posaçme rrjedh se ai është i pabartshëm.**
- 2. Në qoftë se asignati i ka deklaruar asignatarit se e pranon dërgimin, ky pranim ka efekt ndaj të gjithë personave, në të cilët dërgimi do të bartet në mënyrë të parreshtur.**
- 3. Në qoftë se asignati i ka deklaruar fituesit në të cilin marrësi i dërgimit e ka bartur asignacionin se e aprovon atë, ai nuk mund t'i paraqesë fituesit kundërshtime që ka ndaj asignatarit personalisht.**

1035.1. Sipas kuptimit të paragrafit të parë të nenit 1035, asignatari mund t'ia kalojë asignacionin një personi tjetër (personit të tretë) edhe para aprovimit të dërgimit nga ana e dërguesit, ndërsa ky i fundit mund ta bëjë kalimin më tej, përveç rasteve kur vetë dërgimi ose kur nga rrethanat e secilit rast konkret të asignacionit kuptohet se dërgimi-asignacioni është i pakalueshëm. Sipas këtij paragrafi, kalimi i asignacionit mund të

bëhet pareshtur nga një marrës i dërgimit (asignatari) te tjetri, me përjashtim të rasteve kur dërgimi është i pakalueshëm ose kur kjo varet nga rastet e veçanta. Pakalueshmëria e asignacionit mund të jetë shumë e rëndësishme te disa punë ose veprime bankare, qëllim kryesor i të cilave është realizimi i pagesave dhe jo sigurimi i kredive. Një lloj i veçantë i dërgimit ekziston kryesisht te dy lloje të letrave me vlerë: kambiali dhe çeku. Në këtë kuptim, trasanti (dhënësi i çekut) është në pozitë pothuajse të njëjtë me të asignantit, sepse e autorizon trasatin, në këtë rast asignatin, që zakonisht është banka, që në llogari të tij të bëjë një veprim të caktuar për personin e tretë – poseduesin e çekut, përkatësisht asignatarin. (Alishani, S Alajdin, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 875., Prishtinë, 1988). Por, me ligj mund të përcaktohet shprehimisht që disa forma dhe lloje të asignacionit të jenë të kalueshme ose të pakalueshme.

1035. 2. Paragrafi 2 i këtij neni parashikon rregullën se, në qoftë se asignati ka deklaruar se e pranon asignacionin, ky pranim ka efekt ndaj të gjithë personave të cilëve u kalohet asignacioni në mënyrë të njëpasnjëshme. Deklarata e asignatit për pranimin e përvokueshëm të asignacionit ka rëndësi mjaft të madhe për pozitën juridike të asignatarit dhe për çdo palë të tretë që pranon urdhrat dhe pozitën e asignaiti (pasi kjo u sjell atyre siguri juridike).

1035.3. Paragrafi i 3 i nenit 1035 parashikon rregulla të veçanta për kundërshtimet që mund t'i bëjë asignati për rastet kur asignatari ia kalon asignacionin një personi të tretë (fituesit). Në këtë kuptim, ky paragraf parashikon rregullën që asignati nuk ka të drejtë t'i paraqesë kundërshtime fituesit të asignacionit - marrësit të fundit të dërgesës, kundërshtime këto që asignati i ka pasur personalisht dhe ka mundur t'i ushtrojë ndaj asignatarit personalisht.

Neni 1036. Parashkrimi

- 1. E drejta e asignatarit për të kërkuar përmbushjen nga asignati parashkruhet për një (1) vit.**
- 2. Në qoftë se nuk është caktuar afati i përmbushjes, parashkrimi fillon të rrjedhë kur asignati ta aprovojë asignacionin, e në qoftë se ai e ka aprovuar përpara se t'i jetë dhënë asignatarit, atëherë kur t'i jetë dhënë këtij.**

1036.1. Siç u tha në paragrafin 1 të nenit 1034, me pranimin e asignacionit themelohet një marrëdhënie e re, e pavarur ndërmjet dërguesit dhe marrësit të dërgimit. Rregullat e asignacionit, të përcaktuara nga nenet 1032 deri 1046, të cilat u referohen të drejtave të asignatarit për përmbushjen e kërkesave drejtuar asignatit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, parashkruhen në afat prej 1 (një) viti. Mirëpo, siç mund të shihet në këtë paragraf, kjo dispozitë parashikon rregullat e parashkrimit vetëm sa i përket të drejtës së asignatarit për të kërkuar përmbushjen nga asignati, por jo edhe të parashkrimit të kërkesave që dalin nga marrëdhënia e mëhershme ndërmjet asignatarit dhe asignantit. Prandaj, në mungesë të këtyre rregullave, rekomandohet zbatimi i rregullave të përgjithshme të parashkrimit

në afatin 5-vjeçar, sipas nenit 352 të LMD; (në lidhje me rregullat e përgjithshme të parashkrimit, shih komentimin e nenit 352 e tutje).

1036.2. Paragrafi i dytë i këtij neni përcakton momentin nga kur fillon të llogaritet dhe kur fillon të ecë afati i parashkrimit. Në kuptim të këtij paragrafi, afati i parashkrimit fillon të ecë nga momenti kur asignati miraton asignacionin, (rregull kjo që zbatohet vetëm për rastet kur nuk është caktuar afati i përmbushjes). Gjithashtu, po qe se asignati pranon dërgimin para se t'i dërgohet asignatarit, afati i parashkrimit fillon të ecë nga momenti kur asignatari merr dërgimin. “Në rastin e dytë, po qe se asignati pranon asignacionin para se t'i dërgohet asignatarit, afati i parashkrimit fillon të ecë që nga momenti kur asignatari merr dërgimin”; (shih për këtë: Alishani, S Alajdin, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 876., Prishtinë, 1988).

KREU 3

MARRËDHËNIA MIDIS ASIGNATARIT DHE ASIGNATIT

Neni 1037. Në qoftë se asignatari është kreditor i asignatit

- 1. Kreditori nuk ka për detyrë ta pranojë asignacionin që ia ka bërë debitori me qëllim të përmbushjes së detyrimit të vet, por ka për detyrë që për refuzimin e vet menjëherë ta njoftojë debitorin, përndryshe do t'i përgjigjet për dëmin.**
- 2. Kreditori që e ka aprovuar asignacionin ka për detyrë ta ftojë asignatin që ta zbatojë atë.**

1037.1. Paragrafi 1 i këtij neni parashikon detyrimin e asignatarit, i cili është kreditor i asignantit nga një marrëdhënie e mëhershme detyrimi, që ta njoftojë asignantin në rastet kur asignatari nuk e pranon dërgimin (asignacionin), respektivisht kur asignatari nuk e pranon përmbushjen e detyrimit të tij me asignacion. Në rast se nuk e njofton për këtë mospranim të dërgimit, atëherë asignatari përgjigjet për dëmin që i shkaktohet asignantit. Kohën brenda së cilës duhet bërë ky njoftim ligjvënësi e ka përcaktuar me shprehjen e përgjithshme “menjëherë”, ashtu që, në këtë kuptim, mendohet se shprehja e përdorur nga ligjvënësi e pasqyron natyrën emergjente të detyrës së njoftimit që duhet të ekzekutohet nga asignatari. Asignatari duhet ta ekzekutojë detyrimin e njoftimit të asignantit pa humbur kohë, sa më parë që kjo praktikisht të jetë e mundur për asignatarin, përndryshe do të mund t'i përgjigjet asignantit me shpërbllim të dëmit që do ta pësonte ai me këtë rast.

1037.2. Sipas këtij paragrafi, kreditori i cili ka pranuar dërgimin (përkatësisht asignatari) ka për detyrë ta ftojë asignatin që ta zbatojë asignacionin, respektivisht të ofrojë përmbushjen e kërkesës së tij me asignacion. Në këtë kuptim, pranimi i asignacionit do të thotë edhe përmbushje e kërkesës që del nga raporti i mëhershëm debitor-kreditor i asinantit dhe asignatarit.

Neni 1038. Asignacioni nuk është përmbushja

- 1. Kur kreditori e ka aprovuar asignacionin e bërë nga debitori i tij me qëllim të përmbushjes së detyrimit, ky detyrim nuk pushon, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe as me aprovimin e tij të asignacionit dhe as me aprovimin nga ana e asignatit, por vetëm me përmbushjen nga ana e asignatit.**
- 2. Kreditori që e ka aprovuar asignacionin e bërë nga ana e debitorit të tij, mund të kërkojë nga asigntati që t'i plotësojë atë që i debiton vetëm në qoftë se nuk ka marrë përmbushje nga asigntati në kohën e caktuar në asignacion.**

1038.1. Në rastet kur asigntari pranon asignacionin, ai ka për detyrë t'i respektojë rregullat e parashikuara në këtë nen. Kështu, në rastet kur asigntari e pranon asignacionin e bërë nga asigntati me qëllim të përmbushjes së detyrimit të tij, atëherë ky detyrim nuk pushon as me aprovimin e dërgimit nga ana e tij, as nga ana e asignatit, por vetëm me përmbushjen e dërgimit nga asigntati. Mirëpo, sipas këtij paragrafi, detyrimi ndaj asigntarit (si kreditor i marrëdhënies) mund të pushojë edhe në tjetër mënyrë, nëse palët e kanë parashikuar këtë mundësi me marrëveshjen e tyre. Siç shihet nga përmbajtja e këtij paragrafi, parimisht kjo dispozitë u mundëson palëve që të rregullojnë me marrëveshje raportet e tyre sa i përket përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e asignacionit. Përgjithësisht, në rastet kur nuk është kontraktuar diçka tjetër, përpos përmbushjes së plotë të detyrimit, niratimi i asignacionit nga ana e asigntarit dhe asigntatit nuk e shuan detyrimin që rrjedh nga marrëveshja e asignacionit, përkatësisht detyrimi përmbillet kur asigntari e pranon objektin e detyrimit me anë të përmbushjes nga ana e asigntatit.

1038.2. Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, në rastet kur kreditori që ka aprovuar asignacionin-dërgimin nga debitori i tij-asigntati, mund të kërkojë nga ky i fundit ta përmbushë atë që i debiton (që i ka borxh), përkatësisht ta përmbushë objektin e detyrimit, vetëm në qoftë se akoma nuk e ka pranuar përmbushjen nga asigntati në kohën e caktuar, ashtu siç është parashikuar me asignacion.

Neni 1039. Detyra e asigntarit për ta njoftuar asigntantin

Në qoftë se asigntati refuzon ta aprovojë asignacionin, e refuzon përmbushjen që kërkon prej tij asigntari, ose deklaron që përpara se nuk do ta zbatojë, asigntari ka për detyrë ta njoftojë menjëherë asigntantin për këtë gjë, përndryshe do t'i përgjigjet për dëmin.

1039. Dispozita e këtij neni parashikon përgjegjësinë e asigntarit për njoftimin dhe lajmërimin e menjëhershëm të asigntatit, në rastet kur asigntati refuzon ta aprovojë asignacionin, kur refuzon përmbushjen e detyrimit të kërkuar prej tij nga asigntari, ose nëse ai deklaron paraprakisht se nuk do ta zbatojë asignacionin. Sipas kësaj dispozite, njoftimi nga asigntari për mospërmbushje të detyrimit nga asigntati, asigntatit duhet

t'i bëhet menjëherë, përndryshe asignatari do t'i përgjigjet për dëmin e shkaktuar konform dispozitave për shpërblimin e dëmit për shkak të mospërbushjes së kontratës. Sigurisht, njoftimi me kohë i asignantit për sjelljet e tilla të asignantit i mundësojnë të parit që të ndërmarrë masa ose të përdor mjete adekuate juridike që të mbrohet nga veprimet e tilla të asignantit.

Neni 1040. Heqja dorë nga asignacioni i aprovuar

Asignatari që nuk është kreditori i asignantit dhe që nuk dëshiron që asignacionin ta përdorë mund të heqë dorë prej tij, edhe në qoftë se ka deklaruar se e aprovon atë, por ka për detyrë që për këtë gjë ta njoftojë asignantin pa vonesë.

1040. Kjo dispozitë e LMD parashikon mundësinë e asignatarit për heqjen dorë nga asignacioni në rastet kur ky i fundit nuk dëshiron ta përdorë asignacionin, përkatësisht në rastet kur asiknatarit nuk është kreditor i asignantit. Kjo dispozitë, po ashtu, lejon mundësinë e heqjes dorë nga asignacioni edhe në rastet kur asignatari ka deklaruar se e aprovon asignacionin, por me detyrimin e lajmërimit dhe njoftimit pa vonesë të asignantit. Kjo mundësi vlen për rastet kur asignatari nuk është kreditor i asignantit dhe kur marrëdhëniet e tyre rregullohen në bazë të kontratës së asignacionit, p.sh., kur i jepet kredi asignantit, kurse për asignatarin është njësoj nëse asignati e jep këtë kredi si debitor i asignantit apo si debitor i ri. (Alishani, S Alajdin, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 875., Prishtinë, 1988). Sipas këtij paragrafi, për rastet e përmendura të heqjes dorë nga asignacioni, asignatari duhet ta njoftojë pa vonesë asignantin. Ligji kërkon njoftimin e asignantit për këtë mundësi, pasi që njoftimi pa humbur kohë i mundëson atij kursimin e shpenzimeve, por edhe shmangien e dëmeve që mund të rrjedhin nga kjo vonesë e moslajmërimit. Për sa i përket shprehjes “pa vonesë”, në rast kontesti eventual të palëve, mund të themi se kjo duhet të përcaktohet nga rrethanat e secilit rast veç e veç.

Neni 1041. Revokimi i autorizimit të dhënë marrësit të dërgesës

Asignanti mund ta revokojë autorizimin që me anë të asignacionit ia ka dhënë marrësit të asignacionit, përveç se asignacionin e ka lëshuar me qëllim të përbushjes së ndonjë borxhi të vet ndaj tij dhe në përgjithësi në qoftë se asignacionin e ka lëshuar në interes të tij.

1041. Përderisa neni paraprak parashikonte të drejtën e asignatarit që të heqë dorë nga asignacioni edhe atëherë kur ka deklaruar se atë e pranon, ky nen parashikon mundësinë dhe të drejtën e asignantit që ta revokojë autorizimin që ia ka dhënë asignatarit për pranim të asignacionit. Në këtë kuptim, parimisht assignanti mund ta revokojë autorizimin e dhënë asignatarit kur ekzistojnë dy shkaqe: në rastin e parë, kur assignanti ka lëshuar asignacionin me qëllim të përbushjes së ndonjë borxhi të tij ndaj asignatarit dhe në atë rast assignanti ka përbushur detyrimin në ndonjë mënyrë ose formë tjetër (jashtë marrëdhënies së asignacionit), ndërsa në rastin e dytë është kur përgjithësisht assignanti e lëshon asignacionin në interesin e tij. Se cilat janë interesat e tij varet nga rasti në rast.

KREU 4 MARRËDHËNIET E ASIGNATIT DHE TË ASIGNATARIT

Neni 1042. Në qoftë se asignati është debitor i asignantit

- 1. Asignati nuk ka për detyrë ta aprovojë asignacionin edhe nëse është debitor i asignantit, përveç nëse ia ka premtuar këtë.**
- 2. Kur asignacioni është lëshuar në bazë të borxhit të asignatit, asignati ka për detyrë ta zbatojë deri në shumën e këtij borxhi, në qoftë se kjo nuk është në asnjë pikëpamje më e rëndë nga sa është përmbushja e detyrimit ndaj asignantit.**
- 3. Zbatimi i asignacionit të lëshuar në bazë të borxhit të asignatit, asignati shkarkohet në të njëjtën masë nga borxhi i vet kundrejt asignantit.**

1042.1. Nga përkufizimi i kontratës së asignacionit kuptohet efekti i marrëdhënieve të detyrimeve ndërmjet tri subjekteve kryesore të kësaj kontrate. Kështu, marrëdhënia ndërmjet asignantit dhe asignatit vë në dukje arsyen për të cilën asignati duhet të kryejë ndonjë veprim për asignantin (në llogari të asignatarit). Siç u tha në përkufizimin e kësaj kontrate, kjo marrëdhënie ndërmjet këtyre dy subjekteve quhet edhe marrëdhënie përballimi, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me ekzekutimin e detyrimit ndaj asignatarit nga asignati, në llogari të asignantit.

Në këtë kuptim, këtu kërkohet të ekzistojë mbulesa materiale, ngase asignati ia bën pagesën asignatarit nga mjetet të cilat i ka marrë ose do t'i marrë nga asignanti mbi bazë të ndonjë marrëdhënieje të mëhershme interne ndërmjet asignantit dhe asignatit. (Alishani, S Alajdin, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 872., Prishtinë, 1988).

Sipas përmbajtjes së këtij paragrafi, duhet të merret parasysh fakti nëse është ose jo asignati debitor i asignantit. Në këtë kuptim, ky paragraf parashikon rregullën, sipas së cilës, asignati nuk është i obliguar ta aprovojë asignacionin edhe kur asignati është debitor i asignantit mbi bazë të ndonjë marrëdhënieje tjetër juridike, përveç nëse asignati ia ka premtuar këtë. Pra, sipas këtij paragrafi, një detyrim i tillë rrjedh vetëm atëherë kur ky të jetë kontraktuar paraprakisht ndërmjet palëve.

1042.2. Paragrafi i dytë i këtij neni rregullon një rast të veçantë, kur asignati është i detyruar të pranojë dhe të zbatojë urdhrat e asignantit. Ky detyrim i referohet rastit kur urdhri i përmbushjes i referohet borxhit të asignatit ndaj asignantit, të cilin asignati duhet t'ia përmbushë sipas urdhrat asignatarit, ndërsa asignati ka për obligim që këtë detyrim ta zbatojë deri në shumën e këtij borxhi. Përmbushja e tillë e detyrimit nga asignati (përmes ekzekutimit të urdhrat të asignacionit) në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë më e lartë se përmbushja e rregullt e detyrimit të tij ndaj asignantit.

1042.3. Nëse ka ekzistuar rasti ashtu si u diskutua në paragrafin dy me lart, kur përmbushja e detyrimit të asignatit ndaj asignantit bëhet përmes ekzekutimit të urdhrat të asignacionit,

asignati lirohet nga borxhi (ndaj asignantit) në të njëjtën masë sa i ka paguar asignatarit (përmes ekzekutimit të asignacionit), me fjalë të tjera, sa është shuma e ekzekutimit në llogari të asignatarit nga asignati, për aq lirohet asignati nga borxhi që ka ndaj asignantit.

Neni 1043. Revokimi i autorizimit të dhënë asignatit

- 1. Asignanti mund ta revokojë autorizimin të cilin me asignacion ia ka dhënë asignatit, gjithnjë gjersa ky nuk i deklaron asignatarit se e aprovon asignacionin, apo se nuk e zbaton atë.**
- 2. Ai mund ta revokojë edhe kur në vetë asignacion është shënuar se është i parevokueshëm, si dhe kur nga revokimi do të ofendohej ndonjë detyrim i tij ndaj asignatarit.**
- 3. Hapja e falimentimit mbi pasurinë e asignantit tërheq vetvetiu në bazë të ligjit revokimin e asignacionit, përveç me rastin kur asignati e ka aprovuar këtë më parë asignacionin përpara hapjes së falimentimit, si dhe kur në çastin e aprovimit nuk ka qenë në dijeni dhe as që ka mundur të ishte në dijeni për këtë falimentim.**

1043.1. Fillimisht duhet të dihet se asignacioni iniciohet përmes urdhrin të njëanshëm të asignantit, i cili, parimisht, vendos për dhënien ose revokimin e asignacionit që ia ka dhënë asignatit. Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, asignanti mund ta revokojë autorizimin që ia ka dhënë me asignacion asignatit, përderisa ky (asignati) nuk i deklaron asignatarit se e aprovon asignacionin ose, në rastin e tjetër, përderisa asignati nuk e zbaton asignacionin (dërgesën) te asignatari. Sigurisht, përjashtimi nga ky nen që, në disa raste, urdhri i asignacionit nuk mund të revokohet, ka për qëllim t'i mbrojë interesat e asignatarit; (në lidhje me aprovimin e asignacionit nga asignatari, shih komentimin e nenit 1033).

1043.2. Në paragrafin e dytë të këtij neni është rregulluar dhe parashikuar e drejta dhe autorizimi i asignantit për ta revokuar autorizimin e dhënë asignatit për asignacion edhe atëherë kur ky autorizim është shënuar në kontratën (ose urdhrin) e asignacionit si i parevokueshëm. Gjithashtu, një rast tjetër sipas këtij paragrafi kur mund të bëhet revokimi i urdhrin të asignacionit është edhe ai kur revokimi i urdhrin do të mund t'i cenonte disa detyrime që i ka ky (asignanti) ndaj asignatarit. Ky rast arsyetohet me rregullën e autonomisë së vullnetit dhe lirisë së kontraktimit.

1043.3. Sipas paragrafit të tretë të këtij neni, si rregull, hapja e procedurës së falimentimit mbi pasurinë e asignantit ka kuptimin e revokimit të autorizimit sipas fuqisë së ligjit (ex lege). Në këtë kuptim, përjashtimisht mbetet në fuqi autorizimi nga rasti i parë, nëse asignati e ka aprovuar paraprakisht asignacionin, d.m.th., para hapjes së falimentimit të asignantit, si dhe në rastin kur, në çastin e aprovimit, asignati nuk ka qenë në dijeni dhe nuk ka mundur të jetë në dijeni për hapjen e falimentimit ndaj asignantit.

KREU 5

VDEKJA DHE PRIVIMI I AFTËSISË PËR TË VEPRUAR

Neni 1044. Vdekja dhe privimi i aftësisë për të vepruar

Vdekja e asignantit, asignatarit ose e asignatit, si dhe privimi i aftësisë për të vepruar të ndonjërit prej tyre nuk ka ndikim në asignacion.

1044. Në kuptim të përmbajtjes së asignacionit, pamë se asignacioni përfshin tri subjekte kryesore të asignacionit dhe themelimin e tri marrëdhënieve të caktuara juridike: marrëdhëniet ndërmjet asignantit dhe asignatarit, marrëdhëniet ndërmjet asignantit dhe asignatit dhe marrëdhëniet ndërmjet asignatarit dhe asignatit. Këto marrëdhënie, siç thamë, janë marrëdhënie kreditor-debitor në kuptimin që asignanti e përmbush detyrimin - borxhin e tij ndaj asignatarit përmes dërgimit të cilin e ekzekuton asignati. Marrëdhëniet e tyre janë reciproke dhe të pavarura, kurse në kuptimin ekonomik, përbëjnë një tërësi unike të një operacioni afarist. (Alishani, S Alajdin, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 877., Prishtinë, 1988). Në zbatimin e asignacionit këto subjekte kryesore janë rëndom persona fizikë ose persona juridikë. Mirëpo, në kuptim të përmbajtjes së kësaj dispozite, kjo rregull duhet të interpretohet në të njëjtën mënyrë si në rastin kur bëhet fjalë për persona fizikë, ashtu edhe për persona juridikë. Në këtë kuptim, sipas kësaj dispozite, te marrëdhënia e asignacionit në rast të vdekjes së njërit nga subjektet e asignacionit ose privimit të tij nga zotësia për të vepruar, kjo e drejtë u kalohet pasardhësve të tyre. Në këtë pikëpamje, mund të thuhet se e njëjta gjë vlen edhe për personin juridik, si konstruksion juridik, në të cilin suksesorët marrin përsipër detyrimet e paraardhësit, në lidhje me ekzekutimin e asaj që del nga marrëdhënia e asignacionit). Në këtë kuptim, mund të përfundohet se marrëdhënia që themelohet me asignacion është marrëdhënie jopersonale, prandaj të drejtat dhe detyrat e palëve nga kjo marrëdhënie mund t'u kalohen suksesorëve.

KREU 6

ASIGNACIONI NË FORMË TË LETRËS SË PRURËSIT

Neni 1045. Asignacioni në formë të letrës së zotëruesit

- 1. Asignacioni me shkrim mund t'i lëshohet zotëruesit.**
 - 2. Në këtë rast secili titullar (posedues) i letrës ka ndaj asignatit pozitën e asignatarit.**
 - 3. Raportet që me asignacion linden midis asignatarit dhe asignantit, formohen në këtë rast vetëm midis secilit posedues të veçantë të letrës dhe të personit që ia ka ceduar letrën.**
-

1045.1. Fillimisht duhet të vihet në dukje se konstrukcionet ekonomike dhe juridike të asignacionit shfaqen në praktiken e punës gjatë qarkullimit mall-para dhe kjo kryesisht në operacionet bankare dhe instrumentet e ndryshme të pagesave në ekonomi, duke përfshirë këtu edhe letrat me vlerë. Në këtë kuptim, detyrimet që rrjedhin nga kjo dispozitë ligjore duhet të zbatohen në lidhje me detyrimet të cilat rrjedhin nga dispozita e neneve 217-244 të këtij Ligji. Kështu, paragrafi i parë i këtij neni parashikon mundësinë që udhëzimi-autorizimi të asignacioni t'i lëshohet në formën e shkruar zotëruesit, i cili mund t'i realizoj të drejtat që janë pasqyruar në urdhrin e asignacionit, të materializuara në letrën e asignacionit). Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, kjo formë siguron një shkallë të lartë të lëvizshmërisë në trajtimin e asignacionit si në konceptin ligjor, ashtu edhe në atë ekonomik.

1045.2. Paragrafi i dytë i këtij neni parashikon rastet e udhëzimit të shkruar tek asignacioni në formën e letrave me vlerë të prurësit, kur secilit titullar i letrave me vlerë të prurësit ka pozitën e asignatarit ndaj asignatit. Kjo marrëdhënie ndërmjet asignatit dhe asignatarit është deri diku e padefinuar, sepse asignatar konsiderohet çdo posedues i ligjshëm i letrave me vlerë të prurësit, prandaj, si e tillë ajo supozohet gjithmonë, në kuptim të nenit 222 të LMD. (Në lidhje me realizimin e të drejtave që dalin nga letrat me vlerë, shih komentet nga neni 222 e tutje). Po ashtu, duhet të thuhet se këto rregulla, megjithatë, nuk mund të lidhen vetëm me letrat me vlerë të prurësit, sepse, në praktikën e punës, palët ekzekutojnë shpesh edhe veprime dhe operacione të caktuara bankare, si dhe përdorin instrumente të caktuara të pagesave, ashtu që në të dyja rastet, mund të mos kenë lidhje me letrat me vlerë.

1045.3. Ky paragraf parashikon rregulla të veçanta sa i përket rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet asignantit dhe asignatarit edhe atëherë kur është lëshuar letra me vlerë e prurësit. Në këto raste nuk është e thënë që çdo mbajtës i letrave me vlerë të jetë në marrëdhënie juridike me asignantin, pra jo domosdoshmërisht ka një marrëdhënie juridike ndërmjet asignantit dhe asignatarit, por, megjithatë, asignatari ka të drejtë të kërkojë arkëtimin ose të drejtën që është e materializuar në letrën e asignacionit.

KREU 7

ASIGNACIONI NË FORMË TË LETRËS SIPAS URDHËRIT

Neni 1046. Asignacioni në formë të letrës sipas urdhërit

Asignacioni shkresor që është i pagueshëm në të holla, në letrat me vlerë, oe në sendet e zëvendësueshme, mund të lëshohet me dispozitën “sipas urdhërit”, në qoftë se asignati është person që merret me veprimtari ekonomike dhe në qoftë se ajo që duhet të kryejë, bie në kuadrin e kësaj veprimtarie.

1046. Ky nen i LMD ka themeluar rregulla të veçanta sa u përket udhëzimeve që kanë të bëjnë me asignacionin shkresor, i cili përmban klauzolën “sipas urdhërit”. Në këtë rast, LMD në këtë nen parashikon krijimin e marrëdhënies së detyrimeve me dërgim dhe dhënie të dërgimit në formë të letrës me vlerë sipas urdhrit. Në kuptim të këtij neni, për krijimin e këtij lloji të asignacionit në formë të letrës me vlerë “sipas urdhërit” duhet të plotësohen tri kushte: së pari, asignacioni duhet të jetë në të holla, në letra me vlerë, ose në sende të zëvendësueshme; së dyti, asignati duhet të jetë një person që merret me veprimtari ekonomike dhe, së treti, veprimi i të cilin duhet ta kryejë asignati bie në kuadrin e asaj veprimtarie (afariste) që ndërlidhet me ekzekutimin e urdhrit sipas asignacionit. Duhet të vihet në dukje se është shumë e nevojshme që, kur lëshohen letrat me vlerë sipas urdhrit, duhet çdoherë të shënohet emri i asignatarit ose asignatarëve, të cilët do të pranojnë përmbushjen e detyrimit. Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, përmbushja kumulative e këtyre tri kushteve është e domosdoshme, përndryshe asignacioni i dhënë në këtë formë nuk do të ketë asnjë efekt juridik. Në praktikat e biznesit, ekzekutimin e asignacionit në bazë të letrave me vlerë sipas urdhrit zakonisht e bëjnë personat juridikë, siç janë bankat, përmes operacioneve bankare, ashtu që mund të thuhet se pothuajse çdoherë ky ekzekutim bie në veprimtarinë e tyre.

PJESA XXIX

UJDIA

Neni 1047. Përkufizimi

1. Në kontratën për ujdinë në mes të personave në kontest apo të cilët kanë paqartësi lidhur me ndonjë marrëdhënie juridike, kontestet ndërpriten me ndihmën e lëshimeve reciproke, respektivisht eliminohen pasiguritë dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke.
2. Konsiderohet se ekziston një paqartësi edhe atëherë, nëse ushtrimi i një të drejte specifike është e pasigurt.

Shqyrtime të përgjithshme.- Ujdia apo pajtimi është një kontratë, me të cilën palët kontraktuese i rregullojnë dhe i përcaktojnë raportet e tyre reciproke në mënyrë të tillë që kjo marrëveshje përfaqëson pajtimin e tyre të ndërsjellë. Andaj mund të thuhet se lëshimi reciprok i të dy palëve kontraktuese lidhur me ndonjë paqartësi në ndonjë marrëdhënie juridike, krijon lehtësi reciproke, gjë që përbën elementin thelbësor të zgjidhjes së mosmarrëveshjes mes tyre. Pra, ky nen jep përgjithësisht kuptimin dhe përkufizimin e kontratës për ujdinë.

1047.1 Sipas përmbajtjes së paragrafit të parë të këtij neni, kontrata e ujdisë ekziston atëherë kur palët që gjenden në kontest apo që kanë paqartësi lidhur me ndonjë marrëdhënie të caktuar juridike, pajtohen që mosmarrëveshjet të ndërpriten me ndihmën e lëshimeve të ndërsjella, nëpërmjet të cilave eliminohen pasiguritë dhe definoen të drejtat dhe detyrimet e tyre të ndërsjella. Kështu, kjo dispozitë përcakton se ujdia ekziston kur bëhen lëshime reciproke, kur eliminohen pasiguritë dhe kur përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, pra me këtë marrëveshje (ujdi) palët pajtohen dhe rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në atë formë që mënjanon mosmarrëveshjen ose pasigurinë e tyre të ndërsjellë. Sipas këtij kuptimi, nuk do të kishte pajtim dhe as zgjidhje nëse nuk ka lehtësime reciproke dhe pajtim të ndërsjellë. Në rast se vetëm njëra palë pajtohet për zgjidhjen e një kontesti të caktuar, atëherë nuk do të kishim ujdë, por shkarkim të borxhit, kontratë të dhuratës ose ndonjë institut të ngjashëm juridik. Për shembull, në qoftë se vetëm një palë “dështon” dhe kërkesa e tij është ulur, ndërsa pala tjetër këmbëngul në kërkesën e saj, atëherë ajo mund të quhet dhuratë - kur ka animus donandi ose vetëm një pjesë të lehtësimit (faljes) së borxheve.

1047.2. Siç u pa, në paragrafin paraprak përcaktohej se çka konsiderohet paqartësi në rast të kontestit eventual ndërmjet palëve. Në kuptim të kësaj dispozite, paqartësia ekziston në rastet kur palët kanë mosmarrëveshje lidhur me ndonjë marrëdhënie juridike dhe, në këtë kuptim, kjo dispozitë është më e përgjithshme. Kështu, paragrafi i dytë i këtij neni përcakton se paqartësia ekziston edhe në rastet kur ushtrimi i një të drejte specifike është i pasigurt. Në këtë kuptim, p.sh., paqartësi kemi te rastet e pasigurisë, kur nuk shihet qartë

mundësia e ushtrimit të së drejtës së parablerjes ose kur kreditori nuk e ka të qartë në një marrëdhënie të caktuar juridike nëse do të mund të kërkojë përmbushjen nga dorëzani i debitorit etj. Në këtë vështrim, kjo dispozitë zgjeron mundësinë e palëve kontraktuese që të përcaktojnë detyrimet e tyre reciproke përmes kontratës së ujdisë edhe për rastet kur ushtrimi i një të drejte të tyre në një marrëdhënie të caktuar juridike është i pasigurt.

Neni 1048. Shtrirja e lëshimeve reciproke

- 1. Lëshimet mund të ekzistojnë, midis tjerash, në njohjen e pjesshme ose të plotë të ndonjë kërkesë të palës tjetër ose në heqjen dorë nga ndonjë kërkesë të vet, në marrjen mbi vete të ndonjë detyrimi të ri, në zvogëlimin e shkallës së kamatës, në zgjatjen e afatit, në dhënien e pëlqimit për pagimin e kësteve të pjesshme; në dhënien e të drejtës së pendimit.**
- 2. Lëshimi mund të jetë me kusht.**
- 3. Kur vetëm njëra palë i bën lëshim palës tjetër dhe njuh, p.sh. kërkesën e palës tjetër, atëherë kjo nuk është ujdi dhe nuk i nënshtrohet rregullave të ujdisë.**

1048.1. Paragrafi i parë i këtij neni parashikon mundësinë e palëve kontraktuese që, në lidhje me paqartësitë të cilat i kanë në marrëdhënien e caktuar juridike, lëshimet e tyre mund t'i bëjnë duke njohur pjesërisht ose në mënyrë të plotë kërkesën e palës tjetër, me heqjen dorë nga kërkesa e vet, me marrjen përsipër të ndonjë detyrimi të ri, me zvogëlimin e normës së kamatës, me zgjatjen e afatit, me dhënien e pëlqimit për pagimin e kësteve të pjesshme si dhe duke i njohur palës tjetër kontraktuese të drejtën e pendimit. Në kuptim të përmbajtjes së këtij paragrafi, lëshimet nuk janë caktuara një për një, pra janë të formuluar në mënyrë ekstensive, ashtu që u mundëson palëve kontraktuese të zbatojnë modalitete të ndryshme, në raste të ndryshme. Pra, paragrafi i parë i këtij neni u mundëson palëve përfundimin e kontestit të tyre, duke u lënë hapësirë që lëshimet e tyre t'i bëjnë varësisht nga marrëdhënia e tyre e detyrimit.

1048.2. Paragrafi i dytë parashikon se lëshimi mund të jetë edhe me kusht. Pra, nga karakteri i i kushtit, do të varet edhe fati i ujdisë, domethënë varësisht nga fakti nëse kushti është shtyrës apo zgjidhës. (Në lidhje me kushtin, shih komentin e nenit 36 dhe neneve 59-64 të LMD.)

1048.3. Nëse vetëm njëra palë i bën lëshim palës tjetër në kuptim të këtij paragrafi, kjo nuk mund të quhet ujdi sipas dispozitave të kësaj pjese të LMD-së dhe nuk u nënshtrohet rregullave të pajtimit. Prandaj, këto lëshime mund të llogariten si dhuratë, falje e borxhit, pranim i borxhit etj.

Neni 1049. Aftësia

Për lidhjen e kontratës për pajtimin është e nevojshme aftësia për disponim me të drejtën, e cila është objekt i ujdisë.

1049. Duke pasur parasysh se ujdia ka efekt konstituiv, pra krijon të drejta dhe detyrime të reja mes palëve kontraktuese ose i ndryshon a i shuan ato, ekzekutimi i ujdisë kërkon një aftësi të veçantë juridike. Pra kjo, sipas përmbajtjes së këtij paragrafi, është aftësia për disponimin e së drejtës që është objekt i ujdisë (neni 1050.1.), përkatësisht aftësia e plotë e veprimit, (që në të drejtën tonë arrihet në moshën 18 vjeçare). Në këtë kuptim, nëse aftësia e veprimit të personit i cili ekzekuton një ujdinë është e kufizuar, mund të thuhet se ndaj saj zbatohen po ato rregulla që zbatohen te kontratat e tjera (në lidhje me kontratën me persona të paaftë për të vepruar, shih komentimin e nenit 41).

Neni 1050. Objekti

- 1. Objekt i ujdisë mund të jetë çdo e drejtë me të cilën mund të disponohet.**
 - 2. E vlefshme është ujdia për pasojat pasurore të një çështje penale.**
 - 3. Objekt i ujdisë nuk mund të jenë kontestet që u përkasin marrëdhënieve statusore.**
-

1050.1. Paragrafi i parë i këtij neni përcakton se objekt i ujdisë është çdo e drejtë, e cial mund të disponohet lirisht, përkatësisht çdo e drejtë e karakterit pasuror që mund të kalohet dhe nuk është e lidhur me personalitetin e palëve. Në këtë kuptim, dispozita e këtij paragrafi ka karakter të përgjithshëm. Me anë të kontratës së ujdisë palët i rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre të ndërsjella në fusha të ndryshme juridike - pasurore. Mund të thuhet se kjo u referohet kryesisht marrëdhënieve me karakter pasuror ose, më saktë, marrëdhënieve kontraktuese, trashëgimore, pronësore, afariste, të shpërblimit të dëmit etj. Pra, bëhet fjalë vetëm për rregullimin e marrëdhënieve juridike në ato fusha në të cilat mbizotëron autonomia e vullnetit të palëve dhe liria e disponimit të vlerave pasurore. Kjo do të thotë se palët mund t'i rregullojnë raportet e tyre reciproke vetëm në ato fusha ku ligji u jep hapësirë për t'i rregulluar ato.

1050.2. Paragrafi i dytë i këtij neni saktëson se e vlefshme është edhe ujdia për pasojat pasurore (çështjet e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me veprë penale) edhe te çështjet penale. Kështu, mund të thuhet se kjo mundësi u jepet palëve në rastet kur kanë të drejtë të shtrojnë kërkesë për realizmin e kërkesës pasurore-juridike që rrjedh nga një veprë e caktuar penale. Në këtë kuptim, mund të vërehet se palët janë të kufizuara të arrijnë ujdi vetëm sa u përket kërkesave pasurore juridike.

1050.3. Paragrafi i tretë i këtij neni parashikon një rregull detyruese për sa i përket mundësisë që në marrëdhëniet statusore palët të arrijnë ujdi. Kështu, ky paragraf

përrjashton mundësinë që marrëdhëniet statusore të jenë objekt i ujdisë, duke përrjashtuar kështu çdo mundësi të palëve të arrijnë ujdin për marrëdhëniet statusore. Prandaj, ujdin që arrihet ndërmjet palëve për sa u përket marrëdhënies statusore është absolutisht e pavlefshme; (për pavlefshmërinë absolute të objektit të kontratës, shih kometimin e nenit 35 të këtij Ligji).

Neni 1051. Zbatimi i dispozitës për kontratat e dyanshme

- 1. Për kontratën për ujdin vlejnë dispozitat e përgjithshme mbi kontratat e dyanshme, në qoftë se për atë nuk është parashikuar diçka ndryshe.**
- 2. Në rastet kur në emër të ujdisë kontraktuesit kryejnë ndonjë punë tjetër, në ato marrëdhënie të tyre nuk zbatohen dispozitat e ligjit të cilat vlejnë për ujdin, por ato të cilat vlejnë për punën e kryer.**

1051.1. Nga sa u diskutua më lart për ujdin, u pa se marrëveshja ose kontrata e ujdisë arrihet kur që të dyja palët sakrifikojnë diçka nga interesat e pretenduara, ashtu që, duke bërë kompromise të caktuara, arrijnë të përfundojnë në ujdin. Në këtë kuptim, pasi që të dyja palët sakrifikojnë diçka nga interesat e tyre pasurore, mund të përfundohet se kjo marrëdhënie ndërmjet palëve është me interes pasuror të ndërsjellë, gjë që ngjan shumë me kontratat e dyanshme dhe me shpërblim, të cilat, po ashtu, manifestohet interesi pasuror i ndërsjellë i palëve. Për shkak të ngjashmërisë që ekziston me këtë rast, paragrafi i parë i këtij neni saktëson rregullën se për ujdin vlejnë dispozitat e përgjithshme mbi kontratat e dyanshme (me shpërblim), në qoftë se për këtë nuk është parashikuar diçka tjetër, kështu që qëllimi i rregullave ligjore të kontratave të dyanshme dhe me shpërblim është të ruhet drejtshmëria dhe ekuivalenca reciproke e prestimeve të ekzekutuara ndërmjet vetë palëve të kontratave në fjalë.

1051.2. Paragrafi i dytë përcakton rregullën se, në rast se palët kanë përcaktuar marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në kontratën e ujdisë, por në emër të ujdisë kryejnë një punë tjetër, atëherë në ato marrëdhënie nuk zbatohen dispozitat e veçanta që vlejnë për ujdin, por dispozitat e tjera të LMD, të cilat vlejnë për punën e kryer ndërmjet palëve.

Neni 1052. Dëmtimi i pamasë

Për shkak të dëmtimit të pamasë nuk mund të kërkohet anulimi i ujdisë.

1052. Si rregull, dëmtimi i pamasë është shkak i pavlefshmërisë relative të kontratës, ashtu që pala e dëmtuar ta kontratat me shpërblim (nëse janë plotësuar kushtet për zbatimin e rregullave të dëmtimit të pamasë) mund të kërkojnë nulitetin e kontratës dhe shpërblimin e dëmit. Mirëpo rregulla që zbatohet të kontratave të dyanshme dhe me shpërblim përbën një përrjashtim që nuk zbatohet dhe nuk ndikon në anulimin e ujdisë së arritur nga palët

kontraktuese. Kjo do të thotë se, në qoftë se në detyrimet kontraktuese mes palëve dëmtimi i pamasë ka ekzistuar në kohën e arritjes së ujdisë, palët nuk mund të kërkojnë anulimin e saj, pasi që konsiderohet se tek ujdia palët bëjnë kompromise të caktuara, prandaj, me anë të marrëveshjes së ujdisë, palët e pranojnë rrezikun juridik të cilit i ekspozohen, kështu që në këto raste nuk ka vend për zbatimin e rregullave të dëmtimit të pamasë. Kjo rregull e parashikuar në nenin 1052 të LMD, shfuqizon rregullën e përgjithshme të përmbajtur në nenin 122 të LMD (që lidhet me dëmtimin e pamasë). Megjithatë, kjo rregull e këtij neni nuk e përjashton zbatimin e rregullave për ekzistimin e mashtrimit (neni 49 i LMD), nëse ato janë të pranishme në marrëveshjen e ujdisë.

Neni 1053. Efekti i ujdisë ndaj dorëzimit dhe pengdhënësit

- 1. Në qoftë se me ujdë është bërë përtëritja e detyrimit, dorëzani lirohet nga përgjegjësia për përmbushjen e tij dhe njëherit shuhet edhe pengu të cilën e ka dhënë ndonjë person i tretë.**
- 2. Dorëzani dhe i treti që kanë dhënë sendin e tyre në peng mbeten edhe më tutje në detyrim, ndërkaq përgjegjësia e tyre mund të zvogëlohet me anë të pajtimit, por jo edhe të rritet, përjashtimisht nëse ata janë dakorduar me pajtimin.**
- 3. Kur debitori me anë të ujdisë pranon kërkesën e kontestueshme, dorëzani dhe pengdhënësi rezervojnë të drejtën që kreditorit t'i paraqesin kundërshtimet nga të cilat debitori me anë të ujdisë ka hequr dorë.**

1053.1. Si rregull, ujdia nuk e përfundon marrëdhënien ekzistuese, edhe pse marrëveshja e re është lidhur. Nga kjo rregull, sipas dispozitës së këtij paragrafi, del se, kur me ujdë përtërihet detyrimi ekzistues, dorëzani lirohet nga përgjegjësia e përmbushjes së detyrimit të përtëritur me pajtim; gjithashtu, nëse arrihet përtëritja me ujdë, shuhet edhe pengu të cilin e ka dhënë ndonjë person i tretë me qëllim të sigurimit të asaj marrëdhënie të mëhershme. Pra, eliminiimi i paqartësive dhe përcaktimi i detyrimeve në një marrëdhënie të kontestuar dhe të pasigurt kontraktuese me anë të ujdisë, krijon efekte të reja në marrëdhënien e re kontraktuese dhe, kështu, i çliron subjektet nga kërkesat siguroese (garantuese dhe të pengut).

1053.2. Në marrëdhëniet e tjera të detyrimit, dorëzani ose penglënësi që kanë dhënë sendin e tyre peng me qëllim të sigurimit të detyrimit, edhe më tej vazhdojnë të jenë të detyruar, nëse palët kanë arritur pajtim. Megjithatë, vëllimi i detyrimit të dorëzimit ose penglënësit, që është arritur me pajtim, mund të zvogëlohet, por jo edhe të rritet. Për rritjen e vëllimit të detyrimit të penglënësit ose dorëzimit, të arritur me pajtim, kërkohet pëlqim i veçantë nga dorëzani, respektivisht penglënësi.

1053.3. Paragrafi i tretë i këtij neni parashikon të drejtën e dorëzimit dhe penglënësit t'ia paraqesin kreditorit kundërshtimet nga të cilat debitori ka hequr dorë me rastin e arritjes së ujdisë, përkatësisht në rastet kur debitori ka pranuar kërkesën e kontestueshme. Duke

pasur për qëllim që të mbrohet pozita dorëzanit dhe pengdhënësit nga përmbajtja e ujdisë që debitori mund ta arrij me kreditorin, paragrafi në fjalë nuk e privon dorëzanin dhe pengdhënësin nga e drejta e kundërshtimit nga i cili debitori ka hequr dorë me anë të ujdisë.

Neni 1054. Ujdia për punën e cila mund të kundërshtohet

- 1. E vlefshme është ujdia për punën juridike, kundërshtimin e së cilës njëra palë mund ta kërkojë, nëse pala në çastin e ujdisë ishte në dijeni për mundësinë e kundërshtimit.**
- 2. Megjithatë, është e pavlefshme pajtimi për punën juridikisht të pavlefshme kur kontraktuesit kanë ditur për pavlefshmërinë, por kanë dashur që këtë ta shmangin me ujdi.**

1054.1. Paragrafi i parë i këtij neni përcakton vlefshmërinë e ujdisë së arritur edhe për ato punë juridike që mund të kundërshtohen nga njëra palë në ujdi (të ashtuquajturat punë të rrëzueshme juridike), nëse me rastin e arritjes së ujdisë pala ishte e vetëdijshme për mundësinë e kundërshtimit të asaj punë juridike. Kjo zgjidhje juridike u mundëson palëve të arrijnë ujdi edhe për punët juridike të kundërshtueshme, përkatësisht të rrëzueshme, ashtu që palët, duke mos kundërshtuar ato, (mbasi kanë marrë dijeni për këtë mundësi), lëshojnë mundësinë e kundërshtimit, duke arritur ujdinë përkatëse.

1054.2. Paragrafi i dytë i këtij neni ka karakter detyrues, ashtu që, sipas përcaktimit të kësaj dispozite, ujdia është e pavlefshme kur palët kanë ditur për punën juridike të pavlefshme, por me anë të ujdisë kanë synuar t'i mënjanojnë ato, p.sh., është e pavlefshme ujdia që ka për qëllim të zëvendësoj një punë juridike absolutisht të pavlefshme.

Neni 1055. Pavlefshmëria e ujdisë

- 1. Ujdia është e pavlefshme, në qoftë se është bazuar në lajthitje të të dy kontraktuesve dhe në qoftë se përmban marrëdhënie juridike e cila në të vërtetë nuk ekziston, si dhe në qoftë se pa lajthitjen e tyre nuk do të kishte asnjë kontest dhe pasiguri midis tyre.**
- 2. E njëjta gjë vlen edhe kur lajthitja e kontraktuesve ka të bëjë me fakte të zakonshme.**
- 3. Heqja dorë nga ky nulitet nuk ka efekt juridik dhe se ajo që është dhënë në emër të ekzekutimit të detyrimeve nga ajo marrëveshje mund të kërkohet që të kthehet.**

1055.1. Paragrafi i parë i këtij neni parashikon pavlefshmërinë e ujdisë për rastet kur ajo ka mundësuar zgjidhjen në bazë të besimit të gabuar të palëve për sa i përket ekzistencës së mosmarrëveshjeve dhe paqartësive lidhur me marrëdhënien e tyre të detyrimit si, p.sh., rastin kur kontrata që më parë është shuar sipas fuqisë së ligjit ose ex lege. Kjo në kuptim të përmbajtjes së këtij paragrafi, në të cilin përcaktohet se ujdia është e pavlefshme kur ajo

është e bazuar në lajthitjen e palëve kontraktuese dhe në qoftë se palët kanë lidhur ujdj për marrëdhënien juridike e cila fare nuk ekziston, si dhe në rastin kur pa lajthitjen e tyre nuk do të kishte asnjë kontest dhe as pasiguri ndërmjet palëve.

1055.2. Paragrafi i dytë i këtij neni zgjeron pavlefshmërinë e ujdisë edhe në rastet kur bëhet fjalë për lajthitjen e palëve kontraktuese në lidhje me fakte të zakonshme. Në këtë kuptim bëhet fjalë për faktet notore, të cilat në praktikë quhen edhe fakte botërisht të njohura, ashtu që në kuptim të këtij paragrafi ujdja është e pavlefshme edhe kur lajthitja e palëve ka të bëjë me këto fakte.

1055.3. Në paragrafin e tretë të këtij neni është parashikuar dispozita detyruese, që e ndalon heqjen dorë nga pavlefshmëria sipas dispozitave të këtij neni ose, për ta thënë ndryshe, ka përjashtuar të drejtën e palëve të heqin dorë nga pavlefshmëria e ujdisë. Pra, sipas përmbajtjes së këtij paragrafi, ajo që është dhënë në emër të ekzekutimit nga ajo marrëveshje e ujdisë (që plotëson kushtet e nulitetit), mund të kërkohet të kthehet në kuptim të dispozitave që kanë të bëjnë me pasurimin e pabazë; (lidhur me pasurimin e pabazë, shih komentimin e neneve 149-202 të LMD-së).

Neni 1056. Nuliteti i një dispozite të ujdisë

Dispozitat e ujdisë interpretohen si tërësi prandaj nëse një dispozitë e vetme është e pavlefshme, atëherë e tërë ujdja është e pavlefshme, përveç nëse nga vetë ujdja shihet qartë se ajo përbëhet nga pjesë të pavarura.

1056. Dispozita e këtij neni parashikon rregullën e interpretimit të ujdisë. Sipas këtij neni, dispozitat e ujdisë interpretohen si tërësi, prandaj kur një dispozitë e vetme e ujdisë është e pavlefshme, atëherë e tërë ujdja është e pavlefshme, përveç nëse nga vetë përmbajtja e saj shihet qartë se ujdja përbëhet nga pjesë të pavarura. Ky është një përjashtim nga rregulla pacta sunt servanda dhe rregullat e përgjithshme për pavlefshmërinë e pjeseshme; (në lidhje me pavlefshmërinë e pjeseshme, shih komentimin e nenit 91 të LMD-së).

PJESA XXX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 1057. Zbatimi i këtij ligji

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

1057. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në rregullimin e marrëdhënieve juridike detyrimore, të cilat kanë lindur që nga momenti kur ky ligj ka hyrë në fuqi e tutje. Ditë e hyrjes në fuqi të këtij ligji është data 20 dhjetor 2013. Dispozitat e këtij Ligji nuk zbatohen në rregullimin e marrëdhënieve juridike që kanë lindë para momentit të hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 1058. Ndërprerja e vlefshmërisë dhe zbatimi i ligjeve tjera

- 1. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/68, për kontratat mbi shitjen e mallrave pushojnë se ekzistuari.**
 - 2. Në kuptim të këtij ligji, e në pajtim me nenin 145 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligj i aplikueshëm për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave është Konventa e Kombeve të Bashkuara për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave**
 - 3. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89), pushojnë se ekzistuari, me përjashtim të dispozitave në vijim: Kreu XXXI, nenet 1035 deri 1046; Kreu XXXII, nenet 1047 deri 1051; Kreu XXXIII, nenet 1052 deri 1060; Kreu XXXIV, nenet 1061 deri 1064; Kreu XXXV nenet 1065 deri 1068; Kreu XXXVI nenet 1069 deri 1071; Kreu XXXVII, nenet 1072 deri 1082; Kreu XXXVIII, nenet 1083 deri 1087; Kreu XXXIX, neni 1088, të cilat përshtatshmërisht do të vazhdojnë të aplikohen përderisa legjislacioni nacional nuk fuqizon ligje, përkatësisht akte tjera nënligjore për rregullimin e të njëjtave.**
 - 4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vepruari edhe dispozitat e ligjeve të mëparshme që kanë rregulluar këtë materie, përveç në rastet kur me këtë ligj është parashikuar ndryshe.**
-

1058.1. LMD ka shfuqizuar dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/68, datë 29 dhjetor 2000, e ashtuquajtura Rregullore për kontratat mbi shitjen e mallrave. Kjo Rregullore ishte, në realitet, një përkthim fjalë për fjalë i tekstit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave.⁹⁰¹ LMD e rregullon me

901 Për më shumë në lidhje me tekstin e Rregullorës së UNMIK-ut për kontratat për shitjen e mallrave vizito veb-faqen si në vijim: < unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_68.htm >; dt. 12.12.2013.

dispozita të veçanta kontratën për shitjen; (shih dispozitat e LMD në lidhje në kontratën për shitjen, duke filluar nga neni 438). Me qëllim të evitimit të mundësisë së kundërshtimit ndërmjet instrumenteve ligjore që rregullojnë një fushë të njëjtë juridike, ky paragraf i LMD urdhëron shfuqizimin e Rregullores së UNMIK-ut në fjalë.

1058.2. LMD u referohet si Ligj në fuqi për kontratat me element të huaj dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Kontratat e Shitjes Ndërkombëtare të Mallrave. Në kuptim të kësaj zgjidhjeje juridike, nëse në vendin tonë trajtohet një çështje kontraktuese me element të huaj dhe si ligj në fuqi referohet ligji në fuqi i vendit tonë, atëherë, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1058, ligj në fuqi për trajtimin e çështjes - marrëdhënies kontraktuese me element të huaj është Konventa e Kombeve të Bashkuara për Kontratat e Shitjes Ndërkombëtare të Mallrave.⁹⁰²

1058.3. LMD, në paragrafin e tretë të këtij neni, saktëson se pjesë të tëra të Ligjit të vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ”, nr. 29/78, 39/85, 57/89), do të vazhdojnë të ngelin në fuqi dhe të paraqesin burim sekondar për rregullimin e disa prej marrëdhënieve të detyrimeve, përderisa ato nuk janë rregulluar me burime tjera primare, (me ligje ose akte nënligjore). Në këtë pjesë kryesisht bëhet fjalë për kontrata dhe punë juridike bankare, të cilat në ekonominë dhe tregun modern kërkojnë një legjislacion bashkëkohor dhe në shumë raste një legjislacion detyrues. Për shkak të veçantive që paraqesin kontratat dhe punët bankare në përgjithësi, duket se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që marrëdhëniet e tilla të detyrimeve, të cilat u referohen kontratave dhe punëve bankare, të rregullohen me ligj ose akt tjetër nënligjor të veçantë. Në këtë pjesë të LMD së vjetër, të cilat paraqesin burim sekondar të LMD pothuajse hyjnë pjesët dhe nenet si në vijim: Kreu XXXI, nenet 1035 deri 1046; Kreu XXXII, nenet 1047 deri 1051; Kreu XXXIII, nenet 1052 deri 1060; Kreu XXXIV, nenet 1061 deri 1064; Kreu XXXV nenet 1065 deri 1068; Kreu XXXVI nenet 1069 deri 1071; Kreu XXXVII, nenet 1072 deri 1082; Kreu XXXVIII, nenet 1083 deri 1087; Kreu XXXIX, neni 1088.

1058.4. Me hyrjen në fuqi të LMD, pushon efekti juridik i dispozitave të ligjeve të mëparshme, me të cilat rregullohej ky lëmë, përveç në rastet kur në këtë ligj është parashikuar ndryshe. Këtu në radhë të parë është fjala për pushimin e dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të ish-RSFJ (i shpallur në “Gazeta Zyrtare e RSFJ”, nr. 29/78, 39/85, 57/89), si ligj i vjetër qëi ishte në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij LMD. Pra, LMD i vjetër pushon së ekzistuari, përveç përjashtimeve të theksuara në paragrafin e tretë të këtij neni, të cilat u vunë në dukje më sipër dhe që mund të paraqesin burim sekondar të rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve.

902 Për versionin në gjuhën shqipe të Konventës së Kombeve të Bashkuara për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave shih veb-faqen si në vijim: < <http://cisg7.institut-e-business.de/pdf/Textsammlung/textsammlung-albanisch.pdf>>; dt. 12.12.2013.

Neni 1059. Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës”.

1059. LMD është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në datën 10.5.2012; është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës në datën 30.5.2012 - dekreti nr. DL-024-2012; ky Ligj u shpall në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” në datën 19.6.2012; pra, ky Ligj ka hyrë në fuqi gjashtë muaj pas shpalljes, kështu që si ditë e hyrjes në fuqi të LMD konsiderohet data 20 dhjetor 2012.

BIBLIOGRAFIA

- Alishani, Alajdin, E drejta e Detyrimeve (pjesa e përgjithshme, Prizren, 1989
- Alishani, Alajdin, Odgovornost za materijalne nedostatke stvari, Beograd, 1996
- Aliu, Abdulla, Burimet e së drejtës civile në Kosovë, Prishtinë, 1999
- Aliu, Abdulla, E Drejta Civile, Prishtinë, 2013
- Aliu, Abdulla, E Drejta Sendore, Prishtinë, 2013
- Blagojević, Borislav, Borislav, Pravna Enciklopedija, Beograd, 1979
- Blagojević, Borislav, Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I, Beograd, 1980
- Blagojević, Borislav, Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II, Beograd, 1980
- Brestovci, Faik, E drejta e procedurës civile II, Prishtinë, 2004
- Brestovci, Faik E drejta e procedurës civile I, Prishtinë, 2006
- Bukljash, Ivan, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima,
- Crnić, Ivica, Zakon o Obveznim Odnosima sa komentarom i sudskoam praksom, Zagreb, 2012
- Ćesić dhe të tjerë, Komentar Zakon O Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005
- Dauti, Nerxhivane, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2001
- Dimitar, Pop Georgiev, Obligaciono Pravo, Shkup, 1990
- Galgano, Francesko, E drejta private, Tiranë, 1999

- Gashi, Haxhi & Aliu, Abdulla & Vokshi Adem, Komentar i Ligjit për Familjen i Kosovës, botimi I, Prishtinë 2012
- Gorenc, Vilim & Slakoper Zvonimir, Opci Dio Obveznog Prava, Zagreb, 2004
- Gorenc, Vilim, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005
- Krsmanoviq, Tomislav, Aktuelna sudska praksa iz obligacionih odnosa, Beograd, 2000
- Latifi, Juliana, E drejta civile, pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2005
- Morina, Iset & Nikçi Selim, Komentari i Ligjit të Procedurës Kontestimore, botimi I, Prishtinë 2012
- Nuni, Ardian, E drejta civile, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2009
- Skrame, Olti, Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Vëllimi i parë dhe i dytë, Tiranë, 2011
- Skrame, Olti, Komentar i Kodit Civil, Vëllimi 2, Tiranë, 2011
- Stankoviq, Obren, Novcana naknada neimovinske stete, Beograd, 1965
- Stankoviq, Obren, Naknada za pojacane napore i za umanjenje zivotne aktivnosti, Beograd, 1972
- Veljković, Dragoslav, Obligaciono Pravo, Beograd 2005
- Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat – Pjesa e posaçme, Dalloz, 2006
- USAID, Programi i sistemit të përmbartimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Forma standarde e agro-kontratës për shitjen, me komentarin ligjor dhe udhëzuesin për përdorim të përgjithshëm, Prishtinë, 2012

KODE DHE LIGJE

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i vitit 1994, Ligji nr. 7850, dt. 29.07.1994
- Code Civile, 101 Edition, Dalloz, 2002
- Kodi Civil i Përgjithshëm i Gjermanisë i vitit 1900
- Ligji Nr.04/L-21 për Mbrojtjen e Konsumatorit i Kosovës, Gazeta Zyrtare nr.32, datë 20 nëntor 2012
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Malit të Zi, (“Sl. List Crne Gore”, br. 07/48, 07.08.2008.
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Kroacisë, Narodne Novine br. 35/05 dhe 41/08 dt. 9 travnja 2008.
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës
- Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore i Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.57, datë 04 Gusht 2009
- Švajcarski zakonik o obligacijama, Od 30. Marta 1911, sa izmenama i dopunama izvršenim do 1 januara 1976, Bg, 1976
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008)
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/13, dt. 4 mars 2005 “Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme shoqërore, që administrohet nga komunat në Kosovë”
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i miratuar me Ligjin nr. 7850, dt. 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr. 8536, dt. 18.10.1999 dhe nr. 8781, dt. 03.05.2001
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-007, u shpall në Gazetën Zyrtare më 19 qershor 2012, në fuqi nga 20 dhjetor 2013
- Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës. nr. 38/2008, datë 30 shtator 2008
- Ligji i Procedurës Jokontestimore, nr. 03/L-007, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 45/2009, datë 12 janar 2009
- Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-082, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 19, datë 13 korrik 2012

- Ligji i Familjes i Kosovës, nr 2004/26, Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve, nr. 4/2006 dt. 1 shtator 2006
- Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, nr. 2004/26, Gazeta zyrtare e IPVQ-ve nr. 3/2006 datë 1 gusht 2006
- Ligji 03/L-008 për Procedurën Përmbartimore, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 33/15 Korrik 2008; Ligji i ri në vitin 2012
- Ligji i Punës, nr. 03/L-212, Gazeta zyrtare e R. së Kosovës 90/01, dhjetor 2010
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, nr. 03/L-006, Gazeta zyrtare e R. së Kosovës nr. 57/04, gusht 2009
- Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 13/01, shtator 2011
- Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes
- Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës
- Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia
- LSDAP Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia
- Ligji për Familjen i Kosovës nr. 2004/26 Gazeta Zyrtare e IPVQ nr. 4/2006 e dt. 01.09.2006
- Ligji për Trashëgiminë i Kosovës nr. 2004/26 Gazeta Zyrtare e IPVQ nr. 3/2006 e dt. 01.08.2006
- Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Ligji 04/L-018 i dt. 23 qershor 2011 i shpallur me dekretin nr. DL-003-2011, datë 5.7.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e RK, nr. 4, dt. 14 korrik 2011
- Ligji për Noterinë 03/L-010 i dt. 17.10.2008 i dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekretin DL-053 -2008, dt. 6.11.2008 dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Noterinë 04/L-002 i dt. 21.7.2011
- Ligji për Avokatinë 04/L-193 i dt. 02.05.2013 i dekretuar nga ana e PRK me dekretin DL-25-2013, dt. 21.5.2013
- Ligji anglez për Sigurimet i vitit 1774
- Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dt. 16.8.2010
- Rregullorja e BQK për Sigurimin e Jetës, dt. 17.12.2007

Ligjet e vendeve tjera

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Malit të Zi
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Kroacisë
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës

VENDIME GJYQËSORE

- Aktgjykimi i Gjykatës së Rrethit në Varazhdin : Županijski sud u Varaždinu, Gž. 566/03-2 od 06. svibnja 2003
- Aktgjykimi i Gjykatës së Rrethit në Varazhdin : Županijski sud u Varaždinu, Gž. 1074/08-2 od 04.08.2008
- Aktgjykimi i Gjykatës së Rrethit në Varazhdin : Županijski sud u Varaždinu, Gž. 2122/04 od 07.03.2005
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Zagreb, Gžn. 1481/10 od 22. ozujka 2011
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Zagreb, Gžn-1737/09 od 27. Trvanja 2011
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 402/2008, dt. 07.10.2011
- Aktgjykimi i Gjykatës së lartë Ekonomike në Beograd, Ae. nr. 4001/88
- Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë Ekonomike në Beograd, Ae. nr. 1142/95
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Vojvodinës, Ae. nr. 475/91
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Serbisë, Ae. nr. 105/85
- Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë Ekonomike të RK, AE-1317/93, dt. 4 janar 1994
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të RK, Rev. nr. 383/88, dt. 5 tetor 1988
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac. nr. 868/2006, dt. 14.2.2008
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, C. nr. 815/2002, dt. 31.3.2006
- Vendimi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 46-1301, datë 3.7.2009
- Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Përmbledhje vendimesh të Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndët pronësore, 2011

- Qendra Juridike e Kosovës Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, 2004 – 2005
- Qendra Juridike e Kosovës Buletini i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, korrik – shtator 2005
- Buletini i Praktikës Gjyqësore – Gjykata Supreme e Kosovës – vëllimi 1, 2011
- Buletini i Praktikës Gjyqësore për gjykatat e qarkut Kosovë vëllimi 1, 2011
- Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2000-2001
- Vendimi i Gjykatës së Apelit të Republikës së Shqipërisë, nr. 1177, dt. 16.05.2012
- Vendimi i Gjykatës Supreme të RK, Rev. nr. 1350/91, datë 17 tetor 1991
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të R K, nr. U-III-1006/1998, dt. 14 qershor 2001
- Vendimi i Gjykatës së Lartë të RK, Rev. nr. 3009/2000-2, dt. 4 shkurt 2004
- Vendimi i Gjykatës së Lartë të RK, Rev. nr. 1070/98, dt. 17. 12.2001
- Vendimi i Gjykatës së Lartë të RK, Rev 119/1997, dt. 28.01.1998
- Vendimi i Gjyk. Supr. e Kos. Prishtinë, Rev. I. nr. 278/2008

SHKURTESAT

BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Gjyk. Sup. BH	Gjykata Supreme e Bosnjës dhe Hercegovinës
Gjyk. Sup. Fed.	Gjykata Supreme e ish Federatës Jugosllave
Gjyk. Supr. e Kos.	Gjykata Supreme e Kosovës
Gjyk. Sup. Kr.	Gjykata Supreme e Kroacisë
Gjyk. Sup. Serb.	Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë
Gjyk. Sup. Voj.	Gjykata Supreme e Vojvodinës
KCF	Kodi Civil Francez
KCRSH	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
KCZ	Kodi Civil Zviceran
KPK	Kodi Penal i Kosovës LMD Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve Kontestimore
LCKSHF	Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes
LFK	Ligji i Familjes i Kosovës
LMD	Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve
LMDBH	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Bosnjës dhe Hercegovinës
LMDMZ	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Malit të Zi
LMDRKR	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Kroacisë
LMDRS	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Serbisë
LP	Ligji i Punës
LPDS	Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore
LPJ	Ligji i Procedurës Jokontestimore
LPK	Ligji i Procedurës
LSPMSHPAP	Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës
Nar. Nov.	Kroatisht “Narodne novine” (Gazeta popullore),
PRK	Presidenti i Republikës së Kosovës
RK	Republika e Kroacisë
R. Kos.	Republika e Kosovës
Rev.	Shenja e vendimit të gjykatës sipas mjetit juridik të jashtëzakonshëm – revizionit
ZOO	Zakon o Obveznim (Obligacionim) Odnosima - emërtim i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në gjuhën kroate, përkatësisht serbe

